



PROKURORIA E PËRGJITHSHME

**PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE
UNIFIKUESE PENALE**

1999-2015

PASQYRA E LËNDËS

1. Vendim Unifikues nr. 3, datë 02.11.2015 – Vjedhja e pasurisë së bankave, gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave për administrimin apo ruajtjen e kësaj pasurie	3
2. Vendim Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015 – Lirimi me kusht.....	33
3. Vendim Unifikues nr.1, datë 27.04.2015- Mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv.....	66
4. Vendim Unifikues nr.2, datë 03.11.2014 – Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit.....	90
5. Vendim Unifikues nr.1, datë 10.03.2014 - Gjykimi në mungesë i të pandehurit.....	109
6. Vendim Unifikues nr.3, datë 08.07.2013 – Pozicioni procedural i të pandehurit në gjykimin rishikues.....	132
7. Vendim Unifikues nr.2, datë 20.06.2013 – Pushimi i çështjes ose akuzës.....	145
8. Vendim Unifikues nr.1, datë 19.06.2013 – Rivendosja në afat e ankimit dhe rekursit.....	164
9. Vendim Unifikues nr.7, datë 14.10.2011 - Caktimi i masës së sigurimit.....	182
10. Vendim Unifikues nr.6, datë 30.09.2011 – Konkurrimi i veprës penale të “Vjedhjes me pasojë vdekje” me “Vjedhjen me dhunë” dhe “Vjedhjen me armë”	204
11. Vendim Unifikues nr.4, datë 15.04.2011 – Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale.....	219
12. Vendim Unifikues nr.3, datë 24.01.2011 - Trafikimi i narkotikëve mbetur në tentativë.....	232
13. Vendim Unifikues nr.2, datë 24.01.2011 - Caktimi i trupit gjykues me short.....	249
14. Vendim Unifikues nr.1, datë 20.01.2011 – Gjykimi në mungesë.....	266
15. Vendim Unifikues nr.5, datë 15.09.2009 - Nënshkrimi i rekursit nga mbrojtësi.....	283
16. Vendim Unifikues nr.4, datë 24.06.2009 – Ankimi ndaj masës së sigurimit të caktuar në mungesë.....	289
17. Vendim Unifikues nr.2, datë 06.02.2009 - Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.....	297
18. Vendim Unifikues nr.1, datë 08.01.2009 - Zbatimi i masës së sigurimit personal.....	311
19. Vendim Unifikues nr.1, datë 27.03.2008 – Përcaktimi i sasisë së lëndës narkotike për përdorim personal.....	325
20. Vendim Unifikues nr.1, datë 25.01.2007 - Ligji 9284/2004.....	330
21. Vendim Unifikues nr.1, datë 25.03.2005 – Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, heqja e paligjshme e lirisë dhe vetgjyqësia	349
22. Vendim Unifikues nr.2, datë 30.06.2004 – Zbatimi i ligjit penal ushtarak ndaj punonjësit të burgjeve.....	361
23. Vendim Unifikues nr.1, datë 16.04.2004 – Kompetenca lëndore e gjykatës për krime të rënda.....	468
24. Vendim Unifikues nr.6, datë 11.11.2003 – Llogaritja e afateve të paraburgimit.....	379
25. Vendim Unifikues nr.5, datë 11.11.2003 – Pasoja e rëndë në vjedhjen e pasurisë.....	388
26. Vendim Unifikues nr.4, datë 27.03.2003 – Ligji penal favorizues	396
27. Vendim Unifikues nr.3, datë 27.03.2003 – Kompensim për burgim të padrejtë.....	401
28. Vendim Unifikues nr.2, datë 29.01.2003 – Gjykimi i shkurtuar	411
29. Vendim Unifikues nr.1, datë 30.01.2003 – Njohje e vendimit penal	419

30. Vendim Unifikues nr.4, datë 14.10.2002 – Funksionet e prokurorit.....	431
31. Vendim Unifikues nr.2, datë 14.10.2002 –Rivendosja në afat.....	439
32. Vendim Unifikues nr.7, datë 11.10.2002 – Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit	448
33. Vendim Unifikues nr.6, datë 11.10.2002 – Rishikimi i vendimit.....	456
34. Vendim Unifikues nr.5, datë 10.10.2002 – Ankimi ndaj vendimit që ka njohur vendimin e huaj.....	465
35. Vendim Unifikues nr.3, datë 27.09.2002 – Marrja e cilësisë së të pandehurit.....	474
36. Vendim Unifikues nr.1, datë 12.03.2002 – Kontrabanda dhe konkurimi me shpërdorimin e detyrës.....	488
37. Vendim Unifikues nr.2, datë 19.04.2001 - Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.....	503
38. Vendim Unifikues nr.1, datë 15.02.2001 – Thirrja e të pandehurit.....	511
39. Vendim Unifikues nr.371, datë 27.10.2000 – Gjykimi në mungesë	518
40. Vendim Unifikues nr.284, datë 06.10.2000 – Krimi vazhdues.....	532
41. Vendim Unifikues nr.154, datë 15.04.2000 – Zbatimi i ligjit penal shqiptar për shtetasit shqiptar që kanë kryer vepër penale në territorin e një shteti tjetër.....	539
42. Vendim Unifikues nr.354, datë 28.07.1999 – Gjykimi në mungesë.....	546
43. Vendim Unifikues nr.30, datë 28.01.1999 – Gjykimi në mungesë i të miturit	550

Nr. 3 i Regj. Themeltar
Nr. 3 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 02.11.2015, mori në shqyrtim çështjen penale me:

TË GJYKUAR: **GJERGJI XHAHO**, *përfaqësuar nga Av. Sonila Çekrezi*

GJYKUAR PËR: *Veprën penale të “Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit” me pasoja të rënda dhe “Falsifikim i dokumenteve” më shumë se një herë.*

BAZA LIGJORE: *Neni 136/2 dhe 186/2 i Kodit Penal.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.76 datë 23.02.2012, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjergji Xhaho për kryerjen e veprës penale të “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit” me pasoja të rënda dhe në bazë të nenit 136/2 të Kodit Penal dënimin e tij me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjergji Xhaho për kryerjen e veprës penale të “Falsifikim i dokumenteve” me shumë se një herë dhe në bazë të nenit 186/2 të K.Penal dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim dhe me gjobë në masën 900.000 lekë.
- Në zbatim të nenit 55/1, 2 të K.Penal në bashkim të dënimeve, të caktohet si dënim i vetëm për të pandehurin Gjergji Xhaho, dënimi me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim dhe me gjobë në masën 900.000 lekë.

- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet dënimi me 1/3 dhe përfundimisht, i pandehuri do të dënohet me 12 vjet burgim dhe 6.000.000 lekë gjobë.
- Vuajtja e dënimit me burgim do të fillojë nga data e ndalimit data 28.12.2010, kurse gjoba do të paguhet brenda 2 vjet nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.”

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.715, datë 20.12.2012, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.76, datë 23.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për sa i përket kualifikimit të veprës penale dhe masës së dënimit në këtë mënyrë.

- Të deklarohet fajtor i pandehuri Gjergji Xhaho për veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” dhe sipas nenit 135 të K.Penal e dënon me 10 (dhjetë) vjet burgim, duke filluar dënimi nga data 28.12.2010.
- Urdhërohet zbritja e 1/3 e dënimit në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale.
- Prishjen e vendimit të mësipërm për të dhe pushimin e çështjes për sa i përket aplikimit të dënimit me gjobë.

Kundër këtij vendimi, më datë 21.01.2013, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit Vlorë, me anë të të cilit kërkon: *Prishjen e vendimit nr.715, datë 20.12.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.76, datë 23.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.*

Duke paraqitur këto shkaqe:

- Arsyetimi i Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me teorinë dhe praktikën e deritanishme gjyqësore. Ky arsyetim prek bazat dhe parimet e legjislacionit penal të përcaktuara posaçërisht në nenet 1/a dhe 1/c të Kodit Penal.
- Vjedhja duke shpërdoruar detyrën, është një vepër penale që merr në mbrojtje çdo lloj pasurie, por që objekt i saj nuk janë bankat, për sa kohë ka një dispozitë të posaçme që merr në mbrojtje këtë lloj pasurie.
- Ligjvënësi i ka kushtuar rëndësi të veçantë përcaktimit të figurave konkrete të veprave penale duke u nisur nga ana objektive por edhe objektit të veprave penale.
- Edhe pse subjekti në rastin konkret është i posaçëm, pasi personi ka qenë punonjës në këtë bankë, kjo nuk e përjashton atë nga të qenit subjekt i veprës penale “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit”, pasi kjo vepër penale ka subjekt të përgjithshëm, çka do të thotë që aty përfshihet edhe subjekti i posaçëm. Është pikërisht vendi ku realizohet vjedhja (banka) që e dallon këtë figurë krimi nga vjedhjet e tjera.
- E njëjta gjë mund të thuhet nëse subjekti i posaçëm (ai që ka në administrim pasurinë e bankës), duke përfituar nga detyra e tij të siguronte kopje të çelësave dhe bashkë me persona të tjerë të realizonte vjedhjen nga jashtë të kësaj banke që ai ka administrim apo në përkujdesje të veçantë. Po kështu, roja i bankës (që mund të jetë edhe punonjës i një subjekti tjetër) por që ka në ruajtje këtë pasuri, do të përgjigjej në bazë të nenit 136 të K.Penal edhe pse si subjekt i posaçëm veprimet i ka kryer duke pasur në ruajtje pasurinë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se ka interpretime jo të njëjta në lidhje me cilësimin e veprës penale në rastet e vjedhjes së bankave, në seancën gjyqësore të datës 29.04.2015, në bazë të nenit 17, shkronja “a” të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, vendosi për njësimin e praktikës gjyqësore të kalojë në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çështjen penale që i përket të gjykuarit Gjergji Xhaho.

Çështjet që shtrohen për diskutim, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore, çmohen të jenë:

- 1. Personi, i cili vjedh pasurinë e bankave apo të arkave të kursimit, gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave për administrimin apo ruajtjen e kësaj pasurie, do të përgjigjet për veprën penale të “Vjedhjes së bankave apo arkave të kursimit” parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal apo “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal?
- 1.a. Personi punonjës i bankës që kryen një detyrë në administrimin apo ruajtjen e kësaj banke, i cili vjedh pasurinë e bankave apo të arkave të kursimit, duke përdorur, dhunë, mbajtur armë a municion, apo shkakton vdekjen e një personi, për cilën nga veprat do të përgjigjet?
- 1.b. Personi, i cili ushtron dhunë për vjedhjen e pasurisë bankare apo të arkave të kursimit apo nën kërcënimin dhe përdorimin e armëve, apo duke sjellë si pasojë të rëndë vdekjen e personave të tjerë, kryer në bashkëpunim me personin gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave në administrimin apo ruajtjen e pasurisë së bankave, për cilat vepra do përgjigjet, sipas nenit 135 dhe 25, apo nenit 136/2, apo nenit 139 dhe 25, apo nenit 140 dhe 25, apo nenit 141 dhe 25 të Kodit Penal?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarit Artan Zeneli dhe atë të gjyqtares Majlinda Andrea; Prokurorin Arqilea Koça, që kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale dhe masës së dënimit në lidhje me veprën penale të vjedhjes e për pasojë, dhe masën e dënimit përfundimtar me burgim, duke lënë në fuqi për këtë pjesë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për dënimin me gjobë; dëgjuan mbrojtësen e të gjykuarit, Av. Sonila Çekrezi, e cila kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë; si dhe pasi shqyrtuan në tërësi çështjen,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e faktit

1. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore rezulton se i gjykuari Gjergji Xhaho nga data 08.05.2005 deri në datë 17.11.2010 ka qene në punë pranë Alfa Bank dega Fier, fillimisht me detyrën e oficerit të kredisë, më pas me detyrën e drejtorit të kësaj banke dhe nga data 02.08.2010 me detyrën e oficerit të kredisë, po pranë kësaj banke, ku dhe është pushuar nga puna.
2. Nga ana e Drejtorit të Alpha Bank Albania, Tiranë z.Andreas Galatoulas është bërë kallëzim për ndjekje penale ndaj të gjykuarit Gjergji Xhaho pasi, ky shtetas duke kryer tërheqje, derdhje apo transferta bankare në mënyrë të pa autorizuar dhe me qëllim

- përfitimi personal i ka sjellë bankës një dëm ekonomik në shumën 1.300.000 (një milion e treqind mijë) euro.
3. Ky kallëzim ka marrë shtytje për shkak të shqetësimeve të vazhdueshme të klientëve të Alpha Bank dega Fier, të cilët ose i kanë gjetur të prekura në mënyrë të pa autorizuar llogaritë e tyre bankare ose nuk kanë gjetur në këto llogari asnjë vlerë monetare të depozituar.
 4. Kështu, në muajin qershor të vitit 2010 në sportelin ku punonte deklaruesja Mariola Zariu në shërbim klientit të Alpha BANK dega Fier, është paraqitur motra e shtetasës Vasilika Kandari e cila kishte llogari dyshe me të motrën. I ka kërkuar që të mbyllte depozitën me afat, por ka konstatuar një gjendje minimale në llogari 50 euro, të cilat ishin shumë herë më pak se çfarë ajo pretendonte. Kjo shtetase e nervozuar ka filluar të flasë me zë të lartë derisa aty është afruar i gjykuari Gjergji Xhaho, i cili ishte supervizori i bankës dhe ka biseduar me zë të ulët me të; bisedë, e cila nuk është dëgjuar nga deklaruesja Marjola Zariu. I gjykuari Gjergji Xhaho më pas e ka ulur në sportelin e tij motrën e shtetasës Vasilika Kandari, kurse deklaruesja Marjola Zariu vuri në dijeni për këtë ngjarje drejtorin Klodian Mahilaj.
 5. Në mesin e muajit korrik të vitit 2010 në sportelin ku punonte deklaruesja Marjola Zariu është ulur shtetasi Janaq Samara, emigrant prej vitesh në Kanada, i cili kishte një llogari dyshe në bankë me shtetasin Ferdinand Ferko, dhe i ka kërkuar deklarueses t'i bënte një përmbledhje të llogarisë së vet.
 6. Deklaruesja pasi ka kryer verifikimet në sistem ka konstatuar se ky klient kishte një gjendje minimale në llogari 50 euro. Ky fakt është kundërshtuar nga deklaruesi Janaq Samara i cili ka pretenduar se kishte gjendje në llogari pranë Alpha Bank 63.000 euro dhe 500.000 lekë, dhe për këtë dispononte një printim të para dy muajve nga i pandehuri Gjergji Xhaho. Nga verifikimet e bëra nga deklaruesja Marjola Zariu në përmbledhësen e transaksioneve të kryera në emër të Janaq Samarës rezultonte se ishin kryer në emër të tij 5 deri në 6 transaksione në emra që vetë Janaqi nuk i njihte dhe të bëra në data të ndryshme. Pasi ka biseduar me drejtorin Klodian Mahilaj, mbi bazën e kërkesës së klientit Janaq Samara, deklaruesja Mariola Zariu i ka vënë në dispozicion të gjitha mandatet e transaksioneve të kryera, dhe pasi u njoh me to ky shtetas ka deklaruar se në asnjë nga këto mandate firma nuk ishte e tij gjë që sipas deklarueses ishte e vërtetë pasi dallohej me sy të lirë që nuk ishte firma e tij, por dhe se për periudhën që ishin kryer veprimet bankare deklaruesi Janaq Samara ishte në Kanada dhe jo në Shqipëri.
 7. Të njëjtat veprime i gjykuari Gjergji Xhaho ka kryer edhe ndaj deklaruesit Arben Fejzo, i cili ka pasur llogari dyshe pranë Alpha Bank me shtetasin Vladimir Faria, ku pa i marrë asnjë miratim i ka tërhequr atij nga llogaria një sasi të hollash të cilat më pas në kushtet e këmbënguljes së këtij deklaruesi për t'ia kthyer, në kushtet kur ai ishte nën kontrollin e auditit ia ka kthyer nëpërmjet një mikut të tij në Greqi. Dy ditë para se i gjykuari Gjergji Xhaho të kthehej nga leja, në degën Fier ka ardhur dhe Drejtori i të gjithë rrjetit të Alpha Bank, Genci Zyrbo, i cili është takuar me vetë drejtorin e degës Klodian Mahilaj. Ditën kur i gjykuari Gjergji Xhaho është kthyer në punë nga leja, ka ardhur dhe audit i Alpha Bank, të cilët kanë filluar të kontrollojnë dokumentet dhe më pas, ka ardhur dhe përfaqësuesi i auditit nga Greqia, ku është dhe banka mëmë, nga ku rezultoi jo vetëm vjedhja e bankës në këto raste, por dhe në mjaft raste të tjera të evidentuara në raportin special të auditit.
 8. Në raportin e auditit është përcaktuar se i gjykuari ka përvetësuar shumën prej 1.684.443.06 euro.

- Konkretisht në periudhën 31.03.2008 - 28.06.2010, i gjykuari Gjergji Xhaho ka kryer 61 mbyllje të parakohshme të depozitave me afat të klientëve që përgjithësisht jetonin jashtë shtetit, ka përvetësuar shumën e mësipërme nga 50 llogari klientësh, depozita me afat e të cilëve ishin prishur para kohe për t'i përfituar ai vetë në mënyrë të paligjshme. Për të kryer vjedhjen e mësipërme i gjykuari gjatë periudhës 04.07.2008 - 04.07.2010 ka kryer 106 transferta të brendshme në vlerën 1.279.812.71 euro, nga kompjuteri i tij duke debituar llogarinë e mësipërme, ndërsa falsifikonte firmat e klientëve në mandate.
9. Gjatë periudhës 13.09.2007-13.01.2010, nëpërmjet arkëtareve, të cilat kanë deklaruar se kanë vepruar me mirëbesim, ka kryer 44 transaksione tërheqjesh në vlerën 404.630.35 euro nga llogaritë e mësipërme, pa prezencën e klientëve në Degë.
 10. Nga akti i ekspertimit teknik - vlerësues ekonomik datë 27.07.2011, konfirmon se: i gjykuari Gjergji Xhaho për periudhën 2007-2010 në Degën e Alpha Bank Fier ka falsifikuar nënshkrime të titullarëve të llogarive dhe ka kryer 61 mbyllje të parakohshme të 7 depozitave me afat nga kompjuteri i tij, me vlerë ekuivalente në euro 1.512.230 pa dijeninë dhe prezencën e klientëve ka falsifikuar nënshkrimet e titullarëve të llogarive dhe ka kryer 106 transaksione, transferta të brendshme me vlerë 1.279.812 euro, për disa transaksione që tejkalojnë të drejtën për të dhënë autorizim elektronik për kryerjen e transaksionit ka përdorur të drejtën e tij si drejtor dege, nga i pandehuri Gjergji Xhaho për shumën 1.279.812 euro, janë kryer transferta me mandat urdhër pagese të brendshme, nga llogaritë rrjedhëse të disa klientëve të tjerë brenda degës së Alpha Bank. Nënshkrimet në këto mandate janë të falsifikuara, nga arkëtarët, i pandehuri Gjergji Xhaho ka mundur të përvetësojë shumën prej 404.630 euro, të cilat janë tërhequr CASH, prej arkëtarëve, direkt nga llogaritë e klientëve.
 11. Në total llogaritë rrjedhëse të klientëve janë debituar për shumën 1.684.443 euro me mandate të falsifikuara, pa dijeninë dhe prezencën e klientëve në bankë.
 12. Në analizë të akteve të mësipërme shkresore dhe shkencore, gjykata e shkallës së parë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka konkluduar se i pandehuri ka kryer veprën penale të “Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit” me pasoja të rënda dhe “Falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga nenet 136/2 dhe 186/2 të Kodit penal.
 13. Ndërsa Gjykata e Apelit, ka arritur në konkluzionin se i gjykuari ka kryer veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal.

II. Procedura gjyqësore

14. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**, me vendimin nr.76 datë 23.02.2012, ka vendosur:
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjergji Xhaho për kryerjen e veprës penale të “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit” me pasoja të rënda dhe në bazë të nenit 136/2 të Kodit Penal dënimin e tij me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.
 - Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjergji Xhaho për kryerjen e veprës penale të “Falsifikim i dokumenteve” më shumë se një herë dhe në bazë të nenit 186/2 të K.Penal dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim dhe me gjobë në masën 900.000 lekë.
 - Në zbatim të nenit 55/1, 2, të K.Penal në bashkim të dënimeve, të caktohet si dënim i vetëm për të pandehurin Gjergji Xhaho, dënimi me 18 (tetëmbëdhjete) vjet burgim dhe me gjobë në masën 900.000 lekë.
 - Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet dënimi me 1/3 dhe përfundimisht, i pandehuri do të dënohet me 12 vjet burgim dhe 6.000.000 lekë gjobë.

- Vuajtja e dënimit me burgim do të fillojë nga data e ndalimit data 28.12.2010, kurse gjoba do të paguhet brenda 2 vjet nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.”

15. **Gjykata e Apelit Vlorë**, me vendimin nr.715, datë 20.12.2012, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.76, datë 23.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për sa i përket kualifikimit të veprës penale dhe masës së dënimit në këtë mënyrë:

- Të deklarohet fajtor i pandehuri Gjergji Xhaho për veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” dhe sipas nenit 135 të K.Penal e dënon me 10 (dhjetë) vjet burgim, duke filluar dënimi nga data 28.12.2010.
- Urdhërohet zbritja e 1/3 e dënimit në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale.
- Prishjen e vendimit të mësipërm për të dhe pushimin e çështjes për sa i përket aplikimit të dënimit me gjobë.

16. **Kundër këtij vendimi**, më datë 21.01.2013, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit Vlorë, me anë të të cilit kërkon: *Prishjen e vendimit nr.715, datë 20.12.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.76, datë 23.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkaqe si në pjesën hyrëse të vendimit.*

Me arsyetimi se:

Gjykata e Apelit e shqyrton çështjen në shkallë të dytë mbi ankim të të pandehurit, i cili ka pretenduar për cilësim juridik ligjor të gabuar, që akuza dhe gjykata e shkallës së parë, iu ka bërë veprimeve të kundërligjshëm kryera prej tij.

Në ankim është parashtruar se, i pandehuri, i cili ka patur detyrë funksionale, specifike që të administrojë pasurinë e bankës, duke shpërdoruar këtë detyrë, ai jo vetëm që nuk e ka miradministruar, por ka kaluar kufijtë e ligjit për të kryer në mënyrë korrekte detyrën duke vjedhur këtë pasuri në favor të tij. Nga analiza e provave të mësipërme, gjykata e Apelit çmon se ndryshe nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i pandehuri Gjergji Xhaho ka konsumuar të gjitha elementet e figurave të veprave penale të ‘të vjedhjes me shpërdorim detyre, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Nga ana objektive kjo vepër realizohet nëpërmjet vjedhjes së pasurisë së personave juridikë apo fizikë apo shtetit, vjedhje që realizohet, duke shpërdoruar detyrën nga personat që janë ngarkuar për ta ruajtur këtë pasuri. Pra subjekt të këtij krimi janë ata persona që e kanë për detyrë të ruajnë dhe miradministrojnë pasurinë qoftë të personit fizik apo juridik privat apo shtetëror pavarësisht nga posti që ata mbajnë në këtë miradministrim apo ruajtje të pasurisë, element ky specifik dhe i nevojshëm në realizimin e veprës penale të vjedhjes për shkak detyre.

Në rastin objekt gjykimi, në rrethanat kur është provuar se këtë pasuri të bankës (ana objektive) e ka vjedhur një subjekt i posaçëm (subjekti i veprës penale), Gjykata e Apelit çmon se ndodhemi para kërkesave të nenit 135 të K.Penal.

Sa më sipër, Gjykata e Apelit do t’i japë faktit një cilësim juridik ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, duke u deklaruar fajtor i pandehuri Gjergji Xhaho për veprën penale të “Vjedhjes me shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Në rrethanat e parashtruara më sipër, Gjykata e Apelit do të vendosi ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë Fier për sa i përket kualifikimit ligjor të veprës dhe dënimit e tij për veprën penale të “Vjedhjes për shkak detyre” parashikuar nga neni 135 të Kodit Penal.

Lidhur me dënimin me 900.000 lekë gjobë, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, më shumë se një herë, në bazë të nenit 186/2 të K.Penal, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, do të priset dhe çështja do të pushohet, në bazë të vendimit të

Gjykatës Kushtetuese, pasi jemi në rastet ku dispozita është konsideruar si antikushtetuese, ku përveç dënimit me burgim si dënim kryesor ka të parashikuar dhe dënimin me gjobë.

Në caktimin e masës së dënimit, Gjykata e Apelit do të marrë parasysh rrezikshmërinë e madhe shoqërore të veprës penale, “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” shkallen e fajësisë, duke marrë parasysh mekanizmin e ngjarjes, mjetet dhe mënyrat e sofistikuara që i pandehuri ka përdorur për kryerjen e veprës penale. Gjykata konkludon se pavarësisht qëndrimit që i pandehuri ka mbajtur ndaj faktit penal që në momentet e para, bazuar në rrethanat e faktit dhe rrethanat e tjera, që në kryerjen e kësaj veprimtarie të kundërligjshme ka ndikuar vesi i ulët dhe denigrues i bixhozit dhe përfshirja në lojërat e fatit, duke i shkaktuar pasoja shumë të rënda financiare për buxhetin e Alpha Bank, i pandehuri do të deklarohet fajtor dhe do të dënohet, për veprën penale të “Vjedhjes me anë të shpërdorimit të detyrës”, me maksimalen që parashikon kjo dispozite me 10 vjet burgim.

III. E drejta e zbatueshme

17. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe i qëndrimeve të palëve në gjykim, për t’i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara, përsa i takon njësimi të praktikës gjyqësore, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në rekurs, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh, para së gjithash, dispozitat vijuese të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit me nr.9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

18. Neni 29 i Kushtetutës:

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare.

19. Ligji nr .9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”:

Neni 1: Objekti

Objekt i këtij ligji është vendosja e kushteve dhe e rregullave për krijimin, licencimin, organizimin, drejtimin, kujdestarinë dhe likuidimin e bankave, ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare, si dhe mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2: Fusha e zbatimit

Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”.

Subjekte të këtij ligji janë personat që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, sipas përcaktimeve në nenin 4 dhe 54 të këtij ligji, me përjashtim të Bankës së Shqipërisë dhe të subjekteve të tjera, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj të veçantë.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë me akte nënligjore që subjektet e përmendura në nenin 126, që ushtrojnë veprimtari të përshkuara në nenin 54 të këtij ligji,

për shkak të natyrës, vëllimit të veprimitarisë apo të origjinës së burimeve financiare të tyre, të përjashtohen nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji.

Neni 3: Sistemi bankar

Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga Banka e Shqipërisë, statusi i së cilës përcaktohet me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe nga bankat dhe degët e bankave të huaja, statusi i të cilave përcaktohet nëpërmjet këtij ligji.

Neni 4: Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Bankë” është personi juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

“Veprimtari bankare” është pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet.

“Veprimtari financiare” është çdo lloj veprimtarie që përcaktohet në nenin 54 pika 2 të këtij ligji.

“Licencë” është akti administrativ i lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me anën e të cilit i jepet e drejta një personi juridik për të kryer veprimtari bankare dhe financiare, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

“Filial” është një shoqëri, e cila zotërohet në më shumë se gjysmën e kapitalit nga një shoqëri tjetër. Të gjitha filialet e filialit janë filiale të personit juridik që ushtron kontroll mbi këtë filial.

“Shoqëri të bashkëkontrolluara” janë dy ose më shumë filiale të një personi juridik, i cili ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi to.

“Degë e bankës” është njësia organizative në varësinë e bankës, e cila ushtron në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha apo disa nga veprimtaritë që ushtron banka, në emër dhe për llogari të kësaj të fundit.

“Degë e bankës së huaj” është dega e një banke të licencuar për të kryer veprimtari bankare nga autoriteti përgjegjës i një vendi tjetër, të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë. Kjo degë licencohet nga Banka e Shqipërisë dhe regjistrohet në regjistrin e shoqërive tregtare.

“Agjenci bankare” është njësia organizative e bankës, nën varësinë e degës së bankës, e cila ushtron drejtpërsëdrejti një ose disa veprimtari bankare dhe financiare në emër dhe për llogari të bankës.

“Subjekt financiar jobankë” është personi juridik që licencohet nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 54 pika 2 të këtij ligji. Subjekti financiar jobankë ndalohet të grumbullojë depozita monetare dhe fonde të tjera të ripagueshme nga publiku.

Neni 5: E drejta për të ushtruar veprimtari bankare

Veprimtaria bankare në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga:

banka me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe e licencuar nga Banka e Shqipërisë;

dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 11: Shtirija e rrjetit bankar

Banka ka të drejtë të hapë degë, agjenci bankare, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të ofrojë shërbime ndërkufitare dhe të hapë zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet dhe kriteret e hapjes së një dege, agjencie bankare, zyre përfaqësimi ose ofrimit të shërbimeve bankare dhe/ose financiare ndërkufitare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Banka e huaj ka të drejtë të hapë një ose disa degë apo agjenci bankare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për të cilat Banka e Shqipërisë lëshon një licencë të vetme. Këto degë, për qëllime të mbikëqyrjes, konsiderohen si një e vetme.

20. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, nenet 134-141 të tij:

Neni 134: Vjedhja

Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Neni 135: Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën

Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 136: Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit

Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 139: Vjedhja me dhunë

Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 140: Vjedhja me armë

Vjedhja e pasurisë, e shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 141: Vjedhja me pasojë vdekjen

Vjedhja e pasurisë, kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

IV. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

III – 1. Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për unifikim,

Personi, i cili vjedh pasurinë e bankave apo të arkave të kursimit, gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave për administrimin apo ruajtjen e kësaj pasurie, do të përgjigjet për

veprën penale të “Vjedhjes së bankave dhe e arkave të kursimit” parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal apo “Vjedhjes e kryer duke shpërdoruar detyrën” parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal?

21. Rendi juridik mbron shoqërinë duke siguruar marrëdhëniet, vlerat dhe interesat themelore juridike të shoqërisë, përmes mbrojtjes penale. Kryerja e një vepre penale shkakton një cenim apo vendos në rrezik një marrëdhënie juridike të mbrojtur shprehimisht nga rendi juridik. E drejta penale, si pjesë e rendit juridik, reagon ndaj kryerjes së kësaj vepre nëpërmjet parashikimit të sanksionit penal që zbatohet, duke vepruar në vlerat dhe marrëdhëniet më themelore të autorit, që janë liria personale dhe pasuria. Sanksioni penal që do të zbatohet duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljen e kryer. Në legjislacionin shqiptar sjelljet e njeriut (veprimet a mosveprimet) që konsiderohen si vepra penale, si dhe dënimet përkatëse për to, janë të parashikuara në mënyrë të shprehur në Kodin Penal, i cili përbën bazën e garantimit dhe respektimit të parimit themelor të ligjshmërisë në të drejtën penale të garantuar në Kushtetutë dhe të parashikuar me ligj.
22. Me qëllim zgjidhjen e çështjes së shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të ndalen në konceptin e “konkurrimit të veprave penale” kur një person shkel më shumë se një herë ligjin penal, dhe në konceptin e ndryshëm të “konkurrimit të normave penale”. Në këtë rastin e fundit, në pamje të parë (*prima facie*), një veprim a mosveprim që përbën vepër penale, duket sikur klasifikohet dhe përfshihet nën fushën e zbatimit të më shumë se një norme penale inkriminuese (norma që parashikon vepër penale), por që në fakt, vetëm një është norma penale që do të gjejë zbatim, për këtë arsye konkurrimi quhet vetëm në dukje, pra, në aparençë dhe është i ndryshëm nga konkurrimi real. Kjo për shkakun se në thelb, është i “njëjti fakt”, është e njëjta shkelje, dhe cenohet vetëm njëherë e njëjta marrëdhënie juridike. Për të sqaruar nëse ka konflikt në dukje normash penale apo konkurrim real veprash penale, rëndësi ka të përcaktohet se cilat janë kriteret dhe parimet që shërbejnë për cilësimin e saktë ligjor të normës penale të zbatueshme në rastin konkret dhe mënyrën si veprojnë këto kriteret.
23. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, krahas konkurrimit efektiv (real) të veprave penale të kryera kur një normë penale shkelet më shumë se një herë (bashkim veprash), ekziston edhe konkurrimi në dukje i disa normave penale inkriminuese që duket sikur zbatohen për të njëjtën sjellje/fakt që përbën vepër penale (konflikt normash). Konkurrimi në dukje i dispozitave penale, i njohur ndryshe edhe si “konkurrimi i ligjeve penale”, është një koncept i ndryshëm nga konkurrimi i veprave penale, sepse edhe pasojat që vijnë janë të ndryshme. Kështu, në rastin e konkurrimit aparent të normave penale, për shkak se kemi të bëjmë me një shkelje të vetme, zbatohet vetëm një normë penale. Domethënë e njëjta sjellje kriminale si fakt kriminal, në të njëjtën kohë, duket sikur parashikohet nga më shumë se një dispozitë penale dhe nuk ka vend për bashkim veprash. Konkurrimi apo konflikti i normave penale është vetëm në dukje si aparent, pasi çdo figurë konkrete e veprës penale, duhet të përcaktohet vetëm nga një normë penale e vetme që e parashikon atë vepër të caktuar. Kjo për faktin se nuk është e mundur që një vepër penale, në kuptimin e një figure të sjelljes kriminale konkrete, të parashikohet njëkohësisht nga dy norma të ndryshme. Ndërsa, në rast të konkurrimit efektiv të veprave penale, kemi bashkim veprash penale dhe rëndim të masës së dënimit, pasi kemi të bëjmë me shumë se një shkelje të normës që përbën vepër penale.

24. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se konflikti i normave i përket fushës së zbatimit dhe cilësimit të ligjit dhe është i lidhur me zbatimin dhe interpretimin e përpiktë të ligjit penal material. Përcaktimi i saktë i normës që parashikon veprën penale, ka një rëndësi themelore, sepse është një parakusht për respektimin e parimit të ligjshmërisë, që një person të merret në përgjegjësi penale, e më pas ndaj tij të zbatohet sanksioni penal, sipas figurës së veprës penale saktësisht të kryer prej tij. Në konkurrimin e normave penale, kemi të bëjmë me hapësirën dhe kufirin e zbatimit të normës penale (ligjit penal), pasi përcaktohet kategoria e atyre ngjarjeve tipike penale që klasifikohen sipas “një” norme penale që parashikon një veprë të caktuar, në raport me ato ngjarje tipike që kufizohen, për shkak të cilësimit të ndryshëm, sipas një norme tjetër penale. Prandaj, në konkurrimin e normave penale, e njëjta marrëdhënie juridike e mbrojtur, pra, e njëjta “lëndë” duket sikur rregullohet, në pamje të parë, nga një pluralitet normash, duke lindur problemi i përcaktimit të saktë të normës juridike që është e zbatueshme në rastin konkret dhe që rezulton të jetë shkelur realisht. Kjo për shkak se është e ndaluar ndëshkimi i të njëjtit fakt që përbën veprë penale, më shumë se një herë. Me gjithë pluralitetin e normave që duken sikur janë të zbatueshme, në fakt, vepra penale është e njëjtë, sepse e vetme është shkelja e normës penale dhe një është norma e zbatueshme, por në këtë rast duhet të evidentohet norma e zbatueshme. Ndërsa, në rastin e “konkurrimit të veprave penale” kemi të bëjmë me më shumë se një marrëdhënie juridike të mbrojtur penalisht, dhe që në rast shkeljeje, shtrohet problemi për të vërtetuar nëse janë cenuar të gjitha këto marrëdhënie juridike, qoftë për shkak të ‘një’ veprimi apo mosveprimi të vetëm kriminal (konkurrim formal), apo qoftë për shkak të një ‘pluraliteti’ veprimesh apo mosveprimesh (konkurrim material). Pra në këtë rast, ngrihet çështja nëse subjekti aktiv i veprës penale, domethënë autori i saj, do të ndëshkohet për të gjitha cenimet që ai i ka shkaktuar marrëdhënieve juridike të mbrojtura nga ligji penal apo jo. Në konkurrimin e veprave penale, cenimi i më shumë se një marrëdhënieje juridike të mbrojtur penalisht, sjell praninë e më shumë se një veprë penale, dhe nga pikëpamja e trajtimit ndëshkimesor do të gjejë zbatim instituti i bashkimit të veprave penale, në bazë të parimeve të kumulacionit juridik dhe atij material. Kësisoj, në krahasim me dukurinë e konkurrimit aparent të normave penale, dallimi me konkurrimin material të veprave penale, është i qartë, pasi prania e shumë sjelljeve (veprime a mosveprime) përbën në vetvete gjithsecila një veprë penale, domethënë secila me vete një shkelje të ndryshme të normës penale. Ndërsa në krahasim me konkurrimin formal të veprave penale (më shumë se një shkelje të së njëjtës normë), për dallimin duhet të përcaktohet nëse kemi të bëjmë me konflikt normash (një shkelje e vetme e së njëjtës normë dhe individualizimin e saj) apo shkelje të ndryshme të së njëjtës normë penale (veprë penale e vazhduar).
25. Për sa më sipër, me konkurrim “në dukje” të normave penale do të kuptohet dukuria në bazë të së cilës, një fakt që përbën veprë penale, në kuptimin e tij si një episod historik, pra, një ngjarje historike, duket sikur klasifikohet “njëkohësisht”, si shkelje nën suazën e zbatimit të më shumë se një dispozite ligjore penale. Porse më konkretisht, mbi bazën e një analizë logjike dhe juridike, vetëm një normë penale do të zbatohet në rastin konkret, sepse në të kundërt, do të cenohej parimi themelor i ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën veprë penale (*Ne bis in idem*). Parimi i ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën veprë penale përbën bazën themelore logjike dhe juridike të zbatimit të ligjit, në rastin kur kemi të bëjmë me praninë e një pluraliteti normash inkriminuese, të cilat në pamje të parë (*prima facie*) duken të gjitha si të zbatueshme, por që vetëm njëra prej tyre gjen zbatim.

26. Në bazë të parimit të përgjithshëm të ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale, askush nuk mund të gjykohet më shumë se njëherë për të njëjtën shkelje ligjore. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky parim zbatohet jo vetëm në procedurën penale, por edhe në të drejtën penale materiale. Në bazë të këtij parimi, është i ndaluar procedimi dy herë i një personi për një fakt që përbën vepër penale, për të cilin është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë që është bërë i pakundërshtueshëm. Gjithashtu, sipas këtij parimi, ndalohet për të njëjtin person edhe atribuimi i më shumë se një shkeljeje ligjore lidhur me të njëjtin fakt. Domethënë është i ndaluar për të njëjtin fakt atribuimi i më shumë se një shkeljeje të normës penale, kur shkelja e normës është e mjaftueshme, në raport me marrëdhënien juridike të cenuar dhe përmban elementet e veprës penale për caktimin e një dënimi penal në një masë proporcionale. Në nenin 47 të Kodit Penal parashikohet se: “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese”. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se kjo dispozitë e marrë në tërësinë e saj, i referohet parimit të individualizimit të dënimit dhe mënyrës se si ky parim duhet respektuar nga gjykata. Parimi i individualizimit, në thelb, përmban parimin e proporcionalitetit mes veprës penale të konsumuar dhe dënimit që caktohet ndaj autorit të saj. Në bazë të jurisprudence kushtetuese, “Gjykata [Kushtetuese], duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar europiane në këtë fushë, konstaton se, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën.” (Vendimi nr.19, datë 01.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese).
27. Zbatimi i parimit të ndalimit të gjykimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër në të drejtën penale materiale është i lidhur me funksionin e mbrojtjes së lirisë personale, parimin e sigurisë juridike dhe me atë të ligjshmërisë në të drejtën penale. Parime këto të parashikuara me ligj dhe të garantuar në Kushtetutë, si dhe në aktet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut, si Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike¹, dhe KEDNj-së, etj. Në rastin *Boman k. Finlandës*, nr.41604/11, datë 17.02.2015, GjEDNj ka theksuar se neni 4 i Protokollit nr.7 i KEDNj-së, nuk është i kufizuar vetëm në të drejtën për të mos u dënuar dy herë për të njëjtin fakt, por ai shtrihet duke përfshirë edhe të drejtën për mos t’u ndjekur penalisht apo gjykuar dy herë (rasti *Sergey Zolotukhin k.Rusisë* [DhM], nr.14939, datë 10.02.2009, § 82-83, *Salier k. Austrisë*, 06.09.2002, *Franz Fischer k. Austrisë*, 29.08.2001, *Oliveria k. Zvicrës*, 30.07.1998.). Në të kundërt, nuk do të kishte qenë e nevojshme të ishte përdorur fjala “dënuar/ndëshkuar”, krahas fjalës “gjykuar”, pasi kjo do të kishte qenë veçse një dublikim i thjeshtë. Neni 4 i Protokollit nr.7, zbatohet edhe kur individët janë ndjekur në procedim penal që akoma nuk ka rezultuar në një dënim përfundimtar.
28. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, në rast konkurrimi të normave penale, fakti që konsiderohet si vepër penale duket sikur parashikohet nga dy ose më shumë dispozita penale, por në të vërtetë kemi një vepër të vetme dhe nuk aplikohen dispozitat mbi bashkimin e veprave penale. Në këto raste, dispozitat e ndryshme që parashikojnë të njëjtin fakt si vepër penale, ose përjashtojnë njëra tjetrën, ose thithin njëra tjetrën, për arsye se marrëdhënia juridike që është cenuar, mbrohet nga dispozitat penale që parashikojnë si vepër penale të njëjtin fakt. Për të zgjidhur çështjen e zbatimit të saktë të

¹ Aderuar me ligjin nr.7510, datë 08.08.1991, nga Republika e Shqipërisë.

normës ligjore, dhe si pasojë, cilësimin e saktë ligjor të veprës penale të parashikuar nga norma e zbatueshme, në rastin kur në pamje të parë (*prima facie*), në të njëjtën kohë duket sikur veprojnë më shumë se një dispozita penale, si kriteret logjike dhe juridike për zgjidhjen e kësaj çështjeje nga doktrina janë elaboruar këto parime: i) parimi i specialitetit (*lex specialis derogat legi generali*), ii) parimi i subsidiaritetit (*lex primaria derogat legi subsidiariae*), iii) parimi i përthithjes (*lex consumens derogat legi consumptae*).

29. i) Në bazë të parimit të specialitetit, kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë, zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme, kjo në përputhje me kriterin e përgjithshëm juridik për zgjidhjen e kundërshtive *lex specialis derogat legi generali*. Raporti i specialitetit ekziston kur elementet përbërëse të një norme penale (të përgjithshme) janë të gjithë të pranishëm edhe në një normë tjetër (e posaçme), e cila përveç tyre, përmban edhe disa elemente më specifike që e cilësojnë normën e dytë, të posaçme në raport me normën e parë. Norma e përgjithshme përmbahet krejtësisht në normën e posaçme, kjo e fundit ka një përmbajtje më të gjerë dhe e përfshin të parën (marrëdhënie lloj dhe specie), prandaj shkelja e normës së posaçme (si normë me madhe) logjikisht përfshin edhe shkeljen e normës së përgjithshme (norma më e vogël), ndaj vetëm norma e posaçme do të zbatohet. Sa më e madhe të jetë prania e elementëve specifikues përbërës të një norme penale inkriminuese, aq më e ngushtë është fusha e veprimit dhe e zbatimit të saj, në raport me normën e përgjithshme, duke pasur kjo e fundit më pak elemente rrethorë që e kufizojnë fushëzbatimin e normës së përgjithshme, e cila rrjedhimisht gjen një zbatim më të gjerë. Meqenëse norma e përgjithshme ka një fushëzbatim më të gjerë nga ajo e posaçme, një fakt që përbën veprën penale që hyn në fushëzbatimin e normës së posaçme, do të hyjë edhe në fushëzbatimin e normës penale të përgjithshme. Megjithatë, po t'i zbatonim të dyja normat penale do dyfishoheshin efektet dhe do të shkelej parimi i ndalimit të gjykimit dy herë mbi të njëjtin fakt. Prandaj, vetëm njëra normë inkriminuese do të gjejë zbatim, ajo e posaçme, sepse norma e përgjithshme do përfshihet nga norma e posaçme.

Baza e zbatimit të këtij parimi mbështetet në faktin se kemi të bëjmë me të njëjtën lëndë, domethënë me të njëjtin objekt; pra me të njëjtën marrëdhënie juridike të mbrojtur nga norma penale inkriminuese.

30. ii) Parimi i subsidiaritetit, bazohet në praninë e një raporti funksional midis dy normave penale lidhur me mbrojtjen e një marrëdhënieje juridike që mbrohet në nivele të ndryshme cenimi apo formash të cenimit. Sipas këtij parimi, një normë kryesore ka përparësi, kur ajo e mbron në një nivel më lartë marrëdhënien juridike që mbrohet në një nivel më të ulët nga një normë dytësore. Pra, fakti penal i parashikuar sipas normës dytësore, plotëson dhe përthithet nga fakti i parashikuar si veprën penale nga norma e kryesore, duke gjetur përparësi zbatimi i normës kryesore. Në këtë rast, konkurrimi i normave penale, zgjidhet në favor të normës kryesore. Prandaj, vetëm në rast se fakti që përbën veprën penale, nuk hyn në fushëzbatimin e normës kryesore do gjejë zbatim norma dytësore. Raporti i ndërveprimit në këtë rast, mund të konsiderohet si një raport hierarkik, ku njëra normë (kryesore) parashikon përparësinë e zbatimit të saj, në raport me normën tjetër (dytësore). Kjo e dyta, zbatohet vetëm kur nuk gjen zbatim norma e parë (kryesore). Sipas këtij parimi, zbatimi i njëres normë në të njëjtën kohë për të njëjtin fakt, përjashton zbatimin e normës penale tjetër, në rastin e mbrojtjes së marrëdhënieve juridike që mbrohen në mënyrë progresive dhe të përshkallëzuar nga një nivel më i ulët drejt një niveli më të lartë.

Si shembull për këtë rast, mund të sillet norma penale që parashikon veprën e plagosjes së rëndë me dashje me normën e veprës e plagosjes së lehtë me dashje, lidhur me shëndetin e personit. Parimi i subsidiaritetit ndërhyr për të mbuluar një hapësirë të lënë nga norma tjetër, apo kur dy a më shumë norma mbrojnë në shkallë të ndryshme marrëdhënien juridike. Baza për praninë e këtij parimi të përgjithshëm në Kodin Penal shqiptar gjendet edhe në parashikimin e klauzolave tipike ligjore: “kur (fakti) nuk përbën vepër tjetër penale”, si dhe në interpretimin e normës në raport me marrëdhënien juridike.

31. iii) Parimi i përthithjes, sipas së cilit kur më shumë se një normë i referohet një fushe të caktuar të njëtrajtshme të marrëdhënies juridike, duhet të gjejë zbatim vetëm ajo normë që e “përfshin” në mënyrë të plotë dhe shteruese kundërligjshmërinë e cenimeve, duke mbizotëruar mbi normat e tjera. Kjo për arsye se zbatimi i normës penale së parë më të rëndë, për të njëjtin fakt, konsumon përmbajtjen e normës penale më të lehtë. Në raportin përthithës, norma përthithëse përfshin brenda vetes faktin penal të normës së konsumuar dhe zbatohet në rastin kur përmbajtja e njëres normë është më e gjerë dhe në të përfshihet edhe përmbajtja e normës tjetër, domethënë kur kalohet në mënyrë graduale nga një normë që parashikon një vepër penale të caktuar në një tjetër më të rëndë. Si shembull për këtë rast, mund të sillet norma penale që parashikon veprën e ngacmimit seksual me atë që parashikon veprën e marrëdhënies seksuale me dhunë me të rritura.

Sipas këtij parimi, norma përthithëse ka një parashikim ndëshkues në shkallë dhe në masë të atillë më të rëndë sa që shteron plotësisht rrezikshmërinë shoqërore të faktit penal të parashikuar nga norma tjetër e konsideruar më lehtë. Në këtë rast, zbatimi njëkohësisht edhe i normës së përthithur që parashikon veprën penale tjetër për të njëjtin fakt, do të shndërrohej në një masë të tepërt e të shpërpjesëtuar dënimi në ngarkim të autorit të veprës penale, po të aplikohet bashkërisht edhe norma tjetër penale. Baza e parimit të përthithjes mund të gjendet në përcaktimin e parashikuar në nenin 1/c të Kodit Penal, në të cilin është përdorur termi “drejtësi e caktimit të fajësisë dhe dënimit”, term ky që zberthehet më gjerësisht në nenin 47 të Kodit paragrafi i dytë, ku parashikohen elementët që gjykata duhet të ketë parasysh në caktimin e dënimit për veprën penale, duke i shërbyer gjithmonë parimit të drejtësisë në caktimin e dënimit dhe proporcionalitetit të tij.

32. Në zbatim të parimeve të mësipërme për çështjet e shtruara për diskutim, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, dispozitat penale që parashikojnë veprat penale kundër pasurisë janë parashikuar në kreun e tretë të Kodit Penal, të titulluar “vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”. Në bazë të ligjit penal, pasuria është e mbrojtur në këndvështrimin e marrëdhënies individuale, ndërsa sfera e ekonomisë është e mbrojtur në këndvështrimin e interesave publike ndikimin e tyre mbi sistemin ekonomik. Dispozitat e kreut të tretë të Kodit Penal mbrojnë në radhë të parë, marrëdhëniet juridike ekonomiko-pasurore të subjekteve private a publike, e në radhë të dytë, edhe marrëdhënie të tjera të rëndësishme, siç mund të jenë ato personale. Analiza për klasifikimin e veprave penale kundër ‘pasurisë’, bazohet kryesisht mbi mjetin e përdorur dhe mbi mënyrën e cenimit në arritjen e rezultatit që dëmton personin pasiv të veprës penale (të dëmtuarin). Kështu, ligji penal dallon duke ndarë veprat penale me përdorimin e dhunës, nga veprat penale me përdorimin e gënjeshtërs a shpërdorimin e besimit, duke parashikuar si vepra penale vetëm modalitete të caktuara sjelljesh (veprime a mosveprime) shprehimisht të parashikuara të cenimit të marrëdhënies pasurore, dhe jo çfarëdo lloj cenimi që mund t’i bëhet atyre marrëdhënies pasurore.

33. Për nga mënyra e cenimit të marrëdhënies pasurore në raport me subjektin pasiv të veprës penale, veprat kundër pasurisë mund të grupohen në:
- 1) vepra penale, ku cenimi i marrëdhënies juridike të mbrojtur vjen në mënyrë të njëanshme, ku subjekti aktiv (autori) pa bashkëpunimin e subjektit pasiv të veprës penale, zgjedh rrugën e drejtpërdrejtë, duke vepruar drejtpërdrejt mbi sendin, pa pëlqimin e subjektit pasiv që është i dëmtuar, i cili pëson veprën penale. Për të arritur rezultatin e synuar, autori i veprës penale nëpërmjet skemës së: a) marrjes së dhe shtënies në dorë të sendit (vjedhja e thjeshtë); b) shkatërrimit apo dëmtimit të sendit (shkatërrim i pronës), c) shpërdorimit të regjimit të sendit (shpërdorimi i tokës) apo cenimit në gëzimin e sendit (pushtimi i tokës, ndërtimi i paligjshëm në tokën e tjetrit), cenon sferën e pasurisë së tjetrit në mënyrë të njëanshme;
 - 2) veprat penale, ku cenimi i marrëdhënies juridike të mbrojtur vjen me bashkëpunimin e të dëmtuarit për të përfituar nga një veprim mbi disponimin e pasurisë, i cili jepet për shkak të përdorimit të mjetit të gënjeshtërs, ose shpërdorimit të besimit të dhëna nga mbi bazën e ligjit apo të një veprimi juridik (mashtrimi), apo nën kushtet e dhunës (vjedhja me dhunë, a me armë). Në këto raste, pëlqimi i subjektit pasiv të veprës penale lind dhe është i vesuar dhe nuk merret parasysh.
34. Duke iu kthyer veprës penale të vjedhjes, lidhur me figurat e veprës penale të vjedhjes, edhe pse në Kodin tonë Penal nuk ekziston një ndarje e tillë, referuar mënyrës së formulimit të dispozitave të veçanta në Kreun III, Seksioni I, mund të bëhet një ndarje e figurës së “vjedhjes” në “të thjeshtë” dhe “vjedhje në rrethana cilësuese”². Vjedhja kryesisht është në rrethana cilësuese, kur përveç dhunimit të së drejtës së pronësisë, cenohet edhe një e drejtë tjetër në të njëjtën kohë, ndërsa ajo e thjeshtë është kur në kryerjen e saj nuk konkurrojnë rrethana të tilla që e bëjnë më theksuar shkallën e cenimit të marrëdhënies juridike, domethënë të drejtën e pronësisë. Kjo ndarje bëhet për t’i dhënë në mbrojtje sa më të përshtatshme marrëdhënieve juridike të pasurisë nga mënyrat e vjedhjes së kryer në disa rrethana të cilësuar, duke parashikuar një dënim më të rëndë, për shkak se marrëdhënia gjendet në kushte të një mbrojtjeje më të vogël se zakonisht. Madje, ajo rezulton e ekspozuar përkundrajt zgjedhjes së një mënyre të cenimit të marrëdhënies që është më e rrezikshme dhe që shpreh një shkallë vendosmërie më të lartë të autorit, e për rrjedhojë, të një rrezikshmërie më të lartë të tij në kryerjen e veprës penale.
35. Duke iu referuar rrethanave cilësuese të parashikuara në Kodin Penal, Kolegjet vërejnë se vjedhja klasifikohet duke patur parasysh: a) shkallën e rëndimit (gravitetit) të sjelljes kriminale: Vjedhje me dhunë (neni 139 i K.Penal), vjedhje me armë (neni 140 i K.Penal); b) pasojat e ardhura: vjedhje me pasojë vdekjen (neni 141 i K.Penal); c) sipas vlerës së sendeve të vjedhura: vjedhje me pasoja të rënda (neni 134/2 i K.Penal); d) sipas cilësisë së personit që kryen vjedhjen (subjekt i posaçëm): vjedhje duke shpërdoruar detyrën (neni 135 i K.Penal); e) sipas rëndësisë së sendeve të vjedhura (objektit material të vjedhjes): vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit (neni 136 i K.Penal); vjedhje e veprave të artit dhe kulturës (neni 138 i K.Penal) vjedhje e energjisë elektrike ose impulsive telefonike (neni 137 i K.Penal). Parashikimi i këtyre rrethanave cilësuese nga ana e ligjvënësit ka krijuar kushte ligjore të përshtatshme për të mundësuar zhvillimin e një lufte sa më efektive kundër kriminalitetit në një sferë kaq të rëndësishme siç është mbrojtja dhe garantimi i marrëdhënieve juridike pasurore në rendin juridik shqiptar.

² Siç është bërë tashmë një ndarje e tillë në doktrinën e huaj, kryesisht atë franceze dhe italiane.

36. Sa i përket veprës penale bazë të vjedhjes së pasurisë, në Kodin e Penal, vjedhja është e parashikuar në seksionin e parë të kreut të tretë, në të cilin janë parashikuar të gjitha figurat e veprës penale të vjedhjes. Në Kodin Penal shqiptar nuk jepet ndonjë përkufizim i konceptit “vjedhje”³, por një përkufizim i tillë jepet nga doktrina. Sipas doktrinës me vjedhje kuptohet marrja, hedhja në dorë, në mënyrë të kundërligjshme, të fshehtë ose të hapët, e pasurisë së luajtshme, e kryer me dashje, me qëllim për të mos e kthyer më, për të nxjerrë përfitim material për vete ose në dobi të personave të tjerë. Pra, krimi i vjedhjes së pasurisë së një personi fizik ose juridik, nga ana objektive konsiderohet si i kryer, kur subjekti në mënyrë të paligjshme, fshehurazi ose haptazi, arrin ta zhveshë të dëmtuarin në mënyrë përfundimtare nga posedimi mbi këtë pasuri.
37. Objekt i krimit të vjedhjes janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar paprekshmërinë e pronës mbi sendet e luajtshme të personave privatë, të personave juridikë dhe të shtetit, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Objekt material i veprës është çdo send që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës penale. Sa i përket sendeve, ato përbëjnë objekt të krimit të vjedhjes kur janë të luajtshme; pra, përbëjnë një entitet material për plotësimin e nevojave të njeriut. Vjedhja e thjeshtë pa praninë e rrethanave cilësuese parashikohet në paragrafin e parë të nenit 134 të Kodit Penal, në bazë të të cilit është parashikuar se vjedhja e pasurisë dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.
38. Duke i parë në planin progresiv dhe të përshkallëzuar veprimet kriminale në fushën e pasurisë, për sa i përket dukurisë së konkurrimit, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, figura e veprës penale të vjedhjes, sipas nenit 134 të Kodit Penal, ka pasojë pakësimin e pasurisë së tjetrit në mënyrë të kundërligjshme (Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 11.11.2003). Kurse, figura e veprës penale së vjedhjes me dhunë parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, është një figurë që në raport me vjedhjen e përgjithshme, përbën një vepër penale specifike, pasi krahas elementëve të përgjithshme që përmban vepra penale e vjedhjes së thjeshtë, është e parashikuar edhe rrethana e shoqërimit të përdorimit të dhunës. Si element ky për marrjen dhe shtënien në dorë të sendit, duke ushtruar dhunë jo vetëm për marrjen dhe vënien në posedim të sendit, por edhe mbi personin, domethënë subjektin pasiv të veprës penale që ka në posedim sendin (i dëmtuari). Sikundër mund të vërehet, sipas praktikës gjyqësore ndër vite të Kolegjeve të Bashkuara, vepra penale e vjedhjes me dhunë është një vepër penale e përbërë nga dy vepra penale përbërëse, të cilat janë: vjedhja e thjeshtë, sipas nenit 134 të Kodit Penal, si dhe vepra penale përkatësisht: ose e plagosjes së rëndë, sipas nenit 88 të Kodit Penal, ose ajo e plagosjes së lehtë, sipas nenit 89 të Kodit Penal, ose ajo e dëmtimeve të tjera me dashje, sipas nenit 90 të Kodit Penal, apo ajo e kanosjes serioze për jetën. Objekti i kësaj vepre penale të përbërë, krahas atij kryesor të mbrojtjes së marrëdhënieve juridike të krijuara për paprekshmërinë e pasurisë, është edhe mbrojtja e marrëdhënieve juridike për shëndetin dhe lirinë e personit, të cilit i merret pasuria nën kërcënimin e dhunës. Në interpretim të nenit 139 të Kodit Penal vjedhja është e kryer me dhunë, kur dhuna ushtrohet si ndaj sendeve, ashtu edhe ndaj personit. Kjo për faktin se Kodi ynë Penal përdor shprehjen “e shoqëruar me përdorim dhune”, duke mos bërë dallimin mes dhunës së ushtruar ndaj sendeve dhe asaj ndaj personit dhe duhet të jetë

³ Neni 446 i Kodit Penal shqiptar i vitit 1928, parashikonte:

Kushdo që me qëllim përfitimi merr posedimin e një sendi të lujtëshëm të tjetërit, tue e heq nga vendi ku gjindet, pa pasun hirin e të zotit, ndëshkohet me burgim të randë nga një muej deri në tre vjet dhe me gjobë të randë.

e tillë saqë në psikikën e subjektit që pëson sjelljen kriminale (subjektit pasiv) të krijohet bindja se ai është kthyer në një “instrument” në duart e subjektit aktiv (autorit të veprës penale). Pra, viktimja, thuhet në doktrinë, “*non agit sed agitur*”; çka do të thotë se ajo nuk vepron me vullnetin e saj, por sepse është e detyruar. Për të patur një veprë të tillë penale, duhet që vullneti i personit subjekt dhune të jetë totalisht i përjashtuar. Në mënyrë të përshkallëzuar, figura e veprës penale të vjedhjes me dhunë, sipas nenit 139 të Kodit Penal përbën shkallën e parë, për nga rëndimi i cenimit të marrëdhënieve të mbrojtura, më tej pas saj është parashikuar vepra e vjedhjes me armë, sipas nenit 140 të Kodit Penal. Në këtë nen, parashikohet si rrethanë cilësuese: ose shoqërimi i mbajtjes së armëve dhe municioneve luftarake, ose përkatësisht, përdorimi i tyre. Po kështu, e fundit për nga graviteti i cenimit të marrëdhënieve të mbrojtura është edhe vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, sipas nenit 141 të Kodit Penal. Në këtë nen ku përcaktohet figura e veprës penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, parashikohet si rrethanë cilësuese ajo e vdekjes së personit. Me anë të dispozitës të parashikuar në nenin 141 të Kodit Penal, mbrohen në mënyrë të posaçme dy marrëdhënie të rëndësishme shoqërore, të cilat janë pasuria dhe e drejta e jetës së personit, ku objekti kryesor në këtë rast, është marrëdhënia pasurore, ndërsa jeta e personit është objekti dytësor i mbrojtur në këtë dispozitë. Figura e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal përbëhet nga dy vepra penale materiale, për të cilat është e detyrueshme ardhja e pasojës kur ato qëndrojnë si vepra penale më vete, në mënyrë që ato të quhen të konsumuara plotësisht. (Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.6, datë 30.09.2011).

39. Sipas praktikës gjyqësore në vite të Kolegjeve të Bashkuara mbi konkurrimin, vepra penale e vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i K.Penal dhe vepra penale e vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i K.Penal, kur kryhen për shtënien në dorë të së njëjtës pasuri në asnjë rrethanë nuk mund të konkurrojnë me veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, sepse edhe kjo e fundit është një formë e cilësuar e dy të parave, pasi edhe në këtë rast, nga ana objektive vepra penale kryhet me dhunë, e cila është ekstreme dhe përfundon me vdekjen e personit. (Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr.6, datë 30.09.2011). Në këto kushte, norma penale që parashikon figurën e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, kur ka ardhur pasoja dhe është kryer me armë, e përthith përkatësisht normën penale që parashikon figurën e veprës penale të veprës së vjedhjes me armë dhe atë të vjedhjes me dhunë. Përfundim ky që bazohet jo vetëm mbi bazën e jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara, por edhe në bazë të zbatimit të parimeve të përgjithshme për konkurrimin e normave penale.
40. Duke iu kthyer grupimit të figurave të veprës penale të vjedhjes, ku nuk parashikohet dhuna apo shtrëngimi, si është në rastin e figurës së veprës penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, kjo figurë e veprës penale parashikon si rrethanë cilësuese elementin në bazë të cilit vepra penale duhet të kryhet nga subjekti aktiv që, për shkak të ligjit apo një veprimi juridik ka: i) ose për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë pasurinë objekt të veprës penale, ose ii) vjedhja shoqërohet me shpërdorimin e detyrës. Në bazë të kësaj dispozite, si rregull i përgjithshëm, pasuria objekt i veprës penale, normalisht në çastin e kryerjes së veprës penale, ndodhet pranë subjektit aktiv të veprës penale (autorit), duke iu besuar atij për një qëllim të caktuar për ruajtje, administrim, etj., në mënyrë të ligjshme, siç mund të jenë për shembull: kujdestari i personit të deklaruar si i zhdukur, sipas nenit 16 të Kodit Civil, apo kujdestari i trashëgimit, sipas nenit 344 të Kodit Civil, apo administratori i falimentit, apo transportuesi

gjatë transportimit të sendit nga në bazë kontratës së spedicionit, apo magazinieri, rojës së depos, etj. Sikundër mund të vërehet, në këtë veprë penale, subjekt aktiv për kryerjen e veprës penale nuk është një subjekt i çfarëdoshëm, por një subjekt i cilësuar, prandaj kjo veprë penale mund të kryhet vetëm nga një subjekt i posaçëm i veprës penale që ka cilësi të veçanta (*delictum proprium*).

41. Me qëllim dhënien e përgjigjes mbi çështjet e shtruara për unifikim, si dhe në funksion të zgjidhjes së rastit objekt rekursi në lidhje me akuzën për veprën penale të vjedhjes së bankave dhe e arkave të kursimit, sipas neni 136 të Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të analizojnë, fillimisht se çfarë kuptohet me termat “bankë” dhe “arkë kursimi”, sipas legjislacionit tonë dhe cili është fushëveprimi normës penale, kur kemi të bëjmë me kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit”, parashikuar nga neni 136 i K.Penal, në krahasim me atë të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal.
42. Në rastin e figurës së veprës penale të vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit, të parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal, Kolegjet vërejnë se kjo veprë penale mund të kryhet nga cilido dhe nuk është veprë penale që kryhet nga subjekte të posaçme. Në Kodin tonë Penal, në kohën kur është parashikuar si veprë penale, “vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit”, në fakt, nuk është bërë një përkufizim i nocionit “bankë” dhe i atij “arkë kursimi”, prandaj për këtë arsye, duhet t’i referohemi ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
43. Sipas dispozitave të këtij ligji me termin “bankë” kuptohet personi juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera, sipas përcaktimeve të ligjit⁴. Po ashtu, me shprehjen: “veprimtari bankare”, kuptohet pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, si dhe emetimi i mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike⁵. Në bazë të kuadrit ligjor, sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga Banka e Shqipërisë, statusi i së cilës përcaktohet me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe nga bankat dhe degët e bankave të huaja, statusi i të cilave përcaktohet nëpërmjet ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”⁶. Në këtë kuadër, veprimtaria bankare në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga: banka me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë e licencuar nga Banka e Shqipërisë; dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë⁷. Banka ka të drejtë të hapë degë ose agjenci bankare brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Banka e huaj ka të drejtë të hapë një ose disa degë apo agjenci bankare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për të cilat Banka e Shqipërisë lëshon një licencë të vetme. Këto degë, për qëllime të mbikëqyrjes, konsiderohen si një e vetme⁸. Autoriteti i vetëm përgjegjës, për licencimin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe veprimtarive të tjera financiare është Banka e Shqipërisë⁹.

⁴ Neni 4 pika 1.

⁵ Neni 4 pika 2.

⁶ Neni 3.

⁷ Neni 5 i ligjit.

⁸ Neni 11 i ligjit.

⁹ Neni 14 i ligjit.

44. Në këtë kuadër, Kolegjet vlerësojnë se për qëllime të zbatimit të nenit 136 të Kodit Penal, me termin “bankë” do kuptojmë vetëm ata persona juridikë që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë përkufizim nuk përfshihen institucionet e ndryshme të dhënies së kredive, siç janë subjektet financiare jobanka, të cilat janë persona juridikë që licencohen nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare të përcaktuara në ligj dhe që u ndalohej të grumbullojnë depozita monetare dhe fonde të tjera të ripagueshme nga publiku.
45. Kurse, në lidhje me nocionin “arka të kursimit” të parashikuar nga Kodi Penal në nenin 136 të sipërcituar, vërehet se nuk ka një përkufizim të tillë në ligjin, të cilit i referohemi për përkufizimin e nocioneve ligjore dhe përkufizimin e vetë fushëzbatimit të dispozitës penale. Kolegjet e Bashkuara, duke patur parasysh faktin se si vepër penale, “Vjedhja e bankës dhe arkave të kursimit”, u parashikua me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, do t’i referohen legjisllacionit në fuqi në kohën që u miratua ky Kod për të gjetur përcaktimin e nocionit “arkë kursimi”. Kështu, mbi institutin arka të kursimit, më saktë “Institut të Arkave të Kursimit”, bëhej fjalë në ligjin nr.6600, datë 30.06.1982, “Për Institutin e Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve”, ligj ky, i cili është shfuqizuar me ligjin nr.7505, datë 31.07.1991, “Për Bankën e Kursimeve”. Porse, një nocion i tillë “arkë kursimi”, nuk gjendet më në ligjet që vijuan më pas¹⁰. Prandaj, meqenëse sipas legjisllacionit në fuqi, nuk ekzistojnë më “arkat e kursimit”, si persona juridikë, atëherë, për qëllim të zbatimit të nenit 136 të Kodit Penal, personi ka përgjegjësi penale, sipas këtij neni, kur vjedhja kryhet ndaj personit juridik “bankë”, sipas përkufizimit të legjisllacionit në fuqi për bankat.
46. Për sa më sipër vërehet se, banka është institucioni kryesor për funksionimin e sistemit financiar ku zhvillohet transferimi i kursimeve dhe rishpërndarja e riskut ekonomik, si dhe ku bëhet depozitimi dhe kreditimi i parasë së publikut të gjerë, e për rrjedhojë ekzistojnë edhe interesa publike që ndikojnë vetë ekonominë e vendit në tërësi. Është, pikërisht, për shkak të rëndësisë së objektit të veprimtarisë së bankës dhe besimit publik që ekziston mbi sigurinë dhe besueshmërinë e këtij institucioni, mënyrën e funksionimit të tij, që ligjvënësi ka parashikuar një figurë të mëvetëshme të veprës penale të vjedhjes së bankave, duke parashikuar një dënim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim. Rrethana cilësuese për këtë figurë të veprës penale është, pikërisht, parashikimi i rëndësisë së posaçme të objektit të veprës penale; domethënë, vetë marrëdhënia juridike e pasurisë së këtij subjekti dhe, në të njëjtën, kohë cilësimi i subjektit pasiv të kësaj figure të veprës penale, që është pikërisht “banka”. Prandaj, për konfigurimin e kësaj e veprës penale, rëndësi të veçantë ka objekti i veprës penale dhe titullariteti i marrëdhënies juridike të mbrojtur, që është personi juridik bankë e licencuar sipas legjisllacionit në fushën e bankave.
47. Në zbatim të konkluzioneve dhe argumentimeve sa më sipër, lind pyetja se çfarë kuptojmë me rrethana cilësuese dhe kur ato janë pjesë e elementëve të disa veprave penale konkrete, cila vepër penale do të “mbizotërojë” ndaj të veprave penale të tjera, në mënyrë që gjykata zbatojë drejtë ligjin penal, duke e deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale të saktë

¹⁰ Ky nocion nuk gjendet në ligjet e miratuara pas këtij ligji të shfuqizuar dhe konkretisht nuk e hasim në Dekretin nr.7493, datë 1.12.1990 "Për Bankën Shqiptare të Tregtisë"; në ligjin nr.7505, datë 31.07.1991, "Për Bankën e Kursimeve"; në ligjin nr.7560, datë 28.4.1992 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr.8075, date 22.2.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë" dhe as në ligjin nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

që ai, konkretisht, rezulton të ketë kryer. Në këtë rast, Kolegjet e Bashkuara do t'i referohen parimeve të përgjithshme juridike të argumentuara më lart për konkurrimin e normave penale, me qëllim identifikimin e një rendi për zbatimin e dispozitave penale që parashikojnë vepra penale të ndryshme në lidhje me faktin penal të vjedhjes, duke u udhëhequr nga parimi i sigurisë ligjore dhe ai i parashikueshmërisë të pasojave ligjore. (Shih rastin *Alimuçaj k. Shqipërisë*, nr.20134/05, datë 07.02.2012, § 150-151, *Baskaya dhe Okçuoglu k. Turqisë*, datë 08.07.1999).

48. Rrethanat cilësuese, ndryshe nga rrethanat rënduese dhe lehtësuese, janë pjesë përbërëse e domosdoshme e veprës penale që e përcaktojnë atë ose shërbejnë për cilësimin ligjor të saj, duke e specifikuar veprën. Pra, janë ato elemente që janë parashikuar nga ligjvënësi në ndërtimin e vetë normës së parashikon veprën penale. Rrethanat cilësuese kanë të bëjnë me të dhënat e sjelljes kriminale, pra me veprimin a mosveprimin, me pasojën, por që nuk rrjedhin nga sjellja kriminale. Disa rrethana cilësuese, kanë të bëjnë me përcaktimin e subjektit të veprës penale; pra, përshkruajnë ose subjektin aktiv (autorin) ose atë pasiv të veprës penale. Në të drejtën penale, për disa vepra të caktuara penale, disa rrethana mund të përcaktojnë një subjekt të caktuar që mund të kryejë veprën penale; pra, një subjekt të posaçëm që mban disa cilësi të veçanta. Në këtë rast, kemi të bëjmë me vepra penale të veçanta, domethënë vepra penale që kryhen nga subjekte specifike (*delicta propria*), ndërsa për disa vepra të tjera penale, nuk ka ndonjë përcaktim të cilësisë së subjektit që kryen veprën penale dhe parashikohet ose kuptohet se “kushdo” mund të kryejë një veprë penale të caktuar. Në këtë rast, kemi të bëjmë me vepra penale të përgjithshme (*delicta impropria*), domethënë, vepra penale që kryhen nga subjekte të çfarëdoshme, ku cilësimi i subjektit aktiv nuk ka të bëjë me cilësimin e veprës penale.
49. Sa i përket çështjes së konkurrimit të rrethanave cilësuese, në mënyrë që të verifikohet përthithja e normës që parashikon rrethanën cilësuese të përgjithshme, në raport atë që parashikon një rrethanë cilësuese të veçantë, është e nevojshme që kjo e fundit, të përmbajë të gjitha elementet e veprës penale të parashikuar nga norma e përgjithshme, përveç elementëve të tjera specifike. Pra, në lidhje me aplikimin e rrethanave cilësuese apo jo, në rastin e kualifikimit të një veprimtarie kriminale, do të aplikohet fillimisht, parimi «*lex specialis derogat legi generali*», dhe më pas parimet e tjera të përpunuara nga doktrina.
50. Duke iu kthyer analizës së veprave penale të parashikuara nga nenet 135 (vjedhje duke shpërdoruar detyrën) dhe 136 (vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit) të Kodit Penal, Kolegjet vërejnë se qëllimi i rrethanës cilësuese të parashikuar në nenin 136 të Kodit Penal është mbrojtja e pasurisë së bankës në momentin e ndodhjes së faktit të vjedhjes, për shkak të rëndësisë së posaçme të pasurisë së bankës, që kryesisht konsiston në paratë e mbledhura nga publiku dhe për të cilat, garantohet një mbrojtje dhe një besueshmëri e lartë e tyre, ku edhe siguria e ruajtjes duhet të jetë maksimale. Vjedhja në këto kushte, është një sjellje që shkakton një pasojë, e cila tregon një rrezikshmëri më të madhe e të veçantë të personit që kryen veprën, duke vendosur kështu norma theksin në objektin material, që është pasuria e bankës dhe jo vetëm për shkak të vendit ku ndodh vepra. Ndërsa, në rastin e veprës penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, qëllimi i parashikimit ligjor është mbrojtja e pasurisë nga personi që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë; pra, norma parashikon një subjekt të posaçëm, si element të figurës së veprës penale dhe jo objektin e saj, që mund të konsistojë në çfarëdo lloj marrëdhënie pasurore, përveç asaj të bankave.

51. Në veprën penale të vjedhjes së bankës, duke patur parasysh qëllimin e dispozitës penale, për shkak të rëndësisë së posaçme të marrëdhënies juridike dhe institucionit, të cilit i referohet rrethana cilësuese, që është “banka, rrethana cilësuese për qëllim të zbatimit të normës, duhet kuptuar në një mënyrë më të gjerë se ai që lë të kuptohet termi “bankë”. Kjo për faktin se rëndësia e posaçme e marrëdhënies, qëllimi (*ratio*) i parashikuar nga norma, konsiston në vlerësimin e ekzistencës së një risku të shtuar, që vendos në rrezik më të madh vetëm pasurinë e bankës. Kjo edhe për shkak të një komplikimi dhe rëndimi të mundshëm të situatës që do të vinte, si rezultat i zbulimit eventual të personit që kryen vjedhjen, nga prania e rojeve të armatosura në bankë, dhe nga një zhvillim i pritur i shtimit të egërsisë së veprimeve të personit (subjekt aktiv të vjedhjes) që futet në një ambient të tillë dhe që mund të sjellë si pasojë edhe përballjen direkte dhe të rrezikshme të këtij personi me të gjithë personat që ndodhen në bankë. Në këtë aspekt, çështja përqendrohet në individualizimin e kritereve mbi bazën e të cilave mund të konkludohet për zbatueshmërinë e dispozitës në fjalë, nëse një vend duhet të hyjë në fushëzbatimin e nenit 136 të Kodit Penal. Kriteret që mund të ndiqen janë dy llojesh: kriteri material ose hapësinor, sipas të cilit kërkohet përkatësia e mjedisit në raport me bankën, kundrejt ambienteve të tjera që e rrethojnë atë. Kriteri kualitativ ose funksional, sipas të cilit kërkohet përkatësia e mjedisit në raport me bankën të jetë e destinuar për zhvillimin e aktivitetit të bankës me të gjitha mjediset e lidhura me të. Sipas kriterit të dytë, në mjediset e bankës përfshihen edhe godinat ku banka ushtron aktivitetin e saj, përfshirë këtu zyrat, magazinat dhe ambientet e tjera shërbyese, por edhe mjetet e tjera në dispozicion të saj, siç janë edhe automjetet me të cilat banka operon. Ky kriter ndiqet për faktin se, edhe këto ambiente janë mjedise të bankës që përmbajnë dhe përbëjnë pasuri të saj, të cilat janë në pronësi/përdorim po të bankës, ku person pasiv i veprës penale do të ishte po banka. Një kuptim ndryshe i këtyre ambienteve, duke dalluar për veprat penale që do të ndodhnin brenda bankës, për të cilat do të gjente zbatim neni 136 i Kodit Penal, në ndryshim nga ato siç janë: magazinat dhe ambientet e tjera shërbyese, automjetet me të cilat banka operon, për të cilat nuk do të zbatohet e njëjta normë; do të krijonte një dallim të papërligjur, duke trajtuar ndryshe personat që kryejnë një vepër penale kundër pasurisë së bankave, për shkak të vendndodhjes së pasurisë së bankës në mjedisin kryesor, apo mjediset e tjera që nuk janë pjese apo afër mjedisit kryesor me selinë e bankës.

52. Në referim të nenit 135 të Kodit Penal që parashikon veprën “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, me nocionin “ruajtje të pasurisë”¹¹ do të kuptojmë mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e pasurisë, me qëllim që të mos e sulmojnë, dëmtojnë apo vjedhin atë. Kurse, personi që ruan pasurinë, është ai i cili është ngarkuar për ta mbajtur apo për t’u kujdesur për atë pasuri. Ndërsa me nocionin “administrim” të pasurisë do të kuptojmë kujdesin e treguar për pasurinë, që ajo të përdoret mirë sipas rregullave ose sipas nevojave për ruajtjen e asaj pasurie, në bazë të drejtimit dhe organizimit të punës në një fushë të caktuar, në bazë të rregullave teknike dhe ligjeve përkatëse të shtetit.

53. Në lidhje me veprën e vjedhjes së bankës nga ana e punonjësit të bankës, nëse do t’i cilësonim veprimet kriminale të punonjësit të bankës, sipas nenit 135 të Kodit Penal, duke i dhënë përparësi subjektit të posaçëm, kjo normë nuk do përmbante të gjitha elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal. Për faktin se kjo normë nuk ka si objektin material pasurinë e bankës, por një objekt të përgjithshëm, që konsiston në çdo

¹¹ Fjalori shqip-shqip.

pasuri që është nën ruajtjen dhe administrimin e subjektit aktiv të posaçëm, përveç pasurisë së bankës për të cilën ligjvënësi ka parashikuar enkas një vepër penale të posaçme.

54. Në zbatim të parimeve të specialitetit dhe atij të subsidiaritetit, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, neni 135 i Kodit Penal, në krahasim me nenin 136 të Kodit Penal, vënë theksin në objekte të ndryshme. Në rastin e nenit 135 të Kodit Penal, për veprën penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, evidentohet jo shumë objekti i veprës penale, domethënë, lloji i pasurisë së mbrojtur dhe vendi ku kryhet vepra penale, por subjekti i posaçëm. Subjekti posaçëm në rastin e nenit 135 të Kodit Penal, për shkak të funksionit që mban, ka të bëjë me pasuri, të cilën e ka ligjërisht në disponim atë duke e përvetësuar atë. Këtu mbrojtja e poseduesit legjitimin për pasurinë rezulton e zvogëluar, pasi ai në mirëbesim mbahet nga subjekti i posaçëm, i cili duke përfituar nga rasti vendos ta vjedhë atë. Ndërsa, në rastin e nenit 136 të Kodit Penal, për veprën penale të vjedhjes së bankave, qëllimi i normës, nuk është evidentimi i subjektit aktiv që punon në bankë (pasi është vepër që mund të kryhet nga subjekte jo të veçanta), por objekti i veçantë. Pra, “pasuria” e bankës dhe që ligjërisht ka të drejtë ta disponojë banka në mënyrë ligjshme si person juridik sipas organeve përkatëse emër dhe për llogari të saj, dhe jo punonjësit e saj në mënyrë të paligjshme. Duke vënë theksin në rëndësinë e posaçme të objektit të veprës penale, në bazë të parimit të specialitetit, vërehet se specialiteti i objektit të veprës penale të vjedhjes së bankave, është më i posaçëm, sesa specialiteti i subjektit pasiv të veprës penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën. Në rastin e nenit 135 të Kodit Penal, personi i posaçëm vjedh një pasuri që e ka në disponim atë, por jo atë bankare. Kësisoj, në bazë të parimit të subsidiaritetit, përparësi duhet të gjejë neni 136 i Kodit Penal, pavarësisht cilësisë së personit punonjës ose jo, që ka vjedhur pasurinë e bankës.
55. Një tjetër argument në favor të këtij përfundimi, do të ishte edhe interpretimi i normave sipas qëllimit të ligjvënësit. Nisur nga një kriter i tillë interpretimi, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se neni 135 i Kodit Penal që parashikon veprën penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, përcakton një sanksion më të ulët dënimi sesa neni 136 i Kodit Penal që parashikon sanksionin për veprën penale të vjedhjes së bankave. Në këto kushte, ligjvënësi ka dashur t’i sigurojë një mbrojtje të veçantë pasurisë së bankës, si një institucion që ushtron veprimtarinë e pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku, duke i përdoruar ato për dhënie kredie dhe vendosur në emër dhe për llogari të saj. I njëjti arsyetim mund të bëhet edhe për Bankën e Shqipërisë, së cilës i është dhënë e drejta e nxjerrjes dhe e vënies në qarkullim të monedhës shqiptare, e drejta e zbatimit të pavarur të politikës monetare dhe e mbajtjes, administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë. Nuk ka qenë qëllimi i ligjvënësit që vepra penale e vjedhjes së pasurisë së bankës nga personi që ka për detyrë që ta ruajë dhe administrojë këtë pasuri, të dënohej më pak sesa personi i jashtëm, i cili vjedh pasurinë e bankës, duke mos qenë punonjës i saj. Kështu, vepra penale e parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal përcakton një dënim me burgim gjër në 10 vjet, ndërsa ajo e parashikuar nga neni 136/1 i Kodit Penal, përcakton një dënim me burgim nga 5 deri në 15 vjet burgim, dhe ajo sipas paragrafit të dytë nga 10 deri në 20 vjet burgim.
56. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, theksojnë se rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer nga punonjësi, i cili ka për detyrë ta ruajë dhe administrojë pasurinë është më e madhe sesa e asaj të kryer nga një person që nuk është punonjës i saj, pasi atij të parit, i është besuar një detyrë e rëndësishme në institucionin bankë dhe për këtë arsye, për

personin që vjedh pasurinë e bankave, qoftë gjatë apo për shkak të ushtrimit të funksionit, do të gjejë zbatim vepra penale e vjedhjes së bankës parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal, duke u përthithur rrezikshmëria e nenit 135 nga neni 136 i Kodit Penal.

57. Prandaj, lidhur me pyetjen e parë të shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara, arrijnë në përfundimin unifikues se: **personi, i cili vjedh pasurinë e bankave, gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave për administrimin apo ruajtjen e kësaj pasurie, do të përgjigjet për veprën penale të “Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit”, parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal.**

III – 2. Në lidhje me nënpyetjen e parë të shtruar për unifikim

I.a. Personi punonjës i bankës që kryen një detyrë në administrimin apo ruajtjen e kësaj banke, i cili vjedh pasurinë e bankave apo të arkave të kursimit, duke përdorur, dhunë, mbajtur armë a municion, apo shkakton vdekjen e një personi, për cilën nga veprat do të përgjigjet?

58. Kolegjet e Bashkuara në bazë të përfundimeve të arritura më sipër, vërejnë se në rastin e shoqërimit gjatë vjedhjes së bankës me rrethanën e përdorimit të dhunës, mbajtjes së armës a municionit, apo të asaj me pasojën e vdekjen së personit, nuk kemi të bëjmë me një “konkurrim në dukje të normave penale” midis veprave të përbëra, por me një konkurrim efektiv veprash penale, për ato pjesë/fakte të rrethanave që cenohet një lloj tjetër marrëdhënieje juridike, siç është shëndeti, liria personale, rendi dhe siguria (në rast përdorimi të armës), e drejta e jetës, etj. Në këto kushte, duke qenë veprat penale të vjedhjes në rrethana të cilësuar, vepra penale të përbëra dhe që mbrojnë dy objekte, domethënë dy lloj marrëdhëniesh juridike, për shkak të rëndësisë së objektit të veprës penale të vjedhjes së bankave, kur vjedhja ndodh në bankë, vetëm për pjesën që i përket “pasurisë së bankës” do të gjejë zbatim neni 136 i Kodit Penal. Ndërsa në rast se gjatë kryerjes së kësaj vepre rezulton se janë cenuar edhe lloje të tjera marrëdhëniesh juridike që mbrohen shprehimisht nga norma të tjera penale, për këtë pjesë nuk do të zbatohet *lex specialis*, por do të zbatohen në mënyrë kumulative veprat penale sipas normave penale që parashikojnë veprat penale përkatëse përbërëse sipas rrethanave cilësuese, siç janë: vepra e plagosjes a dëmtimeve si rezultat i përdorimit të dhunës, krahas asaj të vjedhjes së bankës, dhe nëse plagosja është bërë me armë, konkurrimi, krahas vjedhjes së bankës edhe i veprës penale të plagosjes me atë të mbajtjes së armës pa leje.
59. Kolegjet vlerësojnë se në rastin kur gjatë vjedhjes së bankës përdoret “dhunë”, apo mbahet “armë” a “municione”, apo ndodh “vdekja e një personi” tjetër, nuk mund të gjejnë zbatim asnjë nga parimet për konkurrimin e normave, përkatësisht, parimi i specialitetit, ai i subsidiaritetit, si dhe parimi i përthithjes së rrethanave të posaçme. Kjo për faktin se kemi të bëjmë me marrëdhënie juridike me objekte të ndryshme, duke u zbatuar në këtë rast, konkurrimi i veprave penale përbërëse në masën që mbrojnë objektin e ndryshëm nga ai i pasurisë së bankës, për shkak të cenimit të më shumë sesa të një marrëdhënieje juridike, veç asaj të pasurisë së bankës. Çka do të thotë se, vepra penale e vjedhjes së bankave, konkurron me veprën penale të plagosjes, a dëmtimeve të tjera, pasi mbrohet edhe shëndeti i personit, por nuk konkurron me veprën penale të vjedhjes me dhunë të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Po ashtu, vepra penale e vjedhjes së bankave konkurron me veprën

penale të mbajtjes pa leje të armëve apo municionit, por jo me veprën penale të vjedhjes me armë që parashikohet nga neni 140 i Kodit Penal. Edhe në rastin e ndodhjes së pasojës së vdekjes së një personi, gjatë ekzekutimit të veprës së vjedhjes së bankave, këto vepra do të konkurrojnë së bashku, duke u zbatuar përkatësisht, konkurrimi material i veprave penale, për shkak të cenimit të më shumë se një marrëdhënieje juridike të mbrojtur posaçërisht. Në rastin konkret, konkurrimi i veprës penale të vjedhjes së bankave me atë të vrasjes, por jo me veprën të vjedhjes me pasojë vdekjen të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal. Në këtë rast, nëse vrasja ka ndodhur me armë zjarri, kjo vepër konkurron edhe me atë të mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit. Për ilustrim, nëse një person punonjës i bankës planifikon për të vjedhur pasurinë e bankës (paratë që janë në kasafortën e saj) dhe gjatë ekzekutimit të vjedhjes dëmtohen mjediset e bankës, përdoret arma për të shtënë në dorë pasurinë dhe vritet një person në bankë, për këtë rast, do të kemi konkurrimin efektiv të veprave penale të vjedhjes së bankës, me atë të dëmtimit të pasurisë me dashje, me atë të veprës penale të vrasjes me dashje të atypëratyshme, si dhe me veprën penale të mbajtjes pa leje të armës. Pra, në këtë rast do të gjejë zbatim instituti i bashkimit të dënimeve parashikuar nga neni 55 i Kodit Penal, dhe jo neni 141 i Kodit Penal.

60. Në lidhje me nënpyetjen e parë të shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara, arrijnë në përfundimin unifikues se: **personi punonjës i bankës, i cili vjedh pasurinë e bankave ose të arkave të kursimit duke përdorur, dhunë, mbajtur armë a municion, apo ka shkaktuar vdekjen e një personi, etj., ai do përgjigjet për veprat penale, sipas nenit 136 të Kodit Penal së bashku me veprën penale tjetër përbërëse që mbron marrëdhënien juridike të ndryshme nga pasuria efektivisht të cenuar sipas rrethanave, dhe jo për veprën penale përkatësisht, sipas nenit 135, apo nenit 139, apo nenit 140, apo nenit 141 të Kodit Penal.**

III – 3. Në lidhje me nënpyetjen e dytë të shtruar për unifikim

1.b. Personi, i cili ushtron dhunë për vjedhjen e pasurisë bankare apo të arkave të kursimit apo nën kërcënimin dhe përdorimin e armëve, apo duke sjellë si pasojë të rëndë vdekjen e personave të tjerë, kryer në bashkëpunim me personin gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave në administrimin apo ruajtjen e pasurisë së bankave, për cilat vepra do përgjigjet, sipas nenit 135 dhe 25, apo nenit 136/2, apo nenit 139 dhe 25, apo nenit 140 dhe 25, apo nenit 141 dhe 25 të Kodit Penal?

61. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se një nga parimet themelore të së drejtës penale është edhe ai i autonomisë së përgjegjësisë, i quajtur ndryshe edhe parimi i përgjegjësisë personale të personit që kryen vepër penale. Parimi i autonomisë së përgjegjësisë shfaqet edhe në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material ose moral për kryerjen e veprës penale. Dallimi mes aplikimit të parimit të autonomisë së përgjegjësisë në veprat penale me një autor të vetëm, nga ato të kryera në bashkëpunim, qëndron në faktin se, në rastin e parë, autori duhet të ketë kryer edhe materialisht veprën penale, ndërsa në rastin e bashkëpunimit, mjafton edhe që ai të ketë lehtësuar kryerjen e veprës penale nga persona të tjerë (Vendimi Unifikues nr.4, datë 15.04.2011), duke sjellë një kontribut relevant për kryerjen e veprës penale në mënyrë kolektive nga një pluralitet personash.
62. Sa i përket institutit të bashkëpunimit në veprën penale, sipas doktrinës shqiptare, bazën e përgjegjësisë penale në bashkëpunim, në kuptimin material dhe juridiko-formal, ashtu

sikurse edhe për kryerjen e veprës penale nga një person i vetëm, në çdo rrethanë e përbën prania e veprës penale dhe e figurës së saj juridike me veprimin ose mosveprimin e pjesëmarrësit. E drejta penale nuk devijon nga ky parim themelor dhe i përgjithshëm i përgjegjesisë penale as në kushtet kur vepra kryhet në bashkëpunim.

63. Në lidhje me konfigurimin e veprës penale të bashkëpunimit (eventual) të personave në një vepër penale, janë të nevojshëm: 1) pluraliteti i subjekteve aktivë, 2) realizimi i një vepre penale të parashikuar si të atillë nga ligji material penal, 3) kontributi objektivisht relevant i bashkëpunëtorit (përkatesisht i ndarë sipas roleve vertikale: organizatorë, ekzekutorë, shtytës, ndihmës, apo të ndarë horizontalisht sipas punëve në veprën e përbashkët (Vendimi Unifikues nr.1, datë 12.03.2002), dhe 4) elementi subjektiv.
64. Nga pikëpamja e anës objektive kërkohet që vepra penale të jetë kryer nga jo më pak se dy persona, pra të provohet që në kryerjen e saj të kenë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen nga gjykatat e faktit referuar rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të Kodit Penal.
65. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ana subjektive përbën një nga komponentët strukturore të institutit të bashkëpunimit, i cili kërkon si element të domosdoshëm ekzistencën e një marrëveshjeje në kryerjen e veprës penale (*pactum sceleris*). Në përcaktimin e kushteve të marrëveshjes për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, ana subjektive në kryerjen e veprës penale në bashkëpunim konsiston në dy elemente: - ndërgjegjja dhe vullneti i personit për të kryer veprën penale dhe - vullneti për të bashkëpunuar me persona të tjerë për kryerjen e saj. (Vendimi Unifikues nr.4, datë 15.04.2011). Që një vepër penale të konsiderohet e kryer në bashkëpunim, nuk kërkohet prania e një marrëveshjeje të shprehur, por mjafton edhe rënia dakord me anë të veprimeve konkludente në faza të ndryshme të konceptimit, përgatitjes, organizimit dhe ekzekutimit të veprës penale, me kushtin që secili prej bashkëpunëtorëve të jetë i ndërgjegjshëm për veprimet e të tjerëve, duke ndikuar/lehtësuar ato në kryerjen e një fakti penal të përbashkët.
66. Pavarësisht nga kontributi dhe roli që luajnë në kryerjen e veprës penale, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen për veprat penale që varen nga veprimtaria kriminale e rënë dakord nga ana e tyre sipas planit apo objektivit kriminal të synuar bashkërisht prej tyre. Bashkëpunëtori duhet të jetë i ndërgjegjshëm se veprimet e tij bëhen në kuadrin e marrëveshjes me bashkëpunëtorët e tjerë dhe janë pjesë e së tërës, pra pjesë e veprimtarisë së përbashkët dhe se kanë lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar prej tij dhe prej të gjithë të tjerëve. Shkalla e përgjegjesisë së bashkëpunëtorëve ndryshon në varësi kontributit të dhënë në kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve të tyre konkrete, për të cilat ata përgjigjen personalisht. Kjo pasi, si në rastin kur vepra penale kryhet nga një person i vetëm, ashtu edhe në rastin e bashkëpunimit, në të drejtën penale gjen zbatim *parimi i përgjegjesisë personale*, sipas të cilit për secilin prej bashkëpunëtorëve duhet të verifikohen më vete ekzistenca e elementeve objektive dhe subjektive të figurës së sipas shkallës së pjesëmarrjes së tyre në realizimin e veprës penale të përbashkët në caktimin e dënimit sipas nenit 27 të K.Penal.
67. Sa i takon objektit të bashkëpunimit, kur vepra penale kryhet në bashkëpunim, si rregull, bashkëpunëtorët duhet të përgjigjen për veprën penale të parashikuar nga e njëjta dispozitë e pjesës së posaçme të Kodit Penal. Por, bashkëpunëtorët në kryerjen e veprës penale

përgjigjen vetëm brenda kufijve të marrëveshjes së tyre, ata përgjigjen vetëm për veprimet e veta që kanë kontribuar, në çdo formë qoftë ajo, në arritjen e objektivit kriminal, si dhe për ato veprime ose mosveprime të kryera nga bashkëpunëtorët e tjerë që burojnë nga marrëveshja dhe që janë brenda masës së nevojshme për zbatimin e vendimit apo të synimeve të përfshira në planin e tyre të përbashkët kriminal. Ata nuk përgjigjen për veprime të ekzekutorit gjatë kryerjes së veprës penale, që dalin tej marrëveshjes, jashtë planit të përgjithshëm të bashkëpunimit, të cilat cenojnë marrëdhënie juridiko-penale të tjera, duke shkaktuar pasoja kriminale të padëshiruara prej tyre. Në të drejtën penale këto tejkalime apo teprime quhen eksesi i ekzekutorit. Për to, përgjigjet vetëm ekzekutori apo bashkëekzekutorët që i kanë kryer.

68. Në bazë të vendimin Unifikues nr.1, datë 12.03.2002, të Kolegjeve të Bashkuara, është përcaktuar se, “kur vepra penale kryhet në bashkëpunim, si rregull, bashkëpunëtorët duhet të përgjigjen për veprën penale të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Por, kjo ka të bëjë me përgjegjësinë penale të bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprës penale, në rastet kur ndodhemi para ndarjes klasike të roleve, në organizatorë, shtytës dhe ndihmës dhe jo edhe kur shtrohet problemi i përgjegjësisë penale të bashkëekzekutorëve të një veprë penale, ku ndodhemi përpara ndarjes së punëve midis pjesëmarrësve në një veprimtari të caktuar kriminale, sikurse në rastin në gjykim dhe jo përpara ndarjes së roleve. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga parimet e përgjithshme të doktrinës të së drejtës penale sipas të cilave, kur ndodhemi para figurave specifike të veprës penale (*delictum proprium*) në të cilat bashkëekzekutimi është i mundur vetëm midis personave që janë mbajtës të disa cilësive të veçanta, për të qenë subjekte të disa veprave penale, (subjekte të posaçme), vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet sipas dispozitës së Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, subjekt i të cilës mund të jenë vetëm personat që janë mbajtës të këtyre cilësive të veçanta. E tillë është edhe figura e krimit të kontrabandës nga punonjës të doganave parashikuar nga neni 175 i K.Penal”.
69. Sa i takon bashkëpunimit të në të njëjtën vepër penale midis subjekteve bashkëpunëtorë që janë mbajtës të disa cilësive të veçanta, të veprës penale, (subjekte të posaçme) dhe subjekteve bashkëpunëtorë që nuk janë mbajtës të disa cilësive të veçanta, të veprës penale, por subjekte të çfarëdoshëm, domethënë në rastin e bashkëpunimit të subjektit me cilësi të veçantë të veprës penale dhe subjektit të jashtëm në raport me veprën penale që nuk i ka këto cilësi, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se me vendimin Unifikues nr.1, datë 12.03.2002, në lidhje me bashkëpunimin e subjekteve të veçanta (*intraneus*) në veprën penale të kontrabandës nga punonjësit e kontrabandës me subjekte të tjera (*extraneus*) që nuk e kanë këtë cilësi, kanë përcaktuar se, vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet sipas dispozitës përkatëse të nenit 175 të Kodit Penal, “kontrabandë nga punonjës të doganave”. Ky konkluzion i përket vetëm zbatimit të nenit 175 të Kodit Penal, që parashikon veprën e kontrabandës nga punonjës të doganave.
70. Në lidhje me çështjen e konkurrimit të subjekteve aktivë të përgjithshëm në një vepër penale të veçantë për të cilën, për autorin kërkohet pasja e një cilësie të posaçme, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se në rastin e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, bashkëpunimi i një subjekti të veçantë (*intraneus*) me një subjekt tjetër të përgjithshëm (*extraneus*) përbën një rast të veçantë, që është parashikuar shprehimisht dhe posaçërisht nga neni 175 i Kodit Penal, i cili disponon se “*Kryerja e kontrabandës nga*

punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”.

71. Ndërsa në lidhje me veprat e tjera penale, për të cilat nuk është parashikuar në mënyrë posaçërisht të shprehur nga norma penale inkriminuese, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën bashkëekzekutimit, si rregull, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen për të “njëjtën vepër penale” të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posaçme të Kodit Penale. Në rastin e personave të tjerë të përgjithshëm (*extraneus*) që nuk mbajnë cilësitë e veçanta apo nuk kanë pozitën subjektive të personit të cilësuar në veprën penale dhe që bashkëpunojnë me subjektin e cilësuar, të gjithë bashkëpunëtorët, qofshin ata të cilësuar apo të përgjithshëm, do të përgjigjen për të njëjtën vepër penale, **vetëm kur personat e përgjithshëm bashkëpunëtorë që nuk janë të cilësuar (*extraneus*) janë të vetëdijshëm, duke pasur dijeninë në lidhje me cilësinë apo pozitën subjektive të personave të cilësuar dhe kjo cilësi e tyre ka lehtësuar bashkëpunimin për kryerjen e veprës penale të përbashkët.** Pra, nëse personat e tjerë nga ata që janë të cilësuar, kanë anën subjektive lidhur me cilësinë e veçantë të personit të veprës penale, qoftë në formën e pakujdesisë, ku personi duhej dhe mund ta kishte parashikuar rrethanën e cilësisë së veçantë të personit të veçantë, qoftë në formën e dashjes, të dy këto kategori bashkëpunëtorësh do të përgjigjen për të njëjtën vepër penale. **Në mënyrë që bashkëpunëtorët e tjerë të përgjigjen për veprën penale të kryer nga bashkëpunëtorë me cilësi të veçanta (*intraneus*), ata duhet të kenë dijeni rreth bashkëpunimit (kontributit bashkëpunues) dhe pranisë së një subjekti të veçantë, domethënë të cilësuar që ka kontribuar në kryerjen e veprës penale që është rënë dakord edhe me të tjerët.** Nëse mungon elementi subjektiv rreth dijenisë së rolit dhe subjektit të posaçëm, nga të gjithë bashkëpunëtorët e tjerë, atëherë për këtë cilësi, kur konsiderohet jashtë marrëveshjes së të gjithë bashkëpunëtorëve do të përgjigjet vetëm personi që ka apo në rast bashkëekzekutimi vetëm ata persona që e kanë bashkëekzekutuar, duke u konsideruar kjo cilësi si eksesi i ekzekutorit, dhe mos iu atribuuar bashkëpunëtorëve të tjerë. Në arritjen e këtij përfundimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbajnë parasysh parimin themelor të së drejtës penale të përgjegjësisë personale të personit që kryen veprën penale.
72. Duke u kthyer çështjes objekt shqyrtimi, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, në bazë të konkluzioneve të mësipërme u arrit në përfundimin se personi, i cili vjedh pasurinë e bankave, gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave për administrimin apo ruajtjen e kësaj pasurie, përgjigjet për veprën penale të “Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit”, parashikuar nga neni 136 i Kodit Penal. Kjo vepër penale është e përgjithshme, pra nuk kërkohet ndonjë cilësi e veçantë e subjektit aktiv për kryerjen e veprës penale kur kemi të bëjmë me bashkëpunim personash. Nëse gjatë kryerjes së kësaj vepre penale nga personi i jashtëm, i cili ka përdorur, dhunë, ose mbajtur armë a municion, apo ka shkaktuar vdekjen e një të treti, në bashkëpunim me personin punonjës të bankës (*intraneus*), ata do përgjigjen sipas objektit të marrëveshjes për veprat penale, në bazë të nenit 136/2 të Kodit Penal së bashku me veprën penale tjetër përbërëse, e cila mbron marrëdhënien tjetër që rezulton të jetë cenuar efektivisht në kufirin e bashkëpunimit. Pra, jo për veprën penale përkatësisht, sipas nenit 135-25, 139-25, 140-25, apo 141-25 të Kodit Penal. Nëse gjatë gjykimit provohet vetëm eksesi i ekzekutorit në kryerjen e veprës penale tjetër sipas rrethanës cilësuese, përgjegjësi do të mbajë vetëm ekzekutori për atë vepër, ndërsa personi

tjetër bashkëpunëtor do të përgjigjet për veprën për të cilën ishte lidhur edhe marrëveshja dhe rënë dakord mes bashkëpunëtorëve.

73. Si përfundim, në lidhje me nënpyetjen e dytë të shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara, arrijnë në përfundimin unifikues se: **personi, i cili ushtron dhunë për vjedhjen e pasurisë bankare apo të arkave të kursimit, apo nën kërcënimin dhe përdorimin e armëve, apo duke sjellë si pasojë të rëndë vdekjen e personave të tjerë, etj., kryer në bashkëpunim me personin gjatë ose për shkak të kryerjes së detyrave në administrimin apo ruajtjen e pasurisë së bankave, do të përgjigjen përkatësisht, sipas veprave të parashikuara nga neni 136/2 i Kodit Penal, së bashku me veprën penale tjetër përbërëse sipas rrethanës që mbron marrëdhënien e ndryshme efektivisht të cenuar, sipas rregullave për bashkëpunimin, dhe jo për veprën penale përkatësisht, sipas nenit 135 dhe 25, nenit 139 dhe 25, apo nenit 140 dhe 25, nenit 141 dhe 25 të Kodit Penal.**

IV. Lidhur me zgjidhjen e çështjes

74. Në përfundim, duke iu kthyer rekursit objekt shqyrtimi, Kolegjet e Bashkuara pasi shqyrtuan rrethanat dhe faktet sikundër janë pranuar dhe nga vetë gjykata e apelit, në vështrim të parimeve kushtetuese dhe atyre të procedurës penale, vlerësojnë se veprimi kriminal i kryer nga ana e të gjykuarit Gjergj Xhaho, bazuar në konkluzionet e mësipërme të arritura për unifikimin e praktikës gjyqësore, duhet të cilësohet si “vjedhje e bankave dhe e arkave të kursimit” sipas nenit 136/2 të Kodit Penal. Për arsye se qëllimi i normës që parashikon këtë vepër penale, nuk është evidentimi i subjektit aktiv që punon në bankë, pasi është vepër penale që mund të kryhet nga subjekte jo të veçantë. Në fakti qëllimi i nenit 136/2 të Kodit Penal, është mbrojtja e objektit të veçantë, pra e “pasurisë” së bankës dhe që ligjërisht ka të drejtë ta disponojë “banka” në mënyrë ligjshme si person juridik, dhe jo punonjësit e saj në mënyrë të paligjshme, që kurrsesi nuk mund të përfaqësojnë vullnetin e bankës. Në rastin konkret, nisur nga pasoja e rëndë e shkaktuar nga ana e të gjykuarit Xhaho, ku dëmi i shkaktuar ndaj pasurisë së personit të dëmtuar nga vepra penale, domethënë bankës, kalon vlerën mbi 2.000.000 lekë (Vendim Unifikues nr.5/2003, datë 11.11.2003), duhet të zbatohet paragrafi i dytë i nenit 136/2 të Kodit Penal, duke u ndryshuar vendimi i gjykatës së apelit për këtë pjesë.
75. Megjithatë, Kolegjet çmojnë se, në lidhje me akuzën e falsifikimit të dokumenteve të ngritur ndaj të gjykuarit Xhaho, duke qenë se kjo vepër është kryer me qëllim shtënien në dorë të pasurisë së bankës, si edhe mbështetur në faktin se, nga njëra anë, vepra penale e falsifikimit të dokumenteve është e klasifikuar në kreun e tretë të Kodit Penal dhe ka për qëllim mbrojtjen e besueshmërisë së dokumenteve të bankës, dhe nga ana tjetër, vetë qëllimi i normës është mbrojtja e posaçme e marrëdhënies së pasurisë së bankës për shkak të besueshmërisë dhe sigurisë që ekziston në këtë institucion, në rastin konkret, figura e veprës penale të falsifikimit të nënshkrimeve për shtënien në dorë të pasurisë së bankës, sipas parimeve për konkurrimin e normave penale, përthithet dhe nuk konkurron me veprën penale të vjedhjes së bankave sipas nenit 136/2 të Kodit Penal. Kjo për shkak se nga ana objektive kemi të bëjmë me të njëjtin fakt dhe kundërligjshmëria e normës penale që parashikon veprën penale të vjedhjes së bankave me pasoja të rënda, përfshin edhe faktin e kundërligjshëm të falsifikimit kur ai është kryer si mjet për shtënien në dorë të pasurisë që synohet për vjedhje. Në këto kushte, arrihet në përfundimin se akuza për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve duhet të pushohet për shkak se përthithet në

këtë rast, nga vepra penale e vjedhjes së bankave sipas nenit 136/2 të Kodit Penal. Lidhur me pjesët e tjera, për fillimin e datës së vuajtjes së dënimit, provat materiale, asgjësimin e tyre dhe shpenzimet procedurale, vendimi i gjykatës së apelit duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 438 dhe 441 të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N:

- Ndryshimin e Vendimit nr.715, datë 20.12.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë lidhur me cilësimin ligjor të veprës penale, duke e deklaruar fajtor të pandehurin Gjergj Xhaho veprën penale të “vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit”, parashikuar nga neni 136/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit, duke dënuar përfundimisht me 12 vjet burgim.

- Pushimin e çështjes penale për akuzën e ngritur për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

- Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera.

- Unifikimin e praktikës gjyqësore siç parashikohet në këtë vendim.

- Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi.

Tiranë, më 02.11.2015

ANËTAR

Andi ÇELIKU

ANËTAR

Medi BICI

KRYESUES

Xhezair ZAGANJORI

ANËTARE

Evelina QIRJAKO

ANËTAR

Aleksandër MUSKAJ

ANËTAR

Guxim ZENELAJ

ANËTAR

Shkëlzen SELIMI

ANËTAR

Ardian DVORANI

ANËTAR

Edmond ISLAMAJ

ANËTAR

Tom NDRECA

ANËTARE

Majlinda ANDREA

ANËTAR

Artan BROCI

ANËTAR

Admir THANZA

ANËTAR

Artan ZENELI

Nr.1 i Regj. Themeltar
Nr.2 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

në seancën e datës 25.05.2015, mori në shqyrtim çështjen penale me nr.Akti 52601-01615-00-2014 që i përket:

KËRKUES: ALEKSANDËR PRENGA

OBJEKTI:
Lirim me kusht

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.36, datë 28.05.2014 ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesës së kërkesit Aleksandër Prenga si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.121 datë 18.09.2014 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.36, datë 28.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në këtë mënyrë:

Pranimin e kërkesës së kërkesit Aleksandër Prenga.

Urdhërohet lirimi me kusht i të dënuarit Aleksandër Prenga për pjesën e pavuajtur të dhënë me vendimin nr.25, datë 02.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, i lënë në fuqi me vendimin nr.824, datë 17.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë duke urdhëruar vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 18 muajsh.

Urdhërohet i dënuari të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Lezhë gjatë periudhës së provës.

Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit Aleksandër Prenga nëse nuk ka masë sigurimi “Arrest në burg” për llogari të ndonjë procedimi tjetër penal ose dënim tjetër me burgim.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka paraqitur rekurs, me datë 22.09.2014 Prokurori pranë Prokurorisë së Apelit Shkodër, i cili kërkon ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe lënien në fuqi të vendimit nr.36, datë 28.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke paraqitur këto shkaqe:

- Lirimi me kusht nuk është një dispozitë detyruese, pasi ajo parashikon se i dënuari me burgim mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta.
- Është e rëndësishme të përgjithësohet qëndrimi se “arsyet e veçanta” që justifikojnë lirimin e parakohshëm të të dënuarit duhet të kenë natyrë jetike dhe të burojnë nga shkaqe shëndetësore, familjare ose shoqërore që diktojnë në mënyrë të detyrueshme vijimësinë e edukimit dhe rehabilitimit të të dënuarit pranë familjes, komunitetit apo nën kujdesin e nevojshëm mjekësor. Praktika gjyqësore ka zgjeruar kufijtë e vlerësimit dhe në drejtim të llojit të veprës penale, rrezikshmërisë së autorit dhe kohës së shkurtër të puvajtur nga dënimit penal (vendimi nr 445, datë 08.10.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).
- Vepra penale e kryer e të dënuarit paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore; ne raport me masën e dënimit, të dënuarit i mbeten edhe 7 muaj dhe 12 ditë, periudhë kjo e konsiderueshme në raport me masën e dënimit.
- Shërbimi i Provës në raportin e përgatitur para gjykatës nuk shprehet apo më saktë nuk rekomandon lirimin e tij.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin nga gjyqtarët Shkëlzen SELIMI dhe Artan BROCI; prokurorin Artur SELMANI, i cili kërkoj prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbrojtësin e caktuar kryesisht të kërkuesit Aleksandër Prenga, Av.Sonila ÇEKREZI, e cila kërkoj lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e çështjes

1. I dënuari, kërkuesi, Aleksandër Prenga, ka vuajtur në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (“IEVP”), Shënkoll, Lezhë dënimin e dhënë me vendimin penal nr.25, datë 02.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë. Sipas këtij vendimi ai është deklaruar fajtor dhe dënuar me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim për kryerjen e veprave penale të “Vjedhjes me armë” në bashkëpunim, “Plagosjes së rëndë me dashje” në bashkëpunim dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” të parashikuara nga nenet 140-25, 88/2-25 dhe 278/2 të Kodit Penal. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.824, datë 17.11.2006 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

2. Siç rezulton nga aktet e ndodhura në dosje (kartela personale e të dënuarit Aleksandër Prenga e plotësuar më datë 27.02.2007) ai është arrestuar më datë 02.12.2005. I dënuari Aleksandër Prenga, duke pretenduar se plotëson kushtet e nenit 64 të K.Penal, i është drejtuar Gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë, me kërkesën për lirimin e tij me kusht.

3. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit, përcjellë gjykatës me shkresën nr.10161, datë 27.11.2013, rezulton se kërkuesi Aleksandër Prenga është arrestuar më datë 02.12.2005, dhe

deri më datë 02.12.2013 ka vuajtur 9 (nëntë) vjet 8 (tetë) muaj e 7 (shtatë) ditë nga të cilat 5 (pesë) muaj e 22 (njëzetedy) ditë i ka fituar me paraburgim, 1(një) vit, 2 (dy) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë me vendime gjyqësore për ulje dënimi dhe i kanë mbetur për të vuajtur edhe 2 (dy) vjet 3 (tre) muaj e 23(njëzet e tre) ditë. Nga dinamika e vuajtjes së dënimit hartuar nga I EVP Lezhë, e cila i është përcjellë gjykatës me shkresën nr.4681, datë 19.05.2014 rezulton se kërkuesi Aleksandër Prenga deri me datë 19.05.2014 të ketë shlyer 11 (njëmbëdhjetë) vjet 4 (katër) muaj e 18 (tetëmbëdhjetë) ditë burgim dhe t'i kenë mbetur për të vuajtur 7 (shtatë) muaj e 12 (dymbëdhjetë) ditë. Ai ka përfutur ulje dënimi, përkatësisht 1(një) vit me ligjin nr 22/2014 , datë 10.03.2014 “Për dhënie amnistie” dhe 1 (një) vit 5 (pesë) muaj e 9 (nëntë) ditë me vendime gjyqësore për ulje dënimi, në zbatim të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

4. Me vendimet penale nr.288, datë 11.07.2011, nr.295, datë 31.05.2010, nr.150, datë 15.04.2009, nr.148, datë 17.03.2008, nr.342, datë 27.07.2012, nr.108, datë 20.02.2013 dhe nr.141, datë 24.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë rezulton se të dënuarit Aleksandër Prenga t'i jetë ulur dënimi si rezultat i zbatimit të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

5. Kërkuesi ka paraqitur dokumente të tjerë shkresorë, të cilat kanë marrë vlerën e provës, për të vërtetuar se plotëson kushtet e Nenit 64 të K.Penal; të tilla janë:

- i. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore nr.2, datë 03.05.2011, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë, nga ku rezulton se i dënuari Aleksandër Prenga është dënuar vetëm një herë sipas vendimit penal të gjykatës së rrethit gjyqësor Mirditë nr.25, datë 02.05.2006 dhe të mos jetë recidivist në krim.
- ii. Raporti i I EVP Shënkoll nr.10163 prot, datë 27.11.2013 nga ku rezulton se i dënuari Aleksandër Prenga është dënuar me 12 vite burgim për veprat penale të parashikuara nga nenet 140-25, 88/2-25 dhe 278/2 të K.Penal, është i penduar për veprën e kryer, nuk ka konsumuar vepër tjetër penale, paraqitet me gjendje fizike dhe psikologjike të mirë, ndërsa e sjellja e tij gjatë 3(tre) viteve të fundit ka qenë e mirë.
- iii. Vlerësimi i sjelljes nr.10162, datë 27.11.2013 i lëshuar nga I EVP Shënkoll, Lezhë, sipas të cilit rezulton se i dënuari Aleksandër Prenga të jetë vendosur në këtë institucion më datë 26.02.2007, është beqar, me arsim 8 klasë, i penduar për veprën e kryer për të cilën shprehet se ka ndodhur për shkak të moshës; zbaton kërkesat e rregullores, nuk është i ndëshkuar me masë disiplinore për tre vitet e fundit, ka marrëdhënie që nuk kanë rënë ndesh me personelin, reciprokisht të mira me bashkëvuajtësit, ndërsa me familjen ruan kontaktet dhe marrëdhëniet korrekte duke e pasur si burim mbështetjeje. I dënuari nuk bën pjesë në listën e të punësuarve, nuk është pjesë e programeve të arsimit profesional, por merr pjesë në programet terapeutike duke pranuar këshillat, bisedën, punën në grup si dhe ka aktivizim të mirë e korrekt në veprimtaritë kulturore dhe sportive. Si konkluzion komisioni i vlerësimit i I EVP Lezhë e ka vlerësuar pozitivisht kërkuesin për periudhën 3 vjeçare në lidhje me kërkesën objekt gjykimi.
- iv. Raporti i Vlerësimit i hartuar nga Zyra e Shërbimit të Provës Lezhë me nr.30/2 prot, datë 20.01.2014 nga ku rezulton se kjo zyrë të ketë rekomanduar mospranimin e kërkesës së të dënuarit për shkak se riintegrimi i tij në shoqëri është i vështirë pasi nga vlerësimi i sjelljes, ajo vlerësohet si sjellje që nuk bie ndesh me personelin, dhe jo si sjellje e mirë, se ai nuk është i punësuar në institucion, se me raste shfaq shenja pendese, apo se vepra është një temë që nuk preferon t'i referohet, se kryerja njëkohësisht e tre veprave penale tregon rrezikshmëri të tij, se ai në intervistë ka shpjeguar se ka qenë i pirë në kohën e kryerjes së veprës penale, fakt i cili nuk rezulton

nga vendimi gjyqësor, se i dënuari ka nivel arsimor të ulët dhe në dy raste nuk ka përfituar ulje të plotë dënimi.

- v. Nga raporti i shërbimit të provës rezulton se familja e kërkuesit jetonte në Shënkoll, dhe përbëhej nga dy prindërit, dy vëllezërit dhe bashkëshortja e vëllait Arben. Familja e të dënuarit sipas referencës nr.158, datë 10.04.2013 rezulton të trajtohet me ndihmë ekonomike dhe ajo jeton nga puna sezonale e babait apo vëllait të tij. Ajo jeton në kushte të vështira ekonomike në një banesë me 4 dhoma. Në gjendjen shëndetësore të të dënuarit raportohet se ai ka pësuar dy ndërhyrje kirurgjikale një për apendisit dhe tjetrin për heqjen e bajameve.
- vi. Sipas vërtetimit të datës 15.12.2013 të lëshuar nga firma “Kopi” rezulton që kjo firmë të ketë marrë përsipër që të punësojë kërkuesin në rast të lirimit me kusht. Nga deklarata e datës 20.04.2013 e Dioqezës së Rrëshenit rezulton se për ngjarjen e datës 29.11.2005 ku ishin vjedhur me dhunë dhe plagosur me armë zjarri në Klos-Fanë Mirditë nga të dënuarit Aleksandër Prenga dhe Robert Lleshi murgeshat e dëmtuara të kenë deklaruar se i dënuari ishte falur prej tyre plotësisht. Ato kanë konsideratë nga gjykata marrëdhëniet e tyre kristiane ishin normalizuar kërkuar që kjo deklaratë pajtimi të merret në për lirim me kusht të të dënuarit.
- vii. Vërtetimi i Qendrës Shëndetësore Shënkoll i datës 12.12.2013 rezulton se prej dy vitesh, nëna e të dënuarit, shtetasja Dila Prenga vuante nga sëmundja nodulare me hiperfunksion të tiroides që sillte si pasojë takikardi, stres dhe gjendje depresive psikotike.
- viii. Nga shkresat nr.9004/4 prot datë 21.12.2012, 10388, datë 13.11.2009, 7838/1 prot, datë 21.08.2013 dhe 2755/4 prot, datë 10.04.2013 të IEVP Lezhë kërkuesit Aleksandër Prenga i është dhënë disa herë leje shpërblyese për sjellje të mirë dhe në një rast për gëzim familjar dhe nuk rezulton që ai të ketë thyer kushtet e lejes. Sipas shkresës nr 5340 prot, datë 18.06.2014 të IEVP Lezhë rezulton se kërkuesi të jetë diagnostikuar me Migrenë me aura (në muajin qershor 2014) dhe trajtohet për këtë sëmundje, ndërkohë që nga historiku klinik rezulton të jetë ankuar për çrregullime të gjumit, ndërsa në shkurt 2012 i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale Tonsillectomia.

6. Duke parashtruar sa më sipër kërkuesi Aleksandër Prenga, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka pretenduar se plotëson kushtet e N.64 të K.Penal për lirim me kusht; përfaqësuesi i Zyrës së Shërbimit të Provës Lezhë, ka rekomanduar mospranimin e kërkesës së tij, ndërsa Prokurori pranë Prokurorisë Lezhë ka kërkuar rrëzimin e kërkesës.

II. Procedurat gjyqësore

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.36, datë 28.05.2014 ka vendosur:

- i. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Aleksandër Prenga si të pabazuar në prova dhe në ligj.
- ii. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

8. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.121 datë 18.09.2014 ka vendosur:

- i. Ndryshimin e vendimit nr.36, datë 28.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në këtë mënyrë:

Pranimin e kërkesës së kërkuesit Aleksandër Prenga.

Urdhërohet lirimi me kusht i të dënuarit Aleksandër Prenga për pjesën e pavuajtur të dhënë me vendimin nr.25, datë 02.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, i

lënë në fuqi me vendimin nr.824, datë 17.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë duke urdhëruar vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 18 muajsh.

Urdhërohet i dënuari të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Lezhë gjatë periudhës së provës.

Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit Aleksandër Prenga nëse nuk ka masë sigurimi “Arrest në burg” për llogari të ndonjë procedimi tjetër penal ose dënim tjetër me burgim.

III. Arsyetimi ligjor i vendimit të ankimuar

9. Gjykata e Apelit Shkodër e ka gjetur të gabuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe ndër të tjera arsyeton se:

“Sjellja e të dënuarit përgjatë tre viteve të fundit të vuajtjes së dënimit vlerësohet pozitive. I dënuari ka respektuar në vijimësi kërkesat e rregullores dhe në asnjë rast nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.

Ai ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha aktivitetet e përbashkëta kulturore, edukative e sportive dhe ka qenë pjesë e programeve të karakterit psikoterapeutik. Shprehja e pendesës për veprën penale është evidentuar në vlerësimin e sjelljes së tij për efekt të lirimimit me kusht, në të cilin shprehet se kur bie fjala për veprën penale shfaq shenja pendese dhe ia le moshës. [...]

Shërbimi i provës nuk ka analizuar faktin se kishte një normalizim marrëdhëniesh me të dëmtuarat nga vepra penale dhe se i dënuari kishte një ofertë punësimi në rast lirimimi nga burg.

Gjykata e Apelit konstaton se që nga data e kryerjes së përllogaritjeve të fundit për pjesën e pavuajtur të dënimit datë 19.05.2014 kishte kaluar rreth 4 muaj, nga përllogaritjes e pjesës së pavuajtur të dënimit në momentin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit atij t’i mbeten për të vuajtur edhe 3 muaj e 13 ditë burgim. Fakti që gjatë kohës që ai ka qëndruar në burg ka pasur rezultate pozitive, ka respektuar në vazhdimësi rregulloren, ka manifestuar një sjellje të mirë me bashkëvuajtësit dhe personelin dhe është aktivizuar rregullisht në programet e edukimit tregon se ai ka bërë të gjitha përpjekjet për risocializimin dhe rehabilitimin etj. [...]

Në lidhje me kushtet dhe rrethanat personale të veçanta për të cilat kërkohet lirimi me kusht gjykata e Apelit vlerëson se arsyet e veçanta si kusht ligjor për të motivuar një kërkesë me lirim me kusht nuk gjejnë një rregullim ligjor të mirëpërcaktuar, por ato vlerësohen rast pas rasti nga gjykata. Ky qëndrim është mbajtur në vijimësi nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë.

Në rastin që po gjykohet, rezulton se i dënuari Aleksandër Prenga gjendet në rrethana veçanërisht të vështira familjare duke qenë se familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike, se ai vuan nga një sëmundje e tillë si migrena me aure, si dhe nga ana tjetër nëna e tij vuan nga sëmundje kronike prek dy vitesh.

Këto fakte janë raportuar edhe nga aktet e depozituara nga kërkuesi, por edhe nga punonjësi i shërbimit të provës.

Nga ana tjetër dy murgeshat e dëmtuara nga vepra penale kanë shfaqur miratimin e tyre për lirimim me kusht të të dënuarit duke pohuar se marrëdhëniet me të ishin normalizuar.

Një element pozitiv në rastin e kërkuesit Aleksandër Prenga është edhe oferta e punësimi që ka bërë për të firma “Kopi” ofertë e cila megjithëse është raportuar nga kërkuesi nuk është analizuar dhe vlerësuar nga shërbimi i provës. [...]

Punonjësi i shërbimit të provës deformon faktet duke referuar se i dënuari nuk ka sjellje të mirë me personelin, ndërkohë që nga vlerësimet e sjelljes për të dënuarin rezulton e kundërta. E njëjta gjë ndodh edhe me referimin e uljes së pjesshme të dënimit kur punonjësi i shërbimit të provës i referohet një ulje të dënimit 45 ditore të dhënë në vitin 2008, periudhë e cila nuk përfshihet në periudhën e fundit tre vjeçare të sjelljes dhe i referohet një vendimi të gjykatës të

dhënë në vitin 2013, me të cilin është aplikuar ulje e pjesshme, për shkak se ulja është dhënë për një periudhë më të vogël se një vit të plotë të vuajtjes së dënimit dhe jo për shkak të problemeve të sjelljes së të dënuarit.

Raporti i Shërbimit të provës nuk është vendimtar në vlerësimin e rastit nga gjykata, pasi vlerësimi nëse ndaj kërkesit duhet aplikuar apo jo dënimi alternativ është një atribut i gjykatës, i cili lidhet ngushtë me vlerësimin e ekzistencës së kushteve ligjore e veçanërisht të atyre që kanë të bëjnë me vlerësimin e sjelljes së të dënuarit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit dhe me faktin se sa ia ka arritur qëllimit për edukimin e të dënuarit pjesa e vuajtur e dënimit, me qëllim që i dënuari të mos përbëjë më rrezik për shoqërinë, të përfshihet sërish në aktivitete kriminale si dhe me impaktin që krijon në shoqëri lirimi me kusht i të dënuarit [...].”

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se ka interpretime jo të njëjta në lidhje me kuptimin e togfjalëshit “arsye të veçanta” të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, në shqyrtimin e kërkesave të të dënuarve me objekt “Lirim me kusht”, vendosi që për njehsimin e praktikës gjyqësore, çështjen penale që i përket të dënuarit Aleksandër Prenga, ta kalojë në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

IV. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara dhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara:

11. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore vlerësohen të jenë:

- a. *Në mungesë të një përkufizimi në Kodin Penal, çfarë do të kuptohet me shprehjen “arsye të veçanta” të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, në procesin penal me objekt lirim para kohe me kusht?*
- b. *Në rastin kur pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, a duhet gjykata të caktojë gjithashtu një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë? Nëse po, sa duhet të jetë ky afat i mbajtjes në provë?*

12. Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me çështjet që duhet të unifikohen për efekt të njehsimit të praktikës dhe të pasojës që ka në lidhje me zgjidhjen e çështjes ishte si më poshtë:

- i. *Prokurori në lidhje me çështjen e parë mbajti qëndrimin se: interpretimi më i drejtë është ai që e trajton nenin 64 të K.Penal sikur parashtron vetëm një kusht, atë të arritjes së riedukimit të të dënuarit. Ky interpretim bën të nevojshëm që togfjalëshin “arsye të veçanta” ta trajtojmë si sinonim të togfjalëshit “kur me punën dhe sjelljen e tij i dënuari tregon se i është arritur qëllimit të riedukimit”. Pra sipas këtij interpretimi kuptimi i shprehjes “kur me punën dhe sjelljen e tij i dënuari tregon se i është arritur qëllimit të riedukimit” nuk është gjë tjetër veçse shpjegim apo zbërthim i vetë shprehjes “arsye e veçantë”. Kjo do t’i bënte të gjitha rrethanat e tjera që lidhen me gjendjen ekonomike dhe shëndetësore të familjarëve të të dënuarit krejtësisht të papërshtatshme për t’u parashtruar nga palët dhe aq më pak për t’u pranuar nga Gjykata si rrethana që shërbejnë për të vendosur lirimin e të dënuarit para kohe.*
- ii. *Në lidhje me çështjen e dytë: Sugjerohet që të pranohet si praktika më e drejtë dhe logjike ajo sipas të cilës afati i veprimit të kushtit është vetë masa e dënimit të pavuajtur nga i dënuari që do të lirohet. Kjo praktikë është logjike dhe në frymën e ligjit pasi sipas këtij interpretimit të afatit të zbatimit të kushtit, koha e kushtit është në përpjesëtim të drejtë me masën e dënimit. Kjo vjen në përputhje me logjikën se koha e kushtit duhet të jetë më e gjatë sa më i lartë të jetë risku i kryerjes përsëri të një vepr*

penale. Dhe është e kuptueshme se ky risk është më i lartë për një person me dënim të rëndë në raport me një tjetër të dënuar me një dënim më të butë.

- iii. Mbrojtja në lidhje me çështjen e parë: “Arsyet e veçanta nuk janë aspak ato të ndjekura deri tani gjatë praktikës gjyqësore, dhe që kanë konsistuar përgjithësisht në kushtet shëndetësore dhe social ekonomike të personit të dënuar dhe familjarëve të tij. Nuk është ekzistenca e ndonjë prej këtyre arsyeve që duhet të përlligjin lirimin me kusht. Po të mbështetemi në faktin se burgu është një institucion riedukimi i cili ka për qëllim riedukimin e të dënuarit për ta bërë atë përsëri të denjë për shoqërinë, do të arrijmë në përfundimin se është pikërisht ky kriter që përbën arsyen e veçantë të lirimit me kusht, pra arritja e qëllimit për edukim.
- iv. Në lidhje me çështjen e dytë: Referimi që i bëhet nenit 59 të K.Penal në lidhje me periudhën e provës është i gabuar pasi periudha e provës duhet të jetë për aq kohë sa është edhe periudha e mbetur pa vuajtur. Kjo periudhë duhet të shërbejë si një periudhë që do t’i shërbejë të dënuarit si adoptim më normal me jetën jashtë institucionit [të vuajtjes së dënimit] nëpërmjet një institucioni të specializuar që është Shërbimi i Provës. Shtrirja e kësaj periudhe për një kohë më të gjatë se ajo që të dënuarit i kishte mbetur pa vuajtur përbën një kufizim të lirisë së tij përtej asaj që është dhënë me vendim dhe bie ndesh dhe me kriterin e kërkuar në nenin 64 të K.Penal sipas të cilit personi që është liruar me kusht ia ka arritur qëllimit të edukimit dhe për këtë arsye zgjatja e kësaj kohe do të përbënte një “kufizim të lirisë personale”.

V. Qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

A. Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për unifikim: Në mungesë të një përkufizimi në Kodin Penal, çfarë do të kuptohet me shprehjen “arsye të veçanta” të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, në procesin penal me objekt lirimin para kohe me kusht?

13. Ndonëse në Kodin Penal nuk gjendet një përkufizim se çfarë do të kuptohet me shprehjen “arsye të veçanta”, parashikuar në nenin 64 të tij, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (“Kolegjet e Bashkuara”) vlerësojnë t’i japin përgjigje pyetjes së shtruar duke u bazuar në (i) qëllimin e institutit të lirimit me kusht; (ii) interpretimit tekstual të dispozitës në fjalë; si dhe në (iii) etapat e nevojshme që gjykatat duhet të mbajnë në konsideratë në gjykimet me objekt lirimin me kusht.

(i) Qëllimi i institutit të lirimit me kusht

14. Instituti i lirimit me kusht klasifikohet në Kodin Penal si një nga alternativat e dënimit me burgim (Kreu VII i K.Penal). Në vlerësim të Kolegjeve të Bashkuara, lirimi me kusht është një institut me karakter riedukues, human, dhe social.

15. Elementi “riedukativ” i ligjvënësit është lehtësisht i kuptueshëm dhe dallohet qartë nga vetë teksti i nenit 64 të Kodit Penal, i cili parashikon se ‘I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht [...] nëse [...] me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për riedukimin e tij [...]’ (theksimi i Gjykatës). Pra duket qartë se objektivi kryesor i lirimit me kusht është riedukimi i të dënuarit, me kusht plotësimin e kërkesave specifike të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal. Ndërkohë që dënimi penal në vetvete, përmban elemente të teorive ndëshkuese dhe parandaluese të krimit, orientimi i tanishëm në shumë legjislacione penale evropiane, sidomos në lidhje me periudhën e fundit të vuajtjes së dënimit, fokusohet në riedukimin (ose risocializimin) e të

dënuarit.¹² Ky orientim bazohet në uljen e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit dhe riedukimin e tij, nëpërmjet punës dhe programeve të ndryshme brenda dhe jashtë institucioneve të vuajtjes së dënimit, me qëllim dekurajimin e kryerjes së veprave të tjera penale, si dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarve.

16. Karakteri “human” i lirimit me kusht lidhet me shmangien e ndëshkimit të panevojshëm dhe është pasqyrim i drejtpërdrejtë i një prej parimeve të Kodit Penal, parashikuar shprehimisht në nenin 1/c të tij.¹³ Siç u përmend pak më lart, edhe vetë elementi ndëshkues në teorinë e së drejtës penale nuk duhet të konsiderohet si një “hakmarrje” e shoqërisë kundrejt autorit të veprës penale, por më tepër si një shprehje e shpagimit së kësaj të fundit në lidhje me sjellje të patolerueshme për një shoqëri civile dhe demokratike. Në kushtet e arritjes së qëllimit kryesor të dënimit penal, pra riedukimit të të dënuarit, si dhe plotësimit të kushteve objektive të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal,¹⁴ vazhdimi i vuajtjes së mëtejshme të dënimit do të konsiderohej si i panevojshëm dhe i padobishëm për shoqërinë. Për më tepër, edhe vetë masa e dënimit penal, është në vetvete një “parashikim” nga ana e gjykatës i kohës që konsiderohet e mjaftueshme për të arritur në riedukimin e të dënuarit, në raport kjo me rrezikshmërinë e veprës së kryer dhe të autorit të saj. Kjo kohë e mjaftueshme, mund të jetë e ndryshme për persona të ndryshëm; dhe pikërisht për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e lirimit me kusht për këtë kategori të dënuarish, të cilët, pasi kanë vuajtur një pjesë të konsiderueshme të dënimit të dhënë, janë riedukuar plotësisht dhe nuk ekziston më nevoja për t’i mbajtur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

17. Kolegjet e Bashkuara mbajnë parasysh këtu edhe efektet “sociale” të lirimit me kusht, që kanë të bëjnë jo vetëm me qëllimin e përgjithshëm të lirimit me kusht -- duke shërbyer si shembull për të dënuarit e tjerë që me punë dhe sjellje të mirë mund të lirohen me kusht -- por edhe me fenomenin e mbipopullimit të burgjeve, duke ulur sadopak edhe barrën financiare të taksapaguesve për sistemin penitenciar, natyrisht duke mos u sakrifikuar objektivi kryesor që është siguria e komunitetit ndaj personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe detyrat e legjislacionit penal dhe parimet e Kodit Penal, parashikuar nga nenet 1/b dhe 1/c të Kodit Penal. Në këtë kuptim, autoritetet shtetërore duhet të përpiqen që të arrijnë riedukimin e të dënuarve sa më shpejtë të jetë e mundur, duke evituar masa dënimi me karakter thjesht ndëshkues. Studime të shumta kanë treguar se zbatimi i lirimit me kusht është një nga mënyrat më efektive në arritjen e qëllimit ndëshkues, parandalues dhe riedukativ të dënimit penal.¹⁵ Vlen këtu të përmendet edhe Rekomandimi nr.R(99)22 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve sipas të cilit “lirimi me kusht duhet të konsiderohet si instrumenti më

¹² *Vinter dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe, Aplikimet nr.66069/09, 130/10 dhe 3896/10, Vendim i datës 09.07.2013, në para 115.

¹³ Neni 1/c (Parimet e Kodit Penal):

Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, *si dhe të humanizmit* (theksim i Kolegjeve).

Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet.

¹⁴ Kushtet objektive lidhen me i) vuajtjen e një pjese të dënimit në varësi të llojit të veprës penale të kryer; ii) të mos ketë qenë përsëritës për krime të kryera me dashje; dhe të mos jetë dënuar për vepra të veçanta në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

¹⁵ Memorandum Shpjegues i Rekomandimit Rec(2003)22 të Komitetit të Ministrave mbi Lirimin me Kusht, faqe 11.

efektiv dhe konstruktiv, i cili jo vetëm ul kohën e burgimit, por edhe kontribuon në mënyrë thelbësore në riintegrimin e të dënuarit në komunitet”.¹⁶

18. Në konsideratë të sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se neni 64 i Kodit Penal, në tërësinë e tij -- përfshirë këtu edhe “arsyet e veçanta” -- duhet të interpretohet në përputhje me qëllimin e parashikuar nga ligjvënësi, që është riedukimi dhe riintegrimi i të dënuarit në shoqëri.

(ii) *Interpretimi i shprehjes “arsye të veçanta”*

19. Në interpretimin e shprehjes “arsye të veçanta”, Kolegjet e Bashkuara e gjejnë me vend fillimisht të rikujtojnë ndryshimet e pësura të institutit të lirit me kusht. Sipas Kodit Penal të vitit 1995, i dënuari mund të ‘Lirohej para kohe me kusht’ kur:

Ka vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit të dhënë dhe me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

Në gjysmën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarit përsëritës në krime.

Lirimi para kohe me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari gjatë kohës së kushtit kryen një vepër tjetër penale po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

20. Dispozita e vitit 1995 nuk bënte dallim ndërmjet llojit të veprës penale të kryer, dhe vendoste vetëm kushtin e vuajtjes të së paktës gjysmës së dënimit të dhënë. Ndryshimet më të mëdha ndodhën me reformën e ligjit nr.8733, datë 24.01.2001. Neni 7 i tij ndryshonte nenin 64 të K.Penal si më poshtë:

I dënuari me burgim mund të lirohet para kohe me kusht, nga vuajtja e dënimit *vetëm për arsye të veçanta*, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi para kohe me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.

Lirimi para kohe me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

21. Siç vihet re, reforma e vitit 2001 tentoi të sqaronte mundësinë e aplikimit të institutit të lirit me kusht, element ky që evidentohet me identifikimin e “arsyëve të veçanta” si dhe në diferencimin e trajtimit të veprave penale. Mundësia e lirit me kusht pas vuajtjes së gjysmës së dënimit të dhënë do të lejohej vetëm për kundërvajtjet penale, ndërsa për krimet, koha e nevojshme për zbatimin e institutit të lirit me kusht rritej, përkatësisht me dy të tretat dhe tre të katërtat, në varësi të rrezikshmërisë së veprës penale (dhe rrjedhimisht të masës së dënimit). Gjithashtu, në ndryshim me regjimin e Kodit të vitit 1995, me reformën e vitit 2001, lirimi me

¹⁶ Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi nr.R(99)22 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Inflacionin e Popullatës së Burgjeve, datë 30.09.1999, parag. 24.

kusht do të revokohej vetëm në rastin e përsëritjes së veprave penale të kryer me dashje, dhe jo çdo lloj veprave penale, siç ishte parashikuar me Kodin e vjetër.

22. Në vitin 2008, me anë të ligjit nr.10023, datë 27.11.2008, nga instituti i “lirimit para kohe me kusht” u hoqën fjalët “para kohe”, si dhe në paragrafin e fundit, heqja e fjalëve “po aq të rëndë ose më të rëndë se e para”, për sa i përket revokimit të lirimit me kusht në rast të kryerjes së ndonjë veprave tjetër penale gjatë kohës së kushtit. Gjithashtu, ky ligj parashikoi edhe krijimin e shërbimit të provës, i cili është ‘organi shtetëror që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social’.¹⁷ Më së fundmi, neni 12 i ligjit 143, datë 02.05.2013, eliminoi përfundimisht mundësinë e aplikimit të lirimit me kusht të të dënuarve për çdo lloj veprave penale të vrasjes me dashje (duke shtuar fjalët ‘si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100’).

23. Momentalisht, neni 64 i Kodit Penal në fuqi parashikon se:

I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfutur me amnisti ose falje. Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

24. Kolegjet e Bashkuara do të kthehen tani në interpretimin e shprehjes “arsye të veçanta”, në këndvështrimin e qëllimit dhe tekstit të nenit 64 të Kodit Penal.

25. Në praktikën gjyqësore, si gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit, ashtu edhe organi i Prokurorisë, vazhdimisht e kanë interpretuar kriterin e “arsyeve të veçanta” si një kriter shtesë dhe të jashtëm me cilësitë dhe personalitetin e të dënuarit. Në shumë çështje gjyqësore me objekt lirimin me kusht, janë pretenduar si “arsye të veçanta” rrethana të tilla si për shembull, gjendja familjare e rënduar e të dënuarit; sëmundja e rëndë e prindërve apo e të afërmeve të tjerë; apo qenia me fëmijë të mitur dhe me bashkëshortë në ngarkesë të të dënuarit. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, kjo qasje është e papranueshme dhe e gabuar. Kjo pasi në interpretimin që i kanë bërë shprehjes “arsye të veçanta”, gjykatat më të ulëta efektivisht kanë shtuar me pa të drejtë një kriter të jashtëm të paparashikuar nga ligji si kusht ndalues për efekt të pranimit të kërkesës për lirim me kusht. Megjithatë, siç edhe do të sqarohet më poshtë,¹⁸ Kolegjet vlerësojnë se rrethanat që kanë të bëjnë me familjarët e të dënuarit mund të merren parasysh nga ana e gjykatave, jo si kusht thelbësor, por si rrethanë që shkon në favor të kërkesës për lirim me kusht, në drejtim të analizës së gjykatës për riintegrimin e plotë të të dënuarit pas lirimit.

¹⁷ Neni 10 i ligjit nr.10023, datë 27.11.2008, i cili shton nenin 31/7 të Ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”.

¹⁸ *Infra*, para. 41.

26. Së pari, për sa i përket interpretimit teleologjik, orientimi i zgjedhur nga gjykatat më të ulëta që kushtëzon zbatimin e lirimit me kusht me praninë e domosdoshme të një kriteri jashtë kontrollit të të dënuarit (siç mund të jetë gjendja e rënduar e familjarëve të tij), mohon pa të drejtë mundësinë e lirimit me kusht të një të dënuari të riedukuar plotësisht vetëm për arsyen se familjarët e tij nuk ndodhen në gjendje ekonomike apo shëndetësore të rënduar. Kjo jo vetëm që shkon kundër qëllimit të institutit të lirimit me kusht -- pasi prania apo jo e këtyre kushteve të jashtme nuk ndikon drejtpërdrejt në uljen e rrezikshmërisë së të dënuarit, por vetëm në trajtimin më human të të dënuarve -- por edhe i vendos të dënuarit në pozita pabarazie përpara ligjit. Nëse do të pranohej përjasja e faktorëve të jashtëm nga puna dhe sjellja e të dënuarit, në mënyrë paradoksale, një i dënuar, ndonëse i riedukuar, do të duhej të "shpresonte" në ndodhjen e një fatkeqësie të familjarëve të tij në mënyrë për t'u liruar me kusht.

27. Së dyti, ky orientim i gjykatave më të ulëta mbetet i pambështetur edhe për sa i përket interpretimit tekstual të tij. Nëse "arsyet e veçanta" do të konsideroheshin si të pavarura nga "sjellja dhe puna" e të dënuarit, edhe teknika legjislative do të ishte ndryshe dhe do të kishte shtuar lidhësen "dhe" pas shprehjes "arsye të veçanta". Pra dispozita do të lexohej: 'I dënuari me burgim mund të lirohet [...] vetëm për arsye të veçanta, *dhe* nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se [...]. Mosprania e lidhëses "dhe" bën që "arsyet e veçanta" të jenë tekstualisht dhe logjikisht të lidhura me "sjelljen dhe punën e të dënuarit".

28. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se, ndërkohë që pranohet se "arsyet e veçanta" janë të lidhura ngushtë me riedukimin dhe nuk kanë të bëjnë me elementë apo faktorë jashtë kontrollit të të dënuarit, kjo nuk do të thotë se "arsyet e veçanta" mund të lexohen thjesht si ri-përsëritje e sjelljes dhe punës së të dënuarit. Rregullat e interpretimit e imponojnë Gjykatën të shmangë, me sa të jetë e mundur, leximin e një dispozite si përsëritëse apo të panevojshme. Përkundrazi, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se shtimi i shprehjes "arsye të veçanta", bërë me ndryshimet e nenit 64 të Kodit Penal nga ligji nr.8733, datë 24.01.2001, ka patur si qëllim "sqarimin" e aplikimit të lirimit me kusht dhe pranimin e tij vetëm në rast se i dënuari, nëpërmjet *rrethanave konkrete* që lidhen me punën dhe sjelljen gjatë vuajtjes së dënimit, ka treguar se është arritur qëllimi i riedukimit të tij. Në rastin e "arsyeve të veçanta" qëllimi i ligjvënësit ka qenë, në vlerësimin e Kolegjeve, kontrolli më rigoroz nga ana e gjykatës dhe dhënia e arsyeve objektive, konkrete dhe specifike mbi rezultatin e sjelljes dhe punës së të dënuarit në drejtim të riedukimit dhe gatishmërinë e tij ose saj për t'u riintegruar në shoqëri.

29. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ("Kolegji Penal") ka patur shpesh rastin për t'u shprehur mbi shprehjen "arsye të veçanta". Sipas Kolegjit Penal "arsyet e veçanta" nuk duhen nënkuptuar si një kusht shtesë, por si një kusht i vetëm, i përbërë nga fakte të cilat provojnë se është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai/ajo është i/e gatshëm të riintegrohet në shoqëri.¹⁹ Kolegjet e Bashkuara e vlerësojnë të drejtë interpretimin e bërë nga ana e Kolegjit Penal dhe nuk gjejnë arsye për ta ndryshuar këtë qëndrim konstant të tij. Për më tepër, Kolegjet marrin në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe nga ana e mbrojtjes, të cilët iu bashkuan këtij qëndrimi të mbajtur nga ana e Kolegjit Penal, duke pranuar se "arsyet e veçanta" nuk kanë të bëjnë me elementë apo faktorë të jashtëm nga puna dhe sjellja e të dënuarit, por me riedukimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri.²⁰

¹⁹ Gjykata e Lartë, Kolegji Penal, vendim nr.10, datë 10.01.2012, para 17; Gjykata e Lartë, Kolegji Penal, vendim nr.72, datë 07.03.2012, para 21; Gjykata e Lartë, Kolegji Penal, vendim nr.125, datë 02.05.2012, faqe 3; Gjykata e Lartë, Kolegji Penal, vendim nr.155, datë 16.11.2011, faqe 4; Gjykata e Lartë, Kolegji Penal, vendim nr.160, datë 08.06.2012, para. 15.

²⁰ Faqe 8 e konkluzioneve të Prokurorisë së Përgjithshme: "Nëse do të pranohet këtë interpretim atëherë do të duhej që Gjykatat të mos vendosnin lirimin para kohe që një të dënuari totalisht i rehabilituar thjesht sepse ai

(iii) *Çështjet e nevojshme që gjykatat duhet të vlerësojnë në shqyrtimet e kërkesave me objekt lirim me kusht*

30. Në vijim Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë të ndalohen në etapat e nevojshme që gjykatat duhet të ndjekin në gjykimin me objekt lirim me kusht.

31. Kolegjet vërejnë se lirimi me kusht rregullohet nga neni 64 i Kodit Penal, si dhe neni 31/6 i Ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” (Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008). Neni 31/6, i këtij të fundit parashikon ndër të tjera se:

Pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirit.

32. Siç vërehet, ligji nr.8331, datë 21.4.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” i ka përcaktuar qartë detyrat dhe kompetencat si të drejtorit të IEVP-së, ashtu edhe të Shërbimit të Provës. Ndërkohë që i pari ka për detyrë paraqitjen e një raporti për të ndihmuar gjykatën të kuptojë nëse i dënuari, me sjelljen dhe punën e tij është riedukuar, raporti i të dytit nevojitet për të ndihmuar gjykatën në parashikimin, me sa të jetë e mundur, të suksesit të riintegrit të të dënuarit në shoqëri.

33. Natyra e veprës penale të kryer është një nga elementët më të rëndësishëm që duhet të merret parasysh nga ana e gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht. Sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit. Gjithashtu, edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, duhet të mbahen në konsideratë. Një vepër penale e kryer në bashkëpunim, me paramendim, apo me dhunë tregon për një shkallë të lartë rrezikshmërie të të dënuarit, çka duhet të shtyjë gjykatën për të qenë veçanërisht e kujdesshme në pranimin e kërkesës për lirim me kusht. Në këto raste, gjykata duhet të jetë pothuajse plotësisht e bindur, nëpërmjet fakteve dhe rrethanave konkrete, se i dënuari nuk do të jetë burim rreziku për shoqërinë nëse lirohet.

34. Qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës është elementi i dytë që ligji parashikon për t’u trajtuar në raportin e Drejtorit të IEVP-së. Pendimi i të dënuarit duhet të rezultojë nga të dhëna objektive. Në këtë kuptim, nuk mjafton vetëm deklarimi i të dënuarit para gjykatës se shpreh pendesë për veprën e kryer, por ky qëndrim pendues të ketë rezultuar edhe gjatë vuajtjes së dënimit, në raport me bashkëvuajtësit e tjerë, personelin e institutit penitenciar, me familjarët e tij, marrjen pjesë në aktivitete riedukuese, dëshirën për të punuar, etj. Për sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me viktimën/të dëmtuarin apo familjarët e tij, nëse rezulton të ketë ndodhur, gjykata duhet natyrisht ta marrë parasysh si element në favor të kërkuarit. Megjithatë, Kolegjet vlerësojnë se, ndërsa në vetvete normalizimi i marrëdhënieve nuk është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërkesës për lirim me kusht, me rendësi është të paktën tentativa e të dënuarit për të kërkuar faljen dhe normalizimin

nuk do të kishte familjarë të sëmurë apo nëse familjarët e tij do të ishin në gjendje të mirë ekonomike. Ky lloj interpretimi duket se përmban një eksces krejtësisht të paarsyeshëm dhe aspak relevant me logjikën e lirit para kohe të një të dënuari, pasi në këtë mënyrë do të arrihej në mohimin e lirit para kohe të një të dënuari të riedukuar plotësisht dhe ai të mbahej në burg për rrethana që nuk varen aspak prej tij dhe as kanë lidhje me qëllimet e dënimit”.

e marrëdhënieve me personin e dëmtuar/viktimën dhe familjen e tij, si dhe zëvendësimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose ndihma aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale.

35. Ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej të dënuarit. Në rast se i dënuari rezulton përsëritës për krime të kryera me dashje, gjykata, në bazë të nenit 64(3) të Kodit Penal, do të jetë e detyruar të rrëzojë kërkesën, pasi ky element konsiderohet si ndalues i dhënies së lirimimit me kusht. Në rastet e tjera, hetimi mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit duhet të vlerësohet në perspektivën e rrezikut të recidivizmit të tij.

36. Gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar. Për sa i përket gjendjes fizike të të dënuarit, Kolegjet vlerësojnë se nëse i dënuari ka një gjendje të rënduar fizike apo moshë të madhe, kjo rrethanë do të konsiderohet në favor të të dënuarit, jo vetëm për arsye humanitare, por edhe pasi rrezikshmëria shoqërore në këtë rast do të cilësohet si më e ulët. Ndërkohë, në qoftë se i dënuari gëzon gjendje të mirë fizike, kjo rrethanë do të konsiderohet si neutrale nga ana e gjykatës, por jo në disfavor të kërkuarit. Kjo pasi siç u sqarua më lart, qëllimi i ligjvënësimit nuk është neutralizimi i të dënuarit, por riintegrimi i tij në shoqëri.

37. Dinamika e sjelljes së të dënuarit në I EVP është, së fundmi, një element kyç në lidhje me provën e riedukimit të të dënuarit. Ky i fundit, jo vetëm që është i detyruar për të zbatuar me korrektësinë maksimale rregulloren e brendshme të I EVP-së, por edhe të tregojë konkretisht, se gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, sjellja e tij ka qenë e tillë sa për të çuar drejt përfundimit se i dënuari vërtet ka treguar pendim, duke u sjellë me korrektesë me bashkëvuajtësit; autoritetet e I EVP-së; ka mbajtur (ose tentuar të mbajë) marrëdhënie të rregullta me familjarët e tij; ka normalizuar (ose tentuar t'i normalizojë) marrëdhëniet me personin e dëmtuar/viktimën dhe familjen e tij, si dhe ka zëvendësoje dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; si dhe ka marrë pjesë në aktivitete pune, trajnuese, kulturore dhe edukative.

38. Në vështrim të sa më sipër, Kolegjet vërejnë se raporti i autoriteteve të I EVP-së në të cilën vuan dënimin kërkuar, është me rëndësi për gjykatën për sa i përket analizës së saj në lidhje me riedukimin e të dënuarit. Për t'u konsideruar si i riedukuar, i dënuari nuk duhet thjesht dhe vetëm të këtë respektuar rregulloren e I EVP-së gjatë vuajtjes së dënimit, por të jetë aktivizuar duke marrë pjesë në aktivitete riedukuese, kulturore, trajnuese, punësimi, përmes të cilave të kuptohet pendimi i të dënuarit në raport me veprën e kryer dhe riedukimi i tij.

39. Shërbimi i Provës. Ndërkohë, ligjvënësi ka parashikuar që, përveç kontrollit nëse i dënuari është riedukuar apo jo, gjykata duhet të analizojë edhe mundësinë, nëse i dënuari do të riintegrohet me sukses në shoqëri dhe nuk do të rezultojë më përsëritës veprash penale. Për këtë analizë, ndonëse të drejtuar drejt së ardhmes, gjykata ndihmohet nga raporti i Shërbimit të Provës. Sipas nenit 31/6, pika 3 e ligji nr.8331, datë 21.4.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", 'Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimimit'.

40. Kolegjet theksojnë se roli i Shërbimit të Provës nuk duhet të ngatërrohet me rolin e autoriteteve të I EVP-së. Ndërkohë që raporti i këtyre të fundit i shërben gjykatës për të vendosur nëse vuajtja e dënimit ka arritur qëllimin e riedukimit të të dënuarit, raporti i Shërbimit të Provës, shërben vetëm për të ndihmuar gjykatën në një analizë të riskut të shmangies së recidivizmit dhe të mirë integritetit të të dënuarit në shoqëri pas lirimimit të tij. Në këtë kuptim, ligjvënësi ka parashikuar që raporti i Shërbimit të Provës të përmbajë (i) kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe (ii) planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimimit.

41. Në lidhje me kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, Kolegjet theksojnë se kushtet e vështira ekonomike apo gjendja e rëndë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit, ndërkohë që në raste dhe rrethana të caktuara mund të merren në konsideratë si element

potencial për efekt të uljes së rrezikut të recidivizmit, ato nuk duhet kurrsesi që të konsiderohen, në vetvete, si element në disfavor të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

42. Për sa i përket planeve konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit, Kolegjet vërejnë se këto duhet të jenë sa më realiste, në raport me mundësitë efektive të të dënuarit, dhe duhet të shërbejnë për të bërë sa më të lehtë tranzicionin që i dënuari kalon në periudhën menjëherë pas lirimit. Konkretisht, Kolegjet theksojnë se planet për të punuar apo sigurimi i një kontratë pune duhen konsideruar si një element mjaft i rëndësishëm që shkon në favor të kërkesit. Ndërkohë që sigurimi apo jo i një kontrate pune nuk është në vetvete një kriter ndalues për pranimin e kërkesës, me rëndësi është qasja e të dënuarit për të kërkuar aktivisht punësimin, si mjet efektiv i riintegrimin të tij në shoqëri.

43. Në këtë aspekt, roli i Shërbimit të Provës nuk duhet të jetë thjesht formal, por proaktiv në mbështetjen që i jepet gjykatës në marrjen e një vendimi sa më të drejtë. Kështu, në rast se gjatë shqyrtimi gjyqësor gjykata krijon dyshimin se, për shembull, një kontratë punësimi e paraqitur nga i dënuari mund të jetë fiktive, gjykata mund të aktivizojë Shërbimin e Provës duke i kërkuar të hetojë në terren dhe t'i paraqesë një raport gjykatës mbi situatën reale.

44. Gjithashtu, në rast se raporti i Shërbimit të Provës rezulton të jetë formal apo i mangët, duke mos dhënë një situatë të qartë rreth kushteve familjare apo planet konkrete të të dënuarit, gjykata duhet që të kërkojë plotësimin e raportit në fjalë në mënyrë që vendimmarrja e saj të jetë e mirinformuar.

45. Vetëm pasi të kenë kaluar etapat e mësipërme, pra nëse gjykata e konsideron të plotë raportin e Shërbimit të Provës, ajo mund të vendosë për pranimin apo jo të kërkesës për lirim me kusht. Ndërkohë që gjykata nuk është e detyruar të vendosë sipas konkluzionit të raportit të Shërbimit të Provës, ajo duhet, në rast mosdakordësie, të sqarojë arsyet konkrete se përse e konsideron të gabuar këtë raport. Kjo mund të ndodhë, për shembull, në rastet kur raporti i Shërbimit të Provës është alogjik, apo bie në kundërshtim me provat e administruara në gjykim.

46. Kolegjet e Bashkuara e vlerësojnë me rëndësi të theksojnë se të dy raportet që i paraqiten gjykatës, si ai i autoriteteve të IEVP-së, ashtu edhe ai i Shërbimit të Provës, duhen domosdoshmërisht të shmangin vlerësime me karakter abstrakt dhe përgjithësues, por të jenë specifikisht të individualizuara për të dënuarin konkret. Vetëm në bazë raportesh specifike, ku të përshkruhen me hollësi sjellja e të dënuarit gjatë vuajtjes apo kushtet familjare dhe planet e tij për të mundësuar riintegrimin në shoqëri, do të bëhet e mundur që gjykata të vlerësojë me të dhëna objektive zbatimin apo jo të institutit të lirimit me kusht për të dënuarin përkatës. Në rast se rezulton e qartë se i dënuari është riedukuar dhe se ky i fundit është i gatshëm për t'u riintegruar në shoqëri, gjykata duhet, (pra nuk ka diskrecionin) të pranojë kërkesën për lirim me kusht. Megjithatë, çdo vendimmarrje e gjykatës, duhet të bazohet në elementë objektivë dhe konkretë, duke përshkruar qartësisht hapat ligjore të sipërpërmendura, në mënyrë që të bëjë të mundur kontrollin gjyqësor të gjykatave më të larta.

47. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se:

- **Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit para kohe me kusht i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të**

cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.

B. Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për unifikim: Në rastin kur pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, a duhet gjykata të caktojë gjithashtu një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë? Nëse po, sa duhet të jetë ky afat i mbajtjes në provë?

48. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, ndryshe nga neni 59 i Kodit Penal²¹ (Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë) -- i cili është ndonëse është një institut i ndryshëm nga ai i lirimit me kusht, përmban gjithsesi elemente të përbashkët me të -- neni 64 i Kodit Penal nuk shprehet në lidhje me mundësinë e caktimit, në rast pranimit të kërkesës nga ana e gjykatës, të një periudhe prove ku i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. I vetmi kusht i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal gjendet në paragrafin e fundit të tij, i cili shprehet se 'Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve'. Pra, ndryshe nga paragrafi i fundit i nenit 59 i Kodit Penal, i cili parashikon sanksione në rast se i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e vëna nga gjykata në bazë të nenit 60 të Kodit Penal,²² në rastin e lirimit me kusht, i vetmi detyrim (dhe sanksion në rast shkelje) i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, lidhet vetëm me moskryerjen e një vepre penale tjetër me dashje.

²¹ Neni 59 i Kodit Penal: 'Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit [...], gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, mund të urdhëroj, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale'.

²² Neni 60 i Kodit Penal

Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë:

I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:

1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.
2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.
3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.
4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.
5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.
6. Të mos frekuentojë vende të caktuara.
7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.
8. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.
9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.
10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.
11. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.
12. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre.

49. Megjithatë, Kolegjet vërejnë se në fakt, një detyrim i tillë, pra i mbajtjes së kontaktit me Shërbimin e Provës gjendet në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”. Neni 31/6, paragrafi 5 i këtij ligji parashikon se: ‘Personi i liruar me kusht duhet t’i raportojë rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirimit me kusht’. Ndërkohë, paragrafi i fundit i po këtij neni parashikon se:

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe ato të Policisë së Shtetit. Shërbimi i provës mund t’i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht, kur ai nuk është në gjendje t’i përmbushë ato.

50. Siç kuptohet qartë nga leximi i paragrafit të fundit të nenit 31/6 të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, ndonëse nuk e ka pasqyruar edhe në tekstin e nenit 64 të Kodit Penal, ligjvënësi jo vetëm që ka parashikuar mbajtjen e kontakteve me Shërbimin e Provës si dhe mbikëqyrjen e saj të vendimit të lirimit me kusht, por edhe ka nënkuptuar dhënien nga ana e gjykatës, *të një ose të disa detyrimeve* personit të liruar me kusht. Qëllimi për mbajtjen e kontakteve dhe dhënia e një ose disa detyrimeve nga ato të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal ka të bëjë natyrisht me nevojën për të bërë sa më lehtë për të dënuarin kalimin e periudhës tranzitore të kalimit nga gjendja e burgimit në atë të lirisë, duke mundësuar rikthimin e suksesshëm të të dënuarit në shoqëri. Për këtë arsye, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se në rast pranimi të kërkesës për lirim me kusht, gjykata duhet të caktojë një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

51. Në rast se i dënuari nuk mban lidhje me Shërbimin e Provës apo nuk përmbush detyrimet e vëna nga gjykata (me përjashtim të rastit kur nuk është në gjendje t’i përmbush ato), Kolegjet vërejnë se gjykatat mund të vendosin ndryshimin apo revokimin e lirimit me kusht në bazë të nenit 31/10 i ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”,²³ nën i cili, në interpretim të Kolegjeve, jo pa qëllim shmang referimin e një instituti të veçantë, duke iu referuar në përgjithësi, një “dënimi alternativ”, të parashikuar nga Kodi Penal. Duke pasur në konsideratë se Kodi Penal e liston institutin e lirimit me kusht si një nga Alternativat e Dënimit me Burgim (Kreu VII), atëherë edhe neni 31/10 i ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” duhet të konsiderohet si baza ligjore për të vepruar në rast të mos mbajtjes së kontakteve me Shërbimin e Provës dhe mospërmbushjeve me dashje të detyrimeve të dhëna nga gjykata.

52. Në lidhje me kohën e provës, Kolegjet vërejnë se as neni 64 i Kodit Penal, dhe as ligji nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” nuk jep ndonjë afat minimal apo maksimal të periudhës së kushtit. Në këtë kuptim, Kolegjet vërejnë se në disa raste praktike gjyqësore, gjykatat kanë zgjedhur për analogji, kohën e caktuar nga neni 59 i Kodit Penal, që varion nga 18 muaj deri në 5 vjet. Kolegjet e Bashkuara nuk ndajnë këtë qëndrim.

²³ Neni 31/10 i ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”:

Shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ:

Gjykata, me kërkesë të prokurorit, shqyrton shkeljen e kushteve të dënimit alternativ apo mospërmbushjen e detyrimit të dhënë dhe mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e pjesshëm a të plotë të dënimit alternativ.

Gjatë periudhës që shqyrton masën e revokimit të dënimit alternativ, gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e tij dhe të urdhërojë që personi i dënuar të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

Kur gjykata vendos ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, dënimi me burgim jepet në mungesë të dënimeve të tjera alternative të përshtatshme. Në çdo rast, gjykata merr parasysh mënyrën dhe shkallën e mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari.

Gjykata, pasi dëgjon prokurorin, të dënuarin, mbrojtësin e tij dhe provat e kërkuara prej tyre, merr vendim brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit. Vendimi i njoftohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, shërbimit të provës dhe prokurorit.

Ndaj vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

53. Së pari, në rastin e nenit 59 të Kodit Penal, i dënuari nuk vuan dënimin në një IEVP dhe vihet në provë, ndërkohë që në rastin e të liruarit me kusht, i dënuari ka vuajtur një pjesë të konsiderueshme të masës së dënimit; është riedukuar; ndërkohë që qëllimi i mbajtjes së kontaktit me shërbimin e provës është vetëm kapërcimi i vështirësive për riintegrimin social të të dënuarit. Për më tepër, kohëzgjatja e tepërt e periudhës së provës nuk është e justifikuar pasi “benefiti” për të liruarin me kusht është shumë herë më i vogël se në krahasim me të dënuarin që i pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim.

54. Së dyti, për sa kohë që ligjvënësi nuk ka përcaktuar qartë periudhën e kushtit, nuk mundet që gjykatat të marrin përsipër rolin e ligjvënësit duke caktuar në mënyrë arbitrare periudhën e kushtit për personin që lirohet me kusht. Në këtë kuptim, Kolegjet vlerësojnë se në mungesë të një rregullimi ligjor mbi periudhën e kushtit dhe referim të qëllimit të institutit të lirimit me kusht, kjo kohë nuk mund të jetë më e shkurtër se koha që i mbetet për t’u vuajtur të dënuarit. Ky interpretim mbështetet edhe në argumentin se ndërkohë që çdo caktim i periudhës së kushtit përtej kohës së mbetur të dënimit do të konsiderohej si i pambështetur në ligj, rasti i kundërt, pra caktimi i një periudhe kohe më të shkurtër se koha e mbetur e dënimit, do të shkonte kundër qëllimit të institutit të lirimit me kusht si dhe do të ulte efektivisht masën e dënimit të dhënë nga gjykata me vendim të formës së prerë.

55. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në qëndrimin unifikues si më poshtë:

- Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal.

- Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.

VI. Në lidhje me rekursin e Prokurorit të Apelit Shkodër

56. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi i ankimuar është i mbështetur në prova dhe në ligj dhe si i tillë, do të lihet në fuqi, me arsyetim pjesërisht ndryshe, me plotësimin e ngarkimit të kërkuarit Prenga si detyrim zbatimin e nenit 60 paragrafi I, pika “1” e Kodit Penal, përsa i përket ushtrimit të veprimtarisë profesionale.

57. Nga aktet rezulton se kërkuari Aleksandër Prenga ka plotësuar kërkesat objektive të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal. Për sa i përket kushtit të vuajtjes së të paktën $\frac{3}{4}$ të dënimit të dhënë (për masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim) rezulton se kërkuari, i dënuar përfundimisht me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim, të ketë vuajtur, deri me datë 02.12.2013, 9 (nëntë) vjet 8 (tetë) muaj e 7 (shtatë) ditë burgim, nga të cilat 5 (pesë) muaj e 22 (njëzetedy) ditë i ka fituar me paraburgim, 1 (një) vit, 2 (dy) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë me vendime gjyqësore për ulje dënimi, dhe i kanë mbetur për të vuajtur edhe 2 (dy) vjet 3 (tre) muaj e 23 (njëzet e tre) ditë.

58. Pretendimi nga ana e akuzës se kërkuari nuk ka vuajtur plotësisht $\frac{3}{4}$ e dënimit të dhënë për shkak të llogaritjes si kohë e vuajtur dhe të uljeve që i dënuari ka përfituar në bazë të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, nuk qëndron. Kolegjet e Bashkuara ri-përsërisin qëndrimin e Kolegjit Penal se në referim të nenit 64/2 të Kodit Penal²⁴ ligjvënësi ka përjashtuar në mënyrë të shprehur vetëm kohën e përfituar me

²⁴ Neni 64/2 i K.Penal: “Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje”.

falje dhe amnisti, ndërkohë që nuk shprehet për uljet e dënimit. Për aq kohë sa nuk ka një dispozitë ndaluese, uljet e dënimit do të përfshihen si pjesë e dënimit të vuajtur për efekt të aplikimit të institutit të lirimit para kohe me kusht. Në këtë kuptim, Kolegjet e gjejnë me vend të theksojnë parimin e përgjithshëm se normat e ligjit penal janë të ndërtuara, nga ana e teknikës legjislative, në aspektin negativ. Ndryshe nga fusha të tjera të së drejtës, ligji penal disiplinon vetëm sjelljet e ndaluara dhe që konsiderohen të dëmshme për shoqërinë. Çdo sjellje që nuk është parashikuar në ligjin penal si e ndaluar (dhe për të cilën parashikohet edhe sanksioni përkatës), është natyrisht e lejuar. Gjithashtu, interpretimi i normave penale duhet të orientohet gjithnjë drejt parimit *favor rei*. Nëse ligjvënësi do të kishte pasur për qëllim përjashtimin, përveç amnistisë dhe faljes, edhe të uljeve të dënimit që i dënuari ka përfutuar në bazë të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, atëherë me siguri do ta shtonte këtë kategori shprehimisht në tekstin e nenit 64 të Kodit Penal. Së fundi, edhe termi i përdorur nga organi i akuzës nuk është i saktë. Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka përfutuar nga faljet, dhënia e të cilave është prerogativë absolute e Presidentit të Republikës; por nga ulje të dënimit, që është prerogativë e gjykatave; ndërkohë që dhënia e amnistive i takon Kuvendit.

59. Gjykata e Apelit Shkodër me të drejtë ka arsyetuar se kërkuesi është riedukuar. Sipas saj kërkuesi Prenga ‘ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha aktivitetet e përbashkëta kulturore, edukative e sportive dhe ka qenë pjesë e programeve të karakterit psikoterapeutik. Shprehja e pendesës për veprën penale është evidentuar në vlerësimin e sjelljes së tij për efekt të lirimit me kusht, në të cilin shprehet se kur bie fjala për veprën penale shfaq shenja pendese dhe ia le moshës’.

60. Në lidhje me “arsyet e veçanta”, Kolegjet vlerësojnë se ato janë plotësuar pasi me punën dhe sjelljen e tij gjatë vuajtjes së dënimit, por edhe në vështrim të kushteve familjare; normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarit; si dhe sigurimin e një kontrate pune, kërkuesi është riedukuar dhe është i gatshëm për t’u riintegruar në shoqëri.

61. Në lidhje me natyrën e veprës penale të kryer, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se veprat penale të “Vjedhjes me armë” në bashkëpunim, “Plagosjes së rëndë me dashje” në bashkëpunim dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” të parashikuara nga nenet 140-25, 88/2-25 dhe 278/2 të Kodit Penal, konsiderohen si vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për të cilat kërkuesi është dënuar përfundimisht me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. Në këtë kuptim, rrezikshmëria e lartë shoqërore e veprave dhe e autorit (në kohën e kryerjes) vlerësohet si element negativ në pranimin e kërkesës për lirim me kusht dhe nevojën për t’u siguruar se gjatë kohës së vuajtur, kërkuesi Prenga është riedukuar.

62. Nga aktet e gjykimit rezulton se qëndrimi i kërkuesit Prenga ndaj veprave penale dhe ndaj të dëmtuarve nga veprat penale kanë qenë pendues. Gjykata e Apelit Shkodër me të drejtë ka marrë në konsideratë raportin e autoriteteve të IEVP-së Lezhë, nga kur rezultonte se sjellja e të dënuarit përgjatë tre viteve të fundit të dënimit vlerësohej pozitive; ka respektuar në vijimësi kërkesat e rregullores dhe nuk është ndëshkuar me masë disiplinore; e konstatuar në mënyrë indirekte kjo edhe nga përfitimi i uljeve të dënimit në bazë të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”. Për më tepër, gjatë kësaj kohe, kërkuesi rezulton të ketë marrë pjesë në programe dhe aktivitete kulturore, edukative e sportive dhe ka qenë pjesë e programeve të karakterit psikoterapeutik. Ndonëse, siç u përmend pak më lart, arritja e normalizimit të marrëdhënieve me të dëmtuarin nga vepra penale nuk është kusht ndalues në vetvete për pranimin e kërkesës për lirim me kusht (ndonëse kërkohet të paktën tentativa për të arritur normalizimin), në rastin konkret rezulton se me normalizimi i marrëdhënieve ka ndodhur, ku me deklaratën e datës 20.04.2013 nga Dioqezës së Rrëshenit, murgeshat e dëmtuara të kenë deklaruar se i dënuari ishte falur prej tyre plotësisht. Për sa më sipër

Kolegjet e Bashkuara e konsiderojnë qëndrimin e kërkuesit Prenga ndaj veprave penale dhe ndaj personave të dëmtuar nga vepra penale si pozitive dhe në favor të lirit me kusht.

63. Në lidhje me kushtet e tjera të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, rezulton se kërkuesi nuk është përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe nuk është dënuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100 të Kodit Penal. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, kjo rrethanë konsiderohet si neutrale.

64. Gjendja fizike e kërkuesit, sipas raportit të autoriteteve të I EVP-së rezulton e mirë. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, kjo rrethanë konsiderohet si neutrale.

65. Sipas akteve rezulton gjithashtu se kërkuesi ka marrëdhënie që nuk kanë rënë ndesh me personelin, reciprokisht të mira me bashkëvuajtësit, ndërsa me familjen ruan kontaktet dhe marrëdhëniet korrekte duke e pasur si burim mbështetjeje. I dënuari nuk bën pjesë në listën e të punësuarve, nuk është pjesë e programeve të arsimit profesional, por merr pjesë në programet terapeutike duke pranuar këshillat, bisedën, punën në grup si dhe ka aktivizim të mirë e korrekt në veprimtaritë kulturore dhe sportive. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, dinamika e sjelljes së kërkuesit Prenga gjatë vuajtjes së dënimit duhet të konsiderohet si pozitive.

66. Në vlerësimin tërësor të kërkesave ligjore dhe në bazë të akteve të administruara, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se Gjykata e Apelit Shkodër me të drejtë e ka konsideruar pozitivisht raportin e përpiluar nga autoritetet e I EVP-së Lezhë, duke e cilësuar si arritur qëllimin e riedukimit të kërkuesit Aleksandër Prenga.

67. Në lidhje me perspektivën e riintegrit në shoqëri të kërkuesit, Gjykata e Apelit me të drejtë ka konstatuar se punonjësi i Shërbimit të Provës ka deformuar faktet duke referuar se i dënuari nuk ka sjellje të mirë me personelin, ndërkohë që nga vlerësimet e sjelljes për të dënuarin ka rezultuar e kundërta. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me referimin e uljes së pjesshme të dënimit kur punonjësi i shërbimit të provës i referohet një ulje të dënimit 45 ditore të dhënë në vitin 2008, periudhë e cila nuk përfshihet në periudhën e fundit tre vjeçare të sjelljes dhe i referohet një vendimi të gjykatës të dhënë në vitin 2013, me të cilin është aplikuar ulje e pjesshme, për shkak se ulja është dhënë për një periudhë më të vogël se një vit të plotë të vuajtjes së dënimit dhe jo për shkak të problemeve të sjelljes së të dënuarit.

68. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se kushtet e rënduara ekonomike të familjarëve të kërkuesit nuk duhet të konsiderohen si element negativ në pranimin e kërkesës për lirim me kusht. Për sa i përket gjendjes shëndetësore të tij dhe familjarëve të tij, Gjykata e Apelit ka pranuar se vetë kërkuesi vuan nga ‘një sëmundje e tillë si migrena me aure, si dhe nga ana tjetër nëna e tij vuan nga sëmundje kronike prek dy vitesh’. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, ky element konsiderohet në favor të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

69. Në lidhje me planet konkrete të kërkuesit për të mundur riintegrimin e plotë të tij pas lirit, nga gjykatat është administruar edhe oferta e punësimit e shoqërisë “Kopi” sh.p.k e cila sipas Gjykatës së Apelit Shkodër, ‘megjithëse është raportuar nga kërkuesi nuk është analizuar dhe vlerësuar nga shërbimi i provës’. Siç u cilësua edhe më lart,²⁵ ‘planet për të punuar apo sigurimi i një kontratë pune duhen konsideruar si një element mjaft i rëndësishëm që shkon në favor të kërkuesit’. Megjithatë ky plan duhet të jetë realist dhe i kontrollueshëm. Për këtë arsye, Kolegjet e Bashkuara e gjejnë me vend urdhërimin e detyrimit të kërkuesit për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës dhe zbatimin nga ana e tij të kushtit të parashikuar nga neni 60, paragrafi I, pika 1 e Kodit Penal në lidhje me ushtrimin nga ana e tij të një veprimtarie profesionale, sipas kontratës së punës të paraqitur në kërkesën për lirim me kusht. Në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, plotësimi i këtij detyrimi, pra ushtrimi i një aktiviteti profesional, përbën një faktor me rëndësi në uljen e rrezikut të recidivizmit dhe riintegrimin e kërkuesit në shoqëri nëpërmjet punës.

²⁵ *Supra*, para. 42.

VII. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

70. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi i ankimuar është i mbështetur në prova dhe në ligj dhe si i tillë, do të lihet në fuqi, me arsyetim pjesërisht ndryshe, me plotësim ngarkimin e kërkuesit Prenga si detyrim të zbatimit të nenit 60 paragrafi I, pika “1” të Kodit Penal, për sa i përket ushtrimit të veprimtarisë profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 438 dhe 441/a të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N

Lënien në fuqi të vendimit nr.121 datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër me këtë plotësim:

Detyrimin e të dënuarit Aleksandër Prenga për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës, duke i ngarkuar si detyrim zbatimin e nenit 60 paragrafi I, pika “1” e Kodit Penal, për sa i përket ushtrimit të veprimtarisë profesionale, sipas kontratës së punës të paraqitur në kërkesën me objekt: “Lirim me kusht”

Ky vendim është unifikues, njehson praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 25.05.2015

MENDIM PAKICE

Unë gjyqtari **Medi Bici** jam kundër vendimit unifikues nr.02, datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkuarit Aleksandër Prenga, me objekt lirim para kohe me kusht, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, prandaj në përputhje me kërkesat e nenit 112/5 të K.Pr.Penale, përpiloj këtë procesverbal përmbledhës me motivet e kundërshtimit të vendimit.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes ka rezultuar si më poshtë:

Kërkuesi Aleksandër Prenga, ka vuajtur në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë dënimin e dhënë me vendimin nr.25, datë 02.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë. Ai është deklaruar fajtor dhe dënuar nga kjo gjykatë me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim për kryerjen e veprave penale të vjedhjes me armë, e kryer në bashkëpunim, plagosjes së rëndë me dashje, e kryer në bashkëpunim dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 140-25, 88/2-25 dhe 278/2 të Kodit Penal, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.824, datë 17.11.2006.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezultojnë që kërkuesi është arrestuar me datë 02.12.2005. Duke pretenduar se plotëson kushtet e nenit 64 të Kodit Penal, ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me kërkesën për lirim të tij me kusht.

Kërkuesi Aleksandër Prenga është arrestuar me datë 02.12.2005 dhe deri me datë 02.12.2013 ka vuajtur 9 (nëntë) vjet 8 (tetë) muaj e 7 (shtatë) ditë burgim nga të cilat 5 (pesë) muaj e 22 (njëzet e dy) ditë i ka fituar me paraburgim, 1 (një) vit, 2 (dy) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë me vendime gjyqësore për ulje dënimi dhe i kanë mbetur për të vuajtur edhe 2 (dy) vjet 3 (tre) muaj e 23 (njëzet e tre) ditë. Nga dinamika e vuajtjes së dënimit e hartuar nga I EVP Lezhë, rezultojnë se kërkuesi Aleksandër Prenga deri me datë 19.05.2014 ka shlyer 11 (njëmbëdhjetë) vjet 4 (katër) muaj e 18 (tetëmbëdhjetë) ditë burgim dhe i kanë mbetur për të vuajtur 7 (shtatë) muaj e 12 (dymbëdhjetë) ditë burgim. Ai ka përfituar ulje dënimi, përkatësisht 1 (një) vit me ligjin nr.22/2014, datë 10.03.2014 “Për dhënie amnistie” dhe 1 (një) vit 5 (pesë) muaj e 9 (nëntë) ditë me vendime gjyqësore për ulje dënimi, në zbatim të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Me vendimet nr.288, datë 11.07.2011, nr.295, datë 31.05.2010, nr.150, datë 15.04.2009, nr.148, datë 17.03.2008, nr.342, datë 27.07.2012, nr.108, datë 20.02.2013 dhe nr.141, datë 24.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë rezultojnë se të dënuarit Aleksandër Prenga t’i jetë ulur dënimi si rezultat i zbatimit të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr.02, datë 03.05.2011, e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë rezultojnë se i dënuari Aleksandër Prenga është dënuar vetëm një herë sipas vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë nr.25, datë 02.05.2006 dhe ai nuk është recidivist (përsëritës) në krim.

Raporti i I EVP Shënkoll nr.10163 prot, datë 27.11.2013 tregon se i dënuari Aleksandër Prenga është dënuar me 12 vite burgim për veprat penale, të parashikuara nga nenet 140-25, 88/2-25 dhe 278/2 të K.Penal, është i penduar për veprën e kryer, nuk ka konsumuar vepër tjetër penale, paraqitet me gjendje fizike dhe psikologjike të mirë, ndërsa sjellja e tij gjatë 3 (tre) viteve të fundit ka qenë e mirë.

Vlerësimi i sjelljes nr.10162, datë 27.11.2013 i lëshuar nga I EVP Shënkoll, Lezhë, konfirmon se i dënuari Aleksandër Prenga është vendosur në këtë institucion me datë 26.02.2007, është beqar, me arsim 8 klasë, i penduar për veprën e kryer për të cilën shprehet se ka ndodhur për shkak të moshës; zbaton kërkesat e rregullores, nuk është i ndëshkuar me masë disiplinore për tre vitet e fundit, ka marrëdhënie që nuk kanë rënë ndesh me personelin, reciprokisht të mira me

bashkëvuajtësit, ndërsa me familjen ruan kontaktet dhe marrëdhëniet korrekte, duke e pasur si burim mbështetjeje. I dënuari nuk bën pjesë në listën e të punësuarve, nuk është pjesë e programeve të arsimit profesional, por merr pjesë në programet terapeutike, duke pranuar këshillat, bisedën, punën në grup si dhe ka aktivizim të mirë e korrekt në veprimtaritë kulturore dhe sportive. Si konkluzion komisioni i vlerësimit i I EVP Lezhë e ka vlerësuar pozitivisht kërkuesin për periudhën 3 vjeçare në lidhje me kërkesën objekt gjykimi.

Raporti i vlerësimit i hartuar nga Zyra e Shërbimit të Provës Lezhë me nr.30/2 prot, datë 20.01.2014 nga ku rezulton se kjo zyrë të ketë rekomanduar mospranimin e kërkesës së të dënuarit për shkak se riintegrimi i tij në shoqëri është i vështirë, pasi nga vlerësimi i sjelljes, ajo vlerësohet si sjellje që nuk bie ndesh me personelin, dhe jo si sjellje e mirë, se ai nuk është i punësuar në institucion, se me raste shfaq shenja pendese, apo se vepra është një temë që nuk preferon ti referohet, se kryerja njëkohësisht e tre veprave penale tregon rrezikshmëri të tij, se ai në intervistë ka shpjeguar se ka qenë i pirë në kohën e kryerjes së veprës penale, fakt i cili nuk rezulton nga vendimi gjyqësor, se i dënuari ka nivel arsimor të ulët dhe në dy raste nuk ka përfituar ulje të plotë dënimi.

Nga raporti i shërbimit të provës rezulton se familja e kërkuesit jeton në Shënkoll Lezhë dhe përbëhet nga dy prindërit, dy vëllezërit dhe bashkëshortja e vëllait Arben. Familja e të dënuarit sipas referencës nr.158, datë 10.04.2013 rezulton të trajtohet me ndihmë ekonomike dhe ajo jeton nga puna sezonale e babait apo vëllait të tij. Ajo jeton në kushte të vështira ekonomike në një banesë me 4 dhoma. Në gjendjen shëndetësore të të dënuarit raportohet se ai ka pësuar dy ndërhyrje kirurgjikale, një për apendisit dhe tjetrin për heqjen e bajameve.

Sipas vërtetimit të datës 15.12.2013 të lëshuar nga firma “Kopi” rezulton që kjo firmë ka marrë përsipër që të punësojë kërkuesin në rast të lirimit me kusht. Nga deklarata e datës 20.04.2013 e Dioqezës së Rrëshenit rezulton se për ngjarjen e datës 29.11.2005 ku ishin vjedhur me dhunë dhe plagosur me armë zjarri në Klos-Fan Mirditë nga të dënuarit Aleksandër Prenga dhe Robert Lleshi murgeshat e dëmtuara të kenë deklaruar se i dënuari ishte falur prej tyre plotësisht. Ato kanë konsideratë nga gjykata marrëdhëniet e tyre kristiane ishin normalizuar kërkuar që kjo deklaratë pajtimi të merret në për lirim me kusht të të dënuarit.

Vërtetimi i Qendrës Shëndetësore Shënkoll i datës 12.12.2013 rezulton se prej dy vitesh, nëna e të dënuarit, shtetasja Dila Prenga vuante nga sëmundja nodulare me hiperfiksion të tiroides që sillte si pasojë takikardi, stres dhe gjendje depresive psikotike.

Nga shkresat e I EVP Lezhë rezulton që kërkuesit Aleksandër Prenga i është dhënë disa herë leje shpërblyese për sjellje të mirë dhe në një rast për gezim familjar dhe nuk rezulton që ai të ketë thyer kushtet e lejes. Sipas shkresës nr 5340 prot, datë 18.06.2014 të I EVP Lezhë rezulton se kërkuesi të jetë diagnostikuar me Migrenë me aura (në muajin qershor 2014) dhe trajtohet për këtë sëmundje, ndërkohë që nga historiku klinik rezulton të jetë ankuar për çrregullime të gjumit, ndërsa në shkurt 2012 i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale Tonsillectomia.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.36, datë 28.05.2014 ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Aleksandër Prenga si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.121, datë 18.09.2014 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.36, datë 28.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në këtë mënyrë:

Pranimin e kërkesës së kërkuesit Aleksandër Prenga.

Urdhërohet lirim me kusht i të dënuarit Aleksandër Prenga për pjesën e pavuajtur të dhënë me vendimin nr.25, datë 02.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, i lënë në fuqi me vendimin nr.824, datë 17.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke urdhëruar vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 18 muajsh.

Urdhërohet i dënuari të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Lezhë gjatë periudhës së provës.

Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit Aleksandër Prenga nëse nuk ka masë sigurimi “Arrest në burg” për llogari të ndonjë procedimi tjetër penal ose dënimi tjetër me burgim.

Me rekurs të Prokurorisë së Apelit Shkodër çështja ka ardhur për shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 22.01.2015 e ka sjellë atë për unifikimin e praktikës gjyqësore, duke parashtruar para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë pyetjet e mëposhtme:

Në mungesë të një përkufizimi në Kodin Penal, çfarë do të kuptohet me shprehjen “arsye të veçanta”, të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, në procesin penal me objekt lirin para kohe me kusht?

Në rastin kur pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, a duhet gjykata të caktojë gjithashtu një periudhë kohe ku i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë? Nëse po, sa duhet të jetë ky afat i mbajtjes në provë?

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr.02, datë 25.05.2015 kanë vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.121, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër me këtë plotësim:

Detyrimin e të dënuarit Aleksandër Prenga për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës, duke i ngarkuar si detyrim zbatimin e nenit 60 paragrafi I, pika “1” të Kodit Penal, përsa i përket ushtrimit të veprimtarisë profesionale, sipas kontratës së punës të paraqitur në kërkesën me objekt: “Lirim me kusht”.

Ky vendim është unifikues, njëson praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Pakica vlerëson se vendimi unifikues nr.02, datë 25.05.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me ligjin material penal, si përsa i përket unifikimit të praktikës gjyqësore, ashtu edhe përsa i përket zgjidhjes së çështjes konkrete.

Përsa i përket pikës së parë të unifikimit, shumica ka arritur në përfundimin që “arsyet e veçanta”, të parashikuara nga neni 64/1 i Kodit Penal duhet të lidhen me “edukimin” e të dënuarit dhe se “arsyet e veçanta” nuk duhet të merren si rrethana të jashtme (të veçuara).

Ky përfundim që ka arritur shumica është në kundërshtim me parashikimet e nenit 64/1 të Kodit Penal, sepse “arsyet e veçanta” dhe “edukimi” i të dënuarit mund të jenë krejtësisht të pavarura nga njëra-tjetra. Vlerësimi im është se, shumica nuk ka arritur të kuptojë si duhet qëllimin e ligjvënësit në çastin e ndryshimit të kësaj dispozite ligjore, duke e shkrirë “arsyen e veçantë” me “edukimin” e të dënuarit.

Për ta bërë më të qartë këtë moment, duhet të kthehemi pas në kohën e ndryshimit të nenit 64/1 të Kodit Penal me ligjin nr.8733/2001. Ky ndryshim i ligjit erdhi pas kontrollit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në disa gjykata të vendit dhe sidomos në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2000. Nga këto kontrole rezultoi që nga gjykatat instituti i lirit para kohe me kusht ishte kthyer në një mjet të zakonshëm për lirin e të dënuarve menjëherë sapo ato mbushnin gjysmën e dënimit të dhënë nga gjykata, pa marrë parasysh asnjë lloj kriteri tjetër, duke u konsideruar gjithë të dënuarit “të edukuar”.

Duke u ndodhur në këto rrethana, ligjvënësi jo vetëm rriti pjesën e vuajtjes fizike deri në ¾ e dënimit, por tha që instituti i lirit me kusht mund të zbatohet nga gjykatat “vetëm për arsye të veçanta”, që do të thotë se, një i dënuar që kërkon të lirohet para kohe me kusht jo vetëm që duhet të rezultojë me një sjellje shembullore në burg, duke treguar qartësisht se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, por ai duhet të provonte para gjykatës se ekzistonte të paktën edhe një arsye e veçantë, në mënyrë që ai të ketë të drejtë që të përfitonte nga instituti i

lirimit para kohe me kusht. Arsyetimi i veçantë i është lënë në dorë gjykatës për ta vlerësuar, duke arsyetuar në çdo rast se, përse ajo që pretendon i dënuari përbën me të vërtetë një rrethanë e veçantë.

Në kohën kur ka bërë ndryshimin e nenit 64/1 të Kodit Penal, ligjvënësi ka patur si qëllim për të nxjerrë në pah edhe natyrën humane të institutit të lirimit para kohe me kusht, që do të thotë që “arsyeja e veçantë” lidhet me natyrën humane të ligjit, siç mund të jenë: mbetja e fëmijëve të mitur pa prindin tjetër, gjendja e rëndë shëndetësore e një të pjesëtari të familjes në ngarkim të të dënuarit, kur për këtë nuk ka asnjë person tjetër që të kujdeset, etj.....

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë këtë bindje, por mendimi im është se ato ngatërrojnë “arsyen e veçantë” me “edukimin” e të dënuarit, që në fakt kanë ndryshime thelbësore me njëra-tjetrën, pasi “edukimi” i të dënuarit duhet të shikohet si kriteri i parë (kryesor) për tu përmbushur nga i dënuari që kërkon të lirohet para kohe me kusht dhe nëse gjykata bindet plotësisht nga provat sjella nga institucionet e riedukimit dhe shërbimi i provës se me kohën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e të dënuarit, kjo gjë nuk mjafton që ai të lirohet para kohe me kusht, por gjykata duhet të marrë në shqyrtim edhe “arsyen e veçantë”, të pretenduar nga i dënuari. Sipas vlerësimit të pakicës vetëm edukimi i të dënuarit sipas kuptimit të nenit 64/1 të Kodit Penal nuk i jep të drejtë atij që të lirohet para kohe me kusht, po që se nuk është prezent të paktën edhe një arsye e veçantë. Arsyetimi i mësipërm të çon në konkluzionin se, për t’u zbatuar neni 64/1 i Kodit Penal është e detyrueshme që të përmbushen në të njëjtën kohë dy kushte, të cilat janë: “Edukimi” i të dënuarit dhe “arsyeja e veçantë” (të cilat janë komulative).

Arsyetimi që bën shumica në vendim se, duhet të ulet mbipopullimi i burgjeve sipas rekomandimit të Bashkimit Europian nuk qëndron, sepse gjykatat zgjidhin çështjet e të drejtës dhe jo politikat që bëjnë shtetet me të dënuarit, të cilat janë në kompetencë ekskluzive e organeve të tjera shtetërore. Mbiipopullimi i burgjeve mund të zgjidhet fare lehtësisht me zbatimin e institutit të amnistisë, i parashikuar nga neni 71 i Kodit Penal, ose nga zbatimi i institutit të faljes, i parashikuar nga neni 70 i Kodit Penal.

Duke bashkuar të dy kërkesat e parashikuara nga neni 64/1 i Kodit Penal në një kërkesë të vetme, shumica nuk bën gjë tjetër veçse ka shfuqizuar kërkesën e parë të nenit 64/1 të Kodit Penal që përbëhet nga togfjalëshi “*vetëm për arsye të veçanta*”, duke e çuar dispozitën ligjore në gjendjen e saj të para ndryshimeve të vitit 2001, duke i hapur në këtë mënyrë rrugën lirimit para kohe me kusht të gjithë personave të dënuar dhe duke ulur tej mase rëndësinë që ka instituti i lirimit para kohe me kusht, duke e bërë atë një instrument të zakonshëm për lirimin e të dënuarve, në një kohë që ligji ynë penal parashikon se, për disa lloje veprash penale nuk ekziston instituti i lirimit para kohe me kusht, ndërsa për disa vepra penale të tjera gjykatat mund të urdhërojnë që i dënuari të mos ketë të drejtë të lirohet para kohe me kusht pa mbushur një masë dënimi të caktuar. Këto argumente përforcojnë qëndrimin që mban pakica se instituti i lirimit para kohe me kusht është një institut probabël (i mundshëm) i të drejtës penale shqiptare, që do të thotë se kurrësi ai nuk mund të përdoret si një instrument i zakonshëm për uljen e mbipopullimit të burgjeve, por nga ai duhet të përfitojnë vetëm të dënuarit me një sjellje shembullore, të cilët provojnë para gjykatës se kanë të paktën edhe një arsye të veçantë për tu liruar para kohe me kusht.

Pakica e ka vënë në pah edhe herë të tjera se, nuk është në kompetencë të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë shfuqizimi, ndryshimi, ose bërja e ligjeve, pasi kjo kompetencë i përket Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, por është detyrë e Kolegjeve të Bashkuara që nëpërmjet interpretimit të ligjit të mbushin boshllëqet ose keqkuptimet që mund të lejoj ligji, në mënyrë që të udhëzohet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt praktika gjyqësore.

Edhe në pikën e dytë të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse ato kanë dalë jashtë funksionit të tyre

kushtetues, duke caktuar vetë afate, pra në këtë pikë të vendimit, Kolegjet e Bashkuara kanë bërë të kundërtën e asaj që kanë bërë në pikën e parë unifikuese të vendimit, ku kanë shfuqizuar pjesërisht ligjin (në pikën e dytë unifikuese ato kanë bërë ligj të ri).

Neni 64 i Kodit Penal dhe ligji nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” nuk parashikojnë ndonjë afat minimal apo maksimal të periudhës së kushtit. Në disa raste gjykatat kanë zgjedhur për analogji, kohën e caktuar nga neni 59 i Kodit Penal, që varion nga 18 muaj deri në 5 vjet. Shumica është kundër këtij qëndrimi që ka mbajtur praktika gjyqësore, duke arritur në qëndrimin unifikues se: Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim, për të dënuarin që lirohet me kusht.

Jam i mendimit se në rastin konkret nuk janë gjykatat më të ulëta ato që kanë marrë rolin e ligjvënësit (ashtu siç arsyeton shumica), pasi ato i janë referuar një afati që është i parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal, i cili nuk i përket lirimit para kohe me kusht, por dënimit me kusht. Duhet theksuar se këto dy institute të së drejtës penale janë të ngjashme me njëri-tjetrin, prandaj rolin e ligjvënësit e kanë marrë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë caktuar afate të reja (që janë të ndryshme për të dënuar të ndryshëm). Meqenëse për këtë moment ka boshllëk ligjor, pakica pajtohet plotësisht me qëndrimin që ka mbajtur deri tani praktika gjyqësore, që në lirimin para kohe me kusht si afat duhet të zbatohet ai i parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, sepse kështu gjykatat i bëjnë një interpretim të zgjeruar ligjit, duke e ruajtur funksionin e tyre, dhe jo të caktohen afate të reja nga gjykata, që në fakt nuk është gjë tjetër veçse bërja e një ligji të ri, gjë e cila e nxjerrë Gjykatën e Lartë jashtë funksionit të saj kushtetues.

Përsa i përket zgjidhjes së çështjes konkrete, pakica është e mendimit që në rastin në shqyrtim duhej të pranohej rekursi i paraqitur nga prokurori, prandaj çështja duhej të kthehej për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër, me tjetër trup gjykues. Në rigjykim gjykata e apelit duhet të hetonte në lidhje “edukimin” e kërkuarit dhe “arsyen e veçantë” të pretenduar prej tij.

Për të gjitha këto që u thanë më sipër, pakica krijon bindje të plotë se vendimi unifikues nr.02, datë 25.05.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me kërkesat e nenet 64/1 të Kodit Penal, si përsa i përket unifikimit të praktikës gjyqësore, ashtu edhe përsa i përket zgjidhjes së çështjes konkrete, prandaj vota ime është kundër tij.

Medi Bici

MENDIM PAKICE

Ne, gjyqtarët në pakicë Ardian Nuni dhe Aleksandër Muskaj, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me zgjidhjen e çështjes penale në Vendimin Njësues nr.02, datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Jemi dakord me konkluzionet e arritura nga Kolegjet e Bashkuara në lidhje me çështjet e shtruara për njësim se:

- *“Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit para kohe me kusht i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri “.*
- *“Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.”.*

Mbi këtë bazë duke vlerësuar se arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri, vërejmë se:

Në lidhje me çështjen e parë, ne gjyqtarët në pakicë çmojmë se Kolegjet e Bashkuara janë kontradiktore kur, nga njëra anë shprehen se *“arsyet e veçanta”* janë të lidhura ngushtë me riedukimin dhe nuk kanë të bëjnë me element apo faktorë jashtë kontrollit të të dënuarit, ndërsa nga ana tjetër vijnë arsyetimin se rrethanat që kanë të bëjnë me familjarët e të dënuarit mund të merren parasysh nga ana e gjykatave, jo si kusht thelbësor, por si rrethanë që shkon në favor të kërkesës për lirim me kusht, në drejtim të analizës së gjykatës për riintegrimin e plotë të të dënuarit pas lirimit dhe se një nga çështjet e nevojshme që gjykatat duhet të vlerësojnë në shqyrtimin e kërkesave me objekt lirim me kusht janë dhe kushtet familjare dhe prejardhja shoqërore e të dënuarit duke theksuar se kushtet e vështira ekonomike apo gjendja e rëndë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit nuk duhet kurrsesi që të konsiderohen, në vetvete, si elementë në disfavor të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.

E më tej Kolegjet arsyetojnë se vetëm në bazë të raporteve specifike, ku të përshkruhen me hollësi sjellja e të dënuarit gjatë vuajtjes apo kushtet familjare dhe planet e tij për të mundur riintegrimin e tij në shoqëri, do të bëhet e mundur që gjykata të vlerësojë me të dhëna objektive zbatimin apo jo të institutit të lirimit me kusht për të dënuarin përkatës.

Lidhur me sa më sipër vlerësojmë:

Së pari: Kushtet familjare apo sociale të të dënuarit jo vetëm që nuk barazohen apo kanë të bëjnë me “arsyet e veçanta”, por as nuk përfshihen në të, pasi janë një faktor i jashtëm, i cili nuk ka të bëjë dhe nuk është shprehje as e riedukimit, as e arritjes së qëllimit të dënimit penal për të dënuarin konkret, i cili kërkon që të lirohet me kusht.

Së dyti: Kushtet familjare apo sociale të të dënuarit nuk janë të parashikuara si kriter ligjor në nenin 64 të K.Penal mbi lirimin me kusht. Kjo dispozitë, parashikon vetëm dy kushte që duhet të mbahen parasysh nga gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesave për lirimin me kusht, të cilët janë i) arsyet e veçanta, pra kur me punën dhe sjelljen e tij tregon se është arritur qëllimi i edukimit të tij me dënimin e vuajtur dhe ii) në varësi të llojit dhe natyrës së veprës për të cilën është dënuar, vuajtjen e një pjese të caktuar të dënimit.

Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara se edhe këto kushte duhet të merren parasysh nga gjykata, në favor të pranimit të kërkesës së lirimit para kohe me kusht apo që gjykata të vlerësojë me të dhëna objektive zbatimin apo jo të institutit të lirimit me kusht për të dënuarin përkatës, jo vetëm që është i pabazuar në këtë dispozitë, por nuk është në interpretim të drejtë me ligjin e posaçëm. Neni 31/6 i Ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, shtuar me Ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008, parashikon ndër të tjera se: “Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e tij pas lirimit”, duke mos e lidhur në asnjë moment këtë kusht me pranimin apo jo të kërkesës, por vetëm me mundësinë e gjykatës për të vlerësuar me objektivitet se cila do të jetë rruga apo e ardhmja e të dënuarit pas lirimit të tij me kusht, pra për të qenë sa më i lehtë

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendimin Njësues nr.2, datë 25.05.2015 kanë vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.121, datë 18.09.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër me këtë plotësim:

Detyrimin e të dënuarit Aleksandër Prenga për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës, duke i ngarkuar si detyrim zbatimin e nenit 60 paragrafi I, pika “1” e Kodit Penal, përsa i përket ushtrimit të veprimtarisë profesionale, sipas kontratës së punës të paraqitur në kërkesën me objekt: “Lirim me kusht”...”.

Në këtë vendim shumica ndër të tjera ka arsyetuar se: “Në lidhje me “arsyet e veçanta”, Kolegjet vlerësojnë se ato janë plotësuar pasi me punën dhe sjelljen e tij gjatë vuajtjes së dënimit, por edhe në vështrim të kushteve familjare; normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarit; si dhe sigurimin e një kontrate pune, kërkuesi është riedukuar dhe është i gatshëm për t’u riintegruar në shoqëri”.

Pakica vlerëson se, nuk duhet ngatërruar çmuarja e rrezikshmërisë, rrethanave personale, qëllimi riedukues dhe vlerësimi i bërë në momentin e caktimit të dënimit me atë të bërë në momentin e shqyrtimit të kërkesës me objekt lirimin me kusht të të dënuarit.

Në rastin e parë, pra në momentin e caktimit të dënimit, gjykata mban parasysh nenet 47 e vijues të K.Penal, në mënyrë që të individualizohet dënimi duke i caktuar personit konkret dënimin më të përshtatshëm në funksion të arritjes së qëllimit final, riedukimit të tij. Ndërsa, në rastin e shqyrtimit të kërkesës me objekt lirimin me kusht, gjykata nuk është më e lidhur me rrethanat dhe kushtet e marra parasysh në caktimin e dënimit, por me sjelljen aktuale të të dënuarit dhe zbatimin i këtij instituti, në thelb, nënkupton se i dënuari, ndryshe nga ç’është disponuar në

vendimin e dënimit, nuk ka nevojë më të mbahet i izoluar nga shoqëria, pikërisht sepse me sjelljen dhe punën e tij tregon se dënimi i dhënë e ka arritur qëllimin përpara se të ekzekutohet plotësisht.

Lidhur me zgjidhjen e çështjes konkrete, pakica mendon se nuk është detyrë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por e gjykatave të faktit vlerësimi i rrethanave konkrete të faktit që kanë lidhje me çështjen.

Shumica është kontradiktore në qëndrimin e saj pasi nga njëra anë shprehet se kushtet familjare apo sociale të të dënuarit nuk janë të parashikuara si kriter ligjor në nenin 64 të K.Penal mbi lirimin me kusht, nga ana tjetër i merr në konsideratë ato në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, duke u shprehur se “arsyet e veçanta”, janë plotësuar edhe në vështrim të kushteve familjare, si dhe normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarit.

Kolegjet e Bashkuara, në çështjen konkrete kanë vlerësuar në mënyrë kontradiktore me qëndrimin njësoj, “arsyet e veçanta” janë të lidhura ngushtë me riedukimin dhe nuk kanë të bëjnë me element apo faktorë jashtë kontrollit të të dënuarit, duke marrë në konsideratë si element që konsiderohet në favor të pranimit të kërkesës për lirim edhe faktin se nëna e tij vuan nga një sëmundje kronike prej dy vitesh.

Pakica mban qëndrimin se, edhe disponimi i shumicës për urdhërimin e kërkuesit Aleksandër Prenga për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës dhe zbatimin nga ana e tij të kushtit të parashikuar nga neni 60, paragrafi I, pika 1 i Kodit Penal në lidhje me ushtrimin nga ana e tij të një veprimtarie profesionale, sipas kontratës së punës të paraqitur në kërkesën për lirim me kusht, nuk është një çështje që mund të zgjidhet gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë si gjykatë ligji, por është një çështje që duhet të ishte objekt vlerësimi nga gjykatat e faktit.

Gjithashtu vendimmarrja e shumicës është kontradiktore me qëndrimin njësoj të arritur prej saj, pasi ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër i cili ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës së kërkuesit Aleksandër Prenga.*”

Urdhërohet lirimi me kusht i të dënuarit Aleksandër Prenga për pjesën e pavuajtur të dhënë me vendimin nr.25, datë 02.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, i lënë në fuqi me vendimin nr.824, datë 17.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë duke urdhëruar vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 18 muajsh”.

Gjykata e Apelit Shkodër ka urdhëruar vënien në provë të të dënuarit Aleksandër Prenga për një periudhë prej 18 muajsh ndërkohë që nga aktet e dosjes gjyqësore, ka rezultuar se kërkuesit deri në datën e dhënies së vendimit në apel i kanë mbetur pa vuajtur edhe 3 muaj e 13 ditë burgim.

Kolegjet e Bashkuara, në kundërshtim me qëndrimin e arritur prej tyre, e shtrijnë periudhën e provës, edhe për periudhën pas përfundimit plotësisht të dënimit prej kërkuesit Aleksandër Prenga.

Sa më sipër, duke vlerësuar se rrethanat faktike të çështjes janë objekt vlerësimi vetëm nga gjykatat e faktit dhe se vendimi nr.121, datë 18.09.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër është kontradiktor me vlerësimin e tyre dhe inkohorent me qëndrimin njësoj, mendojmë se çështja duhet të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjithashtu edhe urdhërimi i kërkuesit për mbajtjen e kontakteve me shërbimin e provës duhet t’i nënshtrohet shqyrtimit në fakt.

Si përfundim ne gjyqtarët në pakicë jemi të mendimit se vendimi nr.121, datë 18.09.2014, i Gjykatës së Apelit Shkodër duhej të prishej dhe çështja të dërgohej për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

G J Y Q T A R Ë

Aleksandër MUSKAJ

Ardian NUNI

MENDIMI I PAKICËS

Si gjyqtarë në pakicë, kemi qëndrimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk duhet të kishin disponuar lënien në fuqi të vendimit nr.121, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër me plotësimin e detyrimit të të dënuarit Aleksandër Prenga për të mbajtur kontakte me shërbimin e provës dhe për të zbatuar detyrimin për ushtrimin e veprimtarisë profesionale. Përkundrazi, disponimi i Kolegjeve të Bashkuara duhet të ishte prishja e vendimit nr.121, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trupë gjykuese.

Qëndrimi jonë i kundërt si gjyqtarë në pakicë në raport me shumicën e Kolegjeve të Bashkuara, lidhet jo vetëm me mënyrën e arsytimit dhe të disponimit për zgjidhjen e çështjes objekt i këtij gjykimi, por edhe me interpretimin dhe përfundimet që shumica e Kolegjeve ka parashtruar për pyetjen e parë të shtruar për diskutim në funksion të njehsimit të praktikës gjyqësore.

Së pari, shumica e Kolegjeve të Bashkuara ka arritur në përfundimin unifikues se, me shprehjen “arsye të veçanta” të nenit 64 të Kodit Penal, ligjvënësi nuk i ka treguar konkretisht se cilat janë këto “arsye”, duke ia lënë vlerësimin e ekzistencës së tyre konkretisht gjykatës që shqyrton çështjen konkrete.

Si gjyqtarë në pakicë ndajmë të njëjtin qëndrim lidhur me këtë përfundim të parë të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara.

Së dyti, si gjyqtarë në pakicë, gjithashtu, kemi qëndrim të njëjtë me shumicën e Kolegjeve të Bashkuara edhe lidhur me përfundim se këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe se duhet të vlerësohen njëkohësisht, së bashku me kushtin tjetër, atë të arritjes së qëllimit të edukimit të të dënuarit nëpërmjet vuajtjes së tij.

Por, në dallim nga shumica e Kolegjeve, ndonëse i konsiderojmë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit me kusht, me riedukimin e riintegrimin e të dënuarit, kemi qëndrimin se “arsyet e veçanta” duhet të verifikohen nga gjykata si përmbushje ose jo të një kushti tjetër, të pavarur nga fakti nëse është arritur kushti i parë, pra ai i riedukimit të të dënuarit, për shkak se këto ‘arsye të veçanta’ nuk janë element i vlerësimit të ekzistencës dhe pjesë e arritjes së kushtit të parë, atij të riedukimit të të dënuarit sipas sjelljes dhe qëndrimit të mbajtur prej tij gjatë vuajtjes së dënimit.

Së treti, si gjyqtarë në pakicë, kemi mendim të kundërt me shumicën e Kolegjeve të Bashkuara lidhur me përfundimin e ardhur prej saj se arsyet e veçanta “...nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për riedukimin

dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri...” dhe se “....kemi të bëjmë me një kusht të vetëm...”

Nëse do të ishte ky interpretimi i ligjit, do të duhej të pranohej që shprehja “*vetëm arsye të veçanta*” e nenit 64 të Kodit Penal, është një shprehje e tepërt dhe e panevojshme. Por, pakica ka qëndrimin se nuk mund të pranohet që kjo shprehje, aq më tepër me fjalën “*vetëm*”, është e lidhur me vërtetimin e rrethanave të arritjes së qëllimit të riedukimit dhe cilësive të riintegrit. Sipas qëllimit dhe në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal i dënuari duhet të rezultojë ose jo i riedukuar, por nuk mund të ketë konkluzion për sjellje dhe punë që tregojnë riedukim “*vetëm*” “*të veçantë*” apo thjesht “*të zakonshëm*”, të dënuar shumë të riedukuar apo mjaftueshmërisht të riedukuar. Ligji kërkon thjesht dhe qartë që, në këtë aspekt, të plotësohet kushti i parë, ai që i dënuari të vërtetohet se me sjelljen dhe punën e tij gjatë vuajtjes së dënimit është “*riedukuar*”.

Gjithashtu, shprehja “*vetëm arsye të veçanta*” nuk mund të lidhet as me rrethanat që kanë të bëjnë me kushtet e tjera ndalues, ato të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal, lidhur me gjendjen dhe natyrën e recidivitetit të të dënuarit për kryerje të veprave penale me dashje apo të kryerjes së disa llojeve konkrete të veprave penale.

Prandaj, në ndryshim nga shumica e Kolegjeve të Bashkuara, në interpretim dhe zbatim të drejtë të parimeve kushtetuese të shtetit ligjor, barazisë para ligjit, humanizimit, parimeve dhe normave të tjera të lidhura me qëllimin e dënimit penal, parandalimin e përgjithshëm dhe atë të posaçëm etj., si gjyqtarë në pakicë, kemi qëndrimin se ligjvënësi ka vendosur më shumë se një kusht që duhen të përmbushen njëkohësisht në mënyrë që gjykata të pranojë kërkesën e të dënuarit për lirim me kusht.

Kushti i parë është ai i arritjes së qëllimit të dënimit penal për edukimin e të dënuarit, të vërtetuar rast pas rasti nga sjellja dhe qëndrimet e tij gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.

Ligjvënësi, për secilën figurë të veprës penale ka parashikuar llojet e dënimit, minimumin dhe maksimumin e dënimit penal dhe kriteret e individualizimit të dënimit, të cilat duhet të zbatohen për personin që ka kryer atë vepër penale. Nëpërmjet këtij parashikimi, ligjvënësi ka përcaktuar, në parim dhe si rregull, kufijtë se sa duhet të jetë kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit në mënyrë që të arrihet objektivi i parandalimit të posaçëm dhe të përgjithshëm, si edhe riedukimi i të dënuarit.

Por, meqenëse nëpërmjet veprimtarisë edukative të shtetit dhe vetë qëndrimit e të sjelljes personale të të dënuarit, riedukimi i tij mund të arrihet edhe përpara vuajtjes së plotë të dënimit të dhënë nga gjykata, atëherë ligjvënësi parashikon edhe të drejtën që ky i dënuar të kërkojë që gjykata të vlerësojë mundësinë, gjithsesi jo detyrimin e saj, për të zbatuar ndaj këtij të dënuari lirimin me kusht edhe përpara përfundimit të plotë të kohës së vuajtjes së dënimit. Ky interpretim, si një mundësi, e jo si një detyrim, për gjykatën rezulton nga vetë dispozita e nenit 64 të Kodit Penal, e cila, në paragrafin e parë, në fillim të tij, shprehet se “*i dënuari me burgim mund të lirohet me kusht.....*”.

Kjo mundësi, ekzistenca e së cilës vlerësohet rast pas rasti nga gjykata, lidhet, së pari, me plotësimin e kushtit që, i dënuari, “*... me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për riedukimin e tij...*”.

Megjithatë, ky kusht i parë, arritja e qëllimit të riedukimit nuk është i mjaftueshëm për të disponuar lirimin me kusht të të dënuarit.

Në nenin 64, ligjvënësi ka parashikuar qartazi edhe disa kushte të tjera, plotësimi i të cilave duhet të verifikohet njëkohësisht me kushtin e parë. Këto kushte të tjera nuk kanë asnjë lidhje me arritjen e qëllimit për riedukimin e të dënuarit nga puna, sjellja dhe qëndrimet e tij gjatë pjesës së vuajtur të dënimit me burgim.

Nisur nga interpretimi që i bëhet parimeve kushtetuese dhe normave penale lidhur me dënimin dhe qëllimet e tij, nuk do të kishte asnjë arsye dhe logjikë që, në kushtet e arritjes së

qëllimit për riedukimin e të dënuarit, në të njëjtën dispozitë të nenit 64 të Kodit Penal, ligjvënësi të parashikonte edhe disa kushte të tjera të shprehura ndaluese apo nga ato që përfshihen në kushtin “*vetëm për arsye të veçanta*” e të vlerësueshme nga gjykata rast pas rasti.

Nëse do të pranohet arsyetimi i kundërt sikurse parashtron shumica e Kolegjeve të Bashkuara, pra që kusht parimor, vendimtar dhe thelbësor, është ai i arritjes së riedukimit, atëherë lind pyetja se për çfarë arsye në Kodin Penal parashikohen edhe përmbushja e kushteve që nuk kanë lidhje me riedukimin e tij ? P.sh., i dënuari, ndonëse mund të konsiderohet dhe vërtetohet në gjykim se është tërësisht i riedukuar dhe i gatshëm për riintegrim, njëkohësisht duhet të ketë vuajtur:

“ - jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.”

Në të njëjtën logjikë juridike, për aq kohë sa janë në fuqi dhe nuk ka ndonjë vendim tjetër që do t’i konsideronte antikushtetues, mund të interpretohet edhe qëndrimi tjetër i shprehur i ligjvënësit në nenin 64 të Kodit Penal, i cili, pavarësisht se i dënuari mund të jetë “*riedukuar*”, nëse ka kryer disa lloje veprash penale me dashje, nuk ka të drejtë të kërkojë dhe përfitojë lirim me kusht:

“*Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.*”

Si gjyqtarë në pakicë, kemi mendimin se, në thelb, përgjigja e kësaj pyetje qëndron në faktin se qëllimi i dënimit penal ka në themel të tij jo vetëm arritjen e riedukimit të të dënuarit dhe atë të parandalimit të posaçëm, por edhe arritjen e qëllimit të parandalimit të përgjithshëm në të gjitha dimensionet e tij përfshirë edhe atë të domosdoshmërisë së “*ndëshkimit*” që duhet të vuajë i dënuari për veprën penale që ka kryer dhe pasojat që ajo ka sjellë.

Prandaj, ndonëse mund të riedukohet në një kohë shumë të shkurtër, për disa vepra penale konkrete përsëri i dënuari nuk mund të përfitojë lirimin me kusht për shkak të kryerjes së këtyre veprave, ndërsa për kryerjen e veprave të tjera penale duhet të vuajë dënimin e dhënë, qoftë edhe si një person “*i riedukuar*”, deri në minimumin e afatit të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, përpara se ti lindë e drejta për të kërkuar lirim me kusht.

Në këtë kontekst, si gjyqtarë në pakicë, kemi qëndrimin se duhet të zërthehen dhe të interpretohen edhe kategoria e rrethanave që përfshihen në kushtin “*vetëm për arsye të veçanta*”, të parashikuara në paragrafin e parë të nenit 64 të Kodit Penal.

Edhe këto “*arsyet e veçanta*” janë të tilla që nuk kanë lidhje me kushtin e arritjes ose jo të qëllimit të riedukimit nëpërmjet vuajtjes së dënimit deri në çastin e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht dhe përfundimisht në atë të dhënies së vendimit gjyqësor përkatës.

Në dallim nga rrethanat e tjera të sipërcituara që kanë të bëjnë me llojin e veprës penale të kryer nga i dënuari dhe me kohëzgjatjen minimale të vuajtjes së dënimit, të cilat janë kushte ligjore të shprehura, taksative, me karakter ndalues ndaj kërkesës për lirim me kusht, “*arsyet e veçanta*” janë rrethana të tilla, të cilat, nga njëra anë, nuk kanë lidhje me arritjen e qëllimit të riedukimit të të dënuarit dhe, nga ana tjetër, duhet të verifikohen në gjykim rast pas rasti, për të çmuar nëse janë të tilla që jo vetëm nuk cenojnë respektimin e parimit të drejtësisë penale mbi parandalimin e përgjithshëm, por edhe janë të tilla që, mund të justifikojnë lirimin me kusht të një të dënuari tashmë të riedukuar dhe të gatshëm për riintegrim në shoqëri.

Ligjvënësi nuk tregon në mënyrë të shprehur se cilat janë këto “*arsye të veçanta*” nisur nga synimi i tij që gjykata, rast pas rasti, nëse vërtetohet që i dënuari është riedukuar, të verifikojë

njëkohësisht edhe nëse vërtetohen kushtet, rrethanat e tjera të mundshme të posaçme e konkrete, që justifikojnë lirimin me kusht, duke u kujdesur që të respektohen dhe të mos cenohen parimet themeltare kushtetuese e ligjore të drejtësisë penale lidhur me parandalimin e përgjithshëm dhe atë të humanizmit.

Kjo kategori rrethanash, të verifikueshme rast pas rasti, duhet të jenë “vetëm” të karakterit “të veçantë”, pra jo të zakonshme, të tilla që e justifikojnë lirimin me kusht, por, gjithsesi, pa rënë ndesh me parimin e parandalimit të përgjithshëm.

Një aspekt tjetër, i këtyre rrethanave është që ato të jenë “të veçanta” edhe në kuptimin e rrethanave të karakterit personal e familjar, ma natyrë jo të zakonshme e përjashtimore, të tilla që, në rastin konkret, të justifikojnë lirimin me kusht para vuajtjes së plotë të dënimit nga i dënuari tashmë i riedukuar, nisur nga zbatimi i parimit të humanizimit të shtetit pikërisht ndaj këtij të dënuari dhe rrethanave të veçanta personale e familjare të tij. Këto arsye të veçanta, vërtet jo të zakonshme dhe përjashtimore, duhet të jenë rrethana të pavarura nga sjellja dhe qëndrimi i të dënuarit, e të tilla që të kenë lindur, të jenë rënduar dhe të ekzistojnë pas dhënies së vendimit të dënimit penal, kjo për shkakun se vetë ligji penal, në tërësinë e tij, është ndërtuar dhe rregulluar duke e respektuar parimin e humanizmit dhe gjykatat e dënimit e kanë pasur parasysh atë në kohën e gjykimit dhe të dhënies së vendimit të dënimit penal. Po kështu, këto “arsye të veçanta” mund të shërbejnë për të justifikuar lirimin me kusht nëse janë të kënaqshme dhe të justifikuara në varësi të shkallës së riedukimit, asaj të përgatitjes për të qenë i integruar në shoqëri, nevojës përjashtimore të pranisë personale të të dënuarit së bashku me zotërimin prej tij të personalitetit dhe të aftësive vetjake për të përballuar rrethanën e veçantë personale e familjare etj.

Në këtë kuptim, nëse këto “arsye të veçanta”, verifikohen dhe vërtetohen gjatë gjykimit, atëherë ato mund të justifikojnë lirimin me kusht të të dënuarit, në respektim të parimit të parandalimit të përgjithshëm dhe/ose atij të humanizmit, e njëkohësisht pa e cenuar zbatimin e drejtë të parimit tjetër themeltar, atij të barazisë para ligjit, përkundrajt të dënuarve të tjerë të riedukuar që nuk gjenden apo përballen me ndonjë prej këtyre rrethanave, arsyeve të veçanta.

Nisur nga formulimi aktual i nenit 64 të Kodit Penal, ligjvënësi nuk ka treguar konkretisht se cilat janë “arsyet e veçanta”, me vërtetimin ose jo të të cilave, e në mungesë të kushteve të tjera ndaluese të shprehura po në atë dispozitë, të justifikohet lirimi me kusht nëse njëkohësisht vërtetohet se është arritur qëllimi i riedukimit të të dënuarit.

Megjithatë detyra e gjykatës është të interpretojë ligjin dhe të kërkojë “arsyet e veçanta” që duhen verifikuar dhe që e justifikojnë lirimin me kusht të të dënuarit, pikërisht nisur nga parimet kushtetuese dhe ligjore, nga qëllimet dhe objektivat mbi të cilat ngrihet dhe vepron drejtësia penale dhe ligji penal. Këto arsye, rrethana, do të përbënin kushte që mund të bënin të pranueshme ose jo kërkesën e të dënuarit për lirim me kusht.

Prandaj, në përmbushje të detyrimit të gjykatës për të interpretuar drejt ligjin dhe për ta bërë të zbatueshme normën sipas vullnetit dhe qëllimit të ligjvënësit, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se “arsyet e veçanta” duhet të kërkohen dhe të verifikohen në rrethana të tilla, përfshirë edhe ato që trajton shumica e Kolegjeve, në pikat 33-36 e 41 të këtij vendimi unifikues, të cilat mund të grupohen në:

nevojën për të garantuar interesin dhe sigurinë publike nga sjelljet dhe veprat penale, nëpërmjet parandalimit dhe ndëshkimit të tyre, në kohën e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht; natyrën e veprës penale që ka kryer i dënuari, pasojat që ajo ka sjellë dhe qëndrimin që mban shoqëria ndaj këtyre sjelljeve kriminale, në kohën e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht; gjendjen e sigurisë publike dhe të kriminalitetit në kohën e gjykimit të kërkesës për lirim me kusht, parashikimin e pritshmërisë së publikut ndaj liritimit me kusht të të dënuarit, si edhe efektet pozitive apo negative që mund të sjellë në shoqëri lirimi me kusht i tij përpara përfundimit të vuajtjes së dënimit, veçanërisht nisur nga natyra e veprës dhe pasojave që ka shkaktuar;

kryerja ose jo më parë e veprave penale nga i dënuari;
personaliteti në tërësi që shfaq i dënuari, krahas arritjes së qëllimit për riedukimin e tij, si edhe aftësitë e tij profesionale dhe dobishmëria e tyre për shoqërinë nëse ai lirohet me kusht;
historia e jetës së të dënuarit, gjendja dhe rrethanat e tij personale e familjare etj..

Nëse nuk ekzistojnë kushtet ndaluese të shprehura që përmban neni 64 i Kodit Penal, si edhe nëse vërtetohet që është arritur qëllimi i riedukimit të të dënuarit, nëpërmjet verifikimit të këtyre rrethanave të tjera në tërësinë e tyre, rast pas rasti, gjykata mund të arrijë në përfundimin se kemi të bëjmë ose jo me “arsye të veçanta”, të cilat shërbejnë si mbështetje për të disponuar pranimin ose jo të kërkesës për lirim me kusht.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin disponuar për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trupë gjykuese.

Kolegjet e Bashkuara, nga njëra anë, kanë ardhur në përfundimin unifikues se “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal për riedukimin e të dënuarit dhe riintegrimin e tij në shoqëri. Nga ana tjetër, në kundërshti me vetë përfundimet e tyre unifikuese, shumica e Kolegjeve ka arsyetuar faktin dhe ka pranuar që rrethana të tilla si gjendja shëndetësore, familjare etj. ndonëse nuk janë kusht thelbësor, gjithsesi janë rrethana që shkojnë në favor të kërkesës për lirim me kusht. Më tej, shumica e Kolegjeve ka vlerësuar rrethanat faktike të të dënuarit, kërkesit Aleksandër Prenga, nëse ato justifikojnë ose jo lirimin me kusht.

Së pari, si gjyqtarë në pakicë kemi qëndrimin se, shumica e Kolegjeve të Bashkuara, duke arsyetuar në këtë mënyrë, gjendet në kundërshtim me vetë qëndrimet e saj për interpretimin e ligjit procedural në përgjigje të pyetjes së parë unifikuese.

Së dyti, duke vlerësuar rrethanat e faktit, lidhur me arsyet e parashtruara nga kërkesi për gjendjen e tij shëndetësore e familjare në mbështetje të kërkesës së tij për lirim me kusht, shumica e Kolegjeve të Bashkuara ka arsyetuar e disponuar si gjykatë fakti dhe jo si gjykatë ligji.

Në këtë kontekst, shumica e Kolegjeve nuk mund të dispononte as për urdhërimin e të dënuarit për të mbajtur kontakte me shërbimin e provës dhe për të zbatuar kushtin që përmban neni 60/1 i Kodit Penal për ushtrimin e veprimtarisë profesionale. Ky aspekt i gjykimit duhet t'i nënshtrohej hetimit gjyqësor nga gjykata e faktit, pra nga gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim asaj gjykate, si gjykatë fakti dhe ligji, duke i përcaktuar udhëzimet e nevojshme për tu konsideruar në rigjykimin e çështjes.

Së fundi, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, shumica e Kolegjeve ka lejuar që, në kundërshti me përfundimet e saj rreth pyetjes së dytë të shtruar për unifikim, i dënuari të mbetet në periudhë prove përtej kohës së parashikuar për vuajtjen e plotë të dënimit. Kjo për shkakun se gjykata e apelit ka disponuar vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 18 muajsh, disponim ky që nuk është ndryshuar nga Kolegjet e Bashkuara.

Për të gjitha motivet e parashtruara më sipër në këtë mendimi pakice, kemi qëndrimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet të dispononin prishjen e vendimit nr.121, datë 18.09.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

Artan Zeneli

Evelina Qirjako

Arjana Fullani

Ardian Dvorani

Nr.2 i Regj. Themeltar
Nr.1 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 27.04.2015 morën në shqyrtim çështjen penale me nr.52601-00364-00-2015 Akti, që u përket:

KËRKUES:	PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
I GJYKUAR:	ARBEN MEHMETI, përfaqësuar nga Av. Skënder Breca

A K U Z A:

Marrëdhënie seksuale me të mitura,
parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.582, datë 25.03.2014, ka vendosur:

1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Arben Bujar Mehmeti për kryerjen e veprës penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal.
2. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Arben Mehmeti nga dhomat e paraburgimit, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo, i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
3. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprahe si dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të pandehurit Arben Mehmeti.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.50, datë 21.01.2015, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.582, datë 25.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

Kundër vendimit më datë 13.02.2015, ka paraqitur rekurs i pandehuri Arben Mehmeti, me anën e të cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr.50 datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të Vendimit nr.582 datë 25.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.*

Duke parashtruar edhe shkaqet përkatëse:

Vendimi i gjykatës së apelit është në kundërshtim me ligjin sepse:

- Gjykata e Apelit Tiranë çmon se vendimi që ankimohet është i pavlefshëm për shkak se është marrë pas analizës, veç të tjerave, të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, me dëshmitarë, dhe në aktet e fashikullit nuk rezultojnë pikërisht thëniet e dëshmitarëve.
- Arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë se riprodhimi audio nuk e zëvendëson procesverbalin në kuptim të nenit 115/1 është i gabuar. Po të analizojmë nenin 115/2 të K.Pr.Penale, është më se e qartë se procesverbali me dorëshkrim behet vetëm në rastet kur nuk është i mundur që procesverbali të bëhet me stenotipi apo mjet tjetër teknik.
- Bazuar në Udhëzimin nr.282, datë 15.06.2012 “Për Mbajtjen e Procesverbalit të Seancës Gjyqësore me Mjete Audio”, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe paragrafit 7 e 8 të nenit 6 paragrafit 2, të nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë, janë përcaktuar rregullat e detyrueshme mbi: a) mbajtjen fjalë për fjalë të procesverbaleve të seancave Gjyqësore, nëpërmjet regjistrimit audio, përmes mjeteve dixhitale, në të gjitha ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore, në përputhje me nenet 77, 118 dhe 172 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 115 deri 122 të Kodit të Procedurës Penale dhe me çdo dispozitë tjetër procedurale në fuqi; b) funksionimin e sistemit të regjistrimit audio; dhe c) mënyrën e ruajtjes së materialeve të këtyre regjistrimeve audio dhe përgatitjes, kur është e nevojshme, të transkripteve të tyre. Ku parashikohet se kur regjistrimi i seancës gjyqësore është i pamundur të realizohet, për shkak të defekteve në pajisje, procesverbali i seancës mbahet në një nga mënyrat e tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale ose Kodi i Procedurës Civile apo çdo normë tjetër procedurale në fuqi sipas përcaktimit të kryetarit të seancës gjyqësore. Në këtë rast, në procesverbal shënohet shkaku i mbajtjes së procesverbalit në mënyrën tjetër.
- Kur, gjatë seancës gjyqësore, pajisjet e regjistrimit janë ndezur, por shfaqen probleme me funksionimin e tyre/regjistrimin, sekretari lajmëron kryetarin e seancës, i cili urdhëron që të vijohet me një mënyrë tjetër të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor.
- Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin e saj objekt rekursi, që riprodhimi audio i pyetjes së dëshmitarit përbën një formë dokumentimi të veprimeve të seancës gjyqësore, e cila është në funksion të transparencës së procesit, por nuk e zëvendëson procesverbalin e seancës gjyqësore, i cili përcaktohet nga neni 115/1 i Kodit të Procedurës Penale, si i vetmi akt që dokumenton veprimet e Gjykatës është i gabuar pasi është vetë Udhëzimi nr.282, date 15.06.2012 “Për Mbajtjen e Procesverbalit të Seancës Gjyqësore me Mjete Audio”, i cili ka sanksionuar që kur regjistrimi i seancës gjyqësore është i pamundur të realizohet, për shkak të defekteve në pajisje, procesverbali i seancës mbahet në një nga mënyrat e tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale ose Kodi i

Procedurës Civile apo çdo normë tjetër procedurale në fuqi sipas përcaktimit të kryetarit të seancës gjyqësore.

Nisur nga fakti se ka interpretime të ndryshme lidhur me mbajtjen e procesverbalit nëpërmjet regjistrimit audio apo audioviziv, të parashikuar në nenin 115 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nisur nga rëndësia që paraqet kjo çështje për të gjithë praktikën gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 10.03.2015, në bazë të nenit 438/2 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur, të dërgojë për shqyrtim këtë çështje në Kolegjet e Bashkuara, për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Me anë të këtij vendimi, Kolegji Penal ka shtruar për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara çështjen e mëposhtme:

- 1. Mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore, si akt për dokumentimin e veprimeve në seancë gjyqësore, nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, a duhet të konsiderohet në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale?**

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Artan Zeneli dhe Evelina Qirjako; prokurorin Arqilea Koça, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.50, datë 21.01.2015 dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në gjykatën e apelit, mbrojtësin e të pandehurit Av. Skënder Breca, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.50, datë 21.01.2015 dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në gjykatën e apelit; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e faktit

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ardhur për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit Arben Mehmeti, i akuzuar se ka kryer veprën penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal, në dëm të shtetasës K.Sh.

Nga procesverbali i seancës së datës 04.02.2014, ora 13:10, rezulton se janë shënuar gjeneralitetet e dëshmitares së pyetur nga gjykata, procedura e betimit të saj, por nuk janë shënuar pyetjet e bëra nga palët dhe gjykata dhe as përgjigjet (thëniet) e dëshmitares. Në të njëjtën mënyrë janë pasqyruar, në procesverbal, thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancat e tjera gjyqësore.

II. Procedura gjyqësore

- 1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.582, datë 25.03.2014, ka vendosur:**

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Arben Bujar Mehmeti për kryerjen e veprës penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal.

Duke arsyetuar mbi bazën e provave shkresore dhe atyre me dëshmitarë, të marra në seancë gjyqësore, referuar kryesisht regjistrimit audio.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.50, datë 21.01.2015, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.582, datë 25.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

1. *Me arsyetimin se:* “Në kuptim të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal, i cili përpilohet nga sekretari në formë të plotë ose të përmbledhur.

Kur procesverbali përpilohet në formë të përmbledhur, duhet bërë edhe riprodhimi fonografik dhe po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv, kur është i domosdoshëm.

Sipas këtij rregullimi, procesverbali i pyetjes të dëshmitarit në seancë, duhet të përmbajë, qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur, thëniet e dëshmitarit, dhe po të jenë kushtet, duhet bërë edhe riprodhimi audioviziv.

Në gjykimin në shkallë të parë, në procesverbalin e seancës, janë shënuar gjeneralitetet e dëshmitarëve të pyetur nga Gjykata, procedurat e betimit të tyre, por nuk janë shënuar pyetjet dhe për më tepër thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancë.

Riprodhimi audio i pyetjes së dëshmitarit përbën një formë dokumentimi të veprimeve të seancës gjyqësore, e cila është në funksion të transparencës së procesit, por nuk e zëvendëson procesverbalin e seancës gjyqësore, i cili përcaktohet nga neni 115/1 i Kodit të Procedurës Penale, si i vetmi akt që dokumenton veprimet e Gjykatë.

Gjykata e Apelit Tiranë çmon se procesverbali i cili nuk paraqet thëniet e dëshmitarëve të pyetur nga Gjykata, të cilat kanë shërbyer për të si bazë e vendimit përfundimtar, nuk dokumenton veprimet e kryera nga Gjykata, sipas parashikimit të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Apelit Tiranë çmon se vendimi që ankimohet është i pavlefshëm për shkak se është marrë pas analizës, veç të tjerave, të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, me dëshmitarë, dhe në aktet e fashikullit nuk rezultojnë pikërisht thëniet e dëshmitarëve. Në këto kushte, ky vendim duhet prishur dhe çështja duhet të rigjykohet në shkallë të parë.”.

III. E drejta e zbatueshme

2. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe i qëndrimeve të palëve në gjykim, për t’i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara, për sa i takon njësimin të praktikës gjyqësore, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në mjetin e rekursit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh, para së gjithash, dispozitat vijuese të Kushtetutës, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore (“KEDNJ”) dhe të Kodit të Procedurës Penale.
3. Neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: “*Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:*
 - a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;
 - b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
 - c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.”

4. Neni 42/2 i Kushtetutës parashikon se: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.
5. Në nenin 6 pika 1 të KEDNJ parashikohet se: “Neni 6 – E drejta për një proces të rregullt – Në përcaktimin e (...) çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme; t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; (...) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës. (...).

6. Kodi i Procedurës Penale, në dispozitat relevante parashikon se:

Neni 115: Procesverbali

1. Dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal.
2. Procesverbali përpilohet nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përmbledhur, me stenotipi, me mjet tjetër teknik dhe, kur mungojnë këto mjete, me dorëshkrim.
3. Kur procesverbali përpilohet në formë të përmbledhur duhet të bëhet edhe riprodhimi fonografik dhe, po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv kur është i domosdoshëm.

Neni 116: Përmbajtja e procesverbalit

1. Procesverbali përmban tregimin e vendit, të vitit, të muajit, të ditës dhe kur është e nevojshme, edhe të orës, në të cilat ka filluar dhe është përfunduar, gjeneralitetet e personave që kanë marrë pjesë, tregimin e shkaqeve, kur dihen, mungesën e personave që duhet të marrin pjesë dhe kërkesat e paraqitura nga palët.

Neni 117: Nënshkrimi i procesverbalit

1. Procesverbali, me përjashtim të atij që mbahet në seancën gjyqësore, pasi lexohet, nënshkruhet në fund të çdo flete nga ai që e ka përpiluar, nga ai që procedon dhe nga personat që kanë marrë pjesë.
2. Kur njëri nga pjesëmarrësit nuk do ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, bëhet vërejtje ku tregohet edhe shkaku.

Neni 118: Transkriptimi i procesverbalit të redaktuar me mjete stenotipie

1. Shiritat e shtypur me shenja stenotipie transkriptohen me shkronja të zakonshme jo më vonë se pesë ditë nga data kur janë formuar dhe lidhen me aktet bashkë me transkriptimin.

2. Kur për personin që ka shtypur shiritat ka ndalime për të bërë transkriptim, gjykata urdhëron që transkriptimi t'i besohet një personi të përshtatshëm, qoftë edhe jashtë administratës shtetërore.

Neni 119: Riprodhimi fonografik ose audioviziv

1. Riprodhimi fonografik ose audioviziv bëhet nga persona teknike, qoftë edhe jashtë administratës shtetërore nën drejtimin e sekretarit të gjykatës.
2. Kur bëhet riprodhimi fonografik, në procesverbal tregohet çasti i fillimit dhe i mbarimit të veprimeve të riprodhimit.
3. Kur riprodhimi fonografik nuk kuptohet, si provë shërben procesverbali i përpiluar në formë të përmbledhur.
4. Regjistrimet fonografike ose audiovizive u bashkohen akteve.

Neni 120: Format e dokumentimit në raste të veçanta

1. Gjkata vendos të bëhet përpilimi i procesverbalit në formë të përmbledhur kur veprimet që duhet të pasqyrohen kanë përmbajtje të thjeshtë ose kur mungojnë mjetet mekanike të riprodhimit ose ndihmësit teknike.
2. Kur përpilohet procesverbali në formë të përmbledhur, gjykata kujdeset që të shënohen pjesët thelbësore të deklarimeve dhe rrethanat në të cilat janë bërë.

Neni 121: Deklarimet gojore të palëve

1. Kur ligji nuk kërkon formën e shkruar të dokumentit, palët mund të bëjnë, vetë ose me anë të përfaqësuesve të posaçëm, kërkesa ose deklarime me gojë. Në këtë rast sekretari i gjykatës përpilon procesverbalin dhe regjistron deklarinimet. Procesverbalit i bashkohet, kur është rasti, prokura e posaçme.
2. Palës që e kërkon, i lëshohet me shpenzimet e veta një vërtetim ose kopja e deklarimeve të bëra.

Neni 122: Pavlefshmëria e procesverbalit

1. Procesverbali është i pavlefshëm kur ka dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar.

Neni 345: Procesverbali i seancës

1. Sekretari mban procesverbalin e seancës, në të cilin tregohen:
 - a) vendi, data, ora e hapjes dhe e mbylljes së seancës;
 - b) përbërja e gjykatës;
 - c) emri dhe mbiemri i prokurorit dhe të dëmtuarit akuzues;
 - ç) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, gjeneralitetet e mbrojtësve, të palëve private dhe të përfaqësuesve të tyre.
2. Menjëherë pas mbylljes së seancës, procesverbali, i nënshkruar në fund të çdo flete nga ai që e ka mbajtur, i paraqitet kryetarit për ta vistuar.
3. Procesverbali i seancës përfshihet në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor.

Neni 346: Përmbajtja e procesverbalit

1. Procesverbali përshkruan veprimet e kryera në seancë dhe pasqyron në mënyrë të përmbledhur kërkesat dhe konkluzionet e prokurorit, të të dëmtuarit akuzues, mbrojtësve dhe përfaqësuesve të palëve private.

2. Urdhrat e dhëna me gojë nga kryetari riprodhohen tërësisht. Urdhrat e shpallura në seancë me anë të leximit i bashkohen procesverbalit.

Neni 347: Kërkesat e palëve për procesverbalin

1. Palët kanë të drejtë të kërkojnë shënimin në procesverbal të çdo deklarimi për të cilin kanë interes. Memoriet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, i bashkohen procesverbalit.

2. Kryetari mund të urdhërojë, edhe kryesisht, që sekretari të lexojë pjesë të veçanta të procesverbalit me qëllim që të verifikojë saktësinë dhe plotësinë e tij. Mbi kërkesat për korrigjim ose shuarje, si dhe mbi ato që parashikohen në paragrafin 1, kryetari disponon me vendim.

Neni 368: Procesverbali i marrjes së provës

1. Në procesverbalin e marrjes së provës shënohen gjeneralitetet e dëshmitarëve, ekspertëve e të përkthyesve, si dhe paralajmërimi që u bëhet për të thënë të vërtetën dhe për përgjegjësinë që kanë në rast se bëjnë dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë.

2. **Sekretari i gjykatës riprodhon pyetjet e bëra nga palët dhe nga kryetari, si dhe përgjigjet e personave të pyetur.**

3. Kur gjykata vendos që procesverbali të mbahet në formë të përmbledhur, kontrolli për saktësinë e tij bëhet nga kryetari.

7. *Udhëzimi i Ministrisë të Drejtësisë nr.353, datë 03.09.2013, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”,*

“Neni 2: Fusha e veprimit

Mjetet dixhitale audio të regjistrimit të seancave gjyqësore përdoren për regjistrimin e seancave gjyqësore të gjykimeve civile, administrative **dhe penale**, të zhvilluara në ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3: Sistemi i regjistrimit audio

Procesverbali audio i seancave gjyqësore përbën procesverbalin zyrtar të seancës në përputhje me nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 34 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

8. *Urdhër i Ministrisë të Drejtësisë nr.358, datë 5.9.2013, “Për tarifën e transkriptimit të procesverbalit të seancës gjyqësore, të mbajtur me mjete të regjistrimit audio ose audioviziv”;*

9. *Urdhër i Ministrisë të Drejtësisë nr.359, datë 5.9.2013, “Për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore apo të veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë seance”;*

IV. Arsytimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

10. Me qëllim dhënien e përgjigjes mbi çështjen e shtruar për unifikim, si dhe në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt rekursi, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të analizojnë, fillimisht, se çfarë nënkupton procesverbali, cilat janë llojet e mjeteve dhe format apo mënyrat e mbajtjes së tij, bazuar në nenet 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, për të arritur në konkluzionin nëse regjistrimi audio ose audioviziv është një prej tyre.
11. Në Pjesën e parë, titulli i tretë, të kreut të parë të seksionit të tretë të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar dispozitat e përgjithshme mbi dokumentimin e veprimeve procedurale.
12. Një nga parimet themelore të Kodit të Procedurës penale është ai i oralitetit, në bazë të të cilit, kur nuk parashikohet ndryshe në ligjin procedural, veprimet e gjykatës apo të palëve, që kanë të bëjnë me procesin penal, normalisht, paraqiten me gojë. Veprimtaria e dokumentimit të akteve të procesit penal bazohet në nevojën për ruajtjen, përshkrimin dhe pasqyrimin e veprimeve dhe akteve procedurale me qëllim që ato të kujtohen dhe vlerësohen, gjatë të gjitha fazave të procesit penal. Në këtë mënyrë, procesverbali shërben për fiksimin e ngjarjeve, fakteve dhe veprimeve procedurale ku do të bazohet, më pas edhe vendimmarrja e gjykatës dhe eventualisht të ushtrohet e drejta e ankimit.
13. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se veprimet procedurale të procesit penal duhet të dokumentohen, në mënyrë që të ruhen gjurmët e krijimit dhe përshkrimit të tyre, me qëllim që të sigurohet një proces gjyqësor i drejtë e i rregullt, sipas standardeve të gjithëpranuara. Në seancën gjyqësore mbahet vetëm një procesverbal, i cili mund të mbahet me anë të disa mjeteve alternative të përshtatshme, në formë të plotë ose të përmbledhur.
14. Kodi i Procedurës Penale parashikon parimin e përgjithshëm, sipas të cilit dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal, i cili përpilohet nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përmbledhur, me stenotipi, me mjet tjetër teknik, dhe kur mungojnë këto mjete, me dorëshkrim.
15. Në bazë të këtij kuadri ligjor, vërehet se Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë nuk bën një përkufizim të nocionit të ‘procesverbalit’, por përcakton karakteristikat më themelore që e përbëjnë atë. Karakteristika e parë e veprimtarisë së dokumentimit është cilësimi i subjektit procedural, që mban procesverbalin; pra, ai që e përpilon apo kujdeset për hartimin e procesverbalit, në varësi të faktit nëse mbahet apo jo në seancë gjyqësore. Procesverbali është një veprim publik që provon kryerjen e veprimeve të akteve procedurale që kanë ndodhur apo janë kryer në prani të këtij subjekti. Por që në vetvete, ky veprim nuk përbën provë të plotë e të paracaktuar. Si rrjedhojë, nga ana e gjykatës mund të vlerësohet lirisht ajo çka është pasqyruar dhe paraqitur në këtë veprim dokumentues, si për sa i takon korrektësisë, ashtu dhe vërtetësisë së përshkrimeve të kryera në të gjatë zhvillimit të gjykimit.
16. Karakteristika e dytë është lloji i mjetit, domethënë mënyra e krijimit të procesverbalit, e cila ka rëndësi për dokumentimin e veprimeve. Kurse karakteristika e tretë është forma, që sipas ligjit do të thotë sasia e të informacionit të pasqyruar në procesverbal. Kjo karakteristikë e fundit ka varësi nga lloji i mjetit për hartimin e procesverbalit, pikërisht sepse, nisur nga lloji i mjetit të mbajtjes së procesverbalit, mund të jetë “e plotë” apo “e

përmbledhur”. Forma e plotë, nënkupton pasqyrimin integral dhe literal të asaj që ndodh, thuhet apo kryhet në seancë gjyqësore.

17. Në këtë kuadër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të analizojnë fillimisht çështjen nëse ligji shqiptar (shih të drejtën e zbatueshme) parashikon mjete të tjera të mbajtjes së procesverbalit, përveç asaj me dorëshkrim, që rëndom përdoret sot si një lloj mjeti për dokumentimin e veprimeve në procesin penal.
18. Në lidhje me llojin e dokumentimit të veprimeve procedurale; pra, lidhur me llojin e mjetit dokumentues, nenit 115 i Kodit të Procedurës Penale parashikon tre lloje mjetesh për mbajtjen e procesverbalit kryesor, domethënë të dokumentimit të veprimeve, përkatësisht: i) procesverbali i përgatitur me mjetin e stenotipisë; ii) procesverbali i përgatitur me mjet tjetër teknik; iii) procesverbali i përgatitur me dorëshkrim. Ndërsa, për sa i përket formës së mbajtjes së procesverbalit, si një karakteristikë përcaktuese e tij, sipas nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se procesverbali mund të hartohet: a) në formë të plotë ose b) në formë të përmbledhur. Kur procesverbali mbahet në formë të përmbledhur, parashikohet detyrimi për riprodhimin fonografik, e po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv kur ai është i domosdoshëm.
19. Në analizë të këtij kuadri ligjor, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, nisur nga formulimi i dispozitës së parashikuar në nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton mëse e logjikshme dhe e natyrshme, që forma e përmbledhur e procesverbalit, i referohet vetëm llojit të procesverbalit të mbajtur me mjetin e dorëshkrimit. Kjo për arsye se, për dy llojet e para të procesverbaleve të mbajtur si mjet kryesor dokumentimi, domethënë atij të bërë me anë të mjetit të stenotipisë dhe atij të bërë me mjete të tjera teknike, duke qenë ata veçse “të plotë”, nuk mund të bëhet fjalë për një përmbledhje të tyre. Kjo sepse nuk do të kishte asnjë kuptim përmbledhja e tyre, për shkak se ata përmbajnë të pasqyruar ‘gjithçka’ që është deklaruar apo kryer në seancë e në prani të gjykatës. Prandaj, në vlerësimin e Kolegeve të Bashkuara, dy llojet e para të procesverbalit të mbajtur si mjet kryesor, duhet të konsiderohen vetëm (në formë) të plotë. Riprodhimi fonografik apo audioviziv (jo kryesor) në mbështetje të procesverbalit të bërë në formë të përmbledhur, bëhet (vetëm) në ato raste kur është mbajtur procesverbali me (mjetin me) shkrim, pikërisht në formë të përmbledhur. Edhe në këtë rast, ka rëndësi të theksohet se “procesverbali” në tërësi përbëhet nga: përmbledhja me shkrim e mbajtur nga sekretari gjyqësor së bashku me riprodhimin fonografik apo audioviziv të veprimeve procedurale.
20. Bazuar në formulimin e dispozitës të sipas nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, por nisur edhe nga parime të rëndësishme që përshkojnë ligjin procedural penal, të tillë si: parimi i oralitetit, ai i kontradiktorialitetit dhe ai i gjykimit të pandërprerë, mjeti i stenotipisë është renditur duke u listuar si i pari. Kjo edhe për faktin se ai ishte një mjet mjaft i njohur për kohën kur është miratuar Kodi i Procedurës Penale. Nisur nga interpretim sistematik ky mjet për mbajtjen e procesverbalit të vetëm të seancës nuk është i vetmi. Krahas këtij mjeti, ligjvënësi jo pa qëllim ka parashikuar edhe mjete të tjera “teknike”, si alternativa kryesore për hartimin dhe mbajtjen e procesverbalit për dokumentimin e veprimeve procedurale.
21. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se për identifikimin e llojit të mjetit për mbajtjen e procesverbalit mbi dokumentimin e veprimeve – veçanërisht në seancë – duhen mbajtur

parasysh: i) qëllimi i ligjvënësit, ii) evoluimi i praktikës gjyqësore në raport me arritjet e teknologjisë së informacionit, në mënyrë që të sigurohet një mjet dokumentimi, i cili të ngërthejë objektivat e zhvillimit të një gjykimi në kohë të arsyeshme, si dhe nevojat për saktësinë, korrektesinë dhe ato të autenticitetit të paraqitjes së të dhënave në funksion të dokumentimit.

22. Në bazë të një interpretimi sistematik të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe frymës së legjislacionit në fuqi, Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se mjeti tradicional për dokumentimin e veprimeve procedurale “dorëshkrimi” është renditur si i fundit”, ndër mjetet apo llojet e dokumentimit të veprimeve procedurale. Në fakt, ai është parashikuar si një përjashtim, duke u përdorur vetëm në mungesë të mjetit teknik të llojit “stenotipi”, si dhe në mungesë të mjeteve të tjera teknike.
23. Nisur edhe nga parimet e përgjithshme që përshkojnë fazën e shqyrtimit gjyqësor, si edhe nga fryma e dispozitave lidhur me dokumentimin e veprimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se përdorimi i mjetit kryesor të mbajtjes së procesverbalit me “dorëshkrim” dhe zgjedhja e formës së përmbledhur, në kushtet aktuale, kur në gjykatat shqiptare janë të instaluar aparaturat përkatëse dhe funksionon normalisht mjeti i shërbimit të regjistrimit dixhital audio apo audiovideo për procesverbalin, do të pengonte realizimin e një seance gjyqësore në përputhje me parimin e oralitetit, dhe palët nuk do të kishin mundësi efektive për ndërveprimin sipas metodës dialektike procedurale.
24. Për sa i takon regjimit të mbajtjes së procesverbalit, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, në parimet e përgjithshme të tyre, parashikojnë një situatë ligjore që ka mundësi të hapur mbi llojet kryesore dhe metodologjinë e mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore. Dispozitat në fjalë, parashikojnë pikënisjen nga parimi tradicional i mbajtjes me dorë të procesverbalit, për të parashikuar edhe më tej. Pra, ligjvënësi ka përcaktuar hartimin e procesverbalit, duke filluar nga niveli mekanik (me dorë) për përpilimin e procesverbalit të seancës gjyqësore, si garancia ligjore më minimale në këtë drejtim të standardit, por jo e vetmja alternativë. Kjo garanci minimale, ka qenë përdorur si më zakonisht, dhe është e lidhur me kushtet, kur u miratua Kodi i Procedurës Penale. Ky mjet, për qëllimin e dokumentimit me procesverbal, mund të gjejë zbatim në formë të plotë ose në formë të përmbledhur. Por, duke qenë një mjet i mbështetur në formatin në letër, ligjvënësi ka parashikuar një seri rregullash për nënshkrimin, datimin, dhe tregimin e elementëve të tjerë, të nevojshme për t’i dhënë besueshmëri dhe autenticitet zgjedhjes së këtij mjeti tradicional të dokumentimit të veprimeve. Gjithsesi, në raport me dokumentimin e veprimeve, ligjvënësi jo pa qëllim, në nenin 115/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka përfshirë në parashikimin ligjor edhe “mjete të tjera”, duke mos i përjashtuar ato nga legjitimitimi dhe nga arritjet e mëpasshme të zhvillimit të teknologjisë së avancuar dixhitale. Në këtë mënyrë, ligjvënësi ka parashikuar një qasje elastike dhe të hapur edhe për “lloje të tjera alternative”, sa i përket krijimit dhe mbajtjes së procesverbalit të seancës, siç janë: mbajtja e procesverbalit me mjetin e stenotipisë në formë të plotë, si edhe mbajtja e procesverbalit me mjete të tjera teknike. Alternativa këto, të cilat nëse plotësojnë karakteristikat dhe qëllimin e dokumentimit, mund t’i përgjigjen në mënyrë ekuivalente kërkesave dhe nevojave për dokumentimin e praktikës gjyqësore, duke sjellë efekte cilësore dhe favorizuese për palët dhe gjykatën në procesin penal.

25. Në këtë kontekst, çmohet të vihet në pah se kur është përzgjedhur dhe procedohet me mbajtjen e procesverbalit me mjetin e dorëshkrimit dhe në formë të plotë, mjetet dhe format e tjera, në përputhje me parimin e ekonomisë gjyqësore nuk gjejnë përdorim, pasi në këtë rast, garancia është më se e plotë. Ndërsa, kur është përzgjedhur mbajtja e procesverbalit me dorëshkrim dhe në formë të përmbledhur, ligji procedural parashikon që, krahas kësaj metode, të bëhet edhe riprodhimi fonografik apo eventualisht, kur është rasti edhe ai audioviziv. Pra, në këtë rast, kur nuk është zgjedhur si formë kryesore, regjistrimi audio apo ai audiovideo, konsiderohet si një mjet riprodhimi për një veprim procedural. Kurse kur është përzgjedhur mbajtja e procesverbalit me mjetin stenotipi, i cili nuk mund të mos jetë veçse në formë të plotë, ligji procedural penal parashikon transkriptimin e plotë të shiritave të shtypur me stenotipi.
26. Ajo që ka rëndësi në përcaktimin ligjor të dispozitave procedurale është parimi i përgjithshëm se, kur zgjidhet një lloji i caktuar i dokumentimit me procesverbal, pra, si tipologji kryesore, atëherë mjetet dhe mënyrat e tjera të dokumentimit vendosen në funksion mbështetës dhe në shërbim të plotësimi të mjetit kryesor të dokumentimit. Çka do të thotë, se kur nuk është zgjedhur si mjet kryesor, regjistrimi fonografik apo eventualisht, edhe ai audioviziv, ai shërben si mbështetës duke “riprodhuar” përmbajtjen e procesverbalit të mbajtur me mjet kryesor. Në bazë të këtij argumentimi mund të thuhet se, kur zgjidhet si mjet kryesor teknika e regjistrimit dixhital audio apo audiovideo, mënyrat e tjera të dokumentimit, siç janë shënimet apo transkriptimi, duhet të vendosen në funksion të këtij mjeti kryesor dhe të mbështesin këtë mënyrë kryesore të mbajtjes së procesverbalit.
27. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, për nga mënyra e formulimit të nenit 115/1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk përbën asnjë pengesë për përdorimin e regjistrimit me mjetin audio apo audiovideo - kur ekzistojnë aparatat e instaluar në gjykatë dhe shërbimi funksionon normalisht - në zgjedhjen si mjet kryesor dhe alternativ, të atij të dokumentimit të veprimeve me anë të regjistrimit audio dhe audiovideo. Mjet ky që shërben, krahas atij të stenotipisë dhe eventualisht atij me dorëshkrim, në mbajtjen e procesverbalit të seancës.
28. Çështja që shtrohet përpara Kolegjeve të Bashkuara është nëse regjistrimet dixhitale audio apo kur janë instaluar ato audiovideo, mund të konsiderohen si “mjete teknike”, të cilat për nga vetitë dhe karakteristikat e tyre janë ose jo, të afta dhe në gjendje që të dokumentojnë veprimet gjatë procesit penal, e më konkretisht, veprimet procedurale si akte apo si fakte të ndodhura në seancën gjyqësore në prani të palëve pjesëmarrëse dhe të gjykatës.
29. Për të arritur në një përfundim të drejtë për sa parashtrohet, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të vlerësojnë nëse regjistrimet dixhitale audio, apo audiovideo përmbushin kriteret dhe karakteristikat që duhet të ketë një mjet teknik i aftë dhe në gjendje për dokumentimin e veprimeve. Kriteret, të cilat çmohet të jenë: besueshmëria, siguria, autenticiteti dhe integriteti i të dhënave, si dhe identifikimi i qartë pjesëmarrësve dhe përpiluesit të procesverbalit.
30. Kolegjet e Bashkuara, vlerësojnë se nga karakteristikat e këtij mjeti për hartimin e procesverbalit të seancës, i cili duke qenë i llojit dixhital-zanor apo dixhital-pamor dhe zanor, i kryer nën mbikëqyrjen e sekretarit gjyqësor dhe të kryesuesit të seancës, mbi të cilin edhe nëse tentohet të “ndërhyhet” mbi të, mund të dallohen pjesët e ndërhyra, faktin e

ruajtjes së tij së bashku me fashikullin gjyqësor, ose në një vend tjetër publik, ai përbën një mjet efektiv për mbajtjen e procesverbalit. Funksionimi efektiv i aparatit të audio apo audiovideo regjistrimit mund të vrojtohet lehtësisht duke vëzhguar, imazhin që përvijohet në monitor nga ana e sekretarit apo e gjykatës. Prandaj, çmohet se ky mjet i përmbush kriteret e autenticitetit. Gjithashtu, nisur nga vetia e këtij mjete për të identifikuar zërin e pjesëmarrësit në gjykim apo edhe figurën, ai mund të konsiderohet si mjet i besueshëm për dokumentim, domethënë, i aftë për paraqitjen e veprimeve dhe akteve të tjera të kryera në seancën gjyqësore, duke shfrytëzuar të gjithë potencialitetin që ky lloj mjete mbart në vetvete, lidhur me aftësitë integrale të dokumentimit të veprimeve procedurale.

31. Për më tepër, vërehet se edhe elementet e tjerë të një akti procedural siç janë: identifikimi i palëve, tregimi i orës, i datës, i vendit, i emrit të personave pjesëmarrës dhe përmbajtja e deklarimeve të tyre, të cilat janë të domosdoshme kur zgjidhet si mjet dokumentimi ai tradicional, mund të konstatohen a të perceptohen lehtësisht përmes “dëgjimit” a “shikimit” të regjistrimit kur ai riprodhohet në mjet (suport) videodixhital apo audiodixhital që disponohet nga ana e gjykatës. Po ashtu, kur gjykata ose njëra nga palët e procesit e kërkojnë, mund të disponohet transkriptimi i atyre pjesëve relevante që kanë rëndësi për zhvillimin e procesit. Në mënyrë të ngjashme mund të thuhet edhe në rastin e mjetit dokumentues me anë të teknikës audiovideo.
32. Elementët e dokumentimit procedural janë të domosdoshëm në rastet e mbajtjes së procesverbalit me “mjete tradicionale”, por vlerësohet nuk është e domosdoshme, në rastin e mbajtjes së procesverbalit me mjetin teknik audio apo audiovideo, i cili dokumenton me tjetër mënyrë, po aq ekuivalente. Lidhja automatike e regjistrimit audio/audiovideo me shënimet e mbajtura dhe të sinkronizuara, realizohet përmes një gjurmë kohore, e cila dëshmon orën e saktë kur ngjarjet a aktet e përshkruara ndodhin në seancën gjyqësore. Zëri i subjekteve pjesëmarrëse në një seancë regjistrohet në kanale të veçanta dhe të gjitha regjistrimet, të cilat kanë datën dhe vendin e saktë ku është zhvilluar seanca, ruhen në serverin e gjykatës. Prandaj, ashtu si të ish mbajtur me në formë të plotë e me shkrim, procesverbali i mbajtur me mjetin e regjistrimit audio/audiovideo plotëson të gjithë elementët karakterizuese të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
33. Elementi i detyrimit të leximit sipas nenit 117 të Kodit të Procedurës Penale, vlen për hartimin e procesverbalit me mjete tradicionale. Ndërsa në rastin e mbajtjes së procesverbalit me mjetin teknik audio apo audiovideo, meqenëse kemi të bëjmë me një dokumentim-regjistrim, e jo vetëm thjesht me një përshkrim, nuk është i domosdoshëm qëndrimi i palëve dhe nënshkrimi i tij. Ndonëse jo të gjitha kërkesat formale procedurale të konceptuara për procesverbalin tradicional gjejnë zbatim për procesverbalin e mbajtur me mjet audio apo audiovideo. Në fakt, ato gjejnë zbatim gjatë transkriptimit të procesverbalit audio apo audiovideo, sepse rëndësi themelore përbën mundësia e parashikuar për disponimin e transkriptimit nga ana e gjykatës, duke përfshirë edhe gjykatën që shqyrton ankimin, apo qoftë me kërkesë paraprake të palëve, për transkriptimin e përmbajtjes së audio-verbalit apo audiovideo-verbalit.
34. Në paragrafin e parë të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se “dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal”. Sipas këtij pohimi ligjor mund të kuptohet se lloji dhe forma e procesverbalit tradicional të shkruar nuk mund të jetë dhe nuk duhet të konsiderohet si i vetmi lloj i dokumentimit të veprimeve procedurale. Domethënë

ky mjet nuk është parashikuar, si e vetmja metodë për paraqitjen e akteve dhe fakteve të ndodhura në seancë gjyqësore nga ana e sekretarit gjyqësor si “dëshmi” dhe ruajtje e gjurmëve rreth veprimtarisë së kryer në seancë. Ky përfundim gjen konfirmim dhe parashikohet si në nenin 346/2, ashtu edhe në nenin 368 /2 të Kodit të Procedurës Penale. Në të dy këto dispozita kërkohet shprehimisht, jo vetëm pasqyrimi i përmbledhur, por riprodhimi i plotë i veprimeve procedurale apo akteve të parashikuara nga këta paragrafë, vetëm kur eventualisht, është përzgjedhur mjeti i mbajtjes së procesverbalit me dorëshkrim, kontrolli për saktësinë kryhet nga kryesuesi i seancës.

35. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se edhe mundësia e regjistrimit “audio” apo “audiovideo”, për mbajtjen e procesverbalit tashmë, mund të konsiderohen, në vetvete, si mjete teknike (elektronike) të afta për paraqitjen e akteve dhe fakteve të ndodhura në seancë gjyqësore nga ana e sekretarit gjyqësor si “dëshmi” dhe ruajtje e veprimtarisë së kryer në seancë. Madje, riprodhimi i faktit apo i aktit, siç mund të jenë aktet deklarative si dëshmi apo thënie të palëve, rezulton të jetë më tepër në përputhje me efektivitetin e parimit të kontradiktorialitetit dhe atij të oralitetit të sistemit procedural, sidomos në fazën e hetimit gjyqësor. Ky mjet, krahas vetive të mjetit tradicional me shkrim, pasqyron edhe ato dhëna, shprehje joverbale zanore apo pamore vështirësisht të paraqitshme me mjetin me shkrim dhe sidomos, me atë në formë të përmbledhur. Në këto kushte, përdorimi i procesverbalit mbajtur me mjetin audio apo audiovideo, do të mundësonte vlerësimin e drejtpërdrejtë dhe pa ndërmjetës të tjerë, për njohjen dhe shqyrtimin e akteve a veprimeve procedurale. Zgjedhja e këtij mjeti për mbajtjen e procesverbalit rezulton të jetë i miratuar edhe në Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë.²⁶
36. Mbajtja e procesverbalit me mjetin alternativ të llojit audio ose audiovideo, përveçse ka karakteristikat e atij të mbajtura me mjete tradicionale, pra të mjetit me shkrim apo me stenotipi, përmban edhe një karakteristikë të shtuar, e cila konsiston në regjistrimin nën kujdesjen e sekretarit të seancës dhe të kryetarit të seancës. Pra kryerja e veprimeve dhe akteve procedurale, do të mund të shqyrtohet përmes dëgjimit apo shikimit, që lejon në riprodhimin saktë e besnik të fakteve dhe akteve që kanë ndodhur në praninë e gjykatës, sikur ato të kenë ndodhur në çastin e dëgjimit apo shikimit të audio apo video-verbalit.
37. Disponueshmëria e dokumentimit të veprimeve procedurale nëpërmjet regjistrimit me mjetin audio ose audiovideo, si një metodë integrale për përdorimin e saj si mjet kryesor, nisur nga karakteristikat e brendshme të tij, nënkupton që ndjekja e të gjitha rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale për metodën e procesverbalit me dorëshkrim nuk është aq rëndësishme saqë mosrespektimi i tyre të konsiderohet në rrafshin e pavlefshmërisë së procesverbalit. Kjo për arsye se shënimet dhe transkriptimet, kur regjistrimi audio apo ai audiovideo është zgjedhur si mjeti kryesor, në krijimin e procesverbalit, konsiderohen si mbështetëse të kësaj metode. Në këtë aspekt, çmohet se ky fakt i jep mundësinë gjykatës apo palëve për të lehtësuar konsultimin me përmbajtjen e audio-verbalit apo audiovideo-verbalit të seancës. Në Kodin e Procedurës Penale, pavlefshmëria e procesverbalit parashikohet në mënyrë shteruese vetëm për dy shkaqe, të cilët janë: i) kur është e pamundur të identifikohen me saktësi personat pjesëmarrës dhe ii) kur procesverbali nuk është nënshkruar nga përpiluesi i tij.

²⁶ Shih, në pjesën e të drejtës së zbatueshme të këtij Vendimi, Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr.353, datë 03.09.2013, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”.

38. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se çështja që mund të shkaktojë një keqkuptim apo keqinterpretim mbi atë çka përbën procesverbal apo mbi mënyrën e mbajtjes së tij është, pikërisht nënshkrimi, i parashikuar si element, mungesa e të cilit passjell pavlefshmëri, sipas neneve 122 dhe 345/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kërkesa ligjore e “detyrimit për nënshkrimin”, që mund të çojë në argumentin se procesverbalet janë të pavlefshëm, kur nuk janë të nënshkruar nga personeli që i ka përpiluar ato, është e zbatueshme vetëm për procesverbalet e mbajtura me mjetin me shkrim. Prandaj, ky argumentim nuk e ndalon apo përjashton mbajtjen e procesverbalit të vetëm me mjetin alternativ të audios apo audiovideos.
39. Meqenëse neni 115 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon që procesverbalit të mbahet me mjetet e disponueshme teknike, dhe duke qenë se dispozita mbi nënshkrimin i referohet vetëm procesverbalit me shkrim, atëherë mund të konkludohet se “rregulli i nënshkrimit” nuk është i zbatueshëm për regjistrimin audio apo audiovideo, dhe rrjedhimisht dispozitat e nenit 122 dhe nenit 345/2 i K.Pr.Penale, gjejnë zbatim vetëm kur procesverbalit është mbajtur me shkrim. Në këto kushte, mungesa e shënimeve apo transkriptimeve kur është zgjedhur mjeti kryesor i dokumentimit të veprimeve procedurale nëpërmjet regjistrimit audio ose audiovideo duhet të konsiderohet si një parregullësi, e cila mund të ndreqet kryesisht nga gjykata apo palët e interesuara, duke kërkuar shënimin apo transkriptimin e pjesëve relevante të verbalit audio apo audiovideo.
- 40. Në përgjigje të pyetjes së shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të K.Pr.Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, eficiencën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.**
41. Meqenëse Kolegjet e Bashkuara kanë çmuar si të pajtueshëm me ligjin procedural mbajtjen e procesverbalit me mjetin teknik të audios apo audiovideos, e vlerësojnë si të nevojshme të ndalen në çështjen e pasjes së mundësisë për kuptimin dhe lehtësimin e përdorimit në mënyrë efikase nga ana gjykatës të procesverbalit audio apo audiovideo. Veçanërisht kjo, në lidhje me “procesverbalin e seancës gjyqësore”, i cili përbën dhe objektin kryesor të çështjes së shtruar për unifikim, si edhe për zgjidhjen e rekursit objekt gjykimi para Kolegjeve të Bashkuara.
42. Dokumentimi i veprimeve procedurale me anë të mjetit teknik audio apo audiovideo duhet të bëhet në përputhje me parimin e procesit të rregullt në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së. Kjo do të thotë se gjykata, kur e çmon të nevojshme, qoftë kryesisht, qoftë me kërkesë të palëve, përveç mundësisë së mbajtjes së shënimeve të sekretarit të sinkronizuara në procesverbalin audio apo audiovideo, duhet të disponojë sa herë që kërkohet apo e çmon të nevojshme, transkriptimin e atyre pjesëve relevante që konsiderohen si të nevojshme për qëllime të gjykimit dhe ushtrimit të drejtave ligjore që u janë njohur palëve.

43. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë, se nisur nga fakti se procesverbali i vetëm i seancës, i hartuar me mjetin e regjistrimit audio apo video, është një mjet alternativ dhe kryesor për dokumentimin e veprimeve procedurale, mungesa e pasqyrimin apo përshkrimin të plotë të thënieve të dëshmitarit apo provave të tjera të tipit deklarativ nuk duhet të konsiderohet nga ana e gjykatës së apelit si shkak pavlefshmërie, që ndikon në prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por në këto raste gjykata e apelit, qoftë edhe kryesisht, duhet të disponojë transkriptimin e audio verbalit apo video verbalit, me qëllim që të formojë bindjen e saj të brendshme dhe të realizojë funksionin kryesor të saj, atë të dhënies së drejtësisë.
44. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në kushtet kur ofrohet një lloj i mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore me mjet më efektiv, mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjetin e dorëshkrimit në formë të përmbledhur, është një formë më pak efektive sesa format e plota të dokumentimit të veprimeve në seancë. Në rastet kur gjykatat e themelit do të procedojnë me hartimin e procesverbalit me mjetin e dorëshkrimit në formë të përmbledhur, ato duhet të arsyetojnë në mënyrë të detajuar rreth shkaqeve që kanë diktuar përzgjedhjen e një mjeti dokumentimi më pak efektiv sesa ai alternativ të mbajtjes së procesverbalit me llojin audio, apo audiovideo. Arsye që duhet të jenë vetëm objektive, të tilla siç mund të jenë: mungesa e mbajtjes së procesverbalit me mjetin kryesor për shkak të pamundësisë së teknologjisë, mungesa apo defektet e paparashikuara të impiantit, mungesa e energjisë elektrike, etj.

IV. Lidhur me zgjidhjen e çështjes

45. Duke iu kthyer çështjes objekt rekursi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkludojnë se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë që ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke e ridërguar çështjen për rigjykim në shkallë të parë, me arsyetimin se: në gjykimin e shkallës së parë në procesverbalin e seancës nuk janë shënuar pyetjet dhe për më tepër thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancë, dhe se riprodhimi audio i pyetjes së dëshmitarit përbën një formë dokumentimi të veprimeve të seancës gjyqësore, e cila është në funksion të transparencës së procesit, por nuk e zëvendëson procesverbalin e seancës gjyqësore, i cili përcaktohet nga neni 115/1 i Kodit të Procedurës Penale, si i vetmi akt që dokumenton veprimet e Gjykatë, është një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin procedural, prandaj rekursi i paraqitur nga mbrojtja e të pandehurit është i bazuar në ligj në masën dhe për arsyet e parashtruara si më sipër.
46. Ligji procedural nuk e parashikon si rast pavlefshmërie të procesverbalit mungesën e thënieve të dëshmitarit në të. Pavlefshmëria e procesverbalit është parashikuar vetëm në rastet e parashikuara në mënyrë shteruese nga neni 122 i K.Pr.Penale. Në rastin e procesverbalit të mbajtur me mjetin audio nuk mund të flitet për mungesë të thënieve të dëshmitarit, pasi procesverbali përbëhet nga zëri dhe mund të dëgjohet.
47. Në rastin konkret, meqenëse kemi të bëjmë me rastin e një dëshmitari të mitur, mbajtja e procesverbalit me mjetin alternativ të regjistrimit audio ose audiovideo, do të përbënte edhe një garanci të shtuar për mbrojtjen e interesit të të miturit, sepse do të evitonte pyetjen e tij të shpeshtë, ri-viktimizimin dhe prekjen e tij si viktimë vulnerabël.

48. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata Europiane e Drejtësisë (Gjykata e Luksemburgut), në rastin *Pupino C-105/03*²⁷, datë 16 Qershor 2005, ka përcaktuar detyrimin e shteteve anëtare të Bashkimit Europian ta interpretojnë të drejtën e tyre të brendshme procedurale penale në përputhje me të drejtën e Bashkimit Europian (vendim kuadër) dhe mbrojtjen e viktimave vulnerabël, siç janë të miturit, sa përket jetës dhe privatësisë së të miturit, duke dhënë dëshminë e tyre në përputhje me masat e marra për mbrojtjen e tyre sipas një niveli të caktuar. Edhe GjEDNj-ja në rastin *Rosin k. Estonisë*, nr.26540/08, datë 13.12.2013, § 55, ka deklaruar si në përputhje me Konventën Evropiane faktin e përdorimit si dëshmi, të procesverbalit të regjistruar audio gjatë hetimeve paraprake të një të mituri viktimë e abuzimit seksual.
49. Në këtë mënyrë, regjistrimi audio ose audiovideo do të shmangte ri-viktimizimin si dhe ripyetjen e të miturës më shumë se një herë pa qenë e nevojshme në apel apo edhe gjatë rigjykimit të çështjes.
50. Për sa më sipër, vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në gjykatën e apelit me trup tjetër gjykues, i cili, duhet të shqyrtojë shkaqet e ngritura në apel në bazë të parimit të procesit të rregullt e të drejtë, duke disponuar me dëgjimin verbalit audio ku paraqiten thëniet e dëshmitarëve të pyetur nga gjykata, të cilat kanë shërbyer për të si bazë e dhënies së vendimit përfundimtar, dhe gjykimin e çështjes sipas përcaktimit të konkluzioneve dhe të frymës së këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 438 dhe 441/ç të K.Pr.Penale

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.50, datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 27.04.2015

²⁷ Shih: <http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=60809&pageIndex=0&doclang=EN&mode=req&dir=&occ=first&part=1&cid=603601>

MENDIMI I PAKICËS

1. Si gjyqtar në pakicë, në ndryshim nga shumica, kam qëndrimin se ishte vendi që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të kishin disponuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Shumica e Kolegjeve të Bashkuara kanë disponuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit duke e dërguar çështjen për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trupë gjykuese, në thelb, duke arsyetuar se:

2.1 Nisur nga karakteristikat që kanë, regjistrimet dixhitale audio apo audiovizive konsiderohen mjet tjetër teknik në kuptim të nenit 115 të K.Pr.Penale, në gjendje për dokumentimin e veprimeve dhe një mjet efektiv për mbajtjen e procesverbalit.

2.2 Ashtu si të ish mbajtur në formë të plotë dhe me shkrim, procesverbali i mbajtur me mjetin e regjistrimit audio/audiovideo plotëson të gjithë elementët karakterizues të parashikuara nga KPrPenale.

2.3 Mundësia e regjistrimit audio apo “audiovideo”, për mbajtjen e procesverbalit tashmë, mund të konsiderohen, në vetvete, si mjete teknike (elektronike) të afta për paraqitjen e akteve dhe fakteve të ndodhura në seancë gjyqësore.

2.4 Zgjedhja e këtij mjeti për mbajtjen e procesverbalit rezulton të jetë miratuar edhe në Udhëzimin nr.353 datë 03.09.2013 të Ministrit të Drejtësisë.

2.5 Mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv është në përputhje me nenin 115 të K.Pr.Penale, duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit dhe duke përmbushur funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.

2.6 Procesverbali i vetëm i seancës, i hartuar me mjetin e regjistrimit audio dhe video, është mjet alternativ dhe kryesor për dokumentimin e veprimeve procedurale. Mungesa e pasqyrimin të thënieve të dëshmitarit dhe provave të tjera deklarative nuk konsiderohet nga gjykata e apelit si shkak pavlefshmërie për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit, qoftë edhe kryesisht, duhet të disponojë transkriptimin e audioverbalit, me qëllim formimin e bindjes së saj për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

3. Si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se ky arsyetim është rrjedhojë e një interpretimi dhe zbatimi të gabuar të ligjit procedural penal përse i përket kuptimit të procesverbalit të seancës gjyqësore, mënyrave të mbajtjes së tij dhe rasteve të ekzistencës e të pavlefshmërisë së këtij akti procedural, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Procesverbali si mjet i dokumentimit të veprimeve në procesin penal

4. Kodi i Procedurës Penale nuk përmban një përkufizim të shprehur lidhur me “procesverbalin”. Në doktrinë, kur flitet për formën si një aspekt të jashtëm i akteve, mund t'i referohesh si mënyrës së shfaqjes në botën e jashtme ashtu edhe mënyrës së dokumentimit. Shfaqja në botën e jashtme, që mund të jetë me gojë ose me shkrim, përbën mjetin që ka përdorur autori për të manifestuar dhe për ta bërë të njohur për të tjerët, aktin, në momentin që po realizohet.

5. Dokumentimi i një procesi bazohet në nevojën për të risjellë dhe vlerësuar, me distancë kohore, në të njëjtën shkallë ose në shkallë të tjera të gjykimit, atë që ka ndodhur në prani të subjektit që e ka mbajtur procesverbalin. Pra, dokumentimi i veprimeve, duke

patur si qëllim që të vërë në dispozicion gjurmën e asaj që ka ndodhur gjatë procesit, e destinuar për t'u ruajtur në kohë, garanton në mënyrë të veçantë mundësinë e verifikimit *a posteriori*, në rast ankimi, të vendimeve të marra më parë në kohë.

6. Përsa i përket formave të shfaqjes së akteve, në botën e jashtme, Kodi i Procedurës Penale vendos si rregull parimin e oralitetit (neni 121) që do të thotë se kur ligji nuk kërkon formën e shkruar të dokumentit, palët mund të bëjnë, vetë ose me anë të përfaqësuesve të posaçëm, kërkesa ose deklarime me gojë. Në këtë rast sekretari i gjykatës përpilon procesverbalin dhe regjistron deklarinimet. Palës që i kërkon i lëshohet me shpenzimet e veta një vërtetim ose kopja e deklarinimeve të bëra. Një rregull i tillë, në interpretim të kësaj dispozite, është parashikuar për aktet që paraqiten nga palët dhe jo për aktet e gjykatës.

7. Referuar doktrinës procesverbali është një akt i shkruar, i përpiluar nga sekretari i gjykatës, që ka funksione pasqyruese dhe ruajtëse pasi në të riprodhohen aktet dhe faktet që janë kryer dhe kanë ndodhur në prani të përpiluesit të tij. Pra kur flasim për procesverbal, doktrina ka parasysh formën e shkruar të tij dhe kjo formë është mënyra kryesore e dokumentimit të akteve të procesit. Pozicioni superior në sistemin e mjeteve të dokumentimit, i këtij instrumenti tradicional, rezulton se konfirmohet nga rrethana që edhe *në ato raste kur Kodi i Procedurës Penale kërkon që të bëhet regjistrimi fonografik apo audioviziv këto duhet gjithmonë të shoqërohen me procesverbalin me shkrim, në mënyrë të përmbledhur.*

Mënyrat e mbajtjes së procesverbalit dhe format e tij

8. Duke konsideruar që parimet nga të cilat udhëhiqet Kodi i Procedurës Penale janë thjeshtësi maksimal i procedimit dhe adoptimi i metodave orale, kontrolli i asaj që ka ndodhur gjatë procesit e ka bërë të nevojshme që të përdoren edhe teknika të ndryshme nga ajo e redaktimit tradicional të procesverbalit (që është ai me shkrim). Prandaj janë parashikuar mënyra plotësuese të dokumentimit, si regjistrimi fonografik e audioviziv.

9. Ligji procedural penal parashikon dy forma të dokumentimit të veprimeve në procesin penal. *Së pari*, është forma shkresore, e cila, si rregull, redaktohet me stenotipi ose mjet tjetër teknik, me parashikimin e zbatimit të mënyrës së dorëshkrimit vetëm në mungesë të këtyre mjeteve (neni 115 i K.Pr.Penale). *Së dyti*, riprodhimi fonografik dhe audioviziv. Lidhur me këtë formë, ajo e riprodhimit fonografik është i parashikuar, në mënyrë të shprehur, që të gjejë përdorim aty ku procesverbali është përpiluar në mënyrë të përmbledhur (neni 115/2), ndërsa ajo audiovizive mund të përdoret vetëm kur është e domosdoshme.

10. Përsa i takon akteve të fazës së hetimeve paraprake, në përgjithësi, në Kod parashikohet forma shkresore e tyre, si p.sh. në rastet kur duhet të bëhet njohja e personave, vendeve dhe sendeve; ballafaqimi i personave që kanë deklaruar të dhëna që kanë rëndësi për hetimin; në rastet e marrjes së provave materiale; në rastet e përgjimeve kur duhen transkriptuar bisedat e regjistruara etj, madje në disa raste Kodi parashikon që veprimet duhen përshkruar hollësisht në procesverbal²⁸. Ndërsa nga interpretimi i përmbajtjes së nenit 315 të K.Pr.Penale rezulton që mund të mbahen shënime, për dokumentimin e veprimeve të prokurorit, kur ekzistojnë rrethana të pakapërcyeshme që pengojnë dokumentimin aty për aty të veprimeve, pavarësisht se

²⁸ Nenet 170, 171, 188, 223 të K.Pr.Penale

Kodi nuk e parashikon në mënyrë të shprehur. Por edhe në këtë rast, shënimet duhen materializuar menjëherë sapa zhduket rrethana që e pengoi, në formën e procesverbalit me shkrim.

11. *Përsa i përket mjeteve teknike për përpilimin me shkrim të procesverbalit ligji procedural penal parashikon atë të stenotipisë, nëpërmjet mjeteve të tjera teknike dhe dorëshkrimit.* Pra, K.Pr.Penale lejon dy mundësi për mbajtjen e procesverbalit: redaktimi përmes stenotipisë (që transkriptohet në shkrim ose mjeti tjetër mekanik shkrimi. Në mungesë të tyre, lejohet përpilimi i procesverbalit me anë të dorëshkrimit. Sipas kësaj dispozite i jepet përparësi përdorimit të mjetit të parë, stenotipisë ose mjetit tjetër teknik të shkrimit. Dorëshkrimi mund të përdoret vetëm në rast të pamundësisë ose mungesës së mjetit të stenotipisë ose mjeteve të tjera ekuivalente teknike.

Format e mbajtjes së procesverbalit me shkrim

12. Sipas nenit 115 të K.Pr.Penale, mbajtja (përpilimi) i procesverbalit për dokumentimin e veprimeve bëhet *me shkrim*. Ndërkohë, përsa i përket mjeteve teknike për mbajtjen e procesverbalit me shkrim, ligji parashikon si mënyra, forma kryesore e parësore mjetin e stenotipisë (i cili në vetvete është edhe ky një “mjet teknik”) dhe mjete të tjera teknike të shkrimit të ndryshme nga stenotipia (si p.sh me kompjuter, makinë shkrimi mekanike apo të tjera mënyra të shkrimit që ofron teknologjia). Si përjashtim, në mungesë ose pamundësi të përdorimit të këtyre mjeteve teknike, parashikohet mbajtja e procesverbalit me dorëshkrim, pra nëpërmjet shkrimit të aktit nga sekretari pa përdorim të mjeteve teknike.

13. Po kështu, ligji procedural parashikon dhe dallon përpilimin e *procesverbalit në formën e plotë (riprodhim) ose të përmbledhur*. Ligji i jep përparësi dhe orienton që dokumentimi i akteve dhe veprimeve, të realizohet nëpërmjet redaktimit në formën e riprodhimit (të plotë), duke lejuar përdorimin e formës së përmbledhur si përjashtim, si edhe në rastet kur norma e lejon në mënyrë të shprehur (p.sh neni 120 i K.Pr.Penale).

14. Nga formulimi i nenit 115 të K.Pr.Penale, në përmbushje të detyrimit ligjor që procesverbali të mbahet me shkrim, si mjet teknik për realizimin e këtij detyrimi është parashikuar stenotipia ose mjete të tjera teknike të shkrimit. Pra, gjykata ka mundësinë që të përdorë edhe mënyra të tjera, të cilat, aktualisht ose në të ardhmen, i ofron teknologjia për të ndihmuar dokumentimin e saktë me shkrim të akteve dhe veprimeve të procedimit. Por, sipas K.Pr.Penale këto mbeten gjithsesi vetëm mjete plotësuese dhe të pamjaftueshme, si të vetme, për të kryer, në kuptim të ligjit rolin e procesverbalit “me shkrim”, si mjeti ligjor i pashmangshëm për dokumentimin dhe riprodhimin e akteve, veprimeve, deklarimeve dhe thënieve që ndodhin gjatë procedimit penal.

15. Me fjalë të tjera, këto mënyra nuk mund të zëvendësojnë kërkesën e shprehur dhe të qartë të ligjit për dokumentimin “me shkrim” të procesverbalit. Në fund të fundit, procesverbali nënkupton dokumentimin me anë të shkrimit të veprimeve dhe thënieve, pavarësisht nëse “shkrimi” realizohet me mjete teknike apo me dorëshkrim (pra pa përdorimin e këtyre mjeteve teknike). Prandaj, përveçse si një mjet plotësues dhe aspak kryesor, njësoj si riprodhimi fonografik, edhe teknologjitë e ndryshme të regjistrimit audio apo audiovideo, të cilat madje shërbejnë vetëm “për t’u përdorur me masë” e vetëm kur është e domosdoshme, mbeten mjete thjesht ndihmëse e plotësuese të dokumentimit tashmë të realizuar “me shkrim” të veprimeve në procesin penal, sikurse parashtrohet më sipër.

16. Sipas nenit 115/2 të K.Pr.Penale, mbajtja e procesverbalit në mënyrë të përmbledhur shoqërohet me riprodhimin fonografik apo atë audioviziv kur ky është i domosdoshëm. Ndërkohë, neni 120/2 parashikon raste në të cilat forma e përmbledhur e përpilimit të procesverbalit bëhet pa ia bashkuar detyrimisht me riprodhimet e ndryshme teknologjike: a) për dokumentimin e veprimeve që kanë përmbajtje të thjeshtë; b) kur mungojnë mjetet mekanike të riprodhimit ose ndihmësit teknikë. Në çdo rast mundësia për të zgjedhur mes formave të procesverbalit i takon gjyqtarit, duke u nisur nga nevojat e çdo rasti konkret.

17. Atëherë kur, si rregull i parashikuar nga K.Pr.Penale, për përpilimin e procesverbalit procedohet me përdorimin e mjetit teknik të stenotipisë, merren në konsideratë dy dispozita të tjera që përmbahen në titullin III, seksionin III: veçanërisht neni 118, që parashikon detyrimin e transkriptimit në shkrim të shiritave të stenotipisë jo më vonë se 5 ditë nga data kur janë formuar, si dhe neni 119 që parashikon mundësinë e riprodhimit fonografik ose audioviziv nga personat teknikë, qoftë edhe jashtë administratës shtetërore, nën drejtimin e sekretarit të gjykatës.

18. Në ato raste kur procesverbali mbahet me mjetin teknik të stenotipisë, kalimi i afatit të transkriptimit nuk sjell ndonjë pavlefshmëri procedurale, duke u parashikuar e drejta e palës që të kërkojë shënimin në procesverbal të çdo deklarami që ka interes dhe madje të kërkojë nga kryetari i seancës që të lexojë pjesë të veçanta të procesverbalit me qëllim që të verifikojë saktësinë dhe plotësinë e tij, pra edhe përputhjen mes asaj që është transkriptuar edhe asaj që është regjistruar²⁹.

19. Madje, kërkesa për transkriptimin e saktë dhe të menjëhershëm të informacionit të plotë të mbajtur me mjetin teknik të stenotipisë është tashmë një problem i zgjidhur nga teknologjia me adoptimin e sistemeve teknologjike të stenotipisë përmes lidhjes së tastierës me një kompjuter që siguron tekstin e redaktuar në karaktere të zakonshme.

20. Neni 115 i K.Pr.Penale parashikon individualizimin e dy formave të tjera të dokumentimit, të ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin e dytë, të konsideruara si “tipike”. Forma e parë që mbështet dokumentimin e veprimeve është ajo e parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni: riprodhimi fonografik. Madje ky paragraf e përcakton si rregull prezencën e përhershme të këtij mjeti teknik kur mbahet procesverbal i përmbledhur me shkrim. Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në nenin 120 të K.Pr.Penale. Sipas doktrinës, është vetë Kodi ai që dikton një vendosje në “shkallë hierarkie”: në kuptim të nenit 119/3 të K.Pr.Penale, për shkak se, në fakt, procesverbali në formë të përmbledhur (me shkrim) shërben si provë vetëm atëherë kur regjistrimi fonografik nuk kuptohet, duke i dhënë kështu në rast përjashtimor më shumë besueshmëri regjistrimit me zë.

21. Forma e dytë që mbështet dokumentimin e veprimeve në kuptim të ligjit procedural penal, e parashikuar në nenin 115/3 të K.Pr.Penale, është ajo e riprodhimit audio apo audioviziv. Ky përbën një mjet jo të zakonshëm, i cili mund të përdoret vetëm në raste kur është “e domosdoshme”. Por edhe ky mjet regjistrimi e riprodhimi audioviziv i bashkohet gjithmonë procesverbalit të redaktuar në mënyrë të përmbledhur me shkrim.

22. Pra, regjistrimi fonografik ose audioviziv është një mjet që e shoqëron procesverbalin e përmbledhur me shkrim. Neni 120 i K.Pr.Penale parashikon dy situata në të cilat gjyqtari mund të

²⁹ Neni 347 i K.Pr.Penale

disponojë me procesverbalin e përmbledhur. E para ka të bëjë me veprimet që kanë përmbajtje të thjeshtë, por në të cilën përjashtohet faza e debatimit të provave. E dyta lidhet me rastet kur mungojnë mjetet teknike të riprodhimit ose ndihmësit teknikë. Sipas doktrinës, këtu kemi të bëjmë me situata të mungesës së aparaturave të regjistrimit zanor ose të ndihmësve teknikë. Fryma e Kodit të Procedurës Penale nuk është ajo e lënies në diskrecionin e gjykatës të mbajtjes së procesverbalit përmbledhës në mungesë të aparaturave të stenotipisë, por vetëm në mungesë të disponimit të aparaturave të regjistrimit zanor. Çështja e mosdisponimit të mjeteve ose të teknikëve duhet kuptuar si prani e një pengese të përkohshme dhe të mënjanueshme me vënien në dispozicion të mjeteve të regjistrimit fonografik me pasojën e mosaplikimit të normës për mungesa të infrastrukturës në gjykatë.

Vlera provuese e procesverbalit të seancës gjyqësore

23. Kodi i Procedurës Penale, nuk përmban ndronjë dispozitë të shprehur njësoj si përmbajtja e dispozitës së nenit 30 të K.Pr.Penale të vitit 1979, sipas të cilit përbënin provë edhe procesverbalet gjyqësore të mbajtura për çështjen penale. Ky ometim i ligjit ka sjellë debate dhe qëndrime të ndryshme në jurisprudencë në lidhje me vlerën provuese të procesverbalit sipas K.Pr.Penale në fuqi.

24. Në doktrinë ekzistojnë dy orientime të kundërta. Sipas njërit orientim, heshtja e legjislatorit ka zbehur efikasitetin provues të privilegjuar të cilin e gëzonte procesverbali sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 1979, duke mundësuar në këtë mënyrë që gjyqtari të vlerësojë lirisht, sipas çdo dokumenti, përmbajtjen e procesverbalit. Sipas qëndrimit tjetër doktrinor procesverbalit, dhe në përgjithësi të gjitha mjeteve të dokumentimit të përdorura në një proces penal, i atribuohet vlerë e privilegjuar, derisa nuk është deklaruar falsiteti.

25. Kam mendimin se procesverbali i seancës gjyqësore në procesin penal përbën provë të plotë për atë që përmbahet në të, për faktet që kanë ngjarë në prani të përpiluesit të procesverbalit ose për veprimet procedurale të kryera gjatë kësaj seance. Ky procesverbal duhet të jetë domosdoshmërisht i nënshkruar, nga sekretari i seancës, me pasojë pavlefshmërie sipas nenit 122 të K.Pr.Penale.

Mbajtja e procesverbalit në fazën e marrjes provave dhe debatit rreth tyre

26. Nisur nga rëndësia e tyre e posaçme, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar rregulla të veçanta të përpilimit dhe mbajtjes së procesverbalit gjyqësor gjatë marrjes së provave dhe debatit lidhur me to. Ky Kod, për këtë moment procedural, edhe pse ndoshta jo me pasojë pavlefshmërinë, parashikon shprehimisht formën e mbajtjes së plotë, pra jo atij të përmbledhur, të procesverbalit gjyqësor, si p.sh për deklaratimet e të pandehurit, pyetjen e dëshmitarëve, ekspertëve dhe palëve private³⁰. Ndërsa kërkesat dhe pretendimet përfundimtare të prokurorit dhe të palëve pasqyrohen në procesverbal në mënyrë të përmbledhur³¹.

27. Sipas nenit 368 të K.Pr.Penale rezulton se në procesverbalin e marrjes së provës shënohen gjeneralitetet e dëshmitarëve, ekspertëve e të përkthyesve, si dhe paralajmërimi që u bëhet për të thënë të vërtetën dhe për përgjegjësinë që kanë në rast se bëjnë dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë. Pyetjet e bëra nga palët dhe kryetari si dhe përgjigjet e personave të pyetur,

³⁰ Neni 368 i K.Pr.Penale

³¹ Neni 347 i K.Pr.Penale

riprodhohen (me shkrim) nga sekretari. Pra për fazën e marrjes së provave, në veçanti të provave me dëshmitarë dhe ekspertë, kodi ka dashur që t'i veshë procesverbalit një formë të veçantë, duke parashikuar formën e plotë (riprodhimin) të shkrimit (me stenotipi, mjet tjetër teknik apo dorëshkrim). Kjo nisur edhe nga fakti që, gjatë procesit të të provuarit, ndryshe nga procesi civil, krahas provave shkresore, në procesin penal rëndësi kryesore marrin provat me dëshmitarë, duke qenë shpesh edhe prova kyçe. Prandaj edhe pasqyrimi i saktë i tyre, në procesverbal, në mënyrë të plotë, merr rëndësi të veçantë.

28. Pra, veçanërisht në rastet e nenit 368, mbajtja e procesverbalit me shkrim, në mënyrë të plotë, përbën mënyrën e domosdoshme të dokumentimit të akteve që përpilohen në fazën e debatit të provave. Ndërsa për veprimet e tjera që ndodhin gjatë kësaj faze të hetimit gjyqësor, ato mund të pasqyrohen edhe në mënyrë të përmbledhur sipas rregullave të parashikuara në nenin 120 të Kodit të Procedurës Penale.

29. Rëndësia e procesverbalit si akt i dokumentimit të procesit, rezulton edhe nga përmbajtja e nenit 371 të K.Pr.Penale sipas të cilit procesverbalet dhe aktet që janë lexuar në seancë gjyqësore si dhe dokumentet e paraqitura nga palët e të pranuar nga gjykata, futen bashkë me *procesverbalin e seancës*, në fashikullin e gjykatës. Kjo dispozitë qartazi i referohet formës së shkresore, të plotë, të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor.

Mungesa apo pavlefshmëria e procesverbalit gjyqësor

30. Bazuar në parimet dhe dispozitat në tërësi të Kodit të Procedurës Penale, gjen zbatim parimi sipas të cilit ekziston liria e zgjedhjes së formës së akteve me të cilat palët i drejtohen gjykatës, përveç rasteve kur ky Kod e lidh vlefshmërinë e aktit me një formë të caktuar. Ndërsa në rastin e akteve të gjykatës, zgjedhja e njërit apo tjetrit mjet të dokumentimit të veprimeve që kryhen në procesin penal, i përket, si rregull, gjyqtarit, por kriteret për të zgjedhur këtë mjet janë ato të diktuar nga K.Pr.Penale, si p.sh neni 120.

31. Mbajtja e procesverbalit jo në përputhje me rregullat e vendosura në nenin 115 të K.Pr.Penale, nuk parashikohet që të passjell zbatimin e ndonjë sanksioni, as edhe pavlefshmëri të procesverbalit. Të vetmet raste të pavlefshmërisë së tij janë ato të parashikuara në nenin 122 të K.Pr.Penale, pra kur ekziston pasiguria absolute në lidhje me identitetin e personave që kanë marrë pjesë në redaktimin e aktit si dhe kur vërtetohet mungesa e nënshkrimit të nëpunësit që e ka përpiluar (sekretarit të seancës).

32. Pra, duket se nuk përbën shkak pavlefshmërie, absolute apo relative, mosrespektimi i neneve 115-120 të K.Pr.Penale, përfshirë edhe rastin e mbajtjes së procesverbalit të seancës në mënyrë të përmbledhur, duke mos pasqyruar veprimet që ndodhin në seancë, deklaratimet dhe pyetjet e palëve apo thëniet e dëshmitarëve të pyetur në seancë gjyqësore.

33. Megjithatë, është thelbësore të mbahet parasysh se, nëse nuk mbahet procesverbal me shkrim (me transkriptim nëpërmjet stenotipisë, me mjete të tjera teknike të shkrimit apo me dorëshkrim) atëherë jemi përpara gjendjes së mungesës tërësore të procesverbalit gjyqësor.

34. Riprodhimi fonografik apo riprodhimi audio ose audioviziv nuk janë procesverbal dhe as nuk janë mjet që e zëvendëson procesverbalin me shkrim. Procesverbali është akt i shkruar, me mjet teknik apo dorëshkrim. Regjistrimi dhe riprodhimi fonografik, audio, audioviziv, etj. nuk janë

forma të shkrimit të thënieve ose të përshkrimit të veprimeve, por janë forma të dëgjimit apo shikimit të njeriut me shqisat e tij nëpërmjet mjeteve teknologjike të këtyre thënieve dhe veprimeve. Por K.Pr.Penale, me formulime të qarta e të shprehura të dispozitave aktuale të tij, ka parashikuar që, pavarësisht nga ekzistenca dhe përdorimi ose jo i mjeteve teknologjike të regjistrimit apo riprodhimit të seancave, thëniet dhe veprimet në procedimin penal duhet të dokumentohen me shkrim, nëpërmjet procesverbalit gjyqësor.

35. Edhe kur ligji procedural parashikon formën e mbajtjes së procesverbalit të përmbledhur, ai i parashikon riprodhimin fonografik ose audioviziv si mjete shoqëruese e plotësuese të detyrueshme për efekt të dokumentimit, pra edhe vërtetësisë së thënieve dhe veprimeve që ndodhin gjatë seancës gjyqësore. Por, gjithsesi, K.Pr.Penale nuk lejon asnjë hapësirë që riprodhimi fonografik apo audio ose audioviziv të konsiderohen apo zëvendësojnë procesverbalin me shkrim, të plotë a të përmbledhur, të seancës gjyqësore.

36. Nëse procesverbali nuk gjendet në fashikullin e gjykimit, me shkrim, në formë të plotë apo të përmbledhur me elementët e përmbajtjen përkatëse sikurse e kërkon qartë apo shprehimisht ligji, atëherë, në kuptim të nenit 115 e vijues të K.Pr.Penale, këtë akt procedural nuk e përmbush a zëvendëson rregullisht as edhe mbajtja e një dokumenti shkresor, qoftë edhe të quajtur “procesverbal”, i cili vetëm synon të dokumentojë ndonjë aspekt që thjesht tregon se gjykimi ka ndodhur, e të cilit i bashkëlidhet një mjet i cili përmban regjistrimin audio apo audiovideo të seancës. Në situata të këtilla nuk kemi të bëjmë me çështje vlefshmërie apo pavlefshmërie të aktit procedural, por me mungesë, me mos ekzistencë formale juridike të dokumentimit të thënieve dhe veprimeve që kanë ndodhur gjatë procesit gjyqësor. Sipas nenit 115 të K.Pr.Penale, qartazi, pa asnjë lloj dyshimi dhe alternative, parashikohet shprehimisht që dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal dhe procesverbali mbahet me shkrim, me mjet teknik apo dorëshkrim. Riprodhimi fonografik, audio apo audioviziv nuk përbëjnë “dokumentim të veprimeve” në kuptim të ligjit procedural penal.

37. Si përfundim, përsa i përket njësimimit të praktikës gjyqësore, si gjyqtar në pakicë kam mendimin se Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin ardhur në përfundimin *se për dokumentimin e veprimeve në seancë gjyqësore, duhet të mbahet procesverbal, i cili është akt i shkruar, me anë të mjetit teknik të stenotipisë e të transkriptuar, me mjete të tjera teknike të shkrimit ose me dorëshkrim. Ky procesverbal me shkrim, nëse mbahet i plotë, mund të shoqërohet me riprodhim fonografik apo regjistrim audio ose audioviziv. Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur, përjashtoj rastet e nenit 120, shoqërimi me mjetin e riprodhimit fonografik apo regjistrimit audio ose audioviziv, është i detyrueshëm për gjykatën. Këto mjete nuk përbëjnë dhe as nuk zëvendësojnë procesverbalin gjyqësor, por, nëse përdoren sikurse parashitohet mësipër, sigurisht që konsiderohen, në këndvështrimin teknik por jo në atë juridik, si mjete plotësuese efikase e të përshtatshme për të realizuar e ndihmuar në mënyrë të menjëhershme, të saktë dhe autentike, dokumentimin ligjor me anë të shkrimit të veprimeve që ndodhin gjatë seancës gjyqësore, si dhe tërësinë komplekse të riprodhimit të ngjarjeve, akteve apo fakteve që kanë ndodhur në seancë, duke përfshirë edhe dokumentimin e sjelljeve zanore apo pamore.*

38. Së fundi, si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se shumica e Kolegjeve të Bashkuara ka zbatuar gabim parimet themeltare kushtetuese të fuqisë dhe shtrirjes (fushës së zbatimit) së efekteve normative të akteve nënligjore në procedimin penal. Shumica, gjatë arsyetimit të qëndrimit të saj në tërësi, e veçanërisht në pikën 38, si argument të saj për ta konsideruar të ligjshme mundësinë e mbajtjes së procesverbalit me mjetin audio, i referohet edhe zgjedhjes së

këtij mjete me Udhëzimin nr.353, datë 03.09.2013 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”.

39. Por, ndryshe nga sa arsyeton Shumica e Kolegjeve të Bashkuara, si gjyqtar në pakicë vërej se, ky Udhëzim, për nxjerrjen e tij, gjen mbështetje të shprehur ashtu sikurse e kërkon neni 118 i Kushtetutës, vetëm në paragrafin e fundit të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet se: “*Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja. Rregullat e hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë*”.

40. Si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se, *së pari*, nxjerrja e këtij akti nënligjor nuk i referohet dhe as mbështetet në ndonjë delegim që ligjvënësi ti ketë bërë Ministrit të Drejtësisë përpara se të përket kryerjes së akteve procedurale dhe mbajtjes së procesverbalit në procesin penal. *Së dyti*, nxjerrja e këtij akti nënligjor i është ngarkuar Ministrit të Drejtësisë vetëm lidhur me procesin gjyqësor civil. *Së treti*, nxjerrja e këtij akti nënligjor i është ngarkuar Ministrit të Drejtësisë vetëm lidhur me çështjet e ruajtjes dhe arkivimit të procesverbalit gjyqësor (civil), por aspak për çështjet e mënyrës dhe formave të lejuara të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor, me mjete audio apo të çdo forme tjetër, për shkak se këto çështje i rregullon dhe duhet ti rregullojë vetë ligji. *Së katërti*, përveç kësaj, ky Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë, pa respektuar urdhërimet kushtetuese (neni 118), në pjesën hyrëse të tij, referon si mbështetje ligjore si K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale, por pa treguar dispozitën konkrete të këtyre kodeve që e ngarkon atë me kompetencën për nxjerrjen e këtij Udhëzimi. Ndërkohë që delegimin e përmban vetëm paragrafi i fundit i nenit 118 të K.Pr.Civile. *Së pesti*, kjo dispozitë deleguese e ngarkon Ministrin e Drejtësisë që, me anë të një “urdhri”, të përcaktojë “rregulla të hollësishme” vetëm për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbaleve gjyqësore civile. Pra, nisur nga natyra përgjithësisht teknike e çështjeve të deleguara nga ligji, me anë të aktit nënligjor “urdhër” Ministri i Drejtësisë duhet të miratonte nxjerrjen e një Rregulloreje për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbaleve gjyqësore civile, ndërkohë që ai ka nxjerrë një “udhëzim” i cili është akt nënligjor i cili, për nga natyra e tij, ndjek dhe përdoret në raste e për qëllime të tjera rregullatore.

41. Duke u kthyer në çështjen objekt gjykimi, nisur nga sa arsyetohet më sipër mbi interpretimin e drejtë të ligjit të zbatueshëm, në ndryshim nga shumica, si gjyqtar në pakicë kam mendimin se Kolegjet e Bashkuara duhet të dispononin lënien në fuqi të vendimit nr.50 datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin ishte prishur vendimi i gjykatës së shkallës së parë duke e dërguar çështjen për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në kushtet kur mungon procesverbali i plotë apo edhe ai i përmbledhur me përmbajtjes sikurse e kërkon shprehimisht ligji procedural penal, e duke u zëvendësuar me të quajturin “procesverbal me mjetin audio”, gjykoj se jemi përpara mungesës së një akti procedural pa të cilin nuk mund të vërtetohet ligjërisht e rregullisht dokumentimi i thënieve dhe veprimeve që kanë ndodhur në procesin gjyqësor penal.

Ardian Dvorani

**Nr.2 i Regj. Themeltar
Nr.2 Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Medi Bici	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Artan Broci	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

në seancën e datës 03.11.2014, mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

KËRKUES: ERION BORAKAJ
KUNDËR: PROKURORIA PRANË GJYKATËS PËR KRIME
TË RËNDA

OBJEKTI:

Parashkrim të ekzekutimit të vendimit penal

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.44, datë 25.07.2013 ka vendosur:

Pranimin e kërkesës.

Deklarimin e shuar të dënimit dhënë ndaj të dënuarit Erion (Herion) Borakaj me vendim të kësaj gjykate nr.11, datë 11.02.2008, i ndryshuar me vendimin nr.293, datë 26.03.2010 të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.35, datë 09.09.2013 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.44, datë 25.07.2013 të Gjykatës së Shkallë së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues (për shkak të njoftimit të kërkesit).

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.106, datë 04.12.2013 ka vendosur:

Pranimin e kërkesës.

Deklarimin e shuar të dënimit dhënë ndaj të dënuarit Erion (Herion) Borakaj me vendim të kësaj gjykate nr.11, datë 11.02.2008, i ndryshuar me vendimin nr.293, datë 26.03.2010 të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.55, datë 30.12.2013 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.106, datë 04.12.2013 të Gjykatës për Krime të rënda, Tiranë.

Prëzimin e kërkesës së të dënuarit Erion Borakaj me objekt: “parashkrimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit nr.20, datë 15.04.2008 të Gjykatës së apelit për Krime të Rënda

Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar rekurs nëpërmjet përfaqësuesit të tij, kërkuesi **Erion Borakaj**, i cili kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i gjykatës së apelit është i padrejtë dhe i pabazuar në ligjin penalo-procedural dhe vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.2, datë 14.10.2002.
- Gjykata e apelit ka interpretuar gabim fillimin e afatit të parashkrimit të dënimit ndaj të dënuarit Erion Borakaj, duke konsideruar si fillim afati datën 26.03.2010, dhe jo atë 15.04.2008.
- Fillimi i afatit ligjor për parashkrimin e ekzekutimit të një vendimi penal lind në momentin e marrjes formë të prerë të këtij vendimi. Në këto kushte ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 15.04.2008.
- Ndryshimi që i ka bërë Gjykata e Lartë, në drejtim të cilësimit ligjor të veprës penale në ngarkim të të dënuarit Erion Borakaj, dhe masës së dënimit të tij, nuk ka prekur si ekzistencën e veprës penale të kryer në realitet nga ai, ashtu edhe fajësinë e tij. Pra Gjykata e Lartë efektivisht nuk ka prekur këto dy elementë të domosdoshëm të veprës penale që lidhen me të dënuarin Erion Borakaj.
- Në mbështetje të argumentit të mbrojtjes është edhe Vendimi Unifikues, nr.7, datë 11.10.2002 – ku nënvizohet koha e fillimit të afatit të parashkrimit, i cili në rastin tonë është mbështetës.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarëve Shkëlzen Selimi dhe Guxim Zenelaj; prokurorin Arqilea Koça, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr.55, datë 30.12.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; mbrojtësin e kërkuesit av. Jorgo Dhrami, i cili kërkoi zbatimin e nenit 68(c) të K.Penal në drejtim të mosvënies në ekzekutim të vendimit penal të të dënuarit Erion Borakaj pasi ai është parashkruar; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Erion Borakaj është akuzuar nga organi i ndjekjes penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për kryerjen e veprave penale të “Rrëmbimit ose mbajtjes peng në bashkëpunim, i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike” dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” në bashkëpunim, të parashikuar përkatësisht nga nenet

109/3 e 25 dhe 278/2 e 25 të K.Penal. Ai është akuzuar se në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë A.E. dhe L.E. kanë rrëmbyer dhe më pas kanë vrarë më datë 15.08.2004, shtetasin P. Z., banues në Vlorë. Procesi ndaj këtij të gjykuari është shqyrtuar në të gjitha shkallët e gjykimit duke rezultuar me vendime fajësie kundër tij, për kualifikime ligjore të ndryshme.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.11, datë 11.02.2008, ndër të tjera ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Erion Azis Borokaj për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim” për interes, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 78/2 e 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 21 vjet burgim. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Erion Azis Borokaj për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 278/2 e 25 të K.Penal. Vuajtja e dënimit të këtij të pandehuri i fillon ditën e ekzekutimit të vendimit dhe të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.”*
3. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.20, datë 15.04.2008, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr.11, datë 11.02.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë”.*
4. Gjykata e Lartë, me vendimin nr.00-2010-517(293), datë 26.03.2010 ndër të tjera ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të gjykuarit Erion Borokaj, për veprën penale të përkrahjes së autorit të krimit dhe në bazë të nenit 302/1 të K.Penal, dënimin e tij me 5 vjet burgim”.*
5. Siç rezulton nga aktet e ndodhura në dosje, urdhri për ekzekutimin e vendimit penal nr.11, datë 11.02.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka dalë më datë 09.05.2008 (rreth 3 javë pas shpalljes së vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda). Gjithashtu me shkresën nr.468/5, datë 26.05.2010 është dërguar prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, urdhri për ekzekutimin e vendimit nr.00-2010-517(293), datë 26.03.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
6. Megjithë kërkimet e kryera nga ana e organeve ligjzbatuese, vendimi nr.00-2010-517(293), datë 26.03.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka mbetur i pa ekzekutuar për shkak se i dënuari nuk është arritur të kapet.
7. Në kushtet kur vendimi i dënimit nuk është vënë në ekzekutim, kërkuesi Erion Borokaj i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me kërkesën me objekt: *“Parashkrim të ekzekutimit të vendimit penal (vendimit nr.20, datë 15.04.2008 të Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda). Kërkuesi e mbështet kërkesën në nenin 68, germa “c” të K.Pr.Penale, pasi nga momenti i marrjes formë të prerë të tij kanë kaluar mbi 5 vjet pa u vënë në ekzekutim nr.20, datë 15.04.2008 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.*

II. Procedurat gjyqësore

8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr.44, datë 25.07.2013 ka vendosur:
 - iii. Pranimin e kërkesës.
 - iv. Deklarimin e shuar të dënimit dhënë ndaj të dënuarit Erion (Herion) Borokaj me vendim të kësaj gjykate nr.11, datë 11.02.2008, i ndryshuar me vendimin nr.293, datë 26.03.2010 të Gjykatës së Lartë.
9. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.35, datë 09.09.2013 ka vendosur:
 - ii. Prishjen e vendimit nr.44, datë 25.07.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues (për shkak të njoftimit të kërkuesit).

iii.

10. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.106, datë 04.12.2013 ka vendosur:

i. Pranimin e kërkesës.

ii. Deklarimin e shuar të dënimit dhënë ndaj të dënuarit Erion (Herion) Borakaj me vendim të kësaj gjykate nr.11, datë 11.02.2008, i ndryshuar me vendimin nr.293, datë 26.03.2010 të Gjykatës së Lartë.

11. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.55, datë 30.12.2013 ka vendosur:

i. Ndryshimin e vendimit nr.106, datë 04.12.2013 të Gjykatës për Krime të rënda, Tiranë.

ii. Rrëzimin e kërkesës së të dënuarit Erion Borakaj me objekt: “parashkrimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit nr.20, datë 15.04.2008 të Gjykatës së apelit për Krime të Rënda.

III. Arsytimi ligjor i vendimit të ankimuar

12. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në vendimin nr.55, datë 30.12.2013, midis të tjerave, arsyeton:

Domethënia kryesore e një vendimi të prerë, është se tashmë ka përfunduar së ushtruari pushteti i gjykatës, sepse çështja është gjykuar “thelbi i së cilës konsiston në nevojën për të siguruar, në një moment të caktuar qartësi dhe qëndrueshmëri ligjore, përfituar kjo me përfundimin e procesit [...] ndërkohë në planin penal ajo shënon fillimin e afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, (neni 68 K.Penal), në planin procedural penal ajo reflekton pamundësi për të gjykuar rishtazi të njëjtën çështje ngarkuar të njëjtit person [...] nga sa është e qartë se vendimi nr.20, i gjykatës së apelit ku ndaj tij është ushtruar rekurs nuk është i formës së prerë dhe kështu afati i fillimit të ecjes së parashkrimit të ekzekutimit të dënimit nuk mund të llogaritet nga data 15.04.2008, që është data e shpalljes së tij, ky afat fillon të llogaritet kur vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë, pra kur ai nuk është më i ankimeshëm e që nuk mund të ndryshohet e kështu përfundimtar dhe që është pikërisht data 26.07.2010 kohë në të cilën gjykata e larta ka shpallur vendimin e dënimit për të pandehurin Erion Borakaj [...]”

13. **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se ka interpretime jo të njëjta në lidhje me përcaktimin se cili është momenti që një vendim gjyqësor penal quhet i formës së prerë, vendosi që për njësimin e praktikës gjyqësore, në këtë drejtim, çështjen që i përket kërkuarit Erion Borakaj, ta kalojë në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.**

IV. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara dhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara

14. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore janë:

1. *Në mungesë të një përkufizimi juridik të parashikuar nga K.Pr.Penale, çdo të kuptojmë me shprehjen “vendim i formës së prerë”?*
2. *Në aspektin teorik referimi në terminologjinë “vendim i ekzekutueshëm”, “vendim i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar” duhen kuptuar si shprehje e të njëjtit nocion juridik, apo duhet kuptuar si koncepte të ndryshme nga njëra-tjetra?*

3. Si duhet kuptuar dhe interpretuar neni 432 i K.Pr.Penale, titulli “Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë” dhe përmbajtja e tij për efektet që lidhen me vënien në ekzekutim të vendimit penal?
4. Në rastin kur palët në procesin penal për pjesën e gjykitimit që ka lidhje me fajësinë ushtrojnë ankim (rekurs) në Gjykatë e Lartë, dhe kjo e fundit në bazë të nenit 441, paragrafi i parë, germa “c” i K.Pr.Penale e ndryshon vendimmarrjen për efekt të parashkrimit të dënimit, cili do të konsiderohet vendim i formës së prerë për efekt të llogaritjes së afatit kohor të parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal?
5. Kur fillon llogaritja e afatit kohor të parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal në rastin kur Kolegji Penal disponon sipas nenit 441, paragrafi i parë, germa “d” i K.Pr.Penale duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë?

V. Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me çështjet që duhet të unifikohen:

15. Prokurori në lidhje me çështjen e parë mbajti qëndrimin se: K.Pr.Penale jonë nuk ka një përkufizim mbi vendimin e formës së prerë por si në referencë të traditës ashtu dhe në referencë të sistemeve të tjera ka një përkufizim të gjithë pranuar në lidhje me këtë koncept si një vendim i cili për disa arsye është i pa kthyeshëm, i pandryshueshëm, i pa cenueshëm përveçse me mjete të jashtëzakonshme sikurse instituti i rishikimit. Në thelb, vendimi i formës së prerë nënkupton një vendim i cili nuk mund të revokohet nuk mund të ndryshojë. Ai ka karakter 1) të detyrueshëm, pasi merr natyrën e ligjit për çështjen konkrete dhe është i detyrueshëm për të gjithë në lidhje me pjesën dispozitive; 2) të qëndrueshëm, sepse nuk mund të ndryshojë nga asnjë strukturë tjetër shtetërore dhe nga asnjë vendimmarrje tjetër qoftë kjo dhe gjykata që ka dhënë vendimin veçse në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në ligj; si dhe 3) ekskluziv, pasi është shprehje e faktit se për një sjellje të caktuar të një individi të caktuar, ka një qëndrim shtetëror i cili ndalon rishqyrtimin pra nënkupton *res judicata*.

Në lidhje me çështjen e dytë: Termi “vendimi i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar” pavarësisht se në aspektin e përkufizimit formal janë të ndryshme, përputhen në faktin se një çështje e cila përbën unitetin e një sjellje të caktuar dhe të identifikuar penale me personin e identifikuar, konsiderohet se është gjykuar dhe nuk mund të rigjykohe, pra “gjë e gjykuar” veçse kur për këtë çështje gjykata ka arritur në një vendim të formës së prerë. Për sa i përket terminologjisë “vendim i ekzekutueshëm” i cili edhe përse nuk gjendet në legjislacionin procedural penal, është i pranishëm në fjalorin e përdorur nga jurisprudenca dhe ka një lidhje të caktuar me konceptin “vendim i formës së prerë”. Kjo për faktin se një vendim përfundimtar, bëhet i ekzekutueshëm vetëm kur ai bëhet i përvokueshëm, pra i formës së prerë. Por përveç këtyre vendimeve, ka raste kur vetë ligji, K.Pr.Penale parashikon kapacitetin ekzekutues të një vendimi penal jo të formës së prerë. Këto janë rastet që lidhen kryesisht me masat e sigurimit personal apo pasuror. Pra nga sa më sipër termi “vendim i ekzekutueshëm” është më i gjerë se termi “vendimi i formës së prerë” për shkakun se vendimi mund të jetë i ekzekutueshëm për një kategori vendimesh gjyqësore edhe kur ato nuk kanë marrë formë të prerë.

Në lidhje me çështjen e tretë: [K]a dy linja qëndrimi ndaj problematikes së ngritur duke krijuar një ambiguitet që shkakton përplasje mes koncepteve tradicionale dhe parimeve themelore që duhet të operojnë një shtet të së drejtës. Një linjë i jep udhë pikëpamjes se vendimi i formës së prerë është vendimi i cili nuk mund të ankimohet më veçse nëpërmjet institutit të rishikimit sipas nenit 449, të K.Pr.Penale. Kjo të çon në përfundimin se nëse është bërë rekurs ndaj vendimit përfundimtar/të themelit të gjykatës së apelit, ky vendim nuk mund

të jetë i formës së prerë e për rrjedhojë nuk mund të jetë i ekzekutueshëm. [...] Në këtë linjë ka ecur veç një pjese të praktikës sonë edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në disa prej vendimeve të saj që lidhen me Shqipërinë. [...] Linja tjetër i jep udhë pikëpamjes se vendimet e gjykatës së apelit (përveç rasteve të parashikuara në nenin 431 të K.Pr.Penale) janë vendime të formës së prerë. Kjo linjë bazohet në parashikimet dhe interpretimet e një sërë dispozitave kushtetuese apo të K.Pr.Penale apo në faktin e mungesës së njaft parashikimeve që do të argumentonin të kundërtën. [...] Ajo që siguron ruajtjen e balancës së parimeve në një sistem dyshkallësh është natyra e jashtëzakonshme e rishikimit ligjor apo faktik të një vendimi. Për mendimin tonë, rishikimi ligjor aktual nuk është i tillë [i jashtëzakonshëm] [...] Nga analiza rezulton se sistemi aktual i drejtësisë penale shqiptare përbën një përzierje joorganike mes sistemeve e konkretisht mes sistemit dyshkallësh të trashëguar dhe sistemit tri shkallësh të adaptuar kryesisht nga K.Pr.Penale italiane.

Në lidhje me pyetjen e katërt: Nisur nga fakti se ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë, pavarësisht se si ka disponuar në lidhje me çështjen që shqyrton, nuk ka mjet ankimi, vendimi saj është i formës së prerë. Nga ana tjetër, çdo vendim i saj, i ndryshëm nga mospranimi i rekursit dhe nga lënia në fuqi e vendimit të formës së prerë të çështjes që shqyrton, sjell një vullnet të ri gjyqësor, i cili për nga natyra është i padiskutueshëm, pra i formës së prerë. [...] Vendim i formës së prerë edhe për zgjidhjen e çështjes që shqyrtohet do të konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Duke konsideruar si të formës së prerë këtë vendim, nuk ka më dyshim se me momentin e deklarimit të atij vendimi lidhen të gjitha pasojat apo institutet e tjera që kushtëzohen nga ai vendim.

Në lidhje me pyetjen e pestë: Vendim i formës së prerë do të konsiderohet ai i Gjykatës së Lartë e për rrjedhojë dhe efektet që lidhen me nenin 68 të K.Penal do të nisin nga ky vendim. [...] Ka dy arsye se pse ky vendim i Gjykatës [së Lartë] do të konsiderohet i formës së prerë e për pasojë dhe efektet e nenit 68 të K.P. do të fillojnë nga ky vendim. Së pari, nëse ecim me logjikën e mësipërme të nevojës së konfirmimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për t'u quajtur i formës së prerë, konstatojmë se ky vendim nuk është konfirmuar nga gjykata e apelit, në këtë mënyrë konfirmimi i tij nga Gjykata e Lartë i jep atij vendimi natyrën e formës së prerë. Së dyti, [...] mund të argumentohet se nëpërmjet disponimit për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Lartë, në thelb i jep fuqi një vullneti të ri gjyqësor, i cili nuk ekzistonte që pas vendimit të gjykatës së apelit.

16. *Mbrojtja*, ndër të tjera mbajti qëndrimin se: Interpretimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk gjen mbështetje ligjore, pasi vjen në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 68 germa "c", të Kodit penal, nenit 432 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe Vendimin Unifikues nr.7, datë 14.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. [...] Në rast se do të pranojmë për një moment argumentin se 'fillimi i afatit të vuajtjes së dënimit duhet të përllogaritet nga momenti që Gjykata e Lartë, ka ndryshuar kualifikimin e veprës penale si dhe masën e dënimit, dhe jo atë të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë, i dënuari Erion Borakaj, duhet të vuajë një dënim penal dy vjet më shumë nga pesë vjet që realisht ai është dënuar. Përfundim ky, absolutisht absurd, dhe për rrjedhojë, i pa pranuar nga Ligji Penal - Procedural. Kjo, sepse vënia në ekzekutim të një vendimi penal, kurdoherë dhe në çdo rast, në mënyrë të domosdoshme, është i kushtëzuar, me kohën e marrjes së formës së prerë të tij. [...] Vendimi nr.293, date 26. 03. 2010, i Gjykatës së Lartë nuk ka "goditur" themelin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë, nr.20, date 15. 04.2008, [...] pasi ka operuar vetëm në drejtim të kualifikimit ligjor të veprës penale që realisht ka konsumuar i dënuari Erion Borakaj [...] nga "Vrasje me paramendim", në "Përkrahje të autorit të krimit", dhe në bazë të nenit përkatës, 304/1 të Kodit Penal, dënimit e tij të mëparshëm, e kthen në maksimumin e kësaj dispozite, në pesë vjet burgim. [...] Duke mos u ndryshuar themeli i

vendimit penal të Gjykatës së Apelit, vendimi i kësaj të fundit, në esencë, mbetet në fuqi, me gjithë ndryshimet që ka bërë Gjykata e Lartë. Mendojmë kështu, sepse ndryshimi që ka bërë gjykata e Lartë, nuk i ka “dhënë ndonjë kthesë vendimit të gjykatës së apelit”, në përgjithësi, apo në drejtim të vënies në ekzekutim të tij. Prandaj, sipas pikëpamjes tonë, fillimi i afatit të parashkrimit të ekzekutimit të vendimit penal në ngarkim të të dënuarit Erion Borakaj, është koha e marrjes së tij formë të prerë, data 15.04.2008. [...] Në mbështetje të mendimit tone, vjen dhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr.7, datë 11.10.2002, ku theksohet: “...nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit (penal), për asnjë lloj shkak. Kjo vlen, si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu dhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim [...] dhe vuajtja e mëtejshme ndërpritet [...]”.

VI. Qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

A. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar se pyetja e parë dhe e dytë e shtruar për unifikim janë ngushtësisht të ndërlidhura mes tyre, vendosën t’i trajtojnë njëkohësisht. Pyetjet janë: Në mungesë të një përkufizimi juridik të parashikuar nga K.Pr.Penale, çdo të kuptojmë me shprehjen “vendim i formës së prerë? Në aspektin teorik referimi në terminologjinë “vendim i ekzekutueshëm”, “vendim i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar” duhen kuptuar si shprehje e të njëjtit nocion juridik, apo duhet kuptuar si koncepte të ndryshme nga njëra-tjetra?

17. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (“Kolegjet e Bashkuara” ose “Gjykata”) vërejnë se termi “formë e prerë” gjendet i përmendur dyzet e një herë³² në Kodin e Procedurës Penale. Ndonëse asnjë nga këto dispozita nuk jep një përkufizim të qartë se çfarë kuptohet me termin në fjalë, koncepti i formës së prerë në doktrinën juridike lidhet, në pamje të parë, me pandryshueshmërinë dhe forcën detyruese të një vendimi gjyqësor, çka është efekt i drejtpërdrejtë i parimit të sigurisë juridike. Natyrisht, një vendim gjyqësor, ashtu si çdo lloj vendimmarrje në të gjitha fushat, mund të jetë i gabueshëm. Për këtë arsye, ligjvënësi, për shkak të rëndësisë së të drejtave dhe lirive themelore të individëve në procesin penal (por edhe në atë civil apo administrativ) ka parashikuar mekanizma garancie, duke bërë të mundur kontrollin rishikues, si për themelin, ashtu edhe për ligjshmërinë e vendimit përfundimtar të gjykatave të shkallës së parë. Në këtë kuptim, kontrolli i vendimit penal nga një gjykatë më e lartë konsiderohet si pjesë e pandashme e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke ulur mundësinë e gabimeve dhe rritjen e “drejtësisë” së vendimit penal. Megjithatë, procesi gjyqësor nuk mund të vazhdojë pafundësisht, pasi kjo do të binte në kundërshtim me parime të tjera të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, siç është parimi i sigurisë juridike dhe ai i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Që këtu, del nevoja e gjetjes së një balance ndërmjet këtyre parimeve, duke pasur një sistem drejtësie jo vetëm cilësor, por edhe eficient.
18. Në analizimin e kuptimit të shprehjes “formë e prerë”, Kolegjet e Bashkuara gjykojnë se për sa i përket metodologjisë, përjasja më e drejtë do të ishte ajo që lidhet me efektet e “formës së prerë”, të cilat kanë të bëjnë me shterimin e mjeteve të zakonshme të ankimit ose kalimin e afateve për ushtrimin e tyre. Ky është edhe përkufizimi i zgjedhur jo vetëm në shumë

³² Respektivisht në nenet 4(1); 7(1); 21(2); 34(2); 70(1); 71(1); 71(2); 75/b(1); 103(3); 156(1)(b); 192(1); 193(2); 193(5); 217(3); 219(1); 224(1); 268(1); 268(2); 271(4); 273(1); 286(2); 328(2)(e); 343(1); 432; 435(1); 449(1); 450(1)(a); 453(3); 454(2); 459(3); 462(1); 462(3); 470(2); 477(2); 482(1)(a); 483(2)(b); 498(1); 499(1); 514(1)(a); 514(dh); dhe 515(3) (Përfshirë këtu edhe referime të “formës së prerë” në gjykimet civile apo administrative).

legjislacione të ngjashme me atë Shqiptar,³³ por edhe në marrëveshje ndërkombëtare në të cilat shteti Shqiptar është Palë. Kështu, në dhënien e një përkufizimi të “vendimit final” Raporti Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale (Raporti Shpjegues)³⁴ parashikon në lidhje me nenin 1 se:

Vendimi duhet të jetë final. Një vendim është final, nëse, sipas shprehjes tradicionale, ajo ka fituar fuqinë e *res judicata*. Ky është rasti kur vendimi është i përvokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë konsumuar këto të tilla ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa ushtruar ankim. [...]

19. Gjykata vëren se, ndonëse shprehja “gjë e gjykuar” është gjerësisht e përdorur në doktrinë-- dhe deri diku edhe në jurisprudencë -- kjo shprehje nuk gjendet askund në legjislacionin penal e procedural penal Shqiptar. Pyetja e parë që shtrohet, është nëse “gjë-ja e gjykuar” përkon me shprehjen “formë e prerë”, të gjendur në legjislacionin vendas. Për këtë, Gjykata do të bazohet në përkufizimin e mësipërm, për të përcaktuar dispozitat përkatëse në legjislacionin vendas që parashikojnë rastet e shterimit të mjeteve të zakonshme në dispozicion dhe kalimin e afatit pa ushtruar ankim.
20. Gjykata Kushtetuese ka pasur disa herë rastin të shprehet mbi parimin e “gjësë së gjykuar”. Sipas saj, ‘në aspektin formal e procedural, *gjë e gjykuar* nënkupton mosankueshmërinë e vendimit, përfshirë vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës,³⁵ ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit’.³⁶ Ndërkohë, në një vendim tjetër, Gjykata Kushtetuese ka lënë të kuptojë se “gjë e gjykuar” mund të përkojë me “formën e prerë”, duke u shprehur se:

Parimi i gjësë së gjykuar (*res judicata*) pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje e konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.³⁷

³³ Shtete të cilat e lidhin formën e prerë me shterimin e mjeteve të ankimit të zakonshëm janë: Italia (neni 648 i K.Pr.Penale); Greqia (neni 546 i K.Pr.Penale); Zvicra (neni 437 i K.Pr.Penale); Kosova (neni 485 i K.Pr.Penale); Maqedonia (neni 125 i K.Pr.Penale); Bullgaria (neni 412 i K.Pr.Penale); Bosnja (neni 178 i K.Pr.Penale); Mali i Zi (neni 220 i K.Pr.Penale); Serbia (neni 275 i K.Pr.Penale) Sllovenia (neni 129 i K.Pr.Penale); Estonia (neni 408 i K.Pr.Penale); etj.

³⁴ Raport Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjytimeve Penale, CETS No. 70, bërë në Hagë me datë 28.05.1970, ratifikuar me Ligjin nr.9068, datë 15.05.2003, “Për ratifikimin e “Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjytimeve Penale”. Cituar gjithashtu nga Raporti Shpjegues i Protokollit nr.7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

³⁵ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.24, datë 12.11.2008.

³⁶ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.29, datë 21.12.2006, faqe 10.

³⁷ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.2, datë 16.01.2013, para. 10.

21. Një element i rëndësishëm në lidhje me shterimin e mjeteve në dispozicion është vetë juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 131(f) të Kushtetutës, individët mund të investojnë Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, vetëm ‘pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave’. Mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave realizohen nga pushteti gjyqësor, i cili në bazë të nenit 135 të Kushtetutës, “ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj”. Pra, vetëm pasi çështja të jetë shqyrtuar (pa sukses) edhe nga Gjykata e Lartë (dhe ndonëse e limituar vetëm në shqyrtimin e shkeljeve ligjore e procedurale), mundet që individët të paraqesin ankesë para Gjykatës Kushtetuese.
22. Konfigurimi i pushtetit gjyqësor me tri shkallë hierarkike gjykatash është një garanci e shtuar kundër gabimeve gjyqësore. Për sa i përket detyrimeve ndërkombëtare, vlen të theksohet se KEDNj në Protokollin e Shtatë Shtesë të saj,³⁸ si dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (“Pakti”)³⁹ detyron çdo Shtet Palë që për sa i përket gjykimeve penale, të parashikojë në legjislacionin e brendshëm të paktën një shkallë rishikimi të vendimit penal nga një gjykatë më e lartë, me përjashtim të rasteve të veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore.⁴⁰ Në rastin e legjislacionit shqiptar, por edhe shumë legjislacioneve të huaja, kjo e drejtë e të pandehurit për të pasur vendimin e dënimit kundër tij të “kontrollohet” të paktën nga një gjykatë më e lartë është e garantuar akoma më tepër, duke u parashikuar jo vetëm rishqyrtimi në apel i themelit të çështjes, por edhe kontrolli i ligjshmërisë në Gjykatën e Lartë. Megjithatë, konstatimi i numrit të shkallëve të gjykimit nuk do të thotë automatikisht se vendimi i formës së prerë (në kuptimin e gjësë së gjykuar) është në shkallën më të lartë, pra në Gjykatën e Lartë. Për të arritur në këtë përfundim, Gjykata duhet më parë të analizojë nëse rekursi në Gjykatën e Lartë duhet konsideruar si mjet ankimi i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm.
23. Gjykata rikujton Vendimin Unifikues nr.3, datë 08.07.2013, në të cilin shprehej -- ndonëse tërthorazi -- se rekursi në Gjykatën e Lartë klasifikohet si mjet i zakonshëm ankimi. Duke shqyrtuar institutin e rishikimit, këto Kolegje shpreheshin se:

Rishikimi është mjet ankimi i jashtëzakonshëm dhe përjashtimor kundër një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë, i cili nuk mund të kundërshtohet nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit (apeli dhe rekursi). Në këto kushte, kur janë shteruar mjetet e zakonshme të ankimit, vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohet e mbyllur në bazë të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*).⁴¹

³⁸ *Supra*, në notën 3. Protokollin nr.7 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

³⁹ UNTS, vol. 999, p. 171, Miratuar me Ligjin nr.7580, datë 08.08.1991. Neni 14(5): Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale ka të drejtë të kërkojë që shpallja e tij fajtor dhe dënimi i tij të shqyrtohen nga një instancë gjyqësore më e lartë, në përputhje me ligjin.

⁴⁰ Neni 2. E drejta e apelit në çështjet penale:

1. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarinimin e fajësisë ose dënimin. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligj.

2. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen me ligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij.

⁴¹ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr.3, datë 08.07.2013, para. 24.

24. Gjykata i referohet edhe nenit 75/b të K.Pr.Penale, i cili parashikon se “Gjykata e Lartë shqyrton rekursin për shkelje të ligjit dhe kërkesat për rishikimin e vendimeve të formës së prerë”. Që këtu, kuptohet se ligjvënësi ka kërkuar të mbajë të ndarë institutin e rishikimit të vendimeve të formës së prerë, nga rekursi për shkelje të ligjit.
25. Rekursi në Gjykatën e Lartë rregullohet në Kreun III, Titulli VIII të K.Pr.Penale.⁴² Së pari, ndryshe nga kërkesa për rishikim, shkaqet e rekursit të listuara në nenin 432⁴³ të K.Pr.Penale lidhen ngushtësisht me vendimmarrjen e gjykatës së apelit, pra me kontrollin e zbatimit të drejtë të ligjit e të provave nga gjykatat e faktit. E kundërta ndodh me kërkesën për rishikim, ku objekt i shqyrtimit gjyqësor nga ana e Kolegjit të Gjykatës së Lartë është nëse vendimi i formës së prerë ka rezultuar i ‘padrejtë’ për shkaqe të jashtme, të panjohura për gjykatën në momentin e vendimmarrjes.⁴⁴ Së dyti, qëllimi i kërkesës për rishikim, është pikërisht *rihapja* e një procesi gjyqësor të mbyllur tashmë, ndërkohë që për sa i përket rekursit, qëllimi është prishja ose ndryshimi i vendimit të gjykatës së apelit. Së treti, rekursi është një mjet ankimi, pra një e drejtë në dispozicionin e palëve,⁴⁵ të cilët mund ta përdorin pa nevojën e verifikimit të një kushti *extra ordinem*. I vetmi kufizim i palëve në raport me ankimin në gjykatën e apelit ka të bëjë me administrimin e provave, ç’ka nuk është e mundur në Gjykatën e Lartë. Së katërti, ‘karakteri i jashtëzakonshëm i rishikimit si mjet ankimi del edhe nga fakti se ligjvënësi nuk e ka kufizuar brenda një afati kohor ndërkohë që mjetet e zakonshme të ankimit duhet të paraqiten brenda afateve strikte kohore me pasojë papranueshmërinë e tyre’.⁴⁶ Së fundmi, në rastin e rekursit, vendimmarrja e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (ose, sipas rastit, e Kolegjeve të Bashkuara), në krahasim me gjykata supreme analoge, është relativisht e gjerë, pasi në bazë të nenit 441 të K.Pr.Penale, përveç prishjes ose lënies në fuqi të vendimeve të gjykatave të faktit, mund edhe të vendosë edhe ndryshimin e vendimit për cilësimin ligjor të veprës, për llojin dhe masën e dënimit, për pasojat civile të veprës penale; si dhe prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim.
26. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet rikonformuar pohimi sipas të cilit rekursi në Gjykatën e Lartë përbën mjet të zakonshëm ankimi, shterimi i të cilit e kthen vendimin në formë të prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar”. Për efekt të marrjes së vendimit “gjë të gjykuar” në formën e shterimit të mjeteve të zakonshme të ankimit, Kolegjet e Bashkuara do të kuptojnë disponimin e Gjykatës së Lartë sipas neneve 433 ose 441 (1) (a), 441 (1) (b), 441 (1) (c), 441 (1) (d) të K.Pr.Penale.

⁴² Në lidhje me termin e përdorur në titullin e nenit 432 të K.Pr.Penale “Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë”, shih më poshtë, në analizën e pyetjes së tretë të shtruar për unifikim.

⁴³ Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:
 a) për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal;
 b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi;
 c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

⁴⁴ Rishikimi mund të kërkohet:
 a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;
 b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas
 c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;
 ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

⁴⁵ Ndryshe ka qenë rasti i “Rekursit në interes të ligjit”, i cili ka qenë një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, i shtuar me nenin 432/a të K.Pr.Penale (shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.55, datë 21.11.1997) në të cilin parashikohej e drejta vetëm e Prokurorit të Përgjithshëm (dhe jo e personit të akuzuar) për të kundërshtuar vendime të formës së prerë për interes të ligjit, brenda një afati prej 1 vit nga data e marrjes së vendimit formë të prerë.

⁴⁶ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr.3, datë 08.07.2013, para. 33.

27. Për sa i përket mënyrës tjetër të marrjes së vendimit formë të prerë (në kuptimin e gjësë së gjykuar) si pasojë e kalimit të afateve për të paraqitur ankim, është qartazi e kuptueshme se në rast se pala lejon kalimin e afateve strikte për të ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ose rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, (të parashikuar respektivisht në nenet 415(1) dhe 435(1) të K.Pr.Penale) atëherë vendimi përkatës do të marrë formën e prerë, në kuptimin e gjësë së gjykuar, duke përfunduar kështu në mënyrë definitive procesin.⁴⁷ Pra është më se logjike se nëse pala humbet afatin për të ushtruar ankim në gjykatën e apelit, ajo humbet çdo mundësi të mëtejshme për të kundërshtuar vendimin, përfshirë këtu rekursin në Gjykatën e Lartë.
28. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se arsyetimi i mësipërm rezulton në të njëjtën linjë edhe me interpretimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GjEDNj”). Në vendimet e saj GjEDNj-ja citon shprehimisht pjesët e lartpërmendura të Raportit Shpjegues⁴⁸ duke konfirmuar se një vendim merr statusin e gjësë së gjykuar (*res judicata*) nëse palët i kanë shteruar ankimet në rrugë të zakonshme; ose ii) kanë humbur afatet për të paraqitur ankim kundër vendimit të dënimit, duke marrë kështu vendimi formë të përvokueshme.⁴⁹
29. Më posaçërisht, në disa vendime kundër Shqipërisë, GjEDNj-ja ka vendosur shprehimisht se, edhe nëse vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, për sa kohë ekziston mundësia për ta apeluar në një gjykatë të një instance më të lartë siç është edhe Gjykata e Lartë, atëherë ai vendim [i gjykatë së apelit] nuk do të konsiderohet si *res judicata*. Kështu, në çështjen *Gjyli k. Shqipërisë*, GjEDNj-ja është shprehur se:

Ankuesi pranoi se rekursi ishte nën shqyrtim nga Gjykata e Lartë, por pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës ishte i ekzekutueshëm. Gjykata e Lartë nuk kishte pezulluar ekzekutimin sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen në fjalë, Gjykata vë re se vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës [...], i lënë në fuqi nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Durrësit [...], njihte të drejtën e ankuesit për pagimin e pagesave të tij [...]. Në përputhje me nenet 510(a) dhe 511(a) të Kodit të Procedurës Civile u lëshua një urdhër ekzekutimi. Ndërkohë, pala e paditur apeloj në Gjykatën e Lartë të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta [...].

Në këto rrethana, *Gjykata është e mendimit se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 Tetor 2006 nuk mund të konsiderohet përfundimtar dhe detyrues, pasi ai ishte i hapur për ankim*. Në fakt, procesi i apelit është nën shqyrtim para Gjykatës së Lartë. Edhe nëse një ankesë në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues automatik dhe, pavarësisht nga kompetencat e Gjykatës së Lartë sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata rikujton se neni 6 mbron zbatimin e vendimeve përfundimtare dhe detyruese, dhe jo vendimeve të cilat

⁴⁷ Përveç rasteve kur lejohet rivendosja në afat ose rishikimi i vendimit, ose rasti përjashtimor në të cilin ankimi i bërë nga një i bashkëpandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive ekskluzivisht personale, vlen edhe për të bashkëpandehurit e tjerë, dënimi i të cilëve ka marrë formën e prerë (*res judicata*). Sidoqoftë, shtrirja e apelit edhe për të bashkëpandehurin(it) që nuk kanë paraqitur ankim në apel në kohë është e kushtëzuar nga suksesi i ankimit të të bashkëpandehurit që ka paraqitur apelin në kohë. Të dy këto kushte (Motivi jo ekskluzivisht personal i ankimit dhe suksesi i tij) janë kumulative për prishjen e dënimit të formës së prerë të bashkëpandehurit joankimues.

⁴⁸ *Supra*, në notën 3.

⁴⁹ Shiko, ndër të tjera, GjEDNj, *Nikitin v. Ruisë*, Ap. nr.50178/99, Vendim, datë 20.07.2004, para. 37; GjEDNj, *Lucky Dev k. Suedisë*, Ap. nr.7356/10, Vendim, datë 27.11.2004, para. 56; GjEDNj, *Sergey Zolotukhin k. Ruisë*, Ap. nr.14939/03, Vendim, datë 10.02.2009, para. 107; GjEDNj, *Xheraj k. Shqipërisë*, Ap. nr.37959/02, Vendim, datë 29.07.2008, para. 70.

mund të jenë objekt i kontrollit të mëpasshëm të një gjykate të një niveli më të lartë, dhe, që eventualisht, mund të rrëzohen [...].

Duke pasur parasysh proceset nën shqyrtim në Gjykatën e Lartë, çka do të thotë që vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës nuk ka efekt *res judicata*, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është e pranueshme, pasi është e parakohshme dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.⁵⁰

30. Gjykata vlerëson se ky qëndrim i GjEDNj-së ka mbetur i pandryshuar dhe është pjesë e praktikës së konsoliduar të asaj gjykate në lidhje me përcaktimin e shprehjes “gjë e gjykuar”.⁵¹ Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë se shprehja “gjë e gjykuar” (*res judicata*) përkon me shprehjen “formë e prerë” e përdorur nga legjislacioni Shqiptar, për vendimet që marrin këtë status në rastet kur:
1. Gjykata e Lartë disponon sipas neneve 433 ose 441 (1) (a), 441 (1) (b), 441 (1) (c), 441 (1) (d) të K.Pr.Penale; ose
 2. Palët humbasin afatet e parashikuara në nenet 415(1) dhe 435(1) të K.Pr.Penale mbi paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit ose rekursit në Gjykatën e Lartë.
31. Gjykata më poshtë do të analizojë nëse shprehja “formë e prerë” e përdorur nga K.Pr.Penale përkon në mënyrë ekskluzive me shprehjen “gjë e gjykuar”, apo jo.
32. Që në fillim, Gjykata, konstaton se “forma e prerë” paraqitet në kuptim tjetër (ose më saktë jo në përputhje me konceptin e gjësë së gjykuar) në pjesë të tjera të Kodit të Procedurës Penale. Dispozita më autoritare në këtë vështrim është neni 432 i tij. Ky nen titullohet ‘Rekursi ushtrohet kundër vendimeve të formës së prerë’, dhe përcakton se rekursi në Gjykatën e Lartë bëhet kundër ‘vendimeve të gjykatës së apelit’. Megjithatë, siç u sqarua më lart, rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të ushtrohet kundër vendimeve që kanë marrë formën e prerë në kuptimin e gjësë së gjykuar. Gjithashtu, vetë neni 435 i K.Pr.Penale shprehet se ‘rekursi paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë’. Ndërkohë, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të dënimit, neni 462 parashikon se ‘Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë’.⁵² Nga interpretimi i këtyre dispozitave kuptohet qartë se shprehja “formë e prerë” e përdorur nuk përkon me konceptin e gjësë së gjykuar, por me ekzekutueshmërinë e vendimit. Në fakt, një vendim i pa ankimuar në gjykatën e apelit ka marrë formën e prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar”, ndërsa një vendim i gjykatës së apelit, kundër të cilit ushtrohet rekurs brenda afatit të 30 ditëve ka marrë formën e prerë në kuptimin e “ekzekutimit të tij”.
33. **Kjo “kontradiktë” në dukje e shprehjes “formë e prerë” lidhet, në kuptimin e Kolegjeve të Bashkuara, me vetë zgjedhjen e ligjvënësit, i cili ka parashikuar se një vendim dënimi mund të vihet në ekzekutim pa marrë ky i fundit domosdoshmërisht statusin e *res judicata*. Vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, por nuk përbën gjë të gjykuar. E thënë ndryshe, çdo vendim dënimi që është gjë e gjykuar është gjithnjë i ekzekutueshëm, por jo anasjelltas, pasi jo çdo vendim i ekzekutueshëm është gjë e gjykuar.**

⁵⁰ GjEDNj, *Gjyli k. Shqipërisë*, Ap. nr.32907/07, Vendim, datë 29.09.2009, paras 31-34.

⁵¹ Për vendimin më të afërt në lidhje me çështjen në fjalë, shih, GjEDNj, *Beçaj k. Shqipërisë*, Ap. nr.1542/13, Vendim mbi pranueshmërinë, datë 24.06.2014, paras 32-33.

⁵² Me përjashtim të vendimeve pafajësisë, të përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vendime këto që vihen në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së vendimit.

34. Një zgjedhje e tillë e ligjvënësit, (pra ndarja e koncepteve të ekzekutueshmërisë së vendimit dhe gjësë së gjykuar) është e njohur edhe në të drejtën ndërkombëtare. Pikërisht në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, Raporti Shpjegues i cituar më lart, shpjegon se:

Ky nen [neni 3 i Konventës] përmban dy kushte themelore [...] Një kusht është që sanksioni duhet të jetë i zbatueshëm (paragrafi 1). Sipas nenit 1, nën-paragrafi (a), gjykimi duhet të jetë final. Edhe pse në shumicën e rasteve një vendim është i ekzekutueshëm në qoftë se është edhe final, në disa raste paraqitja e një ankimi të jashtëzakonshëm mund të bllokojë ekzekutimin. Në anën tjetër, një vendim i ekzekutueshëm nuk është domosdoshmërisht final meqenëse apeli mund të mos rezultojë në pezullimin e tij. ***Prandaj, ekzekutueshmëria nuk mund të identifikohet plotësisht me të qenit final*** dhe për këtë arsye u konsiderua e domosdoshme që të përcaktohej karakteri i ekzekutueshëm i një vendimi si një kusht tjetër i ndarë nga të tjerët. Ky kusht nuk mund të paraqesë asnjë problem në praktikë, sepse ekziston një dispozitë e shprehur në nenin 16 që autoriteti kompetent i Shtetit kërkues të vërtetojë nëse vendimi është i ekzekutueshëm. Një vërtetim i tillë do të thotë se vendimi penal konsiderohet si i ekzekutueshëm në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shtetit kërkues, dhe gjithashtu se gjykata në shtetin e kërkuar nuk ka nevojë të bëjë ndonjë pyetje për këtë çështje.⁵³

35. Për sa më lart, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në qëndrimin unifikues se:

- Në legjislacionin procedural penal Shqiptar, me shprehjen “vendim i formës së prerë” do të kuptohet, sipas rastit, vendim që ka marrë formën e “gjësë së gjykuar”, ose “vendim i ekzekutueshëm”.
- Vendimi penal merr “formën e prerë” në kuptimin e “gjësë së gjykuar” kur:
 1. Gjykata e Lartë disponon sipas neneve 433 ose 441(1)(a), 441(1)(b), 441(1)(c), 441(1)(d) të K.Pr.Penale; ose
 2. Palët humbasin afatet e parashikuara në nenet 415(1) dhe 435(1) të K.Pr.Penale mbi paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit ose rekursit në Gjykatën e Lartë.
- Në çdo rast tjetër me shprehjen “formë e prerë” do të kuptojmë “vendimin e ekzekutueshëm” të gjykatave të apelit.

B. Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për unifikim: Si duhet kuptuar dhe interpretuar neni 432 i K.Pr.Penale, titulli “Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë” dhe përmbajtja e tij për efektet që lidhen me vënien në ekzekutim të vendimit penal?

36. Siç u sqarua në arsyetimin e mësipërm, vendimi i gjykatës së apelit, ndonëse nuk ka marrë ende statusin e “gjësë së gjykuar” është menjëherë i ekzekutueshëm. Kjo kuptohet edhe nga përmbajtja e nenit 417 të K.Pr.Penale (Pezullimi i ekzekutimit), i cili parashikon se “ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Në rastet e rekursit [...], vendimi mund të pezullohet me urdhër, [...], të Kryetarit të Gjykatës së Lartë [...]”.

⁵³ Neni 3 i Raportit Shpjegues, *supra* në notën 3.

37. Neni 432 i K.Pr.Penale parashikon se:

Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

- a) për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal;
 - b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi;
 - c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.
38. Nga analizimi i përmbajtjes së nenit 432 të K.Pr.Penale, rezulton se kontrolli rishikues i Gjykatës së Lartë lidhet me vendime të formës së prerë (në kuptimin e ekzekutueshmërisë) të gjykatave të apelit, të cilat mund të cenohen vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen të Kodit. Çdo vendim tjetër i cili ka marrë formën e prerë në kuptimin e gjësë së gjykuar, si pasojë e mosrespektimit të afateve për të ushtruar ankim në apel ose recurs në Gjykatën e Lartë nuk mundet në asnjë mënyrë të kundërshtohet me recurs në Gjykatën e Lartë, pasi në të kundërt do të shkelej jo vetëm neni 435 i K.Pr.Penale, por edhe vetë parimi i sigurisë juridike, në përbërje të të cilit janë parimet e *res judicata* dhe *ne bis in idem*.⁵⁴ Në dispozicion të palëve që kanë lejuar kalimin e afateve për të ushtruar ankim në gjykatën e apelit ose recurs në Gjykatën e Lartë, mbeten vetëm mjetet e jashtëzakonshme, që janë, sipas rastit, kërkesa për rishikim ose për rivendosje në afat.
39. Për sa i përket ekzekutueshmërisë së vendimeve objekt recursi në Gjykatën e Lartë, Kolegjet e Bashkuara i referohen arsyetimit të mësipërm, sipas të cilit ligjvënësi ka parashikuar se, ndonëse këto vendime nuk përbëjnë gjë të gjykuar (pasi janë kundërshtuar me recurs në Gjykatën e Lartë në përputhje me afatet ligjore), ato janë menjëherë të ekzekutueshme.
40. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në qëndrimin unifikues se:

- **Neni 432 i K.Pr.Penale, titulli “Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë” duhet kuptuar si Recurs kundër vendimeve që nuk kanë marrë statusin e gjësë së gjykuar, por janë menjëherë të ekzekutueshëm.**
- **Paraqitja e recursit në Gjykatën e Lartë nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit, përveç rasteve kur Kryetari i Gjykatës së Lartë vendos, me urdhër, në bazë të nenit 417(1) të K.Pr.Penale, pezullimin e vendimit të gjykatës së apelit.**

C. Në lidhje me pyetjen e katërt të shtruar për unifikim: Në rastin kur palët në procesin penal për pjesën e gjykimit që ka lidhje me fajësinë ushtrojnë ankim (recurs) në Gjykatë e Lartë, dhe kjo e fundit në bazë të nenit 441, paragrafi i parë, germa “c” i K.Pr.Penale e ndryshon vendimmarrjen për efekt të parashkrimit të dënimit, cili do të konsiderohet vendim i formës së prerë për efekt të llogaritjes së afatit kohor të parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal?

41. Për të kuptuar më mirë efektet e recursit në Gjykatën e Lartë, Kolegjet e Bashkuara e gjejnë me vend të ndalen në mundësitë e disponimit të Kolegjit Penal (ose Kolegjeve të Bashkuara) pas shqyrtimit të çështjes, në bazë të nenit 441 të K.Pr.Penale. Ndryshe nga shumë gjykata supreme analoge (përgjithësisht gjykata kasacioni), të cilat mund vetëm: 1) ta lënë në fuqi vendimin e ankimuar; ose 2) ta prishin atë duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në gjykatën më të ulët, në rastin e Shqipërisë, ligjvënësi i ka caktuar kompetenca të gjera Gjykatës së

⁵⁴ Mbi shkeljen e parimit të sigurisë juridike, shih, *Xheraj k. Shqipërisë*, i cituar më lart në notën 18.

Lartë. Sipas nenit 441 të K.Pr.Penale, Gjykata e Lartë mund jo vetëm të vendosë lënien në fuqi të vendimit ndaj të cilit është bërë rekurs, (ose prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë); prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim; por edhe ndryshimin e vendimit për cilësimin ligjor të veprës, për llojin dhe masën e dënimit, për pasojat civile të veprës penale; si dhe prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim.

42. Në rastin nën shqyrtim, pra kur Gjykata e Lartë disponon në bazë të nenit 441, paragrafi i parë, germa “b” i K.Pr.Penale, mund të ndodhë që masa e dënimit të caktuar nga Gjykata e Lartë të jetë e ndryshme, më e lartë ose më e ulët se dënimi i caktuar nga vendimi kundër të cilit është ushtruar rekurs. Me këtë vendimmarrje të Gjykatës së Lartë, shterohen mjetet e zakonshme të palëve për të kundërshtuar vendimin, duke u kthyer kështu vendimi i dënimit në gjë të gjykuar. Nëse gjatë shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë do të ketë filluar ekzekutimi i dënimit, atëherë natyrisht që vendimi i Gjykatës së Lartë do të mbahet parasysh në llogaritjen e vuajtjes së dënimit pasi vetëm ky vendim (i cili shteron mjetet e zakonshme të ankimit) përcakton në mënyrë përfundimtare masën e dënimit për personin e dënuar. I njëjti arsyetim vlen edhe nëse vendimi i gjykatës së apelit nuk është vënë ende në ekzekutim gjatë shqyrtimit apo dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë. Vetëm pasi të përcaktohet në mënyrë definitive se cila do të jetë masa e dënimit që duhet të vuhet nga i dënuari, do të bëhet e mundur edhe llogaritja e nisjes së afatit për efekt të parashkrimit të vendimit të dënimit.

43. Neni 68 i Kodit Penal (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit) parashikon se:

Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar:

a) pesë vjet për vendime që përmbajnë dënim me burgim gjer në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta.

b) dhjetë vjet për vendimin që përmban dënim pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim;

c) njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzetepesë vjet burgim;

44. Gjykata e vlerëson të ritheksojë se në analizë të nenit 68 të K.Penal, me rëndësi për të bërë të mundur llogaritjen e afatit të parashkrimit të dënimit, është përcaktimi i saktë i masës së dënimit, i cili përkon me marrjen vendimit të statusit të gjësë së gjykuar. Sipas legjislacionit shqiptar, vendimi i gjykatës së apelit (i cili është i ekzekutueshëm) nuk përbën gjë të gjykuar dhe si i tillë është i cenueshëm në Gjykatën e Lartë për shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale. **Për sa kohë që masa e dënimit me burgim e dhënë nga gjykata e apelit mund të ndryshohet nga Gjykata e Lartë në rastet kur disponon në bazë të nenit 441(1)(b) ose 441(1)(c) të K.Pr.Penale, nuk mundet që të kemi zbatim të nenit 68 të K.Penal, pasi shprehja “formë e prerë” e përdorur nga ky nen i K.Penal lidhet pandashmërisht me masën e dënimit e cila duhet të jetë përfundimtare dhe e pandryshueshme.** Natyrisht, kjo nuk do të thotë se prokurori duhet të presë deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal në bazë të nenit 462 të K.Pr.Penale. Përkundrazi, organi përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve penale ka detyrimin për të vënë në ekzekutim menjëherë vendimet e ekzekutueshme të gjykatave të apelit.

45. Gjithashtu, Gjykata vëren se përdorimi i shprehjes ‘nuk ekzekutohet nga dita që ka marrë formë të prerë [...] kanë kaluar [...]’ nga neni 68 i K.Penal nuk lidhet me nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit nga prokurori, por me momentin e fundit që ligji lejon “kapjen” fizike të të dënuarit për të bërë të mundur vuajtjen e dënimit që ka marrë formë të prerë në kuptimin e

gjësë së gjykuar, si pasojë e kalimit të afatit të paraqitjes së ankimit në apel, ose në rast rekursi në Gjykatën e Lartë, të disponimit nga kjo e fundit në bazë të neneve 433, 441(1)(a), 441(1)(b), 441(1)(c), ose 441(1)(d) të K.Pr.Penale.

46. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se shprehja ‘formë e prerë’ e përdorur nga neni 68 i K.Penal duhet të kuptohet në formën e “gjësë së gjykuar” dhe llogaritja e afateve për parashkrimin e vendimit të dënimit duhet filluar nga momenti që vendimi i dënimit të jetë kthyer në “gjë të gjykuar”.
47. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në qëndrimin unifikues se:
- **Në rastin kur Gjykata e Lartë vendos në bazë të nenit 441, paragrafi i parë, germa “c” i K.Pr.Penale duke ndryshuar vendimin kundër të cilit është bërë rekurs, vendimi i Gjykatës së Lartë do të jetë vendimi i cili do të merret për bazë për efekt të llogaritjes së afatit kohor të parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal.**

Ç. Në lidhje me pyetjen e pestë të shtruar për unifikim: Kur fillon llogaritja e afatit kohor të parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal në rastin kur Kolegji Penal disponon sipas nenit 441, paragrafi i parë, germa “d” i K.Pr.Penale duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë?

48. Siç u parashtrua më lart, me rëndësi për të bërë të mundur llogaritjen e afatit kohor të parashkrimit të dënimit, parashikuar nga neni 68 i K.Penal, ka përcaktimi i momentit kur vendimi ka marrë formën e prerë në kuptimin e gjësë së gjykuar. Vetë vendimi i dënimit i gjykatës së shkallës së parë nuk përbën formë të prerë as në kuptimin e ekzekutueshmërisë, dhe as në atë të gjësë së gjykuar.⁵⁵ Për më tepër, fakti se Gjykata e Lartë mund të vendosë për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk do të thotë se data e shpalljes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë duhet të marrë formën e gjësë së gjykuar në mënyrë prapavepruese në kohë. Kjo datë do të jetë veçse momenti në të cilën vendimi (në rastin konkret, i shkallës së parë) nuk do të jetë më i cenueshëm me mjete të zakonshme ankimi. Në të njëjtën logjikë, edhe kur Gjykata e Lartë vendos lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit në bazë të nenit 441(1)(a) të K.Pr.Penale, ose kur vendos mospranimin e rekursit në bazë të nenit 433 të K.Pr.Penale, përsëri data në të cilën vendimi do të marrë formë të prerë (në kuptimin e gjësë së gjykuar) do të jetë ajo në të cilën ka disponuar Gjykata e Lartë, pasi vetëm në atë moment mund të thuhet se janë shteruar të gjitha mjetet e zakonshme të ankimit.
49. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në qëndrimin unifikues se:
- **Llogaritja e afatit kohor të parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal në rastin kur Kolegji Penal disponon sipas nenit 441, paragrafi i parë, germa “d” i K.Pr.Penale duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë fillon nga vendimi i Gjykatës së Lartë.**

VII. Në lidhje me rekursin e të gjykuarit

⁵⁵ Përveç rastit kur ka kaluar afati për ushtrimin e ankimit në apel.

50. Nga aktet e dosjes rezulton se kërkuesi Erion Borakaj është deklaruar fajtor nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.11, datë 11.02.2008, për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim” për interes, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 78/2 e 25 të K.Penal, duke e dënuar atë me 21 vjet burgim, si dhe duke e deklaruar të pafajshëm për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 278/2 e 25 të K.Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.20, datë 15.04.2008. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-517(293), datë 26.03.2010, duke disponuar në bazë të nenit 441(1)(b) të K.Pr.Penale ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe përfundimisht *“Deklarimin fajtor të gjykuarit Erion Borakaj, për veprën penale të përkrahjes së autorit të krimit dhe në bazë të nenit 302/1 të K.Penal, dënimin e tij me 5 vjet burgim”*.
51. Në bazë të arsytimit të mësipërm, rezulton se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.00-2010-517(293), i datës 26.03.2010 është i formës së prerë në kuptimin e gjësë së gjykuar, dhe se nga data e shpalljes së tij do të fillojë ecja e afatit kohor të parashikuar nga neni 68 i K.Penal për efekt të parashkrimit të ekzekutimit të tij.
52. Rezulton gjithashtu, se në bazë të nenit 68(1)(a) të K.Penal, vendimi i dënimit i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.00-2010-517(293), i datës 26.03.2010, me të cilin është dënuar kërkuesi me 5 vjet burgim, nuk është parashkruar.
53. Për sa më sipër, vendimi nr.55, datë 30.12.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës së të dënuarit Erion Borakaj me objekt: *“parashkrimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit nr.20, datë 15.04.2008 të Gjykatës së apelit për Krime të Rënda”* duhet të lihet në fuqi.

VIII. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

54. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se vendimi nr.55, datë 30.12.2013 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është i bazuar në ligj, dhe si i tillë do të lihet në fuqi, me arsyetim të ndryshëm për sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441 (1) (a) të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N

Lënen në fuqi të vendimit nr.55, datë 30.12.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 03.11.2014

MENDIMI I PAKICËS

Ndryshe nga konkluzionet e arritura nga ana e shumicës në Vendimin Unifikues nr.02/2014, lidhur me çështjet e parashtruara për njehsimin e praktikës gjyqësore, gjyqtarët e mëposhtëm të mbetur në pakicë (“pakica”) nuk pajtohen me qëndrimin e arritur nga shumica për arsyet që vijojnë.

Modeli procedural penal në Republikën e Shqipërisë është i konceptuar në sistemin e bazuar në parimin sipas të cilit, vendimi i gjykatës së apelit është vendim i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, prandaj objekti i rekursit në Gjykatën e Lartë janë vetëm vendimet e formës së prerë. Shqyrtimi i çështjes përfundon me zhvillimin e gjykimit në apel dhe Gjykata e Lartë ka për objekt shqyrtimi, vendimet e formës së prerë. Çasti kur vendimi është i formës së prerë është pikërisht, data e shpalljes së vendimit të gjykatës së apelit, dhe nga kjo datë kur vendimi bëhet i objekt ekzekutimi nga ana e prokurorit, ndryshimet eventuale të vendimit të formës së prerë nga ana e Gjykatës së Lartë nuk lidhen me çastin, pra me datën kur vendimi duhet të bëhet i formës së prerë, por me ndryshimin e përmbajtjes së tij, dhe ky aspekt nuk është relevant sa i përket caktimit të momentit se kur duhet të fillojë të eci afati i parashkrimit të dënimit të dhënë me vendim gjyqësor.

Sipas konkluzionit të shumicës, Kodi i Procedurës Penale nuk e parashikon në mënyrë të shprehur konceptin se kur vendimi merr formë të prerë. Por kjo premisë, sipas mendimit të pakicës nuk është e mbështetur. Koncepti i gjësë së gjykuar nuk duhet të jetë i barasvlerëshëm me atë të formës së prerë. Koncepti i vendimit të formës së prerë dhe ai i llojeve të ankimit siç janë: apeli dhe rekursi janë të ndryshëm dhe nuk duhet të konfondohen me konceptin e ekzekutimit dhe afatin e fillimit të ekzekutimit të veprës penale, apo me afatin e parashkrimit të veprës penale.

Kështu, neni 417 i Kodit të Procedurës Penale me titull “Pezullimi i ekzekutimit” i cili parashikon se: *“Ekzekutimi i vendimit të ankimituar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Në rastet e rekursit ose të kërkesës për rishikim, vendimi mund të pezullohet me urdhër, përkatësisht, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së rrethit gjyqësor[...]”*, nga ku del qartë forma e prerë nuk jepet në Gjykatën e Lartë.

Edhe neni 432 i Kodit të Procedurës Penale po të interpretohet i lidhur ngushtë me mjaft dispozita të tjera, sikurse është neni 435 i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: *“Rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formë të prerë”*, do të thotë pa ekuivok që marrja e formës së prerë nuk është e lidhur me afatin e paraqitjes së rekursit apo me çastin deri kur duhet të shprehet Gjykata e Lartë.

Nga analiza dhe interpretimi sistematik që bën pakica arrin në konkluzionin se fryma e legjislacionit procedural penal, duke marrë parasysh dhe atë procedural civil, parashikon se vendimi penal i apelit është i formës së prerë, duke u bërë i ekzekutueshëm menjëherë, për pasojë, objekt rekursi janë vendimet e formës së prerë.

Forma e prerë e një vendimi gjyqësor nuk jepet me mbarimin e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë apo me mbarimin e afatit ligjor të parashikuar për ushtrimin e rekursit.

Në nenin 417 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet vetëm pezullimi i vendimit me paraqitjen e ankimit të apelit, pra zbatohet efekti pezullues i vendimit të shkallës së parë, por e njëjta gjë nuk mund të thuhet në rastin e ushtrimit të rekursit. Fakt ky që nënkupton se vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe menjëherë i ekzekutueshëm, përveç rasteve kur me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Lartë mund të pezullohet.

Në këto kushte, pakica vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit, pas përfundimit të gjykimit në këtë shkallë gjykimit, duke filluar kjo datë nga ajo e shpalljes së vendimit për palën që është e pranishme, apo nga data e njoftimit të tij, është vendim i formës së prerë, dhe menjëherë i ekzekutueshëm.

Pakica vlerëson se në nenin 263 të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, këto afate i referohen vetëm kohëzgjatjes së paraburgimit sa i takon gjykimin në shkallë të parë dhe gjykimi në apel, pra duke e konsideruar rekursin që ka për objekt vendimin e formës së prerë, pikërisht, vendimin e gjykatës së apelit.

Në vendimin e saj shumica e anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka arritur në konkluzionin, sipas mendimit tonë, të pambështetur, duke shpërbashkuar konceptin dhe cilësimin e ‘formës së prerë’ nga cilësimi dhe koncepti i gjendjes së ‘gjësë së gjykuar’.

Instituti juridik i gjësë së gjykuar, i njohur ndryshe si parimi *ne bis in idem*, ngërthen në vetvete dimensionin kushtetues dhe konventor, nga njëra anë, dhe atë ligjor procedural dhe material, nga ana tjetër. Dimensionin kushtetues dhe konventor i institutit të *res judicata* lidhet drejtpërdrejt me parimin e sigurisë juridike në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të çdo subjekti të së drejtës, i cili, mes të tjerash, kërkon që aty ku gjykatat janë shprehur përfundimisht në lidhje me një çështje të caktuar, vendimi i tyre nuk duhet të diskutohet apo të vihet në dyshim.

Në vendimin e saj shumica e anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka arritur në konkluzionin, sipas mendimit tonë, të pambështetur, duke shpërbashkuar konceptin dhe cilësimin e ‘formës së prerë’ nga cilësimi dhe koncepti i gjendjes së ‘gjësë së gjykuar’.

Në interpretimin e ndjekur nga shumica, cilësimi i termit ‘formë e prerë’ zëvendësohet me cilësimin e termit të “ekzekutueshmërisë”, pra, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së apelit si një vendim të ekzekutueshëm. Në bazë të këtij interpretimi, të gjitha vendimet e gjykatës së apelit janë vendime të ekzekutueshme, dhe jo të formës së prerë. Por, pakica është e mendimit se ekzekutueshmëria dhe efektet e saj nuk janë të lidhur me përcaktimin e kuptimit të formës së prerë në domethënien e saj si gjë e gjykuar.

Pakica vlerëson të vërë në dukje faktin se Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.140, datë 03.07.2014, ka vendosur se gjykata referuese i ka orientuar argumentet e saj më tepër drejt çështjes së modelit ligjor të përzgjedhur nga sistemi shqiptar mbi konceptin “vendim i formës së prerë”, se sa si probleme antikushtetueshmërie të dispozitave të kundërshtuara, duke konkluduar për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Si përfundim pakica mban qëndrimin se çështjet e parashtruara për unifikim i kapërcen mundësitë e këtyre Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nuk mund të konsiderohet vetëm problem interpretimi juridik i një dispozite, por në thelb, çështja duhet të konsiderohet një tagër i ligjvënësit.

Për sa më sipër, ndryshe nga qëndrimi i shumicës, pakica shpreh mendimin se rekursi i gjykuarit Borakaj duhet të ishte pranuar në themel, duke qenë se vendimi nr.55, datë 30.12.2013, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është marrë në kundërshtim me ligjin.

Arjana Fullani

Aleksandër Muskaj

Artan Zeneli

Artan Broci

Nr. 1/4 Regj.Themeltar
Nr. 1 Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Artan Broci	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar

në seancën gjyqësore publike të datës 10.03.2014, mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

KËRKUES: PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
SHKODËR
I GJYKUAR: ERVIS NURKAJ

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprës penale të
“Falsifikimit të dokumenteve”,
parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr.36, datë 29.01.2009 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ervis Aqif Nurkaj, për veprën penale
“Falsifikim dokumenti”, parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me
2 (dy) muaj burgim dhe 200.000 (dyqind mijë) lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.228, datë 18.09.2009 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit të bërë nga i pandehuri Ervis Nurkaj, kundër
vendimit nr.36, datë 29.01.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Kundër vendimit nr.228, datë 18.09.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka paraqitur
rekurs, në datë 13.10.2009 i gjykuari Ervis, nëpërmjet av. Ilir Kuka, i cili kërkon:

Prishjen e vendimit nr.228, datë 18.09.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Gjykata në dhënien e vendimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 420 të K.Pr.Penale. Arsyetimi se nuk legjitimohet mbrojtësi për të bërë ankim nuk qëndron, pasi mbrojtësi ka qenë i pajisur me prokurë nga ana e familjarëve të të gjykuarit.
- Në gjykimet e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër mbrojtësi i caktuar nga gjykata jo vetëm ka bërë një mbrojtje formale, pra nuk ka mbrojtur në mënyrë profesionale interesat e të pandehurit, por nuk ka bërë as ankim ndaj vendimit të gjykatës.
- Mungojnë elementët objektivë dhe subjektivë të veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve”, sepse i gjykuari Ervis Nurkaj nuk ka pasur dijeni të falsitetit të dokumentacionit dhe as nuk e ka përdorur këtë dokumentacion, pasi aplikimi pranë Konsullatës Italiane nuk është bërë nga ky shtetas.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarëve Aleksandër Muskaj dhe Guxim Zenelaj; prokurorin Artur Selmani, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr.228, datë 18.09.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër; në mungesë të mbrojtësit të të gjykuarit; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e çështjes

1. I gjykuari Ervis Nurkaj është banor i qytetit të Shkodrës. Ai ka aplikuar për vizë pranë Konsullatës Italiane në Shkodër. Në praktikën e paraqitjes së dokumenteve për pajisjen me vizë ka qenë edhe një vërtetim i datës 02.04.2008, në të cilin pasqyrohet se i gjykuari Ervis Nurkaj punon infermier në Spitalin Rajonal Lezhë.
2. Në datën 30.07.2008, Konsullata Italiane në Shkodër, ka kallëzuar në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, për ndjekje penale, ndër disa shtetas edhe të gjykuarin Ervis Nurkaj. Sipas këtij kallëzimi, nga i gjykuari Ervis Nurkaj është paraqitur një vërtetim pune i rremë, për të siguruar vizë italiane. Sipas akteve të procedimit penal nr.976, viti 2008 të Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se është lëshuar një vërtetim i datës 02.04.2008, në të cilin pasqyrohet se i gjykuari Ervis Nurkaj punon infermier në Spitalin Rajonal Lezhë. Vërtetimi është lëshuar në emër të Drejtorit Sokol Vata dhe ekonomistes së pagave, shtetases Nazmie Halili.
3. Organi i akuzës ka pretenduar se përmbajtja e këtij vërtetimi është e rreme. Sipas Akt-ekspertimit tekniko-grafik nr.6936, datë 14.10.2008 falsifikimi qëndron në faktin që *nënshkrimet e hedhura në emër të Sokol Vatës dhe Nazmije Halilit nuk janë origjinale të tyre*. Këtë fakt e konfirmojnë edhe vetë këta dy persona, bashkë me faktin që i gjykuari nuk ka qenë asnjëherë punonjës i Spitalit Rajonal Lezhë. Sipas akt-ekspertimit përkatës, “shenjat e vulës” së vënë në këtë vërtetim, nuk janë përfutur me bojë të njomë, por nëpërmjet mbartjes-printimit (skanimit) apo fotokopjimit me ngjyra.
4. Mbi bazën e këtyre të dhënave, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka filluar procedimin penal nr.349, datë 24.10.2008, procedim i cili i është kaluar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
5. Nga aktet rezulton se, hetimi i çështjes është bërë në mungesë të të gjykuarit Ervis Nurkaj dhe organi i akuzës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka caktuar mbrojtës kryesisht në përputhje me rregullimin ligjor të parashikuar në nenin 49 të K.Pr.Penale.
6. Pasi ka përfunduar hetimin e çështjes, organi i akuzës i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit (të

gjykuarit) Ervis Nurkaj, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal.

7. I gjykuari Ervis Nurkaj është gjykuar në mungesë, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në seancën e datës 29.01.2009 ka deklaruar mosgjettjen e të pandehurit dhe vazhdimin e gjykimit në mungesë të tij, duke i caktuar mbrojtës kryesisht, (po atë mbrojtës që e përfaqësonte edhe në hetimet paraprake).
8. Pas përfundimit të procesit në gjykatën e shkallës së parë, familjarët e të gjykuarit (babai i të gjykuarit) ka hartuar prokurën e posaçme nr.368 rep; nr.220 kol, datë 27.02.2009 ku emëron përfaqësues të të gjykuarit av. Ilir Kuka, i cili paraqet ankimin përpara gjykatës së apelit, ankimi i cili nuk është pranuar, si i bërë nga person i palegjitimuar.

II. Procedurat gjyqësore

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr.36, datë 29.01.2009 ka vendosur:
 - v. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ervis Aqif Nurkaj, për veprën penale të “Falsifikim dokumenti” parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) muaj burgim dhe 200.000 (dyqind mijë) lekë gjobë.
10. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.228, datë 18.09.2009 ka vendosur:
 - iv. Mospranimin e ankimit të bërë nga i pandehuri Ervis Nurkaj kundër vendimit nr.36, datë 29.01.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

III. Arsytimi ligjor i vendimit të ankimuar

11. Gjykata e Apelit Shkodër, midis të tjerave, arsyeton: *“Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka bërë ankimi av. Ilir Kuka, ku në fund të ankimit është shënimi: përfaqësues me prokurë. Nga shqyrtimi i akteve rezulton se në dosje nuk ka prokurë nga i pandehuri Ervis Nurkaj, për të bërë ankimi në shkallë të dytë. Ndodhur në këto kushte çështja, nga prokurorja e seancës u kërkua mospranimi i ankimit, pasi nuk janë respektuar kriteret ligjore të parashikuara nga neni 410/2 i K.Pr.Penale, për bërjen e ankimit nga mbrojtësi, pasi në këtë rast ai nuk është person i legjitimuar për të bërë ankimi kundër vendimit ... në nenin 420, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se ankimi nuk pranohet kur është bërë nga personi që nuk legjitimohet. Në zbatim të dispozitës së mësipërme, Gjykata e Apelit Shkodër çmon se ankimi i paraqitur nga ana e të pandehurit nuk duhet të pranohet ...”.*

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se në lidhje me përfaqësimin e të gjykuarve në mungesë si dhe me të drejtën e mbrojtësve të caktuar kryesisht nga organi procedues apo nga të afërmit e të pandehurve për të bërë ankimi, ka pasur një sërë praktikash të ndryshme si nga ana e Gjykatës së Lartë, ashtu edhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur të kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

IV. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara:

12. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore vlerësohen të jenë:
 - a. *Në kuptim të nenit 48/3 të K.Pr.Penale, në cilat raste një i afërm i të pandehurit mund të zgjedhë mbrojtës?*

b. Në vështrim të përcaktimit ligjor të bërë nga ligjvënësi në nenin 50 pika 1 e 410 të K.Pr.Penale, a është e drejta për të bërë ankim, një e drejtë e cila i rezervohet personalisht të pandehurit?

c. A mundet i pandehuri ta delegojë të drejtën për të bërë ankim tek mbrojtësi apo tek një person tjetër? Nëse po, cilat janë mënyrat dhe forma e përcaktuar nga ligji për këtë delegim?

d. A legjitimohet mbrojtësi i caktuar nga gjykata, apo i zgjedhur nga një i afërm i të pandehurit, i cili është gjykuar në mungesë, sipas përcaktimit të bërë nga ligjvënësi në pikën 3 të nenit 48 të K.Pr.Penale, të bëjë ankim kundër vendimit të dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë?

13. Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me çështjet që duhet të unifikohen për efekt të njësimi të praktikës dhe të pasojës që ka në lidhje me zgjidhjen e çështjes ishte si më poshtë:

v. Prokurori në lidhje me çështjen e parë mbajti qëndrimin se: “Do të përbëjë shkak për pavlefshmëri absolute të aktit procedural ku mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit ka marrë pjesë, si në rastet kur nuk respektohet vullneti i të pandehurit për zgjedhjen e mbrojtësit, ashtu edhe kur konstatohet se zgjedhja nuk është deklaruar përpara organit procedues ose nuk është bërë me akt të shkruar personalisht nga i afërmi që bën zgjedhjen dhe depozituar pranë mbrojtësit. Po kështu, kjo pavlefshmëri shtrihet edhe mbi aktet e mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit kur kjo zgjedhje është bërë jashtë periudhës kur i pandehuri fizikisht është duke ekzekutuar masën e ndalimit, arrestimit apo burgimit”.

vi. Në lidhje me çështjen e dytë: “nisur nga interpretimi i nenit 50 të K.Pr.Penale si dhe nga elementët me karakter formal, mendojmë se në të drejtat që i rezervohen personalisht të pandehurit përfshihen të drejta të tilla si paraqitja e kërkesës për gjykim të shkurtuar, kërkesa për transferimin e çështjes në një gjykatë tjetër për motive sigurie publike dhe, pa dyshim, mes këtyre të drejtave hyn edhe e drejta e të pandehurit për të ushtruar ankim siç përcakton edhe neni 410 i K.Pr.Penale”.

vii. Në lidhje me çështjen e tretë: “lidhur me formën e delegimit të së drejtës së ankimit tek mbrojtësi mendojmë se kjo formë duhet të jetë ajo që përcakton neni 109 i K.Pr.Penale për rastet kur ky akt lejohet të bëhet edhe përmes përfaqësuesit të posaçëm. Ashtu siç përcaktohet edhe në këtë nen kërkohet në çdo rast që delegimi i së drejtës së ankimit të bëhet me akt noterial, ose me shkresë të vërtetuar nga organet kompetente. Po kështu kërkohet që prokura të pasqyrojë edhe objektin e saj së bashku me faktet që lidhen me këtë objekt. Kjo formë delegimi është e detyrueshme vetëm kur e drejta e ankimit ka cilësinë e së drejtës që i rezervohet personalisht të pandehurit dhe jo edhe kur ajo trajtohet si një e drejtë që i takon edhe mbrojtësit, siç është rasti i të pandehurve që kanë qenë të pranishëm në gjykim. Lidhur me subjektin ku depozitohet ky akt delegimi mendojmë se, edhe pse në nenin 109 të K.Pr.Penale nuk thuhet hapur, është lënë të kuptohet gjithsesi se ai depozitohet pranë organit procedues. Kjo del indirekt nga parashikimi i mundësisë për të vendosur mospranimin e aktit të prokurës kur nuk është respektuar forma e kërkuar nga kjo dispozitë, mospranim i cili normalisht është kompetencë vendimmarrës e organit procedues. Me organ procedues në këtë rast do të kuptojmë atë organ i cili është i ngarkuar me shqyrtimin e ankimit të ushtruar nga i pandehuri dhe jo organi që Kodi parashikon si organi ku depozitohet ankimi”.

viii. Në lidhje me pyetjen e katërt: “pavarësisht nëse mbrojtësi është i caktuar apo i zgjedhur, dhe pavarësisht nëse është i zgjedhur nga i pandehuri apo të afërmit e tij, në të gjitha rastet kur i pandehuri është gjykuar në mungesë, e drejta e ankimit shndërrohet në një të drejtë e cila i rezervohet personalisht të pandehurit dhe si e tillë mund të ushtrohet vetëm me autorizimin e posaçëm dhe të dokumentuar të vetë të pandehurit. Kjo do të thotë se në rastet e një gjykimi në mungesë mbrojtësi, si ai i zgjedhur nga i pandehuri apo familjarët e tij, nuk legjitimohet të ushtrojë ankim nëse në favor të tij pranë organit procedues nuk është depozituar një akt

përfaqësimi që ia delegon posaçërisht atij të drejtën për të ushtruar ankim. Delegimi i së drejtës së ankimit është i vlefshëm vetëm për atë procedim penal dhe atë shkallë gjykimi që përcaktohet shprehimisht në aktin e delegimit. Delegimi i të drejtës së ankimit pa përcaktuar shkallën e gjykimit dhe procedimin penal përkatës mendojmë se duhet konsideruar si një akt absolutisht i pavlefshëm, i cili nuk e legjitimon mbrojtësin të ushtrorë të drejtën e ankimit në emër dhe për llogari të të pandehurit”.

V. Qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

A. Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për unifikim:

14. Paraprakisht, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (më poshtë të cituara “Kolegjet e Bashkuara” ose “Gjykata”) ritheksojnë se e drejta e mbrojtjes, në kuptimin thelbësor të saj, është një e drejtë themelore me karakter kushtetues e cila i përket ekskluzivisht të pandehurit dhe nuk mund të transferohet tek të afërmit.⁵⁶
15. Figura e mbrojtësit në procesin penal është e natyrës teknike. Ajo ushtrohet nëpërmjet dhënies së ndihmës juridike për të mbrojturin dhe përfaqësimit të tij në gjykim. Në funksion të autoritetit që jep tagrin e përfaqësimit, legjislacioni ynë procedural penal njeh dy lloje mbrojtësish, përkatësisht: i) atë të zgjedhur nga i pandehuri (neni 48 i K.Pr.Penale), dhe ii) mbrojtësin e caktuar nga organi që procedon, në rast se i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, ose ka mbetur pa të, dhe gjithnjë nëse e kërkon një të tillë (neni 49 i K.Pr.Penale).
16. Mbrojtësi me marrjen e tagrave ka të drejtat (procedurale) që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit. Për sa i përket të drejtave dhe garancive procedurale në aspektin teknik si subjekt procedural, ligji nuk bën dallime midis këtyre dy kategori mbrojtësish. Edhe pse në krahasim me mbrojtësin e zgjedhur, në rastin e mbrojtësit të caktuar kryesisht mungon raporti i besimit ndërmjet tij dhe të mbrojturit prej tij, përgjegjësia profesionale dhe etike për mbrojtjen e interesave dhe dhënien e një ndihme juridike sa më cilësore, mbetet e njëjtë për të dy këto kategori mbrojtësish.
17. Në dhënien përgjigje pyetjeve të shtruara, Gjykata do të bazohet, në radhë të parë, në tekstin e ligjit (interpretimi tekstual), dhe më pas në kontekstin (interpretimi sistematik), dhe qëllimin e tij (interpretimi teleologjik).
18. Pika 3 e nenit 48 të K.Pr.Penale, parashikon se “Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij (...)”. Nga formulimi i kësaj dispozite rezulton se i afërmi është i kufizuar për të zgjedhur mbrojtës në dy drejtime: *ratione personae*, dhe *ratione temporis*.
19. Në aspektin *ratione personae*, i afërmi lejohet për të zgjedhur mbrojtës vetëm për personin (1) e ndaluar, (2) të arrestuar ose (3) të dënuar me burgim. Në lidhje me dy mundësitë e para, kuptohet lehtësisht se personi ndodhet në kushtet fizike të kufizimit të lirisë personale. Ndërkohë, për sa i përket mundësisë së tretë të parashikuar nga neni 48 (3) i K.Pr.Penale -- *në lidhje me personin e dënuar me burgim* -- nisur nga parashikimi në legjislacionin tonë procedural penal të institutit të gjykimit në mungesë⁵⁷ mund të paraqiten dy situata të ndryshme faktike.
20. Personi i dënuar me burgim mund të jetë në kushtet e vuajtjes së dënimit me burgim në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale. Në këtë rast, statusi i tij *in vinculis* përkon me

⁵⁶ Kolegjet e Bashkuara, vendim nr.1, datë 20.01.2011, faqe 7; Gjykata Kushtetuese, vendim nr.30, datë 17.06.2010, faqe 15-16.

⁵⁷ Për rastet e gjykimit në mungesë, shih, *infra*, paras 32-35 të këtij vendimi.

situatën e personit të ndaluar ose të arrestuar. Element i përbashkët në të tre këto raste ka të bëjë padyshim me gjendjen e personit në kushtet e kufizimit të lirisë personale.

21. Një situatë tjetër mund të rezultojë në rastin e gjykimeve në mungesë. Në këtë kuptim, mundet që vendimi i dënimit me burgim të jetë dhënë në mungesë dhe ekzekutimi i vuajtjes së tij të mos jetë kryer ende. A legjitimohet i afërmi të zgjedhë mbrojtës për personin e dënuar me burgim edhe nëse vendimi për këtë të fundit është dhënë në mungesë? Po ashtu, a mundet që i afërmi të zgjedhë mbrojtës për personin i cili gjykohet në mungesë, por që nuk ka marrë njoftim efektiv për akuzat kundër tij? Para se t'i japë përgjigje kësaj pyetjeje, Gjykata do të përqëndrohet në trajtimin e qëllimit të nenit 48 (3) të K.Pr.Penale.
22. E drejta për të zgjedhur mbrojtës, në funksion të nenit 31 (1) (ç) të Kushtetutës⁵⁸ dhe nenit 6 (3) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNj” ose “Konventa”)⁵⁹ është një e drejtë ekskluzivisht personale, që nuk mund t'i transferohet të afërmeve të të pandehurit. Edhe vetë mundësia e limituar, e dhënë të afërmeve për të zgjedhur mbrojtës, parashikuar nga neni 48 i K.Pr.Penale, buron dhe është pjesë përbërëse e kësaj të drejte vetjake e të pandehurit. Në këtë përfundim arrihet jo vetëm duke u bazuar në konfigurimin e kësaj dispozite si pjesë përbërëse e nenit 48 të K.Pr.Penale, titulluar “Mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri”, por edhe nga qëllimi i vetë normës në fjalë, i cili ka të bëjë me përmirësimin dhe fuqizimin e efektivitetit të institutit të mbrojtësit të zgjedhur.
23. Mundësia e parashikuar nga ligjvënësi për të lejuar të afërmit e personit të ndaluar, të arrestuar apo të dënuar me burgim për të zgjedhur mbrojtës, ka ardhur si rrjedhojë e nevojës për të siguruar ndihmën juridike për të pandehurin që në momentet e para të procedimit penal. Është e kuptueshme se personat të cilët gjenden të izoluar, në kushtet e kufizimit të lirisë personale, e kanë mjaft të vështirë për të kërkuar dhe zgjedhur një mbrojtës të cilit t'i besojnë përfaqësimin dhe strategjinë mbrojtëse gjatë procedimit penal që zhvillohet kundër tyre. Për më tepër, mundësia e zgjedhjes nga ana e të afërmeve tenton të shmangë mundësinë e “sugjerimit” të emrave të mbrojtësve brenda strukturave të burgimit dhe/ose paraburgimit. Nga ana tjetër, të afërmit e të pandehurit, duke qenë “jashtë”, e kanë më të lehtë për të bërë një kërkim të gjithanshëm e të plotë me qëllim zgjedhjen e mbrojtësit që ata besojnë se do t'i japë ndihmën e duhur të afërmit të tyre. Përkundrazi, për sa i përket të pandehurit në gjendje të lirë, të ikur, apo i cili nuk gjendet, kjo nevojë për të “kërkuar” dhe zgjedhur mbrojtësin, mund të realizohet personalisht, pa nevojën e të afërmeve.
24. Në aspektin *ratione temporis*, i afërmi lejohet për të zgjedhur mbrojtës “derisa ky person [titullari i së drejtës] nuk e ka bërë vetë zgjedhjen”. Pra, dispozita lë të kuptojë që kjo zgjedhje nga ana e të afërmit duhet të jetë e kufizuar në kohë, dhe me karakter të përkohshëm. Ndonëse ligjvënësi nuk ka përcaktuar ndonjë afat të caktuar përtej të cilit i afërmi i të pandehurit humbet mundësinë për të zgjedhur mbrojtës, ajo çfarë del nga qëllimi i dispozitës, por edhe nga përdorimi i termit “derisa”, është parashikimi se zgjedhja e mbrojtësit nga vetë i pandehuri do të ndodhë në një moment të caktuar kohor të procedimit penal, në të cilin ky i fundit do të vendosë të zgjedhë një mbrojtës tjetër, ose të pranojë vazhdimin e mbrojtjes nga i njëjti mbrojtës i zgjedhur më parë nga të afërmit e tij. Pranimi, në të kundërt, i mundësisë së zgjatjes së tagrave të mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit për të gjithë kohëzgjatjen e procesit penal, pa pasur vetë i pandehuri mundësinë për të bërë zgjedhjen e tij, do të përkthehej padyshim në një shkelje të së drejtës së mbrojtjes dhe procesit të rregullt ligjor.

⁵⁸ Neni 31(ç) i Kushtetutës shprehet se: ‘Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: (...) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor **të zgjedhur prej tij**’.

⁵⁹ Neni 6(3) i KEDNj-së parashikon se: ‘Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: (...) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës **i zgjedhur prej tij**, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë’.

25. Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se përcaktimi i ligjit se i afërmi i të pandehurit ka të drejtë të zgjedhë mbrojtës, në kuptim të pikës 3 të nenit 48 të K.Pr.Penale, vetëm në rastet kur i pandehuri gjendet i izoluar, në kushtet e kufizimit të lirisë personale është i qartë dhe nuk ka nevojë për interpretim unifikues. Në këtë rast, mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e personit në kushtet e kufizimit të lirisë personale, do të konsiderohet, për efekt të ligjit, si mbrojtës i zgjedhur.

26. Gjykata tashmë do të kthehet në trajtimin e rastit të të gjykuarit në mungesë si një situatë komplekse në kuadër të procesit të rregullt ligjor referuar të drejtës bazë që ka çdo person për t'u dëgjuar në një proces penal që zhvillohet kundër tij.

27. Kushtetuta, KEDNJ-ja por edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ("Pakti")⁶⁰ në parim nuk i ndalojnë *a priori* gjykimet në mungesë. GjEDNJ-ja ka pasur shpesh rastin të shprehet se:

Edhe pse gjykimet e zhvilluara pa praninë e të pandehurit nuk janë në vetvete në mospërputhje me Nenin 6 të Konventës, padyshim do të konsiderohej një mohim i drejtësisë nëse një person i gjykuar në mungesë nuk do ishte në gjendje të kërkonte nga gjykata një rivlerësim të themelit të akuzave, në rastet kur nuk provohet se ai ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur, ose i është fshehur gjykimet (...).⁶¹

28. Në lidhje me heqjen dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim, GjEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin sipas të cilit:

As shkronja dhe as fryma e Nenit 6 nuk e ndalojnë një person për të hequr dorë, vullnetarisht, në mënyrë direkte ose të tërthortë, nga garancitë e një gjykimi të drejtë. Megjithatë, në mënyrë për të qenë efektive në kuptimin e Konventës, heqja dorë e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim duhet të provohet në një mënyrë eksplicite dhe të shoqërohet nga standarde minimale në përpjesëtim me rëndësinë e saj (...). Për më tepër, nuk duhet të dalë kundër ndonjë interesi publik të rëndësishëm (...).⁶²

29. Në lidhje me fshehjen nga gjykimi, GjEDNJ-ja thekson se thjesht fakti se i pandehuri nuk gjendet, nuk shërben për t'ia shkarkuar barrën autoriteteve shtetërore për të bërë të mundur njoftimin efektiv të akuzës të pandehurit. Pra, në veçanti për të pandehurin që nuk gjendet, nuk mund të prezumohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim. Në këtë kuptim, GjEDNJ-ja thekson se:

[K]ur një person i akuzuar për një vepër penale nuk është njoftuar personalisht, nuk mund të prezumohet thjesht nga statusi i tij si i "ikur", e cila bazohet në një prezumim në vetvete, të pabazuar mjaftueshëm në fakte, që i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur (...). [GjEDNJ-ja] Ka pasur gjithashtu rastin të theksojë se, para se të pranohet se i pandehuri, nëpërmjet sjelljes së tij, ka hequr dorë në mënyrë

⁶⁰ United Nations, Treaty Series, vol. 999, p. 171, Miratuar me Ligjin nr.7580, datë 08.08.1991.

⁶¹ *Sejdovic k. Italisë*, Ap. nr.56581/00, GjEDNJ, [DHM], 01.03.2006, parag. 82 (duke cituar *Colozza k. Italisë*, Ap. nr.9024/80, GjEDNJ, 12.02.1985, parag. 29; *Einhorn k. Francës*, Ap. nr.71555/01, GjEDNJ, 16.10.2001, parag. 33; *Krombach k. Francës*, Ap. nr.29731/96, GjEDNJ, 13.02.2001, parag. 85; *Somogyi k. Italisë*, Ap. nr.67972/01, GjEDNJ, 18.05.2004, parag. 66; si dhe *Medecina k. Zvicrës*, Ap. nr.no. 20491/92, GjEDNJ, 14.06.2001, parag. 55).

⁶² *Sejdovic k. Italisë*, para. 86. Shih gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.30, datë 17.06.2010, parag. 30; Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.45, datë 10.10.2011, parag. 18.

implicite nga një e drejtë e rëndësishme e Nenit 6 të Konventës, duhet më parë të vërtetohet arsyeshëm se ai i kishte parashikuar pasojat e zgjedhjes së tij (...).⁶³

30. Në çdo rast, sipas GjEDNj-së, barra e provës i përket gjithnjë autoriteteve shtetërore dhe jo të pandehurit, i cili nuk duhet të provojë se ai/ajo nuk ishte duke kërkuar t'i fshihej gjykimit, apo se mungesa e tij/saj ishte për shkak të forcës madhore.⁶⁴
31. Në Legjislacionin Procedural Penal Shqiptar, gjykimi mund të lejohet të zhvillohet në mungesë në katër raste të ndryshme.
32. *Rasti i parë* (mungesa dhe largimi i vullnetshëm i të pandehurit) ka të bëjë me situatën e parashikuar nga neni 352 (1) i K.Pr.Penale. Në këtë rast, i pandehuri, me dijeni dhe vullnet të plotë heq dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në gjykim, duke u përfaqësuar nga mbrojtësi. Sipas paragrafit 2 të nenit 252 të K.Pr.Penale, *“I pandehuri, i cili pasi është paraqitur, largohet vetë nga salla, konsiderohet i pranishëm, me kusht që të përfaqësohet nga mbrojtësi”*.
33. *Rasti i dytë* (i pandehuri i fshehur) lidhet me situatën kur i pandehuri arratiset ose kur provohet se i fshihet drejtësisë. Ky është edhe rasti i parashikuar nga Kushtetuta në nenin 33 (2) të saj.⁶⁵
34. *Rasti i tretë* (i pandehuri që nuk paraqitet), ka të bëjë me situatën e parashikuar nga neni 351 i K.Pr.Penale, i cili parashikon deklarimin e mungesës në rastin kur i pandehuri i lirë ose i paraburgosur nuk paraqitet në seancë, edhe pse është njoftuar rregullisht. Me njoftim të rregullt në këndvështrimin e procesit të rregull ligjor sipas garancive kushtetuese të shprehura në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (3) të KEDNj-së do të kuptohet marrja dijeni personalisht e të gjykuarit në lidhje me akuzën kundër tij dhe procesin gjyqësor vetëm në rastin kur njoftimi i është komunikuar personalisht të gjykuarit. Dhe këtë standard e përmbush pjesërisht vetëm pika 1 e nenit 140 të K.Pr.Penale, në pjesën ku parashikohet se: *“Njoftimi i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij kopjen e aktit (...)”*.
35. *Rasti i katërt* (i pandehuri që nuk gjendet), përkon me situatën, disi anormale, e cila nuk lidhet me të pandehurin e lirë, të arratisur apo të paraburgosur, por me të pandehurin që nuk gjendet, njoftimi i të cilit rregullohet nga pjesa vazhduese e nenit 140 si dhe 141 të K.Pr.Penale, pra përveç rastit kur njoftimi është marrë personalisht nga personi i gjykuar i cituar më lart.⁶⁶

⁶³ Sejdovic k. Italisë, parag. 87.

⁶⁴ Ibid, parag. 88.

⁶⁵ Neni 33(2) i Kushtetutës: Nga kjo e drejtë [për t'u dëgjuar] nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

⁶⁶ Neni 140 i K.Pr.Penale:

1. (...) njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të.
2. Kur vendet e treguara në paragrafin 1 nuk dihen, njoftimi bëhet në vendin ku i pandehuri ka banimin e përkohshëm ose vendin ku qëndron më shpesh, duke ia dorëzuar atë njërit prej personave të treguar në paragrafin 1.
3. Kopja e njoftimit nuk mund t'i dorëzohet një të mituri nën 14 vjeç ose një personi me paaftësi të dukshme intelektuale.
4. Kur personat e treguar në paragrafin 1 mungojnë ose nuk janë të përshtatshëm, ose refuzojnë të marrin aktin atëherë procedohet me kërkimin e të pandehurit në vende të tjera. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk mund të bëhet njoftimi, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ose të fshatit ku i pandehuri banon ose punon. Lajmërimi i depozitimit afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose të vendit ku punon. Ftuesi gjyqësor e lajmëron atë për depozitimin me letër rekomande me lajmërim marrje. Efektet e njoftimit rrjedhin që nga marrja e rekomandesë.
5. Njoftimi i të pandehurit që kryen shërbimin ushtarak bëhet duke i dorëzuar aktin atij vetë dhe kur nuk mund të bëhet dorëzimi, akti i njoftohet komandës e cila detyrohet të lajmërojë menjëherë të interesuarin.

Neni 141 i K.Pr.Penale:

1. Kur njoftimi nuk mund të bëhet sipas rregullave të caktuara për njoftimin e të pandehurit të lirë, autoriteti procedues urdhëron kërkimin e të pandehurit. Në qoftë se kërkimi nuk jep rezultat pozitiv, atëherë nxirret vendimi i mosgjetyes, me të cilin, pasi i caktohet një mbrojtës të pandehurit, urdhërohet që njoftimi të bëhet duke i dorëzuar një kopje mbrojtësit. I pagjeturi përfaqësohet nga mbrojtësi.
2. Vendimi i mosgjetyes i pushon efektet kur përfundojnë hetimet paraprake ose me dhënien e vendimit nga gjykata.

Ndryshimi i këtij rasti, në krahasim me rastet e tjera të lartpërmendura është thelbësor. Kjo pasi për këtë të pandehur nuk mund të thuhet se ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga të drejtat e tij Kushtetuese të parashikuara në nenet 31-33 të saj, si dhe neni 6 i KEDNj-së apo neni 14 i Paktit. Ndërkohë që për tri rastet e para mund të prezumohet se të pandehurit kanë pasur mundësinë që të ushtrojnë të drejtat e tyre të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ndërkombëtare -- përfshirë të drejtën për të zgjedhur mbrojtës prej tyre -- për rastin e të pandehurit që nuk gjendet ky pohim nuk mund të bëhet, pasi të pandehurit akoma nuk i është dhënë kjo mundësi, pra të vihet në dijeni të procesit kundër tij; të ketë kohën e mjaftueshme për të realizuar mbrojtjen; të ketë ndihmën e një përkthyesi nëse nuk njihet gjuhën shqipe; të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; t'u bëjë pyetje dëshmitarëve ose ekspertëve të pranishëm dhe të kërkojë thirrjen e të tjerëve; etj.

36. Siç vërehet, të gjitha të drejtat themelore të çdo personi në procesin penal lidhen, në radhë të parë me njoftimin e akuzës së ngritur kundër tij. Sipas GjEDNj-së, *'Njoftimi i akuzës luan një rol vendimtar në procesin penal, në kuptimin se është nga momenti i dorëzimit të saj që mund të thuhet se i pandehuri është njoftuar zyrtarisht për bazën faktike dhe ligjore të akuzës kundër tij'*.⁶⁷ Përkundrazi, nëse nuk ka prova të mjaftueshme se i pandehuri i gjykuar në mungesë nuk ka marrë informacion të mjaftueshëm mbi procedimin në ngarkim të tij (qoftë ky jo vetëm rasti i të pandehurit që nuk gjendet, por edhe i të pandehurit të lirë të cilit nuk i është dorëzuar personalisht njoftimi), atëherë i lind detyrimi sistemit tonë ligjor për t'i lejuar të gjykuarit në mungesë, rivendosjen në afat për të ushtruar të drejtat e tij themelore në procesin penal.⁶⁸
37. E thënë me pak fjalë, për rastin e të gjykuarit në mungesë, ekziston mundësia që në momentin që do burgoset nga organet ligjzbatuese me qëllim ekzekutimin e vendimit të dënimit të dhënë në mungesë, ky i fundit të lejohet të rivendoset në afat, me qëllim ushtrimin e të drejtës së tij për t'u mbrojtur, përfshirë të drejtën e zgjedhjes së mbrojtësit.
38. Për këtë arsye, nuk mund të pranohet mundësia e zgjedhjes së mbrojtësit nga ana e të afërmit në rastin kur i pandehuri nuk ka marrë dijeni të mjaftueshme për procesin kundër tij, pasi vetëm në momentin e marrjes dijeni lind e drejta e të pandehurit për të zgjedhur mbrojtës. Në të kundërt, nëse do të pranohej zgjedhja e mbrojtësit nga të afërmit e të pandehurit të gjykuar në mungesë, për efekt të ligjit kjo zgjedhje do të konsiderohej si e bërë nga vetë i pandehuri, çka do të passillte praktikisht shkeljen e së drejtës për të zgjedhur personalisht mbrojtësin.
39. Megjithatë, Gjykata konstaton se në praktikë ka ndodhur shpesh që të afërmit e të pandehurit që gjykohet në mungesë të zgjedhin mbrojtës, edhe në rastin kur ky i fundit nuk ka marrë dijeni efektive mbi procesin që zhvillohet kundër tij. Gjykata e mirëkupton shqetësimin e të afërmeve për bërjen e mundur të mbrojtjes së interesave të të afërmit të tyre të gjykuar në mungesë. Sidoqoftë, ky shqetësim nuk mund të tejkalohet dhe as të shkelë të drejtat ekskluzivisht personale të vetë të pandehurit. Për këtë, Gjykata e gjen me vend të interpretojë statusin procedural të mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët e të pandehurit të gjykuar në mungesë (kupto: i pandehuri që nuk gjendet), jo si mbrojtës të zgjedhur nga i pandehuri, por si mbrojtës të caktuar kryesisht në rast se i gjykuari nuk e ka miratuar këtë zgjedhje të familjarëve të tij.
40. Nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se zgjedhja e mbrojtësit nga familjarët e të pandehurit, në kuptim të nenit 48 (3) të K.Pr.Penale, ndodh në rastet kur i pandehuri është në

3. Njoftimi për të pandehurin e fshehur ose të arratisur bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit mbrojtësit dhe kur ai nuk ka mbrojtës autoriteti procedues cakton një mbrojtës kryesisht, i cili e përfaqëson të pandehurin.

⁶⁷ *Sejdovic k. Italisë*, parag. 89.

⁶⁸ *Ibid*, parag. 84: *"Rrjedhimisht, refuzimi për të rihapur gjykimin e zhvilluar në mungesë të të pandehurit, pa patur ndonjë provë se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm gjatë gjykimin, është konsideruar si një "shkelje flagrante e së drejtës" që e ka bërë gjykimin "në kundërshtim të hapur të Nenit 6 ose të principeve të inkuorporuar brenda tij"*.

gjendje të kufizimit të lirisë personale, pra në disponibilitetin e autoriteteve të drejtësisë dhe ka dijeni të mjaftueshme për zhvillimin e një procedimi penal në ngarkim të tij.

41. Në qoftë se i pandehuri nuk është fizikisht i paraburgosur dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të besuar se ka njohuri për procesin penal në ngarkim të tij, atëherë zgjedhja e mbrojtësit nga ana e të afërmeve të të pandehurit të gjykuar në mungesë do të konsiderohet, për efekt të ligjit procedural, si mbrojtës i caktuar kryesisht. **Pra, mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët do të pranohet nga gjykata duke e legjitimuar por duke i njohur tagrat e mbrojtësit të caktuar, që janë të drejtat procedurale që ka mbrojtësi në procesin penal me përjashtim të së drejtave që ligji ia njeh si të drejta ekskluzivisht personale të pandehurit.**

B. Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për unifikim:

42. Neni 50(1) i K.Pr.Penale shprehet se “*Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit*”. Ndërkohë, neni 410 (1) i K.Pr.Penale përcakton se “*I pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Kujdestari i të pandehurit mund të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit*”.
43. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e gjejnë me vend të rikujtojnë se në lidhje me këtë çështje ka pasur qëndrime të ndryshme midis kësaj Gjykate dhe Gjykatës Kushtetuese. Në Vendimet Unifikues nr.354, datë 28.07.1999 dhe nr.386, datë 29.07.1999, Kolegjet e Bashkuara janë shprehur, ndër të tjera, se:
- Ligji procedural penal njeh një sërë të drejtash ekskluzive për të pandehurin, si e drejta për të zgjedhur ose pranuar mbrojtës, pranimi ose jo i veprës që i atribuohet, e drejta për të dhënë shpjegime, e drejta për t’u ankuar ndaj vendimeve të gjykatës, etj.⁶⁹
44. Ky qëndrim i vendimeve të mësipërme u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese, e cila me vendimin nr.17, datë 17.04.2000 do të shprehej në të kundërt, duke gjykuar se:
- Në kundërshtim nga sa arsyetojnë Kolegjet e Bashkuara në vendim, e drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës nuk është një e drejtë ekskluzive, që i takon vetëm të pandehurit, siç është e drejta për të pranuar ose jo veprën penale, për të bërë ose mos bërë deklarime, etj. Sipas ligjit, e drejta e ankimit i takon edhe mbrojtësit si një nga kushtet për realizimin e plotë të mbrojtjes.⁷⁰
45. Megjithatë, këto Kolegje rikonfirmuan qëndrimin e tyre të mëparshëm në Vendimin nr.371, datë 27.10.2000, vendim ky i cili përsëri u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr.5, datë 07.02.2001.
46. Në referencë të fuqisë detyruese që kanë vendimet e Gjykatës Kushtetuese (neni 132 i Kushtetutës) si dhe të shfuqizimit pjesërisht të pikës 2 të nenit 410 të K.Pr.Penale në pjesën “nga i pandehuri” me Vendimin nr.15, datë 17.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese, praktika gjyqësore legjitimoi *a priori* mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët të bënte ankim pavarësisht nëse i pandehuri kishte dhënë më parë pëlqimin. Për pasojë, në praktikën gjyqësore lindën probleme që kishin të bënin me të drejtën e të gjykuarit në mungesë që pas njoftimit të vendimit t’i jepej mundësia e rishqyrtimit të çështjes si garanci e procesit të rregullt ligjor dhe parimit të sigurisë juridike që imponohej nga shqyrtimi i çështjes në të gjitha shkallët e gjykimit mbi bazën e ankimit të mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit.

⁶⁹ Kolegjet e Bashkuara, Vendim nr.354, datë 28.07.1999, faqe 3.

⁷⁰ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.17, datë 17.04.2000, faqe 2.

47. Në reflektim edhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në veçanti të çështjeve *Somogyi k. Italisë*⁷¹ si dhe *Sejdovic k. Italisë*,⁷² Gjykata Kushtetuese vendosi të riinterpretojë praktikën e saj në lidhje me gjykimin në mungesë. Në vendimin nr.30, datë 17.06.2010, Gjykata Kushtetuese do të shprehej:

Lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka, sipas GJEDNJ-së është detyrë e organeve kompetente shtetërore. E njëjta situatë është edhe për sa i përket ankimit. Familjarët e të pandehurit mund të paraqesin ankim vetëm në rast se janë duke përmbushur vullnetin e të pandehurit dhe vetëm nëse i pandehuri ka dijeni se ndaj tij ka filluar e po zhvillohet një proces penal.⁷³

48. Kolegjet e Bashkuara mbështesin vendimin e mësipërm dhe çmojnë se e drejta e ankimit, ashtu si e drejta për të zgjedhur mbrojtës, është një e drejtë ekskluzivisht personale e të pandehurit. Ky përfundim arrihet jo vetëm në referim të qëndrimeve të mëparshme të kësaj Gjykate, si dhe të qëndrimit të sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese, por edhe në referim të interpretimit tekstual të nenit 410 të K.Pr.Penale, sipas të cilit i pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit. Përdorimi i termit “ose nëpërmjet mbrojtësit” nga ana e ligjvënësit, interpretohet nga Gjykata si një vullnet për ta cilësuar të drejtën për të bërë ankim si një e drejtë që i rezervohet personalisht të pandehurit. Kjo e drejtë, që i rezervohet ekskluzivisht të pandehurit, mund të ushtrohet nga i pandehuri vetë personalisht, ose nëpërmjet mbrojtësit. Ndërkohë, të drejtat e parashikuara nga neni 50(1) i K.Pr.Penale, janë të drejta që mbrojtësi “i ka”, automatikisht me faktin e të qenit mbrojtës i zgjedhur, ose i caktuar nga organi që procedon. Në këtë rast, atij i “dublohen” të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit.

49. Ky qëndrim përforcohet edhe nga i vetmi rast përjashtimor, që ka të bëjë me kujdestarin e të pandehurit, i cili është i vetmi person që mund të bëjë “çdo ankim që i takon të pandehurit”. Kjo sepse, në rastin e të pandehurit të cilit i është caktuar kujdestar mungon vetë përgjegjësia për të vepruar, njëjloj si për të miturin.

50. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se:

- **E drejta për të bërë ankim, në vështrim të përcaktimit ligjor të bërë nga ligjvënësi në nenin 50 pika 1 e 410 të K.Pr.Penale, është një e drejtë e cila i rezervohet personalisht të pandehurit.**
- **Në rastin e të pandehurit të cilit i është caktuar kujdestar, kjo e drejtë i përket këtij të fundit, i cili mund ta ushtrojë personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit.**

C. Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për unifikim:

51. Të drejtat që i rezervohen personalisht të pandehurit, ndahen në dy kategori: në ato që mund t’u delegohen personave të tretë, përfshirë këtu mbrojtësin; si dhe ato të drejta të cilat janë thellësisht personale të të pandehurit, delegimi i të cilave nuk mund të lejohet. Ndër këto të fundit, mund të përmendet, pranimi i veprës penale që i atribuohet; apo pranimi, në seancë

⁷¹ Aplikimi nr.67972/01, GjEDNJ, 18.05.2004.

⁷² Aplikimi nr.56581/00, GjEDNJ, [DHM], 01.03.2006.

⁷³ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.30, datë 17.07.2010, faqe 16, parag. 45.

gjyqësore i pezullimit të dënimit sipas nenit 63 të K.Penal.⁷⁴ Ndër të drejtat që përfshihen në kategorinë e parë, mund të përmendet, e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Sipas nenit 403 të K.Pr.Penale, i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të kërkojnë që çështja të përfundohet derisa të mos jetë filluar shqyrtimi gjyqësor. Në praktikë mund të ndodhë shpesh që, në të njëjtin akt me të cilin i jepen tagrat e përfaqësimit mbrojtësit të zgjedhur, i pandehuri të “delegojë” edhe të drejta të tij ekskluzivisht personale, siç është e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Në këtë rast, mbrojtësi i zgjedhur do të ketë njëkohësisht edhe tagrat e përfaqësuesit të posaçëm, për sa i përket asaj të drejte të deleguar. Po kështu, i pandehuri mund të delegojë edhe të drejta të tjera, siç është edhe vetë e drejta për të bërë ankim, e parashikuar shprehimisht nga neni 410 (1) i K.Pr.Penale. Pra, për sa i përket mbrojtësit, përgjigja e pyetjes së shtruar duhet të jetë pozitive.

52. Në lidhje me mundësinë e delegimit të së drejtës për të bërë ankim tek një person tjetër (qoftë i afërm apo jo), Gjykata konstaton se kjo mundësi nuk është e parashikuar shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale. Megjithatë, pyetja merr rëndësi të veçantë në rastin e të pandehurit të arratisur, i cili kërkon të ushtrojë të drejtën e ankimit, duke ia deleguar zgjedhjen e mbrojtësit një të afërmi (apo miku) të tij. Në këto kushte gjykatat e themelit duhet të pranojnë ankimin e mbrojtësit të zgjedhur nga personi i tretë vetëm nëse provohet se si (i) zgjedhja e mbrojtësit, ashtu edhe (ii) delegimi i mbrojtësit për të ushtruar ankim, është rezultat i vullnetit të plotë dhe pa ekuivok të titullarit të kësaj të drejte, që është i pandehuri. Ky është edhe qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, në vendimin e cituar më lart, ku shprehej se “familjarët e të pandehurit mund të paraqesin ankim vetëm në rast se janë duke përmbushur vullnetin e të pandehurit dhe vetëm nëse i pandehuri ka dijeni se ndaj tij ka filluar e po zhvillohet një proces penal” dhe se “gjykata duhet të pranojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provon se ato po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri”⁷⁵ Nga ana procedurale, gjykata duhet të konsiderojë këtë veprim të kryer në bazë të nenit 48 (1) (zgjedhje e mbrojtësit personalisht nga i pandehuri), si dhe në bazë të nenit 410 (1) të K.Pr.Penale (ankim përmes mbrojtësit). Gjykata thekson se ankimi nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjari nuk duhet kurrsesi të klasifikohet si zgjedhje e bërë në referim të nenit 48 (3) të K.Pr.Penale, por si zgjedhje personale e vetë të pandehurit (neni 48 (1) i K.Pr.Penale). Ndryshimi këtu është thelbësor, pasi siç u shpjegua më lart, rastet e parashikuara nga neni 48 (3) i K.Pr.Penale kanë të bëjnë me të pandehur në gjendje të burgosur, i cili e ka të vështirë zgjedhjen e personit që do ta mbrojë në procedimin kundër tij; ndërsa rasti i delegimit të së drejtës për të bërë ankim ka të bëjë me të pandehurin në gjendje të lirë, i cili zgjedh personalisht mbrojtësin në bazë të nenit 48 (1) të K.Pr.Penale.
53. Për sa i përket mënyrës dhe formës së përcaktuar nga ligji për këtë delegim, Gjykata çmon se këto janë të përcaktuara shprehimisht në pikën 2 të nenit 48 të K.Pr.Penale. Akti, nga i cili duhet të vërtetohet qartësisht identiteti dhe vullneti i titullarit të së drejtës, i jepet mbrojtësit personalisht ose i dërgohet me postë rekomandë.
54. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se:
- **I pandehuri lejohet që personalisht të delegojë të drejtën për të bërë ankim tek mbrojtësi. Akti i delegimit mund të jetë në të njëjtin akt me të cilin bëhet zgjedhja e mbrojtësit, ose në një akt të veçantë.**

⁷⁴ Neni 63 i K.Penal:

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik:

2. Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

3. Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

⁷⁵ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.30, datë 17.07.2010, faqe 16, paragraf 45-46.

- I pandehuri lejohet gjithashtu të delegojë të drejtën për të bërë ankim tek mbrojtësi, duke e ushtruar këtë vullnet nëpërmjet delegimit tek një i afërm. I afërmi nuk zgjedh mbrojtës dhe as nuk delegon të drejtën për ankim në mënyrë autonome. Ankimi i mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit lejohet vetëm nëse provohet se (i) zgjedhja e mbrojtësit, dhe (ii) delegimi i mbrojtësit për të ushtruar ankim, është rezultat i vullnetit të plotë dhe eksplicit të titullarit të kësaj të drejte, që është i pandehuri.
- Mënyra dhe forma e përcaktuar nga ligji për këtë delegim është ajo e përcaktuar në pikën 2 të nenit 48 të K.Pr.Penale.

Ç. Në lidhje me pyetjen e katërt të shtruar për unifikim:

55. Në dhënien përgjigje pyetjeve të mëparshme, Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin se (i) të afërmit mund të zgjedhin mbrojtës, në kuptim të nenit 48 (3) të K.Pr.Penale, vetëm në rastet kur i pandehuri gjendet në kushtet e kufizimit të lirisë personale dhe ka dijani për procesin penal në ngarkim të tij; (ii) se e drejta për ankim është një e drejtë personale e të pandehurit, dhe se (iii) kjo e drejtë mund të delegohet tek mbrojtësi apo tek të afërmit.
56. Duke pasur parasysh nga sa më sipër, Gjykata vjen rrjedhimisht në përfundimin se përgjigja e pyetjes së katërt të shtruar për unifikim duhet të jetë negative:
- **Në rastin e të gjykuarit në mungesë, si mbrojtësi i caktuar nga gjykata, ashtu edhe ai i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit (i cili siç u tha më lart, konsiderohet të ketë të njëjtat tagra me atë të caktuar nga gjykata) nuk janë mbrojtës të zgjedhur personalisht nga i pandehuri. Rrjedhimisht, titullari i së drejtës nuk ka deleguar të drejtën e tij për të bërë ankim.**
57. Ky arsyetim vjen edhe në referim të nenit 410 (2) të K.Pr.Penale, ku parashikohet se “*Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji*”. Gjykata mban në konsideratë faktin se me vendimin nr.15, datë 17.04.2003, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi pjesën “nga i pandehuri” duke lejuar ankime edhe nga mbrojtësi i caktuar dhe ai i zgjedhur nga familjarët. Megjithatë, siç u theksua edhe më lart, ky orientim është tashmë i tejkaluar nga vetë Gjykata Kushtetuese, duke filluar nga vendimi i saj nr.30, datë 17.06.2010. Edhe në vlerësimin e Kolegjeve të Bashkuara, mbrojtësi mund të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë vetëm kur është i pajisur me akt përfaqësimi nga vetë i pandehuri, në format e parashikuara nga neni 48 (2) i K.Pr.Penale.
58. Ndryshe nga sa mund të perceptohet, Gjykata vjen në këtë përfundim duke pasur si qëllim jo kufizimin e të drejtës së mbrojtjes, por përkundrazi, garantimin sa më maksimal të saj, duke pasur parasysh jo vetëm kërkesat e Kushtetutës, por edhe ato të instrumenteve ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut, siç janë KEDNj-ja dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.
59. Kështu, për Gjykatën, rëndësi kryesore ka bërja e mundur që, në rast gjykimi në mungesë, të gjykuarit t’i jepet mundësia, nëpërmjet rivendosjes në afat për të bërë ankim, për të kërkuar një përcaktim të ri në lidhje me themelin e akuzave kundër tij nga një gjykatë në përputhje me garancitë e gjykimit të drejtë të parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së. Kjo nevojë vjen edhe në reflektim të vendimeve *Shkalla k. Shqipërisë*⁷⁶ dhe *Haxhia k. Shqipërisë*,⁷⁷ në të cilët

⁷⁶ *Adrian Shkalla k. Shqipërisë*, Ap. nr.26866/05, GjEDNj, 10.05.2011.

⁷⁷ *Haxhia k. Shqipërisë*, Ap. nr.34783/06, GjEDNj, 05.11.2013.

GjEDNj-ja deklaroi shkeljen e nenit 6 të Konventës në lidhje me gjykimet në mungesë kundër tyre. Në të dy vendimet, kërkuesit, të cilët ishin gjykuar në mungesë, nuk lejoheshin të kërkonin rivendosje në afat për të kundërshtuar vendimin e dënimit me burgim pasi kjo mundësi ishte shteruar më parë nga rekursët e bërë nga mbrojtësit e zgjedhur nga të afërmit, edhe pse vetë kërkuesit nuk kishin pasur dijeni efektive për këtë zgjedhje. Në çështjen *Shkalla*, GjEDNj-ja theksoi se:

Fakti se kërkuesi ishte mbrojtur në apel nga një mbrojtës i zgjedhur nga i ati, nuk do të thotë se ai kishte dijeni efektive të mëparshme mbi procedurat gjyqësore kundër tij (...) Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk është provuar se kërkuesi kushte dijeni të mjaftueshme mbi procedurat gjyqësore kundër tij, se ai autorizoi në mënyrë direkte ose të tërthortë veprimet e familjarëve në apel, apo hoqi dorë në mënyrë eksplicite nga e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim duke iu shmangur gjykimit. Në lidhje me çështjen nëse e drejta vendase i lejonte qartësisht mundësinë e një rigjykimi, Gjykata rikujton përfundimet e saj në lidhje me mungesën e mjeteve ligjore efektive në dispozicion të ankuesit (...).⁷⁸

Ndërkohë në çështjen *Haxhia k. Shqipërisë*, GjEDNj-ja doli në përfundimin se:

Në rastin konkret, nuk është e kundërshtuar nga palët që kërkuesi është gjykuar dhe dënuar në mungesë. Nuk është provuar se ai kishte njohuri të mjaftueshme për procedurat gjyqësore kundër tij. Në fakt, është e provuar se kërkuesi u informua mbi dënimin në mungesë vetëm me 3 Qershor 2006, kur u arrestua nga autoritetet turke. As nuk është provuar se ai në mënyrë eksplicite ose implicite autorizoi veprimet e familjarëve të tij në gjykimin në apel (ose në Gj.L), ose të ketë hequr dorë pa ekuivoqe nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në gjykim duke iu shmangur vullnetarisht gjykimit. Sipas legjislacionit vendas, nuk kishte asnjë mundësi për kërkuesin të kërkonte rivendosje në afat [*sipas vendimit nr.1/2011 të Kolegjeve të Bashkuara*].⁷⁹

60. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëndrimin e mbajtur në vendimin objekt shqyrtimi, vlerësojnë se arrihet të shmanget praktika e padëshiruar kur i pandehuri i gjykuar në mungesë humbiste çdo mundësi të kundërshtonte akuzat kundër tij, pasi kjo mundësi i ishte shteruar më parë nga një mbrojtës, i cili, edhe përse vepronte në interes të të pandehurit, përsëri nuk ka qenë i zgjedhur personalisht nga ai. Siç u konstatua edhe nga praktika e GjEDNj-së, moment kyç për ushtrimin e të drejtave që burojnë nga neni 6 i Konventës, është njoftimi efektiv i akuzës të pandehurit. Qysh nga ai moment, çdo person duhet të ketë të drejtën për t'u mbrojtur dhe për të kundërshtuar akuzat në themel, të paktën në një instancë të procesit penal kundër tij. Edhe përse gjykimi në mungesë të të pandehurit, në vetvete nuk bie në kundërshtim me Konventën, ky fakt përsëri nuk i liron shtetet Palë mbi detyrimin për t'i bërë të mundur çdo të pandehuri ushtrimin e të drejtave të garantuara nga neni 6 i Konventës. Detyrimi i autoriteteve shtetërore për garantimin e neneve 31 e 33 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNj-së, quhet i plotësuar vetëm me: njoftimin efektiv të akuzës; mundësinë e të pandehurit për t'u mbrojtur personalisht ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; si dhe mundësinë për t'u dëgjuar në seancë gjyqësore dhe për të kundërshtuar akuzat në themel.
61. Në rastin e të gjykuarit në mungesë (rasti i katërt, i trajtuar më lart, në paragrafin 31), njohja e të pandehurit me akuzën ndodh në një fazë të avancuar të procesit penal, shpesh pasi ka përfunduar si hetimi, ashtu edhe gjykimi në shkallë të parë. Prandaj është e një rëndësie thelbësore që i pandehuri të ketë mundësi, të paktën në gjykimin në apel - i cili është gjithsesi

⁷⁸ *Shkalla*, parag. 72-75.

⁷⁹ *Haxhia*, parag. 63.

një gjykim themeli - për të ushtruar të drejtat e tij kushtetuese thelbësore siç janë: e drejta për t'u dëgjuar, përfshirë këtu të drejtën për të zgjedhur personalisht mbrojtësin; për të kërkuar marrjen e provave nëpërmjet përsëritjes së hetimit gjyqësor si element i respektimit të parimeve të kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve. Vetëm nëpërmjet plotësimit të këtij kriteri, pra mundësimi të të pandehurit për të zgjedhur vetë ose miratuar strategjinë mbrojtëse, mund të thuhet se është garantuar zhvillimi i një procesi të rregull ligjor, i cili nuk duhet të jetë një e drejtë thjesht në letër, por mundësimi i një procesi të zhvilluar në kontradiktorialitetin e palëve, duke respektuar barazinë e armëve dhe garantimin e një mbrojtje efektive.

62. Edhe nëse mbrojtësi i caktuar kryesisht apo ai i zgjedhur nga të afërmit do të lejohej të ushtronte ankim në apel, ky veprim përsëri do të konsiderohej si pa efekte për sa i përket të drejtës së mbrojtjes si e drejtë kushtetuese, pasi kjo e drejtë fillon, në çdo rast, veçse me njoftimin efektiv të akuzës ndaj të pandehurit. Përkundrazi, lejimi i këtyre dy kategorive mbrojtësish për të bërë ankim në apel jo vetëm që nuk do të ishte i dobishëm nga perspektiva e mbrojtjes efektive dhe ekonomisë gjyqësore (pasi në çdo rast të gjykuarit në mungesë do t'i lejohej rivendosja në afat dhe do të kishim një dublikim të panevojshëm të procedurave gjyqësore), por do të ishte i dëmshëm edhe për parimin e sigurisë juridike duke krijuar përplasje me parimin e procesit të rregullt ligjor. Në kushtet kur parimi i procesit të rregullt ligjor ka përparësi mbi atë të sigurisë juridike, investimi i gjykatave në një proces, i cili më pas do të hapej me kërkesën e të gjykuarit në mungesë, do të sillte një proces të pavlefshëm dhe një vendim të cenueshëm që nuk krijon siguri juridike. Kjo pasi *“rishqyrtimi i rekursit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ai Kolegj është shprehur njëherë në lidhje me mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala, jo për shkak të paraqitjes së tij tej afatit ligjor, bie ndesh me parimin e “res judicata” (gjësë së gjykuar), pasi i njëjti Kolegj nuk mund të shqyrtojë dhe shprehet dy herë në lidhje me rekursin e paraqitur nga e njëjta palë kundër të njëjtit vendimi të gjykatës së apelit”*.⁸⁰
63. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson të nënvizojë se të drejtat e palëve të tjera në proces nuk cenohen. Si Prokurori, ashtu edhe ndonjë i bashkëpandehur eventual, që ka qenë i pranishëm gjatë gjyqimit në shkallë të parë, vazhdojnë të gëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në shkallë të parë, në mungesë të një bashkëpandehuri tjetër. Pra, fakti se mbrojtësi i caktuar kryesisht ose ai i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit të gjykuar në mungesë nuk legjitimohen të ushtrojnë ankim në apel dhe se e drejta e ankimit për të gjykuarin në mungesë mund të ushtrohet në një kohë të mëvonshme që lidhet me marrjen dijeni prej tij, nuk do të thotë që kjo ndalesë vepron edhe për palët e tjera të legjitimuara në të drejtat e tyre për të ushtruar ankim në apel, ose rekurs në Gjykatën e Lartë, për sa kohë që e drejta e ankimit për palët është e pavarur.
64. Në këtë kuptim, për secilin bashkëpandehur zhvillohet një procedim teorikisht i pavarur nga të tjerët, që në funksion të ekonomisë procedurale, mund të bashkohet (neni 92 K.Pr.Penale), ose ndahet (neni 93 K.Pr.Penale). Gjithashtu, mund të ndodhë që në një proces me shumë të pandehur, një ose disa prej tyre të kërkojnë gjykimin e shkurtuar, ndërkohë që gjykimi të vazhdojë normalisht për të tjerët (duke pas sjellë ndarjen e çështjes për të parët). Ashtu siç vendimi i dënimit jepet i veçantë dhe në mënyrë individuale për secilin bashkëpandehur (edhe pse i shqiptuar në të njëjtin vendim), po ashtu edhe e drejta e ankimit mbetet individuale. Pra, nëse një i bashkëpandehur nuk ushtron të drejtën e ankimit brenda afatit ligjor, dënimi i tij merr formë të prerë. Për rastin e të gjykuarit në mungesë, në momentin e marrjes dijeni të vendimit kundër tij, ai mund të kërkojë rivendosje në afat, gjithnjë nëse nuk ka hequr dorë më

⁸⁰ Kolegjet e Bashkuara, Vendim Unifikues nr.1, datë 20.01.2011.

parë në mënyrë eksplicite nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim, ka autorizuar familjarët për të bërë ankim, ose i është shmangur hetimit.

65. Neni 416 i K.Pr.Penale përbën një rast përjashtimor e të jashtëzakonshëm, në të cilin ankimi i bërë nga një bashkë i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në *motive personale*, vlen edhe për bashkëpandehurit e tjerë, dënimi i të cilëve ka marrë formën e prerë. Sidoqoftë, shtrirja e apelit edhe për të bashkë pandehurin që nuk ka paraqitur ankim në apel në kohë (pavarësisht nëse ka qenë i gjykuar në mungesë apo jo), nuk vlen *in pejus*. Ajo është e kushtëzuar nga suksesi i ankimit të bashkë të pandehurit që ka paraqitur apelin në kohë. Të dy këto kushte, i) motivi jo personal i ankimit dhe ii) suksesi i ankimit, janë kumulative për prishjen e dënimit të formës së prerë të bashkë të pandehurit jo ankimues.
66. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se:
- **Mbrojtësi i caktuar nga gjykata, apo i zgjedhur nga një i afërm i të pandehurit, i cili është gjykuar në mungesë, sipas përcaktimit të bërë nga ligjvënësi në pikën 3 të nenit 48 të K.Pr.Penale, nuk legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të dënimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë.**
 - **Në çdo rast, i dënuari në mungesë ka të drejtë të kërkojë rivendosje në afat për të ushtruar ankim në apel ose rekurs në Gjykatën e Lartë, përveç rasteve kur ka prova të mjaftueshme se:
 - (i) kishte dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij;
 - (ii) në mënyrë direkte ose të tërthortë, ka autorizuar familjarët për t'u ankimuar në apel; ose
 - (iii) ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në gjykimin kundër tij, duke u fshehur nga drejtësia.**

VI. Në lidhje me rekursin e të gjykuarit

67. Nga studimi i akteve në fashikullin e gjykimit, konstatohet se prokura e përfaqësimit të të gjykuarit Ervis Nurkaj është lëshuar nga i ati i tij, dhe jo nga vetë i gjykuari. Gjithashtu, Gjykata vëren se nga aktet e gjykimit nuk del asnjë element për të besuar se midis të gjykuarit Nurkaj dhe familjarëve të tij të ketë pasur ndonjë kontakt, nga i cili Gjykata të deduktojë se i gjykuari ka marrë dijeni të mjaftueshme për procesin penal të zhvilluar kundër tij.
68. Gjithashtu, prokura e posaçme e lëshuar në datë 27.02.2009, me të cilin i ati i të gjykuarit, shtetasi Aqif Nurkaj ka zgjedhur si mbrojtës av. Ilir Kulla, nuk rezulton të jetë përpiluar me porosi të të gjykuarit Ervis Nurkaj. Madje në dhënien e tagrave nga ana e të atit, shkruhet: “Të më përfaqësojë mua [Aqif Nurkaj] pranë organit të akuzës, Prokurorisë së Rrethit Shkodër lidhur me akuzën e ngritur ndaj djalit tim të quajtur Ervis Nurkaj, akuzuar për veprën penale të falsifikimit”.
69. Përveç kësaj, Gjykata thekson se edhe nëse prokura e posaçme do të ishte përpiluar sikur të ishte e bërë me porosi të vetë të gjykuarit, ajo përsëri nuk do të vlente e vetme, pa ekzistencën e një prokure tjetër të posaçme të vetë të gjykuarit në të cilën i delegohet të afërmit e drejta për të zgjedhur mbrojtës në emër dhe në porosi të tij.
70. Për sa më sipër, rezulton se mbrojtësi i zgjedhur nga familjari i të gjykuarit nuk ka qenë person i legjitimuar për të ushtruar ankim në apel në kuptim të nenit 410 të K.Pr.Penale. Po ashtu, edhe rekursi i paraqitur nga i njëjti mbrojtës, nuk rezulton të jetë bërë nga person i legjitimuar.
71. Gjithashtu nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për të besuar se i ati i Nurkaj ka vepruar në llogari të të gjykuarit, dhe as që vetë i gjykuari të ketë autorizuar në mënyrë direkte ose të

tërthortë zgjedhjen e mbrojtësit gjatë gjykimit në shkallë të parë, në apel, apo për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë. Në referim të arsytimit të mësipërm, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të gjykuarit Nurkaj nuk është person i legjitimuar për të ushtruar rekurs kundër vendimit nr.228, datë 18.09.2009 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

VII. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

72. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se rekursi i paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të gjykuarit Ervis Nurkaj nuk është bërë nga person i legjitimuar dhe për pasojë vendimi i gjykatës së apelit është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 420 (1) (a) dhe 420 (2) të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N

Pushimin e shqyrtimit të çështjes nr.1/4 Akti, që i përket të gjykuarit Ervis Nurkaj, në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është unifikues dhe njëson praktikën gjyqësore për çështjet objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 10.03.2014

MENDIMI I PAKICËS

Ndryshe nga konkluzioni i arritur nga ana e shumicës në Vendimin unifikues nr.01, datë 10.03.2014, lidhur me çështjet ligjore, të parashtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, gjyqtarët e mbetur në pakicë ('pakica') nuk pajtohen me qëndrimin e arritur nga shumica sa i përket çështjes së moslegjitimit të mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit për të ankimuar, për arsytet që vijojnë.

Shumica, në arsyetimin e vendimit, pohon në thelb, se e drejta e mbrojtjes, në kuptimin thelbësor të saj, është një e drejtë themelore me karakter kushtetues, e cila i përket ekskluzivisht të pandehurit e nuk mund të transferohet tek të afërmit⁸¹. Sipas saj mbrojtësi i caktuar kryesisht, apo i caktuar nga të afërmit, nuk janë të legjitimuar të ankimojnë nëpërmjet apelit apo rekursit, vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në qoftë se nuk provohet - në mënyrë të pa ekuivoktë - vullneti i personit në mungesë për të ankimuar vendimin në fjalë. Sipas këtij këndvështrimi rrjedh përfundimi se, derisa të shfaqet dhe të provohet vullneti i personit të dënuar në mungesë për të apeluar apo rekursuar, vendimi i gjykatës së shkallës së parë do të mbetet pa u ankimuar dhe se eventualisht apelimi apo rekursimi mund të bëhen edhe pas një kohe relativisht të gjatë, vetëm kur provohet shprehimisht vullneti i personit që ishte në mungesë.

Pakica argumenton se e drejta për t'u mbrojtur me një mbrojtës, është një e drejtë themelore e individit të akuzuar për një vepër penale, dhe si e tillë ajo duhet të gjejë zbatim në çdo shkallë dhe fazë të procedimit penal.

Pakica shpreh qëndrimin se në fakt, nuk kemi të bëjmë me transferimin e një të drejte të parashikuar e garantuar nga ligji tek mbrojtësi i caktuar nga të afërmit apo ai caktuar kryesisht. Sepse e drejta e mbrojtjes është një garanci objektive që duhet të respektohet, gjithmonë, edhe në rastin kur personi është hetuar, gjykuar, dhe eventualisht, dënuar në mungesë.

Në lidhje me çështjet që shtrohen për unifikim, pakica shpreh qëndrimin se, kemi të bëjmë me të drejtën e mbrojtjes me anë të një mbrojtësi, si një e drejtë e vetme komplekse, e cila mund të ushtrohet në varësi të kushteve dhe rrethanave, sipas një renditjeje preferenciale të përcaktuar zgjedhjeje, duke filluar së pari nga personi i interesuar, së dyti nga mbrojtësi i caktuar kur është caktuar nga organi procedues, apo mbrojtësi i caktuar nga ana e familjarëve, kur këta kanë bërë zgjedhjen e tyre, derisa personi i interesuar nuk e ndryshon këto zgjedhje.

E drejta e të pandehurit për të kërkuar pafajësinë është një garanci, e cila nënkupton faktin se mbrojtësi duhet të ushtrojë të njëjtat të drejta që gëzon i pandehuri, sepse për shkak të njohurive profesionale që ai ka mund të provojë pafajësinë e të akuzuarit, prandaj ligji i vendos si subjekte të procedimit penal, në një plan të njëjtë, meqenëse janë dy figura të nevojshme për zhvillimin e gjykimit të rregullt e të drejtë.

Ndryshe nga sa arsyeton shumica, pakica argumenton se në thelb kemi të bëjmë me një të drejtë të vetme, - të drejtën e mbrojtjes me avokat - e cila në varësi të situatës, mund të ushtrohet nga këto subjekte, në radhë të parë nga i interesuari, kur ai nuk gjendet, nga të afërmit apo i caktuar kryesisht. Mbrojtësi nuk është një subjekt i procedimit penal atëherë kur e cakton personi i pandehur apo ai nën hetime, ai bën pjesë në procedimin penal që nga momenti i lindjes së këtij procedimi. Figura e mbrojtësit bën pjesë e garancisë objektive dhe e tërësisë së nocionit të procesit të rregullt e të drejtë. Kësisoj, vetëm mënyra e zgjedhjes ose heqja dorë prej tij, i takojnë personit të pandehur apo atij nën hetime, në mungesë të këtij personi, garancia e pranisë së mbrojtësit, si e drejtë themelore duhet të konsiderohet si një pjesë e pazëvendësueshme dhe objektive, e cila në bazë të nenit 15 të Kushtetutës qëndron në themel të rendit juridik⁸², dhe si e tillë ajo duhet të vazhdohet të aplikohet në çdo shkallë apo fazë të procedimit penal – duke përfshirë këtu edhe atë të ankimit në gjykatën e shkallës së dytë dhe gjykimin e ligjshmërisë në Gjykatën e Lartë, – deri në çastin kur dhe në masën që personi i interesuar vendos dhe ka një vullnet ndryshe të kundërt.

⁸¹ Vendimi nr.1, datë 10.03.2014, paragrafi 14.

⁸² Neni 15, paragrafi i parë dhe i dytë i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Pra, pakica është e mendimit se për ushtrimin e të drejtave që janë në favor të personit në mungesë, sipas parimit të *favor impugnationis*, nuk është e nevojshme pajisja me prokurë, pasi ankimimi i mbrojtësit (të caktuar kryesisht apo nga të afërmit) do të konsiderohet si vazhdim i pjesës së misionit të tij për të mbrojtur personin e pandehur, edhe kur ai është në mungesë dhe kur akoma nuk është e vërtetuar nëse ai ka dijeni efektive të procedimit penal.

Detyra e mbrojtësit, efektet dhe pasojat e veprimtarisë së tij, nuk mund dhe nuk duhet të kushtëzohen duke u varur nga vullneti i personit nën hetime, i pandehur a i gjykuar në mungesë, sepse prania e mbrojtësit në procedimin penal ka vetëm efekte favorizuese për personin e gjykuar në mungesë, pasi prania e mbrojtësit përbën një pjesë objektive të sistemit ligjor procedural.

Pakica shpreh qëndrimin se mbrojtësi, me çfarëdo lloji titulli emëruar, gati barazohet me të pandehurin në të drejtat. Sipas nenit 50 të K.Pr.P, parimi i përgjithshëm është që mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njej të pandehurit dhe garanton ushtrimin e shpejtë të së drejtës për të ankimuar, qoftë nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht ose atij të zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit.

Gjithashtu e parë nga ky këndvështrim, kjo tezë duket se i jep një përgjigje juridike problematikës për akses në drejtësi të situatës kur personi, i deklaruar në mungesë, teksa është gjykuar në shkallë të parë nga një avokat i caktuar nga gjykata me një nivel mbrojtjeje që ndofta le për të dëshiruar, por ndërkohë, nëpërmjet një vendimi që duket i padrejtë, e personi nuk është gjetur ende, të afërmit e tij mund ta korrigojnë këtë padrejtësi, duke caktuar një mbrojtës tjetër në apel a Gjykatë të Lartë, duke synuar një vendim më të favorshëm dhe në kohë më të shpejtë, pavarësisht vazhdimit të mungesës së personit të proceduar në mungesë.

Sipas nenit 1 të Kodit të Procedurës Penale, legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve dhe, sipas nenit 2 të K.Pr.P, respektimi i normave procedurale është i detyrueshëm për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

Në këtë kontekst, garancitë dhe të drejtat e akorduara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi i Procedurës Penale, nuk mund të varen nga vullneti i individit që është në mungesë.

Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, në nenin 6 të Kodit të Procedurës Penale, me titullin “sigurimi i mbrojtjes”, parashikohet se: “*i pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit*”, neni 9 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se: “*Personave që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë u kthehen të drejtat dhe shpërblehen për dëmin e pësuar*”.

Sipas nenit 48/3 të K.Pr.P, parashikohet përkatësisht se: “*Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2*”.

Në këtë kuadër, ndryshe nga sa arsyeton shumica, neni 48/3 i Kodit të Procedurës Penale është një dispozitë e cila nuk kufizon apo ndalon legjitimitimin e llojit të mbrojtësit. Kushti ligjor që parashikon dispozita në fjalë – nisur nga vendosja e dispozitës në parimet e përgjithshme– nuk i referohet kufizimit të zhvillimit të gjykimit deri në shkallën e parë dhe nuk është e lidhur ngushtësisht me këtë fazë të procedimit, por me shfaqjen e personit të proceduar në mungesë dhe shprehjen e tij të një vullneti ndryshe, që nuk lidhet me shkallën e gjykimit ku shprehet ky vullnet. Në të kundërt, do të krijohet një dallim i papërligjur midis personit që gjykohet në praninë e tij (*in praesentia*) dhe personit që gjykohet në mungesë të tij (*in absentia*). Dispozita e nenit 48/3, të Kodit të Procedurës Penale, nuk i referohet të drejtës për të patur mbrojtës, por mënyrës dhe zgjedhjes së njërit prej mbrojtësve, si njërën prej alternativave të ofruara objektivisht dhe, për shkak të kësaj natyre, duhet të vazhdojë të mbetet në fuqi deri në manifestimin e një vullneti

ndryshe nga ana e personit të interesuar rreth njëres prej alternativave të tjera më të volitshme për të.

Në këto kushte, pakica shpreh qëndrimin se përkatësisht mbrojtësi i caktuar nga afërmit e personit të interesuar apo mbrojtësi i caktuar kryesisht, duhet të vazhdojë misionin e tij deri në shprehjen e një vullneti tjetër, nga ana e personit në mungesë, pasi pikërisht kjo mënyrë është e parashikuar nga ligji procedural si formë përfaqësimi.

Prokura, si akt përfaqësimi në procedimin penal, është një institut që ka të bëjë me rastet e jashtëzakonshme dhe me ato që janë ndryshe nga regjimi normal i garancive procedurale, siç janë rastet e heqjes dorë, kërkimit të gjykimit të shkurtuar, etj., pra, janë rastet kur kemi të bëjmë me një pakësim të garancive të parashikuara me ligj dhe që njihen objektivisht, pavarësisht vullnetit apo pranisë së personit të pandehur.

Sipas Kushtetutës kushdo ka të drejtë të dëgjohej para se të gjykohej, por nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë, pra, e drejta dhe garancia e individit për një proces të rregull zbatohet objektivisht dhe personi që është në mungesë, duhet dhe mund të mbrohet edhe nga ana e mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit e të akuzuarit ose atij të caktuar kryesisht, sepse në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet që kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Pra, kjo e drejtë konceptohet si garanci objektive dhe nuk konsiderohet si e drejtë vetjake dhe ekskluzive vetëm e personit në mungesë, por edhe një e drejtë autonome e paralele që ligji ia njeh edhe mbrojtësit të caktuar nga familjarët, apo atij të caktuar kryesisht dhe mungesa e një vullneti të personit nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë për të ndalur procedimin penal deri në shkallë të parë, për shkak se akoma nuk është provuar padijenja efektive e personit të deklaruar në mungesë.

Qëllimi i procedurës penale është vendosja e së vërtetës, pra vërtetimi i fakteve ku vërtitet akuza në respektim të garancive të mbrojtjes. Parimi i barazisë së armëve kërkon që mbrojtja dhe akuza të ballafaqohen në pozita thujse të barabarta. Pra, qëllimi i shkallës së dytë të gjykimit dhe shkallës së ligjshmërisë në Gjykatën e Lartë është përkatësisht, për apelin nëse provat janë mbledhur në mënyrë korrekte dhe nëse ato janë interpretuar me saktësi në kuadër të fajësisë apo të pafajësisë së të pandehurit; ndërsa për rekursin, nëse ligji i zbatuar është në mënyrë korrekte apo jo. Duke konsideruar këto premisa, pamundësia për të vazhduar shkallët më të larta, për mungesë legjitimitimi të mbrojtësit, do të përbënte shkelje të së drejtës themelore për t'u mbrojtur me avokat dhe një dallim të papërligjur, për shkak të moslejimit të mbrojtjes nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht ose atij të zgjedhur nga të afërmit e të personit të gjykuar në mungesë.

Shkaqet për të cilat një person mund të gjendet në gjendjen e mungesës mund të jenë të ndryshme, ai mund të mos ketë dijeni naive rreth procedimit penal dhe akuzave ndaj tij, ai me vetëdije mund t'i fshihet drejtësisë, ai mund të ketë vdekur, ose e ka të pamundur fizikisht të komunikojë për shkak të qëndrimit në një vend tejet të largët apo në burg jashtë vendit, sëmundjes a shëndetit, por jo atij mendor; pra, mund të ketë raste jashtë atyre kur për të gjykuarin mund të caktohet një person si kujdestar, ku ai do të gjendet në pamundësi apo në mungesë për të ushtruar të drejtën kushtetuese për t'u mbrojtur. Në këto kushte, në rastin e dhënies së një vendimi në mungesë, ata të cilët mund të ndjekin fatin e mëtejshëm të zhvillimit të procedimit mund të jenë të afërmit e tij, të cilët mund të caktojnë një mbrojtës për t'u kujdesur për gjykimin e mëtejshëm, dhe në mungesë të të afërmit madje edhe vetë mbrojtësi i caktuar kryesisht mund të përfaqësojë interesat e personit të gjykuar në mungesë, duke ankimuar me apel apo rekurs çështjen që i është caktuar. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar ndonjë afat të caktuar përtej të cilit i afërmi i të pandehurit humbet mundësinë për të caktuar mbrojtësin.

Ndryshe nga sa arsyetohet në vendim nga shumica, pakica argumenton se, nisur nga fakti që garancia procedurale për praninë dhe legjitimitimin e mbrojtësit është e natyrës objektive dhe e pavarur nga vullneti i personit të interesuar, - deri sa ai nuk është shprehur ndryshe - legjitimitimi i

mbrojtësit të caktuar nga afërmit apo ai i caktuar kryesisht edhe për ankimimin në shkallë të tjera, është një garanci përbërëse e procesit të rregullt.

Në rastin e gjykimit pas rivendosjes në afat, gjithsesi, ankimet dhe vendimet e dhëna më parë nga mbrojtësi i caktuar nga të afërmit ose nga ai i caktuar kryesisht, nuk kanë më efekte dhe duhet të mbeten pa efekte, nisur nga fakti që rivendosja në afat është një mjet i jashtëzakonshëm, dhe ankimet e mëparshme nuk duhet të përbëjnë ndonjë kontrast me parimin e gjësë së gjykuar apo atë të konsumimit të ankimit.

Vendimet e dhëna në bazë të legjitimitit të mbrojtësit të caktuar nga të afërmit apo ai i caktuar kryesisht mbeten pa efekte, pasi i gjykuari i rivendosur në afat po ushtron të drejtën e tij kushtetuese të mbrojtjes dhe është provuar mosdijenja efektive rreth procedimit penal. Gjithsesi, edhe sikur të konsiderohet teza se vendimi dhënë në bazë të ankimit nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët apo ai i caktuar kryesisht është i formës së prerë, ky përfundim nuk është i mjaftueshëm për të privuar personin e gjykuar në mungesë me vendim të formës së prerë dhe të rivendosur në afat nga mundësia për t'u gjykuar edhe njëherë në prani të tij. Edhe në rastin e shumë vendimeve të formës së prerë në fuqi, kjo situatë ligjore gjen parashikim dhe rregullim në nenin 474 të K.Pr.P, duke favorizuar në çdo rast vendimin e formës së prerë që është më i favorshëm për personin e dënuar.

Sa i takon çështjes së konsumimit të mjeteve të ankimit nga ana e mbrojtësit të caktuar ose atij të zgjedhur nga të afërmit në momentin kur vetë i pandehuri shfaqet dhe është rivendosur në afat dhe çështjes nëse do të ishin përpara gjësë së gjykuar, pakica argumenton se shmangia nga parimi i sigurisë ligjore nëpërmjet rishikimit në kushtet e parashikuara nga ligji ka si qëllim ndreqjen e gabimit gjyqësor në dhënien e drejtësisë dhe kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial detyrues ose kur ka arsye serioze legjitime që janë më me peshë se siguria juridike.

Pakica arsyeton se për sa i takon raportit me gjykimin e rivendosjes në afat, në rastin kur personi i deklaruar në mungesë shfaqet, edhe pse duket se është konsumuar nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht ose e atij të zgjedhur nga të afërmit e të akuzuarit e drejta e ankimit, në masën dhe në momentin kur personi i fshehur provon mosdijeninë efektive të vendimit e të procedurave të zhvilluara në mungesë, efekti i rivendosjes në afat për ankimin e të pandehurit është një zëvendësim më garantues i ankimeve të bëra më parë nga ana e mbrojtësit të caktuar ose e atij të zgjedhur nga të afërmit e të akuzuarit. Pra, rivendosja në afat është një gjykim i jashtëzakonshëm, që me kërkesën e të pandehurit, përbën një vendim të ri që deklaron një pavlefshmëri absolute që ka të bëjë me mosrespektimin e garancisë së një procesi të rregullt sipas Konventës Europiane dhe legjitimon rishtazi personin e pandehur të ushtrojë mjetin e ankimit të kërkuar, duke lënë pa fuqi aktet procedurale të mëtejshme dhe vendimet e mëparshme që tashme nuk janë më të formës së prerë. Në bazë të këtij këndvështrimi, nuk bëhet fjalë për konsumim apo shterje të së drejtës së ankimit, siç pretendohet nga vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë. Sipas kësaj linje arsyetimi legjitimon personin e pandehur të ushtrojë mjetin e ankimit. Pavlefshmëria absolute në fjalë, e cila mund të ngrihet në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, mund të bazohet në nenin 128/c të K.Pr.P, që ka të bëjë me thirrjen e të pandehurit, duke e interpretuar togfjalëshin: “*thirrjen e të pandehurit*” gjerësisht dhe që përfshin të drejtën e personit të akuzuar në mungesë për të marrë pjesë aktivisht në procedimin në ngarkim të tij, për kërkuar prova në favor të tij sipas një interpretimi të orientuar drejt respektimit të vlerave dhe standardeve evropiane dhe kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

Pra, për shkak të kësaj pavlefshmërie absolute, ushtrimi i ankimit dhe akteve të mëpasshme të bëra nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht ose të zgjedhur nga të afërmit nuk do të kishte efekt, dhe në fakt, gjëja e gjykuar për shkak të pamundësisë së marrjes dijeni së të

pandehurit nuk është formuar akoma; prandaj mbrojtësi i caktuar nga vetë i pandehuri mund të ushtrojë, pas rivendosjes në afat, të drejtën e ankimit.

Pakica argumenton se neni 147/2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon kushtin se kur “vendimi” është dhënë në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin. Pra, në dispozitën në fjalë nuk specifikohet vendimi i një shkalle, apo ndonjë kushti kur është bërë nga mbrojtësi i caktuar kryesisht apo ai i zgjedhur nga afërmit.

Për më tepër, ky argumentim gjen mbështetje edhe në nenin 141 të K.Pr.P, sipas të cilit, *i pagjeturi përfaqësohet nga mbrojtësi*. Fakt ky që konfirmon tezën edhe të mundësisë për ta ankimuar me avokat të caktuar kryesisht apo të zgjedhur nga të afërmit, kur nuk ka tjetër alternativë tjetër. I vetmi kufizim për mbrojtësit e caktuar ose ata të zgjedhur nga të afërmit e të akuzuarit mbetet paraqitja e kërkesës për rivendosje në afat, për të cilën ata nuk mund të legjitimohen pa një prokurë të posaçme nga i gjykuari.

Si bazë ligjore në mbështetje të qëndrimit të pakicës dhe për legjitimin mbrojtësit të caktuar nga të afërmit do të ishte neni 351 i K.Pr.P. (deklarimi i mungesës), i cili në mënyrë analoge parashikon se vendimi që deklaron mungesën është *i pavlefshëm* kur provohet se ajo ka ardhur nga mosmarrja e njoftimit ose nga pamundësia absolute për t’u paraqitur. Në qoftë se i pandehuri paraqitet pas shpalljes së vendimit, gjykata *revokon vendimin* që ka deklaruar mungesën. Kur paraqitja bëhet para fillimit të diskutimit përfundimtar, i pandehuri mund të kërkojë të pyetet. Mbeten të vlefshme veprimet e kryera më parë, por kur i pandehuri provon se njoftimi është bërë me vonesë jo për fajin e tij, gjykata urdhëron marrjen ose përsëritjen e veprimeve që çmon se kanë rëndësi për marrjen e vendimit. Edhe objekti i gjykimit të rivendosjes në afat, sipas nenit 147, mund të konsiderohet si vërtetimi pasaktësisë (*rectius*: pavlefshmërisë) së vendimit të deklarimit të mungesës dhe të çdo akti të mëpasshëm, përfshirë ankimin e bërë nga ana e mbrojtësit të caktuar ose e atij të zgjedhur nga të afërmit e të gjykuarit në mungesë.

Praktika e Gjykatës Evropiane vëren se, ndonëse Konventa Evropiane nuk e parashikon për të tri shkallët e gjykimit të drejtën e të akuzuarit për një proces të rregullt e për t’u mbrojtur me avokat, nëse të tri shkallët janë të parashikuara nga sistemi juridik i brendshëm, e drejta e të akuzuarit për një proces të rregullt e për t’u mbrojtur duhet të garantohet në tre shkallët. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e drejta e çdokujt të akuzuar për një vepër penale për t’u mbrojtur efektivisht nga një avokat përbën një nga karakteristikat themelore të procesit penal (rasti Van Geyseghem k. Belgjikës [DhM, 26103/95, 21 Janar 1999], ku Gjykata Evropiane ka parashikuar se edhe pse i pandehuri kishte shumë raste për të mbrojtur veten, ishte detyrë e Gjykatës së Apelit të Brukselit për të lejuar mbrojtësin të merrte pjesë në seancë dhe ta mbronte të pandehurin edhe në mungesë të tij. (Van Geyseghem k. Belgjikës [DhM, 26103/95, 21 Janar 1999, § 35). Kur një i pandehur është gjykuar në *absentia*, neni 6 (3) (c) kërkon që avokati i tij të jetë i pranishëm për të përfaqësuar klientin e tij në mungesë (*Karatas dhe Sari kundër Francës* (2002)), po ashtu edhe në rastin Krombach k. Francës, 29731/96, 13 Shkurt 2001, § 90-91.

Përfundimi i arritur nga ana e shumicës, sipas së cilës ankimi ndaj vendimit të shkallës së parë nga mbrojtësi i caktuar kryesisht apo ai i caktuar nga të afërmit për personin në mungesë nuk është i lejuar kur mungon një vullnet i shprehur i personit të gjykuar në mungesë nuk duket i argumentuar, kjo edhe për faktin se nuk përcakton nëse kemi të bëjmë me vendime themeli, apo çfarëdolloj vendimi.

Le ta ilustrim konkluzionin e arritur nga ana e shumicës, në rastin e caktimit të një mase sigurimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe personi është në mungesë, pasi ka ikur.

Në këto rrethana, moslegjitimimi për të kundërshtuar me mjetin apelit apo të rekursit, vendosjen e masës së sigurimit nga ana e mbrojtësit të caktuar nga të afërmit apo atij të caktuar kryesisht – pa bërë kurrfarë dallimi mes tyre – është evident në kundërshtim me nenin 249 të

K.Pr.P, i cili legjitimon mbrojtësin e personit të hetuar. Pra, në rastin e caktimit të masës sipas nenit 228 të K.Pr.P, pa praninë e mbrojtësit dhe personit të hetuar, mohohet e drejta e këtij të fundit për të bërë ankim në gjykatat më të larta. Ndërkohë, edhe Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.4/2009, ka përcaktuar – pa asnjë dallim – për personin në mungesë, se “në asnjërin rast, e drejta kushtetuese për të ankuar vendimin e gjykatës [së shkallës së parë] nuk mohohet”. Sa i takon shprehimisht nenit 249 të K.Pr.P, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë parashikon që “(...) dispozita e nenit 249 të K.Pr.Penale, kur bën fjalë për të drejtën e ankimit brenda 10 ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës, merr kuptim të plotë jo vetëm për zbatimin, por edhe për njoftimin e vendimit. Është lehtësisht e kuptueshme se ndjekja e procedurës nga organet e procedimit në rastet e mos zbatimit të vendimit për caktimin e masës së sigurimit sjell si përfundim detyrimin për njoftim të të pandehurit lidhur me këtë masë, e për rrjedhojë, automatikisht edhe të drejtën kushtetuese dhe ligjore që brenda një afati të caktuar ai të ankimojë vendimin në një gjykatë më të lartë”. Bazuar sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin unifikues se vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal është një vendim i ankimueshëm edhe nëse ai nuk është zbatuar, me kushtin që personi ndaj të cilit është dhënë vendimi të jetë vënë në dijeni pasi të jetë deklaruar me vendim gjykate ikja e tij. [...] E drejta për të ankuar vendimin e caktimit të masës së sigurimit nga personi, ndaj të cilit është caktuar kjo masë në mungesë, lind brenda 10 ditëve nga njoftimi apo marrja dijeni e vendimit prej tij ose mbrojtësit.

Në rastin konkret, Gjykata e Lartë, mbi rekursin e mbrojtësit të personit të caktuar kryesisht, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, e cila kishte vendosur mospranimin e ankimit (apelit) nga mbrojtësi i caktuar kryesisht, me arsyetimin se ai nuk ishte i legjitimuar për të bërë ankim, duke e konsideruar në fakt si të legjitimuar për të bërë ankim (apel dhe rekurs) mbrojtësin e caktuar kryesisht nga ana e gjykatës.

Gjithashtu, duke iu referuar edhe të drejtës së krahasuar, pakica vëren se vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane nr.317/2009 ka deklaruar paligjshmërinë kushtetuese të nenit 175 të K.Pr.P. italian, paragrafit të dytë (i ngjashëm me nenin 147/2 të Kodit shqiptar të Procedurës Penale), në masën ku nuk parashikohet lejimi i të pandehurit të gjykuar në mungesë për t’u rivendosur në afat, kur ai nuk ka qenë në dijeni të procedimit apo të vendimit, për të ushtruar ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, sipas kushteve të parashikuara nga ligji procedural, edhe kur një ankimim i ngjashëm është bërë më parë nga ana e mbrojtësit të të pandehurit.

Në përfundim, pakica është e mendimit se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nr.228, datë 18.09.2008 duhet të prishej dhe çështja të dërgohej për rigjykim në gjykatën e apelit.

Aleksandër Muskaj

Guxim Zenelaj

Edmond Islamaj

Mirela Fana

Artan Zeneli

Artan Broci

Nr.3 i Regj. Themeltar
Nr.3 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Ardian Dvorani	Kryesues
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Artan Broci	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar

në seancën gjyqësore publike të datës 08.07.2013 morën në shqyrtim çështjen penale nr.3 akti që u përket palëve:

KËRKUES: YLLI ÇELHAKA

OBJEKTI:

Kundërshtimin e urdhrit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë
me nr.43, datë 02.04.2012,
për ekzekutimin e vendimit penal nr.19, datë 24.03.2000,
(nr.36, datë 23.04.2007) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
Baza ligjore: Neni 463/1, 463/2, 464, 467, 470 e 471 të K.Pr.Penale,
Ligji nr.8331, datë 21.04.1998, neni 55.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin e ndërmjetëm të datës 13.06.2012, ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesës.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit brenda afateve ligjore.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.232, datë 25.07.2012, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm nr.13 akti, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë si më poshtë:

Pranimin e kërkesës së të pandehurit Ylli Çelhaka, me objekt kundërshtimin e urdhrin të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr.43, datë 02.04.2012, “për ekzekutimin e vendimit penal nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe anulimin e këtij urdhri për ekzekutimin e vendimit penal, si të pabazuar në ligj.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur rekurs prokurori i Prokurorisë së Apelit Durrës, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Me vendimin e gjykatës së apelit nuk jemi dakord, pasi është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural, është haptazi i paligjshëm, pasi pas prishjes së vendimit të formës së prerë nga Gjykata e Lartë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, i dënuari kthehet në pozitë e të paraburgosurit, bie në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitës përkatëse procedurale por dhe me arsyetimin e vendimit nr.19 (00-2012-279), datë 19.01.2012 të Gjykatës së Lartë.
- Mendojmë se në gjykimin e çështjes konkrete me objekt rishikimin e vendimit penal, jemi para kushteve ekstra procedurale, prandaj dhe dispozitat që lidhen me afatet e paraburgimit dhe procedurën e shqyrtimit të çështjes në tërësi, duhet t’u përshtaten këtyre kushteve, ku në rastin tonë konkret pyetjes së çfarë statusi merr personi pas prishjes së vendimit të formës së prerë e ka dhënë Gjykata e Lartë në vendimin e sipërcituar, për më tepër që pezullimi i vuajtjes së dënimit mund të bëhet ose nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimin të rishikimit ose nga trupi gjykues që gjykon çështjen konkrete.
- Me të drejtë gjykata e shkallës së parë konstaton se në rastin tonë konkret kërkuesi Ylli Çelhaka ka qenë në kushtet duke vuajtur dënimin me burgim, pas ekzekutimit të vendimit të formës së prerë dhe prishja e këtij vendimi nga Gjykata e Lartë me qëllim rishikimin e tij nuk e ndalon vuajtjen e dënimit të kërkuesit, pra shqyrtimi i çështjes me objekt rishikim vendimi do të vazhdojë në kushtet e vuajtjes së dënimit dhe jo në pozitë e paraburgimit.
- Në kuptim të dispozitës së nenit 454/1 të K.Pr.Penale, por edhe të vendimit të Gjykatës së Lartë, vuajtja e dënimit do të ndërpritej nëse do të kishim një vendim për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, ndërsa në rastin tonë konkret nuk kemi urdhër të tillë as nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe as nga gjykata e caktuar për rigjykimin e çështjeve (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë), prandaj bazuar në këto dispozita procedurale dhe në vendimin nr.279/19, datë 19.01.2012, arrihet në konkluzionin se pas pranimit të kërkesës për rishikim i gjykuari do të vazhdojë të vuajë dënimin, pasi vendimi i dënimit të tij është ende i ekzekutueshëm për aq kohë sa nuk është vendosur pezullimi i tij.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Shkëlzen Selimi dhe Mirela Fana; prokurorin Bujar Sheshi, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit; mbrojtësin e kërkuesit Ylli Çelhaka, av.Julian Kola, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit; dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e faktit.

Nga shqyrtimi gjyqësor në të dy shkallët e gjykimin rezultojnë të provuara këto rrethana fakti:

1. I gjykuari Ylli Çelhaka është akuzuar nga organi i ndjekjes penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për kryerjen e veprave penale të “Vrasjes me paramendim” dhe të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal. Kjo akuzë është ngritur pasi në datë 28.10.1997 ka qëlluar me armë zjarri duke vrarë viktimën Ardian Hima.
2. Procesi ndaj këtij të gjykuari është shqyrtuar në të gjitha shkallët e gjykimit duke rezultuar me disa vendime fajësie kundër tij.
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr.19, datë 24.03.2000, pasi ka shqyrtuar në themel kërkimin e organit të akuzës, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Ylli Çelhaka për veprën penale të “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78 i K.Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ylli Çelhaka për veprën penale të “Armëmbajtjes pa leje”, parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, në aplikim të nenit 55 të K.Pr.Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Ylli Çelhaka me 20 vjet burgim...”*
4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin penal nr.141, datë 26.06.2000, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë...”*
5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.471, datë 12.12.2000, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i pandehuri Ylli Çelhaka dhe prokurori si të pabazuar në prova e në ligj”*.
6. Në të tilla rrethana rezulton se vendimi penal nr.19, datë 24.03.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka marrë formë të prerë.
7. Për ekzekutimin e këtij vendimi në datë 16.10.2006 është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr.096 nga Prokurori i Rrethit Gjyqësor Kavajë. Ky vendim rezulton të jetë ekzekutuar në datë 17.10.2006, kohë në të cilën ka filluar llogaritja e vuajtjes së dënimit për të gjykuarin Ylli Çelhaka.
8. I dënuari Ylli Çelhaka ka paraqitur kërkesë për rishikim kundër vendimit të formës së prerë nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, me pretendimin se pas përfundimit të gjykimit janë zbuluar prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi i dhënë është i gabuar.
9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.558, datë 02.06.2010, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës për rishikim të vendimit të të dënuarit Ylli Çelhaka. Prishjen e vendimit nr.471, datë 12.12.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr.141, datë 26.06.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për rigjykim, me tjetër trup gjykues”*.
10. Pasi është regjistruar çështja dhe ka filluar **rigjykimi** në Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë, në seancën e datës 20.07.2011, i pandehuri (kërkuesi) Ylli Çelhaka i është drejtuar gjykatës me kërkesë me objekt: *“Shuarje e masës së sigurimit, si rezultat i humbjes së fuqisë së paraburgimit. Heqjen e masës së sigurimit “Arrest në burg”, caktimin si masë sigurimi atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, bazuar në nenet 261, 260/4, dhe 260/2 të Kodit të Procedurës Penale.*
11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin penal nr.13 akti, datë 20.07.2011, ka vendosur: *“Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit për të pandehurin Ylli Alush Çelhaka. Caktimin për të pandehurin Ylli Çelhaka të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.*

I pandehuri Ylli Alush Çelhaka duhet të qëndrojë në banesën e babait të tij Alush Çelhaka me adresë Lagja nr.5, Rruga "Emigranti" shtëpi private, Kavajë.

Urdhërohet Policia Gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.

Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit Ylli Alush Çelhaka, i biri i Alushit dhe i Verës, i datëlindjes 03.01.1974, nëse nuk mbahet i arrestuar për ndonjë veprë tjetër penale...".

12. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.179, datë 09.08.2011, ka vendosur:

"Lënien në fuqi të vendimit nr.13 akti, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë".

13. Gjykata e Lartë me vendimin nr.19, datë 19.01.2012, ka vendosur:

"Prishjen e vendimit nr.179, datë 09.08.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin nr.13, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe pushimin e gjykimit në lidhje e masën e sigurimit".

14. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, gjatë kohës që çështja është duke u rigjykuar ndaj këtij të gjykuari, ka lëshuar urdhrin me nr.043, datë 02.04.2012 për ekzekutimin e vendimit penal nr.19, datë 24.03.2000 (nr.36, datë 23.04.2007) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

15. Kundër lëshimit të urdhrin të ekzekutimit ka bërë ankim i gjykuari, i cili ka kërkuar pavlefshmërinë e tij duke pretenduar se urdhri i ekzekutimit është i paligjshëm, pasi nuk ka vendim gjykate të formës së prerë apo vendim mase për të realizuar.

II. Procedurat gjyqësore

16. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 13.06.2012, ka vendosur:

"Rrëzimin e kërkesës.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit brenda afateve ligjore.

17. **Gjykata e Apelit Durrës** me vendimin nr.232, datë 25.07.2012, ka vendosur:

"Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm nr.13 akti, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë si më poshtë:

Pranimin e kërkesës së të pandehurit Ylli Çelhaka me objekt kundërshtimin e urdhrin të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr.43, datë 02.04.2012 "për ekzekutimin e vendimit penal nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe anulimin e këtij urdhri për ekzekutimin e vendimit penal, si të pabazuar në ligj".

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë,

18. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur **rekurs prokurori** i Prokurorisë së Apelit Durrës, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, duke parashtruar shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit.

III. Arsyetimi i vendimit te ankimuar.

19. Gjykata e Apelit Durrës e ka gjetur të pabazuar në ligjin procedural vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke arsyetuar: "*...Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në interpretim të gabuar të ligjit ka konsideruar vendim penal dënimi me burgim të formës së prerë për të pandehurin Ylli Çelhaka, vendimin nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, vendim i cili rezulton të jetë prishur me vendimin penal nr.00-2010-1084 (558), datë 02.06.2010 të Gjykatës së Lartë, duke e kthyer çështjen në ngarkim të të pandehurit Ylli Çelhaka për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më tej gjykata vazhdon: "...bazuar në N.443 Gjykata e Lartë nuk ka disponuar në dispozitivin e saj se çështja duhet të priset pjesërisht, atëherë konkludohet se vendimi është prishur në tërësi; ..në rastin në shqyrtim m.q.s. çështja rezulton të jetë kthyer për rigjykim, duke prishur vendimet penale nr.471, datë 12.12.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr.141, datë*

26.06.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe vendimit nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr.00-2010-1084 (558), datë 02.06.2010 të Gjykatës së Lartë, atëherë i dënuari Ylli Çelhaka ka rimarrë cilësinë e të pandehurit... Kjo gjykatë konkludon se i njëjti person nuk mund të marrë njëkohësisht dy cilësi si subjekt procedural penal në të njëjtin procedim penal dhe për të njëjtin fakt penal. Nga gjykata e shkallës së parë është njohur, cilësuar dhe proceduar shtetasi Ylli Çelhaka, si “i pandehur” dhe në vendimin e ndërmjetëm të datës 13.06.2012 e cilëson atë si “të dënuar”, me vendimin penal nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për të njëjtin fakt juridik penal...”

20. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se ka interpretime jo të njëjta në lidhje me pozicionin e të gjykuarit mbasi kërkesa për rishikim pranohet, vendosi që për njehsimin e praktikës gjyqësore, në këtë drejtim, çështjen penale që i përket kërkuetit Ylli Çelhaka ta kalojë në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

IV. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara dhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara.

21. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore vlerësohen të jenë:
- Në rast se kërkesa për rishikim të vendimit të dënimit pranohet sipas nenit 453/3 të Kodit të Procedurës Penale⁸³, cila do të jetë pozita procedurale e të gjykuarit në fazën e rigjyimit të çështjes?
 - Në rast se vendimi i fajësisë pas rigjyimit të çështjes ndryshohet, ose i gjykuari shpallet i pafajshëm, cila do të jetë pozita procedurale nëse vazhdon procesi gjyqësor kundër tij?
22. Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me çështjet që duhet të unifikohen për efekt të njehsimit të praktikës dhe të pasojës që ka në lidhje me zgjidhjen e çështjes:

Prokurori mbajti qëndrimin se: “statusi i kërkuetit për rishikim të vendimit të dënimit, pas prishjes së vendimeve, mbetet po ai i të dënuarit dhe në kushtet kur dispozitat e Kreut IV të K.Pr.Penale, në nenet 449 deri 460 të tij, nuk parashikojnë shprehimisht marrjen e masave të sigurimit personal (ndryshe nga disa legjislacione të ngjashme të disa vendeve të tjera që zbatojnë institutin e rishikimit), atëherë mbetet të bëhet interpretimi i këtyre dispozitave për të përcaktuar se në çfarë regjimi sigurimi do të mbetet i gjykuari deri në pritjen e vendimit përfundimtar”.

Mbrojtësi i të gjykuarit Ylli Çelhaka mbajti qëndrimin se: “nga momenti që Gjykata e Lartë ka vendosur rishikimin e vendimit penal dhe çështja është dërguar për t’u rigjykuar, i pandehuri ka marrë cilësinë e të pandehurit në bazë të N.34/3 të K.Penal, i cili parashikon se: Cilësia e të pandehurit rimerret kur prishet vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit. Ç’ka do të thotë se nga data 02.06.2010 mbi Ylli Çelhakën nuk ka rënduar një dënim penal me një vendim të formës së prerë dhe kështu në mungesë edhe të një mase sigurimi a mundet që ky i pandehur të qëndrojë në paraburgim për efekt të dënimit të mëparshëm”.

23. Kolegjet e Bashkuara e gjejnë me vend që paraprakisht është e nevojshme që, për t’i dhënë përgjigje çështjeve të shtruara për unifikim, të trajtojë paraprakisht institutin e rishikimit i cili gjen rregullim në titullin VIII, kreun IV të K.Pr.Penale.
24. Rishikimi është mjet ankimi i jashtëzakonshëm dhe përjashtimor kundër një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë, i cili nuk mund të kundërshtohet nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit (apeli dhe rekursi). Në këto kushte, kur janë shterur mjetet e zakonshme të ankimit,

⁸³ Neni 453/3 “Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë”

Kur kërkesa pranohet, Kolegji Penal vendos prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Vendimi është i formës së prerë.

vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohet e mbyllur në bazë të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*). Në nenin 449 të K.Pr.Penale⁸⁴ përcaktohet se cilët vendime mund të jenë objekt rishikimi.

25. Në nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se: “*Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj*”.
26. Në këtë normë kushtetuese janë parashikuar tre nga parimet më të rëndësishme të procedurës penale: *i*) parimi i mos gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) *ii*) parimi i sigurisë ligjore (*res judicata*) dhe *iii*) mundësia e rihapjes së çështjes penale si mundësi shmangie nga parimi i sigurisë ligjore.
27. Në lidhje me parimin e tretë mundësia e rihapjes së çështjes penale përcaktohet se ai mund të lejohet sipas rregullave të parashikuara në ligj dhe konkretisht në Kodin e Procedurës Penale. Në kapitullin e VIII-të “Ankimet”, Kreun IV është parashikuar “Rishikimi” si mjet i jashtëzakonshëm për të goditur një vendim përfundimtar, d.m.th. të cilit i kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit.
28. Shmangia nga parimi i sigurisë ligjore nëpërmjet rishikimit në kushtet e parashikuara nga ligji ka si qëllim ndreqjen e gabimit gjyqësor në dhënien e drejtësisë. Në lidhje me këtë çështje GJEDNJ-ja në disa çështje^{85,86} është shprehur se: “*Gjykata vlerëson se kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial detyrues, ose kur ka arsye serioze legjitime që janë më me peshë se siguria juridike*”.
29. Rishikimi, si mjet ankimi i jashtëzakonshëm, është përfshirë në kreun IV ku janë parashikuar vendimet që mund të rishikohen, rastet e rishikimit, subjektet e legjitimuara, forma e paraqitjes, gjykimi dhe disponimi i Gjykatës së Lartë si gjykatë kompetente e caktuar me ligj për shqyrtimin e kërkesës për rishikim.
30. Karakteri “*extra ordinem*” i rishikimit del qartë nga vendosja e tij si mjet ankimi jashtë dhe përtej procesit të zakonshëm penal. Ndërkohë ankimi dhe rekursi si mjete ankimi në K.Pr.Penale, ndryshe nga rishikimi, janë përfshirë në fazat e procesit penal të gjykimit si mjete shteruese që çojnë në dhënien e një vendimi gjyqësor përfundimtar me pasojë zgjidhjen e çështjes.
31. Rishikimi si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, sipas nenit 451 të K.Pr.Penale⁸⁷, mund të jetë *i) extra ordinem pro reo* ose *ii) contra reum*.
32. Në rastin e parë *pro reo* rishikimi bëhet me kërkesë të të dënuarit me qëllimin për të provokuar një rivlerësim të së vërtetës në drejtimin e kundërshtimit të vendimit të fajësisë dhe të mundësisë që rihapja e procesit sjell potencialisht mundësinë e dhënies së një vendimi pafajësie. Në themel të rishikimit qëndron parimi se drejtësia duhet të jetë e vërtetë duke thyer kornizat procedurale të mbylljes përfundimtare të gjykimit.

⁸⁴ N.449 i K.Pr.Penale “**Vendimet që mund të rishikohen**”

1. Në rastet e caktuara me ligj lejohet në çdo kohë rishikimi i vendimeve që kanë marrë formën e prerë, edhe kur dënimi është ekzekutuar ose është shuar.

2. Vendimet e pafajësisë për krime mund të rishikohen me kërkesën e prokurorit, por me kusht që të mos kenë kaluar 5 vjet nga dhënia e vendimit.

⁸⁵ Ryabykh kundër Rusisë nr.52854/99, fq.52, ECHR 2003-IX).

⁸⁶ Bratyakin kundër Rusisë nr.53203/99, fq.63-68, 15 Dhjetor 2005,

⁸⁷ N.451 i K.Pr.Penale “**Kërkesa e rishikimit**”

1. Mund të kërkojnë rishikimin: a) i dënuari ose kujdestari i tij, dhe kur ai ka vdekur, trashëgimtari ose një i afërm i tij; b) prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin.

33. Karakteri i jashtëzakonshëm i rishikimit si mjet ankimi del edhe nga fakti se ligjvënësi nuk e ka kufizuar brenda një afati kohor, ndërkohë që mjetet e zakonshme të ankimit duhet të paraqiten brenda afateve strikte kohore me pasojë papranueshmërinë e tyre.
34. Në rastin e rishikimit me kërkesë të prokurorit *contra reum* ka për objekt një vendim të gabuar pafajësie, i cili në këtë rast i shërben dhënies së drejtësisë me qëllimin e ndëshkueshmërisë së autorëve që kryejnë krime dhe për faj të sistemit gjyqësor ngelen të pandëshkuar. Në këtë rast qëllimi është që personat e deklaruar të pafajshëm me pa të drejtë të rigjykoen dhe të dënohen për krimet e kryera, për pasojë procesi i ri i gjykimit mund të sjellë rendimin *in pejus* të dënimit. Ndryshe nga rasti i rishikimit që bëhet nga i dënuari, ligjvënësi e ka kufizuar në kohë kërkesën e prokurorit për të rishikuar një vendim pafajësie në një afat kohor prej 5 vjetësh, duke filluar ky afat nga dita e dhënies së këtij vendimi (neni 449/2 i K.Pr.Penale).
35. Shkaqet për të cilat mund të kërkohet rishikimi i një vendimi përfundimtar janë në funksion të qëllimit (*ratio*), i cili është dhënia fund pasojave të një vendimi të padrejtë i cili është përfundimtar.
36. Gjykimi i iniciuar nëpërmjet një kërkesë rishikimi në mënyrën se si është rregulluar në K.Pr.Penale në fuqi, ky institut kalon në dy faza procedurale, të cilat në varësi të faktit nëse kërkesa do të pranohet ose jo zhvillohen si faza të të njëjtit proces: e para është vlerësuese dhe e dyta gjykuese.
37. Faza vlerësuese zhvillohet në Gjykatën e Lartë e cila investohet mbi bazën e kërkesës së të gjykuarit (si edhe të personave të lidhur me të) ose të prokurorit, në të cilën vlerësohet nëse kërkesa për rishikim ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 450 të K.Pr.Penale⁸⁸.
38. Kërkesa për t'u marrë në shqyrtim duhet të jetë e arsyetuar plotësisht mbi bazën e shkakut ligjor mbi të cilin ka lindur rishikimi i vendimit, e shoqëruar domosdoshmërisht me dokumentet provues të cilat mbështesin pretendimin. Në këtë fazë të procesit rishikues Kolegji Penal në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, bën një vlerësim paraprak të karakterit formal dhe të ndikueshmërisë thelbësore që këto akte mund të kenë nëse shqyrtohen si prova nëse i hapet rrugë gjykimit rishikues.
39. Mandej kur kërkesa deklarohet e pranueshme, shqyrtimi i pranueshmërisë së kërkesës me qëllimin për t'i hapur rrugë rishikimit bëhet në prani të palëve, të cilët lejohen të debatojnë vetëm mbi shkaqet e rishikimit dhe jo mbi drejtësinë e vendimit që do të rishikohet.
40. Kjo fazë është thelbësore pasi përbën gjykimin e rishikimit në mënyrën *strictu sensu*. Nëpërmjet debatit të palëve dhe vlerësimit të shkaqeve ligjore të përcaktuara në mënyrë të qartë, si dhe të dokumenteve provues në këtë fazë vlerësohet se këto akte vetëm ose të interpretuara bashkërisht janë në gjendje të japin një rezultat të ndryshëm të fajësisë apo të pafajësisë nga vendimi i cili rishikohet. Nëse kërkesa gjendet e bazuar në ligj atëherë me vendim Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i hap rrugë rishikimit të vendimit të formës së prerë.
41. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pavarësisht se në nenin 453/3 të K.Pr.Penale është përcaktuar se: ”3. Kur kërkesa pranohet, Kolegji Penal vendos prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim....” në interpretimin integral të dispozitave të K.Pr.Penale si dhe të funksionit të institutit të rishikimit termi “*prishje e vendimit*” nuk ka të bëjë me aspektin rishikues dhe atë kontrollues të gjykatave më të ulëta siç ndodh gjatë *iterit* të zakonshëm dhe të parashikuar në kapitullin e Gjykimit në Gjykatën e Lartë, por ka të bëjë me hapjen rrugë të procesit rishikues të një vendimi të formës së prerë. Për rrjedhojë, përfshi edhe

⁸⁸ N.450 i K.Pr.Penale “Rastet e rishikimit”

1. Rishikimi mund të kërkohet: a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë; b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas; c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar; ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

pasoja juridike që prodhon, vendimi që do të rishikohet mbas pranimit të kërkesës për rishikim vazhdon të jetë në fuqi për të dënuarin. Ky përcaktim mbështet nga neni 454 të K.Pr.Penale, në të cilën parashikohet se: “1. *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe gjykata e caktuar për rigjykimin e çështjeve mund të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të vendimit*”.

42. Në bazë të këtij rregullimi të pasojave juridike që vijnë nga vendimi i pranimit të kërkesës për rishikim, pranimi i kërkesës për rishikim dhe hapja rrugë e procesit të rishikimit mund të sjellë eventualisht edhe pasoja të menjëhershme në mënyrë incidentale për të dënuarin *in vinculis*, në lidhje me pezullimin e mëtejshëm të pasojave që vijnë nga ekzekutimi i mëtejshëm i vendimit, përfshi edhe vuajtjen e mëtejshme të dënimit me burgim.
43. Çështja e *status libertatis* në interpretim të përcaktimit që i jep ligji në rastin kur kërkesa për rishikim pranohet si një mundësi dhe jo si detyrim për gjykatën për të vendosur në favor të pezullimit të dënimit, e bën atë një kërkesë e cila mund të jetë autonome për të cilën mund të shprehet Kolegji Penal në fazën e pranimit të kërkesës dhe nga gjykata përkatëse në varësi të gjykatës që po zhvillon gjykimin rishikues dhe të fazës së këtij gjykimi me pasojë ekzekutimin e menjëhershëm dhe pa të drejtë ankimi.
44. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në përgjigje të çështjeve të shtruara për diskutim me qëllimin unifikimin e praktikës gjyqësore, arrijnë në qëndrimin unifikues se: **Në rastin kur kërkesa e të dënuarit pranohet dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në bazë të kompetencës rishikuese që ka sipas nenit 453 të K.Pr.Penale i hap rrugë procesit gjyqësor të rishikimit, i gjykuari do të vazhdojë të ketë statusin procedural të të dënuarit. Pranimi i kërkesës për rishikim nuk pas sjell në vetvete revokimin e dënimit as edhe lirimin e të dënuarit, por vetëm rihapjen e procesit gjyqësor për efekt të sqarimit të rrethanave të reja me qëllim që vendimi gjyqësor t’i përgjigjet të vërtetës. Ky fakt do të ndodhë vetëm nëse në zbatim të nenit 454 të K.Pr.Penale Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ose gjykata kompetente e cila do të gjykojë çështjen në rishikim, e çmon të nevojshëm pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur nga ecuria e procesit penal vazhdimi i mëtejshëm i vuajtjes së dënimit me burgim do të vinin pasoja të rënda të pariparueshme.**
Pranimi i kërkesës për rishikim nuk e ndryshon pozitën procedurale nga ajo e të dënuarit në atë të të pandehurit.
Në rast se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i hap rrugë rishikimit dhe në gjykimin rishikues në gjykatën e shkallës së parë i gjykuari deklarohet i pafajshëm pozicioni procedural i subjektit nuk është më ai i të dënuarit, por i të pandehurit. Kjo gjendje (statusi i të pandehurit) do të vazhdojë derisa vendimi i ri i pafajësisë i dhënë mbas rishikimit të marrë formë të prerë.
45. Gjykimi rishikues, mbasi i hapet rrugë kërkesës së rishikimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ose në gjykatën e apelit kur kërkesa bëhet vetëm kundër këtij vendimi (neni 453/3 i K.Pr.Penale).
46. Shqyrtimi i ri gjyqësor rishikues si rregull zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë në një gjykim publik. Rregullat procedurale që ndiqen janë ato të parashikuara në kapitullin e gjykimin të shkallës së parë, duke mbajtur parasysh veçoritë e gjykimin rishikues.
47. Rishikimi i vendimit, duke qenë mjet i jashtëzakonshëm ankimi i një vendimi të formës së prerë, nuk pas sjell pavlefshmërinë e provave të marra dhe të përdorura në vendimin që do të rishikohet. Veçoria e këtij gjykimi qëndron në marrjen e atyre provave të cilat kanë shërbyer si shkak për pranimin e rishikimit.
Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se gjykata që rishikon çështjen është e detyruar të marrë në rivlerësim provat të cilat kanë shërbyer në dhënien e vendimit pa ju futur

edhe një herë shqyrtimit të tyre dhe duke e përqendruar hetimin gjyqësor vetëm në ato prova të cilat kanë shërbyer si objekt i kërkesës për rishikim e që janë përdorur si shkak për pranimin e rishikimit.

Në këtë proces rishikues vlerësimi i provave të reja do të jetë në tërësi së bashku me provat e tjera të shqyrtuara më parë me qëllimin që provat e reja së bashku ose në mënyrë të veçantë të çojnë gjykatën në konfirmimin e vendimit të parë që rishikohet,, ose në një vendimmarrje të ndryshme.

48. Në rastin kur vendimi i rishikuar prishet atëherë vendimi i ri i pafajësisë në rast se kërkesa e rishikimit bëhet nga i dënuari pas sjell efektet juridike të cilat çojnë edhe në ndryshimin e statusit të të gjykuarit në atë të pandehurit, duke e futur procesin në *iter* të zakonshëm duke i dhënë të drejtën e ankimit dhe të kontrollit gjyqësor nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit. Në rast se kërkesa për rishikim rrëzohet dhe konfirmohet dënimi për të gjykuarin dhe është disponuar pezullimi i ekzekutimit, atëherë ky vendim i humbet fuqitë dhe do të procedohet me vazhdimin e vuajtjes së dënimit me burgim.
49. **Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke ju kthyer zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi në bazë të qëndrimit unifikues, konstatojnë se vendimi i gjykatës së apelit në lidhje me anulimin e urdhrin të prokurorit për ekzekutimin e dënimit me burgim të caktuar me vendimin nr.19, datë 24.03.2000 është marrë në kuptim dhe zbatim të gabuar të ligjit procedural penal në lidhje me pozitën procedurale të të gjykuarit Ylli Çelhaka, mbasi vendimi penal i dënimit është bërë objekt rishikimi.**
50. Në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se i gjykuari Ylli Çelhaka është deklaruar fajtor me vendimi penal të formës së prerë për veprën penale të vrasjes me dashje dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 78 dhe 278/2 të Kodit Penal. Ky vendim është bërë objekt rishikimi mbi bazën e kërkesës së të dënuarit, kërkesë e cila është pranuar nga Kolegji Penal, i cili ka vendosur t'i prishë vendimet duke i hapur rrugë rishikimit dhe dërgimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë si gjykata kompetente. Nuk rezulton që as Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe as gjykata e cila po gjykon çështjen mbasi rishikimit të ketë disponuar me vendimin për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.
51. Gjatë gjykimit rishikues në shkallë të parë, i dënuari Ylli Çelhaka ka ngritur pretendimin se vendimi i dënimit me burgim është prishur dhe vuajtja e dënimit nuk duhet të vazhdojë. Për këtë shkak ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe caktimin e masës së sigurimit detyrim paraqitje. Kjo kërkesë, e cila është paraqitur gjatë rishikimit të vendimit, është pranuar nga të dy gjykatat e faktit duke i caktuar si masë sigurimi “arrest në shtëpi” me arsyetimin se statusi i tij ka ndryshuar nga “i dënuar” në “i pandehur” dhe për shkak të plotësimit të afatit tërësor të paraburgimit.
52. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e prokurorit, e ka marrë në shqyrtim çështjen duke vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës për shkak të interpretimit të gabuar që gjykatat i kanë bërë statusit procedural të të dënuarit. Më pas i gjykuari ka kundërshtuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori, duke pretenduar se vendimi për të cilin kërkohet ekzekutimi pas hapjes së procedurës së rishikimit nuk është më i ekzekutueshëm.
53. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vazhdim të qëndrimit unifikues të përmendur më sipër, çmojnë se vendimi i gjykatës së apelit është i gabuar dhe jo në interpretim të drejtë të ligjit dhe për pasojë duhet të prishet duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.
54. Ky vendim ka ardhur si rezultat i moskuptimit të drejtë të pozicionit procedural të të dënuarit Ylli Çelhaka mbasi është pranuar kërkesa për rishikim. Konstatohet nga aktet se megjithëse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar kërkesën për rishikim të Ylli Çelhakës nuk ka disponuar në vendim për pezullimin e ekzekutimit të mëtejshëm të dënimit. Po ashtu edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë gjatë rishikimit të çështjes nuk ka disponuar me vendim

pezullimi; fakte këto që nuk i ndërpresin pasojat që vijnë nga vendimi nr.19, datë 24.03.2000 dhe vendimit nr.141, datë 26.06.2000 që kërkohet të rishikohen, përfshi edhe vuajtjen e dënimit me burgim.

55. Megjithëse pozicioni procedural i të gjykuarit Ylli Çelhaka si i dënuar është sqaruar nga Kolegji Penal në vendimin e rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi, përsëri nga Gjykata e Apelit Durrës në kërkesën për rrëzimin e kërkesës është arsyetuar në drejtim të humbjes së fuqisë ekzekutive të vendimit për shkak të rishikimit të tij. Ky vlerësim është i gabuar pasi, ashtu siç arsyetohet më lart, i gjykuari Çelhaka vazhdon të ketë statusin e të dënuarit edhe në fazën e vlerësimit të kërkesës së tij për rishikim dhe për aq kohë sa në bazë të nenit 454/1 të K.Pr.Penale nuk është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit, ai do të vazhdojë të vuajë dënimin me burgim.
56. Urdhri i ekzekutimit të vendimit të dënimit është akt procedural të cilin ligji ia jep prokurorit si subjekt procedural i cili ndjek dhe zbaton ekzekutimet e vendimeve gjyqësore. Lëshimi i tij bëhet në rastet e parashikuara nga neni 462 i K.Pr.Penale⁸⁹, ku një ndër to është edhe ekzekutimi i vendimit të formës së prerë. Siç rezulton nga aktet në lidhje me ekzekutimin e vendimit nr.19, datë 24.03.2000 të Gjykatës së Rrethit Kavajë prokurori rezulton të ketë lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit datë 16.10.2006. Ky vendim rezulton të jetë ekzekutuar në datë 17.10.2006, kohë në të cilën ka filluar llogaritja e vuajtjes së dënimit për të gjykuarin Ylli Çelhaka. Mbas lirimit të të gjykuarit me vendimin gjyqësor nr.13, datë 10.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, i cili është vendim me ekzekutim të menjëhershëm i gjykuari Ylli Çelhaka ka fituar lirinë e përkohshme. Vendimi është konsideruar i padrejtë dhe është rrëzuar kërkesa nga Kolegji Penal për kalimin e tij nga vuajtje dënim për efekt të vendimit të formës së prerë në masë sigurimi. Në rregullim të pasojave që sjell ky vendim prokurori ka lëshuar urdhrin e ri të ekzekutimit për vazhdimin e vuajtjes së dënimit.
57. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se Gjykata e Apelit të Durrësit ka gabuar në interpretimin e nenit 454 të K.Pr.Penale në lidhje me statusin e kërkuesit Ylli Çelhaka gjatë rishikimit duke e konsideruar si të pandehur. Ashtu siç është përmendur më lart, prishja e vendimit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim, duke qenë se rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm i cili jep mundësinë e vlerësimit të vendimit gjyqësor dhe jo të procesit gjyqësor, ka të bëjë vetëm me efektet e pranimit të kërkesës për rishikim dhe të drejtën që ka gjykata kompetente për të vlerësuar drejtësinë procedurale me qëllimin që të korrigjohet gabimi që ka ardhur duke arritur në një konkluzion që i përgjigjet të vërtetës.
58. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka përcaktuar pozicionin procedural të kërkuesit si i dënuar në lidhje me kërkesën e tij dhe në kushtet kur nuk kishte një vendim të posaçëm në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ka rrëzuar kërkesën e tij për anulimin e urdhrin të ekzekutimit. Arsyetimi ligjor i kësaj gjykate mbështetet në të drejtën që ka prokurori që, në varësi të statusit procedural që ka i gjykuari, në efektet e vendimit gjyqësor të procedojë në ekzekutimin e tij nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit.

V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

59. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe si i tillë do të priset duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

⁸⁹ N.462 /1 K.Pr.Penale “Vendimet e ekzekutueshme”

1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 438/2 e 444/1, germa “d” të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.232, datë 25.07.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr.13 akti, datë 13.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim është unifikues dhe njehson praktikën gjyqësore për çështjet objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 08.07.2013

MENDIM PAKICE

Ne, gjyqtarët **Majlinda Andrea** dhe **Medi Bici**, jemi pjesërisht kundër vendimit nr.03, datë 08.07.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përsa i përket pozitës procedurale që merr i dënuari pas prishjeve të vendimeve të gjykatave si pasojë e pranimit të kërkesës së rishikimit nga Gjykata e Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, prandaj, në përputhje me nenin 112/5 të K.Pr.Penale, përpilojmë këtë procesverbal përmbledhës me motivet e kundërshtimit të vendimit.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes ka rezultuar si më poshtë:

Kërkuesi Ylli Çelhaka është akuzuar nga organi i prokurorisë për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal për ngjarjen e ndodhur më datë 28.10.1997 në Rrethin e Kavajës, ku ka mbetur i vrarë me armë zjarri viktima Ardian Hima.

Me vendimin nr.19, datë 24.03.2000 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë e ka deklaruar fajtor të pandehurin Ylli Çelhaka për veprat penale për të cilat akuzohej, duke e dënuar atë përfundimisht me 20 vjet burgim, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës dhe është vendosur mospranimi i ankimit në Gjykatën e Lartë.

Me datën 16.10.2006 Prokuroria pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka lëshuar Urdhrin e ekzekutimit për vendimin e formës së prerë, i cili është ekzekutuar nga organet kompetente me datë 17.10.2006, kohë kur ka filluar edhe llogaritja e dënimit për kërkuesin Ylli Çelhaka.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.558, datë 02.06.2010 ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim të paraqitur nga i dënuari Ylli Çelhaka, duke prishur vendimet e gjykatave dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjatë rigjykimit në shkallë të parë, kërkuesi ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg me pretendimin se ajo e ka humbur fuqinë për shkak të kalimit të afatit të përgjithshëm të paraburgimit, të parashikuar nga neni 261 e vijues i K.Pr.Penale.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin nr.13 akti, datë 20.07.2011 ka vendosur konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit të arrestit në shtëpi, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.19, datë 19.01.2012 ka vendosur prishjen e vendimeve të mësipërme dhe pushimin e gjykimit të çështjes në lidhje me masën e sigurimit të arrestit në burg.

Në zbatim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka lëshuar Urdhrin e ekzekutimit që është ankuar nga kërkuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila në përfundim të gjykimit ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim që është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila ka pranuar kërkesën e kërkuesit, duke anuluar Urdhrin e ekzekutimit të lëshuar nga prokuroria me datë 02.04.2012, me të cilin kërkohet që të ekzekutohet edhe një herë vendimi nr.19, datë 24.03.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Pakica ndan të njëjtin mendim me shumicën në lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore, por nuk është e të njëjtit mendim me të përsa i përket pozitës procedurale që merr personi që ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë, i cili është prishur më pas nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë si pasojë e pranimit të kërkesës për rishikim.

Është e vërtetë që rishikimi i vendimit është një mjet ankimi i jashtëzakonshëm, me anë të cilit i dënuari mund të mbrohet ndaj vendimeve penale të formës së prerë, por ndryshimi ndërmjet tij dhe rekursit ndaj vendimit të formës së prerë nuk është ai që arsyetojnë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku sipas tyre rishikimi ndaj vendimeve të formës së prerë, i parashikuar nga neni 432 i K.Pr.Penale, i prish në “substancë” vendimet e gjykatave, ndërsa instituti i rishikimit nuk e ka një fuqi të tillë.

Pakica vlerëson se rishikimi ashtu edhe rekursi ndaj vendimeve të formës së prerë, i parashikuar nga neni 432 i K.Pr.Penale, janë mjete ankimi që mund të përdorin palët ndaj vendimeve të formës së prerë, prandaj në këtë kuptim ato nuk kanë ndonjë ndryshim nga njëri-tjetri.

Sipas vlerësimit të pakicës ndryshimi ndërmjet tyre qëndron në faktin se rekursi ndaj vendimit të formës së prerë, i parashikuar nga neni 432 i K.Pr.Penale, paraqitet vetëm ndaj vendimeve të formës së prerë të dhëna nga gjykata e apelit, ndërsa rishikimi, i parashikuar nga neni 449 e vijues i K.Pr.Penale, mund të kërkohet ndaj vendimeve të formës së prerë të dhëna nga të gjitha gjykatat.

Ndryshimi tjetër ndërmjet tyre qëndron në faktin se ato paraqiten për shkaqe të ndryshme nga njëri-tjetri, sepse rekursi ndaj vendimit të formës së prerë paraqitet për shkaqet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, ndërsa kërkesa për rishikim paraqitet vetëm për shkaqet e parashikuara nga neni 450 i K.Pr.Penale, por duhet theksuar se në rastin e pranimit të tyre rezultati është gjithmonë i njëjtë, që është prishja e vendimeve të formës së prerë nga ana e Gjykatës së Lartë.

Pakica vlerëson se arsyetimi që bën shumica bie në kundërshtim me Kreun e IV-t të K.Pr.Penale (neni 449 e vijues i K.Pr.Penale), pasi sipas ligjit tonë procedural penal, Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim nuk vendos vetëm për pranimin ose jo të kërkesës për rishikim dhe disponimin mbi vendimin e themelit ua delegon gjykatave më të ulëta, përkundrazi, ajo pasi pranon kërkesën për rishikim prish vendimet e dhëna nga të gjitha gjykatat e tre niveleve dhe më pas e dërgon çështjen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

Nëse Gjykata e Lartë do të vendoste vetëm pranimin e kërkesës për rishikim, pa disponuar mbi vendimet e marra nga gjykatat, atëherë pakica do të pajtohej plotësisht me vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por kështu siç është formuluar Kreu i IV^t në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë nuk lihet asnjë hapësirë për të bërë interpretimin që ka bërë shumica, sepse pas pranimit të kërkesës për rishikim dhe prishjes së vendimeve nga Gjykata e Lartë nuk ekziston më asnjë vendim dënimi, prandaj personi ndaj të cilit vazhdon procedimi penal menjëherë pas pranimit të kërkesës për rishikim dhe prishjes së vendimeve nga

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë merr automatikisht cilësinë e të pandehurit dhe gëzon të gjitha të drejtat e tij gjatë proceseve të mëpasshme gjyqësore.

Me këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, por ato nuk e kanë sqaruar gjykatën e rishqyrtimit të çështjes se si do ta konsiderojë ajo kërkuesin Ylli Çelhaka gjatë rishqyrtimit të çështjes në shkallë të parë (të pandehur, të gjykuar apo të dënuar), në një kohë që ndaj tij nuk ekziston asnjë lloj vendimi dënimi.

Nga ana tjetër shumica nuk arsyeton në vendim se si do të jetë pjesa hyrëse e vendimit përfundimtar që do të japë gjykata e shkallës së parë pas rishqyrtimit të çështjes (si do të quhet kërkuesi: i dënuar, i gjykuar apo i pandehur) dhe nuk shpjegon se si do të jetë dispozitivi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në një kohë kur në arsyetimin e vendimit thuhet se: *kur gjykata e shkallës së parë prish vendimet dhe jep pafajësi masa e sigurimit shuhet.*

Pakica vlerëson se qëndrimi që mban shumica është i pabazuar në ligj, sepse gjatë rishqyrtimit të çështjes në shkallë të parë kërkuesi duhet të mbajë cilësinë e të pandehurit, gjykata e shkallës së parë në përfundim të gjykimit nuk mund të shprehet për prishjen e vendimeve, pasi ato i ka prishur më parë Gjykata e Lartë, por ajo duhet t'i hyjë shqyrtimit në themel të çështjes, duke marrë edhe provat e reja të pretenduara nga palët gjatë rishikimit dhe në përfundim duhet të dalë me vendim fajësie, pafajësie, ose kur janë rastet e parashikuara nga nenet 387 dhe 328 të K.Pr.Penale vendos pushimin e çështjes penale.

Arsyetimi i mësipërm e çon pakicën në përfundimin se rishikimi i vendimit si mjet i jashtëzakonshëm ankimi ndaj vendimeve të formës së prerë duhet të shqyrtohet me shumë kujdes, duke mos e kthyer atë në një mjet të zakonshëm mbrojtje, sepse në rast pranimit të kërkesës për rishikim sipas ligjit tonë procedural penal të gjitha vendimet e dënimit të dhëna nga gjykatat nuk ekzistojnë më, prandaj rezultati i tij është i njëjtë si në rastin e pranimit të rekursit ndaj vendimeve të formës së prerë, të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale ku personi i dënuar pas prishjes së vendimit të formës së prerë merr cilësinë e të pandehurit.

Në raste të tilla gjykata e rishqyrtimit të çështjes, edhe kryesisht, është e detyruar që të verifikojë shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg, të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale dhe, nëse konstaton ndonjërin prej rasteve të parashikuara nga neni 261 i K.Pr.Penale, ajo është e detyruar që të vendosë shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg, sepse në të kundërt shkelet neni 27/1 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe neni 5 i Konventës së të Drejtave të Njeriut, të cilat parashikojnë se askush nuk mund të mbahet në burg pa pasur një vendim dënimi të dhënë nga gjykata, në një kohë që masa e sigurimit e vendosur nga gjykata për veprat penale që akuzohet i dënuari është shuar në përputhje të plotë me nenin 261 të K.Pr.Penale.

Për të gjitha këto u thanë më sipër, pakica është plotësisht e bindur se vendimi nr.3, datë 08.07.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në pjesën që unifikon praktikën gjyqësore në lidhje me cilësinë që merr personi i dënuar pas pranimit të kërkesës së tij për rishikimin e vendimeve dhe prishjes së tyre nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është i pabazuar në ligj, prandaj vota jonë është pjesërisht kundër tij.

Medi Bici

Majlinda Andrea

Nr.2 i Regj. Themeltar
Nr.2 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Mirela Fana	Anëtare
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 20.06.2013 morën në shqyrtim çështjen penale me nr.71008-01151-00-2011 Akti, që i përket:

TË PANDEHURIT: GJERGJ LEKA

OBJEKTI:

Ankim kundër vendimit të pushimit datë 01.12.2009
të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
lidhur me procedimin penal nr.1264 të vitit 2009.
Baza Ligjore: Neni 329 i K.Pr.Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.383 Akti, datë 21.07.2010, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së bërë nga kërkuesi Gjergj Leka.

Shfuqizimin e vendimit datë 01.12.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal nr.1264, të vitit 2009, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të mëtejshme për këtë procedim penal në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afatit ligjor.

Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e Prokurorisë së Rrethit Tiranë, me vendimin nr.834, datë 17.06.2011, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.383 Akti, datë 21.07.2010 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, me trup tjetër gjykues.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 19.07.2011, ka paraqitur rekurs Gjergj Leka nëpërmjet avokatit Vangjel Muzina, i cili ka kërkuar:

Prishjen e vendimit nr.834, datë 17.06.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit penal nr.383 Akti, datë 21.07.2010 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Kthimi i çështjes është një zvarritje e theksuar e gjykatës së apelit.
- Mos thirrja e personave të akuzuar nuk është detyrë e gjykatës, por e Prokurorisë.
- Gjykata e apelit nuk ka kryer asnjë hetim gjyqësor.

Nisur nga konstatimi i praktikave të ndryshme të ndjekura lidhur me zbatimin e institutit të kundërshtimit të vendimeve të pushimit të çështjes ose të akuzës të prokurorit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 19.12.2012, ka vendosur:

Të dërgojë për shqyrtim këtë çështje në Kolegjet e Bashkuara, për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Me anë të këtij vendimi, Kolegji Penal ka shtruar për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara çështjet e mëposhtme:

1. *Referuar nenit 329 të K.Pr.Penale, të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit e ka i dëmtuari dhe i pandehuri, ndërkohë praktika gjyqësore, por edhe Kodi i Procedurës Penale, njeh si pjesëmarrës në procesin penal edhe këto subjekte: 1. kallëzuesin dhe të kallëzuarin. 2. personin të cilit i atribuohet vepra penale. 3. personin ndaj të cilit zhvillohen hetime. A legjitimohen këta persona të paraqesin ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të çështjes penale, pavarësisht nga parashikimi i nenit 329 të K.Pr.Penale?*
2. *Në gjykimin e kësaj çështje, përveç subjektit që paraqet ankim kundër vendimit të pushimit, kush janë pjesëmarrësit e tjerë në gjykim? A është e detyrueshme thirrja në gjykim edhe e atyre personave që përmenden në pikën 1 (kur ata nuk janë ankuesi)?*
3. *Cila është gjykata që do të gjykojë kundërshtimin e vendimit të pushimit, gjyqtari i vetëm apo si trup gjykues prej tre gjyqtarësh, apo gjyqtari që shqyrton kërkesat gjatë hetimeve paraprake?*
4. *Gjykata në gjykimin e kësaj çështjeje, kur konstaton se vendimi i pushimit duhet të ndryshohet (shfuqizohet) dhe hetimet të vazhdojnë, a ka të drejtë të përcaktojë se cilat janë veprimet që prokurori duhet të bëjë domosdoshmërisht? Gjithashtu, kur nuk ka nevojë për hetime të tjera, a ka të drejtë gjykata të urdhërojë prokurorin për të dërguar çështjen në gjykim?*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Artan Zeneli dhe Artan Broci; prokurorin Kujtim Luli, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.834, datë 17.06.2011 dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e faktit

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në materialin kallëzues të depozituar nga shtetasi Gjergj Leka, ka regjistruar procedimin penal nr.1264 të vitit 2009 për veprën penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal. Kallëzuesi, Gjergj Leka ka kërkuar fillimin e procedimit penal ndaj vëllait të tij, shtetasit Vasil Leka, duke pretenduar se vëllai i tij, i nxitur nga vëllai tjetër, Androkli Leka, në vitin 2007 kanë bërë kallëzim penal të rremë në ngarkim të tij, i cili është i regjistruar në prokurori me nr.6709, datë 09.11.2007, me objektin për mashtrim dhe falsifikim lidhur me kontratën e dhurimit të bërë tek noteri Ilir Qejvani, ku ka nënshkruar nëna e tij dhe të pranishëm kanë qenë shtetasit Lutfije Leka e Polikron Leka.

2. Organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin datë 01.12.2009, në përfundim ka vendosur pushimin e çështjes në bazë të nenit 328/1, pika “f” të K.Pr.Penale, që bën fjalë për rastet e tjera të parashikuara në ligj.

3. Pas ankimit të kallëzuesit, me vendimin nr.383 Akti, datë 21.07.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shfuqizimin e vendimit datë 01.12.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pushimin e procedimit penal, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të mëtejshme për këtë procedim penal, në zbatim të detyrave të lëna nga ana e gjykatës.

4. Mbi ankimin e prokurorit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.834, datë 17.06.2011, ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e kthyer çështjen për rigjykim, për shkak se ka konstatuar shkelje procedurale të dispozitave lidhur me njoftimin e pjesëmarrjen e palëve, si dhe se duheshin thirrur në gjykim, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i kallëzuari, i cili ka interesa direkt në këtë procedim.

5. Në seancën para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nga ana e prokurorit u parashtrua se: në gjykimet me objekt “*Kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale*”, në praktikën e Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë janë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me pjesëmarrjen në proces të palëve që kanë interesa, që përfitojnë apo cenohen, nga një vendim gjyqësor (konkretisht: vendimi nr.78, datë 25.05.2011 dhe nr.172, datë 21.12.2011 i Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë). Prokurori ka kërkuar që çështja të tërhiqet pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësim të praktikës gjyqësore, sa i përket përcaktimit të pjesëmarrësve në këtë proces penal. Gjithashtu, prokurori ka çmuar si të domosdoshëm qartësimin e kuptimit dhe interpretimin nëpërmjet një qëndrimi unifikues që duhet mbajtur lidhur me thirrjen apo jo, si palë në proces, në gjykimet që kanë për objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit apo të mosfillimit të procedimit/çështjes penale, të personit ndaj të cilit është bërë kallëzim penal apo të personit ndaj të cilit atribuohet vepra penale.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 19.12.2012, ka vendosur të kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njësimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

II. E drejta e zbatueshme

7. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe i qëndrimeve të palëve në gjykim, për t’i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara sa i takon njësimin të praktikës gjyqësore, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në mjetin e rekursit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh, para së gjithash, dispozitat vijuese të Kushtetutës, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore (KEDNJ) dhe të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 42/2 i Kushtetutës parashikon se: “*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të*

drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj⁹⁰”.

Në nenin 6, pika 1 të KEDNJ, parashikohet se: “Neni 6 “E drejta për një proces të rregullt”

1. Në përcaktimin e (...) çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme (...).”

Në pajtueshmëri me qëllimin dhe frymën e këtyre dispozitave, edhe në nenet 34, 58, 290, 291 328 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë parashikohet se:

“Neni 34 “Marrja e cilësisë së të pandehurit”

1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Kur pas marrjes së personit si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit.

2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit.

3. Cilësia e të pandehurit rimerret kur prishet vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit.

4. Dispozitat që zbatohen për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe. Ndaj këtij personi shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të pandehurin”.

Neni 58 “Të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale”

1. Personi i dëmtuar nga veprat penale ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit.

2. Personi i dëmtuar që nuk ka zotësi juridike për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.

3. I dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e dëmit”.

Neni 290 “Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit”

1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur:

a) personi ka vdekur;

b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale;

c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin;

ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston;

d) vepra penale është shuar;

dh) është dhënë amnisti;

⁹⁰ VGJK 9/2003: E drejta e ankimit është element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe e lidhur ngushtë me parimin e dëgjimit, parashikuar në nenin 33 të Kushtetutës. Ajo parashikohet si “ankim efektiv” në nenin 13 të Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut. Sipas kësaj të drejte, çdo individ mund t’i drejtohet instancave kombëtare kur pretendon se është viktimë e një mase të marrë nga autoritetet shtetërore dhe që sipas tij vjen në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Evropiane të së Drejtave të Njeriut dhe ligjet e brendshme. E drejta e ankimit presupozon të drejtën e qytetarit për t’iu drejtuar një organi më të lartë shtetëror, pranimin e ankimit, ekzistencën e organit për shqyrtimin e ankimit, afatet optimale të shqyrtimit, shqyrtimin objektiv, kontrollin gjyqësor si kontrollin përfundimtar ndaj ankimit dhe një garanci për një rehabilitim të mundshëm si pasojë e shqyrtimit dhe pranimit të ankimit.

e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 291 “Vendimi për mosfillimin e procedimit”

1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.

“Neni 328 “Pushimi i çështjes”

1. Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

a) del qartë se fakti nuk ekziston;

b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

c) i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;

ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;

d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;

dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;

e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;

ë) i pandehuri vdes;

f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Neni 329 “Ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes”

1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri, përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston.

2. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa kur pranon ankimin e të pandehurit ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin.

3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri.

Neni 280 “Marrja dijani për veprën penale”

1. Prokuroria dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 284 “Ankimi”

1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund të tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.

2. Ankimi bëhet nga i dëmtuari te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklarate, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.

3. Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij.

4. Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankuesit dhe i dërgon aktet prokurorit.

5. Për rastet e parashikuara nga neni 59 ankimi bëhet në gjykatë nga i dëmtuari akuzues.

Neni 287/1 “Regjistrimi i njoftimit të veprave penale”

1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

Neni 293

1. Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit.

2. Kur ka urgjencë dhe në rastet e krimeve të rënda, njoftimi bëhet menjëherë edhe me gojë.

3. Me njoftimin, policia gjyqësore tregon ditën dhe orën në të cilën ka marrë dijeni për veprën penale.

III. Arsytimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

8. Me qëllim dhënien e përgjigjeve mbi çështjet e shtruara për unifikim, si dhe në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt rekursi, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të analizojnë, fillimisht, konceptin e subjekteve të procedimit penal, kryesisht të atyre që kanë lidhje me rastin konkret, duke shqyrtuar rolin dhe funksionet e tyre në fazat e ndryshme të procedimit penal, si dhe duke filluar që nga çasti i njoftimit të veprës penale e deri në përfundimin e hetimeve dhe të kalimit të çështjes në fazën tjetër për gjykim.

9. Si subjekte të procedimit penal, ligji procedural penal njih: gjykatën, si organ i vetëm për dhënien e drejtësisë, prokurorinë si organi i vetëm i ndjekjes penale, policinë gjyqësore e cila, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal, të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, të dëmtuarin dhe paditësin e të paditurin civil.

10. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.3 të vitit 2002 kanë trajtuar qartë konceptin e subjektit procedural të “të pandehurit”. Terminologjia e përdorur nga Kodi i Procedurës Penale, gjatë fazave të ndryshme të procedimit penal, ndryshon nga çasti i fillimit të marrjes dijeni për veprën penale deri në përgatitjen dhe dërgimin e çështjes penale për gjykim. Cilësimi dhe emërtimi i subjekteve dhe i personave në raport me veprën penale fillojnë me termin: “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” (neni 287 K.Pr.Penale), “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308, etj.) dhe më pas “i pandehur” që ndeshet në shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale. Autori i mundshëm i veprës penale mund t’i marrë këto emërtime në faza të ndryshme të procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim.

11. Termi “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, parashikohet në nenin 287 të K.Pr.Penale dhe ligjvënësi jo pa qëllim e ka përdorur atë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të K.Pr.Penale, ku flitet për mënyrën se si njoftohet dhe merret dijeni për një vepër penale nga ana e prokurorit dhe policisë. Cilësia e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, fillon: a) ose kur njoftuesi i saj mendon se e di, se cili mund të jetë autori i veprës penale dhe prokurori shënon paralelisht në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, krahas veprës edhe emrin e personit kur ai njihet, ose b) mbasi është bërë regjistrimi i veprës penale, që nga çasti i mëtejshëm kur nga hetimet rezulton një emër personi të cilit, i atribuohet vepra penale. Në këto kushte, nuk ka asnjë dyshim se ky cilësim i

përket fazës fillestare të procedimit penal. Përcaktimi i termit: “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e përcaktuar nga neni 287 i K.Pr.Penale, si dhe pasur parasysh fazën procedurale në të cilën ai përdoret, do të thotë se ai nuk mund të barazohet me termin: “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime”, e as me termin person “i pandehur”. Emri i personit, të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur ai është i njohur, por mund të këtë edhe raste kur, shpeshherë, kallëzuesi apo autoriteti referues nuk është akoma në gjendje të tregojë se kush mund të mendohet si autor i mundshëm i një vepra penale në fillimin e hetimeve. Atribuimi i faktit që përbën veprën penale ndaj një personi, nuk do të thotë se personi ka realisht lidhje me veprën penale. Lidhja e veprës penale me një emër personi, mund të dalë vetëm me kryerjen e hetimeve dhe të dhënave të mbledhura, prej të cilave do të rezultojë një lidhje mes veprës penale që procedohet dhe përgjegjësisë së prezumuar të një personi të caktuar. Vetëm pas daljes së kësaj lidhje dhe në çastin kur identifikohet emri i personit (neni 293 K.Pr.Penale) vepra penale mund t’i atribuohet një personi të caktuar. Pra, krahas lajmit për kryerjen e një vepra penale që merret me kallëzimin apo referimin, në regjistër shënohet edhe emri i personit, të cilit “i atribuohet” vepra penale.

12. Me avancimin e fazës së hetimeve paraprake, kuptohet se ndryshon dhe gjendja procedurale penale e subjektit të veprës penale, i cili nga cilësia e personit që i atribuohet vepra penale, kalon në cilësinë e “personit ndaj të cilit, zhvillohen hetime”. Fakt ky që nënkupton se gjatë hetimeve paraprake, nga momenti fillestar i çeljes së procedimit penal kanë filluar të mbledhen të dhëna, të cilat janë në gjendje të mbështesin akuzën që do të mund të ngrihet në fazën e gjykimit. Termi: personi ndaj të cilit zhvillohen hetime është frymëzuar nga sistemet procedurale penale që pranojnë rregullin, sipas të cilit, cilësimi si i pandehur bëhet në përfundim të hetimeve, vetëm atëherë kur ka elemente për të vendosur që çështja penale mund t’i kalojë gjykatës për gjykim. Edhe ky cilësim i dytë që merr autori i mundshëm i veprës penale gjatë hetimeve paraprake nuk mund të barazohet me termin “i pandehur”. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet është një figurë procedurale e ndërmjetme që qëndron midis asaj që Kodi Procedurës Penale quan “person, të cilit i atribuohet vepra penale” dhe “të pandehurit”. Vetëm drejt çasteve të përfundimit të fazës së hetimeve paraprake, Kodi i Procedurës Penale përdor termin “i pandehur”. I pandehuri është personi që i atribuohet formalisht vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës. Ky status procedural është më i avancuar dhe relativisht më i qëndrueshëm, i cili ruhet i pandryshuar, në çdo gjendje dhe shkallë të procesit penal, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose fajësisë (neni 34/2 i K.Pr.Penale).

13. Sa më sipër, arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga çasti i njoftimit të saj në prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve paraprake (neni 327 i K.Pr.Penale), evoluon gradualisht nga “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” në “personin ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe së fundmi në atë të “të pandehurit”, pavarësisht nëse çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331). Si rregull, statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve paraprake përpara se të depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund të merret edhe me përpara. Kjo është në çmimin e prokurorit, i cili mund të bëjë njoftimin e akuzës në çdo fazë të hetimeve, deri në përfundimin e tyre, pasi ai të ketë mbledhur të dhënat e mjaftueshme (neni 34/1 i K.Pr.Penale).

III-1. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara mbi kundërshtimin e vendimeve të mosfillimit të procedimit penal

14. Procedimi penal merr shkas nga njoftimi që merr prokurori kryesisht apo nga policia gjyqësore, por edhe nga kallëzimi i shtetasve apo personave juridikë për ngjarjen e një vepra penale. Prokurori regjistron procedimin penal fillimisht për veprën që ai ka marrë njoftim se është kryer e, sipas rastit, edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Është pikërisht ky momenti

që prokurori ka mundësi të verifikojë nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara prej nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal.

15. Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Si subjekte që marrin pjesë në këtë fazë, përveç prokurorit dhe policisë gjyqësore, janë edhe kallëzuesi, si njoftues i veprës penale, e në varësi të rastit, edhe personi të cilit i atribuohet vepra penale.

16. Njoftimi për veprat penale mund të merret nëpërmjet kallëzimit që bëjnë personat në Prokurori apo në polici gjyqësore. Për ato vepra penale që ndiqen kryesisht, të gjithë kanë detyrimin të bëjnë kallëzim me t'u vënë në dijeni. Njoftimi për veprat penale mund të raportohet nga personat që mund të jenë nëpunës publikë apo personel mjekësor që, për shkak të detyrës që kanë vihen në dijeni të veprave penale, por edhe nga shtetas të zakonshëm që bien jo vetëm në dijeni, por dhe kanë interesa të drejtpërdrejta për shkak të dëmit që iu është shkaktuar atyre nga vepra penale. Në morinë e personave që kallëzojnë veprat penale mund të përfshihen edhe persona juridikë, të cilët kanë jo vetëm detyrimin për të paraqitur kallëzim, por edhe që mund të jenë të dëmtuar nga vepra penale. Në të tilla rrethana, këta persona kanë të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit (neni 291 K.Pr.Penale).

17. Lind pyetja, nëse në radhët e subjekteve që veprojnë në këtë fazë a duhet të përfshihet edhe personi të cilit i atribuohet vepra penale? Duke qenë se ai mund të ketë interesa në këtë proces, a duhet t'i njoftohet dhe a ka ai të drejtën e ankimit ndaj vendimit? Faza e fillimit të procedimit penal është e lidhur kryesisht me verifikimin e kushteve dhe rrethanave që nuk lejojnë fillimin e hetimeve në drejtim të personit të dyshuar apo atij të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal nuk prek interesa të personit që i atribuohet vepra penale. Në këtë kuptim, nuk mund të ketë ndonjë arsye që ky person të bëjë ankim kundër vendimit të mosfillimit. Në bazë të nenit 291 të K.Pr.Penale, të legjitimuar për të paraqitur ankim janë vetëm kallëzuesi ose i dëmtuari ankues, sipas përcaktimeve të parashikuara prej nenit 284 të K.Pr.Penale.

18. Të drejtën e ankimit dhe për rrjedhojë, edhe legjitimimin për të ankimuar vendimin e mosfillimit, Kodi i Procedurës Penale ia njeh, përveç subjektit të "dëmtuar akuzues", që në bazë të nenit 58 të K.Pr.Penale, si pasojë e veprës penale ka të drejtë që të paraqesë kërkesë për fillimin e procedimit penal dhe të ngrejë akuzë drejtpërdrejti në gjykatë, edhe atyre subjekteve të dëmtuara pa ankimin e të cilëve nuk mund të fillojë procedimi penal, e kur ka filluar nuk mund të vazhdojë, në bazë të nenit 284 të K.Pr.Penale.

19. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke qartësuar, arrijnë në konkluzionin logjik se: **sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale prokurori duhet t'i njoftojë vendimin e mosfillimit të procedimit penal, duke i dhënë mundësinë për t'u ankuar kundër këtij vendimi, kallëzuesit të veprës penale, i cili mund të jetë, rast pas rasti, edhe i dëmtuari nga vepra penale, si edhe ankuesit, kur ka të tillë, në kuptim të nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale.**

20. Lidhur me gjykimin e çështjes së ankimit kundër vendimit të mosfillimit, ligji procedural penal nuk parashikon hollësi për procedurën që duhet të ndiqet. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale nuk parashikojnë se si duhet të zhvillohet ky gjykim dhe cilët janë subjektet që duhet të marrin pjesë në shqyrtimin e ankimit kundër vendimit të prokurorit që ka disponuar mosfillimin e procedimit. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjejnë me vend të njësojnë edhe praktikën gjyqësore lidhur me ritin e shqyrtimit dhe gjykimin të ankimit kundër vendimit që ka disponuar mosfillimin e procedimit penal.

21. Nisur nga aspekti sistematik i Kodit të Procedurës Penale, dispozitat e procedurës penale, në të cilat parashikohet ankimi kundër vendimit të prokurorit që ka disponuar mosfillimin e procedimit penal, janë renditur në pjesën e dytë të Kodit të Procedurës Penale, në titullin e VI: “Hetimet Paraprake”, e pikërisht në kreun e III: “Kushtet e Procedimit”. Në këtë kuadër, vendimi i mosfillimit që merret nga prokurori gjatë fazës së hershme të hetimeve paraprake, ndonëse në hapat fillestare të saj, në çastin kur ai merret, hetimet e mëtejshme paraprake ndalohen. Në këtë kuptim, në vështrim edhe të nenit 278 të K.Pr.Penale, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit është e njëjta gjykatë që shqyrton kërkesat gjatë hetimeve paraprake.

22. Nën dritën e arsytimit të mësipërm, vendimi i prokurorit që ka disponuar mosfillimin e procedimit penal, merret mbasi më parë, janë verifikuar rrethanat e parashikuara nga neni 290 i K.Pr.Penale. Këto rrethana, në fakt, nuk kërkojnë një proces të ndërlikuar e të gjatë për mbledhjen e të dhënave apo të kryerjes së veprimeve të rëndësishme hetimore në drejtim të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë. Në këtë kuadër, gjykimi i ankimit kundër vendimit të prokurorit për mosfillim nuk kërkon një shqyrtim gjyqësor të ndërlikuar dhe, për rrjedhojë, ai mund të bëhet edhe vetëm mbi bazë shqyrtimit të dokumenteve (*de plano*).

23. Në gjykimin e ankimit kundër vendimit të prokurorit për mosfillim marrin pjesë ankuesi dhe prokurori që ka dhënë vendimin, të cilët njoftohen për këtë gjykim të posaçëm, megjithatë nuk kërkohet domosdoshmërisht marrja pjesë në gjykim e këtyre subjekteve. Gjyqtari i hetimeve paraprake (neni 278 i K.Pr.Penale) vlerëson ligjshmërinë e vendimit të mosfillimit në bazë të akteve të mbledhura deri në atë çast të hetimeve paraprake dhe vendos, sipas rastit, shfuqizimin e vendimit dhe rifillimin e hetimeve, ose rrëzon kërkesën e ankuesit si të pambështetur. Ky vendim i gjyqtarit është i ankueshëm, sikurse edhe vendimet e tjera të marra në këtë fazë të hetimeve paraprake sipas nenit 278 të K.Pr.Penale.

III-2 Lidhur me çështjen e parë për unifikim, sipas kësaj pyetjeje: “Referuar nenit 329 të K.Pr.Penale, të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit e ka i dëmtuari dhe i pandehuri, ndërkohë praktika gjyqësore, por edhe Kodi i Procedurës Penale, njeh si pjesëmarrës në procesin penal edhe këto subjekte: 1. kallëzuesin dhe të kallëzuarin. 2. personin të cilit i atribuohet vepra penale. 3. personin ndaj të cilit zhvillohen hetime. A legjitimohen këta persona të paraqesin ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të çështjes penale, pavarësisht nga parashikimi i nenit 329 të K.Pr.Penale?”

24. Në mënyrë të ngjashme edhe lidhur me institutin e pushimit të çështjes apo akuzës, pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore, pra në një fazë më të avancuar të hetimeve, prokurori shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij të jetë njohur me to, duke vendosur kur, është rasti, mbi pushimin e çështjes apo akuzës në bazë të nenit 328 të K.Pr.Penale.

25. Në bazë të nenit 328 të K.Pr.Penale, pushimi i çështjes apo i akuzës vendoset nga ana e prokurorit, qoftë për rrethana të njëjta me ato të parashikuara në rastin e mosfillimit të procedimit, qoftë edhe për rrethana të tjera, të cilat kanë lidhje pikërisht, me përfundimin e hetimeve paraprake. Kundër vendimit të prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes është parashikuar mundësia për të bërë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor nga i dëmtuari dhe i pandehuri.

26. Lidhur me rrethin e subjekteve të legjitimuara, sa i takon subjektit “të dëmtuar”, neni 58 i K.Pr.Penale parashikon të drejtat që ka ky subjekt në procedimin penal. E drejta penale materiale mbron shoqërinë duke siguruar të drejtat, vlerat dhe interesat themelore juridike përmes mbrojtjes penale. Çdo vepër penale cenon dhe lëndon një të mirë juridike të mbrojtur nga sistemi penal, pra, kryerja e një vepre penale shkakton një lëndim apo një rrezik për një interes të mbrojtur nga norma penale. Rendi juridik reagon ndaj kryerjes së kësaj vepre nëpërmjet sanksionit penal. Në sistemin procedural penal, interesi për të siguruar arritjen e një dënimi në zbatim të sanksionit penal përfaqësohet nga ana e prokurorit, si subjekt që bën ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën

në gjykim. Personi i dëmtuar është titullari i interesit juridik të mbrojtur nga norma penale, në vartësi të llojit të veprës penale, marrëdhënies dhe të mirës juridike që mbrohet nga e drejta penale. Kështu, i dëmtuari është personi fizik i cili është i lënduar në trupin e tij, i dëmtuar në shëndetin e tij, i dëmtuar për shkak të cenimit të së drejtave dhe lirive themelore, prekja dhe kufizimi i të cilave, mbrohet nga norma penale, i cenuar në moralin e tij dhe të familjes, etj. I dëmtuar mund të jetë edhe personi juridik, të cilit vepra penale i ka cenuar interesa pasurore të drejtpërdrejta në raport me veprimtarinë që ai ushtron.

27. Nga pikëpamja e subjektit që kërkon ndjekjen e autorit, veprat penale mund të ndahen në: vepra penale që ndiqen kryesisht, dhe vepra penale që ndiqen me kërkesë të dëmtuarit (ankimi). Për veprat penale që ndiqen kryesisht, procedimi fillon pavarësisht nga ankimi i të dëmtuarit, i cili nuk mund të pengojë fillimin e procedimit e as ta ndërpresë atë. Për veprat penale që ndiqen me ankim, ndjekja penale mund të fillojë vetëm kur i dëmtuari paraqet ankim në organet e procedimit penal. Ligji procedural penal njih si subjekt “të dëmtuar” personin, i cili, në bazë të nenit 284 K.Pr.Penale, ka të drejtën për të paraqitur ankimin si kusht për fillimin e procedimit penal, për ato veprat penale që parashikohen shprehimisht nga neni 284 i K.Pr.Penale dhe që nuk ndiqen kryesisht. Gjithashtu, për veprat penale të parashikuara shprehimisht nga neni 59 i K.Pr.Penale, parashikohet i dëmtuari akuzues si subjekt që ka të drejtën për të ngritur akuzën në gjykim, krahas së drejtës për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga vepra penale.

28. Në bazë të analizës së sistemit procedural penal në fuqi, i dëmtuari si subjekt i procedimit penal, ka të drejta “nxitëse” (të parashitëse kërkesa në organin procedues e të kërkojë marrjen e provave), të drejta “pjesëmarrjeje” (kallëzimi, ankesat, kërkesat, e drejta për të marrë pjesë në gjykimin lidhur me to), të drejta “lajmërimi dhe informimi”, si dhe të drejta “monitoruese” ndaj veprimtarisë së prokurorit.

29. Një kriter dallues, ekzistenca e të cilit duket se zgjeron të drejtat e personave që legjitimohen për të bërë ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës është, pikërisht, dallimi ndërmjet figurës së kallëzuesit dhe asaj të të dëmtuarit. Kallëzimi është një akt i një natyre të ndryshme nga ajo e kërkesës ankimore e të dëmtuarit nga vepra penale, jo vetëm për shkak të subjektit, por edhe për objektin dhe qëllimin që kanë këto dy institute të procedurës penale. Kallëzuesi është një person, i cili jo domosdoshmërisht është i prekur apo i cenuar nga vepra penale, prandaj i dëmtuari mund të jetë kallëzues, por nuk është gjithmonë e vërtetë e anasjellta. Kallëzimi mund të paraqitet nga një rreth më i gjerë personash, shtetasish privatë, personash juridikë, zyrtarësh publikë, madje edhe nga vetë personi i dyshuar si autor dhe në disa raste ai është i detyrueshëm. Nëpërmjet kallëzimit raportohet vetëm dijenia rreth ndodhjes së një vepre penale që ka ngjarë dhe që kallëzuesi ka rënë në dijeni për shkaqe të ndryshme rreth saj. Ndërsa, nëpërmjet kërkesës (ankimit) së të dëmtuarit, përveç njoftimit të faktit të veprës penale, shprehet vullneti i të dëmtuarit për të proceduar me gjykimin e personit autor të veprës penale, si dhe manifestohet vullneti i tij për ushtrimin e ndjekjes penale. Vetëm të dëmtuarit nga vepra penale kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit, duke u “ankuar” në organet që ushtrojnë ndjekjen penale ose duke paraqitur “kërkesë në gjykatë” për rastet e parashikuara nga neni 59 i K.Pr.Penale. Në bazë të nenit 283 të K.Pr.Penale, çdo person që merr dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht ka detyrimin për ta kallëzuar atë, pavarësisht se është i dëmtuar ose jo nga vepra penale. Po kështu, në bazë të neneve 281- 282 të K.Pr.Penale, është parashikuar detyrimi i nëpunësit publik dhe personelit mjekësor për të bërë kallëzim kur vihen në dijeni rreth një vepre për shkak të detyrës që ata kryejnë.

30. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke qartësuar arrijnë në konkluzionin njësoj se: **të drejtën për të paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes penale, e ka vetëm personi i dëmtuar nga vepra penale, subjekt ky që mund të jetë njëherazi edhe kallëzues, por kallëzuesit që nuk janë të dëmtuar**

nga vepra penale nuk legjitimohen nga ligji procedural penal të ushtrojnë të drejtën e ankimit sipas nenit 329 të K.Pr.Penale.

III-3 Lidhur me çështjen e dytë për unifikim, sipas kësaj pyetjeje: “Në gjykimin e kësaj çështje, përveç subjektit që paraqet ankim kundër vendimit të pushimit, kush janë pjesëmarrësit e tjerë në gjykim? A është e detyrueshme thirrja në gjykim edhe e atyre personave që përmenden në pyetjen 1 (kur ata nuk janë ankuesi) ”?

31. Në bazë të nenit 329 të K.Pr.Penale të drejtën e ankimit e ka edhe i pandehuri, si një nga subjektet në procedimin penal. Prokurori mund ta njoftojë akuzën si në përfundim të hetimeve paraprake, ashtu edhe në fillim të tyre, kur ka të dhëna të mjaftueshme, është kjo prerogativë e tij se në cilin çast do të bëjë njoftimin e akuzës. Cilësia e personi që i atribuohet vepra penale, sipas ecurisë së hetimeve paraprake dhe mbledhjes së të dhënave, evoluon nga ajo e personit që i atribuohet vepra, në cilësinë e personit nën hetim dhe më pas, në cilësinë e personit të pandehur.

32. Referuar çështjes së shtruar në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore nëse legjitimohen: “i kallëzuar”, “personi, të cilit i atribuohet vepra penale”, “personi ndaj të cilit, zhvillohen hetime”, për të bërë ankim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë me vend për të saktësuar se: **e drejta e të pandehurit për të bërë ankim kundër vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes ose akuzës, në bazë të parimit të shtrirjes së të drejtave dhe garancive sipas nenit 34/4 të K.Pr.Penale, shtrihet edhe për personin nën hetim, qoftë ai në cilësinë e personit, të cilit i atribuohet vepra penale dhe në atë të personit, ndaj të cilit zhvillohen hetimet që është i kallëzuar, sepse, në fund të fundit, është i njëjti person, që në varësi të fazës së hetimeve paraprake, merr cilësi të ndryshme.**

33. Referuar çështjes së shtruar në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore lidhur me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se: Në nenin 329 të K.Pr.Penale përcaktohen qartë si subjektet të legjitimuara që bëjnë ankim kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, subjekti i “të dëmtuarit” dhe “i pandehuri”, çka do të thotë se këta subjekte marrin pjesë në këtë gjykim dhe kanë të drejtën e ankimit për këtë shkak, kur legjitimohen në gjykatën e apelit. Duke qenë se të drejtën e ankimit kundër vendimit të pushimit të çështjes penale e kanë, si i dëmtuari, ashtu edhe i pandehuri, ky i fundit edhe në cilësinë e personit nën hetim; detyrimisht për të garantuar një proces të rregullt ligjor sipas parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktorialitetit ku debati gjyqësor të zhvillohet natyrshëm; duhet të njoftohen me qëllim për t’u thirrur në gjykim jo vetëm prokurori që ka dhënë vendimin e pushimit të akuzës apo çështjes, por edhe i dëmtuari, si dhe i pandehuri apo personi nën hetime. Pra, të gjitha palët që në procesin penal tërheqin interesa të ligjshme.

Në gjykimin me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, sipas nenit 329 të K.Pr.Penale, ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës dhe e drejta për të marrë pjesë, duhet t’i njoftohen, në mënyrë që ai të thirret në gjykim, të dëmtuarit nga vepra penale, si edhe personit, ndaj të cilit zhvillohen hetime, pavarësisht nëse ai ka marrë apo jo, cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës. Mosnjoftimi për të marrë pjesë në gjykim, i këtyre subjekteve të sipërcituara sipas rregullave të K.Pr.Penale mbi njoftimet, përbën një proces të parregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe shkelje të rëndë procedurale sipas nenit 428, pika “ç” të K.Pr.Penale.

III-4 Lidhur me çështjen e tretë për unifikim, sipas kësaj pyetjeje: “Cila është gjykata që do të gjykojë kundërshtimin e vendimit të pushimit, gjyqtari i vetëm apo si trup gjykues prej tre gjyqtarësh apo gjyqtari që shqyrton kërkesat gjatë hetimeve paraprake”?

34. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke vërejtur se në nenin 329 të K.Pr.Penale nuk përcaktohet mënyra e gjykimit të çështjes dhe gjykata kompetente për shqyrtimin

e kësaj çështje, për unifikim të praktikës gjyqësore arrijnë në përfundimin se: në analizë të veprimeve të marra deri në fazën e hetimeve paraprake nga prokurori, sipas procedurës penale, vendimi i pushimit të çështjes i jep fund fazës së hetimeve paraprake, duke e mbyllur çështjen pa dërguar atë në gjykatë, me qëllim që kjo e fundit të deklarohet lidhur me fajësinë ose jo të personit.

Për këtë arsye, duke qenë se çështja përfundohet dhe mbyllet një fazë e procedimit penal, kontrolli i ligjshmërisë së këtij vendimi të prokurorit, i cili si funksion të tij kushtetues ka ndjekjen penale e jo atë të dhënies së drejtësisë, duhet të bëhet nga gjykata.

35. Sa i takon caktimit të gjykatës kompetente, në dispozitat referuese të shqyrtimit të ankimit kundër vendimit të pushimit (neni 329 i K.Pr.Penale) parashikohet se ankimi bëhet në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe se kundër këtij vendimi ankimi bëhet në gjykatën e apelit. Kurse, duke iu referuar dispozitës procedurale penale që bën fjalë për gjykatën kompetente në fazën e hetimeve paraprake (neni 278 i K.Pr.Penale), konstatohet se gjyqtarit për hetimet paraprake i përket vetëm gjykimi i kërkesave të palëve pjesëmarrëse “gjatë hetimeve paraprake”, pra jo i akteve që jepen pas mbas përfundimit të kësaj faze. Vendimi i pushimit apo ai i dërgimit në gjykim janë akte të dala pas përfundimit të fazës së hetimeve paraprake.

36. Gjithashtu, një tjetër argument i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që mbështet përfundimin se kompetente për gjykimin e ankimit kundër vendimit të pushimit të çështjes është gjykata e “themelit” dhe jo ajo e hetimeve paraprake, përbën fakti se vendimi i pushimit të çështjes në shumë raste është një vendim që jep drejtësi, një funksion, i cili i mbetet vetëm i gjykatës së krijuar me ligj. Kështu, në bazë të pikës “dh” të nenit 328 të K.Pr.Penale, përcaktohet të vendoset pushimi i çështjes kur “del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet se e ka kryer ai”. Edhe rastet e tjerat të parashikuara, janë të njëjta me përcaktimet që bën neni 388 i K.Pr.Penale, sipas të cilave parashikohet tagri i gjykatës kur ajo jep vendim pafajësie.

37. Në mbështetje të argumentit të mësipërm shtohet edhe fakti i parashikimit të papajtueshmërisë së gjyqtarit të hetimeve paraprake, të cilit i ndalohet të marrë pjesë në gjykimin e themelit të akuzës. Sipas nenit 15 pika 2 të K.Pr.Penale, duke e trajtuar vendimin e pushimit të çështjes si një vendim *quasi* gjyqësor që ka të bëjë me dhënien e drejtësisë, dhe për arsye paanshmërie, kontrolli i vendimit të pushimit të çështjes nuk mund të bëhet nga i njëjti gjyqtar i hetimeve paraprake, i cili ka kontrolluar edhe veprime të tjera gjatë hetimeve paraprake, por nga gjykata e themelit.

38. Sa më sipër, **gjykimi i ankimit kundër pushimit të çështjes duhet t’i nënshtrohet rregullave të gjykimin që parashikojnë përbërjen e trupit gjykues, sipas nenit 13 pika “3” të K.Pr.Penale për gjykimin në shkallë të parë dhe sipas rregullave të përcaktuara në nenin 14 të k K.Pr.Penale për gjykimin në apel.**

III-4 Lidhur me çështjen e tretë për unifikim, sipas kësaj pyetjeje: “Gjykata në gjykimin e kësaj çështjeje kur konstaton se vendimi i pushimit duhet të ndryshohet (shfuqizohet) dhe hetimet të vazhdojnë, a ka të drejtë të përcaktojë se cilat janë veprimet që prokurori duhet të bëjë domosdoshmërisht? Gjithashtu, kur nuk ka nevojë për hetime të tjera a ka të drejtë gjykata të urdhërojë prokurorin për të dërguar çështjen në gjykim?”

39. Referuar çështjes së shtruar në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore lidhur me pyetjen 4, në funksion të unifikimit të një praktike sa më të qartë, Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë e riformuluan pyetjen si vijon: *Gjykata, në gjykimin e kësaj çështjeje kur konstaton se vendimi i pushimit duhet të ndryshohet (shfuqizohet) dhe hetimet të vazhdojnë, a ka të drejtë të përcaktojë se cilat janë veprimet që prokurori duhet të bëjë domosdoshmërisht? Çfarë vendos gjykata kur prokurori, edhe pse hetimet janë të plota, vendos pushimin në kundërshtim me nenin 328 të K.Pr.Penale?*

40. Në gjykimin me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes, funksioni i gjykatës është kontrolli lidhur me zbatimin e drejtë dhe korrekt të rasteve të parashikuara nga neni 328 i K.Pr.Penale. Gjithashtu, edhe sipas nenit 329 të K.Pr.Penale, gjykata merr vendim duke disponuar, sipas rastit, shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes ose rrëzimin e kërkesës së ankuesit kur ai është i dëmtuari, ndërsa kur ankues është i pandehuri, gjykata mund t'i japë një formulim të ndryshëm vendimit të pushimit më të favorshëm për të pandehurin.

41. Kur gjykata vepron mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit nga vepra penale, krahas kontrollit për respektimin e kritereve dhe rasteve të parashikuara nga neni 328 i K.Pr.Penale nga ana e prokurorit, gjykata kontrollon edhe faktin nëse organi i procedimit ka mbajtur parasysh kërkesat e të dëmtuarit gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake në raport me detyrimin që ka prokurori për trajtimin e kërkesave të të dëmtuarit që kanë të bëjnë me parashtrimin e fakteve dhe marrjen e provave lidhur me akuzën apo çështjen e ngritur. Detyrim ky, i cili buron nga neni 58, pika "3" e K.Pr.Penale. Në këtë kontekst, gjykata verifikon pretendimet e të dëmtuarit lidhur me kërkesat dhe provat e kërkuara prej tij gjatë fazës së hetimeve paraprake, duke vlerësuar njëkohësisht nëse prokurori ka vepruar ose jo, në përputhje me kriteret e parashikuara në ligj për pushimin e çështjes dhe ka paraqitur argumente të mjaftueshme ose jo, lidhur me veprimtarinë e tij hetimore.

42. Sikundër mund të vërehet, lidhur me kontrollin gjyqësor të vendimit të pushimit nga ana e të dëmtuarit, gjykata vihet në lëvizje në bazë të kërkesës ankimore dhe jo kryesisht. Në këtë kuadër, është e kuptueshme që gjykata, pasi vlerëson legjitimitimin dhe interesin e ankuesit për të kundërshtuar, krahas shqyrtimit të kërkimeve të parashtruara nga ankuesi, gjykata njëkohësisht bën edhe kontrollin e ligjshmërisë së vendimit, nëse ai është dhënë sipas përcaktimeve ligjore. Në rast se në ankimin kundër vendimit të pushimit të çështjes janë treguar veprime hetimore që sipas ligjit duhet të ishin bërë, por nuk janë kryer, është e kuptueshme që - kur kërkimet e ankuesit kanë të bëjnë me kryerjen nga ana e prokurorisë të veprimeve të tjera hetimore, të cilat vlerësohen si të domosdoshme për arritjen e një konkluzioni të drejtë në drejtim të ngritjes ose jo të një akuze - gjykata duhet të urdhërojë prokurorin edhe për kryerjen të këtyre veprimeve hetimore shtesë. Detyrimi për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore nuk duhet kuptuar si kapërcim i rolit dhe i funksionit të gjykatës përkundër funksionit të organit të prokurorisë. Ndonëse, prokuroria është organi i vetëm i ndjekjes penale, ky funksion duhet ushtruar në mënyrë të ligjshme dhe të barabartë ndaj të gjithëve. Mënyrë kjo që parashikon të vetmin mekanizëm kontrollues mbi ligjshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë së prokurorit, i cili konsiston në ushtrimin e kontrollit gjyqësor për të dy anët që kanë të bëjnë me funksionin e ndjekjes penale, qoftë kur nuk synohet të veprohet për ushtrimin e ndjekjes penale, ashtu edhe kur abuzohet me ushtrimin e tepruar të këtij funksioni. Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se: **Në gjykimin e çështjes me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, gjykata shqyrton, jo vetëm bazueshmërinë e kërkimeve të paraqitura nga ana e ankuesit, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së këtij vendimi, duke verifikuar nëse nga ana e prokurorit janë respektuar drejt rastet e parashikuara nga ligji lidhur me pushimin e çështjes penale. Kur vendos shfuqizimin e vendimit, gjykata ka të drejtë të disponojë mbi kryerjen e veprimeve të tjera që kanë lidhje me akuzën dhe me veprimet hetimore të kryera deri në atë çast, në funksion të zbulimit të fakteve dhe të vërtetës për ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit.**

43. Referuar rolit të gjykatës në sistemin akuzator, ku mbizotëron funksioni i dhënies së drejtësisë nëpërmjet luajtjes së rolit të saj si një arbitër, do të përbënte një tejkallim të këtij funksioni fakti që, krahas shfuqizimit të vendimit të pushimit, të ekzistonte prerogativa e gjykatës për disponimin, dhe dërgimin e çështjes në gjyq apo ngritjen e akuzave të reja nga ana e saj. Në bazë të ligjit procedural penal, gjykata nuk mund të urdhërojë formulimin e akuzave të reja gjatë fazës së hetimeve paraprake apo në përfundim të saj. Ajo gjykon akuzën e ngritur nga ana e

prokurorit gjatë gjykimit në themel të saj, duke vendosur nëse qëndron ose jo akuza e ngritur. Në këto kushte, i vetmi disponim që mund të ketë gjykata, mbetet ai për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes, meqenëse nuk ka se çfarë veprimesh të tjera hetimore të kryhen, ndaj në këtë rast, gjykata duhet të konstatojë vetëm paligjshmërinë e vendimit të pushimit të prokurorit.

IV. Lidhur me zgjidhjen e çështjes

44. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim me arsyetimin se në gjykimin e shkallës së parë duhej thirrur edhe personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Vasil Leka, është marrë në përputhje me ligjin procedural penal.

Mosnjoftimi për të marrë pjesë në këtë gjykim, e bën procesin gjyqësor të parregullt dhe cenueshëm. Edhe për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime duhet të shtrihet dhe të parashikohet e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në këtë gjykim, pasi prishja e vendimit të pushimit dhe rifillimi i hetimeve cenon direkt interesa të këtij personi. Mohimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në gjykim, nëpërmjet mosnjoftimit për të marrë pjesë në gjykim të çështjes përbën një shkelje të rëndë procedurale në kuptim të nenit 428, pika "ç" të K.Pr.Penale.

Sa më sipër, Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë se vendimi nr.834 date 17.06.2011, i Gjykatës së Apelit Tiranë, është rezultat i zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 438 dhe 441/a të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Lënien në fuqi të vendimit nr.834, datë 17.06.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Unifikimin e praktikës gjyqësore siç parashikohet në këtë vendim.

Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi

Tiranë, më 20.06.2013

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtari Shkëlzen Selimi, ndaj pjesërisht të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket zgjidhjes së çështjes nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr.2, datë 20.06.2013, por jam kundër mënyrës unifikuese për çështjen e tretë dhe të katërt të shtruar për unifikim, për arsye të do të i parashtror më poshtë:

Në lidhje me çështjen e tretë për unifikim⁹¹:

2. Sipas shumicës, gjykimi i ankimit kundër pushimit të çështjes duhet t'i nënshtrohet rregullave të gjykimit që parashikojnë përbërjen e trupit gjykues, sipas nenit 13, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale⁹² (K.Pr.Penale) për gjykimin në shkallë të parë dhe sipas rregullave të përcaktuara në nenin 14 të K.Pr.Penale⁹³ për gjykimin në apel. Në këtë përfundim shumica arrin duke u bazuar në tre argumente, të cilat bazohen në një interpretim jo të saktë të konceptit të “dhënies së drejtësisë” nga gjykatat dhe cilësimin e ankimit kundër vendimit të pushimit të çështjes si “gjykim në themel”.
3. Në argumentin e parë, shumica pretendon se “gjyqtarit për hetimet paraprake i përket vetëm gjykimi i kërkesave të palëve pjesëmarrëse “gjatë hetimeve paraprake”, pra jo i akteve që jepen pas përfundimit të kësaj faze”, dhe rrjedhimisht, “vendimi i pushimit, apo ai i dërgimit në gjykim, janë akte të dala pas përfundimit të fazës së hetimeve paraprake”.⁹⁴
4. Paraprakisht, nga ana e interpretimit tekstual të pikës 2 të nenit 327 të K.Pr.Penale⁹⁵, nuk mund të pranohet pohimi se këto vendime të prokurorit (vendimi i pushimit ose i dërgimit të çështjes në gjykatë) janë akte të dala **pas** përfundimit të fazës së hetimeve paraprake. Në fakt, këto akte janë përmbyllëse të fazës së hetimeve paraprake, pra janë **akte me të cilat përfundohen hetimet**.
5. Akte procedurale të dala **pas** përfundimit të hetimeve janë vetëm aktet e tjera të prokurorit, të nxjerra **pas** dërgimit të çështjes në gjykatë, të cilat kanë më së shumti natyrën e kërkesave të palëve dhe që i përkasin një faze të ndryshme procedurale, atë të gjykimit të themelit.
6. Klasifikimi i vendimit të pushimit në fazën e hetimeve paraprake pranohet edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj V - 5/2009 shprehet se: “*Në parim, ligjvënësia ka nënshtuar të gjitha veprimet hetimore paraprake kontrollit gjyqësor ... Në fund është gjykata që ka të drejtë të shprehet për të gjitha veprimet hetimore përfshirë edhe vendimin e pushimit të çështjes. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij vendimi duhet të konstatojë, nëse prokurori e ka pushuar çështjen në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur*”.⁹⁶

⁹¹ Cila është gjykata që do të gjykojë kundërshtimin e vendimit të pushimit, gjyqtari i vetëm apo si trup gjykues prej tre gjyqtarësh apo gjyqtari që shqyrton kërkesat gjatë hetimeve paraprake?

⁹² **Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre**

Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

⁹³ **Gjykatat e apelit dhe përbërja e tyre** Gjykatat e apelit shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

⁹⁴ Parag. 35.

⁹⁵ **Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit** - Prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë.

⁹⁶ Gjykata Kushtetuese, Vendim nr.5, datë 06.03.2009, faqe 7.

7. Vlerësoj se vendimi i pushimit të çështjes, ose ai i mosfillimit të procedimit, parë edhe në këndvështrimin e një interpretimi sistematik të Kodit, janë akte të fazës së hetimeve paraprake, të disiplinuar në Titullin e VI të K.Pr.Penale. Kompetenca e gjykatës në këtë fazë përcaktohet nga neni 278 i K.Pr.P, pika 2 e të cilit parashikon se “*të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar*”.
8. Ky përfundim nuk cenohet as nga argumenti i dytë i shumicës në mbrojtje të kompetencës së gjykatës së themelit, sipas të cilës vendimi i pushimit të çështjes është në shumë raste një vendim që jep drejtësi, funksion ky që i përket veçse gjykatës së krijuar me ligj. Për këtë, shumica mbështetet në “analogjinë” e nenit 388 të K.Pr.Penale⁹⁷ (vendimi i pafajësisë në gjykimin në themel) me pikën “dh” të nenit 328 të K.Pr.Penale⁹⁸, në të cilin përcaktohet të vendoset pushimi i çështjes kur “del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet se e ka kryer ai”⁹⁹. Fillimisht duhet sqaruar se një “vendim që jep drejtësi” nuk do të thotë domosdoshmërisht vendim themeli. Vetë termi “vendim që jep drejtësi” nuk është gjë tjetër veçse një term arti i përdorur për t’u referuar vendimeve me karakter gjyqësor dhe që ligji dhe Kushtetuta ia atribuojnë vetëm gjykatës së krijuar me ligj. Kështu, jo vetëm një vendim themeli, por edhe një vendim mbi disponimin e masave të sigurisë, përbën dhënie drejtësie.
9. Analogjia e përdorur nga shumica me nenin 388 të K.Pr.Penale përsëri nuk shërben për të mbështetur argumentin e kompetencës së gjykatës së themelit. Në radhë të parë, neni 328 i K.Pr.Penale i referohet disponimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, ndërkohë që neni 388 i K.Pr.Penale, atyre të gjykatës së themelit. Për më tepër, çështja objekt shqyrtimi nuk lidhet me pasjen apo jo të gjykatës së tagrit për të dhënë vendime pafajësie, por cilës gjykatë: asaj të vlerësimit të kërkesave gjatë hetimeve paraprake, apo asaj të themelit? Edhe vetë objekti i vendimit të ankimit kundër pushimit të çështjes është krejtësisht i ndryshëm me atë të vendimit të themelit.
10. Ankimi kundër pushimit të çështjes nuk ka të bëjë me provimin e akuzës, pra me fajësinë apo jo të të pandehurit, në lidhje me kryerjen apo jo të veprës penale e cila i atribuohet, por me ligjshmërinë e veprimeve hetimore të prokurorit, e konkretizuar në vendimin e pushimit të akuzës ose çështjes nga ana e tij. Kjo lidhet edhe me arsyen e parashikimit, nga ana e ligjvënësit, të numrit të gjyqtarëve që përbëjnë trupin gjykues për vepra të caktuara penale. Në referim të nenit 13 të K.Pr.Penale, ky numër rritet në përpjesëtim me rëndësinë e veprës penale dhe të masës së dënimit. Kështu, veprat penale për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet gjykohen vetëm me një gjyqtar, ndërkohë që veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Po ashtu, gjykatat për krimet e rënda gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, me përjashtim të
 - 1) kërkesave të palëve gjatë hetimeve paraprake;
 - 2) kërkesave për ekzekutimin e vendimeve; si dhe
 - 3) kërkesat për marrëdhëniet juridikionale me autoritetet e huaja; të cilat gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Kjo sepse, në gjykimin në themel, ajo çka duhet të provohet, është fajësia e të pandehurit dhe jo

⁹⁷ N.388 K.Pr.P **Vendimi i pafajësisë** Gjykata merr vendim pafajësie kur:

a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston; b) fakti nuk përbën vepër penale; c) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; ç) vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet; d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet; e) fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshimi për qenien e tyre.

⁹⁸ N.328/1/dh K.Pr.Penale **Pushimi i çështjes** 1. Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;

⁹⁹ Parag. 36.

pa fajësia e tij. Në këtë kuptim, është i logjikshëm parashikimi, nga ana e ligjvënësit, i një trupi gjykues të përbërë (prej tre apo pesë) gjyqtarësh në varësi të “*pasojës*” në rast të vërtetimit të fajësisë në përfundim të gjykimit në themel. Përkundrazi, në gjykimin e ankimit kundër vendimit të pushimit të çështjes nuk mund të flitet për gjykatë “themeli” edhe për vetë shkakun (deri diku të vetëkuptueshëm) se në këtë gjykim nuk vendoset mbi “themelin” e çështjes, por mbi vazhdimin ose jo të fazës paraprijëse të gjykimit në themel, atë të hetimeve paraprake.

11. Së fundmi, në argumentin e tretë, shumica mbështetet në papajtueshmërinë e gjyqtarit të hetimeve paraprake, të cilit i ndalohet të marrë pjesë në gjykimin e themelit të akuzës. Siç u sqarua më lart, shumica bazohet në një premisë të gabuar, pasi ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes ***nuk është gjykim mbi themelin e akuzës***. Në këtë kuptim, nuk vepron parimi i paanshmërisë i përcaktuar nga neni 15, pika 2 e K.Pr.P¹⁰⁰, pasi nuk bëhet fjalë për “gjykim”. Cilësimi nga ana e shumicës të vendimit kundër pushimit të çështjes si një vendim “*quasi gjyqësor*” është jo vetëm i sforcuar, por edhe i pabazuar në kod.
12. Pranimi i argumentit të shumicës do të ishte i padobishëm proceduralisht në dobi të praktikës dhe deri diku konfondues të pranisë së dy gjykimesh “themeli”, sidomos në rastet kur pranohet kërkesa kundër vendimit të pushimit dhe pas vazhdimin të hetimeve çështja dërgohet për gjykim. Në lidhje me efektet praktike, për ta ilustruar më mirë, le të marrim një shembull hipotetik në gjykatën për krime të rënda. Le të supozojmë se pas vleftësimit të një mase arresti (1 gjyqtar i investuar), organi i prokurorisë në përfundim të hetimeve vendos pushimin e çështjes. Në vijim të ankimit të të dëmtuarit nga vepra penale, gjykata (me pesë gjyqtarë) vendos pranimin e kërkesës dhe vazhdimin e hetimeve. Në përfundim të hetimeve, prokuroria dërgon çështjen për gjykim, i cili zhvillohet me një trup tjetër gjykues (prej pesë gjyqtarësh). Le të supozojmë se për çdo lloj arsye, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda e kthen çështjen për rishqyrtim në shkallën e parë me trup tjetër gjykues (po prej pesë gjyqtarësh). Në përfundim, vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda do të jenë investuar plot gjashtëmbëdhjetë gjyqtarë, numër ky i barabartë me të gjithë gjyqtarët në atë gjykatë. Çdo të ndodhte nëse, pas rishqyrtimit, kjo çështje do të rikthehej përsëri për rishikim?
13. Në përfundim, mendoj që zgjidhja e drejtë, për sa i përket çështjes së tretë për unifikim, duhet të ishte: **gjykimi i ankimit kundër pushimit të çështjes duhet t’i nënshtrohet rregullave të gjykimit që parashikojnë përbërjen e trupit gjykues, sipas nenit 13, pika “2” germa “a”, dhe 278, pika “2” të K.Pr.Penale¹⁰¹ për gjykimin në shkallë të parë dhe sipas rregullave të përcaktuara në nenin 14 të K.Pr.Penale për gjykimin në apel.**

Në lidhje me çështjen e katërt për unifikim¹⁰²

14. Kundërshtimi im në këtë çështje ka të bëjë me një interpretim të ngushtë që shumica i bën dispozitave të K.Pr.Penale dhe mos gjetjen e një ekuilibri të duhur midis rolit si arbitër të

¹⁰⁰N.15/2 K.Pr.Penale- **Papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim**

Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim.

¹⁰¹ N.278/2 K.Pr.Penale **Kompetencat e gjykatës në hetimet paraprake**

2. Të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.

¹⁰² Gjykata në gjykimin e kësaj çështjeje, kur konstaton se vendimi i pushimit duhet të ndryshohet (shfuqizohet) dhe hetimet të vazhdojnë, a ka të drejtë të përcaktojë se cilat janë veprimet që prokurori duhet të bëjë domosdoshmërisht? Gjithashtu, kur nuk ka nevojë për hetime të tjera, a ka të drejtë gjykata të urdhërojë prokurorin për të dërguar çështjen në gjykim?

gjykatës në sistemin akuzator nga njëra anë dhe kontrollit të ligjshmërisë së vendimit të prokurorit, nga ana tjetër. Për të evituar çdo keqkuptim, më duhet të theksoj se ndaj të njëjtin mendim me shumicën për sa i përket nënpyetjes së parë të çështjes së katërt që lidhet me kërkesën e ankuesit, ku arrihet në përfundimin që “*gjykata shqyrton, jo vetëm bazueshmërinë e kërkimeve të paraqitura nga ana e ankuesit, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së këtij vendimi, duke verifikuar nëse nga ana e prokurorit janë respektuar drejt rastet e parashikuara nga ligji lidhur me pushimin e çështjes penale*”.

15. Megjithatë, shumica në përgjigjen mbi nënpyetjen e dytë, ka arritur në përfundimin se “*Kur vendos shfuqizimin e vendimit, gjykata ka të drejtë të disponojë mbi kryerjen e veprimeve të tjera që kanë lidhje me akuzën dhe me veprimet hetimore të kryera deri në atë çast, në funksion të zbulimit të fakteve dhe të vërtetës për ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit*”. Pra, edhe pse shumica e pranon mundësinë e gjykatës për të disponuar mbi kryerjen e veprimeve të tjera, nuk e specifikon në mënyrë të qartë, nëse kjo ka të bëjë me ligjshmërinë e veprimeve të kryera, apo mund që, në bazë të akteve, të konstatojë *proprio motu* elemente të veprës penale të anashkaluara nga hetimet e prokurorit. Natyrisht, në këtë rast nuk bëhet fjalë kurrësi për ngritjen e akuzës nga gjykata, funksion ky ekskluziv i organit të ndjekjes penale. Siç jam shprehur edhe në një mendim pakice të mëparshëm: “*E drejta për kontroll ndaj vendimit të pushimit të çështjes së prokurorit i jep attribute gjykatës që në rast se nuk ndan të njëjtin qëndrim në lidhje me vendim-marrjen e prokurorit të urdhërojë prokurorin të vazhdojë hetimet duke e orientuar drejt kalimit të çështjes në gjykim duke i bërë të qartë ekzistencën e faktit penal dhe të dyshimeve mbi autorin e veprës penale. Kjo mënyrë vendimmarrje nuk dhunon Kushtetutën dhe as nuk interferon mbi kompetencën e prokurorit për sa kohë procedura i jep të drejtë gjykatës të kontrollojë vendim-marrjen e prokurorit dhe të disponojë me vendim*”.¹⁰³
16. Sa më sipër, mendoj se duhej të ishte arritur përfundimi sipas të cilit: **Gjykata, kur vendos shfuqizimin e vendimit, ka gjithashtu të drejtë, nëse gjatë shqyrtimit të akteve ka konstatuar *proprio motu*, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme, ekzistencën e një fakti a elementi penal të pa hetuar më parë ose të një vendimmarrje të gabuar në lidhje me pushimin e procedimit penal, të urdhërojë prokurorin për vazhdimin e mëtejshëm të hetimit çka nënkupton jo vetëm kryerjen e veprimeve hetimore që kanë të bëjnë me ekzistencën ose jo të faktit penal, por në rast se ato janë të plota edhe të akteve procedurale të domosdoshme për ta kaluar çështjen në gjyq. Në këtë rast kontrolli gjyqësor që të jetë një mjet efektiv drejtësie duhet të shtrihet jo vetëm mbi veprimet hetimore që janë të nevojshme në kuadër të procesit hetimor, por dhe të ligjshmërisë së vendimmarrjes së vendimit të prokurorit në rastin kur disponohet me vendim pushimi të procedimit penal duke qenë gjykata i vetmi organ i pavarur që jep drejtësi.**

Shkëlzen Selimi

MENDIMI I PAKICËS

Unë, anëtari i Gjykatës së Lartë, Aleksandër Muskaj, jam i mendimit që gjykata nuk mund të shfuqizojë vendimin e pushimit të çështjes penale, kur janë kryer të gjitha veprimet hetimore, në pajtim me kërkesat e procesit të rregullt ligjor. Kjo është dhe arsyeja kryesore e mospajtimit tim me shumicën.

¹⁰³ Gjykata e Lartë, Kolegji Penal, Vendim nr.146, datë 23.05.2012, parag.15.

Unifikimi i praktikës gjyqësore, në rastin në gjykim, merr shtysë nga vlerësime të ndryshme të veprimtarisë procedurale, që lidhet me gjendje, nga të cilat rrjedhin vendime të “mosfillimit të procedimit penal” dhe të “pushimit të procedimit penal”.

Ndërsa vendim-marrja për “mosfillimin e procedimit penal” lidhet kryesisht me vlerësime subjektive të faktit penal (përbën apo nuk përbën bazë për fillimin e procedimit, etj.), “pushimi i procedimit penal” vjen pasi është kryer një veprimtari e mirëfilltë procedurale. Janë vlerësuar prej autoritetit procedues ekzistenca e elementeve të figurës së veprës penale dhe janë konstatuar të “meta” apo “mangësi”, materiale apo subjektive, të cilat nuk lejojnë, apo nuk mundësojnë dërgimin e çështjes në gjyq.

Tendenca e sistemit të ri të së drejtës është që ta shkëpusë gjykatën nga bashkëpunimi material dhe institucional me “hetuesinë” apo prokurorinë. Suksesi apo dështimi i organit të akuzës nuk i intereson dhe nuk duhet t’i interesojë gjykatës. Interesimi minimal, qoftë dhe mbi bazën e ndonjë infrastrukture ligjore atavike, do ta shndërronte gjykatën në palë.

Shumica, për të mbrojtur vendimmarrjen e saj, ka përdorur terminologji që përfaqëson institute dhe veprimtari procedurale jo vetëm të panjohur nga sistemi ynë i së drejtës, por edhe të papajtueshëm me të.

Ndërkohë që ishte detyrë e shumicës t’i paraprijë ndryshimeve ligjore, duke materializuar përparësi që e shkëpusin gjykatën nga pjesëmarrja në realizimin me sukses të procedimit penal.

Në këtë të ardhme që projekton shumica, duket me drejtim të kundërt me zhvillimin detyrimi i gjykatës të vlerësojë dhe të korrigjojë veprimtari procedurale me karakter “ndëshkues” të njërës palë – shtetit, kundër një pale tjetër – njeriut, merr karakter të dyshimtë.

Unifikimi i këtij qëndrimi do të udhëheqë trupat gjyqësore drejt vlerësimeve, gjithmonë të karakterit subjektiv dhe, gjithmonë me objektivin për krijimin e një mundësie tjetër apo jo të organit të akuzës.

Për të shoqëruar opinionin tim, edhe natyra procedurale e debatit edhe mundësia e përdorimit të arsytimit të GjEDNj si burim ligji, më lejojnë të citoj dhe të përdor përfundime të GjEDNj, në çështjen “Driza kundër Shqipërisë”, ankimi nr.33771/02, datë 13 Nëntor 2007:

“74. Gjykata pohoi se ka rëndësi themelore që në një shoqëri demokratike gjykata të përcjellë besim tek qytetarët (shih *Padovani v. Italy*, vendimi i dt. 26 Shkurt 1993, *Seria A nr.257-B p.20*). Neni 6 kërkon që një gjykatë, brenda juridiksionit të saj, të jetë e paanshme. Paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi, apo anësie dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Kështu, Gjykata ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm (shih *Piersack v. Belgium*, vendimi i datës 1 Tetor 1982, *Seria A nr.53*, § 30 dhe *Kyprianou v. Cyprus [GC]*, nr.73797/01, § 118-119, *ECHR 2005-...*).

78.Gjykata është e mendimit se kjo praktikë e Gjykatës së Lartë Shqiptare nuk ishte e pajtueshme me kriterin e “paanësisë subjektive” të një gjyqtari që shqyrton një çështje, përderisa askush nuk mund të jetë në të njëjtën çështje paditës dhe gjyqtar (shiko *Svetlana Naumeko v. Ukraine nr.41984/98*, § 97. datës 9 Nëntor 2004)”.

Sidoqoftë, në vlerësimin tim, me këtë qëndrim, shumica sjell në vëmendje dhe diskutim njëkohësisht, parimet të së drejtës, në veçanti atë të paanësisë dhe të objektivitetit në gjykim.

Unë përjashtoj nga këto vlerësime rastet e mosfillimit apo të pushimit të procedimit penal, për akuza dhe subjekte të parashikuara në nenin 284, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale.

Aleksandër Muskaj

Nr.5/4/1 i Regj. Themeltar

Nr.1 i Vendimit

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Ardian Dvorani	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Artan Broci	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar

më datë 18.06.2013, dhe 19.06.2013 morën në shqyrtim në çështjen penale me nr.5/4 Akti, Regj. Themeltar, me palë:

KËRKUESE:	PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, përfaqësuar nga Prokurori pranë Gjykatës së Lartë, Arqilea Koça.
I GJYKUAR:	STILIAN VATHI, përfaqësuar nga Avokati Koli Bele, i caktuar kryesisht.

A K U Z U A R:

Për veprën penale të dezertimit,
parashikuar nga neni 33/1 i Kodit Penal Ushtarak.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.111, datë 13.03.2007, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Stilian Fadil Vathi për kryerjen e veprës penale të dezertimit parashikuar nga Neni 33/1 i K.P.Ushtarak dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.948 akti, datë 24.05.2007, ka vendosur:
Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

Rivendosjen në afat të ankimit të kërkuesit Stilian Vathi kundër vendimit gjyqësor nr.111, datë 13.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.24, datë 13.09.2007, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.111, datë 13.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1569, datë 09.11.2007, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës.

Rivendosjen në afat të ankimit për në Gjykatën e Lartë kundra vendimeve gjyqësore nr.111, datë 13.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr.24, datë 13.09.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs i gjykuari Stilian Vathi, nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe:

- Të dy vendimet e gjykatave janë marrë në mungesë të të pandehurit, pa u njoftuar ai për datën dhe orën e gjykimit, duke i mohuar atij në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt e të drejtë gjyqësor, duke shkelur rëndë dispozitat procedurale penale që garantojnë një proces të rregullt ligjor.
- Në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë mungojnë njoftimet e rregullta për të pandehurin prandaj dhe me të drejtë po kjo gjykatë ka pranuar kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.
- Të njëjtin gabim ka bërë edhe gjykata e apelit, ku edhe pse dihej adresa e saktë e të pandehurit, nuk ekziston asnjë fletëthirrje që t'i jetë komunikuar atij apo ndonjë familjari të tij, për më tepër që nga kjo gjykatë nuk është njoftuar as avokati i caktuar me prokurë nga i pandehuri, duke zhvilluar edhe ajo një proces jo të rregullt ligjor.
- Në Gjykatën e Apelit Tiranë është bërë njoftimi me shpallje për të pandehurin në kundërshtim me kërkesat e nenit 140/4 të K.P.Penale, pasi nuk janë respektuar asnjë prej kërkesave të kësaj dispozite.
- Gjykatat kanë gabuar edhe në kualifikimin ligjor të veprës penale, pasi nuk jemi para elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 33/1 i Kodit Penal Ushtarak, sepse i pandehuri është larguar nga reparti me leje për shkak se e ka pasur nënën shumë të sëmurë dhe është proceduar dhe arrestuar pa u vënë në dijeni për këtë procedim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.s'ka, datë 21.10.2009, ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim njehsimin e praktikës gjyqësore.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim nr.5/4 regjistri themeltar, datë 20.01.2011, kanë vendosur:

Pezullimin e gjykimit të çështjes penale me nr.5/4 Regj. Themeltar datë 11.01.2010 dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar pajtueshmërinë e dispozitave të pikave 4 dhe 6 të nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42, pika 2, 43 dhe 135 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendim nr.31, datë 17.05.2012, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 6 të nenit 147 të K.Pr.P., për shprehjen “në gjykatën e apelit”.

Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 4 të nenit 147 të K.Pr.P.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Mirela Fana dhe Medi Bici; mendimin e prokurorit Arqilea Koça, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Ushtarak Tiranë; në mungesë të përfaqësuesit të të pandehurit; pasi e bisedoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

I. Rrethanat e faktit

1. Nga shqyrtimi gjyqësor në dy shkallët e gjykimit dhe vendimet e dhëna nga dy gjykatat e faktit, rezultojnë të pranuar prej tyre rrethanat si vijon: i pandehuri Stilian Vathi është mobilizuar nga Dega e Mobilizimit Ushtarak Tiranë me datë 08.08.2006 për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe është caktuar në Repartin Ushtarak Qendra Stërvitore Vertop në Berat, ku edhe ka kryer periudhën stërvitore të karantinës.
2. Pas përfundimit të karantinës me datë 04.10.2006, i pandehuri Stilian Vathi është transferuar në Repartin Ushtarak nr.4451 Tiranë, për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.
3. Me datën 06.12.2006, i pandehuri Stilian Vathi është larguar pa leje nga Reparti nr.4451 Tiranë, largim për të cilën Komanda e këtij Reparti Ushtarak ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë Tiranë.
4. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar procedimin penal me nr.395, në datën 20.12.2006, në ngarkim të të pandehurit Stilian Vathi, akuzuar për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar nga neni 33/1 të K.P.Ushtarak.
5. Hetimet paraprake në ngarkim të tij, si dhe gjykimi i çështjes janë bërë në mungesë të të pandehurit.

II. Procedurat gjyqësore.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.111, datë 13.03.2007, ka deklaruar fajtor të gjykuarin Stilian Vathi për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar në nenin 33, paragrafi i parë i K.Penal Ushtarak, vepër për të cilën është dënuar me 6 muaj burgim.
7. Me datë 11.05.2007, Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë ka bërë ekzekutimin e vendimit nr.111, datë 13.03.2007 ndaj të gjykuarit Stilian Vathi.
8. I gjykuari Stilian Vathi, meqenëse kishte humbur afatin për të bërë ankim në gjykatën e apelit, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit.
9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.948 akti të datës 24.05.2007, ka pranuar kërkesën e të gjykuarit Stilian Vathi për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit të themelit nr.111, datë 13.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
10. Mbi ankimin e të gjykuarit, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.24, datë 13.09.2007, ka lënë në fuqi vendimin nr.111, datë 13.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin i gjykuari Stilian Vathi është deklaruar fajtor për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar në nenin 33, paragrafi i parë i Kodit Penal Ushtarak, duke u dënuar me 6 muaj burgim.
11. Përveç sa më sipër, i gjykuari Vathi, ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për t’u rivendosur në afat e drejta e tij për të paraqitur rekurs në

- Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.24, datë 13.09.2007, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i fajësisë dhe dënimit të tij.
12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1569 akti, datë 09.11.2007, ka pranuar kërkesën e të gjykuarit për t'u rivendosur në afat e drejta e tij për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.
 13. Në bazë të këtij vendimi, i gjykuari Stilian Vathi ka paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar shkaqet e përmendura në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
 14. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë prokurori Artur Selmani ka pretenduar se rekursi i të gjykuarit nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi vendimi që ka rivendosur në afat të drejtën e rekursit për të gjykuarin është i pabazuar në ligj dhe konkretisht, përcaktimeve të nenit 147 të K.Pr.Penale, në pjesën që ka të bëjë me marrjen dijeni efektivisht për vendimin e ankimuar.
 15. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim këtë çështje në seancën gjyqësore të datës 21.10.2009, ka konstatuar se zgjidhja e kësaj çështjeje ka lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit 147 të K.Pr.Penale, parë në aspekt të respektimit të parimeve kushtetuese dhe të KEDNJ. Gjithashtu Kolegji ka konstatuar qëndrime jo të njëjta si nga gjykatat me të ulëta, ashtu edhe nga vetë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.
 16. Kolegji Penal, si rrjedhojë e këtyre qëndrime të ndryshme, në bazë të nenit 438 të K.Pr.Penale dhe me qëllimin e ndryshimit dhe njësimin të praktikës gjyqësore, me vendimin nr.1641/833 Regjistri të datës 21.10.2009, ka vendosur të kalojë çështjen penale, që i përket të dënuarit Stilian Vathi, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
 17. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim nr.5/4, regjistri themeltar, datë 20.01.2011, kanë vendosur *“Pezullimin e gjykimit të çështjes penale me nr.5/4 Regj. Themeltar datë 11.01.2010 dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar pajtueshmërinë e dispozitave të pikave 4 dhe 6 të nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42 pika 2, 43 dhe 135 të Kushtetutës”*.
 18. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me vendim nr.31, datë 17.05.2012, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 6 të nenit 147 të K.Pr.P, për shprehjen “në gjykatën e apelit”. Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 4 të nenit 147 të K.Pr.P.”*.

III. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara.

19. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se, nga gjykatat më të ulëta, por edhe nga vetë Kolegji Penal i kësaj gjykate, mbahen qëndrime të ndryshme në lidhje me kuptimin e institutit të rivendosjes në afat të drejtës së ankimit, qëndrime të ndryshme në interpretimin dhe zbatimin e nenit 147 të K.Pr.P.
20. Duke iu referuar praktikës unifikuese të saj vlerëson të sjellë në vëmendje përfundimet unifikuese të shprehura në vendimin nr.2 të vitit 2002, në të cilin Kolegjet janë investuar dhe janë shprehur posaçërisht për Institutin e rivendosjes në afat të drejtës së ankimit.
21. Kështu, Kolegjet e Bashkuara me vendimin unifikues të vitit 2002 kanë ardhur në përfundimin se gjykata (kompetente) që duhet të procedojë me shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të drejtës së ankimit, në çdo rast e rrethanë, është gjykata e shkallës së parë, duke arsyetuar se *“...në kuptim të nenit 147 të K.Pr.P., kërkesa për rivendosje në afat për të bërë ankim paraqitet (shqyrtohet) në gjykatën që ka dhënë vendimin dhe si e tillë duhet kuptuar përgjithësisht gjykata e shkallës së parë (gjykata e rrethit gjyqësor përkatës). Kjo rezulton nga përmbajtja e pikave 5 dhe 6 të nenit 147 të K.Pr.P. ...*

pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në themel ose jo edhe nga gjykata e apelit, kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosjen e afatit të ankimit është gjykata e shkallës së parë. Gjykata e apelit dhe pas saj Gjykata e Lartë shqyrtojnë vetëm ankimet kundër vendimeve respektive...”

22. Por, pavarësisht sa më lart, Kolegjet konstatojnë se, si nga gjykatat më të ulëta, edhe nga vetë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vazhdohet të mbahen qëndrime jo të njëjta në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Institutit të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit. Dhe konkretisht, konstatohen qëndrime jo të njëjta në lidhje me kuptimin e termave të përdorura në këtë dispozitë si: *“gjykatë kompetente”* për të shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat të ankimit, *“organ që procedon”*, palët që duhet të marrin pjesë në shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, e drejta e ankimit në rastet e pranimit apo refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat, etj..
23. Kolegji Penal, si rrjedhojë e këtyre qëndrime të ndryshme, në bazë të nenit 438 të K.Pr.Penale dhe me qëllimin e ndryshimit dhe njësimimit të praktikës gjyqësore, me vendimin nr.1641/833 Regjistri të datës 21.10.2009, ka vendosur të kalojë çështjen penale, që i përket të dënuarit Stilian Vathi, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke shtruar për diskutim këto çështje për unifikim:
 23. (i) *Kundër vendimit të gjykatës që lejon rivendosjen në afat për bërjen e rekursit, a mund të bëhet ankim nga palët përpara shqyrtimit të çështjes së themelit në Gjykatën e Lartë dhe cili do të konsiderohet “vendim përfundimtar”, sipas kuptimit të nenit 147/5 të K.Pr.Penale?*
 23. (ii) *Nëse Gjykata e Lartë, gjatë shqyrtimit të rekursit, konstaton se vendimi i rivendosjes në afat vjen ndesh me ligjin, a ka të drejtë të ndërhyjë në këtë vendim nëse nuk ka rekurs nga palët ndaj vendimit të themelit, nisur nga pengesa e ligjit për ankimin ndaj vendimit që lejon rivendosjen në afat?*
 23. (iii) *Nëse në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit njëra nga palët kërkon mospranimin e ankimit me arsyetimin se vendimi që ka pranuar kërkesën për rivendosjen në afat është në kundërshtim me ligjin, a ka të drejtë gjykata e apelit të shqyrtojë këtë kërkesë pa i hyrë shqyrtimit gjyqësor të themelit, nisur nga përmbajtja e nenit 147/5 të K.Pr.Penale, sipas të cilit vendimi që lejon rivendosjen në afat mund të ankimohet vetëm me vendimin përfundimtar”?*
24. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi kanë marrë në shqyrtim këtë çështje në seancën gjyqësore të datës 20.01.2011, me vendimin nr.5/4 Regjistri Themeltar, kanë vendosur: *“Pezullimin e gjykimit të çështjes penale me nr.5/4 Regj. Themeltar datë 11.01.2010 dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar pajtueshmërinë e pikave 4 dhe 6 të nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42 pika 2, 43 dhe 135 të Kushtetutës”, me arsyetimin se formulimi e nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale në pikat 4 dhe 6 nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe veçanërisht me nenet 3, 4, 42, pika 2, 43 dhe 135 të saj.*
25. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në shqyrtimin e kërkesës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendim nr.31, datë 17.05.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 6 të nenit 147 të K.Pr.P., për shprehjen *“në gjykatën e apelit”* dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 4 të nenit 147 të K.Pr.P.
26. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj arsyeton se: *“... Sipas pikës 6 të nenit 147 të K.Pr.P. ankimi kundër vendimit të refuzimit të kërkesës mund të bëhet në gjykatën e apelit”. Shprehja “në gjykatën e apelit” të çon në përfundimin se mospranimi është vendosur nga gjykata e shkallës së parë. Si rrjedhim, gjykata vlerëson se kuptimi/zbatimi jo i drejtë i dispozitës së nenit 147/4 rrjedh pikërisht nga togfjalëshi “në gjykatën e apelit”*

i parashikuar në nenin 147/6 të K.Pr.P. Nëse pjesë e këtij togfjalëshi nuk do të ishte “e apelit”, atëherë ankimi do të bëhej në gjykatën më të lartë respektive ndaj vendimit të dhënë nga një gjykatë më e ulët, kompetenca e së cilës do të përcaktohej sipas rastit. Në këtë mënyrë, do të garantohej edhe parimi i gjykatës së caktuar me ligj, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Për këtë arsye, gjykata çmon se togfjalëshi “në gjykatën e apelit” bie ndesh me nenin 42/2 dhe 135 të Kushtetutës...”.

27. Në lidhje me çështjet që shtrihen për unifikim për efekt të njësimin të praktikës gjyqësore, tashmë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në seancën gjyqësore të datës 18.06.2013 përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme mbajti qëndrimin se: *“unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me kompetencën e gjykimit të kërkesave për rivendosje në afat, ku kompetente e gjykimit të kërkesës për rivendosje në afat t’i takojë asaj gjykate e cila është kompetente për shqyrtimin e atij mjeti ankimi që kërkohet të rivendoset në afat. Unifikimin e praktikës në rastin kur gjykata kompetente refuzon kërkesën për rivendosje në afat, atëherë, në rast refuzimi të rivendosjes në afat të apelit, ndaj atij vendimi të mund të ushtrohet rekurs ose në rast të refuzimit të rivendosjes në afat të rekursit, vendimi të konsiderohet përfundimtar. Unifikimin e praktikës në rastin kur gjykata kompetente pranon kërkesën për rivendosje në afat, atëherë në rast të pranimit të kërkesës për rivendosje në afat të apelit ndaj atij vendimi të mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Në rast të pranimit të rivendosjes në afat të rekursit vendimi të konsiderohet përfundimtar”.*
28. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe qëndrimeve të palëve në gjykim, për t’i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, gjithmonë në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të shkaqeve të parashtruara në rekursin e të gjykuarit për zbatim të gabuar të ligjit penal procedural nga ana e gjykatave të faktit, vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh kuptimi e zbatimi i dispozitave të Kodit Procedurës Penal lidhur me institutin procedural të rivendosjes në afat, të parashikuara në dispozitat në Titullin III, Kreu III të K.Pr.Penale, të titulluar “AFATET”.
29. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë të theksojnë se ligjvënësi, me qëllimin e mbrojtjes si të interesave të të pandehurve (të drejtës subjektive), ashtu edhe të interesit të shoqërisë në një proces gjyqësor penal, ka përcaktuar në mënyrë të qartë në ligjin procedural penal afate procedurale për të hartuar aktet procedurale, të detyrueshme për t’u zbatuar si për gjykatat, ashtu edhe nga palët ndërgjyqëse në një proces penal.
30. Rivendosja në afat është një institut procedural që për ligj karakterin formal të ligjit procedural. Ligjvënësi ka përcaktuar se rivendosja në afat, që nënkupton kthim mbrapa në kohën procedurale, pra kthim në momentin kur ka lindur e drejta për të përmbushur aktin procedural, është një institut përjashtimor, i mirëpërcaktuar dhe jo i mundshëm për t’u zbatuar për çdo lloj rasti.
31. Instituti i rivendosjes në afat ka si qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, konkretisht garantimi i ushtrimit të së drejtës nga palët në proces për të kundërshtuar një vendim në një gjykatë më të lartë, në ato raste, të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligjvënësi, kur nuk ka pasur mundësi që ta ushtrojë këtë të drejtë brenda afatit ligjor.
32. Rivendosja në afat lejon palën ndërgjyqëse të ushtrojë të drejtën e ankimit kundër vendimit të themelit, pavarësisht tejkalimit të afateve, të cilat për shkak të natyrës prekluzive, me plotësimin apo kalimin e tyre, kanë çuar në dekadencë të së drejtës së saj për të ushtuar këtë ankim.
33. Siç është përmendur më sipër në pjesën përshkruese-arsyetuese të këtij vendimi, ligjvënësi ka parashikuar Institutin e rivendosjes në afat në Titullin III, Kreu III të K.Pr.Penale e konkretisht:

1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore.
2. Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijëni për vendimin.
3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijëni efektivisht për aktin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë për çdo shkallë të procedimit.
4. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj.
5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.
6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit”(neni 147 i K.Pr.Penale).
34. Rastet e parashikuara nga neni 147 i K.Pr.Penale për rivendosjen në afat duhen interpretuar në mënyrë shteruese, të lidhura ngushtësisht me arsyet objektive që kanë penguar palën në ushtrimin efektiv të së drejtës së saj. Kështu pika 1 e nenit 147 parashikon “*forcën madhore*” apo “*rastin faktor*”, si shkak për t’u rivendosur në afat të ankimit kundër një vendimi penal themeli.
35. Ndërsa pika 2 e nenit 147 përcakton si shkak për rivendosjen në afat, “*gjykimin në mungesë*” për aq sa provohet se, i pandehuri nuk ka marrë dijëni për zhvillimin e procesit dhe vendimin.
36. Rastet e sipërcituara përbëjnë kusht “*sine qua non*”, ekzistenca e të cilave justifikon në mënyrë të mjaftueshme paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat. Pala që është ndodhur në këto kushte ka të drejtë që t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për rivendosje në afat. Me anë të kësaj kërkesë, pala që është ndodhur në kushtet e pamundësisë objektive të paraqitjes së ankimit ndaj vendimit të themelit, synon që të rifitojë përsëri kohën që ka kaluar që nga momenti i verifikimit të shkakut deri në momentin e zhdukjes së tij.
37. Shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ekzistencës së kushteve dhe provave të nevojshme për vërtetimin e tyre bëhet nga gjykata gjatë zhvillimit të një procesi, i cili nuk është i njëjtë me gjykimin e themelit të çështjes, bazuar edhe në premisat logjike dhe funksionale që e karakterizojnë atë, ku kërkuesi ka detyrimin (barrën) për të provuar situatën në të cilën është ndodhur, e cila pa fajin e tij e ka vendosur në pamundësi absolute për të respektuar afatet procedurale. Pra, gjatë shqyrtimit të kërkesës, ligjvënësi ka normuar të drejtën e kërkuetit për t’u rivendosur në afat, por vetëm nëse ai provon se nuk ka marrë dijëni për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe vendimit, të provojë se kjo padijëni nuk ka ardhur për faj të tij.
38. Në vijim të këtij arsytimi dhe nga shqyrtimi i dispozitave të sipërcituara, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se dispozitat që kanë sjellë debate, qëndrime të ndryshme dhe vështirësi në praktikën gjyqësore janë ato të pikës 4, 5 dhe 6 të nenit 147 të këtij Kodi, ku parashikohet se: “4. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj. 5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar. 6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit”.
39. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke pasur parasysh edhe qëndrimet përkatëse në vendimin nr.31, datë 17.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese, arrijnë në përfundimin se është vendi për të ndryshuar qëndrimet e tyre të mëparshme, ndryshe nga praktika e unifikuar aktualisht e vendosur sipas vendimit unifikues nr.2, datë 14.10.2002, në lidhje

me mjetin procedural të rivendosjes në afat të ankimit, pra edhe dispozitat e neneve 147 e 148 të K.Pr.P.

40. Në rrethanat kur dispozitat e ligjit procedural nuk parashikojnë rregulla më të hollësishme, nuk janë të qarta apo përmbajnë edhe ndonjë kundërshti mes tyre, janë gjykatat ato që duhet të zgjidhin çështjen duke i zbatuar normat juridike në përputhje me qëllimin e përmbajtjen e tyre dhe në respektim të parimeve themeltare mbi të cilat qëndron procedimi penal në një shtet të së drejtës.
41. Në vijim të arsytimit të më sipërm, në referim të çështjeve që janë shtruar për unifikim, Kolegjet e vlerësojnë me vend t’iu japin përgjigje këtyre pyetjeve:
- (i) *Cila do të konsiderohet gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat, gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit është ushtruar ankim, apo gjykata që do të shqyrtojë ankimin për vendimin e themelit?*
- (ii) *Në procesin e shqyrtimit të ankimit cilat do të jenë palët pjesëmarrëse në proces?*
- (iii) *Në varësi të pranimit apo rrëzimit të kërkesës për rivendosje në afat, cila do të jetë gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit dhe a lejohet që palët në të dy rastet të bëjnë ankim (pra si kur rrëzohet, ashtu edhe kur pranohet kërkesa për rivendosje në afat).*
42. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në përgjigje të pyetjeve të sipërcituara do të kenë në konsideratë, ndër të tjera, edhe vlerësimet dhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje.
43. Konkretisht në vendimin nr.31, datë 17.05.2012, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se: “... gjykata vlerëson se paqartësia që pretendohet nga gjykata referuese se, shprehja “organi që procedon” nënkupton patjetër gjykatën e shkallës së parë, nuk rrjedh nga pika 4 e nenit 147 të K.Pr.Penale por nga kuptimi që i është dhënë kësaj shprehje nga vetë gjykata referuese në vendimin unifikues të saj. Shprehja “organi që procedon” i referohet organit që ka dhënë vendimin, ndaj të cilit kërkohet të ankohet i gjykuari. Pra, nëse i gjykuari kërkohet të ushtrojë ankim ndaj vendimit të apelit, kërkesën për rivendosje në afat duhet ta shqyrtojë gjykata e apelit dhe jo gjykata e rrethit gjyqësor ...”

A .Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së parë.

44. Duke pasur parasysh sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në përgjigje të pyetjes së parë të shtruar për zgjidhje (*Cila do të konsiderohet gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat, gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit është ushtruar ankim, apo gjykata që do të shqyrtojë ankimin për vendimin e themelit?*), **arrin në qëndrimin unifikues se: gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit ushtrohet ankim. E thënë ndryshe, nëse kërkohet rivendosje në afat për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat do të jetë gjykata e shkallës së parë. Respektivisht, nëse kërkohet rivendosja në afat për të bërë ankim (rekurs) kundër vendimit të gjykatës së apelit, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata e apelit.**
45. Në këtë përfundim Kolegjet vlerësojnë se janë në koherencë të plotë me konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në vendimin nr.31, datë 17.05.2012.

B .Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së dytë.

46. Për t’i dhënë përgjigje pyetjes së dytë të shtruar për unifikim (*Në procesin e shqyrtimit të ankimit cilat do të jenë palët pjesëmarrëse në proces?*), Kolegjet e Bashkuara do të nisen nga përcaktimi i bërë nga ligjvënësi në nenin 147, pika 1 e K.Pr.Penale, i cili përcakton se:

“...prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore...”

47. Në vështrim të këtij përcaktimi të ligjvënësit, duke e parë dispozitën e nenit 147 të K.Pr.Penale në tërësi, në harmoni me dispozitat e tjera të këtij kodi, që përcaktojnë përgjithësisht formën e procesit gjyqësor penal dhe palët pjesëmarrëse në këtë proces, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se palët pjesëmarrëse në procesin gjyqësor për rivendosje në afat, do të jenë pikërisht ato të përcaktuara në pikën 1 të nenit 147 të K.Pr.Penale.
48. **Në vijim të arsyetimit të mësipërm Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në qëndrimin unifikues se: palë pjesëmarrëse në gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat do të jenë sipas rastit: prokurori, i pandehuri (i gjykuari), palët private dhe mbrojtësit përkatës.**

C. Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së tretë.

49. Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë me vend trajtimin e saj në dy situata të ndryshme, ashtu siç i parashikon ligjvënësi në nenin 147 të K.Pr.Penale, e konkretisht:
- e para* : në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat pranohet nga gjykata, pra kur pala që ka humbur afatin është rivendosur në afat për të bërë ankim;
- e dyta*: në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat është refuzuar nga gjykata.
50. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë më të ndërlikuar në dukje situatën e parë të pyetjes së tretë të shtruar për zgjidhje e pikërisht kur kërkesa për rivendosje në afat pranohet nga gjykata, pra kur pala që ka humbur afatin është rivendosur në afat për të bërë ankim, situatë ligjore e parashikuar nga ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.Pr.Penale: *“5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar...”*
51. Pra, ndryshe nga parashikimi i pikës 6 të nenit 147, sipas të cilit pala kërkuese mund të bënte ankim menjëherë dhe në çdo rast kur kërkesa për rivendosje në afat refuzohet nga gjykata, në rastin e parashikuar në pikën 5 të po këtij neni, ligjvënësi ka vendosur kufizime për palën që kërkon të bëjë ankim kundër vendimit të gjykatës që lejon rivendosjen në afat.
52. Sipas këtij parashikimi, pala e cila nuk është dakord me vendimin e gjykatës që ka rivendosur në afat të drejtën për të bërë ankim, jo në çdo rast mund të ankohet kundër këtij vendimi, por vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.
53. Për efekt të kuptimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë me vend të sqarojmë edhe njëherë kuptimin e vendimit përfundimtar të gjykatës, të cituar nga ligjvënësi.
54. Gjykata (e cilësdo shkallë gjykimi), shprehet me tre lloje vendimesh: 1. me vendim të ndërmjetëm. 2. me vendim jo përfundimtar dhe 3. me vendim përfundimtar.
55. Vendime të ndërmjetme janë ato që jepen gjatë gjykimit për të siguruar zhvillimin e gjykimit në mënyrë të rregullt në pajtim me kërkesat e dispozitave procedurale, si p.sh. *vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për marrjen e një prove, për shtyrjen e gjykimit, për kryerjen e një ekspertimi, etj...*
56. Vendimet jopërfundimtare janë të gjitha llojet e vendimeve që pa e zgjidhur çështjen në themel i japin fund procesit gjyqësor penal të filluar.
57. Ndërsa vendime përfundimtare janë ato vendime që zgjidhin çështjen në themel, ku përfshihen jo vetëm vendimet e gjykatës së apelit, por edhe vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor që zgjidhin në themel çështjen (p.sh. që deklarojnë fajtor të pandehurin, që e deklarojnë të pafajshëm atë, etj.).

58. Në këtë kuadër, në interpretim të pikës 5 të nenit 147 të K.Pr.Penale, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në qëndrimin unifikues se: **pala (pjesëmarrëse në gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat), e cila nuk është dakord me vendimin për rivendosjen në afat, nuk mund të bëjë ankim në çdo kohë kundër këtij vendimi. Ajo (pala) mund të ankohet kundër vendimit të rivendosjes në afat, vetëm nëse ankohet për vendimin përfundimtar të gjykatës, që do të thotë kundër vendimit që ka zgjidhur çështjen në themel dhe vetëm bashkë me këtë vendim.**
59. **Pra nëse kërkesën për rivendosje në afat e ka shqyrtuar gjykata e rrethit gjyqësor (dhe ka vendosur pranimin e saj), pala që nuk është dakord me këtë vendim mund të bëjë ankim ndaj tij vetëm nëse ankohet kundër vendimit të gjykatës së apelit që ka zgjidhur çështjen në themel në këtë rast (mbi bazën e ankimit të paraqitur bashkë me vendimin për rivendosje në afat), sepse ai është vendimi përfundimtar për të cilin shprehet ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.Pr.Penale.**
60. Në analizë sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se qëndrimi i mbajtur nga ligjvënësi në këtë rast është plotësisht i drejtë, pasi nëse pala e cila nuk ka qenë dakord me vendimin për rivendosjen në afat, por është dakord dhe nuk ka ankim kundër vendimit përfundimtar që ka zgjidhur çështjen në themel, nuk do të bënte sens që kjo palë të ankohej vetëm kundër vendimit për rivendosjen në afat. Në këtë rast mjete i ankimit do të ishte jo efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ.
61. Por, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se situata duket e pazgjidhur plotësisht për rastin tjetër, kur kërkesën për rivendosje në afat e ka gjykuar gjykata e apelit. Në këtë rast vendimi përfundimtar, për të cilin bën fjalë ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.Pr.Penale, është vendimi i Gjykatës së Lartë dhe palët nuk mund të ankohen kundër këtij vendimi.
62. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga qëllimi përfundimtar i gjykimit, që është dhënia e drejtësisë dhe zgjidhja në themel e çështjes, çmojnë se, pavarësisht se pala nuk mund të ushtroje të drejtën e ankimit kundër vendimit të rivendosjen në afat e vendosur nga gjykata e apelit, kjo nuk përbën një shkelje të së drejtës për një mjet efektiv ankimi, pasi ky vendim mund të shihet si vendim i ndërmjetëm, si një vendim që jepet gjatë gjykimit për të siguruar zhvillimin e gjykimit në mënyrë të rregullt në pajtim me kërkesat e dispozitave procedurale.
63. Gjithsesi Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se ky është një qëndrim i ligjvënësit dhe siç është shprehur qartë Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.31, datë 17.05.2012 “... *I takon ligjvënësit të parashikojë një mjet ankimi efektiv lidhur me këtë fazë për të garantuar të drejtën kushtetuese të ankimit të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ...*”.
64. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë më të thjeshtë në dukje situatën e dytë, pra kur kërkesa për rivendosje në afat është refuzuar nga gjykata, është parashikuar nga ligjvënësi në pikën 6 të nenit 147 të K.Pr.Penale e konkretisht: “...*kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit*”.
65. Në vështrim të këtij parashikimi të ligjvënësit, duke qenë se ai (ligjvënësi) kishte parashikuar mundësinë e ankimit në gjykatën e apelit, kuptohet qartë se gjykata kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat, në çdo rast, është gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e themelit të çështjes.
66. Në këtë këndvështrim, përfundimi i arritur nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin Unifikues nr.2 të vitit 2002 se: “...*në kuptim të nenit 147 të K.Pr.Penale, kërkesa për rivendosje në afat për të bërë ankim bëhet në gjykatën që ka dhënë vendimin dhe si e tillë*

duhet kuptuar përgjithësisht gjykata e shkallës së parë...”, ka qenë i drejtë në raport me interpretimin korrekt të dispozitës.

67. Në kushtet kur situata ligjore ka ndryshuar pas vendimit nr.31, datë 17.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese me riformulimin e pikës 6 të nenit 147 të K.Pr.Penale: “6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim”, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë edhe njëherë se nuk mund të jetë Gjukata e Lartë gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat për të drejtën e ankimit, pasi kundër vendimit të Gjykatës së Lartë nuk mund të bëhet ankim.
68. **Në vijim të sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në qëndrimin unifikues se: në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat është refuzuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, kundër këtij vendimi, pala kërkuese (prokurori, i pandehuri, palët private apo mbrojtësit) mund të bëjë ankim në gjykatën e apelit. Gjithashtu edhe në rastin kur kërkesa refuzohet nga gjykata e apelit, pala kërkuese mund të bëjë ankimin (rekursin) në Gjykatën e Lartë.**

IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

69. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit dhe jurisprudencën jo vetëm të Gjykatës së Lartë por edhe të Gjykatës Kushtetuese e GJEDNJ, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur nga i gjykuari Stilian Vathi gjenden të bazuara në ligj për sa i përket njoftimit të tij nga gjykata e apelit ushtarak, duke shkelur në këtë mënyre kriteret e vendosura nga nenet 132 - 141 dhe 351 të K.Pr.P.
70. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi nr.24, datë 13.09.2007 i Gjykatës e Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi vendimin nr.111, datë 13.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e të cilit i gjykuari Stilian Vathi është deklaruar fajtor për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar në nenin 33, paragrafi i parë i K.Penal Ushtarak, duke u dënuar me 6 muaj burgim, është i pambështetur në ligjin penal procedural dhe për rrjedhim duhet të priset dhe aktet duhet të kthehen për rishqyrtim në po atë gjykatë.
71. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se Gjukata e Apelit Tiranë ka zhvilluar gjykimin në mungesë të të gjykuarit duke mos e njoftuar atë, në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në nenet 132 - 141 të K.Pr.Penale.
72. Gjukata e apelit rezulton se për zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 05.07.2007 ka njoftuar të gjykuarin me anë të fletë-thirrjes që mban datën 11.06.2007, duke e dërguar në adresën: Rr.“Myslym Shyri“, pall.6, shk. I, Tiranë.
- 72.1 Kjo gjykatë në seancën gjyqësore të datës 05.07.2007, në bazë të nenit 140/4 të K.Pr.P., ka vendosur njoftimin e të gjykuarit me shpallje, pasi fletë-thirrja e lartpërmendur është kthyer nga Posta Shqiptare me shënimin se “nuk njihet në këtë adresë”. Këtë njoftim gjykata ka urdhëruar të vendoset përsëri në adresën e të gjykuarit: Rr.“Myslym Shyri”, Pall.6, shk.I, Tiranë dhe në Njësinë Bashkiake nr.7, Tiranë.
73. Rezulton gjithashtu se në seancën e datës 05.07.2007, në bazë të njoftimit me shpallje të lartpërmendur, gjykata e apelit ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë të të gjykuarit dhe ka caktuar kryesisht avokat Luan Muho.
74. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se gjykata e apelit ka zbatuar gabim ligjin procedural penal lidhur me njoftimin e të pandehurit dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij. Kolegjet konstatojnë se i gjykuari Stilian Vathi nuk është njoftuar për orën dhe datën e caktuar nga gjykata për zhvillimin e gjykimit sipas kërkesave procedurale penale; njoftimi i tij është bërë me shpallje në kundërshtim me ligjin, duke i mohuar atij të drejtën për të

- marrë pjesë në gjykim, të mbrohet vetë apo me anë të mbrojtësit, të realizojë të gjitha kërkesat kushtetuese e ligjore të një procesi të rregullt ligjor.
75. Kolegjet vlerësojnë se njoftimi me shpallje i datës 05.07.2007 nuk i plotëson kriteret e nenit 140 K.Pr.P. Ky njoftim nuk është vendosur në banesën e saktë ku banon i pandehuri. Rrjedhimisht edhe vendimi i gjykatës për zhvillimin e gjykimit në mungesë të të gjykuarit, caktimin e një avokati mbrojtës kryesisht dhe vazhdimi i gjykimit në praninë e tij (avokatit), nuk është i mbështetur në ligjin procedural penal. Rezulton se së bashku me ankimin e depozituar në gjykatë i pandehuri Stilian Vathi kishte depozituar Prokurën e Posaçme datë 18.05.2007, nr.403 rep., nr.108 Kol., me anë të së cilës kishte caktuar përfaqësuesin e tij Av. Ismail Qesja.
76. Kolegjet e Bashkuara, në referim të kriterëve që përcakton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, Kodi i Procedurës Penale, çmojnë se njoftimet e bëra nga gjykata për pjesëmarrjen e të gjykuarit në gjykim nuk mund të pranohen si realizim i së drejtës së mbrojtjes së ti, në procesin penal, pasi bien në kundërshtim me:
- 76.1 Neni 6 i Konventës Europiane të së Drejtave të Njeriut, në të cilin parashikohet se: *“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*
2. *Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*
- a) *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
 - b) *t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
 - c) *të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
 - d) *të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*
 - e) *të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq..”*
- 76.2 Neni 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; ...ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; ...”*
- 76.3 Neni 6 i Kodit të Procedurës Penale në të cilin parashikohet se: *“1. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat. 2. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t’i garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij ligjore”.*

77. Kolegjet theksojnë se akti gjyqësor i njoftimit të personit kundër të cilit është hapur një proces penal është i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të së drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar “*in absentia*”, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t’u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat. (Sejdovic kundër Italisë 2000).
78. Standardet lidhur me njoftimin dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të të gjykuarit janë vendosur nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, duke çmuar se heqja dorë nga ushtrimi i të drejtës së garantuar nga Konventa duhet të përcaktohet saktësisht. “*Kur ligjet kombëtare lejojnë realizimin e gjykimeve në mungesë për një person “të akuzuar penalisht”, menjëherë, sapo ai merr dijeni për këtë proces, duhet të ketë të drejtën për t’u dëgjuar nga gjykata mbi pretendimet e akuzës. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i Konventës*” (Colozza kundër Italisë, 1985).
79. Në zhvillim të jurisprudencës së saj lidhur me zhvillimin e procesin “*in absentia*” Gjykata Europiane ka theksuar se: “... e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë”. (Ektabani kundër Suedisë 1988 Vaundelle kundër Francës 2003); se: “Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte”. (T and V kundër Mbretërisë së Bashkuar); se: “Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t’i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij”. (Poitrimol kundër Francës 1993, Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë 2001); se: “Është e një rëndësie thelbësore që i akuzuari duhet të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t’i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t’i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustificueshme (Geyseghem kundër Belgjikës 1999); se: “Informimi i një personi mbi procedimin penal të filluar ndaj tij është një akt ligjor me një rëndësi të tillë që duhet të zbatohet në përputhje me kërkesat procedurale dhe të mirëfillta të afta për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të akuzuarit”. (Zyfli kundër Shqipërisë 2005); se: “Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t’u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq”. (Mariani kundër Francës, 2005).
80. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në garantimin e të drejtës themelore për një proces të rregull ligjor vlerësojnë të theksojnë dhe Rezolutën (75) 11 “Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit” të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, në të cilën rekomandohen standardet minimale për shtetet anëtarë mbi njoftimin e të gjykuarit dhe zhvillimin e procesin në mungesë të tij, të tilla si: (i) Askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për gjyq në kohë. (ii) Kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim. (iii) Kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të

vendosë shtyrjen e procesit... (vi) Një vendim gjykate i dhënë në mungesë duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë. (vii) Çdo personi të gjykuar në mungesë duhet t'i jepet e drejta për apelim me çdo lloj mjeti ligjor, që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm. (viii) Për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit. (ix) Një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij”.

81. Në mbështetje sa më sipër, Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar praktikën lidhur me interpretimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale mbi njoftimin e të pandehurit dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij.
82. Kjo gjykatë ka theksuar se: “... Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigorozë të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat për njoftimin.....Në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata arrin në këtë përfundim për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimarrjeje prej tij..... Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i mësipërm është i një rëndësie të veçantë, pasi parashikon se janë organet shtetërore ato që duhet të marrin të gjitha masat, nëpërmjet veprimeve aktive, për të siguruar gjykatën se i pandehuri është njoftuar në mënyrë të rregullt, se në ngarkim të tij ka një procedim penal dhe se i pandehuri, pas këtij njoftimi të rregullt, me vullnetin e tij të lirë vendos t'i fshihet drejtësisë. Pra, ky interpretim i nenit 6 të të KEDNJ-së nga ana GJEDNJ-së përbën një garanci procedurale më shumë për shtetasit e vendeve që kanë nënshkruar Konventën...” (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë vendimi nr.30, datë 17.06.2010).
83. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se zhvillimi i një procesi në mungesë të të pandehurit kërkon domosdoshmërisht garantimin nga gjykatat të marrjes dijeni efektivisht nga i pandehurit mbi zhvillimin e procedimit kundër tij, si dhe heqjen dorë vullnetarisht dhe në mënyrë të qartë për të marrë pjesë në proces.
84. Kolegjet çmojnë se në të tilla rrethana, në kuptim të nenit 432, shkronja “b” të K.Pr.Penale, rekursi i paraqitur nga i gjykuari Stilian Vathi gjendet i bazuar në ligj e si i tillë do të pranohet, rrjedhimisht, në bazë të nenit 441, pika 1, shkronja “ç” të këtij Kodi, vendimi nr.24, datë 13.09.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë do të priset dhe aktet do të kthehen për rishqyrtim në po atë gjykatë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 438, 441 pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.24, datë 13.09.2007 të Gjykatës së Apelit Ushtarak Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 19.06.2013

MENDIM PARALEL

Ne gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Shkëlzen Selimi nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën përsa i përket mënyrës së unifikimit të çështjeve nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr.1, datë 19.06.2013 për arsyet që do t'i parashtrojmë më poshtë:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me të drejtë morën në shqyrtim me qëllim unifikimin e praktikës në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të nenit 147 të K.Pr.Penale i cili rregullon institutin e rivendosjes në afat të ankimit. Kjo nevojë lindi si rezultat i shfuqizimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese me vendimin nr.31, datë 17.05.2012 të togfjalëshit “*në gjykatën e apelit*” në pikën 6 të nenit 147 të K.Pr.Penale¹⁰⁴ dhe që kishte të bënte me ushtrimin e të drejtës së ankimit në rast të refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat.

Ky ndryshim ligjor la pa efekt detyrues vendimin nr.2, datë 14.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara i cili kishte përcaktuar në qëndrimin unifikues se gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat në çdo rast është gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në atë rast në interpretimin e dispozitës ligjore tashmë pjesërisht të shfuqizuar.

Gjykata Kushtetuese, në pjesën arsyetuese, ka konstatuar se togfjalëshi “*në gjykatën e apelit*” bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe për pasojë është antikushtetues, pasi bie ndesh me nenin 42/2 dhe 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën në përcaktimin e gjykatës kompetente në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së rivendosjes në afat, e cila ka arritur në konkluzionin se: “*gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit ushtrohet ankim. E thënë ndryshe, nëse kërkohet rivendosje në afat për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat do të jetë gjykata e shkallës së parë. Respektivisht, nëse kërkohet rivendosja në afat për të bërë ankim (rekurs) kundër vendimit të gjykatës së apelit, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata e apelit*”.

Në kundërshtim me atë që pretendohet nga shumica se ky qëndrim është në koherencë me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, kemi mendimin se duke e unifikuar çështjen e gjykatës kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në mënyrën e lartpërmendur jo vetëm që janë deformuar argumentet ligjore të dhënë nga Gjykata Kushtetuese në favor të përcaktimit të gjykatës së caktuar me ligj, por nuk ka gjetur zgjidhje të drejtë përcaktimi i gjykatës kompetente.

¹⁰⁴ Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.31, datë 17.05.2012 në pjesën arsyetuese është shprehur se:

Gjykata vëren se në lexim të parë të dispozitës duket sikur ligjvënësi nuk e ka përcaktuar gjykatën kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit. Por duke iu referuar interpretimit gjuhësor në zbërthimin e togfjalëshit “gjykata që procedon në kohën e paraqitjes së saj (kupto: kërkesën)”, atëherë kuptohet se ligjvënësi e ka lidhur gjykatën kompetente me llojin e ankimit që bën i gjykuari. Pra, nëse i gjykuari do të ankimojë vendimin e shkallës së parë, atëherë logjikisht dhe duke iu referuar dispozitave procedurale, kompetente për shqyrtimin e ankimit do të jetë gjykata e apelit. Nëse i gjykuari do të ankimojë vendimin e gjykatës së apelit, kompetente do të jetë Gjykata e Lartë. (f.9)

Shihet qartë se përcaktimi i gjykatës kompetente do të bëhet në bazë të llojit të ankimit, duke përcaktuar se kompetente në rastin e shqyrtimit të kërkesës për rivendosje në afat do të jetë ajo gjykatë e cila është edhe kompetente për shqyrtimin e ankimit.

Shumica, edhe pse e citon vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në pikën 43 të vendimit nuk e ka reflektuar këtë në qëndrimin unifikues duke mos e lidhur me kompetencën e gjykatës që do të shqyrtojë ankimin në rast të rivendosjes në afat, por me gjykatën e cila ka dhënë vendimin. Duke vepruar në këtë mënyrë jo vetëm që është vepruar në kundërshtim me parimin që një gjykatë nuk mund të marrë kompetencat e një gjykate tjetër të caktuara me ligj, por dhe me qëllimin e shfuqizimit të pjesshëm të dispozitës nga Gjykata Kushtetuese pikërisht të deformimit të ligjit në lidhje me kuptimin e gjykatës kompetente dhe interpretimit të gabuar të mëparshëm të Kolegjeve të Bashkuara nga një formulim i gabuar i dispozitës procedurale penale. Jemi të mendimit se shumica përsëri ka vendosur në kundërshtim me parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

Kolegjet e Bashkuara, duke definuar kompetencën në rastin e kërkesës për t’u rivendosur në afat, nuk kanë përcaktuar se cila do të ishte gjykata kompetente në rastin kur kjo kërkesë ka të bëjë me vendime apo të drejta gjatë fazës së hetimit paraprak.

Mendojmë se qëndrimi më i drejtë ligjor në lidhje me caktimin e kompetencës për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat do të ishte që: Kompetenca për shqyrtimin e kërkesës për t’u rivendosur në afat i takon asaj gjykate e cila është kompetente edhe për shqyrtimin e vetë ankimit për të cilin kërkohet rivendosja që sipas rastit do të ishte: për kërkesat gjatë fazës së hetimit paraprak gjykata e shkallës së parë (gjyqtari i hetimeve paraprake), për të rivendosur në afat të drejtën e ankimit është gjykata e apelit, ndërsa për rivendosjen në afat të rekursit është Gjykata e Lartë.

Në mbështetje të qëndrimit tonë vjen edhe rregullimi i pasojave që parashikohet në rastin kur kërkesa pranohet. Në nenin 148 të K.Pr.Penale¹⁰⁵, i cili parashikon pasojat që vijnë nga rivendosja në afat e ankimit, parashikohet edhe përsëritja e veprimeve procedurale ku pala duhet të merrte pjesë. Ndërkohë që në paragrafin e dytë parashikohet se: *kur rivendosja në afat bëhet nga Gjykata e Lartë, ç’ka bën të qartë që rivendosja për rekursin është në kompetencën e kësaj gjykate.* Por, për shkak të natyrës që ka shqyrtimi i çështjes në këtë shkallë gjykimi, si gjykim i kufizuar vetëm në shkaqe ligji dhe jo fakti, delegimi i veprimeve procedurale që do të përsëriten i bëhet gjykatës që e ka zgjidhur çështjen në themel.

Kolegjet e Bashkuara në qëndrimin unifikues kanë lënë pa zgjidhur çështjen nëse prokurori ose ndonjë prej palëve të pranishëm në proces ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës e

¹⁰⁵ N.148 i K.Pr.Penale “Efektet e rivendosjes në afat”

1. Gjykata që ka vendosur rivendosjen në afat, me kërkesën e palës dhe për aq sa është e mundur, urdhëron përsëritjen e veprimeve në të cilat pala kishte të drejtë të merrte pjesë. Kur rivendosja në afat bëhet nga Gjykata e Lartë, përsëritja e veprimeve vendoset nga gjykata që është kompetente për shqyrtimin në themel.

cila ka pranuar kërkesën për t'u rivendosur në afat të ankimit dhe nëse po, ku do të paraqitet dhe si do të shqyrtohet.

Në parim, neni 147/1 i K.Pr.Penale i jep të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afat prokurorit, të pandehurit, palëve private si dhe mbrojtësve të tyre.

Sipas nenit 407/4 të K.Pr.Penale, “E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. **Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre**”.

Ankimet për kërkesat për rivendosjen në afat trajtohen përkatësisht në pikat 5¹⁰⁶ dhe 6¹⁰⁷ të nenit 147 të K.Pr.Penale. Në rast refuzimi të kërkesës, pika 6 e nenit të sipërcituar parashikon se kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim. Ndërkohë, në rast pranimit të kërkesës, pika 5 shprehet se “Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar”.

Neni 147 i K.Pr.Penale as në pikën 5, dhe as në pikën 6, nuk përcakton dhe as bën dallim ndërmjet palëve që legjitimohen për të bërë ankim. Kjo pasi instituti i rivendosjes në afat është një institut me karakter të përgjithshëm, i përdorshëm në të gjitha fazat e procesit penal dhe që mund të përdoret teorikisht nga të gjitha palët, si nga i pandehuri ashtu edhe nga prokurori apo palët e tjera të thirrura në proces.

Nisur nga natyra e procesit penal dhe palëve pjesëmarrëse në të, ku prania e prokurorit është e detyrueshme në procesin penal si dhe në varësi të rastit edhe palët private, rastet e kërkesës për t'u rivendosur në afat të këtyre subjekteve janë kufizuar në *i)* rastin faktor dhe *ii)* forcën madhore.

Ndërkohë që ka një situatë specifike që i referohet pikërisht njohjes dhe pranimit nga ligji procedural penal i institutit të gjykimit në mungesë që ka për qëllim njohjen dhe garantimin e të drejtës së ankimit për të gjykuarin në mungesë. Duke pasur parasysh se rivendosja në afat synon të rivendosë një të drejtë të humbur për palët në përgjithësi dhe veçanërisht për të gjykuarin në mungesë, ai në varësi të pranimit ose jo do t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor duke garantuar të drejtat e gjithë subjekteve pjesëmarrëse dhe që legjitimohen të bëjnë ankim. Në interpretim të qëllimit të institutit të rivendosjes në afat dhe të pasojave që krijon për palët duhet të kuptohet dhe të zëbërthet e drejta e ankimit sipas pikës 5 dhe 6 të nenit 147 të K.Pr.Penale. Për më tepër dhe të pasojave që krijon pas rivendosjes së të drejtës dhe të detyrimit që krijon për gjykatën shqyrtimi i çështjes dhe të rënies në dekadencë të pretendimeve që mund të ketë pala tjetër në lidhje me ligjshmërinë e vendimmarrjes.

Mendojmë se shumica në vendimmarrjen e saj nuk ka arritur dot të bëjë dallimin dhe të interpretojë saktë se në rastin kur flitet për të drejtë ankimi sipas pikës 6 të nenit 147 të K.Pr.Penale, ajo i njihet si e drejtë të gjykuarit në mungesë e lidhur kjo ekskluzivisht me rastin e parashikuar në nenin 147/2 të K.Pr.Penale, ndërsa e drejta e ankimit sipas pikës 5 të këtij neni i drejtohet prokurorit ose palëve private.

Parashikimi nga neni 147/6 i shtyrjes së ankimit bashkë me vendimin përfundimtar, është natyrisht një zgjidhje *pro reo*, që i zgjeron të drejtat e këtij të fundit duke i dhënë mundësinë që të përfitojë nga efektet e rivendosjes në afat, deri në momentin e vendimit përfundimtar. Ndryshe nga shumica që ka përcaktuar si vendim përfundimtar vendimin e gjykatës së apelit kemi mendimin se vendimi përfundimtar është vendimi gjyqësor i cili e ka zgjidhur çështjen në themel, pavarësisht i kujt shkalle gjykimi është ai dhe për të cilin kërkohet të ushtrohet e drejta e ankimit (rekursit).

Jemi të mendimit se me këtë vendimmarrje unifikuuese padrejtësisht i është mohuar e drejta e ankimit prokurorit në rastin kur ai nuk është dakord me vendimin i cili rivendos në afat ankimin për të pandehurin, e cila sipas interpretimit tonë i njihet në bazë të nenit 147/5

¹⁰⁶ Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.

¹⁰⁷ Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim.

të K.Pr.Penale. Në çdo rast, kur gjykata pranon kërkesën për rivendosje në afat të ankimit prokurori ka të drejtë ta kundërshtojë në gjykimin e vazhduar në bazë të ankimit të rivendosur në afat nga i gjykuari dhe gjykata, përpara se të shqyrtojë themelin e ankimit në lidhje me vendimin përfundimtar duhet të marrë në vlerësim shkaqet e ankimit kundër vendimit të rivendosjes në afat dhe nëse konstaton se ato janë të pabazuara mandej mund të vazhdojë shqyrtimin e çështjes. Në rast se pretendimet e prokurorit qëndrojnë atëherë gjykata duhet të prishë vendimin e rivendosjes në afat të ankimit dhe të deklarojë të papranueshëm ankimin.

Shumica, duke unifikuar në mënyrë të gabuar se cila është gjykata kompetente në shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat, ka gabuar më pas edhe në të drejtën e ankimit sepse nëqoftëse do të njihej kjo e drejtë, ajo në vetvete do t'i nënshtrohej kontrollit gjyqësor tashmë jo nga gjykata kompetente, por nga një gjykatë më e lartë, ndërkohë që është vetë gjykata kompetente për shqyrtimin e vendimit përfundimtar e cila do të shqyrtojë edhe ligjshmërinë e vendimit të rivendosjes në afat.

Duke e interpretuar në këtë mënyrë, pra të kontrollit paraprak të vendimit të rivendosjes në afat, do të shmangej ajo situatë e cila mund të ndodhë ashtu siç me të drejtë Gjykata Kushtetuese në lidhje me padobishmërinë e ankimit në rast se një gjykatë më e lartë do të konstatonte zbatimin e gabuar të ligjit në vendimin e rivendosjes në afat të ankimit dhe do të prishte një vendim përfundimtar të dhënë në favor të tij. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

Gjykata çmon se në këtë rast kemi të bëjmë me një të drejtë ankimi jo efektive në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ, sepse palët, pas rigjyimit në themel, mund të përballen me një rezultat të ndryshëm pa pasur mundësi të ankohen paraprakisht lidhur me bazueshmërinë në ligj dhe prova të kërkesës për rivendosjen ose jo në afat të së drejtës së ankimit.

Ne, gjyqtarët e mendimit paralel, mendojmë se nëse do të përcaktohej drejt gjykata kompetente, e cila shqyrton kërkesën për rivendosje në afat si dhe të së drejtës së ankimit, do të kishim një proces të rregullt ligjor duke respektuar të drejtat e palëve dhe një zbatim të drejtë të ligjit procedural penal nëpërmjet praktikës unifikuese.

Ardian Dvorani

Shkëlzen Selimi

Nr.6/5 i Regj. Themeltar
Nr.7 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Besnik Imeraj	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Edmond Islamaj	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 14.10.2011 morën në shqyrtim çështjen penale nr.6/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: PROKURORIA PRANË GJYKATËS PËR KRIME TË RËNDA TIRANË.

I PANDEHUR: ILIR KUMBARO, aktualisht me qëndrim në Mbretërinë e Bashkuar, me kombësi e shtetësi shqiptare me gjendje gjyqësore “i padënuar”, i mbrojtur nga avokatët Vojo Bregu dhe Bledar Fejzo, sipas prokurës së posaçme nr.1100 rep. dhe nr.213 kol., datë 08.04.2009 të përpiluar nga noterja Vojsava Karapici, me porositës shtetasin Ervin Kumbaro, i biri i të pandehurit Ilir Nazmi Kumbaro.

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprës penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, kryer në bashkëpunim në tre raste,
“Tortura me pasoja të rënda”, kryer në bashkëpunim,
parashikuar nga neni 109/1 në lidhje me nenin 25 (tre herë)
dhe neni 87 në lidhje me nenin 25 (tre herë) të Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimi i masës së sigurimit personal “arrest në burg”.
Baza Ligjore: Neni 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.154, datë 15.12.2009, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me objekt: caktim mase sigurimi për të pandehurin Ilir Kumbaro.

Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale për të pandehurin Ilir Kumbaro.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.5, datë 05.01.2010, ka vendosur:

Miratimin e vendimit nr.154, datë 15.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë me nr.5, datë 05.01.2010, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, ka paraqitur rekurs i pandehuri Ilir Kumbaro, nëpërmjet mbrojtësit të tij, duke kërkuar në mënyrë alternative prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ose ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit ndaj tij, për këto shkaqe:

- Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë i ka mohuar të drejtën të pandehurit për t’u mbrojtur nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij, pasi zhvilloi seancën për caktimin e masës me një mbrojtës të caktuar kryesisht. Kishim njoftuar gjykatën për pamundësinë e paraqitjes për shkak të nevojës së pjesëmarrjes në një gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Apelit Vlorë.

- Vendimi për caktimin e masës së sigurimit është marrë nga një gjykatë jo kompetente. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar në asnjë rast që gjykata që gjykon themelin e çështjes të mund të caktojë në mënyrë fillestare një masë sigurimi.

- Moskompetenca e gjykatës që gjykon themelin e çështjes për të caktuar në mënyrë fillestare një masë sigurimi nuk përcaktohet në mënyrë të shprehur në ligjin procedural, por rezulton nga interpretimi *a contrario* i dispozitave në lidhje me papajtueshmërinë e gjyqtarit gjatë procedimit.

- Gjykata duhet të arsyetonte në vendim se cilat ishin ato rrethana të reja të krijuara, që tre vjet pasi ka filluar ky procedim u shfaqën dhe shtruan nevojën e caktimit të masës së sigurimit.

- Organi i akuzës përdor dy standarte kur për dy të pandehur procedon pa asnjë masë sigurimi, ndërsa vetëm për njërin kërkon marrjen e masës ekstreme të sigurimit.

- Argumenti se ky i pandehur i fshihet hetimit nuk është i provuar. Nuk ka asnjë akt në fashikull që të provojë se ky i pandehur ka dijeni për ekzistencën e këtij procedimi në ngarkim të tij.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.s’ka, datë 03.03.2010, ka vendosur:

Kalimin e çështjes penale në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Me këtë vendim Kolegji Penal shtron për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara çështjet si më poshtë:

1. *A ka të drejtë organi i prokurorisë të kërkojë caktimin e një mase të sigurimit personal në fazën e gjykimit të çështjes në themel ndaj të pandehurit, për të cilin nuk është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal gjatë hetimit paraprak?*

2. *Nëse po, a është kompetente për të shqyrtuar këtë kërkesë gjykata e cila është duke gjykuar themelin e çështjes, parë kjo në referencë të përmbajtjes së dispozitës së nenit 15/2 të Kodit të Procedurës Penale?*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Majlinda Andrea dhe Ardian Dvorani; prokurorin Artur Selmani, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; mbrojtësin e të gjykuarit Ilir Kumbaro, avokatin Vojo Bregu, i cili përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe atij të Gjykatës për Krimet e Rënda dhe mosmiratimin e vendimit nr.154, datë 15.12.2009 të Gjykatës për Krime të Rënda, me të cilin është caktuar ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro masa e sigurimit “arrest në burg”; dhe pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

V Ë R E J N Ë

II. Rrethanat e faktit

1. Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore dhe vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, u rezultojnë të pranuarat prej këtyre gjykatave rrethanat si vijon:

Në fazën e hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 25.10.1995, ka regjistruar procedimin penal me nr.449, për veprën penale “*Rrëmbim personi*” e kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit maqedonas me kombësi shqiptare Remzi Hoxha, parashikuar nga neni 109/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

E njëjta prokurori, në datën 17.01.2003, ka regjistruar edhe procedimin penal nr.131 për veprën penale “*Rrëmbim personi*” në dëm të shtetasit Ziso Kristopulli. Duke qenë procedime të lidhura është vendosur bashkimi i tyre në një procedim të vetëm, në atë me nr.449 të vitit 1995.

Hetimet paraprake në këtë procedim janë kryer në ngarkim të të pandehurve Ilir Kumbaro, Arben Sefgjini, Avni Koldashi dhe Budjon Meçe.

Ndër të tjera, me kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1229 akti, datë 18.12.2003 ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Mbi bazën e kësaj mase sigurimi, pas kërkimeve pa sukses për gjetjen e të pandehurit Ilir Kumbaro dhe ekzekutimin e saj është proceduar me shpalljen në kërkim ndërkombëtar të këtij të pandehuri.

Hetimet kanë vijuar në mungesë së të pandehurit Ilir Kumbaro deri kur Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të bëjë një cilësim të ri juridik të veprës, duke ndryshuar akuzën nga “*Rrëmbim personi*” kryer në bashkëpunim, sipas nenit 109/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në “*Shpërdorim detyrë*” të kryer në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 248 në lidhje me nenin 25 të këtij Kodi. Për shkak të cilësimit të ri juridik që iu bë veprës penale, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8202, datë 27.03.1997 “*Për amnistinë*”, organi i prokurorisë ka ardhur në përfundimin se ishte vendi për të pushuar akuzat e ngritura në ngarkim të të pandehurve. Prandaj, me vendimin e saj të datës 01.07.2004, prokurori ka vendosur pushimin e akuzave në ngarkim të të pandehurit Ilir Kumbaro e të pandehurve të tjerë dhe pezullimin e hetimeve të këtij procedimi.

Prokurori i Përgjithshëm, me vendimin nr.146, datë 08.09.2006, ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të datës 01.07.2004 për pushimin e akuzave dhe pezullimin e hetimeve, si dhe vazhdimin e hetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda, për shkak se vepra penale për të cilën duhet të hetoheshin të pandehurit u përcaktua ajo e parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal.

Në vijim dhe në zbatim të këtij vendimi të Prokurorit të Përgjithshëm, në datën 13.10.2006, Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda ka regjistruar edhe procedimin penal

nr.94 për veprën penale “*Rrëmbim personi*” sipas nenit 109/1 të Kodit Penal, në dëm të shtetasve Remzi Hoxha, Ziso Kristopulli dhe më pas edhe ndaj shtetasit Avdyl Loshaj.

Pas disponimeve të tjera mbi ndryshimin e akuzës gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, në datën 18.04.2008, ka paraqitur në Gjykatën për Krime të Rënda kërkesën për gjykim duke akuzuar të pandehurit Ilir Kumbaro, Arben Sefgjini, Avni Koldashi dhe Budjon Meçe për veprat penale “*Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit*” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal (tre herë) dhe “*Tortura me pasoja të rënda*” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 87 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal (tre herë), në dëm të tre shtetasve: Remzi Hoxha, Ziso Kristopulli dhe Avdyl Loshaj.

2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, i pandehuri Ilir Kumbaro nuk rezultoi që të jetë paraqitur në seancë gjyqësore. Gjykata për Krime të Rënda pas kryerjes së veprimeve për njoftimin dhe më pas kërkimin e tij ka konkluduar se ai i fshihet drejtësisë, duke deklaruar edhe mungesën e tij në gjykim dhe caktimin e avokatit kryesisht për mbrojtjen e interesave të tij.

Në vijim të gjykimit, pas zhvillimit të një numri seancash gjyqësore, ndërkohë që nga autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar kishte filluar procedura e ekstradimit së të pandehurit Ilir Kumbaro, janë paraqitur avokatët Vojo Bregu dhe Bledar Fejzo, të caktuar për mbrojtjen e këtij të pandehuri me prokurë të posaçme të lëshuar nga i biri i tij, Ervin Kumbaro. Avokatët i paraqitën gjykatës një kërkesë me objekt shuarjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro me vendimin nr.1229 akti, datë 18.12.2003 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në thelb, me anë të kësaj kërkesë, mbrojtja e të pandehurit Ilir Kumbaro parashtronte se, në kushtet kur ishte pushuar procedimi penal në ngarkim të tij, gjatë të cilit ishte caktuar nga gjykata edhe masa e sigurimit “*arrest në burg*” ndaj tij, atëherë ky vendim për caktimin e masës së sigurimit ka humbur çdo fuqi juridike, është shuar.

Gjykata për Krime të Rënda, me vendimin nr.26/79 akti të datës 16.06.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së lartpërmendur të mbrojtësve të të pandehurit Ilir Kumbaro.

E investuar mbi ankimin e avokatëve të të pandehurit Ilir Kumbaro, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.17, datë 16.07.2009, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga ana e mbrojtjes, për shkak se nuk legjitimoheshin të paraqisnin një kërkesë të tillë, pasi i pandehuri Ilir Kumbaro nuk i kishte autorizuar për këtë lloj kërkimi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.202, datë 30.09.2009, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, duke caktuar si detyrë që ajo të merrte në shqyrtim dhe të dispononte lidhur me shkaqet e paraqitura në ankimin e bërë nga mbrojtja e të pandehurit Ilir Kumbaro.

Në rigjykim, pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankimin e të pandehurit Ilir Kumbaro, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda arriti në përfundimin se vendimi nr.26/79 akti, datë 16.06.2009 i Gjykatës për Krime të Rënda, që rrëzoi kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e të pandehurit Ilir Kumbaro, duhej të mbetej në fuqi.

E vënë në lëvizje mbi rekursin e mbrojtësve së të pandehurit Ilir Kumbaro, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.274, datë 02.12.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr.27, datë 26.10.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr.26/79 akti, datë 16.06.2009 të Gjykatës për Krime të Rënda, duke pranuar kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro, të caktuar me vendimin nr.1229, datë 18.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këtë vendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, arsyeton se: “*Me pushimin e akuzave në ngarkim të tyre automatikisht dhe masa e sigurimit personal vendosur ndaj tyre ka humbur fuqinë e saj. Kjo masë është shuar në momentin që është vendosur pushimi i çështjes. Në*

këtë moment ipso lege kjo masë sigurimi shuhet, kjo parashikuar në nenin 261 të Kodit të Procedurës Penale”.

3. Pas dhënies së vendimit të lartpërmendur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për shuarjen e masës së sigurimit në ngarkim të së pandehurit Ilir Kumbaro, në vijim, në datën 09.12.2009, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda ka depozituar në sekretarinë gjyqësore të kësaj gjykate kërkesën drejtuar trupit gjykues që po shqyrtonte në themel këtë çështje penale me objekt: caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për të pandehurin Ilir Nazmi Kumbaro. Kjo kërkesë e organit të akuzës, në thelb motivohej nga fakti që tashmë i pandehuri Ilir Kumbaro nuk ka ndonjë masë sigurimi dhe se në rastin e tij ekzistonin kushtet dhe kriteret për t’i caktuar masën e sigurimit personale “arrest në burg”.

Gjykata për Krimet e Rënda, ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit në seancën e datës 15.12.2009. Kjo gjykatë pasi dëgjoji palët, bazuar në aktet e provat e fashikullit të gjykimit dhe atyre të marra deri në atë moment të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, *me vendimin nr.154, datë 15.12.2009* ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro të caktojë masën e sigurimit personal “arrest në burg”.

Nëpërmjet ankimit, mbrojtësit e të pandehurit Ilir Kumbaro kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, e cila, me vendimin e saj nr.5, datë 05.01.2010 ka vendosur: *“Miratimin e vendimit nr.154, datë 15.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”.*

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë me nr.5, datë 05.01.2010, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i pandehuri Ilir Kumbaro, nëpërmjet mbrojtësit të tij, duke kërkuar në mënyrë alternative prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ose ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit ndaj tij.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 03.03.2010, bazuar mbi shkaqet e pretenduara në rekurs, rrethanat ligjore të çështjes dhe nevojën e unifikimit të praktikës gjyqësore për raste të ngjashme, ka vendosur të kalojë çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njehsimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

III. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara

4. Në seancë gjyqësore, përfaqësuesi i prokurorisë, parashtroi përpara Kolegjeve të Bashkuara se nuk gjen mbështetje në ligjin procedural penal pretendimi i mbrojtjes së të gjykuarit se masa e sigurimit nuk mund të kërkohej dhe gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi personal ndaj tij gjatë fazës së gjykimit të çështjes penale. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, që ka miratuar vendimin e Gjykatës për Krime të Rënda për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për të pandehurin Ilir Kumbaro, është dhënë në zbatim të drejtë të ligjit dhe duhet të mbetet në fuqi.

Sipas parashtrimit të prokurorit, në kuptim e zbatim të drejtë të ligjit, nuk rezulton që Kodi i Procedurës Penale të përcaktojë se kërkesa e prokurorit dhe caktimi i masës së sigurimit nga gjykata mund të bëhet vetëm në fazën e hetimit paraprak. Prokurori mund të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së sigurimit në çdo fazë e shkallë të procedimit penal deri sa gjykata nuk ka dhënë vendim përfundimtar. Kur kërkesa për masë sigurimi paraqitet gjatë fazës së gjykimit, kompetenca për shqyrtimin e saj i përket vetëm trupit gjykues që shqyrton themelin e akuzës.

Ligji procedural penal përcakton rregulla të tilla që bëjnë dallim thelbësor mes fazës së hetimit paraprak dhe fazës së gjykimit. Në fazën e gjykimit, gjykata duhet të marrë vendime pa qenë e ndikuar nga vendimmarrja e mëparshme, qoftë edhe kur ato bazohen në dyshimet e

arsyeshme. Për këtë qëllim parashikohet ndalimi i nenit 15, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilit gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit nuk merr pjesë në gjykimin e themelit të akuzës.

Po kështu ka dallim mes gjykimit lidhur me caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimit lidhur me themelin e akuzës. Për caktimin e masës së sigurimit gjykata disponon bazuar në dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në prova. Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Edhe vetë Kodi i Procedurës Penale i ka njohur palëve mundësinë që, gjatë fazës së gjykimit, t'i kërkojnë vetë gjykatës së themelit të revokojë apo zëvendësojë masën e sigurimit (neni 260).

Masa e sigurimit e caktuar nga gjykata ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro është e mbështetur në prova dhe në ligj. Gjkata, bazuar në provat dhe aktet e procedimit, ka vlerësuar se ekzistojnë rreziqet e parashikuara në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale. Veprat penale të akuzës janë të rënda dhe me sanksione të rënda, ndërkohë që i pandehuri i fshihet drejtësisë duke jetuar në një shtet tjetër e duke u paraqitur me identitet të rremë për këtë qëllim. Masat e sigurimit kanë karakter personal dhe vlerësohen sipas rrethanat konkrete për secilin të pandehur.

5. Nga ana tjetër, krahas pretendimeve lidhur me mënyrën e vlerësimit të provave dhe rrethanave nga gjykatat më të ulëta, në parashtrimin e qëndrimit të tij përpara Kolegjeve të Bashkuara, mbrojtësi i të gjykuarit Ilir Kumbaro, në thelb, parashtrori se vendimi i dhënë nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda janë dhënë në zbatim të gabuar të ligjit procedural.

Mbrojtja parashtrori se, në fazën e gjykimit, ligji procedural penal e ndalon gjykatën që shqyrton themelin e akuzës që të caktojë edhe masa të sigurimit personal të kërkuara nga prokurori. Kjo vjen në kundërshtim me nenin 15, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale.

Prokurori nuk ka të drejtë dhe gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi, nëse një gjë e tillë nuk është kërkuar prej tij dhe nuk është gjykuar nga gjykata në fazën e hetimit paraprak. Kjo rezulton nga përmbajtja e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin, për fazën e gjykimit, i parashikon gjykatës kompetencë për të vendosur revokim a zëvendësim, vetëm në lidhje me masa sigurimi të caktuara më parë në fazën e hetimit paraprak.

Edhe nëse do të lejohej kërkesa dhe caktimi i masës së sigurimit në fazën e gjykimit, lidhur me këtë kërkesë nuk mund të shprehej gjykata që shqyrton themelin e akuzës, por një gjykatë tjetër. Një përfundim i tillë mund të nxirret nga përmbajtja e neneve 17, shkronjat “b” dhe “c”, si dhe 18 të Kodit të Procedurës Penale. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.

Gjkata për Krime të Rënda Tiranë i ka mohuar të drejtën të pandehurit për t'u mbrojtur nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij pasi zhvilloi seancën për caktimin e masës me një mbrojtës të caktuar kryesisht. Kishim njoftuar gjykatën për pamundësinë e paraqitjes për shkak të nevojës së pjesëmarrjes në një gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Organi i akuzës përdor dy standarte kur për dy të pandehur procedon pa asnjë masë sigurimi, ndërsa vetëm për njërin kërkon marrjen e masës ekstreme të sigurimit. Argumenti se ky i pandehur i fshihet hetimit nuk është i provuar. Nuk ka asnjë akt në fashikull që të provojë se ky i pandehur ka dijeni për ekzistencën e këtij procedimi në ngarkim të tij.

6. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë që gjykatat më të ulëta kanë interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin procedural penal. Masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, meqënëse, në rrethanat e çështjes objekt i këtij gjykimi, rezulton se janë përmbushur kushtet dhe kriteret për caktimin e tyre të parashikuara nga ligji procedural penal.

Prandaj, nuk ka mbështetje në ligj pretendimi i ngritur në rekursin e mbrojtësit të të pandehurit Ilir Kumbaro se, në fazën e gjykimit, gjykata nuk mund të caktojë më masë sigurimi. Ajo vetëm mund të revokojë apo zëvendësojë një masë sigurimi që është caktuar njëherë në fazën e hetimit paraprak. Gjykata në fazën e gjykimit nuk mund të caktojë masa sigurimi dhe më pas të zgjidhë në themel çështjen.

Kështu, në thelb, sikurse rezultoi nga rrethanat e çështjes si më sipër të pranuar nga gjykatat, në përfundim të fazës së hetimit paraprak, nga ana e prokurorit është paraqitur në Gjykatën për Krime të Rënda kërkesa për gjykim. Sipas prokurorit, hetimet ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro janë zhvilluar në kushtet e kufizimit të lirisë së tij, përmes masës së sigurimit “arrest në burg”. Kjo masë sigurimi, gjithnjë sipas qëndrimit që ka pasur organi i prokurorisë në këtë procedim ka ekzistuar por nuk është ekzekutuar, pasi i pandehuri nuk ishte e mundur të gjendej, prandaj gjykata kishte deklaruar edhe ikjen e tij (neni 247). Pra, për organin e prokurorisë, i pandehuri Ilir Kumbaro ka qenë në gjendje arresti në burg gjatë fazës së hetimit paraprak.

Në këtë gjendje procedurale të së pandehurit është paraqitur kërkesa për gjykim dhe Gjykata për Krime të Rënda ka filluar shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Gjatë gjykimit, kjo gjykatë nuk pranoi kërkesën e mbrojtjes së të pandehurit për shuarjen e masës së sigurimit, sipas nenit 261 të Kodit të Procedurës Penale, sepse sipas mbrojtjes ajo ishte shuar qysh në fazën e hetimit paraprak, kur i njëjti procedim objekt gjykimi ishte pushuar njëherë nga prokurori. Mbi ankimin e mbrojtësve të së pandehurit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë përfundimisht vendosi që masa e sigurimit ishte shuar qysh në çastin kur procedimi ishte pushuar nga prokurori, pavarësisht se ai vendim pushimi ishte revokuar më pas nga prokurori më i lartë.

Në të tilla rrethana, në seancë gjyqësore, prokurori i paraqiti kërkesë gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro për shkak se ekzistonin rreziqet që parashikonte neni 228 e 238 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata për Krimet e Rënda e pranoi kërkesën e prokurorit dhe ky vendim u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

7. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, vendimet e të dy gjykatave më të ulëta janë dhënë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal. Masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, nëse verifikohen kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit.

Por, në përgjigje të çështjeve të parashtruara për njehsimin e praktikës gjyqësore dhe të pretendimeve të parashtruara në rekursin e të gjykuarit për shkelje të rënda procedurale në gjykim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se nevojitet të interpretohet kuptimi dhe përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale mbi kushtet paraprake për caktimin e masës së sigurimit, kushtet e kriteret e lidhura me “rrezikun” që justifikon këto masa, atyre lidhur me “përshtatshmërinë” e masave të sigurimit, rrethanave se kur vendimi gjyqësor mbi këto masa ka forcën e gjësë së gjykuar, si dhe për kompetencën, natyrën e dallimin e objektit të gjykimit kur gjykata, në çdo fazë të procedimit, investohet, arsyeton e disponon mbi masën e sigurimit nga rasti i vendimit të pushimit, pafajësisë apo dënimit të së pandehurit.

8. Në pikën 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

“1. Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”.

Nëpërmjet analizës dhe interpretimit të drejtë të kësaj dispozite, posaçërisht të shprehjes “*dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova*” në harmoni me institutet e tjera procedurale, mund të bëhet dallimi dhe të arrihet në përfundime të drejta, jo vetëm lidhur me kushtet paraprake për caktimin e masës së sigurimit por edhe se përse kjo masë mund të caktohet edhe në fazën e gjykimit të çështjes penale. Për rrjedhojë mund të kuptohet dhe të dallohet gjykimi mbi dyshimin e arsyeshëm bazuar në prova për caktimin e masës së sigurimit nga gjykimi i provës për efekt të

formimit të bindjes mbi të vërtetën, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, në dhënien e vendimit të pushimit, pafajësisë apo dënimit të së pandehurit.

Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova sipas pikës 1 të nenit 228, nënkupton që bëhet fjalë për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, pra për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim dhe i pandehuri të ketë kryer veprën penale.

Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit a të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij.

Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë ezaurues, domosdoshmërisht një drejtimesh, pra në drejtim të fajësisë. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se *dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij.*

Dispozita e pikës 1 të nenit 228 tregon vetë dallimin e natyrës së veçantë të gjykimit dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës për caktimin ose jo të masës së sigurimit krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Në rastin e parë, gjykimi mbështetet në dyshime të arsyeshme bazuar në prova, që tregojnë mundësinë e kryerjes së veprës penale objekt procedimi dhe mundësinë e atribuimit, pra të ekzistencës së fajësisë, pikërisht në drejtim të të gjykuarit për atë veprë penale (fumus commissi delicti), ndërsa në rastin e dytë, gjykimi mbështetet vetëm në prova që vërtetojnë, jashtë çdo dyshimi, dhe e bindin gjykatën për kryerjen ose jo të veprës prej tij.

9. Nga ana tjetër, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim së të gjykuarit (*fumus delicti*) është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të gjykuarit (*periculum libertatis*). Procesi i vlerësimit dhe gjykimit për vendosjen ose jo të masës së sigurimit sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara nga ligji, mbështetet dhe synon arritjen e ekuilibrit të nevojshëm, nga njëra anë, për respektimin dhe garantimin e rendit publik e të interesit publik për dhënien e drejtësisë dhe nga ana tjetër, me të drejtat dhe interesat ligjore të individit subjekt i procedimit, të dyja të parashikuara nga Kushtetuta.

Prandaj, në vijim, në pikën 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se:

“3. Masat e sigurimit personal vendosen:

a- kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;

b- kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

c- kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të së pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”.

Paraprakisht, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se kushtet dhe kriteret e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos

ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të gjykuarit.

Nga interpretimi i drejtë i kuptimit që duhet t'i jepet termit “rrezik” në nenin 228 në tërësi, pra edhe për rastin e shkronjës “a” të këtij neni, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se *në çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit duhet të motivohen dhe të argumentojnë (konkretisht) nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme, të “rrezikut”, pra të probabilitetit, mundësisë reale që të ndodhë (id quod plerumque accidit) vënia në rrezik e procesit të së provuarit nga ana e të pandehurit.*

Kjo gjendje “rreziku” mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, në dinamikë, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Përfundimi i gjykatës lidhur me gjendjen e rrezikut, arrihet bazuar në tërësinë e rrethanave të faktit e të ligjit që e sjellin atë gjykatë në përfundimin mbi ekzistencën e kësaj gjendje, e cila pengon, ngadalëson apo devijon në mënyrë të parregullt procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal përkatës, në kuadër të garantimit të procesit të dhënies së drejtësisë në tërësi të parashikuar nga Kushtetuta e që pikërisht justifikon parashikimin në ligj të caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit.

Vlerësimi i rrethanave mbi ekzistencën ose jo të rrezikuar për “helmimin” e provave, bëhet rast pas rasti. Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohet verifikimi që i bën gjykata edhe rrethanës mbi kohën që ka kaluar nga çasti i vënies në dijeni të të pandehurit për procedimin penal në ngarkim të tij, në lidhje me rrethanën nëse ka kryer apo mund të kryejë ndonjë veprim a sjellje që “rrezikon” procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provës.

Në këtë kontekst, në parim, edhe e drejta e heshtjes së të pandehurit, si një strategji mbrojtje e tij, nuk përbën në vetvete “rrezik” që mund të shërbejë si motiv për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndaj tij. Gjithsesi, edhe kjo rrethanë mund të vlerësohet në harmoni dhe në lidhje me sjelljet e tjera të tij ndaj veprës që ka kryer dhe procedimit penal të filluar, të cilat mund të çojnë gjykatën në bindjen se ekziston dyshim i bazuar në prova se i pandehuri nëse lihet i lirë do të helmojë provat dhe procesin e të provuarit, sikurse janë kërkimi, marrja, vërtetësia dhe ruajtja e provës e të burimeve të provës, nga ana e të gjykuarit.

10. Më tej, sikurse sipër citohet, në shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet rasti (kushti) “kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet”.

Në lidhje me këtë kusht për caktimin e masës së sigurimit, ndërkohë që “ikja”, “largimi” i të pandehurit është çështje fakti, ka vend të evidentohet që pranimi nga gjykata i ekzistencës së mundësisë, pra “rrezikut të largimit”, duhet të jetë më i motivuar, i mbështetur në elementë konkretë, në fakte e rrethana objektive.

Interpretimi i drejtë i dispozitës së shkronjës “b” të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale i sjell Kolegjet e Bashkuara në përfundimin unifikues se *“rreziku i largimit”, krahas elementëve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar të pandehurin. Po kështu shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij etj. Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, shkronja “b” nuk mund të motivohet mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit.*

Për efekt të motivimit të caktimit të masës së sigurimit, një nga rastet që përbën element objektiv për të sjellë gjykatën në përfundime mbi largimin dhe rrezikun e largimit, është edhe gjendja e ikjes pa lënë gjurmë (fshehjes) të pandehurit. Kjo gjendje, në vetvete, mishëron logjikisht e juridikisht prirjen e të pandehurit për të shkelur dhe mos zbatuar masat e sigurimit (përfshi arrestin në burg), qenien e tij në mënyrë permanente në pozitën e mosbindjes së paligjshme përballë ligjit, prirjen për t'iu shmangur hetimit dhe gjykimit, si dhe vuajtjes së dënimit. Kjo gjendje rreziku normalisht mbetet e tillë edhe nëse i pandehuri i deklaruar i ikur, më pas, tregon disponibilitetin e tij që të paraqitet apo kur paraqitet vullnetarisht para organeve të procedimit.

Një nga arsytet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet por t'i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.

Masa e sigurimit e vendosur në çdo fazë të procedimit nuk ka lidhje as me të drejtën e të pandehurit që të mos paraqitet personalisht në seancë, apo që të largohet prej saj sipas vullnetit të tij të lirë. Nevojat e sigurimit vendosen për qëllime të tjera, ato nuk kanë asnjë lidhje dhe ndikim në lejin apo kufizimin e së drejtës së të pandehurit për të marrë pjesë në gjykimin që zhvillohet ndaj tij. Të pandehurit, me ose pa masë sigurimi, i garantohet e drejta për të marrë pjesë në gjykimin e akuzës kundër tij. Nëse çmon të mos marrë pjesë në seancë gjyqësore, ai është i lirë të mos paraqitet apo të largohet nga salla, por nëse është me masë sigurimi arrest në shtëpi apo në burg, i pandehuri detyrimisht qëndron apo kthehet në vendin e izolimit të tij.

Prandaj, në këtë kuptim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se duhet të theksohet që, largim sipas kuptimit të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 228 përbën edhe rrethana kur i pandehuri është larguar, transferuar e qëndron jashtë shtetit dhe me një sjellje e tillë duket se synon që ai t'i shmanget ushtrimit të juridiksionit penal shqiptar. Ky përfundim vlen edhe nëse pretendohet në gjykim se adresa e të pandehurit në shtetin tjetër është e njohur, përderisa largimi si sjellje nuk nënkupton vetvetiu edhe fshehjen e identitetit apo të adresës së qëndrimit nga ana e të pandehurit. Ky përfundim vlen gjithashtu edhe në rastin kur transferimi e largimi jashtë shtetit kanë ndodhur përpara se të fillohej procedimi penal ndaj këtij subjekti. Sikurse vlen edhe në rastin kur largimi i personit nga vendbanimi i njohur në drejtim të paditur brenda vendit apo jashtë vendit ka ndodhur përpara fillimit të procedimit penal. Sjellje të tilla, në thelb, përbëjnë shmangie të autorit të veprës nga ushtrimi i juridiksionit penal shqiptar.

Gjithashtu, për efekt të disponimit për caktimin e masës së sigurimit, edhe rrethanat e fshehjes apo kamuflimit të identitetit, tërheqja e fshehja e pasurive dhe sasive të konsiderueshme monetare apo transferimi i tyre jashtë vendit, janë elementë objektivë konkrete, të cilët, në lidhje edhe me rrethana të tjera, mund të krijojnë dyshimin e arsyeshem të bazuar në prova, pra bindjen se i pandehuri ka rrezik të largohet.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, vlen të evidentohet situata kur është ushtruar apo përfutuar nga i pandehuri e drejta e azilit në një shtet tjetër, si një e drejtë e lirisë së shprehjes (politike) në një shoqëri demokratike. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se e drejta e azilit lidhet dhe mbetet e lidhur vetëm në marrëdhëniet që krijohen mes refugjatit dhe shtetit të huaj pritës. Por kjo gjendje, këto marrëdhënie, nuk ndikojnë aspak në marrëdhëniet dhe çështjet e mëparshme apo në vijim që ekzistojnë mes këtij subjekti dhe shtetit të tij të origjinës, pra nuk pengojnë ushtrimin ligjor të autoritetit të shtetit të origjinës për ta hetuar, gjykuar dhe eventualisht dënuar atë.

Azilanti, për shtetin e origjinës, mbetet një i pandehur në gjendjen e personit të ikur, të larguar (pra jo në atë të rrezikut për t'u larguar), përderisa ai i fshihet drejtësisë së vendit të

origjinës, përfshirë edhe gjykimin e zbatimit ndaj tij të masave të sigurimit, mes të tjerave, të justifikueshme pikërisht edhe për shkak të largimit të tij jashtë shtetit. Kjo gjendje është e kuptueshme se e tejkalon edhe konceptin, kriterin e “rrezikut të largimit”, edhe kjo në vetvete e mjaftueshme për të zbatuar masën e sigurimit që synon të evitohet që i pandehuri dhe, më pas, eventualisht, i dënuari t’i shmanget gjykimin dhe vuajtjes së dënimit përfundimtar.

11. Në shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet rasti (kushti) *“kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të së pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”*.

Përmbajtja e dispozitës së sipërcituar të shkronjës “c” të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhet me nevojën për caktimin e masës së sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit për garantimin e rendit e të sigurisë publike, paprekshmërinë e jetës, shëndetit, pronës dhe interesave e të drejtave të tjera të ligjshme nga kryerja e veprave të tjera penale nga ana e të pandehurit. Në këtë aspekt, për të legjitimuar kufizimin e lirisë së të pandehurit, pra caktimin e masës së sigurimit, mes të tjerave, objekti i gjykimin është verifikimi i rrethanave konkrete të faktit të cilat i shërbejnë gjykatës për të vlerësuar e konkluduar mbi rrezikshmërinë e autorit dhe, nga ana tjetër, për të përcaktuar veprat penale që ka rrezik të kryhen prej tij.

Në këtë kuptim, për pranimin e ekzistencës së nevojës së sigurimit, të rrezikut konkret për komunitetin, cënimin e rendit dhe të sigurisë publike, të cilat justifikojnë caktimin e masës së sigurimit sipas kësaj dispozite, objekt i hetimit gjyqësor duhet të jetë vlerësimi konkret i rrethanave të faktit, duke nxjerrë nga sjellja në tërësi e të gjykuarit elemente konkrete të vlefshme për të bazuar dhënien e vendimit.

Sikurse për rastet e rrezikut për “eliminimin” e provave dhe atij të ikjes, edhe në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, *nisur nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë, në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të së pandehurit, nëse ka precedentë penale, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij.*

Bazuar në vlerësimin e provave mbi ekzistencën e elementeve konkrete të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të së gjykuarit, jo domosdoshmërisht kumulative, gjykata nxjerr përfundimin nëse ekziston dyshim i arsyeshëm mbi rrezikshmërinë e tij dhe nevojën për të garantuar paprekshmërinë e komunitetit, nëse ekziston mundësia reale që i gjykuari në të ardhmen, duke qenë në gjendje të lirë, mund të kryejë vepra penale të rënda apo të së njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar.

“Krimet e rënda” në kuptim të shkronjës “c” të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale nuk përfshijnë vetëm ato për të cilat ka kompetencën Gjykata për Krime të Rënda, por edhe vepra të tjera penale të rënda, të cilat, për vetë rrezikshmërinë dhe pasojat e tyre, janë pranuar si të tilla në praktikën tonë gjyqësore edhe para krijimit të këtyre gjykatave.

12. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

“1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.

2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprës penale prej tij dhe, nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilat tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut, së paku sipas njërit prej rasteve të nenit 228.

Si në rastin kur masa e sigurimit caktohet për herë të parë, ashtu edhe kur shqyrtohet zëvendësimi i masës ekzistuese, gjykata nuk ka detyrim që të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret ndaj të gjykuarit është masa e përshtatshme. Në çdo rast mbetet detyrimi i gjykatës që, fillimisht, të argumentojë se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova në ngarkim të së gjykuarit për kryerjen nga ana e tij të veprës penale.

Prandaj, edhe në rastin kur vendos caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, gjykata nuk ka detyrim të analizojë në hollësi përse llojet e masave të tjera nuk janë të përshtatshme në çështjen në gjykim. Bazuar në elementet objektive mbi natyrën dhe llojin e veprës penale, mjetet dhe mënyrën e kryerjes së saj, pasojat e shkaktuara, si dhe në elementet subjektive të lidhura me personalitetin e të gjykuarit dhe gjendjen e rrezikut, gjykata argumenton se masa e vetme e përshtatshme ndaj të gjykuarit në raport me llojin dhe shkallën e rrezikut është ajo e arrestit në burg.

Në rastin e procedimeve penale për kryerjen e krimeve të rënda apo që kanë sjellë pasoja të rënda, për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes e të pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme të rrezikshmërisë së autorit të tyre sipas nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Masa e sigurimit arrest në burg e kërkuar nga prokurori ndaj të gjykuarit mund të çmohet nga gjykata si e papërshtatshme, vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit arrest në burg.

13. Në pikën 1 të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

“1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa”.

Së pari, nga përmbajtja e saj del qartë se qëllimi i ligjvënësit është të urdhërojë se masa e sigurimit caktohet vetëm nga gjykata. Gjykata nuk disponon kryesisht, pra masa nuk caktohet nëse nuk paraqitet kërkesë nga prokurori, e cila duhet të jetë e mbështetur në prova dhe në ligj.

Së dyti, kërkesa duhet t’i paraqitet *gjykatës kompetente*. Kjo dispozitë gjendet në Pjesën e Parë, Titullin V, Kreu II. Pra, jo vetëm nga vendi ku gjendet në Kodin e Procedurës Penale (përpara Titujve mbi fazën e hetimit paraprak dhe atij të gjykimit), por edhe nga përmbajtja e saj, kjo dispozitë thjesht evidenton se duhet respektuar parimi procedural i disponimit nga organi që procedon.

Pa dyshim që, në fazën e gjykimit, i vetmi organ që procedon me çështjen penale të dërguar për gjykim, pra edhe për caktimin e masës së sigurimit, revokimin e zëvendësimit e saj, është gjykata, pikërisht vetëm ajo gjykatë e cila është caktuar për gjykimin e veprës penale deri në dhënien e vendimit të pushimit, pafajësisë apo dënimit.

Kodi i Procedurës Penale, në pikën 1 të nenit 13, parashikon gjykatat të cilat gjykojnë veprat penale. Ndërsa në pikën 2, përcaktohet se me përbërje monokratike gjykojnë kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, ku bëjnë pjesë edhe disponimet lidhur me masat e sigurimit.

Dispozita e pikës 2 nuk tregon se kush disponon për kërkesa të palëve lidhur me masa sigurimi në fazën e gjykimit, as për përbërjen e gjykatës. Kjo nuk është e rastit dhe as ndonjë ometim nga ana e ligjvënësit. Qëllimi i këtyre dispozitave nuk është të tregojnë a kufizojnë ushtrimin e së drejtës së paraqitjes të kërkesave të palëve apo ushtrimin e kompetencës së gjykatës mbi masat e sigurimit vetëm në fazën e hetimit apo edhe në atë të gjykimit. Dispozita thjesht tregon që, nëse kërkesat paraqiten në fazën e hetimit, vendos gjykata monokratike, e njëjta gjykatë që gjatë hetimit, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, disponon edhe për ecurinë e zbatimit të masës së sigurimit.

Por edhe neni 246 nuk shprehet dhe nuk e lidh zbatimin e urdhërimeve të saj vetëm me fazën e hetimit, sepse, gjatë fazës së gjykimit, është gjykata e themelit që vlerëson situatën e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar më parë gjatë hetimit paraprak apo në fazën e gjykimit.

Ndërkohë që, edhe kuptimi e zbatimi i dispozitave të nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale nuk lidhet me ndonjë fazë gjykimi, por gjejnë zbatim kurdoherë “*kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit*” të një mase sigurimi të caktuar më parë. Madje pika 4 e këtij neni tregon qartë se për revokimin a zëvendësimin e masës ekzistuese disponon, jo vetëm gjyqtari i hetimit paraprak, por, në varësi të fazës së procedimit, edhe e njëjta gjykatë, pra ajo që shqyrton kërkesën për gjykim dhe zgjidh përfundimisht në themel çështjen. As kjo dispozitë nuk tregon apo urdhëron se masat e sigurimit caktohen vetëm në fazën e hetimit paraprak.

Në Titullin V të Kodit të Procedurës Penale “*Masat e Sigurimit*” parashikohen rregulla mbi kushtet dhe kriteret e paraqitjes së kërkesës dhe të disponimit të gjykatës lidhur me masat e sigurimit. Dispozitat e këtij titulli nuk përmbajnë ndonjë rregullim specifik lidhur me *gjykatën kompetente* për shqyrtimin e kërkesave për masat e sigurimit, as edhe ndonjë rregullim mbi lejjimin apo ndalimin e shqyrtimit të kërkesave mbi këto masa nga gjykata në fazën e hetimit paraprak apo në fazën e gjykimit.

Po kështu, ky Kod, në dispozitat vijuese, sikurse edhe në Titullin VII “Gjykimi” dhe në dispozitat në vijim nuk përmban ndonjë rregullim konkret me të cilën të shprehet lidhur me paraqitjen e kërkesave dhe ankesave lidhur me caktimin, revokimin, zëvendësimin, etj., të masave të sigurimit, mbi kompetencën dhe përbërjen e gjykatës, mënyrën e disponimit të saj në rastin e shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe ankesave.

Nëse është paraqitur kërkesa për gjykim, i përket vetëm gjykatës së caktuar për shqyrtimin e saj dhe asnjë gjykatë a gjyqtari tjetër kompetenca që të vendosë caktimin, zëvendësimin a revokimin e masave të sigurimit.

Me depozitimin e kërkesës për gjykim, gjyqtari i fazës së hetimeve paraprake (i njëjti gjyqtar për të gjitha kërkesat) vetvetiu ka humbur kompetencën e tij për të trajtuar kërkesa lidhur me masat e sigurimit dhe çdo lloj kërkesë tjetër të palëve për të cilat kompetente është gjykata. Ajo i ka kaluar gjykatës së caktuar për shqyrtimin e kërkesës për gjykim.

Gjyqtari që ka dhënë vendimin e dënimit mbetet kompetent lidhur me masat e sigurimit edhe në periudhën deri kur, mbi ankimin e palës, çështja të jetë regjistruar në gjykatën e apelit. Në thelb gjykata e apelit nuk mund të shqyrtojë një kërkesë lidhur me masat e sigurimit, për sa kohë nuk i është depozituar dhe nuk ka regjistruar çështjen për shqyrtim në apel. Deri në atë moment vendos gjyqtari që ka dhënë vendimin e dënimit. Në pamundësi objektive për të njëjtin gjyqtar, gjithsesi vendos një gjyqtar tjetër i po asaj gjykatë ku është dhënë vendimi i dënimit.

Nga ana tjetër, nga interpretimi i drejtë i përmbajtjes së dispozitave kushtetuese (nenet 27 e 28) dhe atyre të Kodit të Procedurës Penale, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se vullneti i ligjvënësit, qëllimi i caktimit të masave të sigurimit dhe efektet e zbatimit të tyre nuk dallojnë e nuk ndryshojnë nga fakti se në cilën fazë të procedimit ato caktohen apo nga gjykata dhe përbërja e gjykatës që ka dhënë vendimin lidhur me to. Masat e sigurimit personal nuk përbëjnë në vetvete akte të hetimit dhe të marrjes së provës dhe as nuk lidhen me fillimin e përfundimin e afateve të

hetimit paraprak e pasojat përkatëse. Prandaj është e ligjshme që masat e sigurimit të caktohen, revokohen apo zëvendësohen nga gjykatat edhe pas përfundimit të fazës së hetimit paraprak sepse si gjykatë që procedon, pra si gjykata që ka disponibilitetin e akteve është gjykata që shqyrton kërkesën për gjykim. Kështu që, me paraqitjen e kërkesës për gjykim, kompetenca për të disponuar mbi kërkesat e ankesat lidhur me masat e sigurimit kalon ipso iure tek gjykata që e shqyrton themelin e akuzës.

Prandaj, bazuar në analizën dhe interpretimin e normave më sipër në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se ***ligjvënësi nuk ka vendosur ndonjë kufizim lidhur me të drejtën e palëve për të paraqitur kërkesa lidhur me masat e sigurimit, përfshirë atë për caktimin e saj për herë të parë në gjykim, as edhe për gjykatën që procedon (në fazën e hetimit paraprak apo në atë të gjykimit), lidhur me atë kërkesë. Pra, masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, nëse janë nevojat e sigurimit, nëse nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji nënen 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.***

Parimi i përgjithshëm procedural penal është që lidhur me çështjet, kërkesat e ankesat e palëve, apo atyre që çmohen kryesisht, kompetencën për të vendosur e ka organi që procedon. Organi që procedon dhe ka disponimin e akteve të çështjes në fazën e hetimit paraprak është prokurori, ndërsa në fazën e gjykimit është gjykata.

Përfundimisht, ligji përcakton se në fazën e hetimit paraprak, ndonëse mbi çështjen dhe aktet vlerëson e disponon prokurori, në rastin e masës së sigurimit, për shkak se ato lidhen me kufizimin e lirisë së individit, vendimin për caktimin ose jo të saj, si dhe për revokimin a zëvendësimin e masës, e bën gjyqtari monokratik i hetimit paraprak. Por kur është paraqitur kërkesa për gjykim, mbi aktet e çështjes disponon pa asnjë përjashtim dhe ekskluzivisht e njëjta gjykatë, gjykata e themelit (monokratike a kolegjinale) që ka kompetencën lëndore e tokësore të shqyrtimit në themel të çështjes.

Në të gjitha rastet, investimi e disponimi i gjykatës nuk përbën paragjykim e rrjedhimisht njëanshmëri të gjykatës drejt një vendimi dënimi (fajësie), pushimi apo pafajësie sepse qëllimi, natyra dhe kriteret ligjore të gjykimit dhe motivimit të vendimit për caktimin e masës së sigurimit janë të ndryshme nga ai për zgjidhjen në themel sipas neneve 387 deri 399 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo njëanshmëri nuk ekziston, si në rastin kur gjykata cakton masën e sigurimit, ashtu edhe kur e revokon apo zëvendëson me një masë tjetër, më të lehtë ose më të rëndë. Përkatësisht nuk ka vend për paragjykim të qëndrimit të gjykatës në lidhje me akuzën si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.

Lehtësimi apo rëndimi i masës së sigurimit, si pjesë e kuptimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal, nuk ka lidhje as me parimin e mos rëndimit të pozitës së të gjykuarit, sepse ky parim gjen zbatim vetëm në kuptimin e zbatimit të ligjit penal material. Njëra nga situatat që afirmon këtë është pika 3 e nenit 260 ku parashikohet që kur nevojat e sigurimit rëndohen, gjykata zëvendëson masën e zbatuar me një tjetër më të rëndë. Madje këtë e bën jo vetëm me kërkesën e prokurorit por, aq më tepër, edhe kryesisht, kur e çmon se është rasti.

Nuk kemi njëanshmëri edhe për faktin e thjeshtë që këtë kompetencë të gjykatës së themelit e parashikon vetë ligji, kur i jep asaj detyrën për të vendosur edhe revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit me një më të lehtë apo më të rëndë. Madje ligji e lejon gjykatën të vendosë edhe kryesisht (neni 260).

I vetmi kufizim procedural, i parashikuar shprehimisht nga ligji, gjendet në pikën 2 të nenit 15 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilën parashikohet se nuk mund të marrë pjesë në gjykim (pra në fazën e gjykimit) gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit, apo çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim. Nga ana tjetër, ligji

procedural obligon që të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake të shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.

Vetëm për heqjen dorë apo mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit apo anëtarit të trupit gjykues, vetë ligji procedural parashikon shprehimisht e përjashtimisht se disponon një gjyqtar apo trupë tjetër gjykuese (nenet 17, pika 2 dhe 21). Kjo për arsyen e thjeshtë se vetë ligja procedurale e pengon këtë gjyqtar të procedojë me tej me çështjen dhe të disponojë me vendime derisa të shprehet gjykata tjetër për përjashtimin ose jo të tij nga ajo çështje (neni 18, pika 2)

14. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se nuk përjashtohet mundësia që, sipas rrethanave konkrete të ecurisë së një procedimi penal, gjykata të caktojë masë sigurimi ndaj personit në hetim apo të pandehurit, edhe pse masa e mëparshme e dhënë ndaj tij ishte shuar apo revokuar më parë nga gjykata.

Kështu, në rastet kur vendimi për caktimin e masës së sigurimit është çmuar më pas nga gjykata si i pavlefshëm, pra thjesht për shkelje formale procedurale (p.sh. për mungesë të nënshkrimit nga gjyqtari), apo kur kjo masë është shuar për shkak të pushimit të çështjes në fazën e hetimit paraprak (p.sh. neni 261, pika 1), nuk ka asnjë logjikë juridike për të përjashtuar mundësinë që masa e sigurimit të mund të caktohet sërish nga gjykata në çdo fazë të procedimit, për të njëjtat rrethana të faktit e të ligjit lidhur me nevojat e sigurisë për të cilat ajo ishte vendosur. Ajo vendoset me kërkesën e prokurorit dhe nëse përmbushen kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji.

Në këto raste nuk shkelet parimi *ne bis in idem* në shqyrtimin dhe disponimin e gjykatës mbi masat e sigurimit. Por, në zbatim të këtij parimi, kërkesa e prokurorit për caktimin sërish të masës së sigurimit nuk pranohet nga gjykata, në rast se është motivuar mbi të njëjtat rrethana të faktit e të ligjit, të cilat nga gjykata janë vlerësuar njëherë si motive për të shuar, revokuar apo ndryshuar vendimin e mëparshëm për caktimin e masës ndaj të gjykuarit, i cili ka marrë formë të prere. Prokurori ose i pandehuri që kanë paraqitur kërkesë për caktimin, revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit, kanë barrën e provës të argumentojnë para gjykatës se kanë lindur apo ndryshuar nevojat e sigurimit apo rrethanat e faktit lidhur me të.

Është thelbësore të mbahet parasysh se, në zbatim të drejtë të ligjit, në rastin e masave të sigurimit, vlera e gjësë së gjykuar ka natyrë relative, në kuptimin që ajo lidhet vetëm me parimin e garantimit të nevojave të sigurimit, rrjedhimisht me rrethanat e faktit e të ligjit, të cilat ekzistojnë në çastin e dhënies së vendimit gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit.

Nëse ndryshojnë nevojat e sigurimit, pra nëse rrethanat ndryshojnë, gjykata mund të revokojë ose ndryshojë masën e dhënë më parë (neni 260), apo të caktojë një masë të re nëse lind përsëri nevoja e sigurimit.

Prandaj, në vështrim të interpretimit të ligjit procedural penal të parashtuar më sipër në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se ***masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, sa herë që nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet paraprake dhe kriteret e rrezikut të parashikuara nga nenet 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Kjo gjendje "rreziku" mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Vendimi lidhur me caktimin e masës së sigurimit apo për zëvendësimin, revokimin e shuarjen e saj jepet për gjendjen në të cilin është procedimi, për gjendjen në të cilën janë aktet, për rrethanat e faktit e të ligjit në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe shqyrtimit të saj nga gjykata.***

Ndonëse për vetë natyrën dhe mënyrën e zhvillimit të një procedimi penal, masat e sigurimit normalisht e zakonisht caktohen në fazën e hetimit paraprak, nuk ka asnjë logjikë juridike apo pengesë ligjore që këto masa të mos caktohen për herë të parë edhe në fazën e gjykimit. Nëse ekzistojnë nevojat e sigurimit, të cilat, sikurse edhe respektimi i lirisë së individit,

janë garanci e detyrime që burojnë nga Kushtetuta, pra nëse janë kushtet paraprake dhe verifikohen rrethanat e rrezikut të parashikuara nga ligji, jo vetëm që nuk është pengesë, por përkundrazi, është detyrim për gjykatën që të pranojë kërkesën e prokurorit dhe të caktojë masën e sigurimit. Qëllimi dhe efektet e parashikuara nga ligji procedural penal për masën e sigurimit, koncepti juridik i “rrezikut” dhe parimi i “përshtatshmërisë” për caktimin dhe zbatimin e saj, qëndrojnë dhe i shërbejnë njësoj, si fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe asaj të gjykimit.

15. Duke pasur parasysh arsyetimin mbi interpretimin dhe unifikimin e ligjit procedural penal të parashtruar më sipër në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit e përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur mbrojtësi i të pandehurit Ilir Kumbaro nuk janë të mbështetura në ligj.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, bazuar në aktet që përmbahen në fashikullin e gjykimit dhe nga provat e tjera të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor e të paraqitura nga palët, kanë arsyetuar e pranuar se ekziston një fakt kriminal dhe ka dyshime të arsyeshme në drejtim të pjesëmarrjes së të pandehurit Ilir Kumbaro në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë në kryerjen e veprimit kriminal, shoqërimin e paligjshëm, rrëmbimin dhe kryerjen e keqtrajtimit fizike dhe torturave ndaj shtetasit maqedonas me kombësi shqiptare Remzi Hoxha dhe të dëmtuarve Avni Koldashi, Ziso Kristopulli duke përdorur mjetet dhe objektet shtetërore në Vain të Rrethit të Lezhës dhe Tiranë.

Mbi këto rrethana dhe për identifikimin e autorëve të mundshëm të veprimit kriminal, veç të tjerave, kanë dhënë deklaratimet e tyre të dëmtuarit Avni Koldashi dhe Ziso Kristopulli. Ndërsa rreth shtetasit maqedonas me kombësi shqiptare Remzi Hoxha, përveç atyre mbi faktin se ushtronte veprimtari në Tiranë nga ku u rrëmbye dhe izolimit e keqtrajtimit në Vain të Lezhës, megjithë përpjekjet e kërkimit e familjarëve të tij dhe autoriteteve, nuk ka asnjë të dhënë nëse është liruar dhe nëse ende jeton.

I pandehuri Ilir Kumbaro në periudhën e ngjarjes kishte detyrën e Kryetarit të Degës së Parë në Drejtorinë e Tiranës së Shërbimit Informativ Kombëtar, duke marrë pjesë drejtpërdrejt në shoqërimin e paligjshëm të të dëmtuarve dhe shtetasit Remzi Hoxha.

Prandaj, Gjykata për Krime për të Rënda ka ardhur në përfundimin se, mbështetur në dyshimet e arsyeshme të bazuara në prova, i pandehuri Kumbaro në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë kanë kryer veprat penale të rënda dhe me pasoja të rënda, sikurse janë “rrëmbimi ose mbajtja peng e personit” dhe “tortura me pasoja të rënda” sipas neneve 109/1 e 25 dhe 87 e 25 të Kodit Penal.

I pandehuri Kumbaro, në dijeni të procedimit penal ndaj tij, vijon t’i fshihet drejtësisë me qëllim shmangien nga hetimi dhe gjykimit ndaj tij duke qëndruar jashtë shtetit dhe duke ndërruar identitetin e tij duke përdorur dokumente të një shtetasi kosovar. Ndërkohë që personaliteti dhe sjellja e tij tregojnë se ka rrezik që të kryejë krime të rënda.

Në rrethana të tilla, Gjykata për Krime të Rënda ka vlerësuar se gjendet përpara kushteve e kritereve të parashikuara nga nenet 228, pika 3, shkronja “b” e “c” dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në burg, e parashikuar nga neni 238 e këtij Kodi.

Masa e sigurimit arrest në burg ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro e caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me një arsyetim të ngjashëm, është miratuar edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

16. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, të dy gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin procedural penal duke pranuar kërkesën e prokurorit dhe caktuar për të pandehurin Kumbaro masën e sigurimit arrest në burg.

Të dy vendimet gjyqësore, duke respektuar kërkesat e ligjit procedural penal, mbështesin arsyetimet e tyre jo në konstatime të përgjithshme por në prova që tregojnë rrethanat konkrete të faktit e të ligjit të analizuara prej tyre, të cilat i kanë sjellë me të drejtë ato në dyshimin e arsyeshëm se veprat penale janë kryer nga i pandehuri Ilir Kumbaro në bashkëpunim me të tjerë.

Drejt kanë evidentuar gjykatat rrethanën që i pandehuri i fshihet drejtësisë, hetimit dhe gjykimit të tij duke u larguar e qëndruar jashtë vendit, duke ndërruar për këtë qëllim edhe identitet, të cilin ia ka marrë një shtetasi kosovar. Kjo rrethanë identifikohet me kriterin e parashikuar nga shkronja “b” e pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit.

Njëkohësisht drejt kanë evidentuar gjykatat edhe rrethanën që personaliteti i të pandehurit, si ish funksionar i lartë dhe aktiv i shërbimit sekret, si dhe sjellja e tij para e pas ngjarjes dhe procedimit ndaj tij, tregojnë se ai ka rrezik të kryejë krime të tjera të rënda, rrethanë e cila identifikohet me kriterin e parashikuar nga shkronja “c” e pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit.

Po kështu, veprat penale që i atribuohen të pandehurit Kumbaro janë të rënda sikurse edhe pasojat janë të rënda, pra rrëmbim personi dhe tortura me pasoja të rënda ndaj tre personave. Me të drejtë, kjo e ka sjellë gjykatën në përfundimin që është vendi për të zbatuar kriteret e nenit 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, nisur nga rrezikshmëria e veçantë e veprave penale dhe sanksioneve mbi 10 vjet heqje lirie.

Akuza për kryerje të krimeve të rënda dhe që kanë sjellë pasoja të rënda, në bashkëpunim me të tjerë, duke pasur parasysh personalitetin e tij dhe sjelljen para e pas ngjarjes dhe shmangia permanente nga hetimi e gjykimi, të sjellin në konkluzion ligjor se e vetmja masë sigurimi e përshtatshme për të pandehurin Ilir Kumbaro është ajo e arrestit në burg.

17. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, nuk qëndron pretendimi i ngritur në rekurs nga mbrojtësi i të pandehurit Ilir Kumbaro mbi mohimin nga Gjykata për Krimet e Rënda të së drejtës së të pandehurit për t’u mbrojtur nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij dhe duke e zhvilluar padrejtësisht seancën për caktimin e masës së sigurimit me një mbrojtës të caktuar kryesisht.

Kolegjet vërejnë se i pandehuri Ilir Kumbaro mbrohej nga dy avokatë. Njoftimet për vendin dhe kohën e zhvillimit të seancës gjyqësore pasardhëse ndaj dy mbrojtësve së të pandehurit janë kryer rregullisht nga gjykata.

Ndërsa njoftimi i mëvonshëm nga mbrojtësit për pamundësinë e paraqitjes në seancë gjyqësore për shkak të nevojës së pjesëmarrjes në një gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Apelit Vlorë, sipas Kolegjeve të Bashkuara nuk justifikon mungesën e të dy avokatëve në seancën gjyqësore ku u shqyrtua kërkesa e prokurorit dhe u caktua masa e sigurimit arrest në burg për të mbrojturin prej tyre, të pandehurin Ilir Kumbaro.

Garantimi i mbrojtjes së të gjykuarit në procesin penal dhe prania e mbrojtësit në gjykim janë garanci kushtetuese dhe ligjore për të, si person nën hetim apo i pandehur. Nëse është caktuar nga i pandehuri apo gjykata kryesisht, detyrimi kushtetues e ligjor i mbrojtësit është që të sigurojë pjesëmarrjen e tij në veprimet procedurale dhe në seanca gjyqësore, si dhe të kryejë efektivisht dhe me profesionalizëm veprimet, kërkesat, ankesat, etj., në interes të së mbrojturit prej tij.

Mbrojtësi ka edhe detyrimin kushtetues që të marrë të gjitha masat që varen nga vullneti dhe kontrolli i tij për të mos munguar në kryerjen e veprimeve dhe në seanca gjyqësore për mbrojtjen e interesave të klientit të tij. Mungesa e tyre është e justifikuar vetëm nëse ka pengesa apo gjendet në pamundësi për të realizuar mbrojtjen e klientit të tij, për shkaqe të pavarura prej tij, të tilla që e bëjnë objektivist të pamundur të përmbushë detyrën e mbrojtësit, sikurse janë rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme dhe fatkeqësive natyrore, ngjarje aksidentale mbi personin e tij apo familjarë të tij, raste fatkeqësie në rrethin më të afërt familjar, gjendja shëndetësore personale e

tillë që pamundëson kryerjen e detyrës apo gjendja shëndetësore e rëndë e familjarëve të tij nëse evidentohet domosdoshmëria e pranisë së tij tek i sëmuri.

Nuk përbën justifikim të pranueshëm ligjërisht pretendimi i mospjesëmarrjes në kryerjen e veprimit procedural apo në seancë gjyqësore, kur avokati njofton se ndodhet në kryerjen e një veprimi procedural për një klient tjetër në një çështje tjetër, ose në një gjykim tjetër, ndodhet jashtë qendrës së autoritetit procedues apo jashtë shtetit për motive profesionale apo çlodhëse e zbavitëse, etj.

Nëse, nga njëra anë, është e drejta e të gjykuarit të ketë mbrojtës, nëse është detyrim i gjykatës të sigurohet që i gjykuari ka mbrojtës të caktuar prej tij e nëse nuk ka a mungon t'ia sigurojë një tjetër kryesisht dhe se mbrojtësit e ushtrojnë profesionalisht dhe efektivisht detyrën e tyre, nga ana tjetër, është detyrimi ligjor i mbrojtësve të marrin masa për të siguruar pjesëmarrjen në hetim apo gjykim dhe, nëse e kanë të pamundur, jo vetëm të njoftojnë gjykatën por edhe të mbrojturin prej tij për pengesën e pamundësinë për të ushtruar mbrojtjen.

Në këtë kontekst, nuk ka logjikë juridike për të justifikuar mungesën e mbrojtësit me arsyetimin se gjendet në një proces tjetër. Përfshirja e avokatit në mbrojtjen e klientëve në procedime të ndryshme dhe ngarkesa e tij me punë janë zgjedhja e tij, sikurse është edhe vijimi i realizimit të mbrojtjes apo heqja dorë nga mbrojtja. Pranimi i ushtrimit të detyrës dhe heqja dorë prej saj nga mbrojtësi janë akte të vullnetit të tij dhe plotësisht të kontrollueshme prej tij. Si të tilla është detyrimi i avokatit të marrë masa organizative për të bashkëpunuar me kolegë të tjerë, apo për të mbajtur aq ngarkesë pune sa mund të garantojë klientët dhe autoritetet gjyqësore se është në gjendje të përmbushë detyrën. Nuk janë gjykatat ato që duhet të zgjidhin problemet e ngarkesës me punë të avokatëve, sikurse nuk është çështje e avokatëve të zgjidhin problematikën e ngarkesës së punës së gjykatës.

Po kështu, secili procedim, çdo gjykim ka të njëjtën standart dhe të njëjtën rëndësi për dhënien e drejtësisë dhe procesin e rregullt ligjor. Secila gjykatë ka detyrimin t'i përmbahet këtyre standarteve. Nuk është avokati ai që "zgjedh" se cila gjykatë duhet të vijojë me praninë e tij dhe cila të shtyjë gjykimin, as edhe përcakton ai se cili prej gjykimeve është më i rëndësishëm se tjetri. Nëse avokati është i ngarkuar me shumë çështje, nëse gjendet para angazhimit të njëkohshëm në dy gjykime të ndryshme, detyra e tij është të njoftojë mospjesëmarrjen dhe shkakun përkatës. Gjykata nuk ka detyrim për të shtyrë seancën por ka detyrimin tjetër që, nëse e kërkon ligji, t'i sigurojë të gjykuarit një mbrojtës kryesisht.

Nisur nga sa arsyetohet më sipër, pretendimi i mbrojtjes se ka njoftuar gjykatën për pjesëmarrje në një gjykim tjetër nuk është i mbështetur në ligj. Aq më tepër në çështjen objekt gjykimi, kur i pandehuri Ilir Kumbaro mbrohej nga dy avokatë, madje si pjesë e një studioje ligjore. Gjykatat kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor, duke i caktuar të pandehurit një mbrojtës tjetër kryesisht, duke i dhënë atij edhe kohën e nevojshme për t'u përgatitur dhe duke zhvilluar gjykimin në atë seancë gjyqësore me praninë dhe pjesëmarrjen (mbrojtjen) efektive të këtij avokati.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të nenit 438 dhe të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të shkronjës "a" të nenit 17 të Ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë*",

V E N D O S Ë N

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.5, datë 05.01.2010 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.

3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njehson praktikën gjyqësore.

Tiranë, më 14.10.2011

MENDIMI I PAKICËS

Për vendimin nr.7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ne gjyqtarët, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Majlinda Andrea, Fatos Lulo, Andi Çeliku e Guxim Zenelaj, nuk jemi dakord me vendimin e marrë nga shumica, e cila ka konsideruar të drejtë e të bazuar në ligj vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, duke pranuar se masa e sigurimit personal mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e çështjes, nëse verifikohen kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit. Ndryshe nga vendimi i shumicës, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.5, datë 05.01.2010 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, jemi të mendimit se si vendimi nr.5, datë 05.01.2010 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe vendimi nr.154, datë 15.12.2009 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë duheshin prishur dhe të rrëzohej kërkesa.

Pa dashur të përsërisim rrethanat e çështjes, të cilat janë trajtuar në vendimin e shumicës, do të argumentojmë më poshtë qëndrimin tonë kundër, mbështetur në dispozitat ligjore.

Shumica, pasi ka parashtruar sintetikisht faktet e administruara nga gjykatat e dy niveleve, ka arritur në përfundimin se vendimet ishin të bazuara në ligj dhe duheshin lënë në fuqi.

Jemi kundër pranimit nga ana e shumicës të pohimit të prokurorit në gjykimin e çështjes se sipas organit të akuzës, i pandehuri Ilir Kumbaro është hetuar në gjendje arresti në burg. Sipas Organit të Prokurorisë, masa e sigurimit arrest në burg ka ekzistuar për të si organ edhe pse ajo nuk ishte ekzekutuar, për shkak se i pandehuri nuk gjendej dhe për këtë shkak ishte deklaruar ikja e tij. Këtë qëndrim të prokurorisë e ka pranuar shumica në vendimin e saj, qëndrim që për ne gjyqtarët në pakicë është i papranueshëm.

Nuk mund të pranojmë se organi i prokurorisë ka menduar apo ka marrë të mirëqenë faktin se gjendja procedurale e të pandehurit deri në dërgimin e çështjes për gjykim ka qenë e një të pandehuri me masë sigurimi “arrest në burg”. Kjo do të vinte në kundërshtim me ligjin procedural penal, në të cilin është sanksionuar se në rastet e pafajësisë apo të pushimit të çështjes hiqen edhe masat e sigurimit (neni 389 i K.Pr.P.).

Në nenin 261 të K.Pr.Penale janë parashikuar rastet e shuarjes së masave të sigurimit dhe në pikën 1/a të këtij neni përcaktohet se: “1. *Masat e sigurimit shuhet: a) kur për të njëjtin person është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë vendimi i pafajësisë*”.

Në kushtet kur për të pandehurin Ilir Kumbaro, nga vetë prokurori i çështjes është vendosur me vendimin datë 01.07.2004 pushimi i çështjes, atëherë në këtë moment është shuar edhe masa e sigurimit arrest në burg e caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr.1229, datë 18.12.2003 për të pandehurin.

Nuk mund të pranohet që nga prokurori të bëhej i “*padituri*” për këtë fakt dhe të vazhdohej procedimi (hetimi i çështjes) pas shfuqizimit nga Prokurori i Përgjithshëm më datë 08.09.2006 (pas më shumë se 2 vjetësh nga pushimi) i vendimit të pushimit të çështjes, duke konsideruar se i pandehuri ishte me masë sigurimi.

Masa e sigurimit pas pushimit të çështjes dhe riçeljes së saj, nuk mund të rivihen në fuqi automatikisht, pa kërkesë të prokurorit, si personi i ngarkuar nga ligji me kryerjen e disa veprimeve procedurale gjatë hetimit, i cili mbikqyr hetimin.

Pakica, në të kundërt me sa ka pranuar shumica në vendim, konkludon se i pandehuri Ilir Kumbaro është dërguar për gjykim pa masë sigurimi.

Që këtej lind pyetja: a) mund të caktohet masë sigurimi për një të pandehur me kërkesë të prokurorit në gjykim, kur i pandehuri është dërguar në gjykim pa masë sigurimi, pra është hetuar pa masë sigurimi? Në përgjigje të kësaj pyetje, shumica ka ardhur në përfundimin se masat e sigurimit mund të caktohen në çdo fazë të procedimit penal dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që këto masa të mos caktohen për herë të parë edhe në fazën e gjykimit.

Ndryshe nga përfundimi i shumicës, pakica është e mendimit se masa e sigurimit nuk mund të kërkohet të vendoset në fazën e gjykimit për herë të parë, nëse i pandehuri është dërguar në gjykim pa iu caktuar ndonjë masë sigurimi.

Edhe pse pakica është dakord me arsyetimin dhe interpretimin që shumica i bën pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për kushtet kur vendosen masat e sigurimit, pakica çmon se vlen të theksohet se dispozita e nenit 228 të K.Pr.Penale, ashtu si çdo dispozitë tjetër, lexohet e zbatohet që në fillim të saj.

Në pikën 1 të nenit 228 të K.Pr.Penale përcaktohet se: *“Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”*. Në interpretim të kësaj pike të nenit 228, çmojmë se që për një person të kërkohet të caktohet një masë sigurimi duhet të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm, objektiv, i krijuar dhe i mbështetur në prova. Pra bëhet fjalë për një person në ngarkim të të cilit ekziston dyshimi i bazuar në një sërë indicjesh e provash se ai është autor i një veprë penale. Por, kur një person është i dyshuar se ka kryer një vepër penale? Ai është i dyshuar gjatë fazës së hetimit të çështjes, pasi në momentin që çështja është dërguar për gjykim në gjykatë në ngarkim të së pandehurit rëndon një akuzë përfundimtare, të cilën ia ka atribuar prokurori. Për prokurorin, i pandehuri, për të cilin është paraqitur kërkesa për gjykim përpara gjykatës, nuk është më një person i dyshuar, për të cilin ka pak indicje dhe prova, por për prokurorin mbi të pandehurin rëndon një akuzë dhe ekzistojnë prova të plota për të provuar fajësinë e tij. Për pakicën, masa e sigurimit është një veprim procedural që zbatohet në ngarkim të një personi, i cili është në hetim dhe dyshohet se ka kryer një vepër penale.

Organi i akuzës kërkon caktimin e një mase sigurimi për të garantuar vazhdimin e hetimit duke pasur parasysh ekzistencën e kushteve dhe kriterëve ligjore për caktimin e saj. Në asnjë nen të K.Pr.Penale nuk thuhet shprehimisht, qartë e pa ekuivok, se masat e sigurimit mund të vendosen rishtazi gjatë gjykimit në themel të çështjes, nga trupi gjykues që e gjykon atë. Kështu, kur çështja penale ndodhet për gjykim dhe nëse i pandehuri nuk ka masë sigurimi, atëherë në fazën e gjykimit nuk mund të kërkohet dhe caktohet rishtazi një masë sigurimi, nëse nga ana e prokurorit nuk ka një akuzë të re për një vepër penale tjetër, apo nuk del gjatë shqyrtimit gjyqësor një fakt i ri, në mënyrë që prokurori të procedojë sipas përcaktimeve të neneve 373, 374 të K.Pr.Penale.

Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk bashkohemi me mendimin e shprehur nga shumica, e cila ka interpretuar pikën 3 të nenit 228 të K.Pr.Penale në favor të përfundimit se në çdo fazë të procedimit, duke përfshirë edhe gjykimin, kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit duhet të argumentohet në lidhje me mundësinë reale që të ndodhë vënia në rrezik e procesit të së provuarit nga ana e të pandehurit, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për të ndaluar të pandehurin dhe lidhur me nevojën për të caktuar masën e sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit, pasi ashtu si argumentuam më lart, masat e sigurimit vendosen për të garantuar hetimin sa më të plotë dhe në prani të së pandehurit, ndërkohë që faza e gjykimit rregullohet me dispozitat e titullit VII “Gjykimi” në

K.Pr.Penale. Në këtë pjesë të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se për të pandehurin, i cili nuk paraqitet në gjykim, i fshihet gjykimit, nga ana e gjykatës që gjykon çështjen deklarohet mungesa e tij dhe vazhdon gjykimi në mungesë, në prani të mbrojtësit.

Ndërkohë që në dispozitat procedurale penale që rregullojnë gjykimin në mungesë, nuk ka ndonjë rregullim të tillë, që në rastin e mosparaqitjes së të pandehurit në gjykim, prokurori të kërkojë caktimin e një mase sigurimi nëse i pandehuri nuk ka masë. Ky përfundim mbështetet dhe në praktikën e vazhdueshme gjyqësore.

Në lidhje me marrjen e provave, ato janë siguruar dhe mbledhur gjatë procesit të hetimit. Organi i Prokurorisë i ka mbledhur provat mbi të cilat do të mbështesë procesin e të provuarit të akuzës ndaj të pandehurit. Mënyra e marrjes në shqyrtim të provave në gjykim bëhet me vendim të trupit gjykues që urdhëron marrjen ose jo të provave të kërkuara nga palët, të atyre provave që nga ana e prokurorit janë siguruar gjatë hetimit paraprak dhe një pjesë e rëndësishme e tyre, kryesisht ato shkrësore e materiale, i janë bashkangjitur kërkesës së prokurorit për gjykim, në përputhje me nenin 332 të K.Pr.Penale. Në këtë dispozitë, ndër ato ç'ka i bashkohen kërkesës për gjykim janë dhe aktet për marrjen e masave të sigurimit (neni 332/1-c i K.Pr.P.), që na forcon më shumë bindjen që masa e sigurimit vendoset gjatë hetimeve paraprake.

Në favor të mendimit të mësipërm është edhe interpretimi i nenit 15 të K.Pr.Penale, konkretisht i pikës 2 të tij, ku përcaktohet se: “Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim”. Në një interpretim literal të këtij neni, së pari do rezultonte se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit në të njëjtin procedim, ndërsa në një lexim të dytë integral të tekstit të dispozitës, rezulton nga një deduksion literal që masat e sigurimit vendosen (vetëm) gjatë hetimit paraprak.

I lexuar neni 15 i K.Pr.Penale edhe në kontekstin e nenit 231 të K.Pr.Penale (Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal) dhe nenit 260 të K.Pr.Penale (Revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit), mund të arrihet në një konkluzion logjik që gjatë gjykimit në themel të çështjes, masat e sigurimit vetëm mund të zëvendësohen, bashkohen, revokohen, por nuk mund të vendosen rishtazi (pra për herë të parë) nga i njëjti trup gjykues që gjykon çështjen.

I vetmi rregullim procedural penal që implikon vullnetin dhe veprimtarinë e gjykatës gjatë gjykimit në themel të çështjes (paragrafi 4 i nenit 260 të K.Pr.Penale), me masat e sigurimit, e lejon këtë vetëm në lidhje me “ revokimin ose zëvendësimin”. Në të dy rastet, si në revokim ashtu dhe në zëvendësim, gjykata thjesht vendos në lidhje me një çështje fakti, pa i hyrë arsytimit nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova që tregon se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet, arsytim i domosdoshëm në rastin kur masa e sigurimit vendoset për herë të parë dhe që bëhet nga gjyqtari që shqyrton kërkesën për caktimin e masës së sigurimit në hetimin paraprak. Në zëvendësimin e masës së sigurimit, gjykata thjesht do të marrë dijeni nga prokurori se janë rënduar nevojat e sigurimit, apo nga i pandehuri se janë zbutur nevojat e sigurimit, apo kanë rënë kushtet dhe kriteret e zbatimit të masës, e për këtë shkak do të vendoset nën një regjim të ri, më të ashpër sigurie (në rastin e kërkesës së prokurorit për zëvendësim mase). Kjo vendimmarrje e gjykatës nuk e implikon aspak atë (gjykatën) në sytë e të pandehurit.

Në të kundërt, çfarë do të ndodhte nëse për të pandehurin pa masë sigurimi prokurori do të kërkonte në gjykimin në themel caktimin e një mase sigurimi, në kushtet kur nuk ka asnjë rrethanë të re, akuzë a fakt të ri? Sigurisht që gjyqtari, në momentin që do të shqyrtonte në gjykim kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, do të shqyrtonte kushtet dhe kriteret, sigurisht do analizonte rrethanat e veprës penale, veprimet e mundshme të personit të pandehur, provat, në të cilat do të bazohej kërkesa për masë (që do të ishin provat e sjella në gjykim nga prokurori për të provuar akuzën ndaj të pandehurit), veprime që do të çonin në vënien në dyshim të paanësisë së gjyqtarit apo të trupit gjykues në sytë e të pandehurit. Gjikata automatikisht do të paragjykohej nga i

pandehuri si një gjykatë e njëanshme. Një vendim për caktimin e masës së sigurimit nga i njëjti trup gjykues që gjykon çështjen në themel nuk do të merrej pa krijuar tek gjyqtarët, qoftë edhe minimalisht, bindjen se individi i akuzuar është ai që ka kryer veprën, gjë që bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë, e kështu do të rrëzohej paanësia e tyre objektive dhe vendimi përfundimtar do të ishte i paragjykuar dhe do të konsiderohej si një produkt i një procesi të parregullt ligjor.

Përfundimisht mendojmë se duheshin prishur të dy vendimet dhe të rrëzohej kërkesa e organit të prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit.

Besnik Imeraj

Majlinda Andrea

Gani Dizdari

Fatos Lulo

Andi Çeliku

Guxim Zenelaj

vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Arlind Hyseni në dëm të shtetas Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të K.Penal, në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të K.Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Arlind Hyseni me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar, në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, dënimin përfundimisht të pandehurit Arlind Hyseni me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Arlind Hyseni fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi nga policia gjyqësore.

Deklarimin fajtor të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 141-25 të K.Penal dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetasit Myrteza Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të K.Penal, në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetas Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të K.Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të K.Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Florian Muça me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Florian Muça me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit të të pandehurit Florian Muça fillon nga dita e arrestimit në flagrancë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.65, datë 01.02.2006, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.641, datë 02.06.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate, por me tjetër trup gjykues.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.612, datë 03.10.2007, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.65, datë 01.02.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Tiranë, pas rigjykimit të çështjes, me vendimin nr.312, datë 16.05.2008, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.641, datë 02.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër vendimit nr.312, datë 16.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs i gjykuari Florian Muça, nëpërmjet mbrojtësve të tij Ferdinand Doja dhe Klotilda Dashi, të cilët kërkojnë:

Prishjen e vendimit nr.312, datë 16.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

Shkaqet që paraqet në rekurs i gjykuari Florian Muça për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit janë:

- Gjykata e shkallës së parë me të drejtë bëri ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për sa u përket pasojave të ardhura tek të dëmtuarit Myrteza dhe Hatixhe Sade, por ajo përsëri gaboi, sepse mendimi kriminal është një, pasi nga ana subjektive të pandehurit janë marrë vesh që të vidhnin këtë banesë.
- Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen kërkon se kur gjatë kryerjes së vjedhjes, edhe kur nga dhuna e ushtruar kanë ardhur si pasojë vdekja e një ose më shumë personave, apo vdekja e një personi dhe dëmtimi i të tjerëve, përsëri do të kishim vetëm një akuzë, atë të parashikuar nga neni 141 i K.Penal.
- Gjykata në rastin konkret mund të kishte ngritur akuzën e vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade dhe plagosjes së dy personave të tjerë.
- Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë gabuar, pasi vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 141 i K.Penal nuk është konsumuar plotësisht, por ajo ka mbetur në fazën e tentativës, e parashikuar nga neni 141-22 të K.Penal.
- Ndërmjet autorëve të veprës penale ka ekzistuar marrëveshja për të kryer vjedhje me anë të dhunës, por nuk ka ekzistuar marrëveshja që ato të kryenin vjedhje me pasojë vdekjen, prandaj është e qartë se ndodhemi përpara eksedit të ekzekutorit.
- Ne kemi mbajtur qëndrim pohues që në fillim të procedimit penal, pasi kemi shpjeguar gjithçka mbi mekanizmin e ngjarjes, duke treguar pendesë, prandaj gjykatat duhet ta kishin parasysh këtë fakt dhe të bënin diferencimin në caktimin e masave të dënimit për dy të pandehurit, pasi nuk mund të barazohet një i pandehur që i fshihet drejtësisë me një tjetër që ka treguar pendesë të thellë.

Kundër vendimit nr.312, datë 16.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs i gjykuari Arlind Hyseni nëpërmjet mbrojtësit të tij Laert Rexho, i cili kërkon:

Prishjen e vendimit nr.312, datë 16.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i caktuar të gjykuarit një masë më të butë dënimi.

Shkaqet që paraqet në rekurs i gjykuari Arlind Hyseni për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit janë:

- Ne kemi pasur si qëllim vjedhjen e banesës së shtetasit Myrteza Sade dhe jo dëmtimin e familjarëve që jetonin në atë banesë.
- Vepra penale pavarësisht nga vullneti i të gjykuarve nuk është kryer, por ka mbetur në fazën e tentativës, prandaj këtë fakt duhet ta merrnin parasysh prokuroria në ndërtimin e akuzës dhe gjykata në dhënien e vendimit.

- Nga i gjykuari është kërkuar gjykim i shkurtuar dhe megjithëse gjykata ka zbatuar nenin 406 të K.Pr.Penale, ajo ka dhënë një dënim në maksimumin e tij, ç'ka nuk i përgjigjet rrethanave lehtësuese që kanë qenë prezent.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 23.06.2010, ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 141 të Kodit Penal.

Kolegji Penal shtron për zgjidhje përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë çështjet e mëposhtme:

- 1- Në rastin e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekje, të parashikuar nga neni 141 i K.Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit, por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, vepra penale do të konsiderohet e konsumuar apo e mbetur në tentativë?
- 2- Në rastet e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekje, të parashikuar nga neni 141 i K.Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, a kemi konkurrim me nenin 141 të K.Penal të veprave të tjera si vjedhje me dhunë, vjedhje me armë, plagosje e rëndë, plagosje e lehtë?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Andi Çeliku dhe Majlinda Andrea; prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Artur Selmani, që kërkoj ndryshimin e vendimit nr.312, datë 16.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me kualifikimin e veprave penale si më poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vrasjes me dashje në dëm të shtetasit Genci Sade, parashikuar nga neni 79/ë të Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me armë të kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Myrteza Sade dhe, në bazë të neneve 141-22-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të plagosjes rëndë me dashje në dëm të shtetasit Myrteza Sade dhe, në bazë të nenit 88/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 6 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me armë e mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Hatixhe Sade dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të Kodit Penal dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Në bashkim të këtyre dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me një dënim të vetëm, me burgim të përjetshëm.

Me aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e tij me 25 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Genci Sade dhe, në bazë të nenit 141.22-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me armë e mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit Myrteza Sade dhe, në bazë të nenit 140-22-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me armë të kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë në dëm të shtetases Hatixhe Sade, parashikuar nga neni 140-22-25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 4 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit me burgim të përjetshëm.

Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Proçedurës Penale dënimin e të pandehurit Florian Muça me 25 vjet burgim.

Dëgjuan mbrojtësin e të gjykuarit Florian Muça, Av. Ferdinand Doja, i cili, në bazë të nenit 441/b të K.Pr.Penale, kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale dhe masës së dënimit me të cilën është dënuar i gjykuari Florian Muça; në përfundim,

V Ë R E J N Ë

Në Gjykatën e Lartë me datë 24.06.2008 është regjistruar çështja penale nr.53109-00526-00-2008 regj. them., që u përket të gjykuarve Arlind Hyseni dhe Florian Muça, të akuzuar për veprat penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, vjedhjes me dhunë e kryer në bashkëpunim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 141-25, 139-25 dhe 278/4 të Kodit Penal.

Vendimi nr.312, datë 16.05.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr.641, datë 02.06.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë në zbatim të keq të ligjit material penal, prandaj vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen, për sa i përket cilësimit juridik të veprave penale të kryera nga të gjykuarit.

Nga gjykimi i çështjes në gjykatat e të gjitha shkallëve, deri në këtë fazë të gjykimit rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Të gjykuarit Arlind Hyseni dhe Florian Muça janë banorë të qytetit të Tiranës dhe kanë pasur njohje të mëparshme me njëri-tjetrin.

Me datë 12.07.2004 rreth orës 01.45 të gjykuarit, pasi janë marrë vesh më parë me njëri-tjetrin, kanë shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit Myrteza Sade dhe pasi kanë vënë në kokë kapuçat kanë kapërcyer murin rrethues dhe janë futur në oborrin e banesës private të të dëmtuarit, e cila ndodhet në Rrugën “Besa” në Tiranë.

I gjykuari Florian mbante në dorë një thes ku kishte futur automatikun e tij, një copë litar, një thikë dhe një ngjitëse, të cilat ia kishte dhënë më parë i gjykuari Arlind, ndërsa ky i fundit ishte i armatosur me një pistoletë.

Pasi kanë lënë thesin në oborr të gjykuarit, të armatosur i janë drejtuar njëri pas tjetrit hyrjes së banesës dhe i gjykuari Arlind, pasi ka hapur derën ka hyrë në dhomën e gjumit të të dëmtuarve, ndërsa i gjykuari Florian me automatik në dorë ka qëndruar në korridor ku po flinte viktima Genci Sade.

Në momentin kur i gjykuari Arlind ka hyrë në dhomën ku flinin të dëmtuarit Myrteza dhe Hatixhe Sade, i gjykuari Florian ka dëgjuar të bërtiturat e një gruaje prej të cilave është zgjuar viktima Genci Sade, i cili ka kapur automatikun që mbante në dorë i gjykuari Florian.

Në kohën që i gjykuari Arlind ka dalë nga dhoma e gjumit të çiftit Sade, duke u përleshur me to, i gjykuari Florian ka mbushur automatikun dhe ka qëlluar, sepse viktima Genci Sade nuk po ia lëshonte armën.

Më pas i gjykuari Florian ka dëgjuar të shtëna pistolete pranë vendit ku ishte parkuar makina e pronarëve dhe më pas ka parë viktimën Genci Sade që është rrëzuar përtokë.

Pasi kanë kapërcyer murin rrethues të banesës të gjykuarit kanë dalë në rrugë dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të bregut të lumit ku kanë hedhur armët dhe kanë djegur rrobat në mënyrë që të fshihnin gjurmët e krimit.

Gjatë rrugës i gjykuari Arlind i ka treguar bashkëpunëtorit tjetër se personat me të cilët ishte përlëshur i kishin hequr maskën, prandaj ai kishte qëlluar dhe në oborrin e shtëpisë i kishte mbetur njëra atlete, ndërsa i gjykuari Florian i ka treguar të gjykuarit tjetër se thesin që kishte me materiale e kishte lënë në oborrin e banesës.

Të nesërmen i gjykuari Florian ka shkuar në Elbasan tek shtëpia e xhaxhait të tij ku edhe është arrestuar, ndërsa i gjykuari Arlind që nga ajo ditë i fshihet drejtësisë.

Pas kryerjes së veprimeve të para hetimore ka rezultuar se nga kjo ngjarje e rëndë ka mbetur i vdekur viktima Genci Sade, është plagosur rëndë i dëmtuari Myrteza Sade dhe është e plagosur lehtë e dëmtuara Hatixhe Sade, prandaj organi i akuzës i ka dërguar në gjyq të gjykuarit, duke i akuzuar ata për veprat penale të vjedhjes me pasojë vdekjen të kryer në bashkëpunim, vjedhjes me dhunë të kryer në bashkëpunim dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parachikuara nga nenet 141-25, 139-25 dhe 278/4 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.641, datë 02.06.2005 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë në nenit 141-25 të K.Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Arlind Hyseni në dëm të shtetasit Myrteza Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parachikuar nga neni 139-25 i K.Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Arlind Hyseni në dëm të shtetasës Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parachikuar nga neni 139-25 të K.Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të K.Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Arlind Hyseni me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, dënimin përfundimisht të pandehurit Arlind Hyseni me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Arlind Hyseni fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi nga policia gjyqësore.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë në nenit 141-25 të K.Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetasit Myrteza Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parachikuar nga neni 139-25 të K.Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetasës Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parachikuar nga neni 139-25 të K.Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të K.Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të K.Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Florian Muça me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Florian Muça me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit të të pandehurit Florian Muça fillon nga dita e arrestimit në flagrancë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.65, datë 01.02.2006, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.641, datë 02.06.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate, por me tjetër trup gjykues.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.612, datë 03.10.2007, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.65, datë 01.02.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Tiranë pas rigjykimit të çështjes me vendimin nr.312, datë 16.05.2008 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.641, datë 02.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga të gjykuarit Florian Muça dhe Arlind Hyseni, me vendimin e datës 23.06.2010 ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 141 të Kodit Penal.

Kolegji Penal shtron për zgjidhje përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë çështjet e mëposhtme:

Në rastin e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekjen të parashikuar nga neni 141 i K.P., kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, vepra penale do të konsiderohet e konsumuar apo e mbetur në tentativë?

Në rastet e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekjen të parashikuar nga neni 141 i K.P., kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, a kemi konkurrin me nenin 141 të K.P. të veprave të tjera vjedhje me dhunë, vjedhje me armë, plagosje e rëndë, plagosje e lehtë?

.....
Për sa i përket Unifikimit të Praktikës Gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bëjnë këtë analizë juridike:

Në nenin 141 të Kodit Penal përcaktohet se:

Vjedhja e pasurisë, kur është e shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet, ose me burgim të përjetshëm.

Nga citimi i kësaj dispozite ligjore del qartë se Kodi Penal me anë të saj mbron në mënyrë të posaçme dy marrëdhënie të rëndësishme shoqërore, të cilat janë pasuria dhe jeta e personit, por duhet theksuar se objekti kryesor në këtë rast është pasuria, ndërsa jeta e personit është objekti dytësor, i cili është element thelbësor i veprës penale kryesore.

Kjo do të thotë se po nuk u cënua jeta e personit (po nuk erdhi vdekja e tij), atëherë nuk mund të ekzistojnë elementët e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 141 i K.Penal, por mund të jemi përpara kryerjes së një vepre tjetër penale, siç mund të jenë vjedhja me dhunë ose vjedhja me armë, të parashikuara nga nenet 134, 139 dhe 140 të K.Penal.

Në Kodin Penal të vitit 1977, vepra penale objekt gjykimi ka qenë e përfshirë në veprën penale të grabitjes, e parashikuar nga neni 102 i tij, ku përfshiheshin edhe veprat penale të vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i K.Penal dhe vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i K.Penal.

Neni 102 i Kodit Penal të vitit 1977 përbëhej vetëm nga një paragraf, ku hynin përdorimi i dhunës fizike deri në vdekjen e personit, dhuna psikike dhe përdorimi i armëve, që do të thoshte se gjykata pasojën e rëndë do ta merrte vetëm si rrethanë që rëndonte masën e dënimit, e cila i caktohej subjektit të veprës penale, pasi vetë kjo dispozitë ligjore nuk e parashikonte kryerjen e veprës penale në rrethana të cilësuar.

Në Kodin Penal të vitit 1995 dhe në ndryshimet e mëpasme që i janë bërë atij, ligjvënësi e ndau veprën penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 102 i K.Penal (të shfuqizuar) në tre vepra penale më vete, të cilat janë: vepra penale e vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i K.Penal, vepra penale e vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i K.Penal dhe vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal.

Në veprën penale të vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i K.Penal përfshihen vjedhjet e pasurisë të shoqëruara me dhunë psikike dhe fizike (dëmtime që fillojnë nga më të lehtat e deri në më të rëndat, duke përfshirë vdekjen), në veprën penale të vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i K.Penal përfshihen vjedhjet e pasurisë të shoqëruara me përdorimin e armës me ose pa leje dhe në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, përfshihen vjedhjet e pasurisë kur si rezultat i veprimeve të kundraligjshme të subjektit të veprës penale ka ardhur si pasojë vdekja e personit.

Qëllimi kryesor i ligjvënësit në shpërbërjen e veprës penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 102 i K.Penal (të shfuqizuar), ka qenë fakti që kjo dispozitë ligjore nuk parashikonte rastet kur vepra penale kryhej në rrethana të cilësuar dhe kishte një ndryshim shumë të madh ndërmjet minimumit dhe maksimumit të masës së dënimit, ç'ka në disa raste ka lejuar qëndrime jo të drejta në caktimin e masave të dënimeve.

Doktrina jonë juridike dhe praktika gjyqësore shumëvjeçare kanë mbajtur qëndrimin e konsoliduar se grabitja, e parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal (të shfuqizuar), quhet krim i kryer nga çasti i kryerjes së sulmit, pavarësisht nëse autori i krimit ka arritur ose jo të hedhë në dorë pasurinë. Kjo shpjegohet nga fakti se ligjvënësi për shkak të rrezikshmërisë së theksuar të veprës penale i jepte rëndësi vendimtare jo kalimit të pasurisë, por sulmit për të vënë në dorë pasurinë. Nuk kishte rëndësi nëse dhuna përdorej para hedhjes në dorë të pasurisë ose gjatë përpjekjeve për t'u larguar të subjektit të veprës penale.

Aktualisht ka qëndrime të ndryshme në praktikë në lidhje me faktin se nëse vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, mbetet ose jo në fazën e tentativës, kur subjekti i veprës penale megjithë veprimet e kryera prej tij për ta realizuar veprën penale nuk ka arritur për shkaqe që nuk varehin prej tij për të shtënë në dorë pasurinë, por si pasojë e veprimeve të kundraligjshme të tij ka ardhur pasoja e rëndë, që është vdekja e personit, i cili ishte vënë në mbrojtje të pasurisë.

Për të krijuar një tablo më të qartë se çfarë përfaqëson në vetvete vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, është e domosdoshme që t'i referohemi doktrinës juridike në vite, e cila e ka përkufizuar atë si një vepër penale të përbërë nga dy vepra penale, që janë vepra penale e vjedhjes dhe vepra penale e vrasjes së personit, të cilat në kushtet e zakonshme qëndrojnë si vepra penale më vete, e para e parashikuar nga neni 134 e vijues i K.Penal dhe tjetra e parashikuar nga neni 76 e vijues i K.Penal.

Megjithëse në Kodin Penal veprat penale të vjedhjes dhe të vrasjes së personit parashikohen si vepra penale më vete, në rastin e nenit 141 të K.Penal vepra penale e vrasjes së personit është element thelbësor i veprës penale të vjedhjes, e cila kurrsesi nuk mund të kryhet nëse nuk vjen pasoja shumë e rëndë, që është vdekja e personit.

Figura e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal përbëhet nga dy vepra penale materiale, për të cilat është e detyrueshme ardhja e pasojës kur ato qëndrojnë si vepra penale më vete, në mënyrë që ato të quhen të konsumuara plotësisht, ndërsa në

rastin kur ato janë të lidhura me njëra tjetrën sipas nenit 141 të K.Penal dhe kur nga kryerja e veprës penale, e cila është element thelbësor i veprës tjetër penale pasoja e rëndë vjen detyrimisht, atëherë nuk mund të thuhet që vepra penale kryesore ka mbetur në fazën e tentativës, në një kohë kur personi që po mbronte pasurinë nuk jeton më, pasi kjo logjikë juridike nuk do të funksiononte.

Në ndryshim nga vepra penale e vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i K.Penal dhe vepra penale e vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i K.Penal tek të cilat vepra penale që i përket objektit dytësor mund të jetë një vepër penale formale, e cila nuk kërkon ardhjen e pasojës, siç janë mbajtja e armës ose dhuna psikike, vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen e kërkon detyrimisht ardhjen e pasojës së rëndë për veprën penale që shërben si element thelbësor për veprën tjetër penale, që do të thotë se po nuk erdhi vdekja e personit, vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen nuk do të kryhej dhe nuk kishte asnjë arsye që ajo të parashikohej si vepër penale në pjesën e posaçme të Kodit Penal, prandaj pasoja e rëndë e veprës penale që i përket objektit dytësor është pasojë e rëndë edhe për veprën penale që i përket objektit kryesor dhe rrjedhimisht vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen është e konsumuar plotësisht që në momentin që ka ardhur pasoja e rëndë vdekja e personit, pavarësisht nëse subjekti i veprës penale e ka shtënë ose jo në dorë pasurinë.

Nga leximi i nenit 141 të K.Penal del mjaft e qartë se vetë kjo dispozitë ligjore e konsideron këtë vepër penale automatikisht të konsumuar, sepse përdor shprehjen.....*shoqëruar me dhunime që kanë sjellë si pasojë vdekjen e personit.....*, ndryshe nga vepra penale kryesore e vjedhjes së pasurisë (kur është më vete), parashikuar nga neni 134 i K.Penal, në të cilën përdoret shprehja se: *vjedhja e pasurisë dënohet.....*, gjykata vlerëson se kjo e fundit mund të mbetet në fazën e tentativës, pasi ligji nuk kërkon medoemos ardhjen e pasojës.

Pavarësisht vendosjes së veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal në Kreun e III të Kodit Penal ku parashikohen veprat penale kundër pasurisë dhe sferës ekonomike, ligjvënësi i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe mbrojtjes dhe paprekshmërisë së jetës së personit, pavarësisht se kjo pasojë në këtë rast vjen si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale dytësore, e cila shërben si element thelbësor për veprën penale kryesore.

Një çështje tjetër që ka qenë objekt diskutimi në Kolegjet e Bashkuara ka qenë fakti nëse vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal konkurron me veprat penale të vjedhjes me dhunë, vjedhjes me armë, plagosjes së rëndë dhe plagosjes së lehtë, të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 e 89 të K.Penal.

Teoria e së drejtës penale dhe praktika jonë gjyqësore në vite kanë konsoliduar qëndrimin se veprat penale konkurrojnë me njëra-tjetrën, atëherë kur ato qëndrojnë si vepra penale më vete, por nëse njëra prej tyre shërben si element thelbësor për veprën tjetër penale, atëherë nuk kemi konkurrim të tyre.

Vepra penale e vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i K.Penal dhe vepra penale e vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i K.Penal kur kryhen për shtënien në dorë të së njëjtës pasuri në asnjë rrethanë nuk mund të konkurrojnë me veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, sepse edhe kjo e fundit është një formë e cilësuar e dy të parave, pasi edhe në këtë rast nga ana objektive vepra penale kryhet me dhunë, e cila është ekstreme dhe përfundon me vdekjen e personit.

Gjithashtu gjatë kryerjes së veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal subjekti i veprës penale nga ana objektive mund ta përdori armën, ashtu si dhe nga kryerja e veprës penale të vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i K.Penal mund të vijë pasoja e rëndë (dëmtimet fizike, deri tek plagosja e rëndë), por ajo që i dallon këto dy vepra penale nga njëra-tjetra është fakti se tek vjedhja me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, domosdoshmërisht duhet të kemi një ose më shumë viktime, prandaj nëse konstatohet ardhja e kësaj pasoje, atëherë pavarësisht se gjatë vjedhjes mund të përdoret arma, ose mund të

ketë dhunë psiqike edhe dëmtime në formën e lezioneve, nuk do të kemi konkurrin të veprave penale, pasi dy veprat penale më të lehta nuk mund të qëndrojnë si vepra penale më vete, por i thith vepra penale më e rëndë, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal.

Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal nuk konkurren as me plagosjen e rëndë, ose të lehtë, të parashikuara nga nenet 88 dhe 89 të K.Penal, kur këto dëmtime kryhen në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri, ose të largimit të pengesave që nuk e lejojnë subjektin e veprës penale që të largohet menjëherë nga vendngjarja.

Nëse subjekti i veprës penale ka kryer një plagosje të rëndë apo të lehtë para ose pas kryerjes së veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, por që nuk kanë lidhje me këtë të fundit, atëherë veprat penale e plagosjes së rëndë ose të lehtë qëndrojnë si vepra penale më vete dhe për rrjedhojë do të ishim para institutit të konkurrimit të veprave penale.

Duhet të kemi parasysh se në këtë rast dallimin e bën ana subjektive si një nga elementët e veprës penale, që do të thotë se nëse subjekti i veprës penale e bën plagosjen e rëndë ose të lehtë të personit në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri, ose të mbrojtjes së saj menjëherë pas vjedhjes, atëherë nuk do të jemi përpara konkurrimit të veprave penale, pasi dhuna e bërë në këtë rast është një pasojë, e cila përfshihet në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, ku krahas vdekjes së një personi mund të kemi si pasojë edhe dëmtimin e personave të tjerë.

Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, kur është rrjedhojë e një mendimi unik kriminal, i cili ka si qëllim vjedhjen e të njëjtës pasurie duhet të cilësohet vetëm një herë sipas nenit 141 të K.Penal, pavarësisht nga numri i pasojave të rënda që kanë ardhur, siç mund të jenë vdekja e dy ose më shumë personave, vdekja e një personi dhe plagosja e një ose më shumë të tjerëve dhe faktin që ka pasur më tepër se një pasojë të rëndë gjykata duhet ta mbajë parasysh në caktimin e masës së dënimit.

Në mendimin e tij, të dhënë përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, prokurori kërkoi që gjykuari Arlind Hyseni të deklarohet fajtor e dënohet për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese, e parashikuar nga neni 79/ë i K.Penal, ndërsa i gjykuari tjetër të deklarohet fajtor e dënohet për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 141-22-25 i K.Penal, për sa i përket viktimës Genci Sade, në një kohë që nga gjykimet ka rezultuar e provuar se ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë qenë ekzekutorë të veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e parashikuar nga neni 141-25 i K.Penal.

Megjithëse mendimi i prokurorit nuk referon në ndonjë dispozitë ligjore konkrete, të parashikuar nga legjislacioni ynë procedural dhe material penal, kërkesa e tij është në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës, pasi ai i referohet një legjislacioni dhe praktike të huaj gjyqësore, të cilat nuk janë pjesë e të drejtës tonë penale, prandaj, sipas dispozitës kushtetuese që përmendëm më lart, ato nuk mund të gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Nëse shihet me kujdes mendimi i prokurorit del qartë se, duke i copëtuar akuzat sipas pasojave të ardhura në të vërtetë ai nuk kërkon një cilësim të ndryshëm ligjor të veprave penale, por ngre akuza të reja në ngarkim të të gjykuarve, gjë e cila nuk mund të bëhet në këtë fazë të gjykimit, pasi ndryshimi i cilësimit juridik të veprave penale duhet t'i nënshtrohet rigorozisht përcaktimeve të bëra nga neni 375 i K.Pr.Penale.

Duke arsyetuar si më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në këto përfundime unifikuese:

❖ *Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit, por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, do të konsiderohet plotësisht e konsumuar që nga çasti që ka ardhur si pasojë vdekja e personit, të cilit i përkiste pasuria ose ishte vënë në mbrojtje të saj, pavarësisht nga shtënia në dorë ose jo e kësaj pasurie nga subjekti i veprës penale.*

❖ *Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, nuk konkurron me veprat penale të vjedhjes me dhunë, vjedhjes me armë, plagosjes së rëndë dhe plagosjes së lehtë, të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 dhe 89 të K.Penal, gjithmonë kur bëhet fjalë që këto të fundit janë kryer në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri.*

.....
Përsa i përket zgjidhjes së çështjes konkrete Kolegjet e Bashkuara bëjnë këtë analizë juridike:

Në rekurs i gjykuari Florian Muça pretendon se megjithëse gjykata e shkallës së parë bëri ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, për sa u përket të dëmtuarve Myrteza dhe Hatixhe Sade, përsëri ajo gaboi, sepse veprimet e të gjykuarve janë rrjedhojë e një mendimi unik kriminal, prandaj cilësimi juridik i veprës penale duhej të bëhej vetëm një herë sipas nenit 141-25 të K.Penal, pretendim i cili vlerësohet si i bazuar në ligj, pasi të gjykuarit Arlind Hyseni dhe Florian Muça në marrëveshje të mëparshme me njëri-tjetrin kanë vendosur që me çdo mjet të vjedhin banesën e shtetasit Myrteza Sade, por meqenëse ata hasën në kundërshtimin e fortë të tre anëtarëve të familjes, për t'i shpëtuar përgjegjësisë penale vranë viktimën Genci Sade dhe plagosën të dëmtuarit Myrteza e Hatixhe Sade.

Veprimet e të gjykuarve ashtu siç pretendon edhe mbrojtja e të gjykuarit Florian janë rrjedhojë e një mendimi unik kriminal, prandaj vepra penale nuk duhet të cilësohet sipas pasojave të ardhura, por ajo duhet të cilësohet vetëm një herë si vepër penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 141-25 i K.Penal.

Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 141-25 të K.Penal është e konsumuar plotësisht, sepse është e provuar se nga veprimet e paligjshme të të gjykuarve ka ardhur pasoja e rëndë e vdekjes së shtetasit Genci Sade dhe për rrjedhojë nuk ka vend që të pranohet kërkesa e të gjykuarve për cilësimin e kësaj vepre penale, si vepër penale e mbetur në fazën e tentativës.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se edhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, për të cilën akuzohen dy të gjykuarit, ka vend për ndryshimin e cilësimit juridik, në përputhje me nenin 375 të K.Pr.Penale, pasi kjo vepër penale nuk është kryer në sasira të mëdha dhe në bashkëpunim nga të gjykuarit, pasi ato kanë qenë të armatosur me armë personale pa leje, përpara se të shkonin në vendngjarje. Gjithashtu nuk është e provuar se të gjykuarit e kanë kryer më shumë se një herë këtë vepër penale dhe pasoja e rëndë që parashikon neni 278/4 i K.Penal nuk ka kuptimin e një vrasje, apo dëmtimeve të tjera, por ajo ka kuptimin e pasojave të rënda që mund të vijnë si rezultat i shpërthimeve, ose i burimit të rrezikut të shtuar, prandaj vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, e kryer nga të gjykuarit duhet të cilësohet sipas nenit 278/2 të K.Penal.

Duhet theksuar se vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, e parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal, konkurron me veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, pasi në këtë të fundit vrasja e personit mund të bëhet edhe me mjete të tjera si litar të cilin të gjykuarit e kishin marrë me vete, sende të forta, etj., prandaj vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake nuk është element thelbësor i veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 141 i K.Penal (Shih Vendimin Unifikues nr.01, datë 03.02.2006 të Kolegjeve të Bashkuara).

Pretendimet e tjera të ngritura në rekurs nga të gjykuarit janë të pabazuara në ligj, sepse nuk mund të jemi përpara ekselit të ekzekutorit siç pretendon i gjykuari Florian Muça, sepse ky i fundit në çdo vend ka qenë bashkë me të gjykuarin tjetër, ka qenë i armatosur më rëndë se ai, ka qëlluar mbi të dëmtuarit, pasi në vendngjarje janë sekuestruar gëzhhojat e dy armëve të ndryshme, ka shkuar bashkë me bashkëpunëtorin tjetër për të fshehur armët, etj. Eksesi i ekzekutorit kërkon

që bashkëpunëtorët të mos jenë marrë vesh për atë që kryen njëri prej tyre dhe ai që pretendon eksesein nuk duhet të ketë marrë pjesë në kryerjen e atij veprimi të kundërligjshëm.

Masat e dënimit të të gjykuarve janë caktuar nga gjykata në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 47 të K.Penal, duke u pasur parasysh rrethanat e parashikuara nga nenet 48, 49 dhe 50 të K.Penal, sepse duhet theksuar se në ngarkim të të gjykuarve ka rrethana rënduese të parashikuara nga gërmat **gj** dhe **i** të nenit 50 të K.Penal, prandaj pretendimi i të gjykuarit Florian për të pasur diferencime në masën e dënimit me të gjykuarin tjetër në mungesë është i pabazuar në ligj, pasi ai ashtu si dhe bashkëpunëtori i tij kanë pasur të njëjtin rol në kryerjen e veprës penale atë të ekzekutorit, ç'ka tregon që ai është një person me rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit dhe përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e të gjykuarve Arlind Hyseni dhe Florian Muça janë pjesërisht të bazuara në ligj, prandaj vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen, vetëm për sa i përket cilësimit juridik të veprave penale.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 438 dhe 441/b të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Ndyshimin e vendimit nr.312, datë 16.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.641, datë 02.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë të nenit 141 e 25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Arlind Hyseni me burgim të përjetshëm.

Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Arlind Hyseni me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë të nenit 141 e 25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Florian Muça me burgim të përjetshëm.

Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Florian Muça me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga dita e arrestimit të tij në flagrancë, me datë 13.07.2004.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 30.09.2011

MENDIM I PAKICËS

Për vendimin nr.6, datë 30.09.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ne gjyqtarët Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Majlinda Andrea, Fatos Lulo, Mirela Fana nuk jemi dakord me vendimin e marrë nga shumica, e cila ka ndryshuar vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, duke deklaruar fajtorë dhe dënuar të gjykuarit për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen.

Ndryshe nga vendimi i shumicës, me të cilin është vendosur ndryshimi i dy vendimeve të gjykatave të faktit, duke i deklaruar fajtorë dhe dënuar të gjykuarit për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 141 e 25 i K.Penal, jemi të mendimit se si vendimi nr.312, datë 16.05.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë edhe vendimi nr.461, datë 02.06.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duheshin prishur në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, duke i deklaruar fajtorë të gjykuarit për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, në lidhje me vdekjen e shtetasit Genci Sade; ndërsa në lidhje me plagosjen me armë zjarri në vendngjarje të shtetasve Myrteza e Hatixhe Sade, të gjykuarit duhet të deklaroheshin fajtorë për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 140 e 25 të K.Penal.

Duke mos dashur të përsërisim me detaje rrethanat e çështjes, të cilat janë trajtuar në vendimin e shumicës, do të argumentojmë më poshtë qëndrimin tonë kundër, mbështetur në dispozitat ligjore.

Shumica pasi ka parashtruar sintetikisht faktet e administruara nga gjykatat e dy niveleve, ka arritur në përfundimin se vendimet duheshin ndryshuar në lidhje me cilësimin juridik të veprës.

Ka rezultuar e provuar se të gjykuarit Arlind Hyseni e Florian Muça, të pajisur edhe me armë zjarri, litar, kapuçë për maskim, thikë e letër ngjitëse, kanë bërë plan dhe kanë shkuar për të vjedhur në banesën e shtetasit Myrteza Muça, me qëllim për të vjedhur. I pandehuri Arlind ka hyrë në dhomën ku flinin çifti Myrteza e Hatixhe Sade (prindërit e viktimës Genci Sade). Gjatë përleshjes me çiftin, që është zgjuar, është zgjuar edhe djali i tyre Genci, i cili ka dashur t'i marrë armën të pandehurit Florian Muça, por ky i fundit ka mbushur automatikun dhe ka qëlluar e më pas kur ka nisur të largohet ka dëgjuar krisma pistolete dhe ka parë viktimën Genci që është rrëzuar në tokë. Për shkak të rrjedhës së mësipërme të ngjarjes, të pandehurit janë larguar, pasi kanë kapërcyer murin rrethues të shtëpisë dhe kanë dhe gjatë bregut të lumit kanë hedhur armët dhe kanë djegur rrobat, duke mos mundur të realizojnë këtë vjedhje. Gjatë tentativës për kryerjen e vjedhjes, nga ana e të gjykuarit Arben Nika është vrarë me armë zjarri i ndjeri Genci Sade dhe është plagosur rëndë shtetasi Myrteza Sade dhe plagosur lehtë shtetësja Hatixhe Sade.

Duke arsyetuar se të gjykuarit kanë konsumuar veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen për viktimën Genci Sade, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka konkluduar se ajo është konsumuar, ndërsa ajo (vepra) ka mbetur në tentativë përse i përket të dëmtuarve Myrteza e Hatixhe Sade. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi me të njëjtin arsyetim nga gjykata e apelit.

Ne gjyqtarët në pakicë, ndryshe nga vendimi i shumicës, mendojmë se cilësimi ligjor i veprës penale në ngarkim të të gjykuarve, lidhur me vrasjen e shtetasit Genci Sade gjatë tentativës për vjedhjen e banesës së familjes Sade, duhet të kualifikohej si e mbetur në tentativë.

Edhe pakica është dakord me qëndrimin se, me anë të dispozitës së nenit 141 të K.Penal, mbrohen dy marrëdhënie të rëndësishme shoqërore, siç janë pasuria dhe jeta e personit, duke mbajtur parasysh se objekti kryesor në këtë rast është pasuria, ndërsa jeta e personit është objekti dytësor, por pakica nuk ka të njëjtin qëndrim me shumicën se objekti i dytë i kësaj vepre penale është dhe elementi thelbësor i saj. Në Kodin Penal të vitit 1995 nuk është parashikuar si vepër

penale ajo e grabitjes, por ekzistojnë tre vepra penale të ndryshme, parashikuar nga nenet 139, 140, 141, të cilat kanë për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e pasurisë së personit fizik, personit juridik dhe shtetit dhe jetën e personit, por ne pakica nuk jemi të të njëjtit mendim se pasoja në veprën penale të vjedhjes me dhunë e bën këtë vepër të cilësuar.

Vepra penale e parashikuar nga neni 141 i K.Penal bën pjesë në seksionin e parë të titulluar “vjedhja e pasurisë” të Kreut të III të K.Penal, kre në të cilin janë përfshirë veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën e ekonomisë. Objekti kryesor i kategorisë së veprave penale që përfshihen në këtë seksion janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e pasurisë së personit, e mbrojtur kjo posaçërisht nga legjislacioni penal, por në disa prej këtyre veprave, marrëdhëniet juridike që preken janë më shumë se një. Kështu, në rastin e dispozitës së nenit 141 të K.Penale, veç marrëdhënieve të vendosura për mbrojtjen e pasurisë së personit, autori prek direkt edhe ato marrëdhënie juridike të vendosura për të siguruar të drejtën e një personi për të jetuar, e sanksionuar kjo nga neni 21 i Kushtetutës. Edhe pse prekja e këtij objekti nga vepra penale paraqet rrezikshmëri shumë më të madhe shoqërore se ai që mbron paprekshmërinë e pronës.

Pakica çmon se vepra do të cilësohet e kryer atëherë kur autori ka cënuar të dyja marrëdhëniet juridike që mbron kjo dispozitë. Nuk mund të cilësohet vjedhja e pasurisë së tjetrit e kryer kur provohet se autori nuk ka mundur të realizojë deri në fund qëllimin e tij, pra pakësimin e pasurisë së tjetrit. Në rrethana të tilla, ndërkohë që vjedhja e pasurisë ka mbetur në fazën e tentativës, pasoja tjetër që kërkon dispozita e nenit 141 të K.Penal është konsumuar, pra është vërtetuar vdekja e viktimës Genci Sade. Fakti që me veprimet e tyre të gjykuarit Arlind Hyseni e Florian Muça nuk kanë mundur të realizojë vjedhjen, vepra penale për të cilën ata duhet të deklarohen fajtorë, ka mbetur në fazën e tentativës.

Neni 22 i K.Penal parashikon se: “vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmer veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij”. Në kuptim të kësaj dispozite, të gjykuarit për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre, megjithëse kanë ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për të vjedhur banesën e familjes Sade, nuk kanë mundur të realizojnë qëllimin, duke mos mundur të vjedhin, për shkak se nuk u lejuan prej viktimave. Është e vërtetë se gjatë tentativës për të realizuar vjedhjen të gjykuarit, për të shmangur pengesat, kanë vrarë një person (të ndjerin Genci Sade), por ky fakt nuk mund ta cilësojë vjedhjen si të kryer, ndërkohë që provohet të mos ketë pasur pakësim të pasurisë.

Gjithashtu ne gjyqtarët në pakicë, kemi mendim të kundërt me shumicën edhe përsa i përket konkluzionit lidhur me çështjen e dytë shtruar për zgjidhje në Kolegjet e Bashkuara, lidhur me konkurrimin e veprave penale të parashikuar nga neni 141, me veprat penale të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 dhe 89 të K.Penal, për të cilën Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në konkluzionin unifikues se: “Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, nuk konkurren me veprat penale të vjedhjes me dhunë, vjedhjes me armë, plagosjes së rëndë, plagosjes së lehtë, të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 dhe 89 të K.Penal, gjithmonë kur bëhet fjalë që këto të fundit janë kryer në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri”.

Ndryshe nga shumica, ne gjyqtarët në pakicë kemi mendimin se vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, konkurren me veprat penale të vjedhjes me dhunë dhe vjedhjes me armë, në rastin kur gjatë përpjekjes për vjedhjen e pasurisë, krahas pasojës së vdekjes së një personi, vijnë edhe pasoja të tjera, pra dëmtime të një apo disa personave të tjerë.

Edhe pse ashtu siç ka pranuar shumica ardhja e pasojave të tjera gjatë tentativës për vjedhjen e pasurisë janë pasoja të ardhura gjatë një veprimi unik kriminal, mendojmë që përveç

vdekjes së një personi, pasojë pa të cilin nuk mund të ekzistonte kjo veprë penale, pasojat e tjera nga vepra penale, e cila ka pasur si qëllim pakësimin e pasurisë, siç janë plagosje e lehtë apo e rëndë, nuk mund që të përfshihen në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, pasi për personat e tjerë pasoja e veprimeve kriminale të autorit janë të tjera.

Pakica mendon se vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen konkurron me veprat penale të vjedhjes me dhunë dhe vjedhjes me armë dhe jo me plagosjen e rëndë me dashje dhe plagosjen e lehtë me dashje të parashikuara nga nenet 88 e 89 të K.Penal, pasi këto të fundit, pra dëmtimet e personave të tjerë që përpiqen të ruajnë pasurinë apo zbrapsin veprimet e autorit, vijnë si rezultat i veprimeve kriminale të autorit për të bërë të mundur arritjen e qëllimit, vjedhjes së pasurisë dhe në analizë të elementeve të veprës penale, këto pasoja përfshihen në anën objektive të veprave penale të vjedhjes me dhunë dhe vjedhjes me armë (nëse autori përdor armë).

Përfundimisht mendojmë se vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishej dhe të gjykuarit Arlind Hyseni e Florian Muça të deklaroheshin fajtorë për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen të kryer në bashkëpunim e të mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Genci Sade, parashikuar nga neni 141-25-22 të K.Penal dhe të deklaroheshin fajtorë për veprën penale të vjedhjes me armë të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasve Myrteza e Hatixhe Sade, parashikuar nga neni 140 e 25 i K.Penal.

Majlinda Andrea

Besnik Imeraj

Gani Dizdari

Fatos Lulo

Mirela Fana

Nr.7/6 i Regj. Themeltar
Nr.4 i Vendimit

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Besnik Imeraj	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 15.04.2011 morën në shqyrtim çështjen penale nr.7/6 me palë:

I GJYKUAR: ADRIAN QIQI, i dtl. 16.05.1979

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprës penale të
“Vrasjes me dashje” në bashkëpunim,
parashikuar nga nenet 76 e 25 të K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1372, datë 26.11.2007, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të Adrian Jorgo Qiqi për kryerjen e veprës penale të
“Vrasjes me dashje” në bashkëpunim, bazuar në nenet 76 e 25 të K.Penal dhe
dënimin e tij me 16 vjet burgim.

Në zbatim të nenit 51 të K.Penal, dënimin përfundimtar të të pandehurit
Adrian Qiqi me 8 (tetë) vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Adrian Qiqi të fillojë nga dita e ndalimit
datë 11.08.2006 dhe të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

Prova materiale: Gëzhoja me përmasa 24 mm dhe diametër 7.62 mm, e cila
mbahet në kartotekën balistike, të asgjësohet.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 242, datë 16.04.2008, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 1372, datë 26.11.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër vendimit nr. 242, datë 16.04.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs i gjykuari Adrian Qiqi, i cili parashtroi këto shkaqe:

- Vendimet penale janë bazuar në prova të cilat janë deklaruar absolutisht të pavlefshme dhe të papërdorshme.
- Në seancën e datës 08.10.2007 gjykata e rrethit, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur “Pavlefshmërinë e të gjitha akteve dhe veprimeve hetimore të sjella me fashikullin për gjykim nga ana e akuzës”.
- Deklarimi i dëshmitarit Vasil Cavo është bërë në kundërshtim me ligjin.
- Kemi kërkuar ballafaqimin e dëshmitarëve Ilir Surreli dhe Fatmir Koci me vëllain e viktimës, por gjykata e apelit nuk e mori parasysh.
- Tërësia e veprimeve hetimore është kryer tërësisht jashtë afatit ligjor të hetimit.
- Prokuroria, por edhe gjykata, janë kontradiktore në momentin që pranojnë se vrasja është kryer në bashkëpunim me një person të pidentifikuar me emrin Bledar.
- Nuk mund të ketë bashkëpunim pa marrëveshje dhe në këtë rast, edhe duke ju referuar qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji Penal (vendimi nr.494, datë 05.11.2008 dhe vendimi nr.76, datë 09.02.2005), vepra nuk mund të cilësohet si vrasje në bashkëpunim.
- Dëshmitarët okularë kanë pohuar para gjykatës se nuk kanë parë njeri të dalë nga makina e viktimës.
- Ardian Qiqi nuk i është fshehur asnjëherë në 10 vjet organeve të drejtësisë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendim të marrë në seancën gjyqësore të datës 30.06.2010 ka vendosur:

Kalimin e çështjes penale në ngarkim të të gjykuarit Adrian Qiqi për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin e praktikës gjyqësore, lidhur me çështjen e cilësimit të veprës penale si të kryer në bashkëpunim.

Çështjet e shtruarra për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë:

1. Nëse provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, prej të cilëve vetëm njëri është identifikuar, a do të kualifikohet vepra e kryer në bashkëpunim pa u identifikuar personi i dytë, apo personat e tjerë nëse janë disa.? Në lidhje me identifikimin e bashkëpunëtorit duhet të mbahet parasysh fakti nëse është ai i përgjegjshëm para ligjit për shkak të moshës, apo gjëndjes mendore.

2. A do të cilësohet vepra penale e kryer në bashkëpunim nëse nga organi i akuzës, për shkak të mos identifikimit të bashkëpunëtorit, nuk është ngritur akuzë ndaj ndonjë personi tjetër apo nuk është vendosur veçimi i çështjes.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatorët Shpresa Beçaj dhe Besnik Imeraj; Prokurorin Artur Selmani, që kërkoj lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë; Av.Koli Bele, që kërkoj prishjen e dy vendimeve dhe deklarimin e pafajshëm të të gjykuarit ose pushimin e çështjes në ngarkim të tij; dhe si shqyrtuan në tërësi çështjen,

V E R E J N Ë

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur për gjykim procedimin penal nr. 414, datë 08.04.1997 në ngarkim të të pandehurit Adrian Qiqi, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “vrasjes me dashje” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76 e 25 të K.Penal.

Gjykatat e faktit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, kanë pranuar këto rrethana të ngjarjes:

Në datën 02.04.1997, në Rrugën “At Nikolla”, Tiranë, është vrarë me armë zjarri në makinën e tij shtetasi Odhisea Vasil Çavo, banor i qytetit të Tiranës.

Në këtë datë, Odhisea dhe vëllai i tij, Aleksandër Çavo, ndodheshin në afërsi të banesës së tyre, në bodrumin poshtë pallatit që ata e përdornin për të mbajtur sende të ndryshme dhe veglat e makinës. Ndërkohë që vëllezërit ishin në bodrum, aty kanë ardhur Adrian Qiqi (të cilin e njihnin pasi është rritur në atë lagje) dhe një shok i tij, i panjohur për vëllezërit Çavo. Adriani ua ka prezantuar me emrin Bledar.

Adriani u ka kërkuar ujë për të pirë. Pasi i kanë dhënë ujë, Adriani së bashku me shokun e tij janë larguar, ndërsa Odhisea me Aleksandrin janë ngjitur në banesën e tyre.

Kur dy vëllezërit ndodheshin në banesë, nga një fqinj janë njoftuar se makinën ja kishin hapur dy djem. Odhisea ka zbritur poshtë pas pak minutash. Pas tij ka zbritur edhe Aleksandri, i cili nuk e ka gjetur as makinën tip “Opel Record” dhe as Odhisenë. Aleksandri ka mësuar që vëllai i tij, Odhisea, ishte larguar me makinën e tij së bashku me Adrian Qiqin.

Aleksandri ka filluar ndjekjen e tyre me makinën e fqinjit Fatmir Koçi, e cila drejtohej nga Fatmiri, i shoqëruar edhe nga fqinji tjetër Ilir Surreli. Aleksandri ka qëndruar në sediljen e parë të makinës.

Duke ecur nëpër rrugën “Mihal Grameno” ata kanë parë autoveturën e Odhiseas dhe e kanë ndjekur atë në largësi shikimi. Kanë vënë re që makina ka shkuar deri tek lokali i babait të Adrian Qiqit, Jorgo Qiqi, që ndodhej në oborrin e Q.S.U.T. “Nënë Tereza” Tiranë. Nga makina ka dalë Adrian Qiqi dhe ka hyrë brenda në lokal.

Aleksandri ka zbritur nga makina, e cila ndodhej disa metra larg makinës tjetër dhe e ka pyetur të vëllanë se çfarë po ndodhte, por, Odhisea i ka thënë: *“ik në shtëpi se do marr atë që më kanë marrë dhe do kthehem”*.

Pas kësaj bisede të shkurtër, Aleksandri ka hipur përsëri në makinën me të cilën i kishte ndjekur të vëllain dhe të gjykuarin Ardian Qiqi dhe ka qëndruar në pritje.

Në veturën “Opel Rekord” të Odhiseas ka hipur sërish Adrian Qiqi dhe janë larguar, ndërsa Aleksandri ka vazhduar t’i ndjekë nga pas me autoveturë.

Drejtimi i lëvizjes ka qenë në Rrugën “Bardhyl” që është segment i Unazës, mandej në Rrugën “Hoxha Tahsim”. Këtu, makina “Opel Rekord” ka ndaluar para një banese, për të cilën dëshmitari Aleksandër Çavo ka shpjeguar se kishte nr.206.

I gjykuari Ardian Qiqi ka zbritur nga makina, ka hyrë në këtë banesë dhe ka dalë pas pak minutash i shoqëruar nga personi tjetër, që pak më parë, tek bodrumi poshtë shtëpisë së tyre, e kishte prezantuar me emrin Bledar.

Më pas vetura “Opel Rekord” ka ecur nëpër rrugica deri në Rrugicën “At Nikolla”. Sapo vetura “Opel Rekord” ka hyrë në rrugicë dhe ka ecur për disa metra, kur ishte pothuaj në mes të saj, është dëgjuar një krismë.

Në këto çaste, në të njëjtën rrugicë ka hyrë edhe vetura në të cilën ishin Aleksandri së bashku me dy fqinjët e tij. Nga vetura “Opel Rekord”, që tashmë ishte e ndaluar, dëshmitari Aleksandër Çavo ka parë që kanë dalë i gjykuari Adrian Qiqi dhe shoku i tij me emrin Bledar, të cilët janë larguar me vrap në drejtim të kundërt me makinën tjetër.

Kur kanë shkuar tek makina, Aleksandri dhe dy fqinjët e tij kanë vënë re që Odhisea ishte i rënë përmbys mbi timon, i vdekur. Ai kishte një plagë me armë zjarri në faqen e djathtë.

Pasi kanë krijuar bindjen mbi bazën e çmuarjes së provave të shqyrtuara në gjykim, gjykatat e faktit kanë deklaruar fajtor dhe dënuar të gjykuarin për veprën penale të vrasjes së kryer në bashkëpunim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke konstatuar se lidhur me çmuarjen dhe vlerësimin e provave gjykatat e faktit kanë zbatuar drejt kërkesat e nenit 152 dhe 380 të K.Pr.Penale, pasi në marrjen e vendimit për të gjykuarin Qiqi kanë përdorur vetëm prova të cilat janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor dhe bindjen e kanë krijuar pa i dhënë vlerë të paracaktuar asnjë prove, e gjejnë të bazuar në ligj vendimin e gjykatave lidhur me fajësinë e të gjykuarit Ardian Qiqi.

Lidhur me faktin përse vepra penale e kryer nga i gjykuari duhet të kualifikohet edhe sipas dispozitës së nenit 25 të K.Penal si dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të shtruarra për unifikimin e praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se më parë duhet të bëhet një interpretim i zgjeruar i veprës penale, përgjegjësisë penale dhe kuptimit të bashkëpunimit sipas Kodit tonë Penal.

Sipas dispozitës së nenit 25 të K.Penal, *bashkëpunim konsiderohet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre*. Në çështjen objekt shqyrtimi, nga pikëpamja e anës objektive, sikurse kanë pranuar të dyja gjykatat, rezulton e provuar se vepra penale është kryer në bashkëpunim mes të gjykuarit Ardian Qiqi dhe një personi tjetër të paignifikuar për të cilin çështja, sipas nenit 326 të K.Pr.Penale, është pezulluar dhe organi i prokurorisë ushtron veprimtarinë e tij të mëtejshme procedurale për identifikimin e personit të dyshuar.

Pra, vepra është kryer me më shumë se një person, që në kuptim të nenit 25 të K.Penal, ajo është kryer në bashkëpunim mes të gjykuarit dhe një tjetër personi, aktualisht të paignifikuar.

Sipas ligjit dhe doktrinës së të drejtës penale, që të ndodhemi përpara figurës së veprës penale për efekte të përgjegjësisë penale kërkohet verifikimi i bashkëekzistencës së katër elementeve të veprës penale, që janë: objekti, subjekti, ana objektive dhe ana subjektive.

Pra, së pari duhet të ekzistojë nga pikëpamja materiale vepra penale, të jetë cënuar një marrëdhënie shoqërore e mbrojtur nga ligji penal, duke ardhur objektivisht një pasojë kriminale nga veprimi ose mosveprimi shoqërisht i rrezikshëm. Në rastin konkret është provuar se shtetasi Odhisea Çavo është vrarë në rrethanat që kanë pranuar gjykatat.

Së dyti, për të patur figurën e veprës penale, kërkohet që fakti kriminal të jetë pasojë e një veprimi ose mos veprimi të kundërligjshëm, të dënueshëm penalisht të personit që ka kryer veprën penale. Identifikimi i personit, subjektit të veprës penale, ka rëndësi për të përcaktuar në radhë të parë se kush e ka kryer veprën penale dhe në radhë të dytë për të verifikuar nëse sipas ligjit përgjigjet penalisht për këtë vepër apo përjashtohet nga ajo duke mbetur përgjegjësitë e tjera ligjore jo penale. Në rastin në shqyrtim është provuar se subjekt i kësaj vepre penale janë i gjykuari Ardian Qiqi dhe një person tjetër aktualisht i paignifikuar.

Së treti, e rëndësishme për përcaktimin e figurës së veprës penale është mënyra se si ajo është kryer, mekanizmi i ndodhjes së ngjarjes, provueshmëria e veprimeve apo mosveprimeve me pasoja penale të subjektit apo subjekteve që e kanë kryer atë. Nga kjo pikëpamje, nga gjykimi i çështjes ka rezultuar e provuar se i gjykuari së bashku me një person të pidentifikuar, e kanë marrë me forcë viktimën me automjetin e tij dhe më pas e kanë qëlluar me armë zjarri duke i shkaktuar vdekjen.

Së katërti, shkak/shkaqet apo motivet që kanë çuar në kryerjen e veprës penale janë të rëndësishme për të përcaktuar ndër të tjera edhe vetë figurën e veprës penale si edhe për të përcaktuar nga pikëpamja materiale dispozitën konkrete për të cilën duhet të përgjigjen personat që kanë kryer veprën penale.

Edhe në këtë këndvështrim, sipas vendimeve të të dyja gjykatave të faktit ka rezultuar e provuar se i gjykuari, së bashku me një person tjetër akoma të pidentifikuar, e kanë kryer veprën për shkak të një detyrimi që viktimë ka patur ndaj të gjykuarit.

Nga kjo analizë e përmbledhur e elementeve të domosdoshëm të figurës së veprës penale rezultojnë të drejta vendimet e të dyja gjykatave përsa i përket faktit kriminal të ndodhur dhe përgjegjësisë penale për të gjykuarin Ardian Qiqi.

E diskutueshme në këtë çështje që ka çuar edhe në nevojën për unifikimin e praktikës gjyqësore është nëse për efekte të cilësimit juridik të saj, ajo është kryer në bashkëpunim apo jo, në kushtet kur njëri nga bashkëpunëtorët nuk është i identifikuar. Të dyja gjykatat kanë pranuar se edhe në këto kushte vepra penale duhet të kualifikohet e kryer në bashkëpunim mes të gjykuarit Ardian Qiqi dhe personit ende të pidentifikuar.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë edhe këtë përfundim të të dyja gjykatave të faktit e gjejnë të bazuar ligjërisht e për pasojë çmojnë se vendimet e tyre janë të drejta dhe të pa cënueshme nga pikëpamja e zbatimit të ligjit.

Megjithatë, qëndrimet e ndryshme të mbajtura nga gjykatat çojnë në nevojën e interpretimit të unifikuar të praktikës gjyqësore nga Kolegjet e Bashkuara, me qëllim stabilizimin e mendimit juridik dhe të praktikës gjyqësore për të ardhmen në lidhje me kuptimin e bashkëpunimit në një vepër penale.

Ashtu sikurse u arsyetua më sipër, për t'u ndodhur përpara figurës së veprës penale duhet të bashkekzistojnë të katër elementet e saj, por nëse ajo është kryer nga një apo më shumë persona, kjo s'ka të bëjë me vetë ekzistencën e veprës (e cila qëndron që në momentin e verifikimit të katër elementeve të saj), por me rrethanat dhe rrezikshmërinë shoqërore të saj.

Kodi ynë Penal institutin e bashkëpunimit e ka parashikuar në dy forma të ndryshme, nëpërmjet kualifikimit të cilësuar të vetë veprës penale, ose me konsiderimin e saj të kryer në rrethana rënduese në kuptim të nenit 50/gj të tij.

Në këtë drejtim, që dispozita e nenit 25 e K.Penal të gjejë zbatim, kërkohet bashkekzistenca e dy elementeve të rëndësishëm: - e para, që vepra të jetë kryer nga dy ose më shumë persona dhe - e dyta, që kjo vepër të jetë kryer në marrëveshje ndërmjet tyre.

Sikurse u analizua më sipër, nga pikëpamja e anës objektive kërkohet që vepra penale të jetë kryer nga jo më pak se dy persona, pra të provohet që në kryerjen e saj të kenë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen nga gjykatat e faktit referuar rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të Kodit Penal.

Nga pikëpamja e anës subjektive kërkohet gjithashtu marrëveshja e këtyre personave në kryerjen e veprës penale.

Shtrohet pyetja, nëse mund të ketë marrëveshje në kuptim të kësaj dispozite ndërmjet një personi që ka përgjegjësi penale sipas ligjit dhe një personi tjetër, i cili në momentin e gjykimit mbetet i paidentifikuar, apo për shkak të moshës ose paaftësisë së tij mendore nuk mban përgjegjësi penale.

Për t'i dhënë përgjigje sa më sipër, si dhe për të arritur në konkluzionet unifikuese, ndër të tjera Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbajnë parasysh një nga parimet themelore të së drejtës penale, atë të autonomisë së përgjegjësisë, quajtur ndryshe edhe si parimi i përgjegjësisë personale të personit që kryen vepër penale.

Sipas këtij parimi, çdo person mban përgjegjësi sipas ligjit penal për veprimet e paligjshme të kryera nga ana e tij në kufijtë e fajit të vet, kjo pavarësisht rrethanave në të cilat është kryer vepra penale.

Kolegjet e Bashkuara theksojnë se parimi i autonomisë së përgjegjësisë shfaqet në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material ose moral në kryerjen e veprës penale. Në këtë drejtim doktrina ka pranuar se për të qenë në kushtet e bashkëpunimit, «... mjafton që pjesëmarrësi të ketë influencë mbi një detaj të veprimit kriminal të ndërmarrë, qoftë lidhur me të mirën apo të drejtën e mbrojtur, qoftë lidhur me planin organizues ...» Në këtë logjikë përfshihen si veprimet *ex ante*, ashtu edhe ato *ex post* të autorit në kryerjen e veprës penale, me kushtin që të kenë ndikuar apo të kenë synuar pasojën kriminale.

Dallimi mes aplikimit të parimit të autonomisë së përgjegjësisë në veprat penale me një autor të vetëm, nga ato të kryera në bashkëpunim, qëndron në faktin se në rastin e parë autori duhet të ketë kryer edhe materialisht veprën penale, ndërsa në rastin e bashkëpunimit mjafton edhe që ai të ketë lehtësuar kryerjen e veprës penale nga persona të tjerë.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ana subjektive është një nga komponentet strukturore të institutit të bashkëpunimit, i cili kërkon si element të domosdoshëm ekzistencën e një marrëveshjeje për kryerjen e veprës penale.

Në përcaktimin e kushteve të marrëveshjes për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se ana subjektive në kryerjen e veprës penale në bashkëpunim konsiston në dy elemente: - ndërgjegjia dhe vullneti i personit për të kryer veprën penale dhe - vullneti për të bashkëpunuar me persona të tjerë për kryerjen e saj.

Që një vepër penale të konsiderohet e kryer në bashkëpunim ekzistenca e një marrëveshjeje paraprake në kryerjen e saj nuk është e domosdoshme, por mjafton edhe marrëveshja e paparashikuar, e cila mund të shfaqet gjatë kryerjes së veprës penale, me kushtin që secili prej autorëve të jetë i ndërgjegjshëm për veprimet e të tjerëve.

Lidhur me kushtet që duhet të plotësojë **marrëveshja** mes dy ose më shumë personave për të kryer veprën penale në mënyrë që të ndodhemi përpara institutit të bashkëpunimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se mes marrëveshjes në kuptimin e ligjit civil dhe marrëveshjes në kuptimin e ligjit penal, ekziston një dallim esencial dhe se ligji penal zbaton një standard të ndryshëm nga ai civil lidhur me kuptimin e marrëveshjes.

Në këtë drejtim, Kolegjet e Bashkuara theksojnë, se në kuptimin e të drejtës civile, **marrëveshja** përbën një veprim juridik që, sipas nenit 189 të Kodit Civil, përkufizohet si: “... shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik që synon të krijojë, të ndryshojë, ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.

Duke qenë një formë e ligjshme e shprehjes së vullnetit, në të drejtën civile, një nga elementet e domosdoshëm për vlefshmërinë e marrëveshjes është edhe zotësia e plotë për të vepruar e personave (me përjashtim të një kategorie të caktuar veprimesh të përcaktuara në nenet 7 dhe 8 të Kodit Civil, të cilat mund të kryhen edhe nga personi pa zotësi për të vepruar ose personi me zotësi të të vepruar¹⁰⁸). Neni 92/c i Kodit Civil parashikon si pasojë të mosekzistencës së këtij elementi pavlefshmërinë absolute.

Ndërkaq, kuptimi i marrëveshjes, sipas nenit 25 të Kodit Penal, është krejtësisht i ndryshëm nga sa më sipër. Kuptimi i marrëveshjes në të drejtën penale, ndryshe nga e drejta civile, lidhet me shprehjen e vullnetit të dy ose më shumë personave për të kryer një veprim të paligjshëm dhe ligjërisht të dënueshëm. Kjo shprehje vullneti mund t'i paraprijë veprës penale, ose të jetë e atëçastshme.

Duke qenë një formë e shfaqjes së vullnetit për të kryer një veprim të paligjshëm, marrëveshja për të kryer një vepër penale nuk i nënshtrohet kushteve të vlefshmërisë që duhet të plotësojë marrëveshja si një veprim juridik në të drejtën civile. I vetmi kusht për pranimin e saj është të provuarit se mes autorëve ka ekzistuar një marrëveshje për kryerjen e veprës penale.

Cilësitë personale që mund të kenë eventualisht një apo disa nga autorët e veprës penale, si mosha e mitur, mungesa e përgjegjshmërisë mendore, etj., janë elemente që shërbejnë për përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale, por nuk çenojnë *marrëveshjen* e arritur për kryerjen e veprës penale.

Ndryshe nga ligji civil, Kodi Penal në dispozitat e tij nuk ka parashikuar asnjë kusht që duhet të plotësojë marrëveshja mes autorëve të veprës penale sipas nenit 25 të tij. Kjo pasi në nenet 12 dhe 17 të tij, Kodi Penal, duke përcaktuar rastet e përjashtimit nga përgjegjësia penale, indirekt ka përcaktuar edhe pasojat që vijnë në rastet kur vepra penale kryhet nga një person i mitur apo i paqëndrueshëm mendërisht. Në secilin nga këto raste vepra penale gjithsesi ekziston, por cilësitë e veçanta të personit bëjnë që ai të përjashtohet nga përgjegjësia penale apo t'i ulet dënimi.

Për rrjedhojë edhe marrëveshja e arritur për të kryer një vepër penale në bashkëpunim me një person që nuk mban përgjegjësi penale ekziston, por cilësitë e njërit apo disa prej autorëve, bazuar po në parimin e autonomisë së përgjegjësive, nëse është rasti, mund të bëjnë që personi konkret të përjashtohet nga përgjegjësia penale apo të përfitojë lehtësi që ligji parashikon.

Duke parashikuar parimin e autonomisë së përgjegjësive si një nga parimet themelore të së drejtës penale, ligjvënësi ka dashur të përjashtojë mundësinë që njëri autor i veprës penale të përfitojë nga cilësitë e autorit tjetër. Kjo është edhe arsyeja pse si kusht i vetëm për ekzistencën e *marrëveshjes*, sipas nenit 25 të Kodit Penal, mjafton vullneti i autorëve për të kryer veprën penale. Çdo rrethanë tjetër e faktit mund të ndikojë në përjashtimin apo llojin dhe masën e dënimit të secilit prej autorëve, por nuk çënon marrëveshjen e tyre si element i bashkëpunimit, gjë që merr përgjigje rast pas rasti sipas rrethanave të provuara të kryerjes së veprës penale.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkekzistojnë si kushte *sine qua non*:

1. dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash);
2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale;
3. dhënia e një kontributi rilevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve;

¹. Sipas nenit 10 te Kodit Civil “*Personi madhor, që për shkak sëmundjeje psiqike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës*”. Në këto raste personit që me vendim gjykate i është hequr zotësia për të vepruar barazohet me të miturin nën katërmbëdhjetë vjeç, ndërsa personi që me vendim gjykate i është kufizuar zotësia për të vepruar barazohet me të miturin mbi katërmbëdhjetë vjeç.

4. ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal.

Kolegjet e Bashkuara theksojnë se karakteristikë e veprës penale të kryer në bashkëpunim është uniteti i anës subjektive të veprës penale të kryer në bashkëpunim. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, megjithëse përgjegjësia penale është e njëjtë për të gjithë autorët e veprës, shkalla e tyre e përgjegjësisë ndryshon në varësi të veprimeve apo mosveprimeve të tyre konkrete, për të cilat ata përgjigjen personalisht. Kjo pasi, si në rastin kur vepra penale kryhet nga një person i vetëm, ashtu edhe në rastin e bashkëpunimit, në të drejtën penale gjen zbatim *parimi i përgjegjësisë personale*, duke bërë që për secilin prej bashkëpunëtorëve të verifikohen më vete ekzistenca e elementeve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, pavarësisht rolit të tyre në realizimin e saj sipas nenit 27 të K.Penal.

Verifikimi i katër elementeve të mësipërm bën që vepra penale të cilësohet e kryer në bashkëpunim, pavarësisht rolit që ka kryer secili prej bashkëpunëtorëve në realizimin e veprës penale me veprimet apo mosveprimet e tij dhe pavarësisht përgjegjësisë penale që ai mban për këto veprime a mosveprime, përcaktimi i të cilave i takon rrethanave të faktit të provuara në gjykim. Në cilësimin juridik të veprës penale, marrja e cilësisë së bashkëpunëtorit në kryerjen e një veprë penale ekziston që në momentin që plotësohen kushtet e sipërpërmendura dhe qëndron e pavarur nga fakti nëse njëri prej bashkëpunëtorëve është ose jo person që mban përgjegjësi penale.

Sa më sipër çon në përfundimin se secili prej bashkëpunëtorëve në veprën penale mban përgjegjësi penale për veprën konkrete, të kryer në bashkëpunim, pavarësisht karakteristikave subjektive që mund të kenë bashkëpunëtorët e tjerë.

Kështu, mund të ndodhë që njëri nga subjektet e veprës penale të jetë bashkëpunëtor në veprën penale dhe në të njëjtën kohë të jetë person i padënueshëm nga ligji penal, për shkak se nuk mban përgjegjësi penale sipas dispozitave në fuqi, për shkak të cilësive të tij subjektive.

Lidhur me këtë çështje legjislacionet e huaja mbajnë dy qëndrime të ndryshme: legjislacionet e disa vendeve, si ai italian dhe grek, kanë parashikuar shprehimisht rastin e përjashtimit nga përgjegjësia penale të njërit prej bashkëpunëtorëve si një rrethanë që nuk përjashton cilësimin e veprës në bashkëpunim edhe për bashkëpunëtorin/bashkëpunëtorët e tjerë (shih p.sh. nenet 112 dhe 119 të K.Penal italian dhe neni 45 e 49 i K.Penal grek), ndërsa legjislacione si ai gjerman (ku dhe është prezantuar teoria e “autorit ndërmjetës” - ai që përdor ose shtyn një person që nuk mban përgjegjësi penale në kryerjen e një veprë penale), nuk përmbajnë këto parashikime. Në këtë situatë të dytë, vetë ligji parashikon shtytjen apo “përdorjen” e një personi që nuk mban përgjegjësi penale, kur këto cilësi njihen nga personi që i shfrytëzon, në dispozita të veçanta, ç’ka bëjnë që vepra penale të cilësohet sipas këtyre dispozitave. Ndërkohë legjislacioni ynë, duke mos e përmbajtur dispozita konkrete, nuk ka zgjedhur në mënyrë të qartë asnjërin nga këto situata, ç’ka ka çuar në zbatimin e ndryshëm të ligjit nga gjykatat në praktikë.

E vetmja dispozitë e Kodit tonë Penal që parashikon një situatë të tillë specifike është neni 129 i këtij Kodi, sipas të cilit: “*Shtytja ose tërheqja e të miturve nën moshën katërmëdhjetë vjeç për të kryer krim dënohet me burgim gjer në pesë vjet*”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore lidhur me konkurimin e dispozitave të bashkëpunimit të parashikuara në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal dhe dispozitave të veçanta të pjesës së posaçme të këtij Kodi, siç është neni 129 i tij, theksojnë sa vijon:

Neni 129 i Kodit Penal, megjithëse nga emërtimi i tij “shtytja apo përdorimi i personit që nuk mban përgjegjësi penale” është gjithëpërfshirës, në fakt ka si objekt të tij vetëm marrëdhëniet shoqërore që mbrojnë të miturit nën moshën 14 vjeç, të cilët, sipas nenit 12/1 të Kodit Penal, nuk mbajnë përgjegjësi penale për kryerjen e një krimi.

Ana objektive e kësaj vepre realizohet me veprime direkte në dy forma: *shtytje* ose *tërheqje* e të miturit për të kryer një krim. Në rastin kur vërtetohet se vepra penale është realizuar nga i mituri, si pasojë e shtytjes së tij në krim nga një person që mban përgjegjësi penale, ky i fundit përgjigjet sipas nenit 129 të Kodit Penal dhe nuk ka vend për diskutimin nëse kjo veprë konkuron apo jo me bashkëpunimin.

Ndërsa në rastin kur personi që mban përgjegjësi penale tërheq një të mitur për të kryer një krim dhe vërtetohet se krimi është kryer në bashkëpunim, autori përgjigjet si për krimin e kryer në bashkëpunim, ashtu edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 129 i Kodit Penal, pasi në këtë rast neni 129 i K.Penal konkuron me dispozitën konkrete lidhur kjo e fundit me nenet 25-27 të Kodit Penal, duke qenë se ato rregullojnë situata të ndryshme juridike.

Ligjvënësi në parashikimin e tij në nenet 12 dhe 17/1 të K.Penal për përjashtimin nga përgjegjësia penale të personave të mitur apo atyre që vuajnë nga turbullime psiqike apo neuropsiqike të përhershme apo të atëçastshme, për shkak të cilësive të veçanta të tyre, ka dashur të përjashtojë këta persona nga përgjegjësia penale, por kurrsesi nuk ka pasur si qëllim që nga cilësitë e tyre personale të përfitojnë edhe personat e tjerë që mbajnë përgjegjësi sipas ligjit penal.

Për rrjedhojë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se bashkëpunimi sipas legjislacionit tonë ekziston që në momentin që plotësohen kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit (shih *ut supra*) dhe bazuar mbi parimin e përgjegjësisë personale, pavarësisht karakteristikave personale të bashkëpunëtorëve të tjerë, vepra penale konsiderohet e kryer në bashkëpunim, edhe në rastet kur autori tjetër i veprës penale nuk mban përgjegjësi penale.

Pra, në çdo rast, secili nga autorët e veprës penale të kryer në bashkëpunim, pavarësisht unitetit të anës subjektive të veprës, mban përgjegjësi personale për veprimet ose mosveprimet e tij. Si në rastet kur bashkëpunëtorët mbajnë përgjegjësi penale, ashtu edhe në rastet kur njëri apo disa prej tyre nuk mbajnë përgjegjësi penale, bashkëpunëtori apo bashkëpunëtorët që mbajnë përgjegjësi penale do të përgjigjen për veprën penale konkrete, të kryer në bashkëpunim, pasi për ta të gjithë elementet e bashkëpunimit ekzistojnë dhe mjafton ekzistenca e tyre për t'u ndodhur në kushtet e bashkëpunimit, pavarësisht karakteristikave personale të bashkëpunëtorëve të tjerë, të cilat shërbejnë si bazë për përjashtimin e këtyre të fundit nga përgjegjësia penale, por kurrsesi për eliminimin e cilësimit të veprës në bashkëpunim.

Mbi këtë qëndrim, është i qartë edhe pranimi i ekzistencës së bashkëpunimit në rastet kur bashkëpunëtori apo bashkëpunëtorët e tjerë janë të panjohur. E njëjta logjike të çon në përfundimin se, edhe në rastet kur njëri nga bashkëpunëtorët është i panjohur, ndodhemi në kushtet e veprës penale të kryer në bashkëpunim, pasi personi në gjykim përgjigjet për veprimet apo mosveprimet në shkallën e kryer nga ai vetë. Mosnjohja e karakteristikave personale të bashkëpunëtorit të panjohur nuk shmang ekzistencën e bashkëpunimit dhe nuk e bën të paaplikueshme dispozitën e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal. Në çdo rast, eventualisht karakteristikat personale të bashkëpunëtorit të panjohur do ishin shkak për përjashtimin e tij nga përgjegjësia penale, por nuk ndikojnë në cilësimin juridik dhe përcaktimin e përgjegjësisë për personin në gjykim.

Në të njëjtën linjë arsyetimi Kolegjet e Bashkuara çmojnë se edhe në rastet kur për shkak të mosidentifikimit nga ana e organit të akuzës nuk ka filluar procedim penal ndaj ndonjë personi tjetër, ose për të njëjtin shkak a ndonjë shkak të ndryshëm çështja nuk është veçuar, përsëri vepra do të cilësohet e kryer në bashkëpunim dhe personi në gjykim do të përgjigjet për veprimet apo mosveprimet e kryera nga ai vetë, me kusht që të provohet dhe vërtetohet ekzistenca e kushteve të përgjithshme të bashkëpunimit.

Për gjithë sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: **kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet**

kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në kërkesat e nenit 438 dhe 442/a të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Lënien në fuqi të vendimit nr. 242, datë 16.04.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 15.04.2011

MENDIMI I PAKICËS

Ne gjyqtarët në pakicë, Gani Dizdari dhe Fatos Lulo, kemi mendimin se si zgjidhja e çështjes penale në ngarkim të të gjykuarit Adrian Qiqi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke lënë në fuqi vendimin nr.242, datë 16.04.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ashtu dhe përfundimi unifikues i arritur prej tyre, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit.

Nga dosja rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1371, datë 26.01.2007 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të Adrian Qiqit, për kryerjen e veprës penale të “vrasjes me dashje” në bashkëpunim, bazuar në nenet 76 e 25 të K.Penal, dënimin e tij me 16 vjet burgim.

Në zbatim të nenit 51 të K.Penal, dënimin përfundimtar të të pandehurit Adrian Qiqi me 8 vjet burgim.

Këtë vendim e ka lënë në fuqi Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.242, datë 16.04.2008.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendim të marrë në seancë gjyqësore datë 30.06.2010, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin e praktikës gjyqësore, lidhur me çështjen e **cilësimit** të veprës penale si të kryer **në bashkëpunim**.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.04, datë 15.04.2011 kanë lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke arritur në përfundimin unifikues se: “Kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë, apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë”.

Në kushtet si më sipër, pakica ka mendimin se kualifikimi ligjor i veprës penale si e kryer në bashkëpunim nga i gjykuari duhet ndryshuar në vrasje të kryer jo në bashkëpunim, bazuar vetëm në nenin 76 të K.Penal, e për rrjedhojë edhe unifikimi i arritur në të dy rastet është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit penal.

Siç pranon e drejta penale dhe praktika gjyqësore, si në çdo rast, edhe në kryerjen e veprave penale në bashkëpunim, **faji** është element i domosdoshëm i veprës penale, ndërsa **marrëveshja** është element i domosdoshëm i bashkëpunimit, e për pasojë, pa faj nuk mund të ketë përgjegjësi penale e pa marrëveshje nuk mund të ketë bashkëpunim.

Karakteristikë e veçantë dhe element i domosdoshëm i bashkëpunimit në veprën penale, nga pikëpamja subjektive, është marrëveshja e bashkëpunëtorëve për kryerjen e krimit a të kundravajtjes penale.

Bashkëpunim pa marrëveshje nuk ka, marrëveshja nënkupton dashjen direkte të secilit prej bashkëpunëtorëve për arritjen e një rezultati të përbashkët kriminal. Ajo përfaqëson unitetin e anës subjektive të veprës penale, bashkon fajin e secilit bashkëpunëtor me fajin e bashkëpunëtorëve të tjerë, pra bën lidhjen organike të fajësisë së të gjithëve.

Nisur nga përcaktimi teoriko-ligjor, sipas të cilit bashkëpunimi konsiston në kryerjen e veprës penale nga dy ose më shumë persona në marrëveshje në mes tyre, del qartë se në fjalën persona nuk duhet kuptuar person fizik në kushtin juridiko-civil të tij, por duhet kuptuar **person fizik si subjekti i figurës së veprës penale**.

Ashtu siç ka pranuar edhe praktika gjyqësore (vendimi nr.76, datë 09.02.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë) "...se për bashkëpunimin në kuptimin juridiko-penal, mund të bëhet fjalë vetëm atëherë kur bashkëpunëtorët në kuptimin gjuhësor të kësaj fjale plotësojnë kushtet për të qenë subjekt i figurës së veprës penale, se vetëm ndaj këtyre të fundit mund të zbatohen përcaktimet e parashikuara në dispozitat e nenit 27 të K.Penal (përgjegjësia e bashkëpunëtorëve").

Në të drejtën tonë penale, **subjekti i veprës penale** quhet personi që ka mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale dhe që është i përgjegjshëm.

Përgjegjësi penale mban personi që ka vetëdijen e rëndësisë së sjelljes së vet dhe aftësinë e kontrollit të saj, që kupton lidhjet shkakësore që krijon midis veprimeve ose mosveprimeve të tij dhe pasojave të shkaktuara prej tyre.

Por, që të përgjigjet penalisht autori i veprës penale duhet të jetë mbajtësi i **dy cilësive, të ketë mbushur një moshë të caktuar dhe të jetë i aftë mendërisht, i përgjegjshëm**.

Në kushtet si më sipër kur marrëveshja në kuptimin juridiko-penal, minimalisht duhet të realizohet të paktën në mes dy personave të cilët të kenë dashjen direkte për arritjen e një rezultati të përbashkët kriminal, pra nga **ana subjektive** të kenë aftësinë, të kenë ndërgjegjen për të kuptuar se për çfarë po merren vesh, çfarë detyrash do të kryejë secili, çfarë rezultati kriminal do të arrijnë, të kuptojnë fajin e tyre, të bashkojnë fajin e secilit me fajin e bashkëpunëtorëve të tjerë, pra të bëjnë lidhjen organike të fajësisë së të gjithëve, etj., por në qoftë se **njëri nga këta dy persona** nuk ka ndërgjegjen, nuk e ka aftësinë për të kuptuar e vlerësuar se për çfarë bisedohet, pa le më të kuptojë se për çfarë thamë më lart, a mund të kemi marrëveshje në rastin konkret, a mund të kemi marrëveshje me një person që nuk ka asnjë nga kushtet për të bërë marrëveshje, përveç faktit se është krijesë njerëzore, është frymor dhe ndoshta për të realizuar jetesën, ekzistencën e tij duhet domosdo një person tjetër me cilësinë e kujdestarit, etj.

Ne si pakicë mendojmë se në këtë drejtim nuk ka nevojë për koment, mbasi në rastin konkret vetëm marrëveshje nuk mund të ketë.

E parë në këtë këndvështrim, ne si pakicë mendojmë se edhe përfundimi i arritur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (faqe 11 e vendimit) ku thuhet:

"Cilësitë personale që mund të kenë eventualisht një apo disa nga autorët e veprës penale, si mosha e mitur, mungesa e përgjegjësisë mendore, etj., janë elementë që shërbejnë për përjashtimin e tyre nga përgjegjësia, por nuk cenojnë marrëveshjen e arritur për kryerjen e veprës penale" është kontradiktor, i pa argumentuar.

Kolegjet e Bashkuara, nga njëra anë pranojnë se cilësitë personale që mund të kenë një apo disa nga autorët e veprës penale si mosha e mitur dhe mungesa e përgjegjshmërisë mendore, pra,

kur kemi mungesën e ndërgjegjes, mungesën e vetëdijes, paaftësinë për të kuptuar veprimin e kryer, paaftësinë për të kuptuar pasojën e ardhur, etj., **bëjnë që ata të përjashtohen nga përgjegjësia penale**, nga ana tjetër, megjithëse ekzistojnë këto mangësi kapitale tek këta persona, për pjesën tjetër që Kolegjet e quajnë marrëveshje, veprimet e tyre janë të përgjegjshme, të vetëdijshme e për rrjedhojë marrëveshja mbetet e pa cenuar.

E thënë ndryshe i njëjti person, në të njëjtën kohë, për të njëjtin veprim kriminal nga njëra anë ka aftësi dhe është i përgjegjshëm për të bërë **marrëveshje**, pra nga ana e subjekteve ka aftësi dhe ndërgjegje për të ideuar, për të përcaktuar detyra për vete dhe për të tjerë, për të kuptuar dhe parashikuar rezultatit kriminal që do të arrijnë, për të kuptuar fajin e tij dhe të tjerëve, pra të bëjë lidhjen organike të fajësisë së të gjithëve, etj., por nga ana tjetër kur bëhet fjalë për realizimin e veprës penale, ai nuk ka vetëdije, nuk ka ndërgjegje, nuk ka aftësi për të kuptuar veprimtarinë kriminale dhe pasojën e ardhur e për rrjedhojë **është i papërgjegjshëm** dhe duhet përjashtuar nga përgjegjësia penale.

Duhet theksuar se deri tani, si nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore është pranuar se kur autori i veprës penale është ndihmuar nga një person i papërgjegjshëm, ky i fundit është konsideruar si mjet, si instrument në realizimin e veprës dhe ky fakt është mbajtur parasys nga gjykata në caktimin e dënimit për autorin në zbatim të nenit 47 të Kodit Penal e nuk është konsideruar si vepër e kryer në bashkëpunim, si rrethanë cilësuese, apo si rrethanë rënduese e parashikuar nga neni 50 i Kodit Penal.

Ndërsa kur autori i veprës penale ka aktivizuar, ka përdorur, ka tërhequr të miturit në krim, ai duhet të përgjigjet dhe është përgjigjur edhe për veprën penale të “shtytjes së të miturve në krim”, parashikuar nga neni 129 i Kodit Penal, ç’ka me të drejtë edhe Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se në këtë rast kjo vepër penale konkurren me veprën tjetër penale në të cilën janë shtytur të miturit në krim.

Por edhe në këtë rast, për kushtet si më sipër, autori i veprës penale duhet të përgjigjet për “shtytje së të miturve në krim” por jo edhe për bashkëpunimin me ta, pra vetëm për veprën penale të “shtytjes së të miturve në krim”.

Mendojmë se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të arritur në përfundime më të bazuara, në rastin konkret duhej të mbështeteshin edhe në doktrina të tjera, që mbajnë precizione të ndryshme, të kundërta me doktrinën italiane, siç është doktrina gjermane.

Doktrina gjermane **nuk e pranon bashkëpunimin** në rast se njëri nga bashkëpunëtorët është i papërgjegjshëm apo i padënueshëm, për shkak se nuk mund të ketë bashkëpunim ndërmjet një personi të përgjegjshëm dhe një tjetri të papërgjegjshëm apo të padënueshëm, për faktin se vetëm ai që është i përgjegjshëm penalisht mund të konsiderohet autori i veprës penale, duke marrë figurën e “autorit të ndërmjetëm”, ndërsa ekzekutori material duhet të konsiderohet thjesht si një **instrument** për realizimin e veprës penale.

Ne si gjyqtarë në pakicë mendojmë se autori i veprës penale nuk duhet të përgjigjet për bashkëpunim në veprën penale të kryer as për rastet kur nuk identifikohet bashkëpunëtori, apo bashkëpunëtorët, përderisa nuk është provuar se ata janë subjekt i veprës penale. Vetëm identifikimi i atyre personave dhe përmbushja prej tyre e kushteve për të qenë subjekti i figurës së veprës penale “mosha dhe përgjegjshmëria” do të përbënte bazën ligjore që ata të konsiderohen bashkëpunëtor me të gjykuarin.

Mendojmë se me identifikimin e personit apo të personave nëqoftëse ata i plotësojnë kushtet për të qenë subjekti i veprës penale, në zbatim të nenit 451 dhe 452 të Kodit të Procedurës Penale, prokurorit i lind e drejta që me anë të kërkesës për rishikim të realizohet gjykimi dhe dënimi i autorit për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim.

Për sa parashtrua më sipër, ne si gjyqtarë në pakicë jemi kundër vendimit nr.04. datë 15.04.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si për unifikimin e arritur në lidhje me

bashkëpunimin në veprën penale, ashtu edhe në përfundimin e arritur në lidhje me zgjidhjen e çështjes në themel duke lënë ne fuqi vendimin objekt shqyrtimi nr.242, datë 16.04.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Fatos Lulo

Gani Dizdari

**Nr.8/7 i Regj. Themeltar
Nr.3 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Ardian Dvorani	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 17.01.2011 dhe 24.01.2011 morën në shqyrtim çështjen penale nr.8/7 Akti, që i përket:

TË PANDEHURIT: SHEZAI GEGA, i padënuar, gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”.

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 283/a e 22 të K.Penal.

Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.10, datë 11.02.2009, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Shezai Gega për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, vepër kjo e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 9 (nëntë) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 406 dënimin e tij përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet burgim.

Vuajtja e dënimit së të pandehurit Shezai Gega fillon nga dita e arrestimit të tij datë 01.02.2008, vuajtje e cila do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

Konfiskimin e sendeve të sekuestruara si më poshtë:

Një aparat celular model “Samsung” tipi SGH E 700 me numër imei 35312900072696/8 së bashku me kartën AMC me numër serie 1070125085535.

Një aparat celular model “Samsung” tipi SGH E 700 me numër imei 353254301415369/9 së bashku me kartën Vodafon me numër serie 863550200002170703013 - Kartë Vodafon me numër serie 89355020000218707618014.

Një aparat celular tip «NOKIA» me numër imei 352746010635847 me kartën AMC me numër serie 89355010604203688923.

Automjeti tip kamion i markës “VOLVO” me targë BR 1852 B me kabinë me ngjyrë të zezë me rimorkio me mushama me ngjyrë të verdhë.

Kthimin e sendeve të sekuestruara si më poshtë:

Dëshmi aftësie nr.931453 në emër të Shezai Gega.

Një fletore shkrimi e grisur në anësore në formë të çrregullt me emra telefoni.

Një faturë llogarie e një lokali.

Një copë fletë ku ka të shënuar një numër telefoni 0692820348.

Një copë fletë me ngjyrë të verdhë ku është shënuar CEKU 24x4=96 dhe poshtë saj emri Gori.

Një sasi prej 20.000 lekë të reja të prerjeve 3x5000 dhe 5x1000.

Sasia prej 60 euro me prerje 2x20 dhe 2x10, sasia prej 2500 lekë të reja me prerje 1x1000 dhe 3x500.

Leje Qarkullimi me nr.BR 0001221 për automjetin me targa BR 1852 B në emër të shtetasit Shezai Gega.

Leje Qarkullimi Ndërkombëtar me nr.0092681 në emër të shtetasit Shezai Gega.

Taksë vjetore e qarkullimit rrugor lëshuar më datë 03.10.2007.

Taksë e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor lëshuar më datë 03.10.2007.

Katër mandate arkëtimi në emër të shtetasit Shezai Gega të D.P.SH.T.R. (dy me ngjyrë të verdhë dhe dy me ngjyrë blu).

Çertifikatë me numër 221, datë 11.11.2005 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nga Komuna Kutalli në emër të shtetasit Shezai Gega.

Tre mandate peshimi me numër serie 0078171 dhe 0047791.

Dokument në gjuhën greke për automjetin me targë BR 1852 B me nr.1101.

Policë sigurimi e detyrueshme e mjeteve motorike me nr.Serie 0354780 dhe nr.976, datë 03.10.2007.

Çertifikatë Ndërkombëtare e Sigurimit Motorik me nr.AL 020000942976.

Asgjësimi i lëndës narkotike të llojit Cannabis Sativa në peshë 160 kilogram.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.19, datë 25.03.2009 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.10, datë 11.02.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë si më poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Shezai Gega për veprën penale parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i parë i K.Penal dhe dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, dënimin e tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs i pandehuri Shezai Gega nëpërmjet përfaqësuesit të tij, avokatit Qazim Gjonaj, i cili kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, duke u deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 e 22 i K.Penal. Në thelb, në rekurs parashtrohen këto shkaqe:

- Kundërshtoj vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, vetëm për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale. Gjykatat kanë gabuar në lidhje me cilësimin ligjor të veprës sipas nenit 283/a/1 të K.Penal, në një kohë që i pandehuri Gega është akuzuar për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike të mbetur në tentativë 283/a/1 e 22 të K.Penal. Ai nuk mund të përgjigjet për veprën penale të kryer pasi nuk ka kaluar kufirin.
- Pronësia e kamionit është vërtetuar që është e të pandehurit, por pronësia e lëndës narkotike nuk është zbuluar akoma.
- Kamioni në fjalë i është dorëzuar shoferit Agron Rrushi për të cilin është vendosur mos fillimi i procedimit penal. Dorëzimi është bërë prej datës 30.01.2008 dhe nga ajo kohë i pandehuri Gega nuk ka pasur kontakt me shoferin. Edhe para marrjes në dorëzim të kamionit nga shoferi Agron Rrushi ka qenë në pikë ruajtje në qytetin e Sarandës.
- Në një nga pakot që janë gjetur në makinë kanë dalë gjurmë të një personi që i pandehuri nuk e ka njohur më parë dhe është dërguar për gjykim në gjykatën e rrethit për veprën penale të mbajtjes së lëndës narkotike.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. s'ka, datë 27.10.2010, ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim njehsimin e praktikës gjyqësore, lidhur me fazën e tentativës në veprën penale të parashikuar nga neni 283/a të K.Penal.

Me këtë vendim Kolegji Penal shtron për diskutim çështjet si më poshtë:

1. *Nëse lënda narkotike e ardhur nga një shtet dhe e destinuar për një shtet tjetër i kapet autorit brenda territorit të shtetit shqiptar a do e bëjë veprën të kualifikuar si trafikim të kryer, apo të mbetur në fazën e tentativës?*

2. *Nisur nga përmbajtja e dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal sipas të cilit forma të kryerjes së kësaj vepre janë: "importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin të substancave narkotike e ...", cila do të jetë faza e tentativës në kryerjen e kësaj vepre penale në rastin e tranzitimit, ndërkohë që vepra penale konsiderohet e kryer edhe vetëm duke e importuar, eksportuar apo tregtuar?*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Aleksandër Muskaj; prokurorin Bujar Sheshi, i cili për zbatim të drejtë të ligjit kërkoi të pranohet rekursi i të gjykuarit dhe mbrojtësit duke ndryshuar vendimet e dhëna nga të dy gjykatat, duke e cilësuar veprën penale të kryer nga i pandehuri Gega të mbetur në fazën e tentativës sipas neneve 283/a, paragrafi i parë e 22 të Kodit Penal, duke e lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për pjesët e tjera; dhe pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

V Ë R E J N Ë

IV. *Rrethanat e faktit*

2. Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore dhe vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, u rezultojnë të pranuar prej tyre rrethanat si vijon:

Prokurori për Krime të Rënda Tiranë ka filluar procedimin penal në ngarkim të të pandehurit Shezai Gega, duke e akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të narkotikeve”, e mbetur në tentativë, vepër kjo e parashikuar nga nenet 283/a e 22 të Kodit Penal.

Më datë 31.01.2008 rreth orës 07.30 të mëngjesit, në pikën kufitare të Kakavijës, gjatë një kontrolli të ushtruar në kamionin tip “Volvo” me targë BR 1852 B, janë gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale 131 pako të mbështjella me natriban, në brendësi të së cilave dyshohej se kishte lëndë narkotike. Në kushtet e mësipërme është bërë arrestimi në flagrancë i drejtuesit të automjetit, shtetasit Agron Rrushi si dhe kanë filluar kërkimet për pronarin e kamionit me targë BR 1852 B, pra për shtetasin Shezai Gega.

Është filluar procedimi penal për të dy shtetasit e mësipërm, por për shtetasin Agron Rrushi (shofer i kamionit) është vendosur pushimi i procedimit penal pasi nuk është provuar që ky të jetë marrë me transportimin e kësaj ngarkese.

Procedimi ka filluar për pronarin e automjetit, Shezai Gega, pasi ky dyshohet që është autori i kryerjes së veprës penale të mësipërme, të mbetur në tentativë.

3. Çështja është gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe rrethanat e kryerjes së veprës pranohen njësoj si nga organi i akuzës, ashtu edhe nga gjykatat.

Por, ndërsa i pandehuri është dërguar për gjykim me akuzën e veprës penale të parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pra vepra e mbetur në fazën e tentativës, Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.10, datë 11.02.2009, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Shezai Gega për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, vepër kjo e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, duke e konsideruar atë të kryer plotësisht dhe duke u dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal.

4. E vënë në lëvizje mbi ankimin e të gjykuarit Gega, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me kryerjen e veprës penale, duke e ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm për sa i përket masës së dënimit të dhënë ndaj të pandehurit Shezai Gega.

5. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs i pandehuri Shezai Gega, i cili kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, duke u deklaruar fajtor për veprën penale të mbetur në fazën e tentativës, sikurse parashikohet nga nenet 283/a, paragrafi i parë dhe 22 të Kodit Penal.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 27.10.2010, ka vendosur të kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore. Në mënyrë të përmbledhur, Kolegji Penal ka marrë këtë vendim dhe ka parashtruar për diskutim çështjet për unifikim duke pasur parasysh se, ndonëse çështja është gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe rrethanat e kryerjes së veprës pranohen njësoj si nga organi i akuzës dhe gjykatat, i pandehuri është dërguar për gjykim me akuzën e veprës penale të parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pra vepra e mbetur në fazën e tentativës, ndërsa prej të dyja gjykatave është konsideruar e kryer plotësisht, duke u dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave, por edhe të vetë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vërehen qëndrime të ndryshme madje edhe të kundërta për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale të trafikimit të lëndëve narkotike, veçanërisht rreth konsumimit apo mbetjes në tentativë të kësaj vepre penale. Këto qëndrime e kanë sjellë Kolegjin Penal në përfundimin se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim njehsimin e praktikës gjyqësore, duke i parashtruar dy çështjet e sipërpërmendura për unifikim.

V. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara

7. Kolegjet e Bashkuara, nga shqyrtimi i rekursit të paraqitur nga i pandehuri Shezai Gega dhe mbrojtësi i tij, vërejnë se, në thelb, përveç pretendimeve të tjera për vlerësim të gabuar nga gjykatat të provave lidhur me rrethanat e çështjes, parashtrohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin penal material vetëm për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale sipas nenit 283/a, paragrafi i parë të Kodit Penal, për shkak se ai është akuzuar dhe duhet të përgjigjet për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike të mbetur në tentativë neni 283/a, paragrafi i parë dhe 22 të Kodit Penal. Ai nuk mund të përgjigjet për veprën penale të kryer pasi nuk ka kaluar kufirin.

8. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme, në thelb, parashtrori përpara Kolegjeve të Bashkuara se të gjitha format e trafikimit të narkotikëve kanë fazën e tyre të tentativës. Për të përcaktuar nëse vepra është konsumuar apo ka mbetur në fazën e tentativës ka shumë rëndësi qëllimi i autorit apo autorëve të veprës penale, si dhe momenti dhe vendi i kapjes së narkotikëve.

Nëse provohet se lënda narkotike nuk është prodhuar në vend për t'u eksportuar jashtë, apo nuk është importuar për t'u përdorur në tregun e brendshëm vepra cilësohet si tranzitim. Nëse lënda narkotike kapet në çastin e hyrjes në kufirin shtetëror vepra cilësohet si e mbetur në tentativë. Nëse kapet në brendësi të territorit kemi të bëjmë me tranzitim të konsumuar plotësisht.

9. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe qëndrimeve të palëve në gjykim, për t'i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për njehsimin e praktikës gjyqësore, gjithmonë në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në rekursin e të gjykuarit për zbatim të gabuar të ligjit penal material nga ana e gjykatave, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh kuptimi e zbatimi i dispozitave të Kodit Penal lidhur me tentativën (neni 22) dhe ajo mbi trafikimin e narkotikëve (neni 283/a).

10. Kështu, në dispozitën e nenit 22 parashikohet se :

“Neni 22

Kuptimi i tentativës

Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij”.

Në interpretim të drejtë të kësaj dispozite, në thelb, në rastin e tentativës, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për të kryer veprën penale, ajo ndërpritet dhe nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

Pra, në dallim nga përgatitja, e cila lidhet me krijimin e kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e veprës penale si fillim i materializimit të mendimit kriminal dhe vënies në lëvizje për kryerjen e veprimeve nga autori, në rastin e tentativës jemi përpara kryerjes së veprimeve nga ana e personit, të cilat, për vetë mjetet, mënyrat dhe kohën kur realizohen, synojnë dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në drejtim të shkakimit të pasojave të dëshiruara të veprës penale, pra duke e sjellë atë shumë afër ardhjes së pasojës kriminale të dëshiruar nga autori.

11. Nga ana tjetër, në dispozitën e nenit 283/a të Kodit Penal parashikohet se :

“Neni 283/a

Trafikimi i narkotikëve

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet”.

12. Kolegjet e Bashkuara, duke vërejtur se ka qëndrime të ndryshme madje edhe të kundërta në praktikën tonë gjyqësore, për sa i përket figurës së veprës penale të trafikimit të narkotikëve, për rrjedhojë të kësaj edhe lidhur me përfundimin nëse vepra është kryer apo ka mbetur në tentativë, vlerësojnë të parashtrajnë disa aspekte të interpretimit të drejtë të dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal *“Trafikimi i narkotikëve”*.

Legjislacioni jonë penal nëpërmjet kësaj vepre penale synon mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar kontrollin dhe rendin në veprimtaritë e importimit, eksportimit, tranzitimit dhe tregtimit ndërkombëtar të narkotikëve, kundër veprimeve e mosveprimeve kriminale.

Po kështu, me anë të kësaj dispozite, në harmoni e plotësim reciprok me dispozita të tjera penale, ligjvënësi synon edhe mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për garantimin e jetës, shëndetit, familjes dhe të drejtave të tjera e objektivave sociale në një shoqëri demokratike. Kjo veprimtari kriminale, nëpërmjet nxitjes, sigurimit të burimeve dhe të rrjeteve të përhapjes së përdorimit të paligjshëm, abuziv, të lëndëve narkotike e psikotrope, si në nivel kombëtar edhe ndërkombëtar, ka një ndikim negativ vendimtar, veç të tjerave, jo vetëm në dëmtimin e shëndetit dhe krijimin e varësisë të përdoruesve nga këto lëndë, por edhe në dëmtimin e shëndetit e të pasurisë, pra të cilësisë së jetës personale e familjare dhe zhvillimin normal të shoqërisë, veçanërisht të brezit të ri.

13. Kjo vepër penale kryhet me dashje, me anë të veprimeve a mosveprimeve të kundërligjshme. Sipas rastit, ajo kryhet për motive apo edhe me qëllime nga më të ndryshmet, të fokusuara veçanërisht tek ato që lidhen me përfitimin material.

14. Në nenin 283/a të Kodit Penal, në mënyrë të shprehur qartë parashikohet se janë të dënueshme penalisht importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, *në kundërshtim me ligjin*, i substancave narkotike dhe lëndëve psikotrope.

Legjislacioni jonë përmban rregullime të posaçme për sa i përket çdo lloj veprimtarie që lidhet me substancat narkotike dhe lëndët psikotrope. Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohen Ligji nr.7975, datë 26.7.1995 *“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”* (i ndryshuar) dhe Ligji nr.8874, datë 29.3.2002 *“Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”*.

Këto ligje, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre, parashikojnë rregulla të qarta për kushtet, kriteret dhe procedurat, teknike e ligjore, për lejimin, autorizimin dhe disiplinimin e veprimtarive për prodhimin, fabrikimin, tregtimin, shpërndarjen me shumicë dhe pakicë, transportimin, furnizimin, dhënien kundrejt pagesës ose falas, blerjen, importimin, eksportimin, kalimin tranzit, vënien në përdorim e mbajtjen për qëllime mjekësore, studimore e shkencore ose për qëllime të tjera industriale apo në të tjera veprimtari, të atyre substancave narkotike dhe lëndëve psikotrope që nuk janë të ndaluara për t’u qarkulluar. Këto veprimtari mund të ushtrohen vetëm nga subjekte të autorizuara posaçërisht për këtë qëllim sipas ligjit nga autoritetet kompetente.

15. Veprimtaria kriminale e trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a të Kodit Penal synon pikërisht të realizojë përfitime, duke vënë në qarkullim e tregtim ndërkombëtar lëndë

narkotike e psikotrope, qarkullimi i të cilave është i ndaluar me ligj apo duke tregtuar pa autorizim të posaçëm lëndë të tilla edhe pse ato lejohen të qarkullohen, apo duke shkelur me dashje kushtet e autorizimit dhe rregullat e vënies në qarkullim e tregtim të këtyre lëndëve narkotike e psikotrope.

Prandaj, në kuptim të nenit 283/a, ashtu sikurse në rastin e nenit 283 të Kodit Penal, me shprehjen “*në kundërshtim me ligjin*”, përfshihet pikësëpari kryerja e veprimeve a veprimtarive me substanca narkotike e psikotrope nga ato që janë të ndaluara me ligj për t’u vënë në qarkullim. Së dyti, kryerja e veprimeve e veprimtarive me substanca të tilla të lejueshme për qarkullim por për qëllime jashtë atyre të parashikuara e të lejuara nga ligji. Së treti, kryerja e veprimtarive me substanca të tilla të lejueshme për qarkullim por pa qenë i pajisur me autorizimet përkatëse apo në shkelje e kapërcim të kushteve të parashikuara në autorizim, të cilat kualifikohen si veprime a mosveprime të atilla që përbëjnë veprë penale e jo më shkelje administrative.

16. Nisur nga parashtrimi i mësipërm, subjekt i krimeve të parashikuara nga nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal mund të jetë çdo person fizik a juridik. Pra, subjekt mund të jetë çdo person, i cili nuk është i pajisur me autorizim apo edhe nëse është i pajisur me autorizim, kur ai kryen veprime e veprimtari të kundërligjshme lidhur me substancat narkotike e psikotrope, substanca e veprime, të cilat, janë të ndaluara, të ndryshme apo në kapërcim të qëllimeve, kushteve e procedurave që parashikon ligji lidhur me to, si dhe të atyre që përmbahen në autorizimin e posaçëm të lëshuar nga organi kompetent.

17. Sikurse në rastin e nenit 283, ashtu edhe në nenin 283/a, kriter i përbashkët për kryerjen e veprës penale të trafikimit të narkotikëve, të konsumuar apo të mbetur në tentativë, pavarësisht nga mënyra e forma e kryerjes së veprës, është *kriteri i mbajtjes* së substancës narkotike e psikotrope, kriter ky që ka të bëjë me kontaktin e subjektit me këtë substancë apo kapacitetin e tij për të kryer, drejtpërdrejt apo në bashkëpunim me të tjerë, veprime nga më të ndryshmet në lidhje me këtë substancë deri edhe në disponimin e saj në raport me të tretët.

18. Por vepra penale e parashikuar nga neni 283/a, në të katër format bazë të kryerjes së saj, dallohet nga ajo e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Në thelb, veçanti e legjislacionit tonë penal është se ky dallim lidhet pikërisht me natyrën transnacionale të kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal.

19. Termi juridik i “trafikimit” njihet dhe përdoret tashmë gjerësisht nga akte të së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacione të vendeve të ndryshme. Në mënyrë të përgjithshme, në fushën e së drejtës, me *trafikim* është kuptuar veprimtaria a tregtimi, kombëtar ose ndërkombëtar, i paligjshëm, i mallrave dhe shërbimeve.

Bazuar në traditën dhe përvojën e mëparshme, por edhe në dispozitat e Konventës së Palermos si dhe të disa akteve të tjera ndërkombëtare, në legjislacionin tonë penal, janë parashikuar, ndryshuar e plotësuar një numër veprash penale lidhur me vënien në qarkullim e tregtimin e paligjshëm kombëtar e ndërkombëtar dhe, në tërësi, për veprimtaritë e paligjshme me persona si dhe mallra e shërbime të caktuara, si në rastin kur kjo veprimtari kriminale synon apo realizohet vetëm në territorin shqiptar, ashtu edhe kur kjo veprimtari shtrihet apo intereson edhe shtete të tjera.

20. Kështu, ligjvënësi, për rastet kur vepra ka karakter transnacional, ka përdorur në Kodin tonë Penal termin e përgjithshëm “trafikim” për titullimin e veprës (nenet 110/a, 114/b, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a, 282/a dhe 283/a).

Sipas legjislacionit tonë penal, pavarësisht nga personat e llojet e mallrave që trafikohen dhe origjinën e tyre, në thelb, trafikimi nënkupton rastet kur veprimtaria e kundërligjshme, duke përfshirë Shqipërinë e territorin e saj, kryhet në më shumë se një shtet, kryhet në një shtet por është përgatitur, programuar, drejtuar e kontrolluar në një shtet tjetër, kryhet në një shtet por ka efekte e pasoja thelbësore në një shtet tjetër.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se, *kriter bazë për kuptimin e zbatimit e drejtë të veprave penale të “trafikimit” sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar.*

Sikurse në përgjithësi, edhe për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal, zonat e tranzitit në stacionet, portet dhe aeroportet ndërkombëtare të vendit, janë pjesë e territorit shqiptar.

21. Në këtë kuptim, edhe në rastin e mallrave e shërbimeve të lidhura me substancat narkotike e psikotrope dispozitat penale bazë janë nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal.

Në thelb, neni 283 mbulon rastet kur kjo veprimtari e paligjshme synon, realizohet dhe intereson vetëm territorin shqiptar. Ndërsa neni 283/a mbulon rastet kur veprimtaria dhe pasojat e saj kanë karakter transnacional. Pra, të gjitha situatat e mundshme të kryerjes së veprimtarisë kriminale me narkotikë e substanca psikotrope, në varësi të rrethanave të faktit që rezultojnë rast pas rasti, janë të mbuluara nga dispozitat e neneve 283, 283/a e vijuese të Kodit Penal.

22. Vepra penale e trafikimit të narkotikëve kryhet qoftë edhe në njërin nga mënyrat e parashikuara nga neni 283/a i Kodit Penal, pra në ato të importimit, eksportimit, tranzitimit apo të tregtimit.

23. Në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 283/a, nëse është kryer nga dy ose më shumë persona dhe pavarësisht nga forma e bashkëpunimit, bashkëpunëtorët përgjigjen për veprën penale të trafikimit të narkotikëve. Por në vendimin e dënimit duhet të individualizohet për secilin bashkëpunëtor mënyra e kryerjes së veprës penale. Në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, jo domosdoshmërisht të gjithë bashkëpunëtorët përgjigjen për të njëjtën mënyrë të kryerjes së kësaj vepre penale. Sjelljet e autorit apo të bashkëpunëtorëve në kryerjen e kësaj vepre në raport me substancën narkotike e psikotrope janë alternative dhe autonome.

24. Sikurse parashtrohet më sipër në këtë vendim, dispozita e nenit 283/a të Kodit Penal, ndonëse parashikon katër mënyra të kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve, ajo në thelb është veprimtari, tregtim i paligjshëm ndërkombëtar i substancave narkotike e psikotrope.

25. Por, përcaktimi konkret i mënyrës së kryerjes së kësaj vepre penale, veç të tjerave, është thelbësor si për të vlerësuar e disponuar nëse jemi përpara veprës penale të kryer apo të mbetur në tentativë, ashtu edhe për individualizimin e dënimit për autorin apo secilin bashkëpunëtor.

Pra, duke zbërthyer në dispozitën e nenit 283/a mënyrat bazë (ana objektive) të kryerjes së kësaj vepre penale, ligjvënësi synon jo vetëm të qartësojë vullnetin e tij mbi nocionin juridik të kësaj veprimtarie kriminale, se për çfarë është e dënueshme penalisht, por edhe që t'i mundësojë subjekteve të procedimit penal që të ushtrojnë të drejtat e detyrimet e tyre në të gjitha fazat dhe aspektet e këtij procedimi, duke përfshirë edhe debatin e vendimmarrjen mbi quajtën të kryer apo të mbetur në tentativë të kësaj vepre penale.

26. Përpara se të parashtrorë kuptimin e secilës mënyrë bazë të veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a (importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi), duke qenë njëkohësisht mënyra të zakonshme e të njohura të veprimtarisë së tregtisë ndërkombëtare, Kolegjet e Bashkuara çmojnë që të evidentojnë më parë disa aspekte që lidhen me thelbin e kuptimit ekonomik e tregtar të këtyre veprimeve e veprimtarive.

27. Kështu, *tregtimi* është veprimtaria e vënies në qarkullim ekonomik e tregtar, nëpërmjet shitjes, blerjes, shkëmbimit, dhënies e marrjes, në çdo mënyrë e formë tjetër, të mallrave dhe shërbimeve për qëllime ekonomike e tregtare.

Importimi është veprimtaria e sjelljes së mallrave dhe shërbimeve nga një shtet tjetër, kryesisht për qëllime ekonomike dhe tregtare.

Eksportimi është veprimtaria e dërgimit të mallrave dhe shërbimeve në një shtet tjetër, kryesisht për qëllime ekonomike dhe tregtare.

Importimi dhe eksportimi janë edhe dy nga mënyrat e *tregtimit ndërkombëtar* të mallrave dhe shërbimeve.

28. Ndërsa, *tranzitimi* është veprimtaria e mbartjes, lëvizjes, shoqërimit dhe transportimit të qenieve të gjalla dhe sendeve (p.sh. mallrave) nga një vend në një vend tjetër, një mënyrë a segment i transportimit të tyre, me veçantinë se, gjatë tranzitimit, këto qenie e sende qëndrojnë përkohësisht apo kalojnë nëpërmjet vendeve të tjera të ndryshme nga ai nisjes dhe mbërritjes së synuar.

Pra, tranzitimi është një mënyrë e kryerjes së veprimtarisë së transportimit a transportit nga pika e nisjes drejt destinacionit të synuar, që realizohet e shtrihet në një pjesë a segment të ndërmjetëm të kësaj veprimtarie.

29. Edhe dispozita e nenit 283/a të Kodit Penal, për sa i përket anës objektive të kryerjes së saj, parashikon dhe përfshin të gjitha veprimet e mosveprimet për arritjen e qëllimit, rezultatit kriminal, pikërisht duke i përfshirë të gjitha mënyrat e realizimit të veprimeve dhe veprimtarive të njohura e të lidhura me tregtimin e qarkullimin ndërkombëtar të mallrave, posaçërisht të substancave narkotike, psikotrope dhe të farërave të bimëve narkotike. Kjo dispozitë evidenton si mënyra të posaçme *importimin, eksportimin e tranzitimin*, duke përfshirë në termin “*tregtim*” të gjitha mënyrat e tjera të mundshme të tregtimit e qarkullimit ndërkombëtar të mallrave, posaçërisht të narkotikëve.

Veprimin kriminal dhe mënyrat e kryerjes së tij i lidh me zbatimin e nenit 283/a të Kodit Penal pikërisht realizimi i tyre nga subjektet e veprës penale duke vepruar me dashje dhe *në kundërshtim me ligjin*, përderisa lëndët narkotike i nënshtrohen një regjimi juridik ndalimi apo kufizimesh për vënien në qarkullim të tyre, regjim i cili kufizon dhe disiplinon posaçërisht edhe rrethin e subjekteve që autorizohen për këtë qëllim.

30. Subjekti i veprës penale të parashikuar nga neni 283/a, me dashje, kryen veprime a mosveprime që janë të kundërligjshme, duke parashikuar ardhjen e pasojave të kësaj vepre penale. Pasoja e kësaj vepre penale lidhet me cënimin e marrëdhënieve juridiko-penale të posaçme të vendosura në drejtim të qarkullimit të lëndëve narkotike dhe, posaçërisht, të regjimit të qarkullimit të tyre (a) nga territori i shteteve të tjera me destinacion të fundit territorin shqiptar ose (b) nga territori shqiptar me destinacion territorin e një shteti tjetër, si edhe (c) nëpërmjet zhvendosjes e transportimit të tyre nga territori i shteteve të tjera, nëpërmjet territorit shqiptar, drejt territorit të shteteve të tjera.

Prandaj, edhe pasoja të kësaj vepre penale të cilat sjellin përgjegjësi penale, vijnë pikërisht me kryerjen me dashje të veprimeve a mosveprimeve për hyrjen e lëndëve narkotike në territorin shqiptar ose daljen prej këtij territori, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat e dëshiruara nga subjektet e veprës penale, nëse ata kanë realizuar apo jo të gjitha motivet dhe qëllimet për kryerjen e veprës, sikurse janë padyshim mbërritja e lëndës narkotike në destinacionin, tek personat e synuar brenda apo jashtë vendit, pas kalimit të saj nëpërmjet kufirit tonë shtetëror.

31. Në vijim dhe bazuar në parashtrimin e mësipërm të elementëve thelbësore të lidhura me subjektin, anën subjektive, anën objektive dhe objektin e veprës penale të parashikuar nga dispozita e nenit 283/a të Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se është vendi për të parashtruar edhe thelbin e kuptimit të mënyrave të kryerjes së kësaj vepre penale.

32. *Importimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar

nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje, duke përdorur çfarëdo mjete a forme veprimi a mosveprimi, i sjellin këto lëndë nga territori i një shteti tjetër në territorin shqiptar, me synimin për t'i vënë në qarkullim në territorin shqiptar.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e importimit, sipas nenit 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të qëllimit për ta sjellë (importuar) lëndën narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, nga një shtet tjetër në Shqipëri, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal. Po kështu, nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cili ishte synimi i mëtejshëm i autorëve të veprës pas hyrjes së lëndës narkotike në territorin shqiptar, pra forma e natyra e parashikuar prej tyre për të përfituar dhe gjithsesi për vënien në qarkullim të saj pas realizimit të importimit.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e veprës as natyra e veprimeve e mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të importimit të lëndës narkotike, përderisa këto elementë të anës objektive të kryerjes së krimit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt arritjes së qëllimit kriminal të importimit të lëndës narkotike nga një shtet tjetër në territorin shqiptar (si p.sh. krijimi i kushteve për kërkimin dhe gjetjen e lëndës narkotike, për marrjen, mbajtjen, ruajtjen dhe transportimin e saj nga territori i shtetit tjetër në territorin shqiptar, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

33. *Eksportimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje, duke përdorur çfarëdo mjete e forme veprimi a mosveprimi, i dërgojnë këto lëndë nga territori shqiptar në territorin e shteteve të tjera, me synimin për t'i hedhur në qarkullim në territorin e atyre shteteve.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e eksportimit, sipas nenit 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të qëllimit për ta dërguar (eksportuar) lëndën narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, nga territori i Republikës së Shqipërisë në territorin e një shteti tjetër, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal. Po kështu, nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cili ishte synimi i mëtejshëm i autorëve të veprës pas hyrjes së lëndës narkotike në territorin e shtetit tjetër, pra forma e natyra e parashikuar prej tyre për të përfituar dhe gjithsesi për vënien në qarkullim të saj pas realizimit të eksportimit.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e veprës as natyra e veprimeve e mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të eksportimit të lëndës narkotike, përderisa këto elementë të anës objektive të kryerjes së krimit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt arritjes së qëllimit kriminal të eksportimit të lëndës narkotike nga territori shqiptar në territorin e një shteti tjetër (si p.sh. krijimi i kushteve për kërkimin dhe gjetjen e lëndës narkotike, për marrjen, mbajtjen, ruajtjen dhe transportimin e saj nga territori i shqiptar në territorin e shtetit tjetër, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

34. *Tregtimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje, realizojnë çfarëdo transaksioni a veprimi tjetër financiar e tregtar, të ndryshëm nga ato të importimit dhe eksportimit, brenda apo jashtë territorit shqiptar, me qëllimin për të vënë lëndët narkotike në qarkullim ndërkombëtar ekonomik e tregtar, nëse këto veprimtari zhvillohen apo sjellin pasoja në territorin shqiptar, nëse kryen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasve shqiptarë.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e *tregtimit*, sipas kuptimit të posaçëm të tij në nenin 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të *qëllimit për të krijuar kushte dhe realizuar çfarëdo transaksioni a veprimi financiar e tregtar (të ndryshëm nga ai i importimit dhe eksportimit) për vënien e lëndëve narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, në qarkullimin ekonomik e tregtar ndërkombëtar*, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal. Nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cila është forma e natyra e përfitimit e parashikuar nga autorët e saj si rezultat i krijimit të kushteve dhe vënies në qarkullim tregtar të lëndës narkotike.

Forma të ligjshme të ushtrimit të transaksioneve dhe veprimeve për tregtimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike të lejueshme për qarkullim, të ndryshme nga ato të importimit dhe eksportimit, janë ato që parashikohen posaçërisht nga ligji, aktet nënligjore normative të nxjerra në bazë e zbatim të ligjit, si dhe nga kushtet e përmbajtura në autorizimin e lëshuar për këtë qëllim subjektit nga organi kompetent.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e veprës as edhe natyra e veprimeve e mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të tregtimit (ndërkombëtar) të lëndës narkotike, përderisa këto elementë të anës objektive të kryerjes së kriminit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt arritjes së qëllimit kriminal të tregtimit ndërkombëtar të lëndës narkotike (si p.sh krijimi i kushteve dhe kryerja e çdo veprimtarie tjetër për realizimin e tregtimit ndërkombëtar të lëndës narkotike, të ndryshme nga ato për importimin e eksportimin, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

35. *Tranzitimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje, duke përdorur çfarëdo mjeti e forme veprimi a mosveprimi, i mbartin, ruajnë, shoqërojnë, lëvizin dhe transportojnë këto lëndë përgjatë territorit të Republikës së Shqipërisë, me synimin për t’i kaluar, nëpërmjet tij, nga territori i një shteti në territorin e një shteti tjetër.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e tranzitimit, sipas nenit 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të *qëllimit për ta mbartur, ruajtur, shoqëruar e transportuar (tranzituar) lëndën narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, përgjatë territorit shqiptar, si një segment apo pjesë e segmenteve të ndërmjetëm të transportimit nga shteti i nisjes drejt atij të destinuar për t’u vënë në qarkullim lënda narkotike e tranzituar*, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cila është natyra e veprimeve a mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të tranzitimit të lëndës

narkotike, përderisa këto elementë të anës objektive të kryerjes së krimit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt arritjes së qëllimit kriminal të tranzitimit të lëndës narkotike nëpërmjet territorit shqiptar (si p.sh. krijimi i kushteve për marrjen në dorëzim, mbartjen, ruajtjen, shoqërimin, lëvizjen dhe transportimin e saj përgjatë territorit shqiptar, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

36. Bazuar në arsyetimet dhe parashtrimet e mësipërme lidhur me kuptimin dhe interpretimin e katër elementëve të figurës së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), *Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ka vend për të ardhur në përfundimin se ky krim, pavarësisht nga mënyra se si kryhet, mund të mbetet në fazën e tij paraprake të tentativës së kryerjes së veprës penale.*

Në këtë drejtim Kodi jonë Penal, përfshirë edhe dispozitën e nenit 283/a të tij, janë në harmoni me detyrimin që buron nga aktet e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Palermos, në të cilat Shqipëria është palë, ku përmbahen dispozita që kërkojnë dhe orientojnë shtetet anëtare, të parashikojnë në ligj tentativën dhe përgjegjësinë penale përkatëse, për veprat penale të trafikimit të mbetura në këtë fazë të veprimit kriminal.

37. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, në zbatim të drejtë të ligjit penal dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar penale, nisur nga veçantitë e mënyrës së kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) dhe duke qenë se kryhet me dashje, sipas rastit, autorët kanë përgjegjësi penale për kryerjen e veprës penale ose për veprën penale të mbetur në tentativë, nëse, krahas shfaqjes së mendimit kriminal dhe përgatitjes eventuale për të ardhmen, ata me dashje, kryejnë veprime e mosveprime konkrete dhe të drejtpërdrejta mbi objektin e krimit, me të cilat synojnë (aty për aty) arritjen e qëllimit kriminal, ardhjen e pasojave të dëshiruara prej tyre, pra kryerjen e veprës.

38. Sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim për kualifikimin e veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), ka rëndësi thelbësore të vërtetohet kryerja, me dashje, e veprimeve apo mosveprimeve, konkrete, për të realizuar, në mënyrë të kundërligjshme, qëllimin e dëshiruar nga autorët e veprës, pikërisht hyrjen (sjelljen) ose daljen (dërgimin) e paligjshëm të narkotikëve nga territori shqiptar ose kalimin e paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar në atë të shteteve të tjera, kryesisht për të realizuar përfitime të ndryshme për vete ose për të tretë.

39. Prandaj, lidhur me kryerjen e veprës penale apo mbetjen së saj në tentativë, duke pasur parasysh katër mënyrat e kryerjes së veprimit kriminal të trafikimit të narkotikëve, të parashikuara nga neni 283/a i Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimet unifikuese se:

a) *Vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e importimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike e ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ende mund të mos ketë mbërritur apo të ketë kaluar në pikat kufitare e doganore, stacionet, portet dhe aeroportet e vendit përfshirë këtu zonat e tyre të tranzitit. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, ka mbërritur ose jo tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin shqiptar.*

Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për importimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e importimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

b) *Vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e eksportimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, i është nënshtruar apo jo kontrollit policor e doganor të shtetit tjetër, nëse ka mbërritur tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin e atij shteti.*

Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për eksportimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal në territorin shqiptar, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e eksportimit e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

c) *Vepra penale e trafikimit të narkotikëve, në mënyrën e tregtimit (ndërkombëtar), sipas rastit dhe natyrës konkrete të veprimit a mosveprimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike ka kaluar, duke hyrë ose dalë nga kufiri tokësor, ajror a detar i Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ende mund të mos ketë mbërritur apo të ketë kaluar në pikat kufitare e doganore, në stacionet, portet dhe aeroportet e vendit përfshirë këtu zonat e tyre të tranzitit. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, ka mbërritur tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin shqiptar apo të shtetit tjetër.*

Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për tregtimin ndërkombëtar të saj, sipas rastit, nuk ka hyrë apo nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal brenda a jashtë vendit, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e tregtimit ndërkombëtar e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

ç) *Vepra penale e trafikimit të narkotikëve, në mënyrën e tranzitimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike, pas hyrjes në territorin shqiptar dhe qëndrimit apo lëvizjes brenda këtij territori, ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë drejt një shteti tjetër. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror shqiptar në shtetin tjetër, i është nënshtruar apo jo kontrollit policor e doganor të atij shteti, nëse ka mbërritur tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin e atij shteti.*

Kur lënda narkotike, e cila ka hyrë më parë në territorin shqiptar, megjithë veprimet a mosveprimet e mëtejshme, konkrete e të drejtpërdrejta, të autorëve të veprës për tranzitimin e saj jashtë këtij territori, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e tranzitimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së këtij veprimi kriminal brenda territorit shqiptar.

40. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit dhe përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur nga i gjykuari Shezai Gega, gjenden të bazuara në ligj, vetëm lidhur me kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale, pikërisht aty ku pretendohet se ai duhet të deklarohej fajtor për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike të mbetur në tentativë, sipas nenit 283/a/1 e 22 të Kodit Penal. I gjykuari nuk mund të përgjigjet për veprën penale të kryer pasi nuk ka kaluar kufirin shtetëror.

Nga vendimet e dhëna në të dy shkallët e gjykimit rezulton se gjykatat kanë pranuar si të provuar që në pikën kufitare të Kakavijës, gjatë një kontrolli të ushtruar në mjetin motorik në pronësi të së gjykuarit janë gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale 131 pako të

mbështjella me natriban, në brendësi të së cilave kishte lëndë narkotike të llojit Cannabis. Gjithashtu, në përfundim të hetimit gjyqësor, gjykatat kanë pranuar si të provuar se, i gjykuari Shezai Gega, pronar i mjetit motorik ku u gjend lënda narkotike, është autor i kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a të Kodit Penal.

41. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, si gjykata e apelit ashtu edhe ajo e shkallës së parë për krimet e rënda kanë zbatuar gabim ligjin penal material.

Së pari, ndonëse nuk ndryshon kualifikimin ligjor të veprës dhe, nga pikëpamja e anës objektive, janë mënyra të kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a i Kodit Penal, gjykatat duhet të kishin konkluduar, në mënyrë të shprehur, mbi vetë provat që kishin marrë dhe çmuar prej tyre, se në cilën nga mënyrat e parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni është kryer vepra penale. Kjo i shërben drejtpërdrejt thelbit të gjykimit penal, përcaktimit konkret dhe vërtetimit të fajësisë së të pandehurit për veprën penale që i atribuohet.

Së dyti, duke konkluduar paraprakisht mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a paragrafi i parë), bazuar në vetë provat e marra dhe rrethanat e faktit të pranuar prej tyre, rrjedhimisht gjykatat mund dhe duhet të konkludonin edhe nëse, në çështjen në gjykim, ndodhen përpara veprës penale të kryer apo të mbetur në tentativë.

42. Bazuar në provat e marra dhe rrethanat e faktit të pranuar si nga Gjykata e Shkallës së Parë ashtu edhe ajo e Apelit për Krime të Rënda, në gjykim ka rezultuar e provuar nga veprimet e mosveprimet e të pandehurit Shezai Gega se, pas sigurimit të lëndës narkotike në vend, ai ka vepruar më tej për arritjen e qëllimit të dërgimit të kësaj lënde narkotike jashtë territorit shqiptar, nëpërmjet pikës kufitare të Kakavijës. Por, duke qenë se lënda narkotike është gjetur e sekuestruar, gjatë një kontrolli të ushtruar në mjetin motorik në pronësi të të gjykuarit në pikën kufitare të Kakavijës, pra pa kaluar përtej kufirit shtetëror shqiptar, atëherë veprimtaria kriminale e tij është ndërprerë, pasojat e dëshiruara prej tij nuk kanë ardhur, për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

Në të tilla rrethana, Kolegjet e Bashkuara, për sa i përket zbatimit të ligjit penal material, çmojnë se vepra penale e kryer nga i pandehuri Shezai Gega duhet të kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e eksportimit, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi i parë dhe 22 të Kodit Penal.

43. Së fundi, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë që, shkaqet e tjera të ngritura në rekurs nuk lidhen me zbatimin e ligjit material e procedural penal në gjykimin e çështjes, por kanë të bëjnë vetëm me çmimin e provave nga gjykatat më të ulëta, që është atribut i gjykatave të faktit dhe jo i gjykatës së ligjit, sikurse është Gjykata e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të nenit 438 dhe të shkronjës “a” e “b” të pikës 1 të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të shkronjës “a” të nenit 17 të Ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”.

V E N D O S Ë N

1. Ndryshimin e vendimit nr.19, datë 25.03.2009 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.10, datë 11.02.2009 të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë në këtë mënyrë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Shezai Gega për veprën penale të trafikimit të narkotikëve e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi i parë e neni 22 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke iu zbritur një e treta e dënimit, dënimin e tij përfundimisht me 5 (pesë) vjet burgim.

Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera.

2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.

3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njehson praktikën gjyqësore.

Tiranë, më 24.01.2011

MENDIMI I PAKICËS

Unë, gjyqtari **Medi Bici**, jam kundër vendimit nr.3, datë 24.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për sa i përket ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga ajo e “Trafikimit të narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/a i K.Penal, në veprën penale të trafikimit të narkotikëve e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a-22 i K.Penal (vetëm për pjesën e tentativës), për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri Shezai Gega, prandaj në përputhje me nenin 112/5 të K.Pr.Penale, përpiloj këtë procesverbal përmbledhës me motivet e kundërshtimit të vendimit.

Nga shqyrtimi i çështjes ka rezultuar si më poshtë:

Me datë 31.01.2008 rreth orës 07.30 në pikën kufitare të Kakavijës është ushtruar kontroll në automjetin tip “Volvo” me targa BR 1852 B, i cili drejtohej nga shtetasi Agron Rrushi.

Nga kontrolli ka rezultuar se, në kamion gjendeshin 131 pako të mbështjella me natriban, në të cilat ishin ambalazhuar 160 kg lëndë narkotike e llojit Cannabis-Sativa.

Pas kryerjes së hetimeve paraprake organi i prokurorisë ka pushuar akuzën ndaj shoferit Agron Rrushi dhe ka sjellë për gjykim pronarin e makinës të gjykuarin Shezai Gega, i cili akuzohet për veprën penale të trafikimit të narkotikëve e mbetur në fazën e tentativës, parashikuar nga neni 283/a dhe 22 të K.Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda e kanë deklaruar fajtor të gjykuarin Shezai Gega për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike (pa tentativën), të parashikuar nga neni 283/a i K.Penal.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 27.10.2010 ka vendosur kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara, duke shtruar për zgjidhje çështjet e mëposhtme:

Nëse lënda narkotike e ardhur nga një shtet dhe e destinuar për një shtet tjetër i kapet autorit brenda territorit të shtetit shqiptar a do e bëjë veprën të kualifikuar si trafikim të kryer apo të mbetur në fazën e tentativës?

Nisur nga përmbajtja e nenit 283/a të Kodit Penal, sipas të cilit format e kryerjes janë: importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i substancave narkotike e, cila do të jetë faza e tentativës në kryerjen e kësaj vepre penale në rastin e tranzitimit, ndërkohë që vepra penale konsiderohet e kryer edhe vetëm duke e importuar, eksportuar apo tregtuar?

Ndryshe nga shumica, pakica vlerëson që vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i K.Penal, duke qenë një vepër penale me natyrë ndërkombëtare, nuk njeh kufi, pasi ajo realizohet në territorin e disa shteteve dhe kryhet në katër forma, të cilat janë:

eksportimi, importimi, tregtimi dhe tranzitimi.

Gjykata e apelit arsyeton se, lënda narkotike ishte e destinuar të dërgohej në shtetin e Greqisë, pasi makina që transportonte lëndën narkotike është kapur në pikën doganore të Kavavijës, vend ku ndodhet kufiri shqiptaro-grek.

Kjo provon faktin, që i gjykuari Shezai Gega e ka transportuar lëndën narkotike, nga vendi ku e ka siguruar atë, në një pikë të ndërmjetme, e cila nuk është destinacioni i fundit dhe pikërisht kjo lëvizje e narkotikut në territorin e vendit tonë, për mendimin e pakicës quhet tranzitim.

Sipas vlerësimit të pakicës termi tranzitim ka kuptimin e mëposhtëm:

Tranzitimi është dërgimi (transportimi) i "mallit" nga një pikë fillestare në një pikë tjetër të ndërmjetme (që nuk është destinacioni i fundit).

Transportimi i lëndës narkotike nga vendi ku e ka marrë i gjykuari Shezai Gega dhe deri në kufi, mendoj që është tranzitim dhe kjo nuk lidhet me faktin që mund të jemi ose jo vend origjine, sepse dalja e narkotikut nga kufijtë shtetëror quhet eksport dhe nuk do të ishte fare e nevojshme që legjislatori të shtonte një formë tjetër të kryerjes së veprës penale, atë të tranzitimit, kur mjaftonte eksportimi i lëndës narkotike, në mënyrë që subjekti i veprës penale të kishte përgjegjësi penale.

Arsyeja e vetme që legjislatori ka parashikuar tranzitimin si një nga katër format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve ka qenë fakti se do të mbeteshin pa u ndëshkuar trafikantët që lëviznin lëndën narkotike brenda vendit.

Vlerësimi im është, se mjafton të provohet fakti që lënda narkotike është e destinuar për jashtë shtetit dhe subjekti i veprës penale të transportojë atë nga një vend në një vend tjetër, i cili nuk është destinacioni i fundit, në mënyrë që ai të përgjigjet për formën e tranzitimit, sepse përndryshe do të ishim përpara veprës penale, të parashikuar nga neni 283 i K.Penal (forma e mbajtjes).

Nga mënyra se si është formuluar dispozita ligjore e parashikuar nga neni 283/ a të K.Penal, kuptohet me lehtësi se ajo është përshtatur me Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (Konventa e Palermos), e ratifikuar nga Parlamenti ynë me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

Në nenin 1 të kësaj Konvente thuhet:

Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin, për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar.

Jam i mendimit që vendimi i marrë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk e pasqyron frymën që përçon kjo Konventë tek vendet pjesëmarrëse në të, e cila është lufta e përbashkët për të ndaluar dhe luftuar me efektivitet krimin e organizuar ndërkombëtar.

Në vendimin e gjykatës, kjo Konventë përmendet shkarazi vetëm një herë si Konventa e Palermos, pa u bërë asnjë referim në të, çka tregon që megjithëse po bëhen afro 10 vjet nga ratifikimi i këtij akti ndërkombëtar, akoma praktika gjyqësore ka vështirësi në implementimin e saj, duke mos u kuptuar drejtë zinxhiri i lidhjes së krimin të organizuar dhe lufta kundër tij, të cilat nuk mund të realizohen me prerjen e hallkave të veçanta, por me shkatërrimin e gjithë zinxhirit të krimin.

Nëse do të dënohen anëtarët e grupeve të organizuara kriminale për vepra penale të mbetura në tentativë, atëherë si do ta justifikonim lëvizjen e narkotrafikut nga një vend i lindjes së largët drejt vendit tonë, siç është rasti i trafikut të heroinës, ose nga një vend i Amerikës së Jugut drejt vendit tonë, siç është rasti i kokainës.

Është e rëndësishme të theksohet se me Ligjin 8722, datë 26.12.2000 vendi ynë ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope, e cila në nenin 1 të saj thotë:

"Shtet tranzit" nënkupton një shtet nëpër territorin e të cilit kalojnë droga narkotike, lëndë psikotrope dhe lëndë të paligjshme të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, territori i të cilit nuk është as vendi i origjinës as vendi i destinacionit të tyre.

Vlerësimi i pakicës është se në rastin trafikimit të heroinës dhe të kokainës territori i vendit tonë nuk është vend origjine, pasi këto lëndë narkotike nuk mund të prodhohen në Shqipëri, prandaj kur vendi ynë nuk është destinacioni i fundit, atëhere kalimi i këtyre drogave nëpër territorin e vendit tonë do të ishte tranzitim.

Ndryshe qëndron puna në rastin në gjykim, kur lënda narkotike është e llojit Cannabis Sativa, ku vendi ynë mund të jetë edhe vend origjine, pasi kjo lëndë narkotike kultivohet në mënyrë të paligjshme në disa pjesë të territorit të Shqipërisë, megjithë luftën që bëjnë strukturat e posaçme të shtetit për eliminimin e këtij fenomeni.

Duke qenë vend origjine nuk mund të konsiderohemi shtet tranzit sipas përcaktimit të Konventës, prandaj lind pyetja se lëvizja e Cannabis Sativës nga vendi ku është prodhuar e deri në kufirin ku është kapur çfarë duhet konsideruar?

Mendimi i pakicës është që kjo lëvizje e lëndës narkotike duhet të konsiderohet tranzitim, sepse përndryshe kjo formë e veprës penale nuk duhet të ishte parashikuar në ligj, pasi ajo nuk mund të zbatohet asnjëherë dhe veprimtaria kriminale e subjektit të krimit nga momenti i shtënies në dorë të lëndës narkotike dhe dërgimi i saj deri në pikën kufitare ku është kapur do të mbetet e pa dënuar, gjë e cila do të ishte e padrejtë.

Pakica ka mendimin se, vetëm në dy raste tranzitimi mbetet në tentativë, të cilat janë:

1. Kur lënda narkotike importohet nga jashtë dhe subjekti i veprës penale, i cili nuk ka marrë pjesë në importim, kapet ose zbulohet në momentin që merr në dorëzim lëndën narkotike, por pa filluar lëvizjen e saj nëpër territorin shqiptar me qëllim dërgimin e saj në një vend tjetër.

2. Kur lënda narkotike është prodhuar në vend (Shqipëria është vendi i origjinës), subjekti i veprës penale kapet ose zbulohet në momentin që merr në dorëzim lëndën narkotike me qëllim për ta transportuar atë drejt kufirit të shtetit tjetër, por pa marrë pjesë në eksportin e saj.

Dy rastet e përmendura më sipër kam mendimin se vlejné vetëm për bashkëpunimin e thjeshtë, ose në rastin kur vepra penale kryhet nga një person i vetëm, gjë e cila në praktikë është mjaft e vështirë të ndodhë, pasi këto vepra penale zakonisht kryhen nga organizatat kriminale dhe grupet e strukturuar kriminale, anëtarët e të cilave në bazë të nenit 28/6 të K.Penal kanë përgjegjësi për të gjitha veprat penale që kryen organizata ose grupi i strukturuar kriminal, prandaj është shumë e vështirë që të thuhet se veprat penale me natyrë të tillë mbeten të tentativë.

Për të gjitha këto që u thanë më sipër, jam i mendimit që vendimi nr.19, datë 25.03.2009 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është i bazuar në ligj dhe duhet të lihej në fuqi, prandaj vota ime është kundër vendimit nr.3, datë 24.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Medi Bici

**Nr.5/4/2/2 i Regj. Themeltar
Nr.2 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Ardian Dvorani	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Mirela Fana	Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 17.01.2011 dhe 24.01.2011 morën në shqyrtim çështjen penale nr.5 Akti, që u përket:

TË PANDEHURVE: LODOVIKO SALIS, i biri Mikeles dhe i Karmelas, i datëlindjes 1976, me arsim të mesëm, gjendje civile beqar, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”.

OLSI LEKA, i biri i Bashkimit dhe i Aleksandrës, i datëlindjes 21.12.1976, lindur dhe banues në Tiranë, beqar, i pa dënuar, hetuar dhe gjykuar në gjendje “arresti në burg”.

ENTON LEKA, i biri i Bashkimit dhe i Aleksandrës, i datëlindjes 27.04.1973, lindur në Tiranë, beqar, i pa dënuar, hetuar e gjykuar në gjendje arresti në burg.

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprës penale
“Trafikim i lëndëve narkotike, në bashkëpunim”,
parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal.
Baza Ligjore: Neni 283/a i Kodit Penal.

Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.47, datë 12.12.2006, ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Lodoviko Mikele Salis për kryerjen e veprës penale “trafikimit të lëndës narkotike” në bashkëpunim, e mbetur në

tentativë, parashikuar nga neni 282/a /2 e 22 i K.Penal dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Lodoviko Mikele Salis fillon nga data 29.12.2004 dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Enton Bashkim Leka për kryerjen e veprës penale të “trafikimit të lëndës narkotike” në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Enton Bashkim Leka fillon nga data e ndalimit tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Olsi Bashkim Leka për kryerjen e veprës penale të “trafikimit të lëndës narkotike” në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Olsi Bashkim Leka fillon nga data 09.03.2005 dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.8, datë 15.02.2007, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Kundër vendimit nr.8, datë 15.02.2007 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 432 të K.Pr.Penale, kanë ushtruar rekurs të gjykuar Enton Leka, mbrojtësi i tij, dhe Olsi Leka, duke kërkuar prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim për këto shkaqe:

- Vendimet janë marrë në mosrespektim të ligjit penal si dhe duke lejuar shkelje procedurale që sjellin si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimeve të gjykatës, parashikuar nga neni 128 i K.Pr.Penale.
- Gjykimi çështjes në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë është bërë nga dy gjyqtarë që nuk plotësojnë kushtet për të qënë të tillë. Gjyqtarët Mirela Balili dhe Ilirjana Olldashi janë caktuar anëtare të trupit gjykues në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, jo me short por me urdhër të Kryetarit të gjykatës.
- Gjyqtarja Mirela Balili është caktuar në përbërje të trupit gjykues me urdhër, kurse gjyqtarja Ilirjana Olldashi nuk rezulton të jetë caktuar në përbërjen e trupit gjykues me ndonjë akt të veçantë, pra jo me short.
- Praktika e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me vendimet nr.64, datë 14.02.2007, dhe nr.769, datë 20.12.2006, i ka konsideruar vendimet e marra nga trupat gjykues, ku anëtarët e tij nuk i plotësonin kushtet për të qënë të tillë, si vendime absolutisht të pavlefshme.
- Ankimet e bëra në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda nuk i janë komunikuar avokatit të caktuar me prokurë për të gjykuarin Enton Leka, në kundërshtim me sa parashtron neni 414 dhe 441 i K.Pr.Penale.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.s’ka, datë 19.11.2008, ka vendosur:

Kalimin e çështjes penale me të pandehur Lodoviko Salis, Enton Leka e Olsi Leka, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njehsimin e praktikës gjyqësore.

Me këtë vendim Kolegji Penal shtron për diskutim çështjet si më poshtë:

1. *A mund të zgjerohen rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit në gjykim, veç atyre që parashikohen në nenet 15, 16 dhe 17 të K.Pr.Penale?*

2. *Mungesa e paanshmërisë së gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje konkrete duhet t'i nënshtrohet procesit të të provuarit, apo vetëm të pretendohet? Pra në rastin e zëvendësimit të gjyqtarit/ve të trupit gjykues, që është duke gjykuar një çështje konkrete, mungesa e paanshmërisë është e prezumuar, apo duhet t'i nënshtrohet provës?*

3. *Shorti, në nenin 9 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", parashikohet si mënyrë e ndarjes së çështjeve gjyqësore, a duhet të shtrihet, si formë organizimi, edhe në caktimin e gjyqtarëve të trupit gjykues që do të gjykojnë secilin prej tyre?*

4. *Shorti, si masë organizative (e cila parashikohet në një ligj organik), a duhet të konsiderohet rregull i barazvlefshëm me rregullat procedurale që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale, mosrespektimi i të cilave passjell pasoja në kuptimin e procesit të rregullt ligjor?*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Nuni dhe Gani Dizdari; prokurorin Artur Selmani, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë; mbrojtësin e të gjykuarve Olsi Leka dhe Enton Leka, avokatin Vladimir Meçe, që kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe atij të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, me tjetër trup gjykues; pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

V Ë R E J N Ë

VI. *Rrethanat e faktit*

44. Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore dhe vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulta, u rezultojnë të pranuarat prej tyre rrethanat si vijon:

Nga materialet e çështjes rezulton se më datën 28.12.2004, gjatë kontrollit fizik të ushtruar në pikën e kalimit kufitar të Portit të Durrësit, është kryer kontrolli fizik edhe i automjetit me targa italiane CJ 9668BM, që drejtohej nga i gjykuari Lodoviko Salis (shtetas italian). Në përfundim të kontrollit është konstatuar se në serbatorin e makinës ishte e paketuar një sasi lëndë pluhur, me peshë 2320 gram. Nga ekspertimi përkatës lënda pluhur u konkludua se ishte heroinë.

Në deklaramet e tij i gjykuari Lodoviko Salis ka pranuar se në vitet 2001-2002, në qytetin e Breshias ka njohur një shtetas shqiptar që e thërrisnin "Xhenaro". Pas një vit e gjysëm i gjykuari Lodoviko është kthyer sërish në Breshia dhe ka rënë në kontakt me këtë shtetas shqiptar, i cili i ka propozuar që ta ndihmonte në transportimin nga Shqipëria të lëndës narkotike. I gjykuari Lodoviko ka pranuar dhe i ka kërkuar një mikut të tij italian automjetin.

Më datë 24.12.2004, së bashku me të quajturin "Xhenaro", i gjykuari Lodoviko është nisur në drejtim të Durrësit. Nga materialet portuale ka rezultuar se atë ditë së bashku me Lodovikun ka udhëtuar edhe i gjykuari Enton Leka, i cili në Shqipëri është vënë në kontakt me të vëllanë, të gjykuarin Olsi Leka. Ky i fundit i ka shoqëruar për në hotel "Ballkan", në Tiranë.

I gjykuari Lodoviko ka pretenduar se në asnjë rast "Xhenaro" nuk ka dashur të zbulojë identitetin e tij të vërtetë. Vetëm në një rast ai i kishte parë një kartë identifikimi që i quajturin "Xhenaro" mbante, në të cilën ishte fiksuar emri Enton Leka. Gjithashtu, i gjykuari Enton në një rast e kishte thirrur të vëllanë (Olsin) në emër.

I gjykuari Lodoviko ka përshkruar dinamikën e ngjarjeve, duke pohuar se i gjykuari Olsi i ka treguar se kishte gjetur një sasi prej 2 kg lëndë narkotike të një cilësie të mirë. Ditën e fundit, i gjykuari Enton është larguar nga hoteli me makinë, duke i thënë se po shkonte të merrte dhe vendoste lëndën narkotike. Pasi është kthyer në hotel i gjykuari Enton, i gjykuari Lodoviko është vënë në drejtim të automjetit, duke ndjekur nga pas automjetin që drejtohej nga i gjykuari Olsi, pasagjer në të cilin ishte dhe i gjykuari Enton.

Me të arritur në Durrës, vëllezërit Leka i kanë thënë të gjykuarit Lodoviko që të ndiqte nga pas automjetin e tyre teksa kalonin kontrollin e policisë, pasi dhe ata me automjetin e tyre me targa Tirane do të kalonin për në Itali. Të gjykuarit Leka e kanë kaluar kontrollin policor, ndërsa i gjykuari Lodoviko është kapur në kushtet e flagrancës.

45. Pasi çështja ka ardhur për gjykim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, më datë 31.05.2005, mbështetur në short, është vendosur përbërja e trupit gjykues, respektivisht: S. Simoni - Kryetar i trupit gjykues, D. Hallunaj - gjyqtar relator i çështjes dhe si anëtarë të trupit gjykues gjyqtarët B. Dhama, G. Brahimllari e A. Mustafaj.

Me këtë përbërje të trupit gjykues, ku bënte pjesë dhe gjyqtari S. Simoni, janë çelur seancat gjyqësore të datave 16.06.2005, 01.07.2005, 11.07.2005, në të cilat konstatohet se nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

Me urdhërin e datës 08.09.2005 të kryetarit të gjykatës, *“Meqënëse anëtari i trupit gjykues të kësaj çështje gjyqtari Sandër Simoni për arsye pune nuk mund të marrë pjesë në seancën gjyqësore të sotme”*, është urdhëruar ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues duke u zëvendësuar gjyqtari S. Simoni me gjyqtaren M. Balili. Sipas procesverbalit, ky ndryshim është pasqyruar që në seancën e datës 08.09.2005.

Në seancën e datës 07.11.2005 është hapur shqyrtimi gjyqësor dhe në vijim janë zhvilluar disa seanca gjyqësore.

Seancat e datave 08.06.2006 e 16.06.2006 janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, pasi gjyqtarja M. Balili mungonte për arsye shëndetësore.

Në seancën e datës 27.06.2006, rezulton që në vend të gjyqtarës M. Balili, figuron të jetë në përbërje të trupit gjykues gjyqtarja I. Olldashi, e cila ka marrë pjesë deri në fund të gjykimit. Lidhur me këtë ndryshim të trupit gjykues nuk ka patur kundërshtime nga palët pjesëmarrëse në gjykim. Po kështu, nga aktet që përmban dosja gjyqësore nuk rezulton që të ketë ndonjë akt apo urdhër të Kryetarit të gjykatës me të cilin të jetë bërë ky zëvendësim në përbërjen e trupit gjykues.

46. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata për Krime të Rënda Tiranë ka disponuar për deklarimin fajtorë të të gjykuarve duke caktuar edhe masat e dënimit përkatës, sikurse parashtrohet më sipër në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Mbi ankimin e të pandehurve Olsi Leka, Lodoviko Salis dhe Enton Leka, në mungesë, përfaqësuar nga avokati F. Shanaj, çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë.

47. Kundër vendimit nr.8, datë 15.02.2007 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë kanë ushtruar rekurs të gjykuarit Enton Leka dhe Olsi Leka, duke kërkuar prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim.

Ndërmjet të tjerave, ashtu sikurse në ankimin që i kishin paraqitur gjykatës së apelit, të gjykuarit parashtrojnë edhe në rekurs pretendimin se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën për Krime të Rënda Tiranë dhe, për rrjedhojë, edhe vendimi i dhënë nga ajo gjykatë, janë realizuar në shkelje të rënda procedurale që sjellin si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimeve të gjykatës, sipas

parashikimeve të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale. Në përbërje të trupit gjykues kanë marrë pjesë dy gjyqtarë që nuk plotësojnë kushtet për të qënë të tillë, për shkak se, në kundërshtim me ligjin, janë caktuar anëtarë të trupit gjykues jo me short, por, njëri me urdhër të Kryetarit të gjykatës, ndërsa tjetri pa ndonjë akt të veçantë që të tregojë motivet dhe mënyrën e zëvendësimit të gjyqtarit.

48. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 19.11.2008, ka vendosur të kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njehsimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore. Në mënyrë të përmbledhur, Kolegji Penal ka marrë këtë vendim dhe ka parashtruar për diskutim çështjet për unifikim duke patur parasysh se zëvendësimi i gjyqtarëve gjatë shqyrtimit të çështjes është një veprim i përhapur, faktin që në gjykatat më të ulta zbatohen praktika të ndryshme, si dhe nisur nga qëndrimet e kundërta mbi kuptimin e zbatimit të ligjit procedural të mbajtura prej tyre por edhe në vetë Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

VII. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara

49. Në seancë gjyqësore, përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, krahas pretendimeve lidhur me mënyrën e zgjidhjes në themel të çështjes nga gjykatat më të ulta, sikurse në gjykimin në apel dhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, edhe në parashtrimin e qëndrimit të tij përpara Kolegjeve të Bashkuara, mbrojtësi i të gjykuarve Olsi dhe Enton Leka, në thelb, argumentoi se vendimi i dhënë nga Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë është akt absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të zbatimit të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale.

Mbrojtja parashtrroi se janë shkelur urdhërimet e ligjit lidhur me kushtet për të qënë gjyqtar në çështjen konkrete. Më konkretisht, janë shkelur urdhërimet e nenit 15 të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor për detyrueshmërinë e caktimit të përbërjes së trupit gjykues nëpërmjet shortit. Kjo dispozitë, sikurse edhe ato të Kodit të Procedurës Penale, nuk i kanë njohur Kryetarit të gjykatës ndonjë të drejtë që, pa treguar arsytet e largimit dhe pa respektuar rregullat e shortit, të urdhërojë e caktojë një gjyqtar në përbërje të trupit gjykues për të zëvendësuar gjyqtarin e caktuar më parë me short.

50. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i prokurorisë, në thelb, parashtrroi përpara Kolegjeve të Bashkuara se pretendimi i mbrojtjes së të gjykuarve lidhur me rregullshmërinë e caktimit të gjyqtarit në përbërje të trupit gjykues mund të përfshihet si rast në atë që parashikon neni 17, pika 1, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Penale: “*ë. Kur ekzistojnë shkaqe të tjera njëanshmërie*”.

Gjithësesi, sipas përfaqësuesit të prokurorisë, rastet e parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes konkrete, nëse vërtetohen në gjykim nuk sjellin pavlefshmëri absolute, por pavlefshmëri relative. Vetëm vërtetimi i rasteve të parashikuara nga neni 15 dhe 16 sjell pavlefshmëri absolute të akteve të gjyqtarit në kuptim të nenit 128, pika 1, shkronja “a” të këtij Kodi.

Kushtet për të qënë gjyqtar, në kuptim të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, lidhen me rastet e shkeljes së ligjit procedural, pikërisht të dispozitave të këtij Kodi dhe jo të atyre që parashikohen në ligje të tjera, përfshirë këtu rregullimet në dispozitat e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor ku parashikohen rregullat për ndarjen e gjyqtarëve në kolegje e dhoma penale e civile, si dhe rregulli për caktimin me short të gjyqtarit në përbërje të trupit gjykues.

Së fundi, përfaqësuesi i prokurorisë mbajti qëndrimin se respektimi ose jo i rregullave të caktimit me short të trupit gjykues, apo të zëvendësimit të anëtarëve të tij, nuk cënon parimin kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj dhe as kushtin për të qënë gjyqtar në çështjen konkrete, sikurse përcaktohet nga neni 128 i Kodit të Procedurës Penale.

51. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe qëndrimeve të palëve në gjykim, për t'i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për njehsimin e praktikës gjyqësore, gjithmonë në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në rekurs për shkelje të rënda procedurale në gjykim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh, para së gjithash, dispozitat vijuese të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në nenet 4, 15 pika 1 dhe 42 pika 2 të Kushtetutës parashikohet se:

“Neni 4

- 1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.*
- 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.*
- 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.*

Neni 15

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.*

Neni 42

- 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj”.*

Në nenin 6 pika 1 të KEDNJ parashikohet se:

“Neni 6 – E drejta për një proces të rregullt

- 1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. ”.*

Në pajtueshmëri me qëllimin dhe frymën e këtyre dispozitave, edhe Kodi i Procedurës Penale, në nenin 128, pika 1 shkronja “a” parashikon se:

“1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me:

- a- kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod;..... ”.*

Krahas standarteve dhe garancive themeltare në një shtet ligjor për një gjykatë “të pavarur” dhe “të paanshme”, në shqyrtimin gjyqësor të një çështjeje penale apo civile, parimi dhe standarti tjetër kushtetues, thelbësor për zhvillimin e një procesi të drejtë (të rregullt) ligjor, është ai i gjykatës së “caktuar me ligj”.

Parimi dhe garancia kushtetuese e shqyrtimit të çështjes konkrete nga gjykata “e caktuar me ligj”, ka të bëjë me respektimin e dispozitave normative që përcaktojnë mënyrën e formimit të gjykatës, kompetencën lëndore, numrin e gjyqtarëve që duhet të përbëjnë trupin gjykues sipas natyrës së çështjes dhe shkallës së gjykimit, si edhe mbi caktimin e përbërjes nominative të trupit gjykues.

52. Përsa i përket mënyrës së formimit të gjykatës dhe përbërjes nominative të saj, nga një vështrim i përmbajtjes dhe zbatimit të kuadrit kushtetues e ligjor në tërësi dhe ligjit procedural penal në veçanti, vërehet se, që nga koha e hyrjes në fuqi dhe deri më sot, në Kodin e Procedurës Penale, ndërsa përmbahen rregullime konkrete lidhur me numrin e gjyqtarëve e kompetencën

lëndore në varësi të natyrës së çështjes penale, si dhe mbi kompetencën tokësore, nuk parashikohen rregulla mbi mënyrën e formimit të gjykatës apo për caktimin e përbërjes nominative të saj. Kështu, as neni 333 dhe neni 424 i këtij Kodi nuk tregojnë se si formohet përbërja nominative e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit. Ndërsa neni 436, lidhur me Gjykatën e Lartë, parashikon vetëm se Kryetari i kësaj gjykate cakton kolegjet pesëanëtarëshe për shqyrtimin e rekursve, por nuk shprehet p.sh. se si caktohet gjyqtari relator i çështjes konkrete. Gjithashtu, Kodi nuk përmban rregulla për mënyrën e caktimit të gjyqtarit në përbërje të trupit gjykues në rastet kur lind nevoja e zëvendësimit të njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

Por, në procesin e zhvillimit të legjislacionit në lidhje me organizimin e gjykatave, duke reflektuar evolucionin e standarteve mbi procesin e rregullt ligjor, nga ana e ligjvënësit është çmuar dhe janë vendosur rregulla më të hollësishme lidhur me mënyrën e formimit të gjykatës penale dhe të përbërjes së saj nominative, nëpërmjet mekanizmit ligjor të shortit, e kombinuar me atë të formimit periodik të kolegjeve dhe dhomave penale në të gjitha shkallët e gjykimit.

Kështu, ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 14 dhe 15 të tij (të zbatueshme në çështjen objekt i këtij gjykimi) parashikonte se:

“Neni 14

Në fillim të çdo viti, Kryetari i gjykatës së apelit dhe Kryetari i gjykatës së shkallës së parë, përcaktojnë për vitin në vazhdim shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma penale e civile të gjykatës.

Në dhomën e çështjeve civile përfshihen edhe gjyqtarët e seksioneve për gjykimet e posaçme.

Kur madhësia e gjykatës nuk lejon të organizohen të paktën një dhomë civile dhe një dhomë penale, ndarja e çështjeve bëhet midis të gjithë gjyqtarëve në mënyrë të barabartë.

Neni 15

Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short, sipas procedurave të përcaktuara me ligj”.

Edhe ligji në fuqi me nr.9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 9 dhe 18 të tij parashikon se:

“Neni 9 - Ndarja e çështjeve gjyqësore

Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 18 - Kompetencat e Kryetarit të gjykatës

1. Një herë në çdo dy vjet kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit përcaktojnë shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma dhe seksione për vitet në vijim. Kjo ndarje nuk e pengon kryetarin e gjykatës që, gjatë vitit kalendarik, për nevoja pune, të komandojë gjyqtarë për të gjykuar në një seksion tjetër.

.....

3. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe Kryetari i gjykatës së apelit, përveç sa më sipër, kryejnë edhe këto detyra:

.....

b) bëjnë ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues;

c) në fillim të çdo muaji, bëjnë planifikimin e gjyqtarëve për gjykimet me objekt vlerësim i arrestit në flagrancë apo ndalimit, caktimin e masave të sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër gjatë fazës së hetimit, sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin....”.

53. Nëse ligji nuk do të parashikonte shortin si mjet për caktimin e gjyqtarit monokratik ose relator të çështjes konkrete, apo vendimin e Kryetarit të gjykatës për caktimin periodik të përbërjes së kolegjit penal, kjo situatë nuk do të mundësonte parashtrimin nga palët në gjykim të pretendimeve dhe përkatësisht disponimit nga gjykata mbi parregullësi në formimin e gjykatës së caktuar me ligj, pra edhe për pavlefshmëri të gjykimit. Maksimumi që mund të pretendohet nga palët, apo që mund të parashtrohet nga gjykata, do të ishte parashtrimi i çështjes së pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën dhe KEDNJ.

Kushtetuta dhe KEDNJ shprehen vetëm për gjykatën e formuar me ligj, pra nuk paracaktjnë shortin, caktimin periodik të kolegjeve penale, etj., si mënyra formimi të ligjshëm të gjykatës për shqyrtimin e një çështjeje konkrete, duke ia dhënë ligjvënësit të çmujë dhe përcaktjnë mënyrat e formimit dhe caktimit të rregullt të përbërjes nominative të gjykatës për gjykimin e një çështjeje konkrete. Pasi në legjislacionin tonë shorti për çështjen konkrete në kombinim me caktimin periodik të kolegjeve u parashikuan shprehimisht në ligj, pa bërë dallim për çështjet penale apo civile, atëherë këto mënyra të formimit të gjykatës sot përbëjnë një standart, një rregull normativ që, nëse nuk respektohet, sjell vetvetiu parregullshmërinë e përbërjes së gjykatës dhe nulitetin e gjykimit në referim të pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ, në lidhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 128 të K.Pr.Penale.

Nga ana tjetër, duke qënë garanci e parim kushtetues, për të cilën Kushtetuta nuk bën dallim, ajo nuk indikon mënyrën apo llojin e aktit, por thjesht përcakton se gjykata duhet të caktohet me ligj. Rrjedhimisht Kushtetuta nuk bën asnjë dallim, madje nuk është as edhe vendi për të vënë në diskutim hierarkinë e normave, pra nëse rregullat për formimin e gjykatës duhet të jenë domosdoshmërisht të parashikuara në vetë Kodin e Procedurës Penale apo edhe në ligje të tjera, aq më tepër në rrethanat kur këto rregulla mbi caktimin e përbërjes nominative të gjykatës janë parashikuar në ligje të miratuara nga Kuvendi me 3/5 e anëtarëve të tij. Kjo edhe për arsyen se, mënyra e formimit dhe caktimit të përbërjes nominative të gjykatës, nuk janë thjesht çështje organizimi dhe funksionimi të gjykatave, por në thelb lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut, ku bën pjesë edhe rregullshmëria e procesit gjyqësor. Në këtë kuptim, respektimi i procesit të rregullt ligjor përfshin zbatimin e çdo normë ligjore që lidhet me ato elemente e standarte të procesit gjyqësor që garantojnë respektimin e kriterëve të pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

Nëse do të gjykohej ndryshe atëherë në mënyrë të pakuptimtë do të defaktorizohej arsyeja e përcaktimit në ligj të rregullave për formimin e rregullt të gjykatës. Në aspektin e respektimit të parimeve kushtetuese dhe të KEDNJ për gjykatën “*e caktuar me ligj*”, do të ishte njësoj sikur të mos respektohej, pra të defaktorizohej edhe rregullimi tjetër ligjor mbi kompetencën lëndore apo edhe mbi numrin e domosdoshëm të gjyqtarëve që formojnë gjykatën sipas natyrës së çështjes, goftë kur ky rregull të ishte parashikuar apo jo nga vetë K.Pr.Penale.

Pra, pavarësisht nga diskutimi eventual mbi atë se cila do të ishte mënyra më afër, më e pranueshme dhe më e besueshme për publikun për formimin e përbërjes nominative të gjykatës në çështjen konkrete, me short ose në forma të tjera apo kombinimi i tyre, zgjedhja që bën ligjvënësi duhet të respektohet dhe zbatohet nga gjykatat dhe autoritetet e ngarkuara për këtë qëllim.

54. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se, *nisur nga dispozitat aktuale në fuqi të sipërcituara në këtë vendim, përbërja nominative e trupit gjykues në një gjykim penal konsiderohet e rregullt vetëm nëse, në varësi të natyrës dhe shkallës së gjykimit, rezulton se janë respektuar e zbatuar procedurat për përcaktimin nominativ të gjykatës monokratike apo të përbërjes së kolegjit që shqyrton një çështje konkrete, ato të përcaktimit periodik të përbërjes nominative të dhomave dhe kolegjeve penale për shqyrtimin e çështjeve penale në tërësi, si dhe ato të shortit për caktimin e gjyqtarit relator të çështjes konkrete apo për*

caktimin e gjyqtarit që zëvendëson anëtarin e trupës gjyquese që ka hequr dorë apo është përjashtuar nga gjykimi i çështjes konkrete.

Duke qënë se çënojnë drejtpërdrejt dhe në thelb parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës) dhe të drejtën e njeriut për t'u gjykuar nga një gjykatë "e caktuar me ligj" (nenet 15 dhe 42/2), përbën çënim të procesit të rregullt ligjor thjesht dhe vetëm shkëlja e rregullave normative që parashikohen nga ligji për mënyrën e formimit të rregullt të përbërjes nominative të gjykatës në çështjen konkrete. Në kuptim e zbatim të drejtë të nenit 128, pika 1, shkronja "a" të K.Pr.Penale, aktet e nxjerra nga ajo gjykatë dhe vendimet e dhëna prej saj janë absolutisht të pavlefshme.

55. Në rekursin e paraqitur nga të gjykuarit, sikurse edhe nga parashtrimet e palëve përpara Kolegjeve të Bashkuara, ndonëse qëndrimet e tyre janë të kundërta lidhur me rregullshmërinë ose jo, si dhe efektet përkatëse përsa i përket zëvendësimit të gjyqtarit pa short dhe në tërësi për mënyrën e formimit të përbërjes nominative të gjykatës, vërehet se gjithësesi ato e lidhin vetvetiu respektimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj me institutin procedural të paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e një çështjeje konkrete. Për rrjedhojë, edhe me shkaqet (rastet), sjelljen e kërkimet e palës dhe disponimet e gjykatës për heqjen dorë të gjyqtarit apo përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes, sikurse parashikohen nga nenet 15 e vijues të K.Pr.Penale.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se dispozita e pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës parashikon shprehimisht tre parime, tre garanci kushtetuese, për respektimin e procesit të rregullt ligjor në një shtet të së drejtës, ato të "pavarësisë" së gjykatës, të "paanshmërisë" së saj dhe parimin e "gjykatës së caktuar me ligj".

Këto tre garanci kushtetuese lidhen me aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor. Vërtetimi në gjykim i çënimin të njërit prej tyre nuk nënkupton dhe as nuk sjell domosdoshmërisht e vetvetiu si efekt çënimin e njëres apo të dy garancive të tjera kushtetuese.

Rrethana e njëanshmërisë së gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje konkrete mund të lindë krahas apo pavarësisht nga mënyra e formimit, numri i gjyqtarëve dhe mënyra e caktimit të përbërjes nominative të gjykatës.

56. Prandaj Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se, *mosrespektimi i rregullave normative mbi mënyrën e formimit, numrin e gjyqtarëve apo për caktimin e përbërjes nominative të trupit gjykues nuk ka lidhje dhe as nënkupton, vetvetiu, "njëanshmërinë" e gjykatës, për rrjedhojë vënien në zbatim nga palët dhe gjykatat të mjeteve procedurale të kërkesës për përjashtim apo heqjes dorë nga gjykimi i çështjes. Kjo gjendje nuk lidhet me perceptimin subjektiv apo objektiv mbi cilësitë, rrethanat, qëndrimin dhe sjelljen e gjyqtarit brenda apo jashtë, përpara apo gjatë gjykimin të një çështjeje konkrete.*

Gjyqtari mund të jetë caktuar në përbërje të trupit gjykues pa u respektuar, sipas rastit, rregullat mbi mënyrën e formimit të kolegjeve gjyquese apo ato të shortit, po kështu gjykata mund të jetë formuar me një numër më të vogël se ajo që parashkon ligji, por këto rrethana nuk e bëjnë gjyqtarin apo gjithë gjyqtarët e trupit gjykues të njëanshëm. Prandaj, nëse për riparimin e këtyre parregullësive zhvillohen e respektohen rregullat për formimin e gjykatës sipas ligjit, në përbërje të trupit gjykues mund të jenë po ata gjyqtarë.

Nëse përveç parregullësive në caktimin e përbërjes nominale të gjykatës, pretendohet e motivohet se gjithë kjo ka ndodhur qëllimisht për motive njëanshmerie apo një a disa anëtarë të trupës gjyquese kanë shkaqe të tjera përjashtimi sipas nenit 15 e vijues të K.Pr.Penale, atëhere, krahas kërkesës për formimin e parregullt të gjykatës, kërkohet edhe përjashtimi eventual, në çdo rast, të gjyqtarit që është caktuar në përbërje të trupit gjykues të formuar në mënyrë të parregullt.

57. Nisur nga rëndësia thelbësore që kanë për zhvillimin e një gjykimi të drejtë si rezultat i një procesi të rregullt ligjor, mënyra dhe mjeti eventual ligjor i zbatuar për formimin e gjykatës apo për zëvendësimin e një anëtari ekzistues të trupës gjyqësore, duhet t'i bëhen të njohura palëve nga kryetari i trupit gjyqësor në momentin e shpalljes së përbërjes së gjykatës të caktuar për shqyrtimin e asaj çështjeje, apo në fillim të çdo seance pasardhëse, sa herë që ka ndryshime në përbërjen e gjykatës. Realizimi i këtij njoftimi pasqyrohet në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Në këtë mënyrë jo vetëm i mundësohet, por edhe i garantohet palës pjesëmarrëse në gjykim e drejta që, në çdo kohë, të paraqesë para gjykatës pretendimin e saj për formimin e parregullt të gjykatës. Gjykata duhet t'i japë përgjigje këtij pretendimi me vendim të ndërmjetëm dhe nëse e pranon, shtyn seancën për të mundësuar që të riparohet shkelja dhe gjykata të formohet rregullisht. Gjithashtu, gjykata mund të marrë kryesisht në bisedim ekzistencën ose jo të rrethanës së formimit të parregullt të gjykatës.

58. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit e përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur nga të gjykuarit Enton Leka, mbrojtësi i tij dhe Olsi Leka janë të mbështetura në ligj.

Sikurse ka rezultuar e vërtetuar nga vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulta dhe aktet që përmban dosja gjyqësore, pasi çështja ka ardhur për gjykim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, më datë 31.05.2005, mbështetur në short, është vendosur përbërja e trupit gjyqësor, respektivisht: S. Simoni - Kryetar i trupit gjyqësor, D. Hallunaj - gjyqtar relator i çështjes dhe si anëtarë të trupit gjyqësor gjyqtarët B. Dhama, G. Brahimllari e A. Mustafaj.

Me këtë përbërje të trupit gjyqësor, ku bënte pjesë dhe gjyqtari S. Simoni, janë çelur seancat gjyqësore të datave 16.06.2005, 01.07.2005, 11.07.2005, në të cilat konstatohet se nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

Por, me urdhërin e datës 08.09.2005 të Kryetarit të gjykatës, *“Meqënëse anëtari i trupit gjyqësor të kësaj çështjeje gjyqtari Sandër Simoni për arsye pune nuk mund të marrë pjesë në seancën gjyqësore të sotme”*, është urdhëruar ndryshimi i përbërjes së trupit gjyqësor duke u zëvendësuar gjyqtari S. Simoni me gjyqtaren M. Balili. Sipas procesverbalit, ky ndryshim është pasqyruar që në seancën e datës 08.09.2005.

Në seancën e datës 07.11.2005 është hapur shqyrtimi gjyqësor dhe në vijim janë zhvilluar disa seanca gjyqësore.

Seancat e datave 08.06.2006 e 16.06.2006 janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjyqësor, pasi gjyqtarja M. Balili mungonte për arsye shëndetësore.

Në seancën e datës 27.06.2006, rezulton që në vënd të gjyqtarës M. Balili, figuron të jetë në përbërje të trupit gjyqësor gjyqtarja I. Olldashi, e cila ka marrë pjesë deri në fund të gjykimit. Lidhur me këtë ndryshim të trupit gjyqësor nuk ka patur kundërshtime nga palët pjesëmarrëse në gjykim. Po kështu, nga aktet që përmban dosja gjyqësore nuk rezulton që të ketë ndonjë akt apo urdhër të kryetarit të gjykatës me të cilin të jetë bërë ky zëvendësim në përbërjen e trupit gjyqësor.

59. Në rrethana të tilla, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka zbatuar gabim ligjin procedural, posaçërisht dispozitën e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 128 të K.Pr.Penale kur nuk ka pranuar pretendimin e ngritur nga të gjykuarit në ankim për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krime të Rënda, pasi në marrjen e tij nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qënë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për formimin e kolegjeve.

Urdhëri i Kryetarit të gjykatës është një veprim ekstra procedural. Të tilla janë edhe zëvendësimet që i janë bërë gjyqtarëve mbi bazën e urdhërave të kësaj natyre, çka e bën të gjithë procesin proceduralisht të cënueshëm. Në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998, *“Për*

organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të zbatueshëm në çështjen objekt i këtij gjykimi, ku parashikohet se: “Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj.”, ashtu edhe në dispozitat e K.Pr.Penale, është rregulluar mënyra dhe rastet e largimit të një gjyqtari nga trupi gjykues, mënyrë që nuk lejon Kryetarin e gjykatës të ndërhyjë. Gjyqtari i caktuar sipas shortit në trupin gjykues zëvendësohet po me short në rastet kur heq dorë, pranohet kërkesa për përjashtimin e tij, apo për shkaqe të tjera të përligjura.

Kryetari i gjykatës është figurë procedurale për aq të drejta dhe detyrime që rrjedhim nga K.Pr.Penale dhe ligji, tek të cilat, nuk ka asnjë dispozitë që t’i njohë atij të drejtën për të ndryshuar trupin gjykues.

Prandaj, si përfundim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, në çështjen objekt gjykimi, përderisa ndryshimi i trupit gjykues është bërë në një rast me urdhër të Kryetarit të gjykatës dhe, në rastin tjetër pa short e pa treguar arsyen dhe mënyrën e zëvendësimit të gjyqtarit ekzistues, pra jashtë rregullimeve procedurale e ligjore, ky trup gjykues vlerësohet se nuk është formuar rregullisht, duke qënë kështu një nga rastet që, në kuptim të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 128 të K.Pr.Penale, e bëjnë vendimin nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krime të Rënda një akt absolutisht të pavleshëm.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 432, të nenit 438, të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 441 dhe nenit 443 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të shkronjës “a” të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S Ë N

2. Prishjen e vendimit nr.8, datë 15.02.2007 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, me tjetër trup gjykues.

2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.

3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njehson praktikën gjyqësore.

Tiranë, më 24.01.2011

A N Ë T A R A N Ë T A R K R Y E S U E S
Gani DIZDARI Ardian DVORANI Shpresa BEÇAJ

A N Ë T A R A N Ë T A R A N Ë T A R
Ardian NUNI Fatos LULO Besnik IMERAJ
kundër

A N Ë T A R A N Ë T A R A N Ë T A R

Arjana FULLANI Andi ÇELIKU Aleksandër MUSKAJ
kundër

kundër

ANËTAR
Mirela FANA

ANËTAR ANËTAR
Majlinda ANDREA Guxim ZENELAJ
kundër

ANËTAR
Evelina QIRJAKO
Kundër

MENDIMI I PAKICËS

1. Ne, gjyqtarët në pakicë Ardian Nuni, Arjana Fullani, Aleksandër Muskaj, Majlinda Andrea dhe Evelina Qirjako, jemi të mendimit se për rastin në shqyrtim nuk ndodhemi përpara një procesi jo të rregullt ligjor dhe as përpara pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale, sikurse pranon shumica e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

2. Pakica vlerëson se qëndrimi njehsues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me parimin kushtetues të *“një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*, ka dalë tej kornizës juridike të dispozitave kushtetuese, të Kodit të Procedurës Penale dhe të rrethanave të çështjes konkrete.

3. Sikurse Kolegjet e Bashkuara, edhe pakica mendon se është vendi të trajtohet me këtë rast kuptimi i drejtë dhe realist që duhet patur për standartin e gjykatës se pavarur, të paanëshme dhe të caktuar me ligj. Edhe për pakicën, pavarësia dhe paanshmëria e secilit prej anëtarëve të trupit gjykues dhe e gjykatës në tërësi, konsiderohen parime të rëndësishme që garantojnë dhënien e vendimeve të drejta dhe që mundësojnë krijimin e besimit tek gjykata.

4. Në thelb, problemi i shtruar para Kolegjeve të Bashkuara ka të bëjë me formimin e gjykatës dhe përbërjes nominative të saj, që referon në parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor dhe në Kodin e Procedurës Penale janë përcaktuar rregullimet konkrete në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore, me numrin e gjyqtarëve, si dhe rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit. Ndërsa në lidhje me formimin e gjykatës dhe përbërjen nominative të saj nuk ka dispozita specifike të cilat të rregullojnë në mënyrë të detajuar këtë çështje.

5. Në referencë të legjislacionit të zbatueshëm, edhe tej momentit të dhënies së vendimeve për çështjen konkrete nga Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë (vendimi nr.47, datë 12.12.2006) dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë (vendimi nr.8, datë 15.02.2007), konstatohet paqëndrueshmëri në lidhje me procedurën që duhet ndjekur për mënyrën e formimit të përbërjes nominative të trupit gjykues. Kështu, në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”* përcaktohej se *“Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj”*, ndërsa me ligjin nr.9877, datë 18.02.2008, që ka shfuqizuar ligjin e mësipërm, përcaktohet se *“Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”* (neni 9).

6. Evidentohet se deri në momentin e shpalljes së vendimit nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, as për rastin e parë dhe as për të dytin nuk ka patur rregullime përkatëse në zbatim të këtyre dispozitave.

6.1. Aktet, mbi bazën e të cilëve është mundësuar ndarja e çështjeve gjyqësore, kanë qënë: (i) Urdhëri nr.1830, datë 03.04.2001 i Ministrit të Drejtësisë *“Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”*, sipas të cilit organizimi dhe dokumentimi i shortit realizohej nga kancelari nën mbikqyrjen e kryetarit të gjykatës (nenet 8 dhe 11) dhe, (ii) vendimi nr.238/1/a, datë 24.12.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë me të cilin, *inter alia*, janë miratuar dhe procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore.¹⁰⁹

¹⁰⁹ Neni 6 i vendimit nr.238/1/a, datë 24.12.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë: *“Në rastin kur një prej anëtarëve të trupit gjykues vlerësohet se ka një shkak për përjashtim ose është në pamundësi të përkohëshme paraqitjeje, plotësimi i trupit gjykues bëhet me caktimin në vend të tij të një gjyqtari tjetër, me përzgjedhje nga kryetari i gjykatës. Në*

6.2. Në vështrim të këtyre rregullimeve ndarja e çështjeve gjyqësore me anë të shortit rezulton të jetë një veprim jashtë rregullave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe mosrespektimi i tyre nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute në kuptim të nenit 128/1, gërma “a” të po këtij Kodi. Këto akte nuk mund të njehsohen me rregullimet e rasteve të përjashtueshmërisë të gjyqtarit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

7. Pakica mendon se në kushtet ekzistuese të legjislacionit procedural penal dhe kur në asnjë ligj tjetër të veçantë nuk është parashikuar mënyra e formimit të përbërjes nominale të trupit gjykues, rregulli i ndjekur për caktimin e gjyqtarit zëvendësues, përderisa nuk bie ndesh me dispozitat kushtetuese dhe me ato të Kodit të Procedurës Penale, nuk përbën cënim të procesit të rregullt ligjor.

8. Për më tepër, kur përbërja nominative e trupit gjykues apo zëvendësimi i gjyqtarit nuk është kundërshtuar nga subjektet pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, qoftë dhe për ndonjë arsye subjektive (sipas neneve 18-20 të K.Pr.P.) nuk rrjedhon *a priori* në pavlefshmëri absolute në kuptim të nenit 128, pika 1, gërma “a” të Kodit të Procedurës Penale.

9. Në lidhje me çështjet e shtruara për njehsim të praktikës gjyqësore, ndryshe nga Kolegjet e Bashkuara, në opinionin e saj ligjor, pakica vlerëson përkatësisht:

I. *A mund të zgjerohen rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit në gjykim, veç atyre që parashikohen në nenet 15, 16 dhe 17 të K.Pr.Penale?*

10. Rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit në gjykim nëpërmjet interpretimit gjyqësor nuk mund të zgjerohen tej atyre të parashikuara në nenet 15, 16, 17 dhe 342/4 të Kodit të Procedurës Penale.

10.1. Çdo zgjerim i rasteve të papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit, veç atyre të parashikuara në këto dispozita, bie ndesh jo vetëm me parimet kushtetuese, por dhe me atë ç’ka ka në funksion gjykata, qofshin dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjykata nuk mund të shtojë raste të tjera veç atyre që janë parashikuar shprehimisht në ligj, por ajo, në interpretim të drejtë, duke nxjerrë kuptimin e saktë të dispozitës ligjore, e zbaton atë për çështjen konkrete.

II. *“Mungesa e paanshmërisë së gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje konkrete duhet t’i nënshtrohet procesit të të provuarit, apo vetëm të pretendohet? Pra në rastin e zëvendësimit të gjyqtarit/ve të trupit gjykues, që është duke gjykuar një çështje konkrete, mungesa e paanshmërisë është e prezumuar, apo duhet t’i nënshtrohet provës?”*

11. Në lidhje me pyetjen e dytë, në kuptim të dispozitave kushtetuese, të legjislacionit organik, si dhe atyre të Kodit të Procedurës Penale, paanshmëria e gjyqtarit për të gjykuar një çështje konkrete prezumohet.

11.1. Si rregull, supozohet që gjyqtari është subjekt personalisht i paanshëm, me përjashtim të rasteve kur dalin prova të kundërta.¹¹⁰

11.2. Kush pretendon se gjyqtari ka shkaqe për njëanshmëri duhet të provojë ekzistencën e këtyre shkaqeve dhe të kërkojë përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes konkrete.

përzgjedhjen e gjyqtarit më të përshtatshëm, kryetari i gjykatës mban parasysht një trajtim të njëjtë mes gjyqtarëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit dhe seksionin përkatës”.

¹¹⁰ Gjykata e Strasburgut në çështjen “Le Conepte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës”.

11.3. Pretendimi për mungesë të paanshmërisë së gjyqtarit, i cili plotëson kushtet për të qënë gjyqtar, në gjykimin e një çështje konkrete, duhet t'i nënshtrohet provave.

11.4. Në çështjen objekt gjykimi, nuk është shprehur asnjë dyshim apo rezervë nga palët për gjyqtarin zëvendësues. Përkundrazi, sikundër rezulton nga aktet procedurale, ato janë shprehur dakord për zëvendësimin. Por, edhe sikur të ishin shprehur dyshime apo rezerva për paanshmërinë e tyre nga të pandehurit apo mbrojtësit e tyre, përsëri pakica mendon se ato nuk do të ishin të mjaftueshme për të arritur në përfundimin për anësi në gjykim të tyre, derisa të provohej se ato ishin "objektivisht të justifikueshme".¹¹¹

III. *"Shorti në nenin 9 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, parashikohet si mënyrë e ndarjes së çështjeve gjyqësore, a duhet të shtrihet, si formë organizimi edhe në caktimin e gjyqtarëve të trupit gjykues që do të gjykojnë secilin prej tyre ?*

12. Shorti (caktimi i anëtarëve të trupit gjykues) nuk është veprim procedural i parashikuar në Kodin e Procedurës Penale. Shorti është parashikuar në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor si mënyrë e organizimit të punës nga drejtuesit e gjykatave.

12.1. Si formë organizimi, do të ishte më e gjetur që shorti të shtrihej edhe në caktimin e anëtarëve të trupit gjykues. Por nga sa ka qënë parashikuar në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 dhe parashikohet në nenin 9 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një gjë e tillë nuk përbën detyrim ligjor për organizuesit e shortit. Megjithatë, pavarësisht mungesës së normave juridike konkrete, i vlerësueshëm është aplikimi nga gjykatat i kësaj forme për caktimin e përbërjes së trupit gjykues.

IV. *"Shorti, si masë organizative (e cila parashikohet në një ligj organik), a duhet të konsiderohet rregull i barazvlefshëm me rregullat procedurale që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale, mosrespektimi i të cilave passjell pasoja në kuptimin e procesit të rregullt ligjor?*

13. Mosrespektimi i normave procedurale penale passjell, sipas rastit, pavlefshmërinë absolute ose relative të akteve procedurale. Përsa i përket mosrespektimit të rregullave jashtë procedurës penale (sikundër janë rregullimet aktuale lidhur me shortin), përfshirë dhe ndryshimin apo zëvendësimin e anëtarëve të trupit gjykues, ato janë të asaj kategorie të cilat gjykata më e lartë ia ve në dukje gjykatës që ka gjykuar çështjen si të metë për të mos e përsëritur në të ardhmen, por që nuk përbëjnë shkak për pavlefshëmri absolute të gjykimit.

13.1. Pakica mendon se shorti si masë organizative nuk duhet konsiderohet rregull i barazvlefshëm me rregullat procedurale që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale.

13.2. Ndër të tjera, nëpërmjet shortit nuk mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv, por rregullohet dhe parandalohet abuzimi i mundshëm në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, nëpërmjet përdorimit të metodave selektive.

14. Shprehja gjykatë e krijuar me ligj përfshin jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e një gjykate, por gjithashtu dhe përbërjen e trupës gjykuese në çdo çështje.¹¹²

¹¹¹ Gjykata e Strasburgut në çështjen "Haschildt kundër Danimarkës".

¹¹² Gjykata e Strasburgut në çështjen Buscarimi v San Marino (dec), nr.31657/96, 4 Maj 2000.

14.1. Në këtë kuptim dhe në vijim të argumenteve të mësipërme, pakica mendon se me përbërjen e trupit gjykues lidhen pazgjidhshmërisht parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë. Ky i dyti ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.¹¹³

15. Sikundër vlerësuam në përgjigje të pyetjes së dytë e gjejmë me vend të parashtrijmë se ekzistenca e paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar dy teste: **testin objektiv, që shqyrton nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë, dhe testin subjektiv, që ka të bëjë me bindjen e brendshme të gjyqtarit për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Nga pikëpamja e testit subjektiv, gjykimi konsiderohet i paanshëm derisa njëra nga palët, në rrjedhën e procesit, të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën**¹¹⁴.

15.1. Nga këndvështrimi i testit subjektiv, rekursuesi nuk ka vënë në dyshim bindjen e brendshme të gjyqtarit përkatës për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

16. Për më tej, në shqyrtim të pretendimeve të rekursuesit nga pikëpamja e testit objektiv parshtrijmë:

16.1. Në rrethanat specifike të çështjes në shqyrtim, edhe konstatimi i ekzistencës së një defekti apo të mete në procesin e organizimit të shortit nuk përbën i vetëm shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ. Së pari, edhe pse gjyqtari u ndryshua për shkaqe të arsyeshme, gjyqtari zëvendësues dhe anëtarët e tjerë të trupit gjykues mbetën të njëjtë gjatë gjithë procesit. Së dyti, besueshmëria dhe paanësia e këtij gjyqtari nuk u vu dhe nuk është vënë në diskutim nga të pandehurit për asnjë moment, madje edhe gjatë gjykimit para Kolegjeve të Bashkuara nuk u ngrit ndonjë pretendim i tillë që të vinte në dyshim paanshmërinë e tij. Së treti, nuk ka asnjë pretendim se gjyqtari zëvendësues ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes ose për ndonjë motiv tjetër të papërshtatshëm. Në këto kushte, fakti se zëvendësimi i gjyqtarit është bërë pa short nuk mund të përbëjë shkak për të konsideruar procesin si të parregullt.

16.2. Gjithashtu konstatohet se nga rekursuesi apo nga ndonjë palë tjetër e gjykimit nuk janë kundërshtuar ndryshimet e anëtarëve të trupit gjykues.

16.3. Në këto rrethana, pakica vlerëson se Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, në përbërje të të cilës ka qenë edhe gjyqtari I. Olldashi, **i ka ofruar palëve garancitë e nevojshme të cilat i'ua kanë larguar atyre dyshimin për njëanshmërinë e gjykatës.**

17. Lidhur me pretendimin se gjykimi në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë nuk është bërë nga gjykatë e caktuar me ligj për aq sa nuk janë respektuar kërkesat për hedhien e shortit dhe të formimit të trupit gjykues, pakica gjykon se mosrealizimi i shortit në zëvendësimin e gjyqtarit për shkaqe të parashikuara në nenin 342/4 të Kodit të Procedurës Penale nuk ka sjellë asnjë cenim të të drejtave apo interesave të ligjshme të të pandehurit.

17.1. Përkundrazi, konstatohet se të pandehurit gjatë gjykimit në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë nuk i është cënuar asnjë e drejtë procedurale. Kjo palë ka marrë pjesë në gjykim,

¹¹³ Vendim nr.12, datë 13.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

¹¹⁴ vendimet nr.7, datë 11.03.2008 dhe nr.11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

është dëgjuar e mbrojtur, ka paraqitur provat e vlerësuara prej saj si të nevojshme për këtë gjykim dhe ka diskutuar mbi to, ka debatuar në lidhje me pretendimet e palës akuzuese.

18. Nga ana tjetër, nuk evidentohet asnjë nga rastet e papajtueshmërisë me funksionin e ndonjë prej gjyqtarëve në gjykimin e çështjes, prania e të cilëve do të bënte që të mungonin kushtet për qënien e tij anëtar i trupit gjykues dhe për rrjedhojë do të bënin edhe vendimin absolutisht të pavlefshëm (shkronja “a” e nenit 128/1 të K.Pr.Penal).

18.1. Rastet e parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes konkrete, nëse vërtetohen në gjykim, nuk sjellin pavlefshmëri absolute, por pavlefshmëri relative. Vetëm vërtetimi i rasteve të parashikuara nga nenet 15 dhe 16 sjell pavlefshmëri absolute të akteve të gjyqtarit në kuptim të nenit 128, pika 1, gërma “a” të këtij Kodi.

19. Veç kësaj, sikurse u argumentua më sipër, referimi i rekursuesit në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” nuk ka lidhje me rastin e pavlefshmërisë absolute të parashikuara nga gërma “a” e nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo edhe për faktin se në këtë dispozitë veç sa thuhet se “*Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj*”. Pra nuk janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe as karakteri i kësaj procedure në raport me dispozitat e ligjit procedural penal, për rastet kur kjo procedurë nuk respektohet.

20. Ndryshe nga sa është pranuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk evidentohet asnjë “*element procedural*” që të ketë patur ndikim në dëm të zgjidhjes së drejtë të çështjes, përmbajtjes së vendimit dhe në dëm të interesave të palëve. Nëse ndikimi do të kishte qenë thelbësor dhe njëkohësisht të vërtetohej, atëherë do të ishim para shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

21. Për rastin në shqyrtim, vlerësojmë se zëvendësimi i gjyqtarëve i pa kontestuar nga palët nuk përbën cënim të procesit të rregullt ligjor dhe nuk mund të sjellë pavlefshmëri absolute. Për rrjedhojë nuk ndodhemi përpara mosrespektimit të parimeve kushtetuese të zhvillimit të një procesi gjyqësor nga një gjykatë e paanëshme dhe e caktuar me ligj, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

22. Në argumentim sa sipër, mendojmë se nuk ka shkaqe ligjore që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të prishnin vendimet e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe dërgonin çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë.

Arjana Fullani

Evelina Qirjako

Ardian Nuni

Aleksandër Muskaj

Majlinda Andrea

Nr.3/2/1/1 i Regj. Themeltar
Nr.1 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Gani Dizdari	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 20.01.2011 morën në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURIT: STEFAN HODAJ

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprës penale të favorizimit të prostitucionit me të mitura, parashikuar nga neni 114/2 të Kodit Penal.

TË PANDEHURIT: EDMOND SPAHAJ

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprave penale të marrëdhënieve seksuale me të mitura dhe favorizimit të prostitucionit me të mitura, parashikuar nga nenet 100/1 dhe 114/2 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.302, datë 11.12.2002, ka vendosur:

Të deklarojë fajtor të pandehurin Edmond Spahaj për kryerjen e veprës penale të marrëdhënieve seksuale me të mitura, parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal (K.P.), ligji 7895, datë 27.01.1995 dhe, bazuar në këtë dispozitë, e dënon atë me 8 vjet burgim.

Të deklarojë fajtor të pandehurin Edmond Spahaj për kryerjen e veprës penale të favorizimit të prostitucionit me të mitura, parashikuar nga neni 114/2 i K.P. dhe, bazuar në këtë dispozitë, e dënon atë me 8 vjet burgim.

Në bazë të nenit 55 të K.P., në bashkim të veprave penale, e dënon të pandehurin Edmond Spahaj me një dënim të vetëm 12 vjet burgim.

Të deklarojë të pafajshëm të pandehurin Stefan Hodaj për kryerjen e veprës penale të favorizimit të prostitucionit me të mitura, pasi nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.82, datë 04.04.2003, ka vendosur:
Mospranimin e apelit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.22, datë 20.04.2004, ka vendosur:
Rivendosjen në afat të kërkesit Edmond Spahaj për të bërë ankim kundër vendimit nr.302, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.585, datë 10.12.2004, ka vendosur:
Lënien në fuqi të vendimit nr.302, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr.872, datë 16.12.2005, ka vendosur:
Mospranimin e rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit Edmond Spahaj kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.128, datë 13.04.2007, ka vendosur:
Pranimin e kërkesës së kërkesit Edmond Spahaj.
Rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë recurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë ka bërë recurs i pandehuri Edmond Spahaj, i cili paraqet këto shkaqe:

- Kallëzimi i marrë prej të dëmtuarës nga ana e policisë gjyqësore është një fakt procedural i pavlefshëm, pasi nuk është një kallëzim i lirë i saj, por është bërë në kuadrin e një interviste me pyetje-përgjigje.
- Pavarësisht se sipas kallëzueses, në momentin që ajo është kapur nga policia italiane duke prostituuar në rrugë, ka qenë e martuar me shtetasin R.S, organi procedues nuk është marrë me saktësimin e pozitës së këtij të fundit, por me një histori që i përket një periudhe kohore 4-5 vjet më parë, duke marrë në ndjekje penale të pandehurin.
- Kallëzuesja, pas dhënies së dënimit, ka lëshuar një deklaratë noteriale ku thotë se nuk ka qenë Edmond Spahaj personi që e ka dhunuar e detyruar të prostituonte.
- Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar e provuar se i pandehuri Edmond Spahaj ka qenë në Greqi në periudhën kohore që akuzohet për veprat penale.
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë bie në kundërshtim me rregullat për formimin e trupit gjykues, parashikuar nga neni 345 i Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P.) .

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 09.04.2008 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin e praktikës gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Andi Çeliku dhe Arjana Fullani; prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Artur Selmani, që kërkoi mospranimin e rekursit të paraqitur dhe lënien në fuqi të vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë; mbrojtësin e të pandehurit av. Mark Pëllumbi, i cili kërkoi pranimin e rekursit dhe prishjen e vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr.302, datë 11.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me anë të të cilave është dënuar Edmond Spahaj dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

Nga gjykimi i çështjes në gjykatat e të gjitha shkallëve, deri në këtë fazë të gjykimit rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Më 06.02.2002, nga ana e policisë italiane është kthyer në portin e Durrësit e dëmtuara Brunilda Xhukollari, nga fshati Vërdovë i Pogradecit, e dtl.1983. Sipas kallëzimit të saj, të dhënë të nesërmen e kthimit, në muajin shtator të vitit 1997, kur ajo së bashku me të motrën e saj më të madhe, Xhuljeta, të dtl.1980 kanë qenë duke shëtitur në Pogradec, kanë takuar një shokun e kësaj të fundit, të cilit i kanë shprehur dëshirën për të shkuar e punuar në Itali. Ky ka njoftuar të pandehurit, banorë të fshatit Mesaplik, Vlorë, të cilët kanë ardhur rreth orës 14³⁰ në shtëpinë e djalit nga Pogradeci (i pa identifikuar) dhe të pestë së bashku janë nisur në Vlorë, ku janë strehuar në apartamentin e vëllait të të pandehurit Edmond, të ndodhur në një pallat 4-katësh, në vendin e quajtur "Kapele", Vlorë. Të nesërmen të dëmtuarat kanë dalë me dy të pandehurit për të blerë rroba dhe kur janë kthyer nuk kanë gjetur më në banesë djalin nga Pogradeci, i cili sipas thënieve të të pandehurve, i kishte shitur te ata dhe së bashku do të shkonin në Itali për të bërë një jetë normale. Po atë natë, personat e sipërpërmendur janë ndarë në çifte dhe me dëshirën e tyre kanë fjetur në dhoma të veçanta dhe kanë kryer marrëdhënie seksuale.

Të nesërmen, po të katërt janë nisur me skaf për në Itali dhe shpenzimet e udhëtimit janë paguar prej të pandehurve. Deri në Peruxhia ata kanë udhëtuar së bashku dhe këtu janë ndarë, duke shkuar e dëmtuara Brunilda (kallëzuesja) me të pandehurin Edmond, ndërsa e dëmtuara Xhuljeta me të pandehurin Stefan.

Pas një jave qëndrimi të së dëmtuarës Brunilda në shtëpinë e motrës së të pandehurit Edmond, e cila gjithashtu punonte si prostitutë, me kërkesën e të pandehurit Edmond kjo ka filluar të ushtrojë prostitucion në rrugë. Pas disa kohe pune, i pandehuri Edmond, duke qenë i pakënaqur nga të ardhurat e nxjerra prej saj nga prostitucioni, ka filluar ta rrahë dhe keqtrajtojë. Për një periudhë 6 mujore kjo e dëmtuar ka shpëputur lidhjet si me familjen e saj në Shqipëri, ashtu dhe me të motrën, të dëmtuarën tjetër. Mbas 1 viti e gjysëm kohe qëndrimi në Itali, afërsisht nga fundi i vitit 1998, të dyja motrat janë takuar rastësisht dhe pasi i janë ankuar njëra - tjetrës për dhunën e ushtruar nga të pandehurit dhe kanë vendosur të shkëputen prej tyre dhe, pasi e dëmtuara Brunilda ka mundur t'i marrë të pandehurit Edmond 10.000.000 lireta, dy motrat janë larguar në provincën e Ternit, ku kanë punuar për llogari të tyre.

Më pas e dëmtuara Xhuljeta është martuar me një shtetas italian, me të cilin ka lindur dhe një fëmijë, ndërsa e dëmtuara Brunilda është kthyer në Shqipëri, ku është fejuar me një djalë nga Durrësi, të quajtur R.S. Me këtë të fundit, ajo ka shkuar përsëri në Itali në vitin 2002, ku pas tre

muajsh qëndrimi atje është kapur nga policia italiane në rrugë, pa dokumente dhe është riatdhesuar. Sa më sipër janë deklaruar prej saj dhe në seancën gjyqësore të sigurimit të provës.

Në lidhje me sa më sipër, **dy të pandehurit, Edmond Spahaj dhe Stefan Hodaj, janë akuzuar për kryerjen e veprës penale të favorizimit të prostitucionit me të mitura, të parashikuar nga neni 114/2 i K.P., ndërsa i pandehuri Edmond edhe për veprën penale të kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të mitura, të parashikuar nga neni 100/1 i K.P.**

Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, në seancën e datës 14.10.2002, me kërkesë të mbrojtësve të të pandehurve, me vendim të ndërmjetëm, është konstatuar pavlefshmëria absolute e sigurimit të provës së thëniesve të të dëmtuarës Brunilda Xhukellari, pasi në seancën e sigurimit të provës gjykata nuk ka marrë vendim sipas pikës 1 të nenit 320 të K.Pr.P., por ka kaluar në seancë gjyqësore për marrjen e provës, pa i njoftuar të pandehurit për këtë veprim procedural, duke i mohuar kështu të drejtën për të qenë të pranishëm.

Gjithashtu, gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë është thirrur në cilësinë e dëshmitares e dëmtuara Xhuljeta, e cila ka deklaruar se i pandehuri Stefan Hodaj nuk ishte personi që e kishte trafikuar në Itali. Këtë të pandehur ajo dhe motra e saj e kishin takuar rastësisht në kafe, para se të niseshin në Itali dhe me të i kishte prezantuar personi që vërtet e kishte trafikuar këtë dëshmitare në Itali, i quajtur Bari, të cilin ajo e njihte po ta shikonte. Kjo dëshmitare ka deklaruar gjithashtu se nuk e dinte se ku e kishte mësuar e motra emrin e të pandehurit Stefan Hodaj. Por kjo dëshmitare ka konfirmuar pohimet e të dëmtuarës Brunilda në ngarkim të të pandehurit Edmond Spahaj.

Me kërkesë të prokurorit është lejuar dhe leximi i kallëzimit të të dëmtuarës Brunilda.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.302, datë 11.12.2002, ka vendosur:

Të deklarojë fajtor të pandehurin Edmond Spahaj për kryerjen e veprës penale të marrëdhënieve seksuale me të mitura, parashikuar nga neni 100/1 i K.P., ligji nr.7895, datë 27.01.1995 dhe, bazuar në këtë dispozitë, e dënon atë me 8 vjet burgim.

Të deklarojë fajtor të pandehurin Edmond Spahaj për kryerjen e veprës penale të favorizimit të prostitucionit me të mitura, parashikuar nga neni 114/2 i K.P. dhe, bazuar në këtë dispozitë, e dënon atë me 8 vjet burgim.

Në bazë të nenit 55 të K.P., në bashkim të veprave penale, e dënon të pandehurin Edmond Spahaj me një dënim të vetëm 12 vjet burgim.

Të deklarojë të pafajshëm të pandehurin Stefan Hodaj, për kryerjen e veprës penale të favorizimit të prostitucionit me të mitura, pasi nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i tij

Në këtë gjykim i pandehuri përfaqësohej nga Av. Kastriot Brahimucaj (caktuar kryesisht nga gjykata).

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.82, datë 04.04.2003, ka vendosur:

Mospranimin e apelit.

Ankimi i cili shqyrtohej në këtë gjykim ishte nënshkruar nga Av. Kastriot Brahimucaj, por në seancë rezultoi që të jetë përfaqësuar nga Av. Vajsi Haxhiraj (caktuar nga familjarët, por pa prokurë).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.22, datë 20.04.2004, ka vendosur:

Rivendosi në afat të kërkuarit Edmond Spahaj për të bërë ankim kundër vendimit nr.302, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në këtë gjykim i pandehuri përfaqësohej nga Av. Luan Xhuveli (caktuar nga familjarët e të pandehurit me prokurën nr.7/5, datë 05.11.2003).

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.585, datë 10.12.2004, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.22, datë 20.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në këtë gjykim i pandehuri përfaqësohej nga Av. Luan Xhuveli (caktuar nga familjarët e të pandehurit me prokurën nr.7/5, datë 05.11.2003).

Gjykata e Lartë, me vendimin nr.872, datë 16.12.2005, ka vendosur:

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit Edmond Spahaj kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Rekursi është nënshkruar nga Av. Luan Xhuveli (caktuar nga familjarët e të pandehurit me prokurën nr.7/5, datë 05.11.2003)

Gjatë gjithë kësaj periudhe i pandehuri Edmond Spahaj ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Pas ekstradimit në Shqipëri i pandehuri është ndaluar dhe në datë 02.02.2007 ka filluar ekzekutimi i vendimit nr.302, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë lënë në fuqi me vendimin nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Po në datën 02.02.2007 i pandehuri Edmond Spahaj është vënë në dijeni edhe të vendimeve gjyqësore të dhëna prej gjykatave të të gjitha shkallëve në lidhje me të.

Për shkak të gjykimin në mungesë, duke pretenduar mos pasjen dijeni për procedimin dhe vendimet e gjykatave në çështjen në fjalë, Edmond Spahaj, nëpërmjet avokatit të caktuar prej tij me prokurë të posaçme, ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë recurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.128, datë 13.04.2007, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së kërkuesit Edmond Spahaj. Rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë recurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Përfaqësimi në gjykim i të pandehurit është bërë nga Av. Arta Danaj, në bazë të prokurës së lëshuar nga i pandehuri Edmond Spahaj.

Kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë ka bërë recurs i pandehuri Edmond Spahaj, nëpërmjet avokatit të autorizuar prej tij me prokurë, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr.302, datë 11.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 09.04.2008, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin e praktikës gjyqësore, meqenëse vërejnë se në praktikën gjyqësore të gjykatave të apelit dhe të Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë, janë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me situatën juridike të shtruara për zgjidhje.

Kolegjeve të Bashkuara u janë parashtruar për shqyrtim këto pyetje:

- Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, a ka të drejtë i pandehuri ose mbrojtësi i tij të kërkojë rivendosjen në afat për të ushtruar recurs ndaj të njëjtit vendim të gjykatës së apelit, nëse i pandehuri pretendon se nuk është vënë në dijeni të vendimit ? E njëjta pyetje shtrohet edhe në rastin kur i pandehuri pretendon të rivendoset në afat për të drejtën e apelit.

- Nëse gjykata më e lartë vendos mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, a mund të kërkohet rivendosje në afat për të ushtruar ankim ndaj të njëjtit vendim?

- Në rastin e më shumë se një të pandehuri, kur çështja shqyrtohet mbi bazën e ankimit të një pjese të tyre, të pandehurve që nuk kanë ushtruar të drejtën e ankimit, a u lind kjo e

drejtë pasi vihen në dijeni të vendimit, nëse gjykata më e lartë në përfundim është shprehur për të gjithë të pandehurit bashkë?

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë gjykimit të çështjes për vendimin nr.3/2, datë 09.01.2009, kanë vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes para Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur për pajtueshmërinë e neneve 48/3 dhe 410/2 të Kodit të Procedurës Penale me nenin 43 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.30, datë 17.06.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se, edhe ashtu siç janë formuluar dy paragrafët e dispozitave të kontestuara, shmanget mundësia e dykuptimisë së tyre përmes interpretimit pajtues të dispozitave konkrete objekt shqyrtimi me Kushtetutën, jurisprudencën kushtetuese dhe me praktikën e Gjykatës Europiane.

Pasi riçelën shqyrtimin e çështjes, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë u dhanë përgjigjet e mëposhtme pyetjeve të shtruara për diskutim.

(i) *Në lidhje me çështjen e parë*

Sistemi penal shqiptar njeh dhe pranon si gjykim të vlefshëm gjykimin e zhvilluar në kushtet e mungesës së të pandehurit. Gjykimi në mungesë, në çdo rast, konsiderohet i vlefshëm vetëm në rast se i pandehuri vullnetarisht ka vendosur të mos marrë pjesë në gjykim, me kusht që njoftimet lidhur me procedimin penal dhe vendimet e dhëna të jenë kryer në përputhje me formën që parashikon ligji procedural penal dhe duke garantuar, në çdo rast, që interesat e tij të mbrohen prej një mbrojtësi të caktuar vetë ose nëpërmjet një prej mënyrave të parashikuara në ligj.

Në kushtet kur i pandehuri nuk merr pjesë në gjykim, kur ai nuk ka mundësi që të japë vetë deklaratat, të parashtojë apo kundërshtojë fakte, të shprehet në lidhje me provat e paraqitura apo të kërkojë administrimin e provave të tjera, njoftimi i procedimit penal dhe vendimet e marra, si dhe dhënia e mundësisë së mbrojtjes me avokat dhe ankimit kundër vendimeve të dhëna, marrin një rëndësi të jashtëzakonshme për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta), në nenin 33 përcakton se: “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë”. Në nenin 43 të Kushtetutës përcaktohet se: “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.

Dispozita kushtetuese mbi të drejtën e ankimit ka gjetur një trajtim të hollësishëm në Kodin e Procedurës Penale, Titulli VIII. Konkretisht, neni 410 i K.Pr.P. parashikon rregullin e përgjithshëm se: “*I pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji*”.

Jurisprudenca kushtetuese, në vendimin nr.30, datë 17.06.2010, ka pranuar se edhe mbrojtësi i caktuar prej palëve, sipas kushteve të nenit 48/3 të K.Pr.P., i cili parashikohen se: “*Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2*”, mund të legjitimohet të paraqesë ankim kundër një vendimi të gjykatës në rast se plotësohen disa kushte. **E drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim, si dhe për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë është një e drejtë kushtetuese vetjake, e cila nuk mund të transferohet te familjarët. Po ashtu, parashikimi në nenin 48/3 për mundësinë e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e të drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehuri nëpërmjet familjarëve. Me fjalë të tjera, i pandehuri e ushtron këtë të drejtë vetjake nëpërmjet familjarëve të tij, të cilët kanë**

mundësinë objektive për të kontaktuar me avokatë, në mënyrë që këta të fundit të marrin cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurit. Në këto kushte, në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij, që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojë vullneti i të pandehurit, i cili në çdo rast mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët”.

Në rastin në shqyrtim rezulton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është investuar njëherë në shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit i caktuar prej familjarëve të tij dhe, me vendimin nr.872, datë 16.12.2005, ky Kolegj ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, me arsyetimin se “Rekursi i paraqitur nga mbrojtësi i të gjykuarit Edmond Spahaj nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i K.Pr.Penale”. Pas ekstradimit dhe arrestimit të të pandehurit, avokati i caktuar prej tij me prokurë të posaçme ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë recurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, kërkesë e cila është pranuar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se ndonëse nga njëra anë paraqitja e rekursit nga i pandehuri Edmond Spahaj, pas rivendosjes së tij në afat, është një e drejtë kushtetues, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, i pandehuri e ka ezauruar këtë të drejtë ankimi (recursi) në momentin e gjykimit të çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, gjykim në të cilin i pandehuri është konsideruar i përfaqësuar rregullisht sipas neneve 48/3 e 410/2 të K.Pr.P. nga avokati i caktuar nga familjarët e tij me prokurë të posaçme. Për më tepër, mospranimi i rekursit nga Kolegji Penal nuk kufizohet vetëm në shqyrtimin e elementeve formalë të rekursit dhe që lidhen me afatin ligjor, tregimin e saktë të shkaqeve të paligjshmërisë së vendimit dhe nënshkrimin nga mbrojtësi (neni 435 i K.Pr.P.), por edhe në kontrollin e ekzistencës ose jo të shkaqeve të rekursit dhe që lidhen me “a) mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi; c) shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit” (neni 433 i K.Pr.P.).

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ritheksojnë qëndrimin tashmë të konsoliduar se e drejta për t’iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve, por kufizimet nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet.

Në rastin në shqyrtim, i pandehuri, në kushtet kur ka ezauruar të drejtën e ankimit dhe kur Gjykata e Lartë është shprehur njëherë me vendim në lidhje me rekursin e paraqitur prej tij, mund të zgjidhte mënyra të tjera ankimi, të parashikuara nga ligji, kundër vendimeve gjyqësore që ai kundërshton. Rishqyrtimi i rekursit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ai Kolegj është shprehur njëherë në lidhje me mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala, jo për shkak të paraqitjes së tij te afatit ligjor, bie ndesh me parimin e “*res judicata*” (gjësë së gjykuar), pasi i njëjti Kolegj nuk mund të shqyrtojë dhe shprehet dy herë në lidhje me rekursin e paraqitur nga e njëjta palë kundër të njëjtit vendimi të gjykatës së apelit.

Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues si më poshtë vijon:

Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit ose mbrojtësi i tij nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të të drejtës për të ushtruar recurs ndaj të njëjtit vendim për të cilin Kolegji është shprehur njëherë, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit. I njëjti qëndrim mbahet edhe në rastin e kërkesës për rivendosje në afat të të drejtës për të bërë apel pasi çështja është shqyrtuar në gjykatën e apelit.

(ii) *Në lidhje me çështjen e dytë*

Kushtetuta, në nenin 43, parashikon se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, mbi bazën e parashikimit kushtetues, gjen zbatim edhe në dispozitat procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*Ky qëndrim mbahet dhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 06.03.2009; nr.14, datë 05.07.2005*). Për këtë qëllim dispozitat procedurale parashikojnë si mjete ankimi apelin, rekursin në Gjykatën e Lartë dhe kërkesën për rishikim (neni 407 i K.Pr.P.), duke parashikuar dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve të ankimit (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 19.06.2009; nr.26, datë 15.12.2008; nr.19, datë 23.12.2004*).

Pavarësisht nga lloji i ankimit, K.Pr.Penale parashikon se ankimi duhet të bëhet në një formë të caktuar (neni 412), të paraqitet pranë një gjykate të caktuar (neni 413) dhe brenda një afati të caktuar (nenet 415 dhe 435).

Rastet kur gjykata vendos mospranimin e ankimit parashikohen në nenet 420 dhe 433 të K.Pr.Penale. Neni 420 përmban një listë shteruese shkaqesh procedurale, të cilat, në rast se konstatohen prej gjykatës (cilido prej tyre), sjellin mospranimin e ankimit të paraqitur nga pala, ndërsa neni 433 parashikon mospranimin për shkaqe të tjera. Depozitimi i ankimit përtej afatit ligjor, si shkak për mospranimin e ankimit, parashikohet në pikën "c" të nenit 420 të K.Pr.Penale.

Vendimi i gjykatës për mospranimin e ankimit, sipas nenit 420 të K.Pr.Penale, është një vendimarrje e cila nuk shqyrton dhe nuk bazohet në shkaqe të tjera përveç mungesës së elementëve të ankimit që lidhen me formën e ankimit dhe afatin e depozitimit të tij.

Mospranimi i ankimit për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të K.Pr.Penale ndjek të njëjtën llogjikë. Në asnjë rast gjykata që vendos mospranimin e ankimit nuk shqyrton dhe nuk shprehet lidhur me thelbin e kërkesave/pretendimeve të palëve, si dhe me faktin nëse gjykata, vendimi i të cilës ankimohet, ka zbatuar drejt ose jo ligjin material e procedural penal. Për rrjedhojë, mospranimi i ankimit për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor nuk zgjidh thelbin e mosmarrëveshjes dhe nuk rrëzon pretendimet e palëve apo miraton vendimin e gjykatës kundër të cilës është ushtruar ankimi.

Një vendim i tillë i gjykatës mund të kundërshtohet në dy mënyra, të cilat ndryshojë thelbësisht nga njëra-tjetra dhe që janë rekursi në Gjykatën e Lartë (neni 420, pika 3 e K.Pr.Penal) dhe rivendosja në afat (neni 147 i K.Pr.Penale). Rekursi kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur mospranimin e ankimit bazohet mbi pretendimin e palës se, shkaqet për të cilat është vendosur mospranimi i ankimit dhe që parashikohen në pikën 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, nuk ekzistojnë.

Nga ana tjetër, kërkesa për rivendosjen në afat, parashikuar në nenin 147 të K.Pr.Penale, nuk kundërshton në thelb vendimin e gjykatës në lidhje me ekzistencën ose jo të shkaqeve të mospranimit të ankimit. Kërkesa për rivendosje në afat është një mjet procedural që i mundëson subjekteve të caktuar të ushtrojnë të drejtën e ankimit, të cilën nuk kanë patur mundësi ta ushtrojnë brenda afateve ligjore për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore. Në kuptim të këtij neni, kërkesa për rivendosje në afat duhet të tregojë se pavarësisht se subjekti ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm, depozitimi i ankimit brenda afatit ligjor nuk ka qenë i mundur për shkaqe që nuk vareshin prej vullnetit të tij. Në rast se këto shkaqe konsiderohen të ligjshme prej gjykatës që shqyrton kërkesën, ajo i mundëson palës që të ushtrojë ankimi duke kundërshtuar vendimin dhe parashtruar shkaqet për të cilat ajo mendon se vendimi nuk është në zbatim të ligjit.

Gjykata, e cila shqyrton ankimin e rivendosur në afat, nuk kufizohet në shqyrtimin e elementëve formalë të ankimit, përveç atyre për të cilët është bërë rivendosja në afat, por shqyrton dhe shprehet lidhur me thelbin e pretendimeve të palës, duke vendosur përfundimisht sipas përcaktimeve të nenit 428 ose 441 të K.Pr.Penale.

Në rastin në shqyrtim, rezulton se Gjykata e Lartë me vendimin nr.872, datë 16.12.2005 ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur prej mbrojtësit të të pandehurit Edmond Spahaj, caktuar prej familjarëve të tij, kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Pas arrestimit të të pandehurit, avokati i caktuar prej tij ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, kërkesë e cila është pranuar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.872, datë 16.12.2005, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të paraqitur prej mbrojtësit të të pandehurit Edmond Spahaj, bazohet në nenin 432 të K.Pr.Penale, që parashikon mungesën e shkaqeve ligjore të rekursit dhe jo në nenin 420 të K.Pr.Penale, që parashikon paraqitjen e rekursit përtej afatit ligjor si shkak mospranimi.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vetëm në kushtet kur gjykata më e lartë vendos mospranimin e ankimit për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor, pa shqyrtuar në themel ekzistencën e shkaqeve ligjore të ankimit dhe ligjshmërinë e pretendimeve të ngritura në ankim, palëve u lind e drejta që të kërkojnë rivendosjen në afat të të drejtës për të ushtruar ankim, në rast se mendojnë se përmbushin kërkesat e pikës 1 të nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale.

Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë përfundimin unifikues si më poshtë vijon:

Në rastet kur gjykata më e lartë ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë rivendosjen në afat të të drejtës për të ushtruar ankim ose rekurs ndaj të njëjtit vendim.

(iii) Në lidhje me çështjen e tretë

Kodi i Procedurës Penale, nenet 79 dhe 92, parashikon dhe lejon gjykimin bashkërisht të disa personave nga i njëjti trup gjykues dhe brenda të njëjtit procesi gjyqësor, me qëllim ekonominë gjyqësore dhe rritjen e eficiencës së shqyrtimit gjyqësor.

Pas mbylljes së hetimit gjyqësor gjykata del me një vendim të vetëm për të gjithë të pandehurit, i cili nuk nënkupton përgjegjësi penale kolektive, por që në kuptim edhe të nenit 383 të K.Pr.Penale “tregon dhe parashtron në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta.....” për secilin prej të pandehurve. Në këtë kuptim, pavarësisht ekzistencës së një vendimi të vetëm gjyqësor, në përmbajtjen e tij gjenden “disa vendime”, të cilat përmbajnë rrethanat dhe provat e administruara nga gjykata, të cilat kanë bërë të mundur edhe kualifikimin e veprës penale të kryer prej secilit të pandehur si dhe nenet e zbatuara prej gjykatës.

Rregullat e përgjithshme të ankimit të përcaktuara në nenet 408 e vijues të K.Pr.Penale, parashikojnë, midis të tjerash, subjektet të cilat mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke e trajtuar ankimin si një regjim me karakter individual që sjell pasoja të caktuara vetëm për personin që e ushtron atë. Në rastet kur ka më shumë se një të pandehur, karakteri individual i ankimit vazhdon të ruhet, por për shkak të specifikës së këtij lloji vendimi, ligji parashikon një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, kur në nenin 416 të K.Pr.Penale parashikon se: “Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë.....”. Dispozitat e mësipërme favorizojnë pozitën që ka një i pandehur, i cili nuk ka bërë apel/ankim, pasi ai mund të përfitojë nga apeli/ankimi i bashkë të

pandehurit, pasi gjykata, sipas rastit, mund të prishë vendimin gjyqësor pavarësisht mos ankimit prej tij.

Në çdo rast, ankimi, i cili është pranuar për t'u shqyrtuar nga gjykata, i heq mundësinë të pandehurit (bashkë i pandehur), i cili nuk ka ushtruar ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij, që të kërkojë rivendosjen në afat për shkak se, bazuar në dispozitën e cituar më sipër, ai do të konsiderohet se e ka ezauruar të drejtën e ankimit. Për rrjedhojë, në kushtet kur gjykata është investuar në shqyrtimin e ankimit dhe është shprehur për bazueshmërinë ligjore të pretendimeve të parashtruara në ankim, i pandehuri nuk legjitimohet të kërkojë rivendosje në afat.

Vetëm në rast se ankimi i paraqitur prej bashkë të pandehurit tjetër nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, i pandehuri (bashkë i pandehur), i cili nuk ka ushtruar ankim, legjitimohet të kërkojë rivendosje në afat të të drejtës së tij për t'u ankuar kundër vendimit të gjykatës.

Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues si më poshtë vijon:

Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkë të pandehuri.

Pavarësisht sa më sipër, në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur ankimi i bashkë të pandehurit nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, si dhe kur gjykata është shprehur në vendim vetëm për ankimin e të pandehurit që ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe jo për gjithë të pandehurit.

Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit dhe përfundimet unifikuese të lartpërmendura, kjo gjykatë nuk mund të rishqyrtojë vendimin nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë për të cilin me vendimin nr.872, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Lartë është vendosur: “Mospranimi i rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit Edmond Spahaj”.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 438 dhe 441/a të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Mospranimin e rekursit të të pandehurit Edmond Spahaj, kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 20.01.2011

MENDIMI I PAKICËS

Ne gjyqtarët Gani Dizdari dhe Andi Çeliku jemi kundër vendimit të shumicës së gjyqtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit është vendosur “Mospranimi i rekursit të të pandehurit Edmond Spahaj, kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë...”.

Në këtë vendim, në përgjigje të pyetjeve të shtruara nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, shumica ka arritur në tre përfundime unifikuese, për të cilat shprehim qëndrimin tonë kundër si më poshtë:

1. Mbi pyetjen *“Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, a ka të drejtë i pandehuri ose mbrojtësi i tij të kërkojë rivendosjen në afat për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim të gjykatës së apelit, nëse i pandehuri pretendon se nuk është vënë në dijeni të vendimit? E njëjta pyetje shtrohet edhe në rastin kur i pandehuri pretendon të rivendoset në afat për të drejtën e apelit”*, shumica e gjyqtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin unifikues se: ***“Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit ose mbrojtësi i tij nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim për të cilin Kolegji është shprehur njëherë, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit. I njëjti qëndrim mbahet edhe në rastin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës për të bërë apel pasi çështja është shqyrtuar në gjykatën e apelit”***.

Kjo sentencë unifikuese ka kushtëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të të pandehurit Edmond Spahaj. Në arsyetimin e kësaj pjese të vendimit për nxjerrjen e këtij përfundimi unifikues, Kolegjet e Bashkuara i janë referuar Konventës Europiane të së Drejtave të Njeriut, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, jurisprudencës Kushtetuese dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, por ne gjyqtarët në pakicë çmojmë se përfundimet e këtij Kolegji bien në kundërshtim me frymën, udhëzimet dhe urdhërimet e akteve ligjore të mësipërme. Në vendimin e tyre Kolegjet e Bashkuara pranojnë fakte të tilla si: i pandehuri Edmond Spahaj është gjykuar në mungesë në të gjitha shkallët e gjykimit; - mbrojtja në shkallën e parë të gjykimit është ushtruar nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata, në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë nga avokati i caktuar nga familjarët e të gjykuarit; - gjatë gjithë gjykimit i pandehuri ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; - pas ekstradimit në Shqipëri i pandehuri është ndaluar dhe në datë 02.02.2007 ka filluar ekzekutimi i vendimit nr.302, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë lënë në fuqi me vendimin nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Po në datën 02.02.2007, i pandehuri Edmond Spahaj është vënë në dijeni edhe të vendimeve gjyqësore të dhëna prej gjykatave së të gjitha shkallëve në lidhje me të për shkak të gjykimit në mungesë, duke pretenduar mos pasjen dijeni për procedimin dhe vendimet e gjykatave në çështjen në fjalë, Edmond Spahaj, nëpërmjet avokatit të caktuar prej tij me prokurë të posaçme, ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.585, datë 10.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, kërkesë e cila është pranuar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.128, datë 13.04.2007, e më pas kundër këtij vendimi është paraqitur nga i pandehuri (avokati i caktuar prej tij) rekursi, objekt gjykimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Duke pasur parasysh faktet e mësipërme të përmendura e të pranura në vendimin e tyre nga Kolegjet e Bashkuara, si dhe konstatimet tona se mungojnë në dosjen gjyqësore akte që të provojnë se i pandehuri i është fshehur hetimit dhe gjykimit të çështjes, se i pandehuri është njoftuar personalisht për ekzistencën e një procedimi penal dhe gjykimi për të, se i pandehuri është njoftuar për vendimet gjyqësore të marra ndaj tij (veç komunikimit të vendimeve pas ekstradimit)

dhe se vullneti i të pandehurit ka qenë në përputhje me vullnetin e familjarëve të tij që kanë autorizuar një mbrojtës për përfaqësimin e të pandehurit në gjykim dhe ushtrimin e së drejtës së ankimit dhe rekursit, ne gjyqtarët në pakicë jemi të mendimit se me të drejtë i pandehuri i është drejtuar gjykatës për rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar rekurs e pas pranimit të kërkesës për rivendosje ishte gjithashtu e drejta e tij për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë e për t'u zhvilluar ndaj tij nga kjo gjykatë një gjykim themeli i çështjes, pra të shqyrtohej bazueshmëria në ligj e vendimit të gjykatës së apelit dhe jo mospranimi i rekursit të të pandehurit.

Në mbështetje të argumenteve të mësipërme të gjyqtarëve në pakicë, vijnë pikërisht të njëjtat akte ligjore që referojnë Kolegjet e Bashkuara në vendimin e tyre.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.30, datë 17.06.2010, ka evidentuar standardet e vendosura nga Gjykata Europiane që konsistojnë në: a) I pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejtë; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të tyre, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur ta ushtrojë personalisht në procesin në mungesë të përfunduar tashmë. “Në kushtet kur i pandehuri nuk merr pjesë në gjykim, kur ai nuk ka mundësi që të japë vetë deklarata, të parashtrojë apo kundërshtojë fakte, të shprehet në lidhje me provat e paraqitura apo të kërkojë administrimin e provave të tjera, njoftimi i procedimit penal dhe vendimet e marra, si dhe dhënia e mundësisë së mbrojtjes me avokat dhe ankimit kundër vendimeve të dhëna, marrin një rëndësi të jashtëzakonshme për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)” (i njëjti vendim i Gjykatës Kushtetuese).

Kështu në lidhje me fshehjen e një të pandehuri nga hetimi dhe gjykimi, njoftimin e të pandehurit në mungesë si dhe njoftimit atij të vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese arsyeton se “.....Pika 2 e nenit 33 të Kushtetutës përcakton se personat që i fshihen drejtësisë humbasin të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata. Në këtë kuptim Kushtetuta ka bërë një zgjedhje që ligjëron gjykimin e të pandehurit në mungesë kur plotësohen disa kushte, për të cilat në jurisprudencën e kësaj gjykate dhe në praktikën gjyqësore kanë ekzistuar interpretime e qëndrime relativisht të ndryshme. Edhe për këtë arsye Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme që, për të siguruar standardet kushtetuese, duhet reflektuar duke u bazuar edhe në praktikën e GJEDNJ-së. Në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet ketë dijeni në se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata arrin në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij. Gjykata vlerëson se në të njëjtën mënyrë në këtë aspekt duhet kuptuar dhe përmbajtja e nenit 147/2 i K.Pr.Penale, në të cilin thuhet: “Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka pasur dijeni për vendimin”.

Të njëjtin qëndrim si më sipër ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja në çështjen *Somogyi kundër Italisë*, pasi ka arsyetuar se mungesa e të pandehurit në një gjykim në ngarkim të tij nuk është në vetvete një dhunim i nenit 6 të KEDNJ-së, duke u shprehur “se jemi para një mohimi të drejtësisë, kur një person i gjykuar në mungesë nuk mund të arrijë që një gjykatë tjetër të shprehet përsëri në lidhje me akuzën, qoftë për sa i përket faktit, qoftë për sa i përket ligjshmërisë, pasi ta ketë dëgjuar, kur nuk përcaktohet në mënyrë të saktë që i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta që të

paraqitet para gjykatës dhe të mbrohet ose që ka pasur qëllimin që t'i fshihet drejtësisë ...". Rreth këtij problemi, në të njëjtin vendim, GJEDNJ-ja është shprehur se " ... njoftimi i të akuzuarit në lidhje me akuzat në ngarkim të tij përbën një akt të një rëndësie të tillë, ku duhet të ekzistojnë elemente të formës dhe përmbajtjes që të garantojnë ushtrimin efektiv të së drejtave të mbrojtjes nga i akuzuari ... për rrjedhojë një njohuri e pasaktë dhe e marrë nga burime jozyrtare nuk është e mjaftueshme".

Gjykata Kushtetuese ka çmuar se vendimi i mësipërm është i një rëndësie të veçantë, pasi parashikon se janë organet shtetërore ato që duhet të marrin të gjitha masat, nëpërmjet veprimeve aktive, për të siguruar gjykatën se i pandehuri është njoftuar në mënyrë të rregullt se në ngarkim të tij ka një procedim penal dhe se i pandehuri, pas këtij njoftimi të rregullt, me vullnetin e tij të lirë vendos t'i fshihet drejtësisë. Pra, ky interpretim i nenit 6 të KEDNJ-së nga ana GJEDNJ-së, përbën një garanci procedurale më shumë për shtetasit e vendeve që kanë nënshkruar Konventën e sipërpërmendur.

Po të njëjtin qëndrim për detyrimin e organeve shtetërore, që të garantojnë njoftimin në mënyrë të rregullt të të pandehurit, se në ngarkim të tij ka një procedim penal, e gjejmë edhe për gjykimin *Sejdovic kundër Italisë*. Në këtë gjykim GJEDNJ-ja ka shkuar edhe më tej, duke vërejtur se: "Dhunimi i nenit 6 të KEDNJ-së ka ardhur si pasojë e keqfunksionimit të legjislacionit dhe procedurave të brendshme, shkaktuar nga mungesa e një mekanizmi efektiv që të bënte të mundur realizimin e të drejtës së personave të dënuar në mungesë, të cilët edhe të painformuar në mënyrë efektive për gjykimin në ngarkim të tyre, edhe që nuk kishin hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta për t'u mbrojtur, për të përfituar që një gjykatë tjetër të shprehet përsëri në lidhje me akuzat".

Gjithashtu, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka miratuar Rezolutën (75) 11 "Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit", duke u rekomanduar shteteve anëtare që të mbajnë parasysh 9 rregulla minimale: (i) Askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për gjyq në kohë. (ii) Kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim. (iii) Kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit. (iv) I akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim. (v) Kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë. (vi) Një vendim gjykate i dhënë në mungesë duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë. (vii) Çdo personi të gjykuar në mungesë duhet t'i jepet e drejta për apelim me çdo lloj mjeti ligjor, që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm. (viii) Për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit. (ix) Një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij.

Gjykata Europiane është shprehur se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të së drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjaftojnë. Nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat (*Sejdovic kundër Italisë 2000*). Sipas praktikës së Gjykatës

Europiane, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigorozë, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve sipas kësaj gjykate, për të dyja rastet është detyrë e organeve kompetente. Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigorozë të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat për njoftimin.

Në lidhje me përfaqësimin dhe ushtrimin e së drejtës së ankimit të të pandehurit, nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët e tij, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.06.2010, është pranuar se “.....E drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim, si dhe për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë është një e drejtë kushtetuese vetjake, e cila nuk mund të transferohet te familjarët. Po ashtu, parashikimi në nenin 48/3 për mundësinë e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e së drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehuri nëpërmjet familjarëve. Me fjalë të tjera, i pandehuri e ushtron këtë të drejtë vetjake nëpërmjet familjarëve të tij, të cilët kanë mundësinë objektive për të kontaktuar me avokatë, në mënyrë që këta të fundit të shqyrtojnë mundësinë për të marrë cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurit. Në këto kushte, në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij, që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojë vullneti i të pandehurit, i cili në çdo rast mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët....Në rastin e gjykimin në mungesë, GJEDNJ-ja përcakton qartë se është detyrë e autoriteteve publike që të informojnë të pandehurin nëse ka ose jo një procedim penal në ngarkim të tij, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet siguria se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Në këtë mënyrë duhet që autoritetet shtetërore të marrin të gjitha masat e nevojshme për të informuar të pandehurin dhe vetëm nëse janë të sigurt se ai ka marrë njoftim në formën që parashikon ligji, atëherë mund të vazhdohet me procedimin në mungesë. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka, sipas GJEDNJ-së është detyrë e organeve kompetente shtetërore. E njëjta situatë është edhe për sa i përket ankimit. Familjarët e të pandehurit mund të paraqesin ankim vetëm në rast se janë duke përmbushur vullnetin e të pandehurit dhe vetëm nëse i pandehuri ka dijeni se ndaj tij ka filluar e po zhvillohet një proces penal. Në këtë mënyrë është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit. Duke këmbëngulur për domosdoshmërinë e njoftimit konform kërkesave ligjore dhe standardeve për këtë problem në çështjen “Sejdovic kundër Italisë”, GJEDNJ-ja u shpreh se nuk përbën provë për të vërtetuar se i pandehuri po i shmanget gjykimin nga vetë fakti se i pandehuri është larguar nga vendbanimi dhe nuk gjendet menjëherë pasi ka ndodhur vepra. Në këto kushte gjykata duhet të pranojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provon se ato po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Po i njëjti arsyetim duhet të ndiqet edhe në rastin kur është një avokat i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit që kërkon rivendosjen në afat, për të ankimuar vendimin e një shkalle më të ulët. Në këtë rast gjykata duhet të hetojë nëse vërtet i pandehuri nuk ka pasur dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij dhe nëse mbrojtësi ligjor i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit është zgjedhur me dijeninë e këtij të fundit”.

Nga ana tjetër, Kolegjet e Bashkuar të Gjykatës së Lartë në vendimin e tyre udhëzojnë të gjykuarin se “.....në kushtet kur ka ezauruar të drejtën e ankimit dhe kur Gjykata e Lartë është shprehur njëherë me vendim në lidhje me rekursin e paraqitur prej tij, **mund të zgjidhte mënyra të tjera ankimi**, të parashikuara nga ligji, kundër vendimeve gjyqësore që ai kundërshton. Rishqyrtimi i rekursit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ai është shprehur njëherë në lidhje me mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala, jo për shkak të paraqitjes së tij tej afatit ligjor, bie ndesh me parimin e res judicata (gjëja e gjykuar), pasi i njëjti Kolegj nuk mund të shqyrtojë dhe shprehet dy herë në lidhje me rekursin e paraqitur nga e njëjta palë kundër të njëjtit vendim të gjykatës së apeli”. Sa sipër vjen në kundërshtim me frymën e dhe udhëzimet e Konventës Europiane të D.NJ., e cila u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjet e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës. Detyra e Gjykatës Europiane është të shqyrtojë nëse rezultati që Konventa kërkon është arrirë nga shtetet kontraktuese. Veçanërisht mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht as nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t’u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë. **Mospranimi, për të rihapur procedurat e zhvilluara në mungesë të të akuzuarit, pa asnjë të dhënë se i akuzuari ka hequr dorë nga të drejtat e tij për të qenë i pranishëm, konsiderohet “një shkelje flagrante dhe mohim i drejtësisë”**. Rihapja e çështjes brenda afateve ligjore, kundër një vendimi të dhënë në mungesë, kur mbrojtësi e kishte autoritetin për të kërkuar pranimin e provave të reja, e bëjnë të detyrueshëm ndryshimin e vendimit dhe të akuzave, në atë mënyrë që procedimet në tërësi do të konsiderohen të drejta (*Stoichkov kundër Bulgarisë*). As një shkronjë, por as dhe shpirti i nenit 6 të Konventës nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë shprehimisht ose taktikisht. Por megjithatë për qëllimet e Konventës do konsiderohet efektive, që të drejtat e atij, që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoke dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre.

Duke pasur parasysh sa sipër, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se, në zbatim të nenit 46 të Konventës lind detyrimi, si për çdo shtet nënshkrues të saj, edhe për Republikën e Shqipërisë që të bëjë të mundur lejimin e shtetasve, që efektivisht nuk kanë pasur dijeni për një procedim penal në ngarkim të tyre, të kenë të drejtën për rihapjen e procesit gjyqësor në përputhje me nenin 147 të K.Pr.P. Gjykata Kushtetuese çmon se ky detyrim lind edhe për të gjithë organet gjyqësore të çdo shkalle, përfshirë edhe gjykatën referuese, e cila ka detyrimin që legjislacionin e brendshëm ta aplikojë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ. Kur ligjet kombëtare lejojnë realizimin e gjykimeve në mungesë për një person “të akuzuar penalisht”, menjëherë, sapo ai merr dijeni për këtë proces, duhet të ketë mundësinë e së drejtës për t’u dëgjuar nga gjykata për një vendim të freskët mbi pretendimet e akuzës. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i Konventës (*Colozza kundër Italisë, 1985*).

Për më tepër që, Kolegjet e Bashkuara, në kushtet kur jemi përpara një vendimi unifikues duhet të tregonin qartësisht se **kush janë rrugët ligjore (për të realizuar një “rigjykim”), që duhet të ndjekë një i pandehur i gjykuar në mungesë**, për të cilin nuk vërtetohet t’i jetë fshehur hetimit dhe gjykimit të çështjes, nuk është njoftuar dhe nuk i është komunikuar personalisht asnjë akt i procedimit hetimor e gjyqësor dhe nuk vërtetohet përputhja e vullnetit të tij me atë të familjarëve të cilët i kanë caktuar mbrojtës. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, në kushtet kur rishikimi i një vendimi penal mbështetur në nenin 450 të K.Pr.Penale kërkon në mënyrë taksative ekzistencën e njërit prej katër kushteve (kushte të cilat nuk kanë të bëjnë me sa arsyetohet më lart), mendojmë se i vetmi mjet për ushtrimin e së drejtës kushtetuese për ankim (rekurs) të të pandehurit do të ishte rivendosja e tij në afatin e paraqitjes së rekursit.

2. Në lidhje me pyetjen e shtruar se: “Nëse gjykata më e lartë vendos mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, a mund të kërkohet rivendosje në afat për të ushtruar ankim ndaj të njëjtit vendim?”, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin unifikues si më poshtë: **“Në rastet kur gjykata më e lartë ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim ndaj të njëjtit vendim”**. Përsa i përket këtij përfundimi të Kolegjeve të Bashkuara, në gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se ai është i mbështetur në ligj me të njëjtin arsyetim që bëjnë Kolegjet, por nuk jemi dakord me arsyetimin se vetëm në këtë rast i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim, pasi siç arsyetuam më lart të pandehurit duhet t’i njihet kjo e drejtë edhe për rastet e pikës 1 të këtij vendimi. Pavarësisht të qenit pro mendimit të shumicës për këtë sentencë unifikuese, në kushtet kur kjo sentencë unifikuese nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me rastin në gjykim dhe me atë çka është vendosur nga Kolegjet e Bashkuara (pasi pyetja dhe sentenca unifikuese janë përfshirë në vendim vetëm për efekt unifikimi), ne gjyqtarët në pakicë mbetemi tërësisht kundër vendimit për mospranimin e rekursit të të pandehurit, të vendosur nga Kolegjet e Bashkuara.

3. Përsa i përket pyetjes së fundit (të tretë) të shtruar nga Kolegji Penal se: “Në rastin e më shumë se një të pandehuri, kur çështja shqyrtohet mbi bazën e ankimit të një pjese të tyre, të pandehurit që nuk kanë ushtruar të drejtën e ankimit, a u lind kjo e drejtë pasi vihen në dijeni të vendimit, nëse gjykata më e lartë në përfundim është shprehur për të gjithë të pandehurit bashkë?”, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin unifikues se:

“Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkë të pandehuri.

Pavarësisht sa më sipër, në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur ankimi i bashkë të pandehurit nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, si dhe kur gjykata është shprehur në vendim vetëm për ankimin e të pandehurit që ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe jo për gjithë të pandehurit”.

Paragrafi i parë i këtij përfundimi unifikues mbështetet në nenin 416 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë.....” Në interpretim të kësaj dispozite, Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se “.....në çdo rast, ankimi, i cili është pranuar për t’u shqyrtuar nga gjykata, i heq mundësinë të pandehurit (bashkë i pandehur), i cili nuk ka ushtruar ankim, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij, që të kërkojë rivendosjen në afat për shkak se, bazuar në dispozitën e cituar më sipër, ai do të konsiderohet se e ka ezauruar të drejtën e ankimit. Për rrjedhojë, në kushtet kur gjykata është investuar në shqyrtimin e ankimit dhe është shprehur për bazueshmërinë ligjore të pretendimeve të parashtruara në ankim, i pandehuri nuk legjitimohet të kërkojë rivendosje në afat”. Ne gjyqtarët në pakicë, mbështetur në argumentet e dhëna nga ana jonë, në përgjigje të pyetjes së parë të shtruar për zgjidhje, çmujmë se nga ky përfundim unifikues duhej të përjashtoheshin rastet kur i pandehuri që nuk ka paraqitur ankim, është gjykuar në mungesë, nuk vërtetohet se i fshihet procedimit, nuk vërtetohet dijenia e tij mbi gjykimin dhe aktet e tij si dhe nuk përputhet vullneti i tij me atë të familjarëve për caktimin nga këta të fundit të një mbrojtësi.

Nga ana tjetër, jemi dakord me përfundimin unifikues të paragrafit të dytë sipas të cilit në rast se ankimi i paraqitur prej bashkë të pandehurit tjetër nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, i pandehuri (bashkë i pandehur), i cili nuk ka

ushtruar ankim, legjitimohet të kërkojë rivendosi në afat të së drejtës së tij për t'u ankuar kundër vendimit të gjykatës.

Edhe në këtë rast, megjithëse edhe për këtë përfundim unifikues jemi dakord, me përjashtimin e përmendur më lart, për shkak se në çështjen në gjykim i pandehuri ka ushtruar rekurs, mendojmë se përgjigja e pikës së tretë nuk ndikon në zgjidhjen e çështjes, por ka vetëm vlera për unifikimin e praktikës gjyqësore, ndaj përsëri mbetemi tërësisht kundër vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Përfundimisht, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se nuk duhej të ishte vendosur mospranimi i rekursit të të pandehurit Edmond Spahaj për shkaqet e përshkruara në vendimin e shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por duke u gjykuar çështja në themel të merrej në shqyrtim rekursi i të pandehurit në lidhje vërtetimin ose jo të shkaqeve të parashikuar nga neni 432 i K.Pr.Penale, duke u vendosur në fund sipas njërës prej rasteve të përcaktuara në nenin 441 të K.Pr.Penale.

Gani Dizdari

Andi Çeliku

Nr.2/1 i Regj. Themeltar
Nr.5 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Spiro Spiro	Anëtar
Evjani Sinoimeri	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Mirela Fana	Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 15.09.2009 morën në shqyrtim çështjen civile nr.2/1 Akti, që u përket:

TË GJYKUARVE: NEKI DREDHA, perfaqesuar nga Av. B.Fejzaj
MEDIN XHELILI, perfaqesuar nga Av. E.Xhelili
LLAMBRO BERBERI, ne mungese
DHIMITER SPIROPALI, perfaqesuar nga Av. E.Bushi

A K U Z U A R:

Per kryerjen e vepres penale te shperdorimit te detyres
dhe fallsifikimit te dokumentave.
Baza Ligjore: Nenet 248 dhe 186/2 te Kodit Penal.

TË GJYKUARËS: GJYZELA MURATI

A K U Z U A R:

Per kryerjen e vepres penale te shperdorimit te detyres.
Baza Ligjore: Neni 248 i Kodit Penal.

Gjykata e Shkalles se Pare Vlore me vendimin nr.223, date 24.11.2004 ka vendosur:

Deklarimin fajtores te pandehurve Medin Xhelili, Neki Dredha, Dhimiter Spiropali, Gjyzela Murati per kryerjen e vepres penale te shperdorimit te detyres, parashikuar nga neni 248 i K.P. dhe denimin e:

Te pandehurit Medin Xhelili, sipas nenit 248 te K.P. me 800.000 leke gjobe, e cila te paguhet brenda 2 muajve pasi vendimi te marre forme te prere.

Te pandehurit Neki Dredha, sipas nenit 248 te K.P. me 800.000 leke gjobe, e cila te paguhet brenda 2 muajve pasi vendimi te marre forme te prere.

Te pandehurit Dhimiter Spiropali, sipas nenit 248 te K.P. me 300.000 leke gjobe, e cila te paguhet brenda nje muaji pasi vendimi te marre forme te prere.

Te pandehuret Gjyzela Murati, sipas nenit 248 te K.P. me 200.000 leke gjobe, e cila te paguhet brenda nje muaji pasi vendimi te marre forme te prere.

Deklarimin te pafajshem te te pandehurit Llambro Berberi per kryerjen e vepres penale te shperdorimit te detyres ne zbatim te neneve 21, 24 te K.P. e 388 germa "ç" te KPrP.

Deklarimin te pafajshem te te pandehurve Neki Dredha, Medin Xhelili, Dhimiter Spiropali e Llambro Berberi per vepren penale te fallsifikimit te dokumentave zyrtare, parashikuar nga neni 186/2 i K.P., sipas nenit 377 e 388 te K.Pr.P.

Gjykata e Apelit Vlore me vendimin nr.143, date 14.05.2004 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.233, date 24.11.2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore dhe kthimin e çeshtjes per rigjykim ne ate gjykate, me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Larte me vendimin nr.337, date 18.05.2005 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.143, date 14.05.2004 te Gjykates se Apelit Vlore dhe dergimin e akteve per rishqyrtim ne ate gjykate, me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Vlore me vendimin nr.107, date 24.03.2006 ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit nr.223, date 24.11.2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore.

Kunder ketij vendimi kane paraqitur rekurs te gjykuarit, te cilet parashtrojne keto shkaqe per prishjen e tyre:

I gjykuari Dhimitraq Spiropali:

- Nuk qendrojne pretendimet se eshte dhene toke ne perdorim ne 66 raste, pasi keta persona nuk e kane disponuar token bujqesore, gje qe eshte vertetuar gjate azhornimit te tokes. Asnjehere siperfaqja e tokes ne pronesi nuk ka qene me e madhe se ajo e dhene ne perdorim.
- Ish punonjesve te N.B. Ullishta nuk u eshte dhene toke bujqesore ne pronesi, pa u dhene me pare ne perdorim.

I gjykuari Neki Dredha:

- Te gjitha vendimet e dhenies se tokes nga perdorimi ne pronesi i ka vendosur komisioni i tokes se rrethit me pare se une te zgjidhesha kryetar bashkie. Asnje nga vendimet e regjistruara nuk ka nenshkrimin tim. Nenshkrimi i formularit 6 nuk ka sjelle asnje pasoje.
- Te gjitha vendimet e marra nga Komisioni i Tokes se rrethit te vitit 2000 jane anuluar dhe nuk jane regjistruar ne Z.R.P.P. Vlore.

I gjykuari Medin Xhelili:

- Nga mbledhja dhe sistemimi i dokumentacioneve nuk i ka ardhur asnje pasoje qofte individit, qofte shtetit.
- Praktika dokumentare ka qene transparente dhe kolegjinale.

E gjykuara Gjyzela Murataj:

- Rastet per te cilat akuzohem kane ndodhur ne vitet kur une nuk kam qene ne marredhenie pune. Jam larguar nga puna ne vitin 1998, duke mos patur asnje mundesi konkrete qe te shperdoroj detyren ne vitin 2000 kur eshte bere ndarja e tokave ne Uje te Ftohte.
- Per asnje nga rastet qe akuzohem nuk ndodhet nenshkrimi im.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin date 18.6.2008 ka vendosur:

Kalimin e ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, me qellim unifikimin e praktikes gjyqesore lidhur me kuptimin e pikes 2 te nenit 435 te K.Pr.Penale, duke shtruar para Kolegjeve te Bashkuara per zgjidhje :

1. A duhen pranuar rekurset e paraqitura prane Gjykates se Larte vetem me nenshkrimin e mbrojtetit te te pandehurit, apo dhe me nenshkrimin e te pandehurit?
2. Ne rastin kur i pandehuri nuk ka mbrojtetes, a duhet qe gjykata te caktojte nje mbrojtetes kryesisht?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e gjyqtareve Besnik Imeraj e Majlinda Andrea; Prokurorin Bujar Sheshi, i cili ne kerkesa paraprake kerkoi mos pranimin e rekurseve, av. E.Bushi, qe kerkoi pranimin e rekursit te te gjykuarit Dhimitraq Spiropali, pasi eshte ne formen e kerkuar nga ligji; av. B.Veizaj, qe kerkoi pranimin e rekursit te te gjykuarit Heki Dredha, pasi edhe pse jashte afatit ceshtja duhet te shqyrtohet ne teresi per gjithte te gjykuarit,

V Ë R E J N Ë

Te gjykuarit Medin Xhelili, Neki Dredha, Dhimiter Spiropali, Gjyzela Murati jane deklaruar fajtorë dhe denuar nga gjykatat e faktit per kryerjen e vepres penale te shperdorimit te detyres, parashikuar nga neni 248 i K.P.

Gjykatat e faktit kane pranuar se, gjate ushtrimit te detyres se tyre, ata kane nenshkruar akte te marrjes se tokes ne perdorim, kur sipas akteve ligjore e nenligjore, afati per dhenien e akteve ka qene deri ne muajin shkurt te vitit 1996 dhe organi kompetent per dhenien e ketyre akteve ka qene vetem komisioni i caktuar nga ish N.B.-te. Si pasoje e ketyre veprimeve, shume perfitues te tokes kane marre siperfaqe toke më shume dhe mbivendosja midis siperfaqeve ka sjelle si pasoje nje sere konfliktesh gjyqesore.

Kunder te dy vendimeve te gjykuarit kane bere rekurs ne Gjykatën e Larte dhe Kolegji Penal, pas kerkesave paraprake te organit te akuzes per mospranimin e rekurseve, e ka derguar ceshtjen per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, te cilat, ne seancen e dates 15.09.2009, u terhoqen per vendim per t'iu dhene pergjigje kerkesave paraprake te prokurorit lidhur me mospranimin e rekurseve dhe konstatuan se:

Rekursi i te gjykuarve Neki Dredha e Mehdi Xhelili rezulton te jete paraqitur ne sekretarine e Gjykates se Shkalles se Pare Vlore jashte afatit 30 ditor qe parashikon dispozita e nenit 435/1 te K.Pr.Penale.Te dy keto rekurse jane depozituar ne daten 25.04.2006, nderkohe qe vendimi i Gjykates se Apelit Vlore eshte shpallur ne daten 24.03.2006. Paraqitja e rekurseve te

ketyre te gjykuarve jashte afatit 30 ditor eshte nje prej shkaqeve qe, ne kuptim te detyrimeve qe rrjedh nga dispozita e nenit 420/c te K.Pr.Penale, e detyron gjykatën te mos pranoje shqyrtimin e tyre.

Sipas pretendimit te organit te akuzes, duke qene se rekursët e te gjykuarve Dhimitraq Spiropali e Gjyzela Murataj nuk jane te nenshkruar nga mbrojtësit e tyre, edhe ato nuk duhet te pranohen, pasi ne paraqitjen e tyre jane shkelur kerkesat e nenit 435/2 te K.Pr.Penale.

Ndryshe nga akuza, mbrojtësit e te gjykuarve pretenduan se duke qene qe kjo dispozite vjen ndesh me te drejten kushtetuese per t'u ankuar ne nje gjykate me te larte ndaj nje vendimi gjyqësor, duke zbatuar drejtpersedrejti Kushtetuten, Kolegjet duhet te rrezojne kerkesen e prokurorit dhe te vazhdojne shqyrtimin e çështjes ne themel.

Por Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se rekursët e paraqitura nga te gjykuarit Dhimitraq Spiropali dhe Gjyzela Murataj nuk mund te shqyrtohen, mbasi ndodhemi perpara rasteve te ndalimit qe parashikon dispozita e nenit 420/c te K.Pr.Penale dhe se dispozita e nenit 435/2 te K.Pr.Penale nuk vjen ndesh me Kushtetuten e Shqiperise.

Në nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashikohet e drejta e ankimit efektiv ndaj vendimit të gjykatës. Kurse në nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, përcaktohet për shtetet detyrimi që të garantojnë nëpërmjet organeve kompetente gjyqësore, administrative, ose legjislative të drejtën e individit për të ushtruar ankim, si dhe krijimin e mundësive për gjykimin e tij. Te njetin qendrim mban edhe Kushtetuta e Shqiperise, e cila ne nenin 43 ka parashikuar se: *“Kushdo ka te drejte te ankohet kunder nje vendimi gjyqësor ne nje gjykate me te larte, perveçse kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe”*. Kjo e drejte kushtetuese e individit eshte e garantuar edhe me nje sere dispozitash procedurale penale, qe rregullohen ne Titullin VIII, Kreun I e qe titullohet *“Ankimet”*.

Sipas pikes 1 te nenit 407 te K.Pr.Penale, eshte ligji qe cakton rastet ne te cilat vendimet e gjykates mund te ankohen, si dhe mjetin e ankimit dhe keto mjete jane te percaktuara ne piken 3 te kesaj dispozite, sipas te ciles: *“mjetet e ankimit jane apeli, rekursi ne Gjykatën e Larte dhe kerkesa per rishikim”*. Pra, duke mos vene asnje kufizim te se drejtes se ankimit, ligjvenesit, ne zbatim edhe te detyrimit kushtetues qe rrjedh nga neni 43 i saj, i ka dhene mundesi kujtdo qe kunder vendimit apo urdherit te dhene nga nje gjykate te ankohet ne nje gjykate me te larte, duke perdorur ato mjete qe ne menyre te shprehur i parashikon K.Pr.Penale.

Por, duke mos kufizuar realizimin e kesaj te drejte kushtetuese, ligjvenesit ka percaktuar rregullime procedurale te cilat dispijlojne formen e ankimit, paraqitjen e tij, menyren e dergimit dhe te njoftimit, si dhe afatin e ankimit. Keshtu, sipas dispozites se nenit 420/1 te K.Pr.Penale, jane percaktuar ne menyre te qarte disa raste kur ankimi i paraqitur ndaj nje vendimi gjyqësor edhe pse eshte e drejte kushtetuese, behet i papranueshem pe t'u shqyrtuar, raste keto qe veçanerisht jane te lidhura me legjitimimin e personit qe ka paraqitur ankim, me llojin e vendimit ndaj te cilit eshte paraqitur ankimi, me respektimin e disa dispozitave qe rregullojne formen e ankimit, si dhe me te drejten e ankuesit per te hequr dore prej tij.

Fakti qe nje ankim, te cilit i mungon qofte edhe njera prej kerkesave procedurale te percaktuara shprehimisht ne piken 1 te nenit 420 te K.Pr.Penale, eshte gjyqesisht i pa pranueshem, kurrsesi nuk mund te konsiderohet si mohim i se drejtes se personit per t'u ankuar ndaj nje vendimi gjyqësor.

Eshte pikerisht kjo arsyeja qe edhe dispozita e nenit 435/2 te K.Pr.Penale ben pjese ne ato rregullime procedurale qe ligjvenesit ka dashur te dispijloje palet per te bere ankim. Jo pa qellim ligjvenesit kete dispozite e ka titulluar *“Paraqitja e Rekursit”* dhe sipas pikes 2 eshte parashikuar se: *“Akti i rekursit dhe memoriet duhet te nenshkruhen me pasoje mos pranimit nga mbrojtësi ...”*. Pra vullneti i ligjvenesit me kete dispozite kerkon nga palet, ne menyre te posaçme per rekursin,

qe te jete i nenshkuar nga mbrojtasi i te pandehurit, ne te kunder ai behet i pa pranueshem. Edhe pse nga permbajtja e nenit 420/1-c te K.Pr.Penale del qarte se rekursi nuk pranohet kur nuk jane zbatuar dispozitat qe lidhen me ... *paraqitjen ... e tij*, jo pa qellim ky fakt eshte perseritur edhe ne nenin 435 te K.Pr.Penale, i cili disiplinon menyren e paraqitjes se rekursit.

Kolegjet e Bashkuara çmojne qe qellimi i ligjvenesit, duke percaktuar ne menyre te shprehur detyrimin qe rekursi ne Gjykatën e Larte duhet te jete i nenshkuar nga mbrojtasi, ka qene vete juridiksioni qe ka sipas Kushtetutes Gjykates se Larte, e cila, sipas dispozites se nenit 141/1, ka juridiksion fillestar e rishikues. Duke qene nje gjykate ligji (ne rastet e juridiksionit rishikues), gjykimi ne Gjykatën e Larte ka nje natyre te veçante.

Se pari, kjo veçori lidhet me faktin se, sipas rregullimeve te nenit 432 te K.Pr.Penale, jane vetem tre rastet kur palet mund te investojne Gjykatën e Larte me ane te rekursit. Ky kufizim i parashikuar ne dispoziten e sipercituar kurrsesi nuk i mohon paleve te drejten kushtetuese te ankimit te vendimit gjyqesor, por vendos kritere te cilat pengojne formalizmin ne paraqitjen e rekursit.

Se dyti, veçoria e gjykimit ne Gjykatën e Larte del qarte edhe nga permbajtja e disa dispozitave te tjera te Kodit te Procedures Penale.

Keshtu, sipas nenit 437/5 te ketij Kodi: “Gjyqtari i ngarkuar relaton çeshtjen. Pas fjales se prokurorit, mbrojtasi dhe perfaqesuesit e paleve private bejne mbrojtjen. Replika nuk lejohet”. Kjo dispozite, e cila mund te duket se mohon nje te drejte themelore te individit, e parashikuar nga neni 33/1 i Kushtetutes, ne fakt gjate gjykimit ne Gjykatën e Larte nuk lejon te pandehurin te marri vete fjalen per te mbrojtur interesat e tij. Kete te drejte ligjvenesit ja ka dhene mbrojtasi te te pandehurit, ashtu si dhe te drejten per te nenshkuar aktin e rekursit. Kjo veçori gjykimi perforcohet edhe nga dispozita e nenit 433/2 te K.Pr.Penale, sipas te cilit: “Mospranimi i rekursit vendoset nga Kolegji i Gjykates se Larte ne dhome keshillimi, pa pjesemarrjen e paleve”. Siç shihet, duke qene nje gjykate ligji dhe qe nuk merr prova, Gjykata e Larte i jep zgjidhje ankimeve te paleve edhe pa pjesemarrjen e tyre, por vetem duke u bazuar ne aktin e rekursit, memoriet dhe dosjen gjyqesore. Eshte pikerisht kjo nje tjetër arsye qe, ndryshe nga sa pretendoi mbrojtja, Kolegjet e Bashkuara çmojne se duke mos pranuar rekursin ne Gjykatën e Larte pa nenshkrimin e mbrojtases, per te pandehurit ne fakt rritet standarti ne favor te garancive per te mos humbur te drejten e gjykimit per shkak te paraqitjes se rekursit jo sipas kerkesave procedurale penale, garanci kjo qe sigurohet me nenshkrimin e rekursit prej nje mbrojtasi. Ky perfundim del nga permbajtja e nenit 433/1 te K.Pr.Penale, sipas te cilit rekursi nuk pranohet, nese behet per shkaqe te ndryshme nga ato qe lejon ligji. Keto shkaqe jane te percaktuara ne nenin 432/1 te ketij Kodi dhe nese rekursi do te behet nga nje person jo specialist, pra jo nga mbrojtasi, rritet ndjeshem mundesia qe rekursi te mos pranohet.

Kolegjet e Bashkuara çmojne se si çdo e drejte subjektive, edhe e drejta e ankimit nuk perjashton mundesine qe ligjvenesit te vendose kufizime ne ushtrimin e saj per te mbrojtur nje interes te caktuar publik, apo te individit. E rendesishme eshte qe kufizimi i vendosur te mos reduktoje mundesine e individit ne nje mase apo menyre te tille sa te cenoje vete thelbin e te drejtes per t'u ankuar, pra kufizimi te mos kthehet ne mohim te se drejtes. Ne rastin e dispozites se nenit 435/2, kufizimi i vendosur nga ligjvenesit lidhur me nenshkrimin e rekursit, jo vetem nuk kthehet ne mohim te kesaj te drejte, ç'ka e tregon edhe vete fakti i zhvillimit te ketij gjykimi, por eshte nje kufizim qe nuk cenon ndonje prej te drejtave qe parashikon neni 17 dhe neni 43 i Kushtetutes se Shqiperise. Ndryshe nga pretendimi i mbrojtases te te gjykuarit Spiropali se mosrespektimi i kriterit te proporcionalitetit qendron pikerisht ne pamundesine e te pandehurit per te gjetur mbrojtjen, Kolegjet e Bashkuara çmojne se nuk qendron. I pandehuri i ka te gjitha mundesite per te patur nje mbrojtjen dhe ne rastet kur eshte ne pamundesi i vjen ne ndihme ligji nr.10039, date 22.12.2008 “Per ndihmen juridike”. Nga permbajtja e nenit 13/1 te ligjit te sipercituar rezulton se te drejten per te

fituar ndihme juridike e kane personat qe: "... kerkojne te mbrohen me avokat ne procesin penal ne te gjitha fazat e tij ..." dhe sipas pikes 3 te ketij neni: "ndihma juridike mund te kerkohet para, gjate dhe pas zhvillimit te procesit gjyqesor".

Ne te njejten linje, ligjvenesi i qendron garancive kushtetuese te individit per te ankuar vendimet gjyqesore edhe duke parashikuar ne dispozite detyrimin qe akti i rekursit te behet i shkruar. Fakti qe neni 435/1 ne menyre taksative parashikon se rekursi duhet te paraqitet me shkrim, ne te kundert sipas nenit 420/c ai nuk pranohet, nuk mund te interpretohet si mohim te te drejtes se te pandehurit per te ushtruar rekurs nese ai nuk di shkrim e kendim.

Dhe pse ne dispozitat procedurale penale nuk eshte parashikuar ne menyre te posaçme e drejta e sekretarise gjyqesore per te verifikuar rregullshmerine e ankimit, Kolegjet e Bashkuara çmojne se vete sekretarite e gjykatave ku depozitohet ankimi mund dhe duhet te vene ne dijeni te pandehurit ne rastet kur rekursi paraqitet i pa nenshkruar nga mbrojttesi, me qellim qe, ne zbatim te kerkesave te nenit 415/2 te K.Pr.Penale, ai te kete mundesine per plotesimin e tij.

Bazuar ne sa siper, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arrijne ne perfundimin unifikues se ***rekursi penal duhet te nenshkruhet nga mbrojttesi, ne te kundert ai nuk pranohet per shqyrtim ne Gjykatën e Larte.***

Lidhur me pyetjen e dyte te shtruar per unifikim, Kolegjet e Bashkuara çmuan te mos e vene ne bisedim, per shkak se Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.13, date 21 Korrik 2008, i ka dhene zgjidhje problemit te caktimit te mbrojttesit kryesisht ne Gjykatën e Larte.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, mbeshetur ne nenin 420/1-c te K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Mospranimin e rekurseve te paraqitur nga te gjykuarit Dhimiter Spiropali e Gjyzela Murati, per shkak se nuk jane respektuar dispozitat per paraqitjen e tyre.

Mospranimin e rekurseve te paraqitur nga te gjykuarit Neki Dredha e Medin Xhelili, per shkak se jane paraqitur jashte afatit procedural.

Ky vendim te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare per njehsimin e praktikës gjyqesore.

Tiranë, më 15.09.2009

Nr.9 i Regj. Themeltar
Nr.4 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykatës së Lartë, te përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Gani Dizdari	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Evjeni Sinoimeri	Anetare
Besnik Imeraj	Anetar
Ardian Dvorani	Anetar
Fatos Lulo	Anetar
Ardian Nuni	Anetar
Guzim Zenelaj	Anetar
Majlinda Andrea	Anetare
Andi Çeliku	Anetar
Arjana Fullani	Anetare
Evelina Qirjako	Anetare
Mirela Fana	Anetare

në seancen gjyqesore te dates 24.06.2009 morën në shqyrtim çështjen penale me:

KËRKUES: ERJON DULAJ

OBJEKTI:

Kundërshtim i vendimit nr.2, date 06.01.2009
të Gjykatës së Apelit per Krime te Renda Tirane
për caktimin e mases se sigurimit.

A K U Z U A R:

Per vepren penale te parashikuar
nga nenet 283/a/2 dhe 278/a/2 te K.Penal,

Gjykata e Shkallës së Parë per Krime te Renda Tirane, me vendimin nr.252, date 11.12.2008 ka vendosur:

Caktimin e masës se sigurimit personal “Arrest ne burg” ndaj personit nen hetim Erjon Dule, pasi dyshohet se ka kryer veprat penale te parashikuara nga nenet 283-a/2 dhe 278-a/2 te K.Penal.

Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane brenda 10 diteve, duke filluar ky afat nga dita e zbatimit te vendimit.

Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane, me vendimin nr.2, date 06.01.2009 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr.252, date 11.12.2008 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

Kunder ketij vendimi, ka paraqitur rekurs mbrojttesi i caktuar kryesisht nga personi nen hetim Erjon Dule dhe ka kerkuar prishjen e tij, duke paraqitur keto shkaqe:

- Eshte shkelur nje nga te drejtat themelore te shtetasve dhe qe lidhet me nje proces te drejte, te hapur dhe te barabarte.
- Gjykata e apelit duhet ta shqyrtonte çeshtjen, pasi ankimi eshte paraqitur brenda afatit dhe pasi kemi marre dijeni per vendimin e shkalles se pare.
- Masa e sigurimit personal eshte vendosur jashte afateve proceduriale te hetimit.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtareve Spiro Spiro dhe Ardian Dvorani; prokurorin Artur Selmani, qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane; av. Sazan Aliko, qe kerkoi prishjen e te dy vendimeve dhe rrezimin e kerkeses per caktim te mases se sigurimit personal “arrest ne burg” per te pandehurin Erjon Dulaj dhe si shqyrtoi ne teresi çeshtjen,

V Ë R E J N Ë

Organi i Prokurorise Vlore ka filluar procedimin penal ne ngarkim te shtetasit Erjon Dulaj, duke e akuzuar per kryerjen e vepres penale te parashikuar nga nenet 283/a-2 dhe 278/a-2 te K.Penal. Duke arsyetuar se ekzistojne dyshime te bazuara ne prova se ky shtetas, ne bashkepunim edhe me persona te tjere, ka tentuar te trafikojte lende narkotike dhe arme, organi i akuzes ka kerkuar ne gjykate qe ndaj tij te caktohet si mase sigurimi personal ajo e “arrestit ne burg”.

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, duke çmuar se ekzistojne kushtet qe kerkon dispozita e nenit 228/1 te K.Pr.Penale dhe pasi ka vleresuar kriteret qe kerkon dispozita e nenit 229 dhe 230 te K.Pr.Penale, ka caktuar ndaj personit nen hetim si mase te sigurimit personal ate te “arrestit ne burg”. Vendimi eshte dhene ne mungese te personit nen hetim.

Pasi eshte vene ne dijeni te ketij vendimi (sipas mbrojtjes dijenia eshte marre pasi organet e policise kane shkuar ne shtepine e tij per te ekzekutuar vendimin e gjykates), mbrojttesi i caktuar kryesisht nga personi nen hetim, Erjon Dulaj, ka paraqitur ankim te Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane.

Kjo gjykate, me arsyetimin se ndaj ketij vendimi, mbrojttesi nuk legjitimohej per te ushtruar ankim, pasi nuk ishte njoftuar sipas dispozitave procedurale penale, ka vendosur mospranimin e ankimit.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, duke konstatuar se ne praktiken e disa gjykatave, por edhe nga Kolegji Penal i Gjykates se Larte, interpretimi i pikave 1 dhe 2 te nenit 249 te K.Pr.Penale eshte i ndryshem, vendosi te dergoje çeshtjen per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per njehsimin e praktikës, duke shtruar per unifikim:

1. Vendimi per caktimin e mases se sigurimit personal ndaj nje personi ne mungese a eshte i ankimeshem para se te ekzekutohet?

2. Nese personi, ndaj te cilit eshte vendosur masa e sigurimit personal, vihet ne dijeni te vendimit te gjykates jo ne menyren qe percakton neni 141 i K.Pr.Penale dhe i fshihet ekzekutimit te ketij vendimi, a ka te drejte ta ankimoje ate para se te ekzekutohet?

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, çmojne se perfundimi i arritur nga Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit kunder vendimit nr.252, date 11.12.2008 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, vjen si rezultat i kuptimit dhe zbatimit te gabuar te dispozitave ligjore qe lidhen me menyren e caktimit te masave

te sigurimit, verifikimit te tyre nga gjykata dhe te drejtes se ankimit qe kane palet ne kete lloj gjykimi.

Kodi i Procedures Penale ka parashikuar dy menyra per caktimin e masave te sigurimit personal. Menyra e pare dhe qe eshte rregulli per caktimin e masave te sigurimit eshte ajo qe parashikohet nga neni 244 e vijues i ketij Kodi. Sipas ketij rregullimi eshte prokurori, i cili, mbasi ka vleresuar ne menyre te njeanshme se ne ngarkim te personit ndaj te cilit zhvillohen hetimet per nje veper te caktuar penale ekziston dyshimi i bazuar ne prova per kryerjen e vepres penale, duke patur parasysh kushtet dhe kriteret qe parashikon Kodi i Procedures Penale, ne nenet 228 e vijues te tij, i ben kerkesa gjykates qe te caktojte nje mase sigurimi personal, me qellim qe te garantoje nevojat e sigurimit. Ne kete rast gjykata verifikon nese ekzistojne realisht nevojat e sigurimit dhe nese ekzistojne kushtet per caktimin e mases se sigurimit personal dhe duke verifikuar rrethanat faktikek percakton llojin e mases se sigurimit ne perputhje me kriteret ligjore, me kushtin e vetem qe masa te mos jete me e rende se ajo qe kerkohet nga prokurori.

Kjo procedure qe ndiqet per caktimin e mases se sigurimit nuk bazohet ne parimin e kontradiktorialitetit dhe nuk garantohen te drejta themelore qe ka personi ndaj te cilit caktohet masa e sigurimit per tu degjuar, per tu mbrojtur vete ose me avokat, per te ngritur pretendime dhe paraqitur prova, pasi ne vetvete kjo procedure e caktimit te mases se sigurimit nuk eshte nje gjykim i mirefillte me elementet qe ai ka te percaktuar sipas Kodit te Procedures Penale, per shkak se, nevojat e sigurimit, kete faze te procedimit e konsiderojne sekret dhe nuk e detyrojne as prokurorin dhe as gjykatën te njoftojne te pandehurin dhe mbrojtësin e tij lidhur me kete veprim procedural. Ky rregullim ligjor eshte logjik, sepse ne themel do te garantoje qe nje person qe dyshohet te kete kryer nje veper penale, te mos kryeje nje veper tjeter, te mos vere ne rrezik marrjen ose vertetesine e proves, apo t'i largohet dhe shmanget procedimit penal. Keto jane dhe shkaqet qe prokurori, edhe pse nuk kemi nje gjykim me pale, duhet t'ia parashtrroje dhe provoje gjykates se ekzistojne se bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret per caktimin e nje mase te sigurimit personal.

Te drejtat e te pandehurit per t'u garantuar nje proces i rregullt me zbatimin e normave kushtetuese dhe atyre nderkombetare per te mbrojtur dhe garatuar lirite ne nje procedim penal, ligjvenesi i ka percaktuar ne nje faze te dyte e cila parashikohet ne nenin 248 te K.Pr.Penale, sipas te ciles gjykata detyrohet qe, jo me vone se tre dite nga zbatimi i mases, te marre ne pyetje personin per te cilin eshte vendosur arresti ne burg ose ne shtepi dhe nepermjet kesaj te verifikojte kushtet dhe kriteret per zbatimin e kesaj mase ne raport me nevojat e sigurimit. Menyra e dyte qe K.Pr.Penale parashikon per caktimin e masave te sigurimit pergjithesisht eshte nepermjet verifikimit te veprimeve me inisiativ te policise gjyqesore ne rastet e arrestimit ne flagrance, apo te ndalimit te personit te dyshuar per nje veper penale i cili ka rrezik ikje. Ne kete rast, gjykata kryen dy funksione brenda nje gjykimi, se pari verifikon nese veprimet per heqjen e lirise se personit jane ose jo ne perputhje me ligjin, nga ana tjeter, mbi kerkesen e prokurorise, gjykata verifikon nese nevojat e sigurimit e kerkojne ose jo qe ndaj personit te caktohet nje mase sigurimit personal. Ky gjykim, si per fazen e pare te tij, ashtu dhe per fazen e dyte eshte nje gjykim qe bazohet mbi parimet e procedimit penal dhe gjykata e zhvillon gjykimin me prezencen si te prokurorit ashtu edhe te personit te ndaluar ose te arrestuar, ku te dyja paleve, si akuzes edhe mbrojtjes, i garantohet e drejta qe pretendimet e tyre t'ia parashtrrojne gjykates ne menyre te barabarte duke ju dhene e drejta te paraqesin prova dhe te kundërshtojne njera tjetren, bazuar ne parimin e nje procesi te rregullt gjyqesor.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte e çmuan te parashtrrojne sa me siper ne menyre te permbledhur procedurat e ndryshme te caktimit te mases se sigurimit, me qellim qe te evidentojne dallimin thelbesor qe ato kane me njera tjetren, por qe pavaresisht nga kjo, ne thelb, ne asnjë rast, e drejta kushtetuese per te ankuar vendimin e gjykates nuk mohohet.

Eshte e vertete se ne rastin e caktimit te mases se sigurimit personal jo si perjashtim, pra jo ne kushtet e flagrances, kerkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykates nuk i njoftohen personit ndaj te cilit kerkohet apo vendoset caktimi i nje mase sigurimi. Keto jane veprime sekrete, te cilat per shkak se masa duhet te ekzekutohet dhe per shkak se marrja dijeni perpara ekzekutimit nga personi ndaj te cilit eshte caktuar nje mase mund ta bente te pamundur ekzekutimin e saj, nuk kerkojne njoftimin paraprak te personit. Jo pa qellim ligjvenesit ka parashikuar qe te drejtat, personi ndaj te cilit eshte caktuar nje mase sigurimi ne keto kushte, mund t'i mbroje gjate gjykimit te vlefesimit te mases nga gjykata brenda tre dite nga ekzekutimi i saj.

Megjithate çdo rregull ka perjashtimin e tij dhe kete ka parashikuar ligjvenesit kur ka formuluar paragrafin e pare te nenit 249, nepermjet te cilit ka parashikuar qe palet, perfshi ketu edhe te pandehurin dhe mbrojtetin e tij, kane te drejte qe brenda nje afati 10 ditore nga zbatimi ose njoftimi te vendimit te gjykates, te ankojne vendimin ne gjykatën me te larte. Ne kete dispozite ka dy momente te rendesishme lidhur me te drejten e ankimit, ate te zbatimit te mases dhe te njoftimit te saj. Zbatimi, pra ekzekutimi i mases se sigurimit eshte rrjedha llogjike e rregullit qe ky vendim i marre pa prezencen e personit te sjelle efektet qe ligji dhe fakti kerkon, pra arrestimin e tij. Nga ana tjetere, ligjvenesit ka bere perjashtimin edhe ketu nga rregulli, kur ka percaktuar se nuk eshte vetem momenti i ekzekutimit ai qe merret ne konsiderate, por edhe njoftimi i personit ndaj te cilit eshte caktuar masa. Nese ne rastin e ekzekutimit situata eshte e qarte dhe nuk ka vend per te interpretuar ne menyre unifikuese, momenti i dyte qe lidhet me pamundesine e ekzekutimit te saj dhe se çfare ndodh me pas, vleresojme se eshte e nevojshme qe praktika gjyqesore te jete e unifikuar ne kuptimin e dispozitave perkatese ligjore, me qellim qe te evitohen qendrime te ndryshme ne situata te ngjashme.

Kolegjet e Bashkuara, per te interpretuar kuptimin qe ka dispozita e nenit 249, paragrafi i pare dhe i dyte, vlereson se ajo duhet pare ne unison me dispozita te tjera te K.Pr.Penale dhe bazuar mbi parimet e procedimit penal, si dhe te drejtat dhe lirite themelore te njeriut.

Në nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashikohet e drejta e ankimit efektiv ndaj vendimit të gjykatës. Kurse në nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, përcaktohet për shtetet detyrimi që të garantojnë nëpërmjet organeve kompetente gjyqësore, administrative, ose legjislative, të drejtën e individit për të ushtruar ankim, si dhe krijimin e mundësive për gjykimin e tij. Te njejtin qendrim mban edhe Kushtetuta e Shqipërisë, e cila ne nenin 43 ka parashikuar se: *“Kushdo ka te drejte te ankohet kunder nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte, pervecse kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe”*. Per te garantuar kete te drejte, K.Pr.Penale ka nje sere dispozitash te cilat e bejne efektive ate. Sipas nenit 242 te K.Pr.Penale, kur personi ndaj te cilit eshte marre nje mase sigurimi personal nuk gjendet nga oficeri ose agjenti i policise gjyqesore, mbahet nje proces verbal, i cili duhet te tregojte ne menyre te hollesishme veprimet qe jane bere me qellim gjetjen e personit dhe venien ne ekzekutim te vendimit te gjykates. Ky proces verbal i dergohet gjykates qe ka dhene vendimin, e cila verifikon nese kerkimet e bera kane qene te plota ose jo dhe ne eventualitetin se ato kane qene te mjaftueshme, gjykata vendos deklarimin e ikjes se personit. Nga ky moment nuk ka me nje vendim sekret per t'u vene ne ekzekutim dhe ky eshte momenti qe gjykata, me aktin e deklarimit te ikjes, eshte e detyruar qe personit te deklaruar i ikur t'i caktojte mbrojtetin dhe urdheron depozitimin e vendimit ne sekretarine e gjykates. Qellimi qe ligjvenesit ka bere kete rregullim eshte qe ta garantojte individin nga nje mase sigurimi qe i privon lirine personale, e cila nuk mundet te zgjase pafundesisht pa ju nenshtruar verifikimit real te drejtesise dhe ligjshmerise se saj. Kjo pasi, sikurse arsyetuar me siper, eshte nje mase e caktuar pa pranine e te pandehurit dhe mbrojtetit te tij. Nje mase e tille, duke riafirmuar qendrimin qe kane mbajtur Kolegjet e Bashkuara se masa e sigurimit nuk eshte denim apo ndeshkim per personin qe dyshohet se ka kryer nje veper penale,

por eshte nje mase qe jepet mbi kushte dhe kriteret saktesisht te percaktuara, nuk mund te qendroje pa u verifikuar duke u lidhur vetem me ekzekutimin e saj. Pranuar se kjo eshte nje mase e cila caktohet pa pranine e personit dhe mbrojtetit te tij dhe se vetem mbas ekzekutimit te saj, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit te kesaj mase. Neqoftese do te pranohet edhe se vetem mbas ekzekutimit dhe verifikimit nga gjykata te kushteve dhe kriterëve te caktimit te mases lind e drejta e personit per ta ankuar vendimin ne gjykatën me te larte, do te pranohet qe vendimi i gjykates per caktimin e mases se sigurimit pa prezencen e te pandehurit te mos verifikohet nga gjykata me e larte per te gjithë periudhën deri ne ekzekutimin e saj, e cila mund te ishte edhe disa vjeçare. Kjo bie ndesh jo vetem me te drejtat qe ka individi ne procesin penal, por edhe me kuptimin qe ka vete masa e sigurimit personal, kushtet, kriteret e caktimit te saj, si dhe nevojat e sigurimit per mbajtjen, ndryshimin, apo heqjen e saj gjate gjithë fazave te procedimit penal. Nje vendim i njehshem ne kete rast do te kishte efekte me te gjata se sa nje vendim i marre ne kushte kur te gjithë palet jane prezent. Nga ana tjetër, nese do pranohet qe ky vendim eshte i pa ankimeshem derisa nuk eshte ekzekutuar, do mohohej disa nga elementet thelbësore te institutit te caktimit dhe vazhdimit te masave te sigurimit personal. Kjo do sillte automatikisht jo vetem pamundesine e personit ndaj te cilit eshte caktuar masa per t'u ankuar ndaj saj, por edhe pamundesine e gjykates qe, ne zbatim te detyrimeve te parashikuara nga neni 249/6 i K.Pr.Penale, te bente verifikimin periodik te kushteve te zbatimit te mases, si dhe do te transformonte vendimin e gjykates se dhene pa pranine e personit ne nje vendim denimi dhe jo caktimi mase sigurimi.

Per te evituar kete, ligjvënësia ka percaktuar detyrime ndaj organit qe meret me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ai duhet ta vere ne ekzekutim vendimin e caktimit te mases se sigurimit dhe ne pamundesi te kesaj, te plotesoje procedurat per te bere te mundur qe vazhdimi i procedimit te jete ne perputhje me te gjitha kerkesat qe parashikon Kodi i Procedures Penale per garantimin e nje procesi te rregullt. Jo pa qellim ligjvënësia e ka lidhur ne paragrafin e dyte te nenit 249 te K.Pr.Penale me rregullimet qe parashikon neni 141 i K.Pr.Penale, per menyren e njoftimit te personit ndaj te cilit eshte caktuar nje mase sigurimi pa prezencen e tij dhe qe eshte deklaruar i ikur me vendim gjyqësor. Keto dispozita duhen pare te lidhura me njera tjetren dhe veprimet qe kryhen kalojne ne disa faza. Se pari, mbi kerkesen e prokurorit ne menyre sekrete caktohet nje mase sigurimi personal me qellim qe ajo te ekzekutohet dhe me pas, nese nje gje e tille nuk behet dot e mundur, ligji parashikon qe mbi njoftimin e organit qe ekzekuton masen, gjykata eshte e detyruar te deklaroje ikjen dhe te caktojë mbrojtetin per te pandehurin dhe se fundi, menyra se si njoftohet personi i ikur dhe detyrimi per ta bere ate percaktohet sipas dispozites se nenit 141 qe referone vete neni 249/2 i K.Pr.Penale. Pra njoftimi i personit mbasi ai eshte deklaruar i ikur nuk eshte me vleresim, por detyrim i organit procedues sipas kerkesave qe parashikon ligji.

Marre per baze sa me siper, rezulton se dispozita e nenit 249 te K.Pr.Penale, kur ben fjale per te drejten e ankimit brenda 10 diteve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit te gjykates, merr kuptim te plote jo vetem per zbatimin por edhe per njoftimin e vendimit. Eshte lehtesisht e kuptueshme se ndjekja e procedures nga organet e procedimit ne rastet e mos zbatimit te vendimit per caktimin e mases se sigurimit sjell si perfundim detyrimin per njoftim te te pandehurit lidhur me kete mase, e per rrjedhoje, automatikisht edhe te drejten kushtetuese dhe ligjore qe brenda nje afati te caktuar ai te ankimoje vendimin ne nje gjykate me te larte.

Bazuar sa me siper, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arrijne ne perfundimin unifikues se **vendimi per caktimin e mases se sigurimit personal eshte nje vendim i ankimeshem edhe nese ai nuk eshte zbatuar, me kushtin qe personi ndaj te cilit eshte dhene vendimi te jete vene ne dijeni pasi te jete deklaruar me vendim gjykate ikja e tij.**

Ne çështjen ne shqyrtim rezulton se si organi i hetimit, ashtu edhe gjykata nuk kane zbatuar detyrimet qe vijne si me siper nga K.Pr.Penale. Ato nuk kane kuptuar e per pasoje nuk kane ndjekur rregullimin qe parashikon ligji lidhur me zbatimin e mases se sigurimit dhe efekteve

qe vijne e per pasoje detyrimeve qe lindin kur masa nuk mund te zbatohet, pasi personi nuk gjendet. Nderkohe i pandehuri Erjon Dule ka marre dijene ne rrethana te caktuara (sipas tij mbasi oficeret e policise gjyqesore kane shkuar per te ekzekutuar vendimin e gjykates ne vendin e banimit te tij), gje qe e provon me ankimin qe ka paraqitur ne gjykate, me te cilin kundershton masen e sigurimit personal. Lind pyetja se si do veprohet, a ka te njejtat efekte sentenca unifikuese edhe pse ne rastin ne shqyrtim nuk jane kryer veprimet dhe nuk jane marre vendimet qe ligji parashikon kur masa e sigurimit nuk mund te zbatohet per shkak se personi nuk gjendet? A mund te kuptohet ne menyre te njejte njoftimi i te pandehurit per vendimin me marrjen dijene prej tij te vendimit dhe pasojat qe vijne me kete rast?

Kolegjet e Bashkuara çmojne se e rendesishme per te garatuar lirite e individit ne procesin penal eshte qe ai te ushtroje te drejtat e tij dhe qe keto duhet t'ia garantoje organi procedues, por me eventualitetin kur ky organ nuk e ka bere dhe personi gjithsesi bie ne dijene te nje vendimi i cili eshte i ankimeshem, ai ose mbrojttesi i tij kane te drejte te kerkojne verifikimin e vendimit ne fjale nga gjykata me e larte. Nga teresia e tyre, rregullimet procedurale penale dhe qe lidhen me njoftimin e akteve te pandehurit, jane detyrime qe ligjvenesit i ka ngarkuar organit procedues me qellim garantimin e te drejtes se personit per t'u vene ne dijene per te gjitha aktet procedurale ne ngarkim te tij. Nese do te rezultonte e provuar se personi i interesuar ka marre dijene per aktin e veçanerisht kur eshte ai vete qe e pranon nje fakt te tille, njoftimi i aktit konsiderohet i realizuar.

Eshte ne detyrimin e vete personit ose mbrojttesit te tij te provoje momentin e marrjes dijene, e lidhur kjo me afatin 10 ditor per te ankimuar vendimin e gjykates. Pranimi i te kundertes do te sillte efektin qe ka sjelle ne kete çeshtje, ku edhe pse organet proceduese kane patur detyrimin ta njoftojne te pandehurin lidhur me vendimin, nuk e kane bere, duke i mohuar te drejten e nje ankimi. Kjo vjen ndesh me dispozitat e nenit 247, 249, si dhe nenit 43 te Kushtetutes.

Bazuar ne arsyetimin e mesiperem, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arrijne ne perfundimin unifikues se **e drejta per te ankuar vendimin e caktimit te mases se sigurimit nga personi, ndaj te cilit eshte caktuar kjo mase ne mungese, lind brenda 10 diteve nga njoftimi apo marrja dijene e vendimit prej ti ose mbrojttesit.**

Ne çeshtjen ne ngarkim te te pandehurit Erjon Dulaj, Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane, duke mos pranuar te shqyrtoje ankimin e paraqitur nga mbrojttesi i te pandehurit, ka vepuar ndesh me dispoziten e nenit 420/1-a te K.Pr.Penale. Mbrojttesi i te pandehurit Erjon Dulaj eshte i legjitimuar te beje ankim ndaj vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, e per kete shkak, vendimi i Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane duhet te priset dhe aktet t'i dergohen per rishqyrtim asaj gjykate per ta gjykuar, me nje tjetër trup gjykues. Duke pranuar qe i pandehuri ka te drejte te ankohet ndaj vendimit te gjykates per caktimin e mases se sigurimit edhe pa u zbatuar kjo mase ne rast se provon marrjen dijene, gjykata nuk mund t'i mohoje kete te drejte mbrojttesit te te pandehurit, i cili per efekt te ligjit barazohet me te. Ne kete perfundim, Kolegjet e Bashkuara arrijne bazuar edhe ne vendimin nr.15, date 17.04.2003 te Gjykates Kushtetuese, sipas te cilit, nder te tjera, eshte theksuar se: "... moslejimi i mbrojttesit për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës, të dhënë në mungesë të të akuzuarit, në kushtet e nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale, e ve njëjërën palë në pozitë të pabarabartë me palën tjetër”.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, mbeshtetur ne nenin 438 dhe 441/ç te K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.2, date 02.01.2009 te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane dhe kthimin e akteve per rishqyrtim ne ate gjykate, me tjetër trup gjykues.

Ky vendim te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare per njehsimin e praktikes gjyqesore.

Tiranë, më 24.06.2009

MENDIMI I PAKICËS

Në vendimin nr.4, datë 24.06.2009 (Unifikues) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ne, Spiro Spiro, Ardian Dvorani, Majlinda Andrea, Mirela Fana dhe Andi Çeliku - gjyqtarë në pakicë, nuk jemi dakord me vendimin nr.4, date 24.06.2009 (Unifikues) të marrë me votat e shumicës të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (me të cilin u prish vendimi 02.01.2009 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe iu kthyen aktet, për rishqyrtim, po asaj gjykate), për arsytet si më poshtë:

Sipas mendimit të pakicës, duke pranuar legjitimitimin e mbrojtësit të të arrestuarit Erjon Dulaj për të bërë ankim kundër vendimit nr.252, date 11.12.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, shumica ka tejkualuar kufijtë e kuptimit të dispozitave të neneve 246 dhe 249 të K.Pr.Penale.

Ndërsa, me të drejtë, shumica, teorikisht, pranon që, sipas nenit 246 të K.Pr.Penale, "... kur personi ndaj të cilit është marrë masa e sigurimit (gabimisht shprehet: një masë sigurimi)", nuk gjëndet, nga oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, mbahet një proces verbal, i cili duhet të tregojë, në mënyrë të hollësishme, veprimet që janë bërë me qëllim gjetjen e personit dhe vënien në ekzekutim të vendimit të gjykatës, proces verbal, i cili i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin për të vendosur deklarin e ikjes së këtij personi", në zbatimin e përmbajtjes së kësaj dispozite në çështjen objekt shqyrtimi, praktikisht, ka tejkualuar kufijtë e përmbajtjes, shumë të qartë, të saj.

Kështu, nga aktet rezulton që mbrojtësi i të arrestuarit Erjon ka paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ende pa u vënë në dijeni të faktit që ekzistonte një vendim arresti kundër tij, nëpërmes, pikërisht, procedurave të ligjshme që parashikohen në nenin 246 të K.Pr.Penale.

Pretendimi, sipas të cilit, i arrestuari u vu në dijeni të këtij fakti, pasi, sipas tij, punonjës të policisë kishin shkuar në banesë, jo vetëm që nuk u shoqërua me ndonjë dokument të lënë prej tyre, apo ndonjë provë tjetër, por bazuar në kronologjinë e dokumenteve që lidhen me ankimin e paraqitur nga mbrojtësi i tij, është i papranueshëm.

Përpos faktit që nuk përmban asnjë shkak dhe pikë të vendimit që kundërshtohet, kërkesë kjo e dispozitës së nenit 242 të K.Pr.Penale, ankimi ka edhe pasaktësi lidhur me datën që mban vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me të cilin u vendos masa e sigurimit personal. Kështu, ndërsa vendimi mban datën 11.02.2008, në ankim është shënuar data 17.02.2008, pasaktësi, të cilat nuk kishte si të ndodhnin nëse do të ishte e vërtetë që punonjësit e policisë kishin shkuar në banesë për ekzekutimin e vendimit.

Pavarësisht kësaj, shumica përdor si argument garantimin e së drejtës për t'u mbrojtur të individit (në rastin konkret të të arrestuarit Erjon), ndaj një vendimi gjyqësor, në përgjithësi, duke anashkualuar kërkesat e ligjit procedural penal për momentin e fillimit të kësaj të drejte, kërkesa këto, të cilat sipas pakicës, parashikohen qartësisht në dispozitat e neneve 246 dhe 249 të K.Pr.Penale.

Në nenin 249 të K.Pr.Penale parashikohet e drejta (afati) i ankimit si në rastet e marrjes dijeni, *de facto* nga vetë personi ndaj të cilit është vendosur masa (pika 1 e nenit 246 të

K.Pr.Penale), ashtu edhe në rastet e marrjes dijëni, *de jure*, prej tij (neni 247 i K.Pr.Penale). Në të dy këto raste bëhet fjalë vetëm për marrjen dijëni në mënyrë të ligjshme.

Bazuar pikërisht në këtë arsytim, kur caktimi i masës bëhet në mungesë të personit të cilit i përket, pakica është e mendimit që gjykata nuk mund të pranojë si të ligjshëm ankimin që bëhet jashtë këtyre dy rasteve të marrjes dijëni për vendimin e caktimit të saj. Pranimi i të kundërtës do ta çonte gjykatën në ligjërimin e palejueshëm të veprimeve të jashtëligjshme të personave që kryejnë detyra shtetërore, nga të cilat rrjedh informacioni për ekzistencën e një vendimi arresti, të marrë nga gjykata në mungesë të individit përkatës, vendim ky, sikundër pranohet edhe nga shumica, për shkak të rëndësisë që ka, përbën sekret.

Pakica është e mendimit që mbajtja sekret e ekzistencës së një vendimi të këtij lloji duhet të zgjasë deri në momentin kur i interesuari vihet në dijëni nëpërmes rrugëve ligjore, që u përshkruan më lart.

Në favor të këtij mendimi është edhe përcaktimi që përmban pika 2 e nenit 249 të K.Pr.Penale, sipas së cilës, për të pandehurin e ikur, afati fillon të ecë nga dita e njoftimit, të bërë sipas nenit 141, dispozitë kjo në të cilën përcaktohen qartësisht dhe në formë detyruese procedurat që duhet të ndiqen për njoftimet e të pandehurit kur nuk gjendet.

Si teoria e së Drejtës Procedurale Penale, ashtu edhe praktika gjyqësore, lidhur me nocionin “njoftim”, në procesin penal kanë mbajtur qëndrim konseguent ligjor. Kanë konsideruar të tillë jo marrjen dijëni, apo vënien në dijëni të personit (i pandehur, dëshmitarët), pavarësisht formës, por vetëm atëherë kur ky proces realizohet në ndonjërin prej formave që përcaktohen qartësisht në ndonjërin prej dispozitave që përfshihen në kreun e II-të të K.Pr.Penale, që titullohet “Njoftimet”.

Spiro Spiro

Ardian Dvorani

Mirela Fana

Majlinda Andrea

Andi Çeliku

**Nr.6/5 i Regj. Themeltar
Nr.2 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Perikli Zaharia	Anetar
Irma Bala	Anetare
Evjeni Sinoimeri	Anetare
Spiro Spiro	Anetar
Besnik Imeraj	Anetar
Gani Dizdari	Anetar
Ardian Dvorani	Anetar
Fatos Lulo	Anetar
Arjana Fullani	Anetare
Evelina Qirjako	Anetare
Majlinda Andrea	Anetare
Ardian Nuni	Anetar
Guxim Zenelaj	Anetar
Aleksander Muskaj	Anetar
Andi Çeliku	Anetar

në seancën gjyqësore të datës 06.02.2009 moren në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURVE: **NDERIM DELIU**, i biri i Belulit, i datl.1965, banues në fshatin Otlak (Berat), i dënuar, i arrestuar.
LEONARD ZEKA, i biri i Rrapit, i datl.1975, banues në fshatin Otlak (Berat), i dënuar, i arrestuar.
3) **PETRIT DELIU**, i biri i Belulit, banues në fshatin Otlak (Berat), i dënuar, i arrestuar.

A K U Z U A R:

Të tre - për krimet e rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, të kryer në bashkëpunim dhe të vjedhjes të kryer në bashkëpunim, që parashikohen në nenet: 109/I, në lidhje me nenin 25 dhe 134, në lidhje me nenin 25 të K.Penal;
kurse të pandehurit Leonard e Petrit - edhe për krimin e prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit, që parashikohet në nenin 278/II të K.Penal.

Gjykata e rrethit gjyqësor Berat, me vendimin nr.2, datë 13.01.2003, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Nderim Deliu për veprën penale të rrembimit ose të mbajtjes peng të personit të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/1 dhe 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Nderim Deliu për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal e dënimin e tij me 2 vjet burgim.

Në bazë të nenit 55/1 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Nderim Deliu me 11 vjet burgim.

Ne bazë të nenit 56/1 e 55/1 të K.Penal, bashkimin e dënimit më sipër me dënimin prej 5 vjetësh burgim të dhënë me vendim nr.90, datë 30.04.2002 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dënimin perfundimisht të të pandehurit Nderim Deliu me 14 vjet burgim, duke i filluar vuajtja e dënimit nga data 18.05.2000.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të rrembimit ose të mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/a dhe 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal e dënimin e tij me 1 vit burgim.

Në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 3 vjet burgim.

Ne bazë të nenit 56/1 e 55/1 të K.Penal, bashkimin e dënimit me sipër me dënimin prej 7 vjetësh burgim të dhënë me vendim nr.75, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Berat (i formes së prerë) dhe dënimin perfundimisht të të pandehurit Nderim Deliu me 9 vjet burgim, duke i filluar vuajtja e dënimit nga data 26.10.2000.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu për veprën penale të rrembimit ose të mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/a dhe 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal e dënimin e tij me 1 vit burgim.

Në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Petrit Deliu me 3 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.147, datë 27.05.2003 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.2, datë 13.01.2003 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Berat dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me trup tjetër gjykes.

Gjykata e Rrethit gjyqësor Berat me vendimin nr.11, datë 25.01.2005 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Nderim Deliu për veprën penale të rrembimit ose të mbajtjes peng të personit, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/1 dhe 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Nderim Deliu për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal e dënimin e tij me 1 vit burgim.

Në bazë të nenit 56 të K.Penal dënimin e të pandehurit Nderim Deliu me 10 vjet burgim.

Pushimin e gjykimit për veprën penale të “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 të K.Penal, për të pandehurin Nderim Deliu

Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të rrembimit ose të mbajtjes peng të personi, të kryer ne bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/1 dhe 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal e dënimin e tij me 1 vit burgim.

Të deklarojë fajtor të pandehurin Leonard Zeka për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal dhe në bazë të këtij neni e dënon me 1 vit burgim.

Në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 11 vjet burgim.

Ne bazë të nenit 56/1 e 55/1 të K.Penal, bashkimin e dënimit me sipër me dënimin prej 7 vjetësh e 6 muaj burgim të dhënë me vendim nr.72, datë 01.07.2003 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Berat (i formes së prerë) dhe dënimin perfundimisht të të pandehurit Leonard Zeka me 16 vjet burgim, duke i filluar vuajtja e dënimit nga data 26.10.2000.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu për veprën penale të rrëmbimit ose të mbajtjes peng të personit, të kryer ne bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/1 dhe 25 i K.Penal dhe denimin e tij me 10 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu për veprën penale të vjedhjes në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal e dënimin e tij me 1 vit burgim.

Të deklaroje fajtor të pandehurin Petrit Deliu për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal dhe ne bazë të këtij neni e dënon me 1 vit burgim.

Ne bazë të nenit 56/1 e 55/1 të K.Penal, bashkimin e dënimit me sipër me dënimin prej 4 muaj burgim të dhënë me vendim nr.72, datë 01.07.2003 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Berat (i formes së prerë) dhe dënimin perfundimisht të të pandehurit Petrit Deliu me 11 vjet burgim, duke i filluar vuajtja e dënimit nga data 26.10.2000.

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.(s’ka), datë 24.03.2006 ka vendosur:

Lënien ne fuqi të vendimit penal nr.11, datë 25.01.2005 të Gjykatës së shkallës së parë Berat përsa i përket cilësimit juridik të veprave penale, deklarimit fajtor, si dhe për sa i përket masës së dënimit për të pandehurit Nderim Deliu dhe Petrit Deliu edhe për vendin e vuajtjes së dënimit.

Ndryshimin e këtij vendimi për sa i përket masës së dënimit për të pandehurin Leonard Zeka si më poshtë:

Dënimin e të pandehurit Leonard Zeka, në bazë të nenit 109/1 e 25 të K.Penal, me 10 vjet burgim.

Dënimin e të pandehurit Leonard Zeka, në bazë të nenit 134 e 25 të K.Penal, me një vit burgim.

Dënimin e të pandehurit Leonard Zeka, në bazë të nenit 278/2 të K.Penal, me 1 vit burgim.

Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimit të mësipërm me dënimin e dhene me vendimin nr.72, datë 01.07.2003 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Berat (i formës së prerë), me 7 vjet e 6 muaj burgim, e dënon përfundimish të pandehurin Leonard Zeka me 11 vjet burgim, duke i filluar ecja e afatit nga data 26.10.200 që është dita e ndalimit të tij, duke i llogaritur pjesën e pa vuajtur të dënimit me dënimin e ri.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë kane bërë rekurs të gjykuarit Petrit Deliu dhe Nderim Deliu, për shkaqet:

- Gjykatat kane gabuar me cilesimin ligjor te vepres penale, e cila duhet te ishte kualifikuar sipas veprës penale të “rrembimit ose mbajtjes peng të personit ne rrethana lehtësuese”.
- Dëshmitari Flamur Subashi ka deklaruar se “... i pandehuri Nderim ka ndikuar e negociuar ne lirimin e tij dhe se ai ka qenë pa maskë dhe i pa armatosur”.
- I gjykuari është ndodhur rastësisht dhe nën frikën dhe influencën e Ilir Jaupit dhe Dritan Zhukës, të cilët janë të njohur për egërsinë e tyre në qytetin e Beratit.
- Gjykatat kanë përkeqësuar pozitën e të pandehurit Nderim, duke shkelur nenin 425 të K.Pr.Penale.
- Nuk ka prova për të vertetuar vjedhjen për të cilën akuzohet të gjykuarit.
- Mund te jete i vertete fakti që, rreth dy orë pas lirimimit të të dëmtuarit Flamur, ai është kapur dhe ndaluar nga persona të tjerë, siç janë Dritan Zhupa, Ilir Jaupi dhe persona të tjerë, por në këtë veprimtari nuk ka rezultuar të jetë në rolin e bashkëpunorit i pandehuri Petrit.

Me vendimin nr.1129 Akti, datë 19.11.2008 të Kolegjit Penal, në zbatim të nenit 438/2 të K.Pr.Penale, kjo çështje u dërgua në Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate për njehsimin e praktikës gjyqësore, përsa më poshtë:

1. Nëse parimi i ndalimit të keqësimit (rëndimit) të pozitës (reformatio in peius), duhet te zbatohet vetëm nga gjykata e apelit, apo edhe nga gjykata e shkallës së parë (gjykata e rigjykimit), mbas kthimit të çështjes penale asaj, për rigjykim, nga gjykata e apelit apo Gjykata e Lartë, në rastet kur apelues apo rekursues është vetëm, sipas rastit, i pandehuri, apo i gjykuari?

2. Nëse ky parim do të gjejë zbatim vetëm për të pandehurin/të gjykuarin që ka paraqitur apel/rekurs, apo edhe për bashkëpandehurit/bashkëtëgjykuarit e tjerë?

3. Ndalimi i keqësimit të pozitës i referohet vetëm dispozitave materiale-penale, apo edhe atyre proceduralo-penale?

4. Parimi i ndalimit te keqësimit të pozitës i referohet vetëm pasojave (llojit dhe lartësisë së tyre), që përfshihen në përmbajtjen e pikës 3 të dispozitës së nenit 425 të K.Pr.Penale, apo edhe çështjeve të natyrës së mirëfilltë juridiko-materiale penale, sikurse është cilësimi ligjor i veprës penale (pa përjashtuar edhe natyrën e saj)?

Çështja ka ardhur në Gjykatën e Lartë me rekurs të të gjykuarve Nderim e Petrit Deliu dhe mbrojtësit të tyre, av. M.Breçani, bërë kundër vendimit 11.25.01.2005 të Gjykatës së shkallës së parë Berat dhe vendimit datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë, me pretendimin për cilësim

të gabuar ligjor të veprës penale të rëmbimit, parashikuar në nenin 109/1 të K.Penal dhe për keqësim të pozitës së tyre.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarëve Majlinda Andrea dhe Guxim Zenelaj; prokurorin Bujar Sheshi, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimeve; mbrojtësin e të gjykuarve Nderim e Petrit Deliu, av. Arenc Berati, i cili kërkoi deklarinimin e pafajshem të të gjykuarit Nderim Deliu; si dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

Se, gjatë shqyrtimit të akteve të procedimit penal që i përket të gjykuarve: Nderim Deliu, Leonard Zeka e Petrit Deliu (të akuzuar, të tre, për krimet e rëmbimit ose mbajtjes peng të personit, të kryer në bashkëpunim, parashikuar në nenin 109 të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij dhe të vjedhjes, të kryer në bashkëpunim, parashikuar në nenin 134 të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij, kurse të gjykuarit Leonard Zeka e Petrit Deliu edhe për krimin e mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit, të kryer në bashkëpunim, parashikuar në nenin 278/II të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij), u konstatua që çështja penale në ngarkim të tyre u gjykua nga dy herë, si në Gjykatën e shkallës së parë Berat, ashtu edhe në Gjykatën e Apelit Vlore.

Kështu, me vendimin nr.2, datë 13.01.2003 të Gjykatës së shkallës së parë Berat, është vendosur që:

- I gjykuari Nderim të deklarohej fajtor për krimet për të cilat ishte akuzuar, duke u dënuar: për krimin e parashikuar në nenin 109/I të K.Penal, (rëmbim personi), të kryer në bashkëpunim - me 10 (dhjetë) vjet burgim, ndërsa për krimin e parashikuar në nenin 134 të K.Penal (vjedhja e pasurisë), në lidhje me nenin 25 të tij, u dënua me 2 (dy) vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, u dënua me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim. Duke u bërë bashkimi i këtij dënimi me dënimin e dhënë ndaj tij me një vendim të mëparshëm (vendimi nr.90, datë 30.04.2002 I Gjykatës së Apelit Vlorë), ky i gjykuar ishte dënuar përfundimisht me 14 (katërmëdhjetë) vjet burgim.

- I gjykuari Leonard: të deklarohej fajtor për krimin e parashikuar në nenin 109/a të K.Penal (rëmbim personi në rrethana lehtësuese), në lidhje me nenin 25 të tij, duke u dënuar me 3 (tre) vjet burgim dhe për krimin e parashikuar në nenin 134 të K.Penal (vjedhja e pasurisë), në lidhje me nenin 25 të tij për të cilin u dënua me 1 (nje) vit burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, u dënua me 3 (tre) vjet burgim. Kurse, mbas bashkimit të dënimit prej 7 (shtatë) vjet burgim dhënë ndaj tij me vendimin nr.75, datë 17.07.2001 të Gjykatës së shkallës së parë Berat, u dënua përfundimisht me 9 (nëntë) vjet burgim.

- I gjykuari Petrit të deklarohej fajtor për krimin e parashikuar në nenin 109/a të K.Penal (rëmbim personi në rrethana lehtësuese), në lidhje me nenin 25 të tij, për të cilin u dënua me 3 (tre) vjet burgim dhe për krimin e parashikuar në nenin 134 të K.Penal (vjedhja e pasurisë), në lidhje me nenin 25 të tij, për të cilin u dënua me 1 (nje) vit burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, u dënua përfundimisht, me 3 (tre) vjet burgim.

Mbi ankimin e mbrojtësit të tre të gjykuarve - av. F.Doja, me vendimin nr.147, datë 27.05.2003, Gjykata e Apelit Vlorë prishi vendimin e Gjykatës së shkallës së parë Berat dhe aktet i ktheu për rishqyrtim në po atë gjykatë, me trup gjykues tjetër.

Sipas vendimit, gjykata e apelit arriti në përfundimin si më sipër, pasi konstatoi pavlefshmëri absolute të akteve në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes në gjykim.

Mbas rigjykimit, me vendimin nr.11, datë 25.11.2005, Gjykata e shkallës së parë Berat i deklaroi përsëri fajtorë të tre të gjykuarit dhe i dënoi, si më poshtë:

- **Të gjykuarin Nderim**, përsëri për krimin që parashikohet në nenin 109/I të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij, duke e dënuar përsëri me 10 (dhjetë) vjet burgim, si edhe për atë të parashikuar në nenin 134 të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij, duke e dënuar me 1 (një) vit burgim. (d.m.th një vit më pak se në gjykimin e parë). Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, e dënoi me 10 (dhjetë) vjet burgim (d.m.th. një vit më pak se në gjykimin e parë), masë dënimi kjo përfundimtare. Meqenëse dënimi i dhënë me vendimin e mëparshëm ishte vuajtur plotësisht, neni 56 i K.Penal nuk u aplikua.

- **Të gjykuarin Leonard**, për krimin e parashikuar në nenin 109/I të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij (për të cilin ligji i kohës parashikonte dënim me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet - nga tre gjer në pesë vjet që parashikonte neni 109/a i K.Penal, sipas ligjit të kohës), për të cilin e dënoi me 10 (dhjetë) vjet burgim (d.m.th. shtatë vjet më shumë se gjykimi i mëparshëm). E deklaroi fajtor, përsëri, edhe për krimin e parashikuar në nenin 134 të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij, për të cilin, e dënoi përsëri me 1 (një) vit burgim. E deklaroi përsëri fajtor edhe për krimin e mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit, që parashikohet në nenin 278/II të K.Penal (vepër penale për të cilën, megjithëse ishte një nga akuzat që përmbante kërkesa e prokurorit për gjykim, në gjykimin e parë ishte ometuar, si gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe në vendimin përfundimtar), për të cilën e dënoi me 1 (një) vit burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, e dënoi me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim (d.m.th. tetë vjet më shumë se në gjykimin e parë), kurse, duke zbatuar nenin 56 të K.Penal, e dënoi, përfundimisht, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim.

Vihet në dukje fakti që, në rigjykim, u aplikua neni 56 i K.Penal për bashkimin me dënimin e përmendur më lart të 7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muajve burgim, që ishte dhënë ndaj këtij të gjykuarit me vendimin nr.72, datë 01.07.2003, d.m.th. pas datës 13.01.2003, që mban vendimi nr.2, datë 13.01.2003 i gjykimit të mëparshëm.

Të gjykuarin Petrit, për krimin e parashikuar në nenin 109/I të K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij (për të cilin ligji i kohës parashikonte dënim me burgim nga dhjetë gjer në njëzetë vjet - nga tre gjer në pesë vjet që parashikonte neni 109/a i K.Penal, sipas ligjit të kohës), për të cilin e dënoi me 10 (dhjetë) vjet burgim (d.m.th. shtatë vjet më shumë se në gjykimin e mëparshëm). E deklaroi fajtor edhe për krimin e mbajtjes pa leje të armëve luftarake e municionit, që parashikohet në nenin 278/II të K.Penal (vepër për të cilën, megjithëse është një nga akuzat që parashikonte kërkesa për gjykim, në gjykimin e parë ishte ometuar, si gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe në vendimin përfundimtar), për të cilin e dënoi me 1 (një) vit burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të K.Penal, e dënoi me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim, (d.m.th. tetë vjet më shumë se në gjykimin e mëparshëm), kurse, duke zbatuar nenin 56 të K.Penal, e dënoi, përfundimisht po me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim (d.m.th. po tetë vjet më shumë se në gjykimin e mëparshëm).

Vihet në dukje fakti, që në rigjykim, u aplikua neni 56 i K.Penal, për bashkimin me dënimin e përmendur më lart të 4 (katër) muajve burgim, që ishte dhënë ndaj këtij të gjykuarit me vendimin nr.72, datë 01.07.2003, d.m.th. pas datës 13.01.2003, që mban vendimi (nr.2), i gjykimit të mëparshëm.

Vendimi nr.11, datë 25.01.2005 i gjykatës së shkallës së parë u apelua, si nga mbrojtësi i të gjykuarit Nderim e Petrit, ashtu edhe nga prokurori. Mbrojtësi kërkonte pafajësi, kurse prokurori vetëm rritjen e masave të dënimit, për të tre të gjykuarit.

Me vendimin nr.108, datë 24.03.2006 të saj, ndërsa la në fuqi vendimin e dhënë nga Gjykata e shkallës së parë Berat (pas rigjykimit), për të gjykuarit Nderim e Petrit, në tërësi dhe për të gjykuarin Leonard - për cilësimin ligjor të veprave penale, për të cilat është deklaruar fajtor dhe

masat e dënimit, si dhe dënimin, pas aplikimit të nenit 55 të K.Penal, për to (njëmbëdhjetë vjet burgim), e ndryshoi, përta i përket aplikimit të nenit 56 të K.Penal, duke e dënuar përfundimisht atë - nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet, që ishte dënuar mbas rigjykimit, në 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim.

Si vendimi nr.11, datë 25.01.2005 i Gjykatës së shkallës së parë Berat, ashtu edhe ai nr.108, datë 24.03.2006 i Gjykatës së Apelit Vlorë, u rekursuan nga mbrojtësit e të gjykuarve Nderim e Petrit.

Në dy rekurset e paraqitura pretendohet për cilësim të gabuar të veprës penale të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit dhe për mospjesëmarrje në vjedhje, kurse ai i të gjykuarit Petrit - edhe për mosprovueshmërinë, sipas tij, të bashkëpunimit në këtë vepër.

Pretendimi tjetër i mbrojtësve është se, sipas tyre, të mbrojturve prej tyre mbas rigjykimit të çështjes, u është keqësuar pozita.

Bazuar në sa kanë pranuar të provuar të dy gjykatat (lidhur me mekanizmin, kronologjinë dhe episodet e ngjarjes në të cilën u rrëmbye dhe u mbajt peng, për disa ditë me radhë, i dëmtuari Flamur Subashi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se, një pjesë e pretendimeve, si më sipër, të mbrojtësve të të gjykuarve, gjejnë mbështetje në aktet e dosjes dhe në ligjin material e procedural penal.

Përta i përket pretendimit për cilësim të gabuar të veprës penale të rrëmbimit të Flamur Subashit, si rrëmbim ose mbajtje peng të personit, figurë krimi kjo që parashikohet në nenin 109/I të K.Penal (dispozitë me të cilën është cilësuar edhe vepra nga të dy gjykatat, mbas rigjykimit të çështjes), ai gjen mbështetje të plotë në aktet e këtij procedimi penal dhe, si i tillë, duhet të pranohet.

Kështu, gjykatat kanë pranuar të provuar që, rrëmbimi i shtetasit R.Subashi u bë në orët e paradites të datës 02.07.1997, para filialit të Shoqërisë “Vefa”, Berat, nga një grup personash, midis të cilëve ishin edhe të gjykuarit Leonard e Petrit. Kanë pranuar të provuar gjithashtu që, personin e rrëmbyer, fillimisht e çuan tek “Serat e H. Gishtit”, pranë rrugës nacionale Berat-Ura Vajgurore; mbas kesaj në mbrëmje në fshatin Otlak, kurse të nesërmen (datë 03.07.1997), në mëngjes, shkuan (duke patur me vete dhe personin e rrëmbyer, tashmë dhe të mbajtur peng) në fshatin Moravë, tek shtëpia e B. Plakut, ku pinë kafe dhe qëndruan tre-katër orë dhe që andej, në qytetin e Beratit ku, në vendin e quajtur “Agjencia”, e lanë të lirë.

Mbas këtij momenti, gjykatat pranojnë të provuar që, në kohën kur i dëmtuari ishte duke hypur në një autobus, persona të tjerë, në mesin e të cilëve ishte edhe i gjykuari Nderim, e rrëmbyen përsëri, deri momentin kur mbasi kishin marrë një pjesë të parave që kishin kërkuar (kohë gjatë së cilës të gjykuarit Leonard e Petrit, jo vetëm nuk kanë bashkëpunuar me këta të fundit, por as nuk është provuar që të kenë kryer ndonjë veprim apo të kenë qenë, qoftë edhe të pranishëm gjatë kohës kur personat e tjerë (përfshirë edhe të gjykuarin Nderim), kryen rrëmbimin, përsëdyti, të F. Subashit, të cilin e mbajtën peng deri në **momentin kur, mbas realizimit pjesërisht të qëllimit, e liruan atë.**

Në kundërshtim me sa më sipër, sipas vendimit të gjykatës së apelit, “... pjesëmarrja e të tre të pandehurve (N. Deliu, L. Zeka e P. Deliu), në kryerjen e veprimeve të kundërligjshme ndaj të dëmtuarit Flamur, si futja në makinë me forcë, goditjet në trup, marrja e lekëve, qenia e tyre i armatosur, janë provuar në gjykim si me deklaratimet e dëshmitarëve okularë, por edhe të vetë të dëmtuarit ...”, duke i marrë kështu, pa të drejtë, pa respektuar kërkesat e dispozitës së nenit 152 të K.Pr.Penale, të provuara, të gjitha episodet e veçanta që e përbëjnë ngjarjen objekt gjykimi.

Kështu, përta i përket episodit të marrjes së 100 mijë lekëve (episod ky, i cili pranohet edhe nga gjykata e shkallës së parë), sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kjo shumë të hollash është marrë mbas momentit të shkëputjes së të gjykuarve Leonard e Petrit nga i gjykuari Nderim dhe personat e tjerë, që u bashkuan më pas me të. Kurse, përta i përket goditjeve në trup,

përveç deklarimeve të të dëmtuarit Flamur, nuk ka asnjë provë apo indicje tjetër që mund të shërbejë si bazë për të përcaktuar vërtetësinë ose jo të tyre (neni 152 i K.Pr.Penale).

Përsa i përket pretendimet për rëndim të pozitës, bazuar në përfundimin për ndryshim të gabuar të cilësimit ligjor të veprës penale të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit - nga kryerja e saj në rrethana lehtësuese, parashikuar në nenin 109/a të K.Penal (me të cilin kishte cilësuar veprën e të gjykuarve Leonard e Petrit gjykata e shkallës së parë, në gjykimin e parë), në rrëmbim ose mbajtje peng të personit pa këto rrethana (lehtësuese), parashikuar në nenin 109/I të K.Penal (me të cilin u cilësua vepra mbas rigjykimit), përfundim ky që u përshkrua me hollësi më lart, Kolegjet e Bashkuara arritën edhe në përfundimin tjetër, sipas të cilit ky pretendim është i drejtë dhe duhet pranuar.

Për të qartësuar kuptimin ligjor të rëndimit të pozitës në këtë rast, çmohet me vend, së pari, të krahasohen, si sanksionet e dispozitave të neneve 109/I dhe 109/a të K.Penal, të cilat janë dukshëm të ndryshëm, ashtu edhe vetë natyra e ndryshme e këtyre dy figurave krimi të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, në lidhje me pranimin e një rrethane specifike të anës subjektive të subjektit të figurës së krimit, që parashikohet në nenin 109/a të K.Penal.

Përsa i përket sanksioneve për veprën penale të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit pa rrethana lehtësuese (neni 109/I i K.Penal), parashikohet (si sanksion), dënimi kumulativ me burgim dhe me gjobë (lloj i veçantë ky sanksioni në K.Penal), në të cilin minimumi i dënimit me burgim është dhjetë dhe maksimumi njëzetë vjet, ndërsa minimumi i gjobës është dy milionë dhe maksimumi pesë milionë lekë, në një kohë kur për veprën penale të rrëmbimit të personit në rrethana lehtësuese (neni 109/a i K.Penal), parashikohet si lloj dënimi vetëm ai me burgim, masa minimale e të cilit është tre, kurse ajo maksimalja pesë vjet.

Përsa i përket rrethanës specifike të anës subjektive të autorit të veprës penale që parashikohet në nenin 109/a të K.Penal, vihet në dukje fakti që ajo ka të bëjë me mos çuarjen deri në fund të veprimtarisë shoqërisht të rrezikshme të autorit të rrëmbimit; ka të bëjë me moskryerjen prej tij të të gjithë atyre veprimeve që do të shpinin në arritjen e qëllimit për të fituar pasuri (ose çdo njërin prej qëllimeve të tjerë, që në formë qartësisht të shprehur, përshkruhen në dispozitën e nenit 109/I të K.Penal), veprime këto, të cilat ndërpriten dhe nuk përfundohen (pra, vepra mbetet në tentativë, në raport, jo me vetë rrëmbimin apo mbajtjen peng të personit, por me pasojën - arritjen e ndonjërit prej qëllimeve që parashikohen në paragrafin e parë të dispozitës së nenit 109 të K.Penal), për shkak të lirit, me vullnetin e lirë të autorit, të personit, para mbarimit të shtatë ditëve nga dita që u krye rrëmbimi ose marrja peng e tij, sikundër ka ndodhur nga ana e të gjykuarve Leonard e Petrit, në çështjen objekt gjykimi.

Së dyti, çmohet me vend të theksohet që, zbatimi i parimit të moskeqësimit të pozitës ...” (reformatio in peius), si një nga parimet e pranuarra gjerësisht, thuajse universale, të së drejtës procedurale penale, të trajtohet, duke patur parasysh rrethanat specifike të çështjes penale konkrete objekt shqyrtimi, gjatë gjithë ecurisë së gjykimeve dhe rigjykimeve të saj. Si rrethanë specifike në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegjet e Bashkuara veçojnë faktin që, sikurse është përmendur në pjesët e para të këtij vendimi, mbas përfundimit të gjykimit të parë të saj në Gjykatën e shkallës së parë Berat, vendimi nr.2, date 13.01.2003 i asaj gjykate u apelua vetëm nga të gjykuarit, duke u pretenduar prej vetë atyre pavlefshmeria e akteve në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes, shkaqe për të cilat edhe u vendos prishja tërësore e tij. Veçojnë gjithashtu edhe faktin që, mbi të njëjtat fakte dhe prova, gjykata e rigjykimit rëndoi pozitën e të gjykuarve Leonard e Petrit, si në lidhje me cilësimin ligjor të veprës së rrëmbimit (nga rrëmbim ose mbajtje peng të personit në rrethana lehtësuese, parashikuar në nenin 109/a të K.Penal, në rrëmbim ose mbajtje peng të personit, pa këto rrethana që parashikohet në nenin 109/I të këtij Kodi) dhe rrjedhimisht edhe dënimin për këtë vepër, ashtu edhe duke i deklaruar fajtorë e dënuar ata edhe për një akuzë tjetër, e cila sikurse u përmend, ishte ometuar gjatë gjykimit të parë,

kuptohet për gabimin e prokurorit të seances gjyqësore dhe vetë gjykatës që gjykoi këtë çështje. Fakti që vendimi i mëparshëm (nr.2, datë 13.01.2003), në këtë rast, u prish për shkelje procedurale, të cilat, sipas dispozitës së nenit 128 të K.Pr.Penale, sjellin pavlefshmëri absolute të akteve të atij gjykimi, **nuk do të thotë që edhe interesat thelbësore të personave të deklaruar fajtorë me vendimin përfundimtar të atij gjykimi, i cili në pikëpamje formalo-juridike, edhe ai, u shpall i pavlefshëm (sikurse janë lloji i veprës penale për të cilën ata ishin deklaruar fajtorë, nga njëra anë dhe sidomos lloji e masa e dënimit, caktuar për ta, nga ana tjetër), pësojnë fatin e atyre akteve.** Po të pranohej e kundërta, e drejta e ankimit të të gjykuarve në procesin penal, e gjithëpranuar, si nga K.E.D.NJ., Kushtetuta e Shqipërisë dhe legjislacioni procedural penal shqiptar, do të zhvishej nga thelbi i saj, nga kushtet reale që duhet t'i garantohen atyre (të gjykuarve), për t'u realizuar, prej tyre, në mënyrë efektive, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës më të lartë me ankim kundër vendimeve të gjykatës më të ulët. Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara çmojnë që **ndreqja e gabimeve të lejuara nga gjykata e gjykimit të mëparshëm, gjatë rigjykimit të çështjes, kur vendimi prishet mbi ankimin vetëm të të gjykuarit (pavarësisht shkaqeve të prishjes), nuk duhet të rëndojë pozitën e tij, sikurse ka ndodhur në çështjen objekt shqyrtimi, me të gjykuarit Leonard e Petrit.**

Në përforcim të këtij rregulli unifikues, këto Kolegje sjellin si argument, edhe faktin e njohur që, në procesin penal individ i ndodhet përballë shtetit. Ai ndodhet përballë organit të akuzës, që sikurse dihet, ka barrën e provës. Por edhe kur është para gjykatës që shqyrton akuzën e ngritur kundër tij, si dhe provat e sjella nga prokurori për të provuar këtë akuzë, mundësitë dhe mjetet që ka në dispozicion individ i akuzuar për të realizuar një mbrojtje efektive përballë tyre, jo rrallë ndodh që të mos jenë të ekuilibruara me ato të organit të akuzës, që përfaqëson shtetin. Po në emër të shtetit, si pjesë e njërit prej tre pushteteve të sistemit të qeverisjes, që është gjykata, kjo e fundit jep drejtësi dhe nuk ka se si të pranohet që, kur individ i ankohet kundër vendimit të dhënë kundër tij dhe ky vendim prishet për gabimet e lejuara në gjykim, po prej gjykatës që e ka dhënë vendimin e ankimuar, në rigjykim të rëndohet pozita e tij në çastin e paraqitjes së ankimit. **Po të pranohej e kundërta, nuk do të ishin të pakta rastet kur, për të mos riskuar, edhe kur mund të kishin realisht bazë për të pretenduar aspekte të veçanta paligjshmërie të vendimeve gjyqësore në dëm të tyre, të gjykuarit do të tërhiqeshin nga ushtrimi i një të drejte themelore të tyre Kushtetuese, sikundër është e drejta e ankimit.**

Në vijim të arsytimit si më sipër, Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin se pretendimi i parashtruar nga prokurori gjatë shqyrtimit të çështjes prej tyre, sipas të cilit, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën në të cilën bëhet fjalë për cilësimin ligjor të veprës, edhe për të gjykuarit Leonard e Petrit, u la në fuqi edhe nga gjykata e apelit dhe (po sipas këtij pretendimi) se, meqenëse rekursues ishte edhe prokurori, bazuar në përmbajtjen e pikës 2 të dispozitës së nenit 425 të K.Pr.Penale, atyre nuk u është rënduar pozita, nuk është i bazuar. Edhe pse, sipas kësaj dispozite, kur apelues është (edhe) prokurori, gjykata e apelit mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të japë lloj më të rëndë dënimi ose të rrisë masën e tij, apo në vënd të pafajësisë ta deklarojë personin e akuzuar fajtor, etj., përcaktime këto, të cilat janë zbatuar edhe në praktikën tonë gjyqësore (përfshirë edhe atë të Gjykatës së Lartë), në çështjen objekt gjykimi, këto përcaktime nuk mund të gjejnë zbatim, **pasi sikurse u përshkrua me hollësi më lart, keqësimi i pozitës procedurale të të gjykuarve Leonard e Petrit kishte ndodhur që me vendimin nr.11, datë 25.01.2005 të gjykatës së rigjykimit (Gjykates se shkallës së parë Berat), mbas prishjes të vendimit të mëparshëm nr.2, datë 13.01.2003, të saj, nga gjykata e apelit), kurse gjykata e apelit vetëm se e konfirmoi këtë formë rëndimi të pozitës së tyre.**

Të pabazuar, këto Kolegje, gjejnë edhe pretendimin tjetër të përfaqësuesit të akuzës, sipas të cilit, bazuar në përmbajtjen e pikës 3 të dispozitës së nenit 425 të K.Pr.Penale, parimi i

moskeqësimit të pozitës të të pandehurit duhet të gjejë zbatim vetëm gjatë gjykimit të çështjes në apel dhe jo edhe në shkallët e tjera të gjykimit.

Lidhur me këtë, **Kolegjet e Bashkuara, megjithëse konstatojnë që, në Kodin e Procedurës Penale, vetëm në pikën 3 të dispozitës së nenit 425 të tij, është sanksionuar shprehimisht me ligj parimi i mosrëndimit të pozitës** (që, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar, kur apelues është vetëm i pandehuri), **edhe pse nuk gjëndet, në formë të shprehur qartë (eksplicite), arritën në përfundimin sipas të cilit, parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit duhet të gjejë zbatim në të gjitha shkallët e gjykimit të çështjes (d.m.th. edhe gjatë gjykimit dhe rigjykimit të saj në Gjykatën e Lartë, apo gjatë rigjykimit në gjykatën e shkallës së parë).**

Baza juridike për zbatimin e këtij parimi gjëndet si në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (neni 7: nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që është zbatueshëm në çastin kur vepra ka qenë kryer), në Kushtetutën e Shqipërisë (neni 29: “Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar në ligj në kohën e kryerjes së veprës penale, pika 2 dhe “Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese” pika 3), ashtu edhe në Kodin Penal të saj (neni 3: Ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese - paragrafi II-të dhe kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale - paragrafi i III-të), në të cilat mishërohet një nga parimet më të rëndësishme të së Drejtës Materiale dhe Procedurale Penale, sikurse është parimi i humanizmit. Parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e konsideron standart Kushtetues, parim, i cili si në këndvështrimin e K.E.D.NJ., ashtu edhe në Kushtetutë, përmban dimension Kushtetues dhe e shtrin atë në të gjitha shkallët e e gjykimit, duke përfshirë edhe atë në Gjykatën e Lartë (Vendimi nr.15, datë 22.07.2008 i Gj.K.), e konsideron “... parim të lidhur me garancitë e aksesit në gjykatë, si element i procesit të rregullt” dhe shprehet se “... Zbatimi i këtij parimi është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë, në mënyrë efektive, të drejtën për t’iu drejtuar me ankim gjykatës”, si dhe se “... ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetura, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre - kupto: (vetëm nga frika se mund t’u rëndohet pozita” (Vendimi 13/2003 i Gj.K.).

Përsa i përket zbatimit të parimit të mosrëndimit të pozitës në çështjen objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara, edhe pse rekurs ka paraqitur vetëm i gjykuari Petrit, përderisa, në të njëjtat kushte me të konstatohet që ndodhet edhe i bashkëigjykuari Leonard, duke patur parasysh faktin që kufijtë e shqyrtimit të çështjes, të përcaktuara në dispozitën e nenit 425/1 të K.Pr.Penale, për gjykatën e apelit, sipas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, vlejné njëllor edhe për këtë të fundit, arritën në përfundimin se ky parim duhet të zbatohet edhe për të.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 438 dhe 441/“b” 490 të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e pjesshme të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë për të pandehurit Petrit Deliu e Leonard Zeka, në lidhje me cilësimin juridik të veprave penale dhe masat e dënimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2, datë 13.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për këta të gjykuar, si më poshtë:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të “rëmbimit ose mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/a e 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të “vjedhjes” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burg.

Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 3 (tre) vjet burg.

Në bazë të nenit 56/1 e 55/1 të K.Penal, bashkimin e dënimit më sipër me dënimin prej 7 (shtatë) vjet burg të dhënë me vendimin nr.75, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Berat e të mbetur në fuqi me vendimin nr.275, datë 15.11.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit Leonard Zeka me 9 (nente) vjet burg, duke filluar vuajtja e dënimit nga dita e ndalimit, datë 26.10.2000.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu, për veprën penale të “rëmbimit ose mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/a e 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu, për veprën penale të “vjedhjes” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burg.

Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 3 (tre) vjet burg, duke i filluar vuajtja e dënimit nga dita e ndalimit, datë 26.10.2000.

Lënien në fuqi të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë për të gjykuarin Nderim Deliu.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për t’u botuar në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 06.02.2009

MENDIMI I PAKICËS

Pakica është e mendimit se vendimi nr.108, datë 24.03 2006 i Gjykatës së Apelit Vlorë ishte dhënë në zbatim të drejte të ligjit dhe duhet të ishte lënë në fuqi.

Gjykata e Apelit Vlorë, e investuar mbi ankimin e të pandehurve, me vendimin nr.147, datë 27.05.2003 ka prishur vendimin nr.2, datë 13.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duke e dërguar ceshtjen për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Gjykata e apelit ka disponuar në këto mënyra, pasi ka çmuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në shkelje të rëndë të normave procedurale penale me pasoje pavlefshmerine absolute të atij vendimi, në interpretim të dispozitave të shkronjave "b" dhe "c" të nenit 128 të K Pr Penale.

Gjykata e apelit, mbështetur në çmimin e provave dhe të akteve të gjykimit, me të drejte ka konstatuar se në gjykimin në shkallë të parë janë lejuar shkelje të rënda që kanë të bëjnë me të

drejten e prokurorit per ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesemarrjen e tij ne ate procedim (neni 128/1/b). Prokurori i çeshtjes ka marre pjese ne kete procedim dhe gjykim ne shkelje te detyrimeve qe parashikohen ne nenet 15/3, 17 dhe 26 te K.Pr.Penale, per shkak se kishte qene me pare avokati i njerit prej te pandehurve ne ate procedim.

Po keshtu, Gjykata e Apelit Vlore ka çmuar se jemi edhe perpara shkeljeve te renda procedurale ne gjykimin ne shkalle te pare, te cilat kane te bejne me thirrjen dhe garantimin e se drejtes se mbrojtjes (neni 128/c), sepse te gjitha te pandehurit jane mbrojtur nga i njeiti avokat, nderkohe qe ne gjykim ishte konstatuar papajtuesmeria e dukshme e interesave ndermjet te pandehurve (neni 54).

Ne rigjykim, duke filluar shqyrtimin gjyqesor nga e para, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat, pasi ka riparuar shkeljet e renda procedurale te lartpermendura, ka dhene vendimin nr.11, date 25.01.2005, nga ku rezulton se per dy nga te pandehurit eshte bere nje cilesim i ri juridik i vepres, duke caktuar edhe masa denimi me te renda nga ai i dhene nga gjykata e shkalles se pare me vendimin e meparshem (i cilesuar si absolutisht te pavlefshem nga gjykata e apelit). E investuar mbi apelin e te gjykuarve dhe te prokurorit, Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin nr.108, date 24.03.2006, ka disponuar per lenien ne fuqi te vendimit te gjykates se shkalles se pare, duke e ndryshuar ate vetem persa i perket mases se denimit per njerin prej te pandehurve.

Shumica e Kolegjeve te Bashkuara ka vendosur prishjen e pjesshme te vendimit te lartpermendur te gjykates se apelit, ne lidhje me dy nga te pandehurit, persa i perket cilesimit juridik te vepres penale dhe mases se denimit, duke lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare nr.2, date 13.01.2003, me disponimin perkates.

Shumica arsyeton qe, duke bere nje cilesim te ndryshem ligjor te veprave penale dhe, per pasoje, duke dhene denime me te renda, gjykata e shkalles se pare, ne rigjykim, ka vendosur ne kundershtim me parimin e mos rendimit te pozites se te pandehurit, si nje garanci kushtetuese qe gjen pasqyrim edhe ne dispoziten e nenit 425/3 te K.Pr.Penale. Ky qendrim mbeshtetet ne argumentin se çeshtja eshte rigjykuar ne shkalle te pare, pasi gjykata e apelit kishte prishur vendimin e meparshem mbi ankimin perkates vetem te te pandehurve. Sipas shumices, ne rigjykim, nuk mund te rendohet pozita e te pandehurit duke u bere nje cilesim juridik i vepres penale dhe duke dhene nje mase denimi me e rende sesa ajo e caktuar me vendimin gjyqesor qe eshte prishur nga gjykata e apelit apo Gjykata e Larte. Pra, shumica ka ardhur ne perfundimin unifikues qe parimi i mos rendimit te pozites se te pandehurit, i parashikuar edhe nga pika 3 e nenit 425 te K.Pr.Penale, gjen zbatim ne çdo rast dhe rrethane, pavaresisht nga shkaqet e prishjes se vendimit te gjykates se shkalles se pare qe ka dhene denimin, perfshire edhe ato qe lidhen me rastet e cilesimit (konstatimit) te vendimit gjyqesor si absolutisht te pavlefshem (neni 128).

Edhe pakica mban qendrimin se respektimi i parimit te mosrendimit te pozites se te gjykuarit perben nje nga garancite kushtetuese me te rendesishme te individit, qe eshte subjekt i nje procedimi penal. ***Por, ne ndryshim nga shumica, jemi te mendimit se ekziston nje perjashtim nga rregulli i pergjithshem. Ky parim nuk gjen zbatim atehere kur ka nje vendim gjyqesor denimi te dhene nga nje gjykate me e ulet, i cili prishet nga nje gjykate me e larte, sepse cilesohet si absolutisht i pavlefshem ne rastin e vertetimit te nje apo disa prej shkaqeve perkatese qe parashikon ligji, si ne rastin e nenit 128 te K.Pr.Penale, pavaresisht se gjykata me e larte eshte investuar vetem mbi ankimin e te gjykuarit.***

Se pari, ne piken 3 te nenit 425 te K.Pr.Penale parashikohet se: "*Kur apelu eshte vetem i pandehuri, gjykata nuk mund te caktojte nje denim me te rende ... nga ai i vendimit te apeluar*". Megjithese kjo norme perfshihet ne kreun qe trajton ankimin perpara gjykates se apelit, duke interpretuar qellimin dhe permbajtjen e normave kushtetuese e procedurale penale ne teresi dhe harmoni me njera-tjetren, pakica vjen ne perfundimin se kjo dispozite, parimi i pergjithshem i mos

rendimit te pozites se te pandehurit, gjen zbatim edhe ne rastin kur vendimi i gjykates se shkalles se pare, se bashku me ate te gjykates se apelit, prishet nga Gjykata e Larte.

Se dyti, ne interpretim e zbatim te shkronjes "ç" te pikes 1 te nenit 428 te K.Pr.Penale, gjykata e apelit jep vendim per prishjen e vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe kthimin e akteve po asaj gjykate, per disa raste qe, ne thelb, jane ato te pavlefshmerise absolute te parashikuara nga neni 128 i ketij Kodi, apo me dispozita te tjera te veçanta. Nga kjo rrjedh perfundimi se, ne lidhje me raste te tjera te pavlefshmerive (relative), apo te vleresimit te gabuar te provave e te ligjit ne gjykimin dhe dhenien e vendimit nga gjykata e shkalles se pare, edhe nepermjet perseritjes se hetimit gjyqesor, gjykata e apelit vendos sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" te pikes 1 te nenit 428. Pra, perkatesisht, vendimi qe jep gjykata e apelit varet nga fakti nese gjendet perpara konstatimit te pavlefshmerise absolute te akteve apo deklarimit te pavlefshem te tyre, si dhe çeshtjeve te tjera te lidhura me marrjen dhe vleresimin e provave. Nderkohe qe, Gjykata e Larte si gjykate ligji, nese çmon se ndodhet perpara rasteve te pavlefshmerise, te çdo lloji (absolute apo relative), ne çdo rast duhet te disponoje prishjen e vendimit te ankimuar duke orientuar gjykatat me te uleta lidhur me pasojat e ndryshme qe rrjedhin nga ato pavlefshmeri.

Se treti, ne interpretim te drejte te pikes 3 te nenit 425 te K.Pr.Penale, parimi i mosrendimit te pozites se te pandehurit gjen zbatim ne te gjitha rastet e ankimeve te parashikuara ne ate dispozite. Nga ana tjetere, ***pakica eshte e mendimit se dispozita e pikes 3 te nenit 425 duhet te gjeje zbatim vetem atehere kur kemi te bejme me nje rigjykim te çeshtjes ne shkalle te pare, i cili nuk perben ne vetvete nje gjykim te ri, por qe eshte ne vijemesi i lidhur me vendimin e prishur nga gjykata me e larte.***

Pakica eshte e mendimit se ne rigjykim te çeshtjes, jemi perpara rastit te nje "**gjykimi te ri**" atehere kur, ndonese e investuar vetem mbi ankimin (rekursin) e te pandehurit, prishja e te dy vendimeve nga Gjykata e Larte apo prishja e vendimit te gjykates se shkalles se pare nga gjykata e apelit behet per motivet e pavlefshmerise absolute te akteve procedurale te parashikuara ne rastet qe permbahen ne nenet 128 dhe 428/1/ç te K.Pr.Penale.

Ne kete kuptim, parimi i mosrendimit te pozites se te pandehurit (reformatio in pejus) nuk perjashton mundesine qe ndaj tij te caktohet nje mase denimi me e rende, nese vendimi i dhene nga gjykata e shkalles se pare prishet per shkak te konstatimit te pavlefshmerive absolute te lartpermendura, te cilat, bejne qe i gjithë gjykimi i zhvilluar ne shkalle te pare te jete i pavlefshem, duke detyruar gjykatën e shkalles se pare, qe ne rigjykim, te zhvilloje nje gjykim te ri. Gjykimi i ri eshte i tille qe nuk mund te konsiderohet si nje rigjykim qe vazhdon si rrjedhe, faze e nje procedimi te ankimuar.

Per rrjedhoje, ne kushtet e nulitetit te gjykimit te meparshem ne thelbin dhe fillesen e tij, duke u ndodhur perpara nje gjykimi te ri, gjendemi edhe perpara mungeses se plote te nje "pozite" te te pandehurit, mbi bazen e se ciles te mund te çmohej prej tij dhe gjykates pozita me e favorshme apo e renduar ne ate procedim, persa i perket mases se sigurimit apo llojit e mases se denimit te caktuar. Kjo per faktin se ***parimi i mos rendimit te pozites se te pandehurit kerkon domosdoshmerisht qe kjo "pozite" te jete e vleresueshme, e krahasueshme, me ate qe do te rezultonte nga nje vendim gjyqesor i meparshem, i cili nuk duhet te jete nje vendim i prishur per shkak te nullitetit te tij, si nje akt qe vjen ne perfundim te nje shqyrtimi gjyqesor absolutisht te pavlefshem, pra pa asnje efekt juridik.***

Se fundi, shumica mban qendrimin se mosrendimi i pozites se te pandehurit ne rastet kur gjykata investohet vetem mbi ankimin e tij eshte i lidhur me nevojen qe atij t'i garantohet parashtrimi i kerkimeve ne gjykatën me te larte pa riskuar denim me te rende, perndryshe ai do te terhijeq ose pengohet ne ushtrimin e se drejtes kushtetuese te ankimit te vendimit ne nje gjykate me te larte, veçanërisht ne rastet e pretendimeve per shkelje te renda procedurale.

Por pakica eshte e mendimit se e drejta kushtetuese e ankimit te nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte, ne vetvete, nuk lidhet me rendimin ose jo te pozites se ankimuesit (te pandehurit) ne procesin penal. Kjo garanci kushtetuese, ne thelbin dhe qellimin e saj te vertete ka te beje me dhenien e mundesise qe, nepermjet ankimit, te pretendohet mbrojtja e interesave te te gjykuarit dhe veçanerisht te drejtave te njeriut, ne menyre qe te vendoset nga gjykata me e larte prishja e vendimit te dhene nga gjykata me e ulet ne shkelje te ligjes, aq me teper kjo ne rastet kur ky gjykim eshte bere ne shkelje te renda te normave qe garantojne te drejtat e njeriut e procesin e rregullt ligjor, shkelje qe bejne te pavlefshem gjykimin ne teresi, duke perjashtuar keshu edhe çdo te dhene, prove e perfundim te arritur ne gjykimin e pavlefshem ne ngarkim te te pandehurit qe ka parashtruar ankimin.

Prandaj, pakica ka arritur ne perfundimin se, ne menyre perjashtimore, parimi i mosrendimit te pozites se te pandehurit nuk gjen zbatim ne rastet e zhvillimit te nje gjykimi te ri ne shkalle te pare apo ne apel, si rrjedhoje e prishjes se vendimeve te meparshme te tyre perkatesisht nga gjykata e apelit apo Gjykata e Larte, per shkak te pavlefshmerise absolute (neni 128 dhe neni 428/1/ç i K.Pr.Penale) te vendimit gjyqesor, apo te akteve mbi te cilat eshte mbeshtetur ai vendim gjyqesor, qe e bejne ne teresi gjykimin te pavlefshem, pra pa asnje efekt juridik.

Ne rrethana te tilla, pakica çmon se ishte vendi per te lene ne fuqi vendimin nr.108, date 24.03.2006 te Gjykates se Apelit Vlore.

Majlinda Andrea Ardian Dvorani Besnik Imeraj

Evelina Qirjako Arjana Fullani Ardian Nuni

Aleksander Muskaj

**Nr.4/3 i Regj. Themeltar
Nr.1 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykatës së Lartë, te përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Perikli Zaharia	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Evjeni Sinoimeri	Anëtare
Spiro Spiro	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Aleksander Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 08.01.2009 moren në shqyrtim çështjen penale që i përket:

KËRKUES: REXHEP CUKU, i biri i Osmanit, i datelindjes 15.01.1960, lindur e banues ne Tirane, i padenuar, perfaqesuar nga avokat Ilir Murati.

OBJEKTI:

Revokim i mases se sigurimit “Arrest ne burg”
dhe lirimin e menjehershem te kerkuesit.

Baza Ligjore: Neni 246, pika 6,
neni 260, pika 1 dhe vijues te Kodit te Procedures Penale.

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, me vendimin nr.94, date 20.05.2008 ka vendosur:

Rrezimin e kerkeses se kerkuesit Rexhep Cuku me objekt revokimin e mases se sigurimit si te pabazuar ne prova e ligj.

Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane, me vendimin nr.31, date 23.06.2008 ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit nr.94, date 20.05.2008 te Gjykares se Shkalles se Pare per Krime te Renda.

Kunder vendimit nr.31, date 23.06.2008 te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane, brenda afatit ligjor, ne mbeshtetje te nenit 432 te Kodit te Procedures Penale, ka paraqitur rekurs kerkuesi Rexhep Cuku, nepermjet mbrojtetit te tij, duke kerkuar ndryshimin e vendimeve gjyqesore te lartpermendura, revokimin e mases se sigurimit "Arrest ne burg" dhe lirimin e menjehershem te kerkuesit ose zevendesimin e asaj mase me nje mase me te lehte, per keto shkaqe:

- Ne gjykimet e zhvilluara ne Gjykatën e Shkalles se Pare dhe ate te Apelit per Krimet e Renda eshte provuar se nga ana e Prokurorise per Krime te Renda nuk eshte marre ne pyetje i pandehuri, nuk jane kryer veprime te tjera te metejshme hetimore, nderkohe qe ne gjendjen qe jane aktet e tjera te ketij procedimi rezulton se nevojat e sigurimit per kete te pandehur nuk ekzistojne.
- Ne gjykim eshte vertetuar se nga ana e Prokurorise per Krime te Renda nuk eshte derguar ne gjykate asnje informacion mbi veprimet hetimore te kryera ne lidhje me te arrestuarin, kerkuesin Rexhep Cuku. Sa me siper, perben shkelje te hapur te kerkesave te nenit 246, pika 6 te Kodit te Procedures Penale. Si rrjedhoje e mospermbushjes qofte edhe vetem te ketij detyrimi ligjor dhe pasojave qe vijne prej tij, vetvetiu, gjykataat ishin te detyruara te revokonin masen e sigurimit "arrest me burg" apo te zevendesonin ate me nje mase tjeter me te lehte. Sa me siper, njekohesisht perben cenim te te drejtave dhe lirive themelore te njeriut te garantuara ne Kushtetute dhe ne Konventen Evropiane te te Drejtave te Njeriut, si dhe te atyre qe parashikohen ne nenin 248 e vijues te Kodit te Procedures Penale.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ne seancen gjyqesore te dates 29.09.2008, ka vendosur kalimin e çeshtjes per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, per te unifikuar praktiken gjyqesore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e çeshtjes nga gjyqtaret Ardian Dvorani dhe Aleksander Muskaj; prokurorin prane Prokurorise se Pergjithshme, Bujar Sheshi, qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Apelit per Krime te Renda; mbrojtetin e te pandehurit Rexhep Cuku, avokatin Ilir Murati, i cili kerkoi ndryshimin e vendimeve gjyqesore te dhena ne te dy shkallet e gjykimit, revokimin e mases se sigurimit arrest ne burg dhe lirimin e menjehershem te kerkuesit, ose zevendesimin e saj me nje mase me te lehte; dhe pasi e biseduan çeshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Vendimi nr.31 date 23.06.2008 i Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane eshte dhene ne respektim te ligjit, prandaj duhet te mbetet ne fuqi.

Nga gjykimi i çeshtjes ne Gjykatën e Shkalles se Pare per Krimet e Renda dhe Gjykatën e Apelit per Krimet e Renda Tirane, rezultojne te provuara faktet dhe rrethanat e meposhtme:

Prokuroria per Krime te Renda ne vitin 2007 ka regjistruar procedimin penal nr.50, per vepren penale te parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dyte ne lidhje me nenin 25 te Kodit Penal. Nga hetimet e zhvilluara, ndermjet te tjerave, ka rezultuar se edhe kerkuesi ne kete gjykim, Rexhep Cuku, dyshohet qe me veprimet e tij ka kryer vepren penale te dhenies ndihme per kalim te paligjshem te kufirit, ne bashkepunim me persona te tjere, ne formen e grupit te strukturuar kriminal, te parashikuar nga nenet 298/3 e 333/a te Kodit Penal.

Mbi bazen e provave te paraqitura dhe shqyrtuara ne seance gjyqesore, Gjykata per Krime te Renda, me vendimin nr.20 date 23.01.2008, ka vendosur caktimin e mases se sigurimit personal "arrest ne burg" ndaj kerkuesit Rexhep Cuku, pasi ka krijuar bindjen per ekzistencen e dyshimit te arsyeshem te bazuar ne prova per kryerjen e vepres penale te dhenies ndihme per kalim te paligjshem te kufirit, ne bashkepunim me persona te tjere, ne formen e grupit te strukturuar kriminal, te parashikuar nga nenet 298/3 e 333/a te Kodit Penal. Kjo gjykate ka konstatuar ekzistencen e kushteve te pergjithshme dhe te veçanta per caktimin e mases se sigurimit personal, sipas nenit 228 e 229 te Kodit te Procedures Penale, perfshire ato mbi pershtatshmerine e llojit e te mases se sigurimit ne raport me nevojat e sigurise, rendesine e faktit, rrezikshmerise se larte te vepres penale e te personit nen hetim, si dhe te sanksioneve te parashikuara ne dispoziten perkatese materiale penale.

Me vendimin nr.10, date 23.02.2008 Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane ka vendosur miratimin e vendimit te dhene nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

Ne date 02.05.2008, mbrojtessi i shtetasit Rexhep Cuku ka kerkuar revokimin e mases se sigurimit personal "arrest ne burg", lirimin e menjehershme te te mbrojturit prej tij apo zevendesimin e kesaj mase me nje mase me te lehte, te parashikuara prej neneve 234 e 237 te Kodit te Procedures Penale. Kete kerkese e mbeshtet ne urdherimet qe permbahen ne dispoziten e pikes 6 te nenit 246 te ketij Kodi. Sipas mbrojtjes, organi i prokurorise nuk ka permbushur detyrimin e parashikuar nga ligjvenesit per te informuar gjykatën çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit te arrestit. Kete rrethane mbrojtja e pretendon si shkak te ligjshem per revokimin a zevendesimin e mases se sigurimit personal per subjektin Rexhep Cuku, vetvetiu dhe ne menyre te menjehershme, si permbushje e kriterëve te parashikuara nga neni 260, pikat 1 e 2 te Kodit te Procedures Penale.

Gjate shqyrtimit gjyqesor te kesaj kerkese, Gjykata per Krime te Renda ka vleresuar se organi i prokurorise nuk e ka informuar me shkrim gjykatën mbi gjendjen e procedimit, ne afatin ligjor dy mujor, sipas parashikimeve te pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale. Ne interpretim te kesaj dispozite, ne seance gjyqesore, gjykata ka urdheruar organin e prokurorise qe te paraqese informacion me shkrim per gjendjen e procedimit ne ngarkim te kerkuesit se bashku me aktet perkatese nga fashikulli i dosjes hetimore. Duke zbatuar urdherimin e gjykates, prokurori ka paraqitur ne seance informacionin perkates, me shkrim, si dhe kopje te akteve procedurale qe lidhen me procedimin ne ngarkim te shtetasit Rexhep Cuku.

Ne perfundim te gjykimit te çeshtjes, Gjykata per Krime te Renda me vendimin nr.94, date 20.05.2008 ka vendosur rrezimin e kerkeses. Kjo gjykate arsyeton se, mospermbushja nga prokuroria e detyrimin ligjor te parashikuar ne piken 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale per dergimin ne gjykate te informacionit periodik dy mujor mbi gjendjen e procedimit ne ngarkim te kerkuesit, nuk passjell automatikisht revokimin apo zevendesimin e mases se sigurimit. Ligji procedural penal, ne veçanti neni 260 i ketij Kodi, kerkon qe njekohesisht te vertetohet se me kalimin e periudhes dy mujore nuk ekzistojne apo kane ndryshuar rrethanat e pranuar me pare lidhur me nevojat e sigurimit per zbatimin e mases se arrestit ne burg, ose keto nevoja sigurimi apo masa e sigurimit personal te mos i pergjigjet me rendesine se faktit a mases se denimit per te pandehurin. Ne gjykim, nga provat e administruara, nuk vertetohet ndryshimi i rrethanave ne lidhje me kushtet dhe kriteret mbi bazen e te cilave ishte caktuar masa e sigurimit personal arrest ne burg.

E investuar mbi ankimin e kerkuesit Rexhep Cuku, Gjykata e Apelit per Krime te Renda, me vendimin nr.31, date 23.06.2008 ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit te gjykates se shkalles se pare.

Duke çmuar te mbeshtetur ne ligj arsyetimin e gjykates se shkalles se pare, Gjykata e Apelit per Krime te Renda shton se, bazuar ne informacionin dhe aktet e paraqitura ne ate gjykim nga prokuroria, provohet se gjate hetimit jane kryer disa veprime hetimore te nevojshme per çeshtjen dhe jane duke u kryer disa te tjera, nderkohe qe kerkuesi nuk parashtrroi ndonje prove qe te vertetoje se nuk ekzistojne apo jane zbutur nevojat e sigurimit. Po keshtu, gjykata e apelit arsyeton se nuk qendron pretendimi per zbatimin e pikes 1 e 2 te nenit 260 te Kodit te Procedures Penale, si rrjedhoje e mosrespektimit te pikes 6 te nenit 246 te tij, sepse keto dy dispozita perfaqesojne ne vetvehte institute te ndryshme te se drejtes procedurale penale. Neni 246 zbatohet kryesisht nga gjykata, pa kerkese te paleve, ndersa neni 260 kerkohet prej paleve, gje qe ben te pavend vendosjen e tyre se bashku ne nje baze ligjore per kerkesen.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane, ka ushtruar rekurs kerkuesi Rexhep Cuku me ane te mbrojtetit te tij, duke i parashtruar Kolegjit Penal te Gjykates se Larte te njejtat pretendime si ne gjykimin e shkalles se pare e ne apel ne lidhje me zbatimin e gabuar te ligjit procedural penal nga gjykatat.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ne seancen gjyqesore te dates 29.09.2008, duke çmuar rendesine dhe mungesen e praktikës gjyqesore te njehsuar ne zbatimin e dispozites se pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, ka vendosur qe çeshtja te kaloje per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke parashtruar per shqyrtim sa vijon:

“1. Mungesa e paraqitjes se informacionit nga ana e prokurorise, ne afatin e percaktuar nga neni 246/6 i K.Pr.P., per zbatimin e mases se sigurimit te arrestit, te caktuar me nje vendim gjyqesor, a legjitimon paraqitjen e kerkeses per revokimin e mases se sigurimit me arrest nga ana e subjektit ndaj te cilit eshte vendosur kjo mase?

2. Ne te njejtat kushte (mungon informacioni i organit te prokurorise), ne rast se mungon nje kerkese e tille nga ana e subjektit ndaj te cilit eshte vendosur masa, a duhet qe gjykata kryesisht te kerkoje informimin e saj nga ana e prokurorise?

3. Ne rast se vete gjykata legjitimohet te kerkoje kete informacion nga ana e organit te prokurorise, shqyrtimi i ketij informacioni, qe shoqerohet me aktet e parashikuara nga neni 246/6 i K.Pr.P., a do te kryhet ne rruge administrative apo ne seance gjyqesore?

4. Ne kushtet kur gjykata merr ne shqyrtim zbatimin e vendimit te arrestit sipas dispozites se nenit 246/6 te K.Pr.P., ne interpretim te shprehjes “mund te revokojë ose te zevendesojë masen e sigurimit” do te kuptohet analizimi i rasteve te parashikuara nga neni 260 i K.Pr.P.?”

Pasi shqyrtuan çeshtjen, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte i gjejne te pambeshtetura ne ligj pretendimet e parashtruara ne rekurs nga kerkuesi Rexhep Cuku per revokimin ose zevendesimin e mases se sigurimit dhe vleresojne te drejte e te bazuar ne ligj vendimin e dhene nga Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane.

Ushtrimi i se drejtes per te kerkuar revokimin a zevendesimin e mases se sigurimit sipas pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, si dhe menyra e procedura e ndjekur per shqyrtimin, gjykimin dhe dhenien e vendimit per zgjidhjen e çeshtjes, ne teresi, jane zhvilluar duke respektuar parimet e procedimit penal dhe dispozitat procedurale penale. Por, ndonese nuk cenojne drejtesine e vendimit te dhene persa i perket zgjidhjes ne themel te çeshtjes, Kolegjet e Bashkuara verejne se, sikurse ne kerkimet e qendrimet e paleve, ashtu edhe ne arsyetimet e gjykatave, ka edhe interpretime te gabuara te ligjit. Prandaj, duke i analizuar keto kerkime e qendrimet ne funksion te zgjidhjes se çeshtjes, Kolegjet e Bashkuara do te shprehen edhe per interpretimin e unifikuar mbi qellimin dhe menyren e zbatimit te drejte te dispozites se pikes 6 te nenit 246 te ketij Kodi.

Ne kerkesen per revokimin ose zevendesimin e mases se arrestit drejtuar gjykates se shkalles se pare, por edhe ne ankimin drejtuar gjykates se apelit dhe ne rekurs, krahas pretendimit se nuk eshte marre ne pyetje dhe as jane kryer veprime te tjera hetimore lidhur me te, kerkuesi

Rexhep Cuku parashtroi edhe se organi i prokurorise, ne kundërshtim me dispoziten e pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, nuk ka permbushur detyrimin per te informuar gjykatën çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit te arrestit. Kete rrethane mbrojtja e pretendon si shkak te ligjshem per revokimin a zevendesimin e mases se sigurimit personal per subjektin Rexhep Cuku, vetvetiu dhe ne menyre te menjehershme, si permbushje e kriterëve te parashikuara nga neni 260, pikat 1 e 2 te ketij Kodi. Ky qendrim i prokurorise, sipas kerkuesit, njekohesisht perben cenim te drejtave dhe lirive themelore te njeriut te garantuara ne Kushtetute dhe ne Konventen Evropiane te Drejtave te Njeriut, si dhe te atyre qe parashikohen ne nenin 248 e vijues te Kodit te Procedures Penale.

Gjate shqyrtimit te çështjes ne te gjitha shkallet e gjykimit, edhe perpara Kolegjeve te Bashkuara, perfaqesuesi i organit te prokurorise ka pranuar se ne rastin konkret jane lejuar mangesi ne permbushjen e detyrimit qe i ngarkon organit te prokurorise dispozita e pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale. Megjithate, sipas prokurorit, kjo mangesi nuk mund te interpretohet si shkak per revokimin vetvetiu te mases se sigurimit personal te arrestit ne burg te caktuar nga gjykata ndaj te pandehurit Rexhep Cuku, per te cilin, edhe pas caktimit te kesaj mase, kane vijuar hetimet duke u realizuar veprime te tjera hetimore per kryerje te vepres penale te dhenies ndihme per kalim te paligjshem te kufirit ne formen e grupit te strukturuar me persona te tjere, te parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a te Kodit Penal.

Ndersa Gjykata e shkalles se pare dhe ajo e Apelit per Krime te Renda Tirane, kane arsyetuar se tejkalmi i afatit dy mujor per informimin mbi gjendjen e procedimit sipas pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale nuk passjell automatikisht revokimin apo zevendesimin e mases se sigurimit sepse, njekohesisht, duhet te vertetohen edhe rrethanat e parashikuara nga pika 1 e 2 te nenit 260 te ketij Kodi.

Kolegjet e Bashkuara vleresojne se duhet te mbahet parasysh qe kushtet, kriteret dhe procedurat per caktimin, zbatimin, rivleresimin dhe pergjithesisht kontrollin gjyqesor mbi masat e sigurimit, veçanerisht atyre te arrestit, jane posaçerisht dhe drejtperdrejt te lidhura me respektimin e te drejtave te njeriut dhe lirive themelore, konkretisht me lirine e personit. Prandaj, per arrijten e perfundimeve te nevojshme per zgjidhjen e drejte te çështjes, perfshire edhe ato me natyre unifikuese, Kolegjet e Bashkuara çmojne te domosdoshme edhe analizen dhe interpretimin e dispozitave perkatese te Kushtetutes, Konventes per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe Lirive Themelore e atyre te Kodit te Procedures Penale, duke u fokusuar edhe ne jurisprudencen shume te pasur per kete fushe te Gjykes Evropiane te Drejtave te Njeriut.

Kushtetuta, ne parimet e pergjithshme te saj, parashikon se *“te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, të patjetërsueshme e të pa dhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”* (neni 15). Keto te drejta mund te kufizohen, ne perpjestim me gjendjen qe ka diktuar kufizimin, vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Nga ana tjetër, *“këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”* (neni 17).

Lidhur me garantimin e lirise se personit, ne nenin 27 te Kushtetutes parashikohet se *“askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj”*. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e treguara ne kete dispozite. Ndermjet rasteve te tjera eshte ai i parashikuar ne shkronjen “c”: *“kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale, ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj”*.

Ne dispozitat vijuese te Kushtetutes, parashikohen garancite per personin qe i nenshtrohet kufizimit te lirise dhe ndjekjes penale ne teresi. Ndermjet te tjerave, ne nenin 28 parashikohet se: *“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet për shkaqet e kësaj mase, si dhe për*

akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij” (pika 1). Po kështu “i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit” (pika 3).

Ne kontekstin e kufizimit të lirise se personit vlen të evidentohet rëndësia e garancise kushtesuese se “*Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë*” (neni 30).

Ndërsa në nenin 6 të Konventes për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore sanksionohen parime të përgjithshme për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, garancite për personin që kufizohet në të drejtën e lirise personale parashikohen më hollesisht në nenin 5 të saj.

Sipas kësaj dispozite, kufizimi i lirise legjitimohet vetëm në rrugë përjashtimore dhe “... në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj ...”. Një nga rastet është ai i parashikuar në pikën 1, shkronja “c”: “... kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj”. Konventa, në pikën 3 dhe 4 ofron disa garanci të tjera thelbësore lidhur me kufizimin e lirise, pikërisht ato të kontrollit efektiv gjyqësor të ushtruar nga gjykata të pavarura, brenda afateve të shkurtra dhe të arsyeshme.

“3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm, ose të lirohet në gjykim e sipër”

“4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”.

Në zbatim të këtyre parimeve dhe dispozitave të Kushtetutes e Konventes, Kodi i Procedurës Penale, veçanërisht në Titullin VI “Masat e sigurimit”, parashikon rregulla të hollesishme edhe për masat e sigurimit personal. Nenet 228 e 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit. Ndërsa neni 230 parashikon disa kritere të veçanta lidhur me caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Këtu vlen të theksohet natyra përjashtimore e masës “arrest në burg”, e cila “... mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e paparshtatshme ...”. Në nenet 244 deri 249 parashikohen caktimi dhe zbatimi i masave të sigurimit, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të procedimit penal, përfshirë ankimin kundër vendosjes e zbatimit të tyre. Përveç të tjerave, në këto dispozita sanksionohet kontrolli rigoroz gjyqësor në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit, përfshirë detyrimin thelbësor të gjykatave për t’i shqyrtuar dhe vendosur mbi kërkesat e ankimeve me shpejtesi (në një kohë të shkurter) dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Në nenin 260 parashikohet revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit, perkatesisht nëse mungojnë apo janë zbutur kushtet dhe kriteret e lartpërmendura të zbatimit të tyre. Ankimi e kërkesat perkatese të prokurorit dhe të pandehurit mund të paraqiten në çdo kohë dhe duhet të shqyrtohen brenda afateve të shkurtra nga ana e gjykatës.

Vlerësuar në këte kontekst, vjen përfundimi se Kodi i Procedurës Penale parashikon të drejtën e paleve për të kërkuar në çdo kohë revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit. Por, në respektim të garancise se lirise se personit dhe të parimit mbi prezumimin e pafajësisë, duke u nisur nga natyra përjashtimore dhe e perkohshme e caktimit dhe zbatimit të masës së “arrestit në burg”, nga natyra jo ndeshkimore e domosdoshmeria për justifikimin kohë pas kohë e në vijimesi të pershtatshmerise (proporcionalitetit) se caktimit të kësaj masë në raport me vepren e pandehur, ligjvënisi ka nxjerre, gjithashtu, edhe një dispozite me natyrë të veçantë. Me anë të kësaj dispozite, ligjvënisi synon që ekzistencën e ligjshmerise se vijimit të zbatimit të masës se

sigurimit “*arrest ne burg*” t’ia nenshtroje verifikimit te detyrueshem, periodik, ne rruge gjyqesore. Prandaj, ne piken 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale parashikohet se: “*Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet nga prokurori për të arrestuarin. Informacioni jepet me shkrim dhe përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, për pyetjen e të pandehurit dhe të personave të tjerë, për përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur është rasti, gjykata mund të revokojë ose të zëvendësojë masën e sigurimit*”.

Ne çeshtjen objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara verejne se ne interpretim te drejte te ligjit, gjykatat kane marre ne shqyrtim dhe gjykuar kerkesen per revokim ose zevendesim te mases se sigurimit te paraqitur sipas pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, duke zbatuar te njejtat procedura e garanci, sikurse edhe ne rastet e tjera te ankimimit kunder masave te sigurimit (neni 249), perfshire ketu garancine e lidhur me te drejtat e lirite themelore te njeriut per zhvillimin e nje gjykimi te kujdesshem (diligjent) dhe me shpejtesi te çeshtjeve te kesaj natyre. Po keshtu, shqyrtimi i kerkeses dhe pretendimeve jane bere ne seance gjyqesore.

Me te drejte gjykatat kane pranuar pretendimin e kerkuesit dhe vleresuar si shkelje te ligjit procedural nga ana e prokurorise, mosrespektimin e afatit dhe mos dergimin e informacionit te prokurorit mbi gjendjen e procedimit ne lidhje me kerkuesin. Me tej, me te drejte gjykatat kane çmuar riparimin e menjehershem te kesaj shkeljeje, duke urdheruar prokurorin te paraqese ne seance informacionin me shkrim dhe kopjet e akteve perkatese, duke ia vene ne dispozicion edhe kerkuesit per t’i krijuar mundesine te parashtrroje qendimin e kerkesat. Me te drejte gjykatat kane krijuar ne kete menyre kushtet per lejimin e zhvillimin e debatit mes paleve mbi materialin e paraqitur. Pasi kane çmuar dhe analizuar ne vendimin e tyre nese mbi bazen e informacionit ka apo jo vend per revokim a zevendesim te mases se sigurimit, me te drejte gjykatat kane çmuar se eshte vendi per rrezimin e kerkeses, mes te tjerave duke arsyetuar edhe se vetem mosrespektimi i detyrimit per informim, apo dergimi me vonese i tij, nuk sjellin vetvetiu revokimin a zevendesiminin e mases se sigurimit.

Por, nga ana tjetere, Kolegjet e Bashkuara verejne se ne interpretim te gabuar te ligjit, pa patur parasysh qellimin dhe veçantite e normes se zbatueshme, gjykatat e lidhin pranimin e kerkeses per revokimin a zevendesimin e mases se sigurimit sipas pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, ne çdo rast e vetem me vertetimin e mungeses apo zbutjen e rrethanave te pranuar me pare prej tyre ne caktimin e mases se sigurimit, te parashikuara shprehimisht ne piken 1 e 2 te nenit 260 te ketij Kodi. Po keshtu, gjykata e apelit interpreton ne menyre te gabuar ligjin kur arsyeton se nuk mund te behet kerkese per zbatimin e nenit 260 si rrjedhoje e mosrespektimit te pikes 6 te nenit 246 te tij, meqenese ne rastin e fundit norma zbatohet kryesisht nga gjykata, pa kerkese te paleve, ndersa per zbatimin e nenit 260 nismen e kane palet nepermjet paraqitjes se kerkeses perkatese.

Kolegjet e Bashkuara verejne se dispozitat e neneve 27, 28 dhe 30 te Kushtetutes sone perkojne me qellimin dhe intepretim e nenit 5 te Konventes, e cila, se bashku me nenet 2, 3 e 4 te saj, jane themeli i te drejtave themelore te njeriut persa i perket mbrojtjes se sigurise fizike te individit, posaçerisht edhe te lirise se personit. Duke interpretuar keto dispozita, Gjykata Evropiane te te Drejtave te Njeriut (GJEDNJ) eshte shprehur se: “*Qellimi kryesor i tyre eshte te parandalojne deprivimin arbitrar ose te pajustificuar te lirise*” (*Castravet kunder Moldavise, 2007*).

Pikat 1 dhe 2 te nenit 28 te Kushtetutes dhe pika 3 e nenit 5 te Konventes sanksionojne te drejten e njeriut qe, nese parashtron kerkesa e pretendime te lidhura me heqjen apo ndryshimin e mases se sigurimit personal, veçanerisht asaj te arrestit, “*ato duhet t’i nenshtrohen shqyrtimit gjyqesor nga gjykata*”. Kontrolli gjyqesor lidhur me veprimet e organit te akuzes qe prekin te drejten e lirise personale perben nje element thelbesor te garancise se parashikuara ne piken 3 te

nenit 5 te Konventes *kundrejt mundesise se ushtrimit arbitrar dhe te pabazuar ne ligj te kompetencave nga organi i akuzes (Schiesser kunder Zvicres, 1979)*. Prandaj, nisur nga keto perfundime, duke patur parasysh se veprimi i parimit te kontrollit gjyqesor mbi masen e arrestit misherohet mes te tjerave edhe ne rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, gjykata kompetente duhet te shqyrtoje me shpejtesi ceshtjen ne seance gjyqesore, duke degjuar prokurorin dhe pretendimet perkatese te individit ndaj te cilit eshte caktuar masa e sigurimit ose mbrojtetin e tij. Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor, mbeshetur ne parimet e normat kushtetuese dhe nderkombetare te detyrueshme si me siper, si dhe kriteret ligjore te parashikuara ne Kodin e Procedures Penale, gjykata duhet te vendose nese kufizimi i lirise per te arrestuarin eshte ose jo e justifikuar ligjerisht.

Mjeti procedurali garantues i parashikuar nga pika 6 e nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, i cili duhet te respektohet rigorozisht nga palet e tjera ne procedimin penal dhe gjykata, gjen zbatim krahas garancise tjeter kushtetuese e ligjore qe i njihet ne menyre te pavarur vete te arrestuarit per te kerkuar ne çdo kohe e rrethane ne gjykate revokimin apo zevendesimin e mases se sigurimit. Ne te dy keto raste, *procedura perkatese e gjykimit duhet te ofroje garancite e duhura ne kontekstin e nje gjykimi qe ka per objekt shqyrtimin e nje kerkese qe lidhet me caktimin dhe vazhdimin e zbatimit te nje mase qe ka te beje me kufizimin e lirise se individit (Assenov e te tjere kunder Bullgarise, 1998)*.

Persa i perket natyres dhe llojit te gjykimit, ne interpretim te drejte te pikes 6 te nenit 246 ne harmoni me dispozitat e tjera te Kodit te Procedures Penale, duhet te mbahet parasysh se synimi i saj nuk eshte te vendose nje komunikim te qendrueshem ne linjen gjykate-prokurori. Qellimi i ligjvenesit eshte qe prokurori te detyrohet te informoje periodikisht gjykatën per gjendjen e procedimit, ne menyre qe kjo e fundit te garantoje se ky informacion, kjo gjendje, te behet objekt i shqyrtimit gjyqesor. Keshtu, ne perfundim te gjykimit, mbi kerkesat e pretendimet e paleve apo kryesisht, gjykata duhet te çmoje nese eshte vendi per revokim apo zevendesim te mases se sigurimit arrest ne burg. Ne kete kuptim, sikurse shprehet GJEDNJ, *kjo procedure duhet te jete te natyres kontradiktore per te garantuar edhe "barazine e armeve" ndermjet paleve. Ne rastin kur nje person i nenshtrohet nje mase arresti ne burg, qe perfshihet ne kuptimin e nenit 5/1 (c), duhet te zhvillohet nje seance gjyqesore. (Reinprecht kunder Austrise, 2005)*.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin unifikues se, **Kushtetuta dhe ligji i kane caktuar organit te prokurorise funksionin e ushtrimit te ndjekjes penale, qe perfshin edhe detyrimin per ta ushtruar ate ne respektim te te drejtave te njeriut e lirive themelore. Prandaj, eshte ne pergjegjesine e prokurorit kompetent te ndermarre nismen e te permbushje, ne afat dhe ne permbajtje, detyrimet perkatese sipas afateve e procedurave qe parashikohen nga pika 6 e nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, ne menyre qe gjykata te rishqyrtoje periodikisht legjitimitetin e zbatimit te mases se sigurimit te arrestit, te cilen ajo gjykate ia ka caktuar individit pikerisht mbi kerkesen e vete organit te prokurorise.**

Gjykata nuk vihet ne levizje kryesisht per te kerkuar nga prokurori kompetent permbushjen e detyrimit te informimit dy mujor, sipas dispozites procedurale te lartpermendur. Detyrimin per venien ne levizje te gjykates, nepermjet paraqitjes se informacionit mbi te arrestuarin dhe gjendjen e procedimit, ligjvensi ia ngarkon prokurorit. Nese ky i fundit nuk permbush detyrimin ne afat, i arrestuari legjitimohet te kerkoje rishqyrtimin e mases se sigurimit. Gjate shqyrtimit gjyqesor te kerkeses, gjykata urdheron prokurorin te riparoje shkeljen e ligjes duke depozituar menjehere informacionin dhe te dhenat mbi gjendjen e procedimit, te cilat i nenshtrohet hetimit gjyqesor dhe debatit mes paleve.

Ne kete kuader, Kolegjet e Bashkuara vijne ne perfundimin tjeter unifikues se, **edhe ne rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, sikurse ne rastet e**

tjera kur paraqitet kerkese nga vete i arrestuari, ne interpretim e zbatim te drejte te pikes 2 te nenit 28 te Kushtetutes dhe te pikes 4 te nenit 5 te Konventes, gjykata e shqyrton çeshtjen ne seance gjyqesore dhe duhet te vendose me shpejtesi, per vijimin, revokimin, ose zevendesimin e mases se sigurimit.

Gjithashtu, lidhur me legjitimitetin e mases se sigurimit te caktuar me pare, veçanerisht asaj te arrestit ne burg, normat e lartpermendura sanksionojne edhe detyrimin qe *gjykimi te caktohet, zhvillohet e perfundoje ne nje kohe te shpejte e te arsyeshme, duke verifikuar nese kerkuesi (i arrestuari) eshte duke u mbajtur ne gjendje arresti per nje kohe te gjate, jo te arsyeshme, aq me shume nese autoritetet nuk veprojne ne lidhje me hetimin me dilgjencen e duhur (Assenov dhe te tjere v. Bullgarise, 1998).*

Ne kete kontekst, nepermjet zbatimit te dispozites se pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, synohet edhe qe nga ana e subjekteve te procedimit penal te mbahet parasysh se rrethanat e çeshtjes penale mund te ndryshojne me kalimin e kohes, gje qe ben te domosdoshem zbatimin e nje mekanizmi te rishqyrtimit periodik, te detyrueshem, te mases se sigurimit nga ana e gjykates, me qellim qe te çmohet nese masa e arrestit vijon te jete e justifikuar ligjerisht dhe nuk cenon te drejtat e njeriut.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara çmojne se i perket ne rradhe te pare gjykates detyrimi qe te siguroje zbatimin efektiv te garancive kushtetuese te lidhura me respektimin e se drejtes themelore te lirise se personit, ne kuptimin qe caktimi e zbatimi i masave te sigurimit, veçanerisht asaj te arrestit, te mos tejkalojne kohen e arsyeshme. Per kete qellim, edhe pas caktimit te mases “arrest ne burg”, pavaresisht nga menyra e venies se saj ne levizje, ne çdo rast, gjykata duhet te shqyrtoje ne seance gjyqesore te gjitha rrethanat e lidhura me ekzistencen ose jo te interesit publik real qe justifikon vazhdimin e zbatimit te kesaj mase. Ne kete gjykim ajo mban parasysh edhe respektimin e parimit te prezumimit te pafajesise, si dhe natyren e mases se arrestit si perjashtim nga rregulli kushtetues i respektimit te lirise individuale.

Kushtetuta dhe Konventa garantojne te drejten e individit per te kerkuar ne gjykate verifikimin e ligjshmerise se ndalimit dhe te mases se arrestit ne burg, pavaresisht nga motivet e vendosjes se saj, si dhe per te fituar revokimin e zevendesimin e saj nese nuk eshte e ligjshme. Praktika jone gjyqesore eshte e pasur ne lidhje me kuptimin dhe zbatimin e kushteve dhe kriterëve te pergjithshme e te veçanta per caktimin dhe zbatimin e masave te sigurimit, si dhe per revokimin a zevendesimin e tyre, veçanerisht ne interpretim te neneve 228, 229, 230 dhe 260 te Kodit te Procedures Penale.

Megjithate, ne kuader te respektimit te se drejtes themelore te njeriut per lirine e personit dhe garancive perkatese ne lidhje me te te sanksionuara nga Kushtetuta e Konventa, Kolegjet e Bashkuara çmojne te nevojshme te evidentojne domosdoshmerine e interpretimit te drejte te dispozitave te lartpermendura e, veçanerisht, asaj te pikes 6 te nenit 246, persa i perket interpretimit kushtetues e ligjor te “*gjendjes se procedimit*” ne ngarkim te nje personi ndaj te cilit zbatohen masa sigurimi, sidomos ajo e arrestit ne burg.

Pika 3 e nenit 28 te Kushtetutes, ku perfshihet edhe qellimi i permbajtjes se pikes 3 te nenit 5 te Konventes nuk mund te interpretohen si nje mjet autorizues per te kufizuar lirine e personit nepermjet arrestit ne burg ne nje menyre te pakushtezuar, pavaresisht se Kodi i Procedures Penale, ne nenet 263 e vijues te tij, ka percaktuar afatet maksimale perkatese te kohezgjatjes se paraburgimit sipas llojit te vepres penale dhe rrethanave te çeshtjes. Prandaj, GJEDNJ ka vleresuar se *per çdo periudhe paraburgimi, pavaresisht sa e shkurter te jete caktuar ajo, autoritetet duhet te parashatrojne perpara gjykates motive te besueshme qe e justifikojne ate periudhe (Belchev kunder Bullgarise, 2004).*

Derisa nuk eshte dhene vendim i denimit, edhe i arrestuari prezumohet i pafajshem. Pika 3 e nenit 28 te Kushtetutes, perkatesisht pika 3 e nenit 5 te Konventes, jane garanci thelbesore per

individin e arrestuar, te cilat ne thelb synojne te mundesojne *lirimin e perkohshem te tij perderisa vijimi i zbatimit te mases se arrestit ka pushuar se qeni e arsyeshme* (McKay kunder Mbreterise se Bashkuar, 2006).

Pra, jo vetem ne caktimin e mases arrest ne burg, por edhe ne shqyrtimin gjyqesor te kerkeses per revokim ose zevendesimin e kesaj mase ne te ardhmen, gjykata duhet te mbaje parasysh se: *“presumimi eshte ne favor te lirimit” te te arrestuarit. Neni 5/3 i Konventes nuk i jep autoritetit gjyqesor te drejten te zgjedhe ne menyre alternative midis dergimit te te akuzuarit ne gjyq brenda nje kohe te arsyeshme, ose dhenies atij te lirise se perkohshme deri ne kohen e gjykimit* (Neumeister kunder.Austrise, 1968).

Gjithashtu, gjykata nuk mund te mjaftohet ne arsyetimin e saj per caktimin e mases se arrestit ne burg, apo per zgjatjen e afatit te paraburgimit duke u kufizuar thjesht e vetem ne perifrize standarte, me teper referuese mbi dispozita te Kodit te Procedures Penale qe parashikojne kushtet e kriteret per caktimin e masave te sigurimit, *pa arsyetuar ne menyre ezauruese se si e perse gjejne ato zbatim ne ceshtjen konkrete* (Sarban kunder Moldavise, 2005). Pra, ne arsyetimin e vendimit te gjykates duhet te analizohen *ne menyre ezauruese e reale motivet konkrete te pranimit ose jo te kerkeses/ankeses per revokim a zevendesim te mases se sigurimit dhe jo te behet nje perskrim ritual e formal i shkaqeve e kriterëve te parashikuara nga ligji* (Mansur kunder Turqise, 1995), (Smirnova kunder Rusise, 2003).

Nisur nga arsyetimet e mesiperme, Kolegjet e Bashkuara çmojne se vijemesia e ekzistences se dyshimit te arsyeshem qe personi i arrestuar ka kryer nje veper penale mbetet nje kusht *sine qua non* per vlefshmerine e vazhdimësisë se zbatimit te mases se arrestit. Por, pas kalimit te nje kohe te arsyeshme, edhe ky motiv nuk mund te qendroje më i vetem si justifikim per zbatimin e mases se arrestit. Prandaj, ne nje gjykim me objekt rivleresimin e kesaj mase, gjykata duhet te çmoje e vendose edhe ne varesi te vertetimit ose jo te motiveve te tjera te parashtruara nga organi i akuzes per justifikimin e vazhdimit te kufizimit te lirise se individit.

Ne kete kontekst, sikurse shprehet GJEDNJ, eshte thelbesore qe te mbahet parasysh se *per te çmuar nese motivet fillestare mbeten apo jo “relevante” dhe “suficente”, gjykata duhet gjithashtu te verifikojë dhe te sigurohet se organet kompetente per ndjekjen penale kane shfaqur ne kryerjen e veprimeve hetimore ne ate procedim penal “diligjence te posaçme”*. (Labita kunder Italise, 2000), (Castravet kunder Moldavise, 2007).

Edhe ne kendveshtrimin e ligjshmerise se caktimit dhe vijimit te zbatimit te mases se sigurimit, posaçerisht asaj te arrestit ne burg, *diligjenca*, pra kujdesi dhe perpjekjet e duhura, te posaçme, nga ana e organit te akuzes ne ushtrimin e ndjekjes penale ne nje ceshtje konkrete, eshte nje element dhe aspekt thelbesor i vleresimit te ekzistences ose jo te procesit te rregullt ligjor. Madje, nga ky vleresim nuk ben perjashtim edhe sjellja e gjykates ne raport me detyrimet e saj procedurale lidhur me pranimin, caktimin per gjykim, shqyrtimin gjyqesor dhe dhenien e vendimit perkates mbi kerkesat per caktimin e masave te sigurimit, apo revokimin a zevendesimin e tyre.

Ne lidhje me sa me siper ne ceshtjen objekt gjykimi, ne gjykatën e shkalles se pare dhe te apelit, ashtu edhe ne rekurs, nga ana e kerkuesit Cuku eshte pretenduar se, pas caktimit te mases arrest ne burg, nga prokuroria nuk jane kryer veprime hetimore me kerkuesin ne menyre qe te justifikojë kohezgjatja e zbatimit te kesaj mase ne ngarkim te tij. Ndersa prokurori, pretendoi dhe paraqiti te dhena te procedimit penal, sipas te cilave ekzistojne nje numer i madh veprimesh hetimore te lidhura me fazen e hetimit te kesaj ceshtje penale ne ngarkim jo vetem te kerkuesit, por edhe personave te tjere, te akuzuar per kryerje te vepres penale ne bashkepunim, ne formen e grupit te strukturuar kriminal.

Kolegjet e Bashkuara çmojne se, ne veshtrim te vleresimit te respektimit te detyrimit per perkujdesje dhe perpjekje te duhura (diligjence) per hetimin e ceshtjes nga organi i akuzes, me te

drejte gjykatat e faktit kane rrezuar kete pretendim te kerkuesit Cuku. Ato kane arsyetuar se mbi bazen e provave te administruara lidhur me kete çeshtje penale, nga organi i akuzes jane kryer e vijojne te kryhen nje numer i madh veprimesh hetimore qe lidhen edhe me akuzen ne ngarkim te te arrestuarit Cuku, per vepren penale te dhenies ndihme per kalim te paligjshem te kufirit ne formen e grupit te strukturuar me persona te tjere, te parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a te Kodit Penal.

Kolegjet vleresojne se ndonese e kane zgjidhur drejt çeshtjen, gjykatat e faktit arsyetojne ne menyre te gabuar kur vetekufizohen dhe lidhin shqyrtimin e informacionit dhe kerkesave, sipas pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, vetem me mosvertetimin e asnjërit prej rasteve te parashikuar ne nenin 260 te ketij Kodi. Ne fakt, interpretimi i drejte i pikes 6 te nenit 246 lidhet jo vetem thjesht me vleresimin nga gjykata te gjendjes se te arrestuarit, ne kuptim te ekzistences, ndryshimit a shuarjes, me kalimin e kohes, te kushteve e kriterëve te parashikuara ne nenet 228, 229, 230 e 260 te ketij Kodi.

Gjykata shqyrton dhe vlereson *informacionin per te arrestuarin*, te lidhur dhe me *gjendjen e procedimit* ne teresi, edhe ne kendveshtrimin e respektimit te procesit te rregullt ligjor persa i perket ushtrimit ose jo nga ana e prokurorit te ndjekjes penale *me perkujdesje dhe perpjekje te duhura*, pra si ne aspektin e kohezgjatjes ashtu edhe te permbajtjes se veprimeve hetimore te kryera, te cilat e justifikojne ose jo kohezgjatjen dhe vazhdimin e zbatimit te mases se arrestit. Ne kete kuader, gjykata shqyrton dhe vendos mbi informacionin per te arrestuarin ne harmoni me perfundimet qe nxjerr nga shqyrtimi i gjendjes se procedimit ne teresi, pra jo domosdoshmerisht e vetem lidhur me veprimin hetimor te pyetjes ose jo te te arrestuarit, por edhe te personave te tjere, si edhe me veprime te tjera hetimore efektivisht te lidhura me ta dhe hetimin e çeshtjes penale konkrete.

Caktimi i mases se sigurimit arrest ne burg kerkon domosdoshmerisht vertetimin e ekzistences se kushteve perkatese, pra te dyshimit te bazuar ne prova, rrezikut per marrjen ose vertetesine e proves, per largimin e te pandehurit apo kryerjen e veprave te tjera penale prej tij, shkallen e rrezikshmerise shoqerore te vepres penale te pandehur apo te vete te pandehurit te parashikuara nga neni 228 i Kodit te Procedures Penale, si edhe te kriterëve te neneve 229 e 230 te ketij Kodi.

Por, nga ana tjetër, ne pikepamje te ligjshmerise se saj, vazhdimi i zbatimit te mases se sigurimit “arrest ne burg”, nuk mund te jete i pakufizuar dhe i pakushtezuar nga detyrimi per justifikimin e kryerjes se veprimeve hetimore te domosdoshme ne pikepamje te kohezgjatjes dhe permbajtjes se tyre. Ne interpretim te Kushtetues dhe Konventes, caktimi dhe vazhdimi i zbatimit te mases se arrestit ne burg jane te lidhura me garantimin e interest publik per ushtrimin e ndjekjes penale, i cili, nga ana e tij, ne menyre proporcionale, duhet te justifikohet me zhvillimin e nje procesi te rregullt ligjor, pra me respektimin e te drejtave te njeriut, ku pa dyshim ben pjese e drejta e lirise se personit, natyra rigorozisht perjashtimore dhe e perkohshme e kufizimit te lirise se tij, si dhe prezumimi i pafajesise. Mosveprimi, zvarritjet, mungesa e diligjences per te kryer ne afate te arsyeshme veprimet hetimore te duhura dhe realisht te lidhura me akuzen ne ngarkim te te arrestuarin ne nje çeshtje konkrete, perbejne ushtrim arbitrar te kompetences nga prokurori me pasoje cenimin e te drejtave themelore te tij dhe shkeljen e procesit te rregullt ligjor.

Ne vijim te analizes se mesiperme, mbeshtetur ne te gjitha normat kushtetuese e te Konventes te permendura ne kete vendim lidhur me garantimin e lirise personale dhe zbatimin perjashtimisht te kufizimit te saj per nje kohe rigorozisht te caktuar, ne dispozitat procedurale penale te nxjerra ne zbatim te tyre, edhe ne kontekstin e zbatimit te drejte te pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin unifikues se: **Organi i prokurorise ka barren e proves per te vertetuar perpara gjykates se ende ka baze te justifikuar per vijimin e zbatimit te mases se arrestit. Objekti i informacionit te detyrueshem**

nga prokurori, parashtrimi i kerkesave te paleve per revokim a zevendesim te mases se arrestit, si dhe objekti i gjykimit mund te shtrihen edhe pertej ekzistences ose jo te motiveve fillestare qe kane justifikuar caktimin e mases se arrestit ne burg, nga ato qe parashikohen ne kushtet dhe kriteret e neneve 228, 229, 230 e vijues te Kodit te Procedures Penale.

Ne kuptim te pikes 6 te nenit 246 te ketij Kodi, ne shqyrtimin gjyqesor dhe dhenien e vendimit per secilen çeshtje konkrete, gjykata nuk kufizohet vetem ne rrethanat qe parashikohen ne shkronjen “c” te pikes 2 te nenit 27 te Kushtetutes (shkronja “c” e pikes 1 te nenit 5 te Konventes), kryesisht te materializuara ne nenet 228-230, si edhe ne dispoziten e nenit 260 te Kodit te Procedures Penale. Njekohesisht, gjykata duhet te mundesoje nje gjykim ku te realizohet efektivisht verifikimi ezaurues, jo formal, i “gjendjes se procedimit” ne teresi, pra i te gjitha rrethanave dhe kushteve thelbesore per ligjshmerine e vazhdimit te zbatimit te mases se arrestit ne burg, ku perfshihet edhe vleresimi mbi *diligjencen e posaçme* - kujdesin dhe perpjekjet e duhura, te justifikueshme, te organit te prokurorise per permbushjen si ne kohe, ashtu edhe ne substance te veprimeve hetimore sipas ligjit, posaçerisht ne raport me rrethanat e procedimit penal objekt i atij gjykimi.

Kur vertetohet ne gjykim, ne varesi te shkalles se mungeses se diligjences ne hetim, qofte edhe vetem per kete shkak, gjykata mund te vendose revokimin ose zevendesimin e mases se sigurimit. Ne dhenien e ketij vendimi, gjykata duhet te mbaje parasysh edhe rrethanat e tjera te çeshtjes konkrete, te lidhura me kushtet e kriteret e parashikuara ne ligj mbi caktimin e masave te sigurimit.

Ne zbatim te pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, ne gjykim, te arrestuarit dhe mbrojtetit te tij duhet t’i garantohet mundesia per t’u njohur me informacionin e paraqitur nga prokurori dhe kopjet e akteve te fashikullit qe shoqerojne ate dhe qe lidhen me te arrestuarin, si dhe me ato qe eventualisht paraqiten nga prokurori ne seance per te justifikuar vazhdimin e zbatimit te mases se sigurimit arrest ne burg.

Respektimi i kesaj garancie lidhet me te drejten e nje procesi te rregullt ligjor, garanci qe parashikohet shprehimisht nga dispozita e pikes 3 te nenit 28 te Kushtetutes dhe pikes 4 te nenit 5 e nenit 6 te Konventes. Njekohesisht ne interpretim te dispozites se nenit 279 te ketij Kodi, prokurori ka te drejten qe te dhena te caktuara t’i parashtroje ne informacion e gjykim ne menyren e pershtatshme qe nuk demton hetimin, duke i njoftuar gjykates nevojën e ruajtjes se sekretit per keto veprime hetimore te caktuara. Sikurse shprehet GJEDNJ, *i arrestuari duhet te njihet me qendrimet e prokurorise dhe te kete mundesi reale per t’u shprehur mbi to Te dhenat qe jane thelbesore per te vleresuar ligjshmerine duhet t’i behen te njohura ne çfaredo forme te pershtatshme te arrestuarit dhe mbrojtetit te tij Nderkohe qe mund te jete e nevojshme per te mbajtur sekretin mbi disa te dhena e prova ne fazen e hetimit paraprak per te parandaluar qe te dyshuarit te demtojne dhenien e drejtesise (Garcia Alva kunder Gjermanise, 2001).*

Ne kete gjykim, me ane te kerkeses se paraqitur ne gjykate, kerkuesi Cuku ka pretenduar se masa e arrestit qe i ishte caktuar duhet revokohej, ose zevendesohet per shkak te mos respektimit nga prokurori te detyrimit per informim ne gjykata dy muaj pas caktimit te mases se sigurimit. Nisur edhe nga qendrimet e mbajtura nga gjykatat, Kolegjet e Bashkuara çmojne te shprehen lidhur me kuptimin dhe interpretimin e drejte ligjor te pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale persa i perket qellimit e nevojës se respektimit te afatit dy mujor te informimit, si dhe pasojave perkatese nese prokurori sillet ne shkelje te ketij detyrimi.

Sikurse eshte permendur me siper, me kalimin e kohes, rrethanat lidhur me kushtet dhe kriteret mbi te cilat ishte mbeshetur gjykata ne caktimin e mases se sigurimit arrest ne burg mund te ndryshojne. Prandaj ligjvenesit ka parashikuar te drejten e te arrestuarit qe t’i drejtohet ne çdo kohe gjykates per revokimin a zevendesimin e mases, sikurse edhe detyrimin e prokurorit qe, pavaresisht nga ushtrimi i se drejtes per rishqyrtim nga vete i arrestuari, te informoje brenda çdo

periudhe kohore te shkurter dy mujore mbi gjendjen e procedimit persa i perket te arrerstuarit. Dispozita e pikes 3 te nenit 28 te Kushtetutes, sikunder edhe ajo e pikes 4 te nenit 5 te Konventes sanksionojne te drejten e njeriut, qe i eshte caktuar nje mase sigurimi, veçanerisht ajo e arrestit, per te patur mundesine jo vetem qe *te kerkoje e te degjohet ne seance gjyqesore nga gjykata ne lidhje me ligjshmerine e mases se sigurimit te caktuar ndaj tij gjate hetimit paraprak*, por kjo e drejte te realizohet *vijimesisht ne menyre periodike e ne intervale kohore sa me te shkurtra (Bezicheri kunder Italise, 1989), (Hutchison Reid kunder Mbreterise se Bashkuar, 2003).*

Ne lidhje me domosdoshmerine e garantimit te mjeteve efektive te rishqyrtimit te masave te sigurimit, duhet te mbahet parasysh qe *natyra e arrestit kerkon zbatimin e afateve kohore te ndermjetme te shkurtra; Konventa sanksionon prezumimin se kjo lloj mase duhet te zbatohet per nje afat kohor rigorozisht te kufizuar (Neni 5 paragrafi 3), sepse ekzistenca e tij ne thelb eshte e lidhur me kerkesat per nje hetim i cili duhet te realizohet ne nje kohe sa me te shpejte (Bezicheri kunder Italise, 1989).*

Per keto arsye, Koelgjet e Bashkuara vijne ne perfundimet unifikuese se **dispozita e pikes 6 te nenit 246 te Kodit te Procedures Penale, nepermjet parashikimit te intervalit dy mujor ndermjet dy gjykimeve per rivleresimin e ligjshmerise se mases se arrestit, synon qe i arrestuari te kete te garantuar te drejten per te kerkuar shqyrtimin e vlefshmerise se ligjshmerise se mases ndaj tij ne intervale kohore te arsyeshme. Mos respektimi apo vonesa nga prokurori ne permbushjen e detyrimit per informim nuk perben ne vetvete shkak per te legjitimuar pranimin e kerkeses per revokimin a zevendesimin e mases se sigurimit. Nga ana tjetere, kjo shkelje e ligjit nga ana e prokurorit legjitimon te drejten e te arrestuarit per t'i kerkuar gjykates permbushjen menjehere te detyrimit per informim nga prokurori. Duke qene pjese e respektimit te procesit te rregullt ligjor, gjykata e mban parasysh edhe kete rrethane, duke e çmuar ate ne harmoni me rrethanat e tjera qe rezultojne ne gjykim nga informimi per te arrestuarin dhe te dhenat ne lidhje me gjendjen procedimit, per te ardhur ne perfundimin nese nese eshte vendi per revokim a ndryshim te mases se sigurimit.**

Se fundi, ndryshe nga sa pretendon kerkuesi, si gjykata e shkalles se pare dhe ajo e apelit, kane marre ne shqyrtim dhe dhene vendimet ne lidhje me pretendimet e parashtruara nga kerkuesi Cuku ne kohe te shpejte dhe te arsyeshme, duke respektuar parimet dhe afatet e parashikuara nga Kodi i Procedures Penale (nenet 249, 260).

Kolegjet e Bashkuara vleresojne qe eshte vendi te theksohet se, sikurse ne rastin e procedurave per caktimin e mases se sigurimit “arrest ne burg”, ashtu edhe ne shqyrtimin gjyqesor te kerkesave dhe ankesave te lidhura me pretendime per revokimin ose zevendesimin e kesaj mase, ne funksion te zhvillimit te nje procesi te rregullt ligjor, gjykata duhet te garantoje gjykimin me shpejtesi dhe brenda nje afati te arsyeshem te çeshtjes.

Pika 3 e nenit 28 te Kushtetutes, sikurse pika 4 e nenit 5 te Konventes, lidhur me shqyrtimin e çeshtjeve per caktimin ose revokimin a zevendesimin e mases “arrest ne burg”, sanksionojne detyrimin e realizimit te tyre me shpejtesi, brenda nje afati te shkurter. Sikurse shprehet GJEDNJ, *keto dispozita nuk kane per qellim te garantojne vetem te drejten e ankimit, gjithsesi ato garantojne detyrimin e prokurorit dhe gjykates qe ankimet te shqyrtohen me shpejtesi (Laidin kunder Frances, 2002).*

Nga ana tjetere, ne interpretim te drejte te dispozitave te lartpermendura, ne funksion te respektimit e vleresimit nese afati i shqyrtimit eshte i arsyeshem, ne shpejtesine e gjykimit perfshihet se pari, *afati brenda te cilit te arrestuarit i mundesohet e drejta per te ankimuar ligjshmerine e zbatimit te mases “arrest ne burg”.*

Se dyti, afati brenda te cilit kerkesa ose ankimi merret ne shqyrtim nga gjykatat, i cili duhet te jete sa me i shkurter qe te jete e mundshme. Respektimi i shpejtesise se gjykimit çmohet

sipas rrethanave te çdo çeshtjeje konkrete, ku perfshihet natyra dhe kompleksiteti i saj (Luberti kunder Italise, 1984) (Letellier kunder France,1991), (G.B. kunder Zvicres, 2000).

Ne çeshtjen objekt gjykimi, kerkesa per revokim te mases se sigurimit eshte paraqitur ne gjykate ne daten 02.05.2008, shqyrtimi i saj ka filluar menjehere dhe vendimi i gjykates se shkalles se pare eshte dhene ne daten 20.05.2008. Ndersa ne gjykatën e apelit vendimi eshte dhene ne daten 23.06.2008. Prandaj, ne rrethanat e çeshtjes konkrete, duke e shqyrtuar ate brenda nje afati te pergjithshem dy mujor, Kolegjet e Bashkuara çmojne se te dy gjykatat kane zbatuar drejt ligjin, duke gjykuar çeshtjen ne afat te shkurter dhe te arsyeshem.

Si perfundim, Kolegjet e Bashkuara vleresojne se, mbeshtetur ne analizen mbi zbatimin e ligjit e perfundimet unifikuese te lartpermendura, duke patur parasysh perfundimet ne lidhje me provat e çmuara nga gjykata e shkalles se pare dhe te apelit, pretendimet e parashtruara ne rekursin e kerkuesit Rexhep Cuku nuk jane te mbeshtetura ne ligj. Prandaj, vendimi i gjykates se apelit duhet te lihet ne fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne mbeshtetje te pikes 2 te nenit 141 te Kushtetutes, te shkronjes “a” te nenit 17 te Ligjit nr.8588, date 15.03.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates se Larte” dhe te nenit 263 te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S I

1. Lenien ne fuqi te vendimit nr.31, date 23.06.2008 te Gjykates se Apelit per Krimet e Renda.
2. Unifikimin e praktikës gjyqesore sikurse percaktohet ne kete vendim.
3. Dergimin per botim ne Fletoren Zyrtare te ketij vendimi qe njehson praktiken gjyqesore.

Tiranë, më 08.01.2009

Nr.1 i Rregj. Themeltar
Nr.1 i Vendimit

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbera nga:

Thimjo Kondi Kryetar
Artan Hoxha Anetar
Gani Dizdari Anetar
Nikoleta Kita Anetare
Agron Lamaj Anetar
Spiro Spiro Anetar
Perikli Zaharia Anetar
Evjeni Sinoimeri Anetare
Irma Bala Anetare
Shpresa Beçaj Anetare
Fatos Lulo Anetar
Besnik Imeraj Anetar
Ardian Nuni Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 27.03.2008, mori ne shqyrtim çeshtjen penale me:

TË GJYKUAR: EMILJANO ZERELLARI

A K U Z U A R:

*Per vepren penale te prodhimit dhe shitjes se narkotikeve,
parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.*

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat, me vendimin nr.208, date 28.12.2005, ka vendosur:

Deklarimin fajtor te te pandehurit Emiljano Zerellari per kryerjen e vepres penale te prodhimit dhe mbajtjes se lendeve narkotike, te parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe ne baze te ketij neni denimin e tij me 5 (pese) vjet burgim.

Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale e denon perfundimisht me 3 (tre) vjet e 4 (kater) muaj burgim.

Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin nr.89, date 10.03.2006, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.208, date 28.12.2005 te Gjykates se shkalles se pare Berat dhe kthimin e çeshtjes per rigjykim ne ate gjykate, me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat, me vendimin nr.125, date 28.09.2006, ka vendosur:

Pushimin e çeshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Emiljano Zerellari, akuzuar per vepren penale te prodhimit dhe mbajtjes se lendeve narkotike, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, pasi ndjekja penale nuk duhet te vazhdoje dhe mbajtja e lendes narkotike ka qene per perdorim vetjak dhe ne sasi te vogla.

Urdherohet lirimi i menjehershëm i të pandehurit Emiljano Zerellari, nëse nuk mbahet për ndonjë veprë tjetër.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.517, datë 26.12.2006, ka vendosur:
Ndryshimin e vendimit nr.125, datë 28.09.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe duke e gjykuar çështjen në fakt:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Emiljano Zerellari për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes së lendeve narkotike, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe në bazë të këtij neni denimin e tij me 5 (pese) vjet burgim.

Kunder vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs i gjykuari Emiljano Zerellari, nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe lenien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke parashtruar keto shkaqe:

- 1. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rezultat i zbatimit të keq të nenit 283/1 të Kodit Penal, pasi veprimet e kryera nga i pandehuri nuk përbejnë elemente të veprës penale, meqenëse ai ka mbajtur një sasi lende narkotike prej 1,9 gramesh, që është doza për përdorim vetjak, është përdorues i rregullt i lendes narkotike, prandaj dhe ligjvënisi e ka përjashtuar nga përgjegjësia penale përdoruesit që mbajnë doza të vogla.

- 2. Meqenëse në ligj nuk është përcaktuar se sa mund të jetë sasia për përdorim vetjak që përjashtohet nga përgjegjësia penale, gjykata duhet të mbante parasysh faktin se i pandehuri është përdorues prej 3-4 vjetësh i heroines, është shtruar dhe në Spitalin Ushtarak dhe ka marrë mjekim të specializuar për t'u shëruar nga kjo sëmundje, por nuk ia ka arritur dhe ka vazhduar ta përdorë rregullisht lenden narkotike.

- 3. Perderisa, sipas mendimit të ekspertit, dozat përdoren të gjitha nga i pandehuri brenda ditës, duke mos qenë fillestar si përdorues i lendes narkotike, për më tepër që dhe në raste analoge, gjykata e apelit ka përjashtuar nga denimi persona të cilëve i janë gjetur doza deri në 2 gram lende narkotike, siç është rasti i shtetasit Artan Hoxha nga Berati, edhe në rastin konkret gjykata e apelit duhet të kishte lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe jo ta ndryshonte atë duke deklaruar fajtor të pandehurin Emiljano Zerellari, për më tepër që dhe mosha e të pandehurve në të dy rastet është e ngjashme.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke çmuar se dispozita e nenit 283/1 të K.Penal është zbatuar dhe interpretuar në mënyrë të ndryshme nga gjykatat e faktit, si dhe vete Kolegji Penal ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me kuptimin që ka shprehja "... përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla ...", vendosi që ta kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të unifikuar praktiken gjyqësore lidhur me:

1. Mbi cilat kritere duhet të bazohet gjykata për të përcaktuar nëse bëhet fjale për "doza të vogël" dhe a mund të përcaktohet konkretisht sasia maksimale e lendes narkotike që do të konsiderohet "doza e vogël"?

2. Kur doza çmohet jo e vogël, por mjeket e konsiderojnë për përdorim vetjak ditor, a do të konsiderohet mbajtja e saj si "për përdorim vetjak"?

3. Sasia e lendes narkotike që përjashton nga denimi personin për shkak të faktit që e ka për përdorim vetjak a duhet të ndryshojë në lidhje me llojin e lendes narkotike?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e gjyqtarëve Besnik Imeraj dhe Spiro Spiro; prokurorin pranë Gjykatës së Lartë, Artur Selmani, i cili kërkoj lenien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit

Vlore; avokatin Shuaip Syri, qe kerkoi prishjen e vendimit te Gjykates se Apelit Vlore dhe lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates shkalles se pare Berat, si dhe pasi shqyrtoi ne teresi ceshtjen,

V Ë R E J N Ë

Se, i gjykuari Emiljano Zarellari u arrestua në flagrancë, pasi më 22.09.2005 është kapur me 1,9 gr. pluhur, të ndarë në gjashtë qese. Rezultoi e provuar që lëndë përmbante heroinë, acetilkodeinë, monoacetilmorfinë, substanca këto, të cilat bëjnë pjesë në grupin e lëndëve narkotike. Sipas aktit të ekspertimit toksikologjik, në urinën e të pandehurit u zbulua prania e po këtyre substancave.

Rezultoi, gjithashtu, i provuar fakti që i gjykuari Emiljano ishte përdorues që prej 4 vjetësh i lëndëve narkotike, kurse, sipas specialistit të thirrur si ekspert, sasia e lëndës narkotike që iu kap atij ishte e mjaftueshme për t’u përdorur prej tij, brenda 24 orëve.

Gjykata e rrethit Berat me argumentin se, doza e gjetur të gjykuarit ishte për përdorim vetjak dhe se nuk provohej që ai të ishte shpërndarës i saj, e ka deklaruar të gjykuarin të pafajshëm. Kurse Gjykata e Apelit Vlorë, me arsyetimin se lëndë e gjetur të gjykuarit ishte në sasi jo të vogël, edhe pse ai e kishte për përdorim vetjak, ndryshoi vendimin e mësipërm, duke e deklaruar fajtor dhe dënuar të gjykuarin për krimin e parashikuar në nenin 283/I të K.Penal, vendim ky për të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se është i drejtë, i bazuar në ligj.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve që përmban rekursi i të gjykuarit Emiljano dhe në funksion të zgjidhjes së çështjes penale, objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, këto Kolegje vunë në bisedim edhe problemet për të cilat Kolegji Penal e kaloi çështjen penale për njehsim të praktikës gjyqësore, për të cilat arriti në përfundimet e mëposhtme.

Krimi i prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike që parashikohet në nenin 283 të K.Penal (me paragrafin e parë të të cilit është deklaruar fajtor e dënuar i gjykuari Emiljano), përveç shitjes, ofrimit për shitje, marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit dhe dorëzimit të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, nga ana objektive, kryhet edhe në formën e mbajtjes së këtyre lëndëve, substancave e farërave, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre. Lidhur me këtë formë (mbajtjen) të anës objektive të kësaj figure krimi, ligjvënësi, si kriter përcaktues për ekzistencën e vetë figurës së krimit dhe, për pasojë, të bazës së përgjegjësisë penale për personat që e konsumojnë atë, ka parashikuar dy rrethana specifike: së pari, mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farëve të bimëve narkotike jo për përdorim vetjak dhe së dyti, edhe kur rezulton i provuar fakti që, këto lëndë mbahen nga personi për përdorim vetjak, në aspektin sasior, ato nuk duhet të jenë në doza të vogla.

Përsa i përket rrethanës së parë, Kolegjet vënë në dukje se ajo është rrethanë fakti - rezultat i procesit të të provuarit nëpërmjet analizës, në zbatim të kërkesave të dispozitës së nenit 152 të K.Pr.Penale, të provave dhe indicieve, në të cilat duhet të bazohet gjykata për të arritur në përfundime të drejta, nëse lëndë narkotike dhe psikotrope, etj. mbahet nga personi për përdorim vetjak apo për të kryer në vijim,(pavarësisht se kur), ndonjërin apo disa nga veprimet e tjera (shitje, ofrim për shitje, dhënie ose marrje në çdo formë, shpërndarje, tregtim, transportim, dërgim dhe dorëzim të saj), që janë elementë të anës objektive të figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve.

E veçanta e rrethanës së “... përdorimit vetjak” është se ajo nuk qëndron më vete. Ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se, duke u bazuar vetëm në ekzistencën e saj (të faktit të provuar tashmë sipas të cilit lëndë narkotike dhe psikotrope, etj. mbahet për përdorim vetjak), nuk ekziston edhe figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të K.Penal.

Kësisoj, ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se nuk ekziston baza ligjore (figura e krimit) për të marrë mbajtësin e tyre në përgjegjësi penale. Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëve të tilla në përgjegjësi penale duhet të provohet se ekziston edhe rrethana e dytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehet ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë “në doza të vogla”.

Nocioni juridiko-penal që është shprehur nga ligjvënësi me togfjalëshin “në doza të vogla”, edhe pse nuk mund të bëhet ndonjë përcaktim numerik i sasise së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t’u konsideruar e vogël, duhet të interpretohet në kuptimin që, në aspektin sasior, lënda narkotike dhe psikotrope, etj., duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret dhe jo në përgjithësi. Ajo nuk duhet të tejkalojë aftësitë fiziko-biologjike të individit përdorues dhe brenda kufijve të tolerancës që paraqet organizmi i tij për llojin konkret të lëndës narkotike, në momentin dhe kushtet e përdorimit të kësaj lënde, për të mos krijuar tek ai efekte tej asaj shkalle që do t’i dëmtonin shëndetin. Marre për baze këto analize, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **Doza e vogel, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tere dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si doza e vogel.**

Përcaktim i tillë i nocionit “në doza të vogla”, për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të K.Penal, veç rrolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe personave që kanë vartësi nga droga, luan dhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundraligjshëm të këtyre lëndëve, i cili ku gjen përhapje në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale. Në kushtet kur tek ne ende nuk janë përcaktuar, me ligj të posaçëm apo me akte nënligjore, rastet e përdorimit të lëndëve narkotike dhe psikotrope “në përputhje me ligjin dhe jo në kapërcim të tyre” (nevojë kjo për të cilën Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, diktohet nga vetë mënyra se si është formuluar dispozita e sipërmendur), përcaktimi si më sipër i nocionit juridiko-penal “në doza të vogla” shërben edhe për ngushtimin, në një masë të arsyeshme, të hapësirave, shfrytëzimi i të cilave, në forma të padrejta, nga keqbërësit, do të ndikonte në shmangien pa të drejtë nga përgjegjësia penale të përdoruesve të lëndëve narkotike dhe psikotrope, të cilët shpesh konstatohet se janë edhe shpërndarës të këtyre lëndëve.

Për shkak të njohurive të posaçme që kerkohen në fushën e toksikologjisë, gjykata për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak duhet të therrase në çdo rast specialiste të fushës, si toksikologe apo mjekë terapiste, mendimi shkencor i të cileve do të shërbejë si njeri prej kritereve ku ajo do të mbështetë arsyetimin e vendimit të saj.

Por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, gjykata duhet të mbështetet edhe në kriterin tjetër, me të cilin lidhet ngushtësisht ai i pari, kriter ky, që konkretizohet nëpërmjet sqarimit të rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi konkret (pikërisht në momentin e gjetjes së saj tek ose pranë tij), nëpërmjet zbatimit të kërkesave ligjore të Kodit të Procedurës Penale që vlejnë për realizimin me sukses të procesit të të provuarit, në përgjithësi.

Bazuar në sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se: **Përdoruesi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, qoftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj në një nga format që parashikon neni 283/1 i K.Penal, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Çmojnë gjithashtu se, përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të K.Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë, etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret-mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope.**

Duke i dhënë kuptimin, si më sipër, togfjalëshit “për përdorim vetjak dhe në doza të vogla”, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në këtë mënyrë, jo vetëm që gjen zbatim të drejtë dispozita e nenit 283 të K.Penal që e përmban atë, por, në të njëjtën kohë, japin edhe kontributin e tyre në drejtim të kuptimit jo si një e drejtë e pakushtëzuar të përjashtimit të përdoruesve në sasira relativisht të vogla të lëndëve narkotike e psikotrope nga përgjegjësia penale. E kundërta do t’u krijonte hapësira ligjore dhe mundësi praktike më të shumta individëve, të cilët, të kamufluar pas termit formalo-juridik “doza të vogla”, t’i shmangeshin, pa të drejtë, përgjegjësisë penale, për mbajtjen e tyre.

Bazuar ne arsyetimin e mesiperm, referuar akteve dhe perfundimeve te gjykates ne çeshtjen ne shqyrtim, rezulton se i gjykuari Emiljano Zarellari, ne momentin qe eshte arrestuar nga policia ka patur ne posedim 1.9 gram lende narkotike te llojit heroine, te ndare ne gjashte paketa me afersisht 0.31 gram, secila. Sipas perfundimeve te eksperteve, sasia prej 1.9 gram e kesaj lende sherben per perdorim ditor per te gjykuarin, duke krahasuar nivelin e lendes narkotike qe atij i eshte gjendur ne analizen e urines. Por sipas mendimit te eksperteve, e gjithë kjo sasi nuk eshte vetem per nje perdorim, por per disa te tilla dhe gjate gjithë dites, duke bere keshtu te kuptohet se, Emiljano Zarellari ka patur ne dispozicion, ne momentin e ndalimit, disa doza te vogla dhe per disa perdorime gjate 24 oreve. Ky fakt, referuar interpretimit te dispozites se nenit 283/1 te K.Penal dhe te unifikuar sipas ketij vendimi te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, çon ne perfundimin se Emiljano Zarellari e ka kryer vepren penale te mbajtjes se lendeve narkotike, sikurse ka pranuar Gjykata e Apelit Vlore ne vendimin e saj, per shkak se ai ka tejkaluar dozen e vogel te mbajtjes per perdorim, qe parashikon dispozita e nenit 283/1 te K.Penal.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 438 e 441/a të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Lënien në fuqi të vendimit nr.517, datë 26.12.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Unifikimin e praktikës gjyqesore sikurse percaktohet ne kete vendim.

Dergimin per botim ne Fletoren Zyrtare te ketij vendimi qe njehson praktiken gjyqesore.

Tirane, me 27.03.2008

**Nr.2/2 i Regj.Themeltar
Nr.1 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykares se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Kristaq Ngjela	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Evjeni Sinojmeri	Anetare
Agron Lamaj	Anetar
Perikli Zaharia	Anetar
Irma Bala	Anetare
Shpresa Beçaj	Anetare
Besnik Imeraj	Anetar
Ardian Dvorani	Anetar
Gani Dizdari	Anetar
Fatos Lulo	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 25.01.2007, moren ne shqyrtim çeshtjen penale me nr.2/2,
me:

KËRKUES: PROKURORIA PRANE GJYKATES SE
SHKALLES SE PARE PER KRIMET E
RENDA TIRANE, perfaqesuar nga prokurori Artur
Selmani

KUNDRA: PERSONIT NEN HETIM XHEVDET TROPLINI,
perfaqesuar nga avokati Skender Demiraj

PERSONA TË TRETË: SHEFQET TROPLINI, LULE TROPLINI,
MAJLINDA TROPLINI, te perfaqesuar nga avokati
Skender Demiraj.

OBJEKTI:

Sekuestrim i pasurive:
Objektet e ish Ndermarrjes se Rritjes
dhe Zenies se Peshkut Durres
me sipërfaqe te pergjitheshme prej 9.900 m2,
vlerat monetare prej 23.726.600 Leke, 20.505 Euro
dhe 203 Dollare amerikane.
Baza Ligjore: Nenet 7 dhe 13 te Ligjit nr.9284, date 30.09.2004
“Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar”.

Gjykata e shkalles se pare per Krime te Renda Tirane, me vendimin nr.39, datë 12.06.2006 ka vendosur:

Vendosjen e mases se sekuestros mbi pasurite e personit nen hetim Xhevdet Troplini si me poshte:

Pasuria e Paluajteshme, ndodhur ne Zonen Kadastrale nr.8517, me n.147/1 pasurie, me adrese ne Spitalle Durres, ish “Ndermarrja e Rritjes dhe Zenies se Peshkut” Durres, me objektet qe ndodhen ne te me siperfaqe totale 9900 m2, nga te cilat 1850 m2 jane nen objekt dhe 8050 m2 truall i lire, me kufizime: Veri - pasuria nr.147/12, lindje - pasuria nr.217, jugu - pasuria nr.238/1, perendim - pasuria nr.147/12.

Sasia ne vlere monetare prej 23.726.600 (njezet e tre milion e shtateqind e njezet e gjashte mije e gjashteqind) leke, 20.505 (njezet mije e peseqind e pese) euro, 203 (dyqind e tre) dollare amerikane.

Per administrimin dhe perdorimin e kesaj pasurie caktohet agjensia per administrimin e pasurive te sekuestruara dhe te konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane”.

Gjykata e Apelit per Krime te Renda Tirane, me vendimin nr.37, date 10.07.2006 ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit nr.39, date 12.06.2006 te Gjykates se shkalles se pare Per Krime te Renda Tirane.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs personi nen hetim Xhevdet Troplini, duke kerkuar prishjen e ketij vendimi dhe duke e gjykuar çeshtjen ne fakt te vendoset rrezimi i kerkeses se prokurorit per sekuestrimin e pasurise, duke parashtuar keto shkaqe:

Shkelje te ligjit procedural:

- Ligji ku mbeshtetet prokurori dhe dy gjykatat eshte ligji nr.9284, date 30.09.2004 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar”. Prokurori duhej t`i referohej nenit 35 te K.Pr.Civile, ku percaktohet se objekti mbi 10 milion leke gjykohet nga tre gjyqtare. Prandaj, perberja e gjykates per gjykimin e kesaj çeshtje eshte ne kundershtrim me ligjen, pasi ligji nr.9284, date 30.09.2004 nuk te referon tek K.Pr.Penale, por tek K.Pr.Civile. Çeshtja duhet te gjykohej me 5 gjyqtare.

Shkelje te ligjit material:

- Gjykates iu paraqiten te gjithë dokumentat zyrtare se familja Troplini eshte nje familje bujqesore qe nga viti 1992. Ne i kerkuam gjykates se shkalles se pare dhe prokurorit qe te bente verifikimin ne vend te kesaj pasurie. Organet e pushtetit vendor mbi kerkesen tone verifikuan ne vend pasurine e kesaj familje ku rezultoi ekzistenca e familjes bujqesore.
- Meqenese e gjithë pasuria e familjes Troplini eshte prone e familjes bujqesore sipas nenit 207 e 222 vijues te K.Civil, nuk eshte i mbeshtetur ne ligj dhe prova perfundimi i gjykates se mjetet monetare te gjetura ne banese jane te Xhevdet Troplinit. Ne ate banese banojne edhe Shefqeti, Lulja, Majlinda dhe 2 femijet e tij.

- Gjykata e Apelit per Krime te Renda, ne mbrojtje te vendimit te gjykates se shkalles se pare, mundohet te interpretoje nenin 13 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, duke arsyetuar se prokurori mund t'i kerkoje gjykates te sekuestroje çdo pasuri te personave qe kane lidhje gjaku e krushqie me personin nen hetim, pavaresisht se pasuria e tyre eshte vene ne rruge krejt te ligjshme dhe nuk ka asnje lidhje me krimin.

Kundër këtij vendimi kane paraqitur rekurs personat e trete, duke kerkuar prishjen e ketij vendimi dhe duke e gjykuar çeshtjen ne fakt te vendoset rrezimi i kerkeses se prokurorit per sekuestrimin e pasurise, duke parashtruar keto shkaqe:

- Kerkesa e prokurorit per venien ne sekuestro eshte per objekte me vlere mbi 35 milion leke, prandaj kompetente per ta gjykuar nuk eshte gjyqtari, por gjykata me trup gjykues.
- Familja Troplini eshte familje bujqesore qe nga viti 1992 me mbi 15 krere lope, mbi 300 krere dele, mbi 1000 krere pula, te gjitha keto te provuara me dokumenta shkresore. E gjithë kjo pasuri na perket te gjithëve dhe jo vetem personit nen hetim Xhevdet Troplini. Edhe objektet e sekuestruara ish Ndermarrja e Peshkimit Durres jane pasuri e familjes tone bujqesore, pasi jane blere ne vitin 2002 dhe paguar me keste duke shitur nga pasuria jone, te vertetuara me dokumenta zyrtare.
- Pasuria e familjes nuk rrjedh nga burime te kundraligjshme. Gjykata shprehet se edhe vlerat monetare jane te personit nen hetim Xhevdet Troplinit. Por ato nuk kane emer, ndonese jane gjetur ne banese. Nese ky person eshte marre me veprimtari kriminale, te identifikohet pasuria e tij e lidhur me krimin dhe te ndahet nga ajo qe i perket familjes bujqesore.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ne seancen gjyqesore te dates 25.10.2006, vendosi ta kaloje çeshtjen per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara, per te unifikuar praktiken gjyqesore lidhur me sa poshte:

1. Te sqarohet dhe te interpretohet kuptimi i nenit 4, pika 3 dhe nenit 28, pika 1 te Ligjit nr.9284, date 30.09.2004 "Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar". Sipas ketij ligji dhe, më posacerisht, ne kuptim e zbatim te dispozitave te mesiperme, cila do te jete gjykata kompetente per hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore te sekuestrimit dhe konfiskimit te pasurive: gjykata penale per krime te renda, duke hetuar e gjykuar çeshtjen sipas rregullave te procedures civile, apo eshte gjykata civile. Nese eshte Gjykata e Krimeve te Renda, a mund te veproje si gjykate civile? Po keshtu, nese ky gjykim do te jete ne kompetence te Gjykates per Krime te Renda, a do te gjykohet ceshtja me nje gjyqtar, ne baze te nenit 13 pika 3 paragrafi "2" te K.Pr.Penale, si nje kerkese e prokurorit e bere ne fazen e hetimit paraprak, apo do te gjykohet ne baze te kriterëve ligjore te percaktuara nga neni 35/2 te K.Pr.Civile.

2. Cili eshte kuptimi dhe interpretimi i neneve 7 e 10 te ketij ligji, nese sekuestrimi paraprak (neni 7) dhe sekuestrimi (neni 10) jane faza te domosdoshme te nje procesi qe i paraprin konfiskimit, apo jane masa te shkeputura nga njera tjetra dhe si te tilla veprojnë ne menyre te pavarur.

3. Nese konfiskimi behet vetem ne rastet pasi me pare eshte vendosur pezullimi dhe sekuestro (neni 9 e 10), apo edhe ne rastet kur me pare eshte vendosur vetem sekuestro paraprake, neni 7.

4. Cili eshte kuptimi i "pezullimit te perkohshem te administrimit dhe disponimit te pasurive" (neni 9) dhe lidhja e tij me sekuestrimin (neni 10). Nese jane hallka te nje procesi qe

duhen zbatuar patjetër për të arritur tek konfiskimi, apo mund të veprojnë pavaresisht nga njëra tjetra.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relativitetin e çështjes nga gjyqtarët Gani Dizdari dhe Thimjo Kondi; prokurorin Artur Selmani, që kerkoi lenien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Renda; mbrojtësin e personit nën hetim Xhevdet Troplini dhe të personave të tretë, avokatin Skender Demiraj, i cili kërkojë prishjen e vendimeve të dhëna në të dy shkallët e gjykimit dhe duke e gjykuar çështjen në fakt rrezimitin e kërkesës së prokurorit për sekuestrimin e pasurisë; dhe pasi e bisedoi çështjen në teresi,

V Ë R E J N Ë

Vendimi nr.37, datë 10.07.2006 i Gjykatës së Apelit për Krime të Renda Tirane, është dhënë në respektim të ligjit, prandaj duhet të mbetet në fuqi.

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e shkallës së parë për Krimet e Renda dhe Gjykatën e Apelit për Krimet e Renda, rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Me datën 14.10.2005 Prokuroria pranë Gjykatës së Barit Itali ka përcjelle në Prokurorinë e Përgjithshme kopjen e dosjes penale që lidhet me veprimtarinë kriminale të shtetasit shqiptar Xhevdet Troplini. Sipas akteve të vëna në dispozicion nga autoritetet italiane, rezultonte që ky shtetas në bashkëpunim me të tjerë të këne trafikuar në drejtim të Italisë lende narkotike të tipit heroine në sasinë prej 11 kg, e cila është sekuestruar nga autoritetet italiane me datë 08.03.2004.

Mbi këto baze Prokuroria e Krimeve të Renda, me vendimin e saj të datës 02.11.2005, ka filluar procedimin penal nr.88, në ngarkim të shtetasit Xhevdet Troplini, duke e akuzuar për veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi 3 i Kodit Penal. Në vijim të procedimit penal, ndaj personit nën hetim Xhevdet Troplini, në datën 17.01.2006, gjykata ka vendosur masën e sigurimit arrest në burg, nderkohe që po në këto date, pas kryerjes së kontrollit në banesën e tij, i janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 23.726.600 leke, 20.505 euro dhe 203 dollare amerikane.

Në rrethanat e tilla, nderkohe që vijon procedimi penal, duke e konsideruar personin nën hetim Xhevdet Troplini edhe si "person të dyshuar", subjekt të nenit 3, pika 1 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", Prokuroria e Krimeve të Renda ka filluar e zhvilluar verifikimin dhe hetimin mbi pasuritë e disponuara prej tij sipas kriterëve dhe procedurave të këtij ligji.

Fillimisht, prokurori ka kërkuar para gjykatës sekuestrimin paraprak të një pasurie të paluajtshme që rezultoi të jetë privatizuar dhe në pronësi të personit nën hetim Xhevdet Troplini, e cila përbehet nga objekte të ish Ndermarrjes së Rritjes dhe Zenies së Peshkut Durrës, me një sipërfaqe të përgjithshme 9900 m².

Gjykata e shkallës së parë për Krimet e Renda, me vendimin nr.39, datë 10.04.2006 ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit dhe ka vendosur sekuestrimin paraprak të kësaj pasurie të paluajtshme, duke caktuar kryesisht edhe datën e seances gjyqësore (26.04.2006) për shqyrtimin e vendosjes së masës së sekuestrimit, sipas ligjit të lartpërmendur.

Gjate shqyrtimit të çështjes në këto seance gjyqësore, prokurori i ka kërkuar gjykatës jo vetëm që të konfirmojë sekuestrimin paraprak, por të vendosë masën e sekuestrimit mbi pasuritë e paluajtshme, objektet e ish Ndermarrjes së Rritjes dhe Zenies së Peshkut Durrës, por edhe sekuestrimin, sipas procedurave dhe standarteve të këtij ligji, të vlerave monetare prej 23.726.600

leke, 20.505 Euro e 203 Dollare amerikane, mbi te cilat, ne procedimin penal ishte vendosur me pare masa e sekuestrimit te tyre si prova materiale.

Gjykata e shkalles se pare per Krimet e Renda, me vendimin nr.39, date 12.06.2006, ka vendosur te pranoje kerkesat e prokurorit, duke sekuestruar pasurite e lartpermendura. Gjykata e Apelit per Krimet e Renda, me vendimin nr.37, date 10.07.2006, ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare duke cmuar te pambeshtetura ne prova dhe ne ligj pretendimet e personit nen hetim Xhevdet Troplini dhe ato te personave te trete te parashtruara ne ankimet perkatese drejtuar kesaj gjykate.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit per Krimet e Renda Tirane, kane ushtruar rekurs si person nen hetim Xhevdet Troplini, ashtu edhe personat e trete, duke i parashtruar Kolegjit Penal te Gjykates se Larte pretendime se gjykatat kane zbatuar ne menyre te gabuar ligjin material dhe procedural.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, pasi ka shqyrtuar ceshtjen, ne seancen gjyqesore te dates 25.10.2006 ka vendosur ta kaloje ceshtjen per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara, per te unifikuar praktiken gjyqesore.

Pasi shqyrtuan ceshtjen, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte i gjejne te pambeshtetura ne ligj pretendimet e parashtruara ne rekurs nga personi nen hetim dhe ate te personave te trete dhe vleresojne te drejte e te bazuar ne ligj vendimin e Gjykates se Apelit se Krimeve te Renda.

Sipas rekursit, referuar nenit 4, pika 3 dhe nenit 28 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, ligji procedural i zbatueshem ne kete gjykim eshte ai procedural civil, ne te gjitha aspektet e tij, perfshire kompetencen e gjykates civile per gjykimin e ceshtjes, perberjen e detyrueshme kolegjiale te trupes gjykuese (sipas nenit 35 te K.Pr.Civile). Por edhe nese eshte gjykata penale, perseri perberja duhet te jete kolegjiale, pra nga gjykata e krimeve te renda gjykimi duhet te behej me 5 gjyqtare.

Lidhur me kete pretendim, te ngritur edhe ne ankim, Gjykata e Apelit per Krimet e Renda ka arsyetuar se nuk jemi perpara nje padie civile, por nje kerkese per vendosje te nje mase provizore sekuestro. Sipas nenit 13 te K.Pr.Penale, gjykata e krimeve te renda i shqyrton kerkesat e prokurorit me gjyqtar te vetem, sikurse eshte edhe kjo kerkese e prokurorit e bere ne fazen e hetimit paraprak. Prandaj edhe Gjykata e Apelit per Krimet e Renda i gjykon keto kerkesa me tre gjyqtare.

Ne kete kontekst, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka shtruar si ceshtje per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara, per efekte te unifikimit te praktikës gjyqesore, sqarimin dhe interpretimin e kuptimit te nenit 4, pika 3 dhe nenit 28, pika 1 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se, pavaresisht nga formulimi dhe gjuha e perdorur, ne permbajtje pika 3 e nenit 4 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004 perben nje norme me karakter rregullues te pergjithshem qe duhet kuptuar e interpretuar jo ne menyre literale, por sipas qellimit dhe vullnetit te ligjvenesit, duke marre parasysh edhe permbajtjen ne teresi te dispozitave te ketij ligji.

Ky ligj lidhet me zbatimin e nje rregjimi juridik te posacem per sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive qe burojne apo lidhen me disa nga fenomenet me te renda kriminale, me nje lloj procedimi te posacem te natyres parandaluese dhe goditese ndaj ketyre fenomeneve. Ndonese nuk eshte procedim penal, me ane te te cilit caktohen rregulla per menyren e ushtrimit te ndjekjes penale, per hetimin dhe gjykimin e veprave penale, etj., ne cdo rast, procedimi parandalues eshte i lidhur me ekzistencen dhe perfundimet e atij penal.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin se, ne kuptim dhe interpretim te pikes 3 te nenit 4, pervec parimeve dhe rregullimeve te parashikuara shprehimisht ne kete ligj, hetimi dhe gjykimi parandalues mbeshtetet, sipas referimeve konkrete, apo sipas rastit,

edhe ne norma te procedimit administrativ, civil dhe penal qe lidhen apo i sherbejne zhvillimit te nje procesi te rregullt ligjor ne procedimin parandalues. Pra si rregull zbatohen kriteret, procedurat, kompetencat e parashikuara apo te referuara nga ky ligj dhe, si plotesim e perjashtim, ato te dispozitave te tjera ligjore. Ndonese ky eshte nje gjykim i vecante, thelbesore eshte qe nepermjet njohjes e zbatimit te ketyre dispozitave te garantohet zhvillimi i nje procesi te rregullt ligjor.

Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara cmojne se ne pajtim me qellimin dhe rregullimin e pergjithshem te dispozites se nenit 4, pika 3 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, neni 28 eshte pikerisht njera nga dispozitat e ketij ligji qe ben nje referim konkret per zbatimin ne gjykimin parandalues te disa prej rregullave te parashikuara nga K.Pr.Civile, vetem lidhur me disa elemente te permbajtjes dhe procedures se paraqitjes se ankimit ndaj vendimit te Gjykates se shkalles se pare te Krimeve te Renda, si dhe per aspekte te caktuara te shqyrtimit te ceshtjes ne shkalle te dyte nga Gjykata e Apelit per Krime te Renda (neni 424/3 i K.Pr.Penale).

Keto rregulla procedurale civile jane te zbatueshme ne gjykimin parandalues vetem ne shkalle te dyte dhe vetem per aq sa jane te pajtueshme e ne funksion me natyren dhe qellimin e ketij lloj procedimi. Pavec kesaj, “afatet” dhe “kushtet e gjykimit” sipas K.Pr.Civile, te treguara ne piken 1 te nenit 28 te ligjit, gjejne zbatim ateher kur nuk parashikohet ndryshe ne kete ligj.

Prandaj ne kete dispozite parashikohet, ne menyre origjinale, shprehimisht, se: “ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit”, pra qofte i ndermjetem (sekuestro apo pezullimi i administrimit), qofte perfundimtar (konfiskimi). Ky rregullim perjashton zbatimin e parimit te pergjithshem te pezullimit te ekzekutimit te nje vendimi themeli ne gjykimin civil (neni 449 i K.Pr.Civile), apo ne ate penal (neni 417 i K.Pr.Penale), duke aplikuar ne cdo rast vetem rregullin e mospezullimit te ekzekutimit sikurse ndodh me vendimet e ndermjetme (neni 471 i K.Pr.Civile), apo te mases se sigurimit (neni 276 i K.Pr.Penale).

Po keshtu, nisur nga natyra, qellimi, objekti i ndryshem i hetimit e gjykimit krahasuar me procedimin penal, si dhe nga dispozitat e neneve 4/3 dhe 28 te ligjit, ne gjykimin parandalues nuk gjen zbatim parimi i mosrëndimit te pozites se personit (te dyshuar apo te trete) qe ka paraqitur ankimin (neni 425/3 i K.Pr.Penale), parimi procedural penal per shqyrtimin ne teresi te ceshtjes ne apel pa u kufizuar vetem ne shkaqet e ankimit (neni 425/1 i K.Pr.Penale). Perkundrazi, gjykata e apelit, ne gjykimin parandalues, i jep pergjigje vetem ceshtjeve te ngritura ne ankim (neni 6, 20, 28, 29 i K.Pr.Civile), afati i paraqitjes se ankimit eshte 15 dite dhe jo 10 dite si ne procedimin penal, etj.

Ne rekurs, personi nen hetim dhe personat e tjere kane ngritur pretendimin se ceshtja objekt gjykimi eshte ne juridiksionin civil dhe ne kompetencen e gjykates civile, pretendim i cili nuk eshte pranuar si i mbeshetur ne ligj nga Gjykata e Apelit per Krime te Renda.

Njekohesisht, Kolegjeve te Bashkuara i jane parashtruar nga Kolegji Penal i Gjykates se Larte per shqyrtim per efekt te unifikimit te praktikës gjyqesore ceshtja se cila eshte gjykata kompetente per hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore te sekuestrimit dhe konfiskimit te pasurive: gjykata civile apo gjykata penale per krime te renda, duke hetuar e gjykuar ceshtjen sipas rregullave te procedures civile. Nese eshte Gjykata e Krimeve te Renda a mund te veproje ajo si gjykate civile?

Gjykata civile nuk mund te kete juridiksion dhe kompetence per gjykimin e masave parandaluese sipas ligjit nr.9284, date 30.09.2004. Ky ligj nuk ka per objekt ceshtje te se drejtes civile, konflikte mbi marredheniet pasurore e personale jopasurore mes subjekteve te se drejtes (civile), pra nuk trajton zgjidhjen e mosmarreveshjeve civile, administrative, etj., ndermjet tyre, ne kuptim te nenit 1 dhe 36 te K.Pr.Civile. Ky ligj synon zbatimin e masave te natyres parandaluese e goditese qe drejtohen ndaj pasurise se pajustificuar ligjerisht te nje kategorie te posacme te

personave shoqerisht te rrezikshem, per shkak te pjesemarrjes ne veprimtari kriminale, te njohura edhe per konvencion si fenomene te krimit te organizuar.

Kolegjet e Bashkuara vleresojne se, masat parandaluese pasurore te parashikuara nga ky ligj, ne parim, mund te gjejne zbatim pasi ka filluar nje procedim penal, ashtu edhe pas perfundimit te tij. Zbatimi i tyre eshte i lidhur me ekzistencen e te dhenave te mjaftueshme, pra te dyshimit te arsyeshem per kryerjen nga personi i dyshuar te njerës prej veprave penale te treguara ne nenin 3 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, apo edhe me vertetimin e fajesise se tij per kryerjen e ketyre veprave penale. Pra, keto masa zbatohen ndaj pasurise se nje personi te dyshuar, i cili, si rregull, i eshte nenshtuar apo i nenshtrohet hetimit a gjykimit per kryerjen e ketyre veprave penale. Madje, ne keto raste, kur ka te dhena te bazuara per kryerjen e nje veprimtarie kriminale - te veprave penale te lartpermendura - masat parandaluese pasurore gjejne zbatim jo vetem ndaj personit te dyshuar, por edhe ndaj familjareve, te afermeve e personave te tjere te trete te lidhur me te, sipas kritereve dhe kushteve te caktuara ne kete ligj te posacem.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin se, duke qene se masat parandaluese pasurore jane te lidhura me dyshimin per kryerjen nga personi te nje vepre penale (neni 3, pika 1 e ligjit nr.9284, date 30.09.2004), me dyshimin dhe prezumimin per zoterimin e prejardhjen e paligjshme te pasurise per shkak e ne lidhje me kete veprimtari kriminale, si dhe me ekzistencen e nje procedimi penal, me ecurine dhe perfundimet e tij, atehere edhe ne procedimin parandalues hetimi dhe gjykimi i ceshtjes se masave parandaluese pasurore jane kompetence e gjykates penale.

Ne gjykimin parandalues krahas dispozitave te posacme te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, njekohesisht, gjejne zbatim edhe norma te caktuara te ligjit procedural civil dhe te atij procedural penal. Prandaj, ne kete kuptim, gjykimin e masave preventive sipas ketij ligji nuk mund ta zhvilloje gjykata civile, por vetem ajo penale.

Nga ana tjetër, ndonese nuk tregohet ne menyre te shprehur gjykata penale dhe prokuroria perkatese kompetente, ligji nr.9284, date 30.09.2004 nuk ndalon qe shqyrtimin e kerkesave te prokurorit per vendosjen e masave parandaluese te jene ne kompetence te gjykates se krimeve te renda. **Per sa kohe ne ligj nuk parashikohet ndryshe, atehere per gjykimin e ketyre masave do te jete kompetente gjykata, e cila, sipas K.Pr.Penale (neni 75/a), ka ne kompetence gjykimin e krimeve te renda, si dhe te atyre veprave penale (neni 3, pika 1 e Ligjit) per te cilat gjejne zbatim masat parandaluese te parashikuara nga ligji nr.9284, date 30.09.2004. Pra, kompetente per gjykimin e kerkeses per vendosjen e masave parandaluese eshte gjykata e krimeve te renda.**

Ne rekursin e personit nen hetim dhe personave te tjere parashtrohet pretendimi se perberja e gjykatave ne te dy shkallet e gjykimit eshte ne kundërshtim me ligjin, sepse si gjykate civile duhet te shqyrtonte me trup gjykues te perbere nga 3 gjyqtare ne shkalle te pare dhe me pese gjyqtare ne shkalle te dyte.

Kolegji Penal, per efekte te unifikimit te praktikës gjyqesore ka shtruar perpara Kolegjeve te Bashkuara pyetjet se, nese ky gjykim eshte ne kompetence te Gjykates per Krime te Renda, a do te gjykohet me nje gjyqtar ne baze te nenit 13, pika 3, paragrafi "2" te K.Pr.Penale, si nje kerkese e prokurorit e bere ne fazen e hetimit paraprak, apo gjejne zbatim kriteret ligjore per perberjen kolegjiale te gjykates te percaktuara nga neni 35/2 i K.Pr.Civile.

Gjykata e Apelit per Krimet e Renda, per kete ceshtje arsyeton se: "Neni 35/2 i K.Pr.Civile parashikon rastet kur padite gjykohen me trup gjyqesor kolegjial ne shkalle te pare. Por, ceshtja objekt gjykimi nuk eshte padi, por kerkese per vendosje te nje mase provizore sequestro. Ndersa sipas nenit 13 te K.Pr.Penale, gjykata e krimeve te renda i shqyrton kerkesat e prokurorit me

gjqtar te vetem, sikurse eshte kjo kerkese e prokurorit e bere ne fazen e hetimit paraprak. Prandaj edhe gjykata e apelit per krimet e renda i gjykon keto kerkesa me tre gjyqtare”.

Kolegjet e Bashkuara, per te arritur ne perfundimet e tyre mbi kete pretendim dhe per qellime te njehsimit te praktikës gjyqesore, cmojne te nevojshme interpretimin sistematik te dispozitave te lartpermndura ne lidhje me qellimin, permbajtjen dhe zbatimin ne teresi te dispozitave te ligjit nr.9284, date 30.09.2004 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar”.

Sipas nenit 13 te K.Pr.Penale, gjykata penale gjykon me trupe kolegjiale pervec kur, shprehimisht, ligji kerkon nje perberje me trup gjykues monokratik. E kunderta sanksionohet ne gjykimin civil, ku gjykata e shkalles se pare shqyrton ceshtjen me gjyqtar te vetem pervec kur ne K.Pr.Civile (neni 35), apo ne ligje te vecanta parashikohet shprehimisht gjykimi me trup kolegjial.

Ndersa ne gjykimin parandalues, persa kohe ne ligj nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, shqyrtimi i ceshtjes ne gjykatën e shkalles se pare per krimet e renda behet me trup gjykues monokratik, ndersa ne shkalle te dyte me trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare.

Gjykimi parandalues nuk kushtezohet nga parimet dhe rregullat e shqyrtimit te kerkesave te paleve gjate hetimeve paraprake (neni 13/2/b i K.Pr.Penale), sepse gjykimi parandalues eshte nje procedim autonom, nuk eshte pjese e ushtrimit te ndjekjes penale, pra nuk eshte as faze hetimesh paraprake e procedimit penal. Ne kete kuptim, megjithese ka zgjidhur drejt ceshtjen, nuk perben nje interpretim te drejte te ligjit arsyetimi i gjykates se apelit qe referon gjykimin e saj ne lidhje me fazen e hetimeve paraprake te procedimit penal. Njekohesisht, procedimi parandalues eshte autonom edhe ne raport me procedimin civil, pasi nuk ka per objekt zgjidhjen e mosmarreshjeve civile. Prandaj perberja e trupit gjykues ne procedimin parandalues nuk mbeshetet, nuk referohet drejtperdrejt, ne nenin 13 te K.Pr.Penale, apo ne nenin 35 te K.Pr.Civile.

Prandaj, **Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin unifikues se gjykimi i kerkesave per vendosjen e masave parandaluese sipas ligjit nr.9284, date 30.09.2004 realizohet ne gjykatën per krimet e renda nga gjyqtari i vetem ne shkalle te pare dhe trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare ne shkalle te dyte.** Kjo perberje e gjykates vleresohet se respekton dhe eshte ne pajtim te plote me standartet per garantimin e nje procesi te rregullt ligjor edhe ne gjykimin parandalues.

Ky perfundim gjen mbeshjetje edhe ne praktiken tone gjyqesore lidhur me shqyrtimin e kerkimeve te vecanta per vendosjen e masave preventive qe drejtohen ndaj pasurise, ne mungesen e parashikimit te shprehur ne ligj per gjykimin e ketyre ceshtjeve me trup kolegjial, pavaresisht nga vlera e pasurise (K.Pr.Civile), apo ne parashikimin e shprehur per shqyrtimin e tyre nga gjyqtari i vetem (K.Pr.Penale).

Gjithashtu, duke qene se, sipas neneve 19 e vijues te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, gjykata e krimeve te renda ka ne kompetence edhe ceshtje qe lidhen me administrimin e sendit te sekuestruar, **Kolegjet e Bashkuara cmojne se nuk perben shkelje te ligjit qe e njejta gjykate te shqyrtoje e vendose si per kerkesat lidhur me masat parandaluese pasurore, ashtu edhe per ato qe kane te bejne me ceshtje te administrimit te pasurive te sekuestruara ne zbatim te ketyre masave, per shkak se vendimet qe jepen lidhur me keto te fundit nuk jane te tilla qe mund te ndikojne ne motivimin ligjor dhe ne fakt te vendimit eventual per konfiskimin e pasurive te sekuestruara.**

Kolegjet e Bashkuara, gjate shqyrtimit te ceshtjes objekt gjykimi, cmuan te vene ne diskutim dhe te shprehen lidhur me ekzistencën dhe respektimin e ligjit persa i perket autonomise dhe lidhjeve eventuale te procedimit parandalues dhe procedimit penal.

Ligji nr.9284, date 30.09.2004 ka per objekt zbatimin e masave parandaluese pasurore ndaj personave te dyshuar per kryerjen e nje kategorie te caktuar veprash penale. Ne kete kuptim,

procedimi parandalues sipas ketij ligji eshte i lidhur domosdoshmerisht me qenien e nje procedimi penal, pavaresisht se ne cilen faze ndodhet ky i fundit, apo nese ka perfunduar.

Masat ndaj pasurise (sekuestrimi, pezullimi i perkohshem i administrimit dhe disponimit, konfiskimi), qe vendosen ne procedimin parandalues nuk mbeshteten, nuk i referohen, nuk jane pjese dhe as nuk i nenshtrohen ndonje procedure vleftesimi ne procedimin penal. Ne kete kuptim, pervec te tjerave, procedimi parandalues vijon ne menyre autonome, pavaresisht nga ecuria e hetimit paraprak apo shkalla e shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes penale, sepse nuk eshte pjese e fazes se hetimeve paraprake ne procedimit penal, nuk eshte nje mase e sigurimit pasuror ne zbatim te neneve 270-276 KPr.Penale.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin se, procedimi parandalues sipas ligjit nr.9284, date 30.09.2004, eshte autonom ne raport me procedimin penal (dhe ate civil). Procedimi preventiv mund te filloje, vazhdoje e perfundoje, si gjate ashtu edhe pas perfundimit te nje procedimi penal. Nga ana tjetere, duke qene procedime autonome ato nuk jane procedime te tilla qe perjashtojne fillimin, vazhdimin dhe perfundimin e njera tjetres, persa kohe pretendohet a vertetohet se ka nje person te dyshuar ne kuptim te ligjit nr.9284, date 30.09.2004 per kryerjen e nje vepre penale, ndaj te cilit eshte duke u zhvilluar apo ka perfunduar nje procedim penal.

Autonomia e procedimit penal dhe atij parandalues, rezulton edhe nga permbajtja e dispozites se nenit 27 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004. Kjo dispozite nder te tjera konfirmon edhe faktin qe keto dy procedime nuk e perjashtojne njera-tjetren, perkundrazi. **Nga dispozita e nenit 27 rezulton se procedimi penal ka perparesi, perderisa masat perkatese pasurore te vendosura gjate gjykimit parandalues mbeten te pezulluara, nuk ekzekutohen, derisa te perfundoje procedimi penal dhe gjykata penale te shprehet, ndermjet te tjerave, edhe per masat e sigurimit pasuror te vendosura ne ate gjykim penal.**

Ne zbatim te nenit 27, masat pasurore te vendosura ne procedimin parandalues shuhen vetvetiu vetem nese gjykata penale vendos konfiskimin per te njejtat pasuri. Por keto masa nuk shuhen ne kete menyre nese gjykata e procedimit penal nuk vendos konfiskimin, apo vendos heqjen e masave te sigurimit pasuror. Ato mbeten ne fuqi, mund te kthehen ne masa konfiskimi, apo mund te rishikohen pas shqyrtimit autonom te ceshtjes nga gjykata e procedimit parandalues, e cila cmon ne teresi, te gjitha rrethanat dhe provat e paraqitura nga subjektet pjesemarres ne gjykimin parandalues, pervec atyre qe kane te bejne me cilesine e personit te dyshuar, te rezultuara ne perfundimet e arritura nga gjykata e procedimit penal lidhur me dhenien e nje vendimi denimi, pafajesie, a pushimi te ceshtjes ne ngarkim te personit te dyshuar.

Ne rekurs, personi i dyshuar (nen hetim) dhe personat e tjere kane pretenduar se, ne hetimin dhe gjykimin e ceshtjes, prokurori dhe gjykata, megjithese kishin detyrimin te vertetonin te kunderten, nuk kane bere verifikimin e pretendimeve te tyre lidhur me origjinen e ligjshme te pasurise se sekuestruar.

Lidhur me kete pretendim, gjykatat e shkalles se pare dhe ajo e apelit per krimet e renda kane arsyetuar se, sipas nenit 13 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, personi ne hetim dhe personat e tjera kane barren e proves te provojne se pasuria e tyre eshte vene ne menyre te ligjshme. Te ardhurat e tyre, edhe sipas akteve e provave qe kane paraqitur vete ne gjykim, jane shume me te ulta sesa vlera e pasurive te vendosura nen masen e sekuestrimit. Pra, ata nuk provuan se pasurite objekt gjykimi u pergjigjen te ardhurave te deklaruar.

Ne kete kontekst, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte konstatojne se ne ligjin nr.9284, date 30.09.2004 parashikohen rregulla te posacme mbi kompetencat dhe proceduren, te drejtat dhe detyrimet e pjesemarresve ne procedimin parandalues, ndermjet te cilave evidentohet percaktimi i bares se proves se personave te dyshuar dhe personave te tjere lidhur me justifikimin e origjines se ligjshme te pasurise se tyre.

Per efekte te gjykimit parandalues, nese prokurori arrin te vertetoje se ndaj nje personi ka nje procedim penal, masa sigurimi, apo nje vendim denimi per njerin nga veprat penale te parashikuara nga neni 3, pika 1 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, atehere kjo perben prove me vlere te plote per te vertetuar para gjykates “dyshimin e arsyeshem te bazuar ne prova” per kryerjen e ketyre veprave penale, pra subjekti i procedimit penal ka edhe cilesite e “personit te dyshuar” (nenet 1, 2, 3 te ligjit).

Sa me siper sjellin Kolegjet e Bashkuara ne perfundimet se i perket prokurorit barra e proves per te vertetuar ne gjykate se nje person ne hetim, apo i denuar permbush kushtet per t’u cilesuar si “person i dyshuar” per kryerjen e veprave penale te parashikuara nga pika 1 e nenit 3 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004

Ne procedimin parandalues mjafton te vertetohet dyshimi i arsyeshem per qenien si “person i dyshuar”, mundesia e zoterimit te pasurive prej tij dhe mos justifikimi i prejardhjes se ligjshme te ketyre pasurive ne raport me veprimtarine, sjelljen, te ardhurat dhe menyren e jeteses, me kohen dhe llojin e vepres qe i atribuohet, apo vertetohet se ka kryer personi i dyshuar. **Por ne gjykimin dhe dhenien e vendimit per vendosjen e masave pasurore, gjykata nuk mund t’i hyje bazueshmerise se perfundimeve qe jane arritur ne procedimin penal lidhur me ato elemente qe ne fakt justifikojne vendosjen e mases preventive pasurore, vecanerisht persa i perket kualifikimit te personit si "person i dyshuar".**

Ne kete aspekt, ne objektin e hetimit dhe gjykimit preventiv eshte vertetimi i "dyshimit te arsyeshem" per pjesemarrje, kryerje te veprave penale sipas nenit 3 te ligjit nr.9284, por jo edhe vertetimi lidhjes shkakësore te veprimeve te tij me pasojat e ardhura per efekt te pergjegjesise penale te tij. Ndersa procedimi penal eshte i lidhur me nje fakt te caktuar qe perben, apo i atribuon personit kryerjen e nje veprave penale, procedimi preventiv eshte i lidhur me vleresimin e rrethanave, rrezikshmerise se nje personi te dyshuar, qe shfaqet edhe ne veprimtari, sjellje e qendrime te cilat jo domosdoshmerisht jane te lidhura me pergjegjesine penale, domethene perbejne veprave penale.

Prandaj gjykata preventive, per qellime te vendosjes se mases parandaluese pasurore, duhet te shqyrtoje dhe vleresoje ne menyre autonome te gjitha faktet, rrethanat, indicjet, etj., per te nxjerre perfundimet e saj mbi elementet qe mbeshtesin ne ligj e ne fakt vendosjen e mases preventive pasurore.

Nga ana tjetere, ne kuptim te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, ne ndryshim nga procedimi penal, prezumohet se pasurite e personit te dyshuar kane nje lidhje me pjesemarrjen, kryerjen e veprave penale te parashikuara ne piken 1 te nenit 3 te ketij ligji. **Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijne ne perfundimin se personi i dyshuar (neni 3, pika 1) dhe personat e tjere (neni 3, pika 2 dhe neni 8) kane barren e proves per te justifikuar origjinen e ligjshme te pasurise se tyre, per te provuar mungesen e lidhjes se pasurise me cilesimin si produkte te veprave penale a investim te tyre dhe, vetem per "personat e tjere" te provojne se, jo vetem nga pikepamja formale, por edhe ne fakt, nuk jemi perpara zoterimit ne cdo menyre te ketyre pasurive prej personit te dyshuar.**

Por, per zbatimin e drejte te ligjit, mbeshtetur ne hetimet e kryera, edhe prokurori ka detyrime per te parashtruar kerkime te motivuara dhe prova mbeshtetese perpara gjykates, lidhur me identifikimin e pasurive te personit te dyshuar e te personave te tjere, te tregojne nga ana e tij se ka baze per dyshime te arsyeshme dhe, ne kete menyre te dhena, prova te mjaftueshme per efekte te gjykimit parandalues, se ato nuk jane pasuri te fituara ne rruge te ligjshme, gje qe motivon ekzistencen e prezumimit qe buron nga ligji nr.9284, date 30.09.2004 dhe, si rezultat, kerkesen per zbatimin e masave pasurore te sekuestrimit, pezullimit te perkohshem dhe konfiskimit, duke i kerkuar gjykates t’i kaloje ne kete menyre edhe barren e proves personave te dyshuar dhe personave te tjere (neni 8, neni 13). Nga ana

e saj, gjykata duhet te siguroje zhvillimin e nje procesi te rregullt ligjor, te kryeje nje hetim te gjithanshem dhe te plote, per dhenien e nje vendimi te mbeshtetur ne prova dhe ne ligj.

Ne zbatim te normave materiale e procedurale penale, gjykata qe shqyrton nje ceshtje penale, me dhenien e vendimit te denimit dhe, kur jane rrethanat, edhe ne rast te nje vendimi per pushimin e ceshtjes apo te pafajesise, mund te urdheroje konfiskimin e pasurive. Masa e konfiskimit jepet nese vertetohet se ka nje lidhje shkakesore, logjike e kronologjike, ndermjet pasurise qe konfiskohet dhe vepres penale te kryer.

Ndryshe nga standartet e te provuarit dhe pergjegjesise ne dhenien e nje vendimi penal, perfshire urdherimin per konfiskimin ose jo te sendeve te sekuestruara, ne procedimin parandalues, sipas ligjit nr.9284, date 30.09.2004, vendosja e mases pasurore ka ne themel te saj mundesine, dyshimin e arsyeshem, te mbeshtetur ne te dhena te mjaftueshme qe rezultojne nga teresia e provave te marra dhe te verifikuara gjate shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara vleresojne se ligji ka parashikuar prezumimin qe, per shkak e pasoje te kryerjes se nje veprimtarie kriminale (vepre penale) e cila i atribuohet apo eshte vertetuar kundrejt personit te dyshuar, kemi te bejme me pasuri te cilat lidhen apo jane produkt i veprimtarise kriminale, a perbejne perdorimin e tyre, te zoteruara direkt apo indirekt nga personi i dyshuar, te cilat formalisht, fiktivisht mund te mbahen edhe nga persona te tjere (neni 3, pika 2 dhe neni 8), te fituara ne menyre te paligjshme, pra qe nuk justifikohen ligjerisht dhe qe jane ne shperpjestim vleror me veprimtarine e mundesite ekonomike, me te ardhurat e deklaruar per qellime fiskale, etj., nga ana e ketyre personave.

Pra, ne ndryshim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbeshtetet ne dyshime te arsyeshme, prova te mjaftueshme e prezumime, duke iu ngarkuar personit te dyshuar dhe personave te tjere barra e proves per te vertetuar ligjshmerine, per justifikimin e origjines se pasurise. Ne procedimin parandalues nuk ka vend per vertetimin domosdoshmerisht nga prokurori e gjykata te lidhjes shkakesore, te drejtperdrejte, te dukshme e imediate, logjike e kronologjike, ndermjet pasurise, prejardhjes se saj dhe vepres penale per te cilen se paku ekziston dyshimi i arsyeshem si e kryer nga personi i dyshuar.

Ne rekurs, si personi i dyshuar dhe personat e tjeret kane parashtruar edhe pretendime per zbatim te gabuar te ligjit material, si dhe per cmimin e provave nga gjykata. Sipas tyre eshte e vertete se pasurite objekt i mases se sekuestros jane ne emer te tij, por ato nuk jane produkt i vepres penale, as investim i tyre, por vijne nga puna e ligjshme e tij dhe e familjes. Ish Ndermarrja e Rritjes dhe Zenies se Peshkut eshte blere perpara vitit 2004, kohe kur akuza pretendon se ai ka kryer vepren penale. Pasuria nuk i perket vetem atij, por te gjithë familjes bujqesore. Perverc kesaj presonat e trete pretenduan se ne cdo rast pjeset takuese te tyre nuk duhet te sekuestrohen, sepse, persa i perket se paku pjeses se tyre, ato jane vene ne rruge te ligjshme, perfshire vlerat monetare.

Gjykata e shkalles se pare dhe ajo e Apelit per Krimet e Renda, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te provave dhe pretendimeve te pjesemarresve ne gjykim, kane cmuar dhe arritur ne perfundimin se shtetasi Xhevdet Troplini eshte person nen hetim ne gjendje arresti ne burg ne procedimin penal ne ngarkim te tij per kryerjen e vepres penale te trafikimit te narkotikeve (neni 283/a paragrafi i trete i K.Penal). Kjo veper penale perfshihet ne nenin 3, pika 1/ç te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, prandaj edhe pasurite e rezultuara ne emer te tij duhet t'u nenshtrohen masave te parashikuara nga ky ligj. Po keshtu, personat e trete bejne pjese ne rrethin e personave te dyshuar, ndaj edhe jane subjekte te zbatimit te ligjit.

Gjykatat kane cmuar se nga te gjitha provat shkresore dhe aktet zyrtare rezulton se objektet e ish Ndermarrjes se Peshkimit te jene blere nga personi nen hetim ne vitin 2002 dhe 2003 dhe te jene ne pronesi te tij. Nderkohe, ne procedimin penal jane sekuestruar ne cilesine e proves

materiale ne banesen e personit nen hetim vlera monetare qe, sipas ligjit nr.9284, date 30.09.2004, i nenshtrohen edhe mases se sekuestros ne procedimin parandalues.

Sipas gjykatave, pretendimet e personit ne hetim dhe personit te trete nuk gjejne mbeshtetje ne ligj dhe ne prova, sepse nuk provohet qe kemi te bejme me nje familje bujqesore me tiparet e saj ligjore dhe ekonomike. Nese pasurite do te ishin prone e familjes bujqesore ato do te figuronin ne emer te personit tjetër Shefqet Troplini dhe jo ne emer te personit te dyshuar nen hetim Xhevdet Troplini. Jo vetem ne kete rast por per te gjitha pasurite objekt i sekuestros ne kete gjykim, personi nen hetim dhe personat e tjere nuk provuan se jane te justifikuara me te ardhurat e deklaruarua nder vite deri ne kohen e gjykimit.

Se fundi, gjykatat kane cmuar se, personi ne hetim eshte i dyshuar per nje veprimari kriminale, e cila nga provat e shqyrtuara, pra nga te dhenat e hetimit, rezulton se ka dyshime te bazuara qe kjo veprimtari ka filluar perpara vitit 2004 dhe vlera e trafikimit te narkotikeve e ka kaluar shumen 800.000 euro. Ky eshte nje dyshim i arsyeshem dhe perfundimet ne kete gjykim mund te ndryshojne vetem nese ne procedimin penal rezulton se rrethanat jane te ndryshme nga ato qe pranon gjykata.

Kolegjet e Bashkuara konstatojne se qendrimi i Gjykates se shkalles se pare dhe te Apelit per Krime te Renda jane te mbeshtetura ne ligj dhe, nisur nga arsyetimi i rekuruesve e qendrimi perkates i gjykatave ne lidhje me pasurite qe mund te jene objekt i masave pasurore preventive, ne vijim cmojne te shprehen lidhur me disa aspekte thelbesore te tyre per efekte te unifikimit te paktikes gjyqesore.

Ligji nr.9284, date 30.09.2004 parashikon se masat parandaluese pasurore ndaj personave te dyshuar zbatohen per pasurite mbi te cilat, ky i fundit, disponon apo mund te disponoje direkt apo indirekt, vlera e te cilave eshte e pajustificuar ligjerisht krahasuar me te ardhurat. ose me veprimtarite ekonomike te deklaruarua ose qe jane produkt i vepres penale, apo perbejne venien ne perdorim te tyre.

Megjithate, hetimi dhe gjykimi preventiv duhet te jete me i thelluar ne rastin e dyshimit te arsyeshem, te dhenave te mjaftueshme, per venien ne perdorim (investimin) te pasurive qe jane produkt i veprave penale apo ne rastin e pasurive qe ne aspektin formal, ne shfaqjen e jashtme, i perkasin personave te tjere, por ne fakt zoterohen nga personi i dyshuar per pjesemarrjen, kryerjen e veprave penale (neni 3, pika 1).

Kolegjet e Bashkuara cmojne se, ne rastin e pare, meqenese venia ne perdorim e pasurive produkt i vepres penale (sipas nenit 287 te K.Penal) realizohet edhe me ane te shtimit, rritjes, trasformimit, permiresimit, etj., mbi pasuri qe tashme jane ne disponim te ligjshem te personit te dyshuar, zbatimi i masave parandaluese pasurore duhet te kufizohet ne ato vlera te pasurise qe jane arritur si pasoje e venies ne perdorim te pasurise produkt i vepres penale, pra, vetem mbi ate pjese te pasurise qe rezulton te jete rezultat i rritjes ne menyre te pajustificuar ligjerisht te saj.

Ne rastin e dyte, ekziston prezumimi qe mbeshtetet ne dyshimin e arsyeshem, bazuar ne te dhena te mjaftueshme se, pasuria formalisht i perket personave te tjere, por ne fakt, eshte ne disponim te personit te dyshuar dhe ka nje lidhje, rrjedh nga veprimtaria e tij kriminale. Pavaresisht nga ky prezumim, ne gjykim duhet te vertetohet lidhur me cdo pasuri te vecante, se cilat prej tyre jane apo mund te jene ne kontrollin, disponimin faktik te personit te dyshuar dhe cilat realisht e jo thjesht formalisht ne ate te personave te tjere te treguar ne piken 2 te nenit 3 dhe ne nenin 8 te Ligjit nr.9284, date 30.09.2004.

Gjithashtu, per zbatimin e masave pasurore ndaj personave te tjere ne gjykim nuk eshte e mjaftueshme te vertetohet thjesht fakti i lidhjes familjare, gjinore, te krushqise, etj., per te provuar ekzistencen e zoterimit ne fakt te pasurise nga personi i dyshuar dhe vendosjen fiktive te saj ne emer te personave te tjere.

Gjykata, perpara se te vendose masen pasurore, duhet te verifikojë dhe te arrijë në perfundime të mbështetura në prova se ekziston një shfaqje e jashtëme, formale, e zoterimit, titullit të pronësive të pasurisë në emër të personave të tjerë, ndërkohe që nga teresia e rrethanave disponimi autonom, efektiv, i pjesshem a i plote, direkt a i terthorë, sikur të ishte pronar i tyre është i personit të dyshuar. Këto prova duhet të përmbajnë të dhëna të mjaftueshme, jo thjesht në trajtën e dyshimeve, indicjeve, por edhe fakte të rrethana konkrete, të sakta, të cilat në harmoni me njëra tjetrën përbejnë prova indirekte që mbështesin këtë prezumim të parashtruar nga prokurori në kërkesën e tij drejtuar gjykates se procedimit preventiv.

Nesë rezultojnë kundërta, duke mos qenë vetë persona të dyshuar sipas këtij ligji, ndaj pasurisë së personave të tjerë nuk mund të gjejnë zbatim masat e parashikuara nga ligji nr.9284, datë 30.09.2004.

Po kështu, duke qenë se personat e tjerë janë subjekte të këtij ligji për shkak të prezumimeve lidhur me personin e dyshuar, këto masa nuk gjejnë zbatim edhe kur vërtetohet se nuk kemi të bëjmë më me një person të dyshuar në kuptim të nenit 3, pikë 1 të ligjit, qoftë edhe sikur të ketë rezultuar në hetim e gjykim se personat e tjerë nuk justifikojnë prejardhjen e ligjshme të pasurisë, apo se ajo pasuri është produkt i një veprë tjetër penale.

Në kuptim të nenit 8 dhe 13 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, prokurori ka detyrimin të parashtrorë përpara gjykates dhe të kërkojë të shqyrtohen prej saj provat në mbështetje të kërkesës për vendosjen e masës pasurore ndaj pasurisë së personave të tjerë. Mbi këtë bazë, ligji i njeh prokurorit edhe të drejtën që, në mënyrë të motivuar, t'i kërkojë gjykates të detyrojë personat e tjerë, pra t'u kalojë atyre barrën e provës, që të justifikojnë mënyrën e fitimit, prejardhjen e ligjshme të pasurisë së tyre, se kjo pasuri nuk ka lidhje me veprimtarinë kriminale të personit të dyshuar, se ajo pasuri është në zoterimin efektiv, pra jo në mënyrë fiktive (formale) në emër të personave të tjerë. Sipas këtij ligji ekziston prezumimi se edhe në këto raste kemi të bëjmë me pasuri të fituara në mënyrë të paligjshme nga personi i dyshuar. Në këtë mënyrë rrjedh, formosohet, edhe prezumimi se pasuri të cilat formalisht janë në emër të personave të tjerë, në fakt, janë në zoterimin direkt a të terthorë të personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale të treguara në nenin 3, pikë 1 të ligjit.

Nga ana tjetër, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit, në rastin kur rezultojnë se personi i dyshuar zoteron një numer pasurish, masa preventive pasurore nuk vendoset vetvetiu mbi të gjitha pasuritë e tij, por cmohet e vendoset për secilën prej tyre dhe vetëm për ato që, nga hetimi dhe gjykimi, rezultojnë se nuk u justifikohet origjina, prejardhja e ligjshme. Kjo për shkak se nuk mund të përjashtohet mundësia që një person i dyshuar sipas këtij ligji, të disponojë edhe pasuri të fituara në mënyrë të ligjshme.

Gjithashtu, për gjykatën nuk mund të jete i mjaftueshem thjesht perfundimi se ekziston mosperputhje ndërmjet të ardhurave të personit të dyshuar dhe pasurive të fituara prej tij, për të cmuar se të gjitha pasuritë duhet të sekuestrohen dhe konfiskohen. Krahas kësaj, gjykata duhet të individualizojë, sipas rrethanave, në mënyrë të mjaftueshme për efekte vetëm të procedimit parandalues, edhe ekzistencën e një lidhje shkakësore të caktuar ndërmjet veprimtarisë kriminale të personit të dyshuar (sipas nenit 3, pikë 1) dhe përfitimit të pajustificuar ligjerisht të pasurisë prej tij.

Pra, masat preventive pasurore sipas ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 gjejnë zbatim nëse mënyra e fitimit, prejardhja e pasurisë së personit të dyshuar apo personave të tjerë (neni 3), e cila zotërohet direkt a terthorazi prej personit të dyshuar, nuk është e justifikuar ligjerisht, si dhe ka lidhje me pjesëmarrjen, kryerjen nga personi i dyshuar të një kategorie të caktuar veprash penale.

Në këtë kuptim, pavaresisht nga përmbajtja e nenit 3, pikë 3 të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, këto masa nuk mund të zbatohen nëse nga procedimi parandalues dhe gjykimi i

kerkeses se prokurorit per vendosjen e tyre rezulton se, pasuria eshte fituar (ne menyre te justifikuar ligjerisht ose jo), eshte vendosur ne cdo menyre ne zoterim te personit te dyshuar perpara kryerjes se vepres penale qe i atribuohet apo per te cilin ai eshte denuar (neni 3, pika 1 e ligjit).

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ka parashtruar si ceshtje per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara per efekt te unifikimit te praktikes gjyqesore, edhe interpretimin e neneve 7 e 10 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, nese sekuestrimi paraprak (neni 7) dhe sekuestrimi (neni 10) jane faza te domosdoshme te nje procesi qe duhet kryer per te arritur te konfiskimi, apo jane koncepte te shkeputura nga njeri tjetri dhe si te tilla veprojne pavaresisht njeri-tjetrit. Po keshtu, nese konfiskimi behet vetem ne rastet pasi me pare eshte vendosur pezullimi dhe sekuestro (neni 9 e 10), apo edhe ne rastet kur me pare eshte vendosur vetem sekuestro paraprake (neni 7).

Ne ceshtjen objekt i ketij gjykimi, rezulton se Gjykata e shkalles se pare per Krimet e Renda, me kerkesen dhe pranine vetem te prokurorit ka vendosur masen e sekuestros paraprake mbi pasuri te personit te dyshuar Xhevdet Tropolini, duke caktuar daten e seances se shqyrtimit (vleftesimit) te saj ne pranine edhe te personit te dyshuar. Ne daten e caktuar, duke thirrur edhe personat e tjere te lidhur me personin e dyshuar dhe pasurite subjekt i masave pasurore, gjykata cmoi te vendose masen e sekuestros mbi pasurite pasi u dha ne gjykim pjesemarrësve ne proces mundesine te parashtronin provat e pretendimet e tyre, sipas detyrimeve dhe barres perkatese te proves.

Ne zbatim te drejte te ligjit nr.9284, date 30.09.2004, procedimi parandalues fillon me nismen e prokurorit, i cili kryen te gjitha veprimet e cmuara prej tij per te verifikuar ekzistencen ose jo te rrethanave dhe kushteve te lartpermendura. Por, sipas ketij ligji, prokurori ne asnje rast nuk mund te vendose masa mbi pasurite qe i nenshtrohen hetimit parandalues. Keto masa, me kerkesen e tij, vendosen vetem nga gjykata.

Si pjese e domosdoshme e procedimit parandalues, nese ekzistojne rrethana dhe kriteret te verifikueshme “per te cilat parashikohet zbatimi i mases se konfiskimit” (neni 7, pika 1) si dhe ato te nenit 13, me kerkesen e prokurorit, gjykata mund te vendose si mase sigurimi pasuror ate te **sekuestrimit te pasurise (neni 13).**

Por, duke mbajtur parasysh kriteret e mesiperme, me kerkesen te motivuar posacerisht nga ana e prokurorit, gjykata mund te vendose me pare edhe masen e **sekuestrimit paraprak** te pasurise, per shkak se, deri ne plotesimin e hetimeve mbi nje pasuri konkrete, rrezikohet qe ajo te humbase, pervetesohet, tjetersohet e te tjera rreziqe qe lidhen me natyren e nje sekuestroje preventive (neni 7, pika 1) (neni 10).

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin se, ne cdo procedim parandalues, sekuestrimi paraprak (neni 7, pika 1) dhe sekuestrimi (neni 10), (neni 13), nuk jane masa sigurimi pasuror te domosdoshme, ne kuptimin qe, edhe kronologjikisht, duhet t’i kerkohen e vendosen nga gjykata njera pas tjetres, perpara se prokurori t’i kerkoje gjykates konfiskimin e pasurise. Sekuestrimi paraprak, sipas ketij ligji, vendoset vetem nese ekzistojne rrethana te posacme (neni 7, pika 1), mase e cila ka efekte te perkohshme deri ne konfirmimin, ose jo te saj ne sekuestro, ne seancen gjyqesore te caktuar per kete qellim nga gjykata qe ka dhene vendimin e sekuestros paraprake.

Nenet 7 dhe 10 te ligjit nr.9284, date 30.09.2004 kane te perbashket, trajtojne, ceshtje qe lidhen me kriteret e procedura per vendosjen e mases se sekuestros. Por, nga ana tjetere, lidhur me natyren e pasurise, neni 7 gjen zbatim per cdo lloj pasurie, pervec atyre qe lidhen me rrethanat, subjektet dhe masat e parashikuara ne nenet 8 dhe 9 te ligjit, per te cilat zbatohet neni 10.

Masa e sekuestros sipas nenit 10, nese cmohet e bazuar, zbatohet pasi te jete vendosur me pare ajo e pezullimit te perkohshem te administrimit te pasurise (neni 9, pika 1). Nga ana tjetere,

masa e sekuestros, sipas nenit 10, kur ekzistojne rrethanat e treguara ne nenin 7, pika 1, mund te paraprihet nga ajo e sekuestros paraprake.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin unifikues se, masa e konfiskimit te pasurise jepet nga gjykata mbi kerkesen e motivuar te prokurorit, nese permbushen kriteret ligjore te tregura ne nenet 24 deri 26 te ligjit, pasi te jete vendosur me pare masa e sekuestrimit mbi pasurine (neni 13), ndersa ne rastin e pasurive sipas nenit 8, pasi te jete vendosur me pare masa e pezullimit te perkohshem te administrimit dhe disponimit te pasurise (neni 9, pika 1), apo nese eshte urdheruar me pas, eventualisht, edhe ajo e sekuestrimit te tyre (nenet 10, 13).

Sekuestro paraprake vendoset nga gjykata nese jane te mbeshtetura ne ligj motivet dhe rrethanat qe permban kerkesa e posacme per kete qellim nga ana e prokurorit (neni 7, pika 1 ne lidhje me nenet 13 e 26). Gjykata, brenda 5 diteve nga paraqitja e kerkeses mund te vendose sekuestron paraprake, ne nje seance gjyqesore, te zhvilluar vetem me "pranine e prokurorit" (neni 7, pika 2), pra "perpara caktimit te dates se seances gjyqesore" (neni 7, pika 1). Ne kete vendim, gjykata percakton edhe daten e zhvillimit te seances pasardhese gjyqesore.

Ndonese ligji nuk parashikon ndonje afat konkret, nisur nga natyra dhe efektet e procedimit parandalues, parimet universale te gjykimit te panderprere, afatet e pergjithshme te vlefshmerise se masave te sigurimit pasuror, si dhe emergjenca, perkohshmeria e motivet ku mbeshtetet vendosja e sekuestros paraprake, duke cmuar edhe rrethanat konkrete te ceshtjes dhe kohen objektive ne dispozicion te paleve per pjesemarrje ne gjykim, gjykata duhet te caktojë daten e seances gjyqesore dhe atyre eventualisht pasardhese ne nje afat sa me te shkurter. Ne afatin e vlefshmerise se mases se sekuestros (neni 13) llogaritet edhe periudha qe ka kaluar nga dita e vendosjes se sekuestros paraprake (neni 7, pika 4 dhe 5, 9, 10, 13, 14).

Keto seanca gjyqesore mundesojne qe prokurori te parashtroje ne menyre te detajuar motivet dhe provat qe mbeshtetin kerkimet e tij, mbrojtjen e personit te dyshuar, thirrjen per te nderhyre ne proces, edhe kryesisht, te personave te trete qe rezultojne te jene subjekt i maseve te sigurimit pasuror, nese kerkohet nga prokurori kohen e nevojshme ne dispozicion te tyre per permbushjen e detyrimit per te justifikuar prejardhjen e ligjshme te pasurise, si dhe veprime te tjera ne funksion te zhvillimit te nje procesi te rregull ligjor, ne nje afat sa me te shkurter, per dhenien e nje vendimi te mbeshtetur ne ligj dhe ne prova lidhur me vendosjen ose jo te mases se sekuestros (nenet 7, pika 1 dhe 3, 10, 13, 14 dhe 16).

Se fundi Kolegji Penal, ne vendimin e tij ka parashtruar si ceshtje per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara per efekt te unifikimit te praktikës gjyqesore edhe ate per interpretimin e mases "pezullim i perkohshem i administrimit dhe disponimit te pasurive" (neni 9) dhe lidhja e tij me sekuestrimin (neni 10), nese jane hallka te nje procesi qe duhen zbatuar patjeter per te arritur tek konfiskimi, apo mund te veprojne pavaresisht nga njera tjetra.

Masat pasurore, sipas ligjit nr.9284, date 30.09.2004, zbatohen se pari: ndaj personave te dyshuar dhe personave te tjere (neni 3, pika 1, dhe neni 3), se dyti: ndaj personave dhe vecanerisht subjekteve te tjere juridike qe nuk perfshihen ne nenin 3, por ndodhen ne rrethana kercenimi e ndikimi nga personat e dyshuar. Ne rastin e dyte gjejne zbatim te posacem edhe dispozitat e neneve 8 deri 13 te ligjit.

Ne kete kontekst, Kolegjet e Bashkuara vleresojne se, ne rastin e personave juridike, pavaresisht nga respektimi i formes ne strukturimin dhe menyren e funksionimit, ne procedimin parandalues synohet e duhet te provohet qe organet drejtuese te tij, persona konkrete qe ushtrojne funksionet perkatese ne keto organe, jane ne gjendje, ne kushtet juridike e faktike qe te drejtojne subjektin, pra dhe te veprojne per llogari te personave te

dyshuar, duke treguar keshtu se ky subjekt kontrollohet, disponohet ne fakt nga personi i dyshuar, sherben si nje mjet, nje baze, per te lehtesuar dhe realizuar qellimet dhe produktet e veprimtarite se tij kriminale sipas nenit 3, pika 1 e ligjit.

Mbeshtetur ne te dhenat e mjaftueshme qe rezultojne nga hetimet e kryera, prokurori i kerkon ne menyre te motivuar gjykates qe, ne gjykimin i cili zhvillohet ndaj personit te dyshuar, te thirren edhe ata persona qe jane pronare e zoterues te te drejtave pasurore te subjektit juridik, anetaret e organeve drejtuese te tij, etj., duke i detyruar qe te justifikojne ligjshmerine e disponimeve pasurore dhe te veprimtarise te tyre, si dhe te paraqesin prova se subjekti nuk eshte nen ndikimin dhe kercenimin e personave te dyshuar (neni 8).

Ne vijim, nese rezultojne te dhena te mjaftueshme te kercenimit, ndikimit, kontrollit mbi subjektin nga personi i dyshuar, prokurori mund t'i kerkoje gjykates edhe vendosjen e mases se pezullimit te perkohshem te administrimit dhe disponimit te veprimtarise dhe pasurive te subjektit (neni 9, pika 1). Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor, gjykata mund te vendose konfiskimin e ketyre pasurive dhe veprimtarive.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara vijne ne perfundimin se, nese ne hetim dhe gjykim rezultojne te dhena te mjaftueshme dhe motive te tjera se ekzistojne rreziqe reale per humbjen, pervesimin, tjetersimin, etj. e pasurive dhe te drejtave te subjektit, prokurori mund te kerkoje edhe sekuestrimin e tyre (neni 10), pa perjashtuar edhe sekuestron paraprake (neni 7). Por masat e sekuestrimit nuk jane hallke, mase e domosdoshme perpara se t'i paraqitet gjykates kerkesa per konfiskimin e pasurise dhe veprimtarive te personave dhe subjekteve te treguar ne nenin 8 te ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne mbeshtetje te nenit 141, pika 2 te Kushtetutes, nenit 17, shkronja "a" te Ligjit nr.8588, date 15.03.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates se Larte" dhe te nenit 263 te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S Ë N

1. Lenien ne fuqi te vendimit nr.37, date 10.07.2006 te Gjykates se Apelit per Krimet e Renda.
2. Unifikimin e praktikës gjyqesore sikurse percaktohet ne kete vendim.
3. Dergimin per botim ne Fletoren Zyrtare te ketij vendimi qe njehson praktiken gjyqesore.

Tirane, me 25.01.2007

MENDIM I GJYQTARËVE NË PAKICË

Nga aktet e ndodhura ne dosje rezulton qe ndaj shtetasit Xhevdet Troplini mbi bazen e nje bashkepunimi me autoritetet italiane, ne daten 02.11.2005 ka filluar ceshtja penale regjistruar me nr.88, me te cilin Xhevdet Troplini eshte marre i pandehur dhe eshte arrestuar per vepren penale te trafikimit te lendeve narkotike, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i trete i Kodit Penal. Gjate vazhdimit te hetimit per veprimtarine kriminale te te pandehurit, pasi prokuroria e krimeve te renda ka evidentuar se i pandehuri kishte pasuri te luajteshme dhe te paluajteshme dhe duke vleresuar se ajo rridhte nga veprimtaria e tij kriminale, i ka kerkuar Gjykates se Krimeve te Renda ne daten 07.04.2006 sekuestrimin e kesaj pasurie dhe me vendimin nr.39 akti, date 10.04.2006, Gjykata e Krimeve te Renda ka vendosur te sekuestroje pasurine e te pandehurit Xhevdet Troplini.

Si prokuroria, ashtu edhe gjykata e krimeve te renda, kane mbeshtetur respektivisht kerkesen dhe vendimin ne ligjin nr.9284, date 30.09.2004, nenet 3, 7, 13 te tij. Kete vendim e kane ankimuar si i pandehuri, ashtu edhe familjaret e tij, kerkuesit Shefqet Troplini, Lule Troplini dhe Majlinda Troplini, duke pretenduar se pasuria nuk rrjedh nga krimi dhe se ajo pasuri nuk eshte vetem e te pandehurit, por edhe e familjareve te tij. Vendimi i Gjykates se Krimeve te Renda eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit te Krimeve te Renda dhe po ashtu u la ne fuqi nga Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte.

Gjyqtaret ne pakice nuk jane dakort me te gjitha keto vendime per shkakun se te treja gjykatat, kane aplikuar gabim ligjin e per rrjedhoje edhe perfundimet e tyre jane te kunderligjshme. Ligji mbi te cilin jane bazuar per te arritur ne perfundimin se pasuria e te pandehurit duhet sekuestruar, eshte ligji nr.9284, date 30.09.2004, "Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar". Sipas ketij ligji personave te dyshuar si pjesemarres ne krimin e organizuar dhe personave te lidhur me ta, mund t'iu sekuestrohet e me pas konfiskohet pasuria qe lidhet me keto krime.

Kemi mendimin se ligji ne fjale, nuk eshte i aplikueshem per rastet kur ndaj personit qe dyshohet per pjesemarrje ne krim te organizuar ka filluar ceshtja penale. Mendojme se ky ligj ka efekte per te gjitha rastet e tjera qe nuk lidhen me procedimin penal. Ne momentin e marrjes se personit me cilesine e te pandehurit apo personit nen hetim apo personit te cilit i atribuohet vepra penale, te cilet sipas nenit 34 te K.Pr.Penal barazohen ne pozite procedurale, i ben ata subjekte te procedimit penal sipas kreut IV te K.Pr.Penale, seksioni i II-te i titullit I-re, e per pasojes, ndaj tyre aplikohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe kodi parashikon per te pandehurin. Te gjitha rregullimet e tjera qe kodi ka ne raport me pozita te caktuara te proceduriale te te pandehurit, gjate gjithesazve te procedimit te tij, jane te parashikuara ne vete permbajtjen e kodit dhe ne dispozita te posacme te tij. Nderkohe qe nje nga parimet themelore mbi te cilin ngrihet procedimi penal percaktohet ne nenin 1 te kodit i cili ka sanksionuar se "*Legjislacioni procedural penal ka per detyre te siguroje nje procedim te drejte, te barabarte e te rregullt ligjor, te mbroje lirite personale, te drejtat dhe interesat e ligjshme te shtetasve, te ndihmoje per forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutes e te ligjeve te shtetit*".

Brenda ketij parimi, kodi ka bere rregullime te tija per te garantuar nje proces te barabarte per te gjitha subjektet qe i nenshtrohen atij, duke percaktuar kufizime te cilat lidhen kryesisht me mbrojtjen e deshmiteve dhe bashkepunetoreve me drejtesine, ne menyre te vecante ne raport me te akuzuarit per vepra penale qe lidhen me trafiket dhe krimin e organizuar. Gjithesesi, ne te gjitha rastet e rregullimeve te posacme ato jane te parashikuara brenda ketij korpusi normash qe perbejne K.Pr.Penale qe sipas Kushtetutes eshte nje ligj qe miratohet me vote te cilesuar dhe qe ne hierarkine e normave vjen pas Kushtetutes se Shqiperise, neni 81 i saj.

Ne keto kushte, kemi mendimin se ne kete ceshtje, derisa per te pandehurin e arrestuar ka filluar nje procedim penal, cdo kerkese dhe vendimmarrje per lirine dhe te drejtat e tij perfshi dhe ato pasurore duhet te mbeshtetet ne dispozitat e K.Pr.Penale.

Neni 208 e ne vazhdim i ketij kodi dhe dispozita te tjera te tij, nuk parashikojne rregullime te posacme per ketegori te caktuar te personave te akuzuar per vepra te ndryshme penale, por kane percaktuar rregullat se si veprohet si persa i perket sekuestrimit dhe me pas, konfiskimit kur rezultojne kushtet qe parashikon ligji, ndaj pasurise qe rrjedh apo lidhet me nje krim.

Edhe pse ceshtja penale kishte 6 muaj qe kishte filluar per te pandehurin Xhevdet Troplini dhe ndaj tij po zbatoheshin normat e K.Pr.Penale, sekuestrimi i pasurise se te pandehurit ne kundershtrim me keto norma eshte kerkuar te behet me nje ligj te posacem dhe jo brenda korpusit te dispozitave te cilat udheheqin dhe mbi te cilat bazohet procedimi penal. Kjo menyre e te vepruarit, te pranuar edhe nga gjykatat, padrejtesisht dhe ne menyre te kunderligjshme e ka vene te pandehurin ne pozite te pabarabarte dhe ne menyre te diskriminuar ne raport me poziten e tij procedurale dhe te drejtave qe burojne per personin e pandehur.

Ky qendrim shkel parimin themelor mbi te cilin ngrihet procedimi penal, te sanksionuar ne nenin 1 te K.Pr.Penale. Lenia ne vleresim te organit te akuzes qe ne rastet analoge, per te cilat ka filluar nje ceshtje penale, te kerkoje sekuestrimin e pasurise se te pandehurit apo personit nen hetim qe te aplikojte dispozitat e K.Pr.Penale apo dispozitat e ligjit nr.9284, date 30.09.2004, mendojme se eshte shume e rrezikshme dhe i hap rrugen nje subjektivizmi me pasoje te drejtperdrejte diskriminimi dhe vendosje ne pozita te pabarabarta te subjekteve te njejta procedurale, duke shkelur parimin themelor te ndjekjes penale dhe te drejtat dhe lirite procedurale e Kushtetuese, per personat qe dyshohen te kene kryer vepra penale.

Ligji per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar i vitit 2004, sipas mendimit te gjyqtareve ne pakice, duhet te interpretohet si nje ligj qe aplikohet per personat e dyshuar si pjesemarres ne krimin e organizuar ku futen jo vetem drejtperdrejt ata qe jane pjesemarres ne keto organizata kriminale, por edhe te tjere, qe edhe pse nuk jane drejtperdrejt pjesemarres, kane lidhje te aferta me ta, sikurse jane bashkeshorti, femijet, personat gjini e krushqi te afert, por edhe personat fizike e juridike pasurite e te cileve zoterohen drejtperdrejt, pjeserisht ose plotesisht nga personat qe dyshohen te kene kryer krim te kesaj natyre.

Sikurse lehtesisht konstatohet ne nenin 3 te ligjit, te titulluar "*rrethi i personave te dyshuar*", sekuestrimi i pasurise shtrihet edhe ndaj personave dhe subjekteve te cilet nuk kane kryer vepra qe lidhen me krimin e organizuar, duke treguar keshtu se aplikimi i ketij ligji nuk lidhet me vete procedimin penal, por eshte jashte tij. Kete qendrim me te drejten mbajne edhe Kolegjet e Bashkuara ne unifikim te praktikës gjyqesore, duke e konsideruar procedim parandalues dhe autonom me procedimin penal dhe ate civil.

Ky ligj, duke qene me karakter te forte represiv dhe qe eshte bazuar ne nevojën per te parandaluar dhe luftuar me mire krimin e organizuar, ka efekte te kufizuara ne kohe duke percaktuar afate me te shkurtra sesa ato te K.Pr.Penale per kohen e venies se sekuestrimit mbi pasurine, por nga ana tjeter, ka lehtesuar mundesine e venies se saj ne raport me dispozitat e K.Pr.Penale. Mendojme se ky eshte edhe shkak qe ligjvenesit ka kufizuar kohen gjate te ciles pasuria mbahet ne sekuestro. Qe ky ligj nuk lidhet me rastet kur ka nje procedim penal, e tregon qarte, ndryshe nga sa pranon shumica, neni 27 i tij ku ne paragrafin e pare percaktohet se, masa e sekuestrimit ose konfiskimit mund te vendoset edhe ndaj pasurive te sekuestruara ne nje procedim penal. Akontrario, duhet kuptuar se ne nje procedim penal aplikohen dispozita te tjera, K.Pr.Penale dhe vetem ne nje rast ky ligj ben lidhjen me procedimin penal kur i jep te drejte gjykates qe te vendose sekuestro apo te konfiskoje pasuri mbi te cilat ajo ka disponuar me pare ne procedimin penal, duke bere keshtu te mundur zbatimin e normave te ketij ligji te lidhura me ato te K.P.Penale. Sipas mendimit te pakices, ky eshte i vetmi rast kur keto dy ligje mund aplikohen se bashku ne nje procedim penal. Pra ne thelb ai eshte nje ligj parandalues, ashtu sikurse ka edhe titullin dhe nuk eshte nje ligj qe shtrihet gjate procedimit penal.

Pakica ka mendimin se ne eventualitetin qe K.Pr.Penale dhe ligji nr.9284, date 30.09.2004, aplikohen se bashku, sikurse praktikisht kane vendosur dhe unifikuar praktiken gjyqesore edhe Kolegjet e Bashkuara, duke qene se dispozitat e ketij ligji rendojne dukshem poziten e te pandehurit qe dyshohet te jete pjesemarres ne nje krim te organizuar, duhet vleresuar paraparakisht kushtetuesmeria e ligjit dhe ceshtja i duhej referuar Gjykates Kushtetuese.

Nga ana tjeter, pakica ka mendimin se edhe sikur te pranohet qe te dy keto jane ligje te aplikueshme, por qe ne thelb kane rregullime me diferenca te medha ne raport me lirite dhe te drejtat e te pandehurit, ligji i aplikueshem jo vetem per shkak te rendesise se tij sipas hierarkise qe percakton neni 81 i Kushtetutes, por edhe per shkak te aplikimit te ligjit favorizues, ben qe K.Pr.Penale te jete ligji i zbatueshem.

Ligji shqiptar nuk eshte nje ligj origjinal. Per hartimin e tij ka sherbyer ligji italian, por situata ligjore dhe kushtetuese mes dy vendeve eshte e ndryshme. Italia, per te gjitha kodet e saj parashikon qe te shoqerohen me ligje aplikues, te cilat shpjegojne dhe zhvillojne me tej dispozita edhe insitute te kodeve, duke i plotesuar ato ne aspekte te caktuara, duke i bere normat e ligjit te barasvlefshme me ato te kodeve. Ne keto kushte, ligjet komplementare, lejohen te vene rregulla te reja ose te detajuara ne raport me kodet, por pa u konsideruar ato kontradiktore me kodin per shkak te diferences se hierarkise se normes juridike.

Ne sistemin ligjore shqiptar, nje gje e tille nuk lejohet nga Kushtetuta. Neqoftese ligjvenesit do te donte te ndryshonte standartet e sekuestrimit dhe konfiskimit te pasurise qe rrjedh nga nje krim, per disa vepra penale te renda, sic eshte rrethi i atyre qe rregullon ligji ne shqyrtim, ato duhet te beheshin ne vete K.Pr.P. dhe jo me nje ligj qe miratohet me shumice te thjeshte ne Kuvend. Ne te kundert, nuk mund te ndryshohen apo te vihen norma represive ne raport me ato te kodit, me nje ligj te posacesm. Nese kjo ndodh, prevalon zbatimi i normave te K.Pr.P., si ligj me i larte ne hierarki.

Ne keto kushte, pakica ka mendimin se: **Ne rastet kur eshte aplikur ligji nr.9284, date 30.09.2004, dhe me pas fillon procedimi penal ndaj personave te akuzuar apo dyshuar per veprat penale per te cilat zbatohet ky ligj, pas ketij momenti, te gjitha veprimet lidhur me sekuestrimin, konfiskimin e prones dhe te drejtat e personit nen hetim, duhet te mbeshteten ne dispozitat e K.Pr.P.**

Bazuar mbi kete afirmim, duke konstatuar se si kerkimi, ashtu edhe vendimmarrja per sekuestrimin e pasurise se te pandehurit Xhevdet Troplini eshte bazuar ne zbatim te gabuar te ligjit, kemi mendimin se te dy vendimet gjyqesore duhej te ishin prishur e per pasoje masa e sekuestrimit mbi pasurine, duhej hequr. Organi i akuzes ne cdo kohe, bazuar ne prova se pasuria eshte e lidhur me veprat penale per te cilat i pandehuri Xhevdet Troplini akuzohet, mund te kerkoje venien e masave te sekuestrimit mbi to, duke i dhene atij mundesi, por edhe te treteve qe preken ne interesat e tyre pasurore, per te kundërshtuar dhe kerkuar verifikimin e vendimeve ne gjykatat me te larta.

Artan Hoxha

Gani Dizdari

Kristaq Ngjela

Besnik Imeraj

Agron A. Lamaj

Evjeni Sinojmeri

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Kristaq Ngjela	Anetar
Perikli Zaharia	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Ylvi Myrtja	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Irma Bala	Anetare
Shpresa Beçaj	Anetare
Besnik Imeraj	Anetar
Ardian Dvorani	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 25.03.2005 moren ne shqyrtim ceshtjen penale qe i perket:

TË PANDEHURVE: EDI BIBA
PAULIN PRENGA
TONIN PJETRI

A K U Z A:

Kryerja e veprave penale
te rrembimit te personit, ne bashkepunim
dhe mbajtje e armeve pa leje,
parashikuar nga nenet 109, paragrafi i pare,
nenet 25 dhe 279, paragrafi i dyte te K.Penal.

Gjykata e Rrethit gjyqesor Mirdite, me vendimin nr.100, date 10.11.2003, ka vendosur:
Pushimin e gjykimit te ceshtjes penale per te pandehurin Edi Biba per vepren
penale te vetegjyqesise, te kryer ne bashkepunim, sipas nenit 277 e 25 te Kodit
Penal, pasi eshte amnistuar.

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Tonin Pjetri për veprën penale të vetëgjyqesise, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Paulin Prenga për veprën penale të vetëgjyqesise, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Paulin Prenga për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe në bazë të nenit 278, paragrafi i dytë i Kodit Penal denimin e tij me 5 muaj burgim, denim i cili është vuajtur.

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurve Edi Biba e Tonin Pjetri për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.163, datë 11.03.2004 ka vendosur:

Lenien në fuqi të vendimit nr.100, datë 10.11.2003 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Mirditë.

Kunder këtyre vendimeve ka paraqitur rekurs prokurori, i cili kërkon ndryshimin e tyre dhe deklarin fajtor të tre të pandehurve për veprën e heqjes së paligjshme të lirise në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe denimin secili me 3 vjet burgim, duke parashtruar këto shkaqe:

- Të dy gjykatat nuk kanë marrë në analizë elementet e veprës penale të heqjes e paligjshme të lirise dhe ndryshimet që kjo veper ka me atë të vetëgjyqesise, si dhe konkurimin e veprave në rastin konkret.
- Të pandehurit në bashkëpunim me njëri-tjetrin i kanë hequr në mënyrë të paligjshme lirine të demtuarit Besnik Lleshi, duke e marrë, futur me dhunë në makinë, me pas e kanë nxjerrë nga makina dhe kanë ecur rruges së malit së bashku dhe e kanë leshuar vetëm nga frika e policise. Po të mos ishte ndërhyrja e policise të pandehurit nuk kishin për ta leshuar të demtuarin.
- Vetëgjyqesia, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, si veper drejtohet kunder pasurise apo interesave të tjera që i pandehuri mendon se i takon, pa i zgjidhur në rrugë ligjore, por jo kunder personit. Po që se gjatë kryerjes së veprës së vetëgjyqesise ushtrohet dhunë në formë të ndryshme ndaj personit, ku mund të shkaktohen dëmtime trupore, apo hiqet liria, këto veprime konkurojnë me vetëgjyqesinë, prandaj të pandehurit duhet të pergjigjen për veprën penale të vetëgjyqesise dhe heqjes së paligjshme të lirise, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 277 e 25, si dhe 110, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Në gjykimin e çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, prokurori ndryshoi perseri qëndrim lidhur me kualifikimin e veprës penale nga heqje e paligjshme e lirise dhe vetëgjyqesi, në rrembim personi të kryer në bashkëpunim, neni 109 e 25 të Kodit Penal. Ai arsyeton se veprimet e të gjykuarve i pergjigjen plotësisht elementeve të anës objektive të veprës penale të rrembimit të personit, që bëhet jo vetëm për të fituar pasuri, por edhe për të realizuar kushte a kërkesa të tjera e çdo qëllim tjetër.

Kolegji Penal i Gjykes se Larte, me vendimin nr.506/6 akti, date 26.01.2005, ka derguar ceshtjen ne Kolegjet e Bashkuara per percaktimin e sakte te praktikes gjyqesore lidhur me cilesimin juridik te vepres penale dhe te interpretimit gjyqesor te dispozitave te nenit 109, 110 dhe 277 te Kodit Penal.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga gjyqtaret Artan Hoxha dhe Valentina Kondili, prokurorin Bujar Sheshi, i cili kerkoi ndryshimin e vendimit te gjykates se apelit dhe deklarimin fajtores te te gjykuarve per vepren penale te rrembimit te personit te kryer ne bashkepunim, neni 109/1 e 25 i K.P.,

mbrojtessin e te gjykuarit Tonin Pjetri, avokatin Viktor Ikonimi, i cili kerkoi lenien ne fuqi te vendimit,

dhe pasi e biseduan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Nga gjykimi i ceshtjes ne Gjykatën e Rrethit gjyqesor Mirdite dhe Gjykatën e Apelit Tirane rezultojne te provuara faktet dhe rrethanat e meposhtme:

I demtuari Besnik Lleshi kishte punuar ne Itali me vellane e te gjykuarit Tonin Pjetri, Altin Pjetrin, i cili i kishte dhene 10 milion lireta qe t'ia dergonte familjes se tij. Njekoheesisht, Altini kishte njoftuar familjaret nepermjet telefonit per dergimin e parave dhe i kishte sqaruar qe nje pjese te shumes t'ja jepin te gjykuarit Edi Biba, per shlyerjen e nje borxhi.

Duke pare se i demtuari nuk po i sillte te hollat, pasi me to kishte blere nje makine, i gjykuar Tonin Pjetri se bashku me dy te gjykuarit e tjere Edi Biba, dhe Paulin Prenga, me date 25.09.2001, kane shkuar ne nje lokal ne fshatin Fierze, ku i demtuari drekonte me dy shoke te tij, me force dhe nen kercenimin e armes e kane marre me vehte. Ne vijim te veprimeve te tyre, kane hipur ne dy makina, ne ate tip "BMW" te vete te demtuarit dhe nje tjetere tip "Golf" dhe jane nisur ne drejtim te fshatit Pllane, Lezhe. Duke qene se policia, e lajmeruar nga shoket te demtuarit, eshte vene ne ndjekje te tyre, ne fshatin Pllane ata kane lene makinat dhe jane ngjitur nje pjese rruge me kembe ne drejtim te malit. Me pas, duke qene te ndjekur nga policia, e kane lene te lire dhe pasi kane hedhur armen jane larguar duke ju fshehur ndjekjes.

Per sa me siper, te gjykuarit jane akuzuar nga organi i prokurorise per vepren penale te rrembimit te personit te kryer ne bashkepunim, si dhe armembajtjes pa leje.

Gjykata e Rrethit gjyqesor Mirdite, duke i pranuar rrethanat e ceshtjes si me siper, ka bere nje cilesim te ri juridik te vepres nga rrembim i personit ne vetegjyqesi, me arsyetimin se te tre te gjykuarit nuk e rrembyen te demtuarin per te realizuar ndonje perfitim ne te holla, por vetem per te bere te mundur dhenien prej tij te shumes se te hollave te derguara nga Italia dhe qe u perkisnin atyre. Nga ky fakt, qe nuk mohohet nga i demtuari, rezulton se mungon qellimi i perfitimit ne dem te nje tjetri, qe ne vepren e rrembimit duhet te jete i pranishem.

Te njejtin arsyetim ka bere edhe Gjykata e Apelit Tirane, e cila ka lene ne fuqi vendimin e shkalles se pare.

Organi i prokurorise ne rekurs ka pretenduar se vepra penale e vetegjyqesise konkuron me ate te heqjes se paligjshme te lirise, per faktin se gjate vetegjyqesise eshte ushtruar dhune ndaj personit dhe i eshte hequr liria, prandaj te gjykuarit duhet te denohen edhe per kete veper.

Ndryshe sa eshte parashtruar ne rekurs, prokurori i seances ne Kolegjin Penal, kerkoi perseri ndryshimin e kualifikimit te vepres ne rrembim personi, neni 109/1 dhe 25 i Kodit Penal,

duke arsyetuar se veprimet e te gjykuarve i pergjigjen plotesisht elementeve te anes objektive te vepres se rrembimit te personit, qe behet jo vetem per te fituar pasuri, por edhe per te realizuar kushte a kerkesa te tjera, apo çdo qellim tjetër.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte diskutoi çeshtjen ne fjale dhe veren se ka mendime te kunderta lidhur me interpretimin dhe cilesimin ligjor te vepres se kryer nga te gjykuarit, nese eshte “rrembim personi”, “heqje e paligjshme e lirise”, “vetegjyqesi”, apo konkurim i tyre me njera-tjetren.

Per sa me siper, nisur nga mendimet e kunderta qe ekzistojne ndermjet gjykatave, organit te prokurorise dhe ne praktiken gjyqesore ne teresi, Kolegji Penal çmoi se kjo çeshtje duhet te kaloje per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara per unifikim te praktikës gjyqesore.

Nisur nga keto fakte dhe rrethana, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se vendimet e te dy gjykatave jane rrjedhoje e interpretimit dhe zbatimit te gabuar te ligjit.

Nga analiza dhe interpretimi i dispozitave te Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara çmojne se vepra penale e kryer nga te gjykuarit nuk eshte ajo e rrembimit ose mbajtjes peng te personit, parashikuar ne nenin 109 te Kodit Penal, por ajo e heqjes se paligjshme te lirise dhe vetegjyqesia, parashikuar nga nenet 110 dhe 277 ne lidhje me nenin 25 te K.P. I gjykuari Paulin Prenga ka konsumuar edhe vepren penale te mbajtjes se armes pa leje, parashikuar ne nenin 279, paragrafi i dyte i Kodit Penal.

Ne arritjen e perfundimeve te tyre ne gjykimin e kesaj ceshtje, Kolegjet çmojne se analiza e anes subjektive te veprave penale eshte vendimtare per te bere kualifikimin e sakte te vepres penale te kryer nga te gjykuarit. Nga vendimet e gjykatave rezulton e pranuar dhe e provuar se qellimi i veprimeve kriminale te kryera nga te gjykuarit ishte ushtrimi i nje te drejte, pa ju drejtuar organeve kompetente apo gjykates, per te marre nje shume te holla qe ndonese njihej si detyrim kundrejt tyre, i demtuari nuk ua kish dhene dhe e mbante padrejtesisht.

Keto elemente dhe rrethana te anes subjektive, duke u shqyrtuar dhe analizuar se bashku me elemente e rrethana te tjera te anes objektive, gjithashtu bejne te mundur dallimin ndermjet veprave penale te lartpermendura, si dhe konkurimin ose jo ndermjet tyre.

Kolegjet e Bashkuara, per te arritur ne perfundimet e tyre dhe per qellime te njehsimit te praktikës gjyqesore, çmojne te domosdoshme analizen dhe interpretimin e elementeve te figures se te tre veprave penale, ate te rrembimit ose mbajtjes peng te personit (neni 109), heqjen e paligjshme e lirise (neni 110) dhe vetegjyqesine (neni 277).

Heqja e paligjshme e lirise, neni 110 i Kodit Penal, parashikon mbrojtjen e pergjithshme te lirise se personit kundrejt çdo lloj privimi te saj, dhunimit dhe nenshtrimit te detyrueshem fizik nga cilido, veprime keto qe nuk jane te autorizuar apo lejuara nga ligji.

Motivi, veprimet a mosveprimet e autorit te kesaj vepre penale nuk jane te nje natyre te percaktuar shprehimisht prej saj. Heqja e paligjshme e lirise mund te realizohet nepermjet veprimeve (aktive) duke perfshire, por pa u kufizuar vetem ne to: ushtrimi i dhunes mbi personin duke e rrembyer, mbajtur peng, e shoqeruar me bllokimin, prangosjen, etj., ose ne forma te tilla si injektimi i substancave narkotike qe pamundesojne reagimin dhe sjelljen normale te viktimes, dhunes psiqike dhe kanosjeve nepermjet perdorimit dhe drejtimit te armeve ndaj viktimes.

Nuk perjashtohen ne heqjen e paligjshme te lirise edhe perdorimi i formave te mashtrimit dhe genjeshtrës me synim dhunimin e lirise apo veteprivimin e viktimes nga liria personale per gjendjen e tij ne situata te nje semundje te pasherueshme, te rende, ngjitese, etj., ne situata te nje rreziku (qe ne fakt nuk ekziston), vendosjen ne gjendje sugjestionimi a supersticioziteti, etj.

Kjo veper mund te kryhet edhe nepermjet mosveprimeve kur nepermjet tyre mund te shkaktohet dhe realizohet heqja e paligjshme e lirise. Ne keto raste zbatimi i dispozites shtrihet

mbi ata persona (autore) qe kane ne ngarkim apo si detyre te percaktueshme mbrojtjen dhe garantimin e lirise individuale te viktimes.

Heqja e paligjshme e lirise (neni 110 i K.P.), nga pikepamja e anes subjektive realizohet per qellime dhe motive qe nuk jane nga ato te perfshira ne nenin 109 te K.P., pavaresisht nese jane a pretendohen te jene te drejta a te ligjshme dhe pavaresisht nese ato jane me natyre pasurore, materiale ose te nje natyre a marredhenie tjeter qe nuk kualifikohen si te tilla.

Nga pikepamja e anes objektive heqja e paligjshme e lirise (nenkuptohet rrembimi dhe mbajtja peng), pavaresisht nga menyra e kryerjes do te kuptohet si privim i lirise se levizjes se personit ne hapesire sipas rrethanave dhe cmimit subjektiv te tij. Paprekshmeria e personit, liria e levizjes personale, per te mos u penguar a mbajtur fizikisht, por edhe psikologjikisht i lidhur nga nje rrethane e paligjshme dhe e dhunshme, eshte nje e drejte universale, natyrale, nje nga lirate themelore te garantuar nga Kushtetuta.

Persa i perket percaktimit te heqjes se paligjshme te lirise, ardhjes se pasojes dhe shkalles se tyre, eshte e rendesishme te vertetohet nje kohezgjatje e mateshme dhe e mjaftueshme e privimit te lirise, e cila jo domosdoshmerisht duhet te jete e gjate. Nuk perben heqje te paligjshme te lirise vertetimi i kesaj gjendje objektive ne nje cast te caktuar ose kalimtar, me motivim dhe ne kryerje e siper te nje veprimi te caktuar.

Gjithashtu, ne kualifikimin e vepres penale te heqjes se paligjshme te lirise, nuk ndikon shkalla relative apo absolute e heqjes se lirise dhe as natyra e pengesave, bllokimit e perdorimit te menyrave te tjera qe bejne relativisht a plotesisht te perjashtuar ose te pamundur kapercimin e tyre nga viktime, apo mundesine e vetelirimit te tij.

Vepra penale e heqjes se paligjshme te lirise, pavaresisht nga kohezgjatja dhe shpjegimet e parashtuara me siper, quhet e kryer qe ne castin kur vertetohet koha dhe vendi i realizimit te privimit dhe dhunimit te lirise se personit.

Rrembimi ose mbajtja peng e personit, neni 109 i Kodit Penal synon te mbroje ne rradhe te pare lirine e personit. Interpretimi dhe zbatimi korrekt i kesaj dispozite kerkon te mbahen parasysh ndermjet te tjerave, dy elemente thelbesore:

a) perfitimi i padrejte e realizimi i interesave te tjera te paligjshme ne kuptim te rasteve te parashikuara nga dispozita dhe

b) lirimi i viktimes perkundrejt marrjes se ketij perfitimi.

Edhe pse eshte e vendosur ne seksionin VII “veprat penale kunder lirise se personit”, neni 109 ka per objekt jo thjesht mbrojtjen e lirise personale por edhe paprekshmerine dhe mbrojtjen e pasurise. Veprimet dhe motivet e autoreve te vepres penale e kthejne viktime ne nje instrument, “send” te cenuar si qenie njerezore dhe ne interesat e tij pasurore e jopasurore. Ekziston nje lidhje e ngushte midis qellimit te vepres, perfitimit dhe lirimit te personit per kete shkak. Ai shkembet, pra lihet i lire, vetem perkundrejt realizimit te perfitimit te pasurise, perfitimeve dhe qellimeve te tjera te parashikuara ne dispozite.

Ne aspektin subjektiv, ekzistenca ose jo e nje marreveshje apo marredhenie te meparshme mes viktimes dhe autorit te vepres penale mund te perbejne edhe shkakun per kryerjen e vepres penale te rrembimit a mbajtjes peng te personit, por ky aspekt duhet te konsiderohet i perfshire ne qellimin final te realizimit te nje perfitimi te padrejte e te paligjshem, si nje cmim, kompensim per lirimin e viktimes, apo edhe per te lehtesuar gjendjen e te demtuarit qe i eshte hequr liria ne menyre te paligjshme.

Neni 109 eshte i qarte ne kete drejtim, sepse ligjevenesit ka percaktuar vendimtar ne kuptim te anes subjektive realizimin e qellimit “... *per te fituar pasuri ose cdo lloj perfitimit tjeter*” dhe jo shkakun e saj. Pra qellimi i perfitimit dhe lirimi i viktimes perkundrejt realizimit te ketij qellimi, perbejne ne menyre te njekoheshme elemente thelbesore te kesaj vepre penale.

Neni 109 i Kodit Penal (ashtu sikurse edhe neni 110 i tij), duhet te konsiderohet i kryer me heqjen e paligjshme te lirise, rrembimin a mbajtjen peng te viktimes, pavaresisht nese autori ka arritur ose jo te realizoje perfitimet dhe qellimet e parashikuara ne veper dhe perkundrejt te cilave ai do te liroje viktimen.

Nese gjate gjykimit vertetohet natyra e padrejte e perfitimit si motiv per rrembimin a mbajtjen peng, jemi perpara rastit kur nje person privohet nga liria, pra, rrembehjet a mbahet peng dhe i kerkohet nje perfitim i padrejte perkundrejt lirimit te tij. Ne kete rast eshte evidente lidhja e ngushte ndermjet veprimeve te kryera, qellimit te perfitimit te padrejte dhe kerkeses per te dhene perfitimin perkundrejt lirimit te viktimes. Prandaj ne keto raste, Kolegjet cmojne se figura e vepres penale qe duhet te gjeje zbatim eshte ajo e rrembimit ose marrjes peng te personit, neni 109 i K.P.

Po ashtu, fakti qe ka ekzistuar nje kerkim a marredhenie e meparshme qofte edhe e paligjeshme ndermjet te autorit te vepres dhe viktimes, sherben vetem per te individualizuar llojin dhe masen e denimit, por jo aspektet e tjera te anes subjektive qe kerkon neni 109 te Kodit Penal, realizimi i nje perfitimi te padrejte perkundrejt lirimit te viktimes.

Nje nga elementet specifike qe eshte dallues dhe percaktues ne kualifikimin e vepres sipas nenit 109, apo nenit 110 te Kodit Penal lidhet me anen subjektive te tyre, pikerisht me qellimin, motivin e autorit te vepres penale dhe qe ka te beje me realizimin e nje perfitimi pasuror, perfitimeve a qellimeve te tjera (te ngjashme). Kjo situat e del nga vete kuptimi ne teresi i nenit 109 te Kodit Penal ku perfitimet dhe qellimet duhet te jene te padrejta, te perbejne nje interes te paligjshem, per vehte ose per te tjeret, perkundrejt lirimit te viktimes. Motivi dhe qellimi i vepres sipas nenit 109 te K.P. lidhet me realizimin ne menyre te padrejte te nje perfitimi pasuror, te nje qellimi tjetere te paligjshem a ne rruge te paligjshme, perfshire edhe qellime te tjera te ngjashme me ato te permendura shprehimisht ne kete dispozite.

Nderkohe, heqja e paligjshme e lirise nuk i ka te percaktuara motivet ne kuptim te anes subjektive, gje qe do te thote se ato jane te tilla qe nuk perfshihen ne nenin 109 te K.P. ose ne vepra te tjera penale.

Duke analizuar permbytjen e nenit 109 te Kodit Penal rezultojne dy ceshtje thelbesore per anen objektive te kesaj vepre. Keshtu, sjellja dhe veprimet e autorit, sipas nenit 109 te Kodit Penal jane: “rrembimi ose mbajtja peng e personit”, qe ne vetvehte nuk jane gje tjetere vecse veprime qe kane kuptim te njejte ose sjellin si pasoje heqjen e paligjshme te lirise se viktimes. Nga ana objektive, kjo veper penale nuk ka dallim substancial me ate te rrembimit te personit, pavaresisht se dy dispozitat permbytne fjale e terma te ndryshme ne pikepamjen gjuhesore: “rrembim ose mbajtja peng” dhe “heqje e paligjshme e lirise”. Edhe ne rastin e nenit 110, nga pikepamja e anes objektive, eshte e nenkuptuar se heqja e paligjshme e lirise e permban ne vetvete ushtrimin e dhunes, kryerjen e veprimeve te tilla qe cojne ne heqjen e lirise dhe pamundesine e personit per te “levizur” ne liri. Keto veprime jo vetem nuk perjashtojne, por perfshijne si rastet e mbajtjes peng e rrembimit te personit, ashtu edhe forma te tjera te privimit te lirise pa ushtrim dhune fizike te permendura me siper ne interpretimin e nenit 110 te Kodit Penal.

Ne vijim te ketij interpretimi mund te behet edhe dallimi ndermjet nenit 109 dhe nenit 109/b te K.P. Ne rastin e nenit 109/b, ligjvenesit, ka percaktuar qarte se realizimi i anes subjektive, kryerja a moskryerja nga personi e nje veprimi te caktuar, perfitimi ndaj tij ose ne dem te tij, padrejtesisht, i pasurise ose cdo perfitimi tjetere, per vete ose te tretet, nga pikepamja e anes objektive realizohet nepermjet kanosjes dhe formave te tjera te dhunes fizike por qe nuk sjellin si pasoje privimin, heqjen e paligjshme te lirise personale te personit (viktimes). Nderkohe qe, ne nenin 109, realizimin e anes subjektive ligjvenesit e lidh shprehimisht me ushtrimin e formave te vecanta te dhunes: rrembimit ose mbajtjes peng me pasoje privimin, heqjen e paligjshme te lirise personale te viktimes.

Si ne rastin e nenit 109, ashtu edhe per nenin 110 (por edhe neni 109/b) te Kodit Penal, vertetimi i realizimit te qellimit dhe motivit perkates, ardhja e pasojave te parashikuara prej tyre, nuk perbejne elemente percaktues per ekzistencen ose jo te vepres penale, por ajo quhet e kryer qe nga momenti i heqjes se lirise se personit.

Vetegjyqesia, neni 277 i Kodit Penal parashikon ushtrimin e nje te drejte nga personi qe i perket ose qe kujton se i perket dhe qe nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shteteror.

Kjo dispozite synon jo vetem te mbroje ushtrimin e autoritetit shteteror, por edhe qe te parandaloje e ndeshkoje sjelljet dhe veprimet shoqerisht te rrezikshme me te cilat autori i atribuon vetvetes te drejten per te realizuar nje te drejte a zgjidhur nje mosmarreveshje qe ka me te demtuarin, duke shmangur rrugen e parashikuar nga ligji per t'iu drejtuar organit kompetent shteteror. Ne kete kuptim, autori i vepres vepron duke shkelur dhe "zevendesuar" veprimin e organit kompetent, i cili nga ana e tij, ka juridiksionin, kompetencen dhe detyren qe te zgjidhe konflikin mes paleve sipas ligjit, me objektivitet dhe paanshmeri. Ky veprim i autorit, ne vetvete eshte i paligjshem dhe arbitrar.

Nuk do te jemi perpara rastit te vetegjyqesise, ushtrimit arbitrar, te paligjshem te se drejtes, nese autori vepron mbi sendin me synimin per te mbrojtur posedimin e ligjshem dhe aktual te tij te cenuar apo shqetesuar nga veprimi i paligjshem i nje personi te trete, perderisa nuk jemi perpara detyrimit ligjor ose mundesise per t'ju drejtuar organit kompetent shteteror, a gjykates.

Pavaresisht se nuk permendet shprehimisht ne dispozite, nga pikepamja e anes objektive, vetegjyqesia kryhet nga autori nepermjet ushtrimit arbitrar te se drejtes, me forma te ndryshme te dhunes fizike a psikike (kanosjes, etj.), drejtperdrejt mbi personin ose indirekt, duke vepruar mbi sendin a interesin mbi te cilin ekziston apo pretendohet se ekziston e drejta (e ligjshme) e autorit te vepres. Objekti mbi te cilin vepron autori jo domosdoshmerisht eshte ai per te cilin ushtron vetegjyqesine, mbi te cilin ai ka te drejten a interesin e ligjshem ose te pretenduar se i perket autorit.

Gjithashtu eshte e rendesishme qe te ekzistojte mjeti, rruga ligjore dhe mundesia per autorin qe te realizoje te drejten e tij duke iu drejtuar organit kompetent shteteror, e ne vecanti, gjykates.

Duke analizuar sa me siper rrethanat e faktit dhe elementet e figures se veprave penale te vena ne shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arrijne ne perfundimet e meposhteme unifikuese:

Nese mungon perfitimi i padrejte, pra synohet a pretendohet te realizohet nje interes i ligjshem, perkundrejt nderprerjes dhe dhunimit te lirise (rrembimit a marrjes peng te viktimes), atehere jemi perpara vepres penale te heqjes se paligjshme te lirise, neni 110 K.P. e cila konkuron me vepren penale te vetegjyqesise, neni 277 i K.P. Natyra e drejte apo e padrejte e perfitimit a interesit duhet te cmohet jo mbi bazen e vleresimit personal te autorit te vepres, por nisur nga vleresimi objektiv i teresise se rrethanave qe rezultojne ne gjykimin e ceshtjes.

Nga pikepamja e anes subjektive, vetegjyqesia dallon edhe nga shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise, neni 109/b i K.P. Ne rastin e nenit 109/b, autori synon nje perfitim te padrejte, eshte ne dijeni dhe parashikon se ajo qe synon te perfitoje apo pretendon te fitoje eshte e paligjshme dhe e padrejte. Ndersa autori i vepres ne vetegjyqesi synon te realizoje nje te drejte qe i perket apo sipas rrethaneve, pretendon se i perket atij dhe eshte i bindur sipas ketyre rrethanave (edhe pse mund te mos kete te drejte) se ajo qe pretendon se i perket atij eshte e drejte.

Dispozitat e neneve 109, 110 dhe 277 te Kodit Penal parashikojne mbrojtjen e marredhenieve shoqerore qe cenojne personin dhe pasurine. Nderkohe, ne rastin e

vetegjyqesise, mbrohen marredheniet qe lidhen me rendin dhe sigurine publike. Eshte e kuptueshme se ligjvenesit ben nje rregullim specifik por edhe te ndersjellte te marredhenieve te mbrojtura nepermjet ketyre dispozitave penale.

Ne rastet e neneve 109 dhe 110, personi eshte cenuar ne te drejten e tij per te gezuar lirine personale. Rrembimi ose mbajtja peng jane forma te ushtrimit te dhunes fizike te shoqeruara ose jo me elemente te tjere te natyres se dhunes psikike dhe qe synojne e sjellin si pasoje nje rezultat te vetem: heqjen e paligjshme te lirise personale. Per keto arsye, pavaresisht nga dallimi persa i perket anes subjektive, keto dy vepra penale nuk konkurojne me njera-tjetren.

Ndryshe nga nenet 109 dhe 109/b te Kodit Penal, ne kuptim te anes subjektive, ne nenin 277 te ketij Kodi, motivi dhe qellimi lidhen me pretendimin per te mbrojtur nje qellim te drejte a interes te ligjshem. Ne kete rast, veprimet te njejta a te ngjashme ne kuptim te anes objektive nuk ndikojne ne perfundimin qe neni 109 (por edhe neni 109/b) nuk konkuron me nenin 277 te Kodit Penal.

Ne nenin 109, vepra kryhet nepermjet rrembimit a mbajtjes peng (qe jane ne vetvete elemente te heqjes se paligjshme te lirise personale), ndersa ne nenin 109/b parashikohen elementet te tjere te dhunes psikike a fizike qe nuk jane ato te permbajtura ne nenin 109 te K.P. Ne kete kuptim, neni 109 nuk konkuron me nenin 109/b.

Nuk konkurojne me njeri-tjetrin as neni 109/b dhe neni 110 i Kodit Penal, per arsye se ne rastin e pare kemi te bejme me veprime a mosveprime te autorit te vepres me motiv sigurimin e perfitimeve te padrejta, por pa i hequr lirine viktimes se tij. Ndersa ne rastin e nenit 110, edhe pse motivi i kryerjes se vepres eshte i pakonkretizuar (raste qe nuk perfshihen ne nenin 109), thelbesore eshte kryerja e saj duke i hequr ne menyre te paligjshme lirine viktimes.

Nderkohe qe konkurojne me njeri-tjetrin neni 110 me nenin 277, per arsyen thelbesore qe vetegjyqesia, neni 277, konsumohet per motive te mbrojtjes se nje te drejte a interesi te ligjshem, pa ju drejtuar organit kompetent. Pavaresisht nga e drejta dhe interesi i ligjshem qe mbrohet, veprimet e autorit, te cdo forme qofshin, drejtohen ndaj personit ose sendeve, ne menyre arbitrare. Nese keto veprime behen duke u shoqeruar me format e privimit te lirise se personit atehere autori ka konsumuar edhe nje veper tjeter penale, ate te heqjes se paligjshme te lirise, neni 110 i K.P.

Bazuar ne arsyetimin e mesiperm, rezulton se te gjykuarit kane konsumuar veprat penale te heqjes se paligjshme te lirise dhe vetegjyqesise, ne bashkepunim me njeri tjetrin, parashikuar nga nenet 110/2 dhe 277 e 25 te K.P.

Gjykata, ne analize te rrethanave te faktit, personalitetit te secilit te gjykuar dhe rrezikshmerise se tyre ashtu sikurse kane pranuar gjykatat e tjera ne arritjen e perfundimeve te tyre, cmon se te gjykuarit Edi Biba dhe Tonin Pjetri duhet te denohen per vepren penale te heqjes se paligjshme te lirise me nga 3 vjet burgim, ndersa, i gjykuari Paulin Prenga me 3 vjet e 6 muaj burgim, ndersa per pjeset e tjera vendimi i gjykates se apelit duhet te lihet ne fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne baze te nenit 141/2 te Kushtetutes, te neneve 14/c dhe 17/b te Ligjit "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykates se Larte te Republikes se Shqiperise" dhe te nenit 438 te K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N:

Lenien ne fuqi te vendimit nr.163, date 11.3.2004 te Gjykates se Apelit Tirane lidhur me deklarimin fajtor te te gjykuarve per vepren penale te vetegjyqesise dhe per per te gjykuarin Paulin Prenga edhe per mbajtje arme pa leje.

Ndryshimin e vendimit persa i perket cilesimit juridik te vepres penale, duke i deklaruar te tre te gjykuarve fajtores per vepren penale te heqjes se paligjeshme te lirise sipas nenit 110/2 te K.P.

Denimin e te gjykuarve Edi Biba dhe Tonin Pjetri me tre vjet burgim dhe te gjykuarin Paulin Prenga me 3 vjet e gjashte muaj burgim. Ne zbatim te nenit 55 te K.P., ne bashkim te denimit, i gjykuari Paulin Prenga denohet perfundimisht me 3 vjet e gjashte muaj burgim.

Ky vendim per njehsimin e praktikës gjyqesore dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 25.03.2005

MENDIMI I PAKICËS

Në vendimin Unifikues nr.1, datë 25.03.2005, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pakica nuk është dakord me vendimin e shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si përsa i përket zgjidhjes që u dha prej saj në këtë çështje (dispozitivit), ashtu edhe pjesës arsyetuese të tij, rrjedhojë e së cilës është kjo zgjidhje.

Nga aktet e dosjes rezulton se ditën e ngjarjes, gjatë kohës që i dëmtuari Besnik Lleshi ishte duke drekuar me dy shokë të tij në një lokal në fshatin Fierzë (Kurbin), tre të gjykuarit, duke qënë të armatosur me lloje të ndryshme armësh luftarake (pistoletë, automatik dhe pushkë të gjatë), kanë shkuar atje me automjetin e tyre dhe, pa bërë ndonjë bisedë të mëparëshme me këtë të dëmtuar, duke i drejtuar armën, e detyruan që t'i shoqëronte në automjetin e tij që ndodhej i ndaluar në rrugë, para lokalit. Me çelsat që i morën të dëmtuarit, nën kërcënimin e armës, hapën derën e automjetit të këtij të fundit dhe, pasi, po me kërcënimin e armëve, e hypën në sedilen e përparëme të pasagjerit, mbrapa së cilës, me armë të drejtuar mbrapa kokës së tij, u ul i gjykuari Pjetri, i gjykuari Biba nisi automjetin në drejtim të qytetit të Lezhës, kurse i gjykuari i tretë, Prenga, i ndiqte nga mbrapa me automjetin me të cilin ata kishin shkuar në vendin e fillimit të kësaj ngjarjeje.

Pa arritur ende në fshatin Pllan, të gjykuarit e urdhëruan të dëmtuarin, që t'u jepte 10 milion lireta italiane (sipas të dëmtuarit për t'ia dhënë një personi me emrin Altin Nikolli, të cilin ata e quanin "Kapo", kurse sipas gjykatave, për llogari të një borxhi). Ndërkohë, nën kërcënimin e armëve i grabitën 500 mijë lireta që i kishte me vete.

Gjykatat, përfshirë edhe shumicën e Kolegjeve të Bashkuara, pranojnë se, duke qënë që policia, e lajmëruar nga shokët e të dëmtuarit, ishte vënë në ndjekje, për t'i shpëtuar kapjes të gjykuarit lanë automjetet në një rrugë dytësore dhe për t'u shmangur, filluan të ngjiten në një rrugë malore fshati, ku, duke qënë vazhdimisht të ndjekur nga policia, u detyruan ta lënë të lirë të dëmtuarin dhe vetë u larguan me shpejtësi për t'u fshehur, duke u rënë madje dhe njëra nga armët në vendin e ngjarjes.

Duke e reduktuar ngjarjen vetëm në shpjegimet e të gjykuarve, sipas të cilave veprimet si më sipër i kishin kryer për të marrë nga i dëmtuari një sasi të hollash që njerit prej tyre i a kishte dërguar nëpërmjet tij, vëllai nga Italia, shumica i cilësoi ato si vetëgjyqësi, heqje të paligjshme të lirisë dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake, vepra penale këto të parashikuara nga nenet 277, 110/II dhe 278/II të K.Penal. Prokuroria i kishte akuzuar ata për krimet e rrëmbimit të personit dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga neni 109 i K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij dhe neni 278/II i këtij Kodi, qëndrim që u mbajt edhe nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithëshme gjatë shqyrtimit të çështjes si në Kolegjin Penal, ashtu edhe në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pakica është e mendimit se kërkesa e prokurorit është e drejtë dhe duhej të ishte pranuar.

Në këtë përfundim pakica, ndryshe nga mënyra e copëzuar që përdor shumica për të bërë interpretimin e dispozitave të neneve 109, 110/II dhe 277 të K.Penal, në të cilat janë parashikuar,

përkatësisht figurat e veprave penale të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë, arriti duke ballafaquar përmbajtjen e secilës prej tyre me njëra tjetrën (interpretimi sistematik).

Pakica niset së pari nga përmbajtja e dispozitës së nenit 109 të K.Penal, në të cilën parashikohet figura e krimit të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, dispozitë në të cilën, në mënyrë qartësisht të shprehur, përkruhen format dhe mënyrat nëpërmjet të cilave kryhet kjo vepër penale nga ana objektive.

Ligjvënësi në këtë dispozitë ka përcaktuar dy format nëpërmjet të cilave kryhet kjo figurë krimi nga ana objektive, që janë: a) rrëmbimi i personit dhe b) mbajtja peng e tij. Mjafton ekzistenca e njëres prej tyre për të patur të plotësuar anën objektive të saj. Dhe, për të dalluar figurën e krimit të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit (neni 109 i K.Penal) nga figura e veprave penale të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë (nenet 110 dhe 277 të K.Penal), i ka kushtëzuar, si rrëmbimin, ashtu edhe mbajtjen peng, me anën subjektive të autorit të tyre (rrëmbimit apo mbajtjes peng i personit). Kushtëzimi konsiston në faktin që jo çdo lloj rrëmbimi apo mbajtje peng i personit (pavarësisht nga mënyra dhe mjetet e përdorura), do të përbëjë rrëmbim apo mbajtje peng, si element të anës objektive të figurës së krimit, të parashikuar nga neni 109 i K.Penal.

Sipas kësaj dispozite (nenit 109 të K.Penal), këto veprime (rrëmbimi dhe mbajtja peng e personit) do të përbëjnë anën objektive të figurës së krimit që parashikohet prej saj, me kushtin dhe vetëm atëherë kur kryhen për të arritur një nga qëllimet e renditura shprehimisht në përmbajtjen e vetë kësaj dispozite. Pikërisht këto qëllime përbëjnë edhe qëllimin e posaçën që është elementi karakteristik, i cili, përveç dashjes direkte, përbën anën subjektive të figurës së krimit të parashikuar në nenin 109 të K.Penal. Ky është edhe elementi bazë që dallon këtë figurë krimi nga figura e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë (neni 110 i K.Penal). Po të niseshim vetëm nga ana objektive, vështirë se do bëhej i mundur dallimi midis tyre, pasi si rrëmbimi (në kuptimin e përgjithshëm të kësaj fjale), ashtu edhe mbajtja peng e personit janë dy nga mënyrat që ndeshen më shpesh në praktikën e gjykatave, nëpërmjet të cilave realizohet vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë. Kjo e fundit mund të kryhet nisur nga motive dhe për të arritur qëllime nga më të ndryshmet, përjashtuar qëllimet dhe motivet, të cilat ligjvënësi i ka përmendur në mënyrë alternative, në përmbajtjen e dispozitës së nenit 109 të K.Penal.

Si qëllime të kësaj natyre, ligjvënësi ka renditur:

- a) për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër;
- b) për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi;
- c) për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi;
- ç) për t'iu shmangur dënimit;
- d) për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara;
- dh) për qëllime politike dhe
- e) për çdo qëllim tjetër.

Këtëj arrihet lehtë në përfundimin se edhe ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk i njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror (që përbën thelbin e figurës së kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë, parashikuar nga neni 277 i K.Penal), kur nuk shoqërohet me veprime që përbëjnë rrëmbim, apo mbajtje peng të personit, përbën figurën e kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë. Kurse në rastet kur ushtrimi i kësaj të

drejte (që i përket ose që kujton se i përket) shoqërohet me veprime të subjektivit, të cilat përbëjnë ose rrëmbim, ose mbajtje peng të personit nga i cili kërkohet realizimi i një të drejte të tillë, vepra cilësohet jo më si vetëgjyqësi (neni 277 i K.Penal), por si rrëmbim apo mbajtje peng e personit. Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa i u drejtuar organit kompetent shtetëror, në këtë rast, përbën një nga format e konkretizimit të qëllimeve - element i anës subjektive të figurës së krimit të parashikuar nga neni 109 i K.Penal. Me këtë duhet kuptuar që vetë figura e kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë, në këtë rast, përbën anën subjektive të figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit - qëllimin e saj. Për rrjedhojë, e para, në këtë rast, thithet nga figura e krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit.

Pakica është e mendimit që, sa u vunë në dukje në këto dy paragrafe, duhej të përbënin edhe një nga përcaktimet unifikuese (sentencat) e këtij vendimi, përcaktime që, për hir të së vërtetës, duhet thënë që në mos i mungojnë, nuk mund të dallohen qartë midis rreshtave të vendimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara.

Përcaktimin e dytë unifikues, sipas pakicës, duhej ta përbënte përfundimi, sipas të cilit edhe pse rrëmbimi apo mbajtja peng e personit në rrethana të zakonshme, janë nga ato veprime që, zakonisht, përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, parashikuar nga neni 110 i K.Penal, kur kryhen për realizimin e ndonjërit prej qëllimeve që përmenden në dispozitën e nenit 109 të këtij Kodi, duhet të cilësohen si rrëmbim apo mbajtje peng të personit, figurë krimi kjo që parashikohet pikërisht nga kjo dispozitë.

Kështu që, ndërsa në rastin e parë, veprimet e vetëgjyqësisë përbënin anën subjektive të figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të të dëmtuarit Besnik Lleshi, në rastin e dytë, veprimet që konsistojnë në heqjen e paligjshme të lirisë së tij përbëjnë anën objektive të kësaj figure krimi (nenit 109 të K.Penal).

Pakica është e mendimit se nuk mund të ketë konkurim as midis figurës së veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë (kur veprimet drejtohen ndaj të njëjtëve persona) dhe figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng; as midis kësaj të fundit dhe figurës së kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë (kur si në rrëmbimin apo mbajtjen peng, ashtu edhe nga vetëgjyqësia dëmtohen të njëjtët persona). Për rrjedhojë, duke qënë se në të drejtën penale vepron parimi që, në këto raste, vepra më e lehtë thithet nga ajo më e rëndë, Kolegjet e Bashkuara duhej të prishnin vendimet e dy gjykatave dhe t'i deklaronin fajtorë të gjykuarit për krimin e parashikuar nga neni i 109 K.Penal, në lidhje me nenin 25 të tij.

Përsa i përket krimit të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të tre të gjykuarit duhej të ishin deklaruar fajtorë.

Spiro Spiro

Perikli Zaharia

Valentina Kondili

Vladimir Bineri

Besnik Imeraj

Irma Bala

Nr.2 i Regj.Themeltar
Nr.2 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbera nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Kristaq Ngjela	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Perikli Zaharia	Anetar
Evjeni Sinojmeri	Anetare
Vladimir Bineri	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Irma Bala	Anetare
Spiro Spiro	Anetar
Shpresa Beçaj	Anetare

ne seancen gjyqesore te dates 30.6.2004 moren ne shqyrtim çeshtjen penale nr.2, qe i perket:

TË PANDEHURVE:

KUJTIM GJURA
KUJTIM DERVISHI
NAZMI ÇELA
AGIM DEMAJ
ILIR TOPI
ILIR DAUTI

A K U Z A:
Shperdorim detyre,
parashikuar nga neni 70/2 i K.P.Ushtarak,
shperdorim detyre,
parashikuar nga neni 248 i K.P.,
dhe shkelje te rregullave te sherbimit te rojes,
parashikuar nga neni 41/2 i K. P.Ushtarak.

Gjykata Ushtarake e Rrethit Tirane, me vendimin nr.217, date 23.7.2003, ka vendosur:

Deklarimin fajtor te te pandehurit Kujtim Gjura per vepren penale te shperdorimit te detyres dhe ne baze te nenit 70/2 te K.P.Ushtarak, denimin e tij me 3 vjet burg, duke i filluar vuajtja e denimit nga data e ndalimit 08.08.2002.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Kujtim Dervishi per vepren penale te shperdorimit te detyres dhe ne baze te nenit 70/2 te K.P.Ushtarak, denimin e tij me 3 vjet burg, duke urdheruar qe ne baze te nenit 59 te K.P., ky denim te mosekzekutohet per nje kohe prej 2 vjet, qe eshte koha e proves.

Deklarimin e pafajshem te te pandehurit Nazmi Çela per vepren penale te shperdorimit te detyres, parashikuar nga neni 248 i K.P.

Deklarimin fajtor te te pandehurve Agim Demaj, Ilir Topi dhe Ilir Dauti per vepren penale te shkeljes se rregullave te sherbimit te rojes dhe ne baze te nenit 41/2 te K.P.Ushtarak denimin e secilit prej tyre me nga 1 vit e 9 muaj burg, duke i filluar vuajtja e denimit nga data 8.8.2002.

Gjykata Ushtarake e Apelit Tirane, me vendimin nr.72, date 21.10.2003:

Ka lene ne fuqi vendimin nr.217, date 23.7.2003 te Gjykates Ushtarake te Rrethit Tirane.

Kunder vendimit te Gjykates Ushtarake te Apelit dhe gjykates ushtarake te shkalles se pare, kane paraqitur rekurs te gjykuarit, te cilet kerkojne prishjen e vendimit dhe pafajesi, duke parashtruar keto shkaqe:

I gjykuari Agim Demaj:

- Nuk jane zbatuar nga gjykata kerkesat e nenit 3 dhe 380 te K.Pr.P., te cilat percaktojne detyrimin e gjykates per te marre vendimin vetem mbi bazen e atyre provave qe jane marre, ose verifikuar ne seance gjyqesore gjate shqyrtimit te ceshtjes.
- Vendimit i mungojne elementet e percaktuar ne nenin 383 germa "ç" te K.Pr.P. Po ashtu edhe gjykata e apelit nuk e ka arsyetuar vendimin e saj.
- Nga ana e te dyja gjykatave nuk jane marre prova te rendesishme te kerkuara nga ana jone dhe qe kane te bejne drejtperdrejt me gjykimin e kesaj ceshtje sic eshte administrimi i kasetave te regjistrimit te veprimtarise se punonjesve edhe te te pandehurve, gje qe do te provonte pafajesine e tij.
- I gjykuari akuzohet per vepren penale te shkeljes se rregullave te sherbimit te rojes qe ka sjelle pasoja te renda, parashikuar nga neni 41/2 i K.P.Ushtarak. Duke iu referuar kesaj dispozite element i domosdoshem i anes objektive eshte ekzistenca e pasojes se rende. Pra ne rastin konkret nuk ka ardhur pasoje dhe nuk kemi veper penale.
- Nuk jane respektuar kerkesat e nenit 14 e vijues te K.P. Nuk u provua asnje nga format e fajit, dashja apo pakujdesia ne kryerjen e detyres nga i gjykuari, por perkundrazi u provua se ai ka qene korrekt ne kryerjen e detyres, profesional dhe si rezultat i veprimeve te tij u be e mundur parandalimi i pasojes, largimi i te denuarve. Pra vepres i mungon edhe ana subjektive.

I gjykuari Kujtim Dervishi:

- Vendimi i gjykates se apelit eshte i padrejte dhe allogjik sepse ai eshte rrjedhoje e mosrespektimit dhe interpretimit te gabuar te ligjit material.
- I pandehuri per vepren penale qe eshte akuzuar dhe denuar, nuk eshte subjekt i juridiksionit penal ushtarak, por i nenshtrohet juridiksionit te zakonshem. Ai nuk eshte subjekt i dispozites te parashikuar nga neni 70/2 i K.P.Ushtarak, sepse ai nuk ka qene i inkuadruar me sherbim ne

kohen kur ka ndodhur vepra penale dhe per rrjedhoje, duhet te pergjigjet sipas nenit 248 te K.P. (Civil).

- Si persa i perket nenit 248 te K.P., ashtu edhe nenit 70/2 te K.P.Ushtarak, i gjykuari Kujtim nuk ka konsumuar asnjeren nga veprat penale, pasi mungon nje nga elementet e saj, pasoja. I gjykuari Kujtim Gjura:
- Eshte zbatuar gabim ligji material. Oficeri i policise se burgjeve nuk mund te jete subjekt i nje vepre penale ushtarake. Objekti i cenuar nuk eshte i fushes se mbrojtjes, por i nje fushe civile.
- Nga ana objektive, vepra penale e shperdorimit te detyres qofte ushtarake, qofte civile, kerkon domosdoshmerisht ardhjen e nje pasoje te rende. Me pasoje te rende gjykatat kane pranuar ate qe eshte çrregulluar veprimtaria normale e institucionit. Kuptimi i pasojes se rende duhet te jete real, i dukshem dhe jo abstrakt.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr.264 akti, date 19.5.2004, ka vendosur:

Dergimin e ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara per njehsimin e praktikese gjyqesore per t'u mbajtur qendrim i unifikuar sa me poshte:

Punonjesit e policise se burgjeve barazohen apo jo me ushtaraket per efekt te zbatimit te perkohshem te Kodit Penal Ushtarak.

Nese punonjesit e policise e gezojne apo jo cilesine e ushtarakut.

Cilesimi juridik i veprave penale te kryera nga te pandehurit do te behet ne baze te nenit 248 te K.P.Ushtarak apo ne baze te nenit 70 te Kodit Penal Ushtarak.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e gjyqtareve Artan Hoxha dhe Kristaq Ngjela, prokurorin Skender Breca, i cili kerkoj lenien ne fuqi te vendimeve, mbrojtessin e te gjykuarit Kujtim Dervishi, avokatin Ridvan Shkemi, i cili kerkoj deklarimin e pafajshem te te gjykuarit, dhe pasi biseduan çeshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Vendimet e te dy gjykatave duhet te prishen per shkak te aplikimit te gabuar te ligjit penal.

Rezulton se te gjykuarit jane akuzuar per veprat penale te shperdorimit te detyres nga ushtaraku, shperdorimit te detyres, shkeljes se rregullave te sherbimit te rojes, sikurse eshte paraqitur ne pjesen hyrese te vendimit, per shkak se ne daten 06.08.2002, ne Burgun e Sigurise se Larte 302 ne Tirane, te burgosurit Gazmend Braka, Viktor Ymeri dhe Taulant Balliu, kane tentuar te largohen prej tij. Nga gjykimi, ka rezultuar se te burgosurit kane hapur murin ndermjet dhomave 10 e 11 si dhe te banjove te ketyre dhomave dhe kane dale ne ambjente te tjera te burgut, por ne tentative per tu larguar, ata jane kapur. Sipas organit te akuzes ngjarja ka ndodhur edhe per shkak se te gjykuarit duke shkelur rregullat e caktuara per ta ne aktet ligjore e nenligjore, kane krijuar kushte te favorshme, me moszbatimin e detyres se tyre, qe te burgosurit te tentojne te largohen nga vendi i vuajtjes se denimit.

Gjykatat, me perjashtim te Drejtorit te Burgut 302, te gjykuarit Nazmi Çela, te cilit i kane dhene pafajesi, per akuzen e shperdorimit te detyres, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, te gjykuarit e tjere i kane deklaruar fajtores per akuzat ne ngarkim te tyre sipas dispozitave te Kodit Penal Ushtarak, (me poshte K.P.U.). Konkretisht, te gjykuarin Kujtim Gjura, me detyren e specialistit te policise per rregjimin e brendshem ne burg dhe Kujtim Dervishin, shef i policise se burgut, i ka deklaruar fajtores per shperdorimin e detyres nga ushtaraku, parashikuar nga neni 70/2 i K.P.Ushtarak, ndersa te gjykuarit Agim Demaj me detyren e inspektorit te informacionit dhe te gjykuarit Ilir Topi dhe Ilir Dauti, me detyren e policit te regjimit te brendshem, i ka gjetur fajtores

dhe denuar per vepren penale te shkeljes se rregullave te sherbimit te rojes, parashikuar nga neni 41/2 i K.P.Ushtarak.

Kunder vendimit te Gjykates Ushtarake te shkalles se pare Tirane, nr.217, date 23.07.2003 dhe te Gjykates Ushtarake te Apelit nr.72, date 21.10.2003, kane paraqitur rekurs ne Gjykatën e Larte te gjykuarit Agim Demaj, Kujtim Dervishi e Kujtim Gjura, te cilet kerkojne te deklarohen te pafajshem. Veç shkaqeve te tjera, ata kane parashtruar edhe se gabimisht si organi i prokurorisë, ashtu edhe gjykatat, kane pranuar t'i trajtojne ata si subjekte te procedimit penal ushtarak, nderkohe qe nuk jane subjekte te tij.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ne seancen gjyqesore te dates 19.5.2004, vendosi ta kaloje çeshtjen per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara, per te unifikuar praktiken gjyqesore lidhur me sa pretendohet prej te gjykuarve, nese ata si punonjes te policise se burgjeve, do te trajtohen si subjekte ushtarake per efekte te pergjegjesise penale, ose jo.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, e gjejne te bazuar pretendimin e te gjykuarve lidhur me faktin se ata nuk jane subjekt i posaçem dhe per pasoje ata nuk kane pergjegjesi penale sipas dispozitave te K.P.Ushtarak. Kushtetuta e Republikës se Shqiperise, e cila shfuqizoi Dispozitat Kryesore Kushtetuese te vitit 1991, ka bere nje ndryshim thelbesor lidhur me percaktimin e struktures se forcave te armatosura. Sipas Dispozitave Kryesore Kushtetuese, ne forcat e armatosura perfshiheshin ushtria, forcat e Ministrise se Brendshme dhe forcat e Sherbimit Informativ Kombetar. Ndersa sipas nenit 168 te Kushtetutes, forcat e armatosura te Republikës se Shqiperise perbehen nga forcat tokesore, detare dhe ajrore. Si rezultat i ketij ndryshimi kushtetues, tashme ne forcat e armatosura nuk bejne me pjese forcat e Ministrise se Rendit, sherbimit informativ dhe struktura te tjera policore qe funksionojne ne Shqiperi. Ky ndryshim kushtetues, sjell efekte edhe lidhur me poziten e posaçme te subjekteve lidhur me pergjegjesine penale.

Fakti qe ne forcat e armatosura perfshihen vetem ato te ushtrise, ve per diskutim nese personat e barazuar me ushtaraket dhe qe kane natyre te perafert funksionale, a duhet te konsiderohen te barabarte edhe per efekte te pergjegjesise penale per vepra penale te kryera ne detyre.

Neni 6 i K.P.Ushtarak i pandryshuar, me ushtarak kuptonte ata persona qe bejne pjese ne forcat e armatosura, si dhe ata persona qe ligji i barazon me ushtaraket. Bazuar mbi kete dispozite e cila ka qene ne fuqi deri ne korrik te vitit 2002, edhe pse Kushtetuta kishte bere percaktime te ndryshme te perberjes se forcave te armatosura, subjekte si Policia e Shtetit, Policia e Burgjeve apo te barazuara me ta, jane trajtuar si subjekte te posaçme te procedimit penal ushtarak, per vepra te kryera ne detyre.

Me Ligjin nr.8919, date 04.07.2002, ne K.P.U. jane bere ndryshime te rendesishme te cilat kane pasqyruar dallimin thelbesor qe Kushtetuta e vitit 1998 ka ne raport me ate te vitit 1991, lidhur me perberjen e forcave te armatosura. Keshtu ne nenin 6 te ndryshuar te K.P.Ushtarak eshte percaktuar se me ushtarak kuptohen ata persona qe bejne pjese ne forcat e armatosura. Po ashtu ne kete nen, percaktohet se subjekte te ketij kodi, jane edhe persona te tjere te percaktuar si te tille sipas ligjit te veçante.

Keto ndryshime te bera ne K.P.U., kane percaktuar tashme qarte se dispozitat e ketij kodi aplikohen vetem per ushtaraket e forcave te armatosura, te tjere qe ligji i posaçem i percakton si subjekte te pergjegjesise penale ushtarake, si dhe ata qe kryejne vepra penale ne bashkepunim me ushtaraket (neni 2 dhe 5 i K.P.U.).

Per te arritur ne perfundimet e veta, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, veç ndryshimeve te bera ne K.P.Ushtarak, analizuan edhe legjislacionin qe rregullon veprimtarine e policise se shtetit, statusin e ushtarakut te forcave te armatosura, ligjin per policine e burgjeve dhe akte te tjera nenligjore te dala ne baze e per zbatim te tyre. Ne nenin 56 te ligjit nr.8553, date 25.11.1999, "Per policine e shtetit", eshte percaktuar se "*punonjesi i policise i nenshtrohet*

juridiksionit penal te zakonshem, ndersa per veprat penale te kryera ne sherbim, pergjigjet sipas dispozitave te vecanta te K.Penal". Ndersa ne nenin 68/2, eshte percaktuar qe "*deri ne miratimin e dispozitave te parashikuara ne nenin 56 te ketij ligji, punonjesi i policise, per vepra penale te kryera ne sherbim, pergjigjet sipas dispozitave te K.P.Ushtarak te Republikes se Shqiperise".* Sikurse rezulton nga keto dy dispozita, por edhe nga ligji ne teresi, edhe pse trajtimi i punonjesve te policise se shtetit behet sipas statusit te ushtarakut te forcave te armatosura, ata jane subjekte te juridiksionit penal te zakonshem dhe jo te atij ushtarak. Megjithate, duke marre ne konsiderate vecantine e funksioneve te policise se shtetit, ligji ka vene detyre qe te plotesohet Kodi Penal me dispozita te posacme, te cilat te rregullojne pergjegjesine penale te punonjesit te policise. Deri me sot, keto dispozita akoma nuk i jane shtuar ketij Kodi e per pasoje, deri me daljen e tyre, per veprat penale te kryera ne detyre nga punonjesit e policise se shtetit, do te aplikohen dispozitat e K.P.Ushtarak. Kjo parashikohet ne menyre te shprehur ne ligj, sikurse citohet me larte.

Ky status tranzitor i pozites se punonjesit te policise se shtetit lidhur me pergjegjesine e tij penale, percaktuar ne ligj, i çon Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne perfundimin unifikues se, **punonjesit e policise se shtetit qe kryejne vepra penale gjate ushtrimit te detyres se tyre deri ne daljen e dispozitave te posacme per ta ne K.Penal, do te jene subjekte dhe do te pergjigjen sipas dispozitave te K.P.Ushtarak. Aktualisht ata jane subjekte te procedimit penal sipas K.P.Ushtarak, per vepra te krvera gjate sherbimit.**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, nuk mbajne te njejtin qendrim lidhur me punonjesit e policise se burgjeve, apo subjekte te tjera qe per efekte te statusit gezojne te drejta te njejta me ate te policise se shtetit. Ne nenin 1 te ligjit "Per policine e burgjeve", nr.8321, date 02.04.1998, eshte bere nje ndryshim i mevonshem, me te cilin, policia e burgjeve gezon te gjitha te drejtat qe parashikon ligji per policine e shtetit, ne vend te rregullimit te meparshem, i cili percaktonte barazine ne te drejta, me ushtarakun e forcave te armatosura. Ne keto ndryshime te vitit 2001, nuk ka ndonje dispozite qe te percaktoje pozite te posacme lidhur me pergjegjesine penale te punonjesve te policise se burgjeve, sikurse ka bere ligji per policine e shtetit.

Nga kjo, Kolegjet e Bashkuara cmojne se barazimi ne te drejta i policise se burgjeve me policine e shtetit nuk passjell edhe juridiksion penal te njejte per ta. Edhe po t'i referohemi rregullimeve te bera ne dispoziten e nenit 6 te K.P.Ushtarak, rezulton se eshte shfuqizuar pjesa qe percaktonte se subjekte te ketij kodi, vec ushtarakeve, jane edhe personat qe ligji i barazon me ta. Po ashtu, ne menyre me eksplicite kjo dispozite kalon nga barazia me ushtaraket, tek percaktimi i shprehur se subjekte te ketij kodi, vec ushtarakeve, jane edhe persona te tjere te percaktuar si te tille me ligj te vecante.

Ne nje veshtrim me te pergjithshem, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arrijne perfundimin unifikues se, **pergjegjesia penale eshte kurdohere e percaktuar ne menyre te shprehur ne dispozita te vecanta, ajo nuk mund te jete kurre e nenkuptuar dhe te nxirret me analogji. Per pasoje, derisa nuk ka nje dispozite te posacme me karakter penal ne ligjin per policine e burgjeve, punonjesit e saj per vepra penale qe kryejne ne detyre, duhet te pergjigjen sipas dispozitave te K.P. e jo atij Penal Ushtarak. Barazia ne status nuk nenkupton edhe juridiksion te njejte penal.**

Kolegjet e Bashkuara bazuar ne parimin kushtetues dhe procedural te mosrendimit te pozites, per shkak se ceshtja eshte shqyrtuar nga gjykata e apelit, po ashtu edhe nga Gjykata e Larte vetem mbi ankimin e te gjykuarve, ne eventualitetin se ata gjenden fajtor per vepra penale qe lidhen me detyren sipas Kodit Penal (Civil), denimi, nuk duhet te kaloje denimet e dhena me pare. Gjykatat ne rishqyrtim nuk mund te rendojne poziten e te gjykuarve (*reformatio ne peius*).

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 141/2 të Kushtetutës, nenit 441 germa “ç” të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 17 të Ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.217, datë 23.7.2003 të Gjykatës Ushtarake të Rrethit Tiranë dhe vendimit nr.72, datë 21.10.2003 të Gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë dhe dergimin e ceshtjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.

Dergimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njehson praktiken gjyqësore.

Tiranë, më 30.06.2004

MENDIMI I PAKICËS

Në lidhje me vendimin nr.2, datë 30.06.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nuk jemi dakord me mendimin e shumicës së Kolegjeve të Bashkuara, shprehur në vendimin nr.2, datë 30.06.2004, të tyre, jo në tërësi, por vetëm pjesë që i përket moszbatimit të Kodit Penal Ushtarak, kuptohet, përkohësisht, për veprat penale që kryhen nga punonjësit e policisë së burgjeve gjatë shërbimit, në zbatim të ligjit 8321, datë 02.04.1998, ndryshuar me ligjin 8757, datë 26.03.2001 "Për Policinë e Burgjeve".

Shumica, me arsyetimin se përgjegjësia penale nuk është e nënkuptuar dhe nuk mund të nxirret me analogji, pohim ky që, edhe për mendimin tonë, si rregull, është teorikisht i drejtë, arrin në përfundimin se: “... derisa nuk ka një dispozitë të posaçme në ligjin për Policinë e Burgjeve, punonjësit e saj për veprat penale që kryejnë në detyrë, duhet të përgjigjen sipas dispozitave të K.P. e jo atij Penal Ushtarak” dhe se “Barazia në status nuk nënkupton edhe juridiksion të njëjtë penal”.

Këto përfundime në kushtet e mangësive, jo aq të ligjit të përmendur për Policinë e Burgjeve, por, më tepër, të mos plotësimit të K.Penal edhe me dispozita të veçanta për vepra penale të kryera, si nga punonjësit e kësaj policie, ashtu edhe të Policisë së Shtetit, për shkak të

disa detyrave specifike që ato kryejnë, i konsiderojmë të parakohëshme dhe, përsa i përket rastit kur ato kryhen nga të parët (punonjësit e policisë së burgjeve) me pasoja në drejtim të dobësimit të rolit parandalues që duhet të luajë dënimi penal për forcimin e disiplinës së punës në një sektor sa të rëndësishëm aq edhe delikat për interesat e shtetit e të shoqërisë, sikurse janë burgjet.

Në fillim nënvizuam faktin se nuk jemi dakord përsa i përket moszbatimit përkohësisht të K.Penal Ushtarak për këtë kategori personash, pasi, çmobjmë nevojë urgjente plotësimin e Kodit Penal me dispozita të posaçme që të parashikojnë, si vepra penale, disa raste specifike moskryerje të detyrës funksionale nga ana e punonjësve të Policisë së Burgjeve që kanë të bëjnë: me ruajtjen e vëndeve të vuajtjes së dënimit me burgim dhe zbatimin e rregullave të brendshme në to, në përgjithësi dhe me ruajtjen perimetrike; hyrjet e daljet në institucionet e vuajtjes së dënimit, sigurimin e zbatimit të rregullave të brëndshme dhe të sigurisë brenda këtyre institucioneve; shoqërimin e të dënuarit gjatë transferimeve, në lejet speciale dhe në lëvizjet jashtë institucionit, si dhe në sigurimin e ruajtjes së të dënuarve në spitale ose qendra të tjera mjekësore, në veçanti, raste këto që kanë të bëjnë me masat që duhet të merren për kryerjen me korrektësi të detyrave funksionale që parashikohen nga neni 5 i ligjit për Policinë e Burgjeve.

Sjellim në vëmendje se në Kodin Penal Ushtarak, në nenet 41, 42/1, 44 dhe 45 të tij parashikohen, perkatësisht, veprat penale të shkeljes së rregullave të shërbimit të rojes; shkelja e rregullave të shërbimit të rojes në objekte të rëndësishme (theksojmë se burgjet si tek ne edhe kudo gjetkë janë konsideruar dhe vazhdojnë të konsiderohen objekte të tilla); shkelja e rregullave të shoqërimit dhe mos caktimi i rojeve.

Këto, për nga natyra e tyre, janë përafërsisht të të njëjtit lloj me ato që u renditën në një paragraf më lart dhe në kushtet aktuale (të mungesës së dispozitave të posaçme, analoge, në Kodin Penal), nëse do të pranohet si i drejtë mendimi i shumicës, do të mbeteshin pa u ndëshkuar, përveç masave disiplinore, edhe me masa penale.

Prandaj, nisur nga barazimi jo vetëm ligjor, por edhe faktik që, në kushtet aktuale, i është bërë statusit të këtyre dy policive (Policisë së Shtetit dhe asaj të Burgjeve) pa devijuar nga rregulli që pergjegjesia penale nuk është e nenkuptuar dhe nuk mund të nxirret me analogji, mendojmë se do të ishte më e drejtë dhe me vlera praktike që për punonjës me të njëjtin status, deri në plotësimin e Kodit Penal, të zbatohet urdhërimi kalimtar i nenit 68/II të ligjit "Për Policinë e Shtetit" edhe për punonjësit e "Policisë së Burgjeve", urdherim ky nepermjet te cilit vete ligjvenesi, ka shprehur vullnetin për të bere perjashtim te perkohshem nga rregulli i permendur.

Perikli Zaharia

Spiro Spiro

Nr.1 i Regj. Themeltar
Nr.1 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Zamir Poda	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Perikli Zaharia	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Ylvi Myrtja	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Evjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare
Shpresa Beçaj	Anetare

ne seancen gjyqesore te dates 16.04.2004 moren ne shqyrtim ceshtjen per mosmarreshjen e kompetences se gjykimit ne shkalle te dyte, qe i perket:

TË PANDEHURIT: EDUARD NDREU

A K U Z A:

Kryerjen e vepres penale
te trafikimit te femrave per prostitucion,
parashikuar ne nenin 114/b/2 te K.Penal.

Gjykata e shkalles se pare Mirdite, me vendimin nr.104, date 24.11.2003,

E ka denuar te pandehurin per vepren penale per te cilen akuzohet, duke caktuar nje denim prej 10 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tirane me vendimin nr.5, date 08.01.2004 ia ka derguar ceshtjen Gjykates se Larte per t`u shprehur lidhur me kompetencen e gjykimit, me arsyetimin se:

Bazuar ne nenin 75/a te K.Pr.Penale, gjykimi i kesaj ceshtjeje eshte ne kompetencen e Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr.65, date 30.01.2004, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.5, date 08.01.2004 te Gjykates se Apelit Tirane dhe kthimin e akteve asaj gjykate, duke arsyetuar se ne rastin konkret nuk ka mosmarreveshje ne lidhje me kompetencen, ne kuptim te nenit 89/1 te K.Pr.Penale.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.89, date 17.02.2004 ka vendosur:

Moskompetencen e gjykimit te ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Eduard Ndreu dhe dergimin e ceshtjes per gjykim gjykates kompetente, Gjykates se Apelit per Krimet e Renda.

Gjykata e Apelit e Krimeve te Renda, me vendimin nr.1, date 01.03.2004 ka vendosur:

Moskompetencen e gjykimit te ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Eduard Ndreu, i akuzuar per vepren penale te parashikuar nga neni 114/b/2 te K.Penal dhe dergimin e ceshtjes ne Gjykatën e Larte per zgjidhjen e mosmarreveshjes ne lidhje me kompetencen.

Kryetari i Gjykates se Larte Thimjo Kondi, pasi studioi vendimin nr.1, date 01.03.2004 te Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda vendosi:

Kalimin per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te ceshtjes per konflikt kompetence midis Gjykates se Apelit Tirane dhe Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda, qe i perket te pandehurit Eduard Ndreu, akuzuar per vepren penale te trafikimit te femrave per prostitucion ne baze te nenit 114/b/2 te Kodit Penal.

Duke pasur parasysh:

Se midis Gjykates se Apelit Tirane dhe Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda ka lindur mosmarreveshja e kompetences, sepse keto dy gjykata e kuptojne, interpretojne dhe zbatojne ne menyre te ndryshme nenin 11/2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave te Krimeve te Renda";

Se kuptimi, interpretimi dhe zbatimi i ndryshem i kesaj dispozite ne raste te tilla te ngjashme, qe do te paraqiten ne te ardhmen ne keto dy gjykata dhe ne gjykata te tjera te apelit, rrezikon te sjelle konfuzion dhe zvarritje te ceshtjeve te krimeve te renda dhe mungese efektiviteti te gjykimit te tyre;

Duke verejtur se edhe ne Kolegjin Penal te Gjykates se Larte ka mendime te ndryshme e te kunderta lidhur me kete mosmarreveshje kompetence;

Kryetari i Gjykates se Larte ka kerkuar nga Kolegjet e Bashkuara njehsimin e praktikës gjyqesore per problemet e meposhteme:

1. *Gjykata e Apelit e Krimeve te Renda a mund te shqyrtoje ne shkalle te dyte, qofte edhe perjashtimisht, ceshtje qe jane shqyrtuar ne shkalle te pare nga gjykatat e rretheve gjyqesore para dates 01.01.2004, te cilat sipas nenit 75/a te K.Pr.Penale jane ne kompetence te gjykatave te krimeve te renda?*

2. *A ka ndeshje (kolizion) midis rregullimit te pergjithshem per kompetencen e Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda sipas nenit 14/3 te K.Pr.Penale dhe nenit 11/2 te Ligjit nr.9110, date 24.07.2003.*

Ne qofte se do te konkludohet per mosperputhje, kontradikte apo ndeshje midis ketyre dy dispozitave, cila prej tyre merr perparesi ne zbatim?

Pergjigjet e pyetjeve te mesiperme duhet te jene rrjedhoje e interpretimit te nenit 11/2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003, sipas te cilit: "Ceshtjet penale, qe do te jene ne gjykim ne gjykatat e shkalles se pare e te apelit deri ne ditën e fillimit te funksionimit te gjykatave per krime te renda,

do te perfundohen nga keto gjykata” dhe te nenit 13/3 (te ndryshuar) te K.Pr.Penale, sipas te cilit: “gjkatat e apelit per krimet e renda shqyrtojne ne shkalle te dyte, me trup gjykues te perbere nga pese gjyqtare, ceshtjet e gjykuara nga gjykata e krimeve te renda”.

Interpretimet e ketyre dispozitave duhet te pajtohen e harmonizohen me frymen dhe qellimet e ligjit nr.9110, date 24.07.2003 dhe te ndryshimeve perkatese ne Kodin e Procedures Penale.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga gjyqtaret Thimjo Kondi dhe Perikli Zaharia, pasi degjuan prokurorin Saliko Hajno, qe u shpreh per kompetencen e Gjykates se Apelit Tirane, e pasi e biseduan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë:

I. Gjykata e Apelit Tirane ka vendosur shpalljen e moskompetences per gjykimin ne shkalle te dyte te ceshtjes me te pandehur Eduard Ndreu, akuzuar per vepren penale te parashikuar nga neni 113/b/2 te Kodit Penal, duke iu referuar nenit 75/a te K.Pr.Penale, qe percakton kompetencen lendore te gjykatave per krime te renda.

Kjo gjykate ka bere ne favor te qendrimit te saj edhe interpretimin e nenit 11/2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 *“Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave te Krimeve te Renda”*, duke arsyetuar se per kete ceshtje nuk kishte filluar gjykimi ne Gjykatën e Apelit Tirane ne kohën kur, sipas ligjit, ka filluar funksionimi i Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda (01.01.2004). Rregjistrimi i ceshtjes nuk nenkupton fillimin e procesit te gjykimit.

Sipas nenit 11/2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 *“Çeshtjet penale, qe do te jene ne gjykim ne gjkatat e shkalles se pare dhe te apelit deri ne ditën e fillimit te funksionimit te gjykatave per krime te renda, do te perfundohen nga keto gjykata”.*

Shtojme se Gjykata e Apelit Tirane, ne vendimin e saj nuk e ka permendur fare nenin 13/3 (te ndryshuar) te K.Pr.Penale, sipas te cilit *“Gjkatat e Apelit per Krimet e Renda shqyrtojne ne shkalle te dyte, me trup gjykues te perbere nga pese gjyqtare, ceshtjet e gjykuara nga gjykata e krimeve te renda”.*

II. Gjykata e Apelit te Krimeve te Renda ka vendosur moskompetencen e saj duke e interpretuar e zbatuar ndryshe nenin 11/2 te Ligjit nr.9110, date 24.07.2003, te sipercituar.

Sipas kesaj gjykate, ne kuptim te nenit 11/2, perderisa ceshtja eshte rregjistruar per gjykim ne Gjykatën e Apelit Tirane, eshte hedhur shorti e eshte bere shpallja e gjykimit, pavaresisht nese jane bere veprime procedurale apo jo, ceshtja duhet te konsiderohet ceshtje ne gjykim ne Gjykatën e Apelit Tirane, prandaj kjo gjykate duhet te konsiderohet kompetente.

Gjykata e Apelit te Krimeve te Renda arsyeton me tej se edhe ceshtjet e tjera penale, te cilat duke iu referuar akuzes jane ne kompetence gjykimi te Gjykates se Krimeve te Renda, nese jane gjykuar ne shkalle te pare nga gjkatat e rretheve gjyqesore, do te vazhdojne te gjykohen ne shkalle te dyte nga gjkatat respektive te apeleve, sepse jane ne vazhdimesine normale te procedures se zakonshme.

Sipas Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda, edhe ne rastet kur nje gjykate apeli prish nje vendim, qe aktualisht ceshtja i takon Gjykates se Krimeve te Renda, por eshte gjykuar ne shkalle te pare nga gjkatat e juridiksionit te zakonshem, ceshtja do te rishqyrtohet nga gjykata e shkalles se pare, nga nje trup gjykues tjetër i asaj gjykate (nenet 428/ç e 429/1 te K.Pr.Penale).

Sipas Gjykates se Apelit te Krimeve te Renda, kjo gjykate eshte kompetente per te shqyrtuar ne shkalle te dyte vetem ceshtjet qe jane paraqitur per gjykim ne Gjykatën e Shkalles se Pare te Krimeve te Renda (qe jane rregjistruar per gjykim ne ate gjykate pas dates 01.01.2004).

*

*

*

1. Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte vleresojne te drejte dhe te bazuar ne ligj qendrimin e Gjykates se Apelit per Krimet e Renda. Kompetenca funksionale e kesaj gjykate percaktohet nga neni 14/3 i K.Pr.Penale. Sipas kesaj dispozite kjo gjykate shqyrton ne shkalle te dyte ceshtjet e gjykuara ne shkalle te pare nga Gjykata e Krimeve te Renda. Ndersa dispozita procedurale ne fjale eshte dispozite qe rregullon kompetencen e gjykimit, neni 11 i ligjit nr.9110, date 24.07.2003 “*Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave te Krimeve te Renda*” eshte dispozita qe percakton kohen e venies ne funksionim te gjykatave te krimeve te renda. Data e fillimit te veprimtarise se ketyre gjykatave, sipas percaktimit qe ka bere ligjvenesit eshte data 01.01.2004. Nepermjet paragrafit te dyte te nenit 11, qe eshte nje dispozite kalimtare, ligjvenesit ka percaktuar cila do te jete ecuria e ceshtjeve te kompetences lendore te gjykatave te krimeve te renda, te percaktuar ne nenin 75/a te K.Pr.Penale, ceshtje te cilat me daten 01.01.2004 do te jene ne gjykim ne gjykatat ekzistuese te shkalles se pare e te apeleve.

Kjo dispozite percakton ne menyre te shprehur se keto ceshtje do te perfundohen nga keto gjykata. Persa u perket ceshtjeve ne gjykim ne gjykatat e shkalles se pare deri tani nuk ka lindur ndonje paqartesi, e jo me te jene mbajtur qendrim te kunderta. Qendrim te kunderta, sic parashtrahet me lart, jane mbajtur per “ceshtjet ne gjykim ne gjykatat e apelit”. Shtrohet pyetja: *Cilat ceshtje do te konsiderohen ceshtje qe jane ne gjykim ne gjykatat e apelit?*

Shumica eshte e mendimit qe ceshtje te tilla konsiderohen ato ceshtje, gjykimi i te cilave ka perfunduar ne shkalle te pare, d.m.th. ato ceshtje per te cilat gjykatat e shkalles se pare kane dale me nje vendim perfundimtar pas shqyrtimit te themelit te tyre, dhe qe kunder vendimit eshte bere apel.

Kjo eshte arsyeja qe ligjvenesit ka perdorur termin “*ceshtje ne gjykim*” dhe jo “*ceshtje te rregjistruara*”.

Nje ceshtje konsiderohet *ceshtje ne gjykim* ne gjykatën e apelit jo ne momentin e veprimit administrativ te rregjistrimit te saj ne rregjistrat e kesaj gjykate, por qe ne momentin kur eshte ushtruar apeli kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare.

Po me ceshtjet qe jane ne gjykim ne gjykatat e shkalles se pare perpara dates 01.01.2004, cfare do te behet? Neni 11/2 i ligjit nuk le asnje dyshim qe keto ceshtje do te vazhdojne te gjykohen nga keto gjykata deri ne perfundimin e tyre. Po keshtu, ne rast apelim kunder vendimit perfundimtar te shkalles se pare, ceshtjet do te gjykohen ne gjykatat ekzistuese te apelit dhe jo ne Gjykatën e Apelit te Krimeve te Renda.

Ne qofte se do te pranohej e kunderta, atehere do te shkelej rregullimi i nenit 14/3 te K.Pr.Penale. Kjo dispozite, duke parashikuar qe Gjykata e Apelit e Krimeve te Renda shqyrton ne shkalle te dyte ceshtjet e gjykuara nga Gjykata e Krimeve te Renda, ne te njejten kohe nenkupton nepermjet interpretimit nga e kunderta (ad contrario) se nje ceshtje qe nuk eshte gjykuar ne shkalle te pare nga gjykata e krimeve te renda (sepse gjykimi i saj ne shkalle te pare ka filluar para dates 01.01.2004), nuk mund te gjykohet ne shkalle te dyte nga Gjykata e Apelit e Krimeve te Renda. Eshte kjo arsyeja qe ligjvenesit ne nenin 11/2 te Ligjit nr.9110, date 24.07.2003, qe eshte nje dispozite kalimtare, i ka perfshire ne nje formulim te vetem “*ceshtjet penale qe do te jene ne gjykim ne gjykatat e shkalles se pare dhe te apelit deri ne ditën e fillimit te funksionimit te gjykatave per krime te renda*”, duke iu permbajtur parimit te vazhdimesise se gjykimit.

Si perfundim: ***Gjykata e Apelit e Krimeve te Renda nuk mund te shqyrtojë ne shkalle te dyte ceshtje qe jane shqyrtuar ne shkalle te pare nga gjykatat e rretheve gjyqesore para dates 01.01.2004, te cilat, sipas nenit 75/a te K.Pr.Penale, jane ne kompetence te gjykatave te krimeve te renda.***

2. Me lart parashtrojme se problematikat e rregullimit prej nenit 14/3 te K.Pr.Penale dhe ajo e nenit 11/2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003, jane te ndryshme: Ndersa neni 14/3 i K.Pr.Penale eshte nje dispozite procedurale qe parashikon kompetencen lendore te gjykatave te krimeve te renda, neni 11/2 i ligjit nr.9110, date 24.07.2003 eshte dispozite kalimtare qe siguron vazhdimesine e gjykimit te ceshtjeve, te filluara para dates 01.01.2004, ne gjykatën e shkalles se pare e mandej ne ate te apelit.

Duke qene dispozita me karakter te ndryshem e me objekt rregullimi te ndryshem, nuk behet fjale per mosperputhje, kontradikte, apo ndeshje midis tyre, as per perparesi ne zbatim. Ato plotesojne njera-tjetren.

Neni 14/3 i K.Pr.Penale eshte nje dispozite procedurale, qe rregullon kompetencen lendore, me karakter te pergjithshem dhe me fuqi per te ardhmen (pas dates 01.01.2004), ndersa neni 11/2 i Ligjit nr.9110, date 24.07.2003, si dispozite kalimtare, ka karakter te perkohshem dhe te kufizuar deri ne perfundimin ne shkalle te pare e ne apel te ceshtjeve ne proces gjykimi para dates kur fillon zyrtarisht veprimtaria e gjykatave te krimeve te renda.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte, ne baze te nenit 141/2 te Kushtetutes, te neneve 14/c dhe 17/b te Ligjit "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykeses se Larte te Republikës se Shqiperise" dhe te nenit 438 te K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N:

Te zgjidhin mosmarreveshjen midis Gjykeses se Apelit Tirane dhe Gjykeses se Apelit te Krimeve te Renda per kompetencen e gjykimit te ceshtjes me te pandehur Eduard Ndreu duke caktuar si gjykate kompetente per gjykimin e kesaj ceshtjeje Gjykatën e Apelit Tirane.

Ky vendim per njehsimin e praktikës gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 16.04.2004

MENDIMI I PAKICËS

Gjykata e Apelit Tirane ka vendosur shpalljen e moskompetences per gjykimin ne shkalle te dyte te ceshtjes me te pandehur Eduard Ndreu, akuzuar per vepren penale te trafikimit te femrave per prostitucion, te parashikuar nga neni 114/b/2 te Kodit Penal, duke iu referuar per kete nenit 75/a te Kodit te Procedures Penale, i cili percakton kompetencen lendore te gjykatave per krimet e renda.

Kjo gjykate ka interpretuar ne favor te qendrimit te saj nenin 11/2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave per Krimet e Renda", duke arsyetuar se:

- Per kete ceshtje nuk kishte filluar gjykimi ne Gjykatën e Apelit Tirane ne kohen kur, sipas ligjit ka filluar funksionimi i Gjykates se Apelit per Krimet e Renda, me 1 janar 2004.

- Regjistrimi i ceshtjes nuk nenkupton gjykimin e saj.

- Sipas nenit 11/2 te ligjit te mesiperm nr.9110, date 24.07.2003, ceshtjet penale qe jane ne gjykim ne gjykatat e shkalles se pare dhe te apelit deri ne ditën e fillimit te funksionimit te gjykatave per krimet e renda, do te perfundohen nga keto gjykata."

Gjykata e Apelit per Krimet e Renda ka vendosur moskompetencen e saj, duke e interpretuar dhe zbatuar ndryshe nenin 11/2 te ligjit te lartpermendur nr.9110, date 24.07.2003.

Sipas kesaj gjykate, ne kuptim te nenit 11/2 te ligjit te mesiperm, perderisa ceshtja eshte regjistruar per gjykim ne Gjykatën e Apelit Tirane, pavaresisht nese jane bere ose jo veprime procedurale, ceshtja duhet te konsiderohet ceshtje ne gjykim ne Gjykatën e Apelit Tirane, prandaj kjo gjykate duhet te konsiderohet kompetente.

Sipas Gjykates se Apelit per Krimet e Renda, kjo gjykate eshte kompetente per te shqyrtuar ne shkalle te dyte vetem ceshtjet qe jane paraqitur per gjykim ne gjykatën e shkalles se pare per krime te renda (qe jane regjistruar per gjykim ne ate gjykate pas dates 01.01.2004).

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me shumice votash vendosen te zgjidhin mosmarreveshjen midis gjykatave te mesiperme per kompetencen e gjykimit te kesaj ceshtjeje, duke caktuar si gjykate kompetente Gjykatën e Apelit Tirane.

Qendrimi i mbajtur nga shumica ne kete rast nuk na duket i drejte, sepse vjen ne kundërshtim me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore qe rregullojne ecurine e gjykimit te ceshtjeve te kompetences lendore te gjykatave per krimet e renda, te regjistruara, por ende te pagjykuara para dates 1 janar 2004 ne gjykatat e apelit. Prandaj parashtojme sa vijon:

Ne ligjin nr.9085, date 19.06.2003 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7905, date 21.03.1995" Kodi i Procedures Penale te Republikës se Shqiperise, ne nenin 1, me te cilin eshte ndryshuar pika 3 e nenit 14 te K.Pr.P., eshte parashikuar **rregulli i pergjithshem** se: Gjykatat e apelit per krimet e renda shqyrtojne ne shkalle te dyte, me trup gjykues te perbere nga pese gjyqtare, ceshtjet e gjykuara nga gjykata e krimeve te renda.

Ne ligjin e mevonshem nr.9110, date 24.07.2003 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave per Krime te Renda", ne nenin 11 qe ben fjale per dispozitat e fundit, pika 1, eshte parashikuar se: "Gjykatat per krime te renda dhe gjykatat e apelit per krime te renda fillojne funksionimin e tyre ne datën 1 janar 2004."

Nderkohe, ligjvenesit nuk ka lene jashte vemendjes rregullimin ligjor te situates kalimtare te ceshtjeve qe deri ne kohen e fillimit te funksionimit te gjykatave te krimeve te renda ndodheshin per gjykim prane gjykatave te zakonshme te shkalles se pare dhe te apelit. Duke mbajtur parasysht kete situatë, ligjvenesit ka pranuar te beje nje perjashtim nga rregulli i pergjithshem qe percakton neni 1 i lartpermendur i ligjit nr.9085, date 19.06.2003.

Keshtu, ne nenin 11, pika 2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave per Krime te Renda", ka parashikuar se: Ceshtjet penale, qe do te jene

ne gjykim ne gjykatat e shkalles se pare dhe te apelit deri ne ditën e fillimit te funksionimit te gjykatave per krime te renda, do te perfundohen nga keto gjykata”.

Konflikti per kompetencen qe ka lindur midis gjykatave te zakonshme dhe atyre per krime te renda eshte i lidhur pikerisht me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e drejte te kesaj dispozite dhe ne varesi te kesaj duhet t’i jepet pergjigje edhe pyetjeve te parashtuara ne vendimin per kalimin e ceshtjes per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte.

Ndryshe nga qendrimi i mbajtur nga shumica, mendojme se dispozitat e fundit dhe kalimtare jo pa qellim bejne nje perjashtim nga rregulli i pergjithshem i gjykimit te ceshtjeve qe sipas nenit 75/a te K.Pr.P. jane ne kompetence te gjykatave te krimeve te renda.

Ky konkluzion mbeshtetet ne disa argumente:

Se pari, ligjvenesi nuk ka bere ndonje ndarje ne lidhje me kohen e funksionimit te gjykeses se shkalles se pare per krime te renda dhe asaj te apelit per krime te renda. Meqenese sipas nenit 11, pika 1, te lartpermendur te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave per Krime te Renda” eshte percaktuar qe te dyja keto instanca te ndryshme gjyqesore do te fillojne funksionimin ne te njejten date, pra me 1 janar 2004; kjo nenkupton qe ligjvenesi ka percaktuar edhe se me cfare do merret gjykata e apelit te krimeve te renda duke filluar nga ajo date.

Pra, shtrohet pyetja: Mos valle ligjvenesi me funksionim te gjykeses se apelit per krimet e renda, ndryshe me ate te gjykeses se shkalles se pare per krimet e renda, nenkupton vetem ngritjen (krijimin) dhe jo zhvillimin e gjykimit prej saj?

Pergjigja nga ana jone do te ishte “jo”, sepse nuk do te ishte e arsyeshme qe gjykata e apelit per krime te renda, mbeshtetur ne rregullin e pergjithshem te lartpermendur, te rrinte ne pritje deri sa t’i vinin per gjykim, nepermjet apelimit, ceshtjet e gjykuara nga gjykata e shkalles se pare per krime te renda, pra praktikisht pas disa muajve qe te kete perfunduar gjykimi ne ate gjykate dhe pasi te jete bere njoftimi i pales kundershtare per apelimin e bere ndaj vendimit perkates.

Ne qofte se do te pranohej kjo, natyrshem lind pyetja tjeter:

Perse duhej qe keto gjykata te niveleve te ndryshme te ngriheshin dhe te komplettoheshin *me urgjence* ne te njejten kohe dhe per rrjedhoje te kerkohej funksionimi i tyre ne te njejten date, me 1 janar 2004?

Jo vetem kaq, por nisur nga fakti qe numri i gjyqtareve te vendit nuk ka ndryshuar, (pra pikerisht gjykata e apelit te krimeve te renda u plotesua nga ky numer), si mund te pranohet se ligjvenesi ka lejuar qe gjyqtaret e apelit te krimeve te renda te rrine ne pritje per te gjykuar pas disa muajve, ndersa gjykatat e zakonshme te apelit, ne kushtet e mungeses se krijuar nga levizja e gjyqtareve te tyre ne gjykatën e apelit te krimeve te renda, te perballojne edhe ngarkesen e ketyre gjyqtareve ne gjykimin e ceshtjeve qe sipas nenit 75/a te K.Pr.P. i takojne gjykeses se krimeve te renda per t’i gjykuar.

Se dyti, ndryshe nga arsyetimi i vendimit te gjykeses se apelit per krime te renda, me ceshtje penale qe do te jene ne gjykim nuk mund te kuptohen edhe ceshtjet penale qe jane regjistruar ne sekretarine e gjykeses, sepse regjistrimi, mbeshtetur ne dispozitat e K.Pr.P., eshte nje veprim administrativ dhe jo nje veprim procedural.

Qe ceshtja te konsiderohet ne gjykim nuk mjafton vetem regjistrimi i saj, por detyrimisht, pas respektimit te rradhes se ceshtjeve te ardhura dhe te regjistruara, caktimi me short i trupit gjykues qe do ta gjykoje ate, standart ky i detyrueshem per funksionimin e pushtetit gjyqesor ne menyre te pavarur dhe te paanshem, ne zbatim te Kushtetutes se Shqiperise dhe Konventes Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut (KEMDNJ) (neni 6).

Pervec kesaj, *vetem pasi procedohet me veprimet paraprake te gjykimit, sipas nenit 426 te K.Pr.P., i cili parashikon urdherimin per thirrjen e te pandehurit, paditesit civil dhe te paditurit*

civil, si dhe te mbrojtësve e te perfaqësuesve te tyre, brenda nje afati paraqitjeje jo me te vogel se 10 dite, ceshtja konsiderohet se eshte ne gjykim.

Ne rast se me ceshtjet ne gjykim do te kuptohen edhe ceshtjet qe vetem sa jane regjistruar, atehere duhet te pranohet paradoksi se, ceshtjet qe jane regjistruar ne Gjykatën e Apelit Tirane ne prag te fillimit te vitit 2004 duhet te perfundonin nga kjo gjykate, pavaresisht se per to nuk ishte ndermarre asnje veprim procedural dhe pavaresisht se objektivisht ato nuk mund te futeshin ne gjykim deri me datën e fillimit te funksionimit te Gjykates se Apelit per Krimet e Renda, me 1 janar 2004.

Per rrjedhoje, ceshtjet e regjistruara ne gjykatën e apelit nuk mund te konsiderohen ne kuptim te nenit 11, pika 2 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave per Krime te Renda”, si ceshtje ne gjykim.

Ne kete veshtrim, aq me i papranueshem eshte qendrimi i shumices se, ceshtje ne gjykim ne gjykatën e apelit konsiderohen ato ceshtje, gjykimi i te cilave ka perfunduar ne shkalle te pare, d.m.th. ato ceshtje per te cilat gjykata e shkalles se pare ka dale me nje vendim perfundimtar pas shqyrtimit te themelit te tyre dhe qe kunder vendimit eshte bere apel.

Ushtrimi i apelit i jep mundesi apeluesit qe ceshtja e tij te shqyrtohet nga gjykata e shkalles se dyte, por cila gjykate duhet ta shqyrtoje ate kjo nuk varet nga ai, por nga rregulli i vendosur me ligj.

Apeli eshte e nevojshme te regjistrohet, por kjo nuk do te thote se qe me regjistrimin e tij si veprim administrativ, ceshtja konsiderohet se eshte ne gjykim ne shkalle te dyte. Nga ana tjetër, vetem ushtrimi i te drejtes se apelit nuk presupozon se ceshtja eshte ne gjykim ne shkalle te dyte, pa u ndermarre veprimet e nevojshme procedurale ne zbatim te kerkesave te K.Pr.P. per gjykimin e ceshtjes ne kete shkalle.

Se treti, edhe ne ligjin nr.9110, date 24.07.2003 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave per Krime te Renda”, ne nenin 5 eshte percaktuar kompetenca e gjykatave per krime te renda. Sipas pikes 1 te ketij ligji eshte parashikuar se: Gjykata per krime te renda dhe gjykata e apelit per krime te renda gjykojne ne shkalle te pare dhe ne shkalle te dyte veprat penale te parashikuara nga neni 75, shkronja “a” te K.Pr.P.

Por, a ka raste kur gjykata e krimeve te renda gjykon ceshtje jo te kompetences se saj?

Pikerisht ne piken 2 te ketij neni eshte pranuar perjashtimi nga ky rregull i pergjithshem. Sipas kesaj pike, kur gjate gjykimit ndryshohet cilesimi ligjor i vepres penale dhe per kete shkak kompetente eshte nje gjykate tjetër, gjykimi vazhdon dhe perfundohet nga gjykata e krimeve te renda, duke zbatuar dispozitat e K.Pr.P.

Pra, vete ligjvenesi ka pranuar se ne raste te vecanta keto gjykata nuk mund te gjykojne vetem veprat penale te parashikuara nga neni 75, shkronja “a” te K.Pr.P.

Po te qendronte strikt ne parimin e vazhdimesise se gjykimit te atyre ceshtjeve qe jane ne kompetence te gjykates se krimeve te renda, atehere ligjvenesi nuk kishte perse ne kete rast ta jepte kete zgjidhje, “duke renduar poziten e te pandehurit”, sic permend shumica ne favor te qendrimit te saj per rastin ne gjykim.

Sic shihet, edhe ne kete dispozite ligjvenesi ka pranuar perjashtimin nga rregulli i pergjithshem.

Me kete rast i jepet pergjigje edhe pyetjes nr.3 te paraqitur ne vendimin per kalimin e ceshtjes per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte. Keshtu, kur ligji i mevonshem parashikon perjashtimin nga rregulli i pergjithshem per te rregulluar nje gjendje kalimtare te gjykimit te ceshtjeve, atehere nuk ka perse ky perjashtim te merret dhe te kuptohet se bie ndesh me rregullin e vendosur nga ligjvenesi ne nenin 75, shkronja “a” te K.Pr.P., lidhur me kompetencat e gjykates per krime te renda.

Se katerti, duke mbajtur parasysh statusin e gjyqtareve te gjykates se krimeve te renda, qe lidhet jo vetem me perzgjedhjen, por edhe me masat e sigurimit dhe trajtimit te tyre, si dhe perberjen e trupit gjykues te kesaj gjykate prej pese gjyqtarësh te kesaj kategorie, ky eshte nje tjetër argument qe mbeshtet qendrimin e pakices se, veprat penale te parashikuara nga neni 75, shkronja "a" te K.Pr.P. duhet te gjykohen nga kjo gjykate apeli, pavaresisht se ne shkalle te pare jane gjykuar nga gjykata e zakonshme. Kjo eshte nje garanci me teper per te pandehurit dhe jo rendim i pozites se tyre.

Ne mbeshtetje te argumenteve te mesiperme dhe duke iu pergjigjur pyetjes nr.2 te parashtruar ne vendimin per kalimin e ceshtjes per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, konkludojme se:

Gjykata e Apelit per Krime te Renda mund te shqyrtoje ne fazen kalimtare ceshtje qe jane shqyrtuar ne shkalle te pare nga gjykatat e rretheve gjyqesore para dates 01.01.2004 dhe qe sipas nenit 75/a te K.Pr.P. jane ne kompetence te gjykatave te krimeve te renda, ne permbushje te qellimit per te cilin ato jane krijuar.

Pergjigja e pyetjes nr.3 eshte e lidhur me sa me siper.

Pra, ne rastet kur nje gjykate apeli (jo e krimeve te renda), e cila eshte duke gjykuar nje ceshtje te kompetences se gjykates per krime te renda, e prish vendimin dhe vendos dergimin e ceshtjes per rishqyrtim, ceshtjen duhet t'ja dergoje gjykates per krime te renda, per shkak se ne kete rast, nga njera ane gjykimi do te konsiderohej se fillonte nga e para, me tjetër trup gjykues dhe nga ana tjetër kjo do te ishte ne permbushje te qellimit per te cilin keto gjykata jane krijuar.

Keshtu, sipas nenit 1 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave per Krime te Renda" synimi i ketij ligji eshte jo vetem rritja e efektivitetit te luftes kunder krimin te organizuar dhe krimeve te renda, por edhe permiresimi i cilesise se gjykimit te tyre.

Ne perfundim, mendojme se Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, per te zgjidhur mosmarreshjen midis Gjykates se Apelit Tirane dhe Gjykates se Apelit per Krimet e Renda lidhur me kompetencen e gjykimit te ceshtjes me te pandehur Eduard Ndreu, akuzuar per vepren penale te trafikimit te femrave per prostitucion, ne baze te nenit 114/b/2 te Kodit Penal, duhet te caktojne si gjykate kompetente per gjykimin e kesaj ceshtjeje Gjykatën e Apelit per Krimet e Renda.

Perikli Zaharia

Shpresa Beçaj

Kristaq Ngjela

MENDIMI I PAKICËS KUNDËR

Ne lidhje me vendimin nr.1, date 16.04.2004 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykeses se Larte.

Nuk jam dakord me vendimin nr.1, date 16.04.2004 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykeses se Larte, jo thjesht persa i takon zgjidhjes perfundimtare qe i eshte bere ceshtjes objekt gjykimi dhe percaktimeve unifikuese (sentencave) qe jane pranuar prej saj, por sidomos per faktin qe kjo ceshtje eshte terhequr me vendim te Kryetarit te Gjykeses se Larte, per t'u gjykuar nga keto Kolegje, per arsytet e meposhteme:

Ne lidhje me gjykimin ne Kolegjet e Bashkuara, ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, behet fjale ne Kushtetute, ne Kodin e Procedures Penale dhe ne ligjin nr.8588, date 15.03.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykeses se Larte te Republikes se Shqiperise".

Konkretisht, ne piken 2 te nenit 141 te Kushtetutes thuhet: "**Per njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqesore**, Gjykata e Larte ka te drejte te terheqe per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara **ceshtje te caktuara gjyqesore**".

Ne piken 1 te nenit 438 te K.Pr.Penale thuhet:

"Kur lind nevoja **per njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqesore**, Gjykata e Larte **ka te drejte** te terheqe per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara ceshtje te ardhura per shqyrtim ne Kolegjin Penal, kurse ne piken 2 te tij thuhet: "Terheqja e ceshtjeve behet me vendim te Kryetarit te Gjykeses se Larte ose te Kolegjit Penal".

Ne shkronjen "c" te nenit 14 te ligjit organik te Gjykeses se Larte, ne te cilin percaktohen ceshtjet qe gjykohen ne Kolegjet e Bashkuara, thuhet: "**Kerkesat per njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqesore**".

Sic shihet, rastet ne te cilat Kolegjeve te vecanta te Gjykeses se Larte apo dhe Kryetarit te kesaj gjykate, i lind e drejta per te terhequr ceshtje ne gjykim ne Kolegjet e Bashkuara, jane qartesisht te percaktuara ne menyre te tille qe nuk lihet shteg per rritjen e numrit te tyre (rasteve).

Ato jane dy:

a) **njehsimi** dhe b) **ndryshimi i praktikës gjyqesore**.

Po keshtu, nga vete formulimi i dispozitave te permendura, del fare qarte se, nevoja per njehsim ose ndryshim, eshte e kushtezuar domosdoshmerisht **me ekzistencen e praktikës gjyqesore**, ne lidhje me ceshtje te ndryshme qe kane patur per zgjidhje te njejtin objekt gjykimi. Ne kuptimin qe, **per te patur praktike gjyqesore**, numri i ceshtjeve te gjykuara me pare nga Kolegji Penal i Gjykeses se Larte ose nga gjykatat e shkalleve te tjera te gjykimit nuk ka rendesi, mjafton qe te kene qene dhene me pare disa vendime te formes se prere per ceshtje analoge.

Ndryshe nga sa me siper, ne rastin objekt shqyrtimi ne Kolegjet e Bashkuara, kjo ishte ceshtja e pare qe erdhi per t'u gjykuar, jo vetem ne Gjykatën e Larte, por edhe ne vete dy gjykatat e apelit (Gjykata e Apelit Tirane dhe ajo per Krime te Renda) midis te cilave ka lindur mosmarreveshja e kompetences.

Ne keto kushte, megjithese zgjidhja e shpejte ne perputhje me kerkesat e ligjit e kesaj mosmarreveshje, mund te ndikoje ne evadimin e ceshtjeve te mbartura, qe per shkak te keqkuptimeve, apo keqinterpretimit te ndryshimeve te K.Pr.Penale dhe pikes 2 te dispozites se nenit 11 te ligjit nr.9110, date 24.07.2003 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave per krime te renda", vazhdojne te qendrojne pezull, nuk i lind e drejta Kryetarit te Gjykeses se Larte qe te terhiqte ceshtjen nga Kolegji Penal dhe ta dergonte per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara.

Investimi pa vend, ne kundersiztim me ligjin, sikurse ne rastin konkret, i Kolegjeve te Bashkuara per te zgjidhur nevoja te karakterit organizativ midis gjykatave, mendoj se perben precedent negativ me pasoja te demshme per pavaresine e gjykatave ne te ardhmen.

Besoj se kjo duhet te kete qene edhe arsyeja qe, ne ndryshimet qe ju bene dispozites se nenit 438 te K.Pr.Penale me ligjin nr.8813, date 13.06.2002, i eshte hequr e drejta Kryetarit te

Gjykates se Larte per te derguar ne Kolegjet e Bashkuara ceshtje, te cilat sipas formulimit te meparshem te kesaj dispozite, konsideroheshin **me rendesi te vecante**.

Per arsyet e parashtruara me lart, jam i mendimit qe kjo ceshtje nuk duhej te vazhdonte te gjykohej nga Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, por te dergohej per shqyrtim ne Kolegjin Penal te saj.

Spiro Spiro

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Kristaq Ngjela	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Agron Lamaj	Anetar
Perikli Zaharia	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Bineri	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Irma Bala	Anetare
Artan Hoxha	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 11.11.2003, moren ne shqyrtim çeshtjen penale nr.6, qe i perket:

**TË PANDEHURVE: FERDINAND XHANGO, JULIAN GUGA DHE
BAFTJAR ALLARAJ**

A K U Z A:

I pandehuri Ferdinand Xhango:
per vepren penale te vjedhjes me arme
ne bashkepunim dhe dezertimit,
te parashikuar nga nenet 140 e 25 te K.Penal
dhe 33/1 te K.Penal Ushtarak.

I pandehuri Julian Guga:
per veprat penale te vjedhjes me arme
ne bashkepunim dhe te marredhenieve seksuale
me te mitur te mbetur ne tentative,
parashikuar nga nenet 140 e 25
dhe 102 e 22 te K.Penal.

I pandehuri Baftjar Allaraj:
per veprat penale te vjedhjes me arme
ne bashkepunim dhe armembajtje pa leje,
parashikuar nga nenet 140 e 22 dhe 278/2 te K.Penal.

OBJEKTI:

Revokim i mases se sigurimit “arrest ne burg”
per te pandehurit dhe lirimi i menjehershem i tyre
Baza Ligjore: Nenet 260/1 e 263 te K.Pr.Penale

Gjykata ushtarake e shkalles se pare Gjirokaster me vendimin nr.77, date 30.9.2002, ka vendosur:

Rrezimin e kerkeses se te pandehurve Julian Guga, Ferdinand Xhango dhe Baftjar Allaraj per shuarjen e mases se sigurimit arrest ne burg.

Gjykata Ushtarake e Apelit Tirane, me vendimin nr.8, date 28.1.2003
Ka lene ne fuqi vendimin nr.77, date 30.9.2002 te Gjykates Ushtarake te shkalles se pare.

Kunder ketyre dy vendimeve kane paraqitur rekurs ne Gjykatën e Larte kerkuesit, nepermjet mbrojtësit me prokurë av. Gjet Kola, me te cilin kerkojne prishjen e te dy vendimeve dhe pranimin e kerkeses, duke parashtuar keto shkaqe:

- 1. Gjykata qellimisht i eshte shmangur kerkeses, pasi revokimi nuk eshte kerkuar per shkak te humbjes se fuqise se paraburgimit per kalimin e afateve te gjykimit e te dhenies se vendimit ne shkalle te pare, por eshte kerkuar se ne daten 27.6.2002, kur kemi depozituar kerkesen per humbjen e fuqise se paraburgimit dhe lirimin e te pandehurve ne gjykatën e shkalles se pare Gjirokaster, kishin kaluar afatet teresore te paraburgimit per 1 vit, 7 muaj e 19 dite. Masa e sigurimit per keta te pandehur duhet te trajtohet me afatin 1 vjecar te kohezgjatjes teresore te paraburgimit, pasi jane arrestuar me 8.11.1999, para hyrjes ne fuqi te ndryshimeve te nenit 263 te K.Pr.P, qe zgjat afatet e paraburgimit.
- 2. Si Gjykata Ushtarake e shkalles se pare dhe Gjykata Ushtarake e Apelit e ka gjykuar kete ceshtje secila rreth 3 muaj jashte afatit ligjor. Kjo ben qe deri ditën e sotme, kohezgjatja teresore e paraburgimit per te tre te pandehurit te jete 2 vjet 3 muaj e 28 dite me e madhe se ajo e parashikuar ne ligj.
- 3. Te pandehurit kane plotesuar 5 vjet paraburgim, kohe kjo, qe dhe me deklarimin fajtor e denimin e tyre, eshte kryer denimi perfundimtar.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr.26, date 5.3.2003, ka kaluar ceshtjen ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, per te bere unifikimin e praktikës gjyqësore si me poshte:

1. Ne rastet kur vendimi priset nga Gjykata e Larte dhe ceshtja i dergohet gjykates se shkalles se pare ose apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dergohet gjykates se shkalles se pare, si duhet te interpretohen fjalet e nenit 264/2 te K.Pr.P. "... nga dita e dhenies se vendimit te Gjykates se Larte apo te apelit, fillojne perseri afatet e parashikuara per secilen shkalle te procedimit". Fillojne perseri afatet e parashikuara vetem per shkallen e procedimit se ciles i dergohen aktet mbas prishjes se vendimit, apo fillojne perseri afatet e parashikuara per te gjitha fazat e procedimit te ceshtjes, deri ne dhenien e vendimit perfundimtar. Kur Gjykata e Larte prish si vendimin e gjykates se apelit, ashtu edhe ate te shkalles se pare dhe aktet i kthen per rishqyrtim kesaj te fundit, fillojne nga e para, vetem afatet e paraburgimit qe jane parashikuar per gjykimin ne shkalle te pare, apo edhe afatet e parashikuara edhe per gjykimin ne apel.

2. Pika 4 e nenit 263 te K.Pr.Penale, para ndryshimeve qe i jane bere K.Pr.Penale me ligjin nr.8570, date 20.01.2000, bente fjale per rifillimin e afateve te parashikuara per secilen shkalle te procedimit, vetem ne rastet kur vendimi prishej nga Gjykata e Kasacionit, ndersa pas ndryshimeve, keto afate fillojne perseri edhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit. Si do te vendoset ne lidhje me kerkesat e te pandehurve, per plotesim te afateve te paraburgimit, kur vendimi i ceshtjes qe i perket atyre, ka qene prishur jo nga Gjykata e Kasacionit, (ose edhe Gjykata e Larte) por nga gjykata e apelit, para hyrjes ne fuqi te ligjit te permendur.

3. Si duhet interpretuar kuptimi i shprehjes, "Kohezgjatja e paraburgimit nuk mund te kaloje gjysmen e maksimales se denimit te parashikuar per vepren penale qe procedohet" qe perdor ligjvenesi ne piken 3 te nenit 264 te K.Pr. Penale

Ne rastet kur kohezgjatja teresore, pervec kohes qe ka kaluar per shkak te zhvillimit normal te shkalleve te procedimit, perfshire edhe kohen e llogaritur mbi pezullimet qe u jane bere afateve te paraburgimit, ne zbatim te nenit 265 te K.Pr.Penale, tejkalon afatet teresore te paraburgimit, a mund te kaloje tej atyre, kur afati teresor nuk ka kaluar gjysmen e maksimales se denimit te parashikuar per vepren penale qe procedohet.

4. Ne dispoziten e nenit 265 te K.Pr.Penale ku parashikohet pezullimi i afateve te paraburgimit, percaktohen rrethanat konkrete, te cilat sherbejne si shkak per pezullimin e ketyre afateve si ne rastin kur gjykatat ndodhen para rrethanave te parashikuara ne shkronjen "a" ashtu edhe atyre te parashikuara ne shkronjen "b" te kesaj dispozite, ligjvenesi perdor shprehjen, "...gjate kohes shqyrtimi gjyqesor eshte pezulluar ose shtyre...". Ne keto kushte, kur ligjvenesi perdor ne menyre alternative fjalet "pezulluar" dhe "shtyre", afatet e paraburgimit do te konsiderohen ligjerisht te pezulluara, si atehere kur gjykata, ne vendimin e ndermjetem te saj, ka perdorur ne forme te shprehur termin "pezullohen afatet e paraburgimit", apo edhe kur ne vendimin per shtyrjen e seancave, perdor vetem shprehjen, "... seanca shtyhet per nje nga shkaqet e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" te dispozites se nenit 265 te K.Pr.Penale".

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e gjyqtareve Artan Hoxha dhe Perikli Zaharia, prokurorin prane kesaj gjykate, Artur Selmani dhe mbrojtessin e te pandehurve, av.Gjet Kola, te cilet kerkuan prishjen e te dy vendimeve, pranimin e kerkeses se te pandehurve, lirimin e tyre nga paraburgimi dhe, pasi biseduan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë:

Vendimet e te dyja gjykatave jane marre ne kundershkrim me ligjin e per kete shkak ato duhet te prishen.

Ne aktet e ndodhura ne dosje rezulton se te pandehurit jane arrestuar ne flagrante ne date 08.11.1999 per veprat penale per te cilat jane akuzuar, sikurse pershkruhet ne pjesen hyrese te vendimit, arrestim ky qe nuk eshte vlefshem i ligjshem nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarande. Me vendimin nr.95, date 11.11.1999 ajo gjykate ka caktuar per te tre te pandehurit, masen e sigurimit arrest me burg, pasi kane ekzistuar shkaqet dhe kriteret per caktimin e kesaj mase.

Meqenese i pandehuri Ferdinand Xhango akuzohej edhe per dezertim nga sherbimi ushtarak, nga ana e Prokurorise se Rrethit Sarande eshte shpallur moskompetenca dhe aktet i jane derguar prokurorise prane Gjykates Ushtarake Gjirokaster per vazhdimin e hetimeve. Ne daten 8.6.2000, ceshtja eshte derguar per gjykim dhe Gjykata Ushtarake e shkalles se pare Gjirokaster me vendimin nr.12, date 23.5.2001, i ka deklaruar fajtores te pandehurit per sa jane akuzuar. Vendimi i mesiperme eshte prishur nga Gjykata Ushtarake e Apelit Tirane me vendimin nr.93, date 2.4.2002 dhe aktet i jane derguar per gjykim Gjykates Ushtarake te shkalles se pare Gjirokaster, me tjetere trup gjykues. Kunder ketij vendimi eshte paraqitur rekurs ne Gjykatën e Larte, e cila ka vendosur mospranimin e tij me vendimin nr.354, date 7.5.2002, duke mbetur ceshtja per t'u rigjykuar ne shkalle te pare.

Gjate kohes qe pritej komandimi nga K.L.D. i gjyqtareve qe do te gjykonin ceshtjen ne themel, ne daten 26.6.2002, nga mbrojtessi i te pandehurve eshte paraqitur kerkese ne Gjykatën Ushtarake Gjirokaster per revokimin e mases se sigurimit dhe nga ana e kesaj gjykate me vendimin nr.60, date 17.7.2002 eshte shpallur moskompetenca, duke ja derguar aktet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarande me arsyetimin se ajo ka vendosur masen e sigurimit e per pasoje edhe kerkesa per revokimin e mases duhet te shqyrtohej prej saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarande, me vendimin nr.32, date 23.7.2002, ka vendosur parashtrimin e mosmarreveshjes per kompetence ne Gjykatën e Larte. Kolegji Penal, me vendimin nr.494, date 31.7.2002, ka prishur vendimin nr.60, date 17.7.2002, te Gjykates Ushtarake te shkalles se pare Gjirokaster dhe ja dergon ceshtjen asaj gjykate, si gjykate kompetente.

Gjykata Ushtarake e shkalles se pare Gjirokaster me vendimin nr.77, date 30.9.2002, ka rrezuar kerkesen e te pandehurve per shuarjen e mases se sigurimit arrest ne burg, vendim i cili eshte lene ne fuqi nga Gjykata Ushtarake e Apelit, me vendimin nr.8, date 28.1.2003.

Duke u nisur nga sa me sipër dhe aktet e ndodhura ne dosje, rezulton se te pandehurit kane qendruar te paraburgosur deri ne dorezimin e akteve nga organi i prokurorise ne gjykate, nga data 8.11.1999 deri ne 8.6.2000, ose 7 muaj, kohe e cila kapercen afatin e paraburgimit te parashikuar nga neni 263, pika 1, germa "b" e K.Pr.P., qe eshte 6 muaj ne maksimum. Nga dita e dorezimit te akteve ne gjykatën e shkalles se pare deri ne marrjen e vendimit prej saj ne daten 23.5.2001, te pandehurit kane qendruar te paraburgosur 11 muaj e 15 dite, kohe me e gjate prej 3 muaj se afati maksimal i parashikuar ne nenin 263, pika 2, germa "b" te K.Pr.P. Nga dita e marrjes se vendimit ne gjykatën e shkalles se pare deri ne marrjen e vendimit nga gjykata e apelit, ne daten 2.4.2002, te pandehurit kane qendruar te paraburgosur 10 muaj e 10 dite, duke kapercyer afatin prej 2 muaj, te parashikuar ne nenin 263, pika 3, germa "b" te K.Pr.P. Gjykata e apelit ka vendosur ne disa raste pezullimin e afateve te paraburgimit, qe sipas perlllogaritjeve jane gjithsej 53 dite. Pra, duke aplikuar zbritjen per shkak te pezullimeve te mesiperme te afateve te paraburgimit, del se ne daten 2.4.2002 kur eshte marre vendimi nga gjykata e apelit, te pandehurve duhet t'u llogaritet si kohe paraburgimi data e marrjes se vendimit nga gjykata e shkalles se pare, 8 muaj e 27 dite, duke bere qe afati per kete faze te procedimit te kalohet.

Ndodhur ne keto kushte, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte konstatojne se afatet e paraburgimit jane kaluar, si persa i perket atyre qe lidhen me fazat e gjykimit, ashtu edhe afati

teresor që parashikon neni 263/6, germa “b” e K.Pr.P. i pa ndryshuar, i cili parashikonte se kohezgjatja teresore e paraburgimit nuk mund të kalojë 1 vit kur procedohet për krim. Kjo për faktin se ndryshimet e nenin 263 të K.Pr.P. janë bërë me Ligjin nr.8570, datë 20.01.2000, pra pasi të pandehurit janë arrestuar. Sipas dispozitës kalimtare të ligjit në fjalë, përcaktohet se afatet e kohezgjatjes së paraburgimit, sipas këtij ligji, do zbatohen ndaj personave që paraburgosen pas hyrjes në fuqi të tij.

Dispozita e ndryshuar e nenit 263 të K.Pr.P., ka sjelle dy elemente të reja krahasuar me atë të mëparshmen: se pari, përcaktimi i kohezgjatjes së paraburgimit lidhet me masën e dënimit që parashikon dispozita, dhe se dyti, përcakton afatet kohore me të gjata paraburgimi për fazat e procedimit, ashtu edhe atë teresor.

Po ashtu, lidhur me afatet e paraburgimit, elementi i ri i kësaj dispozite është rifillimi i tyre jo vetëm kur vendimi priset dhe kthehet për rigjykim nga Gjykata e Lartë, por edhe kur këto e vendos gjykata e apelit.

Në praktiken gjyqësore ka patur qendrimet e ndryshme në kuptimin dhe aplikimin e afateve të paraburgimit, rifillimin e tyre, pezullimin e afateve të paraburgimit, raportin e afatit teresor të paraburgimit me gjysmen e maksimales së dënimit të parashikuar për veprën penale për të cilën procedohet, e të tjera si këto, të cilat çuan Kolegjin Penal në përfundimin e nevojës së unifikimit të praktikës gjyqësore nga Kolegjet e Bashkuara.

Kolegjet e Bashkuara, për efektet e unifikimit të praktikës gjyqësore, do t'i referohen dispozitave aktuale të K.Pr.Penale, pra ndryshimeve që ato kanë pësuar me Ligjin nr.8570, datë 20.01.2000, pavarësisht që ato nuk janë të aplikueshme në gjykimin e çështjes që kanë për shqyrtim. Kjo, pasi për arrestimet e kryera për ndryshimeve të K.Pr.Penale, duhet të zbatohen dispozitat e mëparshme, të cilat në rastin në shqyrtim, janë tejkaluar.

Aktualisht, neni 263/6 i K.Pr.P., përcakton se: *“kohezgjatja teresore e paraburgimit, duke marrë parasysh dhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264 pika 2, nuk mund të kalojë këto afate:*

- a. *Dhjetë muaj, kur procedohet për kundravajtje penale;*
- b. *Dy vjet, kur procedohet për krime që denohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;*
- c. *Tre vjet, kur procedohet për krime që denohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim, ose më burgim të përjetshëm”.*

Neni 264/2 i K.Pr.P., të cilit i referohet dispozita e mësipërme, parashikon që afati i paraburgimit në fazën e hetimit paraprak mund të zgjatet për një kohë jo më shumë se tre muaj dhe vetëm një herë. Shtrohet për interpretim nëse në kohezgjatjen teresore të paraburgimit do të përfshihen edhe pezullimet e afateve të paraburgimit që parashikohen në nenin 265 të K.Pr.P. të ndryshuar.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, cmojnë se në kohezgjatjen teresore të paraburgimit nuk duhet të llogariten afatet e paraburgimit të pezulluara me vendim të gjykatës.

Per të arritur në këtë përfundim, Kolegjet kanë parasysh vetë përcaktimin e dispozitës së nenit 263, pika 6 të K.Pr.P., e cila i referohet në kohezgjatjen teresore, bashkimit të afateve të paraburgimit për çdo fazë të procedimit, duke i shtuar edhe maksimumin e zgjatjes së këtij afati me tre muaj gjatë hetimit paraprak. Pra, po të mbledhen afatet e paraburgimit për çdo fazë të procedimit, shtuar edhe zgjatjen e tyre arithmetikisht, rezultojnë afatet teresore të kohezgjatjes së paraburgimit që parashikon dispozita. Nga ana tjetër, vetë neni 263 i K.Pr.P. nuk ka përfshirë në kohezgjatjen e afateve, rastet e pezullimit të tyre, të cilat parashikohen nga neni 265 i K.Pr.Penale. Në qoftëse ligjvënisi do ta kishte për qëllim një gjë të tillë, atëherë ai do shprehë duke ju referuar dispozitës në fjalë, gjë që s'e ka bërë.

Pezullimi është nderprerje e afateve për shkak të parashikuara shprehimisht në ligj dhe sipas të drejtës penale, këto afate rifillojnë pasi të ketë mbaruar, ose të jetë hequr shkak i pezullimit, dhe vazhdojnë për pjesën e pa konsumuar të tyre. Kur gjykata disponon për një nga shkaqet që ligji parashikon për pezullim të afateve të paraburgimit, këto afate nuk ecin, por rifillojnë pas heqjes së pezullimit. Kjo do të thotë, se vetë afati maksimal i paraburgimit nuk tejkalohet proceduralisht, por koha fizike e paraburgimit mund të jetë me e gjatë se afati teresor. Qëllimi i ligjvënësive me riformulimin e dispozitës së nenit 265 të K.Pr.P., ka qenë frenimi i veprimeve spekulative në fazën e gjykimit, për të plotësuar afatet e paraburgimit nëpërmjet menyrave dhe kërkesave të paligjshme. Po t'i referohemi shkaqeve të pezullimit të afateve të paraburgimit, ato lidhen me veprime dhe kërkesa të padrejta të mbrojtësve apo të pandehurit, apo me mosparaqitjen apo largimin e mbrojtësve nga gjykimi. Pra, pezullimi i afateve të paraburgimit vendoset për shkak që kanë të bëjnë me sjelljen e të pandehurve e mbrojtësve të tyre dhe jo me ato të organit të akuzës apo të gjykatës.

Fakti që në çështjen në shqyrtim, është ngritur konflikti i kompetencës midis gjykatës civile dhe asaj ushtarake, apo se gjykata ushtarake nuk formonte dot trupin gjyqësor dhe ishte në pritje të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për komandimin e gjyqtarëve, nuk janë shkaqet e ligjshme për pezullimin e afateve të paraburgimit, ashtu si padrejtesisht kanë pranuar gjykatat.

Ligjvënësi, për të evituar qëndrimet jo ligjore dhe për t'i dhënë një kuptim me të drejtë dispozitës, ka shtuar dy elemente të rëndësishme me riformulimin e nenit 265 të K.Pr.Penale. Në pari, përcaktohet në mënyrë eksplicite se për pezullimin e afateve të paraburgimit, gjykata duhet domosdoshmërisht të shprehet me vendim dhe këto, ajo e bën kur shtyn seancën gjyqësore. Pra, vetë shtyrja e seancës gjyqësore, nuk është e mjaftueshme për efektet e pezullimit të afateve të paraburgimit, neqoftëse nuk është shoqëruar edhe me vendimin përkatës të pezullimit të këtyre afateve. Në dyti, ka përcaktuar se kundër vendimit që pezullon afatet e paraburgimit mund të bëhet ankimi në gjykatën me të lartë vecmas dhe jo së bashku me vendimin përfundimtar. Me këto, ligjvënësi ka dashur të garantojë nëpërmjet verifikimit nga gjykatat me të lartë, se afatet e paraburgimit janë pezulluar për ato shkaqet të posaçme të parashikuara në ligj dhe jo për të tjera arsye, të cilat që përcakton neni 265 i K.Pr.Penale.

Vendimi i pezullimit, si vendim i ndërmjetëm dhe që ankimohet vecmas, duhet të merret i arsyetuar nga gjykata dhe duhet t'u njoftohet palëve në proces. Në vecanti, rëndësi ka njoftimi i të pandehurit që nuk ka marrë pjesë në seancën ku është vendosur pezullimi i afateve të paraburgimit, me qëllim që të bëhet e mundur që ai të përfitojë nga e drejta e ankimit të vendimit në gjykatën me të lartë dhe që ligji ja njeh. Sa më sipër, cmohet e nevojshme të unifikohet praktika gjyqësore përse i përket afatit të ankimit dhe nëse gjykimi i çështjes në themel kur vendimi i pezullimit ankimohet vazhdon pavarësisht nga ankimi, apo edhe ai pezullohet.

Megjithatë në dispozitë nuk është përcaktuar afati kohor i ankimit, bazuar në nenin 415 të K.Pr.P., por edhe në dispozitë të tjera që rregullojnë raste të ankimeve vecmas të vendimeve të ndërmjetme të gjykatës, Kolegjet çmojnë se afati i ankimit kundër vendimit të pezullimit do të jetë 10 ditë, duke filluar nga e nesërmja e shpalljes ose njoftimit të vendimit. Vetë ankimi kundër vendimit nuk pezullon gjykimin e çështjes në themel.

Në praktiken gjyqësore, konstatohet jo rrallë, që kur pezullohen afatet e paraburgimit dhe shtyhet seanca gjyqësore për shkak të parashikuara nga neni 265 i K.Pr.P., gjykatat caktojnë date relativisht të largët për seancën e ardhme. Ky qëndrim është i pa mbështetur në ligj dhe i pa motivuar në raport me shkakun e shtyrjes së seancës. Kur flitet për pezullim të afateve të paraburgimit ato janë të lidhura me ndodhjen e një fakti, i cili e shtyn gjykatën të vendosë pezullimin e afateve. Kjo do të kuptohet se kohezgjatja e pezullimit duhet të vazhdojë derisa të hiqet pengesa ose shkak i pezullimit, dhe jo kur gjykata në mënyrë të njëjshme të vendosë një afat sipas gjykimit të saj subjektiv. Gjykatat, megjithatë seancën e ardhme e caktojnë ndonjëherë edhe

pas nje apo dy muajve, ato nuk argumentojne arsyet e kesaj kohezgjatje, apo bazohen ne shkaqe te pa justifikuara ligjerisht.

Ky qendrim eshte i gabuar edhe po t'i referohesh parimeve te pergjithshme te gjykimit, ku nje nder ato me te rendesishmet dhe qe garanton nje procedim te shpejte dhe afersine e dhenies se drejtesise nga koha e ndodhjes se krimi, eshte gjykimi i panderprere. Ne nenin 342 te K.Pr.Penale, eshte percaktuar se kur shqyrtimi gjyqesor nuk mund te perfundohet ne nje seance te vetme, gjykata vendos qe te vazhdoje ditën e mepasme te punes. Gjykata lejohet ta nderprese shqyrtimin gjyqesor deri ne 15 dite, vetem per raste te vecanta. Kjo dispozite e marre ne raport me rendesine e faktit qe ka privimi i lirise se individit, eshte mjaft e rendesishme per t'u zbatuar nga gjykatat ne shtyrjen e seancave gjyqesore, kur ato vendosin pezullimin e afateve te paraburgimit. Afatet e paraburgimit jane parashikuar si garanci per mbrojtjen e te drejtave procedurale te te pandehurit, te cilat e detyrojne organin procedues, sipas rastit, te perfundoje hetimin ose gjykimin e ceshtjes ne nje kohe te arsyeshme.

Ligjvenesi ka parashikuar ne nenin 263 te K.Pr.P. se afatet e paraburgimit te parashikuar per secilen shkalle te procedimit rifillojne kur vendimi priset nga Gjykata e Larte, ose gjykata e apelit dhe ceshtja dergohet per rishqyrtim, sipas rastit, ne gjykatën e shkalles se pare, apo te apelit.

Kolegjeve te Bashkuara u eshte shtruar per interpretim se cfare duhet kuptuar me fillim perseri te afateve te paraburgimit per secilen shkalle te procedimit ne raport me ato te konsumuar me pare. A jane keto afate te rifilluara te tilla qe te tejkalojne kohezgjatjen teresore te paraburgimit?

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se ne rigjykim, afatet e paraburgimit nuk mund te rinisin neqoftese kohezgjatja teresore eshte konsumuar plotesisht. Ne rastet e tjera, kohezgjatja e paraburgimit rifillon per cdo shkalle te procedimit, me kushtin qe kohezgjatja teresore e paraburgimit te mos tejkalojet.

Kur ceshtja kthehet per rigjykim, pavaresisht nga afatet e paraburgimit qe parashikon ligji per cdo faze te gjykimit, keto afate nuk llogariten me nga e para si bashkim arithmetik i tyre, por ne dispozicion te gjykates mbetet pjesa e pa konsumuar nga afati teresor i paraburgimit.

Kolegjet me arritjen e ketij perfundimi, terheqin vemendjen lidhur me menyren e perdorimit te afateve te kohezgjatjeve se procedimit ne te gjitha fazat e tij. Fakti qe ne nenin 263 te K.Pr.P., per rastet kur procedohet me te paraburgosur, ka percaktuar afate pjesore dhe teresore brenda te cilave duhet te perfundoje hetimi dhe gjykimi i ceshtjes ne gjendje paraburgimi, ka patur parasysh maksimalet e ketyre afateve, tejkalimi i te cilave nuk lejon vazhdimin e metejsheem te paraburgimit, pasi ai ligjerisht e humbet fuqine e tij. Ligji, duke percaktuar maksimalet e ketyre afateve, tregon kufijte e pa kalueshem per organin procedues, por kjo nuk do te thote se ato detyrimisht jane percaktuar per t'u konsumuar plotesisht. Parimi i gjykimit te panderprere, apo shpejtesise se hetimit, detyrojne si gjykatën, ashtu edhe organin e prokurorise te perfundojne ceshtjet ne nje kohe sa me te arsyeshme. Konsumimi deri ne maksimum i kohes per hetimin dhe gjykimin e ceshtjeve, le pa vlere rifillimin e afateve te paraburgimit, kur vendimet e gjykatave me te ulta prishen nga ato me te larta. Marre per baze sa me siper dhe faktin se kjo ka ndodhur edhe ne ceshtjen ne shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara terheqin vemendjen lidhur me ate se organi procedues ne hetimin dhe gjykimin e ceshtjeve penale nuk duhet te kene si pike referimi maksimumet e afateve te paraburgimit sipas fazave te procedimit, por zgjidhjen ne kohen me te shpejte te mundshme te ceshtjes prej tyre.

Ne nenin 264, pika 3 te K.Pr.P., eshte percaktuar se "kohezgjatja e paraburgimit nuk mund te kaloje gjysmen e maksimales se denimit te parashikuar per vepren penale qe procedohet".

Perpara Kolegjeve te Bashkuara eshte parashtruar per interpretim se si qendron kjo dispozite ne raport me kohezgjatjen teresore te paraburgimit, qe parashikon neni 263/6 i K.Pr.Penale.

Kolegjet e Bashkuara cmojne se neni 263/6 i K.Pr.Penale eshte nje dispozite e pergjithshme, e cila percakton sipas kategorive te veprave penale kohezgjatjen teresore te paraburgimit. Kesaj dispozite i eshte vene nje kufizim i posacem, qe lidhen me vepren penale konkrete per te cilen eshte akuzuar dhe qendron i paraburgosur i pandehuri. Ne keto raste, megjithese afati maksimal e lejon, kohezgjatja e paraburgimit nuk mund te kaloje 1/2 e maksimumit te denimit qe parashikon vepra penale.

Marre per baze kete, Kolegjet arrijne ne perfundimin se kohezgjatja e paraburgimit nuk mund te kaloje 1/2 e maksimumit te denimit te parashikuar per vepren penale per te cilen procedohet, edhe pse afati teresor i percaktuar nga neni 263 i K.Pr.P., e lejon paraburgimin tej kesaj kohe.

Me e dukshme kjo eshte ne rastet e kundervajtjeve penale, kur megjithese kohezgjatja teresore ne maksimum mund te shkoje deri ne dhjete muaj paraburgim, vete dispozitat e vecanta, parashikojne denime te ulta me burgim, te cilat shkojne me aplikimin e 1/2 me pak se sa kohezgjatja teresore e parashikuar nga neni 263 i K.Pr.Penale.

Ne ceshtjen ne shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara, pavaresisht se konstatojne humbjen e fuqise se paraburgimit per te pandehurit per shkak te kalimit te afateve, nuk vendosin te urdherojne lirimine e menjehershme te tyre. Kjo per faktin se, aktualisht te pandehurit Julian Guga e Ferdinand Xhango jane te denuar me vendim te formes se prere te Gjykates Ushtarake te Apelit Tirane nr.62, date 16.09.2003, me burgim respektivisht shtate vjet dhe gjashte vjet e tete muaj. Po ashtu, i gjykuari Baftjar Allaraj eshte deklaruar fajtor dhe denuar me vendimin nr.11, date 6.5.2003 te Gjykates Ushtarake te shkalles se pare Gjirokaster, i cili ka marre forme te prere ne date 16.5.2003, me gjashte vjet e tete muaj burgim.

Megjithate, Kolegjet e Bashkuara cmojne se periodha e kaluar me paraburgim tej afatit maksimal te tij, ne ekzekutim te vendimit te denimit duhet te llogaritet sipas percaktimeve te neni 57 te K.Penal.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne mbeshtetje te nenit 141/2 te Kushtetutes, nenit 17/a te Ligjit nr.8588, date 15.3.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates se Larte" dhe nenit 263 te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S Ë N

1. Prishjen e te dy vendimeve dhe konstatimin e humbjes se fuqise se paraburgimit per te gjykuarit Ferdinand Xhango, Julian Guga dhe Baftjar Allaraj.
2. Unifikimin e praktikës gjyqesore sikurse percaktohet ne kete vendim.
3. Dergimin per botim ne Fletoren Zyrtare te ketij vendimi qe njehson praktiken gjyqesore.

Tirane, me 11.11.2003

MENDIM PARALEL

Perfundimin e Kolegjeve të Bashkuara se “ne rigjykim afatet e paraburgimit nuk mund të rinisin neqoftese kohezgjatja teresore eshte konsumuar plotesisht. Ne rastet e tjera, kohezgjatja e paraburgimit rifillon per çdo shkalle te procedimit duke vazhduar per pjesen e pakonsumuar, me kushtin qe kohezgjatja teresore e paraburgimit te mos tejkalohet”, e çmojme jo konform permbajtjes se nenit 263, pika 4 te K.Pr.Penale.

Kjo dispozite shpreh qarte faktin qe: “Kur vendimi priset nga Gjykata e Larte dhe çeshtja i dergohet gjykates se shkalles se pare ose apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dergohet gjykates se shkalles se pare, nga dita e dhenies se vendimit te Gjykates se Larte apo te apelit, fillojne perseri afatet e parashikuara, per secilen shkalle te procedimit”.

Kjo dispozite, rifillimin e afateve te paraburgimit nuk e kondicionon me faktin e pranuar nga Kolegjet e Bashkuara vetem per pjesen e pa konsumuar te tij (paraburgimit), por me prishjen e vendimit nga Gjykata e Larte (te gjykates se shkalles se pare dhe te apelit) dhe nga gjykata e apelit (te gjykates se shkalles se pare) dhe çeshtja dergohet ne gjykatën e shkalles se pare apo te apelit.

Ne kete rast do te kemi nje rillogaritje te kohezgjatjes teresore te paraburgimit ne kuptim te pikes 6 te nenit 263 te K.Pr.Penale. Ne kete rast, afatet e konsumuara para prishjes se vendimit apo vendimeve dhe ato me pas nuk mund te kalojne “gjysmen e maksimales se denimit te parashikuar per vepren penale qe procedohet”.

Sa eshte pranuar nga Kolegjet e Bashkuara mbeten te pa zbatueshme pika 4, e nenit 263 dhe pika 3 e nenit 264 te Kodit te Procedures Penale.

Vladimir Metani

Bashkim Caka

**Nr. 3 i Regj.Themeltar
Nr. 5 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Zamir Poda	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Evjeni Sinoimeri	Anetare
Vladimir Bineri	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Irma Bala	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Nikoleta Kita	Anetare
Perikli Zaharia	Anetar

me date 11.11.2003, ne seancen gjyqesore, shqyrtuan çeshtjen penale nr.3, qe i perket:

TË GJYKUARVE: FATION NDREU, i biri Muharremit dhe i Baftijes, i datelindjes 1981, lindur dhe banues ne Tirane.
FATMIR KEÇI, i biri Muhametit dhe i Shpreses, i datelindjes 1978, lindur e banues ne Arapaj- Durres.

A K U Z U A R:

Per kryerjen e vepres penale
te vjedhjes ne bashkepunim,
parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Gjykata e rrethit gjyqesor Durres, me vendimin nr.204, date 14.6.2002, ka vendosur:
“Deklarimin fajtor te te pandehurit Fation Ndreu per vepren penale te vjedhjes ne shumen 700.000 leke, e ne baze te nenit 134/1 e 50 “b” te K.Penal e denon me 1 vit e 6 muaj burg.
Vuajtja e denimit i fillon nga data 26.1.2002, qe eshte arrestuar.
Deklarimin fajtor te te pandehurit Fatmir Keçi per vepren penale te mos kallezimit te krimit, e ne baze te nenit 300/1 te Kodit Penal e denon me 9 muaj burg.
Vuajtja e denimit fillon nga data 26.1.2002, qe eshte arrestuar”.

Ne zbatim te nenit 190/ç te K.Pr.Penale, automjeti i bllokuar BMW t'i kthehet pronarit te ligjshem”.

Gjykata e Apelit Durres, mbi apelin e prokurorit dhe te te pandehurit Fatmir Keçi, me vendimin nr.242, date 26.9.2002, ka vendosur:

“Lenien ne fuqi te vendimit penal nr.204, date 14.6.2002 te Gjykates se rrethit gjyqesor Durres”.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Durres dhe vendimit te Gjykates se rrethit gjyqesor Durres, ka paraqitur rekurs, ne baze te nenit 432 te K.Pr.Penale, Prokuroria e Apelit Durres, e cila kerkon ndryshimin e tyre dhe deklarimin fajtores te te pandehurve per vepren penale te parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal e denimin e tyre me 5 vjet burgim secili, duke parashtruar keto shkaqe:

- Gjykatat nuk kane vleresuar drejt provat e administruara dhe ne kete menyre nuk kane arritur ne nje konkluzion te drejte.
- Nga shpjegimet e deshmitareve, te cilat perputhen me ato te te pandehurit Fation Ndreu gjate hetimit, provohet kryerja e vjedhjes ne bashkepunim.
- Gjykata gabimisht ka ndryshuar cilesimin juridik te akuzes.
- Edhe sikur te merret i mireqene fakti se autor i vjedhjes eshte vetem i pandehuri Fation Ndreu, ai duhej deklaruar fajtor per vepren penale te vjedhjes me pasoja te renda, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, pasi vlere prej 700.000 lekesh e autovetures, duhet te konsiderohet pasoje e rende, nisur nga niveli ekonomik i familjeve shqiptare, niveli i pagave dhe i te ardhurave te punonjesve dhe nuk mund te behet rast pas rasti sic argumenton gjykata.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr.93, date 26.2.2003, ka vendosur:

“Kalimin e akteve Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte per njehsimin e praktikës gjyqesore”.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga gjyqtaret Kristaq Ngjela dhe Perikli Zaharia, prokurorin Saliko Hajno, qe kerkoi prishjen e vendimit te gjykates se apelit dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim dhe pasi shqyrtuan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Te pandehurit Fation Ndreu e Fatmir Keçi, jane derguar per gjykim me akuzen e vjedhjes se pasurise ne bashkepunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Ata jane akuzuar se, me date 25.01.2002, kane vjedhur nje automjet veture tip BMV, qe sipas aktit te vleresimit date 15.03.2002 ka nje vlere prej 700.000 leke.

Ne perfundim te gjykimit, Gjykata e rrethit gjyqesor Durres ka vendosur te ndryshoje cilesimin ligjor te vepres, ne ngarkim te te pandehurit Fation Ndreu, nga paragrafi i dyte ne paragrafin e pare te nenit 134 te K.Penal. Ne kete perfundim ka arritur duke arsyetuar se nuk provohet qe vjedhja eshte kryer ne bashkepunim me te pandehurin Fatmir Keçi, i cili eshte deklaruar i denuar perfundimisht per vepren penale te moskallezimit te krimit, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal me 9 muaj burgim.

Gjykata e Apelit Durres, qe ka gjykuar ceshtjen mbi ankimin e prokurorit dhe te te pandehurit

Fatmir Keçi, me vendimin nr.242, date 26.09.2002, ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se rrethit me te njejtat argumenta, duke u shprehur se mungon bashkepunimi ne kryerjen e vepres dhe se, percaktimi i ndryshem juridik qe ka bere gjykata e rrethit, bazuar ne nenin 375 te K.Pr.Penale, duke ndryshuar kualifikimin ligjor te vepres per te dy te pandehurit, eshte i drejte.

Ne ankimin e bere kunder vendimit te Gjykates se rrethit gjyqesor Durres dhe gjate gjykimit ne gjykaten e apelit, prokurori ka pretenduar se edhe ne qofte se nuk pranohet se vjedhja eshte kryer ne bashkepunim, i pandehuri Fation Ndreu duhet te deklarohet fajtor e te denohet, ne baze te nenit 134/2 te K.Penal, pasi duke qene vlera e makines 700.000 leke, ka sjelle pasoja te renda, pretendim, i cili eshte ngritur edhe ne rekursin e paraqitur ne Gjykaten e Larte.

Ne lidhje me kete, gjykata e apelit arsyeton se, ky pretendim nuk qendron pasi ne ekonomine e tregut, kjo vlere nuk mund te konsiderohet pasoje e rende dhe ne praktiken gjyqesore apo ne ligj, nuk ka nje percaktim te tille. Gjithashtu kjo gjykate shprehet se, per te percaktuar pasojen e rende ndaj personit te demtuar nga vepra, nga prokuroria duhej te hetohet dhe te silleshin prova per gjendjen ekonomike te te demtuarit, ndikimin ne gjendjen e pergjithshme qe ka sjelle vepra, per çfare perdorej mjeti, si burim te ardhurash apo perdorim dhe se demi i eshte zevendesuar te demtuarit pasi i eshte kthyer mjeti.

Ne keto kushte, ndodhur para faktit qe gjykatat jo rralle, jane ndeshur ne veshtiresi praktike per zbatimin e paragrafit te dyte te dispozites se nenit 134 te Kodit Penal, ne lidhje me elementin "pasoja te renda" qe permban ky paragraf, Kolegji Penal i Gjykates se Larte, çmoi me vend qe per kuptimin dhe permbajtjen e shprehjes "pasoja te renda", çeshtja t'i dergohej Kolegjeve te Bashkuara te kesaj gjykate per ta bere nje gjje te tille.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke patur parasysh rastet e zbatimit te paragrafit te dyte te kesaj dispozite, ne lidhje me rrethanen "pasoja te renda", qendrimet jo te njejtat qe jane mbajtur ne praktiken gjyqesore, faktin qe ka qendrimet te ndryshme brenda gjykatave dhe gjykatave te ndryshme ne drejtim te interpretimit te saj dhe ne funksion te shqyrtimit te çeshtjes objekt gjykimi, arriten ne perfundimet e meposhtme:

Nisur nga formulimi i bere ne nenin 134/2 te Kodit Penal, duhet pranuar se, ekzistenca qofte dhe vetem e rrethanes "pasoje e rende", ne rastin e vjedhjes se pasurise, eshte e mjaftueshme qe vepra penale e kryer nga personi, te cilesohet sipas ketij paragrafi. Vetem fakti qe vjedhja e pasurise te kete sjelle pasoja te renda, ben qe ajo te konsiderohet e cilesuar.

Interpretimi i termit "pasoja te renda" duhet pare ne raport me vete figuren e vepres penale, me raportet shoqerore qe ajo mbron dhe duhet analizuar ne çdo rast me disa rrethana qe lidhen me demin e shkaktuar nga vjedhja.

Duke u nisur nga fakti qe figura e vepres penale te vjedhjes, ka pasoje pakesimin e pasurise se tjetrit ne menyre te kunderligjshme, Kolegjet e Bashkuara evidentojne faktin se nje nder kriteret baze per te percaktuar pasojen e rende eshte vlere e pasurise se vjedhur e cila do te merret ne çdo rast e lidhur me rrethanat e tjera qe kane ndikuar tek subjekti i demtuar.

Ligjvenesit nuk e kushtezon vjedhjen me vleren dhe ne paragrafin e dyte te nenit 134 nuk permendet fjala vlere, prandaj per te percaktuar "pasojen e rende", duhet patur parasysh se ajo do te jete e ndryshme mes subjekteve qe demtohen nga vepra penale e vjedhjes qe ndahen ne: individe, persona juridike dhe shteti. Ne raport me zhvillimin aktual ekonomik e gjendjen ekonomike te individit e te shoqerise, Kolegjet e Bashkuara percaktojne si kriteret orientuese per vleren si pasoje te rende ne rastet e vjedhjes se parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal:

- 1. Shuma ose sende me vlere mbi 1.000.000 leke kur ato u vidhen individeve.**
- 2. Shuma ose sende me vlere mbi 2.000.000 leke kur vjedhja eshte realizuar ne dem te**

personave juridike dhe pasurise shteterore.

Keto vlere do te jene relative duke patur parasysh edhe pasojat e tjera qe mund te shkaktohen nga kryerja e kesaj vepre penale dhe gjykatat rast pas rasti duhet ta marrin ate lidhur me vendin e kryerjes se vepres penale, kohen e kryerjes se saj, me subjektin e demtuar dhe me pasoja te tjera jo ekonomike qe mund te vijne te cilat, kur rendojne rrethanat e faktit, pavaresisht se vlerat mund te jene me te vogla nga percaktimet e mesiperme, mund ta çojne gjykatën ne perfundimin se vjedhja ka sjelle pasoja te renda e ta kualifikojne ate ne baze te nenit 134/2 te Kodit Penal.

Ne kete perfundim arrihet duke u nisur nga vete formulimi i paragrafit te dyte te nenit 134 te Kodit Penal ku thuhet: "po kjo veper kur ka sjelle pasoja te renda", dhe nga terminologjia qe ka perdorur ligjvenesi per kete qellim ne lidhje me pasojen si element te anes objektive te kesaj figure krimi dhe qe duhen kuptuar jo pasoja te çfaredoshme qe vijne ne çdo rast vjedhjeje te pasurise por pasoja te nje natyre te veçante qe duhen trajtuar te renda duke mbajtur parasysh edhe shkallen e efektit negativ qe peson i demtuari nga vepra penale. Keshtu mund te sillen si shembuj vjedhja e nje pjese ose detaji te linjes teknologjike te nje fabrike ose te nje aparature elektromjekesore, etj., te cilat pavaresisht nga vlere e tyre e shprehur ne te holla, shkakton sipas rasti nderprerjen e procesit teknologjik, le pa pune nje numer te konsiderueshem punonjesh, le pacientet pa mjekimin e domosdoshem jetik, le pa energji elektrike apo uje nje zone, qyteti apo fshati, etj.

Duke ju permbajtur kriterëve te percaktuara, me vend, ne kuptim te kryerjes se vepres penale te vjedhjes duhet mbajtur ne konsiderate territori konkret ku ajo kryhet e zhvillimi ekonomiko-social i tij ne raport me zonat apo pjeset e tjera te territorit.

Per te arritur ne perfundimin ne se koha e kryerjes se vepres penale eshte apo jo cilesuese, ajo duhet lidhur me situaten faktike ne ate vend ku ka ndodhur vepra penale ne raport me territorin dhe individin. Ajo mund te ndikojne ne rendimin e pasojave ekzistuese ne raport me nje situatë te caktuar te rende siç mund te jete gjendja e jashtezakonshme, situata e renduar nga fatkeqesite natyrore, por edhe me vete individin si psh fatkeqesi te renda familjare, gjendje e renduar shendetesore, fatkeqesi me pasoja ekonomike (p.sh. i eshte djegur shtepia), etj., te cilat duhet te provohen rast pas rasti.

Per ta patur vjedhjen te cilesuar ne raport me subjektin e demtuar duhen patur parasysh problemet qe kane te bejne me gjendjen e tij ekonomike, me pasojen direkte qe sjell vjedhja ne situaten e tij ekonomike apo te familjes se tij si dhe efekte te tjera negative qe mund te evidentohen rast pas rasti.

Duhet patur parasysh edhe personi te cilit i shkaktohet pasoja pasi nuk mund te barazohen personat nga pikepamja e efektit negativ qe ushtron vjedhja ne njerin apo tjetrin subjekt, rrethanat individuale te te cilit do te sherbejne edhe per caktimin e mases se denimit brenda marzheve qe parashikohen ne nenin 134/2 te Kodit Penal. Keshtu, nuk mund te barazohet vjedhja e pasurise qe i behet nje pensionisti qe siguron jetesen vetem me pensionin qe merr, me nje person tjetër qe siguron te ardhura nga veprimtaria e tij ekonomiko-private.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte duke patur parasysh keto kriterë orientuese dhe rrethana te vecanta qe mund te dalin gjate shqyrtimit te çeshtjeve penale e qe paraqesin rendesi per kualifikimin ligjor te vepres thekson se **gjykatat detyrimisht, kur arrijne ne perfundimin se ndodhemi para pasojës se rende, duhet te evidentojne rrethanat konkrete qe ndikojne ne nje percaktim te tille e t'i arsyetojne hollesisht ne vendimet e tyre.**

Persa i perket vjedhjes se kryer nga te gjykuarit Fation e Fatmir, ne gjendjen qe jane aktet, nisur nga fakti qe te dy gjykatat nuk kane kryer veprime ne drejtim te vertetimit te ekzistences ose jo te rrethanave te permendura me lart, ne lidhje me vjedhjen e autovetures me vlere 700 mije

leke, Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk iu krijua mundësia praktike, për të shprehur nëse, në rastin konkret ndodhemi ose jo para vjedhjes së pasurisë që ka sjelle pasoja të rënda.

Megjithatë, kolegjet, bazuar në faktin që, ligjvënosi në paragrafin e dytë të dispozitës së nenit 134 të Kodit Penal, përveç pasojave të rënda, ka parashikuar edhe dy rrethana të tjera, sikurse është ajo e bashkëpunimit dhe kryerja e dy ose me shumë vjedhjeve, rrethana këto që secila prej tyre qëndron krejtësisht me vete dhe duke shqyrtuar rrethanat konkrete, në të cilat është kryer vepra në rastin e të gjykuarve Fation e Fatmir, arriten në përfundimin se vendimi nr.242, datë 26.09.2002 i Gjykatës së Apelit Durrës është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit dhe, për rrjedhojë duhet të prishet.

Në këtë përfundim u arrit, pasi në analizen e provave, gjykata duhet të nisët nga parimet bazë për vlerësimin objektiv të tyre dhe kërkesat e nenit 152 të K.Pr.Penale sipas të cilit përcaktimi i vertetësisë dhe fuqisë provuese të provave i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, nuk ka vlerë të paracaktuar dhe së ekzistencës së një fakti mund të nxirret edhe nga indicjet kur ato janë të rëndësishme dhe në përputhje me njëra tjetrën.

Akuza në ngarkim të të pandehurve Fation Ndreu e Fatmir Keçi për vjedhje të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal nuk është ngritur vetëm mbi deklaratën e bërë para oficerit të policisë gjyqësore nga i pandehuri Fation Ndreu por edhe duke ju referuar deklaratimeve të personave të tjerë të marra gjatë hetimit paraprak. Është e kuptueshme që, në bazë të nenit 380 të K.Pr.Penale, për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor por njëkohësisht gjykata është e detyruar që të paraqesë e arsyetojë në vendimin e saj krahas provave mbi të cilat bazon vendimin edhe provat e tjera që i konsideron të pa pranueshme për akuzën.

Në procesverbalin e mbajtur më datën 26.01.2002 mbi deklaratën e personit mbi të cilin zhvillohen hetimet, Fation Ndreu ka shpjeguar hollësisht mekanizmin e kryerjes së vjedhjes së autoveçurës tip BMW në bashkëpunim me të pandehurin Fatmir Keçi dhe veprimet e kryera deri në ditën e kapjes nga organet e policisë, ndërsa Fatmir Keçi i pyetur po në atë datë e me të njëjtën çelësi, ka mohuar të ketë marrë pjesë në vjedhjen e autoveçurës. Mbi deklaratën e të pandehurit Fation, janë pyetur edhe disa persona si Demir Merhati, Arben Kadrimi, Leonard Ndreu deklaratën e të cilëve janë në teresi të njëjta me ato që ka deklaruar Fation Ndreu (në pjesën që lidhet me ta).

Gjykata e rrethit arsyeton në vendimin e saj se nuk rezulton që të pandehurit të kenë bashkëpunuar për vjedhjen e makines, pasi edhe i pandehuri Fation Ndreu nuk pranon vjedhjen në bashkëpunim e se i pandehuri Fatmir Keçi, nuk mund të ngarkohet me fajësi vetëm mbi deklaratën e të pandehurit tjetër të bërë në organet e policisë, të cilat në bazë të nenit 151/4 nuk mund të përdoren pasi janë marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji.

Rezulton nga aktet e administruara së deklaratën nga Fation Ndreu, janë marrë pa praninë e mbrojtësit e në seancën e datës 24.05.2002, mbrojtësi ka kërkuar pavlefshmerinë e procesverbalit. Për kështu rezulton se në seancën e datës 13.06.2002, i pandehuri Fation ka deklaruar se vjedhjen e ka kryer i vetëm pa bashkëpunimin me të pandehurin Fatmir Keçi duke shpjeguar se në polici është shprehur për bashkëpunimin se e detyruan me zor.

Gjykatat nuk kanë patur parasysh kërkesat e nenit 296 të K.Pr.Penale, sipas të cilit në vendin e ngjarjes ose në veprat penale të dukshme oficeret e policisë gjyqësore, edhe pa praninë e mbrojtësit, mund të marrin nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet të dhëna të nevojshme për vazhdimin e hetimeve. Përveç kësaj, gjykata e rrethit në arsyetimin e vendimit për ndryshimin e çelësimit juridik të vepres për të dy të pandehurit, ju drejtohet vetëm deklaratimeve të të pandehurit Fation Ndreu (ndërsa i pandehuri Fatmir Keçi nuk ka pranuar të japë shpjegime) pa marrë për bazë shpjegimet e deshmitareve të pyetur në seancë gjyqësore dhe pa u shprehur fare për faktet e rrethanat që ata kanë shpjeguar. Ky qëndrim i mbajtur nga gjykata vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 152/3 të

K.Pr.Penale, sipas te cilit deklarimet e bera nga bashke i pandehuri ne te njejten veper penale vleresohen ne unitet me provat e tjera qe konfirmojne vertetesine e tyre.

Gjykata e Apelit Durres mban te njejtin arsyetim ne vendimin e saj sikurse dhe gjykata e rrethit pa marre ne analize e pa arsyetuar faktin qe deshmitet e deshmitareve nuk jane marre ne analize e pa ju pergjigjur problemeve te ngritura ne ankimin e prokurorit, gje qe e ben vendimin e saj te cenueshem.

Ne rigjykim, Gjykata e Apelit Durres duhet te perserise pjeserisht hetimin gjyqesor ne baze te nenit 427/3 te K.Pr.Penale duke ripyetur deshmitaret, te zbatoje kerkesat procedurale per vleresimin ne teresi te provave si dhe kerkesat e nenit 362 te K.Pr.Penale, ne rastet e kundershimit te deshmitareve, gje qe do te ndikojte ne percaktimin e drejte te kualifikimit ligjor te vepres se kryer nga te pandehurit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne baze te nenit 141/2 te Kushtetutes, nenit 17/a te ligjit nr.8588, date 15.3.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates se Larte" dhe nenit 441/ç te K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.242, date 26.09.2002 te Gjykates se Apelit Durres dhe kthimin e akteve per rishqyrtim po asaj gjykate me tjeter trup gjykues.

Ky vendim per njehsimin e praktikës gjyqesore, dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 11.11.2003

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jemi dakort me mendimin e shumices se anetareve te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte ne lidhje, se pari: me tejkalinimin e kompetencave qe i jane dhene Kolegjeve te Bashkuara kur eshte fjala per njehsimin e praktikës gjyqesore dhe, se dyti: persa i takon kuptimit, nga pikepamja e permbajtjes, qe i eshte dhene prej saj (shumices) termit "pasoja te renda", qe ka perdorur ligjvenesin ne formulimin e permbajtjes se paragrafit te II-te, te dispozites se nenit 134 te Kodit Penal, drejtime keto, te cilat, pakica mendon se nuk mund te merren te shkeputura nga njeri-tjetri.

Ne lidhje me te paren, pakica mendon se, duke percaktuar kufijte ne vlera absolute, te shprehura ne shuma lekesh, (nje dhe dy milione leke), shumica, ne nje kohe kur duhej t'i jepte zgjidhje problemit te veshtire me te cilin ndeshen gjykatat persa i takon zbatimit te paragrafit te II-te, te dispozites se nenit 134 te Kodit Penal, duke i orientuar ato se ne cilat raste do te konsiderohej prej tyre se, vjedhja e pasurise ka sjelle pasoja te renda, kane marre persiper nje detyre, te cilen vete ligjvenesin, kuptohet qe jo pa qellim, e ka shmangur ate.

Per me teper, edhe vete formulimi i kesaj pjese te vendimit, ku thuhet se: "... Kolegjet e Bashkuara percaktojne si kriteret orientuese per vleren si pasojat te rende ne rastet e vjedhjes se parashikuar nga neni 134/II i Kodit Penal: 1. Per vlera ose sende me vlera ne 1.000.000 leke kur ato u vidhen individeve. 2. Per vlera ose sende me vlera 2.000.000 leke kur vjedhja eshte realizuar ne dem te personave juridike dhe pasurise shteterore", jo vetem qe ben percaktime shumash pa sjelle argumentet ne te cilat ato bazohen, por ne vetvete, permban edhe pasaktesi qe, mund te ç'orientojne gjykatat dhe te sjellin si rrjedhoje prishjen e vendimeve te tyre nga gjykatat me te

larta. Kjo, per shkak te shprehjes se perdorur, qe u permend, "... me vlere ne 1.000.000 leke" ne nje kohe kur mund te interpretohet edhe ne kuptimin "... me vlere 1 milion leke e lart, ne piken 1, ose 2 milion leke e lart, ne piken 2 te shprehjes se cituar".

Pervec kesaj, ne lidhje me percaktimin e ketyre shumave, nga permbajtja e teresise se vendimit, rezulton se vete shumica nuk u eshte permbajtur atyre kur, ne paragrafin e trete te faqes 6 te tij, i jep pergjigje pretendimeve te rekursit, ne lidhje me zgjidhjen e ceshtjes konkrete objekt gjykimi ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, e cila, normalisht duhej te perbente edhe thelbin nga i cili duhej te buronin percaktimet unifikuese te vendimit unifikues te tyre.

Dhe se fundi, pasaktesia ne vendimin e shumices, konsiston edhe ne faktin qe, duke bere percaktimin e shumave absolute si me siper, nuk eshte patur parasysh prej saj, jo vetem shkalla e inflacionit ne vend, e cila, sikurse dihet, eshte e ndryshueshme, ne vartesi te shume faktoreve ekonomike, ne periudha te ndryshme kohe, por as edhe indeksimi i here pas hershem i çmimeve dhe ndryshueshmeria e konvertimit te lekut me monedhat e huaja ne tregun e brendshem dhe ate te jashtem, te lire e bankar.

Persa i perket kuptimit, nga pikepamja e permbajtjes, qe i duhet dhene termit "pasoja te renda" qe ka perdorur ligjvenesi ne formulimin e permbajtjes se paragrafit te II-te, te dispozites se nenit 134 te Kodit Penal, pakica mendon se, per efekte te unifikimit te praktikës gjyqesore, ai duhej te ishte si me poshte:

Nisur nga formulimi i paragrafit te II te dispozites se nenit 134 te Kodit Penal, arrihet ne perfundimin se, ekzistenca qofte edhe vetem e rrethanes "pasoja te renda", ne rastin e vjedhjes se pasurise, eshte e mjaftueshme qe vepra e personit qe e ka kryer ate, te cilesohet sipas ketij paragrafi. Vetem fakti, qe vjedhja e pasurise te kete sjelle pasoja te renda, ben qe ajo te konsiderohet e cilesuar.

Mirepo, ne praktiken e gjykatave, veshtiresi paraqet percaktimi i kushteve dhe rrethanave nga te cilat duhet te udhehiqen gjykatat, per te arritur ne nje perfundim te drejte e te bazuar nese vjedhja e pasurise, ne njerin apo tjetrin rast, ka sjelle ose jo "pasoja te renda".

Lidhur me kete, qe ne fillim duhet thene qe, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se, si kriter nga i cili duhet te nisen gjykatat per te percaktuar nese vjedhja e pasurise ka sjelle ose jo "pasoja te renda", nuk duhet te sherbeje vetem vlere e sendit (pasurise) te vjedhur.

Perjashtim duhet bere vetem ne rastet kur shuma e parave, ose vlere ne vetvete e sendeve te vjedhura, e shprehur ne te holla, eshte dukshem e madhe, ne kuptimin qe ajo ndikon ndjeshem ne keqesimin e gjendjes ekonomiko-financiare te te demtuarit ose ne pakesimin e bilancit financiar te tij.

Ne te gjitha rastet e tjera, per te percaktuar nese ndodhen ose jo para rastit, kur vjedhja e pasurise ka sjelle pasoja te renda, gjykatat duhet qe, vleren e pasurise te vjedhur, ta marrin ne konsiderate ne raport me disa faktore te tjere qe i perkasin, kryesisht, anes objektive te figures se krimi te vjedhjes se pasurise.

Ne kete perfundim arrihet duke u nisur se pari, nga vete formulimi i dispozites (paragrafit te II te nenit 134 te K.Penal) ku thuhet: "Po kjo veper... kur ka sjelle pasoja te renda" dhe, se dyti nga terminologjia qe ka perdorur ligjvenesi per kete qellim ne lidhje me pasojen, si element te anes objektive te kesaj figure krimi.

Persa i perket formulimit, ligjvenesi eshte shprehur me fjalet "...ka sjelle pasoja te renda" me te cilat duhet kuptuar qe, si rrjedhoje e vjedhjes se pasurise, te demtuarit nga kjo veper, person fizik apo juridik qofte ai, t'i jene shkaktuar jo pasoja te çfaredoshme, (per te cilat dihet se vijne ne çdo rast vjedhjeje te pasurise, pavaresisht nga vlere e saj), por pasoja te nje natyre te veçante, te cilat ligjvenesi i ka quajtur te renda.

Me kete duhet kuptuar qe rendesia, (ne kuptimin negativ te saj) e vjedhjes se pasurise, per personin e demtuar prej saj, te jete e madhe, ne kuptimin qe ai te kete ndjere ndikimin e saj, ne nje mase te konsiderueshme jo thjeshte dhe vetem per shkak te demit material qe ka pesuar, i cili sigurisht qe ka lidhje edhe me vleren e sendit te vjedhur, (dem qe ne doktrinen e se drejtes penale shprehet me fjalet "pakesim i pasurise"), por edhe me rrethana te tjera qe lidhen sidomos me anen funksionale dhe qellimin e perdorimit te sendit te vjedhur, prej tij.

Prandaj, arrihet ne perfundimin se, nga menyra se si eshte formuluar kjo dispozite ne paragrafin e dyte te saj, ne percaktimin e faktit nese nga vjedhja e pasurise kane ardhur apo jo pasoja te renda, gjykatat, ne çdo rast, duhet te mbajne parasysh edhe shkallen e efektit negativ te vjedhjes tek i demtuari nga vepra penale.

Per ilustrim te ketij perfundimi, si shembuj hipotetik mund te sillen psh, vjedhja e nje pjese ose detaji te linjes teknologjike te nje fabrike, ose te nje aparature elektromjekesore, etj., e cila pavaresisht nga vlera e saj e shprehur ne te holla, shkakton sipas rastit nderprerjen e procesit teknologjik te prodhimit; lenien pa pune te nje numri te konsiderueshem punonjesish; lenien pa mjekimin e domosdoshem jetik, te nje apo me shume personave; lenien pa energji elektrike apo pa uje te nje zone, qyteti, fshati apo komuniteti te caktuar, etj.

Ndersa, persa i perket terminologjise, ligjvenesi, termin "pasoja te renda" e ka perdorur edhe ne disa dispozita te tjera te pjeses se posaçme te Kodit Penal, duke e vendosur ate si element perberes te anes objektive te figurave te cilesuara te veprave penale qe parashikohen prej tyre.

Mirepo, per t'i dalluar pasojat e renda, ne kuptimin e pergjithshem te tyre, sikurse u dha ai me lart, ne disa prej ketyre dispozitave, (nenet 151/II, 152/II, 152/II, 154/II, 155/II, 161, 162, 228 dhe 282/II te Kodit Penal), vete ligjvenesi ka specifikuar natyren e pasojave te renda, me permendjen, ne vete keto dispozita, te karakterit material te tyre, duke i emertuar "pasoja te renda materiale".

Persa i perket zgjidhjes konkrete te çeshtjeve, ne drejtim te procesit te percaktimit te faktit nese vjedhja e pasurise, ne njerin apo tjetrin rast, ka sjelle apo jo pasoja te renda, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, çmojne se, veç sa u parashtruan me lart, gjykatat duhet te marrin parasysh edhe nje seri rrethanash te tjera qe kane te bejne sidomos me llojin e natyren e sendit te vjedhur, vleren e tij, jo vetem ne kuptimin e ngushte te saj, por edhe ne raport me fuqine ekonomike te personit (fizik apo juridik, publik apo privat qofte ai) te demtuar; kur eshte e nevojshme, me vendin dhe kohen kur eshte kryer vjedhja dhe rrethana te tjera, per te cilat ato çmojne se duhet te merren parasysh, rast pas rasti, ne arritjen e nje perfundimi te tille.

Por, ne te gjithe rastet kur çmojne se nga vjedhja e pasurise kane ardhur pasoja te renda dhe arrijne ne perfundimin se vepra duhet cilesuar me paragrafin e dyte te dispozites se nenit 134 te Kodit Penal, per shkak te ketyre pasojave, gjykatat duhet te evidentojne rrethanat konkrete, ne te cilat jane bazuar per arritjen ne kete perfundim.

Spiro Spiro Bashkim Caka Vladimir Metani Perikli Zaharia Natasha Sheshi Agron Lamaj

**Nr.5 i Regj. Themeltar
Nr.4 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Ylvi Myrtja	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Agron Lamaj	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Evjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare
Zamir Poda	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 27.03.2003 moren ne shqyrtim ceshtjen qe i perket:

KËRKUES: JUAN KONDI, perfaqesuar nga av. N. Duro

OBJEKTI:

Konvertimi i denimit,
ne baze te nenit 283/1 te K.Penal
ndryshuar me Ligjin nr.8733, date 24.01.2001
Baza Ligjore: Neni 3.3 i K.Penal
si dhe neni 2 i Ligjit nr.7942, date 31.05.1995.

Gjykata e shkalles se pare Elbasan, me vendimin nr.111, date 12.04.2002, ka vendosur:
Rrezimin e kerkeses se bere nga i padituri Juan Kondi, per nje konvertim te ri te denimit.

Gjykata e Apelit Durres, me vendimin nr.215, date 06.09.2002, ka vendosur:
Lenien ne fuqi te vendimit nr.111, date 12.04.2002 te Gjykates se shkalles se pare Elbasan.

Kunder vendimit nr.215, date 06.09.2002 te Gjykates se Apelit Durres, ka ushtruar rekurs kerkuesi duke parashtruar keto shkaqe:

- a. Ligji i ri ka fuqi prapavepruese edhe ndaj personave te denuar.
- b. Masa e denimit nuk mund te kaloje kufirin maksimal, sipas ligjit shqiptar (neni 516/1 i K.Pr.P.)
- c. Neni 11 i Ligjit nr.7942, date 31.05.1995, njeh te drejten qe personat t'i drejtohen gjykates per pretendimet lidhur me efektet juridike te hyrjes ne fuqi te Kodit Penal.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr.91 Akti, date 19.02.2003, ka vendosur:

Kalimin e ceshtjes Kolegjeve te Bashkuara per te unifikuar praktiken gjyqesore, duke parashtruar;

a. Cili eshte kuptimi i nenit 3.3 te K.P. ne raport me nenin 7 te Konventes Europiane per te drejatat themelore te njeriut dhe nenit 29/3 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise. Ne themel keto dispozita parashikojne se kur ligji i kohes kur eshte kryer vepra penale dhe ligji i mevonshem jane te ndryshem, ai qe eshte me favorizuesi eshte edhe ligji i aplikueshem per personin qe ka kryer vepren penale.

b. Ne cilen faze te procedimit eshte e aplikueshme kjo dispozite.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e anetareve Z. Poda e V. Metani,
 pasi degjuan prokurorin Artur Selmani, i cili kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Apelit Durres,
 pasi degjuan avokatin N.Duro, qe kerkoi prishjen e vendimeve dhe pranimin e kerkeses,

V Ë R E J N Ë

Nga shqyrtimi i akteve qe ndodhen ne fashikullin e kerkuesit Juan Kondi, rezulton se, ai me vendim nr.3014, date 15.10.1999 te Gjykates se Athines (Greqi), eshte deklaruar fajtor dhe denuar me 17 (shtatembedhjete) vjet burgim, per krimin e mbajtjes dhe transportimit te lendeve narkotike, te kryer ne bashkepunim.

Pasi ky vendim kishte marre forme te prere, Gjykata e shkalles se pare Fier, me vendimin nr.307, date 27.09.2000, ne zbatim te urdherimeve te parashikuara ne dispozitat e neneve 512-516 te K.Pr.Penale, beri njohjen e tij, duke e cilesuar vepren e kryer nga i denuari Juan, me nenin 283/I te K.Penal te Republikes se Shqiperise dhe masen e denimit, e konvertoi ne 15 (pesembedhjete) vjet burgim, qe eshte edhe maksimumi i denimit me burgim, qe parashikohej per kete veper nga kjo dispozite (neni 283/I i K.Penal), para ndryshimeve qe ajo ka pesuar me ligjin nr.8733, date 24.01.2001.

Pas transferimit te tij ne Shqiperi, i denuari Juan, ndersa ishte duke vuajtur denimin ne Institutin e Riedukimit Kosove, me 06.03.2002, paraqiti kerkese per uljen e kesaj mase, ne 10 (dhjete) vjet burgim, aq sa eshte maksimumi i parashikuar per kete veper nga paragrafi i pare, i nenit 283 te K.Penal, pas ndryshimeve qe i u bene kesaj dispozite, me ligjin e permendur me lart.

Gjykata e shkalles se pare Elbasan, me vendimin nr.111, date 12.04.2002, vendosi rrezimin e kerkeses, me arsyetimin se dispozitat e nenit 3/III te K.Penal dhe nenit 2 te Ligjit 7942, date 31.05.1995, "Per hyrjen ne fuqi te Ligjit nr.7895, date 27.01.1995 "Per Kodin Penal te Republikes se Shqiperise", nuk e shtrijne efektin e tyre pas njohjes se vendimeve penale te huaja, vendim, i cili u la ne fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durres, me vendimin nr.215, date 06.09.2002, te saj, me te njejtin arsyetim.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Durres, ka paraqitur rekurs, ne Gjykatën e Larte, mbrojtësi i kerkuesit-avokat Niko Duro, me te cilin kerkon prishjen dhe ndryshimin e tij, sipas kerkeses, duke parashtruar si shkak uljen qe i u be maksimumit te denimit nga pesembedhjetë, ne dhjetë vjet burgim, me ndryshimet qe, me ligjin nr.8733, date 24.01.2001, i u bene dispozites se nenit 283 te K.Penal, ne pergjithësi dhe paragrafit te pare te saj, ne vecanti, duke paraqitur si argument, detyrimin per t'u zbatuar nga gjykata, paragrafi i III-te, i nenit 3 te K.Penal dhe Ligji nr.9742, date 31.05.1995.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, nisur nga fakti qe, prane kesaj gjykate, ndodhen edhe disa kerkesa te tjera te kesaj natyre, cmoi se eshte vendi qe te njehsohet praktika gjyqesore lidhur me kuptimin e permbajtjes se paragrafit te trete te nenit 3, te K.Penal, e pare kjo ne raport me permbajtjen e nenit 7 te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut dhe nenit 29/3 te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise, me vendimin nr.91, date 19.02.2003 te tij, vendosi kalimin e ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara, per t'u unifikuar fakti se ne cilen faze te procedimit eshte i aplikueshem paragrafi i trete, i nenit 3 te K.Penal.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke patur parasysh kuptimin e vertete te permbajtjes se paragrafit te trete, te nenit 3 te K.Penal, qellimin konkret te ligjvenesit qe e miratoi ate, frymen e pergjithshme te permbajtjes se dispozites se nenit 3 te K.Penal, ne lidhje me veprimin ne kohe, ne pergjithësi te ligjit penal, te marra keto ne raport me rrethanat faktike ne te cilat eshte bere njohja e vendimit penal te huaj qe ben fjale per deklarimin fajtor dhe denimin e kerkuesit Juan Kondi, arriti ne perfundimin se, si vendimi nr.111, date 12.04.2002, i Gjykates se shkalles se pare Elbasan, ashtu edhe vendimi nr.215, date 06.09.2002, i Gjykates se Apelit Durres, jane te drejta, te bazuara ne ligj. Ato gjejne mbeshtetje te plote ne rrethanat faktike te ceshtjes dhe si te tille, duhet te lihen ne fuqi.

Ne kete perfundim u arrit, duke u interpretuar, nga Kolegjet e Bashkuara kuptimi i permbajtjes se dispozites se nenit 3 te K.Penal dhe vecanerisht, i paragrafit te trete te saj, pare, jo ne kuader vetem te kesaj dispozite, por ne nje rrafsh akoma me te gjere, sikurse eshte nxjerrja ne pah e kuptimit te vertete te permbajtjes se ketij paragrafi ne raport me imperativin kushtetues, te fuqise prapavepruese te ligjit favorizues, qe buron nga permbajtja e pikes 3, te nenit 29 te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise dhe fryma e pergjithshme e kuptimit te nenit 7 te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut.

Nisur nga fakti qe ligjvensi shqiptar, ne nje dispozite te vetme, sikurse eshte ajo e nenit 3 te K.Penal, ka percaktuar veprimin e ligjit penal ne kohe, jo vetem ne pergjithësi, sipas parimit qe askush nuk mund te denohet per nje veper qe sipas ligjit te kohes kur eshte kryer, nuk perbente veper penale, por, edhe duke dhene perjashtimet nga ky parim, Kolegjet e Bashkuara cmojne se, lidhje me ceshtjen objekt shqyrtimi, ka permbajtja e paragrafeve te dyte dhe te trete te kesaj dispozite, ne te cilat parashikohen perjashtimet nga rregulli i pergjithshem i veprimit ne kohe te ligjit penal dhe, brenda tyre, lidhje me te drejteperdrejte me kete ceshtje, pa dyshim, qe ka paragrafi i trete i saj.

Nga permbajtja e ketij paragrafi, sipas te cilit, kur ligji i kohes kur eshte kryer vepra penale dhe ligji i mevonshem jane te ndryshem, zbatohet ai ligj dispozitat e te cilit jane me te favorshme per personin qe ka kryer veprën penale, arrihet ne perfundimin se, ne rastet kur, ligji qe ka qene ne fuqi ne kohen e kryerjes se vepres penale, eshte me i disfavorshem se ligji qe eshte ne fuqi ne kohen e gjykimit te ceshtjes penale ne ngarkim te personit qe e ka kryer ate, gjykatat detyrohen te zbatojne kete te dytin d.m.th. ligjin e mevonshem, i cili eshte ne fuqi ne kohen e gjykimit te ceshtjes.

Ky detyrim rrjedh nga fakti qe, ne rastin konkret, ligji i mevonshem permban dispozita, te cilat jane me te favorshme per personin qe ka kryer veprën penale ose, duke perdorur

terminologjine kushtetuese, duhet thene se, ligji i mevonshem eshte ligj penal favorizues dhe pikerisht per kete arsye, ai ka fuqi prapavepruese.

Megjithate, duhet vene ne dukje fakti qe fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, ne raport me momentin kohor te zbatimit te tij, nuk eshte e pakufizuar, pasi ky moment, eshte i kushtezuar nga faza ne te cilen gjendet procedimi penal qe i perket personit te akuzuar per kryerjen e vepres penale, faze e cila, duke u bazuar ne sa u thane me hollesi me lart, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, arrijne ne perfundimin se, nuk mund te jete tej momentit kohor kur vendimi i denimit penal te personit te akuzuar, ka marre forme te prere, gje qe vlen edhe per personat e denuar me vendim penal, te formes se prere, te gjykatave te huaja penale, sikurse eshte rasti objekt gjykimi.

Te gjitha ceshtjet e tjera qe mund te lindin mbas ketij momenti, i perkasin nje faze tjeter, asaj te ekzekutimit te vendimit penal.

Dihet se, ndryshe nga fuqia prapavepruese e ligjit penal qe perfshihet ne institutin e veprimtari penal ne kohe, institut, i cili rregullimin e tij ligjor e gjen ne normat e ligjit penal material, faza e ekzekutimit te vendimeve penale, rregullohet nga normat e ligjit procedural penal, nocione keto qe konfondohen ne kerkesen e paraqitur nga mbrojttesi i kerkuesit Juan.

Bazuar ne sa u parashtua, me hollesi ne pjeset e perparshme te ketij vendimi, Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin e pergjithshem se, paragrafi i trete, i nenit 3 te K.Penal, eshte i zbatueshem ne procedimet penale te vena ne levizje pas hyrjes ne fuqi te ligjit favorizues, si dhe ne procedimet penale, te cilat, megjithese jane vene ne levizje para hyrjes ne fuqi te ligjit favorizues, gjykimi, per to, nuk ka perfunduar ende me vendim te formes se prere.

Keshtu qe, personat, vendimi i denimit penal per te cilet ka marre forme te prere, sikurse eshte rasti i kerkuesit Juan, nuk mund te perfitojne nga ligji i mevonshem edhe pse ai mund te jete favorizues ne raport me ligjin penal qe u zbatua, nga gjykatat, ne kohen e denimit te tyre.

I vetmi perjashtim nga ky rregull, ne kushtet e zakonshme te zbatimit te K.Penal, behet vetem per personat e denuar me vendim te formes se prere kur ligji i ri, vepren per te cilen ata jane deklaruar fajtores dhe denuar, nuk e konsideron me veper penale.

Dhe kete perjashtim e ka bere vete ligjveneresi, ne paragrafin e dyte te nenit 3 te K.Penal, sipas te cilit, ligji i ri qe nuk denon vepren penale ka fuqi prapavepruese dhe, ne rast se personi eshte denuar, ekzekutimi i denimit nuk mund te filloje dhe, neqoftese ka filluar pushon.

Thuhet "ne kushtet e zakonshme te zbatimit te K.Penal", pasi ligjveneresi, mbas miratimit te ligjit nr.7895, date 27.01.1995 "Per Kodin Penal te Republikes se Shqiperise, me dy ligje te vecanta, te miratuara ad hoc me nr.7942 dhe 7984, te datave, respektivisht, 31.05.1995 dhe 28.07.1995, miratuar per hyrjen ne fuqi te Kodit Penal, ka parashikuar, shprehimisht, qe personave, te cilet jane denuar me vendim te formes se prere per nje ose me shume vepra penale me masa denimi, per nje ose me shume prej tyre, me te larta se sa maksimumi qe parashikon per to Kodi i ri Penal, ju mbetet, per secilen prej tyre, ky maksimum (nenet 2 dhe 1 te ligjeve respektive).

Nepermjet ketyre dy ligjeve, kane perfituar vetem personat qe ishin denuar para hyrjes ne fuqi te Kodit te ri Penal, d.m.th me Kodet e meparshme penale dhe nje gje e tille ishte jo vetem e domosdoshme, por edhe e kuptueshme, per shkak te disa ndryshimeve, jo pak te rendesishme, qe pesoi instituti juridik i pergjegjesise penale dhe elemente perberes te tij, ne Kodin e ri Penal, ne krahasim me te meparshmet.

Pikerisht, per kete shkak, dy dispozitat e permendura te dy ligjeve qe u miratuan per hyrjen ne fuqi te Kodit te ri Penal, ashtu sikurse edhe vet keto dy ligje per nga permbajtja dhe qellimi per te cilin u miratuan, ishin kalimtare, Ato sherbyen, eskuzivisht, per rregullimin, nga pikepamja ligjore, te gjendjes faktike, te ndryshimeve qe ekzistonin persa i takonte maksimumit te masave te denimit qe ishin dhene nga gjykatat ndaj personave te denuar para hyrjes ne fuqi te Kodit te ri

Penal, per vepra, te cilat, edhe sipas ketij te fundit, vazhdojne te konsiderohen vepra penale dhe nuk mund te zbatohen edhe ne raste te tjera, sikurse, pa te drejte, pretendohet ne rekursin e paraqitur nga mbrojtessi i caktuar nga kerkuesi Juan.

Po keshtu, Kolegjet e Bashkuarat te Gjykates se Larte, cmojne se duhet te vihet ne dukje edhe fakti qe, vec sa u permenden ne pjesen e meparshme te ketij vendimi, pretendimi i mbrojtessit te te denuarit Juan per uljen e mases se denimit nga pesembedhjetete ne dhjete vjet burgim, nuk qendron edhe per shkak se, megjithese maksimumi i denimit me burgim qe parashikohet nga paragrafi i pare i nenit 283 (te ndryshuar) te K.Penal, eshte jo pesembedhjetete, qe e kishte dispozita e pandryshuar, por dhjete vjet burgim, bazuar ne faktin qe, sipas vendimit penal nr.3014, date 15.10.1999, te Gjykates se Athines (Greqi), vepra penale e mbajtjes dhe e transportimit te lendeve narkotike eshte kryer ne bashkepunim, pas ndryshimeve qe i u bene dispozites se nenit 283 te K.Penal, vepra e tij nuk do te cilesohet me paragrafin e pare, por me paragrafin e dyte (i cili bashkepunimin nuk e parashikon si rrethane thjeshte te anes objektive te figures se kesaj vepre penale, por edhe si rrethane cilesonjese) ne te cilin kufijte e denimit variojne nga shtate gjer ne pesembedhjetete vjet burgim d.m.th. jane me te disfavoreshme (me te renda), ne raport me marzhet e denimit, nga pese gjer ne pesembedhjetete vjet, qe parashikonte kjo dispozite e K.Penal, para ndryshimeve qe i u bene asaj me ligjin e permendur disa here me lart.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, mbeshtetur ne nenin 441/a te Kushtetutes dhe nenit 441 pika "a" te K.Pr.Penale

V E N D O S Ë N

Lenien ne fuqi te vendimit nr.215, date 06.09.2002 te Gjykates se Apelit Durrës.
Ky vendim eshte unifikues. Nje kopje e tij te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 27.03.2003

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Natasha Sheshi	Anetare
Valentina Kondili	Anetare
Evjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare
Spiro Spiro	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Vladimir Metani	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Agron Lamaj	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 27.03.2003, moren ne shqyrtim ceshtjen penale qe i perket:

KËRKUES:	GJON BIBA, i biri i Markut, i datl.1969, lindur ne fshatin Markatomaj (Lezhe), aktualisht banues ne Itali.
PERSON I INTERESUAR:	PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE LEZHE.

OBJEKTI:

Kompensim per burgim te padrejte
per periudhen 25.02.1993 deri 16.09.1993
dhe rivendosje ne afat e kerkeses

Gjykata e shkalles se pare Lezhe, me vendimin nr.17, date 23.04.2002 vendosi:

Rivendosjen ne afat te se drejtes se kerkuesit Gjon Mark Biba per t`u kompensuar per bugim te padrejte.

Kerkuesi Gjon Mark Biba te kompensohet per burgim te padrejte per 202 dite, ne shumen prej 1.010.000 (njemilion e dhjete mije) leke.

U ngarkua seksioni i Finances prane Bashkise Lezhe per pagimin e ketij detyrimi.

Gjykata e Apelit Shkoder, me vendimin nr.29, date 09.09.2002 te saj, vendosi:

Lenien ne fuqi te vendimit te mesiperm.

Kunder te dy vendimeve ka paraqitur rekurs ne Gjykatën e Lartë, Kryetari i Bashkisë Lezhe, kurse prokurori i apelit Shkoder ka paraqitur rekurs vetem kunder vendimit te Gjykates se Apelit Shkoder.

Kryetari i Bashkisë Lezhe, kerkon prishjen e te dy vendimeve per shkelje te ligjes procedurale e materiale, duke parashtruar shkaqet e meposhtme:

- Gjykata ka zhvilluar gjykimin pa pale, por vetem me kerkues, ne nje kohe kur kemi te bejme me nje kerkese per demshperblim per burgim te padrejte.
- Gjykata nuk ka patur parasysh faktin se detyrimin per demshperblim ne kuptimin e nenit 268 te K.Pr.Penale, e ka shteti, qe praktikisht, perfaqesohet nga Ministria e Finances dhe organet e saj vartese ne rreth, sic eshte Dega e Thesarit. Per rrjedhoje, si pale e paditur ne kete proces, duhej te ishte Dega e Buxhetit Lezhe.

Prokuroria e Apelit Shkoder kerkon prishjen e vendimit te gjykates se apelit dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim, duke parashtruar shkaqet e meposhtme:

- Ndergjyqesia eshte ndertuar gabim, pasi sipas vendimit te K.Ministrave nr.335, date 02.06.1998, percaktohet qarte se kush institucion pergjigjet per detyrimet si me siper.
- Kerkesa sipas nenit 269 te K.Pr.Penale, duhej te ishte bere Brenda afatit 3-vjecar dhe nuk ekzistonin kushtet per ta rivendosur ne afat kerkuesin Gjon Biba.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e anetareve Agron Lamaj e Ylvi Myrtja, perfaqesuesin e personit te interesuar prokurorin Alfred Progonati, i cili kerkoi prishjen e te dy vendimeve e pushimin e gjykimit te ceshtjes, si dhe pasi biseduan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Nga studimi i akteve qe ndodhen ne fashikullin e ceshtjes qe i perket kerkuesit Gjon Biba dhe gjate shqyrtimit te saj ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Lartë, u konstatua se, nga ana e Prokurorisë se rrethit Lezhe, ishte derguar per t'u gjykuar nje ceshtje penale per nje vrasje te kryer dhe per nje tjetër te mbetur ne tentative per te cilat, vec te gjykuarit Gjergj Biba, i cili u deklarua fajtor dhe u denua, ishte akuzuar edhe vellai i tij, kerkuesi Gjon. Per kete te fundit, Gjykata e rrethit Lezhe, me vendimin nr.54, date 16.09.1993, vendosi pushimin e ceshtjes, deklarimin e pafajshem dhe lirimin e menjehershëm te tij, vendim, i cili u la ne fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkoder, me vendimin nr.77, date 01.11.1993, te saj.

Me 03.04.2003, Gjon Biba paraqiti kerkese prane Gjykates se shkalles se pare Lezhe, me objekt kompensim per burgim te padrejte, per periudhen 25 shkurt deri 16 shtator 1993 dhe rivendosjen ne afat te ketij kerkimi.

Me vendimin nr.17, date 23.04.2002 Gjykata e shkalles se pare Lezhe, me arsyetimin se, kerkuesi ishte larguar nga Shqipëria qe para vitit 1995 (kohe kur hyri ne fuqi Kodi i Ri i Procedures Penale, me te cilin eshte njohur e drejta e kompensimit per burgim te padrejte), vendosi rivendosjen ne afat te se drejtes se kerkuesit per t'u kompensuar per burgim te padrejte dhe kompensimin faktik te tij ne shumën 1.010.000 leke, per 202 dite qe ai kishte qene i paraburgosur, vendim, i cili u la ne fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkoder, me vendimin nr.29, date 09.09.2002 te saj, me te njejtin arsyetim.

Gjate shqyrtimit te rekurseve qe paraqiti prokuroria prane Gjykates se shkalles pare Lezhe, si person i interesuar dhe Kryetari i Bashkisë Lezhe, si perfaqesues i institucionit i cili, me vendim gjykate, ishte detyruar qe te bente kompensimin faktik ne favor te kerkuesit, kunder te dy vendimeve

te permendura me lart, Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin e tij nr.92, date 26.02.2003, vendosi kalimin e akteve te kesaj ceshtjeje Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, per njehsimin e praktikes gjyqesore, ne drejtimet e meposhtme:

1-Kush e ka juridiksionin per gjykimin e ceshtjeve qe kane te bejne me kompensime per burgim te padrejte, gjykata penale apo civile e, ne perputhje me kete, ceshtjet do te gjykohen mbi bazen e kerkesave te K.Pr.Penale apo te K.Pr.Civile?

2- Duhet te behet kerkese padi me padites te percaktuar apo vetem kerkese e, nese duhet bere kerkese padi, kush do te jete i padituri?

3- Pasi merr vendimin perkates per pushimin e ceshtjes apo dhenien e pafajesise, personi qe ka bere burgim te padrejte duhet t'i drejtohet per kompensim Ministrise se Financave apo duhet te kerkoje zgjidhjen e ceshtjes gjyqesisht?

4- Ne paragrafin e dyte te nenit 269 te K.Pr.Penale percaktohet se masa e kompensimit dhe menyra e llogaritjes si dhe rastet e kompensimit per arrestin ne shtepi, caktohen me ligj te vecante. Ne kushtet kur nuk ka dale ligji i vecante, si do te percaktohet menyra dhe masa e kompensimit?

Mbas shqyrtimit ne teresi qe i u bene shkaqeve te parashtruara ne rekursitet e paraqitura dhe ceshtjeve te shtruara per njehsimin e praktikes gjyqesore, ne drejtimet e parashtruara me lart, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, arriten ne perfundimin se, si vendimi nr.17, date 23.04.2002 i Gjykates se shkalles se pare Lezhe, ashtu edhe vendimi nr.29, date 09.09.2002 i Gjykates se Apelit Shkoder, jane marre, duke mos u zbatuar drejt kerkesat e K.Pr.Penale, ne lidhje me rivendosjen ne afat dhe, per kete shkak, ato duhet te prishen.

Keshtu, persa i perket paraqitjes, nga ana e te interesuarve, te kerkeses per kompensim, per burgim te padrejte, ligjveneresi ka parashikuar nje afat, brenda te cilit ajo duhet te paraqitet sepse ndryshe, d.m.th me kalimin e ketij afati, kerkesa nuk pranohet. Sipas permbajtjes se dispozites se nenit 269 te K.Pr.Penale, ky afat eshte brenda tre vjeteve nga data ne te cilen vendimi i pafajesise ose i pushimit te ceshtjes ka marre forme te prere.

Te dy gjykatat qe moren ne shqyrtim ceshtjen ne lidhje me kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Gjon Biba, megjithese nga dita qe vendimi i pushimit te ceshtjes penale ne ngarkim te tij dhe deklarimi i pafajshem e lirimi nga paraburgimi i tij, ka marre forme te prere deri dite e paraqitjes se kerkeses per kompensim per burgim te padrejte, kishin kaluar 9 vjet 1 muaj e 8 dite, e rivendosen ate ne afat ne kundërshtim me frymen e kerkesave te dispozites se nenit 147 te K.Pr.Penale. Kjo sepse nga shqyrtimi i akteve qe ndodhen ne dosje, bazuar ne shprehjen "...deklarimin e pafajshem te te pandehurit Gjon Biba dhe lirimin e tij ne salle", qe ka perdorur Gjykata e rrethit Lezhe ne dispozitivin e vendimit nr.54, date 16.09.1993, te saj, rezulton qe kerkuesi ka qene i pranishem gjate gjykimit te ceshtjes penale ne ngarkim te tij, perfshire edhe dite e shpalljes se vendimit te pafajesise ne favor te tij. Keshtuqë, arsyetimi i perdorur, nga te dy gjykatat, sipas te cilit ai qe larguar nga Shqiperia para vitit 1995, kohe kur hyri ne fuqi Kodi i Ri i Procedures Penale dhe qe u perdor si argument per te justifikuar shkakun e rivendosjes ne afat per te paraqitur kerkesen per kompensim per burgim te padrejte, nuk gjen mbështetje ligjore.

Pretendimi sipas te cilit ai (kerkuesi) gjate periudhes 9-vjecare, nuk mund te vinte ne Shqiperi nga frika e gjakmarrjes, edhe sikur te kete patur baze reale, ne kushtet kur, sipas legjislacionit ne fuqi, te drejten per ta paraqitur kerkesen mund ta kishte ushtruar edhe nepermjet nje perfaqesuesi te ngarkuar prej tij sipas ligjit, nuk qendron.

Pasi zgjidhen, si me siper, ne themel ceshtjen objekt gjykimi, ne zgjidhjen me tej te problemeve qe perbejne drejtimet per te cilat ajo ka ardhur per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, keto Kolegje vleresojne nevojën e trajtimit te tyre, duke mos u kufizuar thjesht dhe vetem ne rrethanat e ceshtjes qe Kolegji Penal i kesaj gjykate cmoi se, duhen unifikuar per te orientuar drejt praktiken gjyqesore ne aspektin praktik te ceshtjeve, qe do te kene per objekt kerkesa per kompensim per burgim te padrejte, por duke u nisur nga fakti qe e drejta e zhdemtit, ne

perputhje me ligjin, te cdo personi, per demin qe ai ka pesuar per shkak te nje akti te paligjshem, sikurse mund te jete edhe vendimi i organit procedues per burgimin e tij, ne kuptimin e gjere te kesaj fjale, nuk eshte e drejte, qe parashikohet vetem ne K.Pr.Penale, por eshte e drejte kushtetuese dhe si e tille ajo perfshihet ne kreun mbi lirite dhe te drejtat vetiake te Kushtetutes ne fuqi, te Republikes se Shqiperise.

Pare lidhur ngushte me kete menyre vleresimi te ceshtjeve objekt unifikimi dhe me rendesine qe ato paraqesin, Kolegjet e Bashkuara cmojne se, gjate trajtimit te tyre, duhet te jepet kuptimi i vertete i dispozitave te ligjit procedural penal, te cilat bejne fjale per kompensim per burgim te padrejte nga njera ane, si dhe per gjykatën ne juridiksionin e se ciles duhen perfshire ceshtjet me kete objekt dhe qe eshte kompetente per gjykimin e tyre, nga ana tjeter.

Lidhur me kete te fundit, d.m.th me gjykatën kompetente, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, konkluduan se kompetente per shqyrtimin e kerkesave per kompensim per burgim te padrejte, eshte gjykata civile dhe kerkesa drejtuar asaj duhet te plotesoje te gjitha kerkesat e parashikuara nga dispozitat e perfshira ne titullin e V^{te} te K.Pr.Civile, ne lidhje me ngritjen e padise.

Edhe lidhur me rregullat procedurale qe duhet te ndiqen, nga gjykatat, gjate shqyrtimit te ceshtjes me objekt kerkesat per kompensimin per burgim te padrejte, Kolegjet e Bashkuara, pavaresisht nga fakti qe, si shkak per ngritjen e padive te ketij lloji, sherben vendimi penal i formes se prere me te cilin pushohet ceshtja ne ngarkim te te pandehurit ose ai deklarohet i pafajshem se nuk provohet se eshte autor i vepres penale per te cilen eshte akuzuar, si dhe vendimi i prokurorit per pushimin e ceshtjes per te njejtat shkaqe **konkludojne se, gjate gjykimit te ketyre ceshtjeve, duhen zbatuar kerkesat e K.Pr.Civile, duke filluar qe nga ato per hartimin dhe paraqitjen e padise, shqyrtimin e saj dhe deri tek ankimet, kunder vendimeve te dhena, paraqitja dhe shqyrtimi i tyre.**

Ndersa, ne lidhje me palet, qe do te formojne ndergjyqesine ne proceset gjyqesore te kesaj natyre, Kolegjet cmojne se ato, vec ish te pandehurit ose trashegimtareve te tij (per trashegimtare, shih nenin 460 te K.Pr.Penale) qe legjitimohen te jene padites, si te paditur do te jene perfaqesuesit e organeve ose institucioneve shteterore qe, me akte nenligjore ngarkohen per te ndjekur dhe zbatuar procedurat per zbatimin e vendimeve gjyqesore per detyrimet qe prekin buxhetin e shtetit. (I tille, sipas vendimit nr.355, date 02.06.1998 te K. Ministrave te Republikes se Shqiperise shkronja "c" e tij, aktualisht eshte institucioni i Ministrise se Financave dhe strukturat e saj, sikurse jane aktualisht, Zyrat e Thesarit, neper rrethe).

Meqenese, sikurse u theksua, si shkak i proceseve gjyqesore te ketij lloji, sherbejne vendimet gjyqesore te formes se prere apo ato te pushimit te ceshtjes nga ana e prokurorit, **cmohet e nevojshme, pjesemarrja ne keto gjykime edhe e perfaqesuesit te prokurorise per ceshtje te vena ne levizje prej saj ose edhe e te demtuarit akuzues per ceshtje, te cilat, sipas parashikimeve te dispozites, se nenit 284 te K.Pr.Penale, ndjekja penale mund te filloje vetem me ankimin e tij, si persona te interesuar.**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se e vecanta e ceshtjeve me objekt kerkesat per kompensim per burgim te padrejte, konsiston ne faktin se, nga njera ane, vete e drejta per te kerkuar kompensimin per burgim te padrejte, buron nga ligji procedural penal. Ne kete ligj parashikohen rastet ne te cilat mund te behet nje kerkese e kesaj natyre, kushtet e zbatimit te saj (neni 268 i K.Pr.Penale), afatet e paraqitjes se tyre, masa e kompensimit dhe menyra e llogaritjes se tij, (neni 269 i K.Pr.Penale). Ndersa nga ana tjeter, nga vete permbajtja e tyre, per shkak te karakterit pasuror qe kane, ato dalin nga natyra e marredhenieve juridiko-penale, thelbin e te cilave e perbejne ato veprime ose mosveprime, te kryera me faj qe vete ligjvenesit, per shkak te rrezikshmerise qe paraqesin, i ka konsideruar vepra penale, si dhe denimet qe jane parashikuar per autoret e ketyre veprave.

Karakterit pasuror i kerkesave per kompensim per burgim te padrejte, spikat dukshem, duke e pare ceshtjen, jo vetem nga qellimi qe ka dashur te realizoje ligjvenesit nepermjet parashikimit, per kete kategori personash, (personat qe deklarohen te pafajshem me vendim te formes se prere, ose ceshtja e te cileve eshte pushuar) te dispozitave te posacme per rehabilitimin e tyre, por edhe nga vete termi "kompensim" qe eshte perdorur kur eshte fjale, per rehabilitimin jo ne kuptimin e gjere te kesaj fjale, por per rehabilitimin ne kuptimin e permiresimit te arsyeshem te nivelit te gjendjes ekonomike te kesaj kategorie personash, e cila, padyshim, qe eshte demtuar gjate kohes qe ata kane qendruar padrejtesisht ne burg, per shkak te nje akti te paligjshem te organeve shteterore.

Akte te tilla, per rastin ne shqyrtim, mund te jene ose vendime te gabuara te gjykatave per caktimin e mases se sigurimit, arrest ne burg ose vendime te gabuara te prokurorit ose te oficerit te policise gjyqesore per arrestimin ne flagrance ose ndalimin e personit, ose deri edhe vendime te gjykatave qe deklarojne fajtor dhe denojne me burgim persona qe kur gjykohen jane ne gjendje te lire dhe qe, me vone, deklarohen te pafajshem, ose pushohen ceshtjet penale ne ngarkim te tyre, me vendim gjyqesor te formes se prere.

Megjithate Kolegjet e Bashkuara, cmojne se, natyra e demtimeve te karakterit pasuror qe peson personi gjate kohes se qendrimit padrejtesisht ne burg, nuk eshte e njejte me demin qe i shkaktohet nje personi, ne menyre te paligjshme dhe me faj, ne kuptimin qe ka termi "dem" ne te drejten civile. Per rrjedhoje, **keto Kolegje, arriten ne perfundimin se midis kompensimit, nga ana e shtetit, te personit te burgosur pa te drejte, per demet pasurore qe ai ka pesuar gjate kohes qe ka qendruar ne burg pa te drejte dhe per shkak te ketij qendrimi, nga njera ane dhe shperblimit te demit si institut i se drejtes civile, nga ana tjeter, nuk mund te vihet shenja e barazimit. Prandaj edhe menyra e llogaritjes dhe kriteret qe duhen ndjekur gjate ketij procesi (procesit te llogaritjes), ne rastin e shqyrtimit, nga gjykatat te kerkesave per kompensim per burgim te padrejte, edhe pse, sikunder u theksua, keto jane ceshtje qe hyjne ne juridiksionin e gjykatave civile, ato i nenshtrohen nje rregullimi ligjor tjeter dhe jo atij te parashikuar nga nenet 640 e vijues te K.Civil ne lidhje me shperblimin e demit, rregullim ligjor ky i posacem, vecantite e te cilit burojne nga permbajtja e pikes 2, te nenit 269 te K.Pr.Penale, sipas se ciles, masa e kompensimit per burgim te padrejte dhe menyra e llogaritjes se tij, caktohen me ligj te vecante.**

Mirepo, vakumi i krijuar ne legjislacion, per shkak te mos miratimit, ende, te nje ligji te vecante me objekt percaktimin e mases se kompensimit per burgim te padrejte dhe menyren e llogaritjes se tij, i ka vene gjykatat ne veshtiresi kur gjykojne kerkesa te kesaj natyre, duke u detyruar qe, megjithese, jo krejtesisht me baza teoriko- ligjore, te llogarisin masen e kompensimit, duke i u referuar, nga nevoja, paragrafit te trete te nenit 57 te K.Penal, sipas te cilit, nje dite paraburgim eshte baraz me 5 (pese) mije leke.

Thuhet, nga nevoja, sepse, sikurse del nga permbajtja e dispozites se nenit 57 te K.Penal, e cila ben fjale per llogaritjen e paraburgimit, ketu eshte fjale per rastet kur, ne perfundim te gjykimit te ceshtjes penale ne ngarkim te tij, i paraburgosuri, deklarohet fajtor dhe denohet ose me burgim ose me gjobe dhe gjykata ben perlllogaritjen, duke konvertuar ditet e kaluara ne paraburgim, me kohet qe ai do te vuaje ne burg dhe ne rastet kur denohet me gjobe, duke llogaritur nje dite te kaluar ne paraburgim, me 5 mije leke gjobe.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, bazuar ne permbajtjen e dispozitave te K.Pr.Penale, qe bejne fjale per kompensimin per burgim te padrejte (nenet 268, 269, 459 dhe 460 te K.Pr.Penale), konstatojne se, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi, kompensimi per burgim te padrejte, i personave te cileve u lind kjo e drejte, nuk realizohet vetevetiu, qe ne momentin kur eshte marre vendimi i organit procedues kompetent mbi bazen e te cilit ajo lind. Ligjvenesit, realizimin e kesaj te drejte, e ka kushtezuar me berjen e kerkeses per kompensim, nga ana e personit qe ka te drejte ta perfitoje ate, e cila duhet te behet, brenda tre vjeteve nga

data ne te cilen vendimi i pafajesise ose i pushimit te ceshtjes ka marre forme te prere (ne rastet e zakonshme) brenda dy vjetesh nga dita qe vendimi i rishikimit ka marre forme te prere (ne rastet kur vendimi i pafajesise ose i pushimit te ceshtjes, ne favor te perfituesit, merret pas rishikimit te vendimit penal te formes se prere) dhe ne te gjitha rastet, realizimi faktik i kesaj te drejte arrihet pasi, per kerkesen e te interesuarit per kompensim per burgim te padrejte, te jete marre nje vendim i vecante, ne favor te tij, nga ana e gjykates.

Ne kete perfundim, megjithese nga dispozita e nenit 269 te K.Pr.Penale, ne te cilen behet fjale, posacerisht per kerkesen per kompensim per burgim te padrejte, nuk del qe te jete permendur, ne forme te shprehur, e drejta dhe njekohesisht detyrimi i perfituesit per t'iu drejtuar gjykates, Kolegjet e Bashkuara arrijne duke i bere interpretimin logjik permbajtjes se saj dhe njekohesisht duke e pare ate ne lidhje me permbajtjen e pikes 3 te dispozites se nenit 459 te ketij Kodi, sipas se ciles kerkesa per kompensim paraqitet ne sekretarine e gjykates qe ka dhene vendimin.

Gjykata se ciles i paraqitet kerkesa per kompensim per burgim te padrejte, gjate shqyrtimit te saj, pervec verifikimit te respektimit ose jo te afateve te paraqitjes se saj dhe ekzistences ose jo te ndonjeres prej rrethanave, prania e te cilave sipas ligjit, perjashton te drejten per kompensim, ben edhe llogaritjet dhe percakton perfundimisht masen, te shprehur ne te holla te kompensimit qe do te perfitoje kerkuesi.

Persa i perket rrethanave qe sherbejne si shkak per te perjashtuar kerkuesin nga e drejta e perfitimit si rrjedhoje e kompensimit per burgim te padrejte, megjithese, ne te gjitha rastet, ligjvensi ato i ka kushtezuar me qendrimin subjektiv te kerkuesit, kur ai ishte ne poziten e te pandehurit, ne kohen kur eshte marre vendimi gjyqesor i formes se prere, ne te cilin ai bazon kerkesen per kompensim per burgim te padrejte, ato (rrethanat e perjashtimit) nuk jane krejtesisht te njejta si ne rastet e zakonshme, ashtu edhe ne rastet kur ndodhemi para vendimit penal te formes se prere te pafajesise ose pushimit te ceshtjes, pas rishikimit te nje vendimi penal te formes se prere.

Ne rastin e pare, sipas permbajtjes se pikes 1, te dispozites se nenit 268 te K.Pr.Penale, personi qe ka marre pafajesi ose ndaj te cilit eshte pushuar ceshtja, perjashtohet nga e drejta per kompensim per burgim te padrejte kur: a) eshte provuar qe vendimi eshte i gabuar, teresisht ose pjeserisht, per fajin e tij dhe b) mos zbulimi ne kohen e duhur te fakteve te panjohura, administrimi i te cilave, nga gjykata penale, nuk do ta conte ate ne marrjen e nje vendimi fajesie per kerkuesin, ka ndodhur teresisht ose pjeserisht per fajin e ketij te fundit.

Kurse, ne rastin e kerkeses, bere per kompensim per burgim te padrejte nga personi qe ka marre pafajesi pas rishikimit te vendimit penal te formes se prere me te cilin ai ishte deklaruar fajtor dhe denuar me burgim, sipas permbajtjes se pikes 1, te nenit 459 te K.Pr.Penale, personi qe ka marre pafajesi, perjashtohet nga e drejta per burgim te padrejte, kur kishte dhene shkak me dashje ose pakujdesi te rende per gabimin gjyqesor qe u vertetua mbas rishikimit te ceshtjes, se kishte qene ai qe kishte ndikuar ne marrjen e vendimit te fajesise ne dem te tij.

Evidentimi, administrimi dhe konkretizimi, rast pas rasti, i ekzistences se ketyre rrethanave, eshte detyre e gjykates penale ose prokurorit qe, perkatesisht, jep vendimin e pafajesise ose pushon ceshtjen.

Nga sa u parashtrua me lart, verehet se, ne te gjitha rastet e kerkesave per kompensim per burgim te padrejte, ndodhemi para vendimeve te gabuara te organit procedues (gjykates, prokurorit, oficerit te policise gjyqesore), por, personit qe eshte demtuar nga ky vendim duke u burgosur padrejtesisht, i lind e drejta per t'u kompensuar per kete burgim vetem neqoftese ai nuk ka vepruar me faj (dashje ose pakujdesi te rende) ne dhenien e vendimit te fajesise ne dem te tij.

Perfundimin nese kerkuesi ka qene ose jo me faj, ne raport me vendimin e burgimit te padrejte, gjykata qe shqyrton kerkesen per kompensim per burgim te padrejte paraqitur prej tij, e arrin, duke u nisur rast pas rasti, nga teresia e vendimit mbi bazen e te cilit ai u burgos (apo edhe u paraburgos) dhe sidomos, nga pjesa arsyetuese e tij, ne te cilen gjykata, sipas kerkesave te

K.Pr.Penale, jane te detyruara te parashtrojne, ne menyre sa me te hollesishme, te qarte e bindese, si provat e fajesishte ashtu edhe te pafajesishte dhe te pasqyrojne qendrimin e te pandehurit ne raport me to e ne pergjithesi me akuzen ne ngarkim te tij si dhe ne raport me teresine e rrethanave te ceshtjes qe perbejne objektin e te provuarait ne gjykimin e cdo ceshtjeje penale (çfare ka ndodhur, ku ka ndodhur, kur ka ndodhur, me ç`mjet ka ndodhur, si ka ndodhur, kush dhe pse e ka kryer ate).

Duke u bazuar ne permbytjen e dispozitave te K.Pr.Penale, te cilat bejne fjale drejtperdrejt ose qe kane lidhje me kerkesen per kompensim per burgim te padrejte, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, konstatojne se rrethi i personave qe legjitimohen te ngrjejne padi me objekt kerkesen per kompensim per burgim te padrejte, perbehet nga:

1. Personat qe deklarohen te pafajshem me vendim te formes se prere.
2. Te denuarit qe kane qene te paraburgosur, me vendim te formes se prere, kur vertetohet se akti me te cilin eshte caktuar masa e sigurimit personal arrest ne burg, eshte nxjerre pa qene kushtet e parashikuara nga nenet 228 e 229 te K.Pr.Penale qe bejne fjale, respektivisht, per kushtet dhe kriteret per caktimin e masave te sigurimit personal.
3. Te paraburgosurit, qe ishin arrestuar ne flagrante, me vendim te oficerit ose agjenteve te policise gjyqesore, kur ceshtja ne ngarkim te tyre eshte pushuar nga gjykata ose prokurori, perjashto rastet e pushimit te ceshtjes per shkak amnistie.
4. Te paraburgosurit qe ishin ndaluar me urdher te prokurorit kur ceshtja ne ngarkim te tyre eshte pushuar nga gjykata ose prokurori, perjashto rastet e pushimit te ceshtjes per shkak amnistie.
5. Te paraburgosurit qe lirohen me vendim te gjykates, sipas te cilit vertetohet qe fakti per te cilin ata ishin arrestuar, nuk perben veper penale per shkak te shfuqizimit te dispozites perkatese, te cilet kompensohen per ate pjese te paraburgimit te vuajtur pas shfuqizimit te dispozites.
6. Personat qe marrin pafajesishte gjate rishqyrtimit te nje vendimi penal te formes se prere dhe
7. Trashegimtarete e personit te burgosur padrejtesisht, kur i denuari vdes gjate, mbas ose edhe para procedimit te rishikimit penal te formes se prere, me te cilin ai ishte deklaruar fajtor dhe denuar me burgim.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, mbeshtetur ne nenin 485/ "c" te K.Pr.Civile.

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.17, date 23.04.2002, te Gjykates se shkalles se pare Lezhe dhe vendimit nr.29, date 09.09.2002, te Gjykates se Apelit Shkoder dhe pushimin e gjykimit te ceshtjes.

Ky vendim eshte unifikues. Nje kopje e tij te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 27.03.2003

MENDIMI I PAKICËS

Ne si pakice kemi mendimin se ligji procedural penal permban disa dispozita qe bejne fjale per kompensimin per burgim te padrejte, te cilat ne zgjidhjen qe i jepet ceshtjes nga shumica kapercehen. Per kete shkak ne kemi mendim te kundert bazuar ne arsyetimin e meposhtem:

Kodi i Procedures Penale, ne kreun e V-te, nen titullin “**Kompensim per burgim te padrejte**” ne nenin 268, parashikon kushtet e zbatimit ku sipas percaktimit te bere ne kete dispozite, ka te drejten per kompensim per burgim te padrejte:

- personi qe eshte deklaruar i pafajshem me vendim te formes se prere, per paraburgimin e vuajtur
- i denuari qe ka qene i paraburgosur, kur me vendim te formes se prere vertetohet se akti me te cilin eshte caktuar masa eshte nxjerre pa qene kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229
- personat e mesiperme e perfitojne kete te drejte edhe kur eshte vendosur pushimi i ceshtjes nga gjykata ose prokurori
- e perfitojne kete te drejte edhe personat e mbajtur padrejtesisht ne arrest shtepie.

Ne paragrafin e pare te nenit 268 theksohet se, personi nuk e perfiton kete te drejte *kur eshte provuar qe vendimi i gabuar ose moszbulimi ne kohen e duhur te faktit te panjohur eshte shkaktuar teresisht ose pjeserisht prej tij*. Ky qendrim i ligjit tone eshte ne perputhje me permbajtjen e nenit 3 te Protokollit nr.7 te Konventes Europiane te Drejtave te Njeriut, ne te cilin parashikohet e drejta per zhdemtimin ne rast gabimi gjyqesor si dhe kufizimi i kesaj te drejte, i cili ka formulim te njejte me perkufizimin e perfitimit te kesaj te drejte ne ligjin shqiptar.

Ligji yne procedural (neni 459) parashikon edhe **kompensimin per denim te padrejte**, duke percaktuar se ka te drejte per nje kompensim ne perpjestim me kohezgjatjen e denimit dhe me pasojat personale dhe familjare qe rrjedhin nga denimi, personi qe ka marre pafajesine gjate rishikimit te vendimit te formes se prere, me kusht kur nuk ka dhene shkak me dashje ose pakujdesi te rende per gabimin gjyqesor.

Nga interpretimi i permbajtjes se ligjeve te mesiperme, del shume qarte se qe nje person te perfitoje kompensim per burgim apo denim te padrejte, nuk mjafton qe ai deklarohet i pafajshem me vendim te formes se prere apo qe ceshtja ne ngarkim te tij te jete pushuar, por *duhet qe te vertetohet qe vendimi i gabuar gjyqesor nuk eshte shkaktuar qofte teresisht apo pjeserisht per faj te tij*, ç’ka do te thote se vertetimi i ketyre te fundit sjell perjashtim te personit nga e drejta per te perfituar kete kompensim.

Percaktimi i kesaj rrethane, qe ne cdo rast konkret mund te jete lejuese ose perjashtuese nga perfitimi i se drejtes per demshperblim, nuk mund te kryhet nga ana e organit te administrates por detyrimisht nga gjykata. Bazuar ne faktin se te gjitha rregullimet e mesiperme parashikohen ne menyre te shprehur ne Kodin e Procedures Penale, nxirret perfundimi se eshte ky legjislacion baza ligjore e zgjidhjes se ceshtjes dhe per rrjedhoje **eshte gjykata penale** ajo qe do te vendose per te drejten e personit per te fituar kompensimin per burgim te padrejte, qe mund te jete sipas rastit gjykata e rrethit gjyqesor, gjykata ushtarake apo gjykata e krimeve te renda kur te krijohet. Qellimi i ligjvenesit qe per te perfituar kompensimin per burgim te padrejte duhet qe te vendose me pare gjykata penale, rezulton edhe nga disa rregulla procedurale te vendosura ne nenet 278, 269 dhe 459 te Kodit te Procedures Penale, ne te cilat permendet kerkesa per kompensimin, afati i paraqitjes, fakti se kompensimi eshte ne perpjestim me kohezgjatjen e denimit, me pasojat personale dhe familjare qe rrjedhin nga denimi, se kompensimi behet me pagimin e nje shume parash ose me dhenien e nje te ardhure jetesore, se masa e kompensimit dhe menyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit per arrestin ne shtepi caktohen me ligj te vecante, se kerkesa per kompensim i komunikohet prokurorit dhe te gjithe te interesuarve, e te tjera.

Keto percaktime tregojne se ligjvenesit ka marre parasysh caktimin e gjykates penale si gjykate kompetente per te vendosur per kompensimin per burgim te padrejte, per shkak te natyres te ketij lloj gjykimi. Ligjvenesit nuk mund te linte ne kompetence te gjykates civile, qe te percaktonte ajo faktin nese personi qe kerkon kompensim ka shkaktuar me dashje apo pakujdesi gabimin gjyqesor ne ngarkim te tij. Procedura Penale, duke parashikuar se kerkesa per kompensim u njoftohet prokurorit dhe te gjitha personave te interesuar, rritet qellimin e ligjit qe percakton si kompetente gjykatën penale.

Personi i deklaruar i pafajshem me vendim te formes se prere, apo qe eshte pushuar ceshtja ne ngarkim te tij, nuk mund t'i drejtohet drejtperdrejte per te kerkuar kompensimin per burgim te padrejte, organit te administrates qe mund te kete detyrimin per te bere pagimin e tij. Kjo rezulton e shprehur ne K.Pr.P., ku percaktohet se personi qe pretendon duhet te paraqese **nje kerkese per kompensim** dhe se ajo paraqitet ne **sekretarine e gjykates qe ka dhene vendimin**.

Parashikimi ne menyre te shprehur te ketyre momenteve ne ligjin procedural penal, pra te faktit se duhet te paraqitet kerkesa dhe se ajo duhet te paraqitet ne sekretarine e gjykates qe ka dhene vendimin, tregon edhe njehere, pervec pamundesise qe personi t'i drejtohet direkt organit te administrates qe te realizoje detyrimin, ashtu edhe faktin se eshte gjykata penale organi ku do te paraqitet dhe do te gjykohe kerkesa per kompensim.

Ligji procedural penal nuk parashikon menyren e gjykimit te ceshtjes nga gjykata penale qe gjykon mbi bazen e kerkeses per kompensim per burgim te padrejte dhe nuk specifikon vendimin qe ka te drejte te marre kjo gjykate. Por bazuar ne permbajtjen e dispozitave te permendura, dhe ne teresi ligjin procedural penal, ne si pakice kemi mendimin se:

- Gjykate kompetente per gjykimin e kerkeseve per kompensim per burgim te padrejte eshte gjykata penale qe ka dhene vendimin e pafajesise apo te pushimit te ceshtjes.

- Personi i interesuar mund ta drejtohe kerkesen per kompensim per burgim edhe njekohesisht me kerkimin tij per pafajesi te bere gjate gjykimit ne temel te ceshtjes. Gjykata penale vendos per *detyrimin per zhdemtim (kompensim)* me vendimin qe zgjidh ceshtjen ne temel, dhe ne rast se kjo nuk eshte e mundur, per shkak te veshtiresive qe mund te krijohen, gjykata vendos ne nje seance tjeter.

- Ne rastet e tjera, kerkesa duhet te paraqitet ne gjykatën penale brenda afateve te percaktuara ne nenin 269/1 te K.Pr.P., qe eshte tre vjet nga data ne te cilin vendimi i pafajesise ose i pushimit te ceshtjes ka marre forme te prere, dhe afatit te percaktuar ne nenin 459, pika 3 e K.Pr.P., qe eshte brenda dy vjeteve nga dita qe vendimi i rishikimit ka marre forme te prere..

Sipas edhe standarteve nderkombetare, shteti nuk eshte i detyruar te paguaje kompensim neqoftese vertetohet qe vete personi ka lejuar marrjen e vendimit te padrejte ne ngarkim te tij. Por i bie barra shtetit qe te vertetohe nje gje te tille. Pra nuk kerkohet qe shteti te paguaje kompensim bazuar vetem ne faktin se personi eshte arrestuar apo denuar ne menyre te padrejte, qendrim ky qe mbahet edhe nga legjislacioni shqiptar. Shteti duhet te miratohe ligjin lidhur me kompensimin per burgim te padrejte, i cili mund te rregullohe procedurat per dhenien e kompensimit dhe menyren e shumate e demshperblimit, por fakti qe ky ligj ende nuk ka dale nuk e menjanon shtetin nga detyrimi qe te paguaje kompensimin.

Demshperblimi per burgim te padrejte jepet mbi bazen e kerkeses se personit te interesuar dhe *gjykata penale* kur e gjen kerkesen te bazuar vendos **detyrimin e shtetit** (Ministrise se Financave) **per zdemtim** (kompensim). Vendimi duhet te permbaje **llojin** e mases shtrenguese te padrejte te marre ndaj personit dhe **kohe zgjatjen** e saj, per te cilen personi duhet te kompensohet.

Mbasi ky vendim gjyqesor te marre formen e prere, shteti eshte i detyruar qe te realizoje kompensimin per burgim te padrejte. Kunder **vendimit te kompensimit (si per vendimin qe refuzon te beje kompensimin ashtu dhe per masen dhe menyren e kompensimit)** te organit shteteror (Ministrise se Finances) personi i interesuar ka te drejte qe te ankohe ne **gjykatën civile**.

Nuk perben asnje pengese per gjykatën civile fakti qe ende nuk ka dale nje ligj i posacem per kompensimin per burgim te padrejte, qe parashikon edhe K.Pr.P. ne nenin 269/2, sepse, sipas nenit 2 te K.Pr.Civile gjykata nuk mund te refuzoje te shqyrtoje dhe te jape vendime per ceshtjet qe i paraqiten per shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk eshte i plote, ka kundërshtime ose eshte i paqarte.

Ylvi Myrtja

Agron Lamaj

Bashkim Caka

Vladimir Bineri

Vladimir Metani

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Metush Saraçi	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Agron Lamaj	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Bineri	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Irma Bala	Anetare

ne seancen gjyqesore te dates 29.01.2003, moren ne shqyrtim çeshtjen penale nr.3/1, qe i perket:

**TË PANDEHURVE: FOTAQ ZAHARIA
ELIDON LAZE
RIDVAN LERA
SAIMIR OSMANI**

A K U Z U A R:

Per vepren penale te rrembimit e mbajtjes peng
te personit me qellim fitimi, kryer ne bashkepunim,
parashikuar nga neni 109/2 e 25 i K.P.
dhe i pandehuri Elidon edhe per vepren penale
te armembajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 i K.P.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Fotaq Zaharia per vepren penale te parashikuar nga neni 109/2 e 25 te K.P. dhe e denon ate me 25 vjet burgim. Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.P. urdherohet zbritja e 1/3 se denimit.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Elidon Laze per vepren penale te parashikuar nga neni 109/2 e 25 i K.P. dhe e denon me 21 vjet burgim.

Deklarimin fajtor për armembajtje pa leje dhe ne baze te nenit 278/2 te K.P. e denon me 1 vit burgim. Ne bashkim te denimeve e denon me 21 vjet burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.P. urdherohet ulja e 1/3 se denimit.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Ridvan Lera per vepren penale te parashikuar nga neni 109/2 e 25 te K.P. dhe e denon me 21 vjet burgim.

Në baze te nenit 406 te K.Pr.P urdherohet ulja e 1/3 se denimit.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Saimir Osmani per vepren penale te parashikuar nga neni 109/2 e 25 te K.P. dhe e denon me 15 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin nr.187, date 24.7.2001, ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit nr.112, date 21.5.2001 te Gjykeses se Rrethit Gjyqesor Vlore per te pandehurin Fotaq Zaharia, Elidon Laze dhe Ridvan Lera.

Ndryshimin e ketij vendimi lidhur me te pandehurin Saimir Osmani dhe duke e gjykuar çeshtjen ne fakt e ka deklaruar fajtor per vepren penale te perkrahjes se autorit te krimit, parashikuar nga neni 302 i K.P. dhe e ka denuar me 2 vjet e 7 muaj burgim.

Kunder vendimit te gjykeses se apelit kane bere rekurs Prokurori i Pergjithshem dhe te gjykuarit.

Prokurori parashtron keto shkaqe:

- 1. Ne kundershtim me dispozitat e K.Pr.P. qe parashikojne gjykimin e shkurtuar, si dhe me nenin 93 te ketij Kodi, eshte aplikuar gjykimi i shkurtuar dhe nuk eshte zbatuar vendimi i ndermjetem per vecimin e ceshtjes ne ngarkim te te pandehurit Saimir Osmani.
- 2. Nuk mund te zhvillohen se bashku edhe gjykimi i shkurtuar edhe gjykimi i zakonshem.
- 3. Pranimi i gjykimit te shkurtuar ne rastin konkret, eshte ne kundershtim me natyren ligjore te ketij gjykimi, i cili ka si qellim te vetem ekonomine gjyqesore dhe zgjidhjen e ceshtjes ne gjendjen qe jane aktet, kurse ne kete ceshtje eshte pranuar kerkesa per gjykim te shkurtuar pas 30 seancash dhe pasi jane marre gjithe provat nga te cilat fajesia e te pandehurve eshte e provuar plotesisht. Prandaj, vendimi i ndermjetem qe pranon gjykimin e shkurtuar duhet te priset.
- 4. Ndryshimi i cilesimit ligjor te vepres per te pandehurin Saimir Osmani, nga gjykata e apelit eshte i gabuar.

I gjykuari Fotaq Zaharia parashtron keto shkaqe:

- Gjykimi eshte bere i njeanshem, sepse jane marre parasysh vetem theniet e te pandehurit Elidon Laze qe kane shume kontradikta te cilat gjykata nuk i analizoi. Ne keto rrethana kerkohet ndryshimi i cilesimit ligjor te vepres nga rrembim personi, ne moskallzim krimi.

I pandehuri Elidon Laze parashtron keto shkaqe:

- Gjykatat nuk kane marre parasysh ne dhenien e vendimit rrezikshmerine me te ulet te tij, shkallen e fajit dhe rrethanat lehtesuese. Prandaj kerkon ndryshimin e vendimit persa i perket mases se denimit me nje mase me te bute.

- I pandehuri Ridvan Lera parashton keto shkaqe:
- Gjykatat kane gabuar persa i perket cilesimit juridik te vepres dhe caktimit te mases se denimit. Nuk eshte marre parasysh personaliteti i mire i tij, pendimi i thelle, implikimi rastesisht i tij ne kete krim, etj. Kerkon zbutjen e denimit.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr.87, date 6.2.2002, ka vendosur:

Dergimin e ceshtjes per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per unifikimin e praktikes gjyqesore lidhur me aplikimin e gjykimit te shkurtuar.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e gjyqtareve Artan Hoxha dhe Metush Saraçi,
prokurorin prane Gjykates se Larte Artan Bajrami, i cili kerkoi pranimin e rekursit,
mbrojtessin e te gjykuarit Ridvan Lera, Av. Virgjil Karaj, i cili kerkoi pranimin e rekursit te paraqitur prej te gjykuarit,
dhe pasi biseduan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Vendimet e te dy gjykatave jane marre ne aplikim te gabuar te ligjit e per kete shkak jane te cenueshem.

Nga aktet e ndodhura ne dosje rezulton se te gjykuarit Fotaq Zaharia, Elidon Laze, Ridvan Lera dhe Saimir Osmani jane akuzuar per vepren penale te rrembimit dhe mbajtje peng te nje te mituri me qellim fitimi, veper penale e parashikuar nga neni 109/2 e 25 i K.P., kurse i gjykuari Elidon Laze edhe per vepren penale te armembajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i K.P.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, ne perfundim te gjykimit, pasi ka administruar provat ne seance gjyqesore, ka arritur ne perfundimin se eshte e provuar akuza ne ngarkim te te gjykuarve dhe i ka denuar respektivisht te gjykuarin Fotaq Zaharia me 25 vjet burgim, Elidon Laze me 21 vjet burgim, Ridvan Lera me 21 vjet burgim, por ju ka ulur denimin me 1/3 ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.P. Po ashtu, ka deklaruar fajtor te gjykuarin Saimir Osmani dhe e ka denuar me 15 vjet burgim dhe per shkak se ai nuk ka kerkuar gjykim te shkurtuar, ky ka qene edhe denimi perfundimtar.

Mbi ankimin e te gjykuarve, por edhe te prokurorit, i cili e ka konsideruar te gabuar aplikimin e gjykimit te shkurtuar nga gjykata e shkalles se pare Vlore, Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin nr.187, date 24.7.2001, ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare per tre te gjykuarit e pare dhe ka ndryshuar ate per cilesimin juridik te vepres per te gjykuarin Saimir Osmani, duke e deklaruar fajtor per vepren penale te perkrahjes se autorit te krimet, parashikuar nga neni 302 i K.P. dhe e ka denuar perfundimisht me 2 vjet e 7 muaj burgim.

Mbi rekursin e prokurorit dhe te gjykuarve kjo ceshtje ka ardhur per shqyrtim ne Kolegjin Penal te Gjykates se Larte per shkaqe te paraqitura ne pjesen hyrese te ketij vendimi. Nisur nga fakti se per gjykimin e shkurtuar ne praktiken tone gjyqesore jane mbajtur qendrimet e ndryshme qe kane sjelle edhe vendime te gabuara, Kolegji Penal ne mbeshtetje te nenit 141/2 te Kushtetutes dhe nenit 438 te K.Pr.P., me vendimin nr.87, date 6.2.2002, ka kaluar ne Kolegjet e Bashkuara kete ceshtje, per te njehsuar praktiken gjyqesore lidhur me:

1. Cilat jane kriteret nga te cilat duhet te udhehiqen gjykatat per te vendosur pranimin e kerkeses per gjykim te shkurtuar.

2. A mundet qe ne te njejten ceshtje e cila u perket disa te pandehurve, per nje apo per disa prej tyre te aplikohet gjykimi i shkurtuar dhe per te tjeret gjykimi i zakonshem.
3. Kur te pandehurit jane sjelle per tu gjykuar per me shume se nje akuze dhe gjykata, mbasi ka pranuar kerkesen e tyre per gjykim te shkurtuar, ne vendimin perfundimtar, ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.P. ul denimin me burgim me nje te treten, si duhet te veproje.
4. A mund te revokohet vendimi i ndermjetem i gjykates me te cilin eshte vendosur pranimi i kerkeses se te pandehurit, ose perfaqesuesit te posacem te tij per gjykim te shkurtuar dhe nese po, ne cilat raste dhe cilat duhet te jene kriteret nga te cilat duhet te niset gjykata per te vendosur revokimin e ketij vendimi.
5. A mund te shfuqizohet vendimi i ndermjetem i gjykates se shkalles se pare me te cilen pranohet kerkesa per gjykim te shkurtuar, nga gjykata e apelit, kur ndaj tij eshte paraqitur ankim bashke me ankimin kunder vendimit perfundimtar.

Nga shqyrtimi ne teresi i akteve te ndodhura ne dosje dhe ashtu sikurse kane pranuar te dyja gjykatat ne vendimet e tyre, rezulton se te gjykuarit Fotaq Zaharia, Elidon Laze, Ridvan Lera, banore te qytetit te Vlores, shoke mes tyre, ne daten 24.10.1999, rreth ores 18.00, ne afersi te njesise tregtare te shtetasit Pajtim Xhelaj kane rrembyer femijen e ketij te fundit, Denis Xhelaj, i moshes 6 vjec, duke e futur ne makinen e te gjykuarit Elidon Laze. Pasi i kane mbuluar koken me nje xhup, ata jane larguar nga vendi i ngjarjes dhe kane qendruar ne kodrat e fshatit Kanine ku me femijen ka ndenjor i gjykuari Ridvan Lera, ndersa dy te tjeret jane kthyer ne Vlore. Pajtim Xhelaj ka konstatuar mungesen e femijes dhe eshte vene ne kerkim te tij, duke njoftuar te aferm e te njohur dhe pas disa oresh ai ka vene ne dijeni edhe policine, organet e shtypit dhe prokurorine. Nder personat qe ai ju ka kerkuar ndihme ka qene dhe i gjykuari Fotaq Zaharia me te cilin kishte njohje te meparshme, por qe ne momentin kur ai e ka kerkuar, rreth ores 23 te dates 24.10.1999, nuk gjendej ne shtepi. Femija Denis Xhelaj nga kodrat prane fshatit Kanine, eshte cuar ne banesen (ku nuk banonte njeri) te dajes se te gjykuarit Elidon Laze, ne lagjen "Kushtrimi" te qytetit te Vlores, me qellim qe derisa te realizohet perfitimi nga rrembimi, te mbahej i fshehur.

Ka rezultuar e provuar se i gjykuari Elidon Laze, i diktuar nga i gjykuari Fotaq Zaharia, ka hartuar nje leter me te cilen i paraqiste kushte babait te femijes se rrembyer qe ne shkembim te djalit te tij, Pajtim Xhelaj duhet te paguante 18 milion leke. Kjo leter i dorezohet dy dite me vone, me 26.10.1999, rreth ores 19.15 nga deshmitarja Alketa Mustafaj, deshmitarit Pajtim Xhelaj. Nderkohe, ketij te fundit, ne numrin e telefonit te vjehrrit te tij, nga te gjykuarit, i jepeshin porosi per dergimin e parave, duke e kercenuar se ne te kundert nuk do ta shihte me femijen. Dy prej ketyre bisedave jane regjistruar dhe kane sherbyer si prove ne gjykim.

Duke qene se rrembimi i femijes Denis u be nje ngjarje publike ne media dhe ne opinion dhe per shkak se policia po intesifikonte kerkimin per gjetjen e tij, te gjykuarit kane vendosur ta largojne femijen nga rrethinat e Vlores. Pasi e futen ne bagazhin e nje makine, e kane cuar ne qytetin e Fierit dhe kur nuk kane gjetur nje shok te te gjykuarit Fotaq, e kane cuar ne shtepine e te gjykuarit Saimir Osmani. Dy te gjykuarit, Fotaq dhe Elidon, jane kthyer perseri ne Vlore per te kontaktuar me familjen e femijes se rrembyer, kurse i gjykuari Ridvan ka qendruar me femijen. Ne daten 2.11.1999, rreth ores 4.00 te mengjesit, dy te gjykuarit, Elidon Laze dhe Fotaq Zaharia kane telefonuar babain e te miturit nga nje kabine, por si rezultat i interceptimit telefonik nga policia, eshte bere e mundur te identifikohet vendi se nga telefonohej dhe keshtu eshte arritur te kapet ne flagrance i gjykuari Elidon Laze, ndersa i gjykuari tjeter Fotaq Zaharia ka mundur te largohet. I gjykuari Elidon Laze ka treguar lidhur me veprimtarine kriminale, bashkepunetoret e tij, si dhe

vendin ku mbahej femija dhe keshu eshte bere e mundur qe ne mengjesin e kesaj dite te kapet ne fragrance i gjykuari Ridvan Lera dhe Saimir Osmani, ne shtepine e ketij te fundit, si dhe te lirohej femija i rrembyer, Denis Xhelaj. Nga kontrolli qe i eshte bere baneses se Elidon Lazes ne daten 2.11.1999, eshte gjetur nje arme zjarri automatike model 56 ne gjendje te mire teknike e per kete shkak eshte akuzuar dhe denuar edhe per vepren penale te armembajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i K.P.

Ne keto kushte, drejte ka vepruar gjykata e shkalles se pare kur ka deklaruar fajtores per akuzen e rrembimit te personit te gjithe te gjykuarit, nderkohe gjykata e apelit ka gabuar lidhur me ndryshimin e cilesimit juridik te vepres, nga rrembim personi, ne perkrahje te autorit te krimit, per te gjykuarin Saimir Osmani.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se veprimet e te gjykuarit Saimir Osmani perbejne figuren e krimit te rrembimit te personit dhe jo ate te perkrahjes se autorit te krimit, parashikuar nga neni 302 i K.P. Sipas kesaj dispozite, perkrahja e autorit te krimit lidhet me veprime te kryera ne favor te tij, pasi ai te kete perfunduar vepren penale dhe te kete arritur qellimin kriminal. Nga ana objektive kryerja e kesaj vepre realizohet nepermjet furnizimit te autorit me ushqime, apo me mjete te tjera, sigurim banese, ose vend qendrimi me qellim qe personi qe ka kryer nje krim, t'i shpetoje arrestimit apo kapjes se tij. Sikurse shihet, per te konsumuar kete figure vepre penale kerkohet qe autorit te kryerjes se nje krimi t'i jepet ndihme me qellim qe te pengohet kapja, ose arrestimi i tij. Pra, veprimtaria kriminale e autorit te krimit qe perkrahet, ka mbaruar, kurse krimi i rrembimit, megjithese eshte konsumuar qe ne momentin e rrembimit, pavaresisht nese e sjell pasojen, realizimin e fitimit, eshte nje veper ne vazhdimesi. Me fjale te tjera, veprimtaria kriminale, megjithese e konsumuar qe me heqjen e lirishe nepermjet rrembimit, ose mbajtjes peng, vazhdon te jete e tille per te gjithe kohen sa vazhdon kjo gjendje. Bashkimi i te tjereve ne kete situatë kriminale, sikurse eshte rasti, pavaresisht se nuk eshte marre pjese ne momentin e rrembimit, e ben te gjykuarin Saimir Osmani bashkeautor ne kryerjen e vepres.

Per te arritur ne kete perfundim, vec sa mesiper, Kolegjet e Bashkuara kane parasysh faktin se neni 109 i K.P., parashikon kryerjen e krimit ne dy forma, ne ate te rrembimit te personit dhe ne ate te mbajtjes peng te tij. Ne rastin e pare, personi largohet nga vendi i tij me force dhe mbahet diku tjeter derisa te arrihet qellimi kriminal. Ne rastin e dyte, personi izolohet dhe mbahet peng ne ambientet ku ai eshte, derisa te realizohet qellimi kriminal. Kur dikush tjeter do te ofrohej per te realizuar mbajtjen peng ne vazhdimesi edhe pse nuk ka marre pjese qe ne fillim te pengmarrjes, ai do te pergjigjet per te njejten figure krimi dhe jo per perkrahje te autorit pas kryerjes se krimit. Mbajtja peng, megjithese eshte konsumuar qe me momentin e pare, vazhdon ne gjendje latente, derisa te kete perfunduar veprimtaria kriminale.

Ndodhur ne keto kushte Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, cmojne te drejte vendimin e gjykates se shkalles se pare Vlore, i cili e ka deklaruar fajtor te gjykuarin Saimir Osmani per vepren penale te rrembimit te kryer ndaj nje te mituri ne bashkepunim me tre te gjykuarit e tjere, po ashtu edhe masen e denimit te caktuar per te nga ajo gjykate.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, cmojne se te gjitha pretendimet e ngritura nga te gjykuarit lidhur me fajesine e tyre dhe masat e denimit, jane te pambeshtetura ne ligj dhe aktet e administruara. Vepra penale eshte provuar plotesisht se eshte kryer nga te gjykuarit, rrezikshmeria shoqerore e saj dhe e autoreve eshte e larte dhe se gjykata e shkalles se pare ne raport me rolin e tyre ne kete veprimtari, si dhe qendrimin qe ata kane mbajtur gjate procedimit, ka individualizuar drejt masat e denimit duke zbatuar kerkesat e neneve 48, 49 e 50 te K. Penal.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, gjejne me vend rekursin e prokurorit lidhur me aplikimin e gabuar te nenit 403 e ne vazhdim te K.Pr.P. Rezulton se te tre te gjykuarit, Fotaq Zaharia, Elidon Laze e Ridvan Lera perpara fillimit te shqyrtimit gjyqesor, ne baze te nenit 403 te

K.Pr.P. kane kerkuar qe te procedohet me gjykim te shkurtuar, ndersa i gjykuari Saimir Osmani nuk e ka bere nje kerkese te tille. Gjate kohes qe procedohej me kete ceshtje, dispozitat e K.Pr.P. qe rregullojne gjykimin e shkurtuar dhe qe kane percaktuar ne menyre te shprehur se kur mund te paraqitet kerkesa per gjykim te shkurtuar nuk kishin pesuar ndryshimet qe jane bere me ligjin nr.8813, date 13.6.2002. Nderkohe, sipas nenit 404 te K.Pr.P. ne fuqi ne ate kohe, kerkesa e refuzuar mund te riparaqitej, derisa nuk ishin bere konkluzionet perfundimtare te paleve. Kerkesa e refuzuar, pas 30 seancash gjyqesore dhe pasi jane marre provat, eshte perseritur dhe gjykata, ne seancen e dates 9.5.2001, ka vendosur te procedohet me gjykim te shkurtuar, duke revokuar vendimin e meparshem te saj. Po ne kete seance, bazuar ne nenit 93 te K.Pr.Penale, ka vecuar ceshtjen per te gjykuarin Saimir Osmani dhe i ka dhene fund shqyrtimit gjyqesor. Me tej, me kerkese te paleve, ka vendosur te procedoje me administrimin e akteve shkresore dhe administrimin e fashikullit te dosjes hetimore. Gjykata ka ftuar palet qe te vazhdojne me diskutimet perfundimtare, por mbi kerkesen e prokurorit te seances dhe mbrojtjesve te te gjykuarve, eshte vendosur qe te jepet kohe per pergatitje. Ne datat 14 dhe 15.5.2001 gjykata ka degjuar ato dhe ne date 21.5.2001 ka shpallur vendimin perfundimtar.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arrijne ne perfundimin se Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore ka gabuar ne vazhdimin e gjykimit bashkarisht per kater te gjykuarit, kur me vendim te ndermjetem ka pranuar vecimin e ceshtjes per njerin prej tyre. Vazhdimi i gjykimit me parashtrimin e konkluzioneve perfundimtare te paleve, mosreagimi i mbrojtjesve per kete dhe ndjekja e procedures te nje gjykimi te zakonshem dhe te pandare per te gjithete te gjykuarit, e ka bere pa vlere vendimin e ndermjetem. Gjykata, edhe pse nuk e ka revokuar ate nga pikepamja formale, ne fakt e ka bere kete duke e shqyrtuar ceshtjen ne vazhdim e te pandare per te kater te gjykuarit. Pra, gjykimi i ceshtjes eshte perfunduar nga e njejta gjykate edhe per te gjykuarin Saimir Osmani, pavaresisht nga mos revokimi formal i vendimit te vecimit te akteve per te.

Edhe pse neni 404 i K.Pr.Penale, ne paragrafin e dyte, tashme te shfuqizuar, parashikonte te drejten per ta riparaqitur kerkesen e refuzuar perpara se palet te jepnin konkluzionet perfundimtare, nuk ka patur per qellim perzierjen e gjykimit te posacem (gjykimit te shkurtuar), me gjykimin e zakonshem. Dispozitat e K.Pr.P., duhen pare te lidhura dhe ne harmoni me njera tjetren, me qellim qe te kuptohet thelbi dhe dallimi ndermjet ketyre gjykimeve. Praktika dhe eksperienca e vendeve te tjera, te cilat kane njohur gjykimet e posacme dhe efektet pozitive te tyre, ka bindur ligjvenesin shqiptar te pranoje gjykimin e drejtperdrejte dhe gjykimin e shkurtuar.

Gjykimi i shkurtuar ka vlere per ekonomi gjyqesore sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtesine dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasoje nje perfitim per te pandehurin ne uljen e 1/3 te mases se denimit dhe mos aplikimin e denimit me burgim te perjetshem.

Eshte e rendesishme te theksohet fakti qe ky perfitim nuk duhet te shkoje ne dem te dhenies se drejtesise. Per kete qellim, kerkesen e te pandehurit ose mbrojtjesit te posacem te tij, gjykata e pranon vetem atehere kur ajo paraprakisht bindet se mund ta perfundoje ceshtjen ne gjendjen qe jane aktet, pa qene nevoja per t'ja nenshtuar ato shqyrtimit gjyqesor. Jo pa qellim, ne nenin 403/2 te K.Pr.P., parashikohet se kerkesa depozitohet te pakten tre dite perpara dates te caktuar per seance, ose perpara fillimit te shqyrtimit gjyqesor, duke i dhene keshtu mundesi gjykates qe ajo te vleresoje se si duhet te procedoje me tej ne gjykimin e ceshtjes. Gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posacem, ne thelb te tij ka pranimin e akteve te grumbulluara gjate fazes se hetimit paraprak dhe eviton marrjen e provave ne seance gjyqesore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim eviton fazen e hetimit gjyqesor e per pasoje, edhe atehere kur ligji e parashikonte te drejten e ri paraqitjes se kerkeses, ne themel ka patur per qellim qe te procedohej me gjykim te posacem, duke prezumuar se gjykimi i zakonshem per shkaqe te ndryshme nuk ishte bere i mundur. Megjithate, per te evituar kete paqartesi, apo ndoshta nje kontradikte te ligjit, ndermjet asaj qe

kerkohej te arrihej dhe asaj qe parashikonte neni 404/2 i K.Pr.P., me ligjin nr.8813, date 13.6.2002, ky paragraf eshte shfuqizuar dhe perfundimisht eshte konsoliduar ligjerisht fakti se kerkesa per gjykimin e shkurtuar behet derisa te mos jete filluar shqyrtimi gjyqesor dhe se nuk mund te riparqitet me kur ai ka filluar.

Bazuar sa me siper, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke unifikuar praktiken gjyqesore arrijne ne perfundimin se kur shqyrtimi gjyqesor ka filluar me gjykim te zakonshem, nuk mund te vazhdohet me tej me gjykim te shkurtuar.

Ne gjykimin e kesaj ceshtje kane qene kater te pandehur, prej te cileve tre kane kerkuar gjykim te shkurtuar, ndersa i katerti ka kerkuar te vazhdoje me gjykim te zakonshem. Gjykata ka vepruar drejte kur ka vendosur fillimisht mos pranimin e kerkeses per gjykim te shkurtuar, por ka gabuar kur, pasi ka zhvilluar gjithë hetimin gjyqesor dhe debatin mbi provat e administruara ka pranuar gjykim te shkurtuar per te tre nga te pandehurit dhe te vazhdoje me gjykim te zakonshem, per te gjykuarin Saimir Osmani. Gjykata, ne kete rast, jo vetem ka kuptuar gabim konceptin e gjykimit te posacem, duke e konsideruar ate vetem si nje perfitim per te pandehurin ne uljen e mases se denimit, padrejtesisht ka pranuar dy lloj gjykimesh ne te njejtin procedim.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke unifikuar praktiken gjyqesore arrijne ne perfundimin se ne nje gjykim me disa te pandehur nuk mund te procedohet per disa me gjykim te posacem dhe per te tjeret me gjykim te zakonshem.

Vetem ne rastin kur ne kushtet e nenit 93 te K.Pr.P., vendoset ndarja e ceshtjes, mund te lejohet gjykimi i shkurtuar per te pandehurit qe e kane kerkuar nje gjykim te tille dhe ceshtja te vecohet per te pandehurit e tjere qe kerkojne gjykimin e zakonshem. Eshte konceptualisht e gabuar kur gjykimi i shkurtuar aplikohet vetem si perfitim per te pandehurin, pavaresisht nga fakti se eshte proceduar me gjykim te zakonshem.

Duke marre shkas nga praktika jo te njejtja gjyqesore, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, me kete vendim unifikues sqarojne edhe disa momente te tjera qe lidhen me gjykimin e shkurtuar.

Ketij gjykimi ne dallim nga gjykimi i zakonshem i mungon faza e marrjes se provave dhe kerkesat lidhur me pavlefshmerine e tyre.

Ligji parashikon qe ceshtja zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet, qe nenkupton pranimin e tyre nga palet ashtu sikurse jane. Eshte detyrim i gjykates te vleresoje nese ne ate gjendje qe jane aktet mund te jape vendim pa cenuar drejtesine dhe intreresat e ligjshme te te pandehurit. Gjykimi vazhdon me paraqitjen e konkluzioneve perfundimtare, te cilat i referohen akteve te pranuar nga palet sikurse parashikon neni 405/5 dhe 6 i K.Pr.P. dhe gjykata jep vendim bazuar ne to.

Ne rast se palet kane pretendime lidhur me pavlefshmerine e akteve, qofshin pavlefshmeri absolute apo relative dhe kerkojne konstatimin apo deklarimin e kesaj pavlefshmerie, gjykata duhet te revokojë vendimin per gjykim te shkurtuar dhe te urdherojë vazhdimin e procedimit me gjykim te zakonshem.

Kur ligji parashikon se gjykata vendos te procedoje me gjykim te shkurtuar ne gjendjen qe jane aktet, nenkupton se gjykata ka detyrimin qe perpara se te marre vendimin per pranimin e kerkeses, duhet te shqyrtojë me imtësi aktet dhe ne qofte se ajo konstaton paraparakisht pavlefshmeri te tyre dhe e vene ate perpara pamundesise per te dhene nje vendim te bazuar, ajo duhet te mos e pranoje qe ne fillim kerkesen per gjykim te shkurtuar.

Kur per nje te pandehur ka me shume se nje akuze mund te lejohet gjykimi i shkurtuar per nje apo me shume prej tyre, kur nje gje e tille kerkohet me kushtin qe ceshtja te ndahet dhe te gjykohet me vehte, pa u demtuar procedimi per ceshtjet e tjera, sikurse parashikon neni 93 i K.Pr.P.

Ne interpretim te pikes 6 te nenit 404 te K.Pr.P. konsensusi i prokurorit nuk eshte kusht i domosdoshem qe gjykata te pranoje kerkesen e te gjykuarit per te proceduar me

grykim te shkurtuar. Kjo justifikon edhe te drejten qe ka prokurori per te bere ankim kunder vendimit te gjykates per pranimin e gjykimit te shkurtuar, ankim qe mund te paraqitet se bashku me ankimin kunder vendimit perfundimtar.

Lloji i gjykimit te ndjekur nga gjykata e shkalles se pare, pavaresisht nga vendimi i saj i ndermjetem lidhur me kerkesen per gjykim te shkurtuar, eshte i rendesishem per qendrimin qe duhet te mbaje gjykata e apelit per ankimin e paleve te parashikuar nga neni 406/3 i K.Pr.Penale.

Me pranimin e kerkeses per te vazhduar me gjykim te shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet ne dosje gjyqesore dhe sherben per t'u bazuar ne parashtrimin e konkluzioneve perfundimtare te paleve dhe per dhenien e vendimit nga gjykata.

Lidhur me menyren e aplikimit te uljes se denimit, duhet fillimisht te caktohet denimi per vepren penale dhe me pas aplikohet zbritja e nje te tretes se tij.

Kur i pandehuri deklarohet fajtor per disa vepra penale, duhet te caktohet fillimisht denimi per cdo njerem prej tyre dhe pasi aplikohet bashkimi i denimeve sipas nenit 55 te K.P., behet zbritja nga denimi i bashkuar me nje te treten.

Marre per baze sa u arsyetua me siper Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se aplikimi i nenit 406 te K.Pr.P., nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore per te gjykuarit Fotaq Zaharia Elidon Laze dhe Ridvan Lera eshte ne kundershtrim me nenin 403, 404, 405 te K.Pr.P., e per pasoje ne kete pjese te tij vendimi duhet ndryshuar. Aplikimi i gabuar i ligjit, padrejtesisht ka krijuar nonsensin qe megjithese roli i te gjykuarit Saimir Osmani ne kete veprimtari kriminale ne raport me tre te gjykuarit e tjere, te jete me me pak rrezikshmeri shoqerore, ky i fundit duhej te vuante nje denim me te larte, apo te njejte me ta.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne mbeshtetje te nenit 141/2 te Kushtetutes, nenit 17/a te Ligjit nr.8588, date 15.3.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates se Larte" dhe nenit 441/d te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.187, date 24.7.2001 te Gjykates se Apelit Vlore dhe lenien ne fuqi te vendimit nr.112, date 21.5.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, duke e ndryshuar ne pjesen qe ben fjale per aplikimin e nenit 406 te K.Pr.P. dhe perfundimisht Fotaq Zaharia denohet me 25 vjet burgim, Elidon Laze me 21 vjet burgim, Ridvan Lera me 21 vjet burgim dhe Saimir Osmani me 15 vjet burgim.

Njoftohet Prokurori prane Gjykates se Larte per ekzekutimin e ketij vendimi.

Ky vendim per njehsimin e praktikës gjyqesore, dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 29.01.2003

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Metush Saraçi	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Zamir Poda	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Irma Bala	Anetare

ne seancen gjyqesore te dates 30.01.2003 moren ne shqyrtim ceshtjen penale me pale:

KËRKUES: PROKURORIA E PERGJITHSHME, perfaqesuar nga prokurori Bilbil Mete.

OBJEKTI:

Njohje e vendimit penal
te Gjykates se pare penale te Apelit te Milanos Itali,
nr.6/01 e nr.39/00, date 02.02.2001,
ne ngarkim te shtetasit shqiptar Arben Grori.
Baza ligjore: Neni 512 i Kodit te Procedures Penale.

I denuari Arben Grori perfaqesohet nga avokatet Vladimir Meçe e Mark Pellumbi.

Gjykata e rrethit Tirane, me vendimin nr.555, date 20.06.2002 ka vendosur:

Mospranimin e kerkeses se Prokurorise se Pergjithshme per njohjen e vendimit penal nr.6/01 dhe nr.39/00, date 02.02.2001 te Gjykates se pare penale te Apelit te Milanos Itali.

Gjykata e Apelit Tirane, mbi apelin e prokurorit, me vendimin nr.384, date 24.07.2002, ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit nr.555 akti, date 20.06.2002 te Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

Kunder vendimeve te mesiperme, ka bere rekurs Prokuroria e Pergjithshme, e cila kerkon ndryshimin e vendimeve dhe pranimin e kerkeses per njohjen e vendimit penal te huaj, per arsyet e meposhtme:

- Nuk ekziston asnje shkak ligjor per mosnjohjen e vendimit penal te autoriteteve gjyqesore italiane per denimin e Arben Grorit.
- Germa "e" e nenit 514, pika 1, e K.Pr.Penale, qe parashikonte kushtin absurd te pelqimit te te denuarit ose te perfaqesuesit te tij ligjor, eshte shfuqizuar me ligjin nr.8813, date 13.06.2002 dhe ky ligj ka qene ne fuqi ne momentin e gjykimit te ceshtjes ne Gjykatën e Apelit Tirane.
- Gjykatat kane vendosur ne kundërshtim me Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë, nenet 3, 4, 5, 6 e 21 te saj, pasi nese ato cmonin se per njohjen e vendimit te autoriteteve gjyqesore italiane behej pengese germa "e" e nenit 514 te K.Pr.Penale, ne mbështetje te nenit 145, pika 2, te Kushtetutes, duhet te pezullonin gjykimin dhe t'ia dergonin ceshtjen Gjykates Kushtetuese, pasi nuk mund te mos vleresohej se permbajtja e kesaj dispozite binte ndesh me ligjin themelor te shtetit.
- Gjykatat kane vepruar ne kundërshtim me vendimin unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, nr.154, date 15.04.2000, pasi kushtet e permendura ne kete vendim ekzistojne plotesisht ne rastin objekt gjykimi.
- Gjykata e apelit ka shkelur parimin e njohur dhe te pranuar boterisht per zbatimin e ligjit procedural penal "tempus regit actum", sipas te cilit zbatohen ato dispozita procedurale qe jane ne fuqi ne kohen e gjykimit te ceshtjes dhe, perjashtim nga ky rregull eshte vetem rasti kur ligjvenesit percakton afate per aplikimin e ligjit procedural penal.
- Nga permbajtja e vendimit te gjykates se apelit arrihet ne perfundimin absurd se autoret e krimi kane vetem te drejta e jo detyrime dhe se vendimet e autoriteteve gjyqesore te huaja ne Shqiperi jane te pazbatueshme, fakt qe flet se kjo gjykate ka mbajtur anen e mbrojtjes, duke shkelur parimin e paanesise ne gjykim.
- Arsyet e gjykates se apelit jane deduksione hipotetike e te pambeshtetura ne dispozitat e posacme te ligjit procedural penal.

Me qellim njesimin e praktikës gjyqesore bazuar ne nenin 438 te K.Pr.Penale dhe nenin 14 te Ligjit nr.8588, date 15.03.2000 "*Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykates se Larte te Republikës së Shqipërisë*", Kryetari i Gjykates se Larte ka vendosur terheqjen e ceshtjes per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara. Ky vendim eshte marre nisur nga fakti se, lidhur me kete kategori ceshtjesh, ne praktiken e gjykatave te rretheve gjyqesore e te apeleve kane lindur probleme persa i perket kuptimit, interpretimit e zbatimit te dispozitave te Titullit X, Kreut III, Seksioni I, te K.Pr.Penale, qe rregullojne ekzekutimin e vendimeve penale te huaja (nenet 512 – 518). Ne menyre te vecante ka lindur e nevojshme te sqarohen e te njesohen qendrimet per problemet e meposhtme:

1. *Ne marredheniet me autoritetet e huaja ne fushen penale, cilat norma kane perparesi ne zbatim, ato te marreveshjeve nderkombetare, te pranuar nga shteti shqiptar, ose parimet e normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare apo ato te legjislacionit te brendshem kombetar?*

2. *Cili eshte dallimi midis: 1) transferimit te te denuarve, qe jane denuar dhe vuajne denimin ne nje shtet te huaj, ne shtetin e tyre te origjines, d.m.th. ne shtetin shtetas te te cilit ata*

jane; 2) ekzekutimit te vendimit penal te huaj ndaj nje shtetasi shqiptar te denuar qe ndodhet pas dhenies se denimit ne territorin e Republikes se Shqiperise; dhe 3) ekstradimit.

3. Ne varesi te qenies ose jo nen kufizim te lirise te nje te denuari me burgim, shtetas shqiptar, si rezultat i nje vendimi penal te huaj, a jemi para proceseve te ndryshme ekzekutimi dhe, per efekt te ketij ekzekutimi, ne njohjen e vendimit penal te huaj, a perben kusht per njohje pelqimi i te denuarit ne te gjitha rastet?

Dhenia e pelqimit te te denuarit prej gjykates se huaj duhet per faktin ne se ai deshiron ta vuaje apo jo denimin, (sic pranon gjykata e rrethit dhe ajo e apelit) apo se ku deshiron ta vuaje denimin, ne burgjet e shtetit denues apo ne burgjet e shtetit, shtetas i te cilit ai eshte?

4. Per problemet e mesiperme a ka ndeshje midis dispozitave te konventave dhe dispozitave te K.Pr.Penale te Republikes se Shqiperise.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga gjyqtaret Thimjo Kondi e Kristaq Ngjela, pasi degjuan prokurorin Bilbil Mete qe kerkoj prishjen e te dy vendimeve dhe njohjen e vendimit te gjykates se apelit te Milanos- Itali, avokatet Vladimir Mece e Mark Pellumbi qe kerkuan lenien ne fuqi te vendimeve, e pasi e biseduan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë:

Vendimi nr.384, date 24.07.2002 i Gjykates se Apelit Tirane dhe vendimi nr.555, date 20.06.2002 i Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, qe i perkasin te denuarit Arben Grori, jane te pabazuar ne ligj, prandaj duhet te prishen dhe ceshtja te dergohet per rishqyrtim ne Gjykatën e rrethit gjyqesor Tirane. Nga aktet e gjykimit ne shkalle te pare e ne apel ka rezultuar si me poshte:

Gjykata e Peste Penale e Milanos ne Republikën e Italise me vendimin e dates 21.12.1999 ka vendosur deklarimin fajtor dhe denimin me burgim te perjetshem te shtetasit shqiptar Arben Grori, per krimet e parashikuara nga nenet 110, 575, 577/3 etj. te Kodit Penal Italian.

Vendimi i mesiperm eshte konfirmuar me vendimin nr.6/01 dhe nr.39/00 te Regj.Pergj. te Apelit te Milanos ne Republikën e Italise.

Kunder vendimeve te mesiperme eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e Kasacionit te Republikës se Italise, i cili eshte hedhur poshte me sentencen e dates 30.01.2002 te Seksionit te Pare te asaj gjykate.

Duke qene se shtetasi shqiptar Arben Grori eshte gjykuar e denuar ne mungese dhe, sipas te dhenave qe kishin autoritetet italiane, ai ndodhej ne territorin e Republikës se Shqiperise, ato kane kerkuar njohjen e vendimit penal te mesiperm nga autoritetet gjyqesore shqiptare. Ministria e Drejtesise e Italise i'a ka percjelle dokumentacionin e nevojshem Ministrise se Drejtesise te Shqiperise dhe kjo e fundit Prokurorise se Pergjithshme, e cila konform nenit 512/1 te K.Pr.Penale, ka vene ne levizje Gjykatën e rrethit gjyqesor Tirane.

Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane nuk e ka pranuar kete kerkese per njohjen e vendimit penal te huaj me arsyetimin se ekzistonte pengesa ligjore e parashikuar ne nenin 514, pika "e", te K.Pr.Penale, sipas te ciles, "*Vendimi i gjykates se huaj nuk mund te njihet kur:*

e – nuk eshte dhene pelqimi nga i denuari ose perfaqesuesi ligjor i tij".

Kjo gjykate ne arsyetimin e vendimit te saj u referohet edhe disa vendimeve te Gjykates se Larte, qe kane te bejne me probleme te ekstradimit dhe te transferimit te personave te denuar nga shteti ku vuajne denimin ne shtetin shtetas te te cilit ata jane.

Lidhur me sa me lart, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte verejne se referencat ne praktiken e kesaj gjykate, te parashtruara ne vendimin e Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, jane te

gabuar. Keto vendime nuk japin zgjidhje per ceshtjen ne fjale sepse problematika ne shqyrtim eshte e ndryshme.

Gjykata e Apelit Tirane ne vendimin e saj shprehet ne menyre te pergjithshme se kerkesa e Prokurorise per njohjen e vendimit penal te gjykates se huaj eshte e pa pranueshme sepse, sipas saj, ajo bie ndesh me parimet e sanksionuara ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe ne Konventat Nderkombetare, ku Shqiperia ka aderuar apo eshte pale, si dhe ne Kodin Penal e ne Kodin e Procedures Penale. Megjithate kjo gjykate nuk ben ndonje analize ne baze te atyre parimeve. Madje nuk kuptohet fare se per cilat parime behet fjale.

Ne pjesen e fundit te vendimit te saj gjykata e apelit permend edhe njehere ne menyre te pergjithshme ekzistencen e parimeve baze te Kreut te Kushtetutes “*Per te drejtat dhe lirite themelore te njeriut*”, si dhe u referohet neneve 3 e 15 e vijues te Kushtetutes, nenit 3/3 te Kodit Penal, si dhe nenit 10 te K.Pr.Penale, sipas te cilit “*Marredheniet me autoritetet e huaja ne fushen penale rregullohen nga marreveshjet nderkombetare, te pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare, si dhe dispozitat e ketij kodit*”.

Gjykata e Apelit Tirane konstaton me te drejte se Shteti Shqiptar dhe Shteti Italian ende nuk kane lidhur ndonje marreveshje per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, por arsyetimi i saj per normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare si dhe normat perkatese te K.Pr.Penale, qe kane lidhje me ceshtjen ne shqyrtim, eshte teresisht dhe qartesisht i gabuar, mbeshtetur nga argumentat qe do te parashtrojme me poshte ne kete vendim.

Gjykata e apelit ne vendimin e saj permend parimin e moskeqesimit te pozites se te pandehurit si dhe detyrimin e gjykates per te zbatuar dispozitat favorizuese. Kjo gjykate jo vetem qe i permend perciptazi dhe ne menyre jo korrekte keto parime, por, per me teper, ato nuk kane lidhje me lenden ne shqyrtim.

Ne menyre te vecante Gjykata e Larte e Republikes se Shqiperise nuk mund te pajtohet me pohime te tilla si: “*...jane pranuar keto parime edhe ne te drejten nderkombetare, por qe nga gjyqtaret e huaj nuk mbahen parasysh kur ata deklarojne fajtores dhe japin denime te renda per shtetasit shqiptare, krahasuar me ato te dhena shtetasve te tyre te denuar per te njejtat vepra penale*”.

Konkluzione te tilla jo vetem qe nuk bazohen ne fakte e argumenta e nuk mund te bindin askend, por, per me teper, ato nuk kane kurrfare lidhje me natyren e permbajtjen e nje vendimi gjyqesor. Shprehje te tilla jane diskretituese per figuren e gjyqtarit dhe ulin kredibilitetin e drejtesise shqiptare, prandaj i behet verejtje gjykates se apelit me qellim qe keto dukuri te mos perseriten me ne te ardhmen.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte konkludojne se te dy vendimet duhet te prishen per zbatim te gabuar te ligjit procedural mbeshtetur ne arsyetimin si me poshte:

1. Qe ne kohen e miratimit te Ligjit nr.7491, date 29.04.1991 “*Per Dispozitat Kryesore Kushtetuese*” eshte pranuar se “*Legjislacioni i Republikes se Shqiperise merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare*” (neni 8/1). Me miratimin e Kodit te Procedures Penale, me ligjin nr.7905, date 21.03.1995, ne nenin 10 te tij u parashikua ne menyre te shprehur se “*Marredheniet me autoritetet e huaja ne fushen penale rregullohen nga marreveshjet nderkombetare te pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare, si dhe dispozitat e ketij kodit*”.

Deri ne miratimin dhe hyrjen ne fuqi te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise ekzistonte vetem nje angazhim i shprehur dhe i pergjithshem per te zbatuar parimet e normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare, ne kete kuader edhe normat qe rregullojne marredheniet juridiksionale midis shteteve ne fushen penale e procedurale penale, si dhe per te ndertuar e pershtatur te gjithe legjislacionin ne keto norma e parime.

Ne nenin 5 te Kushtetutes eshte parashikuar se “*Republika e Shqiperise zbaton te drejten nderkombetare te detyrueshme per te*”.

Nenet 116/b, c dhe 122 te Kushtetutes parashikojne ne menyre te shprehur se marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe te botuara ne Fletoren Zyrtare perbejne pjese te sistemit te brendshem juridik, se ato zbatohen ne menyre te drejtperdrejte, pervec rasteve kur nuk jane te vetezbatueshme dhe zbatimi i tyre kerkon nxjerrjen e nje ligji, dhe se marreveshjet nderkombetare te ratifikuara me ligj kane epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me to.

Nga sa me lart rezulton se ne marredheniet juridiksionale me autoritetet e huaja ne fushen penale perparasi ka Kushtetuta e Republikes se Shqiperise dhe marreveshjet nderkombetare te ratifikuara, pajtueshmeria (*kompatibiliteti*) e te cilave me Kushtetuten mund te vleresohet nga Gjykata Kushtetuese para ratifikimit te tyre (*neni 131/b i Kushtetutes*).

Duke gene se marreveshjet nderkombetare te ratifikuara kane epersi mbi ligjet e vendit, atehere, ne rast papajtueshmerie, kuptohet qe gjykatat duhet te zbatojne normat e marreveshjes nderkombetare dhe jo te ligjit qe nuk pajtohet me te.

2. Lidhur me zbatimin e vendimeve penale me kufizim te lirise te nje te denuari, si dhe te masave shtrenguese penale qe kufizojne lirine e nje personi, ne marreveshjet nderkombetare te ratifikuara (*konventat e Keshillit te Europes*) dhe ne Kodin e Procedures Penale, parashikohen: a) *Transferimi ne shtetin e origjines (ne shtetin shtetas te te cilit jane) i te denuarve, qe jane denuar dhe vuajne denimin penal me burgim ne nje shtet te huaj; b) Ekzekutimi nga autoritetet shqiptare i nje vendimi penal te dhene nga nje gjykate e huaj ndaj nje shtetasi shqiptar te denuar, qe ndodhet pas dhenies se denimit ne territorin e Republikes se Shqiperise; dhe c) Ekstradimi.*

Ekstradimi per jashte shtetit sipas nenit 488 te K.Pr.Penale, eshte dorezimi i nje personi nje shteti te huaj per ekzekutimin e nje vendimi me burgim ose te nje akti qe verteton procedimin e tij per nje veper penale.

Ne kete rast procedimi penal dhe/ose denimi me burgim i personit, qe ndodhet ne Shqiperi dhe qe kerkohet te ekstradohet, eshte bere ne shtetin e huaj qe kerkon ekstradimin.

Ndersa ekstradimi nga jashte shtetit eshte marrja ne dorezim prej autoriteve kompetente te huaja e nje personi te proceduar ose te denuar penalisht, ndaj te cilit duhet te ekzekutohet nje mase qe kufizon lirine personale ne territorin e Republikes se Shqiperise (*neni 504 i K.Pr.Penale*).

Ekstradimi, ne te dy format e siper permendura, nuk ka te beje me ceshtjen ne shqyrtim, por sqarimi i kuptimit te tij ka rendesi per ta dalluar prej ekzekutimit te nje vendimi penal te huaj nga autoritetet shqiptare dhe prej transferimit te te burgosurve shqiptare nga nje shtet i huaj ne Shqiperi.

3. Te dy keto masa me karakter proceduralo – penal gjejne rregullim te pergjithshem ne nenet 512 – 518 te K.Pr.Penale, nen titullin e perbashket “*Ekzekutimi i Vendimeve Penale te Huaja*”.

Transferimi i te burgosurve ka gjetur rregullim edhe ne Konventen Europiane, “*Per transferimin e personave te denuar me heqje lirie*” te ratifikuar nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise e te botuar ne Fletoren Zyrtare, nr.22 te vitit 1999, si dhe ne disa marreveshje bilaterale me shtete te tjera, ndersa Konventa e Keshillit te Europes “*Per Vleren Nderkombetare te gjykimeve Penale*” eshte nenshkruar nga shteti shqiptar, por ende nuk eshte ratifikuar nga Kuvendi. Si e tille kjo konvente nuk mund te konsiderohet pjese e sistemit juridik (*legjislacionit*) te brendshem dhe nuk mund te kete aplikim te drejtperdrejte. Megjithate fakti i nenshkrimet te kesaj konvente, si dhe miratimi i dispozites angazhuese sipas te ciles shteti njeh dhe respekton parimet dhe normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare, na ndihmojne per te kuptuar, interpretuar dhe zbatuar drejt dispozitat e Kodit te Procedures Penale qe kane lidhje me ceshtjen ne shqyrtim. Keto dispozita nuk mund te kuptohen e te interpretohen ndryshe, vecse sipas

kuptimit dhe permbajtjes se parimeve e normave te gjithë pranuar te se drejtes nderkombetare dhe te konventave nderkombetare.

Rregullimi ligjor ne lidhje me njohjen e vendimeve penale te gjykatave te huaja behet me ane te dispozitave te neneve 512 – 518 te K.Pr.Penale, qe perfshihen ne seksionin e I^o te kreut te III^o te ketij kodi dhe qe titullohet “*Ekzekutimi i vendimeve penale te huaja*”. Rendesit per trajtimin e rastit objekt shqyrtimi ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte, kane sidomos dispozitat e neneve 512 dhe 514 te K.Pr.Penale ne te cilat behet fjale, respektivisht, per njohjen e vendimeve penale te huaja dhe per kushtet e kesaj njohjeje.

Nga permbajtja e dispozites se nenit 512 te K.Pr.Penale, rezulton se, behet fjale per njohjen e vendimeve penale te dhena nga gjykatat e huaja ndaj shtetasve shqiptare, shtetasve te huaj ose personave pa shtetesi, por, te cilet ne kohen kur kerkohet te behet njohja, jane me banim ne shtetin shqiptar. Procedimi penal i ketyre personave mund te kete nisur ne shtetin e huaj ose edhe ne shtetin shqiptar, por, ne te dy rastet, te jete bere nga nje gjykate e huaj.

Nevoja e njohjes se vendimeve penale te gjykatave te huaja, nga gjykatat shqiptare, lind vetem ne rastet kur i denuari eshte shtetas shqiptar, ndersa kur ai eshte shtetas i huaj apo person pa shtetesi, problemi, sikurse u trajtua me lart, zgjidhet nepermjet ekstradimit.

Duke u nisur nga permbajtja e pikes 1 te dispozites se nenit 512 te K.Pr.Penale, sipas se ciles, Ministria e Drejtesise, kur i vjen nje vendim penal i dhene jashte shtetit, ndaj shtetasve shqiptare, por me banim ne shtetin shqiptar, ndjek procedurat e parashikuara, po ne kete dispozite, qe nevojiten per njohjen e ketyre vendimeve ne Shqiperi, arrihet ne perfundimin se ketu behet fjale si per te denuarit, shtetas shqiptare, vendimi penal i dhene per te cilet, ka filluar te vihet ne ekzekutim ne shtetin e huaj, ashtu edhe per te denuarit, shtetas shqiptare per te cilet, vendimi penal i formes se prere nuk ka filluar ende te vihet ne ekzekutim.

Njohja e vendimeve penale te formes se prere te gjykatave te huaja per kategorine e pare d.m.th. per te denuarit shqiptare, kur ka filluar ne fakt ekzekutimi i tyre ne shtetin e huaj, kerkohet dhe behet, si rregull, me qellim qe, i denuari te vazhdoje vuajtjen e pjeses se pavuajtur te denimit, ne Shqiperi.

Kurse njohja e vendimeve penale te formes se prere te gjykatave te huaja per kategorine e dyte, d.m.th., per te denuarit, shtetas shqiptare, per te cilet vendimi penal i formes se prere nuk ka filluar te vihet ne ekzekutim dhe qe jane me banim ne shtetin shqiptar, si rregull, behet kur kerkohet per te denuar te cilet, ose jane denuar ne mungese nga gjykata e huaj, ose duke qene ne gjendje te lire, pas denimit, kane lene vendin e huaj dhe kane ardhur ne Shqiperi. Ne kete kategori, duhet te perfshihen edhe te denuarit, shtetas shqiptare, te cilet, megjithese vendimi penal ndaj tyre, ka filluar te vihet ne ekzekutim ne shtetin e huaj, vuajtja e metejshme e denimit, atje, eshte nderprere, pavaresisht nga shkaku (arratisja e te denuarit nga burgu, moskthimi i tij nga leja, etj).

Edhe neni 514 i K.Pr.Penale, qe titullohet “*Kushtet e njohjes [se nje vendimi penal te huaj]*” dhe qe parashikon ne menyre taksative rastet kur nje vendim penal i huaj nuk mund te njihet nga gjykatat shqiptare, perfshin ne rregullimin e tij te dy format (*rastet*) e njohjes: a) *Konvertimin e denimit penal te dhene nga nje gjykate e huaj kunder nje shtetasi shqiptar qe eshte duke e vuajtur ate denim ne shtetin e huaj, kur ky i denuar ka kerkuar qe ate denim ta vuaje apo te vazhdoje ta vuaje ne te ardhmen ne shtetin e tij; b) Njohjen dhe ekzekutimin e nje vendimi penal te dhene nga nje gjykate e huaj kunder nje shtetasi shqiptar (ose edhe shtetasi te huaj apo personi pa shtetesi) me banim ne Shqiperi. Ne kete rastin e dyte shtetasi shqiptar nuk mund te ekstradohet pa pelqimin e tij ne shtetin qe ka dhene kunder tij nje denim penal, ne mungese te nje marreveshje bilaterale qe lejon ekstradimin edhe kunder vullnetit te tij.*

Ne rastin e pare pelqimi i personit te denuar eshte i domosdoshem dhe perben kusht *sine qua non* per transferimin e tij ne shtetin e origjines, ne pajtim me nenin 3, pika “d”, te Konventes

Europiane “*Per transferimin e personave te denuar me heqje lirie*”, si dhe me nenin 514, pika “e”, (para shfuqizimit) te Kodit te Procedures Penale te Republikes se Shqiperise. Persa i perket rastit te transferimit te te denuarve, shfuqizimi i pikes “e” te nenit 514 i bie ndesh dispozites se siperpermendur te Konventes, duke krijuar nje papajtueshmeri. Megjithate ne kete rast kjo nuk sjell efekte negative ne praktike, sepse, sic e kemi permendur edhe me lart, konventa eshte direkt e zbatueshme si pjese e sistemit juridik te brendshem dhe zbatimi i saj ka perparesi ndaj Kodit te Procedures Penale.

Ne rastin e dyte, d.m.th. te njohjes dhe ekzekutimit te nje vendimi penal te huaj, referimi ne, dhe zgjidhja e ceshtjes sipas pikes “e” te nenit 514 te K.Pr.Penale, ne kohen kur kjo ishte ne fuqi, do te perbente nje *non sens*. Ne zgjidhjen qe do te pranonte si domosdoshmeri pranimin edhe ne kete rast te pelqimit te personit te denuar do te na conte vetem interpretimi gramatikor (*ad literam*) i kesaj dispozite, ashtu sic ka vepruar gjykata e shkalles se pare dhe ajo e apelit. Mirepo, interpretimi i nje dispozite ligjore eshte kompleks. Sidomos ne rastet kur interpretimi fillestar gramatikor mund te coje ne nje *non sens*, perparesi merr interpretimi logjik e sistematik. Sipas ketij interpretimi dispozites ne fjale do t'i jepet ai kuptim qe eshte i arsyeshem. Kjo do te thote qe nocionit te “*pelqimit te te denuarit*” nuk mund t'i jepet kuptim i gjere qe te perfshije te dy rastet e njohjes se vendimit penal te huaj, por kuptim i ngushte qe te perfshije vetem nje rast d.m.th ate qe nuk te con ne nje absurditet, sikurse do te ishte dhenia e pelqimit nga i denuari per te vuajtur denimin penal ne shtetin e tij, sikurse ne rastin e te denuarit Arben Grori, i cili sic del nga aktet, gjykimi i tij eshte zhvilluar ne mungese, pasi ai i u shmang drejtesise italiane.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte e vleresojne te drejte arsyetimin e prokuroreve si me poshte: “... *ekzekutimi i vendimit penal te huaj eshte nje forme e marredhenieve juridiksionale me shtetet e huaja, qellimi kryesor i te cilit eshte parandalimi i personit te denuar per t'i shpetuar vuajtjes se denimit. Ne rast se do te pranohej pelqimi i te denuarit si kusht per te njohur vendimin penal te huaj, atehere ky vendim do te behej i pazbatueshem dhe do te minohej qellimi kryesor i dispozitave te kreut te K.Pr.Penale te ekzekutimit te vendimeve penale dhe fryma e marredhenieve juridiksionale me shtetet e huaja. I denuari nuk mund te pyetet se a ka deshire te vuaje denimin, por vetem se ku ka deshire ta vuaje ate. Ne te kundert jemi para nje paradoksi, pasi asnje i denuar nuk do te pranonte me deshire qe te shkonte ne burg per te vuajtur denimin, dhe aq me teper denimin me burgim te perjetshem.*

... *shteti italian eshte ne pamundesi te ekzekutimit te vendimit penal objekt njohjeje, pasi i denuari Arben Grori eshte shtetas shqiptar dhe nuk mund te ekstradohet. Ne rast mosnjohjeje te ketij vendimi, atehere ngelet qe Shqiperia te kthehet ne vend te qete e te sigurte per te gjitha te denuarit qe kryejne krime jashte vendit tone dhe qe arrijne te futen serish ne Shqiperi...*”

Dhenia e pelqimit te nje personi te denuar penalisht prej nje gjykate te huaj eshte kusht i domosdoshem vetem per te percaktuar ne se denimi do te kryhet ne shtetin ku eshte kryer krimi, eshte gjykuar ceshtja dhe eshte dhene denimi, apo ne shtetin e origjines se te denuarit, d.m.th. ne burgjet e shtetit shtetas i te cilit ai eshte.

Ky eshte nje parim i njohur dhe i gjitha pranuar ne konventat nderkombetare dhe kjo fryme pershkron kuptimin e permbajtjen e dispozitave perkatese te kodit tone te Procedures Penale ne teresi. Per analogji, kjo linje eshte ndjekur edhe ne nenin 519 te K.Pr.Penale, qe rregullon kushtet e ekzekutimit jashte shtetit te nje vendimi penal te nje gjykate shqiptare.

Nga permbajtja e nenit 519/3 te K.Pr.Penale rezulton se pelqimi i te denuarit nuk eshte i domosdoshem kur “*ekstradimi eshte mohuar ose sidoqofte nuk eshte i mundur*”.

Ndonese kjo dispozite nuk ka lidhje me rastin ne shqyrtim, zgjidhja qe jepet per nje situatë te ngjashme jep nje argument me teper ne favor te perfundimeve te parashtruara me lart.

4. Per sa parashtrohet ne analizat e mesiperme ne teresi *Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arrijne ne perfundimin se nuk verehet ndonje ndeshje (kolizion) midis dispozitave*

perkatese te Kodit te Procedures Penale dhe dispozitave korespondonjese te konventave nderkombetare, megjithese Kushtetuta e Republikes se Shqiperise eshte miratuar e ka hyre ne fuqi me vone se K.Pr.Penale dhe, gjithashtu Konventat Europiane jane nenshkuar e ratifikuar me vone.

Ne parashtrimet dhe konkluzionet e mesiperme Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte jane unanime. Mendimet ndahen per zgjidhjen ne se Gjykata e Larte mundet dhe duhet ta beje vete njohjen e vendimit penal te huaj, apo duhet ta dergoje ceshtjen per rishqyrtim. Shumica eshte e mendimit se duhet te zbatohet opsioni i dyte per dy arsye:

1. Gjykata e Larte nuk mund te zgjeroje juridiksionin e saj fillestar, vec rastit te parashikuar ne nenin 141/1 te Kushtetutes.

2. Gjykata e Larte, po te vendoste vete, do te shkelte parimin e vendosur ne nenin 43 te Kushtetutes, sipas te cilit, "*Kushdo ka te drejte te ankohet kunder nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte, pervecse kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe*".

Vendimi i gjykates se shkalles se pare per njohjen e nje vendimi penal te nje gjykate te huaj mund te ankimohet ne rrugen e zakonshme te ankimit si te gjitha vendimet e tjera.

Ky vendim i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte i jep zgjidhje te plote e perfundimtare problemit qe ***mosdhenia e pelqimit per njohjen e vendimit prej personit te denuar nga nje gjykate e huaj nuk eshte pengese per gjykatën shqiptare per te proceduar per njohjen e ketij vendimi.***

*

*

*

Gjate gjykimit te kesaj ceshtjeje avokatet kane theksuar faktin qe midis shtetit Shqiptar dhe atij Italian nuk eshte lidhur ndonje marreveshje dypaleshe per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, prandaj, sipas tyre, njohja dhe ekzekutimi i nje vendimi penal te nje gjykate italiane do te cenonte sovranitetin e shtetit shqiptar, te cilin e ushtron vetem Kuvendi i Shqiperise, ne rastin konkret nepermjet ratifikimit te nje konvente nderkombetare apo marreveshje dypaleshe. Ky pretendim eshte i gabuar. Parlamenti shqiptar e ka shprehur vullnetin e tij sovran nepermjet miratimit te K.Pr.Penale, dispozitat e te cilit qe kane lidhje me kete ceshtje duhet te zbatohen sipas kuptimit qe ato kane dhe interpretimit te unifikuar te tyre prej Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, te parashtruar me lart.

Duhet te theksojme gjithashtu se ne mungese te instrumenteve juridike te nenshkuara e te ratifikuara, normat pergjithesisht te pranuar te se drejtes nderkombetare mund te zbatohen edhe sipas parimit te vullnetit te mire dhe te reciprocitetit. Marredheniet juridiksionale me autoritetet e huaja, nder to edhe me ato italiane, Kodi i Procedures Penale i a ka ngarkuar Ministrise se Drejtesise.

Sipas nenit 512 te K.Pr.Penale, ne se kjo Ministri do te procedoje apo jo per te kerkuar ne gjykate nepermjet prokurorisë, njohjen ne Shqiperi te nje vendimi penal qe ndodhet ne Shqiperi, kjo eshte ne diskrecionin e plote te saj si shprehje e nje vullneti politik te shtetit shqiptar. Ky lloj diskrecioni nuk mund te vleresohet gjyqesisht. Gjykata ne kete faze ka te drejte te vleresoje vetem ne se kerkesa eshte bere nga organi kompetent sipas ligjit dhe ne se dokumentacioni eshte i plote dhe te kerkoje qe ai te plotesohet sipas ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, mbeshtetur ne nenin 141/2 te Kushtetutes, ne nenin 14, germa "c", te Ligjit nr.8588, date 15.03.2000 "*Per Organizimin dhe Funksionimin e*

Gjykates se Larte te Republikes se Shqiperise”, dhe ne nenin 438 e 441, pika 1, germa “ç”, te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr.384, date 24.07.2002 te Gjykates se Apelit Tirane dhe te vendimit nr.555, date 20.06.2002 te Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, dhe dergimin e ceshtjes per rishqyrtim ne Gjykatën e rrethit gjyqesor Tirane.

Ky vendim per njesimin e praktikës gjyqesore dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 30.01.2003

MENDIM PAKICE

Jemi dakort me mendimin e shumices se anetareve te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, persa i takon trajtimin ne parim te problemit qe shtrohet per unifikim, ne lidhje me njohjen e vendimeve penale te gjykatave te huaja, ne Republiken e Shqiperise, si dhe me perfundimet unifikuese (sentencat) qe u arriten ne kete vendim.

Jemi dakort, gjithashtu, edhe per trajtimin qe i behet, nga shumica, njohjes se vendimit penal te gjykates se pare penale te Apelit te Milanos (Itali), nr.6/01 e nr.39/00, date 02.02.2001, ne ngarkim te te denuarit – shtetas shqiptar, Arben Gropi.

Por, sikurse eshte shprehur edhe ne fund te pjeses arsyetuese te ketij vendimi, ku thuhet se mendimet ndahen per zgjidhjen nese Gjykata e Larte mundet dhe duhet ta beje vete njohjen e vendimit penal te huaj, apo duhet ta dergoje ceshtjen per rishqyrtim, nuk jemi dakort me zgjidhjen qe i ka dhene shumica ketij problemi, duke vendosur dergimin e ceshtjes, per rishqyrtim, Gjykates se shkalles se pare Tirane, per arsytet e meposhtme:

Shumica shprehet se, Gjykata e Larte nuk mund te zgjeroje juridiksionin e saj fillestar, vec rastit te parashikuar ne nenin 141/1 te Kushtetutes, argument qe, per mendimin tone, nuk eshte bindes, pasi nuk gjen mbeshtetje ne dispozitat e K.Pr.Penale ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, si dhe permban nje keqinterpretim te dispozites se referuar te Kushtetutes, nga ana e vete shumices.

Nisur nga kjo e fundit, duhet thene se, ne piken 1, te nenit 141 te Kushtetutes ku percaktohen rastet, ne te cilat Gjykata e Larte ka juridiksion fillestar dhe rishikues, behet fjale per rastet kur Gjykata e Larte gjykon si gjykate e shkalles se pare, ceshtjen penale, ne teresine e saj. Ne rastet e percaktuara, saktesisht, ne kete dispozite Gjykata e Larte gjykon themelin e ceshtjes penale, akuzen, e cila perben objektin e gjykimit te ceshtjes e ku behet fjale per nje kategori te kufizuar personalitetesh dhe funksionaresh te larte sikurse jane: Presidenti i Republikes, Kryetari dhe anetaret e Keshillit te Ministrave, deputetet, gjyqtaret e Gjykates Kushtetuese dhe gjyqtaret e Gjykates se Larte.

Kurse per themelin ne rastin e ceshtjes, objekt shqyrtimi ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, jane shprehur instancat gjyqesore te Republikes Italiane, sikurse jane: Gjykata e peste penale e Milanos, vendimi i se ciles eshte konfirmuar me vendimin nr.6/01 dhe nr.39/00 Regj. Pergj. te Apelit te Milanos dhe Gjykata e Kasacionit te Italise.

Keshtu qe kerkuesit Arben Gropi, megjithese ne mungese, (me deshiren e tij, per t'iu shmangur drejtesise), i jane krijuar te gjitha mundesite ligjore per te ushtruar te drejten e tij te mbrojtjes, mundesi, te cilat ai edhe i ka shfrytëzuar efektivisht nepermjet ankimit te vendimit te denimit me burgim te perjetshem, ne ngarkim te tij, ne instancat perkatese gjyqesore te shtetit italian, gjersa vendimi mori forme te prere dhe, pas kesaj, organet e ngarkuara me ekzekutimin e tij te mund ta vinin ate ne ekzekutim.

Mirepo, ky vendim nuk u arrit qe te vihet ne ekzekutim ne Itali, pasi kerkuesi ndodhej ne Shqiperi dhe pikerisht kjo qe edhe arsyeja, qe, duke zbatuar kerkesat e ligjit, u kerkua njohja e ketij vendimi nga gjykata shqiptare.

Dihet se, gjykimi i zhvilluar nga gjykatat shqiptare per njohjen e nje vendimi penal te huaj nuk ka te beje me objektin e gjykimit qe eshte zhvilluar nga gjykata e huaj, ne kuptimin qe nuk ka te beje me themelin e ceshtjes per te cilen i gjykuari eshte deklaruar fajtor dhe denuar nga ajo gjykate (gjykata e huaj). Keshtu qe edhe vendimi per njohjen e vendimit te gjykates se huaj, kur plotesohen urdherimet e dispozitave te neneve 512 e 514 te K.Pr.Penale, marre nga gjykatat shqiptare nuk eshte vendim i ri, por ka karakterin e nje vendimi deklarativ, ne kuptimin qe shprehet nese e njej ose jo vendimin penal te gjykates se huaj.

Ne rastin kur vendoset pozitivisht, d.m.th. ne favor te kerkeses se prokurorit per njohjen e vendimit penal te huaj, mbaron faza e pare e ketij gjykimi. Ne fazen e dyte, sipas urdherimeve te

dispozites se nenit 516 te K.Pr.Penale, gjykata cakton denimin qe duhet te vuhet nga i gjykuari ne shtetin shqiptar, duke bere konvertimin e denimit te dhene per te nga gjykata e huaj ne nje nga denimet e parashikuara per te njejtin fakt nga ligji shqiptar, denim qe, nga natyra e tij, duhet t'i pergjigjet atij qe eshte dhene ne vendimin e huaj, me kusht qe masa e denimit te mos kaloje kufirin maksimal, te parashikuar per te njejtin fakt, nga ligji shqiptar. Keto urdherime, sikurse shihet nga natyra dhe permbajtja e tyre, kane karakter tekniko-ligjor, madje, do te thoshim, me teper teknik, gje qe na bind ne per te mos u pajtuar me shumicen per menyren perfundimtare te zgjidhjes se ceshtjes ne ngarkim te kerkuesit, duke e derguar ate ne gjykatën e shkalles se pare, ne nje kohe kur, perderisa u pranua se ekzistojne kushtet e njohjes se vendimit penal te huaj, konvertimi i denimit, sipas urdherimeve te dispozites se nenit 516 te K.Pr.Penale, nuk ka pengese ligjore qe te behej nga vete Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte. Perkundrazi, zgjidhja perfundimisht e ceshtjes nga keto kolegje do te evitonte zvarritjen e ceshtjes, pa cenuar te drejtat kushtetuese te kerkuesit, te cilat, sikurse u tha, jane realizuar qe ne gjykimin ne themel te ceshtjes ne ngarkim te tij.

Vladimir Metani

Spiro Spiro

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me çështjen penale Prokuroria e Pergjithshme, per njohje vendimi penal ne ngarkim te shtetasit Arben Grori.

Kam mendimin se kerkesa e organit te Prokurorise eshte ne kundërshtim me parimet themelore kushtetuese te nje shteti dhe kryesisht me parimin e sovranitetit te shtetit.

Ne baze te nenit 2 te Kushtetutes, sovraniteti i takon popullit, i cili e ushtron kete nepermjet perfaqesuesve te tij.

Ne rastin qe paraqitet, sovraniteti i shtetit tone cenohet, pasi ai detyrohet te kryeje nje veprim te cilin nuk ja ka autorizuar sovrani i tij dhe qe cenon interesat dhe te drejtat e shtetasit te tij.

Po ashtu edhe e drejta ka sovranitetin e saj dhe ajo zbatohet ne kufijte e shtetit te saj. Asnje organ i huaj, qofte edhe i drejtesise nuk mundet te veproje ne shtetin tone nese nuk ka shfaqje te vullnetit nga organi perfaqesues, d.m.th. nese nuk ka nje marreveshje nderkombetare, multi ose bilaterale.

Nese interesat jane te tilla qe duhet te kryhet nje veprim, atehere duhet te gjendet rruga e ligjshme per kryerjen e atij veprimi, pra qeverite e te dy shteteve te lidhin marreveshjet perkatese qe t'i hapin rruge realizimit te veprimtarise se organeve te tjera.

Kjo praktike eshte e njohur jo vetem ne shkalle boterore, por edhe ne marredheniet e shtetit tone me vende te tjera. Si shembull per kete marrim marreveshjet e ndryshme te lidhura me shtetin grek.

Ne rrethanat e mesiperme, çmoj se gjykimi i çështjes duhet te pushohet, persa kohe nuk ka marreveshje dy ose shumepaleshe.

Agron Lamaj

Nr.6 i Regj. Themeltar.
Nr.4 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Agron Lamaj	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Artan Hoxha	Anetar
Metush Saraçi	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Evgjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare

ne seancen gjyqesore te dates 10.10.2002 dhe 14.10.2002 moren ne shqyrtim ceshtjen penale nr. 6
qe i perket:

TË PANDEHURIT : PELLUMB DYRMISHI, i biri Selimit dhe Aishes,
i datelindjes 1965, lindur ne Cerrik Elbasan dhe
banues ne lagjen Nr.13 Durres.

A K U Z U A R:

Per kryerjen e vepres penale
te vrasjes me dashje ne bashkepunim,
parashikuar nga nenet 76 e 25 te K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, me vendim nr. 95 date 13.9.2000, ka vendosur :

“Deklarimin fajtor te te pandehurit Pellumb Dyrmishi per kryerjen e vepres penale te
vrasjes me dashje ne bashkepunim ne dem te shtetasit Gentian Popa, parashikuar nga
nenet 76 e 25 te Kodit Penal e po ne baze te ketyre neneve e denon ate me 13 vjet
burgim.

Vuajtja e denimit fillon nga data 7.10.1999, qe eshte data e ndalimit te tij”.

Gjykata e Apelit Durres, mbi apelin e te pandehurit, me vendim nr. 230 date 8.11.2000, ka
vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 95 date 13.9.2000 te Gjykates se Rrethit Elbasan dhe pushimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Pellumb Dyrmishi, per akuzen e vrasjes ndaj shtetasit Gentian Popa”.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Durres dhe vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, ka paraqitur rekurs, ne baze te nenit 432 te K.Pr.Penale, Prokurori i Pergjithshem i Republikes, i cili kerkon prishjen e tyre dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim, duke parashtruar keto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave jane te pabazuara ne ligj dhe ne prova, pasi:
- 1. Jane kryer veprime hetimore nga oficeret e policise gjyqesore pa urdher delegimi, sipas kritereve te nenit 304/2 te K.Pr.Penale.
- 2. Eshte pushuar akuza ne ngarkim te te pandehurit Genci Duzha, kur ndaj tij nuk ishte ngritur akuze.
- 3. Jane kryer veprime hetimore jashte afatit ligjor dhe sipas kritereve te nenit 324/4 dhe 128/2 te K.Pr.Penale ato jane absolutisht te pavlefshme dhe nuk mund te perdoren.
- Nga ana e Gjykates se Apelit Durres eshte gabuar ne menyren e argumentimit te pushimit te ceshtjes se, Prokurori i Pergjithshem i Republikes nuk e ka patur te drejten e shfuqizimit te vendimit te pushimit dhe, meqenese, per keto raste, jane mbajtur qendrimet te ndryshme, Gjykata e Larte duhet te unifikojte praktiken lidhur me vendimet e shfuqizuara nga Prokurori i Pergjithshem i Republikes, sipas kritereve te nenit 141/2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

Kryetari i Gjykates se Larte, me vendim date 15.5.2002, ka vendosur:

“Terheqjen nga Kolegji Penal te ceshtjes penale me nr. akti 374, date 18.4.2002, qe i perket te pandehurit Pellumb Dyrmishi dhe kalimin e saj per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte”, me arsyetimin “per te sheshuar kundertite e lindura ndermjet vendimeve te kolegjeve te vecanta” dhe pikerisht me interpretimet e bera nga ato lidhur me nenin 24/4 te K.Pr.Penale - “Funkcionet e prokurorit”.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga anetaret Kristaq Ngjela dhe

Ylvi Myrtja, prokurorin Saliko Hajno, qe kerkoj prishjen e vendimit te Gjykates se Apelit Durres e te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan e dergimin e ceshtjes per rishqyrtim gjykates se rrethit e si analizuan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N E

I pandehuri Pellumb Dyrmishi eshte derguar per gjykim per akuzen e vepres penale te vrasjes me dashje te kryer ne bashkepunim parashikuar nga neni 76 e 25 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, pasi ka administruar provat ne gjykimin e ceshtjes, ka arritur ne perfundimin se Pellumb Dyrmishi, e ka kryer vepren per te cilen akuzohet dhe me vendimin nr. 95 date 13.9.2000, ka vendosur deklarimin e tij fajtor per vrasjen me dashje te viktimes Gentjan Popa ne bashkepunim dhe denimin me 13 (trembedhete) vjet burgim.

Ne vendimin e marre, ajo gjykate pranon se:

I pandehuri Pellumb Dyrmishi ka emigruar ne Greqi bashke me familjen, vellane Kujtim, Myrteza (Zani) Caushi, Genc Duzho, Arben Eqimi, etj. ku me pas ka shkuar edhe viktimja Gentjan Popa. Ky i fundit, me daten 8.2.1995, eshte gjetur i djegur ne Pire, gje qe eshte percaktuar se kufoma ishte e tij ne baze te analizave te ADN-se. Duke analizuar provat e marra, gjykata e rrethit

ka arritur ne perfundimin se vrasjen e Gentjan Popes e ka kryer i pandehuri Pellumb Dyrmishi per shkak te nje grindje qe kishte patur me te me daten 5.2.1995 ne bashkepunim me shtetasin Genci Duzho.

Gjykata e Apelit Durres, me vendimin nr. 230 date 8.11.2000 ka vendosur prishjen e vendimit te Gjykates se Rrethit Elbasan dhe pushimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Pellumb Dyrmishi per akuzen e vrasjes se shtetasit Gentjan Popa. Vendimin e saj kjo gjykate e mbeshtet ne faktin se, me vendim te prokurorit date 25.4.1997, eshte pushuar ceshtja penale ne ngarkim te te pandehurit Pellumb Dyrmishi per mungese provash dhe se me urdherin nr. 17 date 1.3.1999, Prokurori i Pergjithshem ka anuluar vendimin e pushimit, veprim ky qe (sipas vendimit te gjykates se apelit) eshte i pabazuar ne ligj pasi Prokurori i Pergjithshem nuk e ka patur te drejten e shfuqizimit te vendimeve e se vendimi i pushimit, mund te shfuqizohet vetem nga gjykata e shkalles se pare ne perputhje me kerkesat e nenit 329 te K.Pr.Penale (ankimi kunder vendimit te pushimit te ceshtjes).

Per te mbeshtetur vendimin e saj, Gjykata e Apelit Durres permend edhe qendrimin e mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr. 270 date 4.9.2000. Ne kete vendim te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte eshte pranuar se, vendimi i marre nga nje prokuror prane Prokurorise se Pergjithshme per shfuqizimin e vendimit te pushimit te ceshtjes marre nga prokurori, ishte ne kundershtrim me kerkesat ligjore, se ai vendim nuk mund te sjelle pasoja juridike pasi prokurori prane Prokurorise se Pergjithshme, nuk kishte te drejten e shfuqizimit te vendimit te pushimit te ceshtjes sepse sipas nenit 24/4 te K.Pr.Penale “urdherat dhe udhezimet e prokurorit me te larte jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet” e per pasoje, prokurori me i larte, nuk ka te drejte te marre vendime por vepron ne realizim te funksioneve te tij vetem me urdhera dhe udhezime.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte e shohin te arsyeshme, qe problemet qe trajtohen ne vendimin e Gjykates se Apelit Durres e ne rekursin e Prokurorit te Pergjithshem te trajtohen hollesisht per te unifikuar praktiken gjyqesore lidhur me zbatimin e nenit 24/4 te K.Pr.Penale e per te menjanuar qendrimet e ndryshme qe jane per kuptimin e zbatimin e atij neni para shteses se bere ne piken 5 me ligjin nr. 8460 date 11.2.1992 sipas te cilit “Prokurori me i larte ka te drejte te vendose ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokurori me i ulet”. Verehet se ne praktiken e gjykatave te rretheve, apeleve dhe te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte ka qendrimet e ndryshme ne keto drejtime:

- a. si duhet kuptuar e drejta e prokurorit parashikuar ne piken 4 te nenit 24 te K.Pr.Penale. Me leshimin e urdherave dhe udhezimeve a ka te drejte prokurori me i larte te vendose per shfuqizimin e vendimeve te prokurorit me te ulet dhe
- b. si duhet kuptuar ne veprimtarine praktike percaktimi qe behet ne piken 4 e 5 te nenit 24 te K.Pr.Penale “prokurori me i larte”.

Ne praktiken gjyqesore ka mjaft vendime qe lidhen me problemet e siperme dhe ne disa raste eshte pranuar se prokurori me i larte ka te drejte te vendose per shfuqizimin e vendimeve te prokurorit me te ulet, ne disa raste se nuk ka kete te drejte si dhe ka patur diskutime e mendime te ndryshme se c’duhet kuptuar me prokuror me i larte dhe ne se te drejten e shfuqizimit e ka Prokurori i Pergjithshem apo edhe prokuroret e tjere prane Prokurorise se Pergjithshme.

Edhe ne vendimet e Kolegjit Penal te Gjykates se Larte verehen qendrimet me te cilat eshte pranuar i ligjshem shfuqizimi i vendimeve ne baze te nenit 24/4 te K.Pr.Penale (permendim ketu vendimet nr. 238 date 11.7.2000, nr. 669 date 21.11.2001) apo vendime qe nuk pranojne veprimin e mesiperme te prokurorit (si vendimi nr. 259 date 29.6.1999, nr. 518 date 3.10.2001 etj.). Ndersa lidhur me prokurorin me te larte, ky kolegj, ka pranuar gjithmone se si i tille do te pranohet vetem Prokurori i Pergjithshem apo prokurore te autorizuar prej tij, pavaresisht nga praktikat e gjykatave te rretheve e apeleve.

Per qendrimin qe duhet mbajtur per problemet e siperme eshte e nevojshme qe t'i referohemi Kushtetutes se Republikes se Shqiperise. Ne baze te nenit 148 te se ciles "Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe perfaqeson akuzen ne gjyq... Prokuroret jane te organizuar dhe funksionojne prane sistemit gjyqesor si nje organ i centralizuar"; nenit 24 te K.Pr.Penale sipas te cilit "Prokurori ushtron ndjekjen penale, ben hetime, kontrollon hetimin paraprak, ngre akuze ne gjykate dhe merr masa per ekzekutimin e vendimeve ne perputhje me rregullat e caktuara ne kete kod"; si dhe ligjit nr. 8737 date 12.2.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republikën e Shqiperise" ku pervec objektit te veprimtarise se Prokurorise eshte percaktuar struktura e funksionet kryesore dhe struktura e saj prane sistemit gjyqesor.

Funksionet e prokurorit, ushtrohen ne baze te kompetences lendore e territoriale te gjykates prane se ciles ai vepron dhe kjo eshte shprehur edhe ne K.Pr.Penale, i cili konkretizon si organizimin e prokurorise ne te gjitha nivelet ashtu edhe marredheniet e vartesisë midis tyre. Ne baze te dispozitave te lartpermendura, ne K.Pr.Penale jane detajuar funksionet e prokurorit ne nenin 24, ne piken 4 te te cilit percaktohet se "urdherat e udhezimet e prokurorit me te larte jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet".

Ne Kodin e Procedures Penale, (neni 328) parashikohen rastet kur prokurori vendos pushimin e ceshtjes penale, por eshte e kuptueshme qe keto vendime nuk mund te qendrojne larg kontrollit te prokurorit me te larte. Problemi shtrohet lidhur me termat qe perdoren ne nenin 24/4 te K.Pr.Penale, per mjetin qe perdor prokurori me i larte per te rivene ne levizje nje ceshtje penale te pushuar ne kundersizim me kerkesat ligjore. Kjo perben anen formale te ceshtjes ne se do te vepohet me urdher apo vendim dhe nuk ka te beje me themelin. (Ketu duhet permendur fakti se me shtesen e pikes 5 te nenit 24 u qartesua ky problem duke u shprehur "prokurori me i larte, ka te drejte te vendose..."). Termat urdher, udhezim, vendim, jane te ndryshme e s'ka precizim te tyre, por gjithashtu ne K.Pr.Penale nuk ka te percaktuara rastet se cilat veprime te prokurorit realizohen me urdher, cilat me udhezim e cilat me vendim. Por ne se i referohemi nenit 305 te K.Pr.Penale, ndeshemi ne nje kuptim qe duhet pranuar edhe per problemin ne shqyrtim. Ne kete nen thuhet "Prokurori i Pergjithshem, mbi ankesen e te pandehurit, te demtuarit ose edhe kryesisht, urdheron, me vendim te arsyetuar..." dhe duke ju referuar pikave 4 e 5 te nenit 24 te K.Pr.Penale, nuk mund te pranohet se ka inkoseguenca ne ligj. Prokurori me i larte ushtron ne cdo kohe kontroll mbi veprimtarine e prokuroreve te tjere (me te ulet) e per rrjedhoje, ne rast se konstaton nje vendim te pushimit te ceshtjes penale te marre ne kundersizim me kerkesat ligjore, ka te drejte te vendose per shfuqizimin e tij. Prokurori me i larte, ne zbatim te kompetences qe i jep neni 24/4 qe urdherat dhe udhezimet e tij jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet, disponon mbi aktet e ketij te fundit gje qe behet me nje akt procedural e nuk mund te pranohet se behet verbalisht. Ne kete aspekt, vendimi i prokurorit me te larte per shfuqizimin e nje vendimi te marre nga nje prokuror tjetër per pushimin e ceshtjes penale, perben ne vetvete nje urdher ne zbatim te nenit 24/4 te K.Pr.Penale.

Nga sa me siper, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, arrijne ne perfundimin se **veprimtaria e Prokurorit te Pergjithshem per shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokuroret e tjere, qofte edhe per pushimin e ceshtjes penale, eshte e ligjshme e ne ushtrim te kompetences qe i jep K.Pr.Penale.** Ne keto rrethana, konkluzioni i arritur nga Gjykata e Apelit Durres se Prokurori i Pergjithshem ka vendosur per rastin ne shqyrtim ne kundersizim me kerkesat e ligjit duke shfuqizuar vendimin e pushimit e se ai nuk mund te sjelle pasoja juridike, eshte i gabuar.

I pabazuar ne ligj, eshte edhe perfundimi tjetër i Gjykates se Apelit Durres se vendimi i pushimit te ceshtjes penale mund te shfuqizohet vetem nga gjykata e shkalles se pare ne zbatim te kerkesave te nenit 329 te K.Pr.Penale. Sipas ketij neni "kunder vendimit te pushimit te ceshtjes mund te bejne ankim ne gjykatën e rrethit i demtuari dhe i pandehuri". Sikurse shihet ne kete nen

nuk i njihet e drejta prokurorit per te bere ankim kunder vendimit te pushimit te ceshtjes penale pasi prokurori me i larte nuk e con ceshtjen ne gjykate sepse kjo ka te beje me atributet e tij dhe e zgjidh vete nepermjet reagimit qe ben. Ne se do te pranohej e kunderta, atehere do te cenohej parimi i barazise se paleve ne procesin penal duke i mohuar prokurorit nje te drejte qe i njihet te pandehurit.

Duke patur parasysh realizimin e kompetencave te tij dhe mjetet qe duhet te perdore, Prokurori i Pergjithshem, me daten 1.3.1999, me urdherin nr.17, ka urdheruar anullimin e vendimit te pushimit te ceshtjes ne ngarkim te te pandehurve Pellumb Dyrmishi e Genci Duzha dhe vazhdimin e metejshem te hetimeve, akt ky i ligjshem e ne perputhje me nenin 24/4 te K.Pr.Penale vleresim ky qe e ben te cenueshem vendimin e Gjykates se Apelit Dures.

Megjithese shitesa e pikes 5 te nenit 24 te K.Pr.Penale e qartesoje me tej te drejten e prokurorit me te larte qe te vendose per ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokurori me i ulet, duhet pranuar se ne thelb kjo nuk solli ndryshime ne kompetencat e prokurorit e nuk mund te mbahet qendrim i kundert per piken 4 te nenit 24 te K.Pr.Penale nga ajo e percaktuar ne piken 5.

Problemi se kush duhet konsideruar prokuror me i larte gjen zgjidhje gjithashtu duke ju referuar dispozitave kushtetuese, te K.Pr.Penale e ligjit "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise".

Sipas nenit 148/2 te Kushtetutes se Republikes te Shqiperise "prokuroret jane te organizuar dhe funksionojne prane sistemit gjyqesor si nje organ i centralizuar". Ndersa ne nenet 13, 14, 15 te ligjit nr. 8737 date 12.2.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republikene e Shqiperise" percaktohet struktura e prokurorise prane sistemit gjyqesor ne prokurore prane Gjykates se Larte, funksione qe ushtrohen nga prokuroret e Prokurorise se Pergjithshme, prokurore prane gjykatave te apelit, funksione qe ushtrohen nga prokuroret e apelit dhe funksionet e prokurorise prane cdo gjykate te shkalles se pare ushtrohen nga prokuroret e shkalles se pare.

Edhe ne K.Pr. Penale jepen percaktimet per ushttrimin e funksioneve te prokurorit duke u shprehur se ne hetimet paraprake dhe ne gjykimet e shkalles se pare ato ushtrohen nga prokuroret prane gjykates se shkalles se pare, ne gjykimin e ceshtjeve te ankimuar, nga prokuroret prane gjykatave te apelit dhe prane Gjykates se Larte (neni 25 germat "a", "b"). Ne piken 2 te ketij neni thuhet: "Prokurori me i larte ka te drejte te ushtroje kompetencat e prokurorit me te ulet".

Ne kuptim te percaktimeve te dhena, duke patur parasysh se prokuroria eshte organ i centralizuar, ne prokurorite prane gjykatave te shkalles se pare prokuror me i larte, eshte prokurori i rrethit. Prokurori prane gjykates se apelit eshte prokuror me i larte ne raport me ate prane gjykates se rrethit gjyqesor vetem persa i perket gjykimit te ceshtjeve. Jo pa qellim ligjvenesit prokurorine e ka organizuar prane gjykatave duke percaktuar dhe funksionet e tyre. Me fjale te tjera, prokurori prane gjykates se apelit eshte prokuror me i larte ne kuptim te pozites dhe qendrimin qe mban lidhur me gjykimin e ceshtjeve penale ne raport me ate qe ka mbajtur prokuroria prane gjykates se rrethit gjyqesor. Nga ana tjeter kjo nuk i jep atij kompetenca apo autoritetin me te larte gjate fazes se hetimit paraprak dhe gjate gjykimit te ceshtjes ne Gjykatene e rrethit gjyqesor. Prokuror me i larte edhe ne rastet e shfuqizimit ose ndryshimit te vendimeve te pushimit te ceshtjeve penale (jo per rastet kur prokurori i rrethit realizon kete funksion) eshte Prokurori i Pergjithshem. Per pasoje edhe **te drejten e shfuqizimit apo ndryshimit te vendimeve te pushimit te ceshtjes penale ne zbatim te nenit 24 te K.Pr.Penale e ka vetem Prokurori i Pergjithshem. Prokuroret e tjere, pra edhe ata prane Prokurorise se Pergjithshme, mund te marrin vendime per ndryshimin apo shfuqizimin e vendimit te pushimit te ceshtjes penale vetem me autorizim te posacem te Prokurorit te Pergjithshem.** Ne se ato vendime merren apo jane marre pa nje autorizim te tille, nuk mund te sjellin asnje pasoje pasi jane marre ne

kundershtim me ligjin. Menyra se si do te funksionojë dhënia e autorizimeve, është problem që zgjidhet nga Prokurori i Përgjithshëm.

Ne çështjen objekt gjykimi në ngarkim të të pandehurit Pellumb Dyrmishi, Prokurori i Përgjithshëm, duke shfuqizuar vendimin e pushimit të çështjes në bazë të nenit 24/4, ka zbatuar drejt ligjin e për pasoje arsyetimet e bera nga Gjykata e Apelit Durrës që e kanë çuar atë në marrjen e vendimit për pushimin e çështjes janë të gabuara e të pabazuara në ligj, prandaj vendimi i marrë prej saj duhet të priset e çështja të kthehet për rigjykim.

Duke patur parasysh se Gjykata e Apelit Durrës nuk ka zhvilluar gjykim të plote të çështjes, por ka prishur vendimin e gjykates së rrethit dhe ka vendosur pushimin e çështjes në bazë të nenit 428/I/c të K.Pr.Penale duke pranuar se janë rastet që nuk lejojnë vazhdimin e procedimit, kjo çështje i duhet dërguar për rishqyrtim Gjykates së Apelit Durrës.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykates së Lartë, në bazë të nenit 441/ç të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr. 230 datë 8.11.2000 të Gjykates së Apelit Durrës dhe kthimin e akteve për rishqyrtim po asaj gjykate me tjetër trup gjykues.

Ky vendim për njesimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 14.10.2002

MENDIM I PAKICËS

Mendimi i pakicës është se vendimi nr.230, datë 08.11.2000 i Gjykates së Apelit Durrës, është rrjedhojë e zbatimit dhe respektimit të ligjes. Për rrjedhojë, në përputhje me kërkesat e nenit 441, germa «a» të K.Pr.Penale, ai duhet të lihet në fuqi.

Është vertetuar se i pandehuri Pellumb Dyrmishi para vitit 1995, ka shkuar si emigrant në shtetin Grek, ku nderkohe ka emigruar edhe viktima Gentian Popa. Ky i fundit rezultoi të jetë gjetur i vdekur (djegur) në zonën e Pireut, në datën 8 shkurt 1995.

Prokuroria pranë Gjykates së Shkallës së Parë Elbasan, mbasi ka zhvilluar hetimet paraprake rreth çështjes, në datën 25.04.1997, ka vendosur pushimin e çështjes për mungesë

provash. Me pas, me Urdherin nr.17, date 01 mars 1999, Prokurori i Pergjithshem, ka shfuqizuar kete vendim dhe ne perfundim te hetimit, ceshtja ka kaluar per gjykim.

Gjykata e Shkalles se Pare Elbasan, mbasi ka zhvilluar gjykimin e ceshtjes, me vendimin e saj nr.95, date 13.09.2000, ka konkluduar duke deklaruar fajtor te pandehurin Pellumb Dyrmishi.

Ne te kundert, Gjykata e Apelit Durres, me vendimin nr.230, date 08 nentor 2000, konkludon per prishje te vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe pushimin e ceshtjes. Arsyetimi i vendimit, ne vija te pergjithshme, mbeshtetet ne mospasjen e te drejtes se Prokurorit te Pergjithshem, per te shfuqizuar nje vendim pushimi te ceshtjes marre nga prokurori para gjykates se shkalles se pare. Me fjale te tjera, kerkesat e nenit 24/4 te K.Pr.Penale nuk e justifikojne nje te drejte te tille (behet fjale per periudhen para ndryshimit te kesaj dispozite).

Duke e pare ne teresine e tij vendimin e Gjykates se Apelit Durres, arrihet ne perfundimin se ai eshte i drejte, objektiv dhe ne perputhje te plote me kerkesat ligjore.

Se pari, prokuroria prane Gjykates se shkalles se pare Elbasan, mbasi ka zhvilluar hetimet, te cilat ajo i ka konsideruar si te nevojshme, ka vendosur ne daten 25 prill 1997, pushimin e ceshtjes penale. Ne kete vendim ajo nder te tjera ka arsyetuar, se nuk ka prova te mjaftueshme qe te vertetohet se i pandehuri ka kryer vepren penale per te cilen akuzohet.

Duke vepruar ne kundershtrim me kerkesat ligjore, Prokurori i Pergjithshem, me urdherin date 01.03.1999, ka anuluar vendimin e siperpermendur te pushimit te ceshtjes. Nje vendim i tille nuk sjell dhe nuk mund te sjelle pasoja juridike, pra per rrjedhoje nuk mund te shfuqizojte vendimin e pushimit te marre nga prokurori prane gjykates se Shkalles se Pare Elbasan date 25.04.1997, sepse:

- Vendimi i pushimit te ceshtjes penale, eshte marre duke respektuar kerkesat procedurale te parashikuara nga neni 328 i Kodit te Procedures Penale.

- Vendimi ne fjale, ne perputhje me kerkesat e parashikuara nga neni 329 i Kodit te Procedures Penale, mund te shfuqizohet vetem nga ana e gjykates se shkalles se pare, ne rast se ndaj tij eshte ushtruar ankim nga ana e personave qe u eshte dhene kjo e drejte.

Prokurori i Pergjithshem, duke marre vendimin per shfuqizimin, nga ana tjeter nuk mund te «arsyetoje» se mbeshtetet edhe ne Ligjin nr.8460, date 11.02.1999 «Per disa shtesa ne Ligjin nr.7905, date 21.03.1995 «Per Kodin e Procedures Penale». Sipas ketij Ligji, ne nenin «24», pas pikes «4» shtohet pika «5», me kete permbajtje: **Prokurori me i larte ka te drejte te vendose ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve te marra nga prokurori me i ulet.**

Ligji ne fjale ka hyre ne fuqi me date 27 mars 1999, pra pas dy vjetesh nga marrja e vendimit te pushimit te ceshtjes dhe 26 ditesh nga nxjerrja e Urdherit per shfuqizimin e atij vendimi. Ne kete ligj, nuk behet fjale per «fuqi prapavepruese». Ne keto kushte ky ligj nuk mund te shtrihe efektet e tij per veprime apo akte te realizuara para hyrjes se tij ne fuqi. Me fjale te tjera, konkludohet se ligji vepron per periudhen pas hyrjes se tij ne fuqi, me perjashtim te rasteve kur ai shprehet ndryshe.

Se dyti, vendimi i Gjykates se Apelit Durres eshte i drejte, duke e pare ceshtjen edhe ne nje kendveshtrim tjeter. Keshtu sipas kerkesave te nenit 24 pika 4 te Kodit te Procedures Penale, kemi: «**Urdherat dhe udhezimet e prokurorit me te larte jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet**». Edhe ne kete rast, Prokurori i Pergjithshem nuk mund te marre nje **vendim** shfuqizim kunder vendimit te pushimit te ceshtjes penale, marre nga ana e prokurorit prane gjykates se shkalles se pare. Duke e pare me kujdes kete dispozite, pakica arrin ne perfundimin, se behet fjale per **urdhera** dhe **udhezime**, te cilat jepen ne nje faze te caktuar qe ka te beje vetem me hetimet paraprake. Pra brenda per brenda nje hetimi te caktuar, i cili ende nuk ka perfunduar. Ne rastin konkret, kemi te bejme me nje **Vendim pushimi** te ceshtjes penale, i cili eshte perfunduar. Duke patur parasysh ceshtjen konkrete dhe analizen si me siper, kete vendim pushimi te ceshtjes penale,

mund ta godase vetem vendimi i gjykates se shkalles se pare, pas realizimit te te drejtes se ankimit, sipas kerkesave te nenit 329 te K.Procedures Penale.

Nga ana tjeter, vete dispozita (neni 24/4 i K.P.P.) nuk ben fjale per **Vendime** te prokurorit me te larte, por vetem per **Urdhera** dhe **Udhezime**. Kjo nga njera ane. Nga ana tjeter, gje qe perben edhe nje argument me shume ne arrijten e perfundimit si me siper, eshte edhe fakti i miratimit te ligjit te cituar «Per disa shtesa ne ligjin nr.7905, date 21.03.1995». Ishte pikerisht boshlleku ligjor qe shihej ne kerkesat e nenit 24 te Kodit te Procedures Penale, qe beri rregullimin me ligj te te drejtes se prokurorit me te larte, per te ndryshuar ose shfuqizuar vendimet e prokurorit me te ulet, kur e shihte te arsyeshme. Me fjale te tjera, ky rregullim ligjor, verteton pikerisht faktin e mospasjes se kesaj te drejte me dispozitat e Kodit te Procedures Penale, para ndryshimit ne fjale.

Nga sa u tha dhe analizua pakica arrin ne perfundimin se vendimi i Gjykates se Apelit Durres, duhet te lihet ne fuqi si i mbeshtetur plotesisht ne ligj.

Zamir Poda

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Metush Saraçi	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Nikoleta Kita	Anetare
Artan Hoxha	Anetar
Irma Bala	Anetare
Evgjeni Sinoimeri	Anetare

ne seancat gjyqesore te dates 28.05.2002 dhe te dates 14.10.2002, me pjesemarrjen e prokurorit Arqile Lole dhe te avokatit mbrojtes te te pandehurit av.Shuaip Syri, moren ne shqyrtim ceshtjen penale me pale:

TË PANDEHURIT: GEZIM TAFI, i biri i Rizait, i datelindjes 1969, banues ne Berat.

A K U Z U A R:

Per krimin e vrasjes me dashje,
parashikuar nga neni 76 i K.Penal.

Me vendimin nr. 12, date 19.06.1996, te Gjykates se Rrethit Kolonje, eshte vendosur:
Deklarimi fajtor i te pandehurit Gezim Tafi, per krimin e vrasjes me dashje, parachikuar nga neni 76 i K.Penal dhe denimin e tij me 12 (dymbedhete) vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.610, date 16.08.1996, vendosi:
Lenien ne fuqi te vendimit te mesiperme.

Me vendimin nr. 1, date 29.10.2001, te Gjykates te rrethit Kolonje, eshte vendosur:

Rivendosja ne afat e te pandehurit per te bere rekurs ne Gjykatën e Lartë, rekurs i cili u paraqit me 10.11.2001.

Ne rekurs kerkohet prishja e vendimit nr.12, date 19.06.1996, i Gjykates se rrethit Kolonje dhe pushim i ceshtjes penale, duke parashtruar shkaqet e meposhtme:

- I pandehuri ka qene duke kryer sherbimin e detyrueshem ushtarak ne kufi, me detyre komandant skuadre. Ne oren 04³⁰ te dates 10.06.1990, u dha suate per shkelje kufiri dhe pasi u ngrit nga gjumi, per shkak te kesaj suate, ne zbatim te detyres per bllokimin e kufirit, diktoi nje person qe po vraponte ne drejtim te kufirit, te cilit i beri ndaljen, por meqenese nuk ndaloi, qelloi ne ajer, duke e paralajmeruar edhe me fjale: ndalo se do te qelloj dhe kur shkelesi i kufirit u sul me thike ne dore ne drejtim te tij, i pandehuri qelloi me bresheri dhe e la te vrare.
- Ne keto rrethana, vepra duhej te ishte cilesuar si shkelje e rregullave te sherbimit te rojes ne ruajtjen e kufijve te shtetit, parashikuar nga neni 146 i K.Penal te meparshem.
- Eshte shkelur neni 432/b i K.Pr.Penale, pasi i pandehuri, duke qene ushtarak, eshte gjykuar nga nje gjykatë civile.
- Vendimi i gjykates eshte jo llogjik, pasi nga njera ane, pranohet se vepra eshte kryer gjate kohes qe i pandehuri ka qene ne sherbim ne ruajtje te kufirit, nga ana tjeter, deklarohet fajtor per krimin e vrasjes.
- Duke u cilesuar vepra si shkelje e rregullave te sherbimit te rojes ne ruajtje te kufirit, ceshtja penale duhet te pushohet, ne baze te ligjit nr.8202, date 27.03.1997 "Per Amnistine".

Kolegji Penal i Gjykates se Lartë me vendimin nr.194, date 21.03.2002 ka vendosur dergimin e kesaj ceshtjeje per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara per te bere njesimin e praktikës gjyqesore.

Ne vendimin e mesiperme Kolegji Penal, nder te tjera shprehet se:

"... Ndodhur para ketyre rrethanave, d.m.th. para faktit qe, jo vetem rekursi, por edhe kerkesa per rivendosje ne afat per paraqitjen e tij ne Gjykatën e Lartë, jane bere nga avokati Shuaip Syri, i pajisur me prokure te posacme, leshuar jo nga vete i gjykuari, por nga i ati, i quajtur Riza Tafa; si dhe para faktit qe nga ana e Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Lartë, ne vendimet, nr.47, date 28.01.1999 dhe nr.386, date 29.07.1999, ashtu sikurse eshte konstatuar edhe ne vendimin nr.17, date 17.04.2000 te Gjykates Kushtetuese, nuk eshte mbajtur qendrim i njellojte edhe ne lidhje me legjitimimin e mbrojtësit per te kerkuar rivendosjen ne afat per paraqitjen e ankimit, Kolegji Penal i Gjykates se Lartë, cmon se, me rastin e gjykimit te ceshtjes penale qe i perket te gjykuarit Gezim Tafa, shihet me vend qe duhet bere njesimi i praktikës gjyqesore..."

Duke marre shkas nga vendimi i Kolegjit Penal, Kolegjet e Bashkuara, per efekt te njesimit te praktikës gjyqesore cmojne t`u japin pergjigje problemeve te meposhteme:

1. Cila gjykatë eshte kompetente per te gjykuar kerkesen per rivendosjen ne afat te ankimit (apelit apo rekusit).
2. Ne interpretim te nenit 147 te K.Pr.Penale, per te pandehurin e gjykuar ne mungese per shkak se i fshihet gjykimit te ceshtjes (neni 352/4 te K.Pr.Penale), kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit a lejohet te behet nga nje avokat mbrojtës i caktuar kryesisht, ose i caktuar nga familjaret e te pandehurit, apo kjo e drejte i perket ekskluzivisht vetem te pandehurit.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga gjyqtaret Natasha Sheshi e Vladimir Bineri, prokurorin Arqile Lole qe kerkoi pranimin e rekursit, avokatin Shuaip Syri qe kerkoi pranimin e rekursit, prishjen e te dy vendimeve e pushimin e ceshtjes penale, e pasi e bisedoi ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë:

Gjate gjykimit ne shkalle te pare dhe ne Apel te dy gjykatat kane pranuar faktet dhe rrethanat e ceshtjes si me poshte:

Me daten 09.06.1990 viktima Fatmir Duro, i shoqeruar nga shtetasi Irfan Lici, eshte nisur nga fshati Orman, Korce, ne drejtim te Ersekës dhe me vone ne drejtim te kufirit shteteror ne Leskovik.

Afer mesnates ata i jane afruar piramides se kufirit, por jane diktuar nga ushtaret e sherbimit, te cilet kane qelluar ne drejtim te tyre. Te dy shkelesit e kufirit jane larguar me vrap e jane fshehur ne erresire.

Pas kesaj eshte dhene alarmi dhe forcat ushtarake kane kaluar ne ndjekje te tyre. Ne mengjes ata kane tentuar perseri te kalojne kufirin. I pandehuri Gezim Tafa ka pare viktimen qe po ecte me shpejtesi, ka qelluar drejt tij me bresheri automatiku dhe e ka lene te vrare ne vend. Nga ekzaminimet qe i jane bere viktimes ka rezultuar se atij i jane shkaktuar disa plage ne vende jetike si rezultat i plumbave qe jane shtire nga arma e te pandehurit me qitje te panderprere, te cilat i kane shkaktuar vdekje te menjehershme.

Vepra eshte cilesuar vrasje me dashje ne baze te nenit 76 te K.Penal. Mbrojttesi i te pandehurit ka pretenduar se i pandehuri fillimisht eshte sulmuar me thike nga viktima, por te dy gjykatat kane pranuar qe i pandehuri me viktimen nuk kane gene ne distance te afert dhe se viktima nuk ka kryer asnje veprim ndaj te pandehurit, prandaj e kane rrezuar pretendimin per cilesimin e vepres si vrasje ne kapercim te kufinjve te mbrojtjes se nevojshme, parashikuar si krim nga neni 83 i Kodit Penal.

Persa i perket gjykimit te kesaj ceshtjeje, Kolegjet e Bashkuara cmojne se, para shqyrtimit te themelit te saj per t`u dhene pergjigje shkaqeve te parashtruara ne rekurs, eshte e domosdoshme te konkludohet paraprakisht ne se jane kushtet procedurale qe e bejne rekursin date 07.11.2001 te pranueshem per shqyrtim. Nepermjet ketij shqyrtimi praprak behet e mundur qe t`u jepet pergjigje edhe disa problemeve te shtruara per efekt te njesimit te praktikës gjyqesore.

1. Se pari, duhet te konkludohet se cila gjykate eshte kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen ne afat per te bere ankim kunder vendimit qe eshte dhene ne mungese.

Shumica eshte e mendimit se, ne kuptim te nenit 147 te K.Pr.Penale, **kerkesa per rivendosje ne afat per te bere ankim behet ne gjykatën qe ka dhene vendimin dhe si e tille duhet kuptuar pergjithesisht gjykata e shkalles se pare (gjykata e rrethit gjyqesor perkates)**. Kjo rezulton nga permbajtja e pikave 5 e 6 te nenit 147 te K.Pr.Penale.

Sipas pikes 5, “Vendimi qe lejon rivendosjen ne afat per berjen e ankimit mund te ankimohet vetem bashke me vendimin perfundimtar”. Ndersa sipas pikes 6, “Kunder vendimit qe refuzon kerkesen per rivendosje ne afat mund te behet ankim ne gjykatën e apelit”.

Duke interpretuar ne teresi e ne lidhje me njera tjetren keto dy pika arrihet ne perfundimin se ankimi i vecante lejohet vetem kur gjykata e shkalles se pare refuzon rivendosjen ne afat te ankimit (sipas rastit, respektivisht, te apelit apo te rekursit).

Dispozita e mesiperme parashikon ne menyre te shprehur (eksplicite) se ankimi behet ne gjykatën e apelit. Mirepo, neni 148/2 i K.Pr.Penale parashikon edhe mundesine qe rivendosja ne afat e ankimit te shqyrtohet nga Gjykata e Larte. Kjo nuk nenkupton te drejten e pales per t`i u drejtuar direkt Gjykates se Larte, por te drejten e saj per t`u ankuar ne Gjykatën e Larte kunder

vendimit per mospranimin e kerkeses per rivendosjen ne afat te ankimit. Kuptohet qe ankimi, sipas nenit 147, pika 7, behet fillimisht ne apel e mandej, ne rast refuzimi, perseritet ne Gjykatën e Lartë. Ne rast se gjykata e apelit e pranon kerkesen per rivendosje ne afat te ankimit, atehere i lind e drejta prokurorit qe te kundërshtojë ne Gjykatën e Lartë rivendosjen ne afat se bashku me vendimin perfundimtar te gjykates se apelit. Ne rastin kur nuk eshte pranuar kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit si nga gjykata e shkalles se pare, ashtu dhe nga gjykata e apelit, dhe Gjykata e Lartë mbi bazën e ankimit qe i eshte paraqitur, konkludon se kjo kerkese duhej pranuar sepse kanë qene kushtet per t'u pranuar, atehere kjo gjykate (Gjykata e Lartë) vendos te ndryshojë vendimet e gjykatave me te ulta, te rivendose ne afatin e ankimit palen perkatese dhe t'ia dergojë ceshtjen gjykates kompetente per ta shqyrtuar ate ne themel.

Si perfundim, pavaresisht nese ceshtja eshte shqyrtuar ne themel apo jo edhe nga gjykata e Apelit, **kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit eshte gjykata e shkalles se pare.** Gjykata e apelit dhe, pas saj, Gjykata e Lartë, shqyrtojnë vetem ankimet kunder vendimeve respektive.

2. Nga analiza e mesiperme konkludohet se, per rastin ne shqyrtim Gjykata e shkalles se pare e rrethit gjyqesor Kolonje ishte kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te rekursit kunder vendimit te themelit te dhene nga gjykata e Apelit.

Kjo kerkese per rivendosjen ne afat eshte shqyrtuar nga nje gjyqtar i vetem.

Mirepo rezulton qe i pandehuri eshte denuar me 12 (dymbëdhjete) – vjet heqje lirie per nje krim per te cilin dispozita perkatese parashikon nje denim maksimal me 20 (njetzet) vjet heqje lirie.

Per rrjedhoje shtrohet pyetja: *gjersa gjykimi i ceshtjes per akuzën ne fjale ne te dy gjykatat e faktit eshte bere me trupa gjykues te perbere nga tre gjyqtare, atehere a mund te pranohet qe kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit kunder vendimeve te dhena te shqyrtohet nga nje gjyqtar i vetem.* Nje gje e tille do te ishte e pranueshem ne qofte se Kodi i Procedures Penale do ta parashikonte ate ne menyre te shprehur (*eksplicite*). Nje parashikim te tille nuk e hasim. Per me teper, edhe ndryshimi i nenit 13 te K.Pr.Penale me ligjin nr.8813, date 13.06.2002, mbështet menyren e arsyesmit si me siper. Dispozita ne fjale parashikon ne menyre taksative rastet kur ceshtjet gjykohen me nje gjyqtar te vetem dhe ne keto raste nuk perfshihet rasti ne fjale.

Pra Gjykata e rrethit gjyqesor Kolonje ka gjykuar me nje gjyqtar te vetem nje kerkese qe, sipas ligjit, duhej te gjykohej me trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare. Kjo perben qartesisht nje rast pavlefshmerie absolute te aktit (vendimit) ne kuptim te nenit 128 te K.Pr.Penale.

Sipas kesaj dispozite, “1. *Aktet procedurale jane absolutisht te pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat qe lidhen me:*

a – Kushtet per te qene gjyqtar ne ceshtjen konkrete dhe numurin e gjyqtareve qe jane te domosdoshem per formimin e kolegjëve te caktuara ne kete kod;”.

Nisur nga sa me lart, vendimi i gjyqtarit te vetem per rivendosjen e afatit te ankimit (rekursit) te te pandehurit te gjykuar ne mungese eshte akt absolutisht i pavlefshem dhe, si i tille, konsiderohet i paqene (*nul*).

Sipas nenit 128/2 te K.Pr.Penale, “2. *Nje akt i cilesuar me ligj si absolutisht i pavlefshem nuk mund te behet i vlefshem”.*

Per rrjedhoje, pavlefshmeria absolute (*nuliteti*) i vendimit nr.1, date 29.10.2001 te Gjykates se rrethit gjyqesor Kolonje, per rivendosjen e afatit te ushtrimit te rekursit ne emer te te pandehurit Gezim Tafa, e ben te papranueshem per shqyrtim edhe rekursin e paraqitur ne Gjykatën e Lartë prandaj duhet te vendoset pushimi i gjykimit ne kete gjykate. Ky vendim per pushimin e gjykimit nuk i a heq te drejten te pandehurit Gezim Tafa per te kerkuar ne te ardhmen, vete, ose nepermjet nje perfaqesuesi te tij te pajisur me prokure, rivendosjen ne afat per te bere ankim kunder vendimit penal te dhene ne mungese te tij, ne pajtim me kriteret e vendosura ne nenin 147/2 e 3 te K.Pr.Penale. Kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit shqyrtohet kurdohere me pjesemarrjen e

mbrojtësit të pandehurit dhe të prokurorit. Ky i fundit, në rast se gjykata pranon rivendosjen në afat të ankimit (rekursit), ka të drejtë që së bashku me kundërrekursin të paraqesë edhe ankimin kundër vendimit që ka pranuar rivendosjen në afat për berjen e rekursit (neni 147/5 i K.Pr.Penale).

3. Rezulton se gjykimi si në shkallë të parë edhe në Apel është bërë në mungesë të pandehurit për shkak se ai është larguar dhe i fshihet gjykimit.

Sipas nenit 147/2 të K.Pr.Penale, “*Ne qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim, kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin*”. Ndërsa sipas paragrafit 3 të kesaj dispozite, “*Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda 10 ditëve ... nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin*”.

Nga shqyrtimi i të dy paragrafeve të mesipër konstatohet në mënyrë eksplicite se subjekti që mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë është vetëm i pandehuri dhe se kjo kërkesë për rivendosje në afat ka një afat 10 ditor për t’u paraqitur, i cili fillon nga momenti kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin e dhënë në mungesë të tij.

Praktikisht ky moment “*i marrjes dijeni efektivisht*” mund të përcaktohet vetëm nga i pandehuri, ose nga ndonjë person tjetër që mund të ketë marrë kontakt personalisht me të dhe që mund të jetë informuar prej tij. Në pikpamje ligjore e drejta për të kërkuar apo jo rivendosjen në afat për të bërë ankim, ashtu si dhe vete e drejta e ankimit, është një e drejtë ngushtesisht personale e të pandehurit madhor. Këtë të drejtë ai mund t’ia delegojë me vullnetin e tij të lirë një mbrojtësi të caktuar prej tij nepermjet një akti përfaqësimi të leshuar e të vertetuar në formën e parashikuar në ligj.

Në këtë rast, në dispoziten e mesipërme, përdoret shprehja “kur provon”, duke i u referuar personalisht të pandehurit. Duke u nisur nga ky përcaktim rezulton se barra e provës për të provuar marrjen dijeni dhe për momentin e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e dhënë në mungesë i perket të pandehurit, pasi është ky ai ndaj të cilit ka një vendim gjyqësor që duhet ekzekutuar, por që mund të ankohet në qoftë se vendimi nuk dihej prej këtij të fundit. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një ekskluzivitet të të pandehurit, i cili mund të ushtrojë vete të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afatin e ankimit, ose nepermjet të autorizuarve posacerisht prej tij. Duke qenë se ligji kërkon që i pandehuri të provoje mospasjen dijeni për vendimin, askush tjetër nuk mund ta zëvendësojë atë për të njejtin shkak, përfshi këtu edhe familjaret. Pranimi i të kundertes nuk do ishte vetëm në kundërshtim me sa parashikon neni 147/2, por do të ishte sa allogjik aq edhe në kundërshtim me interesat e vete të pandehurit. Në qoftë se do të pranohej e kundërta do të krijohej situata që të pranohej apriori i mirëqenë fakti që i pandehuri të ishte në dijeni të një vendimi, kur nuk e dinte realisht atë. Nderkohe duke u konsumuar e drejta që parashikon neni 147/2 i K.Pr.Penale nga mbrojtësi i caktuar kryesisht, ose familjaret e tij, do t’i mohojë padrejtësisht e drejta vete të pandehurit për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit. Sipas nenit 147/3 të K.Pr.Penale, “*... Rivendosja në afat nuk lejohet me shumë se një herë për secilën palë për çdo shkallë të proçedimit*”.

Megjithatë, edhe sikur të pranohej e kundërta, d.m.th. që mbrojtësi i caktuar kryesisht apo nga familjaret e të pandehurit, të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për rivendosje në afat të ankimit (apelit apo rekursit) dhe mandej të bëjë ankimin kundër vendimit në emer e për llogari të të pandehurit, perseri lind një problem që duhet sqaruar: *Ne rastin konkret, personi që ka bërë kërkesën për rivendosje në afat të ankimit dhe që më vonë ka bërë rekursin në Gjykatën e Lartë, a e ka marrë proceduralisht cilesinë e mbrojtësit të caktuar kryesisht nga organi procedues, gjykata, apo të caktuar nga të afërmit e të pandehurit?*

Kjo çilesi konfirmohet dhe pranohet nga organi procedues, prokuroria apo gjykata, gjatë hetimit paraprak apo gjatë gjykimit të ceshtjes dhe jo në rrugë ekstra procedurale. Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se ***një person që nuk është legjitimuar si***

mbrojtës i caktuar kryesisht apo nga familjaret e të pandehurit, gjatë procedimit të cështjes në hetimin paraprak apo gjatë gjykimit, nuk mund ta fitojë këtë cilësi në rrugë ekstra procedurale.

Sa me lart është edhe një argument me shumë në favor të perfundimit që, *ne rastin e gjykimit të cështjes në mungesë të të pandehurit për shkak se ky i fshihet gjykimit, të drejten për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit dhe të drejten për të bërë ankim kundër vendimit në një gjykatë me të lartë e ka vetëm i pandehuri, ose një mbrojtës i caktuar prej tij me prokurë.*

Ky qëndrim konfirmohet edhe prej plotësimit që i bëhet nenit 410/2 të K.Pr.Penale me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.8813 datë 13.06.2002 “*Per disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”*”. Konkretisht, ligjvënosi dispozitën e sipërcituar e ka riformuluar si më poshtë: “ ...2. *Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt – përfaqësimi të leshuar nga i pandehuri në format e parashikuara nga ligji”* .

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenëve 438, 441/c dhe 442/b të K.Pr.Penale, dhe të nenit 17 të Ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “*Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”* ,

V E N D O S Ë N:

1. Prishjen e vendimit nr.1, datë 29.10.2001 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Kolonjë me të cilin është pranuar rivendosja në afat e të pandehurit (të gjykuarit) Gezim Tafa për të ushtruar rekurs në gjykatën e Lartë kundër vendimit nr.610, datë 16.08.1996 të gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Pushimin e gjykimit të rekursit në Gjykatën e Lartë.

3. Ky vendim për njesimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 14.10.2002

MENDIM PARALEL

Jemi dakord me zgjidhjen e ceshtjes nga shumica, duke e konsideruar te papranueshem per shqyrtim ne Gjykatën e Lartë rekursin e te pandehurit Gezim Tafa kunder vendimit nr.610, date 16.08.1996 te Gjykates se Apelit Tirane.

Nuk jemi plotesisht dakord me menyren e arsytimit te vendimit nga shumica, me disa argumenta te parashtruara e konkluzione te nxjerra prej saj.

Shumica ka pranuar se, ***pavaresisht ne se ceshtja eshte shqyrtuar ne themel apo jo edhe nga gjykata e Apelit, kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit eshte gjykata e shkalles se pare.***

Ne kundershtim me sa me lart, pakica eshte e mendimit qe, ne cdo rast, kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit kunder nje vendimi gjyqesor eshte ajo gjykate qe ka dhene vendimin qe kerkohet te ankimohet. Ne qofte se do te kerkohet te rivendoset e drejta e ushtrimit te apelit kunder nje vendimi te gjykates se shkalles se pare, atehere kompetente per te shqyrtuar kerkesen eshte kjo gjykate qe ka dhene vendimin. Ne qofte se, si ne rastin ne shqyrtim, do te kerkohet te rivendoset e drejta e ushtrimit te rekursit kunder vendimit te gjykates se Apelit, atehere i takon kesaj gjykate te marre ne shqyrtim kete kerkese.

Si perfundim, vendimi nr.1, date 29.10.2001 i Gjykates se Rrethit Kolonje, qe ka vendosur rivendosjen ne afat te se drejtes se ushtrimit te rekursit ne emer te te gjykuarit Gezim Tafa, eshte i pavlefshem per shkaqet qe pranon shumica, por edhe sikur te mos ishin ato shkaqe pavlefshmerie, ky vendim eshte marre ne kundershtim me ligjin, sepse gjykata e rrethit Kolonje ka marre kompetencen funksionale te nje gjykate me te larte sic eshte gjykata e Apelit.

Shumica e ka bazuar perfundimin qe ka nxjerre per kete problem nisur nga formulimi i pikes "6 " te nenit 147 te K.Pr.Penale, sipas te ciles, "... 6. Kunder vendimit qe refuzon kerkesen per rivendosje ne afat mund te behet ankimi ne gjykatën e apelit".

Permendja e gjykates se apelit si gjykate qe shqyrton ankimin ne kete rast, nuk do te thote se te gjitha kerkesat per rivendosje ne afat te ankimit (apelit apo rekursit) duhet t'i adresohen detyrimisht gjykates se shkalles se pare.

Kjo do te thote se gjykata e shkalles se pare eshte kompetente per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen ne afat te ankimit (apelit) dhe kur pranohet kerkesa behet ankimi ne Apel kunder vendimit te dhene ne shkalle te pare. Por, kjo nuk do te thote apriori se gjykata e shkalles se pare behet kompetente edhe per te shqyrtuar kerkesen per rivendosjen e afatit te ankimit (rekursit) kunder vendimit te gjykates se apelit. Po te pranohej kjo nuk do te kishte kuptim formulimi i pikes 4 te nenit 147 te K.Pr.Penale. Sipas kesaj dispozite,

"...4. Per kerkesen [per rivendosjen ne afat te ankimit] vendos organi qe procedon ne kohen e paraqitjes se saj."

Ne rastin ne shqyrtim, ne kuptim te dispozites se sipercituar, organi qe procedon ne kohen e paraqitjes se kerkeses eshte gjykata e apelit, vendimi i se ciles eshte i formes se prere, por qe mund te atakohet me ane rekursi ne Gjykatën e Lartë.

Pakica eshte e mendimit qe, edhe sikur te mos ekzistonin shkaqet qe e bejne absolutisht te pavlefshem vendimin nr.1, date 29.10.2001 te Gjykates se rrethit gjyqesor Kolonje, ligjshmeria e ketij vendimi do te ishte objekt shqyrtimi paraprak prej Gjykates se Lartë.

Mund te arsyetohet qe ky vendim eshte i formes se prere dhe, si i tille, ai nuk mund te cenohet per cfaredo lloj shkakut, pervec nulitetit. Pakica ka mendim te kundert. Vendimi qe lejon rivendosjen ne afat nuk eshte vendim themeli. Si i tille ai nuk eshte nga ato vendime qe marrin forme te prere ne kuptimin substancial. Ato mund te shqyrtohen ne shkallet me te larta te gjykimit, kur eshte rasti edhe kryesisht, se bashku me vendimin e themelit te atakuar me apel apo rekurs.

Sipas nenit 434 te K.Pr.Penale, “Gjykata e Larte e shqyrton ceshtjen brenda kufinjve te shkaqeve te ngritura. Por per ceshtjet ligjore, qe duhet te shihen kryesisht nga gjykata ne cdo gjendje e shkalle te procesit, te cilat nuk jane pare, gjykata e Larte ka te drejte te vendose”.

Ky qendrim eshte ne nje linje me vendimin unifikues te Kolegjeve te Bashkuara nr.2, date 19.04.2001, qe u perket te pandehurve Altin Luzi, etj.

Natasha Sheshi

Perikli Zaharia

Thimjo Kondi

MENDIM PAKICE

Pakica eshte dakort me perfundimet e arritura nga shumica lidhur me unifikimin e praktikes gjyqesore. Ajo ka mendimin se kerkesa per rivendosjen ne afat te ankimit ashtu sikurse pranuar nga shumica, duhet te shqyrtohet nga gjykata e shkalles se pare ne te cilen eshte dhene vendimi gjyqesor per te cilin kerkohet rivendosje ne afat te ankimit.

Pakica, gjithashtu eshte dakort edhe me perfundimin se te drejten per te kerkuar rivendosjen ne afat per te bere ankim, ne kuptim te nenit 147/2 te K.Pr.P. e ka personi qe eshte gjykuar ne mungese i cili mund ta kerkoje kete vete, ose nepermjet perfaqesuesit te tij te posacem. Askush tjeter pervec te gjykuarit ne mungese nuk mund te legjitimohet qe te kerkoje rivendosjen ne afat per te bere ankim ndaj vendimit te dhene ne mungese te tij, qofshin keta edhe familjare te tij. Kjo, per faktin se dispozita perkatese e K.Pr.P e lidh ne menyre te shprehur rivendosjen ne afat me vete te gjykuarin, me kushtin qe ai duhet te provoje se nuk ka marre dijene per vendimin e dhene ne mungese. Pranimi i te kundertes, do t'i mohonte te drejten te gjykuarit ne mungese qe te kerkonte rivendosjen ne afatin e ankimit per shkak se te tretet e kane ushtruar te drejten e tij, pa dijenine e vete te gjykuarit. Kjo do ta bente procesin e parregullt dhe ne kundertshtim jo vetem me kerkesat e nenit 147/2 te K.Pr.P., por edhe me te drejten e te pandehurit per t'u mbrojtur ndaj nje vendimi gjyqesor kur ai provon se vendimi eshte dhene ne mungese, dhe jo per faj te tij.

Pavaresisht nga sa pranohet, pakica ka votuar kunder menyres se zgjidhjes se ceshtjes naa Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte qe kane konstatuar shkelje ligjore ne proceduren e rivendosjes ne afat te ankimit dhe kane prishur vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kolonje Nr.1, date 29.10.2001, qe ka pranuar kerkesen. Mendojme se Kolegjet e Bashkuara, megjithese ne themel kane pasur te drejte lidhur me kunderligjshmerine e ketij vendimi, ato kane dale jashte objektit te shqyrtimit te ceshtjes ne Gjykatën e Larte, pasi ai vendim nuk ka qene objekt i kundertshtimit ne kete gjykate. Ajo ka patur per shqyrtim rekursin kunder vendimit te denimit Nr. 12, date 19.6.1996, te Gjykates se Rrethit Kolonje i cill eshte lene ne fuqi nga vendimi Nr.610, date 16.8.1996 i Gjykates se Apelit. Kunder vendimit Nr.1, date 29.10.2001, per te cilin jane shprehur Kolegjet e Bashkuara nuk ka bere askush ankim dhe ky vendim nuk eshte kontestuar Ildhur me bazueshmerine e tij nga organi i akuzes. Ne te kundert, organi i prokurorise, ne seance

gjyqesore ne Kolegjet e Bashkuara, ne kerkimet e tij dhe ne argumentat e paraqitura me shkrim e me goje, jo vetem qe nuk e ka kundërshtuar kete vendim, por duke e konsideruar te mireqene ate, i ka kerkuar Kolegjeve te Bashkuara qe te gjykoje shkaqet e ngritura ne rekurs dhe ta pranoje ate, duke ndryshuar cilesimin juridik te vepres sikurse eshte kerkuar, e per pasoje, te pushoje ceshtjen pasi duhet te aplikohet ligji per amnistine, Nr.8202, date 27.3.1997.

Ne mbeshtetje te qendrimit te saj, pakica mendon se Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ashtu si cdo gjykate tjeter, vihet ne levizje nga palet ne proces dhe ju pergjigjet kerkesave te tyre. Kolegjet e Bashkuara si gjykate me e larte nuk mund te marre ceshtje me inisiative per te shqyrtuar, po ashtu nuk mund te disponoje per vendime te dhena nga gjykatat me te ulta, pa patur ankim nga palet ne proces. Neni 434 i K.Pr.P. parashikon se Gjykata e Larte e shqyrton ceshtjen brenda kufijve dhe shkaqeve te ngritura. Megjithate, ne dallim nga procedura civile, ne procesin penal, kesaj gjykate i jepet e drejta, qe per ceshtje te ligjit te vendose edhe kryesisht, pavaresisht se ato nuk jane ngritur si shkaqe nga palet. Kjo do kuptuar, se per ceshtje te cilat duhej te shiheshin kryesisht nga gjykatat e tjera dhe qe kane te bejne me aplikimin e gabuar te ligjit, edhe pse keto nuk jane ngritur ne rekurs, Gjykata e Larte mund t'i konstatoje kryesisht dhe te disponoje ne vendimin e saj. Ne kete drejtim, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka patur mjaft raste te konstatimit te pavlefshmerive kryesisht, duke zbatuar kerkesat e nenit 434 te K.Pr.P., pavaresisht se ato nuk kane qene bere prezent nga palet dhe ne kuptim te nenit 128 te K.Pr.P., ka cenuar vendimet e marra ne shkelje te ligjit. Raste te kesaj natyre, me te shumta ne numur, kane qene ato qe kane pasur te bejne me sigurimin e pjesemarrjes se te pandehurit ne gjykimin ne gjykatën e apelit, apo raste te tjera pavlefshmerie te parashikuara nga neni 128 i K.Pr.P.

Pavaresisht nga kjo, neni 434 i K.Pr.P., duhet kuptuar me ate qe gjykata konstaton shkelje te ligjit te cilat nuk jane ngritur ne ankimin e bere kunder vendimit gjyqesor nga palet. Pra, ndaj vendimit eshte ushtruar ankim, por shkaqet per cenimin e tij, jane te ndryshme nga ato te ngritura ne rekurs. Kjo do te thote se ne kuptim te nenit 434 te K.Pr.P. kur ushtrohet rekurs vetem ndaj vendimit, do te legjitimohej Gjykata e Larte qe te cenoje vendimin per shkaqet e ngritura e te tjera te konstatuara prej saj dhe te pangritura. Ne rastin ne fjale nuk ka ankim ndaj vendimit Nr.1, date 29.10.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kolonje, por ka ankim ndaj vendimit Nr.610, date 16.8.1996, te Gjykates se Apelit Tirane dhe Nr.12, date 19.6.1996 te Gjykates se Rrethit Kolonje, te cilet e kane deklaruar fajtor te gjykuarin Gezim Tafa per vepren penale te parashikuar nga neni 76 i K.P. dhe e kane denuar ate me 12 vjet burgim.

Pra, gjykata nuk e ka patur objekt te gjykimit vete vendimin e rivendosjes ne afatin e ankimit, pasi askush nuk e ka ankimuar ate. Duke qene ne keto kushte, pakica ka mendimin se Kolegjet e Bashkuara kane vleresuar ligjshmerine e nje vendimi gjyqesor te pa ankimuar ne Gjykatën e Larte duke dale tej caqeve qe lejon ligji.

Vladimir Metani

Artan Hoxha

Kristaq Ngjela

Vladimir Bineri

Evgjeni Sinoimeri

Agron Lamaj

**Nr. 8 i Regj. Themeltar.
Nr. 7 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Nikoleta Kita	Anetare
Spiro Spiro	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Metush Saraçi	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Evgjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare

ne seancen gjyqesore te dates 11.10.2002, moren ne shqyrtim ceshtjen penale nr.8, qe i perket:

TË DËNUARIT: BLERIM LLUKANI

OBJEKTI I KËRKESËS:

Mosekzekutim i vendimit penal te formes se prere,
duke u perjashtuar nga vuajtja e metejshme e denimit,
per shkak te parashkrimit dhe shuarjes se tij.
Baza Ligjore :Nenet 68/c te K.Penal
si dhe 480 e vijues te K.Pr.Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan me vendimin nr. 114, date 30.10.2001 ka vendosur:

“Rrezimin e kerkeses se paraqitur nga i denuari Blerim Llukani me objekt mosekzekutimin e vendimit te denimit penal nr. 141 date 24.7.1996 te Gjykeses se Rrethit Elbasan, per perjashtimin nga vuajtja e metejshme e denimit per shkak te parashkrimit dhe shuarjes se denimit, si te pabazuar ne ligj”.

Gjykata e Apelit Durres, mbi ankimin e te denuarit, me vendimin nr. 280 date 20.12.2001, ka vendosur:

“Lenien ne fuqi te vendimit Nr. 114 date 30.10.2001 te Gjykates se Rrethit Elbasan”.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Durres dhe Gjykates Rrethit Gjyqesor Elbasan, ka paraqitur rekurs ne baze te nenit 432 te K.Pr.Penale i denuari Blerim Llukani, i cili kerkon prishjen e tyre dhe pranimin e kerkeses, duke parashtruar keto shkaqe:

- Nga gjykatat eshte zbatuar gabim ligja, kur:
- Konform nenit 68 te K.Penal eshte parashkruar ekzekutimi i denimit, pasi nga dita qe vendimi ka marre forme te prere ka kaluar mbi 5 vjet.
- Ne kreun VIII te K.Penal, ku eshte dhe neni 68, por qe harmonizohet dhe me nenin 480 te K.Pr.Penale, gjithçka kufizohet taksativisht me afatet e shuarjes dhe parashkruar te denimit, afate te cilat fillojne nga dita qe vendimi ka marre forme te prere.
- Ne K.Pr.Penale per keto afate nuk ka dhe nuk parashikohen pezullime apo nderprerje etj. per mosekzekutimin e denimit dhe per pasoje neni 68 i K.Penal ka karakter detyrues per tu zbatuar dhe nuk kushtezon kete ekzekutim vendimi, qe nuk eshte kryer per faj ose pakujdesi te organeve kompetente qe merren me kete ceshtje.
- Ligja mund te kete vakume ligjore, por ligji nr. 8202 date 27.3.1997 dhe ligji nr. 8268 date 22.12.1997 “Per amnistine” nuk ndryshuan nenin 68 te K.Penal, per te pezulluar apo nderprere ekzekutimin e vuajtjes se denimit per shkak te hapjes se burgjeve, i cili nuk u be per faj te te denuarve.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi degjuan relacionin e anetareve Ylvi Myrtja e Vladimir Bineri, pasi degjuan prokurorin e Prokurorise se Pergjithshme Artur Selmani, qe kerkoj prishjen e vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe te gjykates se apelit dhe pranimin e kerkeses se te denuarit,

pasi degjuan avokatin e te denuarit z. Hysen Kovaci, i cili kerkoj prishjen e vendimit te gjykates se shkalles se pare dhe te gjykates se apelit dhe pranimin e kerkeses,

V Ë R E J N Ë

Me vendim Nr. 141 date 24.7.1996 te Gjykates se Rrethit Elbasan eshte vendosur: “Deklarimi fajtor i te pandehurit Blerim Llukani per vepren penale te vjedhjes me dhune ne bashkepunim dhe ne baze te neneve 139 e 25 dhe 50/gj te K.Penal e 406 te K.Pr.Penale eshte denuar me 6 vjet burgim, duke i filluar vuajtja e denimit nga data e arrestimit 17.12.1995”. Ky vendim, ne baze te vendimit nr.707 date 11.9.1996 te Gjykates se Apelit Tirane, eshte lene ne fuqi, duke u ndryshuar vetem masa e denimit te te gjykuarit nga 6 vjet ne 4 vjet burgim. Vendimi i gjykates se apelit eshte lene ne fuqi me vendimin nr. 333 date 4.12.1997 te Kolegjit Penal te Gjykates se Kasacionit.

Organi i Prokurorise Elbasan, ne baze te nenit 464/3 te K.Pr.Penale, me date 8.10.1996 ka nxjerr urdherin per ekzekutimin e vendimit penal nr.141. Vuajtja e denimit per te denuarin, ashtu sic eshte shprehur dhe gjykata ne vendimin e saj, por dhe ne urdherin e ekzekutimit te prokurorit, ka filluar me date 17.12.1995. I denuari ka filluar vuajtjen e denimit ne Institucionin e Riedukimit 325 Tirane deri me date 13.3.1997, dite kur vuajtja e metejshme e denimit eshte nderprere nga trazirat ne vend. Pas kesaj date i denuari nuk eshte kthyer vullnetarisht me per vazhdimin e

metejshe me te vuajtjes se denimit penal dhe as eshte bere e mundur rivenia ne ekzekutim e denimit, duke ngelur pa vuajtur ende 2 vjet, 4 muaj e 22 dite burgim.

I denuari ne kerkesen e tij drejtuar gjykates kerkon mosekzekutimin e metejshe me te vuajtjes se denimit ne baze te nenit 68 te K.Penal, me pretendimin se ai eshte parashkruar sepse kane kaluar 5 vjet nga dita qe vendimi ka marre forme te prere, pra nga data 11.9.1996.

Gjykata e rrethit gjyqesor Elbasan ka rrezuar kerkesen e tij dhe vendimi eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Durres, me arsyetimin se instituti i shuarjes se denimit dhe mos ekzekutimit te vendimeve penale per shkak te parashkrimit, ben fjale per vendime penale, te cilat nuk jane vene ne ekzekutim dhe jo per vendime penale qe kane filluar te ekzekutohen.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr. 279 date 18.04.2002 ka vendosur kalimin e ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per unifikimin e praktikës gjyqesore.

Problemet ligjore, te cilat duhet te gjejne nje trajtim juridik, ne kete ceshtje jane :

Kur eshte i zbatueshem instituti i parashkrimit te ekzekutimit te denimit :

a) vetem ne rast se vendimi penal nuk eshte vene asnjehere ne ekzekutim;

b) apo edhe ne rastet kur vendimi eshte vene ne ekzekutim dhe nuk eshte permbushur plotesisht;

c) a do te pranohet koncepti i nderprerjes dhe i pezullimit te parashkrimit te ekzekutimit te denimit?

Kolegjet e Bashkuara çmojne se vendimet e te dy gjykatave nuk jane te drejta, pasi ato nuk trajtojne si duhet kuptimin e institutit te parashkrimit te denimit parashikuar nga neni 68 i Kodit Penal.

Ne kete perfundim Kolegjet e Bashkuara edhe pse deri tani nuk ka patur jurisprudence ne lidhje me kete ceshtje, arrihen duke u nisur nga interpretimi i gjithanshem qe u “kane” bere dispozitave te Kodit Penal ne lidhje me parashkrimin.

Ne kreun e VIII-te te Kodit Penal ligjvenesit ka parashikuar nje institut me vete ne lidhje me shuarjen e ndjekjes penale, te denimeve dhe mosekzekutimin e tyre.

Brenda kuadrit te ketij instituti jane perfshire dispozita te vecanta ne lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale, (neni 66 i K.Penal); ne lidhje me parashkrimin e ekzekutimit te denimit, (neni 68 i Kodit Penal) dhe shuarjen e denimit ose, sikurse e ka emertuar vete ligjvenesit, rehabilitimin, (neni 69 i Kodit Penal).

Keto dispozita permbajne rregullimin ligjor te ketij instituti ne tre aspekte te vecanta te tij.

Keshtu, dispozita e nenit 66 te Kodit Penal ben fjale per parashkrimin e ndjekjes penale me te cilin duhet kuptuar ndalimi qe ekziston me ligj per te bere ndjekje penale, ne qofte se, nga koha kur eshte kryer vepra penale, deri ne momentin e marrjes si te pandehur te autorit te saj, kane kaluar afatet e parashikuara ne kete dispozite.

Ne dispoziten e nenit 68 te Kodit Penal ligjvenesit ka parashikuar afatet, me kalimin e te cileve, vendimi i denimit, dhene ndaj nje personi per vepra penale te kryera prej tij, nuk mund te ekzekutohet me.

Kurse ne dispoziten e nenit 69 te Kodit Penal jane parashikuar afatet, me kalimin e te cileve, personi i denuar per vepra penale te kryera prej tij, do te quhet i padenuar ose, sic e ka vete ligji i rehabilituar.

Nga sa u parashtrua shkurtimisht me lart, arrihet ne perfundimin se, ne rastin e pare, (neni 66 i Kodit Penal) ndodhemi para rastit te parashkrimit te se drejtes se organeve kompetente te ndjekjes penale; ne rastin e dyte (neni 68 i Kodit Penal), ndodhemi para parashkrimit te se drejtes se organeve kompetente shteterore, te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit per te ekzekutuar keto vendime. Kurse, ne rastin e trete, (neni 69 i Kodit Penal) ndodhemi para shuarjes

se denimit te dhene ndaj nje personi per vepra penale te kryera prej tij dmth, para rehabilitimit te ketij personi qe sjell si pasoje ndryshimin e gjendjes gjyqesore te tij, nga i denuar ne i padenuar.

Çeshtja objekt gjykimi ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ka te beje me aspektin e dyte te institutit te parashkrimit, dmth me parashkrimin e ekzekutimit te denimit, parashkuar nga neni 68 i Kodit Penal.

Nga permbajtja e kesaj dispozite, del se vendimi i denimit nuk ekzekutohet kur nga dita qe ka marre forme te prere kane kaluar: njezet vjet per vendimin qe permban denim pesembedhjte gjer ne njezetepese vjet; dhjete vjet per vendimin qe permban denim pese gjer ne pesembedhjte vjet dhe pese vjet per vendime qe permbajne denim me burgim gjer ne pese vjet ose denime te tjera me te lehta.

Duket qarte se, ligjvenesi, nepermjet kesaj dispozite, ka vene perpara organeve kompetente shtetore te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit nje kufizim kohor brenda te cilit keto organe kane te drejte qe te vene ne ekzekutim nje vendim penal te formes se prere. Ky kufizim kohor, perben ne te njejten kohe edhe nje ndalim te shprehur per keto organe, i cili nuk u lejon atyre qe te ekzekutojne vendime penale tej afateve te percaktuara, sipas rastit, ne shkronjat "a", "b" dhe "c" te dispozites se nenit 68 te Kodit Penal.

Qellimi i ligjvenesit ne vendosjen e ketij kufizimi kohor dhe ndalimi ka qene se pari, realizimi ne praktike i efektit te pergjithshem dhe te vecante parandalues te denimit ne cdo rast konkret dhe se dyti, disiplinimi i procesit te ekzekutimit te vendimeve te denimit ne pergjithesi dhe ne menyre te vecante ne rastet kur personi i denuar, per njeran apo tjetren arsye i shmanget apo i fshihet ketij procesi.

Te drejten dhe njekohesisht detyren qe kane organet kompetente shtetore, te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit, ligjvenesi e ka kushtezuar se pari me momentin kur vendimi i denimit ka marre formen e prere dhe se dyti, ne vartesi te masave dhe llojeve te denimit te dhene, me afatet, (njezet, dhjete dhe pese vjet), qe parashikohen ne dispoziten e permendur te Kodit Penal.

Nga sa u parashtruan ne paragrafin e mesiperem, arrihet ne perfundimin se, organet kompetente shtetore te ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve te denimit, kane te drejte dhe njekohesisht detyre qe menjehere, sapo vendimi i denimit te kete marre forme te prere, ta vene ne ekzekutim ate.

Kete te drejte ato vazhdojne ta kene derisa pa u plotesuar akoma afatet, njezet, dhjete dhe pese vjet te parashikuara respektivisht nga shkronjat "a", "b" dhe "c" te nenit 68 te Kodit Penal.

Nga kjo del se vendimi i denimit nuk mund te ekzekutohet as para se ai te kete marre forme te prere, as pasi te jene plotesuar afatet njezete, dhjete dhe pese vjet qe u permenden dhe kjo perben ndalimin qe u permend me lart.

I denuari Blerim Llukani eshte denuar me vendimin nr. 141 date 24.07.1996 te Gjykates se shkalles se pare Elbasan. Vendimi i dhene nga Gjykata e Elbasanit ka marre forme te prere me date 11.09.1996 ditën kur ka shpallur vendimin e saj gjykata e apelit. Denimi i dhene per te denuarin Blerim Llukani ka qene me i ulet se 5 vjet burgim.

Me kalimin e pese vjeteve e konkretisht me 12.09.2001 i denuari Blerim Llukani ka hartuar dhe depozituar ne Gjykatën e rrethit Elbasan kerkesen objekt

gjykimi me pretendimin se vendimi i denimit te dhene kunder tij nuk mund te ekzekutohej me per faktin se kishin kaluar pese vjet nga dita qe vendimi kishte marre forme te prere. Nepermjet kerkeses objekt gjykimi i denuari ka kerkuar nga gjykata deklarimin si te parashkuar te denimit te dhene kunder tij. Kerkimet i denuari pervec nenit 68 te Kodit Penal te analizuar me sipër i bazon edhe ne nenet 470, 471 e 480 te Kodit te Procedures Penale.

Dispozitat procedurale te sipercituara sanksionojne gjykatën kompetente ne fazën e ekzekutimit (neni 470 i K.Pr.Penale) mënyrën e procedimit (neni 471 i K.Pr.Penale) dhe kompetencat e gjykates (neni 480 i K.Pr.Penale). Sipas nenit 480 te K.Pr.Penale: “Ne fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente te vendose per shuarjen e vepres penale pas denimit, per shuarjen e denimit, per denimet plotesuese, per konfiskimin dhe kthimin e sendeve te sekuestruara, si dhe per çdo rast te parashikuar me ligj”.

Ne kundërshtim me sa u analizua me sipër, gjykatat e kanë rrezuar padrejtesisht kërkesën e të denuarit Blerim Llukani megjithëse kishin kaluar pesë vjet nga dita që vendimi kishte marrë formë të prërë. Me kalimin e pesë vjeteve vendimi i denimit nuk mund të ekzekutohet (neni 68/c i Kodit Penal). Si gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit ishin të detyruara të deklaronin se denimi i dhënë kundër të denuarit Blerim Llukani nuk mund të ekzekutohej me për faktin se ai ishte parashikuar.

Nga leximi i vetë tekstit të dispozitës së nenit 68 të Kodit Penal shihet fare qartë që ligjvënisi jo vetëm që nuk ka parashikuar, por as ka lënë të nenkuptohet se ekzistojnë shkaqe apo faktore që mund të sjellin si pasoje zgjatjen e afatëve të parashkrimit që janë parashikuar prej tij në lidhje me ekzekutimin e vendimit të denimit.

Gjykata e shkallës së parë Elbasan dhe Gjykata e Apelit Durrës e kanë rrezuar kërkesën e të denuarit Blerim Llukani me arsyetimin: “se me datë 13.03.1997 është nderprerë vuajtja e denimit”. Ky konkluzion i gjykatave nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore të së drejtës penale. Në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet nderprerja e ekzekutimit të vendimeve. Megjithëse në legjislativën penale shqiptarë nuk parashikohet nderprerja e ekzekutimit të vendimit, gjykatat i referohen parimeve të përgjithshme të së drejtës e sidomos të drejtës civile që e parashikon nderprerjen si një institut ligjor. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim me parimet e Kodit Penal shqiptar. Në të drejtën penale shqiptare është sanksionuar: “Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësive në caktimin e fajësive dhe të denimit, si dhe të humanizmit. Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet.

Siç shihet mënyra e arsyetimit që mbështetet në disa parime të përgjithshme për të nxjerrë përfundime të njëjta është kategorikisht e ndaluar për të drejtën penale. Për këtë arsye ligjvënisi ka sanksionuar në Kodin Penal parimin e moszbatimit të ligjit penal me analogji (neni 1/c i Kodit Penal).

Kolegjet e Bashkuara të Gjykates së Lartë arrijnë në përfundimin se edhe duke u nisur nga interpretimi logjik i shprehjes së përdorur nga ligjvënisi në dispozitën e këtij neni ku thuhet: “Vendimi i denimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prërë kanë kaluar...”, nuk mund të ketë zgjatje të afatëve të parashkrimit të ekzekutimit të denimit për asnjëlloj shkak. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i denimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu edhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i denuari ka filluar të vuajë denimin, vuajtja e metejshme e tij nderpritet për çfaredolloj shkak, sikurse mund të jetë edhe largimi i të denuarit nga vuajtja e denimit, sic ka ndodhur me të denuarin Blerim Llukani.

Fakti që vendimi i denimit që i perket këtij të denuari ishte vënë në ekzekutim dhe ai, deri më 13.03.1997 kur u largua nga vendi i vuajtjes së denimit, kishte vuajtur rreth 21 muaj nga denimi i dhënë, nuk mund të shërbejë si rrethanë për t'i bërë dispozitës së nenit 68 të Kodit Penal një interpretim të ndryshëm nga ai që i u bë nga Kolegjet e Bashkuara, në pjesët e mëparshme të këtij vendimi.

Vetëm fakti, që i denuari Blerim ka vuajtur një pjesë të denimit nuk mund ta vendosë atë në pozitë të disfavorshme në raport me çdo të denuar tjetër, vendimi penal ndaj të cilit nuk është vënë ende në ekzekutim. Ishte detyra e organeve kompetente shtetërore, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale që të merrte masat e duhura për të gjetur dhe kapur këtë të

denuar dhe per ta detyruar ate qe te vazhdonte vuajtjen e metejshme te denimit. Per kete kategori te denuarish duhet te aplikohet i njejti rregull. Nisur nga parimi i barazise para ligjit (neni 18 i Kushtetutes) instituti i parashkrimit te ekzekutimit te denimit duhet te zbatohet njelloj per te gjithë te denuarit, si per ata ekzekutimi ndaj te cileve nuk ka filluar si dhe per ata ekzekutimi ndaj te cileve nuk eshte permbushur plotesisht. Eshte e padrejte qe te perfitoje nje person qe nuk ka vuajtur as nje dite burg dhe te mos perfitoje nje person qe ka vuajtur nje pjese te denimit. Ne favor te ketij konkluzioni shkon dhe fakti se qellimi i institutit te parashkrimit te ekzekutimit te denimit eshte i njejte per te gjithë shtetasit, te cilet jane denuar penalisht me burgim.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne baze te nenit 442 te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.114, date 30.10.2001 te Gjykates se rrethit gjyqesor Elbasan dhe vendimit nr.280, date 20.12.2001 te Gjykates se Apelit Durres, pranimin e kerkeses se te denuarit Blerim Llukani duke deklaruar denimin e tij te shuar.

Ky vendim per unifikimin e praktikës gjyqesore dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 11.10.2002

MENDIMI I PAKICËS

Kodi Penal i Republikës se Shqipërisë, ne kreun e tete te tij, nen titullin e perbashket “*Shuarja e ndjekjes penale, e denimeve dhe mosekzekutimi i tyre*”, parashikon dhe rregullon edhe parashkrimin e ekzekutimit te denimit penal.

Parashkrimi i ekzekutimit te denimit penal, si cdo rast tjeter parashkrimi, permban dy elemente: 1. *mosveprimin e shtetit per te realizuar nje te drejte e permbushur nje detyrim (ekzekutimin e vendimit te denimit penal)*; 2. *afatin kohor pas kalimit te te cilit organi i ekzekutimit nuk mund te kryeje me veprime ekzekutimi*.

Pas kalimit te afatit te parashkrimit nuk shuhet automatikisht vete denimi, sepse personi perkates vazhdon te quhet i denuar (nuk quhet i rehabilituar). Afati i reabilitimit, sipas nenit 69 te Kodit penal fillon te ece kur i denuari e ka perfunduar vuajtjen e denimit. Me momentin e perfundimit te vuajtjes se denimit barazohet per kete efekt edhe momenti kur denimi nuk mund te vazhdoje te vuhet me per cfaredo lloj shkak te perligjur.

Shumica ka arritur ne perfundimin se, ne rastin ne shqyrtim, afati 5 vjecar i parashkrimit te ekzekutimit te vendimit te denimit ka filluar kur vendimi ka marre forme te prere (date 11.09.1996) dhe se ne kohen kur eshte gjykuar kerkesa ne gjykatën e shkalles se pare, e per me teper ne gjykatën e Apelit, ky afat ka qene i plotesuar.

Shumica ka arritur ne kete perfundim duke arsyetuar se “*ne Kodin Penal dhe ne Kodin e Procedures Penale nuk parashikohet nderprerja e parashkrimit te ekzekutimit te vendimeve*”, dhe se “*zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet*”.

Pakica per kete problem ka mendim te kundert. Per kete nuk nisemi vetem nga fakti qe doktrina juridike ka pranuar se instituti i parashkrimit eshte institut shumedegesh dhe per kete arsye parimet dhe konceptet themelore qe lidhen me te, te perpunuara gjeresisht nga e drejta civile, jane te zbatueshme, per aq sa kane sens, edhe nga dege te tjera te se drejtes, sic eshte edhe e drejta penale. Nje koncept i tille baze eshte edhe koncepti i nderprerjes se parashkrimit.

Vendimi i denimit penal duhet te ekzekutohet pasi merr forme te prere. Kur quhet se nje vendim merr forme te prere eshte e tepert te analizohet me kete rast. Duke u nisur nga formulimi i nenit 68 te Kodit Penal se, “*Vendimi i denimit nuk ekzekutohet kur nga dita qe ka marre forme te prere kane kaluar: ...*”, arrihet ne perfundimin se afati i parashkrimit te ekzekutimit te vendimit fillon te ece (te llogaritet) nga momenti qe vendimi ka marre forme te prere. Me kete rast shtrohet pyetja se cfare behet me afatin e parashkrimit ne momentin kur vendimi vihet ne ekzekutim, d.m.th. kur i denuari fillon te vuaje denimin e dhene ndaj tij. Pergjigja e kesaj pyetjeje eshte e thjeshte, evidente dhe e natyrshme: *Afati i parashkrimit nderpritet*. Edhe pse ne Kodin Penal nderprerja e parashkrimit te ekzekutimit te denimit nuk eshte parashikuar si koncept juridik, perseri nuk mund te mohohet qe nderprerja e parashkrimit ekziston si gjendje faktike. Ky fakt nuk mund te mos merret parasysh, ndryshe do te krijohej nje *non sens*. Ne qofte se per nje arsye apo nje tjetër, per shkaqe objektive apo subjektive, do te nderpritet procesi i vuajtjes se denimit penal, gje qe do te thote nderprerje e ekzekutimit te vendimit te denimit, atehere natyrshem do te filloje te llogaritet afati i parashkrimit te ekzekutimit te vendimit penal dhe po natyrshem ky afat do te rifilloje te llogaritet nga momenti i nderprerjes se ekzekutimit.

Ne arsyetimin e saj shumica operon edhe me termat “*pezullim*” dhe “*zgjatje*” e afatit te parashkrimit, te cilat si terma juridike te perdorura ne dege te tjera te se drejtes (jo ne te drejten penale) marrin kuptime te vecanta e te ndryshme nga termi “*nderprerje e parashkrimit*”. *Pezullimi* dhe *zgjatja* e afatit te parashkrimit nuk kane sens te pranohen si te barazvlefshme me konceptin e nderprerjes se parashkrimit dhe as si gjendje fakti te lidhura me konceptin juridik te parashkrimit te ekzekutimit te vendimit te denimit penal. Per rrjedhoje, perdorimi i tyre ne kete ceshtje ne cfaredo lloj konteksti nuk mund te jete i pranueshem.

Shumica ka plotesisht te drejte kur citon se “*zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet*”, por, persa i perket problemit te pranimi ose jo te konceptit te nderprerjes se parashkrimit, perdorimi i ketij pohimi nuk ka vend, thjeshte sepse nuk ka lidhje me te. Ndalimi i zbatimit te ligjit penal me analogji rezulton jo vetem i parashikuar ne menyre te shprehur ne nenin 1/c te Kodit Penal, por del edhe nga interpretimi ne teresi i permbajtjes se neneve 1, 2, 3 etj. te Kodit Penal dhe vepron brenda kuadrit te ketyre dispozitave themelore, qe percaktojne kuptimin e vepres penale e te denimit; padenueshmerine e personit per nje veper qe me pare nuk eshte e parashikuar shprehimisht ne ligj si e tille, ose me nje lloj apo mase denimi te paparashikuar shprehimisht ne dispoziten perkatese; kuptimin e veprimit te ligjit penal ne kohe, hapesire e ndaj personave; ndalimin e fuqise prapavepruese te ligjit penal; etj.

Pakica nuk eshte dakord edhe me perfundimin e nxjerre nga shumica, sipas te cilit, po te pranohet nderprerja e parashkrimit te ekzekutimit te vendimit, do te krijohej nje pabarazi perpara ligjit midis personave qe vuajne rregullisht denimin pa nderprerje, nga njera ane, dhe atyre qe e kane nderprere vazhdimin e metejshe me vuajtjes se denimit per cfaredo lloj shkak, nga ana tjetër.

Rregulli eshte i njejte per te gjithë: kushdo qe eshte denuar me nje vendim penal te formes se prere duhet t'i neneshtrohet plotesisht vuajtjes se ketij denimi, sipas llojit dhe mases se denimit te dhene. Mosekzekutimi i vendimit apo nderprerja e ekzekutimit jane raste perjashtimore te

imponuara nga shkaqe apo rrethana jo normale ne funksionimin e shtetit apo te strukturave te caktuara te tij. Sidoqofte keto struktura te shtetit kane te drejte dhe jane te detyruara te marrin te gjitha masat e duhura per te mundesuar venijen ne ekzekutim apo rivenijen ne ekzekutim te nje vendimi denimi brenda afatit perkates te parashkrimit. Koha e venijes apo e rivenijes ne ekzekutim te nje vendimi pas nderprerjes se ekzekutimit, nuk ndikon ne, e as kushtezohet nga sasia e denimit te vuajtur apo te mbetur ende pa u vuajtur. I vetmi ndryshim eshte qe dikush do ta vuaje me shpejt e dikush me vone denimin perkates qe i ka dhene gjykata. Denimi do te filloje te vuhet apo pjesa e mbetur e tij do te rifilloje te vuhet, gjersa ekzekutimi nuk eshte parashkruar apo nuk eshte vertetuar ndonje shkak tjetër i perligjur qe do ta pengonte nje gje te tille.

Edhe pse shkaqe e rrethana te caktuara, jashte vullnetit te ligjvenesit, ne keto raste krijojne gjendje fakti te pabarabarta persa i perket vuajtjes se denimit nga grupe te caktuara te denuarish, keto pabarazi nuk perbejne ndonje diskriminim negativ ne kuptim te nenit 18 te Kushtetutes. Ne keto raste per diskriminimin ekziston nje perligje objektive. Vete instituti i parashkrimit te ekzekutimit te vendimit penal perben ne vetvehte nje perjashtim nga rregulli i pergjithshem per ekzekutimin e vendimeve. Eshte e padiskutueshme qe cdo perjashtim nga rregullat e pergjitheshme perben ne thelb nje trajtim te pabarabarte per kategori te caktuara personash. P.sh. Nder dy te denuar te gjykuar ne mungese, per shkak se i jane fshehur gjykimit, njeri dorezohet vullnetarisht dhe i nenshtrohet ekzekutimit te denimit, ndersa tjetri vazhdon te fshihet per nje kohe te gjate gjersa te plotesohet afati i parashkrimit. Por ne qofte se kapet edhe kur ka mbetur vetem nje dite para se te jete plotesuar afati i parashkrimit ai do t'i neneshtrohet vuajtjes se plote te denimit qe i eshte dhene. Mund te jepen shembuj te ndryshem te cilet tregojne per nje trajtim te pabarabarte, megjithate nuk mund te pranojme se eshte shkelur parimi kushtetues i barazise para ligjit. Per me teper diskriminimi qendron ne mohimin e nje te drejte per nje person apo grupim te caktuar ne raport me te tjeret dhe jo ne permbushjen e nje detyrimi ligjor, sic eshte ne rastin konkret detyrimi per ekzekutimin e nje vendimi gjyqesor.

Sidoqofte pabarazia e krijuar si rezultat i zbatimit te institutit te parashkrimit dhe i situatave te ndryshme qe mund te krijohen ne kete proces zbatimi, ekziston si nje perligje e arsyeshme dhe objektive (*neni 18/3 i Kushtetutes*).

Bazuar ne arsyetimin e mesiperem, pakica konkludon qe si vendimi i shkalles se pare, ashtu edhe vendimi i gjykates se apelit, ne kohen qe jane dhene, e kane zgjidhur drejt ceshtjen, prandaj duhej te ishin lene ne fuqi.

Duke qene se afati i parashkrimit te ekzekutimit te vendimit ka rifilluar te ece me date 13.03.1997, kur i denuari Blerim Llukani eshte larguar nga burgu (*eshte nderprere vuajtja e denimit*), ky afat eshte plotesuar me daten 13.03.2002.

Zgjidhja e ceshtjes ne kete menyre do te sherbente si motiv nxites per te denuarit qe jane larguar nga burgjet gjate trazirave te marsit 1997 per t'u kthyer vullnetarisht ne vendet e vuajtjes se denimit.

Persa i perket te denuarit Blerim Llukani Kolegjet e Bashkuara duhej te ishin shprehur duke percaktuar si date te parashkrimit te ekzekutimit te denimit daten 13.03.2002, gje qe duhej ta bente vete Kolegji Penal me date 18.04.2002 kur ka gjykuar ceshtjen.

Perikli Zaharia

Thimjo Kondi

Zamir Poda

Nikoleta Kita

Nr.7 i Regj. Themeltar.
Nr.6 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Spiro Spiro	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Bashkim Caka	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Evgjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare
Metush Saraci	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 11.10.2002, moren ne shqyrtim ceshtjen penale nr. 7, qe i perket:

KËRKUES: EDMIR GJOKICAJ, i biri i Xhevdetit, i
datelindjes 1973, banues ne Shkoder, i denuar.

OBJEKTI:

Rishikimi i vendimit penal te formes se prere
Nr. 85, date 17.03.2000
te Gjykates se rrethit gjyqesor Shkoder

Gjykata e rrethit gjyqesor Shkoder, me vendimin nr. 256, date 22.10.2001, ka vendosur:

Mospranimin e kerkeses per rishikimin e vendimit penal nr. 85, date 17.03.2000 te po asaj gjykate, dhene ndaj te denuarit Edmir Gjokicaj.

Gjykata e Apelit Shkoder, me vendimin Nr. 197, date 21.12.2001 vendosi

Ndryshimin e vendimit te mesiperm, pranimin e kerkeses per rishikim dhe kthimin e akteve Gjykates se shkalles se pare te rrethit gjyqesor Shkoder, per shqyrtimin e ceshtjes.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Shkoder ka ushtruar rekurs prokurori, i cili kerkon prishjen e tij dhe kthimin e ceshtjes po asaj gjykate per rishqyrtim duke parashtruar keto shkaqe:

- Ne kërkesen për rishikim janë paraqitur si prova të reja tre deklaratat noteriale mbi bazën e të cilave kërkohet shqyrtimi i ceshtjes e dhenia e pafajesisë. Këto tre deklaratat gjykata i quan ligjore e të marra konform rregullave proceduriale duke mos patur parasysh kërkesat e nënveve 450 e 452 të K.Pr.Penale.
- Deklarat noteriale të paraqitura nuk mund të konsiderohen prova të reja e ato nuk mund të sjellin bindje për tu trajtuar në gjykimin e ceshtjes.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 353, datë 23.05.2002, vendosi kalimin e ceshtjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore në lidhje me ceshtjet e mëposhtme:

1. Në kuptim të nenit 453/2 të K.Pr.Penale, a ka të drejtë prokurori të bëjë ankim kundër vendimit të pranimit të kërkesës për rishikim dhe në përgjithësi, pala jo kërkuese, kundër vendimit të pranimit të kërkesës?
2. Çfarë do të kuptohet me rregullimin ligjor të parashikuar nga neni 450, pikë 1, shkronja "c", kur thuhet se: "Kur pas vendimit kanë dalë, ose janë zbuluar prova të reja..."? Për këtë duhen patur parasysh edhe ato prova që nuk janë shqyrtuar gjatë gjykimit dhe që nuk janë kërkuar nga palët, megjithatë dihen prej tyre, apo vetëm ato që janë zbuluar pas dhenies së vendimit, me kusht që pala që e kërkon të mos kish dijeni për ekzistencën e tyre?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionet e anetareve Nikoleta Kita dhe Bashkim Caka, prokurorin Artur Selmani, i cili kërkoi lenien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkoder, përfaqësuesin e kërkuesit avokat Fatos Shanaj, i cili kërkoi lenien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkoder dhe pasi e biseduan ceshtjen në teresi,

V Ë R E J N Ë

Vendimi nr.197, datë 21.12.2001, i Gjykatës së Apelit Shkoder është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet të priset.

Gjatë shqyrtimit të akteve që ndodhen në dosjen penale që i përket kërkuesit Edmir Gjokicaj dhe gjatë gjykimit të ceshtjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u konstatua se, me vendimin nr.85, datë 17.03.2000, kërkuesi është deklaruar fajtor për krimet e vrasjes me dashje dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga nenet 76 dhe 278/II të Kodit Penal për të cilat u denua me 15 (peshembdhjete) vjet burgim, vendim, i cili u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkoder, me vendimin e saj nr.54, datë 28.04.2000 dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 482, datë 10.11.2000, të tij.

Me datë 02.10.2001, avokatet Kujtim Capo e Bahri Piri paraqiten, në Gjykatën e rrethit gjyqësor Shkoder, kerkese për rishikimin e vendimit të saj nr. 85, datë 17.03.2000, me pretendimin se, pas dhenies së këtij vendimi, janë zbuluar prova të reja, të paditura me pare, që hedhin dritë mbi pafajesinë e kërkuesit.

Bashkë me kërkesen, si prova të reja, të zbuluara rishtazi, në kuptim të nenit 450/c të K.Pr.Penale, u paraqiten tre deklaratat në emer të shtetasve Ruzhdi Tafili, Skender Mani dhe Nazmi Mehja, (pa shënuar datën e lëshimit të tyre), nënshkrimet e të cilëve janë vertetuar nga noteri Klement Radovani, me 12.10.2001.

Me anë të këtyre deklaratave, ata shprehën se, ditën dhe orën e vrasjes (për të cilën është deklaruar fajtor dhe denuar kërkuesi), e kanë parë atë, duke festuar ditëlindjen, duke ngrënë e duke pirë, në fshatin Zus, vend ky i ndryshëm nga vendi ku kishte ndodhur ngjarja.

Gjykata e rrethit gjyqesor Shkoder, me vendimin nr. 256, marre ne dhomen e keshillimit me date 22.10.2001, vendosi mospranimin e kerkeses me arsyetimin se ajo eshte bere jashte rasteve te parashikuara nga neni 450 i K.Pr.Penale dhe se kuptimi i shkronjes "c" te kesaj dispozite eshte qe prova e pretenduar te kete ekzistuar ne kohen e kryerjes se vepres penale, por objektivisht, ajo nuk njihej ose nuk mund te merrej.

Ky vendim u ndryshua nga Gjykata e Apelit Shkoder, duke vendosur pranimin e kerkeses per rishikim me arsyetimin se ajo eshte bere ne perputhje me kerkesat e nenit 450/c te K.Pr.Penale.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arriten ne perfundimin se vendimi i Gjykates se Apelit Shkoder eshte marre jo ne perputhje me kerkesat e K.Pr.Penale.

Pervec kesaj, ne marrjen e vendimit nga ana e asaj gjykate (Gjykates se Apelit Shkoder) nuk jane patur parasysh edhe disa parregullsi ne dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi bashke me kerkesen per rishikim, parregullsi qe jane lejuar nga gjykata e shkalles se pare, qe ne fillim kur eshte depozituar ky dokumentacion ne sekretarine e asaj gjykate dhe te cilat jane anashkaluar, pa u vene ne dukje, edhe nga Gjykata e Apelit Shkoder.

Keshtu, nga shqyrtimi i akteve qe ndodhen ne dosje, konstatohet se, ne vete kerkesen qe eshte paraqitur, nga avokatet, per rishikim, nuk eshte shenuar data ne te cilen ajo eshte perpiluar. Nderkohe, konstatohet se, ne permbajtjen e kesaj kerkeses, pervec te tjerave, thuhet se i paraqiten gjykates, bashkengjitur, deklaratat e shtetasve Ruzhdi Tafili, Skender Mani e Nazmi Nuh Mehja.

Mirepo, megjithese, ne te tre keto deklarata nuk eshte shenuar data e leshimit, ne shpinen e seciles prej tyre, figuron autentifikimi i nenshkrimet te deklaruesve nga noteri Klement Radovani, autentifikim qe mban daten 12.10.2001, dmth 16 dite pas dates qe mban shenimi per ardhjen e kerkeses per rishikim ne gjykatën e shkalles se pare.

Keto parregullsi ngjallin dyshime se sekretaria gjyqesore ka lejuar qe edhe pas depozitimit te akteve e formimit te dosjes te behen nderhyrje ne to, duke kompromentuar rende rregullsine e procesit gjyqesor, mbasi nuk ka asnje garanci per nje proces te paanshem, objektiv e te ndershem.

Parregullsi te kesaj natyre diktonin kthimin, ne rruge administrative, pa veprim, te ketyre akteve, nga ana e sekretarise se gjykates dhe meqenese ato u lejuan derisa kerkesa u shqyrtua ne dhomen e keshillimit dhe ceshtja arriti per t'u gjykuar ne gjykatën e apelit, kjo e fundit duhej te vendoste mosmiratimin e ankimit, duke i vene ne dukje, ne vendimin e saj, keto parregullsi, si te meta serioze per gjykatën e shkalles se pare.

Persa u takon problemeve ligjore, qe kane lindur gjate gjykimit te ceshtjeve me objekt rishikimin e vendimeve penale te formes se prere, per unifikimin e te cilave kjo ceshtje ka ardhur ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, keto kolegje arriten ne perfundimet e meposhtme:

Persa i perket ceshtjes se pare qe eshte shtruar per unifikimin e praktikes gjyqesore te deritanishme, sipas se ciles a ka te drejte prokurori, dhe ne pergjithesi pala jo kerkuese, te beje ankim kunder vendimit te pranimit te kerkeses per rishikim, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se kesaj çeshtjeje i duhet dhene pergjigje e kushtezuar me ndryshimet qe jane bere ne K.Pr.Penale, ne lidhje me institutin e rishikimit te vendimeve penale te formes se prere, me ligjin nr. 8813, date 13.06.2002, "Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr. 7595, date 21.03.1995 "Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise", ndryshime keto te bera nga ligjvenesi pasi per kerkesen per rishikim, objekt shqyrtimi ne keto kolegje, ishin marre vendimet perkatese si nga gjykata e shkalles se pare, ashtu edhe nga ajo e apelit. Kjo ka te beje sidomos me faktin se, ndryshe nga ç'parashikohej ne nenin 452 te K.Pr.Penale, (te pandryshuar) qe kerkesa e rishikimit paraqitej ne sekretarine e gjykates se rrethit qe kishte dhene vendimin, e cila e shqyrtonte ate ne dhomen e keshillimit, me ndryshimet qe ka pesuar kjo dispozite, kerkesa bashke me provat dhe dokumentet eventuale qe e perligjin ate, paraqitet ne sekretarine e Gjykates se Larte (neni 57 i ligjit nr. 8813, date 13.06.2002), Kolegji Penal i se ciles e shqyrtonte ate ne dhomen e keshillimit, pa pranine e paleve. Vendimi i ketij kolegji eshte i formes se prere, si kur vendoset mospranimi, ashtu edhe pranimi i

kerkeses (neni 58 i ligjit nr. 8813, date 13.06.2002). Keshtuqë, problemi nese ka apo jo te drejte prokurori dhe ne pergjithesi pala jo kerkuese te beje ankim kunder vendimit te pranimit te kerkeses per rishikim, vetvetiu duhet te konsiderohet i kapercyer tashme.

Ne rastet kur Kolegji Penal i Gjykates se Larte pranon kerkesen per rishikim, vendos prishjen e vendimit te formes se prere dhe ceshtjen e dergon per rigjykim, nga nje tjetër trup gjykues, ne gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ose ne gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të kesaj të fundit.

Kuptohet që, ne keto raste edhe prokurori dhe ne pergjithesi pala jo kerkuese, legjitimohet te ushtroje te gjitha te drejtat e pjesemarrësve ne procesin penal, perfshire edhe te drejten e ankimit, ne gjykatën me te larte, kunder vendimit te gjykates se shkallës së parë dhe te apelit kur nuk është i te njejtë mendim me menyren e zgjidhjes se ceshtjes se rishikuar, tashme, prej tyre.

Ne kete perfundim arrihet duke u nisur nga permbajtja e dispozites se nenit 455/1 te K.Pr.Penale, sipas se ciles ne gjykimin e rishikimit respektohen dispozitat e gjykimit te shkallës së parë brenda kufijve te shkaqeve te parashtruara ne kerkesen e rishikimit.

Ne lidhje me ceshtjen tjetër që është shtruar per unifikim para Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, e cila ka te beje me kuptimin e shkronjes “c” te nenit 450 te K.Pr.Penale, per te arritur ne perfundime sa me te sakta e te drejta ne harmoni me frymen e pergjithshme te legjislacionit procedural penal ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe me qellimin e ligjvenesit ne parashikimin e institutit te rishikimit te vendimeve penale te formes se prere, gjate shqyrtimit te kesaj ceshtjeje, **Kolegjet e Bashkuara, çmojne se duhet patur parasysh jo thjesht dhe vetem kuptimi i permbajtjes se kesaj shkronje, por interpretimi teresor i kesaj dispozite ne frymen e kuptimit dhe qellimit te institutit te rishikimit, ne pergjithesi dhe te problemeve që zgjidhen ne praktike nepermjet zbatimit drejt te dispozitave te ketij instituti rast pas rasti, ne veçanti, ne kuader te dhenies se drejtesise ne kuptimin e plote te kesaj fjale, dmth per dhenien dhe zbatimin perfundimtar te vendimeve penale që i pergjigjen realisht te vertetes.**

Dihet se, rishikimi i vendimeve penale te formes se prere është nje mjet i jashtezakonshem, madje i vetmi, që parashikohet nga ligjvënësi ne K.Pr.Penale per te ndrequr gabimet e mundshme gjyqesore, (ne lidhje me vendimet e formes se prere).

Procesi gjyqesor që zhvillohet nepermjet rishikimit, nuk është nje proces thjeshte revizionimi, (ne kuptimin e ngushte te fjales), te nje procesi te meparshem, por gjykata ne perfundim te tij, mbasi administron e vlereson faktet, rrethanat dhe provat që jane paraqitur rishtaz nga palet, se bashku dhe ne harmoni me provat, rrethanat dhe faktet e administruara dhe te vleresuara ne perfundim te gjykimit te meparshem, mund te arrije ne perfundime te ndryshme, madje dhe krejtesisht te kunderta me ato që kishte arritur ne gjykimin e parë dhe te jape vendim po krejtesisht te kundert. Nga vendim fajesie që mund te jete dhene ne perfundim te gjykimit te parë, gjykata, ne perfundim te gjykimit te rishikimit mund te dale me vendim pafajesie (kur kërkesa e rishikimit behet nga pala e te denuarit) dhe anasjelltas (kur kërkesa e rishikimit behet nga prokurori).

Eshte pikerisht kjo arsyeja që ligjvënësi rishikimin e vendimeve te formes se prere e ka lejuar vetem ne raste rigorozisht te percaktuara, te cilat i ka parashikuar, ne menyre te shprehur, ne nje dispozite te posacme te K.Pr.Penale, konkretisht ne nenin 450 te tij, te cilen e ka emertuar “Rastet e rishikimit”.

Sipas kesaj dispozite, rishikimi mund te kerkohet nga palet vetem neqoftese ekziston ndonjeri prej shkaqeve te parashikuara shprehimisht ne te dhe per asnje shkak dhe rast tjetër. Shkaqe te tilla jane: a) kur faktet e vena ne themel te vendimit nuk pajtohen me ato te nje vendimi tjetër te formes se prere; b) kur vendimi është bazuar ne nje vendim te gjykates civile, i cili është revokuar me pas; c) kur pas vendimit kane dale ose jane zbuluar prova te reja, te cilat vetem ose se bashku me ato që jane

vleresuar nje here, tregojne se vendimi eshte i gabuar dhe ç) kur vertetohet se vendimi eshte dhene si pasoje e falsifikimit te akteve te gjykimit, ose te nje fakti tjetër te parashikuar nga ligji si veper penale.

Ekzistenca, qofte edhe vetem e njerit prej ketyre rasteve, sherben si shkak per te kerkuar rishikimin e nje vendimi penal te formes se prere.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, konstatojne se, ne praktiken e deritanishme, pas hyrjes ne fuqi te K.Pr.Penale, rishikimi eshte kerkuar nga palet, (kryesisht nga i denuari ose perfaqesuesi i autorizuar prej tij), me pretendimin se, pasi vendimi i dhene ka marre forme te prere, kane dale ose jane zbuluar prova te reja dhe per kete eshte pretenduar se vendimi eshte i gabuar dhe duhet te rishikohet.

Gjate gjykimit te ketyre kerkesave, qofte ne dhomen e keshillimit (kur eshte vendosur mospranimi) ashtu edhe gjate shqyrtimit gjyqesor (kur kerkesat jane pranuar dhe çeshtja eshte rigjykuar) jane konstatuar interpretime te ndryshme ne lidhje me faktin se çdo te kuptohet me “prova te reja”, si dhe se kur do te quhet se ato kane dale ose zbuluar pas dhenies se vendimit. Per rrjedhoje, jane mbajtur qendrimet te ndryshme, shpesh edhe kontraktore, sikurse ka ndodhur edhe midis qendrimëve qe jane mbajtur nga gjykata e rrethit gjyqesor dhe ajo e apelit Shkoder, ndaj kerkeses se perfaqesuesve te te denuarit Edmir Gjokicaj, çeshtje qe ka ardhur per zgjidhje dhe unifikim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arriten ne perfundimin se vendimi nr. 197, date 21.12.2001, i Gjykates se Apelit Shkoder eshte i gabuar, pasi eshte marre ne kundërshtim me ligjin. Nga ana e kesaj gjykate eshte interpretuar gabim kuptimi i permbajtjes se shkronjes “c”, te nenit 450 te K.Pr.Penale, pasi kerkesa per rishikim qe eshte paraqitur nga perfaqesuesit e te denuarit Edmir, edhe sikur te mos ekzistonin parregullsite qe u permenden ne pjesen e pare te ketij vendimi, nuk i plotesonte kushtet per t’u konsideruar si nje nga rastet qe ligjvenesit ka parashikuar se mund te kerkohet rishikimi i vendimeve penale te formes se prere.

Deklaratat e leshuara nga tre shtetas te ndryshem nuk mund te konsiderohen prova, ashtu sikurse kerkohet, ne forme qartesisht te shprehur, ne shkronjen “c” te nenit 450 te K.Pr.Penale.

Si shkresat, dokumentat, ashtu edhe objektet te natyres materiale, per t’u paraqitur si shkak per rishikimin e vendimit duhet te plotesojne bashkerisht dy kushte: se pari, te kene dale ose te jene zbuluar pasi vendimi kishte marre forme te prere dhe se dyti, nga pikepamja e formes procedurale, te jene prova, ne kuptimin qe i jep proves ligjvenesit ne dispoziten e nenit 149 te K.Pr.Penale.

Ato, jo vetem qe duhet te permbajne njoftime mbi faktet e rrethanat qe lidhen me vepren penale per te cilat eshte deklaruar fajtor dhe denuar personi, por edhe te jene marre nga njeri prej burimeve te parashikuara ne ligjin procedural penal, ne perputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe qe sherbejne per te vertetuar moskryerjen prej tij te vepres penale, kerkesa keto qe nuk i plotesojne deklaratat e paraqitura si shkak per rishikim ne rastin konkret.

Fakti qe, pasi jane leshuar, ato u autentifikuan nga ana e nje noteri, ashtu edhe sikurse ato te ishin redaktuar teresisht prej tij (noterit) nuk sjell asnje ndryshim ne ato qe u thane me lart, pasi deklarimet e bera para nje noteri nuk u japin atyre cilesine e proves ne kuptimin e nenit 149 te K.Pr.Penale.

Ne lidhje me ceshtjen tjetër qe shtrohet per unifikim para Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte dhe qe ka te beje me shprehjen e perdorur nga ligjvenesit: “ Kur pas vendimit, kane dale, ose jane zbuluar prova te reja...”, duhen patur parasysh edhe ato prova qe nuk jane shqyrtuar gjate gjykimit dhe qe nuk jane kerkuar nga palet, megjithese diheshin prej tyre, apo vetem ato qe jane zbuluar pas dhenies se vendimit, me kusht qe pala qe e kerkon te mos kish dijeni per ekzistencen e

tyre, kolegjet, arriten ne perfundimin se **prova qe sherben si shkak per rishikim duhet te jete e re, ne kuptimin qe ajo te kete dale ose te jete zbuluar pasi vendimi te kete marre forme te prere.**

Ne lidhje me kete ligjvenesie ka perdorur shprehjet: "... kane dale" ose "jane zbuluar". Kuptimi i ketyre dy shprehjeve, nga pikepamja e qellimit te perdorimit te tyre, ne permbajtjen e shkronjes "c" te nenit 450 te K.Pr.Penale, eshte i njejte. **Ne te dy rastet behet fjale per prova, te cilat, megjithese kane ekzistuar objektivist ne kohen kur u shqyrtua ceshtja, ato nuk ishin paraqitur nga palet deri ne momentin qe vendimi ka marre forme te prere, pasi ekzistenca e tyre nuk dihej, deri atehere, prej tyre (paleve).** Mosdijenja e paleve per ekzistencen e ketyre provave, ne keto raste e ka burimin ose ne mosthellimin e tyre ne procesin e zbulimit ose ne pamundesine dhe pengesat reale qe ato mund te kene hasur gjate ketij procesi.

Veshtiresite dhe pengesat ne keto raste mund ta kene burimin sa ne mosthellimin dhe mungesat profesionale te personave qe jane te ngarkuar me zbulimin dhe administrimin e provave, te nje vepre penale, aq edhe ne veprimtarine keqberese te personave te interesuar, per fshehjen, prishjen dhe manipulimin e tyre.

Dallimi midis shprehjeve "... kane dale..." dhe "... jane zbuluar", konsiston ne faktin se shprehja e pare perdoret ne rastin kur ekzistenca e provave te reja qe kane lidhje me nje vendim penal te formes se prere te meparshem evidentohet gjate nje procesi hetimor ose gjyqesor tjetër, i cili nuk ka lidhje me ceshtjen per te cilen eshte dhene vendimi qe kerkohej te rishikohet dhe jane fiksuar ne aktet procedurale (proces-verbalet) e dosjes perkatese. Kurse e dyta, kur palet e interesuara, per te verifikuar pretendimet ose dyshimet e tyre ne lidhje me vertetesine dhe drejtesine e vendimit te dhene, kryejne veprimtari verifikuese, mbasi ky vendim ka marre formen e prere.

Duke u bazuar ne sa u tha me lart, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte arriten ne perfundimin se **provat qe diheshin prej paleve, qe para se vendimi te merrte formen e prere, nuk mund te konsiderohen prova te reja, ne kuptim te shkronjes "c" te nenit 450 te K.Pr.Penale, pavaresisht nga arsyeja e mosparaqitjes se tyre ne ate kohe.**

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte bazuar ne nenin 441/c te K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.197, date 21.12.2001, te Gjykates se Apelit Shkoder dhe lenien ne fuqi te vendimit nr.256, date 22.10.2001, te Gjykates se rrethit gjyqesor Shkoder.

Ky vendim unifikues te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane me 11.10.2002

MENDIMI I PAKICËS

Kemi mendimin se trajtimi i problemit dhe per pasoje zgjidhja e çeshtjes me vendimin e shumices nuk eshte i drejte.

Vendosja e institutit te “rishikimit” ne K.Pr.Penale miratuar me ligjin nr. 7905 date 21.3.1995, i cili ne vetvete eshte nje mjet i rendesishem ankimi qe jep mundesine per rivendosjen e nje te drejte qe mund te jete shkelur, krijoi hapesine per palet ne gjykim qe ta ushtrojne kete te drejte ne perputhje me kriteret e percaktuara. Ky institut parashikohet ne kreun e IV te Kodit Penal ne 13 nene. Neni 449 percakton ne piken 1 se “ne rastet e caktuara me ligj lejohet ne cdo kohe rishikimi i vendimit qe ka marre formen e prere, edhe kur denimi eshte ekzekutuar ose eshte shuar” dhe ne piken 2 “vendimet e pafajesise per krime mund te rishikohen me kerkesen e prokurorit, por me kusht qe te mos kene kaluar 5 vjet nga dhenia e vendimit”.

Nga permbajtja e ketij neni dhe e nenit 451 te K.Pr.Penale del qarte se kerkesa per rishikim mund te behet nga i denuari ose kujdestari i tij (dhe kur ai ka vdekur nga trashegimtari apo nje i aferm i tij) dhe nga prokurori prane gjykates qe ka dhene vendimin.

Pa dashur te trajtojme gjithë problemet qe parashikohen per rishikimin ne K.Pr.Penale, ashtu siç u trajtua ne shqyrtimin e ceshtjes nga Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, problemin baze e perben neni 450 i K.Pr.Penale qe parashikon se kur mund te kerkohet rishikimi. Rastet qe parashikohen ne germen “a”, “b” te atij neni, jane te kuptueshme dhe nuk kane lindur probleme ne praktike (kur faktet e vena ne themel te vendimit nuk pajtohen me ato te nje vendimi tjeter te formes se prere dhe kur vendimi eshte bazuar ne nje vendim te gjykates civile, i cili eshte revokuar me pas). Po e njejta gje duhet thene edhe per rastin e parashikuar ne piken “ç” (kur vertetohet se vendimi eshte dhene si pasoje e falsifikimit te akteve te gjykimit ose te nje fakti tjeter te parashikuar nga ligji si veper penale).

Probleme kane lindur ne vazhdimesi ne praktiken gjyqesore lidhur me zbatimin e rasteve qe parashikohen ne germen “c” te nenit 450 te K.Pr.Penale ku thuhet:

“Kur pas vendimit kane dale ose jane zbuluar prova te reja, te cilat vetem ose se bashku me ato qe jane vleresuar njehere, tregojne se vendimi eshte i gabuar”.

Nga permbajtja e kesaj germe dalin disa probleme si :

- a. ç’duhet te kuptohet me termat “kane dale ose jane zbuluar prova te reja”;
- b. po termi prova te reja ne kete rast si duhet kuptuar, ne çforme do te merret, kush do ta marre, ne ç’forme do t’i paraqitet gjykates?

Duke qene nje mjet i vecante ankimi (por shume i rendesishem ne disa raste per menjanimin e shkeljeve qe kane sjelle si pasoje marrjen e nje vendimi penal gjyqesor jo te bazuar) dhe nga permbajtja qe ka neni 450, del qarte se rastet e ushtrimit te kesaj te drejte jane te kufizuara. Kryesisht, ne praktiken e gjykatave, vihet re se kerkesa per rishikim te vendimeve jane bere vetem ne mbeshtetje te gernes “c” dhe per kete qellim nga te pandehurit apo mbrojtetit e tyre jane marre deklarata me shkrim nga persona qe kane paraqitur rrethana te reja te ndryshme nga ato qe jane marre ne gjykimin e ceshtjes e qe vene ne dyshim permbajtjen e atij vendimi gje qe, nese e cmon e pranon gjykata, mund te sherbeje si baze per rishikimin apo dhe prishjen e nje vendimi gjyqesor te dhene me pare.

Per te ruajtur autenticitetin dhe saktesuar identifikimin e personave qe tregojne rrethana te reja, keto deklarime jane bere para noterit (gje qe tregon edhe faktin se i pandehuri apo mbrojteti i tij ne kete menyre kerkojne te rritin pergjegjesine e personit qe ka bere deklarime e qe ato me pas, ne gjykim, te mos shtremberohen), dhe i jane paraqitur gjykates si prova te reja. Gjykatat jane shprehur per pranimin apo jo te kerkeses per rishikim mbi keto deklarata.

Me te drejte Kolegji Penal i Gjykates se Larte, duke ndjekur praktiken gjyqesore, e ka derguar kete ceshtje per shqyrtim dhe unifikim te praktikës ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte. Kjo per faktin qe u shtrua ne forme pyetjeje edhe me lart se çduhet kuptuar “me prova te reja e si do te merren keto” sepse ne kuptimin e mirefillte te fjales vete deklaratat qofshin apo jo te bera para noterit nuk mund te trajtohen si prova.

Rendesia e ketij vendimi unifikues ka vlerat e tij pavaresisht nga fakti se me ndryshimet e bera ne K.Pr.Penale me ligjin nr. 8813 date 13.6.2002 kompetente per gjykimin e kerkesave per rishikim eshte Gjykata e Larte. Kjo jo vetem per faktin e dhenies se vendimeve te drejta por edhe per te menjanuar rastet e berjes se kerkesave pa plotesuar kriteret per pranimin e tyre.

Ne kete aspekt jemi me te njejtin mendim te shumices per nevojën e unifikimit te praktikës. Po keshthu jemi me te njejtin mendim lidhur me te drejten e prokurorit per te bere ankim kunder vendimit te marre nga gjykata me te cilin eshte pranuar kerkesa per rishikim (siç eshte ne rastin ne shqyrtim qe prokurori me rekurs kerkon prishjen e vendimit nr. 197 date 21.12.2001 te Gjykates se Apelit Shkoder me te cilin eshte vendosur prishja e vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, pranimi i kerkeses se Edmir Gjokicajt per rishikim dhe kthimin e akteve gjykates se shkalles se pare per shqyrtimin e ceshtjes).

Sikurse permendem, eshte e nevojshme te dale qarte se çduhet kuptuar me shprehjen qe percakton germa “c” e nenit 450 te K.Pr.Penale “kane dale ose jane zbuluar prova te reja”. Kuptohet qarte se pari se pala qe kerkon rishikimin (i pandehuri apo prokurori) eshte e domosdoshme qe te paraqese prova te reja pra qe te mos jene administruar e mos i jene nenshtuar shqyrtimit me pare nga gjykata dhe qe te jete zbuluar mbas dhenies se nje vendimi penal qe ka marre forme te prere. Ne kete aspekt duhet pranuar se nuk mund te perbeje prove te re per te rishikuar vendimin nje prove qe eshte kerkuar gjate gjykimit te ceshtjes por qe per arsye te ndryshme nuk eshte marre nga gjykata dhe qe paraqet vlera provuese.

Nocionet “kane dale” ose “jane zbuluar prova te reja” behen te qarta e te kuptueshme edhe nga vete termat qe perdoren por problemi kryesor qe shtrohet per diskutim e zgjidhje eshte se çduhet kuptuar me termin “prova te reja” e si do te merren ato.

Shumica ka mendimin se shkresat, dokumentat apo objektet e natyres materiale mund te paraqiten per rishikimin e vendimit vetem ne rast se ato marrin cilesine e proves sipas percaktimeve te bera ne K.Pr.Penale. Ne nenin 149 te K.Pr.Penale thuhet: “prova jane njoftimet mbi faktet e rrethanat qe lidhen me vepren penale, qe merren prej burimeve te parashikuara ne ligjin procedural penal, ne perputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe qe sherbejne per te vertetuar kryerjen ose jo te vepres penale, pasojat e ardhura prej saj, fajesine ose pafajesine e te pandehurit dhe shkallen e pergjegjesise se tij”, ndersa ne nenin 151 thuhet se “gjate hetimeve paraprake provat merren nga organi qe procedon” e “ne gjykim provat merren me kerkesen e paleve”.

Duke mos e pare te nevojshme te trajtojme llojet e provave qe parashikohen ne Kreun e II te K.Pr.Penale kemi mendimin se ne se do te zbatohet mendimi i shumices per menyren e marrjes se proves, çdo i pandehur apo mbrojtes do te vihej ne pamundesie te plote per te ushtruar te drejten e rishikimit. Ne se do te pranohej qe prove eshte ajo qe merret nga organi qe procedon apo nga gjykata, atehere shtrohet pyetja: si do te merren prej tyre ato fakte qe i pandehuri pretendon t’i paraqese si prova te reja? A kane ndonje detyrim ligjor organi i procedimit dhe gjykata te marrin me cilesine e proves ato qe paraqet i pandehuri me qellim per te rishikuar nje vendim te formes se prere? Keto organe jo vetem qe s’kane asnje detyrim por edhe provat merren prej tyre “gjate hetimeve paraprake” dhe “ne gjykim”. Duke ju referuar ketyre percaktimeve ligjore nuk do te ndodheshin para minimizimit te rasteve te rishikimit te vendimeve penale te formes se prere, por para moszbatimit teresor te gemes “c” te nenit 450 te K.Pr.Penale.

Theksuam se ne praktike jane pranuar per tu diskutuar si prova ne gjykim deklaratat e leshuara nga persona te ndryshem (noteriale apo te thjeshta) te cilat i jane nenshtuar vleresimit te

gjykates ne se jane te mjaftueshme apo jo per tu pranuar te merren si prova. Edhe Kolegji Penal i Gjykates se Larte, ne ato pak raste qe ka shqyrtuar mbi rekurset e ushtruara, eshte bazuar ne po ato deklarata.

Nese do tu qendronim strikt termave qe jep neni 450/c i K.Pr.Penale eshte e nevojshme qe te jepen edhe rruget se si do te gjeje zbatim ai nen e nese shihet se nuk hapet horizont edhe me vendimin e shumices, ne se duhet qe ai te zbatohet, te studiohet mundesia e permiresimit apo ndryshimit te ligjit gje qe do te ishte me e drejte dhe aspak e kontestuar.

Ne rastin ne shqyrtim, Gjykata e Apelit Shkoder, ne marrjen e vendimit per pranimin e kerkeses per rishikim te Edmir Gjokicajt, ka marre per baze deklaratat noteriale te paraqitura prej tij, gje qe bazohet ne eksperiencen dhe praktiken shumevjecare te gjykatave te rrethit, te apelit e te Gjykates se Larte. Per rrjedhoje, vendimi duhet te trajtohet per kohen qe eshte marre e nje vendim gjykate qofte ky edhe unifikues i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte nuk mund te shtrije e te kete efekte prapavepruese por unifikon praktiken qe duhet te zbatohet ne te ardhmen. Per pasoje mendojme se nuk eshte i drejte edhe vendimi i marre per prishjen e vendimit te Gjykates se Apelit Shkoder.

Valentina Kondili

Ylvi Myrtja

Kristaq Ngjela

Agron Lamaj

Nikoleta Kita

Vladimir Metani

Zamir Poda

Vladimir Bineri

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Nikoleta Kita	Anetare
Metush Saraçi	Anetar
Vladimir Metani	Anetar
Vladimir Bineri	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Zamir Poda	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Evjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare

ne seancen gjyqesore te dates 10.10.2002, mori ne shqyrtim ceshtjen penale qe i perket:

KËRKUES: **PROKURORIA E PERGJITHESHME,**

OBJEKTI:

Njohja e vendimit penal
te Gjykates se Apelit Selanik (Greqi)
Nr.651, date 21.09.1999,
ne ngarkim te shtetasit shqiptar Lutfi Daci.
Baza Ligjore: Neni 512,
paragrafi i trete i K.Pr.Penale.

Gjykata e Rrethit Tirane, me vendimin nr. 10 (Akti), date 05.10.2000, ka vendosur:
Njohjen e vendimit penal te Gjykates se Apelit Selanik Nr.651, date 21.09.1999, qe i perket shtetasit shqiptar Lutfi Daci.
Denimi i dhene nga Gjykata Greke me 19 vjet e 6 muaj burgim, per vepren penale te mbajtjes e transportimit te lendeve narkotike kryer ne bashkepunim e ate te kalimit te paligjshem te kufirit konvertohet duke e denuar ne baze te nenit 283/1 e 25 te K.Penal me 15 vjet burgim e ne baze te nenit 297 te K.Penal me 1 vit burgim.

Ne zbatim te nenit 55 te K.Penal, duke bere bashkimin e denimeve e denon perfundimisht me 15 vjet burgim.

Gjykata e Rrethit Tirane, mbi kerkesen e te denuarit Lutfi Daci, me vendim nr.616 (Akti), date 29.10.2001,

Ka rivendosur ne afat te drejten e ankimit te tij kundra vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane nr.10 (Akti), date 05.10.2000, per njohjen e vendimit penal te Gjykates se Apelit Selanik nr.651, date 21.09.1999.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.46, date 08.02.2002, ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane, nr.10 (Akti), date 05.10.2000 per njohjen e vendimit te Gjykates se Apelit Selanik nr.651, date 21.09.1999, qe i perket shtetasit shqiptar Lutfi Daci.

Ndryshimin e ketij vendimi per pjesen qe ka bere konvertimin e denimit per vepren penale te mbajtjes e transportimit te lendeve narkotike ne bashkepunim e ne baze te nenit 283/1 e 25 te K.Penal denimin e Lutfi Dacit me 10 vjet burgim e lenien ne fuqi te vendimit lidhur me denimin per vepren penale te kalimit te paligjshem te kufirit.

Ne zbatim te nenit 55 te K.Penal, duke bere bashkimin e denimeve, denimin e Lutfi Dacit perfundimisht me 10 vjet burgim.

Kunder vendimit te mesiperm te gjykates se apelit ka bere rekurs avokati B. Rusi, i cili kerkon ndryshimin e ketij vendimi dhe caktimin per te denuarin Lutfi Daci te nje denimi me te pershtatshem per arsyet e meposhtme:

- Kualifikimi ligjor i vepres se kryer nga i denuari Lutfi Daci duhet te ndryshohet nga neni 283 ne neni 285 te Kodit Penal qe ka nje denim me te bute, per arsye se ai eshte kapur me kanabis-sativa me forme xhufke qe perdoren per prodhimin e lendeve narkotike pra, me lende qe ne gjendjen qe eshte kapur nuk eshte lende narkotike.
- Duke mbajtur parasysh kete kualifikim ligjor te vepres, faktin qe dispozitat e konventes per transferimin e personave te denuar lene hapsire per vendin ku behet njohja e denimit, te mund te beje uljen e tij. Rrethanat qe lidhen me vete te denuarin Lutfi Daci lejojne qe te behet ulje e metejshme e denimit, duke i caktuar nje denim me te pershtatshem.

Ndersa prokuroria nuk i ka apeluar vendimet e siperpermendura te shkalles se pare dhe as ka ushtruar rekurs kunder vendimit te gjykates se Apelit.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Mbasi degjuan relatimin e gjyqtareve Bashkim Caka e Valentina Kondili, prokurorin Saliko Hajno qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit, mbrojtessin e te denuarit, avokat Baftjar Rusi, qe kerkoi ndryshimin e vendimit lidhur me masen e denimit, e pasi e diskutuan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Nga materialet e dosjes gjyqesore rezulton se me vendimin gjyqesor te formes se prere nr.651, date 21.09.1999 te Gjykates se Apelit Selanik, kerkuesi Lutfi Daci, shtetas shqiptar, eshte denuar me 19 vjet e gjashte muaj burgim per veprat penale te mbajtjes dhe transportimit te lendeve narkotike ne bashkepunim dhe kalim te paligjshem te kufirit shteteror.

I denuari Lutfi Daci ka kerkuar qe te transferohet ne Shqiperi per te vuajtur denimin e dhene nga gjykata e shtetit grek, bazuar ne Konventen e Keshillit te Europes «Per transferimin e

personave te denuar» dhe te marreveshjes bilaterale midis Greqise dhe Shqiperise date 17.5.1993 «Per ndihmen e ndersjellte gjyqesore ne fushen penale, civile dhe te transferimit te te burgosurve»

Gjykata e shkalles se pare Tirane, me vendimin nr.10 akti, date 29.10.2001 ka bere njohjen e vendimit penal te dhene nga gjykata e Selanikut te Greqise duke caktuar perfundimisht per te dy veprat penale 15 vjet burgim per te denuarin Lutfi Daci.

I denuari Lutfi Daci ka pretenduar se Gjykata e rrethit Tirane e ka marre vendimin e mesiperme ne mungese te tij, pa u perfaqesuar ai nga ndonje avokat mbrojtës i caktuar prej tij dhe as nga ndonje mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata dhe, per rrjedhoje, ai ka marre dijëni per vendimin e dhene mbasi eshte bere transferimi i tij ne Shqiperi. Mbi bazen e ketij pretendimi i denuari ka kerkuar rivendosjen ne afat te ankimit.

Gjykata e shkalles se pare Tirane, me vendimin nr.616, akti, date 29.10.2001 ka pranuar kerkesen e te denuarit dhe ka vendosur rivendosjen e tij ne afat per te bere ankim kunder vendimit nr.10 akti, date 29.10.2001 qe ka bere njohjen e vendimit penal te dhene nga gjykata e shtetit Grek. Gjykimi eshte zhvilluar pa pjesemarrjen e prokurorit dhe vendimi nuk i eshte komunikuar atij.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin e saj nr.46, date 8.02.2002 ka vendosur ndryshimin e vendimit te gjykates se shkalles se pare lidhur me konvertimin e denimit dhe ka caktuar si mase denimi ndaj tij 10 vjet burgim duke arsyetuar se gjykata e rrethit ka vepruar drejt qe e ka kualifikuar krimin e kryer nga i denuari ne Greqi sipas nenit 283 te Kodit Penal te Shqiperise, por, sipas gjykates se Apelit, gjykata e rrethit ka gabuar qe e ka konvertuar denimin e dhene nga gjykata greke me maksimumin e denimit qe parashikon neni 283 i Kodit Penal shqiptar per krimin e mbrajtjes e transportimit te lendeve narkotike. Ne uljen e mases se denimit gjykata e Apelit ka vleresuar si rrethana lehtesuese faktin qe i denuari nuk ka qene perserites, qe ai eshte i martuar dhe ka ne ngarkim dy femije te mitur, si dhe faktin qe ka manifestuar sjellje te mira gjate vuajtjes se denimit ne burgun grek.

Per kete kategori ceshtjesh, ne praktiken e deritanishme te gjykatave te rretheve e te apeleve, kane dale disa probleme, qe kane te bejne me menyren e kuptimit dhe zbatimit te dispozitave te titullit te dhjete, kreut te trete, seksioni i pare i K.Pr.Penale, qe rregullojne ekzekutimin e vendimeve penale te huaja (nenet 512-518) dhe konkretisht:

1- Ne kuptim te neneve 407, 431, 432 dhe neneve 512 deri te 518 te K.Pr.Penale, a kane te drejte palet te bejne ankim kunder vendimit te shkalles se pare dhe rekurs kunder vendimit te gjykates se apelit, per rastet e vendimeve me te cilat eshte bere njohja e vendimeve penale te huaja dhe konvertimi i denimit?

2- A ka te drejte i pandehuri ose mbrojtësi i tij qe per kete kategori ceshtjesh qe kane te bejne me njohjen e vendimeve penale te huaja, ne zbatim te nenit 147 te K.Pr.Penale te kerkoje rivendosjen ne afat te ankimit per ne gjykatën e apelit ose te rekursit per ne Gjykatën e Larte?

3- Ne kuptim te neneve 512 deri 518 K.Pr.Penale, a ka te drejte gjykata e apelit te ndryshoje vendimin e gjykates se shkalles se pare qe ka bere njohjen e vendimit penal te huaj, duke ulur mases e denimit te konvertuar, e te dhene nga gjykata e rrethit, ne rastet kur ajo pranon shqyrtimin e ankimit?

Per keto arsye Kryetari i Gjykates se Larte, per te bere njesimin e praktikës gjyqesore, bazuar ne nenin 141 te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise, nenin 438 te K.Pr.Penale dhe nenin 14 te Ligjit Nr.8588, date 15.03.2000 «Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates se Larte te Republikës se Shqiperise», ka vendosur terheqjen nga Kolegji Penal te ceshtjes penale nr.304, qe i perket te denuarit Lutfi Daci dhe kalimin e saj per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per unifikim te praktikës gjyqesore.

Kolegjet e Bashkuar të Gjykatës së Lartë vërejnë se numuri i çështjeve të kësaj natyre është rritur dhe mund të rritet me tej në të ardhmen, dhe në praktiken e gjykatave janë mbajtur qëndrime të ndryshme, çka dikton nevojën e njesimit të praktikës gjyqësore në drejtimit e mesipërme, për të siguruar një kuptim të zbatimit të drejtë të dispozitave të mesipërme procedurale që kanë të bëjnë me njohjen e vendimeve penale të huaja.

Çështja në shqyrtim, si dhe çështje të tjera të ngjashme me të, e gjen zgjidhjen nëpërmjet interpretimit të zbatimit të disa aktëve normative, siç janë: Konventa Europiane “*Per transferimin e personave të denuar*”, ratifikuar me ligjin nr.8499, datë 10.06.1999; Marrëveshja bilaterale midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “*Per ndihmen e ndërsjellte gjyqësore në fushën penale, civile dhe atë të transferimit të të burgosurve*”, datë 17.05.1993, ratifikuar nga parlamenti dhe të dy vendeve, si dhe dispozitat përkatëse të K.Pr.Penale (nënet 512 – 518 etj të këtij Kodi).

Në lidhje me këto kuader ligjor problemi i parë që shtrohet për diskutim është nëse këto akte normative (*dispozitat korespondonjese*) janë në harmoni me njëra – tjetren (*kompatibile*) apo kemi kontradiksione e ndeshje (*kolizione*) midis tyre.

Në eventualitetin e dytë është e domosdoshme të gjendet norma (normat) e zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Për këto, para se gjithash, duhet të nisemi nga rregullimi që bëhet me norma të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Duhet të kemi parasysh se, sipas nenit 122 të Kushtetutës, “**1. Çdo marrëveshje nderkombetare e ratifikuar përben pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetezbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji**

2. Një marrëveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.
.....”

Nga përmbajtja e dispozitës Kushtetuese të sipërcituar ka rëndësi të nxirren në pah këto përfundime:

- 1. Konventa Europiane (marrëveshja kuader) dhe marrëveshja bilaterale midis dy shteteve janë të inkluduara në sistemin e brendshëm juridik të Republikës së Shqipërisë.**
- 2. Këto dy akte normative kanë zbatim të drejtëpërdrejtë.**
- 3. Në rast mospajtimi, dispozitat e marrëveshjeve nderkombetare të lartpërmendura kanë epërsi mbi dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se dispozitat e aktëve juridike nderkombetare qëndrojnë me lartësi në hierarkinë e normave juridike të inkluduara në të drejtën e brendshme të Republikës së Shqipërisë, gjë që rezulton në mënyrë implicite edhe prej nenit 116/1 të Kushtetutës.**

Për sa përshtrihet me lart, nga studimi e vlerësimi në teresi i aktëve juridike të lartpërmendura, që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë cmojnë se midis tyre nuk ka ndonjë papajtueshmëri. Ato konsiderohen komplementare me njëra – tjetren, gjë që konfirmohet edhe nga fakti që deri me sot në marrëdhëniet midis dy shteteve, lidhur me transferimin e të denuarve, është zbatuar një praktikë administrative e gjyqësore e pranuar në mënyrë të ndërsjellte dhe e pakontestuar. Për transferimin në Shqipëri të shtetasve shqiptarë të denuar në Greqi, zbatimi i dispozitave në fjalë, që janë pjesë e rendit juridik të brendshëm të Shqipërisë, sipas interpretimit që u bëjnë gjykatat shqiptare, varet nga pelqimi i personit të denuar që ka kërkuar të transferohet në Shqipëri, si dhe kryesisht nga miratimi përfundimtar i autoriteteve kompetente të shtetit të huaj.

Megjithatë, në marrëdhëniet juridiksionale midis të dy paleve të marrëveshjes bilaterale mund të lindin në të ardhmen probleme në qoftë se do të vazhdohet sipas disa praktikave të

deritanishme te disa gjykatave te rretheve e te apeleve, te cilat kane nderhyre ne vendimet e konvertimit te denimeve pasi eshte perfunduar edhe procedura administrative e transferimit te te denuarve per te vazhduar vuajtjen e denimit te konvertuar ne burgjet shqiptare.

1. Prej ceshtjes ne shqyrtim rezulton se vendimi i gjykates se shkalles se pare per konvertimin e denimit eshte ankimuar ne apel sipas rregullave te pergjitheshme te ankimit kunder vendimeve te themelit qe nuk kane marre forme te prere.

Para se t'i jepet pergjigje pyetjes se shtruar ne se vendimi i gjykates se shkalles se pare, me te cilin eshte bere njohja e vendimit penal te huaj dhe konvertimi i denimit, mund te ankimohet sipas rregullave te pergjitheshme, duhet te sqarojme tiparet dhe vecantite e procedures qe zbatohet ne keto raste dhe sidomos natyren e ketyre vendimeve qe merren nga gjykatat shqiptare, lidhur me nje ceshtje qe eshte gjykuar nga nje gjykate e huaj sipas kuadrit ligjor penal te shtetit te vet, vendimi i se ciles ka marre forme te prere dhe eshte ekzekutuar rregullisht ne perputhje me ligjin e shtetit te huaj.

Sipas nenit 512/2 te K.Pr.Penale te Republikes se Shqiperise, “...*Ministria e Drejtesise kerkon njohjen e nje vendimi penal te huaj edhe kur cmon se ne baze te nje marrveshjeje nderkombetare ky vendim duhet te ekzekutohet ose t'i njihen efekte te tjera ne shtetin shqiptar.*”

Nisur nga permbajtja e dispozites se mesiperme rezulton se Ministria e Drejtesise eshte autoriteti i vetem i ngarkuar ligjerisht te mbaje marredheniet juridiksionale me autoritetet e huaja per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale te huaja. Megjithate Ministria e Drejtesise nuk ka akses te drejtperdrejte ne gjykatat shqiptare. Ne rastin e njohjes se nje vendimi penal te huaj dhe ekzekutimit te tij ne shtetin shqiptar (konvertimin) Ministria e Drejtesise i a paraqet gjithë dokumentacionin e nevojshem me kerkesen perkatese prokurorise, e cila eshte autoriteti i vetem kompetent qe legjitimohet per te vene ne levizje gjykatën (*neni 512/3 te K.Pr.Penale*).

Sipas Konventes Europiane per transferimin e personave te denuar, organet kompetente te shtetit zbatues **a)** *vazhdojne ekzekutimin e vendimit te dhene ne shtetin denues menjehere, ose b)* *konvertojne denimin e dhene ne shtetin denues duke caktuar sanksione sipas legjislacionit te shtetit zbatues.*

Shteti shqiptar, ne rastin e ratifikimit te Konventes, nuk ka pranuar vazhdimin e ekzekutimit te menjehershëm te denimit, sipas te cilit shteti zbatues eshte i detyruar t'i permbahet natyres ligjore dhe kohezgjatjes se denimit, sic eshte percaktuar ne shtetin denues, por ka pranuar konvertimin e denimit ne pershtatje me kerkesat e dispozites homologe te Kodit Penal shqiptar.

Dispozitat e neneve 512 deri ne 518 te Kodit te Procedures Penale ne rastin e njohjes se vendimeve penale te huaja trajtojne konvertimin, i cili eshte ne harmoni me trajtimin qe i ben konvertimit te denimit edhe Konventa Europiane. Kriteret e gjykimit dhe natyra e vendimit qe merret per konvertimin rezultojne nga permbajtja e nenit 516 te K.Pr.Penale.

Kur ben njohjen e nje vendimi penal te huaj, sipas ligjit tone penal, gjykata cakton denimin qe duhet te vuhet ne shtetin shqiptar. Gjykata konverton denimin e caktuar ne vendimin e huaj ne nje nga denimet e parashikuara per te njejtin fakt nga ligji shqiptar, i cili duhet t'i pergjigjet nga natyra atij qe eshte dhene ne vendimin e huaj. Masa e denimit nuk mund te kaloje kufirin maksimal te parashikuar per te njejtin fakt nga ligji shqiptar. Ligji parashikon edhe rastin kur ne vendimin e huaj nuk eshte caktuar masa e denimit dhe mban qendrimin se eshte gjykata shqiptare ajo qe cakton ate mbi bazen e kriterëve te treguara ne Kodin Penal. Pervec ketyre, ne nenin 516 te Kodit te Procedures Penale trajtohen edhe rregullat e caktimit te denimit lidhur me vendime penale te shteteve te huaja qe kane te bejne me caktimin e denimeve me gjobe, konfiskimeve, kur i pandehuri eshte liruar me kusht ose kur ekzekutimi i vendimit te dhene ne shtetin e huaj eshte pezulluar me kusht.

Ne rastin e konvertimit te denimit sipas Konventes, gjykata e shtetit zbatues nuk mund te konvertoje nje denim me burgim ne nje denim me gjobe, gjykata mund te shkurtoje periudhen e

plote te heqjes se lirise qe vuhet nga personi i denuar. Gjykata nuk e rendon denimin e personit te denuar dhe nuk eshte e detyruar t'i permbahet ndonje minimumi qe mund te parashikojë ligji i vendit zbatues per vepren ose veprat e kryera.

Nga interpretimi i dispozitave te Konventes dhe ligjit tone procedural del e qarte se ne rastin e konvertimit te denimit, zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur behet konvertimi i denimit gjykata duhet t'u permbahet konstatimeve per faktet kur ato shfaqen shprehimisht ose nenkuptohen nga vendimi i dhene nga shteti zbatues. Kolegjet e Bashkuara, edhe ne nje vendim te meparshem unifikues nr.154 date 15.04.2000 kane konkluduar se vendimi i gjykates shqiptare qe ben konvertimin nuk eshte nje vendim i ri dhe se gjykata shqiptare nuk e shqyrton ceshtjen ne themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e shtetit denues. Gjykata shqiptare verifikon nese ekzistojne kushtet per njohjen e vendimit te huaj dhe i pergjigjet atij vendimi me nje vendim qe konverton denimin e huaj me nje denim te parashikuar nga legjislacioni shqiptar, duke percaktuar edhe dispozitat perkatese qe aplikohen.

Eshte e tepert qe ne kete vendim te citohet tere permbajtja e vendimit unifikues nr.154 date 15.04.2000 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Edhe praktika e Kolegjit Penal te kesaj gjykate ne lidhje me problemin qe shqyrtojme ka qene dhe eshte konstante dhe konsekuente. P.sh. ne vendimin nr.57, date 23.01.2002, ne ceshtjen qe i perket te denuarit Hysni Tafili, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka vendosur te prishe vendimin nr.85, date 27.07.2001 te gjykates se Apelit Vlore, nder te tjera, me arsyetimin se « ... *ne procesin e njohjes [se vendimit te huaj] dhe te caktimit te denimit [qe duhet te vuhet ne shtetin shqiptar] gjykatat bejne kujdes qe denimi i cili do te vuhet ne territorin shqiptar t'i pergjigjet per nga natyra vendimit te huaj dhe jo ta rivleresoje kete te fundit ne komponentet e tij*».

Duke mos respektuar interpretimin unifikues te bere nga Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne zgjidhjen e nje ceshtjeje te ngjashme, gjykata e apelit i ka lejuar vehtes nje shkelje te rende te ligjit. Sipas nenit 438/4 te K.Pr.Penale , «*Vendimi i Kolegjeve te Bashkuara eshte i detyrueshem per gjykatat ne gjykimin e ceshtjeve te ngjashme*».

* * *

Le t'i kthehemi trajtimit te problemit te ankimit ndaj vendimit te konvertimit te denimit te huaj ne pershtatje me Kodin Penal shqiptar. As neni 516 i K.Pr.Penale e as ndonje dispozite vijuese nuk shprehet per te drejten e ankimit. Ne nenin 518 te K.Pr.Penale, permenden ne menyre te shprehur vetem dy momente: 1. *Njohja e vendimit te huaj dhe* 2. *Ekzekutimi i vendimit nga prokurori sipas ligjit shqiptar*.

Megjithate, pavaresisht nga sa me lart si dhe nga formulimi i nenit 407 te Kodit te Pr.Penale («1. *Ligji cakton rastet ne te cilat vendimet dhe urdherat e gjykates mund te ankimohen, si dhe mjetin e ankimit*.....

4. *E drejta e ankimit i takon vetem atij qe ligji i a njej shprehimisht*), Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte jane te mendimit qe **si prokurorit, ashtu edhe mbrojtetit te te denuarit, per te cilin behet konvertimi i denimit te huaj, nuk mund t'u mohohet e drejta e ankimit kunder vendimit te gjykates per kete ceshtje**, megjithese ky lloj gjykimi nuk eshte gjykim themeli, por nje gjykim i posacem (*sui generis*).

Vendimi i konvertimit te denimit te huaj ne pershtatje me legjislacionin shqiptar, qe jepet nga gjykata shqiptare, pavaresisht nga natyra e tij, eshte ne fund te fundit nje vendim gjyqesor dhe, sipas nenit 43 te Kushtetutes, «*Kushdo ka te drejte te ankohet kunder nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte, pervecse kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe*».

Gjykimi i konvertimit, nga natyra e tij dhe rrethanat objektive ne te cilat zhvillohet, nuk mund te kete pranine e te denuarit qe u ka kerkuar autoriteteve te huaja kompetente te transferohet ne Shqiperi. I denuari qe eshte duke vuajtur denimin me burgim ne nje shtet te huaj objektivisht nuk mund te paraqitet ne gjykatën shqiptare, por ai ka te drejte dhe ka mundesi qe, ne momentin

kur u drejtohet autoriteteve te huaja per te nisur proceduren e transferimit, te autorizojte nje mbrojtes te tij qe ta perfaqesojte ne gjykaten shqiptare. Ne qofte se ne fillim te gjykimit te konvertimit, gjykata shqiptare konstaton se mbrojtesi i caktuar nga i denuari nuk eshte paraqitur pa shkaqe te arsyeshme, ose ai nuk ka autorizuar ndonje mbrojtes, atehere gjykata eshte e detyruar t'i caktojte nje te tille kryesisht. Vendimi i konvertimit mund te ankimohej nga palet ne Apel. Vetem pasi vendimi i konvertimit merr forme te prere prokurori ka te drejte te kryejte veprimet e ekzekutimit, nepermjet dergimit te akteve Ministrise se Drejtesise per te vazhduar kryerjen e veprimeve administrative me autoritetet e huaja nepermjet te cilave do te realizohet transferimi i te denuarit.

2. Ceshtja tjeter e shtruar para Kolegjeve te Bashkuara per unifikim te praktikes gjyqesore eshte nese ka te drejte i pandehuri ose mbrojtesi i tij qe per kete kategori ceshtjesh qe kane te bejne me njohjen e vendimeve penale te huaja, ne zbatim te nenit 147 te K.Pr.Penale, te kerkoje rivendosjen ne afat te ankimit.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte verejne se referimi per kete problem ne nenin 147/2 te K.Procedures Penale eshte i gabuar. Kjo dispozite zbatohet vetem per rivendosje ne afat per te bere ankim te te pandehurit te gjykuar ne mungese per shkak se gjykata ka konkluduar qe ai ishte larguar e i fshihej gjykimit, kur ky i fundit provon se nuk ka marre dijene per vendimin. Pra, sipas kesaj dispozite kemi te bejne me rivendosje ne afat per te bere ankim kunder nje vendimi themeli, gje qe ndryshon teresisht, prej rastit ne shqyrtim. Eshte e vertete se i denuari Lutfi Daci ne gjykimin e konvertimit te denimit nuk eshte perfaqesuar nga ndonje mbrojtes dhe gjykata ishte e detyruar t'i caktonte nje te tille kryesisht. Megjithate pretendimi i tij per t'u rivendosur ne afatin e ankimit kunder ketij vendimi, per shkak se nuk ka marre dijene per te, nuk qendron. Vendimi i konvertimit te denimit i dhene nga gjykata shqiptare u eshte transmetuar autoriteteve greke dhe i denuari, qe kish kerkuar transferimin, kishte te drejte te njihej me vendimin e konvertimit para fillimit te procedurave te transferimit.

Ne qofte se nuk do te ishte dakord me kete vendim te konvertuar, atehere ai nuk mund te sillej ne Shqiperi ne kundershtrim me deshiren e tij. Autoritetet e shtetit te huaj ishin te detyruara te prisnin deri sa i denuari te apelonte vendimin e gjykates shqiptare dhe deri sa vendimi i Apelit te merrte forme te prere.

Theksojme gjithashtu se vertetimi date 26.10.2001 i leshuar nga Drejtori i Burgut Vaqar, sipas te cilit i denuari Lutfi Daci ka marre dijene per denimin e konvertuar pasi eshte transferuar ne Shqiperi me date 26.09.2001, nuk eshte i vlefshem per kete qellim, sepse eshte dhene jashte kompetencave te parashikuara ne ligj dhe nuk pasqyron te verteten. Komunikimet e vendimeve behen nga autoritetet e ngarkuara me ligj dhe ekzekutimi i tyre nga prokurori, i cili pergjigjet edhe per ligjshmerine e ekzekutimit.

Si perfundim, i denuari, ose mbrojtesi i tij, nuk kane te drejte te kerkojne rivendosjen ne afat te se drejtes per te ushtruar ankim kunder vendimit te konvertimit te vendimit te nje gjykate te huaj.

Duke gene se prokurori eshte i ngarkuar ligjerisht me ekzekutimin e vendimit, eshte detyre e tij qe te sigurohet ne se vendimi ka marre forme te prere, pastaj te veje ne levizje Ministrine e Drejtesise per transferimin e te burgosurit. Ishte detyre e prokurorit qe te ankimonte vendimin e rivendosjes ne afat nga gjykata e shkalles se pare, si dhe te ushtronte rekurs kunder vendimit te gjykates se Apelit, detyre te cilen nuk e ka kryer.

Prokurori eshte i detyruar ligjerisht te garantoje paraprakisht qe, kur i denuari te kete realizuar te drejten e transferimit nga vendi i huaj ne Shqiperi per te vazhduar te vuaje denimin e dhene nga gjykata e huaj dhe te konvertuar sipas legjislacionit shqiptar, te jene kryer te gjitha veprimet procedurale dhe administrative midis autoriteteve shqiptare dhe atyre te huaja ne perputhje te plote me kuadrin ligjor ne fuqi, si dhe te jene respektuar rigorozisht te drejtat e te

denuarit te transferuar, dhe, per rrjedhoje, ketij te fundit ne kohen e kthimit ne Shqiperi t'i jene mbyllur ligjerisht te gjitha rruget e zakonshme te ankimit.

3. Ne lidhje me ceshtjen e trete te shtruar per diskutim per efekt te unifikimit te praktikese gjyqesore, Kolegjet e Bashkuara jane te mendimit **se gjykata e apelit nuk duhet te dale jashte kufinjve te shqyrtimit te ceshtjes ne gjykatën e shkalles se pare dhe jashte shkaqeve te ankimit qe jane te pranueshme per t'u konsideruar, sipas natyres specifike te gjykimit te konvertimit te denimit ne pershtatje me kerkesat e kriteret e dispozitave analoge te Kodit Penal Shqiptar.**

Gjykata e apelit duhet te korigjose gabimet ligjore eventuale te gjykates se shkalles se pare lidhur me zbatimin e kriterëve dhe rregullave te konvertimit te denimit. Ajo nuk mund t'i hyje shqyrtimit te problemeve te bazueshmerise faktike e ligjore te vendimit te huaj, as kriterëve te konsideruara nga gjykata e huaj per caktimin e denimit, si dhe cdo aspekti tjetër qe ka te beje me themelin e ceshtjes, vendimi i se ciles ka marre forme te prere dhe eshte ne proces ekzekutimi.

Gjykata e Apelit Tirane ka gabuar rende duke dale tej kufijve qe permenden me siper per kete lloj gjykimi. Ajo ne fakt ka dhene nje denim te ri me te zbutur duke prekur themelin e vendimit te gjykates se huaj, gje qe nuk ka te drejte ta beje.

Gjykata e apelit nuk ka te drejte te marre prova, sic ka vepruar per kryerjen e ekspertimit per llojin e droges, as te beje vleresime te provave te marra nga gjykata e shtetit te huaj. Ajo nuk ka te drejte gjithashtu te marre ne konsiderate e te vleresojë si lehtesuese rrethana te caktuara, pavaresisht ne se jane marre ato ne shqyrtim e jane vleresuar, apo jo, nga gjykata e huaj.

I gabuar eshte edhe qendrimi i gjykates se apelit qe justifikon uljen e mases se denimit me burgim me arsyetimin se denimi i dhene nga gjykata greke eshte konvertuar me maksimumin qe parashikon dispozita homologe e K.Penal shqiptar (neni 283). Neni 516/1 i K.Pr.Penale te Republikës se Shqiperise parashikon qarte e pa ekuivoke se, «... Masa e denimit nuk mund te kaloje kufirin maksimal te parashikuar per te njejtin fakt nga ligji shqiptar». Ne kuptim te po kesaj dispozite denimi i konvertuar nga gjykata shqiptare e shkalles se pare nuk mund te konsiderohet se nuk i pergjigjet nga natyra atij te dhene ne vendimin e huaj.

Tranferimi i te denuarit per te vuajtur ne shtetin e tij denimin e dhene nga nje gjykate e huaj nuk perben nje lehtesi ne kuptim te uljes se mases se denimit, por nje lehtesi per efekte te reabilitimit me te shpejte te tij ne pershtatje me kushtet me te favorshme qe mund te ofroje ne kete drejtim rendi juridik shqiptar, por gjithesesi pa lejuar ne asnje rast rendimin e pozites se tij ne krahasim me qendrimin e mbajtur ne vendimin e gjykates se huaj.

Si perfundim, mbeshtetur ne interpretimin e mesiperme te nenit 516/1 te K.Pr.Penale, rezulton se gjykata e Apelit pa asnje shkak te perligjur ka ulur masen e denimit te caktuar pas konvertimit nga gjykata e shkalles se pare.

Nga sa me lart rezulton se vendimi i gjykates se shkalles se pare qe ka rivendosur ne afat ankimin e te denuarit, si dhe vendimi i Gjykates se Apelit Tirane, qe i ka zbritur te denuarit 5 vjet nga denimi i burgimit, jane haptazi te kundraligjshem. Megjithate keto vendime nuk mund te cenohen sepse nuk kemi reagim procedural te prokurorit. Me kete rast u behet verejtje te dy gjykatave me qellim qe shkelje te tilla te mos perseriten me ne te ardhmen.

Arsyetimi si me siper i vendimit dhe argumentat e perdorura ne te rrezojne njekohesisht te gjitha pretendimet e avokatit te te denuarit te parashtruara ne rekurs.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne baze te nenit 141 te Kushtetutes dhe te nenit 438 te K.Pr.Penale.

V E N D O S Ë N:

1. Lenien ne fuqi te vendimit nr.46, date 08.02.2002 te Gjykates se Apelit Tirane.
2. Ky vendim per njesimin e praktikes gjyqesore dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 10.10.2002

Nr.4 i Regj. Themeltar.
Nr.3 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anetar
Kristaq Ngjela	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Spiro Spiro	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Artan Hoxha	Anetar
Metush Saraçi	Anetar
Valentina Kondili	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Evgjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare
Vladimir Bineri	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 27.09.2002 moren ne shqyrtim ceshtjen nr. 4 qe i perket:

TË PANDEHURIT: VLADIMIR OZMAJ

A K U Z U A R:

Per vepren penale te vjedhjes me ane mashtrimi,
kryer ne bashkepunim,
parashikuar nga neni 143/1 e 25 te K.Penal.

OBJEKTI:

Vlefesim i ndalimit dhe caktim i mases se sigurimit personal.
Nenet 245 dhe 259 te Kodit te Procedures Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres, me vendimin nr. 7, date 11.01.2002, ka vendosur:
Vlefesimin te ligjshem te ndalimit te shtetasit Vladimir Ozmaj.
Caktimin si mase sigurimi personal per shtetasin Vladimir Ozmaj ate te arrestit ne burg.

Gjykata e Apelit Durres, me vendimin nr. 4, date 07.02.2002, ka vendosur:
Shfuqizimin e vendimit nr. 7 date 11.01.2002 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Durres ka bere rekurs prokurori, duke parashtruar keto shkaqe:

- Se pavaresisht, qe shtetasit Vladimir Ozmaj nuk i eshte komunikuar akuza, me akt te shkruar, ai ka marre dijene per te, nga prokurori, gjate gjykimit, per vlefesimin e ndalimit dhe caktimit te mases se sigurimit personal.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, me vendimin nr. 278 date 23.4.2002, duke arsyetuar se per problemin e paraqitur ka praktika te ndryshme gjyqesore, ka vendosur:

Kalimin e ceshtjes, qe ben fjale per te pandehurin Vladimir Ozmaj, per gjykim, ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, per unifikim te praktikes gjyqesore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relatimin e anetareve Vladimir Bineri dhe Agron Lamaj,
pasi degjuan prokurorin Artur Selmani, i cili kerkoi ndryshimin e vendimit te Gjykates se Apelit Durres dhe lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres,
mbrojttesi i te pandehurit nuk u paraqit,
dhe pasi shqyrtuan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Ne muajin korrik te vitit 2000, shtetasi Vladimir Ozmaj nepermjet vjehrres se tij Zenepe Rugova i ka marre te demtuares Teuta Core nje shume prej 8500 dollare per t'i siguruar nje vize per ne Amerike per vajzen e saj, po megjithe interesimin e vazhdueshem te te demtuares Teuta, ka vazhduar ta mbaje me mashtrime dhe as nuk i ka siguruar vizen e as nuk i ka kthyer leket.

Ne keto rrethana, e demtuara Teuta me daten 30.6.2001 ka bere kallzim ne polici ndaj shtetasit Vladimir Ozmaj per kete vjedhje me ane te mashtrimit.

Me daten 4.10.2001, i akuzuari Vladimir eshte pyetur per kete fakt nga oficeri i policise gjyqesore i prokurorise prane Gjykates te shkalles se pare Durres. Procesverbali i mbajtur gjate pyetjes eshte emertuar "Mbi deklarimin nga personi ndaj te cilit zhvillohen hetime". Nga procesverbali rezulton se i akuzuari eshte njoftuar pse akuzohet dhe konkretisht: "Organi i Prokurorise Durres ka filluar mbi bazen e kallzimit te bere nga shtetesja Teuta Core, procedimin penal nr. 283 qe ben fjale per vepren penale te parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Ne kete kallzim akuzoheni ju dhe vjehrra juaj Zenepe Rugova per mashtrimin qe i keni bere Teuta Cores se ciles pasi i keni premtuar asaj per t'i cuar ne Amerike vajzen, Aida me vize amerikane i keni marre asaj 8500 dollare amerikane, dhe pasi nuk keni realizuar kete marreveshje te lidhur midis jush nuk i keni kthyer akoma asaj 8500 dollaret. Sa me siper ne kete ceshtje keni dhe te drejten ligjore te mbroheni me avokat mbrojttes, ne rast se nuk kerkoni atehere jepni shpjegime rreth kesaj ngjarje duke ju pergjigjur pyetjeve".

Me daten 26.11.2001, prokurori i Durresit bazuar ne nenin 253/1 te K.Pr.Penale ka nxjerr urdherin per ndalimin e shtetasit Vladimir Ozmaj per veprimin e mesiperm, me arsyetimin se ne ngarkim te tij ekzistonin te dhena te mjaftueshme dhe bindese se ai kishte kryer ne bashkepunim dhe me te tjere, vepren penale te vjedhjes me ane mashtrimi parashikuar nga nenet 143/1 e 25 te Kodit Penal dhe se ekzistonte rreziku qe ai t'i fshihej hetimit dhe gjykimit.

Me daten 10.1.2002, behet ekzekutimi i urdherit te ndalimit nga oficeri i policise gjyqesore dhe njoftohet prokurori.

Me daten 11.1.2002, prokurori ka paraqitur ne gjykate kerkesen per vleresimin e ndalimit dhe caktimin e mases se sigurimit per Vladimir Ozmajn. Gjate gjykimit prokurori ka deklaruar: "...nga

hetimet e bera per procedimin penal nr. 283 eshte krijuar baza e nevojshme e te dhenave se ky shtetas ka kryer vepren penale te parashikuara nga neni 143/1 e 25 te Kodit Penal, vjedhje e pasurise me ane te mashtrimit ne bashkepunim. Avokati i te ndaluarit ka pretenduar se mungojne elementet e vepres penale, nuk ekzistojne kriteret e nenit 253 K.Pr.Penale, klienti i tij nuk ka marre njoftimin e akuzes, ai nuk eshte marre i pandehur.

Me vendimin nr.7, date 11.1.2002, Gjykata e Rrethit Durres vlereson si te ligjshem ndalimin dhe cakton si mase sigurimi ate te arrestit ne burg per Vladimir Ozmajn me kete arsytim: "Meqenese ekzistojne kushtet dhe kriteret ligjore te parashikuara nga neni 253 te K.Pr.Penale paragrafi i pare, si dhe kushtet dhe kriteret ligjore te parashikuara nga nenet 228, 229, 230 te K.Pr.Penale, te cilat perligjin masen e sigurimit personal te kerkuar nga prokurori ne seance gjyqesore gjykata çmon se kerkesa e tij duhet pranuar".

Me daten 17.01.2002 Vladimir Ozmaj eshte marre i pandehur, per vepren penale te vjedhjes me ane mashtrimi, ne baze te nenit 143/1 te Kodit Penal.

Me vendimin nr.4, date 7.02.2002 Gjykata e Apelit Durres ka shfuqizuar vendimin e mesiperme te Gjykates se Rrethit Durres me arsytimin se ndaj te ndaluarit nuk jane kryer veprimet procedurale ne lidhje me marrjen te pandehur dhe njoftimin e akuzes per vepren penale qe dyshohet. Sipas gjykates se apelit ne momentin e marrjes se mases se sigurimit te "arrestit ne burg" shtetasi duhet te kete cilesine e te pandehurit ne veshtrim te nenit 34, 230/1 te K.Pr.Penale.

Me vendimin nr.278, date 23.04.2002, Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka vendosur kalimin e ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte per unifikimin e praktikes gjyqesore per t'u shprehur **nese ligji procedural penal dhe mbrojtja e interesave te te pandehurit ne gjykim e kerkojne te domosdoshme marrjen e personit si te pandehur dhe njoftimin e akuzes nga organi procedues me pare se te caktohet masa e sigurimit personal nga ana e gjykates.**

Problemi qe shtrohet per tu diskutuar dhe qe ka ardhur per unifikim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte lidhet me faktin ne se mund te caktohet nje mase sigurimi pa u marre personi, me pare, si i pandehur.

Problemi i shtruar per diskutim duhet pare dhe trajtuar ne frymen e:

1. Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut,
2. Kushtetutes shqiptare,
3. Ligjit nr. 7905 date 21.03.1995, me te cilin eshte miratuar Kodi i Procedures Penale.

Ne Konventen Europiane te te Drejtave te Njeriut, problemi i shtruar per zgjidhje pasqyrohet dhe shtjellohet ne nenin 5 te saj dhe me konkretisht ne piken 1/c, 2 e 3 ku thuhet:

1. Cdo person ka te drejten e lirise dhe te sigurise. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me perjashtim te rasteve qe vijojne dhe ne perputhje me rruget ligjore:
 - c. Kur eshte arrestuar dhe paraburgosur per t'u cuar perpara autoritetit gjyqesor kompetent, kur ka arsye te besueshme per te dyshuar se ai ka kryer nje veper penale, ose kur ka motive te arsyeshme per te menduar se duhet ndaluar te kryeje nje veper penale ose te largohet pas kryerjes se saj.
2. Cdo person i arrestuar duhet te informohet, brenda nje afati sa me te shkurter dhe ne nje gjuhe qe ai e kupton, per arsyet e arrestimit te tij dhe per cdo akuze te drejtuar kunder tij.
3. Cdo person i arrestuar ose i paraburgosur, ne kushtet e parashikuara ne paragrafin 1/c te ketij neni, duhet te cohet menjehere perpara nje gjykatesi, ose nje magjistrati tjetër te autorizuar me ligj qe te ushtroje funksione gjyqesore, dhe ka te drejte te gjykohet brenda nje afati te arsyeshem ose te lirohet gjate procedures. Lirimi mund te kushtezohet me nje garanci qe siguron paraqitjen e personit te interesuar perpara gjyqit.

Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut sipas Kushtetutes, pas ratifikimit dhe botimit te saj ne Fletoren Zyrtare, eshte bere pjese e sistemit te brendshem juridik. Konventa zbatohet ne

menyre te drejtperdrejte dhe ka epersi mbi ligjet e vendit qe nuk pajtohen me te (neni 122 i Kushtetutes).

Standarti minimum i te drejtave dhe lirive te parashikuara nga ana e Kushtetutes shqiptare eshte i njejte me standartin minimum te parashikuar per keto te drejta nga ana e Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut.

Ne Kushtetuten shqiptare problemi i shtruar per zgjidhje parashikohet nga nenet 27, pika 2, germa "c" dhe 28 pika 1 e 2.

Ne nenin 27 te Kushtetutes eshte sanksionuar:

" ...

2. Liria e personit nuk mund te kufizohet, pervecse ne rastet e meposhtme:

...

c. Kur ka dyshime te arsyeshme se ka kryer nje veper penale ose per te parandaluar kryerjen prej tij te vepres penale ose largimin e tij pas kryerjes se saj".

Ne nenin 28 te Kushtetutes eshte sanksionuar:

" ...

1. Kushdo, te cilit i hiqet liria, ka te drejte te njoftohet menjehere ne gjuhen qe ai kupton, per shkaqet e kesaj mase, si dhe per akuzen qe i behet. Personit, te cilit i eshte hequr liria, duhet te njoftohet se nuk ka asnje detyrim te beje ndonje deklarate dhe ka te drejte te komunikojte menjehere me avokatin, si dhe t'i jepet mundesia per realizimin e te drejtave te tij.

2. Personi, te cilit i eshte hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nenparagrafi "c", duhet te dergohet brenda 48 oreve perpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo me vone se 48 ore nga casti i marrjes se dokumenteve per shqyrtim.

...".

Edhe legjislacioni shqiptar pershkohet nga te njejtat qellime si dhe Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut. Legjislacioni shqiptar i garanton cdokujt te drejtat dhe lirite e parashikuara ne seksionin e pare te kesaj konvente.

Ne Kodin e Procedures Penale u sanksionuan per here te pare kompetencat e gjykates per miratimin e akteve me te rendesishme te fazes se hetimit paraprak, sic jane ato per masat e sigurimit etj.

Ne ndryshim nga legjislacioni i meparshem, ne K.Pr.Penale u pranuan normat e Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut lidhur me masat e sigurimit u hoq e drejta e prokurorit per caktimin e ketyre masave qe kufizojne lirite e te drejtat themelore te njeriut dhe u pranua norma nderkombetare e caktimit te tyre nga gjyqtari, kur jane rastet dhe kushtet e parashikuara me ligj.

Ne pershtatje me nenin 5 te Konventes, qe ben fjale per te drejten e lirise dhe te sigurimit, ne Kushtetute dhe ne K.Pr.Penale jane percaktuar qarte e sakte rastet e heqjes dhe kufizimit te lirise se personit, si dhe kushtet e kriteret per caktimin e masave te sigurimit ne teresi e te mases se arrestimit ne vecanti.

Ne baze te nenit 27/2 germa "c" te Kushtetutes liria e personit mund te kufizohet vetem kur ka dyshime te arsyeshme se ka kryer nje veper penale ose per te parandaluar kryerjen prej tij te vepres penale ose largimin e tij pas kryerjes se saj.

Si ne Kushtetute edhe ne K.Pr.Penale jane caktuar rregulla te hollesishme per rastin e parashikuar nga neni 5, pika 1, germa "c" e Konventes, sipas te ciles personit mund t'i hiqet liria "kur eshte arrestuar dhe mbajtur per tu cuar perpara autoritetit gjyqesor kompetent, ne rast se ekzistojne arsye te besueshme per te dyshuar se ai ka kryer nje veper penale ose kur ndodhen te dhena te arsyeshme per te menduar se duhet ndaluar te kryeje nje veper penale ose te arratiset pas kryerjes se saj".

Ne pajtim te plote me nenin 5, pika 1, germa "c" dhe piken 3 te ketij, neni te Konventes, neni

228 i K.Pr.Penale ka percaktuar kushtet dhe kriteret per caktimin e masave te sigurimit. Eshte theksuar kushti i rendesishem, sipas te cilit askush nuk mund t'u nenshtrohet masave te sigurimit personal ne qofte se ne ngarkim te tij nuk ekziston nje dyshim i arsyeshem, i bazuar ne prova.

Eshte pranuar tashme si nga teoria dhe praktika gjyqesore shqiptare se dyshimi i arsyeshem nenkupton bindjen qe krijohet nga provat e marra e te shqyrtuara ne perputhje me kerkesat e ligjit, te cilat ne unitetin e tyre tregojne se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo eshte kryer nga ai qe akuzohet.

Per caktimin e masave te sigurimit personal kerkohet patjeter ekzistenca e vepres penale dhe pergjegjshmeria e atij qe akuzohet.

Ne nje kapitull te vecante te K.Pr.Penale jane bere percaktime te sakta e te hollesishme per arrestimin ne flagrance dhe ndalimin e personit qe dyshohet se ka kryer nje krim, duke u zberthyer e konkretizuar pika 3 e nenit 5 te Konventes. Ne nenin 252 te K.Pr.Penale eshte dhene perkufizimi i flagrances, duke u percaktuar se eshte ne gjendje flagrance ai qe eshte kapur ne kryerje e siper te vepres penale ose ai qe menjehere pas kryerjes se vepres ndiqet nga policia gjyqesore, nga personi i demtuar ose nga persona te tjere ose qe eshte kapur me sende dhe prova materiale, nga te cilat duket se ka kryer vepren penale.

Ne nenin 253 te K.Pr.Penale jane percaktuar kushtet per ndalimin e nje personi qe dyshohet se ka kryer nje krim. Sipas ketij neni, prokurori urdheron ndalimin e te dyshuarit per nje veper penale qe denohet me burgim jo me pak se dy vjet kur ka shkaqe te bazuara per te menduar se ai ka rrezik te iki. Keshtu eshte vepruar edhe ne ceshtjen objekt gjykimi...

Ne pershtatje me piken 2 te nenit 5 te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut, ne Kushtetute dhe ne K.Pr.Penale jane percaktuar rregulla te hollesishme per njoftimin e akuzes dhe marrjen ne pyetje te te arrestuarit ose te ndaluarit. Ne nenin 28 te Kushtetutes thuhet se "kushdo, te cilit i hiqet liria, ka te drejte te njoftohet menjehere ne gjuhen qe ai kupton, per shkaqet e kesaj mase, si dhe per akuzen qe i behet.

Ne baze te nenit 256 te K.Pr.Penale i arrestuari ose i ndaluari merret ne pyetje ne prani te mbrojtetit te zgjedhur ose te caktuar kryesisht. **Gjate pyetjes i arrestuari ose i ndaluari njoftohet per faktin, per te cilin procedohet dhe arsyet e marrjes ne pyetje,** duke i treguar te dhenat ne ngarkim te tij dhe kur nuk i shkaktohet dem hetimeve edhe burimet.

Neni 5, pika 3 e Konventes, cakton rregullin se "cdo person i arrestuar ose i burgosur ne kushtet e parashikuara ne paragrafin 1, "c" te ketij neni duhet te cohet menjehere perpara nje gjykatesi... dhe ka te drejte te gjykohet brenda nje afati te arsyeshem ose te lirohet... Lirimi mund te kushtezohet me nje garanci qe siguron paraqitjen e personit perpara gjyqit.

Sipas nenit 28/2 te Kushtetutes dhe nenit 258 te Kodit te Procedures Penale kur nuk urdherohet lirimi i menjehershem i te arrestuarit ose te ndaluarit, prokurori brenda 48 oreve nga arrestimi ose ndalimi, kerkon vleftesimin e mases se marre ne gjykate. Mosrespektimi i afatit prej 48 oresh ben qe arrestimi ose ndalimi te humbase fuqine.

Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqine kur vendimi i gjykates per vleftesimin nuk eshte shpallur brenda 48 oreve te ardhshme nga casti, ne te cilin kerkesa e prokurorit eshte paraqitur ne gjykate (neni 259/5 te K.Pr.Penale).

Seanca e vleftesimit zhvillohet me pjesemarrjen e domosdoshme te prokurorit dhe te mbrojtesit (neni 259/1 te K.Pr.Penale). **Ne seance prokurori tregon shkaqet e arrestimit ose te ndalimit.** Pas prokurorit gjykata degjon te arrestuarin ose te ndaluarin dhe mbrojtesin ose vetem kete te fundit, kur i arrestuari a i ndaluari ka refuzuar te paraqitet (neni 259/2 i K.Pr.Penale). Kunder vendimit te gjykates mund te behet apel ne gjykaten me te larte nga prokurori dhe i arrestuari ose i ndaluari (neni 259/3 i K.Pr.Penale).

Nga shqyrtimi i akteve te dosjes del se Vladimir Ozmaj eshte njoftuar per thelbin e akuzes ne ngarkim te tij, duke ju bere e qarte:

- se ndaj tij eshte filluar nje procedim penal nga Prokuroria e rrethit Durres
- se ai akuzohet per vepren penale te vjedhjes me ane mashtrimi parashikuar nga neni 143/1 te Kodit Penal
- se vepren penale e ka kryer ne bashkepunim me vjehrren e tij
- se procedimi penale ka filluar mbi bazen e kallzimit te shtetases Teuta Core
- se cila eshte permbajtja ne thelb e ketij kallzimi
- se ka te drejte te mbrohet me nje avokat

Sa u thane me siper shtetasit Vladimir Ozmaj i jane njoftuar me date 4.10.2001 ne cilesine e **personit ndaj te cilit zhvillohen hetime.** Ne kete cilesi i akuzuari Vladimir Ozmaj ka dhene shpjegime perpara oficerit te policise gjyqesore si dhe perpara Gjykates se shkalles se pare Durres ditën kur eshte vleftesuar ndalimi dhe shqyrtuar kerkesa e prokurorit per caktimin e mases se sigurimit “arrest ne burg”. Kjo gjendje ka vazhduar deri me datën 17.01.2002. Ne kete date i akuzuari eshte marre i pandehur ne baze te nenit 34 te K.Pr.Penale. Me fjale te tjera i akuzuari eshte marre i pandehur pas vleftesimit te mases se arrestit nga gjykata e shkalles se pare dhe para shqyrtimit te ankimit te tij nga gjykata e apelit.

Duke vleresuar sa u paraqit, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se:

Per ndalimin apo arrestimin ne flagrante, nga organi i akuzes si dhe per caktimin e masave te sigurimit personal, nga gjykata, marrja me pare e personit me cilesine e te pandehurit, nuk eshte e detyrueshme.

Kodi i Procedures Penale, ne teresine e dispozitave te tij, i njeh te drejten organit te prokurorise qe, ne vartesi te te dhenave qe disponon, te marre ne cilesine e te pandehurit personin qe dyshohet se eshte autor i nje vepre penale.

Ne ushtrimin e te drejtes, per te marre personin si te pandehur, prokurori, ne cdo rast, eshte i detyruar qe te veproje ne perputhje me kerkesat e nenit 34, pika 1, te Kodit te Procedures Penale.

Ne baze te kesaj dispozite, **“Merr cilesine e te pandehurit personi te cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit te akuzes, ne te cilin tregohen te dhenat e mjaftueshme per marrjen si te pandehur...”**.

Sic del nga permbajtja e kesaj dispozite, personi e merr cilesine e te pandehurit vetem atehere kur ai njoftohet, me akt te shkruar, ne formen e vendimit, nga prokurori apo oficeri i policise gjyqesore i autorizuar nga prokurori.

Ne kete akt procedural, mbi bazen e te cilit personi merr cilesine e te pandehurit, parashtrohen te dhenat e grumbulluara deri ne ate faze te hetimit paraprak, te cilat jane vleresuar te mjaftueshme, per te konkluduar si per natyren kriminale te vepres se kryer ashtu dhe per autorin e saj dhe fajesine e tij.

Njoftimi i akuzes, me akt te shkruar, si veprim procedural, nenkupton perfundimin paraprak, te arritur nga organi i prokurorise, se vepra penale eshte kryer dhe se autor i saj eshte personi te cilit i behet ky njoftim.

Prokurori marrjen e personit ne cilesine e te pandehurit, nepermjet njoftimit, te akuzes, me akt te shkruar, mund ta realizoje ne cdo faze te procedimit penal, perfshire ketu dhe kohen perpara se personit t'i hiqet liria.

Perpilimi i aktit, per marrjen e personit ne cilesine e te pandehurit, dhe njohja e tij, ne menyre detyrueshme dhe te hollsishme, me faktet dhe rrethanat, qe organi i akuzes ka mundur te grumbulloje kunder tij, ka lidhje me te drejten e personit per tu mbrojtur, pavaresisht nese eshte ne gjendje te lire apo me mase sigurimi.

Duke patur parasysh sa u paraqit dhe sic del nga permbajtja e dispozitave te Titullit V, Seksioni I dhe II, te Kodit te Procedures Penale, **kur personit i eshte hequr liria, ne formen e ndalimit apo arrestimit ne flagrante apo kur ndaj tij eshte caktuar mase sigurimi personal, organi i prokurorise nuk eshte i detyruar qe ate, perpara marrjes se ketyre masave apo perpara se te paraqitet ne gjykate, per vleftesimin apo caktimin e mases se sigurimit personal, ta marre me cilesine e te pandehurit.**

Ne nenin 256, te Kodit te Procedures Penale, percaktohet rregulli qe personi, te cilit i eshte hequr liria, per shkak te ndalimit apo arrestimit ne flagrante, ne cdo rast, duhet te merret ne pyetje nga prokurori, i cili, pas kryerjes se ketij veprimi, eshte i detyruar ta njoftoje ate lidhur me **"... faktin per te cilin procedohet dhe arsyet e marrjes ne pyetje, duke i treguar te dhenat ne ngarkim te tij dhe, kur nuk i shkaktohet dem hetimeve, edhe burimet"**.

Kryerja, nga prokurori, e veprimeve te percaktuara ne kete dispozite, eshte e detyrueshme, per cdo rast, qe personit i hiqet liria.

Marrja ne pyetje, nga prokurori, e personit, te cilit i eshte hequr liria, nuk do te thote se ai, nepermjet ketij veprimi, ka marre cilesine e te pandehurit.

Veprimi qe kryen prokurori, ne baze te nenit 256 te Kodit te Procedures Penale, nuk jane te njejta me ato te parashikuara ne nenin 34 te ketij kodi.

Sipas nenit 256, te Kodit te Procedures Penale, marrja ne pyetje e personit, nga prokurori, realizohet pas zbatimit te ndalimit apo arrestimit.

Perpara marrjes ne pyetje, prokurori ka detyrimin qe personin ta njoftoje lidhur me shkakun per te cilin atij i eshte hequr liria, duke i treguar akuzen, vepren penale konkrete, te cilen ai dyshohet se e ka kryer, si dhe te dhenat apo faktet, qe jane mundur te grumbullohen, deri ne ate faze, kunder tij.

Pasqyrimi i veprimeve, te kryera nga prokurori, sipas nenit 315 te Kodit te Procedures Penale, behet me procesverbal.

Duke kryer veprimet, si mesiper, prokurori, personit te cilit i eshte hequr liria, nuk i ka dhene cilesine e te pandehurit, pasi prej tij nuk eshte perpiluar akti i vecante, vendimi, sic kerkon neni 34, pika 1, i Kodit te Procedures Penale.

Neni 256 i Kodit te Procedures Penale, nuk e urdheron prokurorin qe, ne kete faze te procedimit, te realizoje te drejten per te marre personin si te pandehur.

Njoftimi i personit te ndaluar apo te arrestuar ne flagrante, nga prokurori, me shkaqet dhe kushtet, per te cilat eshte bere ndalimi apo arrestimi ne flagrante i tij, si dhe njoftimi me te dhenat qe disponohen se ai eshte autor i nje vepre penale behet ne cilesine e personit ndaj te cilit zhvillohen hetime.

Duke patur parasysh sa u paraqit, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, çmojne se pretendimet e parashtruara ne rekursin e prokurorit jane te drejta.

Caktimi i mases se sigurimit nuk lidhet me njoftimin e akuzes dhe pyetjen e te pandehurit. Masat e sigurimit, si rregull, caktohen perpara se te behet njoftimi i akuzes dhe kane si qellim, qe te plotesohen nevojat e sigurimit ndaj personit ne procedim. Vetem pas zbatimit te tyre behet njoftimi i akuzes dhe vazhdohet me marrjen ne pyetje. Kjo gje del edhe nga neni 28 i Kushtetutes, qe parashikon se **kushdo, te cilit i hiqet liria ka te drejte te njoftohet per akuzen qe i behet**, ose e thene ndryshe, njoftimi i akuzes behet pas heqjes se lirise.

Mendimi, sipas te cilit, masa e sigurimit mund te caktohet vetem pasi personi te jete marre i pandehur eshte i gabuar. Ai bazohet ne qendrimet teorike dhe praktikat e zbatuara sipas kodit te vjeter per masat e sigurimit.

Qe masa e sigurimit mund te caktohet edhe pa u marre i pandehur del nga disa dispozita te Kodit te Procedures Penale dhe konkretisht:

Ne nenin 307 te Kodit te Procedures Penale behet e qarte se masat e sigurimit mund te caktohen e te zbatohen pa qene nevoja qe personi te jete marre i pandehur. Ne kete nen thuhet: “Ai qe ka marre dijene se ndaj tij zhvillohen hetime, ka te drejte te paraqitet te prokurori dhe te beje deklarime. **Paraqitja vete nuk pengon zbatimin e masave te sigurimit**”. Pra, del qarte qe masa e sigurimit mund te caktohet para se personi, te cilit i atribuohet vepra penale, te pyetet si i pandehur dhe paraqitja e tij nuk pengon masen e sigurimit qe eshte marre me perpara.

Ne nenin 245 te Kodit te Procedures Penale, qe ben fjale per vendimin e gjyqtarit per caktimin e mases se sigurimit thuhet shprehimisht: “Vendimi qe cakton masen e sigurimit permban:

- a. gjeneralitetet e **personit ndaj te cilit merret masa ose çdo gje tjeter qe vlen per ta identifikuar ate** dhe, kur eshte e mundur, tregimin e vendit ku ndodhet”.

Nuk ka si thuhet me qarte qe ai nuk eshte ende i pandehur, por **person ndaj te cilit merret masa** dhe se ai jo vetem mund te mos jete marre i pandehur, por mund te mos i dihen gjeneralitetet e tij, prandaj ne vendim duhet te tregohet cdo gje qe vlen per ta identifikuar ate.

Ne nenin 246, i cili ben fjale per zbatimin e masave te sigurimit thuhet: “Oficeri ose agjenti i policise i ngarkuar me zbatimin e vendimit te arrestit i dorezon **personit ndaj te cilit eshte marre masa** kopjen e vendimit..”.

Ne nenin 248, i cili ben fjale per **marrjen ne pyetje te personit te arrestuar** thuhet: “Jo me vone se tri dite nga zbatimi i mases, gjykata e merr ne pyetje **personin per te cilin ka vendosur arrestin** ne burg ose ne shtepi”.

Perdorimi i fjales “i pandehur” kur flitet per te drejtat e te arrestuarit, lidhet me faktin qe ai mund te jete edhe i tille, por jo se pa qene i tille ndaj tij nuk mund te caktohet mase sigurimi. Kjo gje ndeshet edhe ne legjislacionet procedurale te shteteve qe kane rregullin e marrjes si te pandehur ne fund te hetimeve, kur vendoset dergimi i ceshtjes ne gjykate, pra shume kohe me vone se caktimi i mases se sigurimit (shih nenin 292 te Kodit te Procedures Penale te Italise qe ben fjale per vendimin e caktimit te mases se sigurimit).

Nga permbajtja e dispozitave te analizuara me siper, rezulton, qartesisht i shprehur qellimi i ligjvenesit sipas te cilit, masat e sigurimit mund te merren ndaj çdo personi qe ploteson kushtet per te qene subjekt i vepres penale. Terminologjia e perdorur nga kodi i procedures penale per subjektet e veprave penale ndryshon nga fillimi i ceshtjes penale e deri ne dergimin e saj per gjykim. Emertimi i autoreve te veprave penale fillon me termin “personi, te cilit i atribuohet vepra penale” (neni 287), “person ndaj te cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308 etj.) dhe “i pandehur” qe ndeshet ne shume dispozita te tjera te Kodit te Procedures Penale. Autori i mundshem i vepres penale keto emertime i merr ne faza te ndryshme te procedimit penal. Keto emertime nuk perfaqesojne te njejten gje dhe nuk kane te njejtin kuptim.

Termin “person te cilit i atribuohet vepra penale” e gjejme ne nenin 287 te K.Pr.Penale qe ben pjese ne kreun e dYTE te titullit te gjashte te kodit qe flet per menyren si njoftohet e merr dijene per vepren penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush eshte autori i vepres penale, prokurori, shenon ne regjistrin qe mbahet per njoftimin e veprave penale emrin e personit qe tregon kallzuesi, se eshte ose mund te jete autor i vepres penale. Nuk ka asnje dyshim se ky emertim i perket fazes fillestare te procedimit penal. Termi “person te cilit i atribuohet vepra penale” i marre ne kontekstin e nenit 287 te K.Pr.Penale plus momentin procedural ne te cilin perdoret, kuptohet se nuk mund te barazohet as me termin “person ndaj te cilit zhvillohen hetime” dhe as me termin “i pandehur”. Emri i personit te cilit i atribuohet vepra penale shenohet ne regjister vetem ne ato raste

kur kallzuesi mendon se e di se kush eshte autori i krimimit. Por kjo nuk do te thote se ai eshte vertet autor i vepres penale. Ne se vertet personi te cilit i atribuohet vepra penale eshte apo jo autor i vepres penale do te dale nga nje hetim i plote i gjithanshem e ne perputhje me ligjin.

Ne fazen e hetimeve paraprake kuptohet se ndryshon dhe gjendja juridiko-procedurale penale e autorit te mundshem te vepres penale nga person qe i atribuohet vepra penale ne "person ndaj te cilit zhvillohen hetime". Kete emertim e mbajne vetem personat qe dyshohen si autore te mundshem te vepres penale. Edhe ky, emertimi i dyte qe merr autori i mundshem i vepres penale gjate hetimeve paraprake nuk mund te barazohet me termin "i pandehur". Personi ndaj te cilit zhvillohen hetime eshte nje figure procedurale e perkohshme qe qendron midis asaj qe Kodi Procedures Penale e quan "person te cilit i atribuohet vepra penale" dhe "te pandehurit" e cila eshte nje figure me e avancuar procedurale dhe relativisht me e qendrueshme, e cila ruhet e pandryshuar, ne cdo gjendje dhe shkalle te procesit penal, derisa te kete marre forme te prere vendimi i pushimit, i pafajsise ose fajesise (neni 34/2 i K.Pr.Penale).

Duke permbledhur sa u tha me siper, arrihet ne perfundimin se figura procedurale e autorit te mundshem te vepres penale qe nga momenti i njoftimit te saj tek prokurori e deri ne momentin e perfundimit te hetimeve (neni 327) evoluon nga "person te cilit i atribuohet vepra penale" ne "person ndaj te cilit zhvillohen hetime" dhe se fundi ne "i pandehur", pavaresisht se ceshtja pushohet (neni 328) apo dergohet per gjykim (neni 331). Si rregull statusi i te pandehurit merret ne perfundim te hetimeve perpara se te depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund te merret edhe me perpara. Kjo eshte ne cmimin e prokurorit. Dhe kete prokurori mund ta beje ne cdo faze te hetimit deri ne perfundimin e tyre. Kete veprim prokurori e kryen vetem pasi te kete siguruar **te dhenat e mjaftueshme** (neni 34/1 i K.Pr.Penale).

Duke perfunduar theksojme se caktimi i masave te sigurimit kundrejt autoreve te veprave penale nuk kushtezohet me marrjen e cilesise se te pandehurit. Pavec dispozitave te cituara e te analizuara me siper kjo del edhe nga neni 5 i Kodit te Procedures Penale ku thuhet: "Liria e personit mund te kufizohet me masa sigurimi vetem ne rastet dhe menytrat e percaktuara me ligj". Rregulli i percaktuar ne nenin 5 plotesohet dhe sqarohet me se miri nga pika 4 e nenit 34 te Kodit te Procedures Penale ku thuhet: "Dispozitat, qe zbatohen per te pandehurin, zbatohen edhe per personin nen hetim, me perjashtim te rasteve kur ky kod parashikon ndryshe. Ndaj ketij personi (nenkupto personi ne hetim) shtrihen edhe te drejtat dhe garancite qe jane parashikuar per te pandehurin".

Ne veshtrim edhe te dispozitave te sapocituara duhet pranuar se prokuroria e ka plotesuar ne menyre rigoroze detyrimin ligjor per njoftimin e akuzes. Eshte e vertete se Vladimir Ozmaj eshte marre formalisht i pandehur me vonese e konkretisht me daten 17.01.2002, por ne permbajtje, per akuzen eshte njoftuar shume kohe me pare, qysh me daten 4.10.2001. Procesverbali i mbajtur me kete rast duhet te konsiderohet edhe si akt i njoftimit te akuzes perderisa ai i ploteson ne parim dhe ne permbajtje kerkesat e ligjit per tu konsideruar nje akt njoftimi akuze.

Gjykata e apelit i ka dhene pa te drejte me shume rendesi gjendjes juridiko-procedurale te personit qe do t'i komunikohet akuzat se sa permbajtjes se akuzes. Nga dispozitat procedurale penale del ne menyre te qarte se ligjvenesi nuk eshte i interesuar shume per gjendjen juridiko-procedurale te personit qe akuzohet.

Ajo qe vlen te theksohet dhe te vihet me shume ne dukje eshte percaktimi i permbajtjes se akuzes qe duhet te njoftohet dhe dhenia e mundesise personit te akuzuar per t'u mbrojtur.

Nga kjo rrjedh perfundimi logjik se organi procedues mund ta beje njoftimin e akuzes si perpara pyetjes se personit nen hetim ashtu edhe perpara marrjes se personit ne cilesine e te pandehurit dhe pyetjes se tij

Si perfundim, Kolegjet e Bashkuara theksojne se **masat e sigurimit mund te caktohen edhe pa u marre personi me pare si i pandehur, me kusht qe te jete vene ne dijeni menjehere dhe hollesisht per akuzen qe i behet dhe per te drejtat e tij (neni 31 i Kushtetues).**

Nisur nga sa me lart, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte e konsiderojne te pabazuar ne ligj vendimin nr. 4 date 07.02.2002 te Gjykates se Apelit Durres dhe konfirmojne ligjshmerine e vendimit nr. 7 date 11.01.2002 te Gjykates se shkalles se pare Durres.

Megjithe lenien ne fuqi, ky vendim do te jete i zbatueshem ose jo ne vartesis te ecurise se hetimit te metejshe dhe te gjykimit eventual te ceshtjes brenda afateve perkatese proceduriale te masave te sigurimit, te hetimit e gjykimit te ceshtjes, etj., per te cilat nuk mund te shprehen Kolegjet e Bashkuara.

Ne rast pamundesie ligjore apo objektive te zbatimit te ketij vendimi, per shkak te kalimit te kohes e te krijimit te rrethanave te reja qe krijojne nje pamundesi te tille atehere konsideratat e shprehura ne te marrin vetem vleren e verejtjeve dhe te orientimeve per praktiken gjyqesore ne te ardhmen.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne baze te nenit 441/1 –“d” te K.Pr. Penale

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr. 4 date 7.02.2002 te Gjykates se Apelit Durres dhe lenien ne fuqi te vendimit nr. 7 date 11.01.2002 te Gjykates se shkalles se pare Durres.

Ky vendim per unifikimin e praktikës gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 27.9.2002

MENDIM PAKICE

Nuk jemi dakort me mendimin e shumices per arsyet e meposhteme:

Problemi qe shtrohet per t'u diskutuar dhe qe ka ardhur per verifikim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne lidhje me faktin nese mund te caktohet nje mase sigurimi pa u marre personi, me pare, si i pandehur, per shkak te rendesise qe ka, mendojme se duhet pare dhe trajtuar ne dy aspekte:

1. Ne aspektin juridiko-procedural penal dhe
2. Ne aspektin Kushtetues dhe social.

Ne aspektin juridiko procedural penal, ky problem eshte rregulluar nga ligjevenes nepermjet nje seri dispozitash te K.Pr.Penale, rregullim ky qe, sipas mendimit te pakices, eshte i plote dhe pavaresisht nga mendimet e kunderta qe mund te kete patur, nuk le shteg, per ekuivoke.

Ne kete perfundim arrihet se pari, duke bere interpretimin gramatikor dhe logjik te dispozitave qe jane perfshire ne kreun e pare te titullit te peste te K.Pr.Penale (nenet 227-243), te cilat perbejne grupin e dispozitave nepermjet te cilave ligjevenes ka rregulluar posacerisht dhe vetem problemin e masave te sigurimit personal dhe se dyti, permes interpretimit sistematik krahases te nje seri dispozitash te tjera te perfshira ne seksionet pasardhese te po ketij titulli (kreu II-V inkluziv) ose dhe ne tituj te tjere te kodit.

Ne kreun e pare te titullit te V te K.Pr.Penale, te cilin sikurse u tha me lart, ligjvenes ia ka kushtuar masave te sigurimit personal, masat e sigurimit personal kategorizohen ne dy grupe: ne a)

masa shtrenguese dhe b) masa ndaluese (neni 227). Dallimi midis tyre konsiston ne faktin se, ndryshe nga masat shtrenguese, ato ndalueset mund te zbatohen jo per te gjitha veprat penale, por vetem kur procedohet per vepra penale per te cilat ligji cakton denim me burgim me te larte, ne maksimum, se nje vit, si dhe ne faktin qe, qellimi i vetem i marrjes se ketyre masave eshte parandalues.

Anet e tjera, sikurse jane kushtet per caktimin e masave te sigurimit personal, (neni 228) kriteret per caktimin e masave te sigurimit personal (neni 229) dhe zevendesimin ose bashkimin e masave te sigurimit personal (neni 231), te dy keto grupe masash sigurimi, i kane te perbashketa.

Nga permbajtja e dispozitave te neneve 232-238 dhe 241-242 te K.Pr.Penale, ne te cilat parashikohen llojet konkrete te masave te sigurimit personal (shtrengueset dhe ndalueset), te dy keto grupe masash sigurimi personal, kane te perbashket edhe faktin se cili eshte statusi i personit ndaj te cilit ose thene ndryshe, ne ngarkim te cilit gjykata mund t'i caktoje keto masa.

Keshtu, me vendimin qe urdheron ndalimin e daljes jashte shtetit (neni 233), ***gjqytari urdheron te pandehurin...***; me vendimin per paraqitjen ne policine gjyqesore (neni 234) ***gjqykata urdheron te pandehurin...***; me vendimin qe disponon ndalimin e qendrimit (neni 235), ***gjqykata urdheron te pandehurin...***; garancia pasurore eshte marrja e nje deklarate (neni 236) ***te nenshkruar nga i pandehuri...***; me vendimin e arrestit ne shtepi (neni 237), ***gjqykata urdheron te pandehurin...***; me vendimin e arrestit ne burg (neni 238), ***gjqykata urdheron policine gjyqesore qe ta kape te pandehurin...***; me vendimin qe disponon pezullimin e ushtrimit te nje detyre a sherbimi publik (neni 242), ***gjqykata i ndalon perkatesisht te pandehurit...*** dhe, se fundi, me vendimin qe disponon ndalimin per te ushtruar profesione ose detyra te caktuara drejtuese ne persona juridike (neni 243) ***gjqykata e ndalon perkatesisht te pandehurin....***

Nga citimi i pjesshem i permbajtjes se dispozitave te mesiperme, rezulton, qartesisht i shprehur, qellimi i ligjevenesit sipas te cilit, te gjitha keto masa te sigurimit personal qe u permenden, mund te merren ose vendosen nga gjykata jo ndaj kujtdo, jo ndaj çdo lloj personi (kuptohet qe ploteson kushtet per te qene subjekt i vepres penale), por vetem ndaj personave qe ndodhen ne nje gjendje ose me nje status te caktuar, po qartesisht te shprehur, nga vet ligjevenesit. Dhe ky person, nga vet ligjevenesit, eshte emertuar “i pandehur”.

Nje argument plus qe perforcon konkluzionin e mesiperme, eshte edhe fakti qe, ne nje rast te vetem, kur lind nevoja e caktimit te mases se sigurimit ndaj nje personi, i cili nuk mund te jete subjekt i vepres penale per shkak se vuan nga semundje mendore qe passjellin papergjegjshmeri, sikurse eshte shtrimi i perkohshem ne nje spital psikiatrik (neni 239), ligjevenesit nuk ka perdorur fjalen i pandehur, por shprehet me fjalet: “Kur personi qe duhet arrestuar eshte i semure menderisht...gjqykata ne vend te paraburgimit mund te urdheroje...”.

Dhe, si cdo ne rast tjetër, edhe ketu, pakica mendon se ky percaktim, forcon rregullin.

Edhe nga permbajtja e dispozitave të kreut të II të, të titullit të V të, të K.Pr.Penale, (neni 244-250) në të cilat percaktohen rregullat që duhen ndjekur për caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit, pavarësisht se jo në të gjitha ato përmendet termi “i pandehur”, rezultojnë se masa të tilla mund të caktohen nga gjykata jo ndaj çdo personi, por vetëm ndaj personave që kanë marrë cilesinë e të pandehurit.

Është e vërtetë që në nenin 245 të K.Pr.Penale, bëhet fjalë se vendimi që përmban masën e sigurimit përmban **gjeneralitetet e personit** ose në nenet 246, 247 dhe 248 të tij, bëhet fjalë se agjenti ose oficeri i policisë gjyqësore...**i dorezon personit...**, (neni 246), **ose kur personi...** nuk gjendet...(neni 247) dhe ...gjykata e marrë **ne pyetje personin...**(neni 248), por, duke e parë, në teresinë e saj përmbajtjen, qoftë edhe të këtyre dispozitave, në të bëhet fjalë jo për çfarëdo lloj personi, por për personin ndaj të cileve është caktuar me parë masa e sigurimit personal, që do të thotë se bëhet fjalë për të pandehurin.

Fare qartë një gjë e tillë del nga permbajtja e tre dispozitave të fundit (nenet 249-250) të këtij kreu në të cilat thuhet shprehimisht se, brenda dhjetë ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës...prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij...(neni 249/1), **ose për të pandehurin e ikur...**(neni 249/2), ose **kur i pandehuri është paraburgosur...**(neni 250/2 dhe **kur ndaj të pandehurit janë dhënë disa vendime...** (neni 250/4) nga të cilat kuptohet se është fjala për personin ndaj të cileve ka qenë caktuar me parë një masë sigurimi dhe këta nuk mund të jenë me cilesi tjetër procedurale veç asaj të të pandehurit në një procedim penal.

Argumenti i përdorur nga shumica, sipas të cilit janë disa veprime procedurale, sikurse arrestimi në flagrancë dhe ndalimi i të dyshuarit për një krim (nenet 251 dhe 253 të K.Pr.Penale) që ndermerren akoma pa u marrë personi si i pandehur, pakica mendon se përbejnë konfundim të cështjes midis veprimeve të menjehershme të organeve të ndjekjes para ose pas fillimit të procedimit penal si dhe, në një rast të vetëm (neni 253 i K.Pr.Penale), të prokurorit, kur urdheron të kryhet ndalimi i personit që dyshohet për një krim, kur ka shkaqë të bazuara për të menduar se ka rrezik i keqe dhe veprimeve që kanë lidhje me caktimin nga gjykata të masave të sigurimit personal, sikurse janë akti i njoftimit të akuzës me anën e të cilit personi, të cilit i atribuohet vepra penale, marrë cilesinë e të pandehurit (neni 34 i K.Pr.Penale) dhe kërkesa për caktimin e masave të sigurimit (neni 244 i K.Pr.Penale) që i paraqitet gjykatës pasi personi të cilit i atribuohet vepra penale të ketë marrë me parë cilesinë e të pandehurit.

Edhe në këtë rast, si argument plus që forcon rregullin, mund të sillen veprimet që kryen prokurori, i cili marrë ne pyetje të arrestuarit ose të ndaluarit, të cilit i njofton faktin për të cilin procedohet dhe arsytet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhenat në ngarkim të tij... (neni 256 i K.Pr.Penale), veprim edhe ky që, në cdo rast, kryhet para paraqitjes së kërkesës për caktimin e masës së sigurimit.

Edhe pse në rastin e fundit, ligjvënësia nuk ka përdorur termin “i pandehuri”, nga permbajtja e dispozitës së nenit 256 të K.Pr.Penale ku, veç të tjerave thuhet se “...prokurori...i njofton të arrestuarit ose të ndaluarit faktin për të cilin procedohet dhe arsytet e marrjes në pyetje, **duke i treguar të dhenat në drejtim të tij...**” del fare qartë se është fjala për detyrimin që ka prokurori që të njoftojë personin e ndaluar ose të arrestuar (kuptohet në flagrancë) për fakte dhe të dhëna të cilat duke patur parasysh përmbajtjen e nenit 34 të K.Pr.Penale, automatikisht, i japin këtij personi cilesinë e të pandehurit.

Duke u nisur, veç të tjerave, edhe nga fakti që dispozita e nenit 256, e cila u përmend më lart, është përfshirë në kreun e III të titullit të V të K.Pr.Penale, ku bëhet fjalë për arrestimin në flagrancë dhe ndalimin, kuptohet që ky veprim i prokurorit realizohet para se të bëhet, prej tij, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit.

Ne favor te pikepamjes se parashtuar me larte, megjithese nuk kane te bejne drejtperdrejt me çeshtjen per te cilen diskutohet, sherben edhe permbajtja e nje seri dispozitash te tjera te K.Pr.Penale, te cilat gjenden te shperndara neper tituj dhe nentituj te ndryshem te ketij kodi, sikurse jane dispozitat e neneve 287, 293/1, 295, 296, 302, 303/2-“b” dhe “d”, 304/2, 308 etj te K.Pr.Penale. Per te mos patur ndonje keqkuptim ne lidhje me terminologjine e perdorur nga ligjevenesi per autorin e mundshen te vepres penale per njoftimin e se ciles eshte regjistruar çeshtja penale, pakica mendon se eshte vendi te sqarohet se, ne lidhje me autorin e mundshem te vepres penale, ligjevenesi, pervec termit “i pandehur” ka perdorur dhe termat “personi, te cilit i atribuohet vepra penale” (neni 287) dhe “person ndaj te cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295, 296, 302, 302/2-“b” dhe “d”, 304/2 dhe 308 te K.Pr.Penale.

Duke u nisur jo vetem nga permbajtja e ketyre dispozitave, por edhe nga titulli i kodit ne te cilin ato jane vendosur, si dhe nga organi qe procedon per zbatimin e seciles prej tyre, jemi te mendimit se keto tre terma nuk perfaqesojne te njejten gjë, nuk kane te njejtij kuptim.

Persa i takon termit “person te cilit i atribuohet vepra penale” qe perdoret ne permbajtjen e dispozites se nenit 287 te K.Pr.Penale, nga qellimi dhe momenti procedural ne te cilin eshte perdorur, kuptohet se nuk mund te barazohet as me termin “i pandehur” as edhe me termin “personi ndaj te cilit zhvillohen hetime”. Ai ka te beje me shenimin, nga prokurori, ne regjistrin qe mbahet per njoftimin e veprave penale, te emrit te personit per te cilin ky njoftim ben fjale se eshte ose mund te jete autor i vepres penale dhe kjo ndodh vetem ne ato raste kur njoftuesi mendon se e di se kush eshte autori i kesaj vepre.

Duke patur si pike referimi, po permbajtjen e dispozitave te permendura te K.Pr.Penale dhe organin qe procedon per zbatimin e tyre, mendojme se edhe termi “personi ndaj te cilit zhvillohen hetimet” nuk mund te barazohet me termin “i pandehur” pasi nga permbajtja e dispozitave qe u permenden se eshte perdorur ky term, rezulton qe kete emertim e mbajne vetem personat qe dyshohen si autore te mundshem te vepres penale dhe qe me perjashtim te nje rasti te vetem (neni 308 i K.Pr.Penale), kemi te bejme me veprime te kryera nga oficeri i policise gjyqesore me ta. Kjo sepse, “personi ndaj te cilit zhvillohen hetimet”, eshte nje figure e perkoheshme, provizore procedurale, e cila qendron midis asaj qe ligjevenesi e quan “person te cilit i atribuohet vepra penale” per efekte te regjistrimit, nga prokurori, te emrit te tij, ne regjistrin e veprave penale (neni 287) dhe “te pandehurit”, i cili perben nje figure me te avancuar, relativisht me te qendrueshme procedurale, e cila ruhet e pandryshuar, ne çdo gjendje dhe shkalle te procesit, derisa te kete marre forme te prere vendimi i pushimit, i pafajesise ose i denimit, (neni 34/2 i K.Pr.Penale).

Rasti i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Penale ne te cilin ligjevenesi “personin ndaj te cilit zhvillohen hetime” e ve ne kontakt te drejtperdrejte me prokurorin, ka te beje me elementet qe duhet te plotesoje ftesa qe i ben prokurori ketij personi, ne statusin procedural ne te cilin ai ndodhet deri ne ate moment, moment ky qe me marrjen ne pyetje prej tij, (prokurorit) ky i fundit supozohet se i ka njoftuar edhe perse akuzohet, veprim ky qe ne gjuhen e perditeshme quhet “marrje si i pandehur”.

Supozimi i bere, pak me lart, e ka bazen ne permbajtjen e dispozites se nenit 304 te K.Pr.Penale ne te cilin behet fjale per veprimtarine hetimore te prokurorit, ne piken 2 te se ciles thuhet se ai (prokurori) mund te kerkoje nga policia gjyqesore kryerjen e veprimeve te deleguara posaçerisht, perfshire edhe marrjen ne pyetje te te pandehurit dhe ballafaqimet ne te cilat merr pjese i pandehuri dhe mbrojtesi i tij.

Nisur nga sa u tha ne paragrafin menjehere me lart, mendojme se eshte lehtesisht e kuptueshme qe delegimi i veprimeve oficerit te policise gjyqesore, prej prokurorit, behet pasi ky i fundit t’i kete njoftuar akuzen personit ndaj te cilit jane zhvilluar hetimet, pra ta kete marre ate si te pandehur.

Thene ne forme te permbledhur sa u parashtruan ne shtate paragrafet e fundit, figura procedurale e autorit te mundshem te vepres penale qe ne momentin e njoftimit te saj tek prokurori, *deri ne momentin e kerkeses per caktimin e mases se sigurimit personal*, evoluon nga “person te cilit i atribuohet vepra penale”, ne “person ndaj te cilit zhvillohen hetimet” dhe ne “i pandehur”, cilesi kjo e fundit e cila sikurse u permend edhe me lart, pas kesaj ruhet ne gjendje dhe shkalle te procesit derisa te kete marre forme te prere vendimi i pushimit, i pafajesise ose i denimit.

Ne aspektin Kushtetues dhe social mendojme se, ky problem duhet trajtuar, se pari, ne kuptimin e lirive dhe te drejtave vetjake, qe perfshihen ne kreun e II te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise edhe se dyti, ne kuptim te pasojave negative, ngadonjehere te pariparueshme qe mund te vijne nga zbatimi i gabuar i dispozitave qe u permenden te K.Pr.Penale, gje qe nuk mund te kete tjeter emer veç arbitraritetit, pasiguri dhe marrjes neper kembe te njeres prej lirive dhe te drejtave te njeriut, siç eshte *liria e personit*.

Eshte pikerisht kjo arsyeja qe ligjevenesi ne nenin 27 te Kushtetutes ka percaktuar ne menyre taksative gjashte rastet (shkronjat “a” –“dh” te kesaj dispozite) ne te cilat mund t’i hiqet liria nje personi, *me kusht qe te jene zbatuar procedurat e parashikuara me ligj*. Dhe ligji ne te cilin jane parashikuar procedurat qe duhen ndjekur para se personit t’i hiqet liria eshte ligji procedural penal, pra K.Pr.Penale, gje per te cilen pakica mendon se nuk ka diskutim.

Siç dihet, ne kete kod ligjevenesi ka percaktuar jo vetem organet kompetente, por edhe rregullat, procedurat qe duhen ndjekur dhe respektuar para se te merret vendimi per heqjen ose kufizimin e lirise se personit, gje qe diktohet, prerazi, nga shprehja “...perveçse ne rastet *dhe sipas procedurave te parashikuara me ligj*”.

(pika 1 e nenit 27 te Kushtetutes).

Nga sa u parashtrua me lart arrihet ne perfundimin se detyrimi Kushtetues konsiston ne ate qe askujt nuk mund t’i hiqet liria neqoftese nuk plotesohen dy kushte: a) Ne se rasti nuk parashikohet shprehimisht ne ligj dhe b) Ne se nuk jane respektuar procedurat e parashikuara ne K.Pr.Penale.

Eshte fakt qe ne Kushtetute nuk permendet termi “i pandehur” dhe kjo, pasi ajo bene fjale per lirite dhe te drejtat vetjake te njeriut ne pergjithesi dhe jo per kategori te veçanta njerezish, sikurse jane edhe te pandehurit.

Persa i takon termit “personi” qe permendet ne piken 2 te nenit 28 te Kushtetutes, mendojme se, permbajtja e kesaj pike nuk ka te beje me masat e sigurimit personal, parashikuar nga neni 227 i K.Pr.Penale, por me arrestimin ne flagrance dhe ndalimin, qe sikurse u permend me lart, jane veprime qe kryhen nga oficeri i policise gjyqesore me qellim te nderprerjes se aktivitetit kriminal dhe pengimit te personit autor i mundshem i vepres penale, per te mos i u shmangur hetimit dhe gjykimit te çeshtjes, d.m.th ka te beje me rastet qe parashikohen ne pjesen e dyte te shkronjes “c” te pikes 2, te nenit 27 te Kushtetutes ku thuhet “...per te parandaluar kryerjen prej tij te vepres penale ose largimin e tij pas kryerjes se saj”.

Spiro Spiro

Kristaq Ngjela

Nikoleta Kita

Zamir Poda

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Perikli Zaharia	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Natasha Sheshi	Anetare
Evgjeni Sinoimeri	Anetare
Irma Bala	Anetare
Vladimir Bineri	Anetar
Vladimir Metani	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Bashkim Caka	Anetar
Agron Lamaj	Anetar
Metush Saraçi	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Ylvi Myrtja	Anetar
Spiro Spiro	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 12.03.2002, moren ne shqyrtim ceshtjen penale nr.1, qe i perket:

- TË PANDEHURVE:
1. JORGAQ MURATI, i biri i Kristos, i dt.1954, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar, mbrojtur nga avokat Fatmir Braka.
 2. JANAQ MURATI, i biri i Kristos, i dt.1960, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar.
 3. ARJANA HEBA, e bija e Llazarit, e dt.1961, banuese në Tiranë, në mungesë, mbrojtur nga avokat Mark Pellumbi.
 4. VLADIMIR MOLLA, i biri i Islamit, i dt.1962, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar.
 5. ASTRIT FEJZO, i biri i Abazit, i dt.1950, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar.
 6. GËZIM PILURI, i biri i Harrizit, i dt.1959, banues në Tiranë, në mungesë.
 7. GENCI GJATA (DORACI), i biri i Jakupit, i dt.1962, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar, mbrojtur nga avokat Remzi Kruja.

8. EDVIN NUKU, i biri i Gasprit, i dt.1971, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar, mbrojtur nga avokat Remzi Kruja.
9. SELAUDIN URUÇI, i biri i Sadikut, i dt.1956, banues në Peshkopi, me arsim të lartë, i padënuar.
10. ARIF MURRJA, i biri i Seferit, i dt.1972, banues në Peshkopi, me arsim të lartë, i padënuar.
11. ROBERT MALIQI, i biri i Dalipit, i dt.1967, banues në Vlorë, në mungesë.
12. SOKOL ALIJA, i biri i Koçiut, i dt.1960, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar.
13. EDMOND VODA, i biri i Idajetit, i dt.1967, banues në Tiranë, i padënuar, në mungesë.
14. XHETAN QOKU, i biri i Qazimit, i dt.1968, banues në Peshkopi, me arsim të mesëm, i padënuar.
15. RAMI TOÇI, i biri i Destanit, i dt.1955, banues në Maqellarë (Peshkopi), i padënuar.
16. FLAMUR BURNAZI, i biri i Tofikut, i dt.1962, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar.
17. HARILLA TAÇI, i biri i Theodorit, i dt.1954, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar.
18. ALEKS MURATI, i biri i Kristos, banues në Tiranë me arsim të mesëm, i padënuar, në mungesë.

A K U Z U A R:

Shtatëmbëdhjetë të parët, për krimin e kontrabandës nga punonjës të doganave, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 175, në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

I pandehuri Janaq Murati edhe për krimin e kontrabandës me mallra për të cilat paguhet akcizë, të kryer në bashkëpunim me të pandehurin Aleks Murati,

parashikuar nga neni 172, në lidhje me nenin 25 të K.Penal dhe veçmas, edhe për krimin e largimit të të burgosurit nga vëndi i qëndrimit, parashikuar nga neni 323/1 të K.Penal.

I pandehuri Aleks Murati për krimin e kontrabandës me mallra për të cilat paguhet akcizë, në bashkëpunim me të pandehurin Janaq Murati, parashikuar nga neni 172, në lidhje me nenin 25 të K.Penal.

1. Deklarimin fajtor të të pandehurve Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba dhe Aleks Murati, për krimin e kontrabandës me mallra për të cilat paguhet akcizë, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 172, në lidhje me nenin 25 të K.Penal, duke aplikuar këtë dispozitë për të pandehurin Janaq, dy herë.

I pandehuri Janaq Murati është deklaruar fajtor edhe për krimin e largimit të të burgosurit nga vendi i qëndrimit, parashikuar nga neni 323/1 i K.Penal.

Duke aplikuar edhe nenin 49 të K.Penal, i dënoi:

Të pandehurin Jorgaq Murati me 5 (pesë) vjet burgim.

Të pandehurin Janaq Murati, për krimin e parashikuar nga neni 172 i K.Penal, me 4 (katër) dhe 1 (një) vit burgim, kurse për krimin e parashikuar nga neni 323 i K.Penal me 2 (dy) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, të pandehurin Janaq Murati e dënoi, përfundimisht, me 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Të pandehurën Arjana Heba, me 3 (tre) vjet burgim.

Të pandehurin Aleks Murati, me 500 mijë lekë gjobë.

2. Deklarimin fajtorë të të pandehurve: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gëzim Piluri, Genci Gjata (Doraci), Edvin Nuku, Selaudin Uruçi, Arif Murrja, Robert Maliqi, Sokol Alija, Edmond Voda dhe Xhetan Qoku, për krimin e shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe duke aplikuar, për të njëmbëdhjetë këta, nenet 48 e 49 të këtij kodi, i dënoi respektivisht me: 1 (një) vit burgim (Vladimirin), 1 (një) vit burgim (Astritin), 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me heqjen e së drejtës të ushtrimit të detyrës së punonjësit të doganave dhe detyrave drejtuese, nenet 35 e 40 të K.P. (Gëzimin), 1 (një) vit burgim (Gencin), 2 (dy) vjet burgim (Edvinin), me kohën e paraburgimit (Selaudinin dhe Arifin), me 500 mijë lekë gjobë (Robertin), me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim (Sokolin), me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim (Edmondin) dhe me kohën e paraburgimit (Xhetanin).

3. Deklarimin fajtorë të të pandehurve Flamur Burnazi e Harilla Taçi për krimin e mos kallzimit të kimit, parashikuar nga neni 300 i K.Penal dhe i dënoi me kohën e paraburgimit.

4. Deklarimin e pafajshëm të pandehurit Rami Toçi.

5. Zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, duke u detyruar solidarisht të pandehurit Jorgo Murati, Janaq Murati e Arjana Heba, t'i paguajnë shtetit shumën prej 448.864 dollarë ose 62.840.960 lekë, shumë që përfaqson detyrimet doganore të shmangura dhe lënien në fuqi të të gjithë sekuestrove të vendosura.

6. Zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, duke u detyruar solidarisht, të pandehurit Janaq e Aleks Murati, t'i paguajnë shtetit shumën 4.866 dollarë ose 680.960 lekë, shumë që përfaqeson detyrimet doganore të shmangura, në bashkëpunim midis tyre.

7. Në zbatim të nenit 190 të K.Pr. Penale, sendet e bllokuara si provë materiale, të kalojnë në favor të shtetit.

Gjykata Apelit Tiranë, me vendimin nr. 94 datë 10.03.2000 ka vendosur:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 634 datë 21.10.1999 për të pandehurit: Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba, Xhetan Qoku, Flamur Burnazi, Harilla Taçi dhe Aleks Murati.
2. Ndryshimin e tij përsa i takon cilësimit ligjor të veprës dhe llojit e masave të dënimit për të pandehurit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gëzim Piluri, Genc Gjata (Doraci), Edvin Nuku, Selaudin Uruçi, Arif Murrja, Robert Maliqi dhe Sokol Alija.
3. Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, në bazë të nenit 428/c të K.Pr. Penale, për të pandehurin Edmond Voda.
4. Mospranimin e ankimit, për shkak të heqjes dorë nga prokurori, (nenet 418 e 420/ç të K.Pr.P.), për të pandehurin Rami Toçi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 268 datë 19.07.2000, vendosi:

Prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit për shkelje të ligjit material dhe procedural dhe kthimin e akteve për rishqyrtim, në po atë gjykatë, me trup gjykues tjetër.

Pas rigjykimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 546 datë 18.12.2000, vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 634 datë 21.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Tiranë për të pandehurit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Genci Gjata (Doraci), Arif Murrja, Xhetan Qoku, Rami Toçi, Aleks Murati, Fatmir Burnazi dhe Harilla Taçi.
2. Lënien në fuqi të këtij vendimi, përsa i takon cilësimit ligjor të veprës dhe ndryshimin e tij për masat e dënimit për të pandehurit: Robert Maliqi, Sokol Alija, Gëzim Piluri, Edvin Nuku dhe Selaudin Uruçi, duke i dënuar respektivisht, me 300 mijë lekë gjobë (Robertin), 500 mijë lekë gjobë (Sokolin), 3 (tre) vjet burgim (Gëzimin), 500 mijë lekë gjobë (Edvinin), kurse të pandehurin Selaudin, me kohën e paraburgimit dhe meqenëse me vendimin nr. 54 datë 30.10.1999, të Gjykatës së rrethit gjyqësor Dibër, ndryshuar me vendimin nr. 128 datë 31.03.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të neneve 175, 25 të K.P. dhe 406 të K.Pr.Penale ka qenë i dënuar me 2 (dy) vjet burgim, në zbatim të nenit 56 të K.Penal, e dënoi përfundimisht, me 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim.
3. Prishjen e vendimit nr. 64 datë 21.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pushimin e çështjes për të pandehurin Edmond Voda.
4. Ndryshimin e këtij vendimi për të pandehurit Jorgaq Murati, Janaq Murati dhe Arjana Heba, duke i deklaruar fajtorë për krimin e kontrabandës me regjim të ndërmjetëm, të kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 177, në lidhje me nenin 25 të K.Penal, i dënoi, respektivisht, me 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj burgim (Jorgaqin), me nga 2 (dy) vjet burgim (Janaqin dhe Arjanën). Per te pandehuren Arjana, u urdherua pezullimi i ekzekutimit te vendimit per 5 vjet kohe.
Në aplikim të nenit 35 të K.Penal, të pandehurit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gëzim Piluri, Genci Gjata, Arif Murrja, Selaudin Uruçi dhe Xhetan Qoku, u dënuan dhe me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit në dogana dhe financë, për 3 (tre) vjet kohë.

Kundër vendimit nr. 546 datë 18.12.2000, të Gjykatës së Apelit Tiranë kanë paraqitur rekurs, në Gjykatën e Lartë: Prokuroria e Apelit Tiranë dhe të gjykuarit Gëzim Piluri, Janaq Murati, Jorgaq Murati dhe Arjana Heba, me të cilin kërkojnë:

Prokuroria:

- Ndryshimin e tij, përsa i takon cilësimit ligjor të veprës për të gjykuarit Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Robert Maliqi, Arif Murrja dhe Xhetan Qoku, duke e cilësuar veprën e kryer prej tyre si kontrabandë me mallra me regjim të ndërmjetëm, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 177, në lidhje me nenin 25 të K.Penal, si dhe përsa i përket masës së dënimit për të gjykuarit Jorgaq Murati dhe Janaq Murati, duke e lënë caktimin e kësaj mase në çmimin e gjykatës.

I gjykuari Gëzim Piluri:

- Ndryshimin e tij, përsa i takon llojit dhe masës së dënimit, duke caktuar gjobë ose dënim me burgim, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me kohë maksimale prove.

Të gjykuarit Janaq Murati, Jorgaq Murati dhe Arjana Heba, kërkojnë prishjen e vendimit dhe deklarinimin e pafajshëm të tyre.

Në rekurset e paraqitura, parashtohen shkaqet e mëposhtme:

Prokurori i Apelit:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit është i gabuar përsa i përket cilësimit ligjor të veprës për të pandehurit Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Robert Maliqi, Sokol Alija, Gëzim Piluri, Genc Doraci, Edvin Nuku, Selaudin Uruçi, Arif Murrja dhe Xhetan Qoku, pasi në vendimin e saj, nuk argumenton se çfare veprime konkrete nga ato që pengojnë zbatimin e një ligji konkret, ka kryer secili prej tyre, sikundër kërkohet në nenin 248 të K.Penal.
- Përkundrazi, duke pranuar se të pandehurit Janaq Murati, Jorgaq Murati e Arjana Heba kanë konsumuar veprën penale të kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177, në lidhje me nenin 25 të K.Penal, duhet të pranohet se këtë vepër ata e kanë kryer në bashkëpunim me 10 të pandehurit punonjës të sektorit doganor të Tiranës dhe të Bllatës.
- Pa një marrëveshje paraprake midis të pandehurve Jorgaq, Janaq dhe Arjana dhe të pandehurve të tjerë – punonjës të doganave Tiranë e Bllatë, nuk mund të realizohej kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm, pasi çdo hallkë e vëndit të punës që i përkiste secilit prej këtyre të pandehurve, ishte pengesë për realizimin e veprës penale.
- Vendimi i Gjykatës së Apelit është i gabuar edhe në caktimin e masës së dënimit për të pandehurit Janaq e Jorgaq Murati, duke i dënuar me kohën e paraburgimit, pasi pasojat e ardhura nga vepra penale e kryer prej tyre, paraqet rrezikshmëri të theksuar.

I gjykuari Gëzim Piluri:

- Ndryshe nga detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, gjykata e Apelit, nuk hetoi dhe nuk analizoi veprimet e kryera nga secili i pandehur dhe konkretisht, nga unë, mbasi unë kam qenë në punë vetëm më 18 dhjetor 1998, që është data e kalesës së parë, kurse më 26 dhjetor 1998, nuk kam qenë në punë dhe nuk kam dijeni se çfarë ka ndodhur.
- Gjykata, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit tim nuk mori parasysh as faktin që unë jam i sëmurë, as rrethanat lehtësonjëse të parashikuara nga nenet 48 e 49 të K.Penal. Po kështu nuk morri parasysh as faktin që dispozita e K.Penal me të cilën është kualifikuar vepra e kryer prej meje, përveç dënimit me burgim, parashikon edhe gjobë.

I gjykuari Janaq Murati: (nëpërmjet mbrojtësit, avokat B.Mane):

- Përveç lidhjeve familjare me Jorgaq Muratin, Aleksandër Muratin dhe Arjana Hebën, nuk më lidh asgjë tjetër me veprimtarinë për të cilën akuzohem. Shoqëria “Murati Do Brazil”, bashkëpronar i së cilës jam, ka patur vetëm marrëdhënie huapërdorje me shoqërinë “OJAL”

shpk, e cila është pronare e mallit dhe magazines doganore, mall, i cili është shitur tek të tretë nga vetë kjo shoqëri. Të dy këto shoqëri kanë patur administratorë të veçantë.

- Veç kësaj, gjatë periudhës për të cilën bëhet fjalë në vendimin e gjykatës, ndodhesha i shtruar jashtë shtetit.
- Në kryerjen e ekspertimit kontabël, nuk janë respektuar rregullat procedurale dhe për rrjedhojë, konkluzionet e dyshimta të tij, u morrën si prova të mirëqëna nga ana e gjykatës.
- Përsa i takon zgjidhjes së padisë civile, është vepruar në kundërshtim me nenet 61 e 62 të K.Pr.Penale.
- Në lidhje me deklarinimin fajtor për kontrabandën që është pranuar se është bërë në bashkëpunim me Aleks Muratin, gjykata ka interpretuar gabim ekzistencën e bashkëpunimit midis meje dhe Aleksit.
- Për akuzën e largimit nga vendqëndrimi i detyrueshëm, çështja duhej të ishte pushuar për mungesë të anës subjektive.
- Përsa i takon llojit dhe masës së dënimit, në caktimin e saj, gjykata nuk morri parasysh gjëndjen time shëndetësore.

I gjykuari Jorgaq Murati:

- Kafja e importuar nga Greqia, ishte e firmës “OJAL” shpk dhe nuk kishte asnjë lidhje me firmën “Murati Do Brazil” në të cilën jemi vetëm dy ortakë, unë dhe vëllai im Janaqi. Gjykatat kanë gabuar në interpretimin e marrëdhënieve juridiko-civile që ekzistojnë midis këtyre dy firmave.
- Gjykatat nuk paten parasysh pikën 5/a të Udhëzimit nr.1, date 20.11.1996 “Për Kodin Doganor” në lidhje me kohëzgjatjen e mallrave me regjim të përkohshëm.
- Gjykatat kanë gabuar në vlerësimin e procedurave që u ndoqën për rieksporimin e kafesë, në kushtet kur dhe magazinat administroheshin nga dogana dhe transporti i kafesë ishte në ekskluzivitetin e doganës.
- Nuk janë patur parasysh kërkesat e ligjit për statusin e agjentit doganor, i cili ishte nënshkruar i deklaratës doganore.
- Në bazë të kontratës që ishte lidhur me Jonuz Muçën, pronësia mbi gjithë sasinë e kafesë i kishte kaluar këtij të fundit që në magazinat e Saukut.
- Gjatë kryerjes së ekspertimeve grafike dhe kontabël nuk janë respektuar kërkesat e neneve 178,179/2,181 dhe 325 të K.Pr.Penale.
- Gjykatat kanë gabuar në zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, pasi nuk dime që organi i akuzës të ketë ngritur padi civile para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Nuk është ngritur edhe gjatë gjykimit të çështjes padi civile që të plotësonte kërkesat e K.Pr.Civile për padinë.
- Në kushtet kur të pandehurit e kësaj çështje janë shumë, për të cilët gjykatat kanë pranuar se kanë vepruar në bashkëpunim, si është e mundur që civilisht janë detyruar vetëm ortakët e firmës “Murati Do Brazil”? (Jorgaqi dhe Janaqi).
- Edhe cilësimi ligjor i veprës së kontrabandës, është i gabuar pasi mungon subjekti si dhe pasi nuk ka kalim të mallit duke iu shmangur kontrollit doganor.

E gjykuara Arjana Heba (nëpërmjet avokatit Mark Pëllumbi):

- Nuk i jam shmangur asnjë detyrimi doganor dhe nuk kam fshehur mall.
- Magazina doganore ka qenë në administrim të përbashkët, timin dhe të doganës. Kjo e fundit ka bërë të gjitha praktikat doganore pas përfundimit të kontratës së shitjes së kafesë, prandaj nuk del se cili është mekanizmi i kontrabandës për të cilën akuzohem.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 696, date 19.11.2001, vendosi:

Dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të bërë njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje më çështjet e mëposhtme:

1. A konkurojnë me njera tjetren figurat e krimit të kontrabandes, që janë parashikuar në seksionin e V-te, të kreut të III-te të K. Penal (nenet 171-177 të K.Penal)?
2. A konkuron figura e krimit të kontrabandes nga punonjes që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i K.Penal, me figuren e krimit të shpërdorimit të detyres, parashikuar nga neni 248 i këtij kodi?
3. Në rastet kur kontrabanda kryhet në bashkëpunim midis dy ose me shumë personave, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen sipas të njëjtes dispozite të K.Penal, apo një apo disa prej tyre do të përgjigjen sipas një dispozite të K.Penal, e cila parashikon një lloj kontrabande dhe një apo disa të tjerë do të përgjigjen sipas një dispozite tjetër, e cila parashikon një lloj tjetër kontrabande?
4. Si do të percaktohet përgjegjësia e bashkëpunëtorëve në rastet kur të gjithë ata janë në rolin e bashkëzekutorit?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionet e anetareve Spiro Spiro dhe Ylvi Myrtja; prokurorin Bilbil Mete, i cili kerkoi ndryshimin e vendimit nr. 546, date 12.12.2000, si më poshtë:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Jorgaq Murati, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K.Penal dhe denimin e tij me 7 vjet burgim; deklarinin fajtor të të pandehurit Janaq Murati, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal, dhe denimin e tij për këtë krim me 6 vjet burgim, dhe për krimet e parashikuara nga nenet 172, 25 e 323/I të Kodit Penal, dhe denimin e tij për këtë krim me 2 (dy) vjet dhe 6 muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehures Arjana Heba, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe denimin e saj me 4 vjet burgim; deklarinin fajtor të të pandehurit Vladimir Molla, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal, dhe denimin e tij me 7 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes dogane për 5 vjet kohe; deklarinin fajtor të të pandehurit Astrit Fejzo, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe denimin e tij me 7 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes dogane për 5 vjet kohe; deklarinin fajtor të të pandehurit Gezim (Harris) Piluri, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal, dhe denimin e tij me 7 vjet burgim si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes dogane për 5 vjet kohe; deklarinin fajtor të të pandehurit Genci Gjata (Doraci), për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal, dhe denimin e tij me 4 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes dogane, për 5 vjet kohe; deklarinin fajtor të të pandehurit Edvin Nuku, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal, dhe denimin e tij me 5 vjet burgim si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes dogane për 5 vjet kohe; deklarinin fajtor të të pandehurit Selaudin Uruci, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal dhe denimin e tij me kohën e paraburgimit si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes dogane për 5 vjet kohe; deklarinin fajtor të të pandehurit Arif Murrja, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal, dhe denimin e tij me kohën e paraburgimit, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes dogane për 5 vjet kohe; deklarinin fajtor të të pandehurit Robert Maliqi, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të K. Penal, dhe denimin e tij me 6 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyres si punonjes

dogane per 5 vjet kohe; deklarimin fajtor te te pandehurit Sokol Aliaj, per vepren penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 te K. Penal, dhe denimin e tij me 6 vjet burgim, si dhe me heqjen e te drejtes se ushtrimit te detyres si punonjes dogane per 5 vjet kohe; deklarimin fajtor te te pandehurit Xhetan Qoku, per vepren penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 te K. Penal dhe denimin e tij me kohen e paraburgimit, si dhe me heqjen e te drejtes se ushtrimit te detyres si punonjes policie per 5 vjet kohe; deklarimin fajtor te te pandehurit Rami Toci, per vepren penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 te K. Penal dhe denimin e tij me kohen e paraburgimit, si dhe me heqjen e te drejtes se ushtrimit te detyres si agjent doganor per 5 vjet kohe; deklarimin fajtor te te pandehurit Flamur Burnazi, per vepren penale parashikuar nga nenet 175 e 25 te K. Penal, dhe denimin e tij me kohen e paraburgimit; deklarimin fajtor te te pandehurit Harilla Taci, per vepren penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 te Kodit Penal, dhe denimin e tij me kohen e paraburgimit; deklarimin fajtor te te pandehurit Aleks Murati per vepren penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 te K. Penal, dhe denimin e tij me 500.000 leke gjobe; mbrojtësit e te pandehurve: Jorgaq Murati (avokat Fatmir Braka), Arjana Heba (avokat Mark Pellumbi), Genci Gjata e Edvin Nuku (avokat Remzi Kruja), te cilet kerkuan pafajesi per klientet e tyre dhe pasi e biseduan ceshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë :

Nga shqyrtimi i akteve qe ndodhen ne fashikullin e procedimit penal nr. 801, si edhe gjate gjykimit te ceshtjes ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, rezultoi se, te gjykuarit Jorgaq e Janaq Murati – (vellerer), ishin ortake te shoqerise tregtare “Murati do Brazil” – shpk, me seli ne Tirane, me objekt, pervec te tjerave, edhe import-eksportin e kafese, themeluar me 06.07.1995.

Me 01.07.1998, e gjykuara Arjana Heba, (bashkeshortja e te pandehurit Jorgaq), themeloi nje shoqeri tjeter tregtare, me emertimin “OJAL” – shpk, ortake e se ciles ishte vetem ajo. Objekti i kesaj shoqerie, ishte import – eksporti i mallrave te ndryshem.

Si Gjykata e Rrethit Gjyqesor, ashtu edhe ajo e Apelit Tirane, bazuar ne provat qe u administruan gjate shqyrtimit gjyqesor, arriten ne perfundimin se shoqeria tregtare “OJAL” – shpk u krijua ne marreveshje midis tre te gjykuarve qe u permenden me lart, jo per te ushtruar aktivitetin qe ishte parashikuar formalisht ne aktet e themelimit te saj, por me pikesynimin qe te sherbente si hallke ndermjetese per realizimin e veprimtarise keqberese ne fushen e kontrabandes, ashtu sikurse ndodhi disa muaj me vone, perfundim, i cili u gjet plotesisht i drejte, i bazuar ne ligj e ne prova, edhe nga Gjykata e Larte.

Per venien ne jete te ketij pikesynimi, rreth nje muaj pas pajisjes me autorizimin perkates per Magazine Doganore, ne magazinën e shoqerise tregtare “OJAL” –shpk, qe ishte marre gjoja me qera, me 17.08.1998, nga shoqeria tregtare “Murati do Brazil”–shpk, u magazinuan 223.853 kg kafe kokerr e pabluar, importuar ne datat 25 shtator dhe 7 tetor 1998 nga Greqia.

Magazinimi i kesaj sasie kafe u be si mall me regjim te ndermjetem, ne kushtet e Magazines Doganore, parashikuar nga kreu i IV-te, i pjeses se III-te, te Kodit Doganor, miratuar me ligjin nr. 7599, date 02.09.1992, qe ishte ne fuqi ne kohen e kryerjes se ketij veprimi.

Sipas dokumentacionit qe eshte paraqitur nga shoqeria tregtare “OJAL” – shpk, e gjithë kjo sasi kafe, figuron sikur eshte rieksportuar ne Republikën ish Jugosllave te Maqedonise, ne datat 16 dhe 29 dhjetor 1998, ngarkuar ne 7 kamiona, nepermjet Pikes Doganore Bllate (Peshkopi), dokumentacion, i cili, me te drejte, eshte konsideruar fiktiv nga ana e gjykatave te dy shkalleve te gjykimit te ceshtjes.

Te dy keto gjykata arriten ne perfundimin se, falsifikimi i dokumentacionit per gjoja rieksportimin e kesaj sasie kafeje, u krye nga te gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati e Arjana Heba, ne bashkepunim me nente nga te gjykuarit e tjere te kesaj ceshtjeje dhe konkretisht, me te

gjykuarit: Astrit Fejzo, Vladimir Molla (te dy doganiere te kontrollit fizik ne Doganen Tirane), Robert Maliqi, Sokol Alia, (te dy – police doganore ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave; Roberti – pergjegjes grupi), Gezim Piluri, Genci Gjata, Selaudin Uruci, Edvin Nuku dhe Arif Murrja (te peste punonjes te Pikes Doganore Bllate; Gezimi – drejtor i kesaj dogane), perfundim, i cili edhe ky u gjet i drejte edhe nga Gjykata e Larte, pasi u konstatua se eshte rezultat i analizes logjike dhe ne perputhje me kerkesat e ligjit qe u eshte bere, ne teresi, rrethanave dhe provave qe u administruan gjate gjykimit te ceshtjes ne ngarkim te tyre.

Kolegjet e Bashkuara te kesaj gjykate, arriten ne perfundimin se drejt ka vepruar gjykata e apelit edhe persa i perket cilesimit ligjor te vepres per te gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati dhe Arjana Heba, duke e ndryshuar ate nga kontrabande me mallra per te cilat paguhet akcize, parashikuar nga neni 172 i K. Penal, qe e kishte cilesuar gjykata e shkalles se pare, ne kontrabande me mallra me regjim te ndermjetem te kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 177, ne lidhje me nenin 25 te ketij kodi. Te drejta keto kolegje vleresojne edhe llojet dhe masat e denimit qe jane caktuar per keta te gjykuar nga gjykata e apelit.

Por, persa i perket cilesimit ligjor te vepres penale per nente te gjykuarit e tjere qe, ashtu sikurse u permend me lart, kane vepruar ne bashkepunim me te gjykuarit Jorgaq, Janaq e Arjane dhe konkretisht per te gjykuarit: Astrit, Vladimir, Robert, Sokol, Gezim, Genci, Selaudin, Edvin e Arif, si shperdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, Kolegjet e Bashkuara arriten ne perfundimin se duhet ndryshuar vendimi i kesaj gjykate (vendimi nr. 546, date 18.12.2000), duke e cilesuar vepren e kryer prej tyre si kontrabande nga punonjes te doganave, krim ky qe parashikohet nga neni 175 i K. Penal.

Ne kete perfundim Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, arriten duke u nisur,

Se pari, nga fakti qe, ashtu sikurse percaktohet ne nenin 64 te Kodit Doganor, miratuar me ligjin nr. 7599, date 02.09.1992, qe ishte ne fuqi ne kohen kur eshte kryer vepra, cdo veprim ose falsifikim, i cili ka per objekt shmangien e kontrollit doganor te mallrave, perben kontrabande dhe se dyti, nga fakti qe nente te gjykuarit emrat e te cileve u permenden me rradhe ne paragrafin e meparshem te ketij vendimi, kane vepruar ne bashkepunim me te gjykuarit Jorgaq, Janaq e Arjane, duke qene ne rolin e bashkezekutorit ne kryerjen e vepres penale te kontrabandes ne lidhje me gjoja rieksporimitin e 223.853 kg kafe, mall ky qe, ashtu sikunder u tha, ishte vendosur ne regjim te ndermjetem, ne kushtet e magazines doganore.

Te dy keto figura vepre penale sipas te cilave eshte cilesuar vepra e kryer nga dymbedhete te gjykuarit e permendur me lart, bejne pjese ne seksionin e V-te te kreut te III-te te K.Penal ne te cilin, perfshihen veprat penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike.

Ne kete seksion (seksioni i V-te) ligjevenesit ka perfshire krimet ne fushen e doganave, duke i ndare ne nente figura te vecanta krimi (nenet 171-179 te Kodit Penal), te cilat me perjashtim te figurave te krimit parashikuar nga nenet 178 (tregtimi i mallrave qe jane kontrabande) dhe 179 (ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabande), jane forma specifike te figures se pergjithshme te kontrabandes, variante te vecanta te saj.

Ne kete perfundim arrihet pasi objektin e pergjithshem te gjithe ketyre figurave te vecanta krimi, qe perfshihen ne kete seksion, e perbejne te njejtat marredhenie shoqerore. E perbejne marredheniet shoqerore qe jane vendosur per funksionimin normal te doganave ne Republiken e Shqiperise dhe per mbrojtjen e interesave ekonomike te saj nga cfaredolloj veprimtarie qe ka per qellim shmangien nga pagimi ne buxhetin e shtetit te detyrimeve doganore, te cilat, ne analize te fundit, llogariten ne te holla.

Ndarja e figures se pergjithshme te krimit te kontrabandes ne shtate figura te vecanta kontrabande eshte bere nga ligjevenesit duke u nisur se pari, nga natyra e mallrave, me te cilat behet kontrabanda, regjimi juridik i tyre; se dyti, nga shkalla e rrezikshmerise

shoqerore te secilit prej ketyre llojeve te kontrabandes dhe se fundi, nga subjekti, duke krijuar keshtu, kushte ligjore te pershtatshme per te bere te mundur zhvillimin e nje lufte sa me efektive kunder kriminalitetit ne nje sferë aq te rendesishme te ekonomise, sic eshte ajo e veprimtarise se organeve te doganes.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, arriten ne perfundimin se te dymbedhete te gjykuarit qe u permenden me lart, duke marre pjese aktive, me veprimet e kryera prej tyre, krijuan dokumentacion fiktiv, ne forme zinxhiri te panderprere, duke paraqitur ne te sikur sasia prej 223.853 kg kafe kokerr e pabluar qe, sikurse u tha, ne datat 25.09.1998 dhe 07.10.1998 ishte magazinuar ne magazinën doganore te shoqerise "OJAL"-shpk qe ndodhet ne Sauk (Tirane) dhe sikur kjo sasi kafe, ne datat 16 dhe 25/12/1998, u transportua, tranzit, per ne Doganen e Bllates (Peshkopi) dhe qe atje, sikur u eksportua, duke perpiluar perseri dokumenta fiktive per gjoja eksportin qe u be nepermjet kontrollit doganor, kane bere kontrabande ne kuptimin qe u dha ne pjeset e meparshme te ketij vendimi per figuren e pergjithshme te krimit te kontrabandes.

Rezultati kriminal i arritur nepermjet kesaj veprimtarie, shmangia nga kontrolli doganor, duke mos paguar ne buxhet shumen 62.840.960 leke, sikunder me te drejte kane pranuar gjykatat e dy shkalleve te gjykimit te ceshtjes, ka ardhur si rrjedhoje direkte e veprimeve te kunderligjshme te kryera nga te gjithë te gjykuarit e permendur, te cilet vepruan me marreveshje dhe ne bashkepunim midis tyre, ne rolin e bashkezekutorit te kesaj veprimtarie kriminale.

Marreveshja, qe eshte nje nga elementet e domosdoshem per te patur bashkepunim ne kryerjen e vepres penale, madje me kryesori, mund te vendoset jo vetem midis organizatorit, ekzekutorit, shtytesit dhe ndihmesit qe perben formen klasike te bashkepunimit. Ajo mund te vendoset edhe midis vet ekzekutoreve te vepres penale, (ne rastet kur ata jane dy ose me shume persona) dhe ne kete rast do te ndodhemi para bashkepunimit per te kryer veper penale ne formen e bashkezekutimit te saj.

Per te patur kete forme bashkepunimi, kerkohet qe, secili nga personat qe marrin pjese ne realizimin e vepres penale, ose thene ndryshe, secili nga bashkezekutorët, te kryeje veprime qe te kene lidhje te drejte perdrejte shkakesore me pasojen e deshiruar nga te gjithë te tjeret dhe qe vjen si rezultat i ketyre veprimeve te kryera nga secili prej bashkezekutoreve d.m.th secili nga bashkezekutorët me veprimin apo veprimet e tij, te marre pjese direkt ne realizimin e anes objektive te vepres penale.

Ne te njejten kohe, kerkohet qe veprimet e secilit prej bashkezekutoreve, te jene rezultat i realizimit jo i deshirave individuale te tij, por te jene rezultat i realizimit te vullnetit te perbashket te te gjithë bashkezekutoreve te nje veprimtarie te caktuar, konkrete, kriminale.

Kur vepra penale kryhet ne bashkepunim ne formen e bashkezekutimit, midis bashkepunetoreve nuk ka me ndarje rolesh, ne kuptimin klasik te kesaj fjale, (ndarje ne rolet organizator, ekzekutor, shtytes dhe ndihmes), por ka nje lloj ndarjeje tjeter, e cila ka te beje me ndarjen e puneve direkte qe duhet te kryeje secili nga bashkezekutorët per realizimin e vullnetit te perbashket kriminal, vullnet ky qe, ne fund te fundit, manifestohet ne boten e jashteme, vec veprimeve te secilit, edhe me arrijten e rezultatit kriminal te deshiruar prej tyre.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte konstatuan qe, secili prej te gjykuarve Jorgaq, Janaq, Arjana, Astrit, Vladimir, Robert, Sokol, Gezim, Genci, Selaudin, Edvin dhe Arif, kane kryer veprime aktive, qe kane lidhje te drejtperdrejte shkakesore me rezultatin kriminal qe erdhi si rezultat i kontrabandes qe u be me 223.853 kg kafe, qe kishin qene te magazinuar, me statusin e rregjimit te ndermjetem doganor, ne magazinën doganore te shoqerise tregtare "OSAL" - sh.p.k.

Veprimtaria e te gjithë e ketyre te gjykuarve, duke vepruar ne grupe (dyshe dhe peseshe) sipas fazave qe ishin te nevojeshme per arritjen e qellimit final, **shmangies nga pagimi i detyrimeve doganore ndaj shtetit**, u zhvillua ne forme zinxhiri. Zinxhiri filloi me veprimtarine e te gjykuarve Jorgaq, Janaq e Ariana, te cilet, ashtu sic, me te drejte pranojne, si gjykata e shkalles se pare, ashtu edhe ajo e apelit, me shpenzimet, mjetet dhe objektet e dy te pareve, sajuan themelimin e shoqerise tregtare “OJAL” sh.p.k ortake e vetme e se ciles ishte e gjykuara Arianë, siguruan autorizimin e kesaj te fundit per magazine doganore, ku magazinuan ne fakt 223.853 kg kafe, eksportuar nga Greqia dhe vazhdoi me perpilimin e procesverbaleve fiktive per gjoja ngarkimin e kesaj sasie kafe ne shtate automjete, ne datat 16 dhe 25 dhjetor 1998, nga ana e te gjykuarve Astrit e Vladimir dhe me dy procesverbale te tjera, po fiktive, per gjoja dorezimin e ketyre automjeteve te gjykuave Robert e Sokol, qe kryenin detyren e policeve doganore, te cilet firmosen sikur i kishin marre ne dorezim keto automjete dhe sikur i kishin shoqeruar tranzit deri ne doganen e Bllates. Ne Bllate figuron sikur te gjykuarit e tjere, Gezim, Genci, Selaudin, Edvin dhe Arif, veprimet e te cileve perbejne dhe hallken e fundit te ketij zinxhiri, perpiluan dokumentacionin fiktiv per gjoja eksportimin e kesaj sasie kafe ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise.

Fakti qe, po te mos kishte funksionuar qofte edhe njera prej hallkave te ketij zinxhiri, kontrabanda, objekt i ketij gjykimi nuk do te ishte realizuar, sherben edhe si nje rrethane tjetër per te krijuar bindjen ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte se keta te gjykuar kane qene bashkekzekutore te kesaj kontrabande dhe duhet te pergjigjen si te tille.

Persa i perket percaktimit te pergjegjesise, konkretizimit te saj, ne kuptim te cilesimit ligjor te vepres, per secilin prej ketyre te gjykuarve, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke u nisur nga fakti qe, ashtu sikurse u permend edhe ne pjeset e mepareshme te ketij vendimi, ne Kodin Penal, nuk parashikohet nje figure krimi e vetme kontrabande, por shtate te tilla dhe duke patur parasysh sa u parashtruan me lart, ne lidhje me pjesemarrjen e secilit prej te dymbedhete te gjykuarve te siperpermendur, secili prej tyre do te prgjigjet penalisht si bashkekzekutor ne krimin e kontrabandes ne nje nga format e saj.

Duke u nisur nga rrethanat faktike te kesaj ceshtjeje ku, sikurse rezulton e provuar, kafeja me te cilen u zhvillua kontrabanda, per shkak te statusit te magazines doganore qe kishte, ishte mall me regjim te ndermjetem dhe ligjvenesi per kontrabanden e zhvilluar me mallra te ketij lloji, ka parashikuar nje figure te posacme krimi, te cilen e ka emertuar “Kontrabande me mallra me regjim te ndermjetem” (neni 177 i K.Penal), Kolegjet e Bashkuara, arriten ne perfundimin se nje pjese e ketyre te gjykuarve dhe konkretisht, te gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati e Ariana Heba, duhet te pergjigjen penalisht per kete veper penale, sikurse me te drejte eshte cilesuar vepra e kryer prej tyre edhe nga gjykata e apelit.

Ndersa duke u nisur nga fakti qe te gjykuarit e tjere; Astrit Fejzo, Vladimir Molla, Robert Maliqi, Sokol Alia, Gezim Piluri, Genci Gjata (Doraci), Selaudin Uruci, Edvin Nuku dhe Arif Murrja qe moren pjese si bashkekzekutore te kesaj kontrabande, kane qene punonjes te doganave (doganiere dhe punonjes te policise doganore) megjithese do te pergjigjen penalisht po per kontrabande, vepra penale e kryer prej tyre do te cilesohet me nenin 175 te K.Penal qe parashikon kontrabanden e kryer nga punonjes te doganave.

Eshte e vertete qe, ashtu sikurse pretendohet ne rekursin e paraqitur nga organi i prokurorise, (pretendim ky i perseritur edhe nga perfaqesuesi i ketij organi gjate gjykimit te ceshtjes ne Gjykatën e Larte) kur vepra penale kryhet ne bashkepunim, si rregull, bashkepunetoret duhet te pergjigjen per vepren penale te parashikuar nga e njejta dispozite e Pjeses se Posacme te Kodit Penal. Por, kjo ka te beje me pergjegjesine penale te bashkepunetoreve ne kryerjen e vepres penale ne rastet kur ndodhemi para ndarjes klasike te roleve, ne organizatore, shtytes dhe ndihmes dhe jo edhe kur shtrohet problemi i

pergjegjesise penale te bashkekzektoreve te nje vepre penale, ku, sic u permend, ndodhemi perpara ndarjes se puneve midis pjesemarresve ne nje veprimtari te caktuar kriminale, sikurse ne rastin ne gjykim dhe jo perpara ndarjes se roleve.

Ne kete perfundim arrihet duke u nisur edhe nga permbajtja e paragrafit te pare te nenit 27 te K.Penal.

Sipas kesaj dispozite, organizatoret, shtytesis dhe ndihmesit kane pergjegjesi si edhe ekzekutoret per vepren penale te kryer prej tyre ne kuptimin qe edhe vepra e secilit prej tyre do te cilesohet nga gjykata me ate dispozite te Pjeses se Posacme te Kodit Penal me te cilen do te cilesohet vepra e kryer nga ekzekutori.

Ne rastin konkret, ne kushtet kur nga aktet e hetimeve paraprake dhe nga provat e administruara gjate gjykimit, **nuk eshte e mundur te percaktohet organizatori/ët e kesaj veprimtarie**, por, sikurse u permend, ndodhemi jo para ndarjes se roleve, por para ndarjes se puneve midis pjesemarresve ne realizimin e kontrabandes se 223.853 kg kafe, problemi i pergjegjesise penale te cdo njerit prej tyre, ne kuptimin e cilesimit ligjor te vepres te secilit do te zgjidhet, duke patur parasysh parimet e pergjitheshme te bashkepunimit ne formen e bashkekzektimit, qe u permenden ne pjeset e mepareshme te ketij vendimi, duke e vene secilin prej tyre ne te njetin rol bashkepunimi ne ate te bashkekzektorit te vepres penale.

Dhe meqenese problemi tashme shtrohet per pergjegjesine penale jo te bashkepunetoreve ne kuptimin klasik, por te bashkekzektoreve te vepres penale, **Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke u nisur nga parimet e pergjitheshme te doktrines te se drejtes penale sipas te cilave kur ndodhemi para figurave specifike te vepres penale (delictum proprium) ne te cilat bashkekzektimi eshte i mundur vetem midis personave qe jane mbajtes te disa cilesive te vecanta per te qene subjekte te disa veprave penale, (subjekte te posacme), vepra penale e kryer prej tyre do te cilesohet sipas dispozites se Pjeses se Posacme te Kodit Penal, subjekt i te ciles mund te jene vetem personat qe jane mbajtes te ketyre cilesive te vecanta. E tille eshte edhe figura e krimit te kontrabandes nga punonjes te doganave parashikuar nga neni 175 i K.Penal.**

Pikerisht, ne kuadrin e reflektimit te ketyre parimeve, ne ndryshimet qe i jane bere kesaj dispozite me ligjin Nr. 8733 date 24.01.2001, ligjvenesit veprimtarine e kontrabandes qe kryhet nga punonjes te doganave ose punonjes qe kane lidhje me veprimtarine doganore, e ka perfshire ne nenin 175 te K.Penal edhe ne rastet kur kontrabanda, prej ketyre punonjesve, kryhet ne bashkepunim me persona te tjere, te cileve u mungon elementi i cilesive te vecanta per te qene subjekt i posacem i kesaj figure krimi d.m.th nuk jane punonjes te doganave ose punonjes qe kane lidhje me veprimtarine doganore.

Figure specifike vepre penale, per shkak te regjimit te posacem doganor ne te cilin ndodhen mallrat me te cilet behet kontrabanda, sic ishte regjimi i magazines doganore i 223.853 kg kafe, eshte edhe ajo e kontrabandes me mallra me regjim te ndermjetem, parashikuar nga neni 177 i K.Penal, dispozite me te cilen, sikurse u tha, me te drejte eshte bere cilesimi ligjor i vepres penale te kryer prej te gjykuarve Jorgaq Murati, Janaq Murati dhe Ariana Heba, nga gjykata e apelit.

Keshtu qe, duke qene bashkekzektore te kesaj kontrabande, persa i perket konkretizimit te pergjegjesise penale vepra e dy grupeve te personave qe moren pjese ne kete veprimtari (me perberje te grupit te pare jane te gjykuarit Jorgaq, Janaq dhe Arjana, kurse te dytit, te gjykuarit: Astrit, Vladimir, Robert, Sokol, Gezim, Genci, Salaudin, Edvin dhe Arif) do te cilesohet me dy dispozita te vecanta te pjeses se posacme te K.Penal, perkatesisht me nenet 177 e 175 te tij, ne vartesi, perkatesisht, te regjimit te posacem doganor te 223.853 kg kafe me te cilen eshte realizuar kontrabanda, qe perben nje nga elementet perberes te anes objektive te figures se krimit qe parashikohet nga neni 177 i K.Penal dhe te cilesive te vecanta, bartes te te cilave ishte grupi tjetër i

personave qe e kane kryer ate, te cilet plotesojne kerkesen e te qenit subjekt i posacem, ekzistenca e te cilit kerkohet per te patur figuren e krimit te parashikuar nga neni 175 i tij.

Figura e krimit te kontrabandes me mallra ne regjim te ndermjetem, parashikuar nga neni 177 i K.Penal dhe ajo e kontrabandes nga punonjes qe lidhen me veprimtarine doganore, parashikuar nga neni 177 i ketij kodi, nuk konkurojne as me njera tjetren, as edhe me figurat e tjera te krimit te kontrabandes qe perfshihen ne seksionin e V te nenit te III te K.Penal ne te cilin jane perfshire krimet ne fushen e doganave (nenet 171-179 te K.Penal).

Ne kete perfundim arrihet duke u nisur se pari, nga fakti qe, ashtu sikurse u permend, objekti i te gjitha ketyre figurave krimi eshte i njejte (marredheniet shoqerore qe jane vendosur per funksionimin normal te doganave ne Republiken e Shqiperise dhe per mbrojtjen e interesave te shtetit) dhe se dyti, nga fakti qe vet ligjevenes, per arsye praktike, duke dashur te lehtesoje zbatimin sa me te drejte te tyre ne funksion te zhvillimit te nje lufte sa me efektive ne kete fushe te kriminalitetit, e ka ndare kontrabanden ne disa figura krimi, te cilat, teorikisht dhe praktikisht, mund te perbenin paragrafe te vecante te se njejtës dispozite te pjeses se posacme te K.Penal.

Figura e krimit nga punonjes qe lidhen me veprimtarine doganore, parashikuar nga neni 175 i K.Penal, nuk konkuron as me figuren e krimit te shperdorimit te detyres, parashikuar nga neni 248 i tij.

Ne kete perfundim arrihet duke u nisur nga fakti se, anen objektive te figures se krimit te shperdorimit te detyres, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, te cilin ligjevenes, vec te tjerave, e ka shprehur edhe me fjalet: “Kryerja... e veprimeve ne kundërshtim me ligjin qe perben mospermbushje te rregullt te detyres”, qe jane shume te pergjithshme, ne figuren e krimit te parashikuar nga neni 175 i K.Penal, kete element perberes te kesaj figure krimi, e ka konkretizuar, duke e shprehur me fjalet: “Kryerja e kontrabandes...” veprimtari kjo, e cila eshte e qarte qe eshte ne kundërshtim me ligjin dhe me permbushjen e rregullt te detyres te nje kategorie te caktuar personash dhe konkretisht te punonjesve qe lidhen me veprimtarine doganore.

Keta te fundit perbejne edhe subjektin e posacem te figures se krimit te parashikuar nga neni 175 i K.Penal ne te cilin mund te perfshihet nje rreth i kufizuar personash sic jane punonjesit e doganave ose punonjes te tjere qe kane lidhje me veprimtarine doganore dhe jo cdo punonjes i ngarkuar me funksion shteteror ose me sherbim publik nga te cilat qe perbehet subjekti i figures se krimit te parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Nga sa u tha me lart, arrihet ne perfundimin se figura e krimit te kontrabandes nga punonjes qe lidhen me veprimtarine doganore, parashikuar nga neni 175 i K.Penal, eshte nje variant i figures se pergjithshme te krimit te shperdorimit te detyres, parashikuar nga neni 248 i tij, e cila realizohet ne nje fushe specifike te veprimtarise shteterore sikurse eshte ajo e doganave dhe prandaj keto dy figura krimi nuk mund te konkurojne me njera tjetren.

Pikerisht, duke u nisur nga sa u thane me lart, ne dy paragrafet e meparshme te ketij vendimi, eshte arsyeja qe persa i takon cilesimit ligjor te vepres penale te kryer nga i gjykuarit Xhetan Qoku, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, arriten ne perfundimin se vendimi i gjykates se apelit eshte i drejte, i bazuar ne ligj e ne prova dhe si i tille duhet te lihet ne fuqi. Ne fuqi, ne kete pjese te tij, vendimi i gjykates apelit duhet te lihet edhe persa i takon llojit dhe mases se denimit, caktuar ndaj te gjykuarit Xhetan.

Vendimi nr.546, date 18.12.2000, i Gjykates se Apelit Tirane, duhet te lihet ne fuqi si persa i perket cilesimit ligjor te vepres dhe llojit e mases se denimit, edhe per te gjykuarit Flamur Burnazi, Harilla Taci, e Aleks Murati.

Ne pjesen qe ben fjale per llojin dhe masen e denimit, vendimi i mesiperme i gjykates se apelit duhet te ndryshohet per te gjykuarit Sokol Alia, Robert Maliqi dhe Edvin Nuku, duke i

denuar ata respektivisht me, 2 (dy) vjet e 6 (gjashte) muaj (Sokolin), 1 (nje) vit e 6 (gjashte) muaj (Robertin) dhe 2 (dy) vjet (Edvinin), burgim.

Duke marre parasysh rrethanat lehtësonjese dhe rrethanat e tjera që janë përmendur në vendimet e gjykatës së shkalles së parë dhe të apelit, si dhe faktin që, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga kryerja e veprës penale, asaj i ka ikur aktualiteti, bazuar në nenin 59 të K.Penal, vendimi i denimit me burgim për këta të gjykuar do të pezullohet, duke i vënë në prove për 3 (tre) vjet kohë.

Për të njëjtat shkaqe, ekzekutimi i vendimit me burgim do të pezullohet edhe për të gjykuarin Gezim Piluri, për 5 (pese) vjet kohë.

Përsa u takon kërkesave të prokurorit bere gjatë gjykimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u arrit në përfundimin se ato nuk duhen pranuar, pasi, vec shkaqeve të analizuar me hollësi më lart, përsa i takon cilesimit ligjor të veprës për të gjithë të gjykuarit e kësaj çështje, ato, jo vetëm që janë të ndryshme por edhe në tejkalim të pretendimeve që përmban rekursi i prokurorit të apelit që, krahas rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba e Gezim Piluri, ka shërbyer si bazë për të vënë në levizje Gjykatën e Lartë për gjykimin, prej saj, të kësaj çështjeje penale.

Në lidhje me zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, këto Kolegje, e cmojnë të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr.634, datë 21.10.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka detyruar solidarisht të gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati e Arjana

Heba (me pasurine që ata zoterojnë) t'i paguajnë shtetit shumen prej 62.840.960 leke, shume që përfaqëson detyrimin doganor të shmangur si rrjedhojë e kontrabandës zhvilluar prej tyre dhe po solidarisht, të gjykuarit Janaq e Aleks Murati, (me pasurine që ata zoterojnë) t'i paguajnë shtetit shumen 680.960 leke shume që përfaqëson detyrimin doganor të shmangur si rrjedhojë e kontrabandës zhvilluar prej tyre në doganën e Kakavise (Gjirokaster).

Përsa i takon pretendimit të ngritur në rekurs nga të gjykuarit Jorgaq e Janaq Murati, sipas të cilit, në zgjidhjen e padisë civile, gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me nenet 61 e 62 të K.Pr.Penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arriten në përfundimin se nuk qëndrojnë, pasi këto pretendime nuk gjejnë mbështetje në aktet që ndodhen në dosjen penale që u perket këtyre të gjykuarve.

Perkundrazi, nga shqyrtimi i këtyre akteve, rezulton se kur çështja ishte ende në hetim, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i është bere kerkese organit të prokurorisë për t'u legjitimuar si padites civil në procesin penal për detyrimet doganore të shmangura si rezultat i mosrieksportimit të 223.853 kg kafe, kerkese e cila, në zbatim të nenit 61/1 të K.Pr.Penale, u pranua me vendim të prokurorit të çështjes i cili mbas kësaj, krahas kërkesës për gjykimin e kësaj çështjeje penale, iu drejtua Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë edhe me kerkese të vecante për shqyrtimin, në këtë proces penal, të padisë civile që ishte ngritur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ende pa u filluar shqyrtimi gjyqësor, kerkese, të cilën prokurori e perseriti, në përputhje me kërkesat e ligjit edhe gjatë seancave që u zhvilluan për shqyrtimin gjyqësor të kësaj çështjeje penale.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenet 438 dhe 441/“a” e “b” të K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

1. Lenien ne fuqi te vendimit nr.546, date 18.12.2000, te Gjykates se Apelit Tirane per te gjykuarit: Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba, Xhetan Qoku, Aleks Murati, Flamur Burnazi e Harilla Toci, si persa i perket cilesimit ligjor te vepres, ashtu edhe llojit te masave te denimit.
2. Ndryshimin e ketij vendimi per te gjykuarit: Astrit Fajzo, Vladimir Molla, Gezim Piluri, Genci Gjata (Doraci), Edvin Nuku, Selaudin Uruci, Arif Murrja, Robert Maliqi dhe Sokol Alia, duke bere ndryshimin e cilesimit ligjor te vepres nga shperdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, ne kontrabande, nga punonjes qe lidhen me veprimtarine doganore, parashikuar nga neni 175 i K.Penal dhe denimin e tyre: Astrit Fejzo, me 1 (nje) vit burgim; Vladimir Molla, me 1 (nje) vit burgim; Gezim Piluri, me 3 (tre) vjet burgim; Genci Gjata, me 1 (nje) vit burgim; Edvin Nuku, me 1 (nje) vit burgim; Selaudin Uruci me kohen e paraburgimit (4 muaj e 15 dite); Arif Murrja, me kohen e paraburgimit; Robert Maliqin, me 1 (nje) vit burgim dhe Sokol Alia, me 1 (nje) vit e 6 (gjashte) muaj burgim.
I gjykuari Selaudin Uruci, me vendimin nr.54, date 30.10.1999, te Gjykates se rrethit gjyqesor Diber, ndryshuar me vendimin nr.128, date 31.03.2000, te Gjykates se Apelit Tirane, eshte deklaruar fajtor per krimin e parashikuar nga neni 175, ne lidhje me nenin 25 te K.Penal dhe u denua me 2 (dy) vjet burgim.
Ne zbatim te nenit 56 te K.Penal, i gjykuari Selaudin Uruci, denohet perfundimisht, me 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim.
Ne zbatim te nenit 35/1 te K.Penal, te gjykuarit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gezim Piluri, Genci Gjata, Arif Murrja dhe Selaudin Uruci denohen edhe me heqjen e se drejtes per te ushtruar detyra shteterore, per 3 (tre) vjet kohe.
Ne zbatim te nenit 59 te K.Penal, urdherohet pezullimi i ekzekutimit te vendimit me burgim per te gjykuarit: Sokol Alia, Robert Maliqi, Edvin Nuku dhe Gezim Piluri, duke i vene ne prove, tre te paret (Sokolin, Robertin dhe Edvinin) per 3 (tre) vjet kohe, kurse te gjykuarin Gezim Piluri, per 5 (pese) vjet kohe.
3. Lenien ne fuqi te vendimit nr.546, date 18.12.2000, te Gjykates se Apelit Tirane per te gjykuarin Edmond Voda.
4. Lenien ne fuqi te vendimit ne lidhje me zgjidhjen e padise civile ne procesin penal.
5. Nje kopje e ketij vendimi unifikues te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 26.03.2002

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKES**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga :

Thimjo Kondi	Kryesues
Bashkim Caka	Anetar
Nikoleta Kita	Anetare
Valentina Kondili	Anetare
Ylvi Myrtja	Anetar
Natasha Sheshi	Anetare
Kristaq Ngjela	Anetar
Artan Hoxha	Anetar
Zamir Poda	Anetar
Tefta Zaka	Anetare
Vladimir Metani	Anetar
Metush Saraci	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 19.04.2001 mori ne shqyrtim çeshtjen penale me nr.390 akti qe i perket:

TË PANDEHURVE : 1. ALTIN LUZI
2. AGRON HAJDARI
3. GAZMIR XHAFERRI

A K U Z A:

1. Altin Luzi: Vjedhje me pasoje vdekjen e kryer ne bashkepunim, parashikuar nga nenet 141 dhe 25 te Kodit Penal. Plagosje e lehte me dashje e kryer ne bashkepunim, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 te Kodit Penal. Vjedhje me dhune, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Vjedhje me dhune, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Mbajtje pa leje e armeve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.
2. Agron Hajdari: Vjedhje me pasoje vdekjen e kryer ne bashkepunim, parashikuar nga nenet 141 dhe 25 te Kodit Penal. Plagosje e lehte me dashje e kryer ne bashkepunim, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 te Kodit Penal. Vjedhje me dhune, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Mbajtje pa leje e armeve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

3. Gazmir Xhaferri: Mbjajtje pa leje e armeve luftarake,
parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, me vendimin nr.172 date 23.3.1999 ka vendosur :

1. Deklarimin fajtor te te pandehurit Agron Hajdari per veprat penale te vrasjes me dashje ne lidhje me nje krim tjetër ne baze te nenit 77 te K.P., te vjedhjes me dhune te mbetur ne tentative te kryer ne bashkepunim ndaj shtetasit Xhemal Caka ne baze te nenit 139, 22 dhe 25 te K.P., te vjedhjes me dhune te policit Zog Lika ne baze te nenit 139 te KP, te plagosjes se lehte me dashje ne baze te nenit 89 te K.P. dhe ne aplikim te nenit 51 dhe 55 te KP e ka denuar perfundimisht me 12 vjet e 6 muaj burgim.

2. Deklarimin fajtor te te pandehurit Altin Luzi per veprat penale te vjedhjes me dhune ndaj shtetases Nadire Shatllari dhe te policit Shkelqim Sula ne baze te nenit 139 te K.P., te vjedhjes me dhune te mbetur ne tentative te kryer ne bashkepunim ndaj shtetasit Xhemal Caka ne baze te nenit 139, 22 dhe 25 te K.P., te mbajtjes pa leje te armeve luftarake ne baze te nenit 278/2 te K.P. dhe ne aplikim te nenit 55 te K.P. dhe 406/1 te K.Pr.Penale e ka denuar perfundimisht me 8 vjet burgim.

3. Deklarimin fajtor te te pandehurit Gazmir Xhaferri per vepren penale te mbajtjes pa leje te armeve luftarake, ne baze te nenit 278/2 te K.P. dhe ne aplikim te nenit 51 te ketij Kodi e ka denuar me kohen e qendrimit ne “arrest shtepie”.

Gjykata e Apelit Tirane, mbi ankimin e te pandehurit Agron Hajdari, me vendimin nr.246 date 20.9.1999 ka vendosur :

Lenien ne fuqi te vendimit nr.172 date 23.3.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kunder vendimit te gjykates se apelit kane bere rekurs i pandehuri Agron Hajdari dhe prokurori duke parashtruar keto shkaqe :

Prokurori :

- Ndryshimi i cilesimit juridik te vepres penale nga gjykata nga neni 141 ne nenin 77 te K.P. per te pandehurit Agron Hajdari dhe Altin Luzi eshte bere ne aplikim te gabuar te ligjit dhe nuk eshte mbeshtetur ne asnje prove tjeter pervec atyre qe ka marre prokuroria ne fazen e hetimeve paraprake. Ky ndryshim eshte bere gjithashtu ne kundërshtim me nenin 372 te K.Pr.Penale pa dijenine dhe pelqimin e te pandehurve dhe te avokateve.
- Prokurori i shkalles se pare ne kundërshtim me ligjin ka terhequr akuzen per vjedhje me pasoje vdekje te viktimes Xhemal Caka per te pandehurin Altin Luzi dhe per kete ka denuar te pandehurin Agron Hajdari, duke ia ndryshuar cilesimin juridik te vepres, ne vrasje me dashje ne lidhje me nje krim tjetër.

I pandehuri Agron Hajdari :

- Jam i pafajshem per vrasjen e viktimes Xhemal Caka. Te gjitha provat flasin se kete veper e ka kryer i pandehuri Altin Luzi. Edhe i pandehuri Gramoz Xhaferri ka pohuar se vrasjen e ka

kryer i pandehuri Altin Luzi. Automatiku me te cilin eshte realizuar vrasja eshte gjetur ne shtepine e te pandehurit Altin Luzi.

- Gjykimi i te pandehurit Agron Hajdari eshte bere ne mungese pa u njoftuar me pare ai sikurse parashikon neni 139 dhe 142 i K.Pr.Penale dhe pa u bere shpallja e mungeses. Per kete shkak eshte kerkuar qe te perseritet shqyrtimi gjyqesor ne apel sipas kerkesave te nenit 427 te K.Pr.Penale, gje qe padrejtesisht nuk u pranua nga gjykata. Vet gjykata e apelit ka pranuar se vrasja e viktimes Xhemal Caka eshte kryer ne bashkepunim, por m.q.s. çeshtja ka ardhur me ankimin tim eshte mjaftuar me verejtje duke me lene keshtu ne ngarkim padrejtesisht dhe ne menyre haptazi te palogjikshme vrasjen e viktimes Xhemal Caka.
- Ne gjykimin ne shkalle te pare me rastin e ndryshimit te akuzes nuk na eshte krijuar nga gjykata mundesia dhe e drejta per t'u mbrojtur, pasi ne kundërshtim me nenet 372 dhe 376 te K.Pr.Penale nuk na u dha kohe per te paraqitur pretendimet tona.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin perkates, pasi degjuan prokurorin Mihallaq Bleta qe kerkoi prishjen e vendimeve dhe kthimin e akteve per rishqyrtim ne gjykatën e shkalles se pare, pasi degjuan mbrojtësin e te gjykuarit Altin Luzi, av.Bashkim Haxhi, i cili kerkoi te lihet ne fuqi vendimi i gjykates se apelit, pasi degjuan mbrojtësin e te gjykuarit Agron Hajdari, av.Shefqet Muci qe kerkoi te priset vendimi i gjykates se apelit dhe çeshtja te kthehet per shqyrtim dhe pasi shqyrtuan çeshtjen ne teresi,

V Ë R Ë J N Ë

Vendimi nr 246 dt 20.9.1999 i Gjykates se Apelit Tirane, eshte i pabazuar ne ligj, per rrjedhoje ai duhet te priset .

Me vendimin nr 172 date 23.3.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur deklarimi fajtor i te pandehurit Agron Hajdari per veprat penale te vrasjes ne lidhje me nje krim tjeter ndaj shtetasit Xhemal Caka, parashikuar nga neni 77 i K.P., te vjedhjes me dhune te mbetur ne tentative te kryer ne bashkepunim te parashikuar nga nenet 139, 22 dhe 25 te K.P., te vjedhjes me dhune ndaj policit Zog Lika te parashikuar nga neni 139 i K.P., te plagosjes se lehte me dashje te parashikuar nga neni 89 i K.P. dhe ne aplikim te nenit 51 dhe 55 te K.P. e ka denuar ate perfundimisht me 12 vjet e 6 muaj burgim; Deklarimi fajtor i te pandehurit Altin Luzi per veprat penale te vjedhjes me dhune ndaj shtetases Nadire Shatllari dhe te policit Shkelqim Sula parashikuar nga neni 139 i K.P., te vjedhjes me dhune te mbetur ne tentative te kryer ne bashkepunim ndaj shtetasit Xhemal Caka parashikuar nga nenet 139, 22 dhe 25 te K.P. dhe per vepren penale te mbajtjes pa leje te armeve luftarake parashikuar nga neni 278/2 te K.P. dhe ne aplikim te nenit 55 te K.P. dhe 406/1 te K.Pr.Penale e ka denuar perfundimisht me 8 vjet burgim; Deklarimi fajtor i te pandehurit Gazmir Xhaferri per vepren penale te mbajtjes pa leje te armeve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 te K.P. duke e denuar ate me kohen e paraburgimit.

Kunder vendimit ka bere ankim ne gjykatën e apelit i pandehuri Agron Hajdari. Ne perfundim te gjykimit Gjykata e Apelit ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se shkalles se pare, por nderkohe i ka terhequr vemendjen asaj gjykate per aplikim te gabuar te ligjit. Sipas saj kane qene kushtet qe te pandehurit Agron Hajdari dhe Altin Luzi te pergjigjeshin per vepren penale te vjedhjes me pasoje vdekje, te parashikuar nga neni 141 i K.P., nderkohe qe ata jane deklaruar fajtores per vepren penale te vjedhjes me dhune. Gjykata, duke marre per baze faktin qe ankimi kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare eshte bere nga njeri prej te pandehurve dhe se pozita e tyre nuk mund te rendohet, me te drejte vetem i ka terhequr vemendjen asaj gjykate per aplikim te gabuar te ligjit.

Ne Gjykate te Larte, pervec ankimit te te pandehurit Agron Hajdari lidhur me pretendimet qe ai ngre per drejtesine dhe bazueshmerine e vendimeve te gjykatave, ka bere rekurs nga ana tjeter edhe prokurori, i cili, duke marre shkas edhe nga vendimi i gjykates se apelit, ka kerkuar prishjen e vendimeve te gjykatave per te tre te pandehurit dhe kthimin e ceshtjes ne shkalle te pare, per shkak te cilesimit juridik te gabuar te vepres, duke e konsideruar ndryshimin e tij nga vjedhje me pasoje vdekje parashikuar nga neni 141 i K.P., ne vjedhje me dhune mbetur ne tentative, parashikuar nga neni 139 dhe 22 i K.P., si te pambeshtetur ne ligj dhe ne prova. Me fjale te tjera, sipas rekursit te prokurorit, kerkohet qe pozita e te pandehurit ne rigjykim te rendohet.

Kolegji Penal ka kaluar ceshtjen per shqyrtim Kolegjeve te Bashkuara me qellim unifikimin e praktikes gjyqesore lidhur kufijte e shqyrtimit te ceshtjes ne Gjykatën e Larte kur ankimi per nje ceshtje ne gjykatën e apelit eshte bere vetem nga i pandehuri, ndersa ne Gjykatën e Larte ajo vjen me ankim te te dy paleve ose vetem te prokurorit.

Kolegjet e Bashkuara, pasi diskutuan ceshtjen ne teresi arrijne ne perfundimin se:

Sipas nenit 2 te Protokollit 7 te Konventes Evropiane “Per mbrojtjen e te drejtave dhe lirive te njeriut” dhe nenit 43 te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise, personi i deklaruar fajtor per nje veper penale ka te drejte te paraqese ankim ne nje gjykate me te larte ne kushtet qe parashikon ligji.

Titulli VIII i K.Pr.Penale rregullon ankimet ndaj vendimeve gjyqesore, menyren, proçeduren si dhe kufijte e shqyrtimit te tyre. Ligjvenesit me te drejte ka percaktuar nje garanci proçedurale te rendesishme per te pandehurin duke i garantuar atij te drejten e nje apeli pa patur rrezikun e rendimit te pozites se tij ne ushtrimin e kesaj te drejte.

Ne nenin 425 pika 2 dhe 3 te ketij Kodi eshte parashikuar se, “*kur apelues eshte vetem i pandehuri, gjykata nuk mund te caktojte nje denim me te rende, te zbatoje nje mase sigurimi me te rende, t’i jape pafajesise nje shkak me pak te favorshem nga ai i vendimit te apeluar.*”, ndersa kur apelues eshte edhe prokurori, apo vetem ky i fundit, gjykata e apelit “*mund t’i jape faktit nje cilesim juridik me te rende, te ndryshoje llojin ose ta rrise masen e denimit, ...*”.

Ne kuptim te kesaj dispozite, Gjykata e Apelit kur shqyrton ceshtjen vetem mbi ankimin e te pandehurit ne asnje rast nuk mund te rendoje poziten e tij si per masen e denimit, ashtu dhe per cilesimin juridik nga nje veper penale me te lehte ne nje veper penale me te rende.

Nga ana tjeter, Kodi i Proçedures Penale ne te njejtin titull parashikon te drejten e paleve te ushtrojne rekurs kunder vendimit gjyqesor te formes se prere ne Gjykatën e Larte. Ne kuptim te nenit 432 te K.Pr.Penale, rekursi aplikohet vetem per shkaqe te kufizuara qe lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar te ligjit material ose normave proçedurale te cilat e bejne vendimin e dhene te kunderligjshem. Nga kjo, rezulton se shkelja e ligjit nga gjykatat me te uleta ne dhenien e vendimeve i jep juridiksion Gjykates se Larte te shqyrtojte dhe te cenoje vendimet e tyre, pavaresisht se kush ka paraqitur rekurs. Ne kete kuptim, ne dallim nga neni 425 i K.Pr.Penal, ne nenin 434 te ketij Kodi percaktohet se Gjykata e Larte eshte e detyruar ta shqyrtojte ceshtjen brenda shkaqeve te ngritura, me perjashtim qe ajo, kryesisht, mund te vendose edhe per ceshtje te tjera ligjore per te cilat gjykatat duhet t’i kishin pare kryesisht ne çdo gjendje e shkalle te proçesit. Pra, Gjykata e Larte, pavaresisht se kush i drejtohet asaj, ka detyrimin ligjor qe, kur konstaton se gjykatat e shkalleve me te uleta te kene zbatuar gabim ligjin ne dhenien e vendimeve, t’i prishe keto vendime dhe te disponoje ne nje nga menytrat qe percakton neni 441 i K.Pr.Penale.

Duke marre ne konsiderate percaktimet e mesiperme ligjore, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se, kufijte e shqyrtimit te ceshtjes ne Gjykatën e Larte lidhen vetem me shkaqet ligjore te ngritura apo te konstatuara per prishjen e vendimit, ne dallim me gjykimin ne apel ku kufijte e shqyrtimit te ceshtjes ne ate gjykate lidhen edhe me subjektin qe ka bere ankimin.

Duke pranuar faktin se Gjykata e Larte e shikon ceshtjen nga pikepamja e shkeljeve te ligjit, ligjvenesit nuk i ka vene kufizime asaj ashtu si ka vepruar per gjykatën e apelit ne lidhje me

palen qe ushtron ankimin. Ne kete kuptim, Kolegjet e Bashkuara arrijne ne perfundimin se Gjykata e Larte ne rastin konkret nuk kufizohet ne shqyrtimin e çeshtjes, por konstaton paligjshmerine e vendimit te formes se prere. Ashtu sikurse palet kane te drejte te bejne ankim ne gjykatën e apelit, po ashtu ato kane te drejte te bejne rekurs ne Gjykatën e Larte. Fakti qe prokurori nuk ka ushtruar ankim ne gjykatën e apelit ndaj vendimit te dhene nga gjykata e shkalles se pare, nuk i mohon atij te drejten te ushtroje te drejten e ankimit nepermjet rekursit, ne Gjykatën e Larte.

Ligji nuk ka vene kufizime lidhur me ushtrimin e kesaj te drejte nga palet ne raport apo te diferencuara me njera-tjetren, por kete te drejte ua njeh ne menyre te barabarte. Nga ana tjetere, organi i prokurorise eshte nje organ i centralizuar sipas nenit 148 pika 2 e Kushtetutes se Republikës se Shqiperise. Kodi i Proçedures Penale parashikon ne nenin 24 pika 4 te tij qe “ *urdherat dhe udhezimet e prokurorit me te larte jane te detyrueshme per prokurorin me te ulet* ”. Neni 25 i po ketij Kodi, ne piken 3 te tij percakton se “ *ne seance gjyqesore prokurori ushtron funksionet e tij me pavaresi te plote* ”. Po ashtu, e drejta e prokurorit me te larte per te ushtruar ankim ndaj nje vendimi gjyqesor nuk eshte e lidhur me qendrimin qe eshte mbajtur nga prokurori me i ulet, sikurse parashikon neni 408 i K.Pr.Penale.

Kolegjet e Bashkuara, nga sa referohet me siper çmojne se e drejta e ushtrimit te ankimit ndaj vendimeve gjyqesore nga prokurori me i larte nuk kufizohet nga qendrimi qe ka mbajtur prokurori me i ulet. Pavaresisht se ne çeshtjen konkrete organi i prokurorise nuk ka bere ankim ndaj vendimit te gjykates se shkalles se pare, nuk i mohon te drejten prokurorit te apelit qe te ushtroje rekurs ne Gjykatën e Larte.

Konstatimi i paligjshmerise se vendimeve gjyqesore nga Gjykata e Larte, qofte edhe ne disfavor te te gjykuarit , nuk ka te beje me rendimin ose jo te pozites se tij.

Ne favor te ketij perfundimi eshte edhe fakti qe asnje dispozite e Konventes Evropiane “Per mbrojtjen e te drejave dhe lirive te njeriut” apo e Kushtetutes se RSH nuk parashikojne nje garanci te tille. E vetmja garanci e parashikuar per te pandehurin lidhur me mosrendimin e pozites se tij eshte ajo qe parashikohet ne pikat 2 dhe 3 te nenit 425 te K.Pr.P., kur çeshtja ne gjykatën e apelit shqyrtohet mbi ankimin e te pandehurit.

Sa me siper arrijme ne perfundimin se Kodi yne i Proçedures Penale, bazohet ne parimin e barazise se paleve, ku ne nenin 407 i ketij Kodi, parashikon mjetet e ankimit kunder vendimeve gjyqesore te cilat jane apeli, rekursi ne Gjykatën e Larte dhe kerkesa per rishikim. Secili pjesemarrës ne proçesin penal, si i pandehuri, prokurori dhe i demtuari akuzues per veprat penale qe ndiqen mbi ankimin e ketij te fundit, mund te ushtrojne ne menyre te pavarur dhe te pakushtezuar cilindo mjet ankimi te parashikuar ne dispoziten e siperpermendur, ne perputhje me kriteret e percaktuara per ushtrimin e tyre.

Nga aktet e ndodhura ne dosje rezulton se vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte marre ne kundërshtim me kerkesat e K.Pr.Penale lidhur me gjykimin ne mungese. Keshtu, nuk rezulton qe te jete bere njoftim per te gjykuarin Agron Hajdari ashtu siç percakton neni 141 i K.Pr.Penale. Gjithashtu, nuk rezulton qe te jete bere deklarimi i mungeses se tij konform kerkesave te nenit 141 pika 1 dhe 2 te K.Pr.Penale. Per kete shkak, i gjykuari Agron Hajdari, gjate shqyrtimit te çeshtjes ne Gjykatën e Apelit, ka kerkuar qe te perseritet shqyrtimi gjyqesor, sipas kerkesave te nenit 427 te K.Pr.Penale, por gjykata e ka rrezuar kete kerkese. Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte konstatojne se nje kerkese e tille eshte e drejte dhe ligjore. Ne baze te nenit 427 pika 4 te K.Pr.Penale, Gjykata e Apelit kishte detyrimin ligjor qe, ne kushtet kur i gjykuari Agron Hajdari nuk kishte marre pjese ne gjykimin ne shkalle te pare dhe per shkak te mosrespektimit nga ajo gjykate te dispozitave proçedurale mbi njoftimin e te pandehurit, kjo mospjesemarrje do te konsiderohet pa dijenine e te pandehurit, te pranonte kerkesen e te gjykuarit Agron Hajdari duke vendosur perseritjen e shqyrtimit gjyqesor. Shkelja e kesaj norme proçedurale

nga Gjykata e Apelit Tirane, ka sjelle si pasoje humbjen e se drejtes se ligjshme te te gjykuarit, per nje proçes te rregullt ligjor. Per kete shkak, vendimi i Gjykates se Apelit gjendet i pabazuar ne ligj.

Ne tilla rrethana, Kolegjet e Bashkuara çmojne prishjen e vendimit Nr.246 date 29.9.1999 te Gjykates se Apelit Tirane dhe vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr.172 date 23.3.1999 dhe kthimin e akteve per rishqyrtim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, mbeshtetur ne nenin 141 paragrafi i dyte i Kushtetutes, ne nenin 14 pika "c" te ligjit Nr.8588 date 15.3.2000 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykates se Larte te Republikes se Shqiperise", ne nenin 441 pika 1 germa "ç" dhe nenin 443, pika 1 te Kodit te Proçedures Penale,

V E N D O S Ë N

1. Prishjen e vendimit nr.246, date 29.09.1999 te Gjykates se Apelit Tirane dhe vendimit nr.172, date 23.03.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe kthimin e akteve per rishqyrtim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me tjetër trup gjykues.
2. Ky vendim per njehsimin e praktikës gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 19.04.2001

MENDIM PAKICE

Duke mos qene dakord me menyren e zgjidhjes se ceshtjes nga shumica, si dhe me arsyetimin e vendimit te marre prej saj, paraqes mendimin e pakices si me poshte:

Nje nga te drejtat themelore te te pandehurit ne procesin penal, e parashikuar ne Kushtetuten e Republikën e Shqiperise dhe ne Konventen Europiane te te Drejtat dhe Lirive Themelore te Njeriut, eshte e drejta e mbrojtjes, e cila realizohet, nder te tjera, edhe nepermjet te drejtes per t`u ankuar kunder vendimit te dhene nga nje gjykate me e ulet ne nje gjykate me te larte, si dhe garantohet prej rregullit te mosrendimit te pozites se te pandehurit nga gjykata me e larte, ne qofte se ceshtja i ka ardhur kesaj te fundit vetem nepermjet ushtrimit te ankimit nga i pandehuri.

Kushtetuta dhe Konventa Europiane parashikojne dhe garantojne standartin minimum te ushtrimit te nje ankimi ne nje gjykate me te larte, por ato nuk kufizojne mundesine qe ligjvenesit te parashikojne e te garantojne me ligj te drejten per te ushtruar edhe me shume se nje ankim, duke mundesuar qe ceshtja te kaloje per shqyrtim ne te gjitha shkallet e gjykimit. Eshte gjithashtu e drejte e ligjvenesit te percaktojne me ligj kufinjte e shqyrtimit te ceshtjes nga gjykata me te larte. Pavaresisht nga terminologjia e perdorur ne ligj, si apeli ne gjykatën e Apelit, edhe rekursi ne Gjykatën e Larte, jane mjete ankimi qe i njihen te pandehurit per t`i ushtruar sipas disponibilitetit te tij dhe qe i garantojne atij pamundesine e rendimit te pozites nga nje gjykate me e larte, ne qofte se kunder vendimit nuk i ka ushtruar keto mjete ankimi edhe perfaqesuesi i akuzes (prokurori) ne interes te mbrojtjes se rendit publik.

Nuk kemi ndonje mendim te ndryshem persa i perket arsyetimit te shumices, duke i u referuar nenit 425, pika 2 dhe 3, te K.Pr.Penale, persa i perket gjykimit te ceshtjes ne gjykatën e Apelit, por mendojme shumica nuk i qendron me konsekuence arsyetimit te saj persa i perket shqyrtimit te ankimit te dyte te te pandehurit (rekursit te tij) ne Gjykatën e Larte.

I vetmi ndryshim midis gjykimit ne Apel dhe gjykimit ne Gjykatën e Larte, eshte fakti se kufinjte e shqyrtimit te ceshtjes ne kete te fundit jane me te ngushte: gjykata e Apelit eshte edhe gjykate fakti edhe gjykate ligji, ndersa Gjykata e Larte eshte kryesisht gjykate qe shqyrton bazueshmerine ne ligj te vendimit te kundershuar dhe eshte shume e kufizuar persa i takon shqyrtimit te bazueshmerise ne fakt te ketij vendimi, (*vetem per mungese te arsyetimit ose per shkak te karakterit haptazi jologjik te tij*) sipas kriterëve te vendosura ne nenin 432 te K.Pr.Penale.

Persa i perket parimit te mosrendimit te pozites se te pandehurit ai zbatohet me konsekuence e nje lloj, kur jane kushtet, ne te dy shkallet e gjykimit, si ne apel edhe ne Gjykatën e Larte. Ne qofte se prokurori, si organ perfaqesues i akuzes ne emer te shtetit, e ka humbur mundesine per ta renduar poziten e te pandehurit ne Apel, per shkak se ceshtja atje ka shkuar vetem mbi bazen e ankimit (apelit) te te pandehurit, ai e ka humbur kete mundesi pergjithmone dhe nuk mund ta rifitoje ate me vone nepermjet ushtrimit te rekursit kunder vendimit te gjykates se Apelit. Ne kendveshtrimin e zbatimit te parimit te mbrojtjes se te drejtave te te pandehurit ne procesin penal, pjese e te cilit eshte edhe e drejta e ankimit ne gjykatën e Apelit dhe garancia e mosrendimit te padrejte te pozites se te pandehurit ne kete gjykate (*kur mungon apelimi nga prokurori*), per te njejtin vendim te gjykates se Apelit nuk mund te aplikohen dy standarte vleresimi: Vendimi te konsiderohet i drejte dhe i bazuar ne ligj, sepse eshte dhene konform nje parimi te rendesishem kushtetues e ligjor te vendosur ne favor te te andehurit, dhe njekohesisht te mos konsiderohet i tille ne rast se prokurori e con ceshtjen ne fjale ne Gjykatën e Larte.

Si i pandehuri, edhe prokurori, nuk mund te pengohen apo te kufizohen ne te drejten e tyre per ta cuar ceshtjen nga Apeli ne Gjykatën e Larte, dhe kjo e fundit ka te drejte qe ne vendimin e saj te paraqese e te arsyetoje te gjitha shkeljet e ligjit, per shkak te te cilave, fakteve mund t`u jete bere nje cilesim juridik me i lehte, dhe ndaj te pandehurit padrejtesisht mund te jete aplikuar nje lloj apo mase denimi me e lehte, por, si Gjykata e Larte ne gjykimin qe zhvillon per shqyrtimin e

rekursit te prokurorit kunder vendimit te Apelit, ashtu dhe gjykatat e tjera ne eventualitet te rigjykimit te ceshtjes ne zbatim te urdherimeve te Gjykates se Larte, ne analize te fundit, nuk mund te japin ndaj te pandehurit nje lloj apo mase denimi me te larte se ai (ajo) qe ka dhene fillimisht gjykata e shkalles se pare.

Te gjitha korigjimet e shkeljeve ligjore te mepareshme kane vlere vetem per gjykimet e tjera me qellim qe shkelje te tilla te mos perseriten me ne te ardhmen.

Ne te kundert, do te korigjohet shkelja ne ceshtjen konkrete, por do te dhunohej parimi kushtetues i mbrojtjes se te pandehurit ne procesin penal.

Eshte kjo arsyeja qe ne raste te tilla balanca anon nga mbrojtja e interesit te individit ne dem te interesit publik. Keto jane kosto qe rendojne mbi rendin publik per shkak te mangesive apo neglizhencave ne sistemin e akuzes, qe e bejne ate jo eficient, por ato jane edhe sfida e nxitje per permiresime e progres ne nje shtet te bazuar ne sundimin e ligjit.

Ne nje veshtrim me te thjeshtezuar te problemit ne fjale, po te pranohej e kunderta, atehere i pandehuri ne cdo rast, edhe ne qofte se do ta ndjente ose do te ishte i bindur per pabazueshmerine e vendimit te dhene kunder tij nga gjykata e shkalles se pare, do te hezitonte te bente ankim ne Apel, ose, se paku, do te priste deri ne momentin e fundit te skadimit te afatit apelin e prokurorit per te vleresuar ne se do te bente vete apel ose, ne mungese te apelit te prokurorit, do ta cmonte me te dobishme e me te pershatesheshme qe te hiqte dore nga apeli para fillimit te gjykimit ne shkalle te dyte, se sa te rrezikonte me tej.

Tefta Zaka Thimjo Kondi

Nr.1 i Regj. Themeltar
Nr.1 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Bashkim Caka	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Natasha Sheshi	Anëtare
Artan Hoxha	Anëtar
Metush Saraçi	Anëtar
Valentina Kondili	Anëtare
Vladimir Metani	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Vladimir Bineri	Anëtar
Zamir Poda	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Tefta Zaka	Anëtare
Perikli Zaharia	Anëtar

ne seancen gjyqesore te dates 15.02.2001 mori ne shqyrtim ceshtjen nr.1 qe u perket:

TË PANDEHURVE: QAZIM LIKA, QAMIL LIKA E
ZAMIR LIKA, ne mungese.

A K U Z U A R:

Per vjedhje me arme ne bashkepunim, armembajtje pa leje,
parashikuar nga nenet 140-25 dhe 278/2 te K.Penal.

Gjykata e Shkalles se pare Shkoder me vendimin nr.107 date 23.3.2000, ka vendosur:

Deklarimin fajtor te te pandehurit Qazim Lika per kryerjen e vepres penale te vjedhjes me arme, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 140 e 25 te Kodit Penal, e denimin e tij me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Qazim Lika, per vepren penale te armembajtjes pa leje, parashikuar nga nenet 278/2 te Kodit Penal, e denimin me 1 vit burgim.

Ne baze te nenit 55 te Kodit Penal, denimin perfundimisht te te pandehurit Qazim Lika, me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Qamil Lika per kryerjen e vepres penale te vjedhjes me arme, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 140 e 25 te Kodit Penal, e denimin e tij me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Qamil Lika, per vepren penale te armembajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 te Kodit Penal, e denimin me 1 vit burgim.

Ne baze te nenit 55 te Kodit Penal, denimin perfundimisht te te pandehurit Qamil Lika, me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Zamir Lika, per kryerjen e vepres penale te vjedhjes me arme, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 140 e 25 te Kodit Penal, e denimin e tij me 17 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Zamir Lika, per vepren penale te armembajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 te K.Penal, e denimin me 1 vit burgim.

Ne baze te nenit 55 te Kodit Penal, denimin perfundimisht te te pandehurit Zamir Lika, me 10 vjet burgim.

Ne aplikim te nenit 51 te Kodit Penal, gjykata perfundimisht e denon te pandehurin Zamir Lika me 5 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Shkoder me vendimin nr.56, date 2.5.2000 ka vendosur:

Lenien ne fuqi te vendimit nr.107 date 23.3.2000 te Gjykates se shkalles se pare Shkoder.

Kunder vendimit nr.56 date 2.5.2000 te Gjykates se Apelit Shkoder kane ushtruar rekurs tre te pandehurit duke parashtruar keto shkaqe:

- Jane keqtrajtuar nga policia.
- Nuk ka prova per fajesine.
- I pandehuri Zamir eshte ndodhur ne kushtet e detyrimit e kercenimit.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr.245 akti date 5.10.2000, ka vendosur:

Kalimin e ceshtjes Kolegjeve te Bashkuara per te unifikuar praktiken gjyqesore lidhur me pjesemarrjen e te pandehurit te lire ose te arrestuar, ne gjykimin ne gjykaten e apelit, me arsytimin:

a. Gjykimi ne apel ne mungese te te pandehurve.

b. Gjykata ka realizuar njoftimin e avokateve dhe jo te te pandehurve duke mosrespektuar kerkesat e neneve 425/1 dhe 139/1 e 2 te Kodit Penal.

c. Ne praktike, megjithe qendrimin e Kolegjit Penal te Gjykates se Larte, perseri verehen shkelje rreth kesaj ceshtje.

d. Si duhen kuptuar nenet 33/1 i Kushtetutes dhe 128/c, 426/1 dhe 139 e vijues te K.P.Penale.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e anetareve Zamir Poda e Bashkim Caka,
pasi degjuan prokurorin Mihallaq Bleta, i cili kerkoj prishjen e vendimit dhe dergimin e ceshtjes per rigjykim ne Gjykaten e Apelit Shkoder,

V Ë R E J N Ë

Vendimi nr.56 date 2.5.2000 i Gjykes se Apelit Shkoder, eshte rrjedhoje e zbatimit te gabuar te ligjes. Per pasoje ai duhet te priset dhe ceshtja i duhet derguar per rishqyrtim po asaj gjykate.

Si gjykata e shkalles se pare ashtu edhe Gjykata e Apelit Shkoder kane pranuar, se ne daten 20.12.1999 rreth ores 11.00 te pandehurit Qazim Lika dhe Qamil Lika, vellezer si dhe Zamir Lika, nip i tyre, me kapuce ne koke dhe te armatosur respektivisht i pari me automatik, i dyti me pushke e i treti me automatik, kane ndaluar dhe vjedhur me arme pasagjere te dy kamioneve. Keshtu, ata kane ndaluar nen kercenimin dhe krismat e armeve, se pari nje kamion te tipit "IFA", ne te cilen udhetonin shoferi Gege Ballza dhe pasagjeret Dede Plepi, Gjolek Plepi, Gjergj Tonaj, Kole Polia, Sander Ashta, Nikolle Selvia, Gjon Nika dhe Ndue Koceku dhe u kane marre para e sende te tjera me vlere. Me pas, ne interval kohor prej 20 minutash, ata kane ndaluar serish duke kercenuar me arme, nje kamion tjetere te tipit "IFA". Ne momentin kur kane kerkuar para, ata jane perballur me police, te cilet udhetonin ne ate kamion. Menjehere dy te pandehurit Qazim e Qamil jane larguar, ndersa eshte kapur ne vend, i pandehuri Zamir Lika. Me pas, organet e policise kane bere te mundur edhe kapjen e dy te tjeve.

Duke e pare vendimin e gjykates se apelit ne teresine e tij, arrihet ne perfundim se ai eshte marre ne kundershtim me kerkesat ligjore, mbasi nuk eshte siguruar e drejta ligjore e pjesemarrjes dhe degjimit te te pandehurit ne gjykim. Ne gjykimet e gjykatave te apelit, megjithe qendrimin konstant te mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykes se Larte perseri verehet nje dukuri e tille e kunderligjshme.

Me te drejte, Kolegji Penal i Gjykes se Larte, pavaresisht se nje moment i tille nuk eshte parashtruar ne rekursin e paraqitur nga te pandehurit, ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne nenin 434 te K.Pr.Penale, kryesisht ka konstatuar mosthirrjen e njoftimin e te pandehurve ne gjykimin ne apel.

Urdherimin per thirrjen dhe njoftimi i te pandehurit, per te marre pjese ne gjykimin ne apel, eshte nje detyrim ligjor dhe jo fakultativ per gjykatën.

Nje perfundim i tille kategorik, buron nga analiza qe u behet dispozitave perkatese qe rregullojne te drejten e mbrojtjes se te pandehurit ne procesin penal si dhe te drejten per nje proces te rregullt ligjor, te parashikuara ne **Kushtetute**, ne **Konventen Europiane te te Drejtave te Njeriut**, si dhe ne **Kodin e Procedures Penale**.

Ne praktiken gjyqesore te gjykatave te apelit, pikerisht lidhur me thirrjen dhe njoftimin e te pandehurit ne gjykim, efektivisht jane verejtur qendrimet te ndryshme te kunderligjshme dhe konkretisht:

- a. *Mosurdherimin e thirrjes dhe njoftimin e te pandehurit te lire apo te arrestuar.*
- b. *Njoftimin vetem te mbrojtjes te te pandehurit.*
- c. *Rrezimin e kerkeses se paraqitur nga mbrojtesi, per urdherimin e thirrjes dhe njoftimin e te pandehurit.*
- d. *Urdherimin e thirrjes se te pandehurit, por mosrespektimin e kerkesave ligjore per njoftimin e te pandehurit te burgosur.*

Sic shihet, ne te gjitha rastet, ne substance kemi te bejme me mosgarantim te sigurimit te te drejtes se mbrojtjes per te pandehurin.

Sipas kerkesave te nenit 31 te **Kushtetutes**, "Gjate procesit penal kushdo ka te drejte:

...ç. te mbrohet vete ose ...".

Formulimi i bere ne dispoziten kushtetuese te mesiperme eshte i njejte me formulimin e nenit 6, pika 3, germa “c” te **Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut**, sipas te cilit “...Çdo i akuzuar ka te drejte, nder te tjera dhe kryesisht:

c. *Te mbrohet vete ose....”.*

Me tej akoma, ne nenin 33 pika 1 te **Kushtetutes**, parashikohet:

1. *Kushdo ka te drejte te degjohet para se te gjykohet.*

Nga ana tjetër, ligjvenesi ne nenin 426 te **Kodit te Procedures Penale**, ku parashikohen **Veprimet paraprake te gjykimit** ne Gjykatën e Apelit, ka percaktuar se:

1. *Kryetari i Kolegjit te Gjykates se Apelit urdheron thirrjen e te pandehurit...*

Sigurimi i te drejtes se pjesemarrjes dhe degjimit te te pandehurit ne gjykimin ne apel, eshte nje veprim i domosdoshem, jo vetem ne aspektin kushtetues e ligjor, por edhe per faktin se Gjykata e apelit ne dallim nga Gjykata e Larte, gjykon edhe si gjykate fakti. Keshtu duke ju referuar kerkesave te parashikuara ne nenin 427 te **Kodit te Procedures Penale**, kemi:

1. *“Kur nje pale kerkon rimarrjen e provave te administruara ne shqyrtimin gjyqesor te shkalles se pare ose marrjen e provave te reja, gjykata ne qofte se e cmon se nje gje e tille eshte e nevojshme, vendos perseritjen teresisht ose pjeserisht te shqyrtimit gjyqesor.*

.....

2. *Perseritja e shqyrtimit gjyqesor vendoset edhe kryesisht kur gjykata e cmon te domosdoshme.*

3. *Gjykata vendos perseritjen e shqyrtimit gjyqesor kur vertetohet se i pandehuri nuk ka marre pjese ne shkalle te pare....”.*

Ndersa shqyrtimi ne Gjykatën e Larte, ne perputhje me kerkesat e parashikuara nga neni 432 i Kodit te Procedures Penale, behet vetem per shkaqe te percaktuara qe kane te bejne me...” mosrespektim ose zbatim te gabuar te ligjit penal ose normave te tjera juridike... *mosrespektim te normave procedurale qe parashikojne si pasoje pavlefshmerine, mospranimin ose humbjen e nje te drejte te ligjshme... mungesen e arsytimit ose karakterin haptazi jo logjik..”.*

Duke i pare ne unitet te gjitha dispozitat e cituara me siper, arrihet ne perfundimin se pjesemarrja e te pandehurit te lire apo te arrestuar ne gjykim (edhe ne apel), degjimi dhe mbrojtja e tij, ndersa per te (te pandehurin) eshte **nje e drejte** kushtetuese dhe ligjore, per gjykatën eshte nje **detyrim** gjithashtu ligjor, qe nuk le shteg per ekuivoqe.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojne se mosrespektimi i ketij detyrimi ligjor, per te thirrur dhe njoftuar te pandehurin e lire apo te arrestuar ne gjykimin ne apel, perben shkelje edhe te se drejtes kushtetuese per nje proces te rregullt ligjor, ne kuptim te nenit 42 te **Kushtetutes**, sipas te cilit, “*Liria, prona dhe te drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligj nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor*”.

Duke ju referuar rastit ne shqyrtim, arrihet ne perfundimin se konstatohet shkelje e dispozitave kushtetuese – nenit 31 germa “ç”, nenit 33 pika 1 dhe 42 te Kushtetutes, nenit 6 pika 3 germa “c” te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut, si dhe e kerkesave te parashikuara ne nenin 426 pika 1 te Kodit te Procedures Penale.

Nje moment tjetër i vecante qe duhet t’i nenshtrohet analizes gjithmone ne kuadrin e kesaj ceshtje, eshte edhe dallimi qe duhet bere midis “njoftimit” te te pandehurit dhe “njoftimit” te mbrojtjesit, moment i cili konfondohet ne praktike. Sikunder edhe u permend, gjykatat jo rralle

njesojne pozicionin e mbrojtësit me atë të pandehurit, duke "barazuar" apo "njesuar" të drejtat dhe detyrimet e këtyre dy subjekteve të procesit penal.

Është e vërtetë se mbrojtësi në përgjithësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit. Por ligja procedurale, ka përcaktuar edhe kufijte respektive në këto të drejta. Kështu në nenin 50 të K.Pr.Penale, parashikohet se:

1. *"Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit".*

Është pikërisht i pandehuri, i cili përcakton, gjithnjë në kuadër të kërkesave ligjore, kufijte e të drejtave të mbrojtësit të tij. Edhe nga këndvështrimi i kërkesave të parashikuara në nenin 426 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mundet kurrsesi të "barazohet" thirrja e njoftimi i të pandehurit me mbrojtësin e tij. Në këto dispozite përcaktohet shprehimisht dhe në mënyrë të qartë ndarja e njerit subjekt nga tjetri: *"Kryetari i Kolegjit të Gjyqësorëve se Apelit urdheron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre..."*.

Sic u tha edhe më lart, në dispozitën e cituar të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet urdherimi i thirrjes së të pandehurit në gjykimin në gjykatën e apelit. Në pamje të parë, eventualisht mund të krijohet ideja e gabuar se kemi të bëjmë thjeshtë me *urdherim për thirrje* dhe vetëm kaq. Mirepo, për këto dispozite në funksionin dhe unitetin me dispozitat e tjera të Kodit të Procedurës Penale, arrihet në përfundimin se *"urdherimi për thirrje"* i të pandehurit të lire apo të arrestuar në gjykimin në apel, nuk mund të kuptohet dhe ndahet nga *njoftimi i tij* dhe rregullat procedurale që duhen zbatuar për këto njoftim.

Më të drejta mund të shtrohet pyetja, nëse ekzistojnë dallime ndërmjet *"urdherimit për thirrje"* dhe *"njoftimit"* të të pandehurit, në kuptim të kërkesave të pikës 1 të nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, por edhe më gjere në dispozitat e tjera procedurale. Kolegjet e Bashkuara, çmojnë se efektivisht dhe potencialisht ekzistojnë dallime.

Së pari, në parim ligja procedurale penale në dispozita të vecanta, parashikon dhe përcakton disponime të gjykatave me "urdher" dhe në dispozita të tjera, parashikon dhe rregullon "Njoftimet".

Së dyti, "urdheri" ka të bëjë në esencë me përcaktimin e një veprimi që duhet kryer, kush duhet ta kryejë dhe mjetin me të cilin do të kryhet.

Nga ana tjetër "njoftimet" kanë të bëjnë me anën "teknike" se si do të realizohet marrja e dëgjimit për një akt të caktuar, i cili mund të jetë thirrje, vendim, etj.

Megjithatë, duke qendruar në vazhdim të analizës së problemit konkret, të funksionit dhe unitetit ndërmjet *"urdherimit të thirrjes"* dhe *"njoftimit"* të të pandehurit, në kuptim të kërkesave të nenit 426 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, tërhiqen disa përfundime.

Jo rrallë, gjykatat e apelit e kanë keqkuptuar këto dispozite. Vete qëndrimet, herë herë të ndryshme të tyre, të nënvizuara në fillim të këtij arsytimi, konfirmojnë një gjë të tillë. Në jo pak raste, ato në fazën e veprimeve paraprake, formulojnë me shkrim urdherin për thirrjen e të pandehurit të arrestuar apo të lire, ja adresojnë atë organeve të policisë apo ftuesit përkatës dhe, mbeten me kaq. Për këto gjykata, mjafton të evidentohet ky urdherim në dosjen gjyqësore dhe sipas tyre, gjithçka është bërë në konformitet me kërkesat ligjore.

Mirepo efektivisht në këto raste "harrohet" detyrimi tjetër ligjor, që ky urdherim nuk mund të kuptohet pa realizimin e njoftimit të të pandehurit. Për ta ilustruar funksionin ndërmjet *"urdherimit të thirrjes"* dhe *"njoftimit"* të të pandehurit, mjafton të shikohen përcaktimet që bëjnë në paragrafët 349 dhe 350 të Kodit të Procedurës Penale.

Kështu në nenin 349 të K.Pr.Penale parashikohet:

1. *"Gjykata urdheron edhe kryesisht që të perseritet thirrja për gjykim kur del që i pandehuri ose personi ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga i demtuari akuzues nuk ka marrë njoftim ose njoftimi është i dyshimtë".*

Ndersa ne nenin 350 te K.Pr.Penale, parashikohet:

1. *“Kur i pandehuri, qofte edhe i paraburgosur, ose personi ndaj te cilit ka bere kerkese per gjykim i demtuari akuzues, nuk paraqitet ne séance... gjykata edhe kryesisht shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqesor, cakton daten e seances se re dhe urdheron qe te perseritet thirrja....*
4. *Kur del qe njoftimi nuk ka qene i rregullt, gjykata vendos shtyrjen e shqyrtimit gjyqesor dhe urdheron perseritjen e njoftimit...”.*

Ne analize sa me siper, konkludohet se nuk mund te kuptohet nje ndasi artificiale ndermjet urdherimit te thirrjes nga njoftimi i te pandehurit, sikunder ne menyre te gabuar perceptohet nga gjykata te vecanta. Ne kete kuader, gjykatat e apelit duhet te zbatojne dhe respektojne kerkesat ligjore qe kane te bejne me njoftimin e te pandehurit te lire apo te arrestuar. Dhe konkretisht keto kerkesa jane te parashikuara ne nenet 139 dhe 140 te Kodit te Procedures Penale.

Si rrjedhoje ne rastin konkret te ceshtjes ne gjykim, Gjykata e Apelit Shkoder, duhet te urdheronte thirrjen e te pandehurve te arrestuar Qazim, Qamil dhe Zamir Lika, duke realizuar edhe njoftimin e tyre ne konformitet me kerkesat ligjore te parashikuara nga neni 139 i Kodit te Procedures Penale. Sipas kesaj dispozite, percaktohet se:

1. *«Njoftimi per te pandehurin e burgosur behet ne vendin e burgimit duke i dorezuar atij aktin.*
2. *Kur i pandehuri refuzon te marre kopjen e aktit ose kur ai mungon per shkaqe te justifikuara, akti i dorezohet pergjegjesit te institucionit, i cili per rastin e fundit njofton te interesuarin me mjetin me te shpejte.*
3. *Dispozitat e mesiperme zbatohen edhe kur i pandehuri eshte i paraburgosur per nje akuze tjeter ose eshte duke vuajtur denimin me burgim...».*

Duke mos zbatuar dhe respektuar kerkesat e parashikuara ne nenet 31 germa “ç” e 33 pika 1 te Kushtetutes, ne nenin 6, pika 3, germa “c” te Konventes Europiane te Drejtave te Njeriut, kemi te bejme me shkelje te drejtave kushtetuese dhe per pasoje me nje proces te parregullt ligjor. Nga ana tjeter, duke mos zbatuar dhe respektuar kerkesat e parashikuara nga nenet 426/1 e 139 te Kodit te Procedures Penale, te gjitha aktet e realizuara nga ana e gjykates se apelit ne kete gjykim, jane absolutisht te pavlefshme. Nje perfundim i tille arrihet, duke pare kerkesat e nenit 128 germa “c” te Kodit te Procedures Penale. Ne kete dispozite, e cila ka te beje me pavlefshmerine absolute te akteve, percaktohet se:

1. *“Aktet proceduriale jane absolutisht te pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat qe lidhen me:*
...
c. *thirrjen e te pandehurit ose pranine e mbrojtetit kur ajo eshte e detyrueshme”.*

Nga sa u tha dhe analizua, rezulton se ndodhemi para kerkesave te parashikuara ne nenin 432 te Kodit te Procedures Penale, te cilat e bejne te cenueshem vendimin nr.56 date 2.5.2000 te Gjykates se Apelit Shkoder.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ne mbeshtetje te kerkesave te nenit 142/1 te Kushtetutes dhe 441 pika “ç” te Kodit Procedures Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.56 date 2.5.2000 te Gjykates se Apelit Shkoder dhe dergimin e ceshtjes per rishqyrtim ne po ate gjykate.

Ky vendim unifikues per praktiken gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 15.02.2001

Nr.345 i Regj.Themeltar
Nr.371 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykeses se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Bashkim Caka	Anetar
Agron Lamaj	“
Vitore Tusha	“
Nikoleta Kita	“
Valentina Kondili	“
Natasha Sheshi	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Tefta Zaka	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Pllloçi	“
Ylvi Myrtja	“
Perikli Zaharia	“
Artan Hoxha	“

ne seancen gjyqesore te dates 16.06.1999 dhe 27.10.2000 mori ne shqyrtim ceshtjen civile nr.156
qe i perket:

TË PANDEHURVE: **BAKI HUQI**, ne mungese.
ALBERT HUQI, ne mungese; te dy te perfaqesuar
nga avokatet Shefqet Muçi, Idajet Hoxha e Selfo
Dosti.

A K U Z U A R:

Per vepren penale te vrasjes me dashje ne bashkepunim
parashikuar nga nenet 76-25 te Kodit Penal
dhe vrasjes me dashje ne bashkepunim mbetur ne tentative
parashikuar nga nenet 76-22-25 te Kodit Penal.

Dy te pandehurit Baki dhe Albert Huqi, jane derguar per gjykim me akuzat:
Baki Huqi sipas neneve 76-25 te K.Penal, 76-25-22 te K.Penal, 238 te K. Penal dhe 278/2
te K.Penal.

Albert Huqi sipas neneve 76-25 te K.Penal dhe 76-25-22 te Kodit Penal.

Eshte pretenduar se ngjarja ka ndodhur ne keto rrethana:

Me daten 10 shkurt 1997 i pandehuri Albert Huqi me shokun e tij Arben Pumi, kane hyre
ne nje salle lojrash bingo ne qytetin e Durresit.

Kane qendruar per pak kohe dhe per disa minuta Arben Pumi, eshte larguar nga vendi ku ishte ulur, per te blere bilete. Kur eshte kthyer ne karrigen e tij ishin ulur persona te tjere dhe per kete shkak ka hyre ne grindje e mosmarreveshje me vellezerit Xhixhabesi. Ne kete grindje ka hyre edhe i pandehuri Albert Huqi, sa eshte dashur nderhyrja e punonjesve te salles se bingos qe te qetesohet situata.

Ne mbasditen e po kesaj date Albert dhe Baki Huqi kane shkuar perseri ne sallën e bingos per te vazhduar lojen. Atje kane gjetur edhe vellezerit Xhixhabesi. I pandehuri Albert eshte acaruar perseri me te demtuarin Perparim Xhixhabesi dhe ka tentuar ta qelloje ate me leve, veprime te cilat jane parandaluar nga nderhyrja e personave te pranishem.

Ne kete moment nderhyn i pandehuri Baki Huqi dhe qellon me automatik ne drejtim te vellezerve Xhixhabesi duke i shkaktuar vdekjen Ardian Xhixhabesit dhe plagosje te rende Perparim Xhixhabesit.

Gjykata e rrethit Durres me vendimin nr.205, date 30.10.1998

Ka deklaruar fajtor dhe denuar te pandehurin Baki Huqi me 20 vjet burgim, sipas neneve 76-25 te K.Penal, 76-25-22 te K.Penal dhe 55 te K.Penal.

Pushimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Baki Huqi per veprat penale te parashikuara nga nenet 238, 278/2 te K.Penal ne zbatim te nenit 387 te K.Pr.Penale dhe Ligjit 8202, date 27.03.1997, per shkak se jane amnistuar.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Albert Huqi dhe denimin e tij me 10 vjet burgim, sipas neneve 76-25 te K.Penal, 76-25-22 te K.Penal dhe 55 te K.Penal.

Gjykata e Apelit Durres me vendimin nr.48, date 10.03.1999 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.205, date 30.10.1998 te gjykates se rrethit Durres dhe kthimin e akteve po kesaj gjykate per te pandehurin Baki Huqi, per tu rigjykuar nga nje tjetër trup gjykues.

Prishjen e ketij vendimi dhe pushimin e ceshtjes persa i perket te pandehurit Albert Huqi mbasi nuk vertetohet fajesia e ketij te pandehuri.

Kunder ketij vendimi ka bere rekurs prokurori prane gjykates se Apelit Durres dhe kerkon prishjen e vendimit te gjykates se apelit vetem ne pjesen qe behet fjale per te pandehurin Albert Huqi dhe kthimin e ceshtjes per rishqyrtim prane gjykates se rrethit Durres duke parashtruar keto shkaqe:

I pandehuri Albert Huqi ka qene shkaktar i grindjes te ndodhur mbasdite me daten 10.02.1997 meqenese e ndjente vehten te fyer nga grindja e ndodhur ne mengjesin e po kesaj dite. Per kete shkak ka tentuar te godase me leve te demtuarin Perparim Xhixhabesi. Hetimi paraprak dhe gjykimi kane vertetuar keto fakte dhe bashkepunimin ne vrasje.

Gjykata e Apelit Durres eshte kontradiktore ne vendim, sepse deklaroi te pafajshem te pandehurin Albert Huqi per vrasje ne nje kohe qe per te pandehurin Baki Huqi e kthen ceshtjen per rishqyrtim per t'u gjykuar me akuzat e derguara nga prokuroria, duke pranuar edhe bashkepunimin ne vrasje.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin date 16.06.1999 ka vendosur:

Kalimin e ceshtjes per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara me qellim ndryshimi dhe unifikimi te praktikës gjyqesore, lidhur me te drejten e mbrojtësit te zgjedhur nga familjaret per te bere ose jo ankim kunder vendimit te gjykates se rrethit te dhene ne mungese te te pandehurit.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me vendimin unifikues nr.386, date 29.07.1999 kane vendosur:

Prishjen e vendimit nr.48, date 10.03.1999 te gjykates se Apelit Durres dhe pushimin e gjykimit ne Gjykatën e Larte me arsyetimin **se mbrojtësi i zgjedhur nga te afermit e te pandehurve eshte person i palegjitimuar per te bere ankim kunder vendimit te dhene ne mungese te te pandehurit.**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me kete vendim kane vendosur te ndryshojne praktiken gjyqesore te mepareshme, duke u shprehur, nder te tjera, si me poshte:

“ Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me vendimin nr.47, date 28.01.1999 per te unifikuar praktiken gjyqesore kane legjitimuar mbrojtësin e caktuar kryesisht te beje ankim kunder vendimit te dhene ne mungese, por ne te njejtin pozicion procedural konsiderohet edhe mbrojtësi i te pandehurve ne mungese Baki dhe Albert Huqi sepse, pavaresisht se eshte zgjedhur nga te afermit e te pandehurve, ai eshte lejuar dhe pranuar ne gjykim per te zevendesuar mbrojtësin qe gjykata duhej te caktonte kryesisht per te plotesuar detyrimin ligjor qe ajo kishte sipas nenit 351 te K.Pr.Penale.

Per arsyet e permendura me lart cmohet se vendimi i Kolegjeve te Bashkuara nuk eshte i drejte dhe krijon anomali ne zhvillimin e procesit penal, prandaj diktohet e nevojshme marrja e nje vendimi tjeter nga Kolegjet e Bashkuara per unifikimin e nje praktike gjyqesore tjeter, te ndryshme nga ajo e deritanishmja, ne menyre qe mbrojtësi i zgjedhur nga te afermit e te pandehurve te konsiderohet person i palegjitimuar per berjen e ankimit kunder vendimit te dhene ne mungese te te pandehurve.”

Kunder vendimit unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, te permendur me siper, kane bere ankim ne Gjykatën Kushtetuese avokatet e te pandehurve duke parashtruar keto shkaqe per shfuqizimin e vendimit:

- “Vendimi bie ndesh me parimet kushtetuese dhe dispozitat e Kodit te Procedures Penale qe parashikojne te drejtat e mbrojtësit ne procesin penal.
- Duke qene perfaqesues ligjor i te pandehurit ne mungese, mbrojtësi gezon te gjitha te drejtat e nje perfaqesuesi, te gjitha te drejtat e mbrojtësit ne mbrojtje te detyrueshme ku perfshihet edhe e drejta e ankimit.
- Interpretimi i neneve 50/1, 407/4 e 410 te Kodit te Procedures Penale nga Kolegjet e Bashkuara, eshte i gabuar, sepse sipas ketyre neneve mbrojtësit i njihet e drejta e ankimit.
- E drejta e ankimit nuk perfshihet ne te drejtat ekskluzive qe i rezervohen personalisht te pandehurit. Ne, si mbrojtësa, jemi pajisur me dy akte perfaqesimi te leshuar ne format e parashikuara nga ligji, prandaj kemi te drejten e ankimit sipas nenit 410/2 te Kodit te Procedures Penale.
- Vendimi i gjykates eshte kontradiktor sepse nuk ben dallim midis te drejtes se ankimit dhe te drejtes per te kerkuar rivendosjen e afatit te humbur per te bere ankim.

Kolegjet e Bashkuara, kane prishur vendimin e gjykates se apelit, duke pushuar gjykimin ne Gjykatën e Larte, pa u shprehur se c`duhet bere me ceshtjen apo me vendimin e shkalles se pare, kerkesa keto te parashikuara ne nenin 441 te Kodit te Procedures Penale”.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.17, date 17.04.2000, qe ka hyre ne fuqi me datën 10.05.2000, pas botimit ne Fletoren Zyrtare, ka vendosur:

Shfuqizimin si antikushtetues te vendimit nr.386, date 29.07.1999 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte.

Ceshtja i dergohet per shqyrtim Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte...

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi u njohen me permbajtjen e vendimit te Gjykates Kushtetuese, pasi degjuan relatimin e ceshtjes nga gjyqtaret Thimjo Kondi e Nikoleta Kita,

pasi degjuan prokurorin Arqile Lole i cili kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te gjykates se Apelit Durres per Baki Huqin dhe prishjen e vendimit dhe dergimin e ceshtjes per rigjykim ne gjykatën e rrethit Durres,

avokatet qe kerkuan lenien ne fuqi te vendimit te gjykates se Apelit,
dhe pasi shqyrtuan dhe analizuan ne teresi ceshtjen,

V Ë R E J N Ë

Pas marrjes se vendimit per kete ceshtje nga Gjykata Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ndodhen perpara situates qe, nga njera ane, shfuqizohet si antikushtetues vendimi i tyre nr.386, date 29.07.1999 dhe, nga ana tjeter, ceshtja i dergohet per rishqyrtim po Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, sepse sipas nenit 132/1 te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise, Gjykata Kushtetuese ka vetem te drejten e shfuqizimit te akteve qe shqyrton, d.m.th. ajo nuk mund t`i jape nje zgjidhje perfundimtare ceshtjes konkrete, qe eshte ne juridiksionin gjyqesor te zakonshem.

Duke qene se Kolegjet e Bashkuara jane te detyruara ta rishqyrtojne ceshtjen pas shfuqizimit te vendimit te tyre, duke pasur parasysh se vendimet e Gjykates Kushtetuese kane fuqi detyruese te pergjitheshme, duke qene se, sipas nenit 124/1 te Kushtetutes, Gjykata Kushtetuese ben vetem interpretimin perfundimtar te normave kushtetuese, si dhe nisur nga fakti qe juridiksioni i kesaj gjykate nuk mund te dale jashte kufinjve qe percakton neni 131 i Kushtetutes, rrjedhimisht eshte e domosdoshme qe, duke i u referuar vendimit te Gjykates Kushtetuese per ceshtjen ne fjale, te percaktohen konkretisht ceshtjet qe duhet te zgjidhin Kolegjet e Bashkuara ne kete gjykim te ri.

Gjykata Kushtetuese, duke qene e ndergjegjeshme qe, sipas Kushtetutes, interpretimi i unifikuar i ligjeve eshte ne juridiksionin ekskluziv te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, eshte e mendimit qe ato (Kolegjet e Bashkuara) duhet te dalin me nje vendim te ri unifikues ne pajtim me parimet dhe normat e Kushtetutes se Republikës se Shqiperise.

Fillimisht duhet te nisemi nga pretendimet e avokateve te parashtruara ne kerkesen e tyre, me te cilen eshte vene ne levizje Gjykata Kushtetuese, te evidentojme problemet me karakter kushtetues, qe ata kane ngritur, dhe mandej te gjejme zgjidhjet qe ka ofruar kjo gjykate nepermjet interpretimit prej saj te normave kushtetuese.

Ne kerkesen e tyre avokatet shprehen ne pergjithesi se: “Vendimi [i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte] bie ndesh me parimet kushtetuese dhe dispozitat e Kodit te Procedures Penale qe parashikojne te drejtat e mbrojtjes ne procesin penal”. Lidhur me sa pretendojne nuk eshte dhene asnje argument per shkelje te se drejtes kushtetuese te mbrojtjes ne

procesin penal, ndersa ne pjesen tjeter te ankimit avokatet bejne referenca ne disa dispozita te K.Pr.Penale, duke pretenduar se vendimi i ankimuar prej tyre eshte i paligjshem, kontradiktor, dhe nuk eshte shprehur se c`duhet bere me ceshtjen dhe me vendimin e gjykates se shkalles se pare. Ne thelb ata pretendojne se zgjidhjet ligjore qe ofron vendimi i Gjykates se Larte, sipas tyre, jane te gabuara sepse te tilla jane interpretimet e dispozitave proceduriale penale qe behen me kete vendim. Mbeshtetur pretendimi i tyre vetem mbi interpretimin e dispozitave te K.Pr.Penale do ta vinte Gjykatën Kushtetuese ne pozicionin e gjykates me te larte te sistemit gjyqesor ne “piramiden” gjyqesore, duke i dhene asaj juridiksion per shqyrtimin e ligjshmerise se vendimeve te Gjykates se Larte, madje edhe te atyre unifikuese te marra prej saj sipas te drejtes ekskluzive qe i jep neni 141/2 i Kushtetutes “*per njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqesore*”.

Duke i u referuar vendimit nr.17 date 17.04.2000 te Gjykates Kushtetuese verejme se referencat dhe arsyetimet ne fushen kushtetuese, (*duke mos pasur praktikisht mundesi te vecojme nga konteksti i frazave pjeset qe kane te bejne me konsiderata lidhur me interpretimin e normave ligjore proceduriale.*) jane, ne menyre te permbledhur, si me poshte:

“... Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke bere interpretime te gabuara te dispozitave te Kodit te Procedures Penale, qe parashikojne te drejtat e mbrojtjes ne procesin penal per gjykimet ne mungese te te pandehurit, *kane cenuar parimet kushtetuese te mbrojtjes si dhe te procesit te rregullt ligjor te garantuara nga nenet 31/ç dhe 42 te Kushtetutes...*

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, kane interpretuar gabim ligjin, *duke shkelur nje te drejte themelore te qytetareve dhe njekohesisht, kane zhvilluar nje proces te parregullt gjyqesor...*

Vendimi i Kolegjeve te Bashkuara, *eshte rrjedhoje e nje procesi te parregullt edhe per nje shkak tjeter, sepse nga njera ane pranohet per shqyrtim rekursi i prokurorit kunder vendimit te pafajesise dhe, nga ana tjeter, duke mos vendosur moslegjitimimin e mbrojtjesit te caktuar nga familjaret, i ve palet ne pozita te pabarabarta. Nje qendrim i tille vjen ne kundërshtim edhe me kerkesat e nenit 6 te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut dhe praktiken e Gjykates Europiane, per respektimin e kerkesave per “barazine e armeve”, qe sejciles pale t`i sigurohen mundesite perkatese per t`i parashtruar ceshtjet e saj ne kushte qe nuk e vene ate ne gjendje shume me pak te favoreshme se sa palen e kundert.*

Moslegjitimimi i mbrojtjesit per te bere ankim sipas konceptit te pranuar nga Gjykata e Larte, do te thellonte me tej pabarazine e paleve ne proces ne rastet kur prokurori ushtron rekursin kunder vendimit te pafajesise te dhene nga gjykata e shkalles se pare...

Caktimi i mbrojtjesit ne menytrat dhe kriteret e parashikuara nga ligji, perfshire edhe mbrojtjesin e caktuar kryesisht dhe njekohesisht, *e drejta e tyre per te bere ankim ndaj vendimit te gjykates, ka per qellim respektimin e procesit te rregullt ligjor ne te gjitha shkallet e gjykimit, sic percaktohet edhe ne nenin 2/2 te Protokollit nr. 7 te Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut dhe nenit 14/5 te Paktit Nderkombetar per te Drejtat Civile e Politike...*

Cenimi i procesit te rregullt ligjor te parashikuar nga neni 42 i Kushtetutes, pasqyrohet edhe ne nje aspekt tjeter ne Vendimin e Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Keshtu dispozitivi i vendimit vjen ne kundërshtim me nenin 441 te K.Pr.Penale....”

Duke nenevizuar me lart pjeset e vendimit te Gjykates Kushtetuese synojme te gjejme ne te interpretime te normave perkatese te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise dhe te instrumentave juridike nderkombetare te ratifikuara nga Kuvendi i Shqiperise, si dhe pjese nga arsyetimet e vendimeve te Gjykates Europiane te te Drejtave te Njeriut (*case law*). Kolegjet e Bashkuara ne rishqyrtimin e ceshtjes mbi bazen e vendimit te Gjykates Kushtetuese nuk gjejne interpretime perfundimtare te normave kushtetuese, por vetem pohimin se jane shkelur parimet kushtetuese te mbrojtjes ne procesin penal e te garantimit te nje procesi te rregullt ligjor. Perkundrazi, behen

perpjekje qe argumentat te jepen nepermjet analizes e interpretimit te nje sere normave te Kodit te Procedures Penale, gje qe del jashte juridiksionit te Gjykates Kushtetuese e qe nuk formon jurisprudence kushtetuese. Per me teper, Gjykata Kushtetuese i lejon vehtes edhe nxjerrjen e konkluzioneve te tilla si: vendimi eshte i pabazuar per shkak te inkonsekuences se tij; perben nje arsyetim te gabuar e jologjik; eshte kontradiktor dhe alogjik etj. Keto konsiderata e nxjerrin ate jashte kufinjve te pushteteve qe i jep Kushtetuta dhe, per rrjedhoje, jane te papranueshme.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se procesi i gjykimit te kesaj ceshtjeje eshte zhvilluar rregullisht, duke u zbatuar drejt dispozitat e ligjit procedural, ashtu sic i kupton dhe interpreton ato Gjykata e Larte.

Edhe ne kete rishqyrtim te ceshtjes, te imponuar prej vendimit te Gjykates Kushtetuese dhe te marre pa pasur ankuesit legjitimitet per ta vene ceshtjen ne levizje, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte vazhdojne t'i qendrojne menyres se mepareshme te interpretimit te normave procedurale penale, qe kane lidhje me ceshtjen, duke konkluduar perseri e perfundimisht, edhe me argumenta te reja e me te plota, se:

Mbrojtasi i caktuar kryesisht nga gjykata ose i zgjedhur nga te afermit e te pandehurit, per te marre pjese ne gjykimin qe zhvillohet ne mungese te te pandehurit per te mbrojtur interesat e tij, nuk eshte person i legjitimuar nga normat e ligjit procedural penal ne fuqi per te bere ankim kunder vendimit te dhene ne mungese te te pandehurit. Ai legjitimohet vetem ne qofte se eshte pajisur me nje prokure te posacme te leshuar nga vete i pandehuri e te vertetuar rregullisht sipas ligjit.

Per te argumentuar qendrimin e mesiperme Kolegjet e Bashkuara u referohen dhe analizojne dispozitat perkatese kushtetuese qe rregullojne te drejten e mbrojtjes se te pandehurit ne procesin penal, te drejten e ankimit te vendimit ne nje gjykate me te larte, si dhe te drejten per nje proces te rregullt ligjor lidhur ngushte me to.

Sipas nenit 31 te Kushtetutes, "*Gjate procesit penal kushdo ka te drejte:*

...ç) te mbrohet vete ose me ndihmen e nje mbrojtasi ligjor te zgjedhur prej tij, te komunikojte lirisht dhe privatisht me te ..."

Formulimi i dispozites kushtetuese te mesiperme eshte i njejte me formulimin e nenit 6/3, pika "c", te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut, sipas te cilit: "3....Çdo i akuzuar ka te drejte, nder te tjera dhe kryesisht: ...

c. Te mbrohet vete ose te ndihmohet nga nje mbrojtasi i zgjedhur prej tij..."

Nga ana tjeter neni 6 i kodit te Procedures Penale parashikon se:

"1. I pandehuri ka te drejte te mbrohet vete ose me ndihmen e mbrojtasesit. Kur nuk ka mjete te mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat.

2. Mbrojtasi ndihmon te pandehurin qe t'i garantohen te drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij ligjore" (neni 6 i K.Pr.Penale).

Njekohesisht K.Pr.Penale parashikon edhe gjykimin ne mungese te te pandehurit qe nuk paraqitet ne gjyq pa pasur pengesa objektive e te pashmangeshme per nje gje te tille, ose kur provohet qe ai i fshihet drejtesise, pasi te jene respektuar me pare te gjitha procedurat ligjore te njoftimit dhe te komunikimit te akteve. Ne rastet e gjykimit ne mungese, ne qofte se i pandehuri madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, nuk ka caktuar vete nje mbrojtasi, gjykata eshte e detyruar t'i caktojte kryesisht nje avokat per te kryer detyren e mbrojtasesit ne gjykim.

Kolegjet e Bashkuara cmojne se mospermbushja e ketij detyrimi per t'i caktuar mbrojtasi te pandehurit qe gjykohet ne mungese do te perbente shkelje te se drejtes kushtetuese per nje proces te rregullt ligjor, ne kuptim te nenit 42 te Kushtetutes, sipas te cilit, "*Liria, prona dhe te drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligj nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor"*.

Duke i u referuar rastit ne shqyrtim, nuk konstatojme ndonje papajtueshmeri te dispozitave ligjore te sipercituara e te analizuara me lart me permbajtjen e neneve 31, pika “ç”, dhe 42 te Kushtetutes, si dhe me permbajtjen e nenit 6/3, pika “c”, te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut. Gjithashtu as praktikisht nuk pretendohet ndonje shkelje konkrete e te drejtave te te dy te pandehurve, qe i fshihen drejtesise, per te cilet eshte vendosur te gjykohen ne mungese. Si konkluzion, ne gjykimin ne shkalle te pare te pandehurve u jane garantuar te drejtat kushtetuese te mbrojtjes dhe te nje procesi te rregullt ligjor.

Le te vazhdojme me tej me te drejten kushtetuese te te pandehurit per t`u ankuar kunder vendimit gjyqesor te dhene kunder tij. Sipas nenit 43 te Kushtetutes, “Kushdo ka te drejte te ankohet kunder nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte, pervecse kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe”. Nenvizojme qe ne fillim se rasti ne shqyrtim nuk eshte nga ata per te cilet ne Kushtetute parashikohet ndryshe. Pra, eshte e detyrueshme qe te pandehurve te mos u mohohet e drejta e apelit kunder vendimit te gjykates se shkalles se pare. Neni 43 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise eshte ne harmoni me nenin 2 te Protokollit shtese nr. 7 te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut, sipas te cilit: “1. Çdo person i deklaruar fajtor nga nje gjykate per nje shkelje penale ka te drejte te paraqese per shqyrtim perpara nje juridiksioni me te larte deklarimin e fajesise ose denimin. Ushtrimi i kesaj te drejte, duke perfshire shkaqet per te cilat ajo mund te ushtrohet, jane te percaktuara me ligj.”

Duke i u referuar dispozitave perkatese te Kodit te Pr.Penale, konstatojme se me ligj te pandehurve u njihet dhe u garantohet e drejta e ankimit, e cila eshte nje e drejte ngushtesisht personale. Sipas nenit 410 te K.Pr.Penale, “1. I pandehuri mund te beje ankim vete ose nepermjet mbrojtjesit te tij.

2. Kunder vendimit te dhene ne mungese, mbrojttesi mund te beje ankim vetem kur eshte i pajisur me nje akt perfagesimi te leshuar ne format e parashikuara nga ligji.”

Duke analizuar dispozitat e mesiperme ligjore nuk konstatohet ndonje kufizim i te drejtes kushtetuese te te pandehurit qe gjykohet ne mungese per t`u ankuar kunder vendimit te dhene ndaj tij, por vete gjykimi ne mungese i te pandehurit, i parashikuar ne Kodin tone te Procedures Penale, perben nje kufizim te se drejtes kushtetuese te te pandehurit per t`u mbrojtur. Ne kete rast mund te shtrohet per diskutim problemi ne se ky kufizim, i bere me ligj, eshte apo jo brenda parametrave te nenit 17 te Kushtetutes. Edhe pse nje gje e tille nuk eshte pretenduar ne kete gjykim, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte i japin kesaj pyetje pergjigjen si me poshte:

Ndodhemi perpara nje kufizimi te drejte te vendosur me ligj per nje interes publik e per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve (*nevoja e nje lufte efektive kunder kriminalitetit, sidomos kunder krimeve te renda dhe te organizuara*), kufizimi eshte ne perpjestim me gjendjen qe e dikton ate (*principi i proporcionalitetit*), dhe ky kufizim nuk cenon thelbin e te drejtes dhe nuk tejkalon kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut. Sipas vleresimit te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, kufizimi i se drejtes se te pandehurit per t`u mbrojtur vete ose per ta zgjedhur vete mbrojtjesin e tij, per shkak te gjykimit te tij ne mungese, nuk eshte antikushtetues. Ky kufizim, qe eshte rrjedhoje e zbatimit te ligjit, nuk i tejkalon caqet e parashikuara ne nenin 17 te Kushtetutes. Megjithate, ne qofte se Gjykata Kushtetuese ka mendim te kundert, ajo, kur t`i paraqitet rasti, nuk ka pengese qe t`i shpalle antikushtetuese dhe t`i shfuqizoje dispozitat e K.Pr.Penale qe parashikojne gjykimin ne mungese te te pandehurit. Aktualisht, gjersa keto dispozita jane ne fuqi, prezumohet konstitucionaliteti i tyre. Per rrjedhoje, nuk cmohet se ka vend te pezullohet gjykimi dhe t`i kerkohet Gjykates Kushtetuese te shprehet per pakushtetutshmerine e dispozitave ligjore te sipercituara qe parashikojne gjykimin ne mungese te te pandehurit qe i fshihet drejtesise.

Gjithesesi, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se kuptimi dhe permbajtja e nenit 410 te K.Pr.Penale jane te qarta e te plota dhe nuk lene shkak per keqinterpretim. Sidoqofte,

ketu jemi ne terrenin e interpretimit te ligjit, i cili eshte funksion kushtetues ekskluziv i gjykatave te juridiksionit te zakonshem. Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte cmojne se sipas nenit 410 te K.Pr.Penale te vleresuar ne harmoni me dispozitat e tjera te ketij kodi, e drejta e te pandehurit (*edhe e atij qe eshte gjykuar ne mungese*) per te bere ankim kunder vendimit gjyqesor eshte nje e drejte qe i rezervohet personalisht te pandehurit dhe askujt tjeter (*me perjashtim te kujdestarit te te miturit*). Kjo e drejte, e njohur dhe e garantuar ne ligj, mund te ushtrohet ose jo, sipas vullnetit te lire dhe disponimit te vete te pandehurit. Ligji parashikon gjithashtu se ushtrimi i se drejtes se ankimit mund t'i ngarkohet nga i pandehuri edhe mbrojtetit te tij duke e pajisur kete te fundit me nje akt perfaqesimi (prokure) te leshuar me vullnet te lire dhe ne formen e parashikuar nga ligji.

Ne disa raste te praktikës gjyqesore jane lejuar interpretime te gabuara te nenit 410/2 te K.Pr.Penale lidhur me cilesine e te perfaqesuarit e te perfaqesuesit me prokure, si dhe te permbajtjes e formes se aktit te perfaqesimit. Kur ligjvenesi shprehet per "*nje akt perfaqesimi te leshuar ne format e parashikuara nga ligji*", ai shprehet ne pergjithesi, pa bere ndonje reference konkrete ne ndonje ligj te vecante. Megjithate, akti i perfaqesimit nuk mund te jete ndryshe e nuk mund te mos plotesoje elementet baze te nje prokure.

I perfaqesuari d.m.th. personi ne emer e per llogari te te cilit do te behet ankimi nuk mund te jete person tjeter vec te pandehurit te gjykuar ne mungese, ndersa perfaqesues eshte mbrojteti i caktuar prej tij. Ne rastin kur gjykimi behet ne mungese te te pandehurit, sepse ai nuk eshte paraqitur ne gjyq ose i fshihet gjykimit, avokati mbrojteti i caktuar kryesisht nga gjykata, ose ai i zgjedhur nga familjaret e te pandehurit, nuk perfaqeson vullnetin e te pandehurit sepse nuk ka teger perfaqesimi prej tij. Ai kryen vetem nje funksion publik qe i eshte ngarkuar nga gjykata ne interes te drejtesise, per te ndihmuar ne mbrojtjen e te drejtave procedurale te te pandehurit ne gjyq dhe per te garantuar nje minimum standarti te nje procesi te rregullt ligjor. Ne qofte se nje i pandehur gjykohet ne mungese dhe gjate nje gjykimi te tille nuk i caktohet nje avokat mbrojteti, atehere procesi nuk mund te quhet i rregullt sepse, edhe ne aspektin thjesht formal, nuk mund te sigurohet kontradiktorialiteti dhe nje minimum i nevojshem i "barazise se armeve" ndermjet akuzes dhe mbrojtjes, ose, e thene ndryshe, nje balance e arsyeshme ndermjet interesit publik te gjykimit te krimin e te ndeshkimit te fajtorit, nga njera ane, dhe interesit privat te garantimit te te drejtave procedurale te te pandehurit ne gjykimin qe zhvillohet ne mungese te tij, nga ana tjeter. Misioni si me siper i mbrojtetit mbaron me perfundimin e gjykimit ne shkalle te pare. E drejta e ankimit (apelit) kunder vendimit qe ka dhene gjykata e shkalles se pare per te pandehurin eshte nje e drejte ngushtesisht personale e tij dhe, si e tille, ajo nuk mund te ushtrohet jashte vullnetit te tij te lire, te paraqitur ne menyre te shprehur dhe ne nje forme te caktuar te domosdoshme per vlefshmerine dhe provueshmerine e aktit.

Mbrojteti i caktuar kryesisht nga gjykata ne gjykimin ne mungese, ne rastet kur nuk eshte pajisur me nje prokure te leshuar nga vete i pandehuri, per te bere ankim kunder vendimit, nuk mund te ushtroje kete te drejte per shkak se i mungon tagri per te vepruar ne emer e per llogari te te pandehurit.

Ndersa mbrojteti i zgjedhur nga familjaret e te pandehurit edhe sikur te kete prokure prej tyre, per te bere ankim kunder vendimit, kjo prokure eshte e pavlefshme.

Persa i perket formes se prokures me te cilen duhet te jete i pajisur mbrojteti per te bere ankim kunder vendimit te dhene ne mungese, gjersa K.Pr.Penale nuk jep zgjidhje konkrete, atehere duhet te kemi parasysh kerkesat e dispozitave te ligjeve te tjera qe e parashikojne ate. Eshte e domosdoshme, qe, per efekt te vlefshmerise se saj, akti i perfaqesimit te jete ne forme shkresore, por, qe te siguroje vertetesi per permbajtjen e saj dhe per personin e te perfaqesuarit d.m.th. per efekt provueshmerine, ajo duhet te jete ne forme noteriale. Pra, forma e kerkuar nga ligji, ne kuptim te nenit 410/2 te K.Pr.Penale, eshte forma noteriale ose e vertetuar, sipas rastit, nga nje autoritet tjeter i njohur me ligj.

Ne thelb, moslejimi i se drejtes se ankimit te mbrojtetit te caktuar nga gjykata kryesisht ose te caktuar nga te afermit e te pandehurit, ne rastet e gjykimit ne mungese, kur mungon akti i perfaqesimit apo kur ai eshte i pavlefshem, nuk i demton interesat e tij. Nje mbrojtet i tille, duke mos pasur mundesi te kontaktoje me te pandehurin e te marre informacion prej tij, e ka shume te kufizuar mundesine per te siguruar prova qe do te shfaqesonin te pandehurin ose do te lehtesonin poziten e tij.

Mos ushtrimi i se drejtes kushtetuese te te pandehurit kunder vendimit te gjykates te dhene ne mungese te tij, kur ai i fshihet drejtesise, mund te vije si rrjedhoje e nje vendimi te marre me vullnetin e tij te lire e qe nuk mund te disponohet nga te tjeret, por mund te jete edhe per shkak te nje pamundesie objektive, per provimin e se ciles barra e proves i takon vete te pandehurit, gjate ushtrimit me vone te mjeteve te tjera mbrojtese qe i njeh ligji (K.Pr.Penale).

Mbas gjykimit te ceshtjes ne mungese vendimi i gjykates se shkalles se pare i njoftohet te pandehurit konform kerkesave te nenit 140, 141, te K.Pr.Penale. Lajmerimi i depozitimit te vendimit afishohet ne banesen e te pandehurit, qendren e punes, ju komunikohet fqinjëve ose te afermeve te tij, ndersa ne rastin e te pandehurit qe i fshihet ndjekjes penale ligji parashikon njoftimin e tij nepermjet dorezimit te aktit mbrojtetit te tij dhe, kur nuk ka te tille, mbrojtetit te caktuar kryesisht.

Mbas respektimit te te gjitha rregullave te mesiperme vendimi konsiderohet ligjerisht i njoftuar dhe per te pandehurin fillon perlllogaritja e afatit te ankimit. Plotesimi i afatit ligjor te ankimit i jep vendimit formen e prere dhe ne rastin e mungeses ai ankimohet vetem kushtet e caktuara ligjore.

I pandehuri ne mungese, si rregull, ndodhet ne pozite me te favoreshme ne qofte se vendimi i shkalles se pare merr forme te prere pa u ankimuar, se sa ne qofte se vendimi do te mund te ankimohej ne te gjitha shkallet dhe te lihej ne fuqi. Ankimi i vendimit ne te gjitha shkallet e gjykimit nga persona te paautorizuar prej vete te pandehurit do te conte ne nje zgjidhje perfundimtare te ceshtjes dhe ne ezaurim te mjeteve mbrojtese te te pandehurit.

Perkundrazi, i pandehuri qe eshte gjykuar ne mungese, me te marre dijeni per vendimin e dhene kunder tij, ka te drejte ne cdo kohe te kerkoje rivendosjen ne afat te ankimit te tij, duke pasur barren e proves per te provuar se nuk ka marre dijeni per vendimin.

Sipas nenit 147/2 te K.Pr.Penale, *“Ne qofte se eshte dhene vendimi ne mungese, i pandehuri mund te kerkoje rivendosjen ne afat per te bere ankim kur provon se nuk ka marre dijeni per vendimin.”*

Duke i u referuar e analizuar dispoziten e mesiperme, nuk eshte e veshtire te konstatohet se, ne qofte se te drejten e ankimit do ta kishte avokati mbrojtet i te pandehurit ne mungese, i caktuar kryesisht nga gjykata apo te afermit e tij, atehere e drejta e ankimit do te ezaurohej dhe nuk do te kishte kuptim te ushtrohej per te dyten here nga vete i pandehuri pas rivendosjes ne afat. Gjithashtu, ne kete eventualitet, nje konflikt interesash do te ishte i pashmangshem.

Persa u perket rasteve kur ceshtjen ne Apel e con prokurori ose te pandehurit e tjere, qe nuk kane qene ne mungese apo qe jane perfaqesuar rregullisht nga avokate mbrojtet te caktuar prej tyre, ato do te trajtohen njelloj si rasti kur nje i pandehur ka marre dijeni rregullisht per vendimin e dhene kunder tij dhe nuk e ka cmuar te leverdiseshme per te bere ankim. Ne keto raste ligji i ka zgjidhur drejt kufinjte e shqyrtimit te ceshtjes ne nje gjykate me te larte dhe efektet e gjykimit per palet ne proces.

Duhet te nenevizojme se ne keto raste gjykata eshte e detyruar qe gjate shqyrtimit te ceshtjes t'i caktojte perseri nje avokat mbrojtet te pandehurit qe vazhdon te gjykohet ne mungese. Kjo do te garantoje nje minimum te domosdoshem te mbrojtjes se te drejtave procedurale te te pandehurit ne mungese dhe nje proces te rregullt ligjor.

Gjithashtu, i denuari ne mungese objektivisht i ka mundesite me te medha qe te kerkoje rishikimin e vendimit te dhene kunder tij (nenet 449 – 450 te K.Pr.Penale), sepse ai nuk i ka konsumuar provat qe mund te kete, me te cilat ka te drejte te provoje pafajesine e tij ose te provoje rrethana qe i a lehtesojne poziten.

Se fundi, edhe arsyetimi i bere nga Gjykata Kushtetuese, sipas te cilit neni 441 i K.Pr.Penale nuk e parashikon pushimin e gjykimit te ceshtjes ne Gjykatën e Larte dhe se, ne kete menyre, eshte lene pa zgjidhur ceshtja konkrete mbi fajesine ose pafajesine e te pandehurve, nuk qendron.

Se pari, kjo eshte nje ceshtje interpretimi ligji dhe, si e tille, nuk hyn ne juridiksionin e Gjykates Kushtetuese.

Se dyti, asnje gjykate nuk mund te terhiqet nga zgjidhja e nje ceshtjeje edhe ne qofte se konstaton qe ka boshllek ne ligj.

Duke u vendosur prishja e vendimit nr.48, date 10.03.1999 te gjykates se Apelit Durres, mbetet ne fuqi vendimi nr. 205, date 30.10.1998 i gjykates se rrethit gjyqesor Durres, te cilin gjykata e Apelit Durres padrejtesisht e ka shqyrtuar sepse ankimi eshte bere nga persona te palegjitimuar.

Si konkluzion, ceshtja nuk ka mbetur pa u zgjidhur, sic shprehet Gjykata Kushtetuese. Ajo eshte zgjidhur perfundimisht nga gjykata e shkalles se pare dhe vendimi konsiderohet se ka marre forme te prere pa u ankimuar. Eshte e drejte e te denuarve te gjykuar ne mungese qe, me t`u vene ne dijeni per vendimin e dhene kunder tyre, te kerkojne, apo te mos kerkojne, rivendosjen ne afat te ankimit te tyre, apo te kerkojne ose jo rishikimin e vendimit. Duke qene se ata jane madhore, keto te drejta te tyre nuk mund te ushtrohen nga askush tjeter, pa pasur nje akt perfaqesimi te leshuar prej tyre.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, pas rishqyrtimit te kesaj ceshtjeje per unifikim te praktikës gjyqesore ne zbatim te detyrimit kushtetues qe rrjedh nga vendimi i Gjykates Kushtetuese, duke zgjeruar bazen e arsyetimit e duke shtuar argumenta te reja me te plota, ne analize te fundit arrijne ne te njejtat perfundime qe kane arritur me pare per kete ceshtje. Per kete arsye e cmojne te nevojshme e te dobishme qe, nepermjet ketij vendimi, te dalin edhe me disa konsiderata me te pergjitheshme persa i perket te drejtes kushtetuese te Kolegjeve te Bashkuara te parashikuar ne nenin 141/2 te Kushtetutes. Kjo behet ne funksion te nje kuptimi me te drejte e me te sakte te ndarjes se juridiksionit midis Gjykates Kushtetuese e Gjykates se Larte , si dhe per te kontribuar ne menyre konstruktive e te argumentuar ne arritjen e zgjidhjeve te drejta e te pranueshme nga te dyja palet ne te ardhmen.

Sipas Kushtetutes se Republikës se Shqiperise, interpretimi i ligjeve eshte funksion qe ligjvenesit u jep gjykatave te juridiksionit te zakonshem, ndersa interpretimet me karakter unifikues, te cilat perbejne nje jurisprudence te detyrueshme per t`u ndjekur nga gjykatat e te gjitha shkalleve ne ceshtje te tjera te ngjashme, jane funksion ekskluziv i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Gjykates se Larte, nepermjet interpretimit te dispozitave te ligjit material e procedural relevante me ceshtjen ne shqyrtim, i takon "*fjala e fundit*" per t`u shprehur lidhur me ate se cili eshte kuptimi e permbajtja e sakte e ketyre dispozitave, sipas vullnetit te ligjvenesit dhe situatave specifike qe rezultojne ne nje kontekst te caktuar social – ekonomik, historik e aktual, duke u konformuar dhe pershtatur kurdohere me normat e parimet kushtetues e me parimet themelore te se drejtes.

Pra, eshte e detyrueshme qe, ne analize te fundit, ligji te kuptohet, te interpretohet dhe te zbatohet ashtu sic thote Gjykata e Larte ne Kolegjet e saj te Bashkuara. Askush tjeter nuk mund ta zevendesoje Gjykatën e Larte, as nuk mund te dale mbi te e t`i imponohet, ne kete funksion ekskluziv kushtetues. Kushtetuta e Republikës se Shqiperise ne menyre te qarte e te shprehur nuk i jep Gjykates Kushtetuese funksionin dhe pushtetin per te bere interpretimin e ligjeve , por vetem

ate per te vendosur ne se nje ligj apo norme e kontestuar eshte apo jo ne pajtim me normat e parimet e kushtetutes, duke e realizuar kete nepermjet interpretimit perfundimtar te normave kushtetuese. Shprehja “*interpretim perfundimtar i Kushtetutes*”, nenkupton qe interpretimin e normave te Kushtetutes, brenda kuadrit te funksionit e te juridiksionit te vet, te percaktuar ne Kushtetute, ka te drejte dhe detyrim ta beje cdo organ kushtetues i sejcilit pushtet. Ne kete kuptim kjo prerogative u perket edhe gjykatave te juridiksionit te zakonshem, te cilat kane te drejte te zbatojne edhe ne menyre te drejtperdrejte dispozitat kushtetuese. Sipas nenit 4/3 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, “*Dispozitat e Kushtetutes zbatohen drejtpersedrejt, pervec rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*”. Kjo do te thote se organet e tjera kushtetuese, vec Gjykates Kushtetuese, nuk mund te ofrojne nje interpretim e zbatim te drejtperdrejte te nje norme kushtetuese, ne qofte se vete kjo kerkon, per te gjetur zbatim, miratimin pas saj te nje ligji, apo te akteve te tjera te pushtetit ekzekutiv. Kur keto akte ekzistojne, eshte e drejte e gjykatave te juridiksionit te zakonshem qe, kur kane *locus standi* lidhur me ceshtjen qe u eshte paraqitur per shqyrtim, te bejne interpretimin e normave te akteve te legjislativit e te ekzekutivit duke u nisur nga parimi i prezumimit te konstitucionalitetit te ligjeve. Ne kete kontekst, gjykata e juridiksionit te zakonshem shpjegojne e argumentojne pse dispozita ligjore, apo akti ekzekutiv, duhet interpretuar e zbatuar ne kete apo ate menyre, per te qene e pajtueshme me kuptimin dhe permbajtjen e dispozites perkatese kushtetuese, ne baze e per zbatim te se ciles ajo ka dale. Kur gjykata e juridiksionit te zakonshem jep argumenta te pajtueshmerise se nje ligji me dispozitat kushtetuese dhe arrin ne nje perfundim pozitiv lidhur me te, ajo ne menyre te pashmangeshme, krahas interpretimit te ligjit ben edhe interpretimin e normes kushtetuese ku mbeshtetet ky ligj. Eshte e qarte qe ky interpretim kushtetues nuk eshte perfundimtar dhe ka vetem efekt *inter partes*. Ky interpretim kushtetues i nje gjykate te juridiksionit te zakonshem, i cili merr karakter detyrues per te gjitha gjykatat ne qofte se realizohet apo konfirmohet me nje vendim te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, mund te rrezohet nga Gjykata Kushtetuese, ne rastet kur ajo me pas del me nje vendim te kundert per nje ceshtje ne juridiksionin e saj te percaktuar ne nenin 131, pika “a”, “b”, “c”, te Kushtetutes. Ne te kundert, ne qofte se Gjykata Kushtetues nuk ka juridiksion dhe *locus standi* per nje ceshtje te caktuar, ajo nuk mund te shfuqizojte nje ligj apo norme ligjore. Persa i perket nje vendimi gjyqesor, aq me teper nje vendimi unifikues te Gjykates se Larte, ajo jo vetem nuk mund te prezantoje nje interpretim tjetër ligjor, te ndryshem nga interpretimi qe kane bere gjykatat e juridiksionit te zakonshem, e t’i jape karakter detyrues ketij interpretimi, sic ben ne ceshtjen ne shqyrtim me vendimin e saj nr. 17, date 17.04.2000. Ajo gjithashtu, sic e argumentojme me lart, nuk mund te rrezoje interpretimin kushtetues pozitiv te bere nga Gjykata e Larte, duke vepruar tej kufinjve te juridiksionit dhe te legjitimitetit te subjekteve perkatese qe kane te drejte ta vene ate ne levizje.

Ne rastet e juridiksionit te saj sipas pikes “f” te nenit 131 te Kushtetutes, kur ajo ka juridiksion per te vendosur per “*grykimin perfundimtar te ankesave te individeve per shkeljen e te drejtave te tyre kushtetuese per nje proces te rregullt ligjor, pasi te jene shteruar te gjitha mjetet juridike per mbrojtjen e ketyre te drejtave*”, Gjykata Kushtetuese, te ciles i eshte paraqitur ankesa per te goditur nje vendim te Gjykates se Larte me arsyetimin se eshte shkelur standarti kushtetues “*per nje proces te rregullt ligjor*”, ka te drejte dhe eshte e detyruar qe ne kuader te shqyrtimit te ceshtjes konkrete te percaktoje vetem se cilat jane parametrat kushtetuese “*te procesit te rregullt ligjor*” dhe cilat jane konkretisht keto shkelje, qe sjellin pakushtetutshmerine e vendimit gjyqesor te atakuar. Gjithesesi, Gjykata Kushtetuese nuk mund te konkludoje per shkelje te parametrave kushtetuese duke u mbeshtetur ne nje interpretim qe ajo u ben vete normave te nje ligji te zakonshem, te ndryshem nga interpretimi qe u kane bere ketyre normave gjykatat e juridiksionit te zakonshem e, ne vecanti, te ndryshem nga interpretimi qe eshte bere me nje vendim unifikues te Kolegjeve te Bashkuara. Eshte e diskutueshme ne se Gjykata Kushtetuese, ne nje grykim te

iniciuar ne baze te nenit 131, pika "f", te Kushtetutes, ne menyre incidentale, mbi bazen e kerkeses se nje individi, ne gjykimin e filluar, te shprehet per pajtuesmerine ose jo te ligjit (*apo te normes se vecante te tij*) me Kushtetuten. Ne qofte se Gjykata Kushtetuese do te konkludoje qe e ka kete te drejte ajo mund te shprehet per pakushtetutshmerine e vendimit te Kolegjeve te Bashkuara, vetem pasi te jete shprehur me pare per pakushtetutshmerine e dispozitave ligjore qe lidhen me ceshtjen, e ne kete kuader, edhe per pakushtetutshmerine e interpretimit te unifikuar qe u eshte bere ketyre normave nga Gjykata e Larte. Per rrjedhoje, duke u shfuqizuar si antikushtetuese norma e ligjit, bashke me te bie edhe interpretimi qe i ka bere asaj norme Gjykata e Larte. Si perfundim, ne kete lloj gjykimi, i cili inicohet sipas nje procedure te caktuar, Gjykata Kushtetuese nuk ka te drejte te beje interpretim te ligjit, sikunder ka vepruar ne rastin konkret, por ka te drejte vetem te beje interpretim te dispozitave perkatese kushtetuese, te cilave, sipas vleresimit te saj, u bie ndesh dispozita e ligjit te zakonshem, qe ka ate kuptim e permbajtje qe i ka dhene asaj Gjykata e Larte ne vendimin e saj unifikues.

PER KETO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, ne baze te nenit 141/2 te Kushtetutes se Shqiperise dhe te nenit 441, pika "c" te K.Pr.Penale,

V E N D O S E N

1. Prishjen e vendimit nr. 48, date 10.03.1999 te gjykates se Apelit Durres dhe pushimin e gjykimit te ceshtjes ne shkalle te dyte.
2. Ky vendim unifikues per praktiken gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 27.10.2000

MENDIM I PAKICËS

Gjykimi ne mungese eshte nje institut qe gjen rregullim si ne Kushtetute, ashtu edhe ne Kodin e Procedures Penale.

Ne nenin 33 te Kushtetutes sanksionohet: "Kushdo ka te drejte te degjohet para se te gjykohet. Nga kjo e drejte nuk mund te perfitoje personi qe i fshihet drejtesise".

Nga dispozita kushtetuese e sipercituar, pjesemarrja dhe prezenca e te pandehurit ne gjykim, nuk eshte detyrim, por e drejte e te pandehurit. Per rrjedhoj, vetem kur vertetohet se i pandehuri i fshihet drejtesise ose nuk deshiron te realizoje te drejten e paraqitjes para gjykates, atehere gjykimi i tij mund te behet ne mungese.

Gjykimi ne mungese behet duke respektuar te drejten e te pandehurit per mbrojtje. Ne rastet e gjykimit ne mungese, ne qofte se i pandehuri i rritur nuk ka caktuar vete nje mbrojtjes, gjykata eshte e detyruar t'i caktojte vete kryesisht nje avokat per te kryer detyren e mbrojtjesit ne gjykim (neni 49 i KPrPenale). Realizimi i mbrojtjes ne gjykimin ne mungese eshte percaktuar hollesisht ne dispozitat e Kodit Procedures Penale. Kodi i Procedures Penale me ane te dispozitave te tij, ka krijuar te gjitha garancite e nevojshme kushtetuese qe gjykimi ne mungese te moszhillohet kur i pandehuri deshiron te jete i pranishem, por per shkaqe objektive ose per mungese njoftimi, nuk eshte paraqitur ne gjykim.

Keto rregulla jane te percaktuara ne nenet 350, 351, 352 dhe 427 te Kodit Procedures Penale. Dispozitat e cituara me siper rregullojne gjykimin ne mungese si ne gjykatën e shkalles se pare ashtu edhe ne gjykatën e apelit.

Per gjykimin ne shkalle te pare ligji parashikon: “Kur i pandehuri i lire ose i paraburgosur nuk paraqitet ne seance ndonese eshte njoftuar dhe nuk ka patur shkaqe te ligjshme per t’u paraqitur, gjykata, pasi degjon palet, deklaron mungesen e tij. Ne kete rast, ai perfaqesohet nga mbrojttesi.

Vendimi qe deklaron mungesen eshte i pavlefshem kur provohet se ajo ka ardhur nga mosmarrja e njoftimit ose nga pamundesia absolute per t’u paraqitur.

Ne qofte se i pandehuri paraqitet pas shpalljes se vendimit, **gjykata revokon vendimin qe ka deklaruar mungesen.** Kur paraqitja behet para fillimit te diskutimit perfundimtar, **i pandehuri mund te kerkoje te pyetet.** Mbeten te vlefshme veprimet e kryera me pare, por kur i pandehuri provon se njoftimi eshte bere me vonese jo per fajin e tij, **gjykata urdheron marrjen ose perseritjen e veprimeve qe çmon se kane rendesi per marrjen e vendimit”** (neni 351 KPrP).

Kur keto rregulla nuk jane zbatuar, gjykata e apelit sipas pikes “4” te nenit 427 te Kodit Procedures Penale, ka te drejte te vendos **perseritjen e shqyrtimit gjyqesor** kur vertetohet se i pandehuri nuk ka marre pjese ne shkalle te pare, sepse nuk ka marre dijeni ose nuk ka mundur te paraqitet per shkaqe ligjore.

Ne praktike ka lindur si problem se si duhet te trajtohet mbrojttesi i caktuar kryesisht per gjykimet ne mungese, a ka ai te njejtat te drejta qe ligji i njej te pandehurit, a mund ai te beje ankim kunder vendimit te dhene ne mungese.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me vendimin unifikues nr. 386 date 29.7.1999 kane vendosur se mbrojttesi i caktuar eshte nje person i palegjitimuar per te bere ankim kunder vendimit te dhene ne mungese te te pandehurit.

Kunder ketij vendimi unifikues te Kolegjeve te Bashkuara kane bere ankim ne Gjykatën Kushtetuese avokatet e te pandehurve Baki Huqi e Albert Huqi.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 17 date 17.4.2000 ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues te vendimit nr. 386 date 29.7.1999 te Kolegjeve te Bashkuara dhe e ka derguar çeshtjen per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte.

Kolegjet e Bashkuara pasi e rigjykan çeshtjen vendosen perseri se mbrojttesi i caktuar nuk legjitimohet per te bere ankim kunder vendimit te dhene ne mungese.

Me kete zgjidhje te Kolegjeve te Bashkuara nuk jam dakort per arsyet qe po parashtroj me poshte:

Problemi kryesor qe diskutohet ne çeshtjen objekt gjykimi eshte nese avokati i caktuar kryesisht mundet te beje ankim kunder vendimit te dhene ne mungese te te pandehurit. Ky moment proceduralisht eshte rregulluar nga neni 410 i Kodit te Procedures Penale ku thuhet: “Kunder vendimit te dhene ne mungese, mbrojttesi mund te beje ankim vetem **kur eshte i pajisur me nje akt-perfaqesimi** te leshuar ne format e parashikuara nga ligji”.

Zgjidhja e dhene nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Larte jane te ndryshme. Gjykata e Larte arsyeton se mbrojttesi i caktuar eshte nje person i palegjitimuar per te bere ankim kunder

vendimit te dhene ne mungese te te pandehurit. Gjykata Kushtetuese arsyeton te kunderten. Ne vendimin e saj Gjykata Kushtetuese nder te tjera shprehet: “Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, duke bere interpretime te gabuara te dispozitave te Kodit te Procedures Penale, qe parashikojne te drejtat e mbrojtjes ne procesin penal per gjykimet ne mungese te te pandehurit, kane cenuar parimet kushtetuese te mbrojtjes si dhe te procesit te rregullt ligjor te garantuar nga nenet 31/ç dhe 42 te Kushtetutes”.

Te dyja gjykatat arsyetimet e tyre i mbeshtesin ne te drejten ekskluzive qe u jep Kushtetuta. Gjykata e Larte citon nenin 141/2 te Kushtetutes qe i jep te drejte asaj “per njesimin ose ndryshimin e praktikës gjyqesore”. Gjykata Kushtetuese citon nenet 31/ç, 42, 124/1 dhe 131/f te Kushtetutes.

Interpretimi me karakter unifikues, eshte funksion kushtetues i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Askush tjetër nuk mund ta zevendesojë Gjykatën e Larte ne kete funksion ekskluziv kushtetues. Por duhet theksuar se interpretimi qe ben Gjykata e Larte nuk eshte interpretim perfundimtar. Ky interpretim nuk ka fuqi detyruese te pergjithshme siç parashikon neni 132/1 i Kushtetutes. Vendimi i Gjykates se Larte ka karakter detyrues vetem per gjykatat me te ulta. Ky konkluzion del nga neni 141/2 i Kushtetutes ku thuhet se: “Gjykata e Larte ka te drejte te terheq per shqyrtim ne Kolegjet e Bashkuara çeshtje te caktuara gjyqesore, per njesimin ose ndryshimin e praktikës gjyqesore.

Çdo organ kushtetues, cilido qofte ai, pushteti ligjvenes, ekzekutiv ose gjyqesor, dispozitat e Kushtetutes i zbaton drejtpersdrejti, perveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe (neni 4/3 i Kushtetutes). Dispozita Kushtetuese e permendur me siper u jep te drejte ketyre organeve, te bejne interpretimin e normave kushtetuese sipas fushave te veprimtarise se tyre. Por ne qofte se ky interpretim i bere, nga organet kushtetuese, ankimohet nga subjektet e parashikuara nga neni 134 i Kushtetutes, eshte e drejte e Gjykates Kushtetuese qe te beje gjykimin perfundimtar. Neni 131/f i Kushtetutes se Republikës se Shqiperise ne menyre te qarte e te shprehur i jep Gjykates Kushtetuese funksionin dhe pushtetin per te bere: **“gjykimin perfundimtar te ankesave te individeve per shkeljen e te drejtave te tyre kushtetuese per nje proces te rregullt ligjor, pasi te jene shterur te gjitha mjetet juridike per mbrojtjen e ketyre te drejtave”**. Gjate ketij “gjykimi perfundimtar”, Gjykata Kushtetuese ka te drejte te vendose ne se interpretimi i bere nga organet e tjera eshte ose jo ne perputhje me Kushtetuten.

Funksioni dhe pushteti i Gjykates Kushtetuese nuk buron vetem nga dispozitat kushtetuese te analizuara me siper por edhe nga neni 124/1. Ne baze te kesaj dispozite, Gjykata Kushtetuese eshte ngarkuar me detyren per te garantuar respektimin e Kushtetutes. Kete detyrim kushtetues ajo e realizon kur ben interpretimin perfundimtar te Kushtetutes.

Ne kete rast vendimi i Gjykates Kushtetuese, sipas nenit 132/1 ka fuqi detyruese te pergjithshme (erga omnes). Ne kete kuader vendimi i Gjykates Kushtetuese eshte detyrues edhe per Gjykatën e Larte.

Ylvi Myrtja

**Nr.340 i Regj. Themeltar
Nr.284 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykatës së Lartë, te përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Bashkim Caka	Anëtar
Nikoleta Kita	“
Natasha Sheshi	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Valentina Kondili	“
Vitore Tusha	“
Ylvi Myrtja	“
Zamir Poda	“
Tefta Zaka	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Ploçi	“
Artan Hoxha	“
Agron Lamaj	“
Perikli Zaharia	“

në seancën gjyqësore të datës 15.09.2000 dhe 06.10.2000, morën në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURIT: TOM LLESHDEDAJ, lindur në Gjakovë-Kosovë dhe banues në Kroaci, hetuar dhe gjykuar në gjendje arresti në mungesë, mbrojtur në gjykim kryesisht nga avokati Enver Mema.

A K U Z A:

Veprën penale të mashtrimit të 78 personave
në shumën 910 170 USD,
parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

PADITËSA CIVILË: 1. SAMI KULLA
2. VIKTOR OSMANLLIU
3. KAMBER KAMBERAJ
4. ARQILE LOLE
5. DHIMITRAQ SHKODRANI

I PADITUR CIVIL: TOM LLESHDEDAJ

OBJEKTI:

Kthim shume dhe shpërblim dëmi.
Baza Ligjore: Neni 61 e vijues të Kodit të Procedurës Penale
dhe nenet 445, 450, 1050, 1051 të Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.292, datë 08.05.2000, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Lleshdedaj për veprën penale të mashtrimit dhe në bazë të nenit 143 të Kodit Penal e dënon me 5 (pesë) vjet burgim.

Ky dënim i fillon nga dita e ekzekutimit të vendimit.

Pas vuajtjes së dënimit të pandehurit i hiqet e drejta për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë për një afat prej 5 (pesë) vjetësh, parashikuar kjo nga nenet 40 e 44/2 të Kodit Penal.

Pranimin e padisë civile të ngritur në procesin penal.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj ti kthejë paditësit civil Kamber Kamberaj shumën 5.000.000 (pesë milion) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj ti kthejë paditësit civil Viktor Osmanlliu shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj ti kthejë paditësit civil Sami Kulla shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj t'i kthejë paditësit civil Dhimitraq Shkodrani shumën 3 (tre) mijë USD dhe 700.000 (shtatëqind mijë) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj ti kthejë paditësit civil Arqile Lole shumën 2. 256.800 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e teteqind) lekë dhe interesin bankar nga data 06.08.1996 e deri në ditën e ekzekutimit të vendimit.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr. 284, datë 26.06.2000, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.292, datë 08.05.2000 të Gjykatës së Rrethit Tiranë si me poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Lleshdedaj për veprën penale të mashtrimit ndaj të dëmtuarve Ilir Loli për veprën 10.000 USD, Muharrem Doçi në vlerën 10.000 USD, Hekuran Rushiti në vlerën 12 500 USD, Jorgo Rrapi në vlerën 1000 USD, Jani Biti në vlerën 500 USD, Eduart Pashollari në vlerën 1000 USD, Pirro Beqiri në vlerën 13 000 USD, Agim Basha në vlerën 1 000 000 lekë, Manushaqe Sinjali në vlerën 1 600 000 leke, Dashnor Cenomeri në vlerën 14 500 USD, 1 600 000 lekë, Zenel Bajraktari në vlerën 6000 USD dhe në bazë të nenit 104/2 të K.P. të vjetër e dënon me 5 (pesë) vjet heqje lirie.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Lleshdedaj për veprën penale të mashtrimit ndaj të dëmtuarve për 47 herë, në bazë të nenit 143 të Kodit Penal dhe dënimit e tij me masat e dënimit nga minimumi 1 muaj heqje lirie deri në maksimumin 3 vjet heqje lirie (sipas dispozitivit).

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/2 të Kodit Penal i pandehuri Tom Lleshdedaj dënohet me 8 (tetë) vjet heqje lirie.

Detyrimin e të pandehurit Tom Lleshdedaj tu kthejë të dëmtuarve shumat respektive sipas aktit të ekspertimit kontabël të shprehur në dispozitiv.

Lënien në fuqi të vendimit nr. 292, datë 08.05.2000 të Gjykatës së Rrethit Tiranë ku është vendosur që pas vuajtjes së dënimit të të pandehurit Tom Lleshdedaj ti hiqet e drejta për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë për një afat prej 5

(pesë) vjetësh, në bazë të neneve 40 e 42/2 të K. Penal dhe për shpenzimet gjyqësore që i janë lënë në ngarkim të pandehurit.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- se nuk jemi dakort me masën e dënimit të dhënë nga gjykata e apelit prej 8 (tetë) vjet burg, ajo duhet ti jepte maksimumin e masës së dënimit të nenit 143 të K.P. dhe në bashkim të dënimeve ti jepte një masë dënimi më të ashpër,
- se gjykata nuk ka patur parasysh faktin që i pandehuri i është shmangur hetimit dhe gjykimit, nuk ka patur parasysh pasojat e rënda sociale që sollën firmat piramidale në Shqipëri, si dhe faktin që ky i pandehur nuk ka shlyer detyrimet ndaj kreditorëve.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka paraqitur rekurs mbrojtësi i caktuar kryesisht i të pandehurit, av. Enver Mema, i cili kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit Tiranë përsa i përket fajësisë, cilësimit juridik e padisë civile, kurse përsa i përket masës së dënimit për 5 vjet, që është maksimumi i dispozitës së nenit 143, kërkon uljen e saj, duke parashtruar këto shkaqe:

- se vendimi i gjykatës së apelit është alogjik dhe haptazi i padrejtë,
- se nuk mund të zbatohen të dy dispozitat e kodeve penale të ndryshme për të njëjtën veprë penale, por ajo që është më e favorshme për të pandehurin,
- se është i pabazuar pretendimi i gjykatës, se Kodi i Ri Penal nuk e pranon krimin vazhdues, ai duhet të konsiderohet si pjesë e të njëjtës veprë penale dhe jo vepra penale më vete,
- se ka shkelje ligji kur gjykata zbaton për të njëjtën veprë dy dispozita të kodeve të ndryshme,
- se gjykata ka shkelur nenin 62 të K.P.P. përsa i përket padisë civile, ku thuhet se legjitimimi i paditësit civil bëhet derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor,
- se gjykata në kundërshtim me ligjin pranon si palë kryetarin e grupit të mbikqyrjes, kur padia ngrihet personalisht nga paditësi civil,
- se për kreditorët gjykata ka bërë gjykime për së dyti, kur në fakt jemi para gjësë së gjykuar.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

mbasi dëgjuan relacionin e gjyqtarit Bashkim Caka, dhe të gjyqtarit Vangjel Kosta, mbasi dëgjuan prokurorin Mihallaq Bleta, i cili kërkoj ndryshimin e vendimit penal nr.284, datë 26.06.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke e dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burg, shkaqet e rekursit dhe mbasi shqyrtuan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë

Personi që ka kryer mashtrime do të përgjigjet penalisht për veprën penale të mashtrimit parashikuar nga neni 143 i K. Penal, aq herë sa është numri i personave të dëmtuar.

Ka rezultuar gjatë gjykimit se i pandehuri Tom Lleshdedaj në vitin 1993 ka themeluar shoqërinë tregtare me emrin “ Agron” duke qenë me cilësinë e ortakut të vetëm. Në vitin 1994 i pandehuri ka filluar të marrë hua nga persona të ndryshëm sipas kontratave përkatëse, të cilat parashikonin një interes prej 6-12 % në muaj. Në këtë mënyrë ai ka mundur të marrë shuma të ndryshme parash me një vlerë të përgjithshme prej 910.971 USD, të cilat u përkisnin 78 personave të ndryshëm. Për të krijuar bindjen se ishte shoqëri serioze dhe që garantonte kthimin e shumave të marra hua së bashku me interesat, fillimisht i pandehuri ka shlyer disa interesa. Më vonë, duke

përdorur gënjeshtren se do të kryente investime të ndryshme, ka ndërprerë pagesat. Por, nga gjykimi është provuar se ky i pandehur nuk ka kryer asnjë investim dhe, realisht nuk disponon asnjë aset a pasuri tjetër deri sa më 1998 është larguar nga Shqipëria, duke marrë edhe paratë e mbledhura nëpërmjet kontratave të huasë.

Në keto rrethana, konkluzioni i gjykatave se i pandehuri Tom Lleshdedaj ka konsumuar veprën penale të “mashtimit” është i bazuar në ligj. I pandehuri ka përdorur gënjeshtren për të shtënë në dorë paratë e personave me të cilët në mënyrë fiktive ka lidhur kontratat e huamarrjes. I pandehuri ka paraqitur rrethana të tilla para personave të lartpërmendur për ti bindur ata se ai ushtronte një veprimtari të ligjshme tregtare me anë të së cilës mund të siguronte fitime që tejkalonin atë pjesë të interesit të premtuar kreditorëve. Por, gjatë gjykimit është provuar në mënyrë bindëse se veprimtaria huamarrëse e ushtruar prej të pandehurit është veprimtari e paligjshme. Sipas nenit 1 të ligjit nr. 7560 datë 28.04.1992 “ Për sistemin bankar në Shqipëri” veprimtaria tregtare e “pranimit të depozitave” mund të ushtrohet ekskluzivisht nga një institucion financiar i pajisur me licensë të posaçme sipas kushteve dhe nga organi që parashikon ligji i sipërcituar. Duke qenë në të njëjtën kohë edhe një marrëdhënie juridike-civile ajo mund të realizohet edhe në veprimtarinë civile por vetëm në kushtet që nuk përfaqëson një veprimtari tregtare. Në rastin konkret, veprimtaria e “ pranimit të depozitave” është ushtruar në përmasat e një veprimtarie tregtare. Prandaj, subjekt i ushtrimit të kësaj veprimtarie tregtare mund të jenë vetëm institucionet financiare që parashikon ligji i lartpërmendur.

Përsa i përket cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri nga gjykatat janë mbajtur qëndrime të ndryshme.

Gjykata e shkallës së parë, duke arsyetuar se “ vepra penale e kryer nga i pandehuri është unike dhe se ai ka patur mendim të njëjtë kriminal” e ka konsideruar krimin “vazhdues” dhe ka dënua të pandehurin vetëm një herë sipas nenit 143 të K. Penal.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së gjykatës së shkallës së parë duke pranuar se për çdo person të mashtuar i pandehuri ka konsumuar veprën penale të mashtimit në mënyrë të veçantë.

Lidhur me trajtimin e ekzistencës së krimit vazhdues në veprimet e këtij të pandehuri , duke u nisur nga ekzistenca e praktikave të ndryshme të mëparshme për çështje analoge, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur “gjykimin e kësaj çështjeje në Kolegjet e Bashkuara” me qëllim unifikimin e praktikës përse i përket “ekzistencës ose jo të krimit vazhdues”.

Në rastin konkret problemi shtrohet nëse do të kemi krim vazhdues, d.m.th, një vepër të vetme penale të mashtimit të kryer prej të pandehurit Tom Lleshdedaj.

Për të zgjidhur drejt këtë problem duhet të mbahet parasysh se për të patur krim vazhdues duhet të jenë të pranishëm elementë të tillë si ; sejcila vepër nuk duhet të qëndrojë si akt më vehte, veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të konsumojnë të njëjtën figurë të veprës penale, të ekzistojë një mendim kriminal, i cili të bashkojë aktet e veçanta në një tërësi të vetme të pandashme” . Për të patur krim vazhdues është e domosdoshme që personi të ketë parashikuar hollësitë rreth veprimtarisë së tij kriminale siç janë, koha, mjetet, forma, mënyra për kryerjen e krimit. Mendimi i vetem kriminal, si bosht i kërkësës për krimin vazhdues, presupozon që i pandehuri të ketë përpunuar në mendjen e tij zhvillimin e veprimeve konkrete në kohë e hapësirë. Pavarësisht se është “mendim” ai “lexohet” nëpërmjet veprimeve konkrete që kryen i pandehuri për realizimin e veprës penale.

Në rastin konkret gjykatat kanë pranuar se i pandehuri ka kryer veprime të ndryshme në periudha të ndryshme kohe për të rritur sa më shumë numrin e personave të mashtuar. Kështu, aktiviteti kriminal është zhvilluar në një kohë relativisht të gjatë dhe veprimet e të pandehurit nuk kanë qenë rrjedhojë e një mendimi të vetëm kriminal të përpunuar në momentin që vendosi të kryejë këtë veprimtari kriminale, por kanë ndryshuar në varësi të rrethanave. Kështu, duke patur

parasysh se persona të ndryshëm kanë patur marrëdhënie të ndryshme me të, ai ka përdorur forma të ndryshme mashtrimi. Për personat e njohur drejtpërdrejt prej tij, i pandehuri ka shpërdoruar besimin, ndërsa përsa u përket personave të tjerë, ka përdorur gënjeshtren e “ushtrimit të veprimtarisë së ligjshme tregtare”. Vetë veprimet e të pandehurit si, qëndrimi i ndryshëm lidhur me pagesat e interesave, marrja e objekteve më pas me qira për të “bindur” fillimin e investimeve dhe sidomos ndryshimi i shkallës së interesit tregojnë në mënyrë të qartë mungesën e një mendimi të vetëm paraprak kriminal.

Argumenti i përdorur nga gjykata e shkallës së parë, se ndodhemi para një veprë të vetme penale, pra para krimit vazhdues pasi “ i pandehuri që në fillim kishte kristalizuar në ndërgjegjen e tij një mashtrim sa më të madh që të ishte i mundur pavarësisht nga numri i personave që u mashtruan” nuk është llogjik dhe i bazuar në ato elementë të anës objektive të kryerjes së veprës penale që vetë kjo gjykatë i pranon. Qëllimi në të cilin synon të arrijë autori i krimit, motivi apo shkak i përbashkët nga është nxitur ai në kryerjen e akteve të veçanta, nuk mund të çojnë në konkluzionin se këto akte duhet të bashkohen në një të vetëm.

Duke marrë parasysh sa më sipër, gjykata e apelit me të drejtë veprën e kryer nga ana e të pandehurit, lidhur me mashtrimin e kryer prej tij për 11 persona para se të hynte në fuqi Kodi i ri Penal, e ka cilësuar në bazë të nenit 104/2 të Kodit Penal të mëparshëm. Ndërsa për personat e mashtruar mbas hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, vepra e të pandehurit është kualifikuar në bazë të nenit 143 të Kodit Penal, aq herë sa ka qenë numri i personave të dëmtuar, të mashtruar prej tij. Në këtë aspekt nga kjo gjykatë, është respektuar drejtë përmbajtja e nenit 3, paragrafi i tretë i Kodit Penal në fuqi sipas të cilit, “kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale”. Interpretimi i kësaj dispozite të shpie në konkluzionin se nuk mund të jepet një dënim më i lartë për personin se sa dënimi që zbatohet për veprën penale në kohën që është kryer. Është detyrë e gjykatës që të shqyrtojë me kujdes dispozitat përkatëse, për të përcaktuar se cila është dispozita penale më e favorshme për personin. Kjo arrihet nga gjykata nëpërmjet vlerësimit të kujdesshëm të dispozitivit të dispozitës penale dhe krahasimit të minimumit e maksimumit të dënimit si dhe të dënimeve alternative të parashikuara nga secila dispozitë.

Përsa i përket çështjes në shqyrtim, duhet theksuar se në nenin 104/2 të Kodit Penal të mëparshëm, ishte parashikuar si rrethanë cilësuese kryerja e mashtrimit më shumë se një herë, pra përsëritja. Në këtë mënyrë, kryerja e veprës më shumë se një herë ishte pjesë përbërëse e figurës së krimit dhe shërbenin për cilësimin ligjor të tij. Madje në këtë rast nuk zbatohet dispozita e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal që parashikonte “rrethanat rënduese” sepse ato parashikoheshin në vetë ndërtimin e figurës së krimit të mashtrimit të kryer më shumë se një herë, siç është paragrafi i dytë i nenit 104 të këtij kodi. Pavarësisht se cili ishte numri i personave të mashtruar apo dhe koha e kryerjes së mashtrimit të tyre, vepra penale e kryer nga i pandehuri dënohet vetëm një herë në bazë të kësaj dispozite.

Ndërsa në Kodin Penal në fuqi, në ndryshim nga Kodi Penal i mëparshëm, në përgjithësi “kryerja e veprës më shumë se një herë”, apo “përsëritja” nuk parashikohen si elementë përbërës të veprës penale. Kështu, edhe neni 143 i këtij kodi që parashikon se “vjedhja e pasurisë me anë të gënjeshtres ose shpërdorimit të besimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”, nuk shprehet për kryerjen e kësaj veprë më shumë se një herë. Të njëjtin qëndrim mban kodi penal edhe për vepra penale të tjera më të rënda, si vrasja, vrasja me paramendim, vjedhja, vjedhja me dhunë, shkatërrimi i pronës, e të tjera. Kjo nuk ka kuptimin e zbutjes së ndëshkimit nga Kodi i ri Penal të veprave të kryera më shumë se një herë. Përmbajtja e Kodit të ri Penal, është se personi

fajtor do të përgjigjet penalisht për aq vepra penale që ai kryen. Sipas Kodit Penal të mësipërm (neni 31, germa “a” e Kodit Penal) me përsëritje kuptoheshin rastet e kryerjes nga personi më parë të një ose më shumë veprave penale, qofshin këto të njëllojta apo të llojeve të ndryshme, pavarësisht se ai kishte qenë ose jo i dënuar më parë dhe kur kjo (përsëritja) nuk ishte element përbërës i veprës penale. Në këtë rast, kur dispozita përkatëse nuk e parashikonte përsëritjen si element përbërës të figurës së krimit, vepra cilësohej si e kryer në rrethana rënduese, ndërsa kur dispozita penale e parashikonte përsëritjen si rrethanë cilësuese, nuk zbatoheshin rrethanat rënduese.

Bazuar në këto argumenta arrihet në përfundimin se ligji i kohës kur janë kryer 11 mashtrimet nga i pandehuri, pra neni 104/2 të Kodit Penal është dispozitë më e favorshme se dispozita e mëvonshme, që parashikon krimin e mashtrimit, mbasi siç u theksua, i pandehuri duhet të deklarohet fajtor dhe të dënohet për veprën penale të mashtrimit, aq herë sa ka qenë dhe numri i personave të mashtruar. Në këtë mënyrë për këtë person, duke u bërë caktimi i dënimeve për disa vepra penale në përputhje me nenin 55 të Kodit Penal, masa e dënimit e kalon atë të parashikuar në maksimum nga dispozita e mëparshme penale.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në rastet e mashtrimit të realizuar nga i pandehuri, shumat e parave të marra prej tij, rrethanat në të cilat kanë ndodhur krijimi i firmave piramidale, çmon se masa e dënimit të dhënë të pandehurit është në përputhje me rrezikshmërinë e tij shoqërore dhe të veprës së kryer.

Nga ky kolegji çmohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duhet të priset vetëm përsa i përket padisë civile në këtë proces penal, për arsye se janë lejuar shkelje të ligjit.

Gjykata ka zbatuar gabim ligjin procedural në trajtimin e padisë civile në procesin penal. Nga aktet rezulton se kjo padi është paraqitur para gjykatës së Apelit, e cila pasi e ka shqyrtuar atë ka konkluduar në bazueshmërinë e saj në prova e në ligj dhe ka detyruar të pandehurin, me cilësinë e të paditurit civil që të paguaj shumat e përfituara nëpërmjet veprës penale të mashtrimit.

Kjo padi është pranuar për t’u shqyrtuar prej gjykatës së Apelit pa patur parasysh nenin 62 të K. Pr. Penale. Sipas kësaj dispozite “ Legjitimimi i paditësit civil (në procesin penal) mund të bëhet nga organi procedues, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor”, dhe se “ ky afat nuk mund të zgjatet”. Ky rregullim është i qartë, ndërsa gjykata e Apelit ka vepruar në kundërshtim me këtë rregull pa sqaruar moszbatimin e tij. “ Mosfillimi i shqyrtimit gjyqësor “,sipas dispozitës së mësipërme i referohet “shqyrtimit gjyqësor” në tërësi, pra “mosfillimit të shqyrtimit gjyqësor” në gjykatën e shkallës së parë. Ky konkluzion buron nga vetë konceptimi i institutit procedural të “gjykimit të padisë civile në procesin penal”. Padia civile në rastin konkret nuk ka dallim nga “padia civile” sipas konceptimit nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Dallimi në këtë rast ka të bëjë vetëm me faktin se kjo padi civile, për shkak të specifikës se lidhet “me dëm material nga vepra penale” do të gjykohet nga gjykata penale së bashku me procedimin penal. Ky rregullim i veçantë nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit të padive civile nga gjykata civile duke vlerësuar oportunitetin e bashkimit të dy gjykimeve, të cilat kanë të përbashkëta palët, provat e nevojshme etj. Ky bashkim nuk mund të çënojë as procedimin penal dhe as atë civil. Të dy procedimet ruajnë karakteristikat e tyre të veçanta sipas dispozitave respektive që i rregullojnë por, për shkak të elementëve të përbashkët bashkohen në një procedim të përbashkët. Për rrjedhojë, siç shprehet edhe neni 62 i K. Pr. Penale, padia civile nuk mund të paraqitet në një fazë procedimi që nuk e parashikon K. Pr. Civile. Ky procedim nuk mund të fillojë në gjykatën e shkallës së dytë, siç ka vepruar gjykata e Apelit, pasi do të ndodheshim para cënimit të parimit të respektimit të shkallëve

të gjykimit civil të parashikuar në nenin 135 të Kushtetutës dhe të përshkruar hollësisht në ligjin procedural .

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të neneve 438, 441 të K. Pr. Penale dhe nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S Ë N

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 284 datë 26.06.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me deklarinin fajtor dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit Tom Lleshdedaj për veprën penale të mashtrimit.

2. Prishjen e vendimit nr. 284 datë 26.06.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me shqyrtimin e padisë civile të paditësave civile përfaqësuar prej Grupit Mbikqyrës kundër të paditurit civil Tom Lleshdedaj dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e rrethit Tiranë.

3. Një kopje e këtij vendimi unifikues të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 06.10.2000

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Agron Lamaj	Anetar
Artan Hoxha	“
Bashkim Caka	“
Metush Saraçi	“
Natasha Sheshi	“
Ylvi Myrtja	“
Vladimir Bineri	“
Valentina Kondili	“
Vangjel Kosta	“
Zamir Poda	“
Nikoleta Kita	“
Vladimir Metani	“

ne seancen gjyqesore te dates 08.12.1999 dhe 15.04.2000 mori ne shqyrtim ceshtjen penale nr.81 qe i perket:

KËRKUESIT: ARBEN HAMITI

OBJEKTI:

Shuarje e denimit per vepren penale te prodhimit dhe shitjes se lendeve narkotike dhe kalimit te paligjshem te kufirit, parashikuar nga nenet 283/1 dhe 297 te Kodit Penal.
Baza Ligjore: Neni 480 i Kodit Procedures Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarande, ne aplikim te Ligjit nr.8202 date 27.03.1997 “Per amnistine”, me vendimin nr.1 date 19.05.1999

Ka pranuar kerkesen e te denuarit Arben Hamiti per shuarjen e denimit, dhe ka urdheruar lirimine e tij te menjehershem.

Kunder vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarande, ka bere rekurs prokurori i cili parashtron si shkaqe per prishjen e tij si me poshte:

- Kerkuesi eshte denuar me nje vendim te nje gjykate te huaj dhe Gjykata e shkalles se pare Delvine, ka bere vetem njohjen e vendimit dhe konvertimin e denimit sipas ligjit Shqiptar.
- Ligji “Per amnistine ka hyre ne fuqi ne daten 05.04.1997 dhe ka patur fuqi vetem per veprat penale te kryera ne Shqiperi.

- Njohja e vendimit është bere ne muajin Qershor 1998 ne nje kohe qe ligji “Per amnistine” kishte perfunduar efektet e tij.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e anetarit Vladimir Metani, prokuroren Valentina Ahmetaj, e cila kerkoi prishjen e vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarande, si te pabazuar ne ligj dhe pasi biseduan çeshtjen ne teresi,

V Ë R E J N Ë

Vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarande, është rrezultat i zbatimit te gabuar te ligjit e per kete shkak ai duhet te priset.

Nga materjalet e ndodhura ne dosje rezulton se kerkuesi Arben Hamiti me vendimin nr.90, date 16.10.1996 te Gjykates se Diktimit Janine te Greqise, është denuar me 18 vjet dhe 6 muaj burgim, me gjobe 5 milion dhrami, privimin e te drejtave politike per 3 vjet dhe debimin e perjetshem te tij nga shteti Grek, pas vuajtjes se denimit per veprat penale te:

- a. “Zoterimit te lendeve narkotike”
- b. “Transportit te lendeve narkotike”
- c. “Importit te lendeve narkotike”
- d. “Shitjes se lendeve narkotike te mbetur ne tentative”
- e. “Hyrjes se paligjshme ne vend”

Kerkuesi, bazuar ne Konventen e Keshillit te Europes “Per transferimin e personave te denuar”, ratifikuar me Ligjin nr.8499, date 10.6.1999 dhe te Konventes dypaleshe te dates 17.5.1997 lidhur ndermjet Republikes se Shqiperise dhe asaj te Greqise, ka kerkuar te transferohet ne Shqiperi per te vuajtur denimin e caktuar nga autoritet gjyqesore Greke.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Delvine, ne zbatim te nenit 512 te K.Pr.Penale, me vendimin e saj, nr.9, Akti date 23.05.1998 ka bere njohjen e pjeseshme te vendimit nr.90 date 16.10.1996 te Gjykates se Diktimit Janine, si dhe ka caktuar perfundimisht denimin prej 13 vjet burgim, qe i denuari Arben Hamiti duhet te vazhdoje te vuaje ne shtetin shqiptar.

Kerkuesi Arben Hamiti ka qene duke vuajtur denimin e mesiperm ne burgun e Bençes ne Tepelene dhe ne daten 22.4.1999 i është drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarande, qe te vendose shuarjen e denimit te mbetur ne zbatim te nenit 480/II i K.Pr.Penale dhe paragrafit te pare te nenit 1 te ligjit nr.8202 date 27.03.1997, “Per amnistine” per veprat penale te parashikuara nga nenet 283/1 dhe 297 te K.Penal, per te cilat ai vuan denimin.

Ne perfundim te gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarande, me vendimin nr.1, date 19.5.199 ka pranuar kerkesen e te denuarit Arben Hamiti dhe ka urdheruar lirimin e tij nga vendi i vuajtjes se denimit.

Kolegji Penal i Gjykates se Larte, gjate shqyrtimit te rekursit te ushtruar nga prokurori kunder vendimit te mesiperm, duke qene ne dijeni te zgjidhjeve e qendrimeve te ndryshme mbajtur nga gjykatat e rretheve gjyqesore dhe te apelit per çeshtje te tjera te te njejtit karakter, me qellim per te njesuar dhe unifikuar praktiken gjyqesore, vendosi kalimin e çeshtjes per gjykim ne Kolegjet e Bashkuara te kesaj Gjykate.

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte duke e gjetur te pabazuar ne ligj Vendimin nr.1, date 19.5.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarande, vendosin unifikimin e praktikës gjyqesore lidhur me shtrirjen e ligjit penal shqiptar ne kohe dhe hapësire per shtetasit Shqiptar qe kryejne vepra penale jashte territorit te Republikës dhe per te cilat deklarohen fajtores me nje vendim te formes se prere te autoritetit gjyqesor te shtetit te huaj.

Per te arritur ne perfundimet e veta, Kolegjet e Bashkuara, marrin ne konsiderate dhe aplikojne dispozitat dhe frymen e Konventave te Keshillit te Europes ne fushen perkatese ne te cilat Shqiperia eshte pale, Konventen dy paleshe me shtetin Grek per transferimin e te denuarve te burgosur, dispozitat perkatese te K.Penal dhe te K.Pr.Penale si dhe Ligjin nr.8202 date 27.03.1997 “Per amnistine”.

Ndonese nuk eshte objekt i ketij gjykimi, Kolegjet e Bashkuara vene ne dukje se gjykata me rastin e njohjes se vendimit te Gjykates Greke, me te cilen eshte deklaruar fajtor dhe denuar Arben Hamiti, duhej te merrte ne konsiderate e te shprehej ne vendimin e saj edhe persa i perket faktit nese do te shtrinte ose jo efektet e tij Ligji nr.8202, date 27.03.1997 “Per amnistine”.

Sipas nenit 514 te K.Pr.Penale dhe te nenit 2 te Konventes Europiane “Per transferimin e personave te denuar”, nje nga kushtet per transferimin eshte denueshmeria e vepres si ne shtetin qe kerkohet transferimi, ashtu edhe ne shtetin ku zbatohet vendimi. Mbi kete baze, gjykata, ka patur detyrim ligjor per te arritur ne perfundime te shprehura me vendimin e saj dhe, duke mbajtur nje qendrim te qarte do te garantonte edhe marredheniet juridiksionale me shtetin grek.

Sipas dy Konventave kryesore te Keshillit te Europes ne kete fushe, asaj per vleren nderkombetar te gjykimeve penale e vitit 1970 dhe per transferimin e te denuarve me heqje lirie te vitit 1983, aplikimi i bashkepunimit ne drejtim te njohjes dhe ekzekutimit te vendimeve penale, realizohet nepermjet zgjerimit dhe ngushtimit ne te njejten kohe te juridiksioneve te autoriteteve gjyqesore te vendeve qe perfshihen ne nje veprimtari te tille. Qellimi qe ndjekin konventat, perkrahur edhe nga legjislacionet e shteteve pale ne to, eshte ekzekutimi i nje vendimi gjyqesor te huaj dhe rehabilitimi me i shpejte i personit te denuar ne vendin e tij te origjines.

Ky lloj bashkepunimi realizohet si per te gjithë shtetet pale ne keto konventa edhe per Shqiperine, ne dy drejtime:

- 1) Per shtetasin shqiptar qe ka kryer nje veper penale ne nje shtet tjetër, por ai ndodhet ne Shqiperi, nderkohe qe per te ka nje vendim te formes se prere denimi nga autoriteti gjyqesor i shtetit ku ka kryer vepren penale. Ne kete rast duke qene shtetas shqiptar dhe ne pamundesi per tu ekstraduar, gjykata shqiptare sipas procedurave qe parashikon K.Pr.Penale, njeh dhe ekzekuton vendimin e gjykates se huaj.
- 2) Per shtetasin shqiptar qe eshte duke vuajtur nje denim me heqje lirie te dhene e te vene ne ekzekutim ne nje vend tjetër dhe kerkohet transferimi i tij ne Shqiperi per vazhdimin e ekzekutimit te vendimit te autoritetit gjyqesor te huaj ne Shqiperi.

Sikurse shihet, ne te dy rastet kemi te bejme me nje vendim te autoritetit gjyqesor te shtetit te denimit, i cili njihet dhe vihet ne ekzekutim ne shtetin e ekzekutimit ne perputhje me procedurat e pranuar nga Konventat perkatese e te K.Pr.Penale.

Per efekt te njehsimit te praktikës gjyqesore, Kolegjet e Bashkuara pranojne se per te gjykuarin Arben Hamiti dhe ne cdo rast, vendimi i Gjykates Shqiptare nuk eshte nje vendim i ri. Per kete shkak, gjykata shqiptare nuk shqyrton çështjen ne themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e huaj. Ajo verifikon nese ekzistojne kushtet per njohjen e vendimit te huaj dhe duhet t’i pergjigjet atij vendimi me nje vendim qe konverton denimin e huaj me nje denim te parashikuar nga legjislacioni Shqiptar, duke percaktuar edhe dispozitat perkatese te cilat aplikohen. E rendesishme sipas Kolegjeve te Bashkuara eshte te evidentohet fakti se eshte vendimi i huaj ai qe vihet ne ekzekutim nepermjet nje vendimi njohes te gjykates Shqiptare. Pra nuk kemi te bejme me nje vendim te gjykates shqiptare qe vihet ne ekzekutim, por me nje vendim te nje gjykate te huaj qe ekzekutohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Kolegjet e Bashkuara pranojne faktin se transferimi i personave te denuar nga nje shtet i huaj, eshte nje zgjerim i juridiksionit te autoritetit gjyqesor te huaj ne Shqiperi, i cili perfundon mbas njohjes dhe ekzekutimit te tij ne Shqiperi.

Ne kuptim të Konventës Europiane për transferimin e personave të denuar, është e rëndësishme të evidentohet për sa më sipër se vendimi i autoritetit të huaj mund të ekzekutohet në një nga këto dy mënyra në shtetin e zbatimit:

a - nëpërmjet vazhdimit të ekzekutimit automatikisht të vendimit të dhënë nga autoriteti i huaj ose,

b - nëpërmjet një procedure konvertimi të këtij denimi, duke zëvendësuar sanksionet e dhëna nga shteti i huaj, me sanksione të parashikuara nga shteti i zbatimit.

Megjithatë, pamvaresisht nga mënyra e ekzekutimit, në çdo rast behet fjale për ekzekutimin e vendimit të dhënë nga shteti i denimit në atë të kërkuar dhe jo për një vendim të ri denimi, qoftë edhe kur ai njihet nëpërmjet konvertimit. Ky fakt ka rëndësi të sqarohet për të evituar keqkuptimet që mund të krijohen nën 2 i Ligjit nr.8499 datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Keshillit të Europës “Për transferimin e personave të denuar”, ku Shqipëria pranon zbatimin e vendimeve të huaja jo nëpërmjet aplikimit të drejtëpërdrejtë të tyre, por nëpërmjet konvertimit të denimit të huaj në një denim të bazuar në K.P. të Republikës së Shqipërisë. Edhe në këto rast, shteti shqiptar duke pranuar frymen e konventës, ka pranuar vetëm njerën nga mënyrat e ekzekutimit, pa ndryshuar asgjë nga përmbajtja e konventës.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin çështjes, përveç dispozitave të Konventës së Keshillit të Europës dhe të Konventës Bilaterale me Greqinë, Kodit të Pr. Penale dhe Ligjit nr.8202 datë 27.03.1997, “Për amnistinë”, merr në konsideratë edhe dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë përsa i përket zbatimit të dispozitave të tij në kohë dhe hapësirë.

Neni 6 i K.Penal, në paragrafin e dytë përcakton se: “Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njekohesisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj”. Pra, dispozita përcakton dy kushte për zbatimin në hapësirë të ligjit penal. Se pari, fakti të konsiderohet veprë penale nga legjislacioni i vendit ku është kryer dhe ai shqiptar dhe se dyti, për këto veprë të mos jete dhënë vendim i formës së prërë nga autoriteti gjyqësor i huaj.

Kolegjet e Bashkuara duke konsideruar këto kushte të lidhura e jo të shkeputura nga njëra tjetra, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, arrijnë në përfundimin se ligji penal shqiptar nuk shtrin efektet e tij ndaj shtetasve shqiptar që krvejnë veprë penale në territorin e një shteti tjetër, kur për këto veprë autoriteti gjyqësor i shtetit të huaj ka dhënë një vendim i cili ka marrë formë të prërë. Edhe në rastin eventual kur çështja penale ka filluar ajo duhet të pushohet duke zbatuar nën 328/1, germa “e” dhe “f” të K.Pr.Penale, pasi për të njëjten veprë penale ekziston një vendim gjyqësor i formës së prërë. Kjo garanci procedurale e parashikuar edhe në nën 7 të K.Pr.Penale, është shprehja dhe zberthimi i garancisë kushtetuese të njohur në nën 34 të saj, që duke përkrahur parimin e së Drejtës Romake “Non bis in idem”, përcakton se: “ Askush nuk mund të denohet me shumë se një herë për të njëjten veprë penale dhe as të gjykohet serish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjeve nga një gjykatë me e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj”.

Duke mbajtur qëndrimin e mesipërm, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin që Ligji nr.8202, datë 27.03.1997 “Për amnistinë”, nuk shtrin efektet e tij për shtetasit shqiptar që kanë kryer vepra penale jashtë territorit shqiptar dhe për të cilët janë denuar me një vendim përfundimtar nga autoriteti gjyqësor i huaj në kohën e hyrjes së tij në fuqi, as drejtëpërdrejtë, dhe as pas transferimit të tyre në Shqipëri.

Sipas këtij Ligji, përjashtohen nga ndjekja penale dhe vuajtja e metejshme e denimit të gjithë personat që kanë kryer veprat penale për të cilat ai ligj shprehet. Me ligjin nr.8268, datë 22.12.1997 është amenduar shtrirja në kohë e ligjit të mesipërm deri me datën 30.1.1998 për ata persona, të cilët paraqiteshin vullnetarisht përpara autoriteteve kompetente.

Kolegjet pranojne se ky ligj, doli ne nje shtete te caktuar qe u krijua ne Shqiperi ne vitin 1997, kur strukturat shtetore moren nje goditje te rende dhe burgjet Shqiptare u hapen fillimisht me force dhe me vone per arsye sigurie, shteti liroi te gjithë personat qe mbaheshin te paraburgosur ose te burgosur ne vuajtje te nje denimi te formes se prere.

Duke qene se kjo situata duhej te normalizohej me kalimin e periudhes se emergjences, nje nga masat e marra per kete ishte edhe miratimi i Ligjit "Per amnistine", i dates 27.03.1997 i cili kishte ne themel amnistimin e personave qe kishin kryer nje kategori te caktuar veprash penale dhe per personat e tjere, me kushtin e kthimit vullnetarisht ne vendet e vuajtjes se denimit, parashikonte uljen e denimit me burgim ne 1/3 e tij dhe mos aplikimin e denimit me burgim te perezjtshem.

Sqarimi i ketyre shkaqeve dhe rrethanave te dalies se ligjit "Per amnistine" kane rendesi te evidentohen per te kuptuar me drejte faktin e shtrirjes se efekteve ne territorin shqiptar, per vepra te kryera ne kete territor nga individe shqiptar ose te huaj, per nje shtete dhe periudhe te caktuar kohe.

Sipas arsytimit te mesiperem Kolegjet çmojne se Ligji per amnistin i vitit 1997 nuk shtrin efektet e tij ndaj kerkuesit si gjate kohes qe ndodhej ne territorin e shtetit grek, ashtu edhe kur ai eshte transferuar ne ekzekutim te vendimit te atij autoriteti per vazhdimin e ekzekutimit te denimit te huaj ne Shqiperi.

Nga ana tjetere eshte e vertete qe neni 12 i Konventes se Keshillit te Europes dhe neni 12 i Konventes bilaterale me Greqine parashikojne qe palet mund te japin falje, amnisti ose zevendesim te denimit ne perputhje me Kushtetuten dhe legjislacionet e tyre per te denuarit e transferuar, por ato kane parasysh situaten pasi eshte lejuar dhe ekzekutuar transferimi, apo kur amnistia a falja, jane shprehur edhe per subjekte qe ndodhen jashte territorit te vendit.

Nga ana tjetere eshte i rendesishem lidhur me ushtrimin sovranitetin dhe zbatueshmerine e Kushtetutes e ligjeve nga autoritetet shtetore brenda territorit te secilit shtet pale ne Konvente. Njekohesisht, eshte e rendesishme edhe per te garantuar standarte te njejta per mbrojtjen e te drejtave dhe lirive te personave qe ndiqen penalisht apo qe jane ne ekzekutim te vendimeve gjyqesore te formes se prere. Ne kete kuader edhe kerkuesi mund te perfitoje nga keto dispozita te Konventave dhe neni 480/II i K.Pr.Penale, qe nga koha qe eshte transferuar ne territorin shqiptar, por jo te perfitoje per kohen perpara transferimit, per te cilen ne rastin konkret nuk mund te aplikohet zbatimi i ligjit shqiptar per shkak te shtrirjes se kufizuar te tij ne hapesire.

Duke qene se Ligji nr.8202 date 27.03.1997 " Per amnistine", nuk i shtrin efektet per personat e transferuar per te vuajtur denimin e dhene nga autoriteti gjyqesor i huaj ne shtetin Shqiptar, kerkesa e te denuarit Arben Hamiti nuk duhej te pranohej dhe per kete shkak, vendimi i gjykates se shkalles se pare eshte i cenueshem.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte,mbeshtetur ne nenet 438, 441/c dhe 442 te K.Pr.Penale,

V E N D O S Ë N

1. Prishjen e vendimit nr.1 date 19.05.1999 te Gjykates se Rrethit Sarande dhe rrezimin e kerkeses te te denuarit Arben Hamiti.
2. Njoftohet per ekzekutimin e ketij vendimi Prokurori prane Gjykates se Larte per rivenien ne ekzekutim te vendimit nr.9 aktit date 23.05.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Delvine, i cili ka njohur dhe vene ne ekzekutim Vendimin nr.90, date 16.10.1996 te Gjykates se Diktimit Janine.

3. Ky vendim per njehsim te praktikes gjyqesore te dergohet per botim ne Fletoren Zyrtare.

Tirane, me 15.04.2000

MENDIM PAKICE

Lidhur me shqyrtimin e çeshties ne fjale dhe vendimin e marre ne Kolegjet e Bashkuara nga shumica, kemi mendim te kundert persa me poshte:

1. Rekursi i prokurorit te Prokurorise se Rrethit Sarande, nuk duhej te merrej ne shqyrtim nga Kolegjet e Bashkuara, mbasi ai nuk eshte paraqittir sipas rregullave te parashikuara ne Kodin e Procedures Penale.

Kunder vendimit, te Gjykates se Rrethit Sarande, prokurori ka bere rekurs te drejtperdrejte ne Gjykatën e Larte, pa u bere me pare, ankim ne Gjykatën e Apelit Gjirokaster, brenda afateve qe parashikon Kodi i Procedures Penale.

Ky detyrim, per paraqitjen e ankimit vetem ne Gjykatën e Apelit , del nga permbajtja e nenit 407, pika 3, te Kodit te Procedures Penale, ku percaktohen mjetet e ankimit dhe radhen e parasites se tyre ne organet gjyqesore kompetente.

Per te njejten gje flet dhe neni 417 i Kodit te Procedures Penale, i ciii, ne permbajtjen e tij, nenkupton se ankimi kunder vendimit te Gjykates se Rrethit behet vetem ne Gjykatën e Apelit.

Pervec sa u paraqit si argument qe ankimi duhej te ishte paraqitur ne Gjykatën e Apelit dhe jo ne Gjykatën e Larte, sherben dhe fakti se paleve ne proces, pra dhe prokurorit, Kodit i Procedures Penale ju njeht te drejten, per t'iu drejtuar drejtpersedrejti Gjykates se Larte me rekurs vetem per raste te vecanta te cilat parashikohen ne nenin 431 te ketij kodi, si dhe ne raste te tjera kur kjo e drejte eshte e parashikuar ne ligje.

Duke qene se rasti ne shqyrtim nuk eshte nga ato qe parashikon neni 431 i Kodit te Procedures Penale, si dhe duke patur parasysh se per rastin ne fjale nuk ka rregullim te vecante te parashikuar ne ndonje ligj, kemi mendimin se rekursi i Prokurorit te Rrethit Sarande, ne baze te nenit 433 te Kodit te Procedures Penale duhej te mospranohej.

2 - Vendimi i Gjykates se Rrethit Sarande, qe ka vendosur pranimin e kerkeses se te denuarit per perjashtimin nga vuajtja e metejsjme e denimit, eshte i drejte dhe i bazuar ne ligje.

Transferimi i te denuarit ne fjale, ashtu sikurse pranon dhe shumica, eshte realizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe marreveshjen, midis qeverise shqiptare dhe asaj greke.

Legjislacioni shqiptar, qofte ne drejtim te te drejtave qofte ne drejtim te detyrimeve, te denuarin nga gjykuata e huaj shtetas shqiptar, te transferuar ne Shqiperi, e trajton njesoj, pa asnje diferencim, me te denuarit nga gjykatat shqiptare.

I gjithë legjislacioni shqiptar, i dale perpara transferimit te denuarit ashtu dhe mbas transferimit te tij, nuk parashikon asnje kufizim ne trajtimin e te. denuarve, te cilet vuajne denimin ne Shqiperi.

Ne kete kuptim, dhe ligji shqiptar " Per Amnistine ", ne kushtet kur plotesohen kriteret e percaktuara prej tij, nuk perjashton nga e drejta per te perfituar nga mosvuajtja e metejsjme e denimit te denuarin nga gjykata e huaj te transferuar ne Shqiperi.

Duke patur parasysh sa u paraqit, jemi te nje mendimi me shumicen per faktin se si i gjithë legjislacioni shqiptar dhe ligji "Per Amnistine" i shtrin efektet e tij vetem ne territorin e Shqiperise. Ne kete kuptim, ligji "Per Amnistine", duke mos permendur asnje kufizim, i shtrin efektet e tij mbi cdo te denuar qe vuan denimin ne Shqiperi, pra dhe mbi te denuarin e transferuar, nga nje shtet i huaj.

Arsyetimi i shumices se ndaj te denuarit te transferuar ligji "Per Amnistine" nuk mund te zbatohet, mbasi ai ne kohen e daljes se saj ka qene duke vuajtur denimin ne shtetin tjetër dhe se perfitimi nga ky ligj, kur i deriuari eshte ne Shqiperi, behet vetem ne afate te caktuara eshte i gabuar dhe pa mbeshtetje ligjore.

Eshte e vertete se ne shtetin denues , i denuari shtetas shqiptar nuk mund te perfitoje nga ligji "Per Amnistine" dhe kjo per faktin se ligji penal shqiptar i shtrin efektet e tij vetem ne territorin e Republikes se Shqiperise (neni, 5 i Kodit Penal).

Megjithate, duke qene ne shtetin ekzekutues, ne Shqiperi, i denuari i transferuar per te vuajtur denimin e metejshem, pavaresisht se ligji "Per Amnistine" ka pase dale kohe me pare, nuk mund te kufizohet nga e drejta qe atij dhe te denuarve te tjere, ju njeh ky ligj.

Ligji "Per Amnistine" dihet se eshte ligj penal dhe ne kete kuptim detyrimi qe sjell neni 29, pika 3, e Kushtetutes, se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese, per rastin ne shqyrtim eshte i detyrueshem per tu zbatuar. Si kushtetuta ashtu dhe vete ligji "Per Amnistine" nuk percaktojne afatet kufizuese per zbatimin e tij. Afati qe parashikohet ne ligjin nr.8268, date 22.12,1997, nuk ka te beje me te denuarit qe perfitojne nga amnistia por me personat qe kane kryer vepra penale, te cilet sipas ligjit "Per Amnistine", nuk jane amnistuar persa i perket ndjekjes apo denimit penal.

Si argument tjetër se ligji "Per Amnistine" aplikohet dhe per te denuarin e transferuar nga nje shtet i huaj, flet dhe Konventa midis Republikes se Shqiperise dhe Republikes se Greqise per transferimin e te denuarve te burgosur, ne nenin 7 te saj.

Neni 7, germa a, i kesaj konvente, shprehet se: Transferimi mund te refuzohet kur autoritetet kompetente te shtetit ekzistues kane vendosur te mosfillojne ndjekjen penale ose tu japin fund atyre, per te njejtet fakte".

Siç del nga permbajtja e kesaj dispozite, te dy palet nenshkruese te konventes, kane pranuar faktin se ne shtetin ekzekutues (Shqiperi), perpara realizimit te transferimit te nje te denuari, mund te ekzistojne kushte te vendosura nga organet kompetente (Kuvendi), te cilat e perjashtojne ate nga ndjekja penale ose nga vuajtja e metejshme e denimit kur behet fjale per te njejtat fakte (te njejtat ngjarje), te cilesuara nga te dy shtetet perkatese, si vepra penale.

Duke interpretuar rastin ne shqyrtim, del se te dy shtetet, palet ne marreveshje, kane pranuar se ne Shqiperi, perpara realizimit te transferimit, te te denuarit mund te ndodhen dhe perpara faktit te nje amnistie te dhene dhe ne keto kushte duke njohur te drejten e zbatimit te ligjit Shqiptar, ne territorin e Shqiperise, pra dhe te drejten e te denuarit per te perfituar nga amnistia, shteti Grek ka rezervuar te drejten per te vendosur per miratimin ose ajo te transferimit te kerkuar.

Per rastin ne shqyrtim, shteti Grek, megjithese e ka patur parasysh ekzistencen e ligjit "Per Amnistine" dhe te drejten e te denuarit per te perfituar nga ky ligj, ka miratuar dhe lejuar transferimin e tij ne Shqiperi.

Ne kushtet e mospasjes se asnje pengese ligjore, mos zbatimi per te denuarin ne fjale te ligjit "Per Amnistine", passjell kufizime te te drejtave te tij kushtetuese, duke e vene ate ne pozite te pabarabarta perpara ligjit me te denuarit e tjere, pra te diskriminuar, duke shkelur keshtu nenet 18, pika 1, 16, 17, pika 1, etj. te Kushtetutes se Shqiperise.

Vladimir Bineri

Ylvi Myrtja

Bashkim Caka

Nr.157 i Regj. Themeltar
Nr.354 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara te Gjykares se Larte te perbere nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Vladimir Metani	Anetar
Agron Lamaj	“
Artan Hoxha	“
Vitore Tusha	“
Nikoleta Kita	“
Natasha Sheshi	“
Vladimir Bineri	“
Vangjel Kosta	“
Ylvi Myrtja	“
Tefta Zaka	“
Bashkim Caka	“
Metush Saraçi	“
ZamirPoda	“

ne seacen gjyqesore te dates 28.7.1999, mori ne shqyrtim ceshtjen penale nr.157, qe i perket:

TE PANDEHURIT: ADRIATIK GJATA

A K U Z A:

Dezertim dhe shperdorim armatimi,
nenet 94/2 dhe 62/2 te K.P.U.

Gjykata Ushtarake Korce me vendimin nr.23, date 18.12.1998, ka vendosur:

Deklarimin fajtor per te pandehurin Adriatik Gjata per vepren penale te dezertimit te kuadrit ushtarak ne kohe te gjendjes se jashtezakoneshme sipas nenit 34/2 te K.P.U. dhe e ka denuar me 5 vjet burgim.

Deklarimin fajtor te tij per vepren penale te shperdorimit te armatimit ne te njejtat kushte, neni 62/2 i K.P.U. duke e denuar me 5 vjet burgim. Ne bashkim te denimit sipas nenit 55 te Kodit Penal e ka denuar perfundimisht me 5 vjet burgim.

Mbi ankimin e mbrojtetit te caktuar kryesisht te te pandehurit te deklaruar dhe gjykuar ne mungese, Gjykata Ushtarake e Apelit Tirane me vendimin N.122, date 22.3.1999,

Ka prishur vendimin e mesiperm dhe ka pushuar gjykimin per te dyja veprat, me arsyetimin se ato jane amnistuar sipas ligjit nr.8202, date 27.03.1997 "Per Amnistine".

Kunder vendimit te gjykares se apelit eshte ushtruar rekurs nga prokurori ushtarak i apelit, i cili parashton se:

- Vendimi është i kundershtueshëm përse i përket pushimit të gjyqimit për krimin e shpërdorimit të armatimit pasi ai ka vazhduar edhe pas përfundimit të efekteve të ligjit për amnistinë dhe gjykata e ka aplikuar gabim atë, ndërkohë që pranohet i drejtë në rekurs pushimi i gjyqimit për krimin dezertimit. Shkak tjetër i ngritur për prishjen e vendimit të apelit është moslegjitimiti i mbrojtës të caktuar kryesisht për të ankimuar vendimin në apel, duke ju referuar për këtë nenin 410/2 të K.P.P.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi degjuan relacionin e anetarit Vladimir Metani, prokurorin që kërkojë prishjen e vendimit dhe pasi shqyrtuan çështjen në teresi,

V Ë R E J N Ë

Vendimi nr.12, datë 22.3.1999 i Gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë, është rriedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit e për këtë shkak duhet të prishet.

Gjykimi në shkallë të parë i çështjes rezulton se është bërë pa praninë e të pandehurit, i cili është deklaruar me parë nga ajo gjykatë, si person që nuk gjendet.

Sipas neneve 141 dhe 351 të Kodit të Procedurës Penale, procedohet me gjykimin në mungesë, atëherë kur mungesa është deklaruar me vendim të gjykatës për shkak të mosgjatjes, largimit vullnetar, apo fshehjes së të pandehurit. Në të gjitha rastet e deklarimit të mungesës, autoriteti i procedurës detyrohet t'i caktojë të pandehurit mbrojtës kryesisht atëherë kur nuk ka mbrojtës të zgjedhur ose të pranuar prej tij. Që nga ky moment, të gjitha njoftimet e organit të procedurës për të pandehurin i komunikohen mbrojtës të caktuar i cili përfaqëson të pandehurin gjatë hetimit paraprak dhe në gjykimin në shkallë të parë.

Në veshtrim të nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale, njoftimi i të pandehurit të gjykuar në mungesë për shkak se nuk gjendet apo të deklaruar në mungesë, respektivisht neni 141 dhe 351 i K.P.P, sipas rradhës bëhet në banesën e tij, vendin e punës, vendbanimin e perkohshëm, ose në vendin ku qëndron me shpesh, duke i dorëzuar aktin personave që bashkëjetojnë me të, fqinjët ose një personi që punon me të pandehurin.

Kur njoftimi nuk mund të realizohet në këtë mënyrë, atëherë akti që do të njoftohet, që në rastin konkret është vendimi i gjykatës në shkallë të parë, depozitohet në njësinë administrative të vendit ku banon ose punon i pandehuri. Lajmerimi i depozitimit, afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose në vendin e tij të punës. Ndërsa në rastin e të pandehurit që i fshihet ndjekjes penale, ligji parashikon njoftimin e tij nepermjet dorëzimit të aktit që njoftohet, mbrojtës të tij dhe kur nuk ka të tillë, nepermjet mbrojtës të caktuar kryesisht.

Kryerja e të gjitha kërkesave ligjore lidhur me njoftimin e të pandehurit që procedohet e gjykohet në mungesë, presupozon se i pandehuri ka marrë njoftim për çështjen penale që ka në ngarkim apo për vendimin e gjykatës lidhur me të. Duke u konsideruar ligjërisht i njoftuar për vendimin e dhënë në mungesë, të pandehurit i fillon edhe përlogaritja e afateve të ushtrimit të të drejtës së ankimit ndaj vendimit, që nga dita e njoftimit. Kalimi i ketyre afateve pa u ushtruar e drejta e ankimit, i jep vendimit formë të prerë, i cili në rastin e mungesës ankimohet vetëm në kushte të caktuara ligjore.

Sipas dispozitave të K.P.P. i pandehuri që nuk është i mitur ose me të meta fizike e psikike që e pengojnë të bëjë vetë mbrojtjen, ka të drejtë t'i drejtohet organit të procedurës vetë ose nepermjet mbrojtës të zgjedhur apo të pranuar prej tij. Në nenin 407 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohen rastet dhe mjetet e ankimit. E drejta e ankimit sipas paragrafit të tretë, i takon vetëm atij që ligji ja njeh shprehimisht, dhe kur ai nuk bën dallim ndërmjet paleve, kjo e drejtë i takon seciles prej tyre. Në harmoni me këtë vlerësohet edhe përcaktimi i nenit 50/1 të K.P.P., sipas se

cilit, mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen atij personalisht. Ligji procedural penal njeh një sërë të drejtash ekskluzive për të pandehurin, si e drejta për të zgjedhur ose pranuar mbrojtës, pranimit ose jo i vepres që i atribuohet, e drejta për të dhënë shpjegime, e drejta për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatës, etj.

Sa me sipër gjen shprehje edhe në nenin 410/1 të K.P.P. kur përcaktohet se kundër vendimit gjyqësor i pandehuri mund të bëjë ankim vetë, ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Ndërsa, në rastin e gjykimit në mungesë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, kur i pandehuri nuk e ushtron vetë të drejtën e ankimit, këtë të drejtë ligji ja njeh vetëm mbrojtësit të autorizuar posaçërisht për ushtrimin e saj. Autorizimi kërkohet të jetë "një akt përfaqësues i leshuar në format e kerkuara nga ligji". Për ky akt, duhet të leshohet personalisht nga vetë i pandehuri, vullneti i të cilit vërtetohet sipas rastiit nga noteri ose organi që njeh ligji, dhe në të duhet të delegohet shprehimisht e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor. Në gjykimin e ceshtjes, i pandehuri Adriatik Gjata pasi është deklaruar në mungesë, është përfaqësuar me një mbrojtës të caktuar kryesisht nga organi procedural dhe jo nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij.

Aplikimi i kesaj të drejte se ankimit kundër vendimit të gjykatës se shkallës së parë prej mbrojtësit të caktuar kryesisht nga organi procedural, sikurse është pranuar në gjykimin e të pandehurit Adriatik Gjata, mohon të drejtën e të pandehurit për të ushtruar ose jo ankim ndaj vendimit të gjykatës, mbrojtësi që ka bërë ankimin, nuk është zgjedhur apo pranuar prej tij. Mbrojtja kryesisht, presupozon garantimin e një procedimi dhe gjykimi të drejtë, respektimin e të drejtave dhe lirive të të pandehurit në procesin penal, por kursesi, disponimin të resor mbi të drejtat që atij i njeh ligji. Vetëm në rastin kur një i pandehur është nën kujdestari, ligji parashikon që kujdestari ka të drejtë të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit, ndërsa në rastet e tjera, askush nuk mund të legjitimohet, pa patur pelqimin e të pandehurit.

Kolegjet e Bashkuara çojnë se në gjykimin në shkallë të parë, për shkak të garantimit të të drejtave të pandehurit në procesin penal, mbrojtësi i caktuar kryesisht merr të gjitha atributet e të pandehurit që gjykohet në mungesë dhe legjitimohet për të berjen e kërkesave dhe kundërshtimeve që lidhen me ato faze gjykimi. Me dhenien e vendimit, mbrojtësi perfundon se çeni pale në gjykim e për pasoje, nuk gëzon me të drejtat që ligji ju njeh paleve në procesin penal. Ushtrimi i ankimit në gjykatën e Apelit nga mbrojtësi i të gjykuarit Adriatik Gjata, është bërë në kapërcim të të drejtave që i njeh ligji në këtë fazë të procedimit.

Nga ana tjetër të pandehurit të deklaruar në mungesë sipas nenit 351 të K.P.P. nuk i mohohet e drejta për të ankuar një vendim të dhënë ndaj tij, por kjo duhet të aplikohet në formën e parashikuar me këtë rast nga dispozitat proceduralë. Ai ka të drejtë, mbështetur në nenin 147/2, të K.P.P. të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim, kur vërteton se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dhënë, dhe mbasi t'i jetë njohur kjo e drejtë, ai mund të bëjë ankim kundër vendimit, sipas rastiit, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë.

Kolegjet e Bashkuara çojnë se gjykimi i ceshtjes nga Gjykata Ushtarake e Apelit Tirane me ankim të mbrojtësit të caktuar kryesisht, jo vetëm është i kundërligjshëm, por mohon edhe të drejtën e të pandehurit që të ushtrojë vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të besuar prej tij, të drejtat që i njihen me ligj. Ajo, në gjykimin e ceshtjes, duhet të zbatonte nenin 420/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe të vendoste mospranimin e ankimit, për shkak se mbrojtësi nuk legjitimohet në berjen e ankimit.

Shkaku i paraqitur në rekursin e prokurorit lidhur me moslegjitimin e berjes së ankimit nga ana e mbrojtësit të caktuar për gjykimin në apel, sikurse u pranua me lart, çmohet se është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ndërkohe, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.47 të datës 28.01.1999, kanë unifikuar praktiken gjyqësore dhe kanë njohur të drejtën e mbrojtësit të caktuar kryesisht për të ankuar vendimet e dhëna në mungesë të të pandehurit. Ky vendim çmohet jo i

drejte, dhe praktika gjyqesore duhet te ndryshohet, jo vetem per faktin se keshtu mohohen te drejtat e te pandehurit ne procesin penal, por edhe sepse njohja e kesaj te drejte mbrojtetit te caktuar, deformon dhe krijon anomali ne vete procesin penal.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte, mbeshtetur ne nenin 141/2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe ne nenin 441, germa "c" te Kodit te Procedures Penale,

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit nr.12, date 22.3.1999 te Gjykates Ushtarake te Apelit Tirane dhe pushimin e gjykimit ne Gjykatën e Larte.

Unifikimin e praktikës gjyqesore sipas arsytimit te mesiperm.

Tirane, me 28.7.1999

**Nr. 134/19 i Regj. Themeltar
Nr. 30 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara te Gjykares se Larte te perbere nga:

Avni Shehu	Kryesues
Agim Shkupi	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloci	”
Agim Gjoleka	“
Metush Saraci	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	”
Bashkim Caka	“
Tefta Zaka	“

ne seancen gjyqesore te dates 28.1.1999 mori ne shqyrtim ceshtjen penale nr. 134/19 qe i perket:

TË PANDEHURIT **BLEDAR HOXHA** mbrojtur nga
avokat Adem Klari

A K U Z A

Vrasje me dashje, ne tentative dhe armembajtje pa leje.
Nenet 76, 76-22, dhe 278/2 te Kodit Penal.

Gjykata e rrethit Durres me vendimin nr.73 date 24.4.1998 ka vendosur:

Deklarimin fajtor te te pandehurit Bledar Hoxha per krimin e vrasjes me dashje indirekte te shtetasit Ervin Maliqi, per vrasje me dashje ne tentative, armembajtje pa leje dhe ne baze te neneve 76, 76-22, 278/2, 55/2 dhe 51 te Kodit Penal e denon perfundimisht me 10 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durres me vendimin Nr. 58 date 19.6.1998 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit te bere nga avokat Adem Klari.

Kunder vendimit te gjykares se Apelit ka bere rekurs avokati i te pandehurit Adem Klari duke parashtruar keto shkaqe:

- Vendimi eshte i gabuar.
- Si avokat i caktuar kryesisht nga gjykata une kam marre pjese ne dy shkallet e gjykimit.
- Nuk kerkohet te kemi akt perfaqesimi sipas nenit 410/2 te Kodit Procedures Penale sepse i pandehuri eshte i mitur dhe jam avokat i te pandehurit me nje vendim gjykate.

KOLEGJET E BASHKUARA TE GJYKATES SE LARTE

te angazhuara me vendimin Nr. s'ka, date 9.12.1998 per unifikim te praktikes pasi degjuan relacionin perkates, prokurorin Arqile Lole qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit te gjykates apelit Durres, avokatin Adem Klari qe kerkoi prishjen e vendimit te gjykates se apelit dhe pasi bisedoi ceshtjen ne teresi,

VEREJNE

Me vendimin nr. 73 date 24.4.1998 te Gjykates se rrethit Durres i pandehuri Bledar Hoxha, ne mungese, eshte deklaruar fajtor dhe denuar per vepren penale te vrasjes dhe ne tentative dhe armembajtje pa leje.

Kunder ketij vendimi ka bere apel avokati i te pandehurit te mitur dhe te caktuar kryesisht nga gjykata e rrethit.

Gjykata e apelit Durres nuk ka shqyrtuar ankimin dhe ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se avokati nuk eshte i pajisur me akt perfaqesimi, siç kerkon neni 410/2 i Kodit Pr. Penale.

Kolegjet e Bashkuara te investuara nga vendimi i Kolegjit Penal Nr. s'ka date 9.12.1998, mbeshtetur ne nenin 9 te ligjit Nr. 8362 date 1.7.1998 gjejne me vend te dalin me nje vendim unifikues lidhur me zbatimin e kerkesave te nenit 410/2 te Kodit Pr. Penale, per te pandehurin e mitur, ne mungese, te perfaqesuar nga mbrojtessi i caktuar kryesisht.

Ndryshe nga ç'arsyeton gjykata e apelit Durres ne rastin ne gjykim perderisa organi procedues dhe gjykata ne te gjitha fazat, te pandehurit te mitur, ne mungese i kane caktuar kryesisht me vendim, avokatin mbrojtës Adem Klari. Duke u caktuar avokati si perfaqesues i te pandehurit me vendim te gjykates nuk eshte e nevojshme qe ai te pajiset me akt perfaqesimi tjeter nga vete i pandehuri apo te afermit per te apeluar vendimin e denimit te tij nga gjykata e shkalles se pare.

Te pandehurit te mitur dhe aq me teper ne mungese, garancia e siperme buron dhe nga nenet 1 dhe 6 te Kodit Pr. Penale dhe Nr. 17, 28 dhe 31 te Kushtetutes, te cilat jane ne perputhje dhe me Konventen Europjane per te Drejtat e te Miturve.

Detyrimi ligjor i parashikuar nga neni 410/2 i Kodit Pr. Penale qe kunder vendimit te dhene ne mungese, mbrojtessi mund te bej ankim vetem kur eshte i pajisur me nje akt perfaqesimi; duhet te kuptohet per mungesen dhe largimin e vullnetshem te pandehurit, te parashikuar nga neni 352 te Kodit Pr. Penale.

Nisur nga keto vendimi i Gjykates se Apelit Durres per mospranimin e ankimit te avokatit te pandehurit Bledar Hoxha, duhet te priset si i pambeshtetur ne ligj dhe ceshtja te dergohet per shqyrtim ne po ate gjykate me tjeter trup gjykues sipas neneve 425 e vijues te Kodit Pr. Penale.

PER KETO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte mbeshtetur ne nenin 441/ç te K.Pr.Civile

VENDOSËN

Prishjen e vendimit Nr. 58 date 19.6.1998 te Gjykates se Apelit Durres dhe dergimin e akteve per shqyrtim ne po ate gjykate me tjeter trup gjykues.

Ky vendim eshte unifikues.

Tirane, me 28.01.1999